Xhafer Durmishi

SKENDER

VEPRA
8

FAKTE PËR LËVIZJEN E JUSUF GËRVALLËS

BYTYÇËT E BOTËS
Letra nga Xhafer Durmishi
Letra nga Faridin Tafallari
Letra nga Sabri Novosella
Letra të Partisë Komuniste
(PKMLSHJ) 1982-1985
Letra nga Hafiz Gagica
Letra nga Haxhi Berisha
Letra nga Xhafer Shatri
Letra nga Ibrahim Kelmendi
Big Brother-i i vitit 1984
Big Brother-i i vitit 1985
Komunikim mendimesh, të kërkuara nga Sabri Novosella,

gjatë muajit shkurt 2012
Zëri i Jusuf Gërvallës për Pararojën

Këto letra kanë të bëjnë, me disa përjashtime, me dy vitet e para pas atentatit të 17 janarit 1982, në pragun e shtëpisë së Vëllezërve Gërvalla në Untergruppenbach. Pseudonimet e personave që më së shumti hasen në këto letra janë:

Sabri Novosella=Mërgimi e në ndonjë rast Kameri
Xhafer Shatri = Lleshi, Uka, Xhema
Ibrahim Kelmendi = inicialet IK, Iljazi, Shoku
Xhafer Durmishi = Shpendi, Skenderi, Salihu, Gj.,
Abdullah Prapashtica=Kushtrim Kosova
Osman Osmani=Halimi dhe Nexhati
Faton Topalli=Qemajli

Vlen të potencohet se Ibrahim Kelmendi, të gjitha letrat e periudhës 14 prill 1983 - 19 mars 1984, që janë parashtruar në këtë përmbledhje, ia dërgon Forumit që është quajtur Qendra Ekzekutive (QE).

Ndërtesa ku ka banuar Faridin Tafallari në vitet 1980-të, në Haiterbacherstr.75, 7270 Nagold, në të cilën pas 17 janarit 1982, u bartën materialet kryesore që ishin në shtëpinë e Vëllezërve Gërvalla.

Aktivitet i dendur nga kjo shtëpi u zhvillua sidomos pas janarit 1982. Të gjitha letrat në këtë përmbledhje, me disa përjashtime, kanë kaluar nëpër këtë shtëpi dhe janë ruajtur brenda mureve e nën kulmin e saj për shumë vite. Faridinin e falenderoj për kujdesin dhe dërgimin e shumë letrave edhe gjatë këtij viti, duke mundësuar kështu që kjo vepër të dalë sa më e plotë.

BYTYÇËT E BOTËS

1. Letër nga Pajazit Ibrahimi (Australi), 24 shkurt 1982
2. Letër për Pajazit Ibrahimin, 7 mars 1982
3. Letër nga Sejdi Bytyçi (New York), 23 prill 1982
4. Letër nga Rilind Bytyçi për "Komitetin Vëllezërit Gërvalla" 17 maj 1982
5. Letër nga Rilind Bytyçi, 1 qershor 1982
6. Letër nga Rilind Bytyçi, 2 qershor 1982
7. Letër nga Sejdi Bytyçi, 7 qershor 1982
8. Letër nga Rilind Bytyçi, 17 qershor 1982
9. Letër nga Sejdi Bytyçi, 24 qershor 1982
10. Fjalimi i Rilind Bytyçit në Demonstratën e Sydneut më 26 qershor 1982
11. Letër nga Pajazit Ibrahimi, 5 shtator 1982
12. Letër nga Rilind Bytyçi, 17 nëntor 1982
13. Letër nga Sejdi Bytyçi, 22 nëntor 1982

Të gjitha letrat e mëposhtme janë dërguar për mua Xhafer Durmishin, apo të dërguara meje.

1. Letër nga Pajazit Ibrahimi (Australi), 24 shkurt 1982

Pajazit Ibrahimi (Australi)*: "I nderuar bashk-Atdhetar - Skënder!*

Letrën e juaj, bashkë me katër revista i mora. Pra ju lumtë Vëlla i dashur, që tue ju falëmenderua shumë, më ju thënë të drejtën, meqë isha tepër i demoralizuar, mbi çështjet mizore që po ndodhin në Atdheun tonë, dhe lajmet na vinë me vonesë, ngase gjendemi shumë larg Vendlindjes, pra letrat dhe revistat tuaja na gëzuan pa masë, dhe mi qetësuan nervat. Dhe kjo se çka po ndodhë me Vëllezërit dhe Motrat tona në Atdhe, por më gëzon Lufta që bëjnë, dhe njëkohësisht edhe veprat e punëtorëve tanë në Perëndim. Ju lumtë Vëllezër, se Revolucioni dhe Patriotizmi atë rrugë e ka, dhe le të jetë e lavdishme çdo vepër, e çdo një kosovari trim që sakrifikon gjakun dhe jetën e vet për Atdheun tonë Kosovën trime, që me shekuj e sunduan ...

Vrasja e tre Patriotëve që ndodhi në Gjermani, të dy Vëllezërve Gërvalla dhe një Kosovari tjetër, është humbje e madhe për Atdheun dhe për Popullin tonë, e posaçërisht për familjen Gërvalla. Oh mizori! Qe armiku po na sundon në Vatrën tonë, dhe ajo më e keqja nuk po na lenë në qetësi edhe jashtë kufirit. Por ... pushtuesve dhe tradhtarëve nuk po u shohin sytë se është çuar në këmbë për çlirimin e vendit dhe do të luftojnë deri në pikën e fundit. ...

Këtu në Australi, megjithëse gjendet një numër kogja i madh shqiptarësh, por megjithate disa janë të shitur e disa janë frigacak. Edhe këtu ekziston një grup atdhetarësh, që nuk kursejnë asgjë dhe punojnë për mbrojtjen e Atdheut. Për të ju informuar më mirë, qe urdhëroni një prej revistave, që botohen nga kjo Shoqëri Revolucionare. ...

Megjithëse e kam kuptuar pak se kush jeni, por në të ardhmen ju lutem më shkruani me jeni të vërtetë. ...

Në përfundim, i dërgoj ngushëllimet e mia Familjes Gërvalla dhe shumë të fala juve dhe mbarë Atdhetarëve në Gjermani.

RROFTË KOSOVA E LIRË!" (Letër Xhafer Durmishit, 24 shkurt 1982)

2. Letër për Pajazit Ibrahimin, 7 mars 1982

Pajazit Ibrahimit në Australi 7 mars 1982

Shoku Pajazit,

Përgjigjen në letrën time e mora nga shoku prej të cilit ta kam dërguar. Unë jam në banesën e Familjes Gërvalla. Mirëpo shkrimi i letrave me adresë të kësaj familje nuk është i mirë sepse nganjëherë letrat po vijnë të çelura.

Revistat me sa e kuptova u paskan pëlqyer dhe për këtë jemi të gëzuar. Edhe ne na erdhi mjaft mirë që kishit dërguar ata ekzemplarë të numrit 16 të gazetës së Shoqërisë "Bajram Curri." Herave tjera na dërgoni më tepër, sepse ndikojnë mirë tek punëtorët në Perëndim, të cilët janë të shumtë dhe që shkojnë shpesh në Atdhe.

Në fillim po të prezantohem me të vërtetë se kush jam.

Unë jam Xhafer Durmishi, nga Stanovci i Poshtëm, një fshat afër Vushtrrisë. Vëllau im i madh quhet Xhevat, është student i mjekësisë dhe është shok i ngushtë i vëllaut tënd Nexhatit. Në qershor të vitit 1981 u largova pasi e ndieja veten të rrezikuar nga fushata e burgosjeve. Unë në Kosovë kam qenë anëtarë i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi. Kur dola jashtë, përmes lidhjeve me shokë jashtë atdheut mora kontakt me Jusuf Gërvallën, një nga udhëheqësit me rëndësi të Lëvizjes.

Për punën dhe aktivitetin e Lëvizjes do të informohemi edhe në letrat tjera. Verën e vitit të kaluar isha pak ditë tek Nexhati në Chur. Aty ai ma tregoi një letër tuajën në të cilën ju flitshi për disa shqiptarë të Zvicrës, anëtar të "Frontit të kuq". Atë organizatë e kemi kuptuar, e udhëheqë një Ibrahim Kelmendi nga fshati Vuthaj, tani i shpërngulur në një fshat afër Pejës. Me ardhjen e Jusuf Gërvallës në Gjermani ai njoftohet edhe me Ibrahim Kelmendin, të cilit i ndihmon dhe ia nxjerrë tre numra të gazetës së "Frontit të Kuq" me emrin "Bashkimi".

Jusufi, anëtar i LNÇKVSHJ pra e ka ndihmuar dhe popullarizuar në masën më të madhe "Frontin e Kuq". Prej janarit 1981 Jusufi nuk i ndihmon më Ibrahim Kelmendit në nxjerrjen e gazetës "Bashkimi" për disa shkaqe.

Në organizimin e demonstratave të punëtorëve në Perëndim, krahas Lëvizjes e cila ka bërë shtypjen e thirrjeve me teknikën e saj kanë ndihmuar dhe marrë pjesë Organizata e Marksist - Leninistëve të Kosovës të cilën jashtë Atdheut e ka udhëheqë Kadri Zeka, i cili u vra në mbrëmjen e 17 janarit në Untergruppenbach. Atë ditë aty ka qenë edhe Ibrahim Kelmendi i cili nga këta është larguar kah ora 13.30. Këta të tre janë vra kah ora 22.15 kur me insistimin e Kadriut dalin për të thirrur në telefon në Zvicër prej një automati. Për shkak të provokimeve, familja Gërvalla nuk kishte telefon, e kabina telefonike për thirrje ndërkombëtare gjendej në një fshat tjetër. Kadriu donte t'i telefononte gruas së tij në St Gallen të Zvicrës. Sa i përket OMLK-së nuk dimë se si do të organizohen e vazhdojnë punën e tyre. Sa i përket LNÇKVSHJ mund të them se do të përpiqemi ta vazhdojmë luftën me hov edhe më të madh. Këtu kemi organizua një komitet me emrin Vëllezërit Gërvalla. Për shkak të disa arsyeve që nuk po i përmendi, me Ibrahim Kelmendin do të bashkëpunojmë e koordinojmë aktivitetin por nuk do të kemi marrëdhënie të ngushta me te.

Këtu, si edhe tek ju ka shumë shqiptarë, ka shumë të mirë dhe ka disa agjentë të konsullatave jugosllave të cilat ekzistojnë në shumë qytete të Gjermanisë.

Duke pasur përbazë këtë, shumë shokë të Lëvizjes e poashtu edhe të OMLK nuk njihen nga masat me emrat e tyre të vërtetë por vetëm përmes pseudonimeve. Këtu me shokë jemi marrë vesh të quhem Skënder. Si Xhafer pos dy tre vetave askush nuk më njeh. Tani po më njeh edhe ti. Pra është mirë që këtë punë ta din vetëm ti e para shokëve tuaj më

përmend me emrin Skënder. Tani letrën ma ktheni dhe më folni se si po ju duket kjo puna jonë. Ne do t'ju informojmë më gjerësisht në letrat tjera. Presim edhe mendimet tuaja.

Unë mendoj se unë dhe ti përbëjmë një rast të mirë që të ndikojmë në afrimin e Lëvizjes dhe Shoqërisë "Bajram Curri" në Australi. Kështu përveç këmbimeve të letrave tona private të bëhet komunikimi në mes Komitetit Vëllezërit Gërvalla, Komitetit të Lëvizjes në Zvicër dhe Sh.B.K Bajram Curri. Këtë po e përfundoj me kaq duke ju nisur njëherit edhe disa ekzemplarë të Zërit të Kosovës, të janarit 82, me bindjen se po u plotësoj dëshirën ju dhe bashkatdhetarëve tjerë. Shkruani për aktivitetin, për jetën dhe peripetitë e bashkatdhetarëve në Australi.

Përshëndetje vëllazërore dhe revolucionare nga ne të gjithë.

Kosova-Republikë!

Personalisht ti dhe Shoqëria Bajram Curri, Familjes Gërvalla mund t'i drejtoheni në adresën:
Familja Gërvalla
Habichthöhe str. 40
7101 Untergruppenbach
West Germany (Letër e Xhafer Durmishit për Pajazit Ibrahimin)

3. Letër nga Sejdi Bytyçi (New York), 23 prill 1982

Sejdi Bytyçi: *"I dashur Lul, Letrën tande e lexova me kënaqësi, poashtu edhe të përkohshmet, të cilat do të shumëzohen për njerëzit e përshtatshëm. Të jam mirënjohës që ke shpenzue kohën me m'u përgjigj gjansisht. Fatkeqësisht nuk mund të marrim pjesë në demonstratën tuaj më 24, sepse thirrja erdhi me vonesë, por sidoqoftë u dëshirojmë sukses dhe zemrat tona janë atje me shqiptarët e ndershëm. Përmbajtjen e kësaj thirrje do t'ua paraqes të tri radioprogrameve shqipe këtu në New York, që t'i dëftojmë komunitetit tonë se shqiptarët ne Evropën Perëndimore nuk rrijnë duarkryq. Edhe këtu kemi ba shumë demonstrata por ajo ma me sukses ka qenë në Detroit, ku qyteti u detyrua ta ndaloj festivalin e ashtuquajtun jugosllav, i cili mbahej çdo vit. Me atë rast u bë edhe përleshje fizike, ku fituem na dhe një polic pati guximin me na ofendua flamurin tonë, por edhe kundër këtij u morën masa ligjore dhe u pushua nga detyra. Të gjitha këto ngjarje i ka përfshi gazeta e Detroitit Free Press në faqen e parë."* (Letër Xhafer Durmishit, 23 prill 1982)

4. Letër nga Rilind Bytyçi për "Komitetin Vëllezërit Gërvalla" 17 maj 1982

Partia Komuniste (PKMLSHJ)**: "*Vonë u njoftova** *se Xhafer Durmishi, më 7 mars 1982, pa dijeninë time, por në emrin tim, i kishte shkruar dy letra të njëpasnjëshme dhe i kishte adresuar në shoqatën Bashkimi Kombëtar, Shoqëria „Bajram Curri" në Australi, duke dhënë njoftime rreth „Komitetit Vëllezërit Gërvalla". Letrat i kishte dërguar në këtë adresë:*
P. O. Box 36,
Hastings, VIC., 3915 – Australia
Përgjigjja e Rilind Bytyçit nga Australia, drejtuar Xhafer Durmishit (Skënder Skënderit) ishte..." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f.142)

(Letër e dërguar në Sindelfingen dhe e fshehur nga Nuhi Sylejmani e Osman Osmani prej meje të cilën për herë të parë pata rastin ta lexoj në vitin 2010)
Bashkimi Kombëtar, Shoqëria „Bajram Curri" në Australi
„Komitetit Vëllezërit Gërvalla".

P. O. Box 36,
Hastings, VIC., 3915 – Australia

I dashuri shoku Skënder, 17 maj 1982

Përmes shokut P. Ibrahimi muarem një letër që i dërgonit juve. Dhe për sa shkruanit mbetëm të kënaqur.

Në letrën në fjalë, përveç tjerash mësuam se pakot (2) me revistat e shoqërisë tonë „B. Curri“ nuk i kishit marrur, për arsye vërtetimi, siç e shpjegonit juve. Gjithashtu, mësuam edhe për aktivitetin e „Lëvizjes për Republikë“ në Kosovë dhe tuajin në Evropë. Gjë që na vjen shumë mirë edhe na jep shpresë e kurajo për të ardhmen e dëshiruar.

Juve kishit cekur dhe ndie nevojën edhe për bashkimin e BKSH. „Bajram Curri“ me „Lëvizjen për Republikë“, që ishit shprehur edhe nga shokët brenda në Kosovë. Edhe për këtë ndihemi më se të kënaqur edhe u falënderojmë juve të gjithë sa jeni për besimin që keni në Shoqërinë tonë. Dhe, për këtë çështje kaq të rëndësishme ne nuk kemi kurrgjë kundërshtim përveç se kjo duhet bërë pak më zyrtarisht, me baza më bindëse zyrtare. Me keqardhje e themi, por e vërtetë është se në dy letrat – jo zyrtare – që kemi prej juve nuk mund të bazohemi shumë dhe as të bindemi për saktësinë e personit tuaj. Sepse, juve njëherë jeni Xhafer Durmishi (S. S.) dhe pastaj Nuhi Sylejmani (S. S.): Ne e kuptojmë nevojën për kujdes e pseudonim, por në raste të këtilla dikuj duhet treguar e vërteta, nëse mendohet për sukses më të gjerë.

Pra nëse keni simpati dhe e ndieni nevojën për bashkim me BKSH „B. Curri“ duhet të keni besim edhe në paraqitjen e vërtetë të personit tuaj. Ne, mund t'u themi se asnjë e keqe nga BKSH „Bajram Curri“ nuk ka me u ardhur juve dhe askujt tjetër me parime patriotike dhe dashurinë për popullin dhe Mëmëdhenë tonë të dashur.

Juve bënit fjalë se na keni dërguar nja 20 revista tuajat në adresën e Shoqërisë, ndërsa ne për herë të parë të premten e kaluar muarëm një pako me revistën „Zëri i Kosovës“ nr. 1-2 dhe lajmëtari, dhe këto nga shoku Driton Zogaj dhe jo tre emrat e juaj. E nëse keni edhe emrin e katërt, D. Zogaj, atëherë e dini se revistat i muarëm. Sidoqoftë, shoku Driton Zogaj i faleminderit dhe mbetemi me shpresë se do të marrim edhe tjera revista e letra.

I dashur Skënder,

Siç ceka edhe më sipër, ne nuk kemi kurrnjë kundërshtim për bashkimin e plotë me „Lëvizjen për Republikë“, përkundrazi, kishim me qenë krenar për një gjë të tillë. Vetëm kjo duhet bërë më qartë dhe në mënyrë zyrtare. Pra mbetemi në pritje për një përgjigje të këtillë.

Për bashkim, nuk duhet përjashtuar edhe shokët e „Frontit të Kuq“, nëse këtu nuk ka prova për ndonjë konspiracion e tradhti në vrasjen e tre bashkëvëllezërve Isuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka ((ashtu siç shprehnit dyshim juve në letrën e 7 marsit 1982). Përsa shkruani për përgatitjen e një Demonstrate më 24 Prill 1982 në Vjenë, dëshirojmë që të keni patur sukses dhe herën tjetër na shkruani për të. Ndërsa edhe ne këtu patëm organizuar tri Demonstrata: 24 Prill 1981, 22 Gusht 1981 dhe 2 maj 1982. Me këtë rast po u dërgojmë ca foto me përmbajtje nga këto Demonstrata.

E siguroni një adresë legale – zyrtare, dhe na shkruani për gjithçka u lejojnë kushtet.

KOSOVA – REPUBLIKË!
Rilind Bytyçi

5. Letër nga Rilind Bytyçi, 1 qershor 1982

BASHKIMI KOMBETAR SHOQENIJA 1 qershor 1982
"BAJRAM CURRI"
P.O. Box 36
Hastings
VIC. 3915
Australia

I nderuari shoku Driton,
Duke ju dëshiruar shëndet të mirë dhe suksese gjithnjë e më të shkëlqyeshme në punën për jetë dhe atë patriotike, u njoftojmë se para ca ditëve muarëm një pako me revistat "Zëri i Kosovës" dhe "Lajmëtari i lirisë" dhe njëherit i shpërndamë nëpër shokë. Pra u falemnderit për kujdesin që keni treguar. Dhe shpresojmë se do të marrim edhe numra të tjerë në të ardhmen.
Revistat në fjalë pëlqehen shumë nga shqiptarët e rinj të këtushëm për materialin dhe të dhënat që sjellin mbi ngjarjet në Kosovë. E njejta simpati është edhe për revistën "Liria" dhe gazetën "Bashkimi". Sepse të gjitha këto jan me parim të ngjashëm.
Kosova-Republikë!

Deri në radhën tjetër, shëndet dhe të fala shumë
Rilind Bytyçi (Rilind Bytyçi për Xhafer Durmishin)

6. Letër nga Rilind Bytyçi, 2 qershor 1982

I dashur Skënder, 2 qershor 1982

Letrën tuaj të datës 25 maj 1982 e muarëm dhe përsa shkruanit e kuptuam plotësisht, dhe mbetëm të kënaqur që letra jonë kishte arritur tek motrat Gërvalla.

Në letrën para kësaj, edhe pse isha i porositur nga shoku P. Ibrahimi që t'u njoftoj se ai e ndërron adresën e tij, prapë kisha harruar dhe letrën që i kishit dërguar kohët e fundit mund ta marrë me vonesë, ose edhe mund të humbisi fare. Pra, radhë të tjera, nëse ka diçka të rëndësishme për Shoqërinë tonë, lutemi që të drejtoheni në adresën e qendrës së BKSH "B. Curri". Kështu nuk humbet koha, që nganjëherë mund të jetë me shumë rëndësi.

KOSOVA REPUBLIKË!

Përshëndetje vëllazërore
Rilind Bytyçi (Për Xhafer Durmishin)

7. Letër nga Sejdi Bytyçi, 7 qershor 1982

Sejdi Bytyçi: *"Sot e mora paketën me "Zërin e Kosovës", për të cilën gjë të falenderoj. Këtu po të sjell një çek ($ 50) për t'i mbuluar shpenzimet e vogla që ke (për pulla postale etj.) ...*

Siç thash, këtu do të bëhet një demonstratë me rastin e ardhjes së Stamboliqit, prandaj po pate mundësi të na i shkruash ca sllogane për parullat që do t'i shkruajmë për

demonstratë, ne i përkthejmë anglisht, sepse këto i kopjojnë gazetarët dhe bëjnë efekt. Të fala vëllazërore Sejdiu" (Letër Xhafer Durmishit, 5 qershor 1982)
Pajazit Ibrahimi (Australi): "Për sa më shkruajshit për çështjen e një demonstrate në një vend të Evropës, unë këtu e bëra me dije qendrën e Shoqërisë, që edhe neve këtu të organizohemi, me të njëjtat qëllime dhe në të njëjtën kohë. Por si do të jetë rezultati ende nuk kam marrë lajmin. Ju bëjë me dije se edhe më 1 Maj - të majit të kaluar ne e bëmë një demonstratë para konzullit serb, ku morën pjesë një numër i mirë shqiptarësh dhe na u bashkangjitën shumë prej australianëve dhe kroatëve." (Letër Xhafer Durmishit, 7 qershor 1982)

8. Letër nga Rilind Bytyçi, 17 qershor 1982

BASHKIMI KOMBETAR SHOQENIJA 17 qershor 1982
"BAJRAM CURRI", P.O. Box 36, Hastings, VIC. 3915, Australia
I dashur Skënder,

Sipas fjalëve tuaja në letrën që më dërguat mua më 24 maj 1982 dhe të asaj të shokut Pajazit Ibrahimi, unë dhe shoku Mahmut Rexha, arkatar i Shoqërisë tonë, më

> Partia Komuniste (PKMLSHJ)**: "*Vonë u njoftova** se Xhafer Durmishi, më 7 mars 1982, pa dijeninë time, por në emrin tim, i kishte shkruar dy letra të njëpasnjëshme dhe i kishte adresuar në shoqatën Bashkimi Kombëtar, Shoqëria „Bajram Curri" në Australi, duke dhënë njoftime rreth „Komitetit Vëllezërit Gërvalla"."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 142)

12 qershor vajtëm në Sydney, kryeqytet i shtetit Wales i Ri Jugor (880 km Melbourne-Sydney) dhe pas dy ditë qëndrimi në atë qytet u dakorduam me shokët e atjeshëm që më 26 qershor të organizohet dhe të bëhet një demonstratë.

Arsyeja që demonstratën nuk e organizuam në Melbourne por në Sydney është se, në Sydney deri më tani nuk është bërë ndonjë demonstratë shqiptare dhe më keq, që atje, Konsulli jugosllav, përmes një tradhtari të quajtur I. Hasa, i cili është si nëpunës i konsullit në fjalë, patë formuar një shoqëri – njëherit pas shpërthimit të demonstratave të Kosovës – me emër "Agimi" dhe në emër të Shoqërisë "Agimi" dhe të gjithë shqiptarëve të Sidneut i patën dërguar telegram Beogradit, me të cilin dënonin kërkesat e drejta e të ligjëshme të popullit shqiptar të Kosovës. Prandaj, ne menduam se Demonstrata e 26 Qershorit do të jetë si përgjigje e mirë për dredhitë e poshtëra të serbomëdhenjve e njëkohësisht shpresojmë që pas Demonstratës të shkapërderdhet edhe Shoqëria "Agimi" dhe në vend të saj të formohet një shoqëri me parime patriotike e ndoshta edhe si degë e jona.

Me atë rast, me vete patëm marrë dramën "Besa e Madhe" në videokasetë dhe ua shfaqëm shqiptarëve të atyshëm, të cilët mbetën më se të kënaqur. Gjithashtu atyre u premtuam që kur të shkojmë për Demonstratën e 26 Qershorit, bashkë me parullat dhe traktet për Demonstratë do t'ua dërgojmë edhe dramat "Epoka para Gjyqit" dhe "Gërsheti i luftës" dhe "Manifestimi i punëtorëve të Kryeqytetit – Tiranës – për 1 majin 1982", që t'i shohin pasi të mbaroi Demonstrata....

Deri në letrën tjetër shëndet dhe të fala shumë ty dhe të gjithë bashkëvëllezërve të tjerë me të cilët punoni ju. Kosova – Republikë! Me nderime dhe sinqeritet vëllazëror

Juaj – Rilind Bytyçi (Për Xhafer Durmishin)

9. Letër nga Sejdi Bytyçi, 24 qershor 1982

Sejdi Bytyçi: *"I dashur Lul, para tri ditësh mora letrën tënde të bukur. Të hënën më 14 u bë demonstrata antijugosllave në Chicago dhe të hënën më 21 u bë këtu në New York ku morën pjesë afër 3000 veta. Organizimi ishte fantastik, por shtypi e televizioni qenë të shurdhët. Shihet se janë marrë masa nga J. Parulla "Kosova-Republikë" ka marrë një hov të madh kudo, ku shihej nga afishet që mbanin dhe nga pullat që çdo demonstrues i kishte në gjoks, të cilat po t'i sjell ca që t'i kesh. Të njëjtën kohë po të sjell edhe ca fotografi që po deshe mund t'i botoni në "Zërin e Kosovës". Të gjitha janë nga demonstrata e datës 21 qershor. Ndërtesa me tulla të kuqe është ajo e konsullatës famëkeqe, ku shihen ca fytyra duke vërejtur demonstruesit mu prapa derës."* (Letër Xhafer Durmishit, 24 qershor 1982)

10. Fjalimi i Rilind Bytyçit në Demonstratën e Sydneut më 26 qershor 1982

BASHKIMI KOMBËTAR SHOQENIJA "BAJRAM CURRI"
DEMOSTRATË SHQIPTARE NË SYDNEY - 26 qershor 1982

Të dashur vëllezër dhe motra, zotërinj dhe zonja,

Sot, të gjithë ne, kemi dalë këtu në këtë demostratë në përkrahje dhe solidaritet të plotë me zërin dhe kërkesat e drejta e legjitime të bashkëvëllezërve e motrave tona, të prindërve dhe gjithë popullit tonë shqiptar në Jugosllavi. Në përkrahje të atyre që për të drejta e liri, për mëse një vit e gjysmë, pa ndërprerje po derdhin gjakun lumë në përleshje me ushtrinë e milicinë e okupatorëve serbomëdhenj, të Jugosllavisë revizioniste.

Shpërthimi i demonstratave kryengritëse të popullit shqiptar në Jugosllavi, që nga marsi i vitit të kaluar është rezultat i vuajtjeve të tmerrshme që përjetonte nën thundrën e robëruesve të Beogradit, është mohimi i të gjitha të drejtave demokratike dhe lirisë kombëtare. Për të gjitha këto dhe për shtypjen e dhunën e egër që ushtrohej nga klika revizioniste e Beogradit, populli shqiptar humbi durimin dhe me zemërim e urrejtje të mbledhur në dekada robërie shpërtheu si vullkan i fuqishëm në demonstrata të mëdha popullore.

I gjithë populli, të rinj e pleqë, me këngë patriotike në gojë e me parulla në duar dual rrugëve të të gjitha qyteteve të trevave shqiptare, duke kërkuar punë, të drejtat demokratike dhe lirinë e mohuar. Parullat dhe thirrjet e popullit shqiptar për të drejta e liri të barabartë me popujt e tjerë të Jugosllavisë dhe ngritjen e Kosovës në Republikë, e tmerruar qeverinë e pushtuesve të Beogradit, e në veçanti shovenizmin serbomadh. Prandaj udhëheqësit revizionistë të Beogradit në koordinim edhe me disa vegla tradhtare vendëse i dhanë urdhër policisë e ushtrisë që të suleshin si bisha të egra mbi popullin që kërkonte liri e drejtësi në trojet e veta mijra vjeçare dhe duarthatë, ndërsa armiku i armatosur deri në dhëmbë u sul me tankse, mitralozë e me aeroplanë duke bërë kërdinë mbi të rinj e të reja, gra, pleqë e fëmijë, mbi gjithë popullin shqiptarë që askujt nuk i ka ra në qafë, mbi popullin e pafaj.

Vërtetë që popullit tonë iu vranë e iu plagosën në masë, por ai nuk u frikësua dhe as u gjunjëzua përpara armikut e tradhtarëve, por edhe më me vendosmëri ngul këmbë në kërkesat e tij të ligjëshme. Me zërin e tij të fuqishëm që gumëzhin anekënd trevave shqiptare nën robërinë e sllavëve të jugut: "KOSOVA-REPUBLIKË!" e Vetëvendosje, armikut ia ka ngri gjakun në trup, dhe me sy të çakërdisur, si prej njeriu të prishur mendsh sillen e mbështillen të hakëruar. Ata çirren, bërtasin, shajnë e nuk

Partia Komuniste (PKMLSHJ)*: "* **VONË U NJOFTOVA ...** ***Më 24 qershor****, gjatë një vizite të rastësishme në Sindelfingen, u takova me Xhafer Durmishin dhe Fahredin Tafallarin, të cilët më njoftuan se e kishin organizuar një demonstratë që do të mbahej në Bern të Zvicrës, më 26 qershor."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 142 dhe 45)

lënë gur pa luajtur që ta mëshefin të vërtetën historike dhe atë të sotme, por pa sukses, sepse, siç thotë populli:" Shigjeta nuk mund të mëshihet në thes, dhe as dielli me shoshë nuk mbulohet." Kështu pra nuk mund të mëshifet e të mbulohet me asgjë dhe nga askush edhe e vërteta historike dhe e sotme e popullit tonë, atë e shofin dhe e dëgjon gjithë bota, qartë e mirë si edhe dritën e diellit, sepse është e pastërt dhe e drejtë, prandaj edhe do të fitojmë.

Edhe ne këtu, duke qenë bij dhe pjesë e atij populli atje, s'kemi rrugë tjetër pos të mbështesim plotësisht përkrahjen dhe solidaritetin tonë me popullin dhe për popullin tonë, për kërkesat e tij të ligjëshme. Përndryshe s'kemi si të konsiderohemi, përveç të ligj e tradhtarë!

Vitin e kaluar, pas shpërthimit të demonstratave popullore të trevave shqiptare në Jugosllavi, me urdhër të klikës revizioniste të Beogradit, konsulli ose çerdhja e agjenturës së Beogradit këtu në Sydney me shpejtësi ngritën Shoqërinë "Agimi" dhe në emër të saj dhe të të gjithë shqiptarëve të Sydneyt, tradhtisht, ashtu si e kanë për traditë të tyre, i dërguan telegram Beogradit, dhe atyre kriminelëve që lanë në gjak popullin tonë të pafaj e duarthatë, duke deklaruar gjoja se shqiptarët e Sydneut dënojnë rreptësisht demonstratat e popullit shqiptar dhe kërkesat e tyre, dhe se solidarizohen plotësisht me masat e egra shtypëse të ushtrisë e policisë fashiste të Beogradit kundër popullit shqiptar të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe viseve tjera shqiptare.

Por ja, ja ku janë bijtë e atij populli, në emër të të cilëve keni dërguar atë

Partia Komuniste (PKMLSHJ)*: "* **VONË U NJOFTOVA** ... ***Më 24 qershor****, gjatë një vizite të rastësishme në Sindelfingen, u takova me Xhafer Durmishin dhe Fahredin Tafallarin, të cilët më njoftuan se e kishin organizuar një demonstratë që do të mbahej në Bern të Zvicrës, më 26 qershor."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 142 dhe145)

telegram të poshtër, o kriminelë, o tradhtarë të marksizëm-leninizmit, dilni pra, dilni nëse ua mbanë dhe tani pyeti bijtë e atij populli që e shtypni brutalisht, pyeti se me kend janë dhe se kend përkrahin: Klikën tuaj gjakatare apo popullin shqiptar dhe kërkesat e tij të drejta e legjitime? Por jo, jo, e dimë se juve nuk keni guxim të dilni këtu, sepse e dini mirë se çfarë kishte m'u ngjarë, e dini që këta bij të shqipes do t'u bënin copë e grimë nga zemërimi dhe urrejtja që ndjejnë për ju kriminelë.

Por edhe pse këtu nuk dilni, mos mendoni se do t'i shpëtoni dorës së popullit për krimet që keni bërë e po bëni në të. Populli nuk i harron dhe dora e tij e është e madhe dhe e fuqishme. Pra një ditë do t'i paguani pikë për pikë, për të gjitha ato që po bëni mbi popullin tonë shqiptar.

RROFTË POPULLI SHQIPTAR!
LAVDI DËMSHMORËVE TË RËNË!
POSHTË OKUPATORI SERBOMADH!
KOSOVA - REPUBLIKË!
Rilind Bytyçi: "Fjalim që mbajta në demonstratën e Sydneut, më 26 qershor 1982 përpara konsullatës jugosllave të atyshme".

11. Letër nga Pajazit Ibrahimi, 5 shtator 1982

Pajazit Ibrahimi (Australi)*: "Për demonstratën e 26 qershorit të mbajtur në Bern, që tash na lajmëroni e kuptuam ... Këtu në Australi demonstrata u organizua poashtu më 26 qershor, në Sydney, para konzullit sllav. Dhe megjithë përpjekjet e disa tradhtarëve e armiqve tanë, demonstrata filloj dhe mbaroj me sukses."* (Letër Xhafer Durmishit, më 5 shtator 1982)

12. Letër nga Rilind Bytyçi, 17 nëntor 1982

Rilind Bytyçi: *"Javën e kaluar muarëm edhe revistat "Zëri i Kosovës" që na kishit dërguar (Nr. 2, 40 kopje). Dhe, ne këtu, më 13 dhe 14 Nëntor patëm shfaqur një foto Ekspozitë "38 Vjet Shqipëri Socialiste", si edhe gjëra të artizanatit shqiptar, kostume kombëtare, pulla poste dhe libra të ndryshme nga Shqipëria Mëmë, e me atë rast, shfaqëm edhe 4 filma: "Udha e Shkronjave", "Isa Boletini", "Ylberet mbi Alpe" dhe Koncert me këngë të zgjedhura nga ansambli "Skënderbeu" - Korçë. Prandaj, duke përfituar nga rasti, menduem se revistat "Zëri i Kosovës" të shpërndahen me një çmim prej dy dollarësh, dhe kështu u bë. Këtë e bëmë, sepse, askush tjetër mos past dijeni se sa shpenzime e punë ka një veprimtari si kjo e LRSHJ, neve e dijmë se kemi një përvojë shumë vjeçare. Pra, tani jam duke vajtur në Bankë dhe do t'ua dërgoj ato pak të holla. Por, nëse juve, ose, njerëzit me përgjegjësi në udhëheqjen e Lidhjes nuk akordohen e nuk mbeten të kënaqur me këtë që bëmë ne, pa udhëzimet e juaja, ne kërkojmë falje dhe u sigurojmë se nuk do të përsëritet në të ardhmen. Vetëm, në një letër mjaft kohë më parë, juve shkruanit se në një Demonstratë atje në Evropë, i kishit pas shitur revistat me një çmim prej disa markave. E në bazë të kësaj, edhe ne vepruam ashtu.*

I dashur Skënder,

Me këtë rast, Juve dhe përmes juve, dëshirojmë që edhe familjeve të tre bashkëvëllezërve Dëshmorë, Isuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka t'u dhurojmë nga një shenjë kujtimi vëllazëror.

Tani përshëndetje mëse vëllazërore dhe suksese në punën e shenjtë patriotike për kauzën e popullit dhe Kosovës tonë të dashur. Njëkohësisht: Gëzuar festat e Nëntorit të Kuq, 70 vjetorit të pavarësisë kombëtare dhe 38 vjetorit të çlirimit të Shqipërisë tonë të dashur nga ushtritë Nazi-Fashiste.

Me nderime vëllazërore

Rilind Bytyçi" (Letër për Xhafer Durmishin, 17 nëntor 1982*)*

13. Letër nga Sejdi Bytyçi, 22 nëntor 1982

Sejdi Bytyçi (New York): *I nderuar Lul, Jemi mirë të cilën gjë dëshirojmë dhe për ju. Të falemnderit për numrat e "Zërit të Kosovës". Numri i fundit ka qenë me të vërtetë i pasur dhe i nivelit të duhur. Pashë që këtu ishte përhap dhe popullarizuar mjaftë kjo revistë e re. Pra ju lumtë dhe mbajeni këtë organ të vlefshëm kombëtar në mërgim. Pranoni urimet tona për festën e 28 Nëntorit. Të fala Sejdiu"* (Letër Xhafer Durmishit, 22 nëntor 1982)

Feriz Kunushefci – E dashura Nanë Shqiptare,
letër nga burgu i Heilbronit, janar 1982



Edashura Nané Shqiptare.

Ket leter poe shkruej edhe deshiroj ngushlimme te thella per djemt e juej si e dhan jeten per Vendlindje edhe per popullin ke Shqiptar. Mos u merzit hiq se djemt e juej jeten e kan dhan edhe nuk jan ma ne mesin e familjes se vet, Trupi i tyre ka vdek , Por vepra e tyne edhe puna e tyne per popullin shqiptar kurr nuk ka me vdek. Banu efort edhe thuej: Djemt e mij nuk jan dek por kan lind , se jan dekper Adédhe per popullin shqiptar. Anmiku popullin shqiptar nuk mund mei tut me pushk. Djemt e juej jan Heroja ata nuk jan dek ne Krevet por tue punue edhe ue u mundue dit enat per neve te gjithve shqiptarve. Djemt e tu ika njoft bota edhe i njef . Djemte e juej nuk vdesin kurr sikur Skender Beu edhe Bajram curri ata nuk vdesin kurr por jam met neper zemrat e qdo njenit shqiptar. Mos qaj e mos u merzit se qdo Nané nuk munet me marue asi djemsh ! Une Adresin e juej nuk edi por familjen e juej enef bota tash se ekan dhan jeten vllaznit per popull shqiptar. Une kit leter pi shkruej se me ardh meu pa per kit vdekje nuk muj se une jam ne burg ne helbronn. Vetem zemra pom qan per ata dy trima tu edhe per at shokun apo mikun e djemve tu

Banu e fort edhe zemer guri se djemt tu nuk jan vdek po jan lind se e kan dhan jeten per popull te vet se jo per veti.

Vllaznit : Isufin edhe Bardhin i kemi humb por ata naekan lan ni veper edhe ni pun edhe jan vdek me ftyr edhe per popull edhe kan mbet ne zemrat tona gjithmon oj nane'

Tash poi dha fund edhe mos u merzit ti as familja e juej hiq se per kto pun nuk mun des gjthkush oj nané shqiptare.

Feriz Kunushefci
Nga Burgu i Helbronit

Letra nga Xhafer Durmishi

Shkurt 1982-korrik 1985

1. Letër e Xhafer Durmishit për bashkatdhetarët në Nagold, 8 shkurt 1982
2. Letër Xhafer Durmishit Komitetit të Degës "Hasan Prishtina", 26 shkurt 1982
3. Letër e Xhafer Durmishit për Sabri Novosellën, mars 1982
4. Letër e Xhafer Durmishit për Pajazit Ibrahimin në Australi, 7 mars 1982
5. Letër e Xhafer Durmishit për Sabri Novosellën, maj 1982
6. Letër e Xhafer Durmishit për Sabri Novosellën, 22 maj 1982
7. Procesverbali i KVG, 11 korrik 1982
8. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 13 korrik 1982
9. Letër e Xhafer Durmishit për Sabri Novosellën, 14 korrik 1982
10. Letër Xhafer Shatrit, 6 gusht 1982
11. Procesverbali i rrethit të Shtutgartit, 26 shtator 1982
12. Letër e Xhafer Durmishit për Lëvizjen në emër të KVG, 1 tetor 1982
13. Letër e Xhafer Durmishit për Xhafer Shatrin, tetor 1982
14. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, vjeshtë 1982
15. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, vjeshtë 1982

16. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, vjeshtë 1982
17. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, vjeshtë 1982
18. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, fillim i Nëntorit 1982
19. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 25 nëntor 1982
20. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 29 nëntor 1982
21. Letër e Xhafer Durmishit për Engjëll Kolanecin, nëntor 1982
22. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 30 nëntor 1982
23. Letër e Xhafer Durmishit për Xhafer Shatrin dhe Sabri Novosellën, 3 dhjetor 1982
24. Letër e Xhafer Durmishit për Xhafer Shatrin, 5 dhjetor 1982
25. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 8 dhjetor 1982
26. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 10 dhjetor 1982
27. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 11 dhjetor 1982
28. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 14 dhjetor 1982,
29. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 16 dhjetor 1982
30. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 20 dhjetor 1982

31. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 29 dhjetor 1982
32. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 30 dhjetor 1982
33. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, dhjetor 1982
34. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 2 janar 1983
35. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, shkurt 1983
36. Shkrim i Xhafer Durmishit si material për mbledhjen e parë të Qendrës Ekzekutive në mesin e marsit 1983 në Gjenevë
37. Letër e Xhavit Ramabajës për Xhafer Durmishin, mars 1983
38. Letër e Xhafer Durmishit për Ibrahim Kelmendin dhe Qendrën Ekzekutive, 24 prill 1983
39. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 26 prill 1983

40. Letër Xhafer Durmishit për Qendrën Ekzekutive, 4 maj 1983
41. Letër e Xhafer Durmishit për Xhafer Shatrin, 4 maj 1983
42. Letër e Xhafer Durmishit për Xhafer Shatrin, 13 qershor 1983
43. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, vjeshtë 1983
44. Letër e Xhafer Durmishit për Bashkësinë së klubeve, 1 nëntor 1983
45. Letër e Xhafer Durmishit për shokët në Saar-Louis, nëntor 1983
46. Letër e Xhafer Durmishit për Qendrën Ekzekutive, 3 janar 1984 (pjesë)
47. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, mars 1984
48. Letër e Xhafer Durmishit për delegatët e Bashkësisë së klubeve, mars 1984
49. Letër e Xhafer Durmishit për Shokët e Shtutgartit, 14 maj 1984
50. Letër e Xhafer Durmishit për Januz Prekazin, 14 gusht 1984
51. Letër e Xhafer Durmishit për Remzi Ademin, 18 gusht 1984
52. Letër e Xhafer Durmishit për Imer Berishën, 24 shkurt 1985
53. Letër e Xhafer Durmishit për shokët në Gjermani e Zvicër, 22 mars 1985
54. Letër e Xhafer Durmishit për Remzi Ademin, korrik 1985
55. Letër e Xhafer Durmishit për Hysen Gërvallën, 22 korrik 1985

1. Letër e Xhafer Durmishit për bashkatdhetarët në Nagold, 8 shkurt 1982

Letër falenderimi për bashkatdhetarët në Nagold

Të dashur bashkatdhetarë të Nagoldit!

Na lejoni që të përfitojmë nga rasti për t'ju falenderuar përzemërsisht për kujdesin e madh që treguat me rastin e ngjarjes së hidhur që ngjau në mbrëmjen e 17 janarit në Untergruppenbach.

Ju falenderojmë për të gjitha, për telegramet, për vizitat në familje kur na erdhët menjëherë me të dëgjuar lajmin që ta ndani hidhërimin me ne, për pjesëmarrjen në marshin protestues për të shprehur hapur revoltën e cila na ka përfshi të gjithëve, për nderimet e fundit që u bëmë dëshmorëve ku ju edhe njëherë treguat respektin për veprën e tyre, për ndihmat materiale të pakursyera me të cilat na ndihmuat aq shumë.

Pjesëmarrja juaj me gjithë zemër na e zvogëloi shumë dhembjen tonë.

Ju falenderojmë të gjithëve që në këtë dhe të huaj na rrethuat ngrohtësisht, duke e kuptuar gjendjen se sa fortë ia kemi nevojën njëri-tjetrit.

Për aq sa kemi mundësi, ne nuk do të kursejmë veten tonë dhe do të mundohemi ta arsyetojmë ndihmën dhe kujdesin tuaj.

8 shkurt 1982 Untergruppenbach Shoqëria e punëtorëve të Shtutgartit (Xhafer Durmishi)

(Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë1998, f. 244)

2. Letër Xhafer Durmishit Komitetit të Degës "Hasan Prishtina", 26 shkurt 1982

Letër drejtuar Komitetit të degës së LRSHJ "Hasan Prishtina"

Të dashur shokë!

Udhëtimin e Shpendit (Xhafer Durmishit) e quajtëm si shumë të suksesshëm. Ardhja e Halimit (Osman Osmanit) është me vend dhe angazhimi i tij i menjëhershëm me siguri do të jetë i frytshëm. Ditën kur u kthye Shpendi pra të hënën, ditën e parë të javës, kur shokët ia filluan javës së re të punës.

Meqë këndej shokët janë të shpërndarë në pika të ndryshme dhe që në atë javë nuk kishin farë automjeti, mbledhja zgjedhore e Komitetit nuk mundi me u thirrë gjer më

26 shkurt 1982. Atë mbrëmje në një qytet larg nga këtu u mblodhën: Shpendi (Xhafer Durmishi), Halimi (Osman Osmani), Drita (Suzana Gërvalla), Agimi (Nuhi Sylejmani), Agroni dhe Guximi (Haxhi Berisha).

Mbledhjen e hapi Shpendi i cili në fillim i njoftoi të pranishmit mbi bashkimin, me organizatën e re dhe me detyrën e qëllimin e ardhjes së Halimit.

Ai për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Formimi i degës së LRSHJ për Evropën Perëndimore.

a) Që kjo degë e LRSHJ ta merr emrin e dëshmorëve Gërvalla, pra të quhet ”Komiteti Vëllezërit Gërvalla”.

b) Që Komiteti të përbëhet nga pesë anëtarë

Të ndryshme

Ky rend dite u aprovua një zërit nga të pranishmit.

1. Që në fillim u propozua të zgjidhen anëtarët e Komitetit, pra pesë veta. Meqë Agimi ishte edhe më parë si arkatar, Agroni si anëtarë së bashku me Dritën dhe **Shpendin** nuk u diskutua shumë rreth tyre se a duhet të jenë anëtarë të Komitetit të riorganizuar apo jo. Halimi propozoi që Komiteti t’i ketë edhe dy kandidatë. Ky propozim u quajt me vend dhe i arsyeshëm dhe si i tillë u aprovua. Arsimi që në fillim tha se pyetjen për arkatarë nuk ka nevojë ta përsërisim pasi arkatarin e vyeshëm e kemi që nga fillimi. Propozimi i Arsimit që edhe më tutje të jetë arkatarë Agimi i aprovua.

Shpendi pasi i numëroi disa detyra që i ka pasur Drita si shoqja më e ngushtë e Sokolit (për të cilat disa nga të pranishmit nuk kanë qenë në dijeni) e njëherit i njoftoi se ajo pas një kohe do të shkoj në A. Ai atë e propozoi si sekretare deri sa ajo të jetë në mesin tonë. Ky propozim u aprovua unanimisht. Fjalën pastaj e mori Drita e cila u falenderua dhe në vazhdim i njoftoi të pranishmit se Shpendi (Xhafer Durmishi-shën. im) ishte njeriu që ishte udhëzuar ta ndihmonte Sokolin dhe për këto detyra të kryera ai kohët e fundit ishte pranuar edhe anëtarë i KQ (Komitetit Qendror-shën. im) të ish-LNÇKVSHJ. Duke pas parasysh këtë, vazhdoi ajo, unë mendoj se ai duhet të jetë kryetar i komitetit të degës së LRSHJ për Evropën Perëndimore. Edhe me këtë propozim të pranishmit u pajtuan. Për anëtar mbetën Halimi dhe Agroni.

Me shkuarjen e Dritës (Suzana Gërvallës në Shqipëri-shën i Xh.D.) ne do të mblidhemi prapë dhe në vendin e sekretarit do të zgjidhet Halimi. Ndërsa anëtarë i ri i komitetit do të jetë Arsimi. Kandidati i ri besojmë se në bazë të punës së tij do të zgjidhet Luli.

a) Propozimi që komiteti të quhet ”Vëllezërit Gërvalla” u aprovua një zërit.

b) Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke pasur parasysh faktin se ishte i pranishëm anëtari i ri Halimi edhe ca anëtarë të tjerë të ish-LNÇKVSHJ nuk dinin shumë në lidhje me përbërjen në numër të një komiteti, mbretëroi pak heshtja. Me këtë rast Shpendi shpjegoi se Lëvizja NÇ me këtë praktikë punon qe disa vjet dhe se kjo formë është treguar mjaftë e suksesshme. Halimi vazhdoi se ai me shokët e tij kanë vepruar ndryshe dhe se nuk kanë shumë eksperience lidhur me funksionimin e një komiteti të tillë sidomos në kushtet jashtë atdheut dhe pasi ne ishim të pranishëm tetë ndërsa komiteti do të kishte vetëm pesë anëtarë. Halimi tha se faktikisht për anëtarët e këtij komiteti po dinë 8 veta. Ai tha se edhe ata aktivist të dalluar të jen si kandidat për komitet. Ky propozim dhe arsyetimi i cekur më lartë u pranua. Pra komiteti i degës së LRSHJ ”Vëllezërit Gërvalla” për Evropën Perëndimore ka me shkuarjen e Dritës ai do të duket kësi soji:

1. Shpendi	Kryetar	Xhafer Durmishi
2. Drita/Halimi	Sekretar	Suzana Gërvalla/Osman Osmani
3. Agimi	arkatar	Nuhi Sylejmani
4. Agroni	anëtarë	Faridin Tafallari
5. Halimi	anëtar	Osman Osmani

6. Halili	kandidat	Hafiz Gagica
7. Guximi	kandidat	Haxhi Berisha
8. Arsimi	Përgjegjës i rinisë	Naim Haradinaj

2) Në pikën të ndryshme diskutimet u zhvilluan rreth anëtarësisë, çështjet materiale, puna rreth vendosjes në një bazë të re dhe nxjerrjes sa më të shpejtë të numrit të ri të organit.

Për këto dhe të tjerat herën e ardhshme.

Ju përshëndesin shokët e ”Komitetit Vëllezërit Gërvalla” (Xhafer Durmishi)

Kosova – Republikë" (Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 357-358)

3. Letër e Xhafer Durmishit për Sabri Novosellën, mars 1982

Vëlla Mërgim!

Një shok nga Dibra për të cilin të kam folur, ka shkuar në kamp. Ai prej kampi na lajmëron se si ka arritur një spiun të UDB- së. Fjalët e tij i muarrëm me rezervë të madhe, sidomos kur të kihet parasysh historia e XH.SH., e njëherazi edhe ky shoku është njeri që dyshon shumë sa që tani po më thonë se ai paska shprehur dyshime edhe në mua, kur unë kam thënë një herë kam banuar gjatë studimeve e njëherë jo. Unë vërtetë ashtu kam thënë se gjatë 4, 5 viteve studimi edhe kam banuar edhe kam udhëtuar. Nejse.

Pas bisedës me ju që atë natë, për në Itali i nisëm katër shokë me një automobil. Ndër ta edhe Halimi (Osman Osmani). Edhe unë plotësisht mendoj se do t’ia vlen barra qeran këtij udhëtimi. Organin e dorëzuam për radhitjen e shtylave.na kushtoi 1400 DM. janë 17 artikuj (pa poezi). S’ bashku me fotografitë dhe titujt besoi se do të dal mjaftë material. Pjesa dërmuese e shkrimeve është e Sokolit, megjithëse nga kapuçonët nuk është kthyer as gjysma e materialeve të përgatitura për numër. Organin do ta nxjerrim si numrin 3 të LNÇKVSHJ, por për hir të formimit më të shpejtë, që të mos presim deri tek numri i ardhshëm do të dalim me një fletë të shkapur si te Lajm. Nr 3, duke e quajtur shtojca e zërit. artikujt e saj “Një udhëtim në izr...” dhe “Plisi i bardh mbi faqe të zezë” nuk u dorëzuan në radhitje pasi H. e kishte humbur ndërsa të dytin arkatari ma solli me vonesë. Unë i kisha dorëzuar në radhitje për hir të shpejtësisë edhe pse kështu krejtësisht s’na doli, dhe më tepër për shkak të familjes vendosëm që këtë numër ta punojmë në shtypin e qytetit, sepse këta kapuçonët interesohen fortë se ç’po bëhet, e pa rregullimin e shoqes së Sokolit nuk kishim mund t’i largojmë mjetet e punës siç është një makinë e tillë. Dhe besojë se kjo është e arsyeshme. Kam frikë se organi do të na del me ca gabime gjuhësore jo për fajin tonë, por për shkak të atyre që e përgatisin.

Unë solla edhe mendimin tuaj për I.K. (Ibrahim Kelmendin). Nuk m’i pranuan me pikëpamjet e shumicës e pikëpamje të tilla shprehu edhe Halimi, sidomos pas njohjes me te. Tani shoqja e Sokolit thotë se I.K., i ka thënë Sokolit (Jusufit) para dy viteve, se po qe se doni mund t’iu fus dhe nxjerrë nga Kosova pa therrë në këmbë. Pastaj kur unë iu them se ata janë përcjellë me javë apo muaj të tërë, pse atëherë nuk ndodhi kjo një natë më parë kur me ta ndodhej edhe I.K., me të cilin ata u kthyen në ora gati tre të natës, pas shikimit të filmave. Unë më tepër se kurdoherë po e kuptoj përgjegjësinë për rrjedhën e ngjarjeve dhe nuk kam dëshirë që kjo të zbulohet nëse është e vërtetë. I.K. u interesua shumë se ku ka qenë Besniku në Itali ai thoshte se kemi disa shokë të mirë në kamp. Nga informatat e mëvonshme vim në përfundim se I.K. mund të ketë ditë për XH. Këtu parimisht s’ka gjë të keqe.

Herën e fundit me disa sjellje të tija siç ishte këndimi i pandërprerë korridorit dhe sjellja prej kapadaiu nga dhoma në dhomë mi kaloi gjithë kufijtë e durimit dhe me të vërtetë, kur i shikojsha fotografitë e dy vëllezërve më dukej sikur po më thonë se ç'je duke bërë? Andaj vendosëm që atë natë të bisedojmë me te për disa gjëra. Edhe pse shqiptari nuk e ka zakon me e pyetë mysafirin, pse ke ardhë, unë u detyrova me ia bërë një pyetje të tillë qysh në fillim të bisedës. I thashë se rruga e gjatë, shumë shpenzime, etj., a ke diç për të thënë? Po tha! Tani është njëvjetori i demonstratave, të bisedojmë për ndonjë manifestim apo komemoracion. Të bashkëpunojmë. Në bisedime merrte pjesë edhe shoqja e librit, e cila nuk guxonte të fliste, përveç atëherë kur iu dashke të mbrohej nga akuzat, sidomos të mijat, kur ju thashë se juve ju ka interesuar biseda e çdo kujt këtu dhe për këtë e keni bërë veshin cingare....Në bisedime merrnin pjesë rreth 10 veta, gjë që nuk i pëlqente fare I.K. dhe për këtë u ankua. I fola edhe për: 9000 DM, 26000 njësi të hollash belge, 700 Fr.zvicerane dhe 1300 Fr.franceze, të cilat janë gjetur në palën e një jorgani në dhomën e fjetjes së mysafirëve. I.K. tha se kjo është e montuar nga dikush dhe se atij i intereson përçamja, duke thënë se këtu paska hyrë armiku duke aluduar në mua. I fola për bashkëpunimin e mëparshëm. Ai thoshte se për këtë dinë vetëm ata tre, e jo tjetër kush, ndërsa tani dikujt ato marrëdhënie i intereson t'i interpretoi si të do. Unë thashë se faktet ekzistojnë dhe ato flasin mjaftë. Nëse doni bashkëpunim duhet t'i rishikoni disa gjëra të kaluara. I fola për të hollat në xhirollogarinë "Ndihmat për Kosovën" të publikuar në numrin e parafundit të revistës "Liria". Kush ka tani pushtet në to nëse nuk keni ju, pse nuk u shpenzua asnjë mark nga to për këtë rast, çdo të thotë populli nesër kur ta marrë vesh këtë? I kaloi të gjitha këto pyetje në heshtje duke arsyetuar se punët kanë qenë të ndara. Foli pastaj për mundësinë e botimit të ndonjë broshure të përbashkët në lidhje me rastin. I thamë që atë ta bëjë secila organizatë në organet e veta.

U ndal. Po të më thuheshin fjalë të tilla mua me të vërtetë, në atë vend s'do të dukesha kurrë. Me atë nuk ndodh kështu. Kjo na e rritë edhe më tepër dyshimin se ai me të vërtetë është i detyruar nga dikush që të duroi gjithçka vetëm të jetë i pranishëm dhe të vëzhgojë. Për dashnoren e tij ka paraqit azil. Atë ditë kishin ardhur te avokati rreth çështjes së azilit e këtë nuk donte ta tregonte. Sa i përket çështjes së Has. Po del në pah se unë kam gabuar që nuk të kam dëgjuar. Ai tani është në klubin e Dyseldorfit ku qarkullon I.K. Po thonë se është duke u mërzitur shumë. Por po të ishe në vendin tim dhe me eksperiencën time besoj se do të veprojshe si unë. Ai me të vërtetë ishte i habitur shumë.

Unë iu kam pas afruar me të vërtetë sinqerisht disa herë dhe i kam rrehë shumë gjëra që na preokupojnë. Por ai vazhdimisht ndahej me orë të tëra vetëm me I.K.. Shoku ynë që ka çue material me te në Kosovë do shkoi me bisedue me të. Nga Australia, respektivisht nga shoqëria "Bajram Curri" na ka ardhë një ngushëllim për familjen dhe një falenderim për dërgimin e revistave të cilat i kanë pëlqyer shumë. U qova prapë edhe ekzemplarë tjerë duke përfshirë edhe numrat e Lajmëtarit. Adresën e Besnikut nuk e kemi. Besojmë se shumë adresa të konfiskuara së shpejti do t'i kemi në dorë. Megjithatë na i dërgo të gjitha ato adresa që na ke pas dërguar më parë. Gjithashtu na dërgo adresat që do t'i sigurosh nëpërmjet Plakut. Punën e udhëtimit të Kushtrimit me shokë a e kryeve ende apo jo. Në mbledhjen e afërt që do të thërrasim do ta shtrojmë si çështje që donë zgjidhje edhe punën e dërgimit të materialit në Kosovë, duke pas parasysh se ky ishte edhe AMANETI i Sokolit në çastet kritike të jetës së tij. E presim përgjigjen menjëherë.

Përshëndetje vëllazërore e revolucionare nga Shpendi (Xhafer Durmishi)

(Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 285-287)

4. Letër e Xhafer Durmishit për Pajazit Ibrahimin në Australi, 7 mars 1982

Shoku Pajazit,

Përgjigjen në letrën time e mora nga shoku prej të cilit ta kam dërguar. Unë jam duke banuar në banesën e Familjes Gërvalla. Mirëpo shkrimi i letrave me adresë të kësaj familje nuk është i mirë sepse nganjëherë letrat po vijnë të çelura.

Revistat me sa e kuptova u paskan pëlqyer dhe për këtë jemi të gëzuar. Edhe ne na erdhi mjaft mirë që kishit dërguar ata ekzemplarë të numrit 16 të gazetës së Shoqërisë "Bajram Curri." Herave tjera na dërgoni më tepër, sepse ndikojnë mirë tek punëtorët në Perëndim, të cilët janë të shumtë dhe që shkojnë shpesh në Atdhe.

Në fillim po të prezantohem me të vërtetë se kush jam.

Unë jam Xhafer Durmishi, nga Stanovci i Poshtëm, një fshat afër Vushtrrisë. Vëllau im i madh quhet Xhevat, është student i mjekësisë dhe është shok i ngushtë i vëllaut tënd Nexhatit. Në qershor të vitit 1981 u largova pasi e ndieja veten të rrezikuar nga fushata e burgosjeve. Unë në Kosovë kam qenë anëtarë i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi. Kur dola jashtë, përmes lidhjeve me shokë jashtë atdheut mora kontakt me Jusuf Gërvallën, një nga udhëheqësit me rëndësi të Lëvizjes.

Për punën dhe aktivitetin e Lëvizjes do të informohemi edhe në letrat tjera. Verën e vitit të kaluar isha pak ditë tek Nexhati në Chur. Aty ai ma tregoi një letër tuajën në të cilën ju flitshi për disa shqiptarë të Zvicrës, anëtar të "Frontit të kuq". Atë organizatë e kemi kuptuar, e udhëheqë një Ibrahim Kelmendi nga fshati Vuthaj, tani i shpërngulur në një fshat afër Pejës. Me ardhjen e Jusuf Gërvallës në Gjermani ai njoftohet edhe me Ibrahim Kelmendin, të cilit i ndihmon dhe ia nxjerrë tre numra të gazetës së "Frontit të Kuq" me emrin "Bashkimi".

Jusufi, anëtar i LNÇKVSHJ pra e ka ndihmuar dhe popullarizuar në masën më të madhe "Frontin e Kuq". Prej janarit 1981 Jusufi nuk i ndihmon më Ibrahim Kelmendit në nxjerrjen e gazetës "Bashkimi" për disa shkaqe.

Në organizimin e demonstratave të punëtorëve në Perëndim, krahas Lëvizjes e cila ka bërë shtypjen e thirrjeve me teknikën e saj kanë ndihmuar dhe marrë pjesë Organizata e Marksist-Leninistëve të Kosovës të cilën jashtë Atdheut e ka udhëheqë Kadri Zeka, i cili u vra në mbrëmjen e 17 janarit në Untergruppenbach. Atë ditë aty ka qenë edhe Ibrahim Kelmendi i cili nga këta është larguar kah ora 13.30. Këta të tre janë vra kah ora 22.15 kur me insistimin e Kadriut dalin për të thirrë në telefon në Zvicër prej një automati. Për shkak të provokimeve, familja Gërvalla nuk kishte telefon, e kabina telefonike për thirrje ndërkombëtare gjendej në një fshat tjetër. Kadriu donte t'i telefononte gruas së tij në St Gallen të Zvicrës. Sa i përket OMLK-së nuk dimë se si do të organizohen e vazhdojnë punën e tyre. Sa i përket LNÇKVSHJ mund të them se do të përpiqemi ta vazhdojmë luftën me hov edhe më të madh. Këtu kemi organizua një komitet me emrin Vëllezërit Gërvalla. Për shkak të disa arsyeve që nuk po i përmendi, me Ibrahim Kelmendin do të bashkëpunojmë e koordinojmë aktivitetin por nuk do të kemi marrëdhënie të ngushta me te.

Këtu, si edhe tek ju ka shumë shqiptarë, ka shumë të mirë dhe ka disa agjentë të konsullatave jugosllave të cilat ekzistojnë në shumë qytete të Gjermanisë.

Duke pasur për bazë këtë, shumë shokë të Lëvizjes e po ashtu edhe të OMLK nuk njihen nga masat me emrat e tyre të vërtetë por vetëm përmes pseudonimeve. Këtu me shokë jemi marrë vesh të quhem Skënder. Si Xhafer pos dy tre vetave askush nuk më njeh. Tani po më njeh edhe ti. Pra është mirë që këtë punë ta din vetëm ti e para shokëve tuaj më

përmend me emrin Skënder. Tani letrën ma ktheni dhe më folni se si po ju duket kjo puna jonë. Ne do t'ju informojmë më gjerësisht në letrat tjera. Presim edhe mendimet tuaja.

Unë mendoj se unë dhe ti përbëjmë një rast të mirë që të ndikojmë në afrimin e Lëvizjes dhe Shoqërisë "Bajram Curri" në Australi. Kështu përveç këmbimeve të letrave tona private të bëhet komunikimi në mes Komitetit Vëllezërit Gërvalla, Komitetit të Lëvizjes në Zvicër dhe Sh.B.K Bajram Curri. Këtë po e përfundoj me kaq duke ju nisur njëherit edhe disa ekzemplarë të Zërit të Kosovës, të janarit 82, me bindjen se po u plotësoj dëshirën ju dhe bashkatdhetarëve tjerë. Shkruani për aktivitetin, për jetën dhe peripetitë e bashkatdhetarëve në Australi.

Përshëndetje vëllazërore dhe revolucionare nga ne të gjithë.

Kosova-Republikë!

Personalisht ti dhe Shoqëria Bajram Curri, Familjes Gërvalla mund t'i drejtoheni në adresën:

Familja Gërvalla, Habichtchöhe str. 40, 7101 Untergruppenbach,
West Germany (Xhafer Durmishi)

5. Letër e Xhafer Durmishit për Sabri Novosellën, maj 1982

Shoku Mërgim, maj 1982

Që në fillim po të tregoj se udhëzimi yt që unë t'i shkruaj letrat me makinë, tani për tani praktikisht është vështirë të realizohet e njëkohësisht t'i përgjigjet ritmit të letrave tuaja.

Pas të gjithë atyre ditëve të ngarkuara me aq tension po mundohemi t'i themi vetes se kemi pushuar, por unë vetë jam dobësuar fizikisht. Vështirë është me të vërtetë me u pajtua me faktin se ata nuk janë më fizikisht.

Demonstrata e Bonit shkoi për mrekulli. Ishte më mirë se sa e kishim paramenduar. Uka në fillim, para demonstratës ishte pesimist dhe nuk u angazhua në organizimin e saj. Në telefon, pas demonstratës kur i tregova se si ka shkuar puna, u duk se u nda i kënaqur, por më tha se ishte frikësuar për ndonjë prishje të rendit sepse këtë e ka marrë si punë fëmijësh. Pastaj vazhdoi duke më thënë që thirrjet për demonstrata të mos nënshkruhen në emër të organeve të organizatave sepse kjo po përdoret si shkas për të ushtruar tortura mbi të burgosurit. Nuk ishte dakord që demonstrata të thirret në Vjenë e as tjetërkund. Në telefon më tha se "shiqo se sikur mos kjo është sikur me ndezë zjarr me kashtë dhe vazhdoi se në qoftë se nuk është shpërndarë thirrja për demonstratën e Vjenës në masë të madhe dhe nëse ka mundësi të tërhiqet, le të tërhiqet. Lajmi kishte marrë dhenë edhe pse thirrjet mund të tërhiqeshin, nuk u tërhoqëm.

Në Vjenë vërtetë na pritën befasi. Në thirrje, siç e ke parë demonstrata parashihej të fillonte në ora 11.00 ndërsa arritja e autobusëve në vendin e caktuar filloi nga ora 09.00. Kah ora 09.30 u mblodhën afër 300 veta. Policia erdhi dhe thoshte se nuk keni leje, se dokumenti të cilin ne e kishim për demonstratë është vetëm kërkesa për demonstratë por jo edhe leja. Në anën tjetër shtypi lajmëronte për demonstratë. Policia nuk lëshoi pe dhe duke pritur na detyroi t'i fusim parullat në autobus. Në diskutime e sipër me kalimin e kohës numri i njerëzve shtohej dhe në ora 11.00 ishin rreth 700 veta. Kish nga të gjitha anët e Gjermanisë, Zvicrës dhe Belgjika dhe disa nga Suedia. Gjithashtu kishin dalë disa të Vjenës por jo sa është paramenduar kur të kihet fakti se në Vjenë ka me mijëra shqiptarë.

Ambasada jugosllave ishte aktivizuar në masën e duhur, mirëpo agjentëve të saj u doli më vështirë se sa e kishin menduar. Shumë prej tyre u rrahën dhe u konfiskuam shumë aparate fotografimi.

Këtu është bërë një punë e madhe përpara. Angazhimi i tërë familjes së Sokolit në veprimtarinë patriotike duke gjetur hapësirat e 'demokracisë perëndimore' u dallua aq shumë. Këtë po e theksoj tani për të treguar se kjo familje ka shkri në veprimtari shumë të holla. Kështu mund të thuhet se në mes ndihmave familjes dhe atyre të punës patriotike të cilat u zvogëluan për shkak të të parave nuk ka qenë kurrsesi e mundur të tërhiqet një vijë e prerë megjithëse me të gjitha mundësit këtë jemi munduar ta bëjmë.

Tani jemi duke i rregulluar gurët e varreve....

Që nga 17 janari e deri më sot, në mënyrë të organizuar përveç në tri vende nuk kemi mund me shkua nëpër punëtor. Halimi (Osman Osmani) me tre shokë të tjerë kanë qenë në Zvicër para demonstratës së Vjenës. Kanë shpërndarë thirrjet dhe janë pritur si nuk bënë më mirë. Organi u ka rregulluar shumë terrenin. Unë me ish-arkatarin, para Vjenës isha në Dyseldorf në klubin "Emin Duraku" i cili për rastin e 17 janarit ka ndihmuar me mbi 22000 DM. Edhe aty na pritën mirë. Një nga më të moshuarit më tha: "Nëse sot Kosova nuk çlirohet ju udhëheqësia do të jeni fajtor. Nëse nuk na udhëhiqni e nuk merreni vesh, do t'ju vrasim. Bashkohuni dhe tregoni se ç'duhet të bëjmë dhe për të tjerat shiqo Bacën."

A flet kjo për largim masash apo afrim. Kjo fletë edhe për atë se presioni nga baza për bashkim është aq i madh sa ai që del pengesë në këtë rrugë do të duhet t'a tregojmë. Komunikatën dhe adresat i mora nga sekretari më 2/5-1982 dhe ishin të çelura. Tash nuk e di si thua për atë komunikatë. Çelja e tyre është një punë e keqe. Tani po ta dërgoj këtë adresë të një gjermani. Në këtë mund të shkruash letrat me rëndësi. Gjysmën e kësaj letre po e shkruaj pas bisedës telefonike. Halimi sonte nuk është këtu. Qe dy netë me Hasanin janë në një tjetër vend.

Presioni i policisë në këtë shtëpi po shtohet sepse ata po e vërejnë se këtu ende ka lëvizje dhe këtu ende ka njëfarë burimi. Por ne megjithëse po e dimë se si duhet ende nuk po jemi në gjendje të largohemi nga këtu. Nesër do të vij një marksist gjerman dhe do të ushtrojmë me makinën, teknikën e gazetës. (Është fjala për studimin e disa funksioneve të avancuara të makinës së markës IBM Electronic Selectric Composer, përmes doracakut "Handbook" në gjermanisht, të cilat nuk kisha pasur rast me i mësuar në tërësinë e tyre nga Jusufi - shën i Xh.D.). E di se do të duhej që t'i kontrolloni shkrimet edhe ju me shokët atje. Do t'i fotokopjojmë artikujt dhe po ua dërgojmë që t'i kontrolloni. Unë besoj se edhe ky do të jetë shumë i mirë. Fatoni i ka dërguar dy artikuj, por njëri ishte shumë i ngjashëm dhe i cituar nga Skënder Osumi "Si po shkon Jugosllavia titiste në Kongresin e XII". Prej Abdullah Prapashticës nuk ka ardhë asgjë. Unë i kam përgatitë disa shkrime, por pjesa më e madhe do të jetë e Jusufit. Aftësitë e Ukës në këtë drejtim nuk i di. Fjalët e tij të thëna "punë fëmijësh" në fillim nuk iu kam kushtuar rëndësi fare, por tingëllima e tyre e keqe po vjen duke u rritë. Kur ma the sot atë lajm u gëzova dhe disi po e ndjej njëfarë mobilizimi. Por edhe ndonjë punë e keqe po më demoralizon shumë.

Mirë u pafshim

Skënderi (Xhafer Durmishi)

6. Letër e Xhafer Durmishit për Sabri Novosellën, 22 maj 1982

Shoku Mërgim, 22 maj 1982

Dje e mora një letër nga Xhafer Shatri. Po ta dërgoj të fotokopjuar. Edhe letrat tuaja të dërguara tek shoku gjerman i mora. Do të veprohet asi soji dhe besoj se do të ndikoj pozitivisht. Momentalisht nuk kemi gjetur banesë por sot do të shikojmë një vend për një dydhomëshe që kushton 400 DM në muaj. Në qoftë se nuk është e zënë do të bëhet

shumë mirë. Këtu po ta dërgoj edhe nga një letër që kam marrë nga Suedia dhe SHBA. Jemi duke punuar në dalje të revistës, por prapë se prapë emri i saj po kontestohet e diskutohet. Prej Ankarasë nuk ka ardhë ndonjë material.

Këtu po e përfundoj me kaq.

Të fala

Skënderi (Xhafer Durmishi)

7. Procesverbali i KVG, 11 korrik 1982

Procesverbal i mbledhjes së Komitetit Vëllezërit Gërvalla (KVG) i mbajtur më 11 korrik1982

Rendi i ditës:

Një analizë e punës së gjertanishme

Diskutimi rreth Projektstatutit të Lëvizjes

Puna rreth revistës

Caktimi i datës për takimin e ardhshëm

Të ndryshme

Shtatë të pranishmit (Skënderi, Halimi=Osman Osmani, Naim Haradinaj, Faridin Tafallari, Haxhi Berisha, Hafiz Gagica dhe Nuhi Sylejmani) njëzëri e aprovojnë propozimin mbi rendin e ditës. Skënderi hapë diskutimin rreth pikës së parë.

Fjalën e merr shoku Faridin.

Shpjegim: Në diskutim u vendosë që analiza të bëhet nga 17 janari e gjer më sot. Pritja e njerëzve sipas Faredinit ka qenë e mirë dhe ndihmat për këtë kanë ndikua. Kjo nuk është bërë me një organizim të mirëfilltë por është veprua në atë mënyrë që secili ka veprua si ia ka marrë mendja më së miri. Dalja e numrit të tretë të ZK ka qenë ngjarje e madhe.

Sjelljet e Ibrahim Kelmendit (IK) nuk kanë qenë të mira.

Veprim i ngutshëm nga ana jonë, pra nga Skënderi dhe Haxhiu, si dhe vonimi i Nuhiut që të thotë fjalën e tij me një shumë të hollash prej njëmbëdhjetëmijë DM. Mosmarrëveshja në mes veti për këtë veprim. Demonstratat kanë kaluar mirë. Udhëtimi i Suzanës për në Shqipëri ka qenë në rregull. Formimi i KVG konsiderohet ngjarje e madhe. Riorganizimet në rregull. I dyti jo aq i mirë sepse mungoi Haxhiu. Fushata e shfaqjes së filmave çmohet lartë. Demonstrata e Bonit çmohet lartë e gjithashtu e Vjenës përkundër vështirësive. Haxhiu nuk e sqaroi situatën gjer në fund. Demonstrata e Bernit në rregull. Numri i fundit i revistës dhe komunikata të mira. Me kaq shoku Faridin e mbylli fjalën e tij.

Pas kësaj Skënderi i drejtohet Nuhiut që ta merr fjalën por ai përgjigjet se don të dëgjoj të tjerët e vetë do të flasë në fund. Të tjerët pajtohen me këtë.

Fjalën e merr Naimi:

Pritjen e quan të mirë megjithëse ram në konflikt me IK. Hapat tonë i quan të drejtë sidomos përjashtimin e tij nga shtëpia e Jusufit. Edhe Nuhiu ka qëndrua mirë një kohë të gjatë në pritjen e njerëzve. Marshet protestuese në rregull. Varrimi kishte me qenë më i mirë sikur për incizimin me video kamerë të angazhohej një punëtor profesional. Numri i tretë i revistës i realizuar mirë. Demonstrata e Vjenës më e mirë se e Bonit. Formimi i KVG me vend. E sheh si rënie dhe në kundërshtim me komunikatën. Heqja e citatit të JG e gabueshme. Me kaq Naimi e mbaron fjalën e vetë.

Haxhiu: Pritja në rregull. Për shkak të mos organizimit më të mirë kanë lindur mospajtime. Ka pasur sabotim dhe zhagitje të punëve nga ana e IK. I është tërheq vërejtja disa herë. Sipas mendimit tim ai nuk ka jetuar fare me atmosferën ato ditë. Angazhimin

e një punëtori profesional për incizimin e varrimit e quan të panevojshëm. Përmes formimit të KVG u vazhdua puna e mëparshme. Vështirësitë me demonstratën e Vjenës kanë të bëjnë me qëndrimin anësor të policisë të cilët na thonin herë po e herë jo. (Haxhiu ka qenë i angazhuar për leje dhe ka bërë një udhëtim gjer në Vjenë ditën e enjte më 22 prill 1982). Megjithatë këtë e çmoj më shumë se të tjerat.

Halimi (Osman Osmani): Formimi i KVG i domosdoshëm (ky ia fillon nga kjo ngjarje pasi më parë nuk ka qenë këtu). Puna ka vazhdua por ka pasur dobësi. Për shkak të mos përvojës mund të kemi bërë gabime, por largimi i tij nga familja i mirë për të mos thënë i domosdoshëm. Gabim strategjik që ia kemi thënë të gjitha. Puna e komitetit dhe vetë ekzistenca e tij kanë qenë formale.

Nuhi Sylejmani: Pritja ka mund me qenë më e mirë, por ngjarje të tilla të befasishme s'kemi mund ndryshe. Nuk është i kënaqur. Pritja ka qenë formale. Nuk kemi diskutue në mes veti. Ditën e varrimit nuk dilnin njerëzit prej dhome. Ka shkua si në diktaturë. Video filmimin e varrimit është dashur ta bëjë një profesionist ashtu siç thotë Naim Haradinaj. Formimi i KVG i mirë por është dashur më parë të formohen celulat e pastaj komiteti dhe jo anasjelltas. S'kemi pasur asnjë shokë afër veti. Organizimi i brendshëm jo i mirë. Dekonspirimin e dënon dhe e quan krim të madh.
Veprime me gjaknxehtësi dhe pa marrëveshje i kanë dhënë IK fakte për sulm megjithëse përjashtimi nga shtëpia e Jusufit ka qenë i drejtë.

Udhëtimi i Suzanës në Shqipëri mirë, megjithëse nuk jemi marrë vesh në mes veti. Demonstrata e Bonit e mirë por me Skënderin ka pasur mosmarrëveshje sepse kam brohoritur Kosova-Republikë dhe lavdi Marksizëm-leninizmit e ai më ka thënë mos bëjë ashtu. (Shkaktohet një qeshje kur Nuhiu thotë se më ka thënë mos thuaj Kosova-Republikë, Marksizëm-Leninizëm dhe Nuhiu e përmirëson veten dhe thotë se më ka thënë vetëm mos me brohoritë Marksizëm-Leninizëm.

Skënderi: Moskuptim ka pasur me shokët e Zvicrës dhe të Dyseldorfit lidhur me atë që të lexohen nga dy referate. Shfaqja publike e dyshimeve ndaj IK e gabueshme. Demonstrata e Vjenës përkundër vështirësive është historike sepse është demonstrata e parë shqiptare që bëhet për Kosovën në Austri. Përgjigjja e masave në thirrjet tona është fakti më demantues kundër gënjeshtrave se njerëzit janë dëshpëruar.
Mbyllet pika e parë.

Lexohet projektstatuti në dorëshkrim. Në përgjithësi nuk kishte vërejtje ndaj tij. U vendos që të shtypet dhe të shpërndahet për diskutim e gjithashtu të shërbej si bazë për formimin e celulave të reja.

Nga Skënderi u lexua letra e Abdullah Prapashticës (Kushtrimit). Datë nuk kishte, andaj duhet ta veçojmë me titullin: "Të dashur shokë! Të analizohet". Kjo letër paraqiti disa risi të të shkruarit sepse letra të formuluara në atë formë para këtyre shokëve ende nuk janë lexuar. U vërejt edhe brengosje pse gjithë ato materiale teorike, ligjërata, artikuj e shpjegime të ndryshme, pasi na tregohet se ekzistojnë, thuhet se u gjetën të bllokuara. 'Pra ne kemi shumë nevojë për ato materiale të nevojshme'. Letra e Kushtrimit u kopjua me nga një ekzemplarë për secilin pjesëmarrës.

Skënderi duke ju referuar udhëzimeve të Kushtrimit që të organizohemi sa më shumë edhe nëse në fillim ai të duket formal dhe shton: Ne e kemi formuar një komitet të vetëm (VG) dhe nga kryetari i tij momentalisht po na thuhet se e kemi formuar pa asnjë shokë afër, e në anën tjetër thirremi që të formojmë kaq organizata e forume dhe përfundoi se me të vërtetë vlerësimet e Nuhiut dhe Kushtrimit janë diametralisht të kundërta. Nuhiu pa e kuptuar shpjegimin tim nxehet duke menduar se kam diçka ndaj vlerësimit të tij. Më tutje Skënderi thotë: Nga një drejtim i KQ të LRSHJ ka ardhur një letër ku kërkohet të shpjegohet çështja se a po largohen punëtorët apo nuk po largohen. Pasi Halimi (Osman Osmani) ka dërguar lajme se punëtorët po na largohen ndërsa Skënderi njëkohësisht ka

raportuar se jo vetëm që nuk po largohen por po na afrohen. Për këtë ai këtë çështje e shtron para të gjithëve që të japin vlerësimet e tyre.

Nuhiu e merr fjalën dhe thotë: Po është e vërtetë se njerëzit po na largohen. Në pyetjen se a po u largohen disa njerëzve apo luftës ai përgjigjet: Po na largohen neve, disa vetave, se po ikin prej nesh si prej dreqit. ... Faridini ndërhynë dhe thotë flisni qetë, se më mirë po shkon dhe Nuhiu le ta përfundoj fjalën e vetë. Nuhiu vazhdon: E mirë pra-unë jam dreq. Unë (Skënderi) në këtë kohë nuk i kam në dorë fletët e procesverbalit. Kur i marrë ato prapë që të shënoj fjalën e çdonjërit, ai thotë se nuk thash ashtu. Halimi duke e ditur se është ai i cili e ka informuar KQ se po largohen njerëzit e merr fjalën dhe thotë se këtë e kam bërë me telefon, se ashtu e kam pasur përshtypjen. Prej të tjerëve asnjë nuk ishte i mendimit se njerëzit po na largohen, as neve e as luftës. Nga ky forum u kërkua nga Nuhiu e Halimi që t'i përgatisin me shkrim vlerësimet e tyre duke i bazuar ato me shembuj konkret dhe t'i raportojnë KQ.

Në lidhje me këtë pikë të hapur diskutimi zgjerohet. Në kohët e fundit ka pasur një konflikt në mes Skënderit e Halimit. Si shkak mund të merret një banesë e Nuhiut. Sk i thotë Nuhiut se pse ti me i thënë një njeriu në Shtutgart se këta djemtë po më bëjnë dallavere dhe a mund ta argumentosh këtë. Nuhiu thotë se kjo është çështje private dhe do ta shqyrtoj me atë punëtorin.

Gjithashtu Faridini i drejtohet Nuhiut me fjalët se pse po i përhapë disa fjalë nënçmuese për djemtë duke thënë se edhe filloren e kanë marrë privatisht e kanë ardhë të lavdërohen si studenta. Nuhiu thotë se a është gjallë Qemal Haxhillari (fqinji i parë i Faridin Tafallarit i cili kohëve të fundit është shoqërua më shumë me Nuhiun). Më pas Nuhiu hidhërohet duke i ndryshuar fjalët para të gjithëve herë pas here. Në një moment ngrihet në këmbë dhe thotë: Eh me kend kam mbetë me folë dhe me këto fjalë largohet. Pra ai u largua vetë dhe iku.

Me kaq edhe mbledhja u mbyll, të gjithë të dëshpëruar me sjelljen jonjerëzore të Nuhiut. Në lidhje me largimin dhe shenjat e tij kohëve të fundit KVG do të përgatitë një material të veçantë, si dhe për ndikimin e Halimit dhe punën e tij prej se iu ka bashkua KVG.

Procesmbajtësi

Skënderi (Xhafer Durmishi)

PS. Në pikën tre u diskutua rreth revistës. Më përafërsisht për të foli Sk. Ai tha se puna rreth revistës duhet të filloj menjëherë. Për këtë hap i parë është që makina të vendoset tek shokët gjerman. A pyeti të pranishmit se a ka dikush që të propozoj ndonjë zgjidhje, a don t'a shtroj këtu para nesh, apo don ta thotë në mënyre individuale apo të na thuhet 'bëni si t'ua merr mendja', dhe kjo çështje të mbetet për ata që janë përgjegjës për revistën. Pas një heshtje Nuhiu tha: 'Bëni si të doni!'

8. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 13 korrik 1982

Shoku Faridin, 13 korrik 1982

Projektstatutin do ta shtypim sonte në makinë dhe do ta dërgojmë sa më shpejt me postë. Ulu e bisedo pak me Qendin por pa i dhënë diçka. Prej neve mos të del fjala. Për

këtë të shtunë tuboi shokët. Lexojua projektstatutin, por kopje të tij nuk ke nevojë t'u japësh. Pra thirre një mbledhje me këtë rend dite:

1. Leximi i Statutit (të përkohshëm të LRSHJ).

Në të vërtetë ti ua lexon si me qenë statut i vërtetë që të shohim se a po u pëlqen.

2. Situata momentale.

3. Të ndryshme

4. Caktimi i mbledhjes së ardhshme.

Për situatën momentale folu për atë në Kosovë, ku dje erdhi një shok i Haxhiut dhe tha se ka shumë milici e ushtri. Milicët serb bajnë "shlema" e ata shqiptarë jo. Parulla ka vazhdimisht dhe kudo. Sa i përket neve, edhe ne do të bashkohemi me situatën në Kosovë. Lufta e armatosur duhet të shtyhet edhe për një kohë. Ne duhet akoma të zhvillojmë luftën me mjete demokratike dhe në këtë mënyrë të vazhdojmë ta dobësojmë armikun tonë. Lexojua edhe artikullin e Ademit "Kthimi" dhe krahaso atë se për çka mundohet Ademi, e për çka brengoset Nikolla Pano. Në pikën 3 të rendit të ditës ata le ta marrin fjalën vet dhe të diskutojnë dhe le të bëjnë pyetje çka t'u intereson e ne i përcjellim me shkrim.

Me kaq prit të fala nga Skënderi (Xhafer Durmishi)

(Faridin Tafallari, T-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f.435)

9. Letër e Xhafer Durmishit për Sabri Novosellën, 14 korrik 1982

Shoku Mërgim, 14 korrik 1982

Këtë letër po ia dërgoj njëkohësisht edhe shokut që ka ardhur kohëve të fundit jashtë (XhSh).

Me këtë letër do të mundohem që në maksimum t'i qëndroj besnik realitetit. Kush janë ata të cilët Halimi (Osman Osmani) i ka raportuar tek ju si rrugaç?

1. Hafizi, 23 vjeçar nga Gjilani, i malësisë së Karadakut. Ka mbaruar shkollën e mesme dhe regjistruar diçka në Prishtinë. Babai i tij qe 10 vjet ka punua në Ludwigsburg. Nëpërmjet babait ka ardhur në Gjermani dhe është njohur me Bardhin e Jusufin. Gjatë demonstratave të vitit të kaluar është treguar shumë aktiv dhe siç kam shkruar në një letër tjetër ka qenë hija (përcjellësi) i Jusufit. Në të vërtetë edhe për numrin 1 të Lajmëtarit të lirisë i ka dhënë 200 DM. Është depërtues dhe ia hynë punës në një mjedis ku nuk është punuar më parë. Është i martuar. Në banesën e babës së tij kemi qëndruar shumë, me muaj të tërë. Nga banesa e tij Jusufi e ka nisur telegramin dërguar Partisë së Punës gjatë fillimeve të Kongresit të VIII. Babait të tij ia kanë marrë pasaportën. Hafizi kurrë nuk ankohet.

Halimi i ka thënë një ditë se babën ta kanë ndalë në shtëpi pasi që ka qenë organizimi i dobët. Unë po i tregoj këto cilësi sepse për anën tjetër sigurisht mund të jeni të informuar.

2. Naim Haradinaj, djali i Ismailit, i dënuar me 14 vjet burg, ndërsa vëllau i tij është dënuar me 5 vjet. Në shtëpi ka nënën, gjyshen, një vëlla të vogël dhe një motër. Gjendjen ekonomike e kanë pasur shumë të mirë por ajo po vjen duke u vështirësuar për shkak të mungesës së krahut të punës. Për Naimin disa herë ka shkruar shtypi. Është i pari që e ka dërguar në Kosovë Lajmëtarin e Lirisë. Ka kryer edhe shumë aksione tjera. Ne Gjermani gjatë vitit të kaluar jo vetëm që nuk është kursyer por të gjitha të hollat çka ka punua i ka shpenzua në rrugë për organizimin e demonstratave. Sigurisht mërzitet, e sidomos pas 17 janarit nuk duket se është ai që ka qenë.

3. Haxhi Berisha, 22 vjeçar. Është detyruar ta ndërprej shkollën e mesme pasi ju ka djegur shtëpia dhe është detyruar të vij në Gjermani. I ka ndihmua në fillim Bardhi,

por shumë pak pasi menjëherë është mësuar me mjedisin e këtuhit. Është shumë praktik. U ka gjetë punë në firma gjermane shumicës prej nesh. Sa i përket demonstratave vlejnë të njëjta sikurse për Naimin. Është nip i Jusufit. Ka qenë tri herë në Kosovë me materiale deri në nga 1000 ekzemplarë dhe në të tri rastet ka kaluar me sukses. Duket se e kanë hetuar punën e tij dhe nuk mund të marrë më rrugët që ka bërë më parë. Më 1979 i ka mbajt 3 muaj burg.

Këto janë në pika të shkurta disa të dhëna për këta të rinj që kanë bërë punën më të madhe në rrethin e Shtutgartit.

Sa i përket nen temës së dytë, në këtë letër lidhur me çështjen "se a po na largohen masat apo jo" puna qëndron kësi soji. Vrasja e tre shokëve mund të merret me mend se sa ka ndikua. Humbja e një njeriu po duket se mund t'ia ndryshoj kahjen një shteti 700 milionësh e lere më sa mund ta dëmtojë një shoqëri të ngushtë. Po ju them, e mund ta dini edhe vetë, se Jusufi nuk ka pasur kohë me u marrë me punë organizative, megjithëse në atë drejtim është punua. Njerëzit që kanë qenë pak më larg, gjërat i idealizojnë, sidomos pas ngjarjes i kanë bërë të shenjta. Kjo ka të bëjë pra vetëm me atë planin sipërfaqësor.

Ekzistojnë disa individ që thonë se unë kam qenë afër këtyre punëve gjithmonë e kam qenë me Jusufin bashkë, etj. etj. Në këtë ekstrem është sidomos Nuhiu i cili të bëhet monoton duke thënë se "u takojshim ata të tre si intelektual dhe më marrshin mua mbas veti si klasë punëtore" pra një njeri tek i cili masat janë të mbështetura. Pra ky është kampion në mesin e atyre që brohorasin kudo se Jusufi më ka marrë me veti, se disa gjëra vetëm me mua i kanë biseduar etj. etj. Ky njeri është ai i cili ka lëshua fjalët se masat po na largohen. Këto fjalë i ka thënë në konsultim me Halimin. Të tjerët këto vlerësime i kanë kundërshtuar vendosmërisht, ndërsa unë që para të dyve përhapjen e këtyre vlerësimeve e kam quajt punë armiqësore. Diçka më shumë për këtë do të kuptosh nga procesverbali i mbledhjes së KVG e gjithashtu edhe një nga një raport të cilin u angazhua ta dërgoj Halimi lidhur me këtë çështje. Por lidhur me disponimin e masave pyeteni edhe Xh. Shatrin. Ai tha se pata dëshirë ta shohë këtë lëndë me të cilën do të kemi punë dhe ishte i mahnitun.

Disa veprime të Halimit: Tre apo katër përfaqësuesit PKMLSHJ thonë se kanë dalë jashtë me i bashkua njerëzit se këta nuk e paskan ditë se duhet dhe është mirë me u bashkua, se e paskan ditë se bashkimi bënë fuqinë etj. Dhe këto qëndrime bajate i mbajnë dhe llomotisin edhe atëherë kur të tjerët për këtë çështje kanë dhënë jetën. Strategjia e tyre thonë është kjo: Ata ia kanë tërhequr vërejtjen shtetit (Jugosllavisë) me nota zyrtare, se po nuk u ndërmorën masa do të bëhet ajo çka u bë. Pra edhe në këto punë qëlloi dhe fitoi lotaria. Dhe tani pasi qeveria mori guximin e të çmendurit e nuk ia vuri gishtin kokës para një note të tillë duhet ta dijë më mirë se me kend ka punë dhe kujt ka guxua me ia kthye fjalën. Në të vërtetë sipas fjalëve të Halimit, pas Kongresit të XII të LKJ, puna duhet të ndryshoj plotësisht. Duhet të ndryshohet taktika dhe të kalohet në kërkesë për bashkim kombëtar. Lidhur me këtë kur ishim duke përgatitur gazetën, patë thënë se ndoshta ky do të jetë numri i vetëm që do të bëhet në këtë formë, sepse pas Kongresit të XII ndryshe do të jetë. Pra populli i Kosovës duhet të luftoj për bashkim por vetëm atëherë kur këtë të ia lejon Partia. Unë e kundërshtova shumë në këto lëkundjet e tyre. Këto si duket ia ka përcjellë përgjegjësit të vetë dhe e ka marrë vesh se ashtu nuk shkon. Ajo vërehet edhe në shpjegimin 'gjenial' në letrën e tij të fundit 'se kjo punë nuk mvaret nga ne.'

Kushtrimi i ka dërguar disa letra dhe Halimi ua ka lexua disa shokëve siç të kam treguar në një letër të gjatë. Ata shumë pikëpamje nuk ia kanë pranuar kështu që Halimi i ka tërheq. Letrën tënde dërguar KVG e lexova para shokëve dhe është pranuar mirë. Halimi më tha se pse nuk po i lexon para shokëve edhe letrat e Kushtrimit. I thash mi sjell. Riorganizimin e udhëzuar e quajti formal si dhe krejt punën dhe ekzistencën e KVG.

I fryri në vesh edhe Nuhiut me fjalët ‘se zgjedhja jote është formale, duke i thënë se ti je një njeri i madh por fjala jote nuk po të dëgjohet.’ Dhe kur këto fjalë iu bashkuan edhe me ato prapështitë e veta i mjaftuan që ai ta filloi një propagandë të keqe sidomos ndaj Hafizit dhe për të tjerët duke u thënë se janë të pashkollë dhe lavdërohen se po bëjnë punë të mëdha. Edhe ato fjalët se nuk kishim shokë afër veti, e formuam komitet ua atribuon këtyre të treve duke thënë se nuk ka qenë nevoja të futen në atë rreth. Këtë pikëpamje e mbron edhe Halimi duke thënë se, apo duke e përmirësuar këtë, se në komitet hynë njerëz jo që nuk kanë shokë, por që nuk kanë celula të formuara duke nënkuptuar me këtë, këta tre shokët që i kam përmendur më lartë. Prandaj largimi kaq i shpejt i Nuhiut është meritë e Halimit. Se ai do të largohej është vërejtur sidomos kur i kanë ardhë shoqja dhe fëmijët. Kështu që iu bënë shumë. Frika është një arsye tjetër.

Thuaju le t’i koordinojnë më mirë mendimet. Në njërën anë Kushtrimi thërret për formimin e njëqind organizatave të brendshme duke i ndarë njerëzit në funksione të ndryshme, dhe shton se nuk prishë punë aspak që kjo punë të duket formale, ndërsa Halimi për të vetmin komitet të formuar, që është i vërtetë dhe real, e quan formal dhe që prishë punë, se po të ishte degë, apo ‘front demokratik’, organizatë e grave, apo shtab i ushtrisë së kuqe shqiptare, edhe pse formal nuk do të prishte punë. Makinën me të cilën përgatitet gazeta kam vendosur ta dërgoj tek një shokë që banon larg nga këtu, dhe do të shkoj unë vetë që të merrem me atë punë. Pasi edhe ashtu, sipas marrëveshjes së 15 majit 82, është vendosë që Halimi të merret me çështje organizative në Kosovë e Uka me punë organizative jashtë ndërsa unë të merrem me gazetën. Sa i përket gazetës, pasi kjo është çështja jonë kryesore, unë jam i mendimit që kompetencat më të mëdha ti jepen Xh. Shatrit. Sido që të jetë në këtë drejtim do të fillojnë punët menjëherë.

Shumë të fala (Xhafer Durmishi)

10. Letër e Xhafer Durmishit për Xhafer Shatrin, 6 gusht 1982

Shoku Llesh (Xh. Shatrit) 6 gusht 1982

Sot e mora një letër së bashku me artikullin e Le Mondit.

Në Bruksel, siç ju ka njoftuar edhe shoku F (Faridin Tafallari) nuk mundëm të shkojmë pasi në këtë drejtim na pengoi policia e Belgjikës.

U kthyem në Dyseldorf. Prej orës 3 pas mesnate gjer ne 7 të mëngjesit zhvillova disa bisedime me IK, të cilat u mbështollën dhe u ngrit toni. Aty u fol shumëçka por esenca e disa kërkesave të IK qëndronte më shumë në çështjen se të gjitha sendet e thënuna kanë dalë prej një pike, duke m’u drejtuar për këtë mua. Çka e kam thënë unë vet nuk e mohoj para askujt. Për këtë nuk po zgjatem shumë se disa çështje duhet t’i diskutojmë në një tubim së bashku të cilin duhet ta thërrasim pa vonesë.

Kontaktin me Mitat Vranicën e kam marrë përmes një shoku të tij në Augsburg ku isha para tri javësh për të shfaqur filma. Ai far burri i Augsburgut kur shoku ynë ia ka dhënë revistën tonë ”Zërin” ai në të njëjtin rast ia ka tregua në besim një tub letrash të korrespondencës së tij të dendur me Mitat Vranicën. Ky punëtor në Augsburg quhet Rexhep Sadiku dhe është dervish i rrethit të Gjakovës. Atë ditë kur ishim për filma na ka bërë muhabet të madh. Ka shpërndarë shumë artikujt e Zërit të Popullit dhe ka një bibliotekë të pasur me literaturë të shëndoshë. Është burrë afër 50 vjeçar.

M. Vranicës unë deri më tani nuk i kam shkruar asnjë herë. Për këtë vendosni (ti e SN). Sa i përket N. Dibranit, para një muaji Kameri (SN) i ka dërguar 18 adresa të ndryshme, në mesin e të cilave e ka dërguar edhe të N. Dibranit me nënvizimin se në këto

adresa mund ta dërgoni revistën. Më tepër unë nuk di për te. E kemi edhe adresën e djalit të Metushit dhe më duket se me te mban korrespondencë Kamberi (SN.)

Në lidhje me çështjen e artikullit të Ademit unë them se ai duhet të botohet duke u nisur nga ky numër pasi e kemi paralajmëruar lexuesin për vazhdimin e tij dhe mendoj se ai artikull është vazhdim i artikujve të botuar më parë. Lexuesit e presin e nuk e di se a do të bëhet mirë me e lënë. Unë mendoj se ai shkrim duhet të ndahet në dy vazhdime. Sot fillova nga puna për radhitjen e revistës dhe besoj se së shpejti do t'i adaptohem një ritmi më të lartë të punës.

M'i dërgo disa kopje qekash për "Ndihma për Kosovën" që të bëjmë adaptime e kopje analoge për punëtorët në Gjermani. E angazhojmë në këtë drejtim, për adaptim A. Me udhëzime për adaptimin e tyre duhet t'u drejtohemi edhe shqiptarëve në ShBA, Australi, Suedi, Francë, Austri etj.

(Xhafer Durmishi)

11. Procesverbali i rrethit të Shtutgartit, 26 shtator 1982

Procesverbal i mbajtur gjatë takimit (të datës 26 shtator 1982) të thirrur nga ana e një grupi punëtorësh më aktivist të rrethit të Shtutgartit

Rendi i ditës:

Çështja e Nuhi Sylejmanit dhe pasojat e fjalëve të tij,

Situata momentale

Të dymbëdhjetë të pranishmit e aprovuan rendin e ditës. Në këtë tubim para të gjithëve ka qenë i thirrur Nuhiu (Nuhi Sylejmani) dhe Halimi (Osman Osmani). Tubimi u mbajt 5 km larg banesës së Nuhiut në fshatin D. në pjesën më të madhe në një lokal të qetë, në dhomën e veçuar të një kafeneje.

Nuhiu ftohet dy herë që të vjen në tubim. Në radhën e parë për ta marrë shkojnë Abdurrahman Sadiku, Qemal Haxhillari dhe Murat Kryeziu. Në banesën e tij kishte hyrë vetëm Abdurrahmani, i cili ishte i bindur thellësisht se do t'i përgjigjet thirrjes dhe do të vij, por nuk pati sukses. Pas një ore diskutimi më të lirë duke e parë nevojën shkojnë për ta marrë: Murat Kryeziu, Qemal Haxhillari dhe Nami Ramadani. Të tretë hyjnë në banesë dhe ia shpjegojnë çështjen. Lidhur me shpjegimin e Nuhiut për mosardhjen e tij ata që kishin shkuar me e marrë deklaruan:

Nami Ramadani: Nuhiu tha unë nuk vij sepse e kam drejtimin tim, jam i lidhur me tjetër kend, unë i kam principet e mia. Nuk vij pasi nuk qenka Naimi (Haradinaj). Kur i thash se Naimin ta sjell për dy orë Nuhiu u tërhoq dhe tha prapë se nuk vij.

Murat Kryeziu: Nuhiu më tha se unë nuk përzihem më në politikë, ju vazhdone rrugën pa mua.

Hasan Veselaj: (mysafir i Nuhiut në atë moment i cili kohëve të fundit është shoqërua me Nuhiun dhe Halimin, të cilin e kishin marrë këta të tre): Unë i thash Nuhiut disa herë se duhet me ardhë e me u takua pasi të gjithë po e shohin të arsyeshme, por ai nuk pranoi kurrsesi.

Pasi ai në asnjë mënyrë nuk pranoj me ardhë u vendosë që mbledhja të filloj edhe pa te. I pari nga të pranishmit e mori fjalën Mejdi Rexhaj, i cili duke qenë shumë më afër situatës (shokë i celulës dhe i punës me Nuhiun) e shtroj çështjen se pse Nuhiu veproj

kësi soji në këtë kohë duke kërkuar edhe faktor të jashtëm. Meqenëse kjo temë u hap që në fillim, të pranishmit qenë të mendimit që i pari ta merr fjalën Skënderi i cili foli në mënyrë të përgjithësuar.

Skënderi: Së pari e shohë të arsyeshme t'u flas në lidhje me bashkimin duke ju referuar edhe Komunikatës të botuar në revistë (ZK) në qershor 1982. Lidhur me aq sa jam i njoftuar nga shokët mund t'u them se ZK ka mbetur si organ qendror i LRSHJ me kërkesën e disa shokëve mu për hir të Jusuf Gërvallës. Ky qëndrim është aprovuar plotësisht nga ana e OMLK-së edhe pse me këtë veprim mund t'ju ketë hapur goja ndonjë fjalamani në stilin: a e shifni, kjo më e mirë e ajo mbaroi etj. Kjo nga ana jonë kurrë nuk është lejuar në asnjë moment sepse për shkaqe që dihen veprimi në këtë drejtim ka qenë absurd. Shokët e OMLK-së kanë qenë të mendimit që ZK të mos pësoj asnjë ndryshim, por ndryshimet që janë bërë kanë qenë për të plotësuar disa kërkesa të PKMLSHJ. Halimi është një prej personave më kryesor të kësaj ish-organizate dhe ai ka ardhur me mua nga Turqia për ta ndihmuar çështjen. Me te nuk kemi pasur mosmarrëveshje derisa kemi filluar me përgatitjen e numrit 1 të ZK. Aty na kanë dalur mosmarrëveshje rreth çështjes kërkesës për republikë dhe bashkimit, e sidomos rreth citatit e gjithashtu edhe rreth nënshkrimit të artikujve të Jusufit duke thënë se ata duhet të nënshkruhen me pseudonime. Në Turqi ka shkuar pa u konsultuar me asnjërin nga ne dhe atje ka filluar të gënjej por kur nuk ju kanë shitur ka ndërrua qëndrim. Për shkak të kritikave me të cilat është nënvlerësuar puna e mëparshme dhe e tanishme i është thënë që të punojmë të pavarur në pikëpamje organizative, e raportimi të bëhet në qendër dhe vetëm atëherë të shikohet se çka është për t'u lavdëruar e çka për t'u kritikuar. Insistimin për heqjen e citatit të JG e ka bërë me arsyetimin se nuk ka luftuar vetëm Jusufi dhe me përmendjen e tij (përsëritjen e citatit) u hyjmë në hak luftëtarëve tjerë. Me shokët në Zvicër puna është duke shkuar mirë. Ata janë duke bërë punë të madhe.

Hasan Veselaj: Kur është problemi i revistës? Pse po del kaq rrallë?

Skënderi: Kryesorja është tek çështja financiare. Shokët e kanë pa të arsyeshme që edhe në lexofshim më rrallë, familjet e shokëve të burgosur mos t'i lëmë anash.

Hasan Veselaj: Pse ne në rrethin e Shtutgartit nuk e marrin këtë problem me dhënë të holla se unë nuk jam i informuar?

Nami Ramadani: Ne për këtë punë kemi mbledhur të holla, por në këtë kohë na humbën shokët dhe kemi pasur shpenzime të mëdha, e gjithashtu kemi qenë shumë të zënë. Kur ke qenë ti Hasan tek Nuhiu ne e kemi rrahur këtë problem. Tash është edhe më lehtë sepse ka dalë kontoja në ZK e fundit. Unë i kam tre dëshmitarë që Nuhiu ka dalë sivjet dhe ka bërë propagandë kundër luftës, duke u thënë se sikur t'i kisha këmbët me zift do të shkelsha nëpër pare e në këtë konto nuk do t'i qoja e ata njerëz prapë se prapë kanë ardhur dhe kanë dhënë të holla. Ai ka thënë se të gjitha ato të holla që janë mbledhur vjet janë humbë. Për këtë fjalë kam dëshmitarë dhe kërkoj të del para të dyve e ta thotë të vërtetën.

Hasan Veselaj: Pse një shokë i afërt me u lejua me propagandua kundër organizatës?

Abdurrahman Sadiku: (shok i punës i Nuhiut): Është vështirë me u përgjigj. Ne një ideal na ka bashkuar. Për patriot e kemi njoft. Kohëve të fundit u largua prej shoqërisë sonë. Së pari qëndroi shumë tek familja Gërvalla e thoshte se nuk po kam kohë me ardhë

tek ju. E në anën tjetër ai u distancua sidomos pasi i erdhi gruaja dhe fëmija e vetë. Prandaj shënone se sot është dita e fundit kur ai u largua përfundimisht më 26 shtator 1982.



Abdurrahman Sadiku majtas dhe Faridin Tafallari (Shtutgart 2012)

Nami Ramadani: E kam një shoqëri që ka pasur besim në Nuhiun. I kam tregua qe nëntë muaj që të shkoj dhe kërkoj ndihma se ata më kanë thënë se Nuhiut i besojmë sepse e kemi edhe të afërm por ai kurrë nuk ka ardhur.

Hasan Veselaj: Pse para ca kohe mos me u bashkua me Nuhiun e me bisedua?

Nami Ramadani: Ne kemi pasë takime dhe në të gjitha takimet na thoshte: Kështu thotë Skënderbeu e ashtu Hafiz Pasha e veten gjithmonë të kristaltë.

Skënderi: Të holla tubohen për familje të burgosurish e të tjera edhe për gazetë.

H. Veselaj: Unë propozoj që në çdo shtet të hapen konto numra!

Skënderi: Një organizatë e ka vetëm një njeri më përgjegjës, ajo e ka vetëm një konto numër e në faqet e fundit falenderohen edhe ata që kanë dhënë të holla nga të gjitha shtetet.

H. Veselaj: Unë mendoj që në çdo shtet të ishin botuar qekat.

Skënderi: gazeta jonë nuk e ka për qëllim reklamën. Ne po na mbesin artikuj të fortë pa u botuar për shkak të vendit.

Murat Kryeziu: Unë e kam lanë mysafirin vetëm. Desha të jem këtu për këtë çështje e ai nuk erdh. Unë jam punëtorë e nuk po di shumë se kush është i mirë e kush jo, por po e di se dikush është mundua me e shkatërrue këtë punë. Nuhiu më ka thënë se pas atyre të Zvicrës duhet të çelim konto edhe ne të Gjermanisë.

Faridin Tafallari: Kemi pasur biseda për shtypin. Është thënë prej Jahir Jahirit (Jahiri dhe rrethanat rreth shokëve të tij meritojnë një letër të veçantë-vërejtje e Skënderit), se ZK pas 17 janarit është edhe më i mirë se sa ka dalë më parë dhe, këtë të fundit e pohuan edhe Murat Kryeziu (MK), Abdurrahman Sadiku e Ismet Klaiqi. Jahiri është ai i cili më së shumti e ka kërkuar këtë takim. Tani ai thotë se po e qesin fotografinë e Jusufit tepër në ZK, se ZK më duket qe 10 vjet e ka qitur Riza Salihu e mandej ia ka marrë Jusufi. Pse nuk po e qesin Adem Demën-Demaçin në faqe të parë. Pse e kanë qitë Hydajetin kur ai ende është gjallë? Pse nuk po shkruajnë edhe për Ferizaj por vetëm për

Pejë, pse nuk e qesin Fazli Graiqevcin etj. etj. Unë i kam thënë mblidhë artikuj, adresën e ke dhe dërgoj. Por më duket se këto fjalë nuk janë tuajat.

H. Veselaj: E kam dëgjuar një rast kur isha tek Nuhiu e Ismet Klaiqi, dhe se është folë nga këta dy të fundit për qitë Hafizin se në Augsburg ka thënë se unë jam ai që po e udhëheqi këtë revolucion, e kur këto fjalë dëgjohen për një shok nuk janë të mira.

Ismet Klaiqi: Unë kam telefonua në Augsburg, e ata më thanë ti (Hafiz) na ke dërgue njerëz që po bëkan kushedi se çfarë pune revolucionare, e atëherë unë kam shkua atje. Ata më thanë se Hafizi na ka kritikuar duke thënë se nuk po punoni, dhe na tha se unë ju kam treguar demonstruesve në Bon së bashku me një gjerman se kah me ecë.

Hafiz Gagica: Unë kam qenë me Faridinin. Nga ai në asnjë moment nuk jam nda, prandaj le të flas ai vetë.

F. Tafallari: Kemi qenë në Ingolshtat, kemi shfaq filma e kemi shpërnda libra dhe gazeta. Shumë në rregull ka qenë. Kah jemi kthye u ndalëm në Augsburg me propozim të Hafizit. Shkuam aty dhe na priti një shok i mirë. Filluam bisedën për Shaban (Klaiqin) (i burgosur në dhjetor të vitit të kaluar, është dënuar me tri vite burg së bashku me Islam Rafunën). Janë zënë në kufi duke e futur numrin e parë të ZK, nëntor 1981.) Tregoi se po mbahet shume krenar. Për Ismetin (Klaiqin) tha se është i mirë por nxehet shpejt. Sa u përket filmave tha se ka njerëz që frikohen, por të gjithë duan të ndihmojnë dhe janë të mirë. Zëra kemi mjaft. Dhe në fund na thanë; djema keni kujdes, se prej pakujdesie i humbëm shokët. Unë i thash se ne duhet me ec, e ne kurkushi nuk jemi.

Murat Kryeziu: Nuhiu më ka thënë se Hafizi në Frankfurt ka kërkuar ndihma në emrin e Familjes Gërvalla, se atyre djemve nuk u ka mbetur kush në Sindelfingen përpos Selim Koca. Unë due me e ditë se kush po i bënë këto punë?

F. Tafallari: Nuhiu ka banua tek unë. Qemal Haxhillari ka qenë taksist i tij. Në lidhje me shfaqjen e filmave Nuhiu më ka thënë se pse po i shfaqni. Kemi metoda tjera të luftës. Kur i thoja tregomi ato metoda ai përgjigjej; ti po e shef unë i kam problemet e mia, e në anën tjetër fliste se po udhëtojnë e shfaqin filma duke i harxhuar të hollat e familjes Gërvalla. Më ka thënë se po shkoni e po i prishni shoqëritë duke shkua e duke ju shfaq filma. Unë i kam thënë, baca Nuhi po gabon se unë e kam rrogën time e më mjafton me jetua e bile edhe me u shetit parqeve ditëve të vikendit, e po të isha me i këqyrë problemet e mia nuk do të ishte nevoja me ecë çdo javë nëpër shoqëri.

Ismet Klaiqi: Unë e përkrahu dhe e quaj shumë të drejtë shfaqjen e filmave.

H. Veselaj: A keni qenë në Bon (i drejtohet Skënderit) ti Skënder, Naimi e Nuhiu?

Skënderi: Me Nuhiun kurrë nuk kam qenë në Bon. Vetëm me Nuhiun e pa Naimin kemi qenë në klubin Emin Duraku të Dyseldorfit dhe atë të thirrun nga udhëheqja e klubit.

H. Veselaj: Nuhiu më ka thënë se me shkua në Dyseldorf ka qenë ideja e Skënderit dhe në atë javë kur keni shkuar, ata (të klubit) e kishin pasë ndërmend me ardhë e me pa në Untergruppenbach, por pas asaj vizite ata ishin tërhequr nga ai mendim i tyre, çka do të thotë se ne kemi prishë punë. H. Veselaj vazhdoi gjithashtu se Nuhiu i ka thënë se kur Faridini i ka thirrë njerëzit për ne demonstrata, një punëtor ju ka ankua F. se për shkak të familjes po frigohem, ky ia ka thyer atij se sa për mua nuk ka problem se unë jam i garantuar në Shqipëri.

Qemal Haxhillari: Kemi qenë tek F. me vëllaun e tij (F.) e se kemi gjetë. Jahir Jahiri na ka thënë se nuk keni çka e lypni se ai ka shkua në Shqipëri me familje. Në realitet ai kishte qenë tek familja Gërvalla.

Faridini: Në ato ditë i kam marrë dy ditë pushim e kemi shkuar në Vjenë për punë të demonstratës. Kemi shkuar me kerrin tim unë Hafizi dhe Haxhi Berisha. Kur shkuam në Vjenë shkuam tek një njeri i cili na priti mirë. Ky njeri quhet Sylë Neziri, si duket i

vetmi shqiptar në këtë qytet që ka kafene të veten. Adresën e tij e ka marrë në Augsburg Murat Kryeziu nga një mik i tij me rekomandim se është njeri i mirë. Me këtë njeri, Haxhi Berisha dhe Nexhati (Osman Osmani) janë takuar edhe para këtij rasti, janë takuar kur ka shkua Suzana në Shqipëri. Haxhiu i ka pyetur disa njerëz kur iu ka afrua kafenesë se a e njihni Sylë Nezirin. Disa punëtorë i kanë thënë se Syla e shpërndan ZK në Vjenë. Në atë rast kanë bisedua HB e Halimi (Osman Osmani) duke ia përkujtuar atë se nëse bëhet diç këndej (ndonjë aktivitet) do të drejtohemi tek ti. Kur u ndamë prej tij shkuam tek bashkëfshatarët e mijë pasi ishte e diel e nuk mundeshim me krye kurrfarë pune. Tek bashkëfshatarët e mijë e kemi takua edhe një student (jo Milaim Zekën, megjithëse me rastin e atij udhëtimi e kemi takuar edhe atë). Edhe të hënën nuk kryem punë pasi kishte qëlluar një festë religjioze. Por gjatë kësaj dite u angazhuam që ta gjejmë një person me shtetësi austriake i cili do të garantonte për demonstratën. Në këtë drejtim na ndihmoi një taksist nga Gostivari duke e angazhuar një femër që e kishte të afërme. Njëkohësisht ky taksist na ka vozitur shumë gratis. Të martën në mëngjes shkuam në sekretariatin e Vjenës së bashku me shtetasen austriake dhe taksistin. U dashke të gjej një arsye se çka e shtynë atë ta bëjë këtë pune¨. U vendosë që ajo të thotë se e në një kohë e ka njohur Ali Lajqin e burgosur, e njëherit ka edhe simpati për shqiptarët dhe don t'u ndihmoj në këtë mënyrë. Në polici na thanë se nuk ka problem a do të bëhet apo jo demonstrata, por ne na intereson me na tregua karakterin e demonstratës dhe sa njerëz do të mblidhen. Ata në Vjenë na thanë se me u thënë se bëhen shumë është më vështirë të jepet leja. Ju thamë se do të bëhen 500 veta por disiplina do të jetë e madhe. Unë nesër kisha me qenë në punë dhe kështu rreth orës tre pasdite u kthyem me Hafizin. Në fillim të rrugës i kishim 700 DM. Haxhi Berishës ia lamë 260 DM e vetë për këndej i muarëm 180, se kishim frikë se mos po na prishet kerri i cili kishte ca defekte dhe nuk i punonte nxemja. Haxhiu mbet deri në të enjten ku do të mblidhej një mbledhje, ku policia do të njoftohej me shkrim dhe me gojë për karakterin dhe numrin e demonstruesve.

Kërkesa me shkrim u bë të mërkurën. Të martën në mbrëmje (tani fletë vetëm Haxhi Berisha në lidhje me përgatitjet për demonstratë me kërkesë për informim sa më të hollësishëm nga të pranishmit) kam qëndruar në kafenenë e Sylës deri në ora 24.00 se ishim marrë veshë se do ta bëja natën tek ai. Kah ora 24.00 ai më tha (Syla) a nuk ke ku me fjetë a? Nga mënyra e pyetjes së tij unë e kuptova se aty po prisja kot dhe shkova në hotel. Të nesërmen ditë e mërkurë, kemi ecur tërë ditën me taksistin, në një masë të madhe.

Taksisti dikur më tha më tha: do të ishte mirë me ma pague ditën e gjithashtu me më pague diçka extra se ju keni buxhete të mëdha. Juve ju paguan Shqipëria apo Amerika dhe për këtë nuk kishte fije dyshimi. Kur e nënshkroi kërkesën për demonstratë austriakja i kërkoi 2000 shilinga. Ata aty duke thënë jo ju paguan ai, jo ai tjetri, jo po shkojmë në kafe e po i mbledhim ndër shqiptarë, i nxora 1800 shilingat e fundit dhe ia dhashë. 200 shilinga tjerë ia dha një bashkatdhetarë tjetër. Përmes telefoni kam treguar se në Vjenë kam mbetur pa të holla. Më janë dërgua 200 DM tjera (kanë qenë të hollat e Hysen Spahiut). Të enjten në polici më kanë thënë se mbledhja nuk do të mbahet sot por tri ditë para demonstrate. E njerëzit lirisht mund t'i thirrni. Jam kthye të enjten me tren. Në Vjen ua kam lënë telefonin tonë. Jam kthyer duke e konsideruar si punë të kryer. Të mërkurën më ka lajmëruar taksisti dhe tha se nuk është puna mirë. Jam que të enjten vetëm në mëngjes dhe kam shkua në Vjenë. Në polici më thanë se leja është refuzua. Nëse e gjen atë femrën mund t'ua lejojmë. E kam kërkuar atë shtetasen së bashku me taksistin deri në ora 15.30. Në 15.30 jam largua nga policia me të cilët pata këtë bisedë:

-Ju na keni thënë (premtuar) ne njerëzit i kemi thirrë, nga gjithë Evropa nesër këtu do të jenë. Demonstrata do të bëhet me hatër ose me zor. Krye shefi më tha se për kësi njerëzish ne kemi burgjet. Atëherë lironi 1000 vende për nesër ia prita.

-Kemi vende të mjaftueshme. I tha një tjetrit se duhet lajmëruar kufiri që të mos pranohen. Unë i thash se veç pjesa më e madhe kanë hy në Austri. Atëherë më tha se nëse e gjen një austriak e ma sjell deri në ora 18.00 demonstratën do ta keni të lejuar me një ndryshim se do të niseni një orë më vonë, pra në ora 12.00 dhe jo në 11.00. Kam shkuar në Universitetin e Vjenës, Fakultetin Ekonomik dhe kam gjetur dy të rinj që pranuan të vijnë dhe në ora 17.00 kam shkuar me njërin në polici. Me këtë krye shefi na tha se çdo gjë është në rregull. Të nesërmen në ora 9.00 policia kish pas shkuar tek ai djali dhe i kishin thënë se lutja jote është refuzua dhe të kesh kujdes se për çdo gjë që të ndodhë ti do të përgjigjesh. Në ora 10.00 jam takuar me studentin dhe mi ka tregue fjalët e mësipërme. Kemi shkuar me te në polici dhe e kemi kërkuar krye shefin. Kujdestarët na thanë se ai sot është në pushim. Ju i keni punët tuaja por ne e kemi për detyrë mos me ju lënë.

Taksisti më ka thënë ruajuni Sylës se ai ka qenë në Ambasadën Jugosllave dhe u ka tregua për demonstratën me qëllim që ta tregoj "pastërtinë" e vetë.

Më tej se si u zhvillua situata e keni pa vetë.

Abdurrahman Sadiku: Unë kam dëgjuar prej Nuhiut se ti kur je kthye prej Vjene ke qëndrua me Misinin (Mavrajn) në diskotekë. Gjithashtu është faji yt se nuk ishe asajde kur erdh policia e na tha se nuk keni leje.

Haxhi Berisha: Ndoshta nuk më ke parë njëherë se ishim e e kërkuam krye shefin, se tërë kohën kam qenë në bisedime me polici.

H. Veselaj: Nuhiu më ka thënë se ti ke pasur të holla të mjaftueshme. Ai t'i ka dhënë 2000 dollarë që i ka thye në bankën e stacionit të trenit të Shtutgartit.

Ismet Klaiqi: Mua N. Më ka thënë se H. Berisha i ka pasur me vete 7000 dollarë.

Nami Ramadani: Mua Nuhiu më ka thënë: As nuk më kanë pyetë, as nuk ju kam dhënë të holla, por kanë shkue e kanë ndejtë dy javë bareve të Vjenës me të holla të Familjes Gërvalla.

H. Veselaj: Është propagandue se H. Berisha nuk e ka shkaktue demonstratën në Vjenë por Ibrahim Kelmendi.

Haxhi Berisha: Sa i përket demonstratës atë e ka bërë masa. Merita e Ibrahimit nuk mohohet. Ajo ka ardhë në shprehje tek një fjalim gjatë rrugës dhe në fund në gjuhën gjermane. Se ky aspekt nuk është i rëndësishëm për diskutim u pa në Bern ku Ibrahimi e ka udhëhequr demonstratën.

Mejdi Rexhaj: Hasan Veselaj, çka të shtyri me iu mvesh Nexhatit (Osman Osmanit) dhe si e vlerëson punën e tij?

Hasan Veselaj: Me Nexhatin jam shoqërue më shumë dhe jam ndarë për një kohë por unë nuk kam dashtë me u largua prej rrethi. Njëherë H. G. e Nexhati janë kap në fjalë për imtësina (në lidhje me atë se a duhet thye fotoja e Titos apo jo – thyerjen Nexhati e ka quajtur plan udbeje- vërejtje e Skënd.), ndërsa kanë qarkullua fjalë se unë jam largua.

Haxhi Berisha: Në një kohë jemi takua shpesh herë 'rastësisht' e kohëve të fundit "rastësisht' je takua më shpesh me tjetër kend. Se Nexhati kur mua më ka folë keq për Skënderin e atë tjetrin edhe ty HV të ka folë keq për mua e Skënderin, dhe në këtë drejtim tek ti ka pasur sukses.

H. Veselaj: Mua nuk është mundua me më kthye dhe me te nuk kam pasur biseda të gjana.

Murat Kryeziu (MK): Tek unë kanë ardhë Nuhiu dhe Hasan Veselaj dhe më kanë thënë se Nexhatin e kemi organizatorë më të fortë dhe dil e tregoju shokëve se prej tyre më nuk ka asgjë. Nuhiu gjithashtu më ka thënë se Nexhati ka qenë në Turqi e mezi e kanë lëshua me ardhë, di me shkrua me makinë. Ata i kanë thënë shko e mos ja le ata punëtorë gjithkujt në dorë. Se Nexhati është më i aftë se Skënderi. Unë ju thash se nuk dua t'i besoj

askujt për pa u mbledhë së bashku. Ata (Nu e HV) më thanë se jemi të gatshëm me u ballafaque.

H. Veselaj: E kam një pyetje për Skënderin, se kur ishim tek Nuhiu ke thënë tek Ismet Klaiqi se HV na tha po shkoj në Esslingen e shkoj tjetërkund dhe se i ke thënë Qemal Haxhillarit që ky ta ndjek Faridinin e mos të shikoj gjithfarë mbështjellaqësh.

Skënderi: Të parën e kam thënë se ashtu është, e për të dytën nuk po më kujtohet.

Remzi Ademaj: Ky person që na e kërkuam dhe e thirrëm dy herë me ardhë. Si me ia bërë? Nuhiu nuk pranoi me ardhë kur atë e thirrën 12 vetë. Të gjithë folën për te, prandaj çfarë masash duhet të merren ndaj tij? Duke shkua në Bern, në autobus Nuhiu më ka thënë merre mikrofonin e folë diçka. Për ta marrë fjalën në autobus në rrugë për demonstrata ka qenë punë që është praktikuar më parë. Kur unë ia kam nisur me folë ai i ka fshi lotët. E kjo po kuptohet pse. Kjo më ka hidhërua shumë. Ishim duke u kthye nga Berni. Më tha se tash duhet të bisedojmë për punën e ardhshme, e si po thua me ia bërë. Unë i tregova se je drejtuar në adresë të gabueshme. Atëherë ai më tha se ti si më inteligjent je kap mbas karrieristave. Ti nuk di sa je kanë afër me Jusuf Gërvallën. Nëse donë me e ditë sa unë jam kanë afër eja tek unë e ti tregoj letrat.

Ismet Klaiqi: Nuhiu më ka thënë se pas rastit (17 janarit) i ka ardhur një letër nga një kriminel i udbës.

H. Veselaj: Faridin, në banesën tënde është lidhë besa që Demë Demaj me u largua prej shoqërisë. Atë natë kur janë vra shokët Dema ka qenë në banesën tënde më ka thënë Nuhiu.

Faridini: Në banesën time nuk është vendosur me u largua Demë Dema. (Demë Dema është një shok i Ibrahim Kelmendit dhe Sadik Blakaj ka ardhë përmes shoqërisë së tij në rrethin e Shtutgartit prej nga e ka marrë Hysen Gegën dhe me kurth e ka futur në burg.) por pas rastit JG ka kërkuar që shoqërinë me Demën ta rriti edhe më tepër. Sa që edhe kur jam hidhërua me te, Jusufi ka ardhë në banesën time dhe më ka ndreq dhe më ka thënë: Faridin unë sonte jam këtu i zoti i shtëpisë. E sa i përket atij rastit në banesën time, në një tubim kur Jusufi i fliste butë Demës dhe ia nxirrte fjalët dalëngadalë, Nuhiu ndërhyri duke i thënë Demës: Demë na trego a ke rrëshqitë në tradhti, ndërhyrje e cila e prishi bisedën dhe krejt mundin e bacit Jusuf. Dema u nxehë dhe i tha se me këtë (Nuhiun) as që dua të flas. Edhe pas këtij rasti Jusufi më ka urdhërua me u shoqërua me Demën. Fjalët e këqija më kanë shtyrë me shkua tek Jusufi e me i tregua. Ai më ka thënë: Prej meje a ke dëgjua diçka? Ec ti e punoje punën tënde dhe më ka tregua qëllimin e afërsisë time me Demën. Se deri sa më ka tregua mua nuk më është kujtua. Natën e ngjarjes së këtij viti Dema ka qenë tek unë me grue dhe ka qëndrua gjer në ora 22.00. Për këtë i kam tregua Nuhiut dhe e ka ditë ashtu siç e ka ditë se nuk ka qenë marrëveshja me u përjashtua. Në katund kur ka ardhë me pa më kanë thënë me e qitë prej konakut por nuk kam pranua për shkak të fjalëve të JG. Por prej asaj dite nuk kam kurrfarë kontakti me te dhe kah jemi kthye prej katuni (Untergrupenbachu) e kam qitë prej kerri.

Qemal Haxhillari: Si përfundim po më duket se shkaktari më kryesor Nuhiu, por unë që kam qenë më afër kohëve të fundit e di se Nexhati (Osman Osmani) e ka kryer punën (minuese) më të madhe në këtë drejtim. Nexhati është shumë i lidhur me Nuhiun. Ky i fundit i ka premtuar atij se do ta ketë masën me veti, siç më ka thënë edhe mua.

Në përfundim mbetet që sjelljet e Nexhatit me i zgjedhë shokët më përgjegjës.

Abdurrahman Sadiku: Unë kam edhe disa vërejtje lidhur me një material që na ka ardhur nga Nuhiu me titull "Kosova u sulmua për t'u kthyer rankoviqizmi" ku potencohet se vdekja e Titos është një datë e ligë për shqiptarët, pasi prej asaj dite fillon keqësimi i gjendjes së shqiptarëve.

Skënderi: Materiali i tillë nuk ka kaluar nëpër dorën e kryeredaktorit të ZK. Kjo çështje do të zgjidhet në një tjetër vend.

Në pyetjen a e dënoni këtë veprimtari të pranishmit dhanë këto përgjigje (mendime):

Abdurrahman Sadiku (më i vjetri): Kjo është veprimtari përçarëse dhe e dënueshme.

Ismet Klaiqi: Vetë mos përgjigjja e tij dëshmon mjaft për fajësinë e vetë. Për këtë takim kam qenë i lajmëruar qe 4 ditë. Unë shumë gjëra nuk kam mundur me i thënë e që do t'ia thosha po të ishte këtu. E dënoj këtë veprimtari.

Skënderi: E quaj përçarëse dhe të dënueshme.

Mejdi Rexhaj: Veprimtaria e tij nuk ka të bëjë me organizimin revolucionar e patriotik.

Remzi Ademaj: Pajtohem me mendimin e shokëve dhe veprimtarinë e tij e quaj armiqësore dhe jam të dënohet me dënimin e merituar.

Qemal Haxhillari: Unë isha dy herë me e marrë. Të dytën herë hyra brenda dhe ia numërova të gjithë me emër se kush janë. Ai më tha se do të përgjigjem me shkrim, e nëse e meritoj para gjyqit të popullit kanë të drejtë edhe varrin me ma prishë. Këtë punë e quaj përçarëse dhe e dënoj.

Murat Kryeziu: E quaj përçarëse dhe e dënoj. Më ka premtua se do të vij në takim sa herë të paraqitet nevoja e sot isha dy herë tek ai e nuk erdhi.

Haxhi Berisha: Sipas fjalëve të mëparshme po duket se tërë veprimtaria e tij kohëve të fundit është përçarëse dhe prej tij ne duhet pritur më të keqen. Ky duhet dënuar.

Hasan Veselaj: Kur i dëgjova të gjitha bisedat me fakte deri në dy tri pika që duhet me i vërtetua më vonë, më tronditi shumë veprimtaria e tij, dhe këtë e quaj punë përçarëse teknike.

Mejdi Rexhaj: E dënoj këtë veprimtari shkatërruese sepse çdo kujt është mundua t'i ngjes diçka. Edhe vetë isha me e thirrë e nuk pranoi. Tha se do të përgjigjet më lart me shkrim.

F. Tafallari: Unë Nuhiun e njoh prej një kohe të hershme dhe shumë besim kisha tek ai. E kam nderuar si një njeri më të vjetër që për një kohë iu ka kushtue çështjes. Kohët e fundit e kam pa se është i interesuar për përçarje. Tri herë kur kemi qenë vetëm unë dhe ai, ia kam tërheqë vërejtjen, që të mos shkoi kah shkatërrimi por ai vazhdoi me të veten duke u mundua për një përçarje sa më të madhe por nuk mundi ta realizoj planin e tij të ndytë për shkak të qëndrimit të shokëve që qëndruan besnikërisht. Përflitjet e tij të përlyera e të poshtra i dënoj me dënimin më të rëndë, për këto gjëra me këtë dënim do ta dënoja edhe vëllaun tim.

Hafiz Gagica: Është vështirë për mua të flasë pasi një pjesë e madhe e shpifjeve (akuzave) të tij kanë qenë të drejtuara kundër meje. Por po shifet se unë nuk paskam qenë objekti i vetëm i tij. E dënoj këtë veprimtari.

Duke pasur parasysh ndonjë pyetje që mund të lindë më vonë Haxhi Berisha pyeti:

-Shokë, a ia merr mendja ndokujt se ky tubim ishte një montim i dikujt apo a i është thënë ndonjërit folë kështu për këtë e ashtu për atë? Njëzëri të gjithë pohuan se këtu nuk kishte erë montimi.

Skënderi u shpjegoj në lidhje me pikën dy të rendit të ditës se puna e gurëve të varrezave për tre të rënët është vonuar për shkakun se prej ngjarjes e gjer në gjysmën e qershorit, janë kërkuar gur të kuq. Prej gjysmës së qershorit janë porositur gur të bardhë, të cilët kanë qenë të gatshëm prej 29 korrikut e këtej. Tërë muajin gusht na e ka humbë Ahmet Sadiku nga Frankfurti, lidhur me përkthimet. Gjatë muajit shtator janë duke u krye punët në mes komunës, avokatit dhe shoqeve të shokëve, të cilave iu janë dërguar dokumentet për nënshkrimet e tyre.

Shënimet e mbledhjes i mbajti Remzi Ademaj.

12. Letër e Xhafer Durmishit për Lëvizjen në emër të KVG, 1 tetor 1982

MENDIMI I KVG (Komitetit "Vëllezërit Gërvalla") NË LIDHJE ME LETËRPËRGJIGJEN E KRAHUT TË ish-PKMLSHJ NË LIDHJE ME PËRGJIGJEN E TYRE NDAJ PIKËPAMJEVE TË SHOKUT LL (Xhafer Shatri)

Letra në të hyrë fillon me komplimente të merituara në adresë të shokut Ll. (Xhafer Shatri- shën i Xh.D.). Lidhur me këto komplimente do të ndalem pak më poshtë.

Çështja jonë me rëndësi, organi është preokupim i hyrjes së përgjigjes. Ajo që thirret teorikisht nga autorët nga të tjerët kjo është realizuar me kohë praktikisht. Këtë e vërtetojnë faktet ashtu siç e vërtetojnë faktet edhe atë se kjo thirrje ka mbetur vetëm në letër nga nënshkruesit e saj. Nga ana tjetër në mbledhjen e fundit të KVG, Halimi (Osman Osmani-shin i Xh.D.) kur ishte pyetja e vendosjes së makinës dhe vazhdimit të punës rreth organit, ai për ta arsyetuar planin e vet rreth shkuarjes në Turqi, para të gjithë shokëve tha: (duke mu drejtuar mua), organi është preokupim i imi (pra i Xhafer Durmishit-shën im). Sipas marrëveshjes së 15 majit kjo përgjegjësi i ka mbetur Skënderit. Unë kam detyrën të preokupohem për çështjet e LRSHJ-së brenda dhe në këtë drejtim i kam filluar punimet.

Unë i kam thënë: Ashtu kemi thënë, por këtë punë e di dikush më mirë se unë edhe se ti, dhe kësaj fjale unë iu kam përmbajt. Për këto fjalë të neve të dyve në atë mbledhje mund të japin deklarata katër vet. Gjatë përgatitjes së numrit të ZK të qershorit unë me Halimin kemi pasur disa mosmarrëveshje. Këto i kam shprehur në dy letra të mëparshme që ua kam dërguar U. (Xhafer Shatrit-shën im), dhe M (Sabri Novosellës-shën im) dhe të tjerëve jo, në mungesë të adresës. Duke u nisë nga këto mosmarrëveshje ai në një rast në zyrat e shokëve gjerman më tha: Në të ardhmen, njëri për organin duhet t'i ketë kompetencat e plota dhe duart e lira. Si variant për këtë e ka marrë veten dhe mua. Në asnjë rast U. (Xhafer Shatrin). Nga kjo rrjedh se fjalët në hyrje të letrës, janë përshtatje sipas realitetit, përshtatje e atillë që në zhargonin popullor njihet dhe shprehet si "kthim kah të frynë era", dhe në bazë të asaj çka kemi vërejtur unë dhe shokët këtu, kjo ishte karakteristika themelore në veprimtarinë politike (s'po guxojmë me thënë patriotike se mund të jemi borgjez të rrezikshëm) të këtyre njerëzve.

KVG e mbron pikëpamjen se LRSHJ-ja është përfaqësuesja e vetme e popullit shqiptar në Jugosllavi. Kjo është shprehur edhe në Komunikatën e botuar në numrin 1 të ZK e e potencuar sidomos në fjalimin e mbajtur në Bern. Deri më tani ne nuk jemi të njoftuar në asnjë reagim kundër këtij mendimi, apo pikëpamje.

"Njëherë e mirë për disa që ende po bredhin në hapësirë"

Shoku KK (Kushtrim Kosova = Abdullah Prapashtica-shën im) si njeri me përgjegjësi, në letrën e tij vëmendje të madhe, gjë që është shumë e natyrshme, i kushton vijës politike duke e përmendur këtë fjali shtatë herë në letrën e tij dhe të bashkëmendimtarëve të vet. Në lidhje me vijën politike që i pëlqen aq shumë ta përmend orë e çast ai tërheq vërejtjen KD (Komitetit Drejtues) të LRSHJ-së se si duhet ndërtuar strategjia e LRSHJ-së: se a duhet të preokupohemi pas nacionales apo klasores por meqë këto janë edhe të pazgjidhshme siç e di edhe vet KK donë të na sqaroi se cila duhet të vij në radhë të parë. Për shumicën kjo veç është e qartë, por ai do ta shpjegoi "njëherë e mirë për disa që ende po bredhin në hapësirë..." (faqe 1 e letrës, rreshtat 35-36, vërejtjet dhe citatet tjera me faqe e rresht janë nga kjo letër) se përndryshe sipas tij kjo çështje as që ka

nevojë të shtrohet për diskutim. Duhet në radhë të parë të bëjmë luftë klasore arsyeton Kushtrim Kosova sepse:

- po të përmendet nacionalja atëherë bëjmë vetëm luftë klasike (definicion modern),
- duhet të dominoj klasorja sepse kjo është në përputhje me ideologjinë e popullit tonë në pjesën më të madhe të tij.
- duhet të potencohet klasorja në radhë të parë sepse ky vlim më i ri është i frymëzuar nga kjo ideologji (pa i përmendur askund idolet e asaj ideologjie e as ideologjinë në fjalë).

Nuk duhet të vijë në radhë të parë nacionalja sepse:

- armiku nga akuzon për nacionalizëm e irredentizëm.
- se lufta jonë "klasike" patriotike donë të thotë shi në misër të rankoviqizmit (faqe 2, rreshti 31).
- se potencimi i nacionales të vë firmën e nacionalizmit (faqe 5, rreshti 6).
- ata që janë përkrahës të kësaj pikëpamje donë ta fusin LRSHJ-në në binar borgjez dhe jo vetëm të dyshimtë por edhe shumë të rrezikshëm (f. 5 rreshtat 7,8).
- potencimi i nacionales d.m.th. kthim prapa, në ideologji nacionale (?) dhe kundër internacionalizmit socialist (po ta kishin shfletuar marksizmin apo çfarëdo vepre të kësaj natyre do t'u binte ndërmend se duhet thënë internacionalizmit proletar).
- Sipas kësaj logjike gjërat do të duhet të shikoheshin kështu:
- se një arsimtar në një shkollë fillore së pari duhet të protestoj pse nuk i rritet rroga e pastaj të vijnë protestat për atë se: pse nga muret e korridorit të shkollës së tij janë hequr të gjitha fotografitë e rilindësve përveç njërit, nëse emrin e rilindasit apo të heroit e mban shkolla në fjalë.
- se ai së pari duhet protestuar pse nuk i rriten shtesat e fëmijëve para se të interesohet se pse janë censuruar të gjitha vjershat nga librat e leximit dhe abetareve që po atyre fëmijëve ato vjersha ua ndiznin shpirtin flakë me dashuri për atdheun.
- se punëtori në Obiliq apo në Trepçë së pari duhet kërkuar përmirësimin e kushteve të punës para se të kërkoj llogari për grabitjen koloniale të qymyrit, rrymës e mineraleve.

Duhet luftë klasore sepse kjo është në përputhje me ideologjinë e popullit tonë në pjesën më të madhe të tij. Por ajo pjesë e madhe e popullit tonë që sot e ka preokupim ideologjinë, në një kohë siç e ka thënë edhe vet PPSH dhe Akademia e Shkencave e atij shteti, në një kohë para dyzet vitesh PKSH ka bërë vetëm luftë "klasike" nacionalçlirimtare. PKSH në Konferencën e Pezës ka ftuar të gjitha partitë politike (edhe pse parti politike përveç PKSH nuk kishte) në luftë të përbashkët kundër fashizmit. Fitorja e LNÇl në pjesën e stome të atdheut tonë, çoi në fitoren e revolucionit demokratik i cili me punën e vazhdueshme të partisë revolucioni demokratik u shndërrua në një revolucion socialist.

LNÇKVSHJ-ja e ka kompromet uar PPSH dhe gjithë shtetin shqiptar

Në lidhje me atë se po nuk u shprehëm së pari për klasoren do të jemi në kundërshtim me ideologjinë dhe me popullin tonë të lirë, sipas mendimit të Kushtrim Kosovës unë po përmendi një fragment të kam pasur me bashkëmendimtarin e KK, Halimin (Osman Osmanin). Ai gjatë një bisede se cila organizatë çka ka punuar e si ka punuar më ka deklaruar: LNÇKVSHJ-ja e ka kompromet uar PPSH dhe gjithë shtetin shqiptar duke e shpërndarë literaturën e saj, të ligjësuar këtë veprim edhe me statut, duke e lavdëruar veten se ata nuk kanë pasur nevojë t'i referohen PPSH pasi që e kanë formuar

PKMLSHJ e cila është origjinale dhe nuk është në kundërshtim me vetëqeverisjen e Titon por vetëm me rankoviqizmin dhe forcat regresive në LKJ.

Kjo është idioteske, të kapesh pas disa gjërave pa kurrfarë parimi, por vetëm si ta kërkon rasti për të realizuar qëllimet e tua.

Të flasësh për klasore në cilësinë e një njeriu që do ta trasosh një lëvizje përfaqësuese të një populli dy milionësh në rrugën ml (vërejtje e Skënderit, pasi ml nuk potencohet nga Kushtrim Kosova dhe dy shokët e tij) e të mos i referohesh për asnjë rast qoftë edhe sa për formalitet klasikëve të ml dhe veprave të shokut E. do të thotë se veprat e klasikëve të ml as nuk i ke shfletuar ndonjëherë por vetëm mundohesh të gënjesh të tjerët se je ml e k (marksist-leninist e komunist-shën im).

Veprat e ml asnjë nga ne nuk i kemi studiuar për shkak të kushteve por nga disa shfletime kemi mund me vërejt se ato ku t'i hapësh do të gjesh diçka të afërt, të vlershme dhe të aplikueshme në çdo kohë për ty. Ato janë si një lëmsh i madh përçuesish elektrik që për t'ia gjetur fijet të ndihmojnë treguesit e shumtë të veprave të tyre dhe se ku t'i prekësh ato fije, tregojnë rrymë.

Të thërrasësh deri në kupë të qiellit për luftë klasore si në kushtet tona, si në çfarëdo kushtesh, së pari duhet ta kesh studiuar mirë zbulimin e madh të Marksit se: "... esenca e luftës së klasës nuk qëndron në ndërrimin e një aparati me një tjetër por esenca e luftës së klasës qëndron pikërisht në thyerjen e plotë të këtij aparati dhe zëvendësimin e një klase të tërë shtypëse me një klasë shumë më të madhe në masë, me klasën e të shtypurve..."

Të bërtasësh deri në kupë të qiellit e pas shpine të mbash mburojën për vetëqeverisjen e në anën tjetër të thuash se këtë ma mëson Marksi siç po e sheh KK dhe bashkëmendimtarët e tij, nuk shkon.

Nga ana tjetër nga shteti ynë dhe avangarda e tij dhe udhëheqësi i kësaj avangarde është botuar një libër i njohur me rëndësi të madhe teorike e praktike, i cili ia çjerr maskën socializmit vetëqeverisës, që KK me shokë e kanë ndërmend t'ua marrin burokratëve e me ua kthye punëtorëve, tregon esencën e tij kapitaliste. Pra ne konsiderojmë se vetëqeverisja e kapitalizmi për shqiptarët janë një, ashtu siç janë Titoja dhe Rankoviqi një, dhe për këto nuk kemi çka të flasim as për "hir të politikës së madhe" sepse bëhemi për të qeshur edhe nga armiqtë tanë e lere më nga populli ynë. Një dallim në mes Titos dhe Rankoviqit kundrejt shqiptarëve është munduar me çdo kusht ta bëjë LKJ dhe sidomos UDB-a pas Plenumit të Brioneve. Për shqiptarët Tito dhe Rankoviqi janë të lidhur si mishi e kocka, dhe s'ka fuqi që i ndan. Këtë e di më së miri populli i Kosovës që e ka provuar në kurrizin e tij, e di shteti ynë që këto procese i ka parë më mirë edhe se ne, këtë vazhdon ta pohoj çdo ditë edhe shtypi botëror. Dihet sa ka ndryshue e sa s'ka ndryshue gjendja e shqiptarëve pas brioneve. Titoja është ai që e ka shkelë të drejtën e vetëvendosjes, që ka shkelur marrëveshjet e luftës, është ai që ua mohoi më 1968 republikën shqiptarëve që çuditërisht i kishte rënë ndërmend popullit edhe kur nuk ishte aq aktiv në këtë drejtim KK me shokë, dhe që i burgosi e torturoi deri sa i rrahu fryma.

- Duhet luftë klasore në radhë të parë sepse edhe ky vlim është frymëzuar nga kjo ideologji.

Nga është frymëzuar ky vlim në planin më të përgjithshëm dhe shkencor e ka dhënë artikulli i Zëri të Popullit i datës 8 prill 1981. Nga këndi ynë ne mund të flasim më ndryshe dhe të koncentrohemi në atë se pse tha rinia "kështu më nuk durohet". Së pari mendojmë se ky ishte një zgjim i ndjenjës kombëtare deri në atë shkallë sa populli mbarë ta kuptoj se ka ardhur koha e ndryshimeve të mëdha revolucionare. Këtë zgjim para së gjithash e kushtëzoi 100 - Vjetori i Lidhjes "klasike" të Prizrenit, ashtu siç ndikoi më së shumti 500-Vjetori i vdekjes së Skënderbeut në ngjarjet e vitit 1968. Se forcat e organizuara u brumosën me leximin e veprave të shokut E. dhe fituan një ndjenjë shumë

të madhe të krenarisë kombëtare nga veprat e I. Kadaresë i cili në Prishtinë u prit si kryetar shteti, ai u dashurua në historinë e tij më të re sidomos nga dy librat e Ajet Haxhiut, të Hasan Prishtinës dhe Shote e Azem Galicës, se e tërë ajo gjenerate vajzash të shkollave të mesme nuk kishin arritur të studionin veprat e Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit e të shokut Enver, por që u frymëzuan aq shumë nga këngët "nacionaliste" të Shyhrete Behlulit e Shkurte Fejzës. Programi i televizionit shqiptar për një vit e gjysmë qe katalizatori më efektiv dhe vendimtar që të shpejtësohet një zgjim i tillë në atë shkallë si e kemi sot. ...

Gjatë gjithë kësaj kohe në programin e televizionit shqiptar nuk qe as aludimi më i vogël r. (republikë), për b. (bashkim) me qindra herë. Kur shfaqej drama Shote e A. Galica nëpër Kosovë e sidomos në Drenicë nuk pushonin krismat tërë natën. Kush nuk e di këtë nuk e ka përcjellë televizionin shqiptar. Me një fjalë, nga programet e televizionit shqiptar, sidomos nga emisionet për fëmijë populli i Kosovës e pa se çka do me thënë me qenë i lirë. Kjo ndjenjë e qoi peshë më 1981.

Ai u frymëzua edhe nga shtypi ilegal revolucionar dhe atë nga revistat: Bashkimi, Lajmëtari i lirisë dhe Liria.

Kjo është ajo që e shtyri popullin tonë të thotë mjaft, sipas mendimit tonë.

-Në lidhje me atë se a do t' na etiketojnë si nacionalist armiqtë tanë, për luftën tonë, këtë më së miri e ka shpjeguar me shembull mjaft të mirë shoku Ll. duke u shërbyer me proverbin e gjuhës së Krishtit. Pra këtu s'kemi pse me u kthye mbrapa dhe me diskutue rreth saj. Kur Sylejman Vokshit që në fillim i përmendin vdekjen ai u thotë i kënaqur se "përderisa ma përmendni vdekjen kjo do të thotë se ma paskeni pas frikën, dhe të vjetrit tanë na kanë thënë se në luftë kur armiku ta dëshiron vdekjen d.m.th. ia ke arritur qëllimit". (nga drama Epoka para gjyqit).

Armiku po ushtron presion mbi familjet e kuadrove tona

Letra prek edhe një temë të rëndësishme. Udhëzimin për gjakftohtësi ndaj presioneve që po ushtron armiku mbi familjet e kuadrove tona duke e përmendur rastin e familjes së tij (Abdullah Prapashticës-shën im), dhe kjo nuk është hera e parë që me dorë të vet ia nisë me na tregua se si në një letër më parë "... se nga burime të sigurta ka informata se për kokën time (të Abdullah Prapashticës -shën im) është ndarë një shumë e madhe të hollave...".

Tani në këtë letër përmend prapë vetë presionin që po iu bëka në familje. KK dhe shokët e llojit të vet duhet ta dijë se nga ky mes janë përmendur dhe janë bërë presione ndaj disa njerëzve të cilët kurrë nuk i zmadhuan e as si përmendën kurrë me gojën e tyre. Prandaj shoqërisht po u themi lej këto marrina se njerëzit tanë kanë një respekt të madh për ata që luftojnë dhe rrezikohen, prandaj nëse ti s'e ke parë ende këtë të vërtetë, përvishju punës nëse dëshiron ta shohësh ndonjëherë. Me këtë rrugë e me përmendje të vetes nuk do ta sheh askushi.

Sipas kësaj logjike ne jemi "...duke e sulmuar LKJ, me RSFJ me sistem e me Titon e tyre..." (f. 7, rreshti 22) vetëm kur paskan filluar presionet ndaj disa familjeve të disa kuadrove tona. Me këtë fjalor udhëheqësve të lëvizjeve të Kosovës u janë drejtuar qysh prej kohësh Turqia dhe Serbia. Ata e kanë fyrë variantin se udhëheqësit e lëvizjeve të ndryshme çlirimtare të Kosovës janë njerëz shpirtërisht të dëshpëruar apo edhe siç i drejtohet edhe Mexhid beu Sylejman Vokshit në dramën Epoka para gjyqit: "... ç'tu deshtë jeta e malit Sylejman, ti ashtu edhe derfikt nuk ishe...". Pra Turqia dhe Serbia janë munduar që udhëheqësit e lëvizjeve t'i paraqesin si njerëz pa influencë, të dëshpëruar që u ka humbë qetësia personale, prandaj u ka humb arsyeja dhe nuk duan të pyesin për të përgjithshmen. Por kjo kurrë s'ka qenë kështu. I tillë nuk ishte H. Prishtina, B. Curri, A.

Galica etj. I tillë siç donë me na thënë të kuptojmë KK nuk është M. (Mërgimi=Sabri Novosella) i cili ende nuk na e shtroi si çështje se kaq të holla nga burime të sigurta u njoftova se u paguan për kokën time. I tillë nuk është as U. për presionin që bëhet ndaj familjes së tij, me traditë di sot gjithë Kosova, e i cili nuk u kujtua ende të na thotë se shokë shikoni çfarë presioni, urra kundër LKJ e Titos së tyre. Me e lavdërua veten na duket punë e ulët edhe nëse thua të vërtetën. S'ke q'i bënë, kështu kish pas qëllue karakteri i shqiptarit shoku KK (Abdullah Prapashtica).

Ç'ideologji e ç'punë kanë bërë tri organizatat më përpara KVG pajtohet plotësisht me vlerësimet e dhëna në kryeartikullin e numrit 2 të ZK. Këtu po kthehem te fjala opozitë e përmendur në letrën e shokut L.. i ka shërbyer KK jo për të kuptuar të vërtetën se logjikisht kur ne jemi opozitë e LKJ atëherë sipas të gjitha rregullave edhe LKJ është njëherit opozitë e LRSHJ. Fjala opozitë e përmendur në letrën e 10 korrikut i ka shërbyer KK për një frymëzim që t'i hyj një pune që të nxjerr "dokumente me rëndësi" duke hapur në këtë drejtim edhe perspektiva të mëdha për shkencat historike. Sipas kësaj opozitat e LRSHJ qenkan me zanafillë më të re, nga koha e Lidhjes së Prizrenit e pasojat dhe rrjedhimet e saj po e dëmtojnë aktualisht LRSHJ, përfaqësuesit e të cilës janë ca kuadro të ish-LNÇKVSHJ dhe OMLK. Se a paraqet Lidhja e Prizrenit fillet opozitare të LRSHJ e tema të ngjashme ne nuk po mund të hyjmë duke konsideruar se në lidhje me këtë shkenca shqiptare e ka dhënë fjalën e fundit. Në çështje me Lidhjen e Prizrenit, në maj 1978 në Zërin e rinisë ka qenë i paralajmëruar një studim voluminoz i punës 20 vjeçare të prof. dr. Ali Hadrit se do të botohej, por sot e asaj dite se pa dritën me sy. Mos botimi i tij na jep të drejtën të mendojmë se as në atë studim nuk ka ndonjë fjalë se Lidhja e Prizrenit ishte klasike, se paraqet fillet e opozitës së LRSHJ, dhe se aktualisht idolet e kësaj lidhje po të potencohen aq shumë janë shërbyesit më të mirë të rankoviqizmit. E quaj veten të papërgatitur që t'u hyj këtyre temave që aq lehtë i përmend KK dhe i studion me një fjali si me pas qenë baba i Herodotit.

Në lidhje me diskutimet e më parme rreth çështjes se a duhet të organizohemi në p. (parti) apo në Lëvizje, KK na drejtohej me receta të gatshme: duhet të organizohemi në parti sepse ajo do të jetë parti i e shqiptarëve në Jugosllavi. Pra shumë e qartë, kështu thotë edhe plaku (Bujar Hoxha-shën im). Qëndrimin e tij në Ankara afër plakut (Bujar Hoxhës) KK (Abdullah Prapashtica) ne e ofron ashtu siç ua ofronte Koço Tashkoja grupeve komuniste qëndrimin e tij në Moskë duke thënë se unë jam i pranuar dhe mua më njeh Kominterni.

Të kapesh aq shumë pas ideologjisë e të mos i referohesh asnjëherë asaj do të thotë të jesh një Mao Ce D. i vockël, i cili më 3 shkurt 1967 i kishte deklaruar një delegacioni shqiptar të PPSH: "... për veten time, unë jam një njeri që nuk i dëgjoi radiot, as ato të huajat dhe as ato të Kinës, por vetëm transmetoi." Ai ka pohuar gjithashtu: "Kam deklaruar hapur se nuk do ta lexoj gazetën Zhenminzhibao. Këtë ia thash kryeredaktorit të saj. Unë nuk e lexoj gazetën tënde."

Të kapesh për klasoren me fjalë e në anën tjetër të jesh për ruajtjen e rendit do të thotë të jesh një Mao Ce që kanë nisur me të dalë "gecat". Këtë e vërtetojnë më së miri thirrjet e shpeshta për qeverinë provizore. Maoja ka deklaruar: "... ne dhe Guomindani qankaishist në themel jemi të kundërt me njëri-tjetrin. Si rrjedhim i luftës dhe i përjashtimit reciprok të të dy aspekteve ne me Guomindanin ndërruam vendet..." (Ma Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frengj. f. 479, Pekin 1977).

Faza e tretë

Një komponentë më vete është edhe tërheqja e vërejtjes se dikush po dashka me e hedh popullin në luftë "vetëvrasëse" duke e bërë në këtë mënyrë "mish për top."

Që në fillim këta njerëz kanë deklaruar se strategjia e tyre ka qenë të kërkohet republikë me paqe (me telegrame e letra, faza e parë), faza e dytë me dasma masive që edhe ajo u krye. Faza e tyre e tretë thoshin se është revolucioni i armatosur. Sipas shpjegimit të Halimit (Osman Osmanit) që të mos jepet as shenja më e vogël jashtë kërkesës për republikë ka qenë se ndoshta ky do të jetë numri i fundit (i Zërit të Kosovës qershor 1982-shën i Xh.D.), se do të kalohet në kërkesën e b. (bashkimit) duke i thënë LKJ se p. (partia jonë) boll të luti e tash ke me pas se çka ka me te gjetë. F., pas Kongresit XII (të LKJ-shën i Xh.D.) tha në një rast në praninë time dhe të Halimit: "Tash s'kemi çka e përmendim republikën, pasi nuk na e dhanë kësaj radhe. Halimi ndërhyri duke i thënë se ke shumë të drejtë. Unë jo njëherë e kam kundërshtuar Halimin se këtu nuk mund të luajmë orë e çast. Më 15 maj (1982) Halimi (Osman Osmani) na ka folë mua dhe U. (Xhafer Shatrit) për ZONËN E LIRË duke na e tërhequr vëmendjen mua dhe U. se çka kemi thënë deri më tash (ne PKMLSHJ-ja-shën i Xh.D.) është bë si kemi thënë edhe pse thëniet tona nuk janë bazuar në mundësit reale, prandaj është mirë të përpiqemi e të vazhdojmë me atë tempo. Prandaj KK (Abdullah Prapashtica) mos u lodh aq shumë me ua tërhequr vërejtjen të tjerëve për gjëra që ende vet nuk i ke të qarta. Ti me bashkëmendimtarë, me propozimet tuaja je ai që po të kesh mundësi e bënë popullin mish për top kur thua të lidhemi me b. (Bullgarinë) dhe me udbën e Kosovës e ta shpallim republikën.

Të tëra këto në lidhje me këto sjellje e pikëpamje tregojnë për një pragmatizëm të rrezikshëm që s'ka asnjë fije lidhje me elasticitetin komunist.

Jo KK recetat e gatshme në ideologji nuk hahen. Nëse ke menduar kështu do ta shohësh se ke gabuar. Po më vjen keq që thua të mos bëjmë polemikë, por më duhet të tregoj se polemika në luftën ideologjike është "A". Nëse merr mundimin e me i shfletuar veprat e Marksit, Engelsit e Leninit do të shohësh se 80% e vëllimit të tyre është polemikë. E njëjta është shumë e dëmshme të ndodhë kur kemi të bëjmë me luftë nacionalçlirimtare. Te luftërat nacionalçlirimtare jo vetëm që nuk bëhet polemikë brenda së njëjtës parti por edhe të ndryshmet bëjnë kompromise me njëra tjetrën kundër armikut të kombit. Dhe këto kompromise nuk bëhen duke i fshehur ato me çjerrjen qesharake të unitetit të kristaltë. Pra na u dashtë të bëjmë pak polemikë. Si po e shef, mospajtimet tona nuk janë administrative por qëndrojnë në themel të çështjes. Nuk mund të veprohet me pikëpamje të kundërta në emër të së njëjtës. ...

KVG i përkrah pa asnjë ndryshim më të vogël pikëpamjet e shokut Ll. (Xhafer Shatrit-shën i Xh. D.) të shprehura në letrën e tij të datës 10 korrik 1982.

Komiteti Vëllezërit Gërvalla 1 tetor 1982

Në emrin e tij Shpendi (Xhafer Durmishi)

(Në emër të Komitetit "Vëllezërit Gërvalla" letra e mësipërme u shkrua nga Xhafer Durmishi)

13. Letër e Xhafer Durmishit për Xhafer Shatrin, 14 tetor 1982

Shoku Llesh, 14 tetor 1982

Sot e mora letrën e datës 9 tetor dhe e kuptova. Unë s'kam pas se pse me të keqkuptua sepse e di se mund të ndodhesh në pozitë të keqe. Nesër do ta ndërroj banesën dhe ndërrimi i banesave me të thënë të drejtën deri më të tani ma ka shkaktuar lodhjen më të madhe. Duke u nisur nga ky shkak më duhet të them se nuk e di se a do të kem kohë me e përshkrua letrën dhe me e bërë korrektimin e saj. Fjalën idioteske e kam përmendë e aty dihet se pse e kam përmendë. Unë nuk e di se në çfarë mase je i njoftuar por edhe kryetari i Shoqatës së miqësisë Gjermani-Shqipëri" Peter Platzman e solli bisedën rreth Lëvizjes. Unë e pash se për çka po ka dëshirë me i folë dhe nuk e lash të

flasë por i thash se rrugën që na e kanë lënë shokët do të vazhdohet pa asnjë ndryshim dhe se ne për çështjet kapitale nuk kemi as dilemat më të vogla. Kur i dëgjoi këto nga unë i erdhi mirë dhe më rrahu krahët. Merre me mend se çka mund të ketë pasur në ato momente koka e tij. Në letrën e kaluar të fola se pata edhe takimin e shkurtë me Engjëll Kolanecin. Në panair më duket se kam bërë mirë që shkova sepse u takova me Peterin i cili më ftoi ta vizitoja edhe në shtëpi, dhe me njerëz të tjerë. U takova me një djalë nga Kërçova i cili ka kërkuar strehim në Ludvigshaven, i cili është shumë djalë i mirë, të cilit ia dhashë një adresë që të jemi në kontakt. Për disa momente rreth shtandeve të ndryshme pa dashtë unë më shoqëroi një përfaqësues i "Vëllaut të madh" (diplomati shqiptar nga Vjena-Skënder Dushi). Gjatë gjithë shëtitjes me te më foli vetëm për IK dhe e sillte bisedën se me te nuk bënë të bisedojmë por as ta luftojmë.

Unë me diplomatët shqiptarë jam sjellur si mund të merret me mend se si mund të sillet një idealist. Po kur ia kam dhënë adresën e br (Brukselit) kam bindjen se nuk kam gabuar sepse siç do ta shohësh më vonë atë djalë adresën e të cilit ua kam dhënë e njohin shumë më duket ata të Francës. Këtu nuk po zgjatem por po të them se ky shoku që më shoqëroi më jepte me gjykue se na duhet të sillemi si papagaj e të dimë të themi vetëm Kosova-Republikë! Mund të vërtetohen paramendimet që t'i kam thënë në Bern. Pesë ditë para panairit ia kam dërgua një fletë për ta mbushur Drita në lidhje me gurët e sonte në telefon shoqja e tij më tha se sot e mora letrën nga posta e shoqi qe sa shkoi në punë.

Shaqiri mendoj se është njeri i punës, unë kështu e kam bindjen. Është mirë që kishit biseduar me te, por mos të ngutet lidhur me Nuhiun, shoku Llesh sepse ti nuk e di a je duke e kuptue sjelljen e tij. Ai shkurt nuk din çka është nderi e fjala e burrit. Sido që të jetë unë i përmbahem qëndrimit tim dhe nuk do ta kthej fjalën ashtu sikurse Kamberit (SN). Por për Nuhiun më tepër ka vlejtë një intrigë a premtim i Halimit (Osman Osmanit) se sa korrektësia e Kamberit. Drejtë me të thënë po më vjen inati me të ra rasti edhe ty e me e lutë e me e pyetë Nuhiun se çka po donë. Kjo po më duket dobësi e jona. Thuaja edhe këtë Shaqir (Shabanit) që t'i thotë Nuhiut se ai duhet t'i kthej të gjitha adresat që ia kam dhënë unë që i ka pas përgatit Sokoli (Jusufi) dhe llogarit e plota për tubimin e të hollave që i ka mbledhur (i janë dhënë) në Untergruppenbach, si dhe ndihma për Kosovën. Këto të fundit i kërkojnë shokët e vet.

Lidhur me një takim të mundshëm që mund të thirret në vendin tuaj unë momentalisht nuk mund t'i përgjigjem e sidomos jo për punë të Nuhiut, sepse siç e di, dy herat që kam qenë tek ti kam udhëtuar me letër (pasaportë) të huaj, pasi pasaporta ime është e pavlefshme sepse e kam të ndaluar të hyj në Zvicër për dy vite (nga 20 prilli 1982 deri më 20 prill 1984 -shën i Xh.D.). Po që se do mund ta dërgoj edhe fotokopjen e ndalesës. Nuhiu duhet gjithashtu të m'i kthej disa artikuj të mi në dorëshkrim që i kam shkruar në ato ditë janari. Për të mos u lodhë me ardhë këtej, le të vjen ai atje. Shokët e vet i flasin privatisht, por me e pranua si më parë, jo se ai nuk është sjellë mirë me ta por nuk i ka bërë hesap për njerëz.

Naimi do ta paraqet kërkesën për azil në një vend larg nga këtu. Në atë vend veç ka shkua. (Është fjala për qytetin Hamburg, në këtë kohë, por pas qëndrimit disa mujor në këtë qytet vendosë të shkoj në Suedi, punë të cilën e bënë në pranverë 1983-shën i Xh.D.)

Dërgomi artikujt që i ke të gatshëm se do të filloi nga puna për numrin e ri të revistës. Ty po ti dërgoi këta. Kisha me të thënë se e meriton të botohet edhe artikulli Politika dhe lufta i cili më duket se ka dalë i mirë. Unë me e përmirësue më tepër nuk mundem sepse e kam rishkruar tri herë. Në vazhdim mos më shkruaj në adresë të Faridinit se e kam shumë larg por më shkruan në këtë adresë:

Buchhandlung, Hausmanstr. 107, 7000 Stuttgart, BRD (Xhafer Durmishi)

14. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, vjeshtë 1982

Shoku F.

Unë jam vendos te ai shoku dhe jam mirë. Namiu ma pruni edhe makinën. Ai mundet me të tregue më gjërë se unë në këtë letër. Uka (Xhafer Shatri) letrat le ti dërgoj edhe më tutje në adresë tënde edhe artikujt për organin. Ti ua heq zarfat e Zvicrës dhe i shtinë në postë në adresën që do ta shënoj në fund.

Tani po më mundon tepër problemi pse s'u kthye kurrgjë prej Tushës. Merre Mehdiun e dilni, apo thirrne Haxhiun e diskutone. Le te lyp ai dike në shtëpi në telefon, e nëse paraqitet nevoja do të duhet me e çue diken në Kosovë, sepse koha po ecë, e dimri erdh. Do të shkruaj prapë.

Shkruam në adresën:
Mathilde Roos
Josefstr. 60
6630 Saar Louis - Roden

Unë do ta dërgoj sot një letër në të gjitha drejtimet dhe do ta jap mendimin e punëtorëve të Shtutgartit në lidhje me festën e 28 Nëntorit.

Në Belgjikë ka nisë përgatitja e dramës.

Të fala S. (Xhafer Durmishi)

15. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, vjeshtë 1982

Shoku F. (Faridin)

Adresat që t'i dërgova më parë i fotokopjon e këtë origjinalin që po ta dërgoj ua jep atyre që të porosita.

I thuaj Meh. (Mejdi Rexhës) apo shiko edhe ti vet se mua traka e makinës mu harxhua. Unë pa te nuk mundem. Këqyrë në kofer, në një zarf është artikulli i një komunisti slloven France Kllopçiç me titull "Thuajeni të vërtetën e plotë" që e ka botuar Rilindja. Ma dërgon.

Këto adresa momentalisht janë për ty e Qe. por i mban ti.

Shoku F. këtë shtojcë po ta shkruaj më pas. Po më vjen keq, por e di se edhe ti këtë mundesh me e marrë me mend. Sot mua m'u harxhuan të hollat. Do të më nevojiten për disa letra milimetrike që të radhitet organi (revista) dhe për pulla postale të letrave e telefon. Sipas mundësive m'i dërgon100 DM. Dërgoi në adresën Ismail Hoxha etj., e din ti adresën. Edhe kasetat i dërgon.

Të fala S. (Xhafer Durmishi)

16. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, vjeshtë 1982

Shoku Faridin,

Rrotullat e kauçukut (shiritat e makinës së shkrimit-shën i Xh.D.) me vija e kanë këtë formë. (Vizatim në dorëshkrim) Vija e zezë, ngjitës për me i rrethua artikujt me vija të zeza. Tani po më nevojiten. Janë të gjana 5-10 mm. Mund të ndodh që të jenë te Remziu, vetëm më duket se nuk janë, por në kofer.

Po e pres artikullin e 28 Nëntorit dhe letrën e lexuesve, se përndryshe unë sot do ta kisha dërguar.

Adresa e Muharrem Gjocajt është: Klara str. 9-72, 8 München 19. Ia dërgon një letër, le të thirrë në telefon dhe i thua për kasetat. I tregon se kur mundet me të gjetë, sepse nuk bën ato me nejtë. Ky shoku i ka dy video dhe po incizoka në shumë ekzemplarë.

Këto rrotullar (shiritat) m'i dërgon po që se i gjen se janë shumë shtrenjtë (15 marka copa) dhe në librari duhet me i porositë.

Të fala S. (Xhafer Durmishi)

PS. Në Belgjikë thuaju në atë adresë se festa është vendosë të bëhet veçmas, që pjesëmarrja në çdo rreth të jetë më e madhe.

17. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, vjeshtë 1982

Shoku Faridin,

Para dy ditësh ta lëshova një letër në post, ku të thash me i mbledhë ata shokët. Në anën tjetër me Muratin e lamë që të shkojmë në Augsburg. Kështu, po që se i ke njoftuar shokët për takimin atë duhet edhe me e mbajtë. Kështu për Augsburg jam i mendimit le të shkojnë Remziu, nëse ka kohë, Murati dhe Hafizi. Unë do të shikoj me të marrë në telefon e i qartësojmë senet më mirë. Deri të shtunën gjendet kësajde edhe Ahmeti. Do t'ia japi projektstatutin. Gjithashtu duhet me ia dhënë edhe kasetën.

Me kaq mirë u pafshim.

Gjithashtu edhe këtë kambialin (çekun) me dy mijë dollar e merr me ia dhënë Ahmetit. (Xhafer Durmishi)

18. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, fillim i Nëntorit 1982

Mendimi i punëtorëve të rrethit të Shtutgartit lidhur me organizimin e kremtimit të Festave të Nëntorit

Në lidhje me organizimin për 28 Nëntorin punëtorët e rrethit të Shtutgartit janë të mendimit që të bëhet një organizim qendror i cili nuk do t'u humbte vlerën manifestimeve lokale. Kemi bindjen se një organizimi i tillë do të ishte në rregull. Nuk e shohim të rrugës të hyjmë në arsyetime.

Për këtë çështje kërkojmë mendimin e rretheve të:

- Dyseldorfit, Brukselit, Bernit, Gjenevës, Zurihut dhe Hamburgut.

Mendimi për këtë, punëtorëve të rrethit të Shtutgartit mund t'u dërgohet në adresën:

Buchandlung, Hausmanstr.107, 7000 Stuttgart

* * *

Faridin, dërgojua këtyre njerëzve:

1. Hyzri Rekaj, Mintorpstr. 27, 4000 Dyseldorf
2. Muhamet Ramiqi, Dorf Gaze 14,Horgen, ZH, Suisse
3. Frau Rubin, Inbrand 3852, Riegenburg
4. Dhe në adresën e Brukselit.
5. Ukës po ia dërgoj unë.

(Xhafer Durmishi)

19. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 25 nëntor 1982

Shoku Faridin 25 nëntor 1982

Ja po ta dërgoj edhe fjalimin të cilit duhet ta lexoni ndonjëri prej jush tek varrezat. Nuk e shkrova aq të gjatë po besoj se është i fuqishëm, përndryshe jam edhe pak i lodhur nga puna me revistën. Gjithashtu më mori pak kohë fjalimi për Shaqirin të cilin e shkrova në tri faqe. Unë me këtë shokun do të nisemi të shtunën heret në mëngjes, sepse ky është në ndërrimin e dytë. Ky do të marrë edhe familjen me vete, ka shoqen dhe dy fëmijë; djalin gjashtë vjeç dhe vajzë një vit e gjysmë. Për revistën shikoni gjatë shpërndarjes kur ta merrni, megjithëse se besoj se edhe unë do të jem atje, që të shpërndahet me marrëveshje, ta dimë se cili rreth sa do të marrë, sepse jemi marrë vesh se ajo në të ardhmen do të shitet nga tri marka e gjysmë ose tre franga të Zvicrës.

Gjithashtu edhe nëse vendosim me e shpërnda në sallë, këtë punë ia lëmë një rrethi tjetër. Le të duket sikur ata e kanë sjellë me vete.

Tash nuk po di se si keni biseduar atje në Hamburg, por nëse është marrëveshja që dikush prej rrethit tonë të shkoj të shtunën në mbrëmje në Dyseldorf, atëherë cakto njerëzit që duhet të shkojnë, por jo nga ata që na vyejnë shumë. Namiun po mendoj me e lënë që ta shoqëroj këtë shokun gjatë qëndrimit të tij atje. Sa i përket referatit tek varrezat shiko a mund ta bëjë këtë Haxhiu. Unë mendoj bile do të ishte mirë ta lexonte Ismet Klaiqi. Posa ta marrësh, dërgoja dhe diskutoje se a mundet ta bëjë këtë. I thuaj se ky është mendimi im.

Të fala Skënderi (Xhafer Durmishi)

(Faridin Tafallari, T-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 436)

20. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 29 nëntor 1982

Shoku F. (Faridin) 29 nëntor 1982

Me manifestimin jam shumë i kënaqur, sidomos për pjesën në sallë. Përndryshe jam frikësuar shumë dhe për këtë nuk mund të jemi të kënaqur për pjesën e programit tek varrezat. Përndryshe edhe Nam. e lexoi mirë. Njoftimet nuk ishin bërë mirë dhe në masë të mjaftueshme, sidomos në Sindelfingen.

Abdurrahman (Sadikun) nuk e pashë dhe kjo më çuditi, më intereson me e ditë a ishte në pushim apo jo. Këtë pjesë është dashur ta realizoni mirë.

I thuaj (Hafiz Gagicës) të marrë informata të hollësishme për atë njeriun i cili na informoi për Cyrihun dhe le të ma dërgojë emrin e tij, ku punon dhe s'ka nevojë më tepër. I thuaj gjithashtu Hafizit që të takohet me Kolë Mërturin e nëse e sheh të arsyeshme edhe me Kolë Palokën, por më së pari vetëm me Kolë Mërturin dhe ta pyesë se a kanë qenë ndonjë natë kush te ata, se më duket do të ketë qenë Hasan Veselaj, apo ndonjë i tyre dhe t'u ketë folur ashtu si i kanë folë Murat Kryeziut në Bernhausen.

Me Mehdi (Mejdi) Rexhën e Ismet Klaiqin takohu rregullisht ti dhe mundësisht çdo javë, bile në telefon dhe ata duhet t'i angazhojmë se do ta ndiejnë veten më mirë. Unë isha bërë merak shumë pse nuk ishin treguar më aktivë në njoftim të kësaj ngjarjeje, por më erdhi mirë që posa janë kthyer nga Dyseldorfi qenkan takuar me ty dhe qenkan ndarë të kënaqur. Gjithashtu edhe unë jam i mendimit se duhet ta kemi një vend publik apo rrethi ynë, ku mund të takohemi sa të duam dhe kur të duam. Për video që të bleni mos u ngutni, sidomos mos bleni sistemin VCC 2000 ose të ngjashëm, por shumë më të mirë se po dalin sistemi FHS (VHS) katër orësh. Këndej paska shumë video të tillë dhe qenkan më të mirë. Kasetat e gjata po u prishkan më shpejt dhe po e munduakan videon, ashtu siç e mundon magnetofonin p.sh. traka e 90 minutave. Gjithashtu ne tani e tutje të gjitha incizimet dhe shumëzimet do t'i bëjmë pa të holla, sepse e kemi një mundësi të tillë. Kur

jemi tek kasetat e kam edhe këtë porosi: Ia dërgon Qazim Malës (në Troisdorf) kasetën që ta dhashë e që e kemi pasur këtu, me porosi, duke i treguar se ai është origjinali dhe që ta bëjë një kopje të saj me shokët e tij, me shpenzimet e tyre, sepse ne momentalisht nuk po mundemi. Gjithashtu thuaju se nëse në të ardhmen mendojnë të blejnë ndonjë video, të mos e blejnë të tipit VCC, duke ia përcjellë fjalët që t'i thash ty.

Nuk pata shumë rast të bisedoj me Sahit Tofajn e Hasan Veselajn. Me ata ngadalë, por nuk bënë me i këputë takimet me ta. Kur të takohesh me ta çoje bisedën në atë mënyrë që mos i le aq shumë të flasin për mua, Mërgimin (Sabri Novosellën) etj., duke u thënë se njerëzit nuk janë me rëndësi, me rëndësi është që puna le të shkojë mbarë e se do të shkoj mbarë për atë që ka sy me pa e vesh me dëgjue. Haxhi (Berisha) ndoshta nuk është aq shumë i përshtatshëm, por edhe për të mos diskuto shumë me ta, sepse po duket se ata po sillen sikur në rreth, herë te njëri e herë te tjetri. Kur ta marrësh organin, thërrite Hasan (Veselajn) në telefon dhe e njofto nëse do me ardhë me i marrë. Tregoj se është vendosur që të shitet në të ardhmen. Nëse ka mundësi le t'i paguaj të hollat që të shitet ky numër, por edhe me këtë numër pagimin s'do ta bëjmë të domosdoshëm. Ia përkujto se me ty janë konsultuar edhe kur u bë shitja e tij në Bon. Ia jep vetëm 15 copë sepse nuk kemi më shumë, sepse vërtetë nuk kemi më tepër. Unë kah fundi i mbrëmjes e pyeta: "Si je dhe si e ke familjen?" Dhe e pash se i luajti gjaku në fytyrë çka d.m.th. se ai në brendësinë e tij gjendet në mes dy zjarresh. E pikërisht për këtë duhet të jemi më të durueshëm me ta. Ti nuk ju thua se për këto çështje mund të më drejtoheni vetëm mua, sepse ata unë pres, se edhe në të ardhmen do të takohen me Haxhi (Berishën) sidomos Qazimi. Punën e Jahirit ta shpjegova detalisht. Këtë ua shpjegon edhe Mehdiut (Rexhës) dhe Ismetit (Klaiqit) e gjithashtu në emrin tim i kërko të falur dhe bisedo pak me Bacën Selim (Kocin)se isha i detyruar të sillesha në atë mënyrë. E sa i përket asaj që tha ai: "Mos të më thirrni më se kurrë nuk vij!", për këtë thuaju shokëve të ngushtë se ne kurrkund nuk kemi dalë për hatër të dikujt por pse e kemi ndier borxh. Prandaj ajo s'është ndonjë problem i madh. Nëse thotë: "Mua më ka besuar Jusuf Gërvalla!", i thuaj se atëherë nuk i ke thënë J. Gërvallës pse ia more "Zërin" Riza Salihut etj. siç po thua tash dhe mos e zgjatni shumë me të.

Edhe punën e Nuhi (Sylejmanit) mos e përmendni me askënd dhe mos e bëni hesap që ekziston., kështu është më mirë. Edhe Uka (Xhafer Shatri) e ka pa se prej tyre s'ka asgjë, përkundër përpjekjeve të mëdha të tij. Këta kanë tentua me bërë plane edhe me IK (Ibrahim Kelmendin). Në këtë drejtim sot mora vesh se Uka ka bërë një propozim, të cilin do ta pranojmë për shkak të situatës. Programojeni punën sa më tepër që më 10 dhjetor të jeni sa më shumë të lirë, se i keni dy javë afat, që të organizoheni sa më mirë. Kur të takohesh me Hasanin dhe Sahitin, punën e Nexhatit (Osman Osmanit) mos e zërë fare në gojë, as për mirë as për keq. Nëse duan me folë le të flasin vetë ata. "Zëra" në Adapazar mos dërgo asnjë, e në Stamboll më shumë. I thuaj edhe Hafiz (Gagicës).

Të fala, S. (Skënderi=Xhafer Durmishi)

P.S. Hafizi le të marrë informata prej Neuburgu për atë Komunikatën, se a u ka ardhë me postë, a nën derë, le të tregojnë nëse me postë, prej cilit vend. Atyre mos t'u thuhet se është me rëndësi, se përndryshe është me rëndësi.

Remziu (Ademaj) le të ta jap referatin që e lexoi dhe dërgoma menjëherë.

(Faridin Tafallari, T-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 436-438)

21. Letër e Xhafer Durmishit për Engjëll Kolanecin, nëntor 1982

Shoku Engjëll (Kolaneci-diplomat në Ambasadën e Shqipërisë në Vjenë)

Në prag të festës Faridini më njoftoi për bisedën telefonike që paska pasur me ju. Me këtë rast më tregoi se tek ju paskan ardhur letrat e Suzanës. Siç ju pata thënë edhe më parë, neve na u deshtë që gurët t'i rregullojmë me çdo kusht para festës, dhe siç mund t'ju ketë treguar shoku Faridin, ata (gurët) u vendosën e me sa duket janë të punuar mirë. Edhe njerëzit kanë dhënë vlerësime të mira, por ndonjë fotografi ende nuk ma kanë sjellë shokët. Ne huazuam një shumë të hollash për këtë rast dhe paguam një pjesë për të cilën të kam pas treguar. Firma e gurëve, në të vërtetë më kompetentja, se këto rregulla këtu unë nuk i di, por si më kanë treguar e ka bërë punën në atë mënyrë që, kur të kthehet letra (autorizimi) i Suzanës do të na kthehen të hollat. Siç e dini, në atë letër Suzana autorizon një njeri që të përgjigjet në çdo rast për sigurimin e gurit të të shoqit, për arsye se ajo nuk ka banim të përhershëm në mërgim.

Përndryshe ne jemi mirë, edhe punët janë duke shkuar mirë.

Te fala S. (Xhafer Durmishi)

(Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë1998, f. 255)

22. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 30 nëntor 1982

Shoku F. (Faridin) 30 nëntor 1982

Mbrëmë fola në telefon me U. (Ukën=Xhafer Shatrin). Ai më porositi që të angazhohemi maksimalisht që dasma e Gjenevës të ketë sukses sa më të madh, sepse kjo ka rëndësi të madhe. Pra, që tani shikoni e angazhohuni sa më shumë që për 10 dhjetor të jeni sa më shumë të lirë. Për këtë, punë me rëndësi do të kenë sidomos ata në Sindelfingen.

Në Austri gjithashtu dërgo bukur shumë thirrje të tilla dhe është mirë që edhe prej tyre të angazhohen sa më tepër për këtë rast. Thirrjet nuk do t'ju mjaftojnë, prandaj edhe shumëzoni disa dhe kur t'i dërgoni, porositni edhe ata që t'i shumëzojnë.

Negativat e numrit të fundit merrini, ndërsa të gjitha fotografitë e numrit të fundit ia dërgoni U. (Xhafer Shatrit). Gjithashtu merreni prej atij gjermanit në konvikt edhe fotografinë e Hydajetit dhe atë karikaturën që është botuar në numrin e kaluar e gjithashtu dërgojani U., sepse kështu jam marrë vesh me të. U. në telefon i thash se nuk e di a do të mund të vijë pasi letrën time e kam dorëzuar. Sepse siç e din edhe ti, letra ime nuk vlen më për asgjë. Prandaj nuk e di se si me ia bërë, dhe po që se nuk gjej letër të përshtatshme për udhëtim, do të mbetem kësaj radhe pa ardhë.

Sa i përket Engjëll (Kolanecit) më njofto posa të marrësh letrat e Dritës (Suzana Gërvallës). Nëse ka diçka me rëndësi ai do të shkruajë, apo do t'ia thotë shokut tonë më përgjegjës, i cili është i caktuar për marrëdhënie me ta, sepse unë nuk mund ta thërrasë, sepse e tillë është marrëveshja me shokët.

Këto letra që po t'i dërgoj, gjithashtu lëshoji menjëherë në postë.

Të fala S. (Skënderi=Xhafer Durmishi)

P.S. Namiu (Ramadani) le t'i dërgoj 150 copa në Bruksel sa më parë që ta ketë rastin ose dërgoi me postë në adresën e vjetër.

(Faridin Tafallari, T-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 438-439)

23. Letër e Xhafer Durmishit për Xhafer Shatrin dhe Sabri Novosellën, 3 dhjetor 1982

Letër dërguar Sabri Novosellës e Xhafer Shatrit, 3 dhjetor 1982

Edhe këtë vit, në ditën e shtunë të panairit të librit ishim në Frankfurt. Gjatë ditës brenda në Panair pothuaj kohën më të madhe më shoqëroi Skënder Dushi dhe bisedën më së shumti e solli tek Ibrahim Kelmendi me qëllim që të mbjellë dhe forcoj sa më shumë dyshimet në te.

Në mbrëmjen e asaj dite me Engjëll Kolanecin u takuam unë dhe Faridini. Ai ishte vetëm (dhe kështu ka qenë në të gjitha rastet). Që ta kemi këtë takim kësaj radhe kisha interes edhe unë, pasi desha ta shfrytëzoj rastin e kësaj dite dhe i thash se takimet tona në vazhdim janë të panevojshme.

Faridini i foli edhe për atë çka se prita, se çka i kanë thënë Jahir Jahirit gjatë vizitës së tij në Shqipëri. Engjëlli u përgjigj se atje iu kanë thënë gjëra që bënë me ju thënë, pra edhe ato që ua themi edhe ju, që të ruheni se keni në radhët e tuaja shumë njerëz të dyshimtë, dhe se serbët e dinë se kënd e lëshojnë nga burgu.

Jahir Jahiri është një punëtor, rreth 40 vjeçar, nga fshati Slivovë i komunës së Ferizajt. Ka të afërm në Shqipëri dhe kësaj vere përmes shokëve në Ambasadën e Vjenës, është i vetmi punëtor kosovar me sa di unë që e ka vizituar atdheun. Ka qëndruar një muaj ditë. Ka qenë një prej më aktivëve dhe iu është përgjigjur të gjitha manifestimeve, dhe nuk është dalluar në ndonjë mënyrë prej rrethit të vetë. Për ZK thoshte se po del edhe më i mirë se përpara. Pasi u kthye nga vizita në Shqipëri ka ndryshua për 180 shkallë. Ky ka qenë anëtar direkt i rrethit të Faridinit. Pas kthimit nga vizita u largua nga Faridini e rrethi i tij dhe iu afrua Halimit. Jahiri është iniciatori, ai që ka kërkua me këmbëngulje takimin e aktivistëve kryesor të rrethit të Shtutgartit më 26 shtator 1982. Por si duket u befasua nga se si iu përgjigjën të gjithë këtij takimi dhe mungoi.

Me Jahirin u takova edhe në mbrëmjen e kremtimit të 28 nëntorit, pasi festa ishte organizuar në një sallë në fshatin ku ai banonte. Një punëtor më tha- a shkoj ta marrë, dhe unë i thash se do të ishte mirë nëse vjen. Ai erdhi. Kah mesi i programit, ky shoku që e solli më tha se Jahiri po ka dëshirë me e marrë fjalën. I thash mirë por dua ta dijë se çka do të thotë. Jahiri, pasi kishte pi pak, më thotë se kjo është punë për mua. Unë nuk e lejova se nuk besoja se nuk do ta lëshoj ndonjë fjalë, duke e lutur që të mos na e prishë këtë mbrëmje. Ai u hidhërua si mora më vesh edhe më tepër duke thënë se JJ e njehë krejt Shqipëria etj. etj. (Unë e pyeta Faridinin se si me ia bërë dhe ai tha që të mos ia jap fjalën).

Të fala (Xhafer Durmishi)

24. Letër e Xhafer Durmishit për Xhafer Shatrin, 5 dhjetor 1982

Shoku Llesh,

E mora letrën tënde për të cilën më fole në telefon dhe e kuptova në përgjithësi. Sa u përket gjërave në letrën time dhe përgjigjes, ne po kuptohemi, unë më nuk po e vazhdoj, ne do të ecim përpara e një ditë dikush që do të ketë kohë më shumë do ta analizoj punën tonë më ngadalë. Unë po përgjigjem vetëm pak në te:

Së pari po të them se këtë letër që ta kam dërguar, të mos e kuptosh se është shkruar nën ndikimin e ligjit të inercionit kur pas gjithë atyre diskutimeve të mëparshme në drejtimin tjetër nuk munda të ndalem menjëherë. Së dyti këtë letër nuk e kam shkruar as nën ndikimin më të vogël nga fjalët e Engjëllit, sepse vetë përmbajtja e të letrës dhe e të gjitha qëndrimeve të mia flasin për një besim të patundur i cili nuk do të lëkundet në asnjë moment prej anës tonë. Nuk është vështirë të kuptohet se përmbajtja e letrës së

fundit ka të vetmin qëllim një besim e respekt pak më të madh prej anës tënde ndaj meje, të cilin besoj se kam të drejtë ta kërkoj së paku në masën e 50%-shit të qëndrimit tim.

Përndryshe në të ardhmen është mirë të flasim për disa gjëra më konkretisht, si p.sh. siç është rasti që thua: i Haf. për konton, shpërndarja e një materiali 9 faqesh nga ata të Brukselit, për përmbajtjen e letrave kritikuese në adresë të tyre (dhe nëse me të vërtetë ata kanë pasur kontakte me tjetër kenin, a qenka krim të kthehen në rrugë të drejtë, apo u bënë për çdo kritikë vetëm pas atij udhëtimit tim në Bruksel, në ndërkohë kur në Bern (më 26 qershor) u prezantuan me pompozitet nga IK. Pastaj po deshte edhe për ndonjë rast që pse ti, haku ynë të biesh në pozitë aq të keqe sa t'i lejosh njerëzit të të quajnë naiv. Kjo nuk është në interesin tonë që njerëzit t'i bëjmë të mendojnë ashtu. Kjo nuk ka ndodhë prej anës tonë. Unë e di se në mese të ndryshme jam quajtur gjithqysh, por në pyetjet e mundshme i kam sqaruar shokët këtu ashtu siç kam ditur më mirë, dhe sqarimet e mia kanë pasur efekt.

Më vjen mirë që kaluat me sukses me këto problemet shëndetësore dhe ju uroj rregullimin në vendosje të re. Sa u përket rregullimit të lidhjeve tona në një nivel më të mirë ma merr mendja se aktualisht të dy palët jemi të kënaqura që për këtë punë ta përdorim Faridinin. Kështu që po e pe të arsyeshme të ndërrosh edhe vendin e adresës ku do të vijnë letrat prej anës time ku do të vijnë letrat prej anës sime e atë vend don ta kesh afër që ato të vijnë brenda ditës, atëherë unë të gjitha letrat mund t'i dërgoj te Faridini, ku prej meje e deri tek ai do të vonohen vetëm një ditë e ai t'i nisë menjëherë.

Sa i përket propozimit tënd, unë përgjigjen e tij e shënova në këtë letrën më të gjatë, si dhe për qëndrimin e Engjëllit, se çka i kam thënë unë pas atyre fjalëve të kam treguar më parë. Për qëllimin, nuk di çka të them, di aq sa din ti për këtë, në bazë të këtyre të dhënave që i kam shprehur tash dhe më parë. Unë e mora edhe letrën prej Kamberit (SN) në lidhje me propozimin tënd të cilin ai e aprovon dhe më thotë arsyetimin e vet.

Për dasmë (demonstratë) unë sipas të gjitha gjasave nuk do të mund të vij, sepse një pasaportë me të cilën kam bërë disa udhëtime më parë tani nuk vlen. Unë do të mundohem të gjej një tjetër por do të jetë e vështirë.

Faridinit ia dërgova një letër që ta dërgoj adresën e Seven Bebes sepse unë nuk e kam me vete. Siç të kam pas thënë pas atij rastit, Kamberi më pat thënë mos me i shkruar, e mua adresa që ma dërgoi më humbi. Në kohën kur ma dërgove ti adresën, ai më udhëzoi t'i shkruaj në adresën e mëparshme, kështu që nuk më ra me e përdorë atë që ma dërgoi asnjëherë, andaj edhe nuk e përshkrova nga ajo letër që ma dërgove.

Të fala S. (Xhafer Durmishi) 5 dhjetor 1982

25. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 8 dhjetor 1982

Shoku Faridin, 8 dhjetor 1982

Unë në dasmë (demonstratën e 10 dhjetorit 1982 në Gjenevë-shën i Xh. D.) nuk do të mund të vij. Kjo po ndodhë për shkak të mungesës së letrës së udhëtimit në radhë të parë. Dhe në anën tjetër këtij shokut do t'i kushtoj shumë materialisht e sa i përket këtij, ky e ka dhënë provimin e vetë, mjaft edhe me rastin tim. Edhe po të vija unë, nuk do të mund të ndalesha atje e të bisedonim së bashku edhe për ndonjë ditë, për të njëjtat shkaqe për të cilat nuk munda të ndalem as herën e fundit kur isha në Shtutgart për festë (të 28 Nëntorit-shën i Xh D), edhe pse do të ishte mirë të ndalesha më shumë.

Ti veç je i njoftuar prej letrës së fundit të U. (Ukës=Xhafer Shatrit-shën i Xh. D.) për një propozim të cilin e ka bërë, të cilin e ka pranuar Mër. (Mërgimi=Sabri Novosella-shën i Xh. D.). Unë në atë letër jam përgjigjur me mendimet e mia të cilat nuk kam

mundur ty me të treguar ende. Do t'i dërgoj në këtë letër. Të njëjtën ia kam dërguar Ukës dhe Mërgimit të cilët deri të premten sigurisht do t'i kenë në dorë. Ukës bëri të fala prej anës time. Nga ai merre që atë ditë fjalimin të cilin do ta lexoj dikush që ta përgatiti menjëherë (për botim në revistë-shën im) si dhe i thuaj nëse donë me t'i dhënë të gjitha materialet që janë të gatshme për numrin e ardhshëm. Unë ia kam dërguar një letër Ukës në të cilën i kam thënë edhe atë që ndoshta për të gjitha lidhjet në mes meje e atij do të bëhen përmes teje, kështu që ndoshta letrat në të ardhmen për te, do t'i dërgoj ty e ti ia përcjell. Unë me siguri të hënën do të paraqitem se e kam edhe terminin por këtë s'ke nevojë me ia thënë askujt, as në dasmë. Bisedoni për vendin e takimit dhe të takohemi sa më shpejt sido që të bëhet.

Dërgojani sa më shpejt i thua Mejdi Rexhës, organin (revistën) Peter Ptatzmannit. Ia dërgon edhe të numrit të kaluar, nga dy copa për çdo numër.

Të fala S. (Xhafer Durmishi)

PS. Më shkruaj posa të kthehesh se si kaluat. Disa pyetje i kam bërë Hafizit e nuk mora përgjigje prej tij.

26. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 10 dhjetor 1982

Shoku Faridin, 10 dhjetor 1982

E mora letrën tënde dhe të Hafizit. Këtë letër ia dërgo Hafizit menjëherë, e gjithashtu ti u flet për situatën e krijuar. Po e shoh të arsyeshme që Hafizit t'i shkruaj më shpesh, prandaj i thash që të ma dërgoj një adresë ku do t'ia shkruaj letrat më shpesh, pasi ai me tërë shpirtin angazhohet dhe depërton nëpër njerëz. Prandaj duhet konsultuar sa më shpesh. Edhe kontaktet me Nai. do t'i zhvilloj nëpërmjet tij. Numrin e telefonit të Hyzriut nuk ma kishe shkruar. Unë atij para do ditësh, në të vërtetë pas panairit ia kam pas dërguar një letër lidhur me ata në Bruksel por nuk ma ka kthye. Përndryshe kontaktet me ta do t'i bëjmë vetëm me dijeninë e Ukës, që të mos ketë ndonjë keqkuptim, derisa ta kuptojmë se jemi një.

Përndryshe siç i thash edhe Hafizit, tani mendoj se është krijuar një klimë e mirë dhe mendoj se është me baza mendimi që e kam dhënë edhe në letrën e gjatë. I thuaj Haxhiut dhe Hafizit, se ato 160 marka që na kanë mbetë në "Seel" të Heilbronit, le t'i marrin 10 shirita të makinës për shkrim, të cilën e kam, se më harxhohen shpesh se po e rëndoj shumë e këtu po kushtojnë nga 10 marka, si dhe gjithë të tjerat merrni shirita të hollë tipex për këtë makinë. Hafizi e din se çfarë duhet. Këtë punë le ta bëjë menjëherë. Për këtë dhe për t'i marrë të gjitha gjërat që më nevojiten besoj se do të vij me këtë shokun.

Origjinalin e kësaj letre shtesë ia dërgon Ismailit e kopjen ndale vetë. Letrën dërgoje në këtë adresë: Ismail Abdiu, Postf. 101, 4003 Basel CH.

Këtë letrën tjetër ia dërgon Qazim Malajt në Troisdorf. Gjithashtu merrni masat që ky numër të shpërndahet sa më tepër dhe të bëhet pagesa e tij dhe kam shpresë se shitja e tij do të na e zbutë mirë këtë krizën tonë.

Letrën tënde e kam marrë por siç po e sheh ky rasti do të na vonoj pak në këtë drejtim.

Për këtë po ia nisë një letër edhe Mejdiut, që ata të shikojnë në drejtimin e tyre me Remziun. E gjithashtu në këtë drejtim duhet të angazhohet Murat Kryeziu. Hafizi le t'i pyes ata të Neuburgut se sa ekzemplarë iu duhen.

Të fala, Skënderi (Xhafer Durmishi)

(Faridin Tafallari, T-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 439)

27. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 11 dhjetor 1982

Shoku Faridin, 11 dhjetor 1982

Porosinë që ta bëra në lidhje me blerjen e 10 kasetave (shiritave) për makinë u thuaj Hafizit e Haxhiut që mos t'i porosisin (marrin) 10 kaseta por 6 kaseta, dhe po aq tipeksa, kurse me të hollat që do të mbesin, le t'i porosisin dy palë germa në gjuhën shqipe d.m.th. këto porositen e pas një kohe vijnë në atë mënyrë që në vend të germës ü e vendosin germën ë e në vend të germës ö germën ç por kjo presja përfundi germës c duhet të jetë sipas rregullave. Për të dy këta shembujt për me iu treguar më mirë atyre në librarinë "Seel" në Heilbronn mund ta marrin Zërin e fundit dhe ua krahasojnë. Pra:

ü---------ë
Ü--------Ë

_____

ö--------ç
Ö-------Ç

Të fala S. (Xhafer Durmishi)

Marka e kësaj makine është Brother, Electronic 8300

(Kjo ka qenë makinë e rëndomtë shkrimi dhe nuk duhet ngatërruar me makinën radhitëse të Jusuf Gërvallës IBM Electronic Selectric Composer me të cilën kam punuar gjithashtu në këtë kohë, por atë e kam përdorur vetëm për radhitjen e artikujve të revistës Zëri i Kosovës, dhe jo për shkrimin e letrave me të cilat mbaja kontakt me shokët, sidomos me ata në Shtutgart- shën i Xhafer Durmishit)

28. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 14 dhjetor 1982,

Shoku F. (Faridin) 14 dhjetor 1982

Këtë letër sa më parë drejtoje te Qazim Malaj. Gjithashtu merrni masat që ky numër sa më tepër të shpërndahet dhe të bëhet pagesa e tij dhe kam shpresën se shitja e tij do na zbutë mirë këtë krizën tonë.

Letrën tënde e kam marrë, por siç po e sheh ky rasti do të na vonoj pak në atë drejtim. Pra detyra jonë e parë është që sa më shpejt të marrim masa dhe ky numër i "ZK" të shpërndahet në mënyrë sa më të organizuar.

Për këtë do t'ia nis një letër edhe Mehdiut që ata të shikojnë në drejtimin e tyre me Remzi (Ademin). E gjithashtu në këtë drejtim duhet të angazhohet edhe Murat (Kryeziu). Gjithashtu edhe Hafizi le të shikoj me ata të Nojburgut se sa iu duhen.

(Xhafer Durmishi)

(Faridin Tafallari, T-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 439-440)

29. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 16 dhjetor 1982

Shoku F. (Faridin) 16 dhjetor 1982

Për dramën do të jetë pak e vështirë, se nuk e di si po ia bëjmë më 17 janar. Ti je i informuar për atë propozimin tim, të cilin ia kam dërguar U. (Xhafer Shatrit) dhe M. (Sabri Novosellës). Prej N. më ka ardhur një letër, e cila do të më vij nesër, ku do ta shoh edhe mendimin e tij për këtë çështje. E nëse edhe ai pajtohet me atë mendim, atëherë tërë forcën do të duhet ta përqendrojmë në përgatitjen e Kongresit që të dalë sa më i fortë, e kjo në këtë situatë është me rëndësi shumë të madhe. Nga ana tjetër, prej tij nuk kam marrë letër prej asaj në tri faqe, ndërsa unë ia kam dërguar tri letra. Momentalisht jam

duke pritur një letër prej tij për shumë çështje, e njëherësh edhe ky takim i ne të pestëve duhet të jetë në nivel. Lidhur me dramën, Hafizi e Nax. (Remzi Ademi) të kanë folë për veti, sigurisht tue pas besimin tek unë. Si të thash në telefon letrën me 20 marka e mora. Do të shkruaj ndoshta nesër më gjatë dhe ndonjë letër tjetër, për atë që të kam paralajmëruar. Ti më trego se a u takove me Hasan (Veselajn) e Sahit (Tofajn) për ato që më paske shkruar dhe si u ndave me ta.

Të fala, S.(Skënderi=Xhafer Durmishi)

(Faridin Tafallari, T-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f.440)

30. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 20 dhjetor 1982

Shoku F. (Faridin) 20 dhjetor 1982

Këto letra ia përcjell Mehdi (Rexhës) dhe Shaban (Bobajt). Mehdiut bënë pak edhe me i tregua se është në diskutim përgatitja e një Kongresi të Lëvizjes, por ende nuk është vendosur. Këtë, pra, ia thua vetëm atij, se po që se mbahet, nga rrethi ynë do të marrin pjesë disa veta ku do të jetë edhe Mehdiu. Angazhohu që këto porosi që ua dhashë, t'i kryeni pa u vonuar. Më njofto gjithashtu për çdo gjë të re. Natyrisht si edhe letrat të tjera lexoji edhe këto. Se për disa gjëra që ia thash Mehdiut, bëjnë edhe për ty. E për disa gjëra që do t'i bëni, sidomos tani e tutje aprovojnë ata, duke i pyetur më parë se kështu edhe do të zhvillohet te ata iniciative dhe do ta ndiejnë veten më mirë. Numri i telefonit të Amerikës që ia ke dërguar Muharrem (Gjocajt), nuk është i Sejdisë (Bytyqit) por i Nezir Sumajt, farefis i familjes Gërvalla. Mos u vono hiç, por gjeje kohën një ditë dhe duku te avokati me Hafizin dhe pyetni për pensionin e Tushës dhe ato të holla ia dërgoni Tushës nëpërmjet kushëririt të saj Miftarit, si dhe ia dërgoni ndonjë fotografi të gurëve. I thuaj gjithashtu Namiut (Ramadanit) që disa fotografi i ka bërë shoku ynë ku po rri (Ismail Hoxha) për disa njerëz të cilëve ua ka marrë adresën atë ditë dhe u ka thënë se do t'ua dërgoj fotografitë. E unë i thash atë ditë që ato fotografi t'i bëjë me aparat të Namiut. Pra Namiu le t'i dërgoj këtu disa fotografi me disa njerëz që nuk i njeh e t'i shoh se edhe unë i njoh ata njerëz. Nëse E. të lajmërohet se m'u kthyen apo diçka tjetër, ktheja me të mirë se s'ke si bënë etj. Ai pasi e ka këtë punë në dorë, le të bëjë si t'ia merr mendja. Incizimi që e kemi bërë atë ditë me kamera ka dalë shumë i mirë.

Të fala, S.(Skënderi=Xhafer Durmishi)

(Faridin Tafallari, T-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 440-441)

31. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 29 dhjetor 1982

Shoku Faridin, 29 dhjetor 1982

E mora letrën tënde me 50 marka. Ju falemnderit. Një letër ta shkrova edhe dje e besoj se do ta kesh marrë. Librat e shokut E. "Titistët" nuk më erdhën. Nuk e di se çka është bërë. Sot po t'i lëshoj në postë edhe dy videokaseta me dramën "Besëlidhja shqiptare", i cili është filmi më i mirë që e kam parë deri më sot. Organizohuni disi e merrni me qira ndonjë video për vitin e ri dhe shikojeni. Videoja duhet të jetë e tipit VHS. Në kasetë keni program prej gati 4 orësh. Bëje një fotografi të mirë të varrezave për numrin e ardhshëm, e gjithashtu shkoni në Untergruppenbach e fotografojeni shtëpinë prej pozitave të ndryshme e ta botojmë atë që del më së miri. Por kur ta fotografoni, mos rrini shumë aty e as mos e zgjidhni kushedi se sa pozën, por veproni shpejt që të mos vërehet ajo punë. Këtë letër me këtë porosi ia përcjellë Remziut.

Edhe ti priti urimet më të përzemërta me rastin e vitit të ri.

Të fala, Skënderi (Xhafer Durmishi)

(Faridin Tafallari, T-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 441)

32. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 30 dhjetor 1982

Shoku F. (Faridin) 30 dhjetor 1982

Letrën tënde me porosinë time e mora.

Ma dërgo edhe atë poezinë. Njëkohësisht dërgoni këtu edhe këta filmat shqiptarë së bashku me kasetën tjetër që e ke marrë në Zvicër, se edhe këndej do t'ia shtjellim diqysh punën.

Këto letra lëshoi në postë. Adresat e Ahmetit (Sadikut), Besimit (Rexhës), e të Hajdarit (Sadriut), (Frau Rubin), mundësisht i shkruan me makinë. I telefonova menjëherë E. e ai më tha se atje janë, por ende këndej nuk ka lëshue kush. Veç do ta thërras nesër e do të njoftoj. Letrat mundësisht është shumë mirë që të mos i lëshosh prej qytetit tënd, po dil më larg pak.

Letrat e Ahmetit dhe të Besimit fotokopjoji, sepse unë i kam shkruar pa kopje. Ata të Austrisë porositi që të gjithë çekat që të dërgojnë të holla le t'i japin ty. Hamburgut propozimin për festë çoja në ndonjë adresë për Isak Gutajn, nëse ta ka sjellë Hafizi. Me të vërtetë tani jemi në njëfarë krize materiale. Puna ime tani nuk është aq me rëndësi: me rëndësi është ajo se ne tani kemi edhe 1300 marka borxh për këtë numrin e "Z" e janë mbi emrin e Hafizit (Gagicës). E ai në këto momente nuk e ka punën mirë. Shokut larg ia dërgova një letër të gjatë lidhur me këto e gjithashtu me përmbajtjen e bisedimeve që i patëm te Uka (Xhafer Shatri) në H.

Te një gjerman në Shtutgart më vinë letra prej disa drejtimeve, Italie dhe Australie më së shumti. E ka këtë numër telefoni: 0711609021. E ka emrin Javorek. I prezantohesh si shok i Gagicës, dhe gjeja disi metodën me i marrë, dhe më thuaj a ke ndonjë ide se si me ia bërë disi që të gjitha letrat të më vijnë në një vend e prej atij vendi që të gjitha të m'i nisësh. Do të ishte shumë mirë me u gjetë ndonjë gjerman apo ndonjë plakë në qytetin tënd.

Unë do t'i përgatisë edhe adresat e nevojshme që do t'ia japësh Mehdiut i cili së bashku me Ismetin (Klaiqin) do ta përcjellin organin nëpër vende të ndryshme. Shaqës (Shaqir Shabanit) do t'i them që vazhdimisht për çdo rast të drejtohet tek ti. Edhe ky kontakt që do të vendoset me këta dy vëllezërit në Bern, besoj se do të jetë i mirë. Me Mehdiun takohu e ai le të komunikoj edhe me Remziun (Ademin).

Të lajmërohem prapë. Të fala, S.(Skënderi=Xhafer Durmishi)

(Faridin Tafallari, T-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 441-442)

33. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, dhjetor 1982

Shoku F. (fundi i dhjetorit 1982)

Pas bisedës po ta shkruaj këtë letër.

Si do që të bëhet kësaj radhe I.K. (Ibrahim Kelmendi) le të vjen kësaj radhe te ti. Vet fakti se ai dëshiron të vij tregon se pa marrë parasysh qëllimin, kjo ka rëndësi. Ti prite si gjithmonë. Pyete për përmbajtjen, por sigurisht ai do të jep edhe në shqipe. Për këtë takimin e paramenduar nga Uka mos fol ti i pari. Ai sigurisht do të flet. Atij do t'i intereson se çfarë disponimi ekziston në Shtutgart për te. Po që se bien biseda te unë i thuaj se në rrethinë të Shtutgartit është, apo mos i jep kurrfarë shpjegimi, por mund t'i thuash se po kontaktoj me te, se përndryshe do të ishte një rrenë në erë. Për të tjerat bë si ta merr mendja. Traktin shpërndane kohë pas kohe, shumë lenua njerëzve nëpër xhama të kerreve. Bisedo me te edhe për sallë. Edhe për Brukselin mos u zgjat. Pyete edhe ti për atë kushërinin magjistrin etj. Pyete se ka pa dynja me sy (si për shaka) se si kalove nëpër Amerikë etj.

Të fala S. (Xhafer Durmishi)

PS. Të bëhej takimi kësaj jave mendojsha të vij e të dukem pak. Tash nuk e di. Për vit të ri sigurisht do të rri në banesë. Shoku do të shkon në Francë se e kanë thirrë. Unë më 22 dhjetor isha në Sozialamt. Për 9 ditë më takuan 90 marka. Por si edhe më parë, edhe në këto ditë dy herë kam qëndrua në banesë se më shumë kam nejt tek shoku. Mesatarisht në ditë po më shkojnë 5-7 marka letra e telefon. Përveç teje, tjerat krejt ky shoku i ka paguar. Siç të thash në tel. është mirë ta kemi një bazë tjetër këndej ku do të lenim letra e sende të ndryshme për të cilat nuk do të dinte kush hiq. Përndryshe një ardhje e ime atje do të ishte me rëndësi edhe për t'i marrë shumë sende teknike e edhe shumë libra që po më nevojiten, sepse kam kohë të merrem me to, dhe ajo është e domosdoshme.

34. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 2 janar 1983

Shoku F. (Faridin) 2 janar 1983

Të gjitha fotografitë që janë botuar në organin e fundit, i merr prej Hafizit apo i keni lënë dhe ia dërgon U. (Xhafer Shatrit). Atij ia dërgon gjithashtu të gjitha fotografitë që janë botuar në Zërin e muajit shtator, përveç asaj të dasmës (demonstratës) në Bern, e cila është e jotja. Një fotografi e vogël e Hydajetit është te Remzi (Ademi). Është në një kapak të tavolinës që është atje. Çelësin e ka ai, prandaj le të ma dërgoj menjëherë se ajo foto do të botohet në këtë numër, si e vogël. Për leje ndoshta nuk do të ketë aq problem. Ju popullarizojeni sa më shumë. Shkruaji letër Halitit në Hamburg, pastaj Çazës në Bon (Troisdorf). Çka bëri ai me kasetën? Sa i keni borxh atij për organin. Për këto do t'i shkruaj Qazimit e të na ndihmojë pak me rrethin e tij. Por nga ana tjetër ky numër besoj se do ta paguaj veten dhe të parin. Porositi 3 mijë ekzemplarë. Posa ta marrësh këtë letër, porosite Hafizin që ta rezervoni rendin. Unë të hënën, sipas të gjitha gjasave do ta lëshoj në postë. Organi do të shitet në sallë, e do t'u jepet me sasi të madhe klubeve, të cilat pastaj do t'i dërgojnë të hollat.

Të fala, S.(Skënderi=Xhafer Durmishi)

(Faridin Tafallari, T-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 442)

35. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, shkurt 1983

Shoku F. (Faridin) 1 shkurt 1983 (datë e përafërt)

Tash si shpesh do t'i drejtohem edhe Mehdiut e ta shohim si do të përgjigjet e si do të shkoj puna. Në Hamburg gjithsesi na duhet me dalë, se njëherit një dalje e tillë në prag të tubimit tonë do të më ndihmonte shumë, e pastaj kah të kthehem unë do të ndalem në Bilefeld, Dyseldorf dhe Bon.

Ti studioi ato të dhëna që m'i dha Mehdiu në lidhje me ndihmat e vitit të kaluar e unë do t'i dërgoj edhe të tjerat që do të më dërgojë. Ti gjithashtu përgatiti shënimet e deritanishme lidhur me shpenzimet, e unë gjithashtu në bazë të asaj çka kemi parë do të përgatisë edhe shënimet mbi shpenzimet në Untergruppenbach, kështu që ti do të mbash raportin mbi çështjet materiale.

Të fala, S.(Skënderi=Xhafer Durmishi)

Shikoni e merrni ato librat që janë te gjermanët dhe merri ca ti ose ti me Namiun. Bisedoni me Muratin (Kryeziun) dhe Hysenin (Gërvallën) dhe i çoni te ata. Kur të vini këndej për Hamburg, unë ndoshta do t'ju pres në Trier. Ju e merrni një tubë libra e broshura të ndryshme, por sidomos këto:

-Konferenca e Pezës-broshurë e shokut Enver,

-Më mirë pak por saktë - Lenin
-Ç'të bëjmë-Lenin
-Kapitali-Marks
-Veprat e Leninit, Marksit e Engelsit
Si dhe shumë broshura tjera.
-Shteti dhe Revolucioni-Lenin.
(Faridin Tafallari, T-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 443)

36. Shkrim i Xhafer Durmishit si material për mbledhjen e parë të Qendrës Ekzekutive në mesin e marsit 1983 në Gjenevë

PROBLEME TË NDRYSHME RRETH ÇËSHTJEVE ORGANIZATIVE TË LRSHJ NË EVROPËN PERËNDIMORE

Si një prej detyrave të para tek bashkimi sa më masiv i të gjithë shqiptarëve kudo që të gjenden është organizimi i tyre nëpër të ashtuquajturat "Klube të punëtorëve shqiptarë nga Jugosllavia". Sa më shpejt të gjitha klubet të vihen nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e Lëvizjes. Lëvizja të dijë gjer në hollësitë më të vogla gjithçka që ka të bëjë me to dhe mirëvajtjen e tyre. Tani për tani të studiohen në detale dhe me klube të këtij lloji të intensifikohet puna sidomos në RFGJ, në Zvicër dhe të bëhen hapa të nevojshëm aq sa lejojnë mundësitë në këtë drejtim, pa u vonuar edhe në Austri. Në Belgjikë të veprohet gjithashtu për masivizimin e rretheve në përshtatje me kushtet e vendit dhe çka është bërë gjer më tani në këtë drejtim. Të shikohet puna nëpër shtetet tjera perëndimore dhe të studiohen mirë mundësitë në këtë drejtim. ... Të shikohet konkretisht se çka është bërë dhe çka na duhet të ndërmarrim në të ardhmen për të shikuar situatën në Francë, Suedi, Danimarkë dhe Holandë.

Sa i përket RFGJ duhet shikuar punën sidomos që të krijohen kushtet që nën kontrollin e Lëvizjes të kthehen klube të mëdha në radhë të parë në Frankfurt, Shtutgart dhe München; Në Hamburg dhe Berlin të qohet puna e filluar gjer në fund. Për këtë nuk ka rëndësi që për ndërrime të thella të mos zgjedhen data vjetore kur bëhet riorganizimi i tyre nën kujdesin e konsullatave dhe të deleguarve nga Krahina siç gjendemi tani në prag të rizgjedhjeve në Berlin dhe Hamburg.

Nga ana e Lëvizjes të shtohet agjitacioni dhe të popullarizohen të gjitha klubet pa dallim se në duar të kujt gjenden momentalisht, dhe të sqarohen të gjithë mërgimtarët që sa më shumë të bëhen anëtarë të këtyre klubeve. Nga këto mjedise njerëzish Lëvizja do të ketë përfitime të pallogaritshme dhe nuk do ta ketë fare vështirë që në mesin e këtyre masave të gjej ato shtyllat kryesore që në momentin e nevojshëm këto masa do t'i orientojnë drejt dhe me shpejtësi. Të qërohen sa më shpejt të gjitha klubet nga njerëzit e etiketuar (publikisht si armiq Jugosllavisë nga mjetet e informimit të Jugosllavisë) dhe nga ata që në të ardhmen e afërt ka mundësi të etiketohen.

Të rregullohet mirë relacioni Lëvizje-masë, dhe të studiohen mirë situatat dhe qarkullimi i informatave të ndryshme si dhe të shikohet mirë momenti kur Lëvizja don t'i komunikoj diçka masës, se në çfarë rruge dhe mënyre ta bëjë këtë. Të studiohet mirë popullariteti i Lëvizjes, dhe në raport me këtë të kuptohen sa më seriozisht përgjegjësitë si dhe të analizohen qëndrimet e ndryshme të individëve si deri më tani, si dhe në të ardhmen dhe të jepen shpjegime të nevojshme për sjellje të ndryshme. Me çfarë goje flet Lëvizja, të shikohet se a flet apo a ka folur deri më sot ajo gjithkund me të njëjtën gjuhë, dhe të merren masat e menjëhershme që nëse ajo nuk është arritur gjer më sot në nivel të kënaqshëm, të arrihet menjëherë. Si të realizohet kjo praktikisht?

Praktikisht kjo ma merr mendja se arrihet kur t'i rregullojmë mirë relacionet Zvicër – Gjermani si dhe njerëzit kryesor që do kryesojnë këshillat, grupet apo komitetet udhëheqëse të secilit vend dhe për çdo lëshim më të vogël në këtë drejtim të dimë se kujt t'i drejtohemi. E njëjta të veprohet në të ardhmen edhe me të gjitha shtetet tjera ku do të ndihet fort dora e Lëvizjes.

Rregullimi i shumë çështjeve administrative dhe evidentimi i shumë gjërave si dhe nga përgjegjësi kryesor të dihet mirë efektivi i Lëvizjes.

ÇËSHTJE TË NDRYSHME RRETH PROBLEMEVE PROPAGANDISTIKE TË LRSHJ NË EVROPËN PERËNDIMORE

Sot LRSHJ identifikohet me ZK (Zërin e Kosovës), d.m.th. ky aktualisht edhe në një të ardhme të gjatë do të jetë mjeti kryesore propagandistik i LRSHJ.

Detyrë në këtë drejtim del që sa më shpejt të dimë me saktësi numrin e të abonuarëve, në mënyrë që të përcaktojmë mirë numrin edhe të ekzemplarëve rezervë.

Rregullimi i rrjetit të shpërndarjes: Caktimi i atyre që do të bëjnë në radhë të parë shpërndarjen me postë të pjesës dërmuese të ekzemplarëve dhe shpërndarja e pjesës tjetër me anë të rrugëve tjera të drejtpërdrejta. Ndikim të madh po ka ajo se si po të shpërndahet në mënyrë të drejtpërdrejtë sa që njeriu që është afër e i preokupuar se si ta qes në dritë atë punë, disa probleme që po dalin me rastin e shpërndarjes vështirë e ka t'i përfytyroj. Tubimi dhe rregullimi i të gjitha adresave dhe përgjigja pedante dhe me kohë për kërkesat e reja. Rregullimi i çështjes së vendit se ku do të bëhet në të ardhmen shumëzimi i tij. Një vend shumë i mirë deri më tani na u ka gjetur në Gjermani, i cili na u ka përgjigj mirë sidomos kur ka qenë në pyetje koha e shkurtë siç e kishim situatën në Bon, Bern, më 28 Nëntor etj. Edhe çmimi ka qenë i arsyeshëm. Kjo është në pika të shkurta sa i përket planit organizativ rreth ZK.

Puna kryesore rreth ZK na paraqitet tek përmbajtja dhe karakteri i tij, me një fjalë çka do të zen vend, në të ardhmen, në faqet e ZK. Në këtë drejtim duhet të thellohen sidomos përgjegjësit. Ndarja e rubrikave është një hap që duhet të bëhet patjetër, ndarje e tillë që në të ardhmen do të ndikoj që ZK të merr ato vijat kryesore. Duhet të bëhet ndarja e rubrikave për situatën politike brenda dhe jashtë, ekonominë brenda dhe rrjedhimet e jashtme, rubrika rreth çështjeve në shtypin shqiptar në përgjithësi dhe atë botëror. Natyrisht do të ketë vend edhe për rubrikën e lirë, si dhe të bëhet analiza e të gjitha letrave që kanë ardhur gjer më sot në redaksi dhe të nxirren konkluzione në këtë drejtim.

Mjete tjera me rëndësi propagandistike që kanë dhënë efekte të mira janë sidomos shfaqja e filmave si me kinoprojektor ashtu edhe me sistemin video. Për këtë duhet të bëhet tubimi i të dhënave të sakta se me çfarë mjetesh disponojmë aktualisht dhe çfarë duhet të bëjmë në të ardhmen. Të aplikohet një sistem unik, që do të krijonte lehtësi të madhe në shpërndarje. Të bëhen sa më shumë edhe shfaqje të ndryshme të filmave me anë të kinoprojektorëve. Sa të tillë kemi dhe sa filma për këto aparate disponojmë, rezultatet e gjertanishme në këtë drejtim.

Kush janë ata që po e përballojnë më së shumti me forcat tona programet muzikore, pjesët dramatike dhe recitalet e ndryshme, sa janë dhe sa janë të organizuar në mënyrë të mirëfilltë nga Lëvizja? Çfarë shume (vlere) materiale kap ky inventar?

Evidentimi i parullave të ndryshme nga të gjitha rrethet dhe tekstet e tyre.

Të përgatiten raporte në këtë drejtim se çfarë pune është bërë gjer më tani me të holla. Etapat kryesore: Funksionimi i kontos në Biel gjer më 17 janar 1982, çështjet materiale me rastin e 17 janarit, dhe prej 17 janarit e gjer më sot. Detyrë për të ardhmen:

Tubimi i të gjitha gjërave materiale duke përfshirë edhe anëtarësinë e LRSHJ të dërgohen në Biel. Në çfarë drejtimesh janë bërë shpenzime më së shumti gjer më sot? Sa ka marrë në këtë drejtim shtypi? Nga çfarë burimesh kemi përballuar kërkesat gjer më sot? Borxhet e LRSHJ? Caktimi edhe i një arkatari apo dy vetave që do t'ia përcillnin të hollat arkatarit kryesor të LRSHJ. Çfarë duhet ndërmarrë konkrete dhe të bëjmë me çdo kusht që në këtë drejtim idetë të mos mbesin vetëm në letër, që burimet materiale të LRSHJ të shtohen, për të përballuar kërkesat që do të shtohen me progresion gjeometrik.

Detyrë: Të bëhet sa më shpejt aplikimi i çekave për të gjitha shtetet përkatëse, si dhe të studiohet mirë forma e organizimit të fushatave. Të aplikohen rregulla që njihen në formën legale të kësaj natyre. Kjo d.m.th. çdo individ i interesuar që të ndihmoj çështjen duhet të bindet se të hollat e tij kanë shkuar në Biel e nuk kanë mbetur rrugës, sepse kur kanë shkuar në Biel atëherë kanë shkuar në ZK e ata Zërit të Kosovës po i besojnë. Shumë njerëzve t'u kryhet edhe krejt puna, në mënyrë që të interesuarit t'i mbetet rruga vetëm gjer në postë. Kopjen e pjesës së çekut, ai që ndihmon ia jep udhëzuesit të vet ndërsa origjinalin e ndalë për vete. Fushatat të ndërmerren nga njerëzit më autoritativ dhe më të vjetër, të cilët ne do t'i kemi afër me këshillat dhe udhëzimet tona.

QËNDRIMI I LRSHJ ME TË JASHTMIT DHE PËRVOJA E GJERTANISHME

Për këtë pikë delikate të raportoj (ai që është përgjegjës) se çka ka bërë në këtë drejtim. Kjo është një prej detyrave më me rëndësi sidomos për ne jashtë. Në këtë drejtim duhet shikuar punën në disa ndarje të cilat mendoj se duhet të jenë dy ndarje kryesore: E para në shqiptar dhe joshqiptarë dhe ndarja tjetër në: komunistë dhe jo komunistë.

Me organizatat komuniste shqiptare në radhë të parë me PPSH, kjo çështje diskutohet në një nivel tjetër dhe nuk na takon ta shtrojmë fare në rend të ditës. Me shoqëritë tjera simpatizuese të komunizmit, si BKSH "Bajram Curri" në Australi merret vet LRSHJ dhe këto nuk i konsiderojmë organizata të jashtme. Në këtë kontest futen edhe grupet e mërgimtarëve shqiptarë në Turqi dhe vende të tjera.

Në organizatat shqiptare jo komunistë si; Rinia Kosovare në SHBA dhe me ndonjë organizatë tjetër që nuk është e mbytur me gjakun e popullit duhet të kontaktohet dhe që ka origjinë kosovare. Gjithashtu në këtë drejtim duhet të intensifikohet puna me arbëreshët e Italisë kur të kihet kontributi i tyre i madh në Rilindjen Kombëtare. Të shohim se kush i drejton revistat; "Katundi ynë" dhe "Zjarri". Të studiojmë situatën në klubin e arbëreshëve të Ludwigsburgut. Të shikohet mundësia e kontaktit me çamët, prej të cilëve ka shumë me punë të përkohshme në Gjermani si shtetas grek, të cilët do të na bënin ndihma shumë të mëdha.

Për të gjitha këto të mendoj shumë më tepër përgjegjësi kryesor për këtë punë.

Në organizata të huaja komuniste duhet të shikojmë kontaktet me PK të Zvicrës, PK të Gjermanisë, PK të Turqisë, PK të Spanjës dhe me grupet komuniste të Greqisë. Këtu ka mjaft shumë çka të thuhet dhe për këtë punë ndihet një nevojë për kuadro mjaft të përgatitura. Puna duhet drejtuar në atë mënyrë që përgjegjësi për këtë çështje të ndërtoj një ekip të tërë për këtë punë dhe për secilën organizatë të caktoj nga një njeri.

Me organizata të jashtme jo komunistë më së shumti vëmendje duhet t'u kushtojmë relacionit me kroatë, ku kryesisht do të bëhej punë koordinimi dhe të tjera të ngjashme me dobi reciproke. Mundësitë janë të mëdha në këtë drejtim.

Redaksia e ZK duhet të bëjë kërkesën për organet (gazetat) e të gjitha organizatave të lartpërmendura apo për botimet e ndryshme të tyre që të jemi në korent me punën e tyre si dhe t'u dërgohet të gjithëve "Zëri i Kosovës" për aq sa ta kanë interesim dhe nevojë.

LIDHJET ME KOSOVËN TË LRSHJ NGA EVROPA

Lidhur me këtë të bëhet shqyrtimi i shfrytëzimit të të gjitha mundësive në bashkëpunim me përgjegjësin për këtë punë. Në këtë drejtim të mos kursehet që puna të shkoj mbarë bile në këtë drejtim për intensifikim pune po ka shumë presion edhe nga baza e LRSHJ si jashtë ashtu edhe brenda. ...

PËRFUNDIM

Nga tubimi të dilet me detyra tepër të qarta. Të raportohet nga secili shkurtimisht se çfarë ka bërë prej ditës që ka hyr në fuqi puna e pesëshit (Qendrës Ekzekutive të formuar më 15 janar 1983 në Ludwigsburg). Të vendoset për përpilimin e një materiale që do të shpërndahej nëpër anëtarë. Të dilet me qëndrime konkrete lidhur me të jashtmit dhe në frymën e vendimeve që do të marrim t'u dërgohen organizatave të lartpërmendura letra lidhur me qëndrimin e Lëvizjes ndaj problemeve të ndryshme e sidomos mundësinë për punë të përbashkëta në ato pika që mund të na lidhin. Në fakt kjo praktikisht do të ishte edhe njohje e Lëvizjes nga ana e tyre.

Të vendoset për intervalet e takimeve dhe për mënyrën e komunikimit. Të ngushtohet fortë e ashtuquajtura hapësirë e tolerimeve të ndryshme për hir të unitetit dhe për gabime sistematike nuk kemi pse e kursejmë njëri-tjetrin. Bashkarisht të shqyrtohet ajo që është gabim dhe të shikojmë qëllimin e vërtetë. Për shumë gjëra të jepen bashkarisht mendime me shkrim dhe sa më tepër besoj me këtë do të bien (zvogëlohen) problemet që kanë mundësi zgjedhjeje në dy a më shumë variante dhe do të mbetet vetëm një; ajo më e drejta.

37. Letër e Xhavit Ramabajës për Xhafer Durmishin, mars 1983

Shumë i nderuari shok,

Pikësëpari ju kërkoj falje për vonesën e kësaj letre por, arsyeja e kësaj vonese është se, unë kohëve të fundit isha i zënë rreth një banese të re dhe kështu shpërngulja u bë shkaktare që nuk munda të përgjigjem me kohë ashtu siç është dashur.

Tani me mundësitë e mia po përpiqem t'ua bëjë me dija gjendjen në përgjithësi që i përket çështjes së rrethit në të cilin marrë pjesë edhe vet.

Bielefeldi, qytet me rreth 300 mijë banorë vendas, i përket krahinës së Vestfalisë (Nordrheinwestfalen), gjendet në mesin e Gjermanisë Veriore ndërmjet qyteteve Dortmund dhe Hanover, Kasel dhe Bremen e Hamburg. Numri i punëtorëve shqiptarë nuk është i madh në krahasim me qytetet tjera ku janë formuar klube dhe grupe në të cilat marrin pjesë shokët përparimtarë ku bëjnë punë dhe aktivitet në të mirë të çështjes kombëtare.

Pos në Bielefeld me rrethinë siç janë qytetet Gütersloh, Paderborn, Löhne etj. i kemi kaluar edhe vështirësitë gjeografike dhe kemi formuar lidhje të ngushta edhe me shokët e qyteteve më të largëta siç janë: Hanoveri, Hamburgu, Bremeni, qyteti i Peinit afër kufirit gjermano lindor etj.

Nga këto qytete neve na kanë ardhur shokë sa herë që kemi pasur mbrëmje të organizuara. Duhet ta ceki se shokët që vizitojnë klubin tonë vijnë pothuajse nga të gjitha rrethet e Kosovës, por, gjithashtu edhe nga vise të tjera si Maqedonia, Serbia.

Për hapjen e klubit "Kosova" ishte iniciator shoku X. dhe hapet për të parën herë në vitin 1979, por meqë në këtë vit meremetohej ndërtesa ku e kishim sallën tonë, na u

deshtë të pushojmë disa muaj dhe pas kësaj zgjatjeje të meremetimit ne filluam punën nga fillimi i vitit 1980 dhe rregullisht tuboheshim një herë në javë ditëve të shtune.

Që nga fillimi i punës në klub qëllimet ishin të karta: punë patriotike, atdhedashuri, qëndresë burrërore.

Dhe puna që bëhej të shtunave mbrëma në klub dha rezultatin e vet në prag të shpërthimit të demonstratave në Kosovë. Tani për çdo anëtarë të klubit ishte e qartë situata në Kosovë dhe ngjarja në tërësi. Ata e kishin pritur këtë ditë pasi e njihnin mirë gjendjen e vështirë ekonomike, të vendlindjes së tyre, viktimë e të cilës ishin edhe ata.

Pas ngjarjeve në Kosovë në mars e prill 1981, organet e konsullatës së Dortmundit nuk pushuan duke dërguar "ekspert politik" të tyre çdo javë që t'i shuanin ndjenjat kombëtare të punëtorëve tanë, por qëllimet dhe dredhitë e tyre të poshtra i pamë edhe gjatë vitit 1980 kur ne bënim kërkesa për të na e njohur klubin zyrtarisht dhe, sa herë që kam shkuar unë personalisht në konsullatën e Dortmundit dhe kam bërë kërkesë të ligjshme në lidhje me klubin, përgjigja e tyre ishte: "E keni një klub jugosllav "Domovinën" a nuk ju mjafton". Unë këto fjalë të thëna nga pozitat e tyre shoviniste i mbajta në mend dhe i shënova. Llogaria më doli mirë kur filluan të vijnë pas një viti. Unë këto fjalë i bëra armë të fortë kundër tyre duke ua thënë haptas se ne nuk jemi përfillur fare nga ana e tyre si nënshtetas jugosllav e tani vini me qëllimet e juaja të caktuara kurse neve na e bëni kinse për të na ofruar "ndihmë" si p.sh. për televizor, video etj., vetëm e vetëm që ne të bëjmë punë sipas oreksit të tyre. Ata nuk kursyen as fjalë të mira për të na lavdëruar, e kur i dëgjonin fjalët tona ata ranë në kundërthënie të rëndë me ato të para një viti.

Ndihmat e tyre që i ceka më lartë i përdornin si një ryshfet sikur thua se neve gjendeshim në Anadollin e para 100 vjetëve. Provonin që të paktën punëtorët të rrinë anash e për më tepër edhe t'i dënojnë vëllezërit e motrat e tyre në Kosovë, por, çe do, punëtorët le që i përkrahnin demonstratat në Kosovë por ishin të gatshëm edhe këta të bëjnë çdo sakrificë për vëllezërit dhe Kosovën tonë.

Sa për gënjeshtrat e organeve konsullore të Dortmundit se gjoja klubi jonë dënon demonstratat në Kosovë neve iu përgjigjëm me pjesëmarrjen direkte tonën nëpër demonstratat dhe protestat e ndryshme këtu në Perëndim mbasi që konsullata e Dortmundit kishte dërguar telegrame falso në emër të klubit tonë.

Ne punëtorët me qëllim mbanim qëndrim të urtë e korrekt ndaj emisarëve konzular, nuk përdornim fjalët e mjetet që ata meritonin. Ky qëndrim i urtë u jepte atyre shpresë dhe s'mungonin të vinin prapë por sa herë që vinin strajca u mbetej bosh. Endacaku më i paprituesshëm ishte njëfarë Hadi Kerragjiu.

Për të gjitha këto nuk po zgjatem më tepër kësaj radhe, këto i kam të shënuara në letër dhe e di se meritojnë vëmendje, por nëse e kërkon nevoja dhe rrethanat atëherë do t'i shpalojë më gjerësisht.

Pasi çdo gjë është e lidhur me Kosovën dhe ngjarjet rreth saj gjatë vitit 1981 e shoh të rrugës ta ceki se gjatë këtyre ngjarjeve organet konsulare jugosllave të Dortmundit, pra që nga fillimi i marsit 1981 e gjer në mesin e vitit 1982 ata vizituan tetë herë klubin tonë. Qëllimi i tyre ishte: të ndërrohet kryesia "irredentiste" e klubit në krye me shoku X në krye, por edhe me ndërrimin e udhëheqësisë u zhgënjyen. Për këtë ndërhyrje kanë bërë përpjekje të mëdha. Ia vlen të ceki dy data ku ata falimentuan me shokët e tyre.

Më 10 tetor 1981 dhe më 17 tetor 1981.

Ditën e shtunë me 10 tetor 1981, salla ishte e mbushur sa s'kishte ku veje majën e gjilpërës. 160 punëtor pritnin përfaqësuesit e konsullatës Jugosllave të shoqëruar nga njëfarë Jetullah Gashi, sot kryetar i komunës së Podujevës, Zija Novobërdalija, kryetari i rinisë së Kosovës, emrin e të cilit nuk ia mbajta mend. Me ta ishte edhe Mitalip Qoqa një

gazetar i Rilindjes, i akredituar në Bon, një fotograf i cili thoshte se ishte i Rilindjes, e me siguri ishte ardhur që të fotografonte për qëllimet e Udbës. Ishin të shoqëruar edhe nga tre persona tjerë që me siguri u shërbenin si roje në rast nevoje, por për roje ata kishin siguruar edhe dy policë gjerman nën pretekstin se rrezikoheshin fizikisht nga punëtorët tanë. Por edhe unë ua njihja mirë dredhitë e tyre dhe e dija se dëshironin të bënin tollovi e të na e hudhnin fajin neve dhe unë sigurova një polic gjerman jo për të na ndihmuar por për të qenë si dëshmitar në rast nevoje. Policit ia bëra të qartë se ne nuk duam të sqarohemi fizikisht por duam të diskutojmë haptazi mbi problemet tona para përfaqësuesve Jugosllav, dhe nëse papritmas ndodhë ndonjë aksident fizik kjo ndodhë ngase është kurdisur nga organet e konsullatës Ju. veglave të U..ës.

Dua të them me sinqeritet se unë nuk doja asnjë ndihmë nga polici gjerman përveç dëshmive që mund të merrte ai në rast nevoje.

Për sigurinë tonë ishim përgatitur mirë, çdo i deleguar e kishte të drejtuar në ballë.

Kështu filloi diskutimi në mbrëmjen e datës 10 tetor 1981. Duhet ndërruar udhëheqjen thanë ata. Udhëheqja e këtij klubi është "irredentiste" në krye me shokun X. thanë. Për diskutimet dredhake të mjeshtërisë dinake shquhej punëtori i lartpërmendur nga konsullata e Dortmundit Hadi Kerragjiu dhe i deleguari nga Kosova, Zija Novobërdalija, por punëtorët tanë nuk donin tjetër udhëheqësi. Përgjigja e tyre ishte jo dhe vetëm jo.

Për këtë datë të 10 tetorit 1981 nuk po e zgjasë më shumë. E them se kjo natë ishte për ta një dështim, por ata do të vinin prapë. Ece e pajtoju me fatin, erdhën me i lyp veshët e i lanë edhe brinat.

Pasi delegatët kishin kaluar javën këtu në Bielefeld, ku edhe banonin me shpresa se do t'u ndihmonte tereni i afërt me klubin dhe, pasi kishin bërë plane të reja për heqjen e udhëheqësisë, për dënimin e saj si armiqësore, antijugosllave, "irredentiste" dhe domosdo edhe një provë për dënimin e studentëve e demonstratave në Kosovë, arritën në krye të javës për të dështuar prapë ditën e shtunë të datës 17 tetor 1981.

Për këtë natë punëtorët ishin të informuar mirë dhe e dinin se këta emisar po provonin për herë të fundit që të hiqnin udhëheqësinë me shokun X të cilin ata e kishin cekur me emër – punëtorët e dinin se për këtë qëllim ata kishin qëndruar një javë në Bielefeld. Këto fjalë i dëgjova në sallë pak para ardhjes së emisarëve, dhe këto ishin të vërteta.

Gjatë qëndrimit në Bielefeld emisarët s'kishin ndejtur duar-kryq, ata kishin arritur të bënin për vete veglën, tradhtarin e njohur me emër Jetullah Nazifi. Ky kishte pranuar të bëhej kryetar i klubit "Kosova" për hir të interesit të emisarëve jugosllav dhe u kishte premtuar se me marrjen e mandatit do t'i dënoj demonstratat në Kosovë në emrin e vet dhe të klubit "Kosova". Këtij tradhtari iu kishin bashkangjitur edhe 12 punëtor të cilët emisarët krahinor i kishin përvetësuar nëpër kafenetë e Bielefeldit gjatë javës që kishin qëndruar këtu. Këta për herë të parë hynin në klubin "Kosova" si zagari pas të zotit.

Kjo mbrëmje e 17 tetorit 1981 e gjet klubin tonë ashtu si një javë më parë, plot e përplot. Punëtorët prisnin emisarët e javës së kaluar. Në fytyrat e tyre vërejta se diçka që të bënte me dije se janë të merakosur, andaj edhe u afrova t'i pyes se çka mendonin? Pas kësaj pyetjeje e mora përgjigjen e dëshiruar dhe zemra m'u bë mal kur dëgjova fjalët e tyre: "Ti shoku X mos lako, vepro si shqiptar i vërtetë, neve na ke pas shpine, jemi të gatshëm, ipu përgjigjen e merituar agjentëve, qëndrimi ynë nuk ndërron më thoshin punëtorët.

Roja që ruante në oborrin e klubit lajmëroj ardhjen e emisarëve dhe nuk harroj të cek edhe numrin e tyre 20. Roja, një shok yni ishte i shqetësuar, (numri-shën i Xh D) i dukej i madh, por unë e qetësova duke thënë: edhe 200 më duken pak dhe menjëherë vërejta një lehtësim në fytyrën e tij.

I pari që hyri në derë ishte shefi i konsullatës së Dortmundit Shime Jeliq, disa nëpunës të konsullatës, emisarët e javës së kaluar, Jetullah Gashi, Zija Novobërdalija etj. Këta i shoqëronte edhe tradhtari i njohur i këtushëm Jetullah Nazifi që karakterizohej me mendjemadhësinë e tij prej bajraktari dhe kjo nuk na befasonte mbasi ne e njihnim mirë edhe para ngjarjeve.

Këta prapë ishin siguruar me polic dhe agjentë përreth kurse ne, siç e kam cekur më parë, ishim siguruar me mjete tjera.

Posa hyjnë në sallë këta "politikan" jugosllav punëtorët i "përshëndetën" me parullën "Kosova–Republikë". Thirrjet e parullave ishin me zë të lartë, ishin këto bomba mbi emisarët qëllimkeq që hynin në sallën e klubit "Kosova" dhe vërtetë kjo atmosferë luftarake i hutoj mund të them akoma pa u ulur pendoheshin për ardhjen e tyre.

Por prapë qenerit nuk i largoheshin pa lëpirë ndonjë kockë të hedhur. Shefi i konsullatës u ngrit në këmbë dhe u tha punëtorëve: Ne ua kemi sjellë udhëheqësinë e re të cilën do t'ua prezentojmë!"

Një punëtor u ngrit e e pyeti: "Në cilën kafene e keni zgjedhur këtë udhëheqësi, tek i cili çetnik më drejt, se këtu në Bielefeld të gjitha kafenetë u takojnë emigrantëve çetnik dhe ju aty e kaluat kohën gjatë kësaj jave.

Konsulli i hutuar nga kjo pyetje e papritur heshti për një moment dhe prapë vazhdoi avazin, tha se shoku X është armik i Jugosllavisë, është politikan profesionalist dhe ju këtë mos e dëgjoni se ju futë në rrugë të rrezikshme, do t'u merr në qafë, e sa e sa "këshilla" dhe sugjerime dhe u ul. Për të mos u ftohur muhabeti u ngrit në këmbë Zija Novobërdalija ku i "vërtetoi" fjalët e Shime Jeliqit, bile ia kaloi atij në këtë drejtim. Pastaj m'u lut që të bisedojmë në një dhomë të veçuar në një dhomë po aty në klub. Unë pranova pa kundërshtuar dhe hymë në dhomë. Pasi u ulëm ai filloi të lutej për të "mirën" time. Unë ty -më tha- ta njoh familjen... Ti edhe ata po i rrezikon, pendohu, është për të "mirën" tënde. Thuaju shokëve publikisht këtu në sallë, kam gabuar, nuk do të bëjmë më demonstrata dhe fund!

Po i thash në çast, po pendohem!

Këtij renegati i qeshi fytyra, mendoi se "triumfoi", por "triumfi" nuk i zgjati më shumë se pesë minuta, aq kohë sa bëra unë për të dalë para punëtorëve, kjo dha sihariqin Zija i afrohet Shime Jeliqit dhe e njoftonte për "bindjen" që bëri në mua. Shima u nxitua dhe ja tha tjetrit që kishte pranë dhe të gjithë me fytyra të qeshura pritnin dorëzimin tim.

Zija u ngrit në këmbë e tha: "Shokë fjalën po ia japim shokut X!" Në atë çast mendova: Këta armiq nuk e njohin bindjen time, nuk e dinë se para e përqafoj vdekjen se sa t'i bëj fytyrat e tyre të qeshura, tani ata prapë do të zhgënjehen nga unë, siç u zhgënjyen një orë më parë nga punëtorët! U nguta e thash: Shokë, në demonstrata kemi qenë e do të shkojmë prapë, kërkesa për Kosovën Republikë është e drejtë! Rroftë RSFJ! Rroftë Republika e Kosovës!

Nga kjo ligjëratë e shkurtër emisarët u tërbuan dhe u djersitën, ata i fshinin djersët me mindila kurse punëtorët thërrisnin: Kosova Republikë! Dhe prapë atmosfera qetësohet, punëtorëve u qeshet fytyra nga gëzimi, ndezin nga një cigare e më përshëndesin me grusht.

Tani Shime Jeliqi ngritet e thotë: "Ja ku është udhëheqësija e re" pasi e prezentoi me emër si kryetar Jetullah Nazifin, vegël e njohur, i urryer nga punëtorët tanë i shpërndau fletët që zgjedhja të bëhet e msheht. Çdo punëtori i dha nga një fletë votimi, por asnjë punëtor nuk pranoi të votojë për udhëheqësinë e kafeterive në krye me tradhtarin Jetullah Nazifin.

Vetëm 12 veta kishin votuar për ta, ata që i kishin shoqëruar gjatë kësaj jave.

Kështu edhe kjo mbrëmje përfundoj me fitoren tonë dhe kjo qe një mbrëmje të cilën unë nuk do ta harroj kurrë, si një natë ku u pa qëndresa heroike e punëtorëve tanë.

Me këtë ngjarje kuptova edhe më mirë se populli ynë është i vendosur në luftën e tij të drejtë. Kjo ngjarje, edhe pse e vogël në krahasim me ngjarjet në Kosovë, kam vërejtur qëndresa që janë identike me të kaluarën shekullore të historisë sonë luftarake. Të gjitha këto më bënë edhe më të fortë e të bindshëm se gjatë tërë jetës duhet shërbyer këtij populli trim e liridashës.

Shoku L!!!

Due të ndalem këtu mbasi më duket se, pak a shumë ju shkrova për natyrën e frontit që ka ekzistuar në klubin tonë.

GRUPI FOLKLORIK

Si një grup me vazhdimësi në punë është formuar më 1982. Puna tani për tani është e mbështetur në bazat vullnetare kurse si anëtarë të rregullt të grupit janë vetëm 5 veta.

FILM

Jemi të furnizuar mirë me filma shqiptar, siç vijon më poshtë:

1. AVNI RRUSTEMI	Dokumentar
2. ALI KELMENDI	" "
3. LUIGJ GURAKUQI	" "
4. FIERZA 78	Motive pune mbi lumin Drin (hidrocentrali)
5. VALLËZIMI I SHQIPEVE	Valle popullore nga vise të ndryshme të Shqipërisë
6. KËSHILLTARËT	Nga Lufta e Dytë Botërore
7. GUNAT PËRMBI TELA	Si nalt, u pëlqye shumë mirë nga publiku

Të gjithë filmat në 16 mm për projektor

VEGLA TEKNIKE

1. Projektor	16 mm	BAUER
2. Altoparlanta	2	
3. Zmadhues		
4. Mikrofona	3	
5. Video		
6. Televizor me ngjyra		

Vlera monetare e tyre arrin rreth 6-8 mijë Marka Gjermane.

ANËTARËSIJA

Në fillim kishim 180 anëtarë, kurse sot siç mësova nga sekretari i klubit tonë për këtë vit kishin paguar anëtarësi 45 veta, prej të cilëve 20 veta paguajnë 50 DM në muaj.

PARULLA

Parulla kemi për shokët e vrarë, për ngjarjet në Kosovë në gjermanisht e shqip. Formulimet dhe dimensionet nuk mund t'i shkruaj mbasi janë të shpërndara nëpër punëtorë.

Flamuj të klubit janë dy.

Shoku L

Nëse kjo letër nuk u përgjigjet kërkesave unë e kompensojë me ndonjë letër tjetër.

Me përshëndetje vëllazërore Shoku X (Xhavit Ramabaja për Xhafer Durmishin, mars 1983)

38. Letër e Xhafer Durmishit për Ibrahim Kelmendin dhe Qendrën Ekzekutive, 24 prill 1983

Shoku I. 24 prill 1983

..Unë mora vesh nga Xhema kur ishim së bashku atje herën e fundit. ... Morali i dobët dhe patriotizmi mund të bashkudhëtojnë por me bashkjetuar nuk munden dhe ky është një lixh i vërtetuar me mijëra herë dhe që vlen për çdo kend. Pra si për fillim dhe që është hera e parë që po të drejtohem me letër nuk po mund të zgjatem më shumë në këtë drejtim. Po shfrytëzoj nga rasti që të drejtohem për disa probleme si të përgjithshme ashtu edhe konkrete.

Nuk është nevoja që shumë gjëra t'i përsëris apo të shkruaj siç thua ti, fraza rasti. Në bazë të kontakteve dhe vendeve që jemi takuar mund të them se relativisht njihemi mirë. Kemi vendosur me luftuar se bashku dhe këtë do ta bëjmë. Ku kanë qenë punët para një viti dhe ku janë sot e ke ditur e edhe sot e dinë se ku janë qoftë në planin e përgjithshëm qoftë në atë konkret të relacioneve në mes kuadrove. Është mirë edhe me e paramenduar se në çfarë situate do të ndodhemi pas një ose dy vitesh. Kjo mvaret në masën më të madhe prej nesh.

Ne njihemi vetëm sa na ka kontaktuar puna dhe vetëm puna e asgjë tjetër. Në bazë të saj do të njihemi edhe në të ardhmen. Këto kohët e fundit më ka rënë rasti të vizitoj pothuaj të gjitha rrethet kryesore në RFGJ. ... Opinioneve të ndryshme u intereson lidhja jote me Lëvizjen e mjaft të tjera. Prandaj me aq sa mund të gjykoj është me një rëndësi tejet të madhe studimi i rrethanave sepse sot operacione të ndryshme po zhvillohen shumë shpejt. Në këtë letër po të flas më poshtë më konkretisht mbi mbresat që kam gjatë takimit ... në rrethin e Dyseldorfit ku isha para disa ditësh, ku në mes të tjerëve ishte edhe vëllau yt... Ti e dinë se çfarë na intereson ne për çdo mjedis dhe nga ky qëllim e zhvillova bisedën sidomos fillimin e saj në Dyseldorf. Tonin ia prishi mjaft Mustafa me pyetje të ndryshme se kjo nuk duhet t'ju interesoj juve, se unë vetëm ia paguaj qiranë klubit, pastaj a e ke pyet Ibrahimin etj. Është mirë me i sugjeruar se kam të drejt të takohem me një rreth në çfarëdo kohe që duket e nevojshme. F. më patë treguar se ke shkuar atje ku je dhe unë nuk kisha mundësi me të takuar. Është mirë të ndikosh te ai sepse me të tilla pyetje në radhë të parë të dëmton ty. ... Qëllimi kryesor ishte të dija sa më shumë për klubin, pastaj përgatitje e terrenit për koncertin. Ne diskutuam qartë në Gjenevë për statusin e tyre, andaj në atë rreth të ngushtë e shtrova edhe problemin e anëtarësimit me njerëz të rinj e së bashku me këtë problemi të qonte edhe te fotoja e satrapit. Diskutuam në atë rreth të ngushtë prej pesë vetash....

Të fala S. (Xhafer Durmishi)

39. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, 26 prill 1983

Shoku F. (Faridin) 26 prill 1983

Po ta dërgoj këtë letër me porosi:

1. Broshurat e Leninit që i pata lënë te ti m'i dërgo.
2.Një libër "Shota dhe Azem Galica"
3. Materialin "Detyra të ngutshme" dhe projekt statutin.
4. Kasetën me filmin "Lepuri me pesë këmbë" dhe program muzikor nga televizioni i Prishtinës.
5. Adresën e Sejdi Biticit (Bytyqit) (nga Nju Jorku, është te turku).

6. Materialin që unë ta pata dërguar dhe që ta kërkova para disa ditësh ma dërgo menjëherë. (Xhafer Durmishi)

(Faridin Tafallari, T-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 443)

40. Letër Xhafer Durmishit për Qendrën Ekzekutive, 4 maj 1983

Të dashur shok të Qendrës Ekzekutive, 4 maj 1983

Kaloi një kohë e gjatë e ngjarje të reja po zhvillohen vazhdimisht, kurse ne nuk po jemi në korent në mes veti jo vetëm nëpërmes ndonjë takimi po këtë nuk po e bëjmë as në nivelin më minimal përmes letrave. Andaj me anë të kësaj letre u propozoj që pa u vonuar të mendoni për ndonjë datë takimi të mundshëm ku do të shikonim se si jemi duke ecur dhe çfarë është duke ndodhur.

Në takimin e fundit u diskutua edhe përpilimi i Programit Politik të LRSHJ me rastin e njëvjetorit të formimit. Deri më sot, kur jam duke e shkruar këtë letër, për diçka më shumë në këtë drejtim nuk jam i informuar. Po ashtu mendoj që përmes letrash të vendoset se kush do ta bëjë një projekt program i cili në rrethet e ngushta duhet të lëshohet në diskutim së bashku me projektstatutin. Përndryshe çdo hap tjetër në këtë drejtim është joserioz dhe mund të ketë pasoja të këqija.

Pra unë mendoj se koha është që të takohemi mundësisht sa më shpejt. Mendoni në këtë drejtim, programojeni kohën dhe shikojmë se në cilën ditë e në cilin vend mund të takohemi. Kjo shtrohet më problematike për mua dhe Ilazin (I. Kelmendin), por unë për vete jam i gatshëm të vij në Zvicër, ndërsa për herë të tjera si dhe për rendin e takimeve dhe mënyrës së mbajtjes së kontaktit do të vendosim në takim.

Ju përshëndet S. (Xhafer Durmishi)

41. Letër e Xhafer Durmishit për Xhafer Shatrin, 4 maj 1983

Shoku Llesh 4 maj 1983

Së bashku me letrën e mësipërme po të dërgoj edhe këtë letër që sot ua dërgova dy shokëve tjerë të grupit përgjegjës për Gjermaninë. Lexoje dhe çfarë më propozon tjetër që të bisedoj e si të shkoj puna me ta. Pasi letrat nga Zvicra po vonohen, po që se gjer në takim do të më mungoj fjala jote do të jem i detyruar të flas si ma merr mendja mua e në këtë drejtim janë serioze sidomos problemet rreth temës mbi fraksionizmin në radhët e Lëvizjes. Kjo është e rëndësishme kur të kihet parasysh se tani në Stuttgart që të tretë e firmës së tretë (ish-PKMLSHJ) të cilët përbëjnë kapitullin e veçantë të fraksionizmit në mes fraksionizmave tona. Për arsye të një kontakti të mundshëm me ta, ne duhet t'i informojmë shokët aq sa është e nevojshme sepse këtë e kemi për detyrë.

(Xhafer Durmishi)

42. Letër e Xhafer Durmishit për Xhafer Shatrin, 13 qershor 1983

Shoku Ll. 13 qershor 1983

... Lidhur me fraksionistët mendoj që përgjigja duhet t'u bëhet por jo në ZK sepse në këtë mënyrë mund t'u bëjmë shërbim, dhe kësaj t'i japim përmasa sepse aty ku shkon ZK, këtyre do t'u nevojiten vite të tana me mbërri, gjë që s'do të mbërrijnë kurrë. Kështu që përgjigja të dërgohet tani për tani vetëm në ato vende ku mbërrijnë ata. Në këtë drejtim unë kam menduar me e përgatitë një libër të tërë skeletin e të cilit e kam bërë dhe do ta dërgoj e nëse të duket i arsyeshëm e thellojmë punën në atë drejtim. Kjo s'do të thotë që mos me ua bërë edhe një përgjigje në një trakt dy faqesh, kurse në libër mendoj të jenë të

rrahura shumë probleme më gjerë, dhe me llojet e tjera të fraksionizmit. Unë jam i kënaqur me atë skelet.

Lidhur me takimin rregullojeni si ta gjeni më të përshtatshme. Unë në të ardhmen sigurisht nuk do të mund ta bëjë atë që së paku është thënë teorikisht ta bëjë. Andaj se çfarë taktike do të përdoret dhe si është më mirë të zhvillohet lufta diskutoje më shumë me ata që e ke ndërmend të mbështetesh më shumë. Unë do ta bëjë edhe në të ardhmen atë që më thuhet por jo, me hy deri në atë shkallë sa me i ngritë punëtorët grushtet kundër njëri-tjetrit siç ka ndodhë me vëllaun e Ilazit dhe Musa Dakën.

Të fala S. (Xhafer Durmishi)

43. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, vjeshtë 1983

Shoku Faridin, (vjeshtë 1983)

Ma dërgon atë Statutin të cilin e kam rishikuar. E ke në tubën e materialeve të mia të fundit që ta ka dhënë Hafizi. Ma dërgon edhe atë projekt programin në gjashtë faqe. Statutin e korrigjuar nga unë ua dërgon edhe atyre që duhet me ua dërgua në Zvicër, e Ukës dhe Ilazit. Edhe një letër timen si përgjigje në ato të Ilazit ua përcjell ti.

Të fala S. (Xhafer Durmishi)

44. Letër e Xhafer Durmishit për Bashkësinë së klubeve, 1 nëntor 1983

Letër dërguar delegatëve të Bashkësisë së Klubeve dhe Rretheve Shqiptare në Evropën Perëndimore 1 nëntor 1983

Siç jeni në dijeni, Bashkësia e klubeve, më 16 tetor 1983 thirri mbledhjen e vet të parë, në të cilën pos të tjerash u miratua Statuti i Bashkësisë dhe u zgjodh organi udhëheqës i saj.

Në vazhdën e vendimeve u vendos që organi udhëheqës i Bashkësisë të mblidhet një herë në tre muaj. Në bazë të këtij vendimi Këshilli Drejtues i Punës së Bashkësisë së bashku me këshilltarët e vet do të mblidhet më 14 janar 1984 e do të diskutoj e marrë vendime mbi aktivitetin e mëtejshëm të klubeve dhe rretheve shqiptare në Evropën Perëndimore.

Duke pasur parasysh këto rrethana, Bashkësia e klubeve përmes delegatëve të vet u bënë me dije klubeve shqiptare dhe rretheve të ndryshme që gjatë muajit nëntor të këtij viti të mblidhen udhëheqësitë dhe anëtarët e klubeve për të përpiluar programet e tyre njëvjeçare. Në këtë drejtim ata duhet që në pika të ndryshme të ndalen rreth aktivitetit të tyre të gjertanishëm, të vërejnë sukseset dhe dobësitë dhe në këtë bazë të përpunojnë planet e tyre të punës se ku është qëllimi ynë që të arrijmë pas një viti. Si udhërrëfyes, gjatë përpilimit të plan programeve, të shërbej Statuti i Bashkësisë në të cilin Bashkësia ka treguar qëllimin e vet. Si rrjedhim i kësaj, vendimet që merren duhet të jenë në frymën e Statutit të Bashkësisë, i cili u miratua në mbledhjen e parë të saj.

Qëllimi kryesor gjatë përpilimit të planeve njëvjeçare duhet të jetë masivizimi i klubeve me sa më shumë anëtarë, si dhe krijimi i lidhjeve sa më të shumta me grupe të ndryshme punëtorësh, të cilët edhe nëse nuk mund të bëhen anëtarë për arsye të ndryshme, ta propagandojnë klubin dhe ta ndihmojnë atë materialisht. Rëndësi të madhe, më të madhe se gjer më tani t'u kushtohet kontakteve me organizata të jashtme të vendeve në të cilat punojmë.

Rëndësi t'i kushtojmë konsolidimit të grupeve muzikore, mbledhjes sa më të mirë të materialit filmik.

Njoftoni Bashkësinë me të gjitha vendimet që merrni, të cilës sipas një vendimi, duhet t'i dërgohen raporte të rregullta mbi punën e klubeve dhe për çështje diskutabile kur nevojitet mendimi i Bashkësisë. Në bazë të plan programeve të secilit klub, Këshilli Drejtues i Punës (KDP) do të përpunojë planin njëvjeçar të Bashkësisë në tërësi, në mbledhjen e vet më 14 janar 1984.

Të dashur shokë delegatë, të dashur shokë të udhëheqësive të klubeve!

T'i përvishemi punës me të gjitha forcat, të shkundemi nga përtacia e të mos lejojmë që asnjë minutë të na shkoj kot.

Bashkësia e klubeve i shikon me sy jo të mirë disa dukuri në disa klube të reja për të cilat u angazhuam me sa e sa mundime që t'i krijojmë, kur ende pa u konsoliduar mirë klubet, ngrihen thirrje nga individ të ndryshëm që të ndërrohen udhëheqja e ndonjë klubi, apo e ndonjë anëtari të kryesisë, thuajse se klubet na kanë munguar vetëm e vetëm pse nuk kemi pasur njerëz për t'i caktuar për kryetar.

Të dashur shokë, klubet në disa vende na kanë munguar dhe na janë minuar nga shovinist të ndryshëm dhe vegla të tyre që janë armiq të përbetuar të popullit tonë, të cilët nuk kanë dëshirë t'i shohin edhe dy shqiptarë së bashku. Në të gjithë veprimtarinë tonë, në të mirën e popullit, duhet të punojmë për atë që të shfrytëzojmë në maksimum mundësitë legale dhe t'i bashkojmë njerëzit e jo të ngremë çështje që nuk shkojnë në interesin e përgjithshëm. Pa sakrifikuar nuk mund t'i ndihmojmë interesit të përgjithshëm, e në grupin e sakrificave hynë edhe ajo ndjenjë e durimit për zgjidhjen e problemeve.

Deri në rregullimin e çështjes së adresës së përhershme të Bashkësisë, të cilën së shpejti do ta zgjedhim dhe për këtë do t'ju njoftojmë, raportet i dërgoni në adresën e kryetarit të Bashkësisë.

Ju dëshirojmë punë të mbarë.

Bashkësia e klubeve dhe e rretheve shqiptare në Evropën Perëndimore (Xhafer Durmishi) (Faridin Tafallari, T-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 229-230)

45. Letër e Xhafer Durmishit për shokët në Saar-Louis, nëntor 1983

Të dashur shokë në Saar-Louis, nëntor 1983

Jam në dijeni të aktivitetit tuaj në përgjithësi përmes shokut që e njihni. Iniciativën tuaj për t'u organizuar e kemi përshëndetur dhe e quajmë jashtëzakonisht të mirë. Por kjo do të thotë edhe një obligim më të madh në të ardhmen për punë të mëtejme. Kësaj radhe po iu drejtohem me këtë letër pasi që të vij nuk mundem edhe pak. Edhe për një kohë jam shumë i zanun në rrethin ku gjendem këtu sot në mbrëmje jemi duke u përgatitur që ta presim siç duhet një koncert të një trupe që ka ardhur nga Kosova. Ne i kemi marrë masat tona dhe shpresojmë se do të realizohet plani ynë që përderisa nuk na jepen të drejtat elementare të mos lejojmë asnjë koncert të zhvillohet i qetë (në heshtje) në Evropën Perëndimore. Gjithashtu në këtë rreth më 19 nëntor 1983 do të hapet klubi shqiptar që ka emrin e plotë "Klubi i punëtorëve shqiptarë nga Jugosllavia 'Isa Boletini'", për të cilin ekziston interesim i madh tek shqiptarët e këtij rrethi. Po iu tregoj se tash për tash nëpër të gjitha qytetet e mëdha në Evropë, ku ka shqiptarë po bëhen përpjekje që të hapen sa më shumë klube, sepse në praktikë u pa se përmes një klubi ishte e mundur të bëhet një punë e madhe.

Për në rrethin tuaj ku nuk ka shumë shqiptarë, më e suksesshmja mënyrë është ajo të cilën e keni zgjedhë ju. Po ju njoftoj gjithashtu se më 26 nëntor 1983 në rrethin e Shtutgartit po bëhet një përgatitje e madhe për të pritur festat e Nëntorit të cilat në këtë rreth organizohen qe tri vite më radhë. Është siguruar qysh tani një sallë e mirë, të cilën e kemi pas edhe më 1981. Për këtë festë do t'u vijnë thirrjet e posaçme, të cilat do t'i merrni me kohë dhe do të ishte mirë nëse mundeni me ardhë. Pas këtyre festave do të gjej rastin për t'u takuar me ju. Për këtë arsye qysh tani po ua propozoj këtë takim të cilin mendoj ta mbajmë më 3 dhjetor 1983 me fillim në ora 16.00.

Lidhur me vendin e takimit vendosni ju. Ku të vendosni ju unë do të vij. Në atë takim ne do të shqyrtojmë disa gjëra, por më së shumti do të ndalemi në përpilimin e planit të vitit 1984. Shoku i juaj më ka thënë se lidhur me një porosi që të mblidhen informata për bashkatdhetarët që gjenden në rrethin tuaj është kryer. Detyra e kryer është punë me rëndësi. Deri në takimin e ardhshëm që do ta keni me mua po u lë për detyrë që ta studioni mirë këtë material që po ua dërgoj, pasi lidhur me te do të diskutojmë. Shkruani të gjitha pyetjet eventuale që dëshironi me i parashtrua, në mënyrë që të mos i harroni në momentet e takimit.

Të fala të përzemërta, (Xhafer Durmishi)

46. Letër e Xhafer Durmishit për Qendrën Ekzekutive, 3 janar 1984 (pjesë)

Sa i përket Statutit të përgatitur nga ana ime kam këto vërejtje; duhet shtuar definimin e saktë se kush është, mund të quhet anëtarë i Lëvizjes, dhe një nen të ri që ka të bëjë me sjelljet e anëtarëve të Lëvizjes që veprojnë në shtetet e ndryshme, të cilët nuk guxojnë të bien në kundërshtim me ligjet e vendeve në të cilat veprojnë. Pastaj vërejtjen tjetër, në kapitullin e parë që ka të bëjë me datën e formimit të LRSHJ. Më 10 korrik 1983, Uka më tha se do të ishte shumë mirë në Komunikatë ta kishim shënuar vetëm 15 majin, pasi fraksionistët e PKMLSHJ nuk do të mund të qëndronin shumë, pasi kryesisht ata po thirren në 17 shkurtin. Duke u nisur vetëm nga ai qëllim dhe sidomos kur ka qenë në pyetje fraksioni që u shërbye me metoda shumë të ulëta mua më është dukur e arsyeshme dhe ky ka qenë shkaku kryesor që unë në atë statut e kam shënuar datën e 15 majit. Tani Mërgimi thirret në të njëjtën mënyrë si Uka se qëllimi të shënohet 15 maji ka për qëllim ta devijoj vijën për Republikë për të cilën kemi vendosur më 17 shkurt. Unë nuk ju kam kushtuar vëmendje të duhur këtyre gjërave, sepse për natyrën time nuk më janë dukur gjëra të dorës së parë. Pasi çështja është shtruar kësi soji, atëherë pavarësisht se si do të shprehemi as 17 shkurti nuk mund të fshihet pasi është një fakt, kur janë bërë bisedime dhe është vendosur, çka është më kryesorja, emri i organizatës të cilës më 15 maj nuk iu ndryshua asnjë pikë dhe asnjë presje. Sido që të jetë unë nuk jam për atë që të bëhet objekt diskutimi kjo çështje. Faktet historike mbeten fakte, unë jam për atë që me ato të merret historia.

S. (Xhafer Durmishi)

47. Letër e Xhafer Durmishit për Faridin Tafallarin, mars 1984

Shoku Faridin, (mars 1984)

Po të lajmërohem shkurtimisht.

- Atë materialin që e kishte Ilazi dhe që u vendos me na e dërguar le ta përcjell ty e ti mua. Çështja se atë material ta përcjellim dorë më dorë nuk ka baza pasi ne kemi shkruar në letra gjëra edhe më me rëndësi.

- Ma dërgon atë artikullin që ta pata shkruar ty e që nuk u lexua në Sant Gallen me rastin e dyvjetorit të rënies së shokëve se po më nevojitet.

Këtu në Paris punët me klubin janë duke shkuar mirë. Se në cilën ditë do të hapet të tregoj radhën tjetër.

Të fala S. (Xhafer Durmishi)

48. Letër e Xhafer Durmishit për delegatët e Bashkësisë së klubeve, mars 1984

Të dashur shokë, delegatë pranë Bashkësisë së Klubeve Shqiptare në Mërgim,

Në bazë të vendimit të aktivistëve më të dalluar të klubeve të ndryshme shqiptare në Evropën Perëndimore, që u bë në një tubim më 9 korrik 1983, me formimin e Bashkësisë së klubeve, kjo Bashkësi thirri mbledhjen e vetë të parë më 16 tetor 1983 në Gjenevë, në të cilën pos të tjerash u aprovua Statuti i Bashkësisë dhe një Rezolutë me anë të së cilës klubet marrin përgjegjësi që për organin udhëheqës të Bashkësisë (Këshillin Drejtues të Punës KDP) të përgatisin raporte mbi aktivitetin e tyre.

Puna në këtë drejtim filloi. Disa klube në këtë drejtim u dalluan më shumë se të tjerat.

Disa shokë janë përpjekur në çdo rast që iu është dhënë mundësia të japin sugjerimet e tyre lidhur me atë se në çfarë binarësh të orientojmë aktivitetin nëpër klubet megjithëse Bashkësia filloi nga puna duke pasur në gjirin e vetë një heterogjenitet sipërfaqësor, por jo edhe të parëndësishëm në çështje praktike. Bashkësia me disa aktivitete të saj është përpjekur sidomos t'ia ndalë hovin veprimeve spontane nëpër klube.

Siç jeni në korrent në bazë të letrave, mbledhja e dytë e Bashkësisë së Klubeve ka qenë e planifikuar për datën 14 prill 1984, por me që ra kjo mbrëmje (e 7 prillit) u pa e arsyeshme që ta shfrytëzojmë këtë rast për mbledhjen e dytë të Bashkësisë së klubeve në këtë vit.

Ne besojmë se ju aktivistë të klubeve keni pasur kohë të mendoni dhe vendosni për ato çështje që doni të shtroni në këtë mbledhje. Në këtë mbledhje do të diskutojmë e marrim qëndrime për;

- organizimin e festës së 1 Majit,
- planifikimin e pikave, në të cilat mendojmë të hapim klube të reja gjatë këtij viti,
- angazhimin e disa shokëve për marrjen e kontakteve dhe informatave nga organizata të ndryshme për çështje të emigrantëve, kontakte këto që do të na nevojiten për shokët të cilëve nuk do t'ju vazhdohet viza nga konsullatat jugosllave dhe për çështje tjera që tani janë të njohura në praktikën e punën tonë.

Në këtë takim do të ishte me rëndësi që të sillni me vete edhe Statutet e Klubeve. Kjo shtrohet e rëndësishme pasi Bashkësisë i kanë ardhur vërejtje se një klub në Statutin e tij e paska një nen të atillë në të cilin po u thoka se për t'u bërë anëtarë duhet të shkruar një lutje me shkrim.

Aktualisht udhëheqësitë e klubeve duhet ta ruajnë unitetin e tyre.

Një aktivist i Bashkësisë (Xhafer Durmishi)

49. Letër e Xhafer Durmishit për Shokët e Shtutgartit, 14 maj 1984

Nëntitujt e kësaj letre janë vendosur për këtë përmbledhje.

Shokëve të Shtutgartit e me rrethinë, 14 maj 1984

Po e filloj këtë letër pa ndonjë hyrje të veçantë. Kohë pas kohe jemi ndër informuar lidhur me punët rreth klubit e për disa çështje tjera me disa shokë përmes telefonit. Unë në këtë letër do të mundohem që me disa fjalë të them mendimet e mia lidhur me momentet nëpër të cilat po kalon LRSSHJ, si dhe rrethi i Shtutgartit në veçanti dhe për atë se si mendoj se çfarë qëndrimi duhet mbajtur në këtë situatë. Por para se të vij në përshkrimin e situatës prej mbledhjes sonë të fundit e deri më sot, unë në pika të shkurta do të jap disa shpjegime lidhur me funksionimin dhe raportin e njerëzve në udhëheqjen e LRSHJ në Evropën Perëndimore dhe më gjerë (në përgjithësi në botën e jashtme).

Kjo shtrohet e domosdoshme paraprakisht sepse kur është në pyetje njollosja e ndonjë shoku nuk është qarë koka për konspiracion, ndërsa kur është në pyetje çështja për t'ia qitë fëlliqësirat dikujt në lendinë po thirret me të madhe që të mos hyjmë andej, se po dekonspirohen gjërat, se ato i takojnë një rrethi më të ngushtë e profka të ngjashme si këto. Këto që do t'i numëroj, shumicën prej tyre ua them për herë të parë. Këtë veprim e bëjë i bindur se është i drejtë, sepse përgjegjësitë që na i ka besuar populli (apo thënë më drejtë, që ia kemi besuar vetes) nuk i përmbushëm ne pesë (5) veta për të cilët do të flasë më poshtë.

Formimi i Qendrës Ekzekutive

1. Më 15 janar 1983, pas marshit protestues që u mbajt më 15 janar, u mblodhën në banesën e Hafizit (Hafiz Gagicës); unë, Ibrahimi (Kelmendi), Uka (Xhafer Shatri), Plaku (Hasan Mala). Ishte parashikuar që në atë tubim të merrte pjesë edhe Faridini por ai nuk mori pjesë për shkak se ishte në spital. U mblodhën në një përbërje të tillë me propozimin e Ukës (Xhafer Shatrit) e gjithashtu me propozim të tij u vendos që ai forum të jetë përgjegjës për botën e jashtme, të quhet Qendër Ekzekutive dhe prapë me propozim të Xhafer Shatrit të cilave ne nuk ua bëmë asnjë ndryshim u caktuan këto detyra: Xh. Shatri përgjegjës për propagandë, unë për çështje të organizimit në botën e jashtme, Faridini arkatar i Lëvizjes dhe Ibrahim Kelmendi për çështje me organizatat e jashtme. Hasan Mala përgjegjës për lidhjet brenda. D.m.th. siç po shihet me propozim të Xh. Shatrit u vendos që të jemi shokët më të afërt në bashkëpunim. Unë besova në fjalët e tij siç kanë besuar shumë të tjerë. Në anën tjetër siç e dini pas atij marshi protestues për disa ditë në Shtutgart qëndroi Ganiu (Milaim Zeka), i cili siç po vërtetohet sot është lënë me porosi të Xh. Shatrit, në mënyrë që me aftësitë e tij t'ia "ftofë" Skënderit, Hafizit e Haxhiut. Këtë e dëshmon "spiuni i Shqipërisë" Milaim Zeka. Siç po shihet mjeshtri i madh Xh. Shatri në njërën anë e shtrinte dorën për luftë të përbashkët e në anën tjetër luante me sinqeritetin e shokëve duke i manipuluar me fjalët se "jemi anëtar të një organizate" (pra OMLK-së), për t'i përdorur kundër atyre që u thoshte se po i bënë shokë.

Diskutimi rreth makinës së Jusuf Gërvallës

2. Pasi dolëm prej banesës së Hafizit (Gagicës) më 15 janar, vetëm unë dhe Xh. Sh. biseduam për makinën (e shkrimit) me të cilën nxirrej "Zëri i Kosovës", të cilin për shkak të mungesës së kuadrove deri në numrin 2 të vitit 1983 e nxora unë dhe jam unë ai prej të cilit në lidhje me gazeta, jo vetëm në çështje grafike ka mësuar shumë Xh. Sh. dhe

jo unë prej tij, pavarësisht se ... e paska qitë Zërin e Kosovës para 10 vitesh me ata bashkëpunëtor që i ka përmendur në ZK numër 1 të këtij viti.

Kjo (10 vjetori i ZiK) është një temë më e gjerë e cila nuk i takon kësaj letre e të shqyrtohet më gjerësisht këtu pasi kjo punë mund të bëhet në një rast tjetër. Po kthehemi tek makina e shkrimit. Uka (Xh. Sh.) tha: "Është mirë me e pas makinën unë pran vetit, pasi në një letër që na ka ardhë prej postës së Bernit, përmban shumë kritika dhe se dyshoj se në te ka shumë mendime të Engjëllit (Kolanecit)." Unë pa e biseduar as me Faridinin, as me IK, i cili saktësisht nuk e dinte se kush është duke e qitur ZiK-un, e as me ndonjë shok tjetër rashë dakord, gjë për të cilën kurrë nuk pendohem. e gjithashtu në bazë të luftës që do ta shohim nuk do të luaj rolin e një fëmije që fillon me qajtë kur i marrin ndonjë send nga dora. Ju do të thoni se kërkesa e tij është në përputhje të plotë me vendimet e po asaj dite. Kjo pyetje është e pranueshme në dukje të parë, por këtu lindin edhe disa të tjera në bazë të të cilave mund të bëhen shumë vërejtje po ashtu shumë të drejta ndaj kërkesës së Ukës, si p.sh. Pse ai këtë pyetje në mënyrë direkte nuk e shtroi gjatë mbledhjes, apo pasi u ndan detyrat pse në mënyrë adekuate nuk u veprua edhe në raport me arkatarin e me çështjet materiale. Këto janë pyetje për përgjigjen e të cilave duhet të mendoj Uka.

Mbrëmje përkujtimore në Hamburg

3. Pasi marshit protestues në Shtutgart, Isak Gutaj, për interesa personale, kishte vendosur të përkujtohen dëshmorët Jusuf, Kadri e Bardhosh me rastin e ditës së njëvjetorit të varrimit, në mënyrë të ngjashme siç veproi IK në një mënyrë shumë më egoiste për përkujtimin e trevjetorit të demonstratave sivjet, apo Uka për katër mujorin e rënies së Rexhepit e Nuhiut. Të shohim se çfarë xhemati, çfarë ylemash e çfarë myezinësh do të thërras Xh. Sh. për 6 mujorin, 8 mujorin, 12 mujorin e kështu me radhë. Kështu, Isakut, për hir të xhirimit filmik, i kishte hy në zemër edhe përkujtimi i rënies. Për hatër të egoizmit e të poshtërsisë së vetë, IK për të treguar se kush qon peshë të madhe në Lëvizje e kishte shtruar aq kontestuese se në emër të kujt duhet të thirret kjo mbrëmje. Kështu Xh. Sh. për t'u mbrojtur nga diskreditimi e për t'u ç'fajësuar nga fjalët e mbrëmjes në Weinfelden se ua kemi dërguar "armët më moderne të Evropës", në vend të dërgimit të një pasaporte, dhe për të tjerat, deshti edhe njëherë të thotë se nuk mban as fijen e përgjegjësisë për vrasjen e dy heronjve e as për burgosjen e dhjetërave të tjerëve, si dhe për uljen e autoritetit të Lëvizjes e cila Republikën është duke e kërkuar edhe me armë zjarri të llojeve nga më të ndryshmet. Natyrisht në këtë mbrëmje nuk mungoi as porosia që të këndohet fuqishëm për shokun Enver, duke tentuar t'ia tërhjek vëmendjen PPSH-së se dyshimet për atë se Xh. Sh. është një djathtistë i mykur janë të pabaza.

Po kthehem tek Hamburgu. Në bazë të marrëveshjes së mbledhjes së 15 janarit unë vetë deshta ta shfrytëzoj rastin dhe të shkoj në Hamburg. Ishte kjo hera e parë që shkoja në këtë qytet. Kjo rrugë për në Hamburg m'u mundësua duke iu falenderuar biletës së lirë në grup, dhe për kthim ato 150 DM që m'i dha nga ju Remziu (Ademaj). Për ndërmarrjen e hapit të Isakut ne ishim në dijeni. Xh.SH. na kishte thënë vendosni si të është më e drejtë duke anuar më shumë nga pikëpamja se nuk bënë të bëhet xhirimi, kurse në anën tjetër, siç e zbuloi vetë në mbledhjen e fundit në Gjenevë pas demonstratës, më 3 mars të këtij viti, ai i kishte thënë Isakut se bënë ta xhirosh atëfarë biçim filmi. Komentet për këto veprime më duken të tepërta. Një ballafaqim i organizuar i pikëpamjeve të ndryshme. Mua në telefon më thotë fol në emër të Lëvizjes (kjo u shtrua e nevojshme edhe për faktin se Isaku thoshte se për hapin e vetë e kishte aprovimin e Lëvizjes), dhe përfundoni në ndonjë marrëveshje, duke i propozuar Isakut një realizim të këtij lloji më

vonë, propozim të cilin ai e hodhi poshtë. Për këtë arsye e vetmja zgjidhje qe që t'i paguhen shpenzimet e kontraktimit me gjerman e shpenzime të tjera që ai i vlerësoi 1500 DM, shumë të cilën e pranuam. Vepruam asi soji e në marrëveshje me të gjithë shokët e sidomos me Faridinin që të forconim autoritetin e Lëvizjes duke treguar se ajo është mbi të gjithë ne. Unë pa e përfunduar mirë atë kompromis i tregova Xh. Sh. e gjithashtu pas pak ditësh ia kam dërguar adresën e Isakut. Qëllimet e ulëta të Xh. Sh. nuk do t'ua falshin ndonjë qëllimi të mirë që mund ta ketë pasur në kokën e tij, se si i shpëtoj goja atë natë e me më thanë mua fol në emër të Lëvizjes, pasi me këtë do të shtohej pesha e fjalës sime, andaj për ta anuluar këtë vendosi që të mos ia dërgoi të hollat Isakut, i cili ishte tallur edhe me Lëvizjen edhe me mua për atë se pse nuk e mbajtëm fjalën. Xh. Sh. më thoshte se i janë dërguar të hollat por janë kthyer, bile konkretisht nga posta e Baselit dhe se e kemi vërtetimin e postës. Gënjeshtra dhe vetëm gënjeshtra. Pas dy-tre muajësh Isaku i ka marrë të hollat nga Xhavit Ramabaja. Më vonë Xhavitit i kanë ardhë të hollat nga Zvicra.

Për gabimin e parë do ta bëjmë fuz

4. Kah gjysma e muajit shkurt 1983, makina (e shkrimit) u dërgua në Zvicër. Meqë ata që e kishin marrë përsipër nuk kishin haber nga puna me te, dhe me radhitjen (punën grafike) në përgjithësi në fillim të muajit mars shkova në Zvicër, ku e kalova kufirin me Faridinin (me pasaportë të H.R.) i cili më la në Basel. Në Gjenevë më priti Uka në Stacion. Tek ai qëndrova gjer më 13 mars 1983 kur u bë edhe mbledhja e parë e QE në përbërje të plotë. Por para se të takohemi të gjithë së bashku, u takuam në banesën e Ukës; Unë, Faridini, Plaku (Hasan Mala) dhe Uka ku biseduam për shumë çështje në mes të cilave më e rëndësishme qe puna e arkatarit. Faridini i dorëzoi Ukës një regjistër mbi shënimet e plota lidhur me të gjitha shpenzimet duke u nisur prej asaj dite që e ka marrë punën e çështjeve materiale nga Nuhiu e gjer në atë ditë. Plaku dhe Uka as përafërsisht nuk qenë në gjendje të bëjnë ndonjë shpjegim të saktë lidhur me shpenzimet e ndryshme, e të mos flasim për të hollat të cilat janë mbledhur në konton "Ndihma për Kosovën". Sa kanë qenë gjallë shokët ka pasur një marrëveshje (gojore) të precizuar në këtë çështje se ato do të jenë të përbashkëta, respektivisht do të ndahen në mënyrë të barabartë, pasi të dy palët kanë pasur njerëz të burgosur në Kosovë.

Biseduam edhe në lidhje me Ibrahimin, me të cilin unë gjithmonë i kam pas kartat e hapura dhe çka i kam thënë ia kam thënë gjithmonë parasysh, kurse Uka e ka quajtur shok para syve, ia ka dhënë megafonin në demonstrata dhe gojë më gojë me te (nga i njëjti megafon) kanë brohoritur parulla të ndryshme, si herën e fundit në Gjenevë, kurse prapa shpina nuk ka lënë gjë të zezë pa thënë kundër tij. Këtë e dëshmojnë disa letra. Këtë e dëshmon edhe sjellja e tij në atë mbrëmje, kur ende pa u takuar me Ibrahimin, thoshte se këtë punë (afrimin e tij në QE pra) e kam bërë me dy mendje, dhe se për gabimin e tij të parë do ta bëjmë "fuz". Këtë fjalën "fuz" e përsëriti disa herë para se të takoheshim.

Gjatë takimit unë e kritikova për disa çështje Ibrahimin, sidomos për disa pika që kishin të bënin me klubet. Si duket ai toni im i kritikës dhe mënyra ime e argumentimit e frikësoi Ukën se mos ndonjë ditë do të ndodhet vetëm para meje, kështu që për të ruajtur veten e për të mbajtur ekuilibrin, në fund të mbledhjes tha se me Ibrahimin duhet të sillemi më mirë, të jemi më korrekt se ka punuar shumë.

Mua jeta më ka mësuar që të mos i besoj askujt

Gjatë qëndrimit tim prej më tepër se 10 ditë në banesë të Ukës patëm rastin të këmbejmë mendime për shumë çështje. Tek ai (në adresën e gazetës) kishin ardhur disa

letra për mua që nuk m'i kishte dërguar. Duke e parë se që në fillim ra në sy një atmosferë joshoqërore më tha: " Mua jeta më ka mësuar që të mos i besoj askujt."

Në ato ditë punuam për "ZiK" nr.2 të vitit 1983. Në atë tubim unë lexova të vetmin material që ishte përgatitur në atë mbledhje, në mënyrë më të qartë e që kishte të bënte me punën e aktivitetin që do ta zhvillojmë në mërgim. Sa u përket klubeve unë shpreha disa ide si këto:

- se ne që kemi rënë më shumë në sy me aktivitete të mos dukemi fare nëpër klube,
- t'u sugjerojmë bashkatdhetarëve të shkojnë në të gjitha klubet pa marrë parasysh se kush është në udhëheqjen e tyre,
- që në aktivitetin tonë të orientohemi për të hapur sa më shumë klube, por pasi në to mund të hyj kush të dojë të respektohen rigorozisht simbolet e RSFJ dhe të ndiqet një politikë e tillë që të mos rrezikojmë punëtorë.

Të gjitha këto pikëpamje të miat u aprovuan, me përjashtim të pikës që ne të rënët në sy, të mos dukemi nëpër klube. Këtë pikë e kundërshtuan Uka e Ibrahimi.

5. I mbështetur në këto orientime e vendime për të cilat Ibrahimi e Uka patën fytyrë të betohen edhe para fotografive të tre shokëve të përgatitura në forme fasciklle të Sh.B.K. "Bajram Curri" në Australi, se vendimeve të marrura në të gjithë veprimtarinë do t'iu përmbahen, unë qëndrova disa ditë ndër bashkatdhetarë në Munchen, ku të gjithëve u fola për këto orientime që kemi marrë, prej aty shkova në Bielefeld (gjatë muajit maj e në fillim të qershorit 1983) ku edhe aktivistëve kryesor të klubit "Kosova" u fola për orientimet e marrura, të cilat të gjithëve u pëlqyen. Unë atyre u fola edhe për mundësinë apo ta kenë në perspektivë vënien e fotografisë së Titos në klub. Ky ishte si me thanë vetëm një mendim lidhur me klubet që e kanë hequr apo se kanë vu kurrë. Të gjithë e quanin të drejtë me përjashtim të ndonjërit që kishin frikë se mos po i përçan konsullata jugosllave. Këtë mendim ua thash edhe pesë vetave të klubit "Emin Duraku" (Hyzriut, Zymer Kryeziut, Avdi Begishollit, Mustafë Kelmendit dhe Musa Dakës). Me mua në këtë takim ishte edhe Xhavit Ramabaja. Përveç punës së fotografisë ne diskutuam edhe shumë çështje tjera. Ata më thanë se është vështirë për t'u realizuar kjo ide tek ne, përndryshe është bërë një gabim i madh kur është heq, gabim për të cilin na e kanë tërhequr vërejtjen Jusufi. Yrysh të madh kanë pas marrë "patriotët e mëdhenj me vulë e adresë" kundër meje duke thënë se si ka guxua ai me e diskutuar atë punë, se për ç'arsye kam shkuar atje, se a kam shkua aty për ndonjë punë private apo çfare. Me një fjalë, një fushatë e tërbuar e vume në praktikë prej njerëzve të padjallëzuar në Dyseldorf dhe e aprovuar me kënaqësi prej Gjeneve, e cila dështoi në mënyrë të turpshme, duke i përbirë secili fëlliqësirat që kishte qitur nga goja e vetë, fushatë që i ka ngjarë shumë kësaj të fundit të mbrëmjes së 7 prillit e cila do të përfundoj në mënyrë shumë më të turpshme për kreatorët e saj se sa e para.

Të lumtë se na e zbardhe fytyrën

6. Më 9 korrik 1983 u mbajt takimi i shumicës së rretheve në Zvicër, ku u vendos themelimi i Bashkësisë së Klubeve, si dhe u demaskua fuqishëm veprimtaria përçarëse e Abdullah Prapashticës me kompani. Siç dihet në atë tubim e pata marrë edhe unë fjalën. Se si kam folur e çfarë ndikimi ka bërë ajo fjalë e kanë gjykuar dhe le të gjykojnë të tjerët. Por me sa më kujtohet referat tjetër me shkrim nuk u lexua, përkundër asaj që ishte përgatitur një, por pasi e lexova unë, u vendos vetëm të flitet (d.m.th. spontanisht) e jo të lexohet. Pas dolëm, (pas mbarimit të fjalimit tim) Faridini më thotë: Të lumtë se na e

zbardhe fytyrën dhe aq mirë e ke thënë sa po më duket se Ukës nuk i ka ardhë mirë (nga frika kuptohet). Kjo ishte shumë e vërtetë. Pas atij takimi të gjerë, unë dhe Faridini u ndalëm. Do të takoheshim ne të pestët e QE. Në këtë tubim Uka kishte mjaftë çka për të na kritikuar mua dhe Ibrahimin. Mua pse nuk kam punuar mjaft për demaskimin e fraksionit. Kjo ishte një mënyrë e poshtër sjelljeje sipas devizës "mbrojtja më e mirë është sulmi". Ai kishte arsye të mbrohej për kleçkat e tija në drejtim timin si në Hamburg e Dyseldorf, si dhe për atë që kurrë për asnjë çast të vetëm nuk më kishte pyetur se a kam të holla me udhëtua për të përmbushur detyrën që kisha marrë përsipër, respektivisht që më ishte ngarkuar.

Sa i përket Ibrahimit atë do ta akuzonte si agjent të "shërbimit informativ shqiptar", se e ka dekonspiruar Qendrën Ekzekutive para Shefkate Sherollit, e cila këto të dhëna dhe disa të tjera ia paska dorëzuar Ambasadës Shqiptare në Suedi, në Stockholm.

Në bazë të poshtërsive që ishin bërë në drejtim timin unë kërkova dorëheqje nga një Qendër e tillë. Kërkesa ime për dorëheqje nuk u aprovua. Në atë takim u vendos që të organizohet një demonstratë në Strasbourg. Uka na tha se nuk prishë punë që t'i thërras miqtë e mi kroat që edhe ata të dalin me flamujt e tyre. Kështu na propozoi shoku i Hydajet Hysenit e i Kadri Zekës, përndryshe "armik i dogmatizmit". Natyrisht që propozimi i tillë nuk u aprovua. Kuptohet edhe kësaj here për çështjet materiale përveç ndonjë britme se nga Dyseldorfi po na vijnë shumë pak të holla nuk u fol më tepër. Demonstrata e Strasburgut me përjashtim të gënjeshtrës se është siguruar një sallë e mirë ku do të na argëtojnë aktivitet e Lëvizjes, përfundoi me sukses.

7. Në fillim të muajit nëntor të vitit të kaluar, në Gjenevë erdhi Mërgimi (SN). Pas një jave ata i prishën marrëdhëniet për një varg çështjes si p.sh. lidhur me etiketimet e Xh. Shatrit për shumë aktivist si "spijuj të Shqipërisë apo vegla të Engjëll Kolanecit", lidhur me devijimet në ZiK si dhe mosgatishmëria e Xh SH për korrigjimin e tyre, lidhur me çështje të organizimit të brendshëm të kohëve të sotit dhe më të hershëm, i cili duke pas për bazë akuzat nga një "burim me rëndësi". Mërgimi bashkohet plotësisht me ato akuza që janë bërë.

Për mbrëmjen e 11 nëntorit 1983 ka qenë i thirrur një takim, por nga rasti që ndodhi në Shtutgart, ky takim u mbajt më 13 nëntor. Në atë takim ku ishim ne të pestit ishte edhe Mërgimi (SN). Në atë takim ne shumica vlerësuam se nuk mund të themi akoma se Uka është një njeri në shërbim të udbës, ashtu siç e kishte akuzuar Mërgimi dhe disa individ të tjerë, por vlerësoi se gabimet e tij në Zëri janë më se evidente dhe për atë u vendos formimi i një komisioni i cili do të diskutoj për devijimet e vërejtura, dhe ai komision i studioi e shprehu ato devijime në një mbledhje më 18 dhjetor 1983. Përkundër vërejtjeve të këtij komisioni nga KQ i LRSHJ, Uka vazhdoi me shprehjet e sharjet e tij në nr. 7 të ZK, 1983.

Ide rreth Komitetit Qendror

Në atë tubim u vendos që të riformohet KQ i LRSHJ prej 15 vetash. Në përbërjen e tij do të hynin, në bazë të organizatave të mëparshme 7 nga krahu i ish-LNCKVSHJ dhe 7 nga ish-OMLK dhe IK. Lidhur me këtë u la një takim për natën e vitit të ri. Vendtakimi nuk u caktua. Për arsye se në të **gjitha** takimet e vitit 1983, përveç atij të janarit që u bë pas demonstratës, unë në të gjitha rastet kisha dalë në Zvicër, kësaj radhe nuk kisha mund me sigurua dokument (huazua pasaportë), kisha të drejtë të thosha se edhe ata (të Zvicrës) bënë me dalë në Gjermani. Megjithatë u tentua të organizohet ai takim por nuk pati sukses. Atë natë Faridini u nervozua, pasi vet doli në Zvicër dhe Uka i kishte thënë se nuk mund të vjen gjer në St. Gallen, por e lëmë për një herë tjetër.

Me kalimin e ditëve të para të janarit u hap klubi ”Isa Boletini” si dhe një javë më vonë u organizua mbrëmja në Weinfelden, me ç’rast disa prej jush shkuat edhe në të pame për rastin e Nuhiut e të Rexhepit. Lidhur me marifetllëqet në Weinfelden nuk po zgjatem. Pas pak ditësh, kah 23 janari, unë u largova nga Gjermania, për shkak të zhagitjes së çështjes së dokumenteve, pasi kisha gjasa më të mira që këtë punë shpejt ta rregulloj në Francë.

Në ndërkohë kishte dalë ”Zëri” nr.7 i vitit 1983 me ato shprehjet kundër sarhoshave, dhe se ne ”nuk jemi bisht i kurrkujt”, (duke iu drejtuar PPSH, Shtetit Shqiptarë, që i ka quajtur në tubime me emra të ulët, epitete të cilat nuk po e shoh të arsyeshme t’i shkruaj në letër por që janë të incizuara në shirit magnetofoni. Në anën tjetër dërgoheshin letra me nga 10 faqe, se kështu m’u kanë bërë padrejtësitë (gruaja e Kadriut) si dhe ”Qarkoret e Sqarimet” e Mërgimit (SN) kundër devijimeve të vazhdueshme të Ukës. ....

Demonstratat e organizuara pa Xhafer Shatrin kanë qenë punë fëmijësh

Demonstratën e Gjenevës, të fundit, siç e patë edhe në takimin e fundit, pa u konsultuar me asnjë shok të vetëm Uka e thirri pra këtë demonstratë. Sipas logjikës së tij të sëmurë kjo do të thoshte: Kur të gjithë merreshin me fjalë unë merresha me punë të mëdha dhe organizoja demonstrata. Sa për konsulta, ajo çështje nuk ishte diskutabile pasi nuk kisha me kend të konsultohesha e me kend të merresha vesh për arsye se të tjerët për mua ishin fëmijë, siç më ka pas thënë mua pas demonstratës së Bonit të 3 prillit 1982. Për këto thoshte se është merakosur shumë se mos nuk po shkon puna mirë gjatë demonstratës së Bonit pasi ajo ka qenë si punë fëmijësh. Në frymën e këtij stili ofshante gjatë takimit të fundit pas demonstratës së Gjenevës ”se me kend më ka qitë puna me luftua së bashku”, thuase ai paska qenë më parë duke luftua në këto mjedise dhe dikush nga jashtë paska ardhë me ia përzije dorëzat, në kohën kur është pikërisht e kundërta se ai ka ardhë nga jashtë dhe e ka gjetë një punë që është në vazhdim.

Kur jemi duke folur për këtë, nga sjelljet, tani kuptohet se ai me çdo kusht ka dashtë që të thotë se: ”Tre shokët u vranë, dhe sikur të mos kisha qenë unë, aktivitet në botën e jashtme nuk kishte me pas një kohë të gjatë, për të mos thënë nuk kishte me pas fare. Këtë e dëshmojnë edhe fjalët e ulëta të tij që kanë të bëjnë me bisedimet e bashkimit me më 14 e 15 maj 1982, ku disa shokëve që kanë ardhë tek ai nga Kosova u ka thënë se sikur të mos kisha qenë unë nuk ishte bërë bashkimi, por më 14 maj këtu unë atyre që kanë ardhë për bisedime ua kam thyer dhëmbët. Këto poshtërsi të tij nuk kanë nevojë për koment. Unë dua të theksoj se sa mund të arrij ta konsolidoj veten politikisht njeriu me këto gënjeshtra. Dhe tani i erdhi radha atij të organizoj demonstrata të mira, të organizuara me fotografist, të cilët do ta futin në objektiv çdo njeri që ua bënë me sy ai...

Mbledhja e 3 marsit 1984 në Gjenevë

Mbledhja filloi. Në te u diskutua për shumë çështje. Në mes tjerash në tavolinë iu bë e ditur se Xh Sh nuk është zot i Lëvizjes dhe se në emër të saj i ka takuar edhe tjetërkujt të flet. Në atë tubim u aprovua një dokument, u vendos të formohet redaksia e përbashkët, që të veprohet me organ (gazetën qendrore) ashtu siç u vendos me KQ, të botohet një shkrim në formë autokritike për devijimet e shfaqura në faqet e Zërit, etj. Për çështjet materiale edhe kësaj radhe nuk u diskutua, sepse mungonte Plaku (Hasan Mala), e Uka nuk paska pas mundësi me ardhë gjer tek ato shënime, kështu që kjo temë nuk u shqyrtua fare. Në mungesë kohe, pika për planifikimin e punës në të ardhmen mbeti pa u diskutuar.

Kjo mbledhje u karakterizua edhe nga lajkat e ulëta të Ukës në momentet kur do të kritikohej nga unë duke më thënë: ”Se unë nuk di çka mëshihet nën flokët e tua, dhe se ti një ditë mund të kontribuosh më shumë se Jusuf Gërvalla, pasi ne kemi letra të Jusufit ku ai pas festës së 28 nëntorit 1981 është shprehur se së shpejti me Shpendin (unë e kisha me te pseudonimin Shpendi) do t’i ndajmë punët.

Në ndërkohë ishte përgatitur fletushka ”Republika e Kosovës” para se ne të bëjmë mbledhjen e Gjenevës, nga përkrahësit e pikëpamjes se degët e LRSHJ kanë të drejtë të nxjerrin gazetat e veta, në mesin e të cilëve qëndronte SN (Sabri Novosella). Unë kam qenë dhe mbetem një kundërshtar i vendosur i një pikëpamjeje të tillë. Por SN e të tjerë duke e parë se ne në përgjithësi dhe Uka në veçanti e ka zhagitur tej mase aprovimin e Statutit të Lëvizjes, i cili në një variant më pak të përshtatshëm e jo të plot ka pas ardhur menjëherë pas bashkimit dhe një tjetër variant i shkruar në fillim të tetorit 1983, i shkruar nga unë e që është quajtur shumë i përshtatshëm nga të gjithë dhe me ndonjë plotësim minimal në një mbledhje ka mund të aprovohet. Por Uka vazhdonte me të veten duke thënë se për këtë punë duhet të gjenden ”tre veta që e duan atdheun më shumë se sa veten”, pasi ne të gjithë më shumë po e dashkemi veten se atdheun, kurse Uka vetë dhe dy të tjerë që po i njohka vetëm ai po e dashkan atdheun më shumë se sa veten. D.m.th. pasi ai që na u frynte se në emër të Lëvizjes i shkruante nga 40 letra në ditë, për vite e pezullonte aprovimin e një statuti pa të cilin nuk mund të mendohet funksionimi i asnjë shoqate më të thjeshtë.

Disa aktivist, në mesin e të cilëve edhe anëtarë të KQ e aprovojnë krejtësisht variantin e Statutit të shkruar nga unë, duke i shtuar një pikë tejet delikate se degët e LRSHJ kanë të drejtë të nxjerrin gazetat e veta, dhe nëpër disa vende e shpërndajnë në fund të dhjetorit dhe fillim të muajit janar. Të mbështetur në një Statut të tillë Komiteti i degës së LRSHJ ”Murat Mehmeti” (në Bruksel) nxori fletushkën e vet. Unë u shpreha menjëherë kundër një veprimi të tillë, por jo me shkua deri në atë masë sa përgjegjësinë për mos punën tonë tua hedhim me tërë peshën të tjerëve. Kjo d.m.th. se KQ në përbërje të plotë nuk e ka aprovuar një Statut qoftë edhe të përkohshëm në të cilin thuhet se degët e LRSHJ kanë të drejtë të nxjerrin gazeta dhe as një Statut të atillë në të cilin thuhet se ”Zëri i Kosovës” është i vetmi organ, (e vetmja gazetë) e Lëvizjes, përmes të cilit bëhen të gjitha njoftimet dhe qëndrimet e saj. Sipas kësaj pikëpamjeje, të gjitha traktet që po u bëkan në Kosovë, parullat e ndryshme nëse nuk janë bekuar e aprovuar nga papa i patriotizmit shqiptar Xh. Shatri nuk po u bëkan kabull tek zoti i plotfuqishëm.

Për rastin e fundit (7 prillit) në Dyseldorf si temë më vete nuk po flas, por do të kthehem sipas rastit në disa çështje.

Në bazë të atyre që parashtrova, ... Namiu (Nami Ramadani) tha se nuk është mirë t’i thuash të gjitha këto sepse kjo punë qenka, a mund të bëhet ashtu siç thonë: ”Prishe shtëpinë për me e ndërtua avllinë.”

Ju si rreth, si punëtor, Remzi, Nami, Mejdi, Faridin ishit të mendimit se nuk është mirë me u ngutë por me u ulë e me bisedua edhe njëherë, apo sa herë të jetë nevoja,.... Pra në një situatë të tillë unë e kisha për detyrë ta them mendimin tim në ato mjedise që m’u dha rasti të ndodhem. Në atë mbledhje u arrit në përfundimin që të thirret një tubim i gjer nga aktivist të rretheve më të dalluara, kurse për rrethin tonë u vendos që të mos marrim hapa të ndryshëm pa u konsultuar me njëri tjetrin. ...

Dyert për një takim, nga ana jonë, mbeten të hapura në çdo situatë....

Në përfundim kam këtë kërkesë për shokun Faridin që të m’i dërgoj në adresën e mëposhtme materialet që i lash herën e fundit tek ai, para se të nisesha në Francë.

Në rastin e parë, posa ta marrë pasaportën besoj se do të shihemi.
Pranoni përshëndetjet e mia të përzemërta.
Adresa ime është: Ali Bitic (Xhafer Durmishi)
6 Rue des Cailles
94450 Limeil Brevannes
France

50. Letër e Xhafer Durmishit për Januz Prekazin, 14 gusht 1984

Shoku J., 14 gusht 1984

Këtu në Stockholm arrita më 1 gusht 1984. Në përgjithësi tani gjendem mirë. Sa i përket banesë, përkohësisht më kanë vendosur në një hotel që quhet "Gustav Vasa". Gjatë muajit të ardhshëm besoj se do të më vendosin në një banesë afër shokëve. Punës ia kemi filluar, por edhe me këtë numër mund të vonohemi pak, pasi të gjitha mjetet e nevojshme në një vend të ri nuk mund të sigurohen menjëherë. Mund të them se këtu jemi më afër Kosovës pasi momentalisht kemi më shume kohë të mendojmë për te. Aktualisht kisha me të porositë që të përqendrohesh në këto punë:

1. Gjeje ndokund një telefon ku mund të rrish dhe të presësh me të thirrë ndokush. Këtë po ta them pasi Xh. e ka mundësinë së paku edhe për një kohë me të thirrë gratis, e ti këtë duhet shfrytëzuar që të jesh më shumë në kontakt me shokët dhe me ne. E njëjta do të vlente edhe për H.

2. Shiko me Ali Ademin dhe çeleni një postfach në Hamburg, sepse do të ishte shumë i sigurt dhe do të na shërbente si adresë e përhershme në atë qytet.

Më shkruaj se si kanë kaluar shokët e rrethit tuaj për pushimet dhe për të tjera: Adresa është kjo: Xhafer Durmishi, Björkhagsplan 9, 12152 Johanneshov, Stockholm, Sweden

Të fala të përzemërta nga Skënderi (Xhafer Durmishi)

51. Letër e Xhafer Durmishit për Remzi Ademin, 18 gusht 1984

Shoku Remzi, 18 gusht1984

Unë tani jam mirë. Më mbajtën nja 5 ditë për ta vërtetuar se a jam me të vërtetë unë. Mos të kishte qenë intervenimi i avokatit patën me më ngarkue në aeroplan. Por edhe ky rast përfundoi mirë. Tani jam vendosë në një hotel ku nuk jam larg prej F e G dhe pothuaj kohën më të madhe jemi së bashku dhe po kalojmë mirë. Këtu kushtet për të gjitha janë shumë të mira dhe ne do të përpiqemi që t'i shfrytëzojmë. Kah fundi i muajit besoj se edhe me banesë do të jemi të tre së bashku. Këtë të hënë do t'ia filloj kursit të gjuhës.

Kam edhe këtë porosi të ngutshme: kur kam qenë tek ti në vjeshtë të 82-it e kam parë se e ke librin e Dr Hivzi Islamit "Popullsia e Kosovës". Të lutem t'ma dërgosh se është një libër që na nevojitet shumë.

Kësaj radhe nuk po zgjatem më shumë. Po e lë për herën tjetër.

Shkruaj në këtë adresë: Björkhagsplan 9/403, 121 52 Johanneshov-Stockholm, Sweden.

Të fala S. (Xhafer Durmishi)

52. Letër e Xhafer Durmishit për Imer Berishën, 24 shkurt 1985

Shoku M. (Imer Berisha) 24 shkurt 1985

Revista e muajit shkurt u dorëzua në shtyp. Tjetër diçka të re nuk ka, përveç që jemi duke planifikuar një demonstratë në Malmö për katër vjetorin e demonstratave në Kosovë. Për këtë se si do të kemi sukses të marrim lejen do të duket pas dy ditësh.

Lidhur me rastin që e kam pas me Sabriun unë nuk po ndalem gjatë, pasi nuk kisha me të thënë diçka të re që ti nuk e di. Është fakt i pamohueshëm, që e ke të qartë edhe ti, ato fjalët në organ nuk janë shkaku i vërtetë i veprimit të tij në atë ditë. Por për shkaqet dhe të gjitha të ngjashmet kemi kohë, dhe unë do të jem aty kudo që të shtrohet nevoja me u ulë, por diskutimet të përcillen me shkrim. Lidhur me këtë rast unë nuk i kam shkruar askujt përveç H. në një letër të shkurt i tregova se diçka nuk është në rregull. Siç duket unë përfundimisht i kam shkëputë relacionet me atë person dhe nuk mund të punojmë së bashku.

Unë nuk e kam lexuar atë letër që ua ka dërguar ju, por fare shkurtimisht po ndalem vetëm në një pikë të problemit që mund ta marrë me mend nga biseda telefonike, se si e keni pasur në shqyrtim. Ju mund t'ju jetë dukur nuk po mund të merremi vesh për shkak se "duami të komandojmë njëri tjetrin", por këtë ua demanton vetë Sabriu, kur u thotë se gjoja unë nuk qenkam për luftë, për punë, se qenkam pendue që jam angazhue në politikë etj. "Me këtë duket e qartë se në aktin e tij (Xhafer Durmishit) nuk ka erë karriere".

Unë nuk po ndalem të numëroj asnjë shkak se çka e shtynë atë në veprim, por duhet ta keni të qartë se unë dhe ai kemi ndryshime rrënjësore në idetë politike që në fund të fundit janë aq larg me njëra tjetrën, sa janë edhe të papajtueshme. Unë këtë e kam ditur edhe më parë, por gjithashtu e di se në fazën e sotme të luftës nuk është e domosdoshme të qiten në shesh. Dhe unë nuk do të qitsha as tani, pra do të isha në gjendje t'i shtyj për të ardhmen, për një kohë të pacaktuar. Dalja në sipërfaqe e këtyre divergjencave mund t'ju duket e tepërt në këtë kohë. Kjo mund të jetë e tepërt për një apo disa shokë të bazës, por kur janë në pyetje dy veta që punojnë në një gazetë kjo gjë nganjëherë bëhet e pamundur.

Sa i përket atij mendimit tënd se a po luan dikush me ne, kjo është një pyetje aq e gjerë, për të cilën nevojitet aq kohë, sa është shumë e vështirë përgjigja në këtë. Unë jam i mendimit se përkundër të gjitha vështirësive, revista në mërgim ashtu siç është shtypur më parë duhet të vazhdoj me daljen e saj, ndërsa lufta për çdo ditë do të na qetë në situata të reja ndaj të cilave (sipas aftësive) do të merren qëndrime përkatëse.

Kishte qen mirë të na njoftosh se ç'ke mundur të marrësh vesh ndonjë të re, këto ditë nga Kosova gjatë kontakteve që kishe. Më trego gjithashtu se a e gjete letërnjoftimin tim francez, dhe nëse po, atëherë duhet të merremi vesh me letra që përmes ndonjë shoku të gjendet një njeri i cili të paraqitet në vendin tim dhe të bëjë shpërnguljen time, e për ku (a tek Ibushi a në një vend tjetër të tregoj pas disa ditësh). Pastaj, a erdhi një pasaportë nga Zvicra me mbiemrin "R". Atë pasaportë po që se ka ardhur ia jep S. R.

Gjithashtu po që se e ke aty librin "Materializmi dialektik dhe historik II", kishte me qenë mirë me ma dërguar. Pjesa I është tek unë.

Të fala Skënderi (Xhafer Durmishi)

53. Letër e Xhafer Durmishit për shokët në Gjermani e Zvicër, 22 mars 1985

Të dashur shokë në Gjermani e Zvicër, 22 mars 1985

Numrin 3 të revistës filluam ta përgatisim këtu. Këtë po e bëjmë në mënyrë që të mos humbim kohë në te, pasi ne këtej momentalisht nuk kemi mundësi materiale për të përballuar shpenzimet e rrugës, e gjithashtu mua do të më duhet të lajmërohem në organet e shtetit më 10 prill 1985. Kështu nisjen për andej e shikova më të drejtë ta bëjë pas 10 prillit, dhe shpresoj se do të kem mundësi të rri më shumë në qoftë se në ndërkohë nuk më prishë planin ndonjë thirrje e avokatit apo diçka e paparashikuar që do të më ndërprej qëndrimin atje poshtë para kohe. Gjithashtu për shkak të gjendjes materiale po mendojmë që këtë numër ta nxjerrim si numër të dyfishtë pra 3-4, i cili do të dal në 12 faqe A3. Numrin e ri do ta shumëzojmë në më pak ekzemplarë, si dhe të ardhshmit. Më së tepërmi njëmijë dhe t'ua shpërndajmë vetëm atyre që me të vërtetë janë të interesuar e një pjesë të vogël për ta shpërndarë për qëllime tona edhe aty ku nuk na paguhet në dukje të parë.

Tash ne iu kemi afruar këtij kufiri: Përpara kemi qenë të bërë merak se a mund ta botojmë një numër reviste në muaj apo më shpesh, se a do të kemi forca intelektuale për këtë, dhe në radhë të dytë a kemi mundësi financiare për këtë. Tani çështja shtrohet kështu: Forca për botim kemi, sidomos me bartjen e teknikës në Zvicër, ku besoj se do të kem mundësi të punoj më tepër, por si do të jemi të zotët me i përballua çështjet materiale. Edhe për këtë forca kemi, edhe njerëzit janë, adresat ua dimë por nuk kemi mund t'u shkruajmë dhe as të mbajmë takime të rregullta.

Gjithashtu do të ishte mirë që të na e dërgoni me shkrim (një propozim që do ta drejtonit në adresën e Shukri Demirit, me nënvizim për mua, ku do t'i numëronit arsyet e propozimit për vendosjen e teknikës së shtypit në Zvicër, ku do të potenconit faktin vendimtarë se atje janë mbledhur një grumbull i ri forcash, energjitë e të cilëve nuk po mund të futen në shërbim mirë. E kjo do të bëhej po t'i aktivizojmë në punën teknike të revistës.) Ky sipas meje është edhe shkaku themelor, që ne do të na krijonte më shumë mundësi të merremi me punë krijuese. Një propozim me shkrim do të ishte një çështje e mirë për këta shokët këtu.

Këtu po u shënoj një citat të letrës së Engelsit, dërguar Marksit më 19 nëntor 1844 ku në mes tjerash shkruan:

"...Jungu dhe shumë të tjerë nuk duan ta kuptojnë se midis nesh dhe Ruges ka divergjenca parimore, dhe vazhdojnë të mendojnë se këto janë vetëm zënka personale. Kur u thua se Rugeja nuk është fare komunist, ata prapë nuk e besojnë dhe mendojnë se është një veprim i nxituar që një "autoritet letrar" si Rugeja të flaket tutje. Ç'tu bësh? Na duhet të presim përderisa Rugeja të bëjë përsëri ndonjë budallallëk shumë të madh që të bëhet e qartë ad oculos (sheshit) gjithë këtyre njerëzve." (Marks-Engels, Letra të zgjedhura, faqe 11).

Besoj se kjo letër është e mirë për disa shokë tanët të ngushtë, kur janë në pyetje çështjet tona të brendshme, por që vlen edhe për të gjithë..

Përshëndetje revolucionare, Skënderi (Xhafer Durmishi)

54. Letër e Xhafer Durmishit për Remzi Ademin, korrik 1985

Shoku Remzi, korrik 1985

Është letra e parë që po ia shkruaj dikujt prej shokëve pas mbarimit të numrit të fundit të revistës. Ti disa herë më ke kritikuar për letra të shkurtra. Për mua edhe kjo letër do të jetë e shkurtë. Është letra që më me kënaqësi ia kam nisur dikujt. Më në fund unë

e kuptova të gjithë fillin e punëve që kanë shkuar në mërgim, duke u nisë prej vrasjes më 17 janar e gjer më tani. Unë e kuptova se të gjitha këto janë bërë në bazë të një rregulli të caktuar dhe në bazë të ligjeve të caktuara të cilat ne tani i mësuam, i zbuluam edhe për kushtet tona. Tani për ne më nuk ka kurrfarë krize. Po ta përsëris se jam jashtëzakonisht i lumtur për atë se e qartësova veten në të gjithë këtë amulli qe tri vite në mërgim.

Të them të drejtën gjithmonë e kam pasur një siguri në vete se nuk jam shtrembër dhe kurrë nuk jam udhëhequr prej qëllimeve të errëta. Por në anën tjetër para gjithë atyre intrigave, thashethemeve, fjalëve, pas gjithë asaj xhelozie pas daljes së "Zërit.." menjëherë pas vrasjes në Shtutgart, kur sa e sa vetave u është thënë: "Pse ishit në Shtutgart?! Çka keni me ta? Mos kini punë me ta! e kështu me radhë, më ka ardhë shumë keq, se thosha se këtyre njerëzve po u nxirren telashe edhe për shkak të një pjese të punës sime. Kam menduar se drejt e kemi, por forca, energjia e fuqishme argumentuese edhe për më kokëtrashët më ka munguar. Dhe tani kjo energji më në fund erdhi, dhe për shkak të kësaj energjie e qartësie që më erdhi në muajin e fundit jam shumë i kënaqur. Tani unë po e kuptoj se njeriu mundet me qenë çelik, që nuk mundet me e thye asgjë. Truni jonë u kthjellua dhe kjo do të jetë fitorja më e madhe, fitorja e të gjitha fitoreve. Pas trurit njeriut po i çliroheshin muskujt dhe gjithë trupi, dhe ndien një nevojë edhe për ushtrime fizike.

Tani unë po e kuptoj se me çfarë qëllimi m'u afruan Nuhiu e ndonjë si ai menjëherë pas vrasjes. Atëherë pas vrasjes ai e dinte në bazë të ditëve të mëparshme se unë mund të bëjë diçka. Probleme tjera pos pritjes së njerëzve nuk kishte. Qëllimi i tij ishte i ulët. Ai arsyetonte kështu: ky i penës unë i masës, ky i pari unë i dyti, ky drejtori unë shoferi e marrina tjera mikroborgjeze në këtë formë deri në pakufi. Unë nuk e pranova një shoqëri të tillë dhe ndarja u bë kur erdhi Osman Osmani. Kur erdhi Osmani atëherë i dyti e gjeti të parin, harrni e gjeti thesin.

Në krizën më të rëndë, në situatën më të vështirë ishe ti, që mendove bashkë me mua se ne shokët që do të mblidheshim rreth revistës me adresë në Suedi se ishim në rrugë të drejtë. Prandaj në disponimin e kënaqësinë time se tani po e ndiej veten çelik dhe të gjithë shokët do të çelikosemi, duke pasur pikëpamje të përafërta për thelbin e problemeve kryesore, si pjesëtarë i asaj klase që në fabrikë punon në tri ndërrime, por që edhe në ditët të njohjes te varrezat i kemi kryque bashkë fjalët në fjalimin e rastit mbi varre, këtë kënaqësi gëzim të madh deshta së pari ta ndaj me ty.

Tani për artikuj nuk do të kemi kurrfarë problemesh. Qysh tani mund të them se janë të bëra materialet e gatshme dhe po të duami ky numër mund të dal në 28 faqe të formatit A3. Ndërsa lexuesit duhet të mësohen se tani do të ndeshen vazhdimisht me artikuj të gjatë. Po të siguroj se do të kënaqemi duke luftuar në këtë terren që kemi ra. Tani më duket një fuqi të atillë argumentuese sa fjala jonë e vërtetë ka me ra mbi kokën e serbomëdhenjve dhe të të gjithë demagogëve më e fuqishme se njëqind plumba.
Në fund të fundit me këtë letër desha të ta bëjë me dije se tek unë ka ndodhur një ndryshim i madh sa i përket plotësimit të mënyrës së të të menduarit dhe pastrimit prej shumë mbeturinave mikroborgjeze.

Mund të më shkruash në adresën që e ke.

Të fala të përzemërta Skënderi (Xhafer Durmishi)

55. Letër e Xhafer Durmishit për Hysen Gërvallën, 22 korrik 1985

Përgjigje në letrën e Hysen Gërvallës 22 korrik 1985

Nga ti, Hysen Gërvalla e kemi marrë një letër të datës 12 korrik 1985. Ne e analizuam atë me kujdes, e lexuam disa herë, dhe këtu më poshtë po të japim përgjigjen tonë në letrën tuaj të datës së lartpërmendur.

Ne e dimë se jeni vëllau i dy vëllezërve që u vranë më 17 janar 1982 pranë Shtutgartit. Ky është një fakt shumë domethënës dhe i mirë për ne të gjithë, por për shkak të luftës sonë, karakterit të saj, fazave të zhvillimit të saj, vetëm kjo e dhënë nuk mjafton që ne të merremi vesh në të gjitha pikat. Prandaj prej teje kërkojmë:

1. Që të na tregosh për platformën tënde politike, pasi letra është shkruar në emrin personal, pasi ato nuk na janë të njohura plotësisht.

2. Të na tregosh se ne që na e ke dërguar këtë letër, si për kend na e ke dërguar? Sipas pikëpamjeve tuaja kush jemi ne në këtë rast para teje: A jemi grup, organizatë, dinasti, hordë, rreth familjar, bajraktarë, injorantë, grup i përkatësive primitive, komunistë, ballistë, liberal, fashistë, demokratë apo nuk po e dimë as vetë kush jemi e nuk po e shohim veten. Për këtë arsye ne kërkojmë ta dimë se çka jemi para teje. Çka din ti për programin e statutin tonë dhe si qëndron në raport me to? Çka mendon për gazetën tonë dhe kujt i shërben ajo?

3. Të na tregosh se kush janë dy grupet tjera, që ua ke dërguar letrën dhe që je optimist se do t'i bashkosh të gjithë në një vend? çfarë pikëpamjesh politike kanë, çfarë interesash mbrohen pas fjalëve dhe deklaratave të tyre nëpër gazeta? Cili është programi e statuti i tyre, pasi ne këto nuk i dimë?

Të gjitha këto pika të ndryshimeve, të gjitha pikat e përbashkëta duhet t'i ketë të qarta një njeri që donë të bashkoj dikend, duhet t'i ketë të qarta një grup i cili donë të bashkohet me një tjetër.

Në të gjitha këto pika duami paraprakisht të sqarohemi më shumë nga ti para se nga ana jonë, të japim ty personalisht çfarëdo mendimi të mëtejshëm në lidhur me(iniciativën) letrën tënde të hapur. Në vartësi nga ajo nga ajo se si do të na sqarosh në pikat që shënuam më lartë do të mvaret edhe qëndrimi e përgjigjja jonë në të ardhshmen.

22 korrik 1985 Stockholm (Xhafer Durmishi)

Letra nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin

Letrat nr. 1, 2, 12 e 20 nuk janë të Faridinit por i kam vendosur këtu, në vendin më të përshtatshëm në këtë përmbledhje. Letra nr. 22 është për Shaqir Shabanin, ndërsa të tjerat për Xh. D.

1. Letër e Shaqir Salihut për gratë e Vëllezërve Gërvalla, janar 1982
2. Shënim i Hafiz Gagicës për Faridin Tafallarin, 30 prill 1982
3. Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 28 tetor 1982
4. Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, nëntor 1982
5. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, nëntor 1982
6. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, nëntor 1982
7. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, nëntor 1982

8. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, 2 dhjetor 1982
9. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, 7 dhjetor 1982
10. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, 9 dhjetor 1982
11. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, ndonjë ditë pas
10 dhjetorit 1982
12. Letër e Mejdi Rexhës për Xhafer Durmishin, disa ditë pas 10 dhjetorit 1982
13. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, 14 dhjetor 1982
14. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, 20 dhjetor 1982
15. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, 5 janar 1983
16. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, 19 janar 1983
17. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, fillim i gushtit 1983
18. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, 10 qershor 1983
19. Letër e Faridin Tafallarit për Qendrën Ekzekutive, 6 shtator 1983
20. Letër e Xhavit Ramabajës për Faridin Tafallarin (dhjetor 1983)
21. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, fillim i janarit 1984
22. Letër e Faridin Tafallarit për Shaqir Shabanin

1. Letër e Shaqir Salihut për gratë e Vëllezërve Gërvalla, janar 1982

Të dashtuna motra e Vëllezër Gërvalla,

Na kanë tronditur lajmet mbi vrasjet e Jusufit dhe Bardhoshit. Ju lutem pranoni ngushëllimet tona më të sinqerta, bëhuni të forta e qëndroni edhe pse nuk është lehtë. Këtu në Amerikë kemi dëgjuar mbi ato ngjarje e gjindemi ashtu si ju të mërzitur për ato humbje aq të mëdha.

Emnin e kam Shaqir Salihu e jam prej Prishtine. As Jusufin as Bardhoshin e as shokun e tyre nga Zvicra që u vra me ta nuk i kam njoft. Unë e kam njoft dhe e kam dashtë shumë nji Idriz Gërvallën që është avokat diku në Kosovë. Tani 12 vjet që kam hik se dojshin me më burgos në Prishtinë më 1969.

Në Gazetën "Dielli" që del këtu n'Amerikë iu kam ba thirrje që të gjithë shqiptarët e Amerikës të japin kontributin e tyre me u ndihmue juve që tani keni mbetur vet. Atë fushatë po e bëjë Unë vet e nuk e di se sa pare kam me tubue por e dijë që kanë me dhanë. Ata do t'i nisin ke unë e Unë kur i tuboj të gjitha iu bëjë një çek në dollarë e iu nisi menjëherë. Por adresën e saktë të juajën nuk e kam. Këtë adresë e mora prej disa gazetave. Ju lutem nëse kjo letër iu bie në dorë ma shkruani adresën e Juaj menjëherë si dhe mbi shëndetin e fëmijëve e të Juajin dhe cila prej jush është me barrë dhe ndonjë fotografi të atyre që vdiqën për kombin tonë të varfur.

Ju lutem më shkruani se si Jeni dhe
Ju lutem qëndroni! Vuajtjet janë për ne shqiptarët. Durim.
Mbetshi me shëndet
Shaqir Salihu
nusja Ana dhe fëmijët
Iliri e Donika
Shkruani se nuk iu di adresën e sakët.
Qëndroni! Shaqir Salihu

2. Shënim i Hafiz Gagicës për Faridin Tafallarin, 30 prill 1982

Faredin, unë H. (Hafiz Gagica) isha këtu po ti ishe në punë. Far. nesër më 1 Maj na kanë thirrë gjermanët për festë në demonstratë. Takimi me gjermanët është ora 9.30 në mëngjes. E merr edhe megafonin me veti, dhe nëse don i merr edhe shokët, si ta pash

të arsyeshme. Vetëm me ju tregue më mirë është. Ne takohemi ora 9.30 para stacionit të trenit në Königstrasse. Mirë u pafshim nesër në Shtutgart.

Hafiz Gagica, ora 20.40, 30 prill 1982

3. Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, 28 tetor 1982

Shoku S. 28 tetor 1982 Nagold

Letrat dhe materialin i mora sot. Materialin e dërgova menjëherë nëpër vendet e caktuara. Ja edhe ty po ta dërgoj atë material që të premtova se do ta dërgoj. Letrën e lexova dhe e kuptova. U gëzova që je mirë dhe se shoku te i cili gjendesh shumë mirë po tregon.

Kasetat e videos, nëse i marrë do t'i dërgoj menjëherë dhe për material si t'i marr t'i dërgoj, por deri më sot nuk kam marrë. Prej Ukës (Xhafer Shatrit) asgjë dhe as që u lajmërue?

Në Austri shumë mirë kena kalua dhe shumë me interesim e kanë përcjellë programin-Filmat.

Mejdiu dhe Ismeti erdhën dhe ma morën përsëri dhe sot më lajmëruen se mbrëmë kishin pasur shumë (shikues të filmave - shën i Xh. D.) (Ata) e kanë në plan me dal kah Zvicra. Për ato të hollat, nesër do të bisedoj me Meh. (Mehdiun=Mejdi Rexhën nga Korisha) për (600 DM) dhe do t'i them për traka (shirita) të makinës. Do të interesohem për çdo gjë. Ti pe dinë se Tusha, shoqja e Bardhoshit, i ka dërgua letrat. Tani ka mbetur vetëm Suzana. Shif me ata bisedo e le t'i dërgojnë sa më parë. Haxhiu (Haxhi Berisha) më tha që ta marrësh në telefon, ka diçka me të pyet.

Në Bruksel do t'e dërgoj nesër kasetën por do t'ju them që të ma kthejnë e jo ta bëjnë për vete.

Merëm në telefon. Me të holla si je?

Të fala nga F. (Faridini)

4. Letër nga Faridin Tafallari për Xhafer Durmishin, nëntor 1982

Shoku S.

Të hollat për gurët i tubuam, 2500 DM. Por shumë me komplikime diçka edhe për me ju kthye. Tani ka mbetur që të paguhen edhe 800 DM firmës së gurëve. Po edhe kësaj do t'i përballojmë. Na ndihmuan edhe Meh. (Mejdi Rexha) dhe Ismeti (Ismet Klaiqi) kësaj radhe, edhe diçka kemi mbledhur për ndihma. Biseduam me avokatin që para 28 Nëntorit të vendosen (gurët në varret e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit-shën i Xh. D.)

Ne e mbajtëm një mbledhje lidhur me kremtimin e festës dhe për sallën e të ndryshme. Salla ku kemi qenë vjet, vitin e kaluar, ishte e zanun më 27 të 11. Dhe tani jemi ende pa gjetur sallë. Po ti përgatiti ftesat dhe unë së shpejti do ta dërgoj edhe adresën e vendit ku do ta gjejmë.

1. Shaqa (Shaqir Shabani) bisedoj me mua dhe më porositi me bisedua me ty dhe me e njoftue se ku do të mbetet me e festua Shaqa 28 Nëntorin. Nëse duhet të vjen këtu, atëherë sipas mundësisë tha që ta caktojmë me shkua në Vjenë.

2. Më bëri pyetje se a kam të drejtë me bërë ushtar (shokë) se si më njoftoj atje është shumë mirë duke shkuar puna. Unë i thash po bisedo me S. dhe S. të lajmërohet me letër. Pra nëse ke mundësi përgjigjiu në pyetjet që i ka shtrua.

Salla do të na duhet të jetë më e madhe, se si po shifet do të kena njerëz e mos të jetë tepër ngushtë. Ti a mendon me i ftue ata shokë atje dhe Ramitin.

I dhashë fund se po ngutem për në postë.

Të fala F. (Faridini)

5. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, nëntor 1982

Shoku S.

Uka më porositi që të lajmëroj sa më parë se "Komunikatën" e Ilirisë të Bel-Br. mos me e botuar, se Uka e kishte marrë një letër prej 8 faqe dhe se i kanë kritikua shumë ata njerëzit e Ilirisë.

Atë faqe të "Komunikatës" hiqe nga organi se Uka tha që duhet të bisedojmë me Kamerin (Sabri Novosellën), të konsultohem e çka po thotë Kameri.

Porosia e Ukës është që kësaj radhe të mos botohet "Komunikata" e Ilirisë.

Më pyeti se në sa faqe do të dalë dhe a është gati, dhe një artikull e kishte dërguar te unë javën e kaluar por unë nuk e kam marrë atë letër.

Po ta dërgoj këtë trakt të cilin e mora në Ingolshtat te Neziri, të cilin e kishin shpërnda në atë rreth. Se kush nuk po e dinë njeriun. Në letër nuk po e zgjasim por mirë është që të më marrësh në telefon.

Ditën e mirë. Të fala F. (Faridini)

Kësaj jave jam në ndërrim të parë. Kohë nuk pata dhe nuk kam që t'ju shkruaj atyre në Belgjikë dhe Muhar remit në Munchen. Po lajmëroju ti se jemi të zanun me gurët dhe nuk e di a do të marri fund ... brenda një jave.

6. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, nëntor 1982

Shoku S.

Dje dhe sot i mora letrat tua së bashku me adresat. Meh. (Mejdi Rexhës) nuk ia kam dhënë se nuk jam takuar por duhet që të takohemi dhe të bisedojmë për një sallë apo lokal për festën e 28.

Nuk do të ketë problem, pasi që çdo rreth po e feston veç e veç, do ta kemi më lehtë për të gjetur sallë. Por sidoqoftë duhet të vendoset se ku dhe për t'i informuar shokët pak më herët.

Si po shifet, sa për letrat e Suzanës do t'i vonojnë ose nuk do t'i dërgojnë hiq, por neve na duhet që këtë punë (detyrë) ta kryejmë qoftë edhe me të holla se përndryshe njerëzit do të na keqkuptojnë. Unë bisedova me Namiun dhe me Hafizin që ta bëjmë një kontratë me ata njerëz që po i kërkojnë këto, një afat deri më të parin 12 (1 dhjetor 1982). Nëse nuk na vijnë letrat atëherë do t'ja paguajmë kurse gurët (e varreve të Jusufit, Kadriut e Bardhoshit) të vendosen sa më shpejt.

Bisedova me Ukën (Xhafer Shatrin) javën e kaluar në telefon. Ishte shkua në spital dhe ishte bërë merak për ne, sidomos për ty që e kishe kërkuar në telef. e nuk kishte qenë aty. Por unë ja sqarova se jena mirë dhe të tjera. E informova dhe për të holla se na duhen për Z. e nr. 2 dhe të tjera. Uka tha se do t'i dërgojnë 2000 Franga. Ende s'i kam marrë.

Të shtunën dhe të dielën ishim në vizitë te do shokë në Zvicër dhe mirë kaluam. Kishte djem të mirë por duhet që ndokush t'i informon, të shkon pak më shpesh. Unë ia qova një letër dhe faqen 7 të materialit Shaqës dhe i thash që të merr kontakt me tezakun tim se aty afër Shaqës ishin, 30-40 km larg tij. Pak e njoftova edhe tezakun se do të vjen një shok dhe me atë i thash mos kij kurrfarë frike. ...

Rrotullat (shiritat e makinës së shkrimit-shën i Xh D) e kauçukut unë nuk po i dijë se cilat janë. As letra të holla nuk ka në kofer. E di se ka pas më përpara por sot gjithkah i kërkova dhe nuk i gjeta. ...

Të fala F. (Faridin Tafallari)

7. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, nëntor 1982

Shoku S.

Letrat me letra i mora dje sot ato që duheshin shpërnda i dërgova nëpër vendet e caktuara. Ti dërgova dy trakat (shiritat) e makinës dhe ja sot po t'i dërgoj edhe këto materiale që sot i mora. Kurse kasetat prej Munchenit si kam marrë. S. shih për letrat që duhet dërguar Suzana nga Shq. (Shqipëria). Mos t'i vonojnë se njerëzit janë tepër të interesuar se çka po bëhet me gurët (e varreve të Jusufit, Kadriut e Bardhoshit-shën i Xh. D.) dhe kësaj pune duhet t'i japim fund bile para kremtimit të Festës së 28 Nëntorit të jenë të vendosur.

Po më vetin njerëzit edhe për Festën se ku do ta festojmë dhe për këtë duhet me u angazhua se koha po afrohet e ta dimë që të mos vjen kah fundi e mandej të bëhet për së nguturi.

Një ditë erdhi Has. (Hasan Veselaj) dhe Sahi. (Sahit Tofaj) te unë. Morën Z. (Zërin) Nr. 1-2 dhe hynë pak rreth situatës së N. (Nuhi Sylejmanit) dhe Nexh. (Nexhatit=Osman Osmanit). Me çfarë qëllimi e patën nuk po e dijë, por për ata të dy nuk folën mirë, sidomos për Nexh. (Osman Osmanin). Për N. (Nuhiun) e kritikuan me ca fjalë të ndyta dhe thanë se i kanë thënë N. (Nuhiut) se ato fjalë që i kam dëgjuar te ata shokët, nëse janë të vërteta, po të isha unë si ti do të mbytesha. I bana pyetje për Nexhatin (Osman Osmanin) se a po takohen. Jo tha Nexh. tha u hup si me mos pa qenë kurrë edhe e tija tha s'po merret vesh..

Sahiti tha unë nuk po dijë se si po shkon kjo punë. Kur e bëra atë udhëtim me Nexhatin më thoshin se është shok i mirë, kurse tash po thonë i keq. Pse të mos më tregojnë më parë..

Po unë tha jam që të gjithë të bashkohemi e t'i lamë thashethemet.

Hasani tha se Nuhiu me të vërtet në kohët e fundit filloj të përhap fjalë të këqija kundrejt disa shokëve dhe tjera e tjera.

U interesuan se a po takohem unë dhe ti dhe ku gjendesh. I thash se nuk dijë, po lajmërohet ndonjëherë në telefon ju thash...

Më shkruaj për të gjitha

Të fala F. (Faridini)

8. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, 2 dhjetor 1982

Shoku S. 2 dhjetor 1982

Unë dje isha në Ludwigsburg dhe u takova me Hafizin dhe Haxhiun. Biseduam pak rreth 28 Nëntorit dhe të ndryshme. I mora edhe një mijë copë Zëra të Kosovës dhe kah u ktheva shkova tek Mejdi Rexha. Aty takova edhe Selim Kocën dhe biseduam rreth kësaj dasme që po afrohet, si po dihet ditë pune. Por nuk po e dijë si do të bëhet, a do të dalin apo jo. Për disa po e dijë por pak. (Mejdiut) ia dhashë edhe 80 ZK (Zëra të Kosovës) dhe thirrjet dhe i porosita që t'i lajmërojnë çdo njeriu ashtu edhe Selimi.

Për Abdurr. (Abdurrahman Sadikun) edhe unë isha i habitur por ai kishte qenë tek shtëpia në pushim...

Sa për punë, shumë punë jam kah i bëjë me Hafizin se të tjerët jo aq të gatshëm. Lajmëroju njëherë në telefon zotit E. (Engjëll Kolanecit) se ai më tha se do t'i qoj letrat e Suzanës dhe nuk po i qon. Ti e di se i kemi edhe 1500 DM për ZK me i pagua. Ismeti dhe Mejdiu e dinë se do t'ju kthehen të hollat.

Pasi Engjëlli më ka thënë se (letrat rreth çështjes së gurëve të varreve-shën i Xh. D.) se ne e kena borxh që kur të vinë letrat e Suzanës me ua kthye të hollat, se nuk janë

pak, për ne janë mjaft 2500 DM. Apo ta marrë unë e t'i them se nuk jena asish të rrugëve që të bëjnë si të donë ata.

Sot e mora kryetarin e Klubit "Emin Duraku" dhe i thash se do t'i bije thirrjet dhe ZK, për nesër të premten do t'ia qoj vet dhe do të kthehna menjëherë. Do të shkoj me tren se kështu më tha Uka. Dhe sigurisht shumë mirë do t'ju vjen...

Për në Turqi më trego sa copë me i dërgue dhe adresën. Thuaju se këtë e kërkon Mejdiu se kështu e bëmë dje. Për video u kuptuam. Në Troisdorf janë shpërnda kaseta dhe i shkruajta një letër Qazimit, si më the vet.

Për një klub apo dhomë jemi të interesuar për ta gjetë. Bile si të mundemi në Ludwigsburg me mirë. Kemi shpresa.

Murati në Bernhausen më tha që ta marrë videon dhe fëmijët e të shkoj të dielën e të bisedoj.

Të fala F. (Faridini)

Nëse e ke numrin e tel. ose adresën e Has. ma dërgo se nuk po e dijë.

9. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, 7 dhjetor 1982

Shoku S. 7 dhjetor 1982

Sot i mora letrat tuaja dhe i dërgova por pata pak vështirësi derisa e gjeta numrin e telefonit të S. Bytyçit dhe nuk jam i sigurt a është ky numër apo ndonjë tjetër. Por unë e shënova këtë numër: 21288802. Vetëm këtë e gjeta. Unë kalova shumë mirë në Dyseldorf. Biseduam me të dy Bacat, me Zymer Kryeziun dhe me B. Avdi (Abdyl Begishollin). Më pyetën për ty si je dhe të bënë të fala shumë. Dhe me Hyzriun (Hyzri Rekën) hymë lidhur me Nuhiun. Unë pak i njoftova se si ka qenë puna me sa mujta veçse edhe ata e kishin marrë në sy prej më përpara, ja kishin parë fytyrën e tij të shëmtuar. Mua më bëri pyetje edhe një tjetër por atina i tregova se është mirë dhe me familje mirë. Aty më kishte vërejt Baca Avdi dhe kur mbetëm unë dhe Baca me Hyzriun, më tha se ashtu duhet që të mos ta dinë të gjithë se çka ka ndodhë ose kush është Nuhiu, derisa ta shpallin të gjithë një zëri. Baca Avdi më pyeti për ty, tha a është me ju Skënderi apo me Nuhiun. Unë i thash me ne ka qenë dhe është dhe ne jena me ta.

Më porositën që të kena kontakte më shpesh dhe të bashkohemi që të mos na përçanë kush se këtu po flasin keq për ju..

Pra nëse ke ndonjëherë mundësi merre Hyzriun në tel. se e kishte në banesë dhe mua ma dha (numrin). Dhe nëse të pyet i thua se unë ta kam dhënë numrin. I thash Bacit Zymer dhe Bacit Avdi të dalin nga ne. Hyzriu dhe Baci Zymer kishin qenë në Bruksel për 28 Nëntorin dhe kishin kaluar shumë mirë. ...

Për leje me kalua për dasmë i tregova H. dhe ai e lajmëroi një ... (të afërm - shën i Xh. D.) të vetin dhe tha se do ta qon atë letër. Pra merre në telefon. Uka më tha thuaj Skënderit që e ka marrë letrën tënde.

Të fala F. (Faridini)

E kam shkrua shumë për së shpejti që mos ta vonoj.

10. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, 9 dhjetor 1982

Shoku S. 9 dhjetor 1982

Unë i lexova letrat tuaja dhe jam dakord me të gjitha. Për dasmë Uka tha që të vish mirë por pasi e ke të hanen me u lajmërue atëherë nuk po e shoh të arsyeshme që të udhëton me letër të huaj, se edhe nuk po përngjan në ty. Letrave ju bëra një fotokopje dhe i ndala kur të tjerat po t'i dërgoj së shpejti. Mbrëmë më muar në telefon E. (Engjëll

Kolaneci) dhe më tha se letrat t'i kam dërguar 2 herë dhe u janë kthye? I thash që t'i dërgon në emër të Besimit. Ndoshta thash do të vinë pra mirë ju pafshim.

Uka më tha se e kishte marrë letrën tënde me shumë fleta dhe tha jam dakord me pëlqimin e tij dhe sa më parë me u takue.

Të fala F.

11. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, ndonjë ditë pas 10 dhjetorit 1982

Shoku S.

Ramiti ishte edhe në dasmën (demonstratën e Gjenevës-10 dhjetor 1982) dhe ndejti nja dy ditë te unë.

Një letër ta kam postue së bashku me të Hafizit. A i more apo jo më shkruaj se ndoshta ka humb, se në atë letër i futa 20 DM e bën që i qelin për shkak të të hollave. Aty ka qenë një letër me më shumë fjalë. Sa i përket ZK (Zërit të Kosovës) edhe kësaj radhe e shpërndava unë, me anë të postës nëpër shumë vende në Turqi, Australi, në Gjermani, Argjentinë, po edhe Ahmetit (Ahmet Sadikut) e Besimit (Besim Rexhës) ua postova nga 20 copë. Në Australi (Shoqërisë Bajram Curri) 50 copë e kështu që më kanë mbetur edhe 30 copë dhe këto i lash për diku më me rëndësi. Për Zërin, me këtë numër shumë janë kah e lavdërojnë.

Për Shaqën, mbramë bisedova në tel. dhe e veta më konkret për atë material. Më tha se e kam përdorë nëpër shumë vende në biseda ku kam qenë nëpër shokë, kurse për 28 Nëntor tha se edhe ata që e kishin përgatitur ngjashëm me këtë me data e tjerë dhe nuk kishte pas nevojë ta lexon, kurse nëpër vende të ndryshme shumë kishte bisedua për përmbajtjen e tij. I thash që ta dërgon tek unë, tha ani dhe të bëri shumë të fala.

Shaqirit (Shaqir Shabanit) shkruaji se shumë bënë pyetje për ty sa herë që paraqitet në telefon. Edhe Meh. (Mejdi Rexhës) i shkruan po jo shumë dhe thuaj për ata çeka që të m'i jap mua. Këto ditë i ka vdekë një mixhë. Thuaj që për çdo rast le të paraqitet tek unë, dhe i thua se ti paraqitesh tek unë...

Të fala F. (Faridini)

12. Letër e Mejdi Rexhës për Xhafer Durmishin, disa ditë pas 10 dhjetorit 1982

Tungjat jeta shoku S.

S'pari po ju kërkoj falje që jua vonova përgjegjen, por më beso se s'e kam lan për nasgja, por kushtet kurbetqare s'po na lan asnjë punë ta kryejmë si duhet, po mendoj me kohë. Shoku S., ju falemnderit në ngushëllime, por do të mundohem të mahemi të fort pa tjetër, se e dimë që kështu e ka jeta.

Shoku S. unë deri diku u mundova që t'i kryej qato porosi që m'i kishe dhënë.

Sa i përket qëtyne të hollave që janë dërgu në konto të Kosovës, këto jam mundu, dhe deri diku i rregullova. Janë edhe 2 vende këtu në Sindelfingen të cilat janë kanë të autorizuar me i tubua të hollat, ku unë mendoj për së shpejti do t'i siguroj edhe ato e do t'i dërgoj ty, por me qata emna që Nuhia i ka tubua s'po di si t'ia bëjë. Më trego çka me ba.

Shoku S. ne të gjithë jemi mirë me shëndet, ashtu edhe me punë. Me thanë të vërtetën unë kam pas dëshirë të takohem dhe të bisedojmë kështu rrafsh për shumë gjëra se po kam frikë mos në të ardhmen do të na sjellin përsëri pasoja, pasi që edhe fjala popullore thotë se tesha qysh të vishet edhe shtirret. Për këtë arsye edhe është kanë më se e domosdoshme të bisedonim goja gojës, se ty të kujtohet qysh kur jeni kanë hala pa u prish me N. (Nuhiun), t'i kam pas thanë do fjalë të te, e tash zavendësi i tij sa i përket për

ne, disa na metodat e të përparshmit qysh në fillim po i përdor. Për këtë arsye pra është kanë ma mirë të ishim takua. Shoku S. nuk po e zgjati shumë se mos po bëhet e tepërt. Sa për të dhënat e Islamit dhe të Shabanit asht kanë më mirë t'i drejtohesh Ismetit pasi që ai i njeh më mirë. Pra më lejo t'i përcjell përshëndetjet më të sinqerta, dhe mirë u pafshim.

M. (Mejdi Rexha)

13. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, 14 dhjetor 1982

Shoku S. (Xhafer Durmishi) 14 dhjetor 1982

Po të informoj me disa gjëra ma konkrete. Organizimi i dasmës (demonstratës së 10 dhjetorit 1982 në Gjenevë-shën i Xh. D.) ka qenë në rregull edhe pse ishte ditë pune por mirë u tubuan me autobus. Ka qenë tridhjetë e dy pjesëmarrës. Kështu që gjatë udhëtimit mirë kena kaluar, edhe atje kur arritëm u mblodhën mjaft punëtor sa që s'kena pritë aq. U takova dhe me U. (Uka=Xhafer Shatri-shën i Xh. D.) qysh në fillim dhe më pyeti për ty. Unë i tregova se nuk ke pasur mundësi për shkak të letrës së udhëtimit dhe se ke pasur që të paraqitesh të hanen te avokati. Uka më tha u dashtë që të vije dhe për atë që duhet për bisedime se edhe e kishin siguru një vend për bisedime. Darsmën e filloi U. me pak dhe ashtu ka shkuar deri në mbarim. Shumë në rregull ka shkuar, dhe nga ana e Zvicrës janë shumë me sukses sa e pranuan. Pas demonstratës u kthyem në klub të Gjenevës dhe aty U. më muar në një dhomë dhe biseduam gjerësisht për Nuhi (Sylejmanin), bacën Ja (Jahir Jahirin), Has. (Hasan Veselin) dhe Sah. (Sahit Tofajn). Por Uka me plotë të drejt kishte që të thoshte se ne aspak mos të ngutemi dhe sa ma fort ta ruajmë gjakftohtësinë. Se si të kam shkruar edhe më parë se Hasan Veselaj dhe Sahit Tofaj janë munduar që të pengojnë organizimin tonë me autobus në shumë vende, mirëpo si më parë ashtu edhe kësaj radhe dhe në të ardhmen do t'ju dështoj. Unë si shumë herë që i kam informuar shokët edhe kësaj here (dhe herët tjera do t'i lajmëroj shokët) shkova te baca Jahir tri herë dhe në herën e mbramë, shkova dhe i thash se në sa ora po nisemi dhe i thash të bëhet gati në mëngjes pasi pat premtue se do të vjen me autobus. Më tha se unë nuk mund të vij se nuk po më lejon firma. Por kur pe shoh në Gjenevë para meje kishte mbërri me grupin e Nuhiut. Mua ajo aspak nuk më befasoi se atë edhe e pata mendua. Por edhe në darsëm janë mundua të bëjnë diçka po s'mujtën. Këto ia thash dhe Ukës, por U. thoshte që të mos ngutemi. Një natë para dasmës fola edhe me Hasan Veselin në telefon dhe me ca fjalë në fillim më të buta por më vonë dhe më të egra dhe ia thash atë që kërkonte. I thash se je përçarës i shoqërisë dhe asgjë tjetër dhe se nuk do t'ia arrin dot ... do të pengohesh nga ata vet të cilët mundohesh t'i gënjen. Mua më lypi një takim qysh atë natë në telefon dhe me këmbëngulje. Një gjë të pamundur. Ai mendonte se edhe unë do të pranoja një gjë të tillë, që kurdo që Hasan Veselit t'i tekej një mendim dhe ne menjëherë t'i marrim njerëzit të cilët janë të gatshëm për punë e jo për gjykim e thashetheme. Kur pash që ora (ishte) njëmbëdhjetë (23 i natës) atëherë edhe unë këmbëngulje i thash se jo dhe jo, pikë. Atëherë më kërkoi tjetër takim me tërë shoqërinë dhe me ata shokët e Vaiblingenit. Por edhe këtë e refuzova, e pash të paarsyeshme se aty kishin me qëllim që shoqërinë ta marrin nëpër gojë dhe të kenë e të bisedojnë me atë gojën e tyre të fëlliqur për asgjë tjetër vetëm të kenë të flasin ato që ne as që duhet me merremi... Ashtu edhe me një tubim të dielën që u takuam me shoqërinë tonë më të afërt i biseduam dhe mbeti që kjo të mos na brengos. Por nëse janë për punë le të urdhërojnë, e sa për fjalë jo. Se unë i thash Hasanit mos je kah flet në emër të kolegut tënd, dhe ai më bëri shumë pyetje se cili është kolegu im. Unë i thash Nuhiu. Mu përgjegj se s'e ka ai koleg por ne e kemi koleg, kurse në darsëm ai ka ardhur me te. Në darsëm më folën të dy Hasanat dhe Sahiti dhe unë ju fola. Sahiti më tha kemi dëshirë të bisedojmë me ty, se mos po të shtin dikush prej nesh që të mendon keq. Unë i thash se kurrë nuk mundet me më

shti dikushi që të flas keq për ju, por unë e fola atë që u deshtë dhe se jam i gatshëm t'ju përgjigjem kur do që të doni me mua ose me ndonjë tjetër, me tërë shoqërinë jo.

Uka pasi që bisedoj me mua, bisedoi edhe me Hafizin (Gagicën) e Haxh. (Haxhi Berishën), por me këta shumë pak dhe mandej ka biseduar dhe me Nuhiun. Mua Shaqa (Shaqir Shabani) më tregoi se ishte takuar me Nuhiun.

Pas takimit (të Ukës) me Nuhiun unë nuk e takova Ukën. Për ... takim U. nuk ma caktoi kohën as përafërsisht vetëm që tha duhet sa më shpejt. Ja kërkova atë që më porosite (artikujt) nëse janë të gatshëm por nuk m'i dhanë dhe më porositi që të mos paraqitesh aty ku nuk e ke rrethin më të ngushtë (për azil). Organi kësaj here do të ketë më tepër për shokët e ramë dhe më tha më 15 janar me qenë i gatshëm që atë ditë të shpërndahet.

Ne Shoqëria e Shtutgartit kena vendos që ta përgatisim një gjysmë drame e cila do të bëhet prej 5-6 personave. Kjo dramë do të ketë përmbajtje përafërsisht; një udbash, një kriminel, një spiun, i cili do ta luan rolin herë të udbashit herë të revolucionarit, dy revolucionarë dhe një plak që do t'i përkrah revolucionarët dhe një milic që nuk do të flet hiq. Kjo mendojmë për 15 janar të jetë e gatshme por është pika kryesore që a do të mundesh me e përgatitë tekstin brenda kësaj jave ose tjetrën se nuk dijë a do të munden Hafizi e Haxhiu ta përgatisin se nuk kishim kohë që të bisedojmë atë ditë të diell por ata garantuan që do të bëhet teksti po s'po e dijë ende se (a do ta bëjnë ata vetë) apo folën në emrin tënd?...

Për takimin me Hasanin dhe Sahitin do të takohem sipas porosisë... se me ta nuk e kena prish që të mos takohemi, por me takime të shëndosha e jo të ndërhyrjeve pa lidhje. Sa për një takim ndoshta hiq më larg se nesër. Do të shkoj te të dy dhe do t'i falenderoj për ato që më ke shkruar.

Për këtë dramë që ne kena mendua për nder të vëllezërve, për kujtim të njëvjetorit bisedo ndash dhe me U. e si ta shikoni të arsyeshme ashtu vendosne, vetëm duhet sa më shpejt që të kemi kohë për ta ushtruar.

Më lajmëro çka bëre, a u lajmërove?

Këtu po ta shënoj adresën e Hyz. (Hyzri Rekës) dhe tel., po ashtu edhe adresën e Hafizit.

Të fala F. (Faridin Tafallari)

Adresa e Hafizit: Sinan Gagica, Karlstrasse 11, 7140 Ludwigsburg
Adresa e Hyzriut: Hyzri Rekaj, Mintorpstrasse 27, 4 D-dorf
Tel në punë: 0211 224006; Tel në banesë: 0211 329739

14. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, 20 dhjetor 1982

Shoku S. 20 dhjetor 1982

Këto që po t'i dërgoj janë të marruna nga Neziri i Neuburgut. Mua m'i dha Hafizi, dhe ja tek po t'i dërgoj të cilat janë edhe të shënueme se prej kujt janë. Unë me Hasanin (Veselin) dhe me Sahitin (Tofajn) nuk jam takua. Një ditë u mundova që të takohem por nuk ishin të pajtimit Haxhiu dhe Hafizi dhe unë prita që po më lajmërohet Hasani por ai s'u lajmërua dhe kështu mbeti.

Unë i largova nga banesa të gjitha ato që ishin më me rëndësi dhe i kam shumë në vend të sigurt ku askush s'e di. Deri sa të kalon kjo situatë para vitit 1982. Të kesh kujdes edhe ti. Ti nuk më shkruajte se çka bëre për vete dhe U. (Uka) nuk u lajmrue. Unë e kam një numër që Uka ma dha në dasëm por nuk po e shoh që arsyeshme që unë ta marrë ne tel. para se ai të më merr, dhe unë s'kam çka t'i them.

Ne vendosëm që ta përgatisim një gjysmë dramë me afër 30 minuta. Me siguri tekstin do ta dërgon Hafizi. Më shkruaj diçka për përgatitjen e 15 janarit, për sallën që ta sigurojmë dhe a ta marrin atë të vitit të kaluar, ku e kremtuam 28 Nëntorin, që të mos bëhet vonë dhe të tjera.

Meh. (Mejdi Rexhës) i thash që të m'i dorëzon çeka, në (bazë) të porosisë tënde. Mejdiu i kishte dërgua edhe ato 600 DM në konto.

Haxhiu kishte mbërri mirë në Zvicër. Isa Demi po shkon te shpija më 23 dhjetor. Kishin ardhë nja 2 shokë te do shokë e i kishin thënë mos u ngut se do të bëhet diçka se ashtu po pritet dhe se kjo dasma e Gjenevës ka dhënë një jehonë të madhe në Kosovë, se ata janë ardhë para dy dite nga Kosova.

Sot i mora 10 libra nga Vjena të shokut E. H. me titull "Titistët" me 600 faqe. Këtu dhomën që e kena marrë po takohemi ... dhe po bisedojmë. Jena 10 anëtarë që po paguajmë nga 50 DM në muaj. Njëherë është kah shkon në rregull.

Të fala F.

15. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, 5 janar 1983

Shoku S. 5 janar 1983

Po të lajmërohem nga spitali. Në spital erdha se isha shumë keq prej barkut. Për herë të parë jam shtrua në këtë spital se kam dëgjuar shpesh fjalët e popullit kur thonë se as armikun mos e pasha këtu.

Tani jam mirë por si po shifet këta dojnë të më mbajnë më gjatë por unë do të lypi që më 14 janar 1983 të dal nga spitali. Sot po t'i dërgoj artikujt që i mora nga Uka, dhe po t'i dërgoj me postë të shpejtë. Sa i përket letrave që vinë nuk ka problem se pa humbje shoqja dhe unë po i dërgojmë menjëherë (në të vërtetë shoqes po ja jap).

S. për fotografinë e Hydajetit ndoshta është vonë me ta dërguar por ma mirë ti leja vendin dhe le ta merr Hafizi te Remziu dhe atë ditë që i qon atje e qon edhe ate. Për tjerat që duhet me ja dërgua U. nëse nuk është me shumë rëndësi le të mbeten kur të dal nga spitali se janë në tjetër vend. Thirrjet i shpërndava dhe shumë mirë ishin të shkruara.

Të fala F.

Sa për sallën është shumë e mirë dhe për leje nuk do të ketë problem. Edhe për gjërat tjera të gjitha në rregull.

16. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, 19 janar 1983

Shoku S. 19 janar 1983

Për bisedën që bëmë rreth Kp se me u çue pasi Abdyli nuk u ardhë, mundesh me e que edhe te R. se e para s'mund ta kupton se çka është dhe e kishte dhomën që nuk po i përzihej tjetër. Por ti bën si ta merr mendja. Unë të njoftova edhe për të hollat që i kena borxh. Se me të vërtetë janë shumë dhe duhet që t'i paguajmë patjetër dhe se nga rrethi ynë janë bërë tepër dhe s'keni kujt t'i drejtohemi, kurse borxhlit po i lypin të vetat, të cilat do t'i radhit këtu ma poshtë. Por në anën tjetër nuk duhet që të na skuq kjo punë, se duhet të dihet se këtu ka qenë puna më tepër dhe sidomos me të hollat. Këto të gjitha janë të shënuara dhe do të shënohen edhe më tej:

Ja po i shënoj të gjitha me radhë:

1500 DM Për numrin e ZK (Zërin e Kosovës) nr. 3

2000 DM Për numrin e ZK (Zërin e Kosovës) nr. 4

1000 DM Për gurët (e varreve të Jusufit, Kadriut e Bardhoshit) që janë mbetë borxh qysh nga viti 1981

500 DM Për pllakat që i kanë qitë rretheve (të gurëve) dhe për pastrimin që i pastrojnë gjatë vitit,

500 DM Për avokatin, vetëm kësaj herës së fundit që na ka ndihmua për gurët që i vumë,

1000 DM Për Mejdi (Rexhën) dhe Ismet (Klaiqin) që i dhanë për autorizimin e Suzanës. Por për këto unë si të thash nuk ju kam garantue që ju kthehen (shumë më mirë me ju kthye)

Këto i kena për t'i paguar. Dhe unë jam i mendimit që këto t'i paguajmë dhe mos të na mbeten që të na tubohen shumë e mandej s'po kena aq pare që t'i paguajmë të gjitha.

Të fala F.

S. Shiqo me Ukën, bisedo për këto që të shkruajta e t'i heqim e të marrin drejtimin të dimë se çka me bërë.

Sqarim:

ZK = Zëri i Kosovës, që ka kushtuar botimi.

Gurë - është fjala për gurin e varrit të Jusuf Gërvallës. Për Jusufin është paguar në veçanti, se si azilant qyteti nuk e ka ndihmuar.

17. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, fillim i gushtit 1983

Shoku S.

Mbrëmë bisedova me shokun Xh. (Xhafer Shatri) dhe më porositi që të premten me i njoftue shokët e Munchenit që edhe ata të tubojnë sa më shumë njerëz dhe të marrin pjesë na varrimin e atij kroatit (Stjepan Gjurekoviq-shën i Xh D.), Drejtor i INA-s. Dhe një shok prej tanëve me nja dy fjalë me i que ngushëllimet në emër të popullit shqiptar. ... Ky është një njeri që shkroi për demonstratat në Kosovë...

Të fala F.

Shoku S. edhe leximin tënd me e fotokopjue dhe me ua dërgue në Turqi shokëve. Kështu më tha Xhema (Xhafer Shatri).

18. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, 10 qershor 1983

Shoku S. 10 qershor 1983

Do të ishte mirë që në javën e ardhshme të dalësh nga ne, pasi që janë tri ditë pushim dhe ta shfrytëzojmë kohën që të dalim dikah nëpër punëtor. Sidomos në këtë situatë kur njerëz të tipave të ndryshëm apo t'i quajmë reaksionar që mundohen ditë e natë duke mos pushuar me propagandat e tyre të fëlliqura, kur neve na presin si shokë dhe vëllezër nëpër çdo vend dhe kanë dëshirë që të bisedojnë. Pra pse ne mos t'i vizitojmë që t'ja mbyllim rrugët armikut!

Ne para tri jave ishim në Ingolshtat dhe aty na pritën shumë mirë dhe para se të ndaheshim na porositën që sa më shpejt t'i vizitojmë edhe njëherë dhe na thanë sipas mundësisë nga mesi i këtij muajit. Dhe na u lutën që sipas mundësisë t'ju qojmë edhe ca këngëtarë me vegla muzikore që ata t'i informojnë shokët për një mbrëmje dhe do të kish shumë sukses. Nëse kishe mund me Xhavitin të bisedoje që ai t'i kishte marrë ata të rrethit të Bielefeldit dhe t'ja kishim kushtuar asaj shoqërie, pasi që janë të gatshëm për çdo gjë edhe pse pak larg, do t'ju kushtoj rruga por në anën tjetër do të bëhet shumë mirë. Pra shif në këtë drejtim dhe na lajmëro sa më parë. Për këtë të ka shkrue edhe Hafizi, por ja edhe unë.

Tjetra, disa shokë në Augsburg edhe ata kanë shpreh dëshirën për një vizitë dhe aty do të ishte mirë për t'i vizituar dhe së bashku do të shkonim në Ingolshtat. Unë isha javën e kaluar te Murati dhe ai më tha të shkojmë si të mujmë. Pra mendo në këtë drejtim më tepër. Mendoj që pikë e parë është që edhe këtu të rrish disa ditë nëpër shoqëri se është më se e nevojshme. Imerjahi i Dyseldorfit më muar në telefon dhe ai kërkoj që ne me shkua te ata për një vizitë pasi që edhe atje nuk janë mirë. Për ty i thash që njëherë është i zanun me punë, kurse për ne i thash të shohim me Remziun dhe Shabanin e një apo dy të tjerë me dalë, por vetëm në mënyrë shoqërore me bisedue dhe asgjë në emër të Lëvizjes. Edhe baca Zymer (Kryeziu) na ka thirrë për një vizitë si bashkëvendas para një kohe. Unë me Imerjahin kam biseduar për disa punë si arkatar i klubit dhe besoj se do të bëhet mirë. Pra më porositi që ti me e marrë në telefon. Numrin më tha se e ke, por qe ku po e shënoj: 0211784472.

Këtë të shtunë e kemi një takim me shokët, Mejdi (Rexha), Shaban (Bobaj), Hafiz (Gagica), Nami (Ramadani) dhe unë për ta lexuar Qarkoren e dërguar nga Redaksia e Zërit të Kosovës. Këtë takim do ta bëjmë tek Mejdi (Rexha).

Të fala F.

19. Letër e Faridin Tafallarit për Qendrën Ekzekutive, 6 shtator 1983

Shokëve të QE (Qendrës Ekzekutive)

Të dashur shokë,

Nuk po ndalem në atë që të kërkoj falje për mos shkruarjen e letrave, por unë në letrën e më parme të Xhemë ju përgjegja vetëm shokut Xh. me një letër të shkurt në disa pika të shkurta dhe ajo që shoku Xhemë i patë propozue unë isha plotësisht në pajtim në përgjithësi dhe ashtu mbetem. Më vonë mora dhe letrën nga shoku Il (Ilaz), një letër prej 9 faqesh dhe të cilën e lexova më ngadalë (se unë e kam si zakonisht që t'i lexoj nga dy apo tri herë por kësaj radhe vetëm njëherë se vërtetë ishte pak e gjatë dhe prandaj e lexova njëherë por ngadalë. Kurse unë nuk e mora makinën as në dy faqe, e kësaj çka me i thanë? Pra vet po i përgjigjem jo mirë e jo drejt dhe jo gatishmëri, por po e them atë të shokëve dhe ne duhet dhe duhet patjetër pak e jo aspak.

Me shokun Il (Ilaz-Ibrahim Kelmendi) kemi patur rastin që mbas ngjarjes së rënjeve të shokëve ku në ato qaste ishte nevoja që të tubojmë ndihma për familjet e shokëve (dhe tani) por nëpër disa rreth na premtonin shumë por me fjalë kurse me vepra hiç. Ashtu edhe sot në të tilla rrethe, kurse shokët aktiv që janë treguar si më parë ashtu edhe sot e kurdo që ka nevojë janë dhe do të jenë përherë që çdo gjë të ja falin atdheut. Por duhet ta kemi një gjë të kjart se çdo gjë që u kërkohet këtyre shokëve po ju bien e tërë ajo barrë, se shumë mirë e ka cekë shoku Xhemë, se edhe nuk po janë aspak të sigurt as për punë, por duke prit a sot a nesër po ja jep letrat.

ZK edhe kësaj radhe u shpërnda mirë dhe shumë mirë e kanë prit dhe ZK-së duhet të japim rëndësi që sa më fort të shpërndahet dhe nëpër disa rrethe ku shumë pak po shkon. Po sidomos çështjes së organizimit, ajo është më se e domosdoshme, është fjala për anëtar, formimi i celulave aty është e tërë puna. Celula duhet të ketë në çdo qendër, rrethe të ndryshme e në çdo skaj, te çdo njeri i ndershëm. Se ka shokë ku kanë dëshirë të janë të organizuar dhe nuk janë. Kjo është dëm i madh për ne, që të na mbeten shokët kur është i gatshëm për çdo gjë, se nëpër disa rrethe kam vërejt se po kanë dëshirë dhe nuk nëpër celula. Sot është kjo kohë ku edhe shumë punëtorë e kanë po se nuk kanë rrugë tjetër pos që të bashkohen, për këto duhet të ketë më fort shoku Salih ai që duhet të gjej shokët më të besuar nëpër vende të ndryshme dhe t'i organizojë.

I mora dhe letrat e fundit të shokëve Xh. dhe Il. dhe i lexova me vëmendje. Shoku Il. bënte fjalë rreth disa fjalëve që nuk kanë skaj të sosen, thash e themet me të vërtetë janë të shumta por as që kanë për t'u zhduk ndonjëherë, por neve shumë pak duhet të na hynë në punë apo aspak. Këtu në rrethin e Shtutgartit ka pasur dhe do të ketë, por neve na mbetet për detyrë që me punë të përditshme t'i mundim. Ja kisha me hy vetëm pak në të kaluarën, të sotmen e të ardhshmen. Këtu te na e kena pasë dhe e kena Nuhiun, i cili nuk ka menduar gjë tjetër pos ka vepruar që me thash e theme do t'ia arrin qëllimit tij të poshtër. Ky farë Nuhiu dhe tipa të tillë të një brumi të mykur janë munduar që mbas ngjarjes (17 janarit 1982-shën i Xh D) të fusin një përçarje deri në palcë vetëm e vetëm për t'i përça që më vonë t'i plotëson detyrat e tija aq të poshtra sa që dy shokë mos të mbeten bashkë dhe vet të luaj si të donë. Por të gjitha i shkuan huq. Më kujtohen poshtërsinat e tij gjatë qëndrimit të tij në banesën e Vëllezërve Gërvalla ku mundohej të qes fjalë që as në letër nuk mund të shkruhen... duke menduar mendja e tij e prishur nga idiotizmi që mendonte se ka të bëjë me njerëz të rinj dhe se çfarëdo të thoshte do të besohej, sa aq shkoj, sa që edhe shoqes vet të jetës t'i qes fjalë që atë s'mund ta bëj as një ... Po do t'i vjen dita e do t'i thuhen të gjitha para syve të tij. Dhe sot shkon me shokun e vet R. Salihin që fort mirë e ka ditë se çfarë "shoku" i Sokolit (Jusuf Gërvallës) ka qenë ai R, dhe sot me gazetën Punëtorët del si hije e zezë dhe thotë se ata me ZK e kanë lanë rrugën e shokëve dhe janë lidhë me ballistët, kurse tjetër kund thotë se gazeta Punëtorët është shtylla e Lëvizjes. Por tani ka mbetur vetëm me disa njerëz të kafeneve që deri (para) disa ditësh thoshte vet se këta nuk bëjnë, kurse tani i ka shokë më të afërt. Por po e lëmë edhe këtë e po kaloj në vizitë që ishim në D-dorf. Aty kaluam mirë pos fjalimit të (Milaim Zekës) Ganiut, neve kësaj radhe na kanë nderuar shumë dhe në përgjithësi ka qenë shumë e suksesshme. Patëm takime me shumë shokë si me bacat, të dytë ashtu edhe me kryetarin e klubit dhe me I. Po sidomos edhe me Muhametin dhe kështu që përgjithësisht ka shkuar shumë mirë dhe besoj se në të ardhmen do të bëhet edhe më mirë. Të gjithë shokët tregonin gatishmërinë e tyre për çdo gjë që do të ketë nevojë.

Unë bisedova me bacin Zymer dhe e veta se si kishte kaluar në pushim (në Shqipëri-shën i Xh D); më tha shumë mirë, më tha dhe për Dritën (Suzana Gërvallën-shën i Xh D) dhe tërë familjen e Sokolit se ishin mirë dhe përgjithësisht mirë më tregoi. Edhe për një fjalë që e kishte dëgjuar por mua si më tregoi Baci Zymer (Zymer Kryeziu), se Syla i Dyseldorfit që ka qenë në pushim në Shqipëri dhe e kishte vet shoqen e Sokolit e i kishte thënë se ti ke qitë fjalë se Ibrahimi paska gisht në vrasjen e Jusufit, por këtë si më informoj mu gjoja se Drita vet nuk e kishte thanë, por këtë e kishte thënë Syla i Dyseldorfit? Unë ndëgjova vetëm kaq dhe kështu por kisha me thënë se fjalët nuk ndalen. Sa për një letër unë ia kam dërguar Dritës por ende nuk kisha dëgjuar për këtë fjalë por me fjalët e shokut Jahir që ishte vitin e kaluar dhe ashtu ja shkruajta që njerëzit që po vijnë në pushim, mos të bisedon me çdonjërin se mërgimtarët po i keqpërdorin fjalët, jo që po don ashtu por tani edhe janë mërzit dhe kështu po dalin fjalët.

Sa për organin ja kishte que baci Zymer dhe fort e kishte pëlqyer Drita, kurse gazetën Punëtorët, njëri i Münchenit e kishte marrë me vete dhe e kishte shpërnda nëpër kosovar. Atje këtë po i njihshin si njeri të udbes.

Shoku Iljaz po të pyeti për organin kësaj radhe, a e kanë dërguar prej Zvicre dhe a e kanë dërguar në disa vende. Ndoshta s'u dashtë por nuk e kanë ditë se mua në herën e fundit më ke shkrua që vetëm në një adresë me t'i dërgua, por në të ardhmen përsëri na lajmëro që ta dimë. Kësaj here ia dërgova edhe Naimit 10 numra se m'i kërkoj në telefon. Në të ardhmen edhe për këtë na shkruaj nëse e ke afër, mos t'ja postojmë se edhe posta po kushton. Për kasetat që të kam shkrue na i kena tjerat vetëm atë të paradës së ushtrisë nuk e kena, por si të mujsh na e dërgo. Përndryshe do ta gjejmë edhe këtu po ma vonë.

Pranoni përshëndetja vëllazërore F. 6 shtator 1983 Mërgimë,

20. Letër e Xhavit Ramabajës për Faridin Tafallarin (dhjetor 1983)

Shoku Faredin,

Që në fillim të kësaj letre të kërkoj falje që nuk munda të vijë në Shtutgart që të marrë pjesë në tubimin e caktuar (të Bashkësisë së Klubeve-shën i Xh D), por për mungesë do e njohtojë shokun Skendë më gjerësisht.

Tani shoku Faredin të njohtoj se unë sot po me këtë letër lëshova në postë edhe 2470 marka të tubuara nga disa shokë. Këto i adresova në adresën tënde. Para disa ditësh më thanë edhe tre shokë se kanë dërguar të holla po për këtë qëllim, vetëm se i paskan adresuar në Lëvizje. Këta të tre paskan dërguar njëri 130 DM, 150 dhe 250 DM. Nëse i llogaritim me këto që i dërgova unë sot, del një shumë prej 2970 DM.

Shoku Faredin,

Tani të shkruaj krejt për një tjetër temë dhe pikërisht rreth disa fjalëve të cilat i dëgjova në Shtutgart kur ishim në manifestimin e ditës së pavarësisë.

Unë Xhaviti, dola në bife të ulem me një shok nga Hamburgu për të biseduar disa gjëra. Pak më vonë erdhi edhe një shok i panjohur dhe m'u drejtua dhe më tha: A je ti Xhaviti? Po i thash! A vazhdoi duke më thënë se kishe paskëm shitur Zërin e Kosovës dhe parat i paskam mbajtur për veti! Më erdhi shumë keq që më thoshte kështu. Unë desha të bisedoj me te, por nuk premtonte koha sepse ishte shumë vonë dhe duhej të udhëtonim. Vërejta se ishte i dehur nga alkoholi vetëm se këtë akuzë nuk ma tha rastësisht. Këtë me siguri e kishte dëgjuar dikund andej. Më intereson shoku Faredin mos din edhe ti për fjalë të tilla. Pas disa minutash diskutimi me këtë person ai më tha se quhet Tafallari. Mendova mos është i afërm me ty dhe kështu mund të dish edhe më mirë se qe shtyni të flas kështu.

Me nderime shoqërore – Xhaviti (Xhavit Ramabaja)

21. Letër e Faridin Tafallarit për Xhafer Durmishin, fillim i janarit 1984

Shoku S.

Pasi ti po priton me shkrue po të shkruaj unë. Do të ishte shumë mirë që të jesh për këtë takim të BKSHM (Bashkësisë së Klubeve Shqiptare në Mërgim), se është me rëndësi dhe do të bëhej një punë e mirë. Unë e quaj më me rëndësi këtë takim se duhet të pritet prej klubeve shumë punë. Prandaj nëse ke mundësi eja dhe bisedojmë. Përndryshe përgatit ndonjë farë plani të punës që të mos kaloj koha vetëm me thash e thëna.

Kam shumë për të shkruar por e mallkoj kohën që nuk kam dhe po lodhem me punë, se nuk jam po them dembel si ti. Prej teje pritet shumë punë e jo fjalë apo serigji si thonë kah ne, dhe jo vetëm me u marrë me një klub apo një rreth, po me shumë e shumë punë të tjera. Po bisedojmë kur të ulemi në tavolinë.

Të fala F.

Për ato që i kam shkrua në letër unë i kam shkrua dhe ju qëndroj deri në fund, aspak nuk kam gabue dhe kam mendue kur i kam shkrue.

22. Letër e Faridin Tafallarit për Shaqir Shabanin

I dashur shok Shaqë,

u informuar se je i interesuar seriozisht për hapjen e një klubi në Nyon. Për këtë u konsultuam me disa shokë të Bashkësisë së Klubeve dhe pasi që i analizuam kushtet e atjeshme dhe situatën e përgjithshme ndër mërgimtarë erdhëm në përfundim se një hap i tillë në këto kushte do të ishte më tepër i dëmshëm se sa i dobishëm.

Prej shokëve të atij rrethi pritet me të drejtë që të kontribuojnë në rritjen e numrit të klubeve ekzistuese të Gjenevës dhe Llozanës, në forcimin e tyre dhe në zhvillimin e një aktiviteti të mirëfilltë revolucionar. Atje duhet të bëhet punë më e madhe, sepse ka mundësi. Prandaj kujdesuni që edhe ju të jepni kontributin tuaj.

Po që se ke ndonjë porosi apo sygjerim se si duhet të shkojnë punët andej, do të ishte mirë të shkruani detalisht dhe ne nga ana jonë do të japim kontributin tonë.

Bashkësia e Klubeve Shqiptare në Mërgim (BKSHM)
Faridin Tafallari, Postfach 2, 7271 Rohrdorf, BRD

Letra nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin

Mars 1982 - Mars 1984

Letra nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin

1.Komitetit të Degës së LRSHJ "Vëllezërit Gërvalla"
2.Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin e Osman Osmanin, maj 1982
3. KRYESISË SË KD TË LRSHJ PËR BOTËN E JASHTME, 14 qershor 1982
4. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 12 korrik 1982
5.Letër nga Sabri Novosella e Hasan Rrahmani për Xhafer Durmishin, vjeshtë 1982
6. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 9 tetor 1982
7.Letër nga Sabri Novosella për Nuhi Sylejmanin, 9 tetor 1982
8. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin ,15 tetor 1982
9. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 4 nëntor 1982
10. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 12 nëntor 1982
11. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 24 nëntor 1982
12. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 7 dhjetor 1982
13. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 23 dhjetor 1982
14.Letër nga Sabri Novosella e Sheremet Saraçi për Xhafer Durmishin, dhjetor 1983
15. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 10 janar 1983
16. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 4 mars 1983
17.Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 30 mars 1983
18. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 15 gusht 1983
19. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, vjeshtë 1983
20.Letër nga Sabri Novosella për Faridin Tafallarin, 10 tetor 1983
21.Letër nga Sabri Novosella për Faridin Tafallarin, 25 dhjetor 1983
22.Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 16 janarit 1984
23.Letër nga Sabri Novosella për Komitetin Qendror të LRSHJ në Botën e Jashtme, 6 mars 1984
24.Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 23 mars 1984
25.Sabri Novosella – Si e themeluam LRSHJ, mars 1992

Në këtë kapitull letrat me numrin rendor 15 dhe 17 i janë dërguar Faridin Tafallarit.

1. Komitetit të Degës së LRSHJ "Vëllezërit Gërvalla"

Vëllezër të dashur

Letrën e juaj e muarëm dhe u njohtuam se e paskët riorganizuar Komitetin e Degës dhe e paskët zgjedhë udhëheqësinë e re. Shumë mirë paskët bërë. E shfrytëzojmë dhe me anën e kësaj letre u urojmë sukses të plotë në luftën e mëtejshme që po zhvillohet me plotë sukses si në Kosovën tonë shumë të vuajtur, si në mbarë botën ku gjinden shqiptarët e mërguar, dhe njëkohësisht dëshirojmë që punën që e lanë Herojtë të cilët ranë në ballë të detyrës, do ta vazhdoni me plot sukses duke i pasur udhëzimet e Tyre dhe duke u mbështetur në shembullin e tyre.

Punën që e keni bërë rreth shokut Xh. (Xhafer Shatri-shën i Xh. D.) për ta nxjerrë nga kampi i Romës keni bërë shumë mirë, pa marrë parasysh se atë nuk e keni gjetur në Romë.

Dalja e shokut Xh. (Xhafer Shatri-shën im) e shkuarja tek shokët që para shumë vitesh i ka organizuar vet është bërë shumë mirë, bile më mirë se sa të kishte ardhë tek ju, pasi në atë organizatë motër Xh. gëzon besim shumë të madh, kurse nga ana tjetër me një shok që e kemi këtu ka afërsi shumë të madhe qysh nga koha e vuajtjes së dënimeve në kazamatet jugosllave para 13 viteve. Përveç kësaj ekziston edhe një histori tjetër që i lidhë këta dy shokë për lirinë e popullit tonë. Pasi edhe deri më tani është punuar në bashkimin e organizatave tona, nga ana tjetër nuk ekzistojnë kurrfarë divergjencash parimore, mund të themi se çështja e bashkimit mund të merret si punë e kryer.

U njoftuam që Organin e pasket dorëzuar në shtyp, mirë qenka bërë. Në shtojcën që e pasket vendosur ta botoni Komunikatën mirë është edhe kjo.

Agroni që i paska shprehur dofar "dyshimesh" është dashur t'i përgjigjeni prerë. Skënderin e njofin ata që e kanë dërguar të punoj pranë Sokolit e nuk ka nevojë të japi vlerësime për kuadrat e Lëvizjes. Nga ana tjetër edhe Skënderi ka gabuar që i është përgjigjur në pyetjet e tij, pasi edhe në mërgim duhet të mbretëroj konspiracioni i thellë.

Kushtrimi dhe Qemajli kanë vendosur me ardhë në Evropë. Janë të mendimit që të vendosen në Austri, por, mua vend jo i përshtatshëm për shumë arsye. Mendimi im është që të vendosen në Zvicër, bashkë me shokun tonë që vepron atje dhe me të ta formojnë Komitetin e Degës së LRSSHJ. Fjalën e kam, me anëtarin e deritashëm të Lëvizjes. Për këtë duhet të na përgjigjeni sa më shpejt.

Të fala vëllazërore e revolucionare

Komiteti i Degës së LRSHJ "Hasan Prishtina"

KOSOVA-REPUBLIKË

2.Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin dhe Osman Osmanin, (pas 15 majit - e para 15 qershorit 1982)

Skender - Halim

Sot e mora një letër prej Ukës (Xhafer Shatrit-shën i Xh.D.). Bashkë me te e mora edhe komunikatën ku në pikën dy të saj shifet se është bërë tradhti ndaj vendimeve të 17 shkurtit 1982. Pasi që komunikatën e atyre vendimeve e kemi në dorë, një kopje të së cilës e keni marrë ju me vedi të shkruar me dorë nga Halimi kurse kopja e origjinalit të shtypur me makinë nga plaku (Bujar Hoxha-shën i Xh.D.) gjindet te ai.

Kjo tradhti ndaj atyre vendimeve pasi e lexova komunikatën mendova se është bërë nga ana e Ukës dhe shokëve të tij. Por Uka shpjegon se ndryshim ka bërë në shprehjen nga organizatë K. në Parti K. kurse thotë "por një çështje është e qartë" fjalën e ka te ky emër pasi që edhe se e bën ndryshimin nga organizatë K. në P.K. ai shpreh mospëlqimin dhe jep propozim konkret "ma merr mendja se për shumë shkaqe duhet ta formojmë me P.

Populllore Shqiptare në J. (Jugosllavi-shën i Xh.D.). Prandaj konsultohuni e na njofton sa më parë".

Kjo tregon se Tradhtia e vendimeve të 17 shkurtit nuk është bërë nga Ai por ju ja keni dërguar komunikatën e ndryshuar ku i keni shkelë vendimet e aprovuara edhe nga ju. Çdo shkelje e atyre vendimeve sidomos nga ne që i kemi pruar dhe i kemi nënshkruar është tradhti që sjell pasoja të rënda.

Nga një anë nga dikush ngulet këmbë dhe bëhen manovrime që gjithsesi të shpallet se jemi duke luftuar për Komunizëm e nga ana tjetër Lek Zogu për çka kemi informata të sigurta, i drejtohet qeverive të botës që të mos u apin azil kosovarëve pasi lufta e tyre është kah bëhet për K. të E. H. Këtë e bën me kërkesë të Beogradit me të cilët mban lidhje direkte.

K. H. (Sabri Novosella) (Letër për Xhafer Durmishin e Osman Osmanin -pas 15 majit dhe para 15 qershorit 1982)

3. KRYESISË SË KD TË LRSHJ PËR BOTËN E JASHTME

PROPOZIM

Ky propozim i bërë nga Kamberi, i përkrahur nga Kushtrimi dhe Qemajli i dërgohet Kryesisë gjegjësisht KD për shqyrtim.

1. Propozohet që të gjitha propozimet dhe mendimet mbi propozimet e të nëntë anëtarëve të KD të LRSHJ (për Botën e Jashtme) të ipen me shkrim dhe kryesia në bazë të shumicës përkrahëse të mendimeve bien mendimin përfundimtar.

Duke pasë parasysh se vetëm Kryesia njifet mes veti (kjo duhet te vlejë edhe për ata që njifen në mes veti) Kryesia të merr përgjegjësi gjegjësisht ndërmjet të çdo anëtari të kryesisë të zhvillohet komunikimi me anëtarët tjerë të KD të LRSHJ, kur është fjala për propozimet dhe mendimet mbi to, respektivisht çdo propozim të dërgohet në kryesi si edhe propozime nga anëtarët e kryesisë të shumëzohet në 8 kopje dhe t'u dërgohet anëtarëve të KD të cilët japin përgjigjen – mendimin e tyre personal mbi propozimin, me shkrim dhe e dërgojnë në kryesi.

Pas arritjes të të gjitha (8) përgjegjeve-mendimeve me shkrim në lidhje me propozimin, propozimi aprovohet; nuk aprovohet ose aprovohet me ndryshime të caktuara në bazë të shumicës.

Të ndalohet shqyrtimi gjegjësisht prurja e vendimeve të ndonjë grupi jo formal nga ana e anëtarëve të KD.

2. Kryesia të marrë obligim mbi vete informimin e shpejt dhe racional të të gjithë anëtarëve të KD për informatat që vinë nga të gjitha drejtimet, dhe t'u bëhet me dije të gjithë anëtarëve të KD që çdo informatë te e cila vinë të njëjtat t'i përcjellin në kryesi dhe nga aty të njëjtat të dërgohen tek anëtarët tjerë të KD.

Të deleguarit në kryesi mbajnë komunikimin me bazën e cila i ka deleguar.

14 qershor 1982, Kryetarët e KD të LRSHJ (PBJ=për Botën e Jashtme)
Kamberi (Sabri Novosella)
Kushtrimi (Abdullah Prapashtica)
Qemajli (Faton Topalli)

P.S. Propozimi nën pikën dy është bërë nga ana e Kushtrimit dhe është aprovuar nga Kamberi dhe Qemajli.

4. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 12 korrik 1982

I dashur Vëlla, 12 korrik 1982

Letrën tënde dërguar në adresën e fundit e mora. Edhe të tjerat do t'i marrë nesër pasi ende nuk mujta me shkua e me i marrë.

Bukur fort u mërzita për mos nxjerrjen e Hydajetit para gjyqit me shokë. Kjo bënë me kuptuar se, ose është i vdekur, ose është i shkatërruar në çdo pikëpamje.

Më së tepërmi po më mërzitin gabimet krejt të panevojshme. Të ngritet njeriu kryesor i një organizate dhe të hyj në mes të zjarrit pa pasur kurrfarë nevoje, është naivitet i madh. Kjo është mosnjohje e matematikës politike. Shumë lehtë ke mujtë me qenë edhe ti atje.

Rasti i Halimit po më brengos bukur fort, nuk po mundem me i kuptua këta njerëz. Nga një anë shokët që i kanë organizuar në mënyrë të çoroditur të gjithë i kanë në burg e nga ana tjetër bëjnë aso propozimesh, thua se e tërë Kosova është në duar të tyre. Tani lideri na ka dalë me një propozim të ri: Të shpallet formimi i Republikës së Kosovës. Që të mos zgjatem më tepër, kam krijuar bindjen se, ky njeri është i krisur, sidomos pas propozimit të tij që të bashkohet Lëvizja me L. K. të Kosovës (LK=Lidhjen Komuniste-shën i Xh. D,) dhe propozimit të fundit që e ceka më lart.

Pa marrë parasysh të gjitha, duhet të jemi të matur, të bëjmë çmos që t'i largojmë nga paqartësirat e tyre e t'i kthejmë në rrugë që të bëhen sado pak të dobishëm për çështje. Nga ana tjetër, edhe me qenë të këqij s'kanë çka nga bëjnë, pasi për njerëzit tonë në Kosovë nuk dinë as imtësinë më të vogël, kurse për shokët përjashta, s'kanë çka të bëjnë. Fjalën e kam jo nga tradhtia por nga magarllëqet e tyre. Gjithsesi ruaje gjakftohtësinë, sillu sa më mirë me ta. Kam bindjen se sidomos i vogli mundet me u bërë kuadër i mirë. Edhe se ju kanë burgosur shokët kryesor, prapë se prapë ndonjë bisht ju ka mbetur e ata bishta munden një ditë të bëhen degë.

Besoj se të ka ardhur një letër me disa adresa nga e cila shifet se unë mbaj lidhje bukur të forta me Valon Kosovën i cili është njëri nga kryesorët të revistës së re "Iliria". Ai për mua nuk din asgjë, bile as emrin tim. Ai më ka njohur si Omer me disa fjalë të mira mbrapa e asgjë më tepër. Nga një shok unë e njoh në hollësi. Tani më nuk ka si të bëhet i keq, pasi atë e presin vetëm plumbat nga Jug. e asgjë tjetër. Përndryshe e ka një rreth bukur të mirë. Jam duke u angazhuar që ta krijojmë një Degë të L. në Belgjikë.

Para sa kohës Uka më ka propozuar, që kur të piqen kushtet, ta nxjerrim një revistë letrare me titull "Iliria". Këtë propozim ia përcolla Valonit.

(Sabri Novosella)

5.Letër nga Sabri Novosella e Hasan Rrahmani për Xhafer Durmishin, vjeshtë 1982

I dashur vëlla Shpend, (vjeshtë 1982)

Letrën tënde me propozime e mora dhe do ta shqyrtojmë me shokë. Propozimet e juaja janë shumë të qëlluara, por frigohem se mos po i rëndojmë shumë anëtarët e Lëvizjes. Së dyti çështja e investimit që të sjellë fitime të mëdha nuk është aq e lehtë.

Këtë çështje duhet ta shqyrtojmë mirë me të gjithë. Shokët e juaj si ashtu edhe Uka duhet ta shqyrtojnë me shokët e vet. Unë këndej. Sa u përket shokëve në Atdhe, ata me siguri nuk do të ken vërejtje. Në këtë drejtim pa u shqyrtuar puna mirë e mirë nuk guxojmë të ngutemi.

Shaqir Salihun, sa më duket kështu e ka mbiemrin e njof që nga viti 1968. Kam biseduar disa herë me te, pasiq ai u shoqërojke me I. (Idriz) Gërvallën. I.G. ka pasur mendime të mira për te. Në atë kohë pas demonstratave të 68 (jo për demonstrata por për

çështje propagande) ka qenë dënuar dy vite burg. Atëherë ishe aso atmosfere që ata që nuk dënoheshin mbi dy vjet të liroheshin deri në vendimin e shkallës së dytë.

Shaqiri pasi u lirua që të mbrohet në liri, iku dhe prandaj kam dëgjuar se ka qenë në kampet e Italisë. Ashtu si më parë, në letrat e tij që m'i dërgove edhe në këtë letër shifet gatishmëria e tij që të kontribuoj për çështje. Ai me na dëmtuar nuk mundet asgjë pasi që nuk do të dekonspirohemi para tij. Ai mundet vetëm me i kontribua çështjes.

E pash të arsyeshme t'ia shkruaj këtë letër të cilën e adreson dhe ia dërgoni bashkë me të gjithë numrat e Zërit që nuk ja ke dërguar deri më tash. Mu duk e arsyeshme që ne të mbajmë korrespondencë me të, ashtu që të mos ngarkohesh edhe me këtë barrë. Halimi pasi po vjen këtu do të sqarojmë, të cilët pas tashit duhet të punojnë si degë e veçantë pa pas lidhje direkte me njerëzit e degës "V.G." Çdo gjë që kanë do t'i drejtohen K. Drejtues dhe aty do t'i thojnë krejt çka kanë dhe nëpërmes tij mbajnë lidhjet me degët tjera të Lëvizjes.

Përshëndetje vëllazërore
Mërgimi dhe Hasani (Mërgimi=Sabri Novosella)

6. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 9 tetor 1982

I dashur Vëlla, 9 tetor 1982

Sot i mora prej teje 4 zarfa me letra, pasi i lexova të gjitha mora me ta shkruar këtë letër si përgjegje në to.

Procesi i asaj mbledhje nuk tregon se a është fjala për ata 12 shokë të organizuar, apo ka në mesin e tyre edhe njerëz të paorganizuar?

Në atë mbledhje tehu paska qenë i drejtuar vetëm kundër Nuhiut e jo kundër Halimit. Duhet ta dimë se Nuhiu paraqet rrezik shumë të vogël në krahasim me Halimin. Shifet se çështja e Halimit paska mbetur të shqiptohet në nivelin më të lartë, por mua më duket se ka qenë e nevojshme t'e shfrytëzojsh rastin në atë mbledhje të japësh disa sqarime për të dhe barra kryesore ti mbesi Halimit pasi që është e tillë, kurse rasti i Nuhiut të paraqitet si i ndikuar nga ai.

Unë e kam përgatitur një letër t'ia dërgoj Hisenit, nëpërmes së cilës do të shifet fytyra e Halimit, por po pres një letër prej Ukës, të shofim si po e vlerëson qëndrimin e tij mbas mosardhjes në atë takim. Me K.K. u takova rastësisht (unë e thirra por ai nuk erdhi). E pyeta sa i ka pëlqyer Organi? Halimi nuk ia kishte dërguar, por ia kishte dërguar traktin, duke i thënë se paska bërë ndikim të madh. Organin e paska marrë atë ditë prej një shokut tonë. Kështu e vlerësoi: "Me gabime të vjetra nuk mund të bëhet lufta e re." Domethënë se gabimçarët e vjetër si A. Dema-Demaçi, J.G., H.Hys. e të tjerë nuk munden të bëjnë luftën e re (apo në emër të tyre) që e ka filluar "teoricienti" K.K. Pra shifet se ata me L. nuk kanë asgjë të përbashkët. Çka po dëshirojnë këta njerëz nuk po dimë. Disa shokë këtu kanë filluar të dyshojnë në ta, sidomos në K.K. Pas tri ditësh do të bisedojmë me Plakun. Do ta bisedojmë edhe këtë çështje.

Letra e M. Vranicës kujna i ka ardhur? Me te mos e zgjatni. Ai është shumë i kompromet uar.

Letra që ia paske dërguar ati shokut në Zvicër, në qoftë se nuk është i organizuar dhe me një rëndësi të posaçme, nuk është e arsyeshme, pasi që është shumë dekonspiruese. Në qoftë se miret vendimi të demaskohen e të kritikohen Halimi e të tjerët, duhet të demaskohen vetëm si persona e kurrsesi si P., pasiq bashkimi faktikisht është arritë. Pa marrë parasysh se këta janë ata që e kanë përfaqësuar atë organizatë. Kjo ka ndodh edhe kur janë bashkuar grupet K. dhe është formuar P. më 1941. Përfaqësuesit e një grupi menjëherë kanë tradhtuar, por grupi ka mbetur i bashkuar. Këtyre krejt shokët e organizuar ju kanë ra në burg nga organizimi i tyre i mbrapsht. Këta tani janë duke u

munduar të organizojnë njerëz të ri, duke përdorur metodat e vjetra, duke u munduar të organizojnë edhe njerëz të organizuar.

Sa i përket intrigave se ZK qenka marrë nga Riza Salihu kjo nuk ka kurrfarë rëndësie, pasi që Zëri i Kosovës del që nga 1973-74 këtë e din më së miri Uka. Në qoftë se është munduar të e nxjerr edhe ndonjë Riza Salihu, s'ka kurrfarë rëndësie, pasi Organi nuk është lopë të cilën e ka njëri e ia merr tjetri, por e nxjerrin ata që kanë aftësi. Edhe "Liria" është përsëritje e numrave të mëparshëm, por ato kanë qenë organe të tjera grupeve politike, kurse kjo e fundit e një organizate të veçantë.

Me të vërtetë po na humbin shumë kohë sqarimet e stërsqarimet rreth këtyre gjërave. T'ju kthehemi punëve tona konkrete:

Nuk më kishe njoftuar se a kanë shkuar në rregull ZK në Vajzan? A kie ndonjë lajm prej Aliut dhe ai i ka shkuar ZK?

Të Mimozës po më shkruajnë rregullisht dhe po më thonë se çdo gjë është në rregull te ata. Më pyetën se si me ia bërë me "Ilirinë" pasi iu paskan arrijtë mjaft materiale, unë u thash t'i dërgojnë në adresën e ZK, kurse Ukës i shkrova që t'i korrigjon. Ti kishte qenë mirë t'i shtypësh. Për këtë punë duhet të kesh edhe ndonjë ndihmës, pasiq vështirë do ta kesh t'i përballojsh vetëm. Shumë i përshtatshëm do të ishte Iliri, por ai është në një shtet tjetër. Po të ishi ti dhe Uka në një vend do të ishte shumë mirë. Qysh moti unë e kam cekë këtë, prapë po e potencoi. Me kenë e mundur të jeni në një vend do të bëhej shumë mirë.

Shefkati me të shoqin paskan qenë këtu, prapë paskan kërkuar prej një shokut të shkojë në Zvicër duke ia paguar ata rrugën, por së pari t'i lajmëroi ata e atëherë të shkoj atje. I paskan thanë se a din ndonjë familje që ka nevojë për ndihma, pasi qenka grumbulluar një sasi e madhe e të hollave në Lëvizje. Krejt këto fjalë të tyre na bëjnë që të bindemi se me ta nuk është në rregull. Gradualisht distancohu prej tyre. Ku kanë të drejtë të përzihen ata në këto punë derisa nuk janë anëtar.

Të fala vëllazërore M. (Mërgimi=Sabri Novosella)

7.Letër nga Sabri Novosella për Nuhi Sylejmanin, 9 tetor 1982

Nuhi Sylejmani

Kemi qenë shumë të brengosur dhe të zemëruar në shokët në lidhje me ty. Ti nuk e pe të arsyeshme as të më shkruajsh. Unë të shkrova dhe letrën e ke marrë. Përgjegje nuk më ktheve. U njoftuam se dy shokë do të shkojkan te shoktë. Pritëm se çfarë fjalësh të mira do të sjellin. Ata i sollën këto fjalë:

"Nuhiu na ka thënë, mos dërgoni ndihma aty se ato shkojnë në Beograd."

A është e vërtetë a jo?

Përgjegjen gjithsesi e duam.

8. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 15 tetor 1982

Vëlla i dashur Shpend, 15 tetor 1982

Letrën tënde të shkruar më 7 tetor 1982 e mora dhe e kuptova në tërësi. Për takimin që patët me Ukën nuk më kishe njoftuar në hollësi. Pasi ata paskan bujtur te ju, kuptohet se është biseduar diçka, pasi që edhe për bisedime jeni takuar.

Ti thua se Uka është i rezervuar ndaj teje. Unë nuk po e di në që drejtim po mendon? Po të njoftoj për disa gjëra: Uka për asnjë njeri timin këtu nuk dinë asgjë, ashtu edhe unë për asnjë njeri të tij atje nuk di asgjë (me përjashtim të H.M. për të cilin kam ditur edhe më parë). E kam njoftuar se e kam një rreth të mirë të sigurt, edhe ai më ka njoftuar se e ka një rreth të tillë. Më ka thënë se, p.sh. anëtar i udhëheqësisë së tyre nuk

ka mund me ardhë në konsiderim pa i pasur disa vite përvojë në punë aktive dhe së pakur tri celula e asgjë tjetër nuk më ka njoftuar dhe as që kam kërkuar të di diçka më tepër. Krejt kjo është në vijën e udhëzimeve. Kështu është dashur të jetë edhe te ju, por te ju po më duket se edhe sa ka qenë gjallë Sokoli kështu nuk ka shkuar. Pasi ranë dëshmorët gjendja u keqësua edhe më tepër. Disi puna mori kahjen e veprimtarisë legale. Kjo është shumë e rrezikshme. Dera u hap të depërtoi shumë kush në atë mes. Këtë e bëri edhe rasti i vizitave për kryeshëndosh, por edhe rastet tjera, si për shembull përçarja e shokëve e të tjera.

Mua më ka munduar dhe po më mundon një problem jashtëzakonisht shumë: Si me u kthye prapë edhe në atë mes që veprimtaria të zhvillohet ilegalisht. Përndryshe veprimtaria në atë mes, në qoftë se armiku nuk do të arrijë me shkatërruar nëpërmjet spiujve me intriga e me gjithfarë kurthash, do të marrë edhe një sulm dhe do t'i likuidon edhe një ose dy vetë dhe puna në atë mes do të përfundon me pasoja për krejt çështjen.

Unë kërkova largimin tënd nga ai mes, gjegjësisht ilegalizimin tënd me çdo kusht. Në këtë mënyrë në qoftë se vazhdohet, puna jote është jetëshkurtë. Jo vetëm puna jote, por e të gjithëve. Me siguri është dobësi e ime, por më duhet të them: Për ty brengosem më së tepërmi për shkaqe që i din edhe vetë.

Sot në atë mes, ashtu si po e shef, më tepër njerëzit po merren me intriga se me punë. Kjo duhet të ndërpritet gjithsesi. Krejt kjo është rezultat i veprimtarisë legale në atë mes. Shkuarja jote te Uka do të ishte shumë punë e mirë. Besoj se do ta merrni edhe makinën dhe do të grumbulloheshin kuadrat në një qendër që merren me organ. Ti do të mbajshe lidhjet vetëm me F. (Faridin Tafallarin) e ai me disa persona që janë të sprovuar dhe puna do të shkonte sipas udhëzimeve. Në qoftë se vendosesh aty, prapë në atë stil duhet të punojsh. Përndryshe të jesh i bindur se je shumë i rrezikuar. Armiku thotë: "Obezgllavi pa llako qemo." Sot përjashta janë koka ata që e nxjerrin organin. Goditja e parë po e shef çka bani. Goditja e dytë do të përfundoi punën përjashta ku me ditë për sa kohë.

Rasti i Nuhiut nuk po më brengos shumë edhe se nuk është dashur të vjen deri te kjo. Duke e shkruar këtë letër më erdhi prej tij një letër me fotokopjimin e dy qekave të zbrazët me dorëshkrim të tij ku thotë se S.S. i ka shkye 4000 copa kësi qekash, të cilët qenkan shtypur me vendimin e tre heronjve. Thotë se edhe 5000 copa pamflete të "Lirisë" i paske asgjësuar. Kjo ty nuk të rëndon pasi që s'keni pasur si të dërgoni ndihma në ata qeka derisa tre njerëzit që e kanë pasur atë punë përsipër, janë vra. Edhe pse nuk krye punë për një organizatë, atëherë tjetër, ti nuk je fajtor. Ti i ke pasur 3000 ZK me të cilët në dorë ka vdek Heroi me i shpërnda dhe me shumë punë tjera.

Këtë letër që e mora është përgjegje në një letër që po ta dërgoi. Në letrën e tij ju kam përgjegjur, por në te ende nuk kam marrë përgjegje. Edhe në këtë letër do t'i përgjigjem me pak fjalë. T'ia sqaroj punën e qekave dhe punën e mbledhjes. Do t'i them se mbledhjen se ka thirrur S.S. por punëtorët, shokët tu, të cilët e kanë parë se me ty diçka nuk është në rregull. Ai edhe në këtë letër ngulë këmbë se, nuk do të dërgoi ndihma në qekat e ri të Lëvizjes që dual nga bashkimi i organizatave të mëparshme, por gjoja po dojka me dërguar në ata qeka të mëparshëm. Ne do të mbajmë qëndrim ashtu si duhet, por prej ti po më duket se nuk ka kurgja.

Prej të Mimozës kam marrë shumë letra, ata po supozojnë se të ka folë dikush keq për ta që nuk ua ke dërguar sasinë tjetër të ZK që ta kanë kërkuar. Pasi unë i kam në lidhje me ta mos u zgjero. Të shofin se te ne ka disiplinë, gjë që pa disiplinë, konspiracion e sakrifica nuk ka as punë të mirëfilltë.

Edhe njëherë po e ceku, duhet të vendosesh dikund sa më shpejtë. Të ndërrosh pseudonimin, t'i kushtohesh me tërë qenien organit. Me shokë të mbajsh lidhje vetëm me

Faridinin e me ndonjë tjetër shumë të sigurt. Me një fjalë veprimtaria jote në konspiracion të thellë është e domosdoshme. Më tepër bënë ndikim një numër i ZK se 100 fjalime.

Të fala vëllazërore K. (Sabri Novosella)

9. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 4 nëntor 1982

I dashur vëlla Ali, 4 nëntor 1982

Sot i mora dy zarfa me letra prej teje, pa datë të shkruara. Jam bukur shumë i brengosur për ty, pasi që nuk mu lajmërove prej asaj dite. Kështu i brengosur do të jem derisa të vendosesh dikund definitivisht. Te ai shok qenke mirë, me siguri edhe ai e merr kujdesin ndaj teje si obligim që i takon çdo shqiptari të ndershëm ndaj çështjes së madhe të popullit tonë e jo vetëm si ndihmë ndaj një shoku të zakonshëm.

Artikullin e Sokolit dhe shkresën tënde për pagesën e ZK po ia dërgoj U. me mendimin tim aprovues.

Iliri është shoku i Mimozës. Kjo ide e imja është më tepër dëshirë se sa mendim i bazuar në fakte. Gjithsesi duhet të studiohet mirë. Unë problem kryesor e kam vendosjen tënde. Të sjellet ndonjë shok te ti do të jetë punë më e lehtë.

U. më tha se e ka përgatitur materialin e duhur për ZK. Nuk më njoftove se a të ka ardhur? Ky numër gjithsesi kishte qenë mirë të dali për Festat e Nëntorit. Sa i përket manifestimit duhet të keni parasysh se njëvjetori duhet të shënohet gjithsesi. Këtë diskutoje mirë me U.

U. më propozoi që të hiqet stema e të vendoset ashtu si ka qenë përpara ZK. Unë iu përgjegja se deri sa luftojmë për Republikë nuk bënë të bëjmë kurrnjë ndryshim.

Jam i mendimit që numri i vitit të ardhshëm të filloi prapë me 1 (Nji) ashtu si praktikohet në "Përparimin", "Jetën e re" e të tjera. Unë numrin e parë të ZK (Zëri i Kosovës- shën im) e konsideroi të dalur në vitin 1973 ose 74. Këtë duhet ta dijë më

mirë U.(Uka=Xhafer Shatri-shën im) Dallimin e bën viti, për shembull: (Nr. 1. 1983) .

Krejt materialet po ia dërgoj U. ashtu që të mos humbet kohë t'i dërgoi ty, ti atij e ai prapë ty. Unë prapë shokëve të Mimozës u thash që të gjitha materialet t'i dërgojnë në adresë të ZK. Nxjerrja e numrit tre të I. nuk më duket e arsyeshme, pasi që edhe dy të parët, përveç që shifen qëllimet e pastërta, nuk kanë kurrfarë vlere. L. i duhet një revistë letrare në kuptimin e plotë të fjalës e jo për të dalë diçka sa për të dalë, për t'u shkrua diçka sa për t'u shkrua.

Nuk më kishe njoftuar për vëllaun e korrierit se a kanë shkuar 460 copat dhe a i ka marrë të vetat Alia?

Më njofton për Naimin dhe për shokët tjerë që nuk i kanë të rregulluar dokumentet.

Nuhiut ja kam dërguar një letër të rrastë dhe besoj se më as që më shkruan. Ju këqyrni punët që na duhen e mos u merrni me te, thjeshtë injorone dhe mos e përmendni.

Të fala vëllazërore, K. (Sabri Novosella për Xhafer Durmishin)

10. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 12 nëntor 1982

I dashur vëlla, 12 nëntor 1982

Letrën tënde të shkruar në 6 faqe e mora dhe e kuptova në hollësi. Vërejtjet tuaja janë plotësisht të arsyeshme. Konspiracioni po i detyron njerëzit të gënjejnë, por edhe ajo duhet të ketë kufi. Është e vërtetë se (Xhafer Shatri-shën i Xh. D.) i ka disa gjeste nganjëherë jo të përshtatshme, sidomos njerëzit që nuk e njofin mirë munden me e keqkuptuar. Duhet të jemi të vetëdijshëm se nuk ka njeri pa të meta dhe gabimi më i madh

i njeriut është kur e idealizon dikend, pasi njeri ideal nuk ekziston dhe ata që e kanë princip t'i idealizojnë njerëzit, shpesh dëshpërohen kur i shofin të idealizuarit e vet se edhe ata janë njerëz me të mirat e të këqijat e veta. Është e rëndësishme që njeriu të mos jetë i poshtër si Osmani që çdo fjalë e tij është vetëm gënjeshtër e intrigë e sa për të meta të zakonshme na duhet t'ia durojmë njëri-tjetrit.

Me këtë letër për ty po e nisi edhe një letër për shokun ku je duke qëndruar dhe duke punuar, besoj se nuk do të ndikoj negativisht.

Po më duket se ai shok duhet të jetë një njeri shumë i mirë dhe kishte me qenë mirë të qëndrojsh aty aq sa të jetë e mundur, bile edhe në qoftë se e merr lejen e qëndrimit. Në dhomën e punës mos lejo të hyj askush që të mos vjen te dekonspirimi i punës tënde, kuptohet në marrëveshje me shokun që të mos vij deri te ndonjë keqkuptim.

Të fala vëllazërore M. (M-Mërgimi=Sabri Novosella)

Pasi e shkrova këtë letër më erdhi një letër që i kishte ardhur Hasanit që është këtu, të cilën ia kishte dërguar Hiseni që është atje. Në atë letër, njërën ma kishte shkruar mua si përgjigje në një bisedë telefonike që e patëm para sa kohësh. Në atë bisedë i pata thënë: Bisedoni me N. dhe bashkë me të tjerët distancohuni prej Halimit dhe për çdo gjë i drejtoheni L. në adresë të ZK.

Ai mu përgjegj: Bisedova me atë shokun (domethënë N.) dhe nuk u pajtua me mendimet tua, por edhe unë u pajtova me mendimet e tij." Dhe më udhëzon që të informohem edhe nga drejtime tjera e jo vetëm nga një drejtim. Me këtë u vërtetua se Halimi e ka formuar grupin e vet prej njerëzve që i kanë takuar atij grupi, domethënë gënjeshtrat, intrigat e provokimet i kanë pasur sukses, kuptohet duke e keqpërdorur autoritetin tim, pasi unë e kam dërguar në atë mes dhe në bazë të fjalëve të mia ai mes i besoi dhe ai e keqpërdori besimin tim në mënyrë shumë të poshtër. Për këtë aspak mos u brengos. Çdo kujt fytyra i del në shesh. Ti kushtoju me tërë qenien Organit. Ai është arma më e fuqishme në duart tona në këtë etapë. Ata po e zhvillojë teorinë "Tita i mirë Rankoviqi i keq" për ne që të dy janë të njëjte. Kjo në këtë situatë mund të ketë edhe diçka pozitive, por më vonë do të bjerë dhe me te do të bien edhe ata që e zhvillojnë sot. Në çastin e duhur ne i demaskojmë dhe distancohemi prej tyre. Tani në ZK nuk ua lejojmë ato marrina.

11. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 24 nëntor 1982

I dashur vëlla 24 nëntor 1982

Letrën tënde e mora dhe e kuptova për ato që i thua. Duhet t'e praktikojmë, që posa t'e marrësh letrën time menjëherë të përgjigjesh, ashtu edhe unë të përgjigjem, pasi këtë unë e kam princip dhe e zbatoj rregullisht si me të gjithë të tjerët ashtu edhe me ty.

Vonimi i materialeve nga ana e Ukës, me siguri është shkaktuar nga arsyeja e shtrirjes së tij në spital. Nga spitali e kam marrë një letër prej tij. Në qoftë se nuk arrin të dali ZK para festave nuk do të bëhet mirë pasi që kaloi një kohë bukur e gjatë nga dalja e numrit të mëparshëm dhe vonimi i çdo numri po shkakton njëfarë pasiviteti dhe po u jep mundësi kundërshtarëve të bëjnë gjithfarë manipulimesh.

Atë material që i paska shkuar U. nga ata të Brx. nuk besoj se është i Hasanit, pasi para disa ditësh e mora një letër prej tij dhe nuk më tha asgjë për atë material, por më njoftoi për disa probleme që u paskan lindur atje. Ekziston mundësia që ata tjerët që ishin thye me te e kanë lëshuar ndonjë material që i paska ra në dorë U.

... Osmani e Fatoni paskan shkuar në Zvi. dhe i paskan krye do punë të "mëdha" por te U. nuk paskan shkuar se nuk paskan pasur të holla. Kështu tha Fatoni, i cili erdhi të shtunën te unë bashkë me liderin. I pyeta për O. dhe më thanë se ka mbetur në Gj.

(Gjermani) me i krye do punë të "mëdha". Pas një bisede i pyeta se kush prej tyre ka qenë në Brx? Ata më thanë se këta nuk paskan qenë. Ua nxora dhe ua lexova një letër që më kishte ardhur atë ditë prej shokëve të Brx., ku thuhej: Erdhën 3 njerëz prej Gj. (Gjermanie) dhe i takova në kafenenë e Hysenit. U ula me pi një kafe sa për t'i nderuar mysafirët dhe ata aty për aty i nxuarën propozimet në mënyrë pompoze e me emra të mëdhenj na i shtruan: Të bashkohen me p. (Partinë) e tyre e të formojnë një komitet të përbashkët (në stilin që na e propozojshin ne në fillim). Dhe letra vazhdonte: Ju thash: Shkoni te shokët në Gj. e merrnu vesh me ta për bashkim. Ata (Abdullahu, Osmani e Fatoni-red.) ju paskan përgjegj se LRSHJ-a dhe FK (Fronti i Kuq) e paskan lëshuar rrugën e JG. BG. KZ. dhe ia paskan shkruar IK tri letra, por nuk kanë hasur në mirëkuptim edhe te ata. ... Këta (Abdullahu e Fatoni), e mohuan se kanë qenë ata. Unë ju thash se ndoshta ka qenë Osmani... Ata ma kthyen Osmani është këtu, paska mbetur duke e pritur një telefon shumë të rëndësishëm. Do me thënë Osmani brenda minutave dual nga një kontinent në një kontinent tjetër. Pasi ishin kthye nga Brx. (Brukseli) me bisht nën këmbë, kishin vendosur të vinë te unë me më thënë, ashtu si më thanë: T'i lamë të gjitha ato që kanë ndodhur deri më tani e prej tashit t'ia fillojmë prej zeros. Unë ju thash: Ne ia kemi filluar para 20 vjetësh e ju si të doni.

Pasi u vërtetua se këta ia paskan filluar edhe në këtë mënyrë, ne këtu e përpiluam një QARKORE në emër të KQ të LRSHJ-s e cila do të vjen prej U. brenda një kohe të shkurtër e t'ua qesim fytyrën në shesh, pa ua përmendur emrat, pasi ata e mohuan se paskan qenë.

... K (Kushtrimi=Abdullah Prapashtica) më tha se i paska shkruar U. dhe propozimi i tij, me siguri ka për qëllim që të fitoj në kohë e të na qesi hi para syve, që mos t'i demaskojmë bile edhe për një kohë. Këtë ia thash edhe U., taktikat e tyre duhet të marrin fund njëherë e përgjithmonë.

Fjalimi i shokut E. (Enver Hoxha-shën i red.) sa i përket çështjes sonë është shumë i mirë, sa i përket për m.sh. (Mehmet Shehut-red.) ata e dinë vetë. Një gjë duhet t'e kemi parasysh, prej m.sh. popullit tonë asnjë e mirë nuk kishte mujt me i ardhë dhe as që i ka ardhur ndonjëherë që nga koha që është ulur në atë kolltuk. Bashkë me te janë shkuar disa pisa që kanë pre shqiptarë qe 40 vjet.

Puna jote dhe e F. po më duket shumë më e mirë tani se më parë, pasi vetëm puna në konspiracion të thellë është e suksesshme, por duhet t'i marrim të gjitha masat që ZK të dali sa më shpesh. Kohën e lirë shfrytëzoje për shkrimin e artikujve.

I shkrova edhe U. Shokët në Atdhe dhe këta këtu thonë se K.Q. të quhet K.Q. e jo ashtu si dëshirojnë ata për qëllime djallëzore që Lëvizja të ketë K. e përgjithshëm, kurse p. (partia) e tyre të ketë K.Q. si udhëheqës i L. Besoi se edhe U. nuk do të kundërshtoi dhe të gjitha dokumentet të nënshkruhen me KQ të LRSHJ e jo si deri më tani vetëm në emër të L...

Të fala vëllazërore M. (M-Mërgimi=Sabri Novosella)

12. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 7 dhjetor 1982

I dashur vëlla 7 dhjetor 1982

Sot e mora një shkresë prej teje në tri faqe (faqet 3,4,5) Sa mujta me kuptuar, fjala është për njëfarë projekt programi të atyre që paskan vendosur të formojnë një udhëheqësi të punëtorëve në Evropën Perëndimore, me emër, sa munda me e kuptuar nga inicialet: Bashkësia e Klubeve të Punëtorëve Shqiptarë nga Jugosllavia, me organin qendror (Kurbetçiu).

Në lidhje me këtë me pata shkruar ti me pak fjalë, ashtu si edhe Uka. Sa pata mujt me kuptuar, U. paska kontakt me njeriun kryesor të kësaj iniciative. Në vërejtjet e mia se

mos është ai njeri I.K. i cili mundet një ditë edhe t'i kundërvihet L. U. m'u përgjegj se nuk është I.K. por një shok i tij i ngushtë.

1. Në qoftë se themeluesit e kësaj Bashkësie janë anëtarë të L. dhe i hyjnë kësaj pune me qëllime të caktuara, që anëtarët e saj të jenë simpatizues të L. e të çështjes në përgjithësi, do të jetë shumë mirë.

2. Dalja e Organit, në qoftë se është nën udhëheqjen direkte të ZK edhe kjo do të jetë pozitive, pasi që në te munden të botohen edhe asi artikujsh që nuk mund të botoheshin në ZK. dhe do të bëjshin ndikim pozitiv.

3. Disa shprehje të ngjashme që janë thënë edhe në Komunikatë e në Projektstatut janë në rregull (në qoftë se është fjala për njerëz pozitiv).

4. Përpiluesi i këtij materiali është njeri që posedon aftësi intelektuale.

5. Në qoftë se ky (apo këta njerëz) nuk është njeri i L. kjo punë ka për qëllim t'i kundërvihet L. dhe do të luftoj më mbytjen e aktivitetit të saj.

Ashtu si është e ditur L. punon në konspiracion të thellë. Përveç anëtarëve që i ka (apo që duhet t'i ketë gjithsesi) të fortë, të ngritur në çdo pikëpamje dhe të sigurt, duhet t'i ketë edhe simpatizuesit e vet që veprojnë gjysmë legalisht, por edhe legalisht. Në qoftë se këta njerëz janë ashtu si po dëshirojmë të jenë, do të bëjshin punë shumë të mëdha që nuk do të kishin mundësi t'i kryejnë anëtarët më të mirë të L. Edhe një gjë duhet të kemi parasysh, me këtë material udba nuk mundet me qenë e kënaqur, por do të mundohet t'i fusë njerëzit e vet në kokën e kësaj pune. Pasi kjo punë do të jetë legale edhe mundësitë do t'i ketë.

Ju të jeni shumë të kujdesshëm, mos folni kundër tyne (gjërat me shumë rëndësi, përveç me F. me të tjerët mos i bisedo). Përndryshe, me ta mos u merrni, pasi U. paska kontakt me ta, ata t'e vazhdojnë këtë punë.

Nuk më lajmërove se a ka diçka të re rreth vendosjes dhe a je aty ende?

Prej shokëve të Mimozës a ke ndonjë lajm. Më kanë njoftuar për disa mosmarrëveshje që i paskan në mes veti. Unë i kam udhëzuar që t'i formojnë celulat secili veç e veç dhe t'e vazhdojnë punën sipas udhëzimeve. Ata kërkuan që ti të shkojsh dhe të intervenojsh, por unë nuk e lejova një gjë të tillë, pasi e dimë nga përvoja se njerëzit po prishen mes veti, njëri e ka lëshuar rrugën e po kërkon hala në përpeq. Çdo tentim me i pajtuar po është i kotë, pasi që njërit as që i intereson pajtimi as puna, por në të vërtetë e kundërta po i intereson.

Letra që ja ke dërguar U. e ka idhnua pak, sa po duket. Unë i thash: Disa shprehje në disa letra tua të fundit, por edhe të Sahitit janë të pavend dhe nuk i shërbejnë çështjes, këtë ia kam thënë edhe Sahitit e po ta them edhe ty. Ne në njeri-tjetrin nuk guxojmë të kërkojmë njerëz ideal, por të metat e njëri-tjetrit duhet t'ia plotësojmë si vëllau-vëllaut e jo t'e kapim njëri-tjetrin për gjuhe, për çdo fjalë që e supozojmë se ka pasur këtë qëllim apo atë qëllim. Këto gjëra na duhet t'i pastrojmë njëherë e përgjithmonë. Në lidhje me këto, duhet të ndërpritet menjëherë ky dialog e të merremi me punë që na takojnë.

Këto fjalë t'i citova me qëllim që me të vërtetë mos të lejojmë gjëra të tilla të panevojshme të cilat na sjellin vetëm dam e asgjë tjetër.

Të fala vëllazërore, M. (M-Mërgimi=Sabri Novosella)

13. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 23 dhjetor 1982

I dashur vëlla, 23 dhjetor 1982

Ashtu si të njoftova me anë të telefonit, e pata një shok të Aliut me të cilin mbeta shumë i kënaqur. Ishte me profesion prof. në një shkollë të mesme, i përgatitur në çdo pikëpamje. Më njoftoi detalisht për çdo gjë dhe për ato që e kishte udhëzuar Aliu, për të

cilin kishte respekt shumë të madh. Si çështje kryesore e kishte porositur Aliu t'i shqyrtojmë këto:

1. Çështjen e Sh. të cilin nuk e njifte, por vetëm me një pseudonim.
2. Çështjen e Organit.
3. Çështjen e Aliut, të largohet apo jo (nga shokët paska presion që të largohet).

Me Sh-n Aliu nuk qenka i kënaqur për këto arsye: Paska bindjen se është oportunist, se nuk është konspirativ sa duhet, po u idhnojka shumë lehtë dhe kur po u idhnojka po u bëjka nami. Më njoftoi se paska qenë te një shok prej të cilit qenka ndarë shumë i demoralizuar. (atë shok ky nuk e njifte).

Për Sh. unë thash këtë mendim: Aliu të mbaj kontakt me Sh. pasi që është patriot i mirë. Edhe se ka të meta, ka shumë të mira dhe ka kontribuar për çështje.

Për Organ i thash se, nuk ju ka dërguar nga friga që të mos rrezikohet Aliu e jo pse është lënë në harresë, ashtu si paska supozuar Aliu. Paskan pasur mundësi të marrin numra të ZK edhe prej të tjerëve, por pasi ti i paske thënë që të mos merr prej askujt. Unë i thash se ne në ndonjë rast ku nuk rrezikohet askush të e marrin numrin deri sa të vihet lidhja e sigurt.

Për largimin e Aliut i udhëzova kështu: Në burg mos të bie kurrsesi, deri sa të mos jetë i rrezikuar mos të largohet. U mundova që ta udhëzoj sa më në detale se si të kujdeset për këtë çështje.

Unë e propozova Aliun për kandidat të KQ me çka u pajtua plotësisht. Me këtë Aliu konsiderohet kandidat i KQ. Mua po më duket që ky njeri meriton të jetë anëtarë i KQ.

Jehonën që e bëri dasma e Gjenevës është fitore shumë e madhe për L. por njëkohësisht edhe rrezikim për kuadrat, për këtë të keni kujdes edhe më tepër. Në një mënyrë L. u njoft nga OKB. ....

Sot i mora dy letra prej Brx. thonë se I.K. (Ibrahim Kelmendi-shën i Xh. D.) paska qenë atje. Na duhet gjithsesi të e fusim në dorë, se për ndryshe do të na sjell probleme. Ma kanë dërguar edhe një libër të njëfarë Gani Azemit me poezi. A ju ka ardhur edhe juve. Ishte libër shumë i mirë. Kishte me qenë mirë ta botoni edhe në ZK., sidomos poezinë për A. Demën-Demaçin e cila më ka pëlqyer shumë.

Mundohu sa më parë t'e merrni lejen për ditën e shokëve. Edhe në qoftë se nuk merrni leje, gjithsesi duhet të tuboheni te varret, besoj se për këtë nuk do t'ju sjellin pengesa.

Të fala vëllazërore M. (M-Mërgimi=Sabri Novosella)

14. Letër nga Sabri Novosella e Sheremet Saraçi për Xhafer Durmishin, dhjetor 1982

Vëlla i dashur Shpend,
Unë dhe Sh. jemi së bashku qe dy net. Kemi biseduar për shumë gjëra. Më njoftoj për aktivitet të dendur që kanë zhvilluar me Aliun, njëkohësisht edhe unë e njoftova për shumë gjëra dhe morëm disa vendime për aktivitetin e tyre të mëtejmë.

Aliu paska pyetur për Beqën a me marrë në lidhje ajo. Aliu paska bindje se Beqa është pasivizuar shumë.

Për Aliun kuptova se paska kontakt me shumë persona. Pa marrë parasysh se ata me siguri janë të mirë, vetvetiu kjo mënyrë e punës e rrezikon Aliun. Dëmtimi i tij do të ishte një humbje shumë e madhe, pasi që mosqenia e tij përjashta do t'i pasivizoj të gjitha lidhjet e tij. Nga ana tjetër paska aftësi intelektuale dhe do të mundka që të bëhet një lidhje e mirë për ju rreth organit.

Unë kam bindjen personale se kishte me qenë mirë që Aliu të iu bashkohet. Me këtë do t'i arrinim tri qëllime.

1.Do të zhdukej mundësia për mbyllje,

2.Të gjitha lidhjet që i ka tani gradualisht do të shndërroheshin në krah të veçantë,

3.Prezenca e tij ke Ju do të jetë një ndihmë e madhe për organin.

Sh. është i mendimit se në qoftë se e shohim të arsyeshme, ai do të vij ke Ju. Për këtë e jep mendimin tuaj dhe na e dërgon me shkrim.

Bisedat e juaja telefonike i konsiderojmë të rrezikshme (me Aliun).

Të fala vëllazërore

K dhe Sh (Sabri Novosella dhe Sheremet Saraçi)

(Shënim i Xhafer Durmishit: Në këtë letër personi me emrin Aliu është Asllan Muharremi).

15. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 10 janar 1983

Të dashur vëllezër U., S., (Xhafer Shatrit dhe Xhafer Durmishit) ,10 janar 1983

Mendimi ynë në lidhje me mbajtjen e Kongresit:

Teorikisht mbajtja e kongresit është plotësisht në rregull, por praktikisht mua më duket jo i arsyeshëm në këtë situatë, për këtë arsye:

Mbajtja e kongresit në këto situata bien te dekonspirimi i udhëheqësisë së Lëvizjes në botën e jashtme, gjë që do të jetë një fitore e madhe për armikun dhe katastrofë për Lëvizjen, për këto arsye:

1. Do të e ketë më lehtë me i likuiduar kuadrat fizikisht.

2. Do t'e ketë shumë lehtë me i kompromet uar kuadrat me anën e qpifjeve e intrigave të llojllojshme.

3. Njerëzit nuk do ta konsiderojnë veten si njerëz që veprojnë për L. por për filanin e fistekun dhe me plot sukses do të përhapet parulla se, pasi është filani në udhëheqësi të L. unë nuk dua të jem aty, gjë që kjo fjalë po ndihet çdo kund ku po arrihet t'e njofin njerëzit njëri-tjetrin e që nuk kanë lidhje direkte, apo simpati për njëri-tjetrin.

Para do kohësh unë kam qenë i mendimit që Lleshin t'e popullarizojmë e te dekonspirojmë, por mendimi i tij që të mos popullarizohen personat, por vetëm L. me të vërtetë është shumë i qëlluar e kjo po vërtetohet për çdo ditë ashtu si po e shofim të gjithë.

Ditët e para pas bashkimit të Organizatave, armiku filloi të lëshoi parulla se gjoja L. e ka kokën në Beograd, udhëheqësit e L. janë të dyshimtë e të tjera. Kjo shumë shpejt u tregua e pasuksesshme dhe ju dashtë të dali haptas dhe e sulmoi L., ashtu si veproi pas Demonstratës së Gjenevës, duke trulluar gjithfarë qpifjesh, por njëkohësisht edhe e popullarizoi L. aq shumë saqë, sipas informatave që po na vijnë, si nga anët e Botës, ashtu edhe nga Kosova, sot më tepër flitet për Lëvizjen se sa për PPSH-në. Njerëzit shprehin supozimet se në udhëheqësi është edhe Prof. Dr. Ali Hadri dhe kjo është një fitore e madhe për L. e për çështjen në përgjithësi. Ndoshta mundeni me thënë se kjo e rrezikon Aliun e të tjerët që do të flitet për ta, kjo mos t'ju brengosë aspak, pasi që edhe kjo është fitore jona dhe e çështjes në përgjithësi bile edhe në qoftë se burgosen, apo edhe në qoftë se pushkatohen njerëzit e tillë. Të gjitha këto duhet t'i shfrytëzojmë me shumë kujdes, në këto drejtime: Të mbahet L. e sidomos udhëheqësia e L. në konspiracion sa më të thellë, të dali organi sa më i fuqishëm e sa më shpesh, të formohet një Këshill Ekzekutiv për Evropë e më vonë edhe në vende të tjera ku do të jetë e mundur.

Propozimi i Ll. duhet të realizohet sa më shpejt dhe të formohet Këshilli Ekzekutiv i cili faktikisht ekziston. Tani do të plotësohet me I. (Ibrahim Kelmendin-red.) e më vonë

edhe me kuadra të tjera të afta e të sprovuara, të vazhdohet me aksione si në Vajazan ashtu edhe në botën e jashtme.

Në emër të K. të Degës të L. "Hasan Prishtina", M. (Sabri Novosella)

16. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 4 mars 1983

I dashur vëlla, 4 mars 1983

Letrën tënde e mora dje (pa datë). Sa i përket fushatës së gripit që e paski anena, mos u qofshim falë se, edhe ne me bollëk e kemi. Sa për letra që nuk po më shkruan nuk po më vjen bash mirë, pasi që unë posa ta marrë letrën tënde të shkruaj, gjegjësisht të përgjigjem ne letër, se, në qoftë se nuk të shkruaj menjëherë, as që mundem më vonë të përgjigjem, pasi edhe s'di çka me të shkrua por posa ta marrë letrën tënde (ashtu si të të gjithë shokëve) menjëherë të përgjigjem, duke e mbajtur letrën (në të cilën përgjigjem) para vetit. Kësaj gjithnjë ju kam përmbajtë me të gjithë shokët, por edhe prej tyre kam kërkuar që t'i përmbahen, gjë që edhe i përmbahen. Detyra që t'u paska caktuar prej shokëve të K. Ekzekutiv për b. j. na bënë që pas tashit të kemi korrespondencë të rregulltë, pasi edhe unë nga ana e KQ jam i ngarkuar me këtë detyrë (në çështje të organizimit kam qenë i ngarkuar të punoj që nga viti 1962 kur është formuar L. nga A.D. Po i japi vetes të drejtë të them se në këtë drejtim kam pak përvojë. Si po shifet barra kryesore po na bien ty e mua dhe kjo na obligon që vazhdimisht të jemi në korrespondencë dhe të konsultohemi e ta koordinojmë aktivitetin sa më mirë që puna të ketë sukses sa më të madh. Sa i përket asaj se, mendimet tona ndryshojnë në mënyrën e organizimit në b.j. (botën e jashtme-red) unë për veprimtari sa më konspirative, kurse ti për një veprimtari sa më të gjerë e cila më lehtë i dekonspiron kuadrat, por L. masovizohet). Për mënyrën që e mendoj unë, në Vajazan dhe këtu, është plotësisht e arsyeshme dhe në çdo mënyrë tjetër është katastrofë, kurse për atje ku jeni duke vepruar, unë mundem mos me e ditur, pasi unë atje nuk jam dhe me siguri edhe kushtet nuk i njof në kurrnjë pikëpamje. Këtë çështje duhet ta analizoni ju në K.E. dhe të bini vendim se si është më së miri të veprohet dhe ashtu të veprohet.

Jam i bindur se, punën në ZK, sidomos përgatitjen teknike që ke mujtë me e bërë ti, tjetër kush edhe për një kohë të gjatë nuk mundet me e bërë. Këtë ia kam thënë edhe U. edhe këto ju i dini më së miri dhe veproni si është më së miri. U. po më thotë se ekipi i ZK është kompletuar bukur mirë dhe do të plotësohet në të ardhmen edhe më mirë. Më ka njoftuar se është formuar Dega e L. në Malmö (Suedi-red). Këtë njoftim e kemi marrë edhe nga një anëtar (i anëtarit të KQ e vepron këtu) i L. nga Stokholmi dhe kishte thënë se, edhe në atë qytet po bëhesh përgatitjet për formimin e Degës së L.

Para disa muajsh kam ra në lidhje me G. Azemin nga Brx. Ai mua më njef vetëm me një pseudonim e asgjë tjetër. Ia kam bërë të mundur të kontribuoj për L. por kurrsesi edhe të na dëmtoj, në qoftë se nuk ka qëllime të pastërta. Që ta kesh më të kjart qëndrimin e tij të tanishëm, po ta dërgoj një letër të tij që më erdhi para sa ditësh. Nuk më kishe njoftuar se, a të ka ardhur një përmbledhje e poezive të tij e cila më ka pëlqyer bukur shumë, të cilën i kam thënë Hasanit me ta dërguar? Edhe me Hasanin jam në korrespondencë të përhershme, edhe se ai ma ka dërguar librin e G.A. ai nuk dinë gjë për korrespondencën time me G.A. Edhe në qoftë se kontakton me te, nuk është e nevojshme të dijë asgjë tani për tani.

Të fala vëllazërore, M (Sabri Novosella)

P.S. Tre ekzemplarë të ZK. i dërgon rregullisht në adresën: Seven Bebe, Fevzi Pasa Cad. NO. 47, Fatih-Istanbul

17.Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 30 mars 1983

Vëlla i dashur, 30 mars 1983
Letrat tua të shkruara më 16 dhe 23 mars i mora sot. I lexova dhe i rilexova me shumë kujdes dhe e kuptova mirë krejt çka thuhet në to. Sapo mundem me kuptuar, punët janë vu në vi bukur mirë, pa marrë parasysh pengesat e zakonshme pa të cilat s'do të mbesim deri në fitore.

Me këtë udhë po ta dërgoi një skicë, e cila do të ndihmon që më lehtë t'i sqarojsh shokët e pesëshit tënd që të orientohen më lehtë në punët konkrete, të cilën ia kam dërguar edhe U. (Xhafer Shatrit-shën i Xh. D.). Mendimi yt të e formojsh pesëshin tënd është plotësisht në përputhje me udhëzimet që ipen në këtë skicë. Këtë punë e kryen sa më shpejt, por duke pasur shumë kujdes, që në atë rreth mos të depërton ndonjë jo i sigurt.

Nuk më kishi informuar se me çfarë detyre konkrete është ngarkuar secili prej jush.

Si po shifet S. është ngarkuar me org. U. me pro. I. gjithsesi duhet me çështje të jashtme. H. me financa në qoftë se është ngarkuar, pasi edhe Or. tani është atje, atëherë F. duhet me sigurim. Pa marrë parasysh edhe se duket e pamundur të realizohet shpejt e shpejt, vazhdimisht duhet të punoni në këtë drejtim.

Sa i përket asaj letrës për V. ke të drejtë, disi ashtu është përgjegj edhe U. Të shofim e të bëjmë.

Te ata të Brx. unë nuk e shof të arsyeshme të shkojsh ti. Vetëm munden me të kompromituar. Në qoftë se është e mundur të bëhet diçka me ta, do të mundohem unë me anën e letrave si deri më tani. Gjithsesi më duhet me gjakftohtësinë më të madhe të vazhdoj të bëjmë edhe atje diçka. Në bazë të letrave të tyre dhe në bazë të ankesave që i bëjnë kundër I. shifet se I. ka ndikim te disa atje. Unë i kam udhëzuar që të ndërprejnë çdo gjë me ata të I. dhe të formojnë një Degë të pavarur. Të shofim si do të rezulton puna e tyre. Me G. A. kam korrespondencë të rregullt, ai po e njifka një anëtar të L. që është këtu, për mua nuk dinë asgjë. Ky njeri me ken që punon ashtu si duhet, kam bindjen se kishte me bërë punë.

U. më propozon që të vjen atje Kameri, kam dëshirë që ta kem edhe mendimin tënd. Aty ku është ka mjaft punë, sidomos afërsia me Vajazan ka rëndësi shumë të madhe, por edhe aty ka mjaft punë pasi edhe aty ka shumë shqiptarë.

Për korijerin e ke ndonjë informatë? Prej Alisë e ke ndonjë lajm. Rasti i Vushtërrisë më 11 mars më ka bërë të brengosem për ndonjë lidhje të tij, por edhe të një lidhjeje tjetër, pasi shtypi e ceku se është vërtetuar se po veprojka grupi i organizuar nga brenda. Çdo gjë që merr vesh për ta më njofton.

Formimi i sigurimit të L. është i domosdoshëm. Ne kemi filluar diçka në atë drejtim. Në qoftë se ngarkohet F. me atë detyrë na duhet të bëjmë çmos që puna të shkoj sa më mirë edhe në atë drejtim. Njerëzit që ngarkohen me këtë detyrë duhet të grumbullojnë çdo informatë në imtësitë më të vogla dhe t'i përgtisin me shkrim dhe t'i dorëzojnë nëpërmes lidhjeve të veta në KE.

Ne këndej kemi ndërmarrë diçka që të kontribuoj në grumbullimin e ndihmave për Kosovën. Kemi ndërmend të formojmë një shoqatë me emrin: Shoqata për ndihma Kosovës. Statutin e Shoqatës ia kam dërguar U. për korrigjim. Njerëzit që do të mirren me punë në këtë Shoqatë, puna e tyre e vetme do të jetë që t'i udhëzojnë njerëzit të dërgojnë ndihma në konton në Zvicër, në konton e L. Kemi bindjen se, njerëzit shumë më lehtë do të ndihmojnë Kosovën nëpërmes një Shoqate bamirëse se sa nëpërmes ndonjë organizate politike. Ketë duhet të dijnë vetëm udhëheqësija më e ngushtë se është formuar nga L. Kjo Shoqatë do t'i ketë duartë më të lira për të grumbulluar ndihma edhe në ata të

shkretirës. Duhet të shkruhet një thirrje e thuktë në emër të Shoqatës e të përkthehet në shumë gjuhë. Qendrën e saj do ta shpallim se është në Zvicër. Kjo do të ndikonte mirë te ata që do të jenë të gatshëm të dërgojnë ndihma.

Të fala vëllazërore M.

P.S. Çështja e Statutit dhe Programit gjithsesi duhet të zgjidhet. Projektstatutin e keni atje, në mbledhjen e ardhshme shqyrtone dhe plotësone dhe aprovone. Sa mujta me kuptuar një Projektprogram aksional e paske përgatitur. Edhe ate e shqyrtoni dhe na e dërgoni edhe ne. Kishte me qenë mirë që Haxhiu dhe Hafizi bashk me F. të nagazhohen në çështje të sigurimit. Të grumbullojnë informata deri në imtësi dhe të na i dërgojnë neve këtu, por ato informata i shfrytëzoni edhe ju atje.

18. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 15 gusht 1983

Vëlla i dashur S. 15 gusht 1983

Letrën tuaj të shkruar më 3 gusht 1983 L. të njëjtën dërguar edhe M. e lexuam shumë herë, e analizuam dhe erdhëm në përfundim me ta shkruar këtë letër. Shumë kohë pritëm letër prej teje por letra nuk erdhi. Pasi na the nëpërmes telefonit që mos të shkruajmë letër pa marrë adresë të re, nuk dinim ku të shkruajmë dhe vendosëm ta shkruajmë në adresë të U., e ai me ta dërgua ty kurse ti në përgjegje që është mirë të na e kthejsh sa më parë, të na tregosh edhe adresën ku mund të shkruajmë.

.... Për aktivitetin tuaj pranë heroit Sokol nuk e shohim të nevojshme të zgjatemi, pasi që ekzistojnë dokumentet, gjegjësisht letrat e shkruara me dorën e Sokolit, ku për ty shprehen mendimet më të mira.

Pas rënies së shokëve, kontributi yt është i madh në vazhdimin e aktivitetit të L. në atë mes, por edhe pse puna juaj dhe atyre që mbetën aty, e sulmuar vazhdimisht nga agjenti Osman Osmani, jemi të bindur se puna juaj pas ngjarjes e këndej duhej të ishte më konkrete, më e frytshme sidomos në çështje të organizimit.

Pas rënies së shokëve, i more udhëzimet e duhura, e riorganizove Komitetin e Degës, i cili dual me emër të ri "KVG". Ai Komitet edhe pse filloi punën mirë nuk funksionoi ashtu si duhet dhe sipas gjasave tani më as që ekziston, ashtu si duhej të ekzistonte. Ky është gabim i madh që nuk ka guxuar kurrsesi të ndodh. Në vend që "KVG" sot të ishte një degë e fuqishme e L. me celulat e veta në shumë vende.

Ngjarjet e zhvilluan ashtu si u zhvilluan. Erdhi te formimi i KE (QE-shën i Xh. D.) për botën e jashtme dhe ti u ngarkove me detyrën e S. Or. kurse ti në vend që të formojsh sekretariatin prej tre ose pesë anëtarësh, prej shokëve më të sigurt, më të mirë dhe nëpërmjet tyre të punosh në formimin e celulave në të gjitha ato vende ku ekziston mundësia për një gjë të tillë, ti vazhdove të veprosh në popullarizimin e L. duke ia shtuar L. ndonjë anëtar apo simpatizant (gjë që nuk është për t'u nënvleftësuar) punë që më tepër i takon ta kryej një anëtar i thjeshtë i L. se sa një kuadër me një përvojë jo të vogël në radhët e forcave që janë të organizuara.

Në qoftë se puna juaj në formimin e sek. org. dhe degëve e celulave të tij është ende në zero, atëherë duhet t'ia fillosh nga zeroja:

-Në konsultim me shokët e KE, në një afat sa më të shkurtër t'i zgjedhësh dy a katër shokë më të besuar dhe me një përvojë të duhur dhe të formosh sekretariatin organizativ, prej tre ose pesë anëtarësh.

- Çdo aktivist të ngarkohet me detyrë të caktuar, e jo me detyra të përgjithësuara, e puna të marrë kahjen e stihisë.

- Të mbani mbledhjet e rregullta të KE dhe korrespondencën me ne këndej, e jo si gjer më sot, pasi që është i domosdoshëm takimi, konsultimi dhe marrëveshja për punë të mirëfilltë dhe të suksesshme.....
:"Sa i përket letrës për vëllaun e madh edhe ne kemi qenë të mendimit të shkruhet derisa kemi supozuar se është punë e ndonjë diplomati, por tani kur çdo gjë është e qartë, se kjo nuk është punë e ndonjë personi por qëndrim i dikujt që shqiptarët që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi kurrsesi të mos ken një organizatë të fuqishme e cila do të jetë e aftë t'i prij popullit dhe ta përfaqësoj para shteteve të botës dhe para forumeve ndërkombëtare. Shkruarja e letrave është e kotë. Ne na duhet ta bëjmë punën tonë e ata punën e vetë por gjithnjë duke e ruajtur gjakftohtësinë. Sa i përket asaj që thua se ata luajnë rolin e referit të njëanshëm ajo nuk është e vërtetë pasi referi është i dyanshëm. Kolegu i Plakut (Bujar Hoxhës) që është këtu dhe që kemi kontakte të vazhdueshme me te, na ka thënë tekstualisht: Bujar Hoxha dhe Engjëll Kolaneci kanë hëngër dajak për sjelljet dhe gabimet që i paskan bërë ndaj nesh, kurse ky mundohet të paraqitet si person që mbron krahun e L., por na këshillon që të jemi të matur ndaj Abdullah Prapashticës në qoftë se nuk dyshojmë në te, por nëse dyshojmë ajo është çështje tjetër.

Në pyetjen tonë se çka t'u themi shokëve (njerëzve) për poshtërsitë e A.P. të cilat ia përsëritëm edhe njëherë, ne tre anëtarë të KQ, na u përgjegj:

-U thoni ato që m'i thatë mua!

Kjo tregon se ata nuk janë të interesuar ta përkrahin njërën apo tjetrën, por janë të interesuar që kurrsesi dy milion shqiptar në Jugosllavi të mos e ken një përfaqësues të vetëm në plotë kuptimin e fjalës, por të vazhdoj dhe të zhvillohet vazhdimisht një aktivitet më tepër spontan se sa i organizuar mirë. Çka duan me arritur me këtë do të shifet më vonë.

Të fala vëllazërore Mërgimi e Aliu (Sabri Novosella dhe Asllan Muharremi)

19. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, vjeshtë 1983

(Diplomatët shqiptar në Turqi-shën i Xh. D.) - Thojnë Programi duhet të jetë i shkurtë, i kjartë dhe i nënshkruar nga KQ. Edhe në STATUT të ceket që LRSHJ është formuar më 17 shkurt ashtu si është e vërteta e jo më 15 maj, por më 15 maj ju kanë bashkuar edhe të tjerët. Dhe kurrsesi ndryshe. Kush nuk e pranon këtë datë është armik i LRSHJ dhe donë me shkatërruar si të tillë.... STATUT duhet të jetë ky që e ke përpiluar ti - Skënder. (Sabri Novosella)

20.Letër nga Sabri Novosella për Faridin Tafallarin, 10 tetor 1983

Vëlla i dashur F. (Faridin) 10 tetor 1983

Letrën tënde të shkruar më 29 shtator 1983 e mora dhe e lexova me vëmendje të madhe. Edhe kjo letër ma forcoi bindjen se me largimin e Nuhiut nuk është bërë kurrë një humbje për Lëvizjen, por të kundërtën, është bërë një pastrim i radhëve të Lëvizjes edhe nga një element i keq, kurse për agjentin Osman as të mos flasim. Njerëzit e tillë janë vetëm mikrob të këqij që e brejnë Lëvizjen nga brenda e asgjë tjetër. Atyre ju intereson vetëm me i qitë za vedit e asgjë tjetër edhe nëse i marrim si jo të përgatitur nga vetë armiku për të na goditur nga brenda. Puna e njerëzve të tillë është jetëshkurtë dhe nuk kalon shumë e i dalin në shesh të gjitha poshtërsitë çdo kujt që është i tillë.

Ata e kishin shpërndarë edhe një kumtesë, gjoja për të vërtetuar të kundërtën e asaj që është thënë në Komunikatën e bashkimit, por ata e kishin vërtetuar atë që është

thënë e asgjë tjetër. Aty ishte shtuar vetëm fjala- Socialiste. Kjo fjalë nuk është e rëndësishme, por e vërteta është se nuk është thënë në Vendimin e Bashkimit dhe se me Lëvizjen udhëheq Komiteti Drejtues, gjë që nuk është e vërtetë, por është thënë se me Lëvizjen udhëheq KQ i përbërë nga të tri KQ të tri ish organizatave. Edhe këtu nuk është thelbi kryesor i problemit. Çështja kryesore është se janë bashkuar tri ish organizatat në një të re e të vetme me emrin LRSHJ. Këtë e vërteton edhe kjo farë kumtese e tyre, ku nuk shifet askund se L. e paska formuar p. e tyre. gjë që është e vërtetë, kurse gënjeshtra e tyre ishte vërtetuar edhe me fjalët e tyre në atë kumtesë, pasi që LRSHJ nuk e ka formuar askush si person apo si organizatë e mëparshme, po është formuar me vullnetin e të gjithëve dhe atë punë e kanë krye përfaqësuesit e autorizuar nga të tri ish organizatat. Sa i përket asaj se kush ka dhënë iniciativë për bashkim, këtë e vërteton vetë fakti se gjatë tërë vitit 1982 (ndoshta mund të jetë gabim e është menduar të thuhet 1981-shën i Xh D) është punuar për çështjen e bashkimit dhe gjatë asaj kohe është bërë bashkimi i ish FKP me OMLK dhe kanë qenë në përfundim e sipër bisedime për bashkimin e këtyre të dyjave me Lëvizjen, kurse ata kanë qenë të fundit që janë inkuadruar në punën rreth bashkimit.

Ju jeni duke punuar shumë mirë sipas fakteve që i kemi në dorë, kjo është kryesorja. Çka thonë provokatorët e agjentët e ndryshëm, nuk është aspak e rëndësishme. Atje tani e keni edhe Aliun (Asllan Muharremin-shën i Xh D) i cili është shumë i përgatitur, sidomos në çështje të organizimit dhe disa të tjerë që janë shumë djema të mirë dhe puna e tyre do të rezultoi me siguri shumë mirë në shumë drejtime.

Është mirë që për çdo gjë të konsultohesh me Aliun, pasi që ai është ekonomist dhe merr vesh nga çështjet me të cilën je ngarkuar, si sekretar për çështje financiare.

Formimi i celulave që do të veprojnë në konspiracion të thellë është e domosdoshme, për këtë me siguri keni biseduar edhe me Aliun. Këtë çështje merre me seriozitetin më të madh, se pa organizim, gjegjësisht pa i ngarkuar aktivistët me detyra konkrete, në konspiracion të thellë, nuk është e mundur të ketë punë të frytshme konkrete.

Të fala vëllazërore e revolucionare, M. (Mërgimi=Sabri Novosella)

21.Letër nga Sabri Novosella për Faridin Tafallarin, 25 dhjetor 1983

I nderuari vëlla F. 25 dhjetor 1983

Posa u ktheva nga udhëtimi, pata dëshirë me të shkruar, por nuk pata adresën tënde. Posa e sigurova mora me të shkruar. Me ty nuk më ra me ndejt shumë kohë, por për atë kohë që ndejtëm, më duhet të them se u binda në fjalët e Skënderit që i thotë vazhdimisht për ty. Është keq me ia thënë shokut në sy, por me të vërtetë u ndava prej teje e përshtypjet më të mira. Këso mendimesh ka pasur për ty edhe Sokoli.

Duke mos pasur kohë më të gjatë për t'i sqaruar disa gjëra, ndoshta ke mbetur me disa dilema për rastin e Ukës (Xhafer Shatrit-shën i Xh D). Ti mendon se ndoshta është fjala për ndonjë komplot të atyre të Vjenës. Është e vërtetë se ata na kanë thënë vazhdimisht të ruhemi prej Ukës, ashtu si ju kanë thënë juve, ty e Skënderit, por fjalët e tyre u vërtetuan me fakte: Uka koka "ikur" prej burgut me luftue kundër atyne të Vjenës. Ti e shef se çfarë fryme kundër tyne është krijue atje. A ka qenë një këso fryme kundër tyne sa ka qenë gjallë Sokoli (Jusuf Gërvalla-shën i Xh D)? Jo me siguri, pasi që Sokoli nuk ka qenë njeri si Uka dhe ka pasur tjetër bindje dhe lufta e Sokolit ka qenë e drejtë e jo si e Ukës i cili qëllim të parë e kishte me luftua kundër atyre. Kjo shkon vetëm në interes të serbomëdhenjve e jo në interesin e popullit shqiptar. Ata na thanë për Ukën se është agjent, fjalë të ngjashme na kanë thënë edhe për IK (Ibrahim Kelmendin-shën i Xh D). Ato fjalë ia kanë thënë edhe Sokolit për IK, por për tjetërkend nuk kanë thënë kurrë.

Pse nuk thanë për ty, për Skenderin, për Haxhiun apo ndokend tjetër që nuk është i dyshimtë. Gjërat duhet t'i kemi të kjarta e jo të bahen gabime. Ne nuk mundemi me luftuar kundër tyre. Ata që lufton kundër tyre kanë me përfunduar me turp dhe nuk kanë me i njoftë as familjet e veta. Ata kanë me mbetë rrugëve të botës ashtu si ka mbetur Emil Kastrioti që nuk e ka ihtibarin e qenit.

Pasandej si është e mundur që të gjithë shqiptarët të kërkojnë Republikë dhe vetëm Uka të kërkoj shkatërrimin e Jugosllavisë? Lëvizja është formue për me luftue për Republikë në kuadrin e Jugosllavisë. Si është e mundur me luftue për Republikë e me kërkue shkatërrimin e Jugosllavisë?

Ato që janë kanë përpara nuk bën më me u përmend, pasi tash luftohet vetëm për Republikë. Serbomëdhenjtë na thonë se ne nuk po luftojna për Republikë, por për shkatërrimin e Jugosllavisë. Të njëjtat fjalë po i thotë edhe Uka. Pse me u përputh fjalët e serbomëdhenjve me të Ukës? Qëllimi i serbomëdhenjve është me e shtremrue rrugën e drejtë të Lëvizjes dhe me e humbë drejtimin e vetë Lëvizja, pasi që kërkesën për Republikë po e përkrahë tërë populli shqiptar dhe popujt e mbarë botës. Serbomëdhenjtë po mundohen me na larguar prej kësaj rruge të drejtë e me ne shti me luftua, për çka po dëshirojnë serbomëdhenjtë. Serbomëdhenjtë dëshirojnë me luftue për me e shkatërrue Jugosllavinë, pasi e dinë se një punë të tillë nuk mundemi me e arrijtë por vetëm e vetëm me na shkatrrue më lehtë, kurse nga ana tjetër po don me na shti me luftue kundër atyre të Vjenës (diplomatëve të Shqipërisë-shën i Xh D) dhe udhëheqësve të tyre e me na bë mish për top. Të gjithë ata që ia hyjnë asaj pune kanë me përfundue ashtu si ka përfundua mërgata e qyqeve dhe puna e tyre ka me përfundua me turp.

Pra i nderuari vëlla, duhet ta kemi të kjart; të gjithë ata që në këtë etapë luftojnë me e shkatrrue Jugosllavinë e jo për Republikë janë agjenta të serbëve dhe qëllimi i tyre është me e shkatrrue Lëvizjen. Ne nuk do të lejojmë Ukën me u marrë me punë të tilla kurrsesi, pasi që ajo punë shkon vetëm në interes të serbëve e jo të popullit shqiptar.

Ti duhet të jesh vazhdimisht në kontakt me Skenderin e me Aliun, se vetëm ata e kanë të kjartë se si duhet me punue dhe puna e tyre është e drejtë.

U njoftova se shokët që janë kanë në burg, qenka lëshue, shumë u gëzova.

Edhe një gjë duhet me e ditë se Komiteti Qendror i Lëvizjes është në Kosovë të cilin Uka po don me e shkelë dhe me u bë vet kryetar e me e que Lëvizjen kah po dojnë ata që janë mbrapa Ukës. Anëtarë të Komitetit Qendror të Lëvizjes janë shokët e Sokolit të cilët Uka i urren për vdekje dhe don me shkelë mbi ta. Këtë punë nuk e kam ditur deri sa e kam parë vet se çfarë njeriu është Uka. Edhe udba e din se Komiteti Qendror është në Kosovë por kurrsesi nuk po mundet me e zbulue dhe nuk ka me zbulua kurrnjëherë, pas që ata janë njerëz të dijshëm dhe të fortë e jo si IK apo si Uka, që e urrejnë njëri-tjetrin për vdekje. Lëvizja është në Kosovë e në viset tjera shqiptare në Jugosllavi bashkë me Komitetin Qendror, kurse përjashta është vetëm një pjesë e vogël e Lëvizjes dhe ne na duhet me ba çka thonë ata që janë në Kosovë e jo çka thotë Uka.

Të fala vëllazërore, M. (Mërgimi=Sabri Novosella)

PS. Ne jemi bashkuar dhe prapë do të jemi të bashkuar, por nuk do të bëhet ashtu si thotë Uka, por si thotë Komiteti Qendror e jo si deri më tash; ne ia dërgojshim Ukës e Uka i mshefke, nuk ua jepte juve dhe nuk i botonte në Organ.

22.Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 16 janarit 1984

(Letër e Sabri Novosellës për Xhafer Durmishin dhe Faridin Tafallarin)

Vëllezër të nderuar S. e F. 16 janar 1984

Sot më ra në dorë proqesi i komisionit të mbajtur për rastin e U. (Xhafer Shatrit) i cili ishte i shkruar me dorë të I. (Ibrahim Kelmendit). Së pari po kërkoj falje për këto që do t'i them, pasi që ndoshta fjalët e shënuara në te nuk janë të juajat por të shkruara me kokë të vetë nga Ibrahimit. Nëqoftëse janë të thanuna nga S. (Xhaferi) e F. Faridini pak po habitem. **S. (Xhafer Durmishi) thotë se nuk jam për ate që të bazuar në Shq (Shqipërinë) të akuzohen shokët dhe vazhdon se Mërgimi ka qenë i ndikuar nga diplomacia lidhur me sjelljet e tij**.

Unë jo vetëm se kam qenë i ndikuar nga ata, por fjalët e tyre kanë qene fakti i parë në të cilin jam bazuar, kurse fakti i dytë ka qenë ajo kur e pash me sy të mij, kur ju tha të tjerëve: A i pe shpijunat e Shqipërisë dhe duhet të ruhemi nga shpijunat e tyre.

Për çdo kend që i ka dy kokrra mend në kokë, njeriu që i thotë tjetrit shpijun i Shqipërisë, duhet ta dij se vetë është shpijun i UDB-së. Vjen pyetja; nëqoftëse dikush e akuzon tjetrin se është shpijun i Shqipërisë, vetë shpijun i kujt është. Pasi këto fjalë i tha U. Para syve të mij dhe i kisha faktet që m'i kishte thënë Profesori dhe m'i kishi përcjellë edhe ju fjalët e E. Engjëll Kolanecit, gjë që plotësisht u përputhshin, për mua nuk patë më kurrfarë dyshimi se U. Është i tillë. Këtë fakt e pa çdo kush në tryezë dhe në dorë. U. është njeri i mërgatës së qyqeve dhe të gjithë ata që janë të mërgatës së qyqeve, janë shpijuna të UDB-së, gjegjësisht të gjithë ata që janë kundër Tiranës, janë në shërbim të Beogradit në një mënyrë ose në një tjetër. Përndryshe unë aty e pash një frymë antiShqipëri e cila më tmerroj.

Zoti U. më tha me gojë të vetë se, nëqoftëse do të del në botën e jashtme Rexhep Mala, së pari do ta urdhëron vëllaun e tij me bisedua me te dhe me ia largua frymën që e ka, pasi që të gjithë ata që po vijnë prej mbrendshmit, po vijnë me frymë të atjehit; me dashuri për Shqipërinë dhe për udhëheqësit e saj. Pasi t'ia mbushë mendjen Rexhepit vëllau i vetë, atëherë edhe ne i ndihmojmë e e kthejmë kundër tyre. Se ka vepruar kështu edhe me të tjerët e pash edhe vet ashtu si e keni parë edhe ju; kishte përgatitur njerëzit dhe i kishte bërë ashtu si ishte vet dhe faktikisht aty e kishte formuar bandën antiShqipëri. Do të shifni se ku do ta qoj zotin U. ajo veprimtari e poshtër e tij. Për gjakun e dëshmorëve, sa m'u ka dhimbt Rexhep Mala, aq edhe ia pata lakmi që e dha jetën si patriotë e me atë frymë që e ka pasur deri në çastet e fundit të jetës, dhe nuk doli rrugëve të botës me manipuluar gjithfarë njerëzish të poshtër me te dhe me ia turbulluar mendjen dhe ndjenjat e pastërta.

Jo U., por edhe Adem Dema-Demaçi do t'i thojsha se është shpijun i UDB-së, po t'i thoshte ato fjalë, pasi ato fjalë e vërtetojnë më së miri se kush është i udbës e kush kundër. Luftëtarët e lirisë i lidhë ideali, jo kumaria e akraballëku. Luftëtarët e lirisë janë të lidhur në mes veti deri sa i kanë të njëjta idealet, por kur idealet e tyre ndahen, edhe ata ndahen e shndërrohen në armiq të përbetuar....

Sa i përket asaj se unë paskam folur keq për Zeqën, kjo ka qenë kështu: Më pyeti Uka se pse janë prishë Jusufi me Zeqën kohëve të fundit? Ju përgjegja ashtu si ka qenë. Pas bisedimeve në Stamboll, Zeqa ia kishte dërguar një vendim të rrejshëm se gjoja ishte formuar "Fronti për Republikën e Kosovës", gjë që Sokoli ishte hidhëruar së tepërmi dhe i kishte thanun në një letër: Çdo gjë që e ka fillimin në gënjeshtër është e gjykuar në dështim që në fillim. Në lidhje me bisedimet e Stambollit ia pata dërguar një letër të Sokolit Ukës e cila ia kishte luajtur mendjen dhe tash po mundohet me qpifë diçka kundër meje në atë drejtim, por atë letër po ua dërgoj edhe juve. IK e ka edhe ai një hall tjetër: i

kishte thënë dikujt se gjoja unë e paskna “prishë” me Sokolin dhe ia dërgova një letër të Sokolit që ma ka dërguar me kohë dhe ajo ia kishte luajtur mendjen, pasi Heroi Sokol e ka treguar me fakte se kush është IK dhe unë jam ai që kam bërë çmos që Sokoli mos ta largoj krejtësisht IK-në.

Sa i përket asaj që nuk jam konsultuar me shokë para se ta akuzoj zotin U., unë zotin U. nuk e kam akuzuar në emër të shokëve, por në emër tim personal. Unë nuk kam dashtur me akuzuar U. në emër të shokëve, pasi që e kam pasur parasysh se ndoshta dikush pajtohet me qëndrimet e tij dhe nuk kam dashtur askujt me ju imponuar dhe me qenë i detyruar me vepruar ashtu si i them unë, por të vendos ashtu si t'ia merr mendja dhe si gjykon vetë më së miri. Unë i kam pasur dy rrugë ose të ndahem me U. ashtu si u ndava, ose me i marrë të gjitha marrinat e tij mbi vedi dhe me u marrë me oportunizëm ashtu si qesh i detyruar me u marrë qysh prej fillimit që U. depërtoj në radhët tona.

Në këtë proces pash edhe këso faktesh ku ishin thënë edhe nga IK dhe ju të tjerët të cilat bazoheshin në fakte të pamohuara: Redaksi ka qenë një person, udhëheqësi e Lëvizjes ka qenë një person. Do me thënë ai person është njeri me emrin "Ujkan". Këto nuk i ka bërë pa qëllim zoti U. por me qëllime të poshtra. Si egocentrist i sëmurë ka dashtur me iu imponuar të tjerëve si "autoritet" dhe me manipuluar me ta ashtu si i teket, apo ashtu si e urdhëron dikush.

Kurse për korrespondencën më Nuhiun, Abdullahun e Osmanin, Uka vazhdimisht ka mbajtur një korrespondencë të poshtër, ku është munduar vazhdimisht me e ruajtur njëfarë “miqësie” me ta dhe me e rritë konfliktin në mes nesh dhe atyre dhe me ia bërë ashtu si më tha në mbledhjen e parë dhe ato fjalë janë inçizuar në magnetofon: Ju me Abdullahun jeni munduar me ia hedhë njëri tjetrit, kurse vetëm ne kemi punuar, d.m.th. të gjithë qenkan marrë me punë të kota dhe vetëm Uka paska punuar.

Ajo që thuhet se ZK del duke pasur si busullë Nova Hrvatskën është plotësisht e vërtet, do me thënë ZK nuk e ka busullë Komunikatën e bashkimit dhe artikujt e Z. Popu. të cilët bëjnë fjalë për çështje të Kosovës që janë në të vërtetë busullë për të gjithë dhe për ZK, por organet e hrvatve, kroatëve me të cilët kishte kontakte të vazhdueshme pa u konsultuar me askend, por edhe me do fashista bullgar të cilët i erdhën në shtëpi derisa isha unë në shtëpi të tij. ... Për numrin e 7 njerëzit kanë vërejtje, por edhe ata të Sh.A. (Shqipërisë). Aty ku thuhet: "Lëvizja nuk është bisht as instrument i askujt." Këto fjalë janë të drejtuara në adresë të Sh.A. i ka të kjarta çdo kush kush e sidomos ata që ju drejtohen ato fjalë. Unë ju thash atyre se, ato fjalë janë të thanuna prej U. në kokë të vetë e jo qëndrime të Lëvizjes.

E përfundoj këtë letër duke ju përcjellë ngushëllimet e të gjithëve për vdekjen heroike të dy shokëve në Kosovë.

M. (Sabri Novosella)

PS. në atë proces mungonte faqja 10.

23. SABRI NOVOSELLA PËR FARIDIN TAFALLARIN (31 JANAR 1984 DHE 10 MAJ 1984)

31. 01. 1984

I nderuari vëlla e shok F! (Faridin)

Letrën tënde bashkë me dy letra të Heroit Sokol (Jusuf Gërvalla – shb) i mora dhe i lexova me kënaqësinë më të madhe. Letrat e Heroit Sokol m'i përkujtuan letrat e tij nga të cilat kemi mësuar të gjithë sa herë që na kanë ardhur. Kurse letra jote e sinqertë dhe me dëshirat më të mira për unitet të plotë më gëzoi shumë.

Çështja e bashkimit është çështje e kryer. Askush nuk mundet ta shkatërrojë këtë bashkim. Ju lutem edhe njëherë, lexojini materialet që ju kanë ardhur nga ana e KQ (Komitetit Qendror të LRSHJ-së – shb) e që jua dërguam ne. Ju lutem t'u përmbaheni fjalëve të Heroit Sokol që i paska thënë edhe në këtë letër të tij: "Materiale të tilla nuk bën të lexohen vetëm si artikuj gazete a si roman. Ato duhet të lexohen, të përvetësohen, në mos në tërësi së paku pikat kryesore duhet të zotërohen patjetër". Duke lexuar këto materiale do të shohësh se çfarë dallimi ka në mes atyre që thotë Uka (Xhafer Shatri – shb) në ZK, artikuj të shkruar nga Uka, dhe materialeve të KQ që të kanë ardhur e do të vijnë vazhdimisht. Është e vërtetë se ne kemi gabuar kur e mbrojtëm Ukën që në fillim, kur na u dhanë faktet se Uka është i qitur nga serbët. Atëherë nuk deshëm ta besojmë se kush është Uka (ty personalisht dhe shokut S., /Xhafer Durmishit – shb/ si edhe mua dikush na i ka thanë ato fjalë që në fillim). Ne nuk i morëm fjalët e Engjëllit (Engjëll Koloneci, zyrtar i ambasadës shqiptare në Vjenë – shb) e të kolegëve të tij si fakte që duhet t'u përmbaheshim, por ato fjalë na shërbyen kundër atyre që na i thanë. Ky është gabimi ynë më i madh që kemi bërë ndonjëherë. Na është dashur që atëherë me i vu gishtin kokës dhe mos me e leju Ukën të bëjë marrinat që i ka bërë vazhdimisht dhe krijoi, atje ku është, frymën kundër shtetit tonë, ashtu si e ke parë vetë. Të gjithë ata që janë kundër tyre janë edhe kundër kombit shqiptar, me siguri edhe kundër Kosovës; në veçanti Uka është armik i tyre dhe i tërë kombit shqiptar, ashtu siç janë edhe Lekë Zogu e të tjerët si ai. Uka flet me fjalët që i dëshiron UDB-ja. UDB-ja na akuzon se duam ta shkatërrojmë Jugosllavinë e Uka vazhdimisht thotë këto fjalë në vend që të thotë se Lëvizja është duke luftuar për Republikë në kuadrin e Federatës.

Rrenat e Ukës se po punoka 12 orë në ditë në makinë janë të poshtra. Uka nuk ka çka të punojë nga 12 orë në makinë, pasi ZK po del një herë në dy muaj nga 16 faqe, shumica me materiale të gatshme, përveç atyre poshtërsive që thotë në emër të Lëvizjes pa u konsultuar me askënd dhe krejtësisht kundër Lëvizjes. Sa për atë që paska thënë se paska vuajtur edhe për bukën e gojës, ajo është poshtërsia më e madhe që mund ta thotë vetëm një njeri si Uka, pasi Uka i ka pasur dhe i ka të gjitha mjetet që mblidhen për ndihma për Kosovën. Deri më sot këto ndihma ai i ka keqpërdorur pa u konsultuar me ty dhe ka manipuluar me ty si ka dasht, gjoja se të ka konsultuar për ato ndihma duke të dërguar ndonjë vërtetim se sa para kanë ardhur. Ai zotëri ka dërguar edhe armë në Kosovë, për çka kemi fakte të sigurta. Ai ka thënë para më se 400 punëtorëve se R. Mala dhe N. Berisha kanë qenë të armatosur me armët më të përsosura që ka sot Evropa. Atëherë kush ua paska dërguar ato armë dhe kush e paska autorizuar zotin Ukë t'ua dërgojë ato armë???

Edhe për këtë Uka ka me dhanë llogari si për të gjitha poshtërsitë e tij të tjera. Uka jeton në banesë komforte dhe me mobilje komforte, të cilat janë blerë me djersën e punëtorëve.

Ai shëtit me veturë lluksoze e cila udhëton me benzinën që blehet me djersën e punëtorëve. Kurse deri më sot asnjë frangë nuk u ka dërguar atyre për të cilët mblidhen ndihmat për Kosovën, përveç ndonjë shoku të vet me të cilin manipulon në mënyrë të poshtër. Kur e pyeta unë se pse vepron kështu, Uka më thotë se nuk ditka asgjë për këto, por për to ditka vetëm F, (Faridin Tafallari – shb) i cili është i ngarkuar me ato punë. Kur pyeta S. (Xhafer Durmishi – shb) ai më tha se F. i dërgojnë vetëm disa vërtetime të pagesave dhe asgjë tjetër. Mirë shoku F. po të pyes se kujt i paska dërguar Uka ndihma në Kosovë nga ndihmat që janë grumbulluar për atje përveç ndonjë shokut të Ukës? (nuk ka nevojë me tregu emrat e njerëzve, por vetëm sa vetave). Edhe për këto ka me dhanë përgjigje zoti Ukë e do mundohet me të përlye ty. Të lutem të jesh i kujdesshëm dhe mos e lejo të manipulojë me ty.

Përsa i përket M. Hotit, (Musa – shb) me të kemi mbajtur korrespondencë edhe unë, edhe Uka vazhdimisht dhe jemi munduar që sado pak të kthejmë njerëzit në rrugën tonë. Për atë që thua se M. Hoti qenka kriminel, unë mundem me thanë se gjyqi ndërkombëtar i Hagës nuk e liroi atë si kriminel, por si njeri të pafajshëm, i cili e ka kryer veprën në vetëmbrojtje të domosdoshme; për këtë ekziston dokumenti i gjyqit të Hagës. Domethënë se edhe Sokolit (Jusufit – shb) që vret kriminelët e UDB-së paska pas me i thanë dikush se qenka kriminel. Ju lutem mos më keqkuptoni, sepse e di që këto fjalë nuk janë tuajat por të IK (Ibrahim Kerlmendit – shb) të cilin nuk e dimë çka është, por të gjithë e dimë se është ngatërrestar, e ti këtë e di më mirë. Pështjellimet që po bën atje IK janë ato poshtërsi ku po mundohet zoti Ukë me më futë edhe mua. Por edhe kjo do të shihet se çka është. Përsa i përket asaj që thua për vëllaun e M. Hotit, me siguri duhet të jetë e vërtetë, se më tepër të besoj ty se kujtdo tjetër. Për të edhe M. Hoti më ka thënë se nuk ka asgjë prej tij, por po mundohemi me e kthye në rrugë të mbarë. Kur keni shkuar ju atje, sikur asgjë mos paçi arrit me ba, keni krijuar një frymë të mirë dhe keni futur frymën e Lëvizjes, gjë që ka ndikuar shumë në frymëzimin e njerëzve me atë frymë. Kurse IK dhe Uka kanë pështjelluar vazhdimisht atje. Uka mban lidhje direkte me Enver Hadrin dhe me Gani Azemin, gjë që nuk e kemi parë si të keqe, sepse kemi menduar se po mundohet me i qitë në rrugë të mbarë; por si ka me i qitë në rrugë të mbarë kur ai vetë ishte në rrugë të gabuar.

Përsa i përket asaj që Uka nuk ka punuar kundër shokëve tanë atje, i kemi faktet në dorë. Uka u thotë njerëzve me përzanë rromet shokun S. në qoftëse shkon edhe njëherë atje, kurse shoku S. ka qenë i ngarkuar me atë detyrë. Uka u mundua njëherë me na i shkatërru edhe shokët e Komitetit Qendror që veprojnë në Kosovë ashtu si shkatërroi Rexhep Malën, të cilit i dërgoi 2000 copë të ZK me njerëz pa fijen e përvojës. Sapo ranë në dorë të UDB-së ata dy djem, me disa shuplaka i treguan njerëzit për të cilët ishin dërguar ZK, dhe ai njeri kishte qenë R. Mala. Këso poshtërsish mund t'i bëjë vetëm një njeri i krisur apo një agjent i UDB-së e askush tjetër. Si ka mujt me i dërgu gjithë ato materiale një njeriu si R. Mala, i cili ka qenë i liruar prej burgut vetëm para pak kohësh dhe në çdo hap ka qenë i ndjekur duke mos mundur të kontaktojë me njerëzit e caktuar për të shpërndarë ZK. Kështu donte t'ja bënte edhe shokëve të Komitetit Qendror e kërkonte t'i fuste në kontakt me ndonjë shok të tij, sigurisht me ata djelmoshat pa përvojë për t'i shkatërruar njerëzit. Edhe për këtë Uka ka me dhënë llogari.

Uka rren se shokët e Komitetit Qendror nuk kanë dërguar materiale në Redaksi. Vazhdimisht ata shokë, nëpërmjet meje, i kanë dërguar materialet dhe Uka asnjëherë nuk i ka botuar, pasi Uka ka qenë armik i Lëvizjes dhe ato materiale kanë qenë të shkruara për Lëvizjen e jo kundër Lëvizjes, ashti siç po shkruan zoti Ukë. Uka asnjëherë nuk ka

shkruar ndonjë raport ku t'i njoftojë shokët për të gjitha ato para që mblidhen tek ai dhe për veprimtarinë e Redaksisë. Më ngjan se Redaksia as që ekziston, pasi Uka nuk ka dashur të ketë Redaksi, por ka dashur të jetë vetëm në Redaksi dhe ka manipuluar si ka dashur vetë, apo si e ka udhëzuar dikush që gjendet prapa tij.

I nderuar shoku F!

Dije se për ty dhe për çdo njeri të ndershëm nuk është e lehtë të përballohen këto gjëra, por çfarë t'i bëjmë, lufta është e tillë. Pa këto probleme nuk mund të ekzistojë lufta jonë ashtu si nuk mund të ekzistojnë luftrat e popujve të tjerë që po luftojnë për liri. Unë po të këshilloj të takohesh njëherë me shokun e Vjenës (Engjëll Kolonecin, në ambasadën e Shqipërisë – shb) dhe të bisedosh me të për këto çështje. Duhet ta dish mirë se të gjithë ata që janë kundër tyre do të përfundojnë me turp e unë një përfundim të tilë nuk ta dëshiroj ty ashtu siç nuk ia dëshiroj asnjë shokut tonë të ndershëm. Që në fillim çfarë na kanë thënë ashtu na ka dalë, çfarë nuk kemi dëgjuar keq na ka ra. Ne nuk i dëgjuam për rastin e Ukës që në fillim dhe po shihet si po na dalin punët. Kur ishim në banesën e Haxhiut ti the se të gjithëve kështu do na e bëjnë. Kjo nuk është e vërtetë. Ata deri më sot na kanë thënë vetëm për Ukën dhe i kanë thënë Sokolit për IK me e përzanë si qenin; për askënd tjetër nuk na kanë thënë asgjë të keqe. U pa se me të vërtetë mirë e paskan pasur. Të kishim vepruar si na thanë ata, nuk do të vinin të gjitha këto, por të gjitha këto do të përfundojnë si është më mirë dhe çdokush ka për të marrë atë që meriton.

Po e përfundoj këtë letër duke të porositur edhe njëherë që të takohesh me shokun e Vjenës dhe vazhdimisht të konsultohesh me të. Mbetem në pritje të letrës tënde të ardhshme. Ndërkohë ne do të vazhdojmë të punojmë në rrugën tonë të drejtë dhe në të ardhmen e afërt do të shihet se kush është zoti Ukë. Ne do të punojmë drejtë dhe e drejta do të dalë në shesh. Uka do të jetë i detyruar t'ia dorëzojë teknikën dhe mjetet atyre që u takojnë dhe me to do t'i shërbehet Lëvizjes e jo atyre që duan t'i manipulojnë ato.

Të fala të përzemërta dhe revolucionare

(S. Novosela) M.

24.Letër nga Sabri Novosella për Komitetin Qendror të LRSHJ në Botën e Jashtme, 6 mars 1984

Shokëve të KQ në BJ (Komitetit Qendror në Botën e Jashtme)

U njoftova për vendimet e marura në mbledhjen e fundit (të 3 marsit 1984 në Gjenevë-shën i Xh D), me të cilat pajtohem duke shpresuar se nuk do të bëhen më shkelje e vendimeve të shpallura me Komunikatën e Bashkimit, por gjëja më me rëndësi kishte mbetur pa u zgjidhur në atë mbledhje; çështja e redaksisë. Për këtë arsye dalë me këto propozime:

–Të formohet sa më parë Redaksia prej 5 anëtarësh. Nga krahu ynë të caktohen Aliu dhe S. (Asllan Muharremi dhe Xhafer Durmishi-shën i Xh D). Aliu të inkuadrohet menjëherë në detyrë të caktuar, kurse S. më vonë, sipas nevoje. Për anëtarët tjerë të vendosin shokët e krahut tjetër.

–Të vendoset dhe të nxirret Organi rregullisht për çdo muaj, pasi që ekzistojnë mundësitë kadrovike, materiale etj. pasi që kërkesat janë shumë të mëdha, ku shifet edhe

nga një poezi, të botuar kohëve të fundit në Rilindje, ku i bëhet thirrje masës nëpërmes vargjeve që të informohet nga "Shtypi ilegal", për ngjarjet e vërteta.

–Të bëhet një autokritikë, për disa lëshime të vogla në disa numra të mëparshëm të cilat më nuk do të përsëriten.

6 mars 1984 Përshëndetje revolucionare, M. (Mërgimi=Sabri Novosella)

PS. Shoku F. ju lutem e shumëzon në disa kopje dhe ua dërgon të gjithë shokëve të KQ në BJ nga një kopje.

+++++

25. DISA VËREJTJE NË PIKA TË SHKURTËRA NË LIDHJE ME NUMRIN E FUNDIT TË "ZËRIT TË KOSOVËS"

Nuk do të ndalem gjatë në analizimin e këtij numri të ZK, duke shpresuar se do të jetë numri i fundit me lëshime kaq të rënda, por po i cek vetëm disa nga më karakteristiket:

– Edhe ky numër i ZK është fletushkë e një personi e jo Organ i LRSSHJ pasi asgjë nuk ka në të që e bën një Organ që të jetë Organ i një Organizate të caktuar, përveç disa përkrahjeve sipërfaqësore që ia bën Organizatës Organ i së cilës është.

– Ky numër është i ngarkuar me gënjeshtra që e bëjnë të turpërohet çdo patriot të ndershëm që ka aftësi për me vlerësuar një Organ ashtu si duhet. Në të flitet për dhjetëra mijra traktet që i paska shpërndarë Heroi Rexhep dhe se i vetmi njeri i organizuar paska qenë Heroi Rexhep që qenka dënuar në vitin 1976, gjegjësisht, burgosur në vitin 1975 kur u burgosën rreth 40 (katërdhjetë) patriotë e revolucionarë, në ball me Heroin Adem Demaçi! Po të ishte gjallë Heroi Rexhep, do t'ia shqyente gojën autorit të kësaj gënjeshtre të turpshme, kurse dihet me fakte se të gjithë ata persona u burgosën dhe u dënuan si njerëz që kanë vepruar në kuadrin e Organizatës patriotike-revolucionare /LËVIZJA NACIONAL ÇLIRIMTARE E KOSOVËS/, kurse nga ana tjetër, vet Uka e ka dokumentin në dorë (Aktakuzën e Heroit Adem Demaçi në ball të 19 të akuzuarve që u dënuan në vitin 1976) në të cilën thuhet se "kan tentuar me formuar organizatën armiqësore LËVIZJA NACIONAL ÇLIRIMTARE E KOSOVËS". Kjo rrethanë nuk e nderon askënd, por tregon dobësinë e personit që ka për qëllim me varrosë edhe veprimtarinë e Heroit Adem e të dhjetëra e dhjetëra të tjerëve dhe me i shpallë si "viktima" të okupatorit, kurse nga ana tjetër me nxjerrë vetin se gjoja paska qenë i "vetmi" njeri që paska punuar pranë tij, ndonjë Rexhep dhe ndojë Kadri.

Këtyre marifetllëqeve po ju hyn Uka në stilin e A. Prapashticës dhe po i tregon qëllimet e veta edhe më mirë prandaj nuk kanë si me përfundue pa pasoja të rënda.

Për hir të së vërtetës, duka pasur bindjen se ka ndokush nga anëtarët e lartpërmendur që, nuk e din këtë të vërtetë, po japim një sqarim shkurtimisht: UDB-ja kishte fakte në dorë për aktivitetin e LËVIZJËS NACIONAL ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS, por nuk kishte kurrë një fakt për asnjë anëtar të saj. Kishte supozime se edhe kjo Organizatë është vazhdim i Organizatës LRBSH të formuar në vitin 1962 nga Heroi Adem Demaçi, por gjithnjë pa pasur mundësi t'u bjerë në gjurmë, pasi në të vepronin njerëzit me përvojë të duhur dhe nuk bënin gabime. Në vitin 1975 u burgosën në bazë të supozimeve shumë luftëtarë të Lirisë, sidomos të aktivistëve të viteve 1968, pasi që UDB-ja kishte

indikacione se LRBSH po në atë vit u riorganizua në LNQK (më vonë e zgjeroj emrin me kërkesën e aktivistëve jashtë Kosovës në LNÇKVSHJ) në LNQKVSHJ.

Për këtë arsye u burgosën shumë prej tyre në ball me Heroin Adem Demaçi i cili nuk qenka marrë me aktivitet patriotik gjatë 16 muajve që qëndroi në Kosovë dhe jashtë Kosovës, por ia paska vjedhë kungujt e arave të Tomocit, ashtu si po del nga filozofimet e Ukës. Ndoshta për atë e paskan burgosur! Shkurt, për këtë ekzistojnë dokumentet: Gjatë tërë gjykimit që u mbajt në fillim të vitit 1976 ku u dënua Heroi Adem Demaqi vetë i nëndëmbëdhjetë absolutisht nuk u bë fjalë për GRUPIN REVOLUCIONAR të Ukës, por u bë fjalë për LËVIZJËN NACIONA ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS. Në atë gjykim nuk është dënuar i vetmi, Heroi Rexhep, si i riorganizuar ashtu si gënjen Uka, po përveç të tjerëve është dënuar edhe Celula e Rexhepit, janë dënuar shumë të tjerë të…, ka pasur ndonë viktimë. Çdo nder e respekt shokëve të GRUPIT REVOLUCIONAR, por gënjeshtra askënd nuk e nderon e më së pakut autorin e gënjeshtrës. Eshtë fakt se është ndjerë aktiviteti i Ukës në atë periodë, por disa herë është biseduar në mesin e kuadrove çështja e tij dhe të gjithë jemi habitur se si nuk po burgoset, pasi që aktiviteti i tij ka qenë thuajse legal, pasi që shkonte në Universitet dhe ua tregonte revolen studentëve duke e çelur pallton e duke i dalur revolja në brez. Këtë ia kam thënë Ukës, kurse kuadri i lartëpërmendur që e pat shtruar këtë çështje të Ukës atëhere, ende është gjallë e nuk ka vdekur.

Të gjithë shokët kanë qenë të bindur se është fjala për një spiun, ashtu si u bë edhe shoku i tij, me të cilin ra në burg në vitin 1969, Islam Blakaj, për të cilin tash po shkruan në ZK për ta demaskuar. I vetmi person që e kam mbrojtur, kam qenë unë dhe me këmbënguljen time është caktuar aktivisti për me e këshillue dhe me udhëzue dhe pasi e mori në dorë ai person edhe Uka ndryshoi qëndrimin. Por ishte bërë vonë, pasi që Uka me veprimet e veta ishte zbuluar qysh në atë kohë, por UDB-ja mundohej që nëpërmes tij me ra në udhëheqësit e LNQK. Kur e pa se nuk po mundet me ia arritë qëllimit, u burgos vet i pesti. Uka gjatë hetimeve, çka është e vërteta nuk e qiti aktivistin e lartëpërmendur edhe se në atë kohë, me vendimin e Beogradit ka qenë ndaluar tortura (kjo ka qenë një kohë e shkurtër, pasi që në atë kohë u dënua edhe partia e Dr. Boskoviqit. Kemi supozuar se ky fakt ka ndikuar që ndaj këtij grupi në atë kohë nuk është bërë tortura). Këta ma ka thënë edhe një shok i Ukës, po sa doli prej burgut dhe erdhi e më vizitoi, pasi që unë kisha mundësi me shkue te Ai.

Edhe një vërejtje: Pa marrë parasysh mendimet dhe bindjet tona për Shaban Polluzhën, çka e ndihmon luftën për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi, aktualizimi i tij dhe i luftërave të tij në këtë etapë, deri sa dihet se kundër tij kanë luftuar të gjithë ata që po i quajmë heronj; Gjeladin Hana, Rifat Berisha, por ashtu si na tha me një rast Profesori mua dhe Skënderit: "Të gjithë ata që e përkrahin veprimtarinë e Shaban Polluzhës, shkojnë me të, pasi ne kemi luftuar kundër tij dhe kundër atij që kemi luftuar, ne e kemi armik përgjithmonë". Ne i thamë se Shabani përmendet edhe në librin SHOTA DHE AZEM GALICA, ai na u përgjegj: "Kjo ka qenë gabim".

Kurse thirrja që të vazhdohet epopeja e Shaban Polluzhës, e cila paska filluar me krismat e armëve të Rexhepit e të Nuhiut, ashtu si shprehet Uka në këtë numër të ZK, tregojnë më së miri se Uka jo vetëm i shkel vendimet e bashkimit të shpallura në Komunikatë, por tregon se është armik i përbetuar i LRSSHJ dhe se kjo thirrje e tij, përputhet plotësisht me akuzat që po na i bën Nikolla Lubiqiqi dhe serbomëdhenjë të tjerë dhe zagarët e tyre. Ju lutem shokë, sidomos këtë analizoni sa më mirë se kjo është ajo që po kapemi më së

tepërmi dhe kjo duhet të ndërpritet sa më parë, ose do të ndodhë më e keqja në qoftë se vazhdon edhe pas tashit. Në fund po e cek edhe një rast që e tregon dobësinë e Ukës, i cili me këtë tregon dëshirën, jo vetëm që të lihet në harresë një person, por të lihet në harresë edhe një fazë e aktivitetit të luftës së forcave patriotike-revolucionare në ballë me Heroin Adem Demaqi:

– Para gjashtë muajve ju dërgua një material i gjatë për dëshmorin Hilmi Rakovica në të cilën bëhej fjalë për veprimtarinë e Dëshmorit dhe njëkohësisht të vetë Organizatës në të cilën ka milituar. Këtë material e vlerësoi një person që i ka shkruar 12 vepra të gjinive të ndryshme dhe e quajti, shumë të mirë dhe të shkruar në një stil të lartë. Kurse Uka e botoi një shkrim të vetin me llapa-llupa të zakonshme të tij, kurse materalin e përgatitur me shumë kujdes ashtu si shumë materiale të tjera, e hodhi në shportën e mbeturinave, kurse nga ana tjetër edhe se nuk tha kurgjë faktikisht për Dëshmorin në krahasim me ato që ishte dashtë të thuhet në materialin e përgatitur, por shkrimi i Ukës ishte ngarkuar me gënjeshtra naive. Në shkrimin e Ukës mes të tjerash thuhet se, Hilmi Rakovica ka qenë shok i ngushtë i Shaban Shalës, kurse Hilmiu as që ka qenë duke vepruar, por as që e ka njoftuar personalisht edhe se, në materialin e lartëpërmendur përmendet edhe dëshmori Shaban Shala, por jo si shok i ngushtë i Hilmiut, por si një Dëshmor i mëparshëm që e ka dhënë jetën heroikisht!

Mbetem me shpresë se ma nuk do të përsëriten këto gjëra dhe ZK do të jetë me plot kuptimin e fjalës Organ i LRSSHJ.

Përshëndetje vëllazërore e revolucionare,

Mërgimi (Sabri Novosella)

12.03.1984

26.Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 23 mars 1984

SHOKVE TË KQ NË BOTËN E JASHTME

Shokë të nderuar,

Më ra në dorë një letër e shokut IK e cila ishte shkruar para sa kohësh, por nuk kishte ekzistuar mundësia me më ardhur më heret dhe më erdhi me një vonesë mjaft të madhe.

Pas marrëveshjes që u arrijt në mbledhjen e fundit, gjë që dëshiroj të jetë marrëveshje e suksesshme dhe mos të kemi më nevojë të ulemi dhe të analizojmë punën e kaluar dhe të marrim vendime për punët që i kemi përpara, nuk e shof të arsyeshme të mabjmë korrespondencë veç e veç, por të gjithë çka të kemi për të thënë, t'i themi para forumit të caktuar, apo t'i shkruajmë atij forumi edhe kur kemi me i thënë diçka vetëm njëri-tjetrit, ashtu që të jenë në dijeni të gjithë shokët e KQ në BJ për çdo gjë.

Njëkohësisht më nuk guxojmë të merremi me poltronizëm dhe t'i mshefim njëri-tjetrit gabime që të mos i mbetet hatri dhe të mos prishet jarania që ekziston në mes personave të caktuar, por të thuhen të gjitha ato se sa të vij puna ashtu si erdhi kohëve të fundit. Ku disa shokë më thonë se jam ngut, por qenka dashur këto punë me i lanë që kadal-kadal me dalë në shesh më vonë. Ky do të ishte gabimi i madh i dytë që do të bëhej,

pasi që gabimi i parë është bërë qysh më para, kur i kemi vërejt të gjitha gabimet e Ukës, por kemi heshtur, apo i kemi thënë në mënyrë të tërthortë që të mos bëhet ndonjë thyerje e ky gabim na ka kushtuar edhe pas tashit, pasi që gabimet që janë bërë nga ana e Ukës, ato nuk janë gabime por faje të rënda që e qojnë njeriun në tradhti të hapët.

Shoku I.K. në letër, në mes tjerash më thotë: -Ti po ma mohojshe se kam qenë anëtar i QE. Unë prapë po them se, jo vetëm IK, por edhe F. dhe S. kanë qenë anëtarë të atij forumi de jure, por jo de fakto. Do me thënë se kanë qenë anëtar formal e jo anëtar me plotkuptimin e fjalës. Po nëse paskeni qenë anëtar me plotkuptimin e fjalës, atëherë mbani përgjegjësi për fajet e Ukës, që i bëri me vetëdije të plotë kundër Lëvizjes dhe kundër popullit shqiptar. Ne kemi bindjen se Uka, në kokë të vetë i mori vendimet me të cilat e goditi dhe e kompromet oj aq shumë Lëvizjen e jo duke u konsultuar me ju dhe duke e marrur aprovimin e juaj për ato veprime. Nëse nuk është kështu urdhëroni dhe folni.

Kemi bindjen se Uka nuk është konsultuar me ju dhe nuk e ka marrë aprovimin e juaj kur e privatizoi Organin dhe e shndërroi në fletushkë private në të cilën shkruante çka i tekej, apo çka e dirigjonte dikush. Uka bënte thirrje histerike nëpërmes të Organit që të shkatërrohet e sëmura e Ballkanit, kurse në të vërtetë ato thirrje i paska shoqëruar me punë praktike e konkrete: Uka vetë e vërtetoj para më se 400 vetëve në tubimin me rastin e shënimit të dyvjetorit të ramjes së shokëve, kur tha se, Rexhepi dhe Nuhiu paskan pasur armët më të përsosura që i ka sot Evropa. Ky ishte një fakt i vërtetuar me gojë të vet nga ana e Ukës, se me të hollat e tubuara për familjet e dëmtuara nga goditjet e serbomëdhenjve të cilave nuk ju ka dërguar kurrë njëherë e për këtë Uka as që na pyeti ndonjëherë, ne që ishim më të afërmit e tij se, a ka ndokush që është në gjendje të mjeruar që t'i dërgohet ndonjë ndihmë, por me ato të holla paska blerë armë dhe i paska dërguar atje që me to me "fitue" Republikën. Këtë tashti e vërtetoj edhe burgosja e shokëve që u nxunë duke dërguar armë atje dhe ju dha në dorë ajo që e dëshirojshin qysh me kohë serbomëdhenjtë dhe dualën me fakte para opinionit botëror se, gjoja LRSSHJ na qenka organizatë terroriste dhe jo Organizatë e cila lufton me mjete demokratike, për fitoren e një të drejte që e kanë të gjithë popujt e Jugosllavisë, ashti si është në të vërtetë Lëvizja e cila është Organizatë që lufton me mjete demokratike, pa e përdorur dhunën dhe terrorin, lufton me realizuar kërkesën për formimin e një republike si janë gjashtë të tjerat.

Vjen pyetja, a u pyet shoku IK, apo F. dhe S. kur Uka vendosi dhe muar këso aksionesh anti Lëvizje dhe anti shqiptare në këto situata kaq të ndërlikuara ku menxi që presin të tjerët që Kosova të shndërrohet në një Liban të dytë? Në qoftë se shoku IK, F. dhe S. i keni aprovuar këto punë të Ukës, duhet të jeni të sinqertë dhe të mos i vihen të gjitha fajet në qafë vetëm Ukës. Unë them me ndërgjegje të plotë se, mua kurrnjëherë nuk më ka pyetur dhe nuk kam qenë në dijeni për punë të tilla dhe për këtë arsye kërkoj llogari nga Uka për këto veprime të tij.

Pas dërgimit të materialeve të KQ disa aktivistëve të Lëvizjes që të sqarohen shokët dhe njerëzit e ndershëm, pas sulmeve që filloi me i bë Uka, duke e keqpërdorur si zakonisht Organin e duke i quajtur të gjithë ata që ju kundërvihen punëve të tij anti Lëvizje dhe anti shqiptare, fantosha dhe sarhosha, shoku IK i shpalli ato materiale anti Ukë dhe ju tha njerëzve se, janë të shpërndara nga një lahper dhe se janë të dyshimtë. Kuptohet, njerëzit nuk han bari, por kokën e kanë me veti dhe materialet i kuptuan drejtë dhe ato materiale e bënë efektin e vetë në atë situatë të vështirë. Ato fjalë që i tha IK, por jo edhe Uka, së pakut haptasi, pasi që Uka e dinte se kush është autor i atyre materialeve.

Sa zakonisht, për çdo gjë isha konslutua me njeriun kompetent, ashtu si u konsultova me rastin që na pyetën disa shokë në lidhje me nxjerrjen e një Organi lokal. Edhe për këtë rast m'u dha përgjegja tekstualisht: -Të gjithë ata që punojnë, shkruajnë çfarëdo materialesh, parulla, trakte, por edhe organe, në qoftë se bëjnë fjalë për Republikë, jo se nuk guxon askush me i luftuar, por duhet me i ndihmuar me çdo drejtim që është e mundur. Të gjithë ata që i pengojnë, apo i luftojnë janë armiq të Lëvizjes. Në qoftë se del edhe një udbash dhe kërkon Republikë me gojë ose me shkrim, nuk duhet të luftohet, por duhet të ndihmohet e të përkrahet, kurse sot detyrë mbi detyrat është që të rregullohet çështja e ZK i cili aktualisht është duke i shërbyer armikut dhe jo Lëvizjes, Organ i së cilës është.

Që të konsultohem me këtë shok, ju vet më keni autorizuar dhe deri më sot, nuk kam marrur kurrnjë vendim që më ndalohet të konsultohem me të. Për këtë kam autorizim edhe nga të tjerët...

Shoku S. paska thënë se mos të bëjë edhe unë gabime se nuk po mujka me më mbrojtë. Në qoftë se vetëm me një fjalë më ka mbrojtë si person ka bërë gabim shumë të madh. Në qoftë se e mbrojmë njëri-tjetrin, apo e sulmojmë si person e jo si luftëtar të një çështje, është poshtërsia më e madhe. Ne nuk na lidh kurrnjë akraballëk, apo kumari, por na lidh vetëm e vetëm ideali i përbashkët. Vetëm në këto baza duhet me kritikuar, sulmuar dhe me mbrojtur njëri-tjetrin. Ne të gjithëve na duhet t'e mbrojmë Lëvizjen, t'i luftojmë ata që e godasin Atë.

23 mars 1984 Përshëndetje, Mërgimi (Sabri Novosella)

P.S. Ju lutem shoku F., e shumëzon këtë letër dhe ua dërgon të gjithë shokëve nga një kopje, kuptohet shokëve të KQ në botën e jashtme. Besoj se edhe letrën e mëparshme me të njëjtën porosi ua ke dërguar shokëve.

(Faridin Tafallari, T-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 455-457)

27. SHOKËVE TË KOMITETIT VËLLËZËRIT GËRVALLA / KVG

Shokë të dashur

Po ju drejtohem me këtë letër, me shpresë se, sado pak do t'ju ndihmoj me ringjallë KVG, i cili pas ramjes së shokëve Sokol dhe Besnik. Si vazhdon?

Eshtë e ditur se, KVG u minua nga Nuhiu dhe Osmani, po është gabim të shkapërderdhet dhe të punohet në mënyrë stihike, secili sipas dëshirës së vet, apo të shndërrohen njerzit në vegla qorre të ndonjë personi dhe të manipulojë dikush me ta, ashtu si paska tentuar Uka (Xhafer Shatri – Sh.B) duke vepruar me njerëzit. Një gjë e tillë është anti-Lëvizje dhe anti-kombëtare. Uka paska punuar t'i ndërrojë njerëzit në vegla qorre dhe në atë mënyrë të formojë një agjenturë prej njerëzve veç e veç dhe t'i përdorë ashtu si i teket atij, apo si e urdhëron dikush që gjendet prapa tij.

Një gjë e tillë me siguri ka përfunduar, pasi që i hasi sharra në gozhdë dhe puna nuk i pati sukses. Këtë e vërtetoi në mbledhjen e fundit, për të cilën mbledhje ju ka njoftuar shoku F. (Faridin Tafallari – Sh.B) dhe pas tashit nuk ka me pasur guxim me veprue në atë mënyrë, por dhe nuk ka me pasë mundësi, pasi qëllimet e tij janë zbuluar dhe nuk kanë me lejuar shokët me veprue ashtu.

Ne vazhdimisht kemi kërkuar që të punohet ashtu si duhet, duke u organizuar në Komitete të Degëve, ku secili Komitet i degës me i pasur nga disa për rreth, ashtu që puna me shku në mënyrë të mirfilltë e jo në mënyrë stihike. Për çdo gjë me pasë mundësi shokët e Komitetit të Degës me u tubuar dhe me marrur vendim e qëndrim si forum i caktuar e jo me u bisedue për ndonjë çështje gojë më gojë dhe analizimi i asaj çështje me marrë kahjen e thashethemeve ku marrin hov intrigat e gjithëllojshme dhe i sillet dëm i madh Lëvizjes.

Që të mos ndalemi më tepër në të kaluarën, jam i mendimit t'i përvishemi punës në të ardhmen dhe nga kjo bazë shumë e mirë të shkohet përpara me hapa sa më të sigurt. Ashtu si u formuan në shumë vende komitetet e degëve të LRSSHJ, si në Zvicër – Komiteti i Degës: Rafi Halili, në Belgjikë – Komiteti i Degës: Murat Mehmeti, në Suedi – Komiteti i Degës: Nuhi Berisha, i cili është duke u kompletuar dhe në shumë vende të botës, ashtu si edhe në viset shqiptare në Jugosllavi ku kemi qenë dhe po shtohen për çdo ditë e më tepër, edhe te ju është mirë të riorganizohet KVG dhe të fillojë nga funksionimi i mirëfilltë.

Propozoj: Të tubohen shokët F., H., Bashkimi, kurse dy të tjerët t'i zgjidhni ju të tre, në konsultim me shokun S., i cili nuk duhet të jetë në atë Komitet, pasi që është i ngarkuar me punë të tjera, por duhet të konsultoheni me të vazhdimisht.

Ju i njihni më së miri shokët më të mirë që i keni në atë mes aty ku jeni duke vepruar dhe, ashtu si e ceka, i zgjidhni edhe dy shokë prej më të mirëve dhe e formoni KVG. E zgjidhni Kryetarin dhe 4 Sekretarë ku secili vendoset me punë të caktuar dhe secili punon me i përmbushë detyrat që i ngarkohen.

Jam i mendimit që shoku H., të zgjidhet Kryetar, kurse shoku F. edhe se është i ngarkuar edhe në Forumin më të lartë, duke pasur parasysh përvojën e tij, të zgjidhet edhe në këtë forum-arkatar. Është e vërtetë se shoku F., është mjaft i ngarkuar me punë në KQ dhe me klube, por duke pasur parasysh energjitë e tij të pashtershme, besoj se ka me i përballue edhe kësaj detyre me nder, ashtu si i ka përballuar të gjitha të tjerat deri më tani.

Pasi të formoni KVG, atëhere t'i lidhni të gjithë shokët me këtë Komitet në atë mes. Secili, ashtu si i ka lidhjet dhe të formohen celulat prej nga tre anëtarë dhe të punohet në konspiracionin më të thellë. T'i mbani lidhjet e rregullta, së paku një herë në muaj dhe të lexoni materialin që duhet t'ju vijë për çdo mbledhje, ashtu si duhet t'ju shkojë të gjitha komiteteve të degëve dhe të analizohet, të studjohet dhe të përvetësohet ai material; të analizohet puna që është zhvilluar në të kaluarën dhe të merren vendime për punën që është përpara dhe të caktohet detyra për secilin anëtar.

Pasi të mbahet mbledhja e KVG të shumëzohet ai material dhe t'ju jepet celulave, ashtu që edhe ato t'i mbajnë mbledhjet e veta të rregullta. Të përpunojnë materialin ashtu si ju dhe të marrin vendime për punën në zhvillim, të japin propozime, të bëjnë kritikë për çdo gjë që e shohin të arsyeshme se meriton kritikë dhe me shkrim t'u dorëzohet juve, gjegjësisht KVG dhe ju bashkë me propozimet dhe kritikat e tuaja ua dorëzoni shokëve të KQ nëpër mes shokut F., i cili është anëtar i atij forumi.

Materialet e KQ që ju vijnë Komiteteve të Degëve, nuk duhet me u shpërndarë masovikisht, ashtu si vepruan disa shokë, duke mos ditur se nuk duhet, por ato materiale janë vetëm për anëtarët direkt të Lëvizjes, kurse "ZK" duhet të shpërndahet ashtu si është

shpërndarë deri më tani, por edhe shpërndarja e "ZK" duhet të jetë në mënyrë të rregullt, nga Redaksia duhet t'u shkojë Komiteteve të Degëve; kurse Komitetet e Degëve t'ua shpërndajnë Celulave, kurse anëtarët e celulave ta shpërndajnë masovikisht. Kështu të bëhet edhe tubimi i kontributeve dhe i pagesës për "ZK".

Tjetër është dërgesa me postë që ju bëhet shumë mjediseve dhe individëve.

Në mbledhjen e parë që do të mbani, e përpunoni këtë letër dhe materialin që do t'jua dërgoj me këtë letër dhe të vazhdoni punën në mënyrë të mirfilltë e të drejtë.

Ju lutem mos e merrni këtë propozim timin si urdhër, apo si imponim, por si këshillë e një shoku tuaj dhe të Sokolit.

14.04.1984

Të fala vëllazërore dhe revolucionare
Mërgimi (Sabri Novosella)

28. Sabri Novosella për Faridin Tafallarin

10. 05. 1984
Shoku F! (Faridin)
Duke qenë i bindur se je njeri i ndershëm, ashtu siç është edhe H. Mala, i cili është i mashtruar, edhe ti je i mashtruar. Po ta shkruaj këtë letër me shpresë se do ta shohësh të vërtetën, por njëkohësisht më duhet të pastroj ndërgjegjen, së pari për hir të Heroit Sokol, pasi ke qenë shok i tij dhe gjithnjë ndjej obligim për t'i ndihmuar shokët e shokut tim; kurse ti vepro ashtu si ta merr mendja jote.
Po ta dërgoj këtë artikull të gazetave të Beogradit, ku do të shohësh me fakte se me çfarë punësh të liga është marrë Uka, pa u konsultuar as me ty me siguri, pasi edhe ti ke qenë anëtar i forumit. Ai duhej të ishte konsultuar edhe me ty, ashtu si me shokë të tjerë, gjë që nuk e ka bërë kurrë gjatë kryerjes së këtyre punëve të poshtra, të cilat e kompromentuan kaq shumë Lëvizjen dhe na solli kaq dëme të mëdha.
Siç shihet edhe në këtë artikull që po të dërgoj, citohet një artikull i Ukës ku thuhet: Istoria je osudilla Jugoslaviju na smrt, a sinovima Kosova pripada çast da zadaju posledni udarac (Historia e ka dënuar Jugosllavinë me vdekje dhe bijve të Kosovës u takon me ia dhanë grushtin e fundit). Domethënë, Uka ua dha rastin gjykatësve të Beogradit me na akuzu ashtu si kishin dëshirë ata vetë dhe me na shpall ashtu si dëshirojnë ata. Domethënë se, lufta jonë për Republikë ka qenë rrenë, por e vërteta qenka ashtu si po thonë serbomëdhenjtë dhe Zoti Xh. Shatri!!!
Poshtërsitë që bani ky njeri i poshtër dhe agjent i serbomëdhenjve po na kushtojnë aq shumë sa që UDB-ja edhe sikur të kishte dhënë miliona nuk kishte pas me na dëmtue kaq shumë, me siguri.
Sot shkruajnë të gjitha gazetat e botës se si LRSSHJ gjoja po dërgoka armë në Kosovë dhe materiale kompromentuese, kurse e vërteta është se kjo punë nuk është e Lëvizjes, por është vetëm e renegatit Ukë.
Po të njoftoj se së shpejti ka për të dalë ZK i vërtetë dhe ka me ia qit fytyrën në shesh renegatit Ukë; e ti atëherë ke me e pa të vërtetën. Renegati Ukë na e grabiti makinën e Sokolit me dinakëri. Këtë punë nuk kishte për ta bërë as një magjyp që e shet nderin me para e jo më një njeri që i thotë vetes shqiptar. Na i kindapoi ato mjete që i dërgoi populli

për familjet e goditura dhe me to bëri punë që i interesojnë vetëm UDB-së e u mundua me e varros Lëvizjen me ato gjëra të ulta. Lëvizja nuk mundet me u varros, pasi ajo e ka bazën në Kosovë dhe populli do t'i gjykojë të gjithë tradhëtarët e renegatët si Uka. Unë po të them: largohu prej atij të poshtri sa nuk është vonë dhe bashkohu me shokët e Sokolit që i ke atje. Për të gjitha gabimet e tua merre vetë përgjegjësinë.
Përshëndetje Mërgimi (S. Novosela)

(Ngas libri i autorit Faridin Tafallari: Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 249 – 253)

29.Sabri Novosella – Si e themeluam LRSHJ, mars 1992

SABRI NOVOSELLA: SI E KRIJUAM LËVIZJEN PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI (LRSHJ), MË 17 SHKURT 1982 (I)

Pashtriku.org, 19 shkurt 2021; Botuar në revistën Zëri, 28.03.1992

Më 17 shkurt 1982 në Stamboll u themelua LRSHJ-a!
"ZËRI" boton rrëfimin ekskluziv të Sabri Novosellës, veprimtar i shquar në vitet e lëvizjes ilegale patriotike. Novosella tregon për organizatat ilegale të cilat kanë ekzistuar në Kosovë në vitet e 70-ta, për figurat më të shquara të emigracionit politik majtist, për takimin në tetor të vitit 1981 në Stamboll me Kadri Zekën dhe me Bardhosh Gërvallën, për mospajtimet rreth organizimit të një të vetmes organizatë politike midis OMLK-së (të prirë nga Hydajet Hyseni dhe Kadri Zeka) dhe Lëvizjes nacionalçlirimtare (të prirë nga Metush Krasniqi dhe Jusuf Gërvalla), për manipulimet e diplomacisë së Tiranës, gjegjësisht Bujar Hoxhës dhe Engjëll Kolanecit, për takimin me Abdullah Prapashticën, ish-punëtorin e sigurimit shtetëror dhe njërin nga udhëheqësit e PKMLSH-së etj.

Kah fundi i viteve të shtatëdhjeta në Kosovë vepronin tri organizata politike ilegale e disa grupe të vogla. Organizatat politike ishin:
– Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ),
– Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës (OMLK),
– Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi (PKMLSHJ).
Shpërthimi i demonstratave të vitit 1981 bëri që këto organizata të dekonspirohen bukur shumë dhe të goditen e të burgosen shumë aktivistë të tyre, por disa prej tyre edhe të detyrohen të arratisen jashtë atdheut.
Ekzistimi i këtyre organizatave dhe grupeve patriotike ilegale të ndarë ishte më tepër si rezultat i punës në ilegalitet të thellë e duke mos pasur mundësi të bashkoheshin në një organizatë të vetme sesa që i ndanin ideologjitë e ndryshme.

Takimi në Stamboll me Kadri Zekën

Ashtu, siç është e natyrshme, organizatat politike në viset shqiptare, nën ish-Jugosllavi, organizoheshin dhe udhëhiqeshin nga ideologjia që e kishte shteti amë.

Përkundër goditjeve të rënda që iu bënë këtyre organizmave në njëfarë dore u krijuan disa mundësi për të marrë kontakte në mes veti e posaçërisht të aktivistëve të tyre që tashmë vepronin jashtë atdheut.

Gjithnjë në shembullin e shtetit amë dhe të partisë (PPSH) së saj shihej si domosdoshmëri që organizatat dhe grupet e ndryshme të bashkoheshin në një Organizatë të vetme. Kështu që të gjitha këto organizata çështjen e bashkimit e kishin shtruar si domosdoshmëri.

Duke patur orientim ideologjik

Porsi shteti amë, prapëseprapë njëra nga këto organizata bënte njëfarë dallimi. Kjo ishte LNÇKVSHJ-a, e cila udhëhiqej nga Metush Krasniqi, i cili ishte demokrat i vërtetë dhe mbi të gjitha ideologjinë komuniste e konsideronte si ideologji ruse dhe si të tillë edhe antishqiptare, ashtu siç i konsideronte antishqiptarë sllavo-greko-bizantinët në përgjithësi. Por, afërsia e madhe që ekzistonte në mes të Metush Krasniqit si udhëheqës i LNÇKVSHJ-së dhe Hydajet Hysenit si udhëheqës i OMLK-së dhe respekti i Hydajetit ndaj Metushit, si burrë e patriot i madh dhe dashuria e Metushit ndaj Hydajetit si njeri i ri, entuziast e patriot, bëri që në mes tyre të fillojnë bisedimet për bashkimin e dy organizatave të lartëpërmendura. Këto bisedime i ndërpreu burgosja e Hydajet Hysenit pas demonstratave të vitit 1981, në të cilat Hydajeti luajti rol të madh dhe gjatë zhvillimit të tyre doli disa herë në ballë të tyre.

Në anën tjetër në Evropën Perëndimore vepronin degët e LNÇKVSHJ-së. Në Gjermani udhëhiqej nga Jusuf Gërvalla, kurse në Turqi nga Sabri Novosella. Ndërsa dega e OMLK-së në Zvicër udhëhiqej nga Kadri Zeka. Në Evropë kishin marrë kontakt Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka dhe menjëherë kishin shtruar çështjen e bashkimit të organizatave ekzistuese. Për këtë Jusufi e njoftonte vazhdimisht degën e LNÇKVSHJ-së në Turqi dhe Metush Krasniqin, kryetarin e Lëvizjes në Kosovë.

Në verë të vitit 1981 Jusuf Gërvalla propozoi që të mbahet një takim i përfaqësuesve të LNÇKVSHJ-së dhe OMLK-së në Turqi. Te ky takim erdhi në tetor 1981. Në aeroportin e Stambollit i pritëm shokët që vinin nga Evropa unë dhe Sabri Kosova, që të dy përfaqësues të LNÇKVSHJ-së Dega në Turqi. Shokët që arritën nga Evropa ishin Kadri Zeka (përfaqësues i OMLK-së) dhe Bardhosh Gërvalla (përfaqësues i LNÇKVSHJ-së – Dega në Gjermani). Jusuf Gërvalla nuk kishte mundur të vinte në mungesë të dokumentit të udhëtimit. Ne shprehëm habinë pse kishte ardhur vetëm një përfaqësues i OMLK-së. Këtë e arsyetoi Kadri Zeka: "për çështje të konspiracionit" – tha dhe kërkoi që në bisedime të mos marrë pjesë shoku që më shoqëronte, Sabri Kosova, dhe ashtu u bë.

Në Stamboll e morëm një dhomë në një hotel dhe pas një pushimi të shkurtër filluam bisedimet për çka ishim takuar. Unë dhe Bardhoshi dolëm me qëndrimet e Organizatës që përfaqësonim: të bashkohen organizatat ekzistuese në një organizatë të vetme, e cila mund të pagëzohet "Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi", me një udhëheqje të vetme e cila do të dalë nga përfaqësuesit e organizatave që do të bashkohen, me një program, statut dhe organ të vetëm.

Kadri Zeka doli me qëndrimet e OMLK-së që përfaqësonte: propozoi që të formohet një "Front për Republikën e Kosovës" dhe na e prezantoi një material me titull "Teza rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës". Kërkoi që në "Frontin Popullor për Republikën e Kosovës" të shkrihet LNÇKVSHJ-a dhe të punohet që edhe organizatat e grupet e tjera që veprojnë në Kosovë, të shkrihen në këte "Front.,.", kurse OMLK-ja të mbese organizatë pararojë me program, me statut dhe me organ të vet, e cila do ta udhëhiqte "Frontin…".

Me materialin "Teza rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës" u pajtuan në përgjithësi, pasi edhe qëndrimet e organizatës ishin të ngjajshme, por ne nuk kishim autorizim, njëkohësisht edhe vetë nuk pajtoheshin që Lëvizjen apo Frontin që do të dilte nga bashkimi i organizatave ekzistuese, ta udhëheqë "organizata pararojë". Këtë e arsyetuam kështu: Me presion të jashtëzakonshëm nga PPSH jemi të detyruar të heqim dorë nga programi ynë për çlirim dhe bashkim kombëtar me shtetin amë, Shqipërinë dhe të kthehemi në luftë për një republikë në kuadër të Jugosllavisë, ashtu siç janë gjashtë republikat jugosllave. Të luftohet për një republikë shqiptare në kuadrin e federatës jugosllave pa e luftuar Jugosllavinë, as si shtet e as si sistem, por të luftojmë që ta kemi edhe ne republikën tonë, ashtu siç janë gjashtë të tjerat që e përbëjnë Federatën, por që të udhëhiqemi nga një organizatë markiste-leniniste krejtësisht të njëjtë si PPSH nuk është e logjikshme. Po ashtu na duhet të shpresojmë edhe në ndihmën nga jashtë, por, siç është e ditur, me këtë ideologji nuk mund të na përkrahë askush.

Manipulimet e Bujar Hoxhës

Kadriu mbeti në qëndrimet e organizatës që përfaqësonte, kurse unë dhe Bardhoshi po ashtu mbetëm në qëndrimet e Organizatës që përfaqësonim.

Para se të vinin shokët nga Evropa e kisha njoftuar prof. Bujar Hoxhën se do të vijnë disa shokë nga Evropa për të biseduar rreth bashkimit të organizatave ekzistuese dhe se prof. Bujar Hoxha, si përfaqësues i shtetit shqiptar në Ambasadën shqiptare në Ankara, shprehu dëshirën që edhe ai të takohet me ata shokë.

Posa arritën shokët në aeroport i njoftova për kërkesën e prof. Bujar Hoxhës dhe kërkova mendimin e tyre se a ta lajmërojmë. Që të dy propozimin e aprovuan, bile Kadri Zeka më njoftoi se para se të nisej e paska pasur një takim me Engjëll Kolanecin, i cili ishte diplomat në Vjenë dhe ia kishte dhënë disa porosi (për këto porosi do të flas më vonë).

Të nesërmen, sipas marrëveshjes, në një restorant të Stambollit u takuam ne të tre me prof. Bujar Hoxhën dhe me një njeri të Ambasadës që e shoqëronte, të cilin e quanin Rauf. Në këtë restorant hëngrëm drekë dhe e njoftuam hollësisht prof. Bujar Hoxhën për bisedimet dhe qëndrimet tona. Bujari na dëgioi deri në fund dhe nuk dha kurrnjë përgjigje në shumë pyetje tonat. Në fund të atij takimi prof. Bujari propozoi që Raufi të shkonte t'i merrte disa pako me cigare dhe shishe me konjak për t'ua dërguar shokëve në Evropë për përshëndetje. Pasi u ngrit Raufi, i propozoi edhe Kadriut që ta shoqëronte, menjëherë i propozoi edhe Bardhoshit që edhe ky t'i shoqëronte. U kuptua se Bujari dëshironte të më thoshte diçka vetëm mua.

Pasi mbetëm vetëm iu drejtova:

– "Çka po na thua profesor?"

M'u përgjigj tekstualisht:

– "Mos lëshoni pe".

Bisedimet i vazhduam edhe në mbrëmje të asaj dite. Kadriu ishte kureshtar se çka më tha prof. Bujari, por edhe unë u bëra kureshtar se çka i kishte thënë Engjëll Kolaneci para se të vinte Kadriu në Turqi. Që të dy "dekonspiruam". Kadriu na njoftoi se Engjëll Kolaneci i kishte thënë: mbaj qëndrimet e tua, po ashtu edhe unë e njoftova për atë çka më tha prof. Bujar Hoxha. Që të tre u dëshpëruam keq.

***

Kah fundi i vitit 1981 erdhën në Turqi Abdullah Prapashtica, Nazmie Prapashtica, Osman Osmani dhe Faton Topalli. Posa kishin ardhur, më kishin kërkuar dhe u takuam. Ata dinin shumë gjëra për mua dhe unë me njërin prej tyre kisha një lidhje familjare. M'u prezantuan si përfaqësues të PKMLSHJ-së. Bile, Abdullah Prapashtica i dinte dhe disa

hollësira, pasi që kishte punuar në SPM të Kosovës dhe kishte pasur kontakt me disa aktivistë të LNÇKVSHJ-së gjatë hetimeve si të burgosur

Posa erdhën këta të rinj kërkuan që të punohet drejt bashkimit të organizatave ekzistuese në një organizatë apo parti të vetme. Për ardhjen dhe kërkesat e tyre i njoftova shokët në Kosovë dhe në Gjermani. Udhëzimet na erdhën se fjala është për një grup të rinjsh që organizatës së tyre i kanë vënë emër të madh dhe në përgjithësi janë shërbyer me fjalë e parulla të mëdha si rezultat i entusiazmit rinor të tyre, por gjithsesi nuk nënçmohet kontributi i tyre dhe se duhet edhe me ta të bisedohet rreth bashkimit.

Me këta aktivistë zhvilluam disa herë bisedime. Ne dolëm me qëndrimet tona të njohura: për një organizatë të vetme, me udhëheqësi të dalë nga përfaqësuesit e organizatave, me një program, statut dhe organ (gazetë). Kurse edhe këta dolën me kërkesa të ngjashme me ata të OMLK-së, me një dallim, ashtu si ata të OMLK-së kërkonin që PKMLSHJ të jetë parti pararojë, kurse LNÇKVSHJ dhe organizatat e grupet e tjera të shndërrohen në një organizatë masash, respektivisht partia t'i ketë të gjitha levat e saj: organizatën sindikale, organizatën e grave, të rinisë, të pionerëve etj.

Bisedimet në këtë frymë u zhvilluan edhe deri më 17 janar 1982 kur u vranë tre shokët: Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka nga UDB-ja në Gjermani. Pas vrasjes së shokëve dhe burgosjeve të vazhdueshme që bëheshin në viset shqiptare nën Jugosllavi, okupatorët bënin zhurmë të madhe se "e shkatërruan nacionalizmm dhe irredentizmin shqiptar njëherë e përgjithmonë". Renegati shqiptar, Sinan Hasani, krekosej me mburrje se "armikut ia thyem kurrizin".

***

Pas varrimit të shokëve erdhi nga Gjermania në Turqi Xhafer Durmishi, i cili ishte aktivist i LNÇKVSHJ-së. Posa erdhi ky aktivist, prapë vazhduan bisedimet rreth bashkimit. Ndërkohë aktivistët e PMLKSHJ-së kishin marrë kontakt me diplomatët shqiptarë dhe me një rast Abdullah Prapashtica i dëshpëruar krejtësisht më tha: "Në bazë të kontakteve që i kam me përfaqësuesit e shtetit shqiptar kam ardhur në përfundim se ata janë që në Kosovë të ketë grupe të vogla që bëjnë turbullira, por janë kundër ekzistimit të një organizate apo partie të fuqishme që do të jetë e aftë t'i prijë popullit shqiptar nën Jugosllavi". Këtë ia aprovova, pasi që edhe unë kisha krijuar një bindje të tillë. Edhe ky ishte një faktor që na shtyri të mblidhemi më 17 shkurt 1982 në një ndërtesë në Ankara dhe te shënojmë një mujorin e rënies së shokëve dhe të marrim vendim për bashkimin e LNÇKVSHJ-së dhe PKMLSHJ-së në një organizatë të vetme dhe të punohet që kësaj organizate t'i bashkohen edhe organizatat dhe grupet tjera që vepronin në viset shqiptare nën Jugosllavi.

Atë natë, në mes tjerash, u morën edhe këto vendime:

Organizata që doli nga dy organizatat e lartëpërmendura të quhet Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ).

SI U NËNSHKRUA MARRËVESHJA?

Të përpilohet Deklarata Programore me të cilën do të shpallet formimi i LRSHJ-së, të cilën e quajtëm "Komunikatë".

Të botohet organi i LRSHJ-së, të cilin me propozimin tim e quajtëm "Zëri i Kosovës", pasi që me këtë emër kishte dalë edhe organi i LNÇKVSHJ-së.

Udhëheqje e LRSHJ-së të jenë dy udhëheqjet e dy organizatave deri në zgjedhjet e rregullta.

Vendimin e nënshkman pjesëmarrësit:
– Faton Topalli,
– Osman Osmani dhe
– Abdullah Prapashtica (të PMLKSHJ-së) dhe
– Xhafer Durmishi e
– Sabri Novosella të LNÇKVSHJ-së.
"Komunikatën" e përpiluam pas tre ditësh në banesën time në Adapazar gjashtë anëtarë:
– Abdullah Prapashtica, Osman Osmani e Faton Topalli të ish-PMLKSHJ-së dhe
– Xhafer Durmishi, Sabri Novosella e Abdullah Prekadini të ish LNÇKVSHJ-së.
"Komunikata" u nënshkrua: Lëvizja për Republikën Shqiptare në JugosIlavi.
"Komunikata" u shtyp në tri kopje dhe u muar vendim që së pari të njoftohen me të shokët në Kosovë dhe atje të shpërndahej para se të shpërndahet jashtë.
Kjo "Komunikatë" për herë të parë u shpëmda jashtë atdheut, e botuar në numrin e parë të "Zërit të Kosovës" – organ i LRSHJ-së.
Në këtë takim Abdullahun, Osmanin dhe Fatonin i pyeta se a e kishin takuar prof. Bujar Hoxhën dhe se a e kishin njoftuar për themelimin e LRSHJ-së?
M'u përgjigjën se e kishin takuar. Kur i pyeta se a kishte thënë diçka dhe se a u kishte uruar bashkimin, më thanë se nuk ua kishte uruar bashkimin, por u kishte thënë se ka qenë dashur të jetë edhe ai aty. Unë shtova me ironi, sigurisht paska dashur të na "ndihmojë" si atëherë kur zhvilluam bisedime me përfaqësuesin e OMLK-së.
Pas disa ditësh, Xhafer Durmishi dhe Osman Osmani shkuan në Gjermani dhe vazhduan punën. "Zëri i Kosovës", si organ i LNÇKVSHJ-së, ishte i gatshëm për t'u dërguar në shtyp dhe u vendos që edhe ky numër të dalë ashtu si ishte përgatitur.
Ndërkohë më njoftuan se Xhafer Shatri gjendej në kampin e refugjatëve në Romë. Menjëherë i porosita shokët që të shkojnë e ta marrin.

– VIJON –

==========

==========

SABRI NOVOSELLA: SI E KRIJUAM LËVIZJEN PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI (LRSHJ), MË 17 SHKURT 1982 (II)

Pashtriku, 19 shkurt 2021: (Botuar në revistën Zëri, 04.04.1992)

Xhafer Shatrin e akuzon Sigurimi shqiptar se është spiuni UDB-së!!!

Në vazhdimin e dytë të rrëfimit ekskluziv të Sabri Novosellës: Si bëhet Xhafer Shatri udhëheqës i lëvizjes, pse dhe si Abdullah Prapashtica kthehet kundër lëvizjes pas shkuarjes në Shqipëri, pse Sigurimi hap propagandën për Xhafer Shatrin si spiun i UDB-së, pse Xhafer Shatri përjashtohet nga Lëvizja; pse LRSHJ transformohet në LPRK, pse LPRK më shumë merret me popullarizimin e Enver Hoxhës sesa me çështjen e Kosovës, pse Peter Rullman tha: "Aktiviteti i LPRK-së çon ujë në mullirin e Beogradit" etj.

***

Kishin shkuar katër shokë me një veturë dhe me një dokument të udhëtimit, por Xhafer Shatrin nuk e kishin gjetur atje. Pak ditë më parë kishin shkuar disa aktivistë të OMLK-së nga Zvicra dhe e kishin marrë. Posa kishte arritur në Zvicër, kishte kërkuar që të vërë lidhje me mua dhe e kishte dërguar Hasan Malën në Shtutgart që të marrë adresën time dhe numrin e telefonit. Pas marrjes së adresës dhe numrit tim të telefonit menjëherë u vumë në kontakt dhe vazhdimisht ishim në Lidhje të rregullta me letra apo me telefon.

U morëm vesh dhe më 15 maj 1982 u mbajt një takim në mes Xhafer Shatrit si përfaqësues i OMLK-së dhe Xhafer Durmishit e Osman Osmanit si përfaqësues të LRSHJ-së. Atë ditë u mor vendimi dhe OMLK u bashkua në LRSHJ. Së shpejti u botua numri i parë i organit të LRSHJ-së "Zëri i Kosovës", në të cilën u botua edhe Komunikata e bashkimit.

Xhafer Shatri u vu në ballë të LRSHJ-së!

Me bashkimin e OMLK-së në LRSHJ në ballë të aktivitetit në Evropën Perëndimore u vu Xhafer Shatri. Përkundër shumë viteve të kaluara në burgjet jugosllave Xhafer Shatri kishte një energji dhe vullnet të jashtëzakonshëm për punë dhe si punëtor i madh që ishte i dha hov të madh gjithë LRSHJ-së dhe kështu kjo organizatë u popullarizua shumë si në Kosovë, ashtu edhe në botën e jashtme.
Xhafer Shatri, i liruar krejtësisht nga dogmat staliniste-bolshevike (edhe pse ende nuk kishte guxim të dilte haptas), vuri kontakt me shumë aktivistë të dalluar demokratë në Belgjikë, SHBA, Gjermani etj. Kjo e bëri si të çmendur PPSH-në dhe menjëherë ia filloi nga kurthet shumë perfide.

Së pari e tërhoqi Abdullah Prapashticën dhe e nxiti të dilte me "partinë" e tij dhe megjithë "levat" e saj. E çuan Abdullahun në Shqipëri për ta "shëruar" dhe përpunuar ashtu si duhej. Nuk vonoi shumë edhe Abdullah Prapashtica filloi të nxjerrë organet e "levave" të "partisë" së tij. Së pari nxori një revistë me titull "Punëtorët", si organ i Bashkimit të Punëtorëve të Kosovës, e pastaj edhe gazetën "Kosovarja e Re", si organ i Bashkimit të Grave të Kosovës. Përkundër orientimeve që ua bënte diplomacia e Shqipërisë kosovarëve që të tubohen rreth këtyre dy organeve, krejt ajo punë u tregua e pasuksesshme.
LRSHJ-së, nën presionin e stalinistëve, iu shtua edhe një fjalë "socialiste" dhe u quajt – Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (LRSSHJ). Për këtë, si mua, ashtu edhe Xhafer Shatrit, na u desh që të lëshojmë pe që të mos na dalin për fushë "idetë tona reaksionare".

Xhafer Xhatri kishte krijuar lidhje të ngushta me një varg institucionesh ndërkombëtare, siç ishte Amnestia Internacionale etj., dhe me një varg personalitetesh të njohura, siç ishte publicisti i njohur Peter Rulman etj. Për të gjitha këto Sigurimi i Shqipërisë, përmes diplomatëve të vet, të cilët të vetmen punën që kryenin me sukses ishte puna e spiunimit të shqiptarëve në përgjithësi, kishte informata të bollshme për krejt aktivitetin e LRSHJ-së në Kosovë dhe në të gjitha anët e botës.

Kontaktet e mia me diplomacinë shqiptare, gjithnjë duke pasur iluzione se vetë PPSH një ditë do të bëjë kthesë dhe do të heqë dorë nga rruga e cila e çonte popullin shqiptar në greminë dhe perpjekjet e mia të vazhdueshme qe të bëhej ndikim sado pak që të heqin dorë nga ajo rrugë që e kishte bërë Shqipërinë kamp përqëndrimi, të cilën gjë e kisha parë vetë gjatë dy muajve që kisha pasur rastin të vizitoj Shqipërinë në fillim të vitit 1980.
Nga ana tjetër, veprimtaria e Xhafer Shatrit, pa i përfillur porositë e tyre "largpamëse", bëri që nevojë e domosdoshme të bëhet likuidimi im politik dhe i Xhafer Shatrit. Si hap i parë u vu në veprim makineria e kurtheve për përçarjen në mes meje dhe Xhafer Shatrit.

Në shtator, 1983, më thirri në telefon prof. Bujar Hoxha dhe ma caktoi takimin në restorantin "Saraçoglli", pranë Liqenit Sapangja, afër Adapazarit. Në ditën e caktuar u takuam së bashku me prof. Bujar Hoxhën ishte edhe sekretari i pare i Ambasadës shqiptare në Ankara.
Në bisedë e sipër prof. Bujar Hoxha m'u drejtua:
– "A ke besim të plotë në Xhafer Shatrin?".

Krejtësisht i habitur dhe i tronditur, iu drejtova:
– "Shumë më tepër se në Hekuran Isain", i cili atëherë ishte ministër i Punëve të Brendshme të Shqipërisë.
lu drejtova:
– "Si më pyet ashtu profesor?"
Ai ma ktheu:
– "Jo, jo vetëm ta bëj me dije që të kesh kujdes. Jo vetëm Xhaferi, por tërë familja e tij janë të dyshimtë".
– "Si ia ktheva, biri i asaj familjeje është edhe Sali Shatri në Shqipëri, i cili është oficer i lartë i Sigurimit shqiptar?"
M'u drejtua:
– "Mu për atë UDB-a ka bërë presion të madh në atë familje dhe ka depërtuar me kohë". Nuk e di, por ç' është e vërteta, si intelektual i lartë dhe si bir i Hoxhë Kadri Prishtinës që ishte, në trurin tim mbolli virusin e dyshimit. Këtë ma përsëriti disa herë në takimet e mëvonshme.

Ndërkohë më erdhi një letër nga Gjermania. Xhafer Durmishi, i cili më njoftoi në hollësi se kishte pasur një takim me Engjëll Kolanecin dhe kishte ndejtur me të tërë ditën dhe gjatë tërë asaj bisede ia kishte sjellë fjalën rreth Xhafer Shatrit, duke shprehur vazhdimisht dyshime në Xhafer Shatrin. Për të gjitha këto, si për çdo gjë, e njoftoja Metush Krasniqin në Kosovë. Aq shumë e tronditën këto informata Metushin sa që ai dërgoi një njeri në Shqipëri për të marrë informata më të hollësishme. Dashuria e pakufishme ndaj atdheut e autoriteti i shtetit amë, respektivisht, shpërdorimi në mënyrë flagrante nga ana e shtetit amë te kosovarët; që përpiqeshin për të kontribuar sado pak në të mirë të adheut, e bënte të vetën.

TRANSFORMIMI NË LPRK

Burgosja e Zijah Shemsiut (më 9 tetor 1983 – shën. Im) me disa aktivistë të tjerë, të cilët u zunë me disa armë duke hyrë në Jugosllavi (u arrestuan në afërsi të Beogradit – shën. im) , u shfrytëzua për mrekulli nga diplomacia shqiptare për të na bindur se ajo ishte vepër e Xhafer Shatrit e planifikuar nga ana e UDB-së për të krijuar konflikt në Kosovë e për t'u masakruar Kosova dhe për t'u goditur Shqipëria. Menjëherë thirri diplomati shqiptar në konsullatën shqiptare në Stamboll, Ibrahim Çavolli dhe u takuam në banesën e Zijah Strajës. Ibrahim Çavolli e kishte marrë një numër të "Zërit të Kosovës", në të cilin kishte nënvizuar disa rreshta e posaçërisht një ku thuhej se "do ta bejmë Jugosllavinë pluhur e hi". Ky pasazh sillej si "argument" se Xhafer Shatri, nga njëra anë, përmes organit, thërret për luftë, e nga ana tjetër i dërgon njerëzit me armë sipas planeve të UDB-së për të krijuar konflikt dhe për të bërë masakër në Kosovë dhe kërkoi prej meje që gjithsesi e sa më parë të shkoj në Evropë dhe ta pengoj këtë njeri "shumë të dyshimtë". Përgatita dokumentet e udhëtimit dhe e njoftova Xhafer Shatrin se do të shkoj që të takohem me të e me shokë të tjerë. Xhafer Shatri më dërgoi me të shpejtë biletën e aeroplanit dhe në muajin nëntor arrita me aeroplan në Gjenevë.
Me Xhafer Shatrin ndejta pesë ditë dhe biseduam hollësisht për shumë gjëra. Mund të them se ato kanë qenë ditët më të vështira në jetën time. E akuzova shumë rëndë. Dhe sot më vjen shumë keq, posaçërisht prej gruas së tij, e cila përkundër asaj që i dëgjoi të gjitha ato prej meje, megjithatë u soll shumë njerëzishëm ndaj meje. Nga banesa e Xhafer Shatrit erdhi e më mori Hasan Mala. Në banesën e tij mbajtëm dy mbledhje me anëtarët e udhëheqësisë së LRSSHJ-së jashtë atdheut.
Merrnin pjesë:
– Xhafer Shatri,

– Xhafer Durmishi,
– Hasan Mala,
– Saime Isufi,
– Faridin Tafallari,
– Ibrahim Kelmendi dhe
– Sabri Novosella.

Pas shumë diskutimesh dhe propozimesh, më në fund erdhëm në përfundim që të bëhen korigjimet dhe përmirësimet e gabimeve të lëshuara dhe të zgjidhet udhëheqësia prej 15 vetësh, prej të cilëve 8 në Kosovë e 7 jashtë atdheut. Të rizgjidhet redaksia e "Zërit të Kosovës" dhe u zgjodh një komision për t'i shqyrtuar në hollësi gabimet e atëhershme. Anëtarë të komisionit u zgjodhën
– Xhafer Durmishi,
– Faridin Tafallari dhe
– Ibrahim Kelmendi, kështu që Ibrahim Kelmendit iu dha mundësia t'i realizojë udhëzimet e diplomacisë shqiptare me plot sukses.
Pasi na u duk se u tejkaluan të gjitha pengesat e deriatëhershme, u largova përsëri për në Turqi.

Pas pak ditësh, pasi arrita në Turqi, më erdhi vendimi i komisionit të lartpërmendur. Në vendim ishte propozimi i Ibrahim Kelmendit që unë, Sabri Novosella, të përjashtohem nga LRSSHJ, pasi e kisha fyer rëndë shokun Ujkan -Xhafer Shatrin. Një propozim të tillë Xhafer Durmishi dhe Faridin Tafallari nuk e kishin pranuar dhe kështu kishte ardhur te një thyerje e re.

Pas bisedimeve që pata me Ibrahim Çavollin, u vërejt se nuk kishin mbetur plotësisht të kënaqur, sepse në fillim u duk se nuk u arrit përçarja e dëshiruar prej tyre.
Nga ana e diplomacisë shqiptare në Turqi u inicuan disa "komunikata", "proklamata" e "qarkore", me të cilat duhet të arrihej përçarja e plotë, kurse në Evropë u vunë në veprim spiunët profesionalë që kishin kryer edhe krime të rënda, siç ishin Shefikat e Nexhmi SheroIIi etj. Fushata e tërbuar filloi kundër Xhafer Durmishit. Posa u duk se u krye puna me të, filloi një fushatë edhe më e tërbuar kundër Sabri Novosellës. Kështu, u arrit përçarja e plotë e LRSSHJ-së dhe u krijuan dy krahë të saj.

Filloi të dalë edhe një organ me emrin "Zëri i Kosovës", me adresë në Suedi. Këtë organ e udhëhiqte Xhafer Durmishi. Xhafer Durmishi, i frikësuar tmerrësisht se mos po akuzohet si reaksionar, e kur të jepej epiteti reaksionar nënkuptohej edhe se je kundër PPSH-së, kundër Shqipërisë e tradhtar, kështu që Xhafer Durmishi në këtë organ u bë më Lenin se Lenini e më Stalin se Stalini, për të cilën gjë e jepte bekimin diplomacia shqiptare në Stokholm për çdo numër të organit. Për këtë punë intervenova unë dhe e ndala botimin e organit "Zën i Kosovës", me adresë në Suedi.

Kur iu duk Sigurimit të Shqipërisë se u arrit përçarja e plotë dhe largimi im nga aktiviteti, ju vërsulën Ibrahim Kelmendit e Xhafer Shatrit me një akuzë plot 34 faqe, me të njejtat intriga që i kishin lëshuar më parë kundër meje.

Në vitin 1985 LRSHJ faktikisht pushoi së ekzistuari si e tillë, për çka ishte themeluar dhe me komplote të njëpasnjëshme, në stilin e komploteve që bëheshin në Tiranë, u shndërrua në një filialë të PPSH-së. E ndërroi edhe emrin, nga LRSSHJ u emërua Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK). Në ballë të kësaj LPRK-je ia vunë organizatën "pararojë" – OMLK dhe organin "Pararoja". Kështu pra, që nga viti 1985 LPRK u shndërrua në një organizatë "masash", e udhëhequr nga OMLK e re dhe kreu një aktivitet të dendur, ashtu siç tha me një rast një publicist i njohur gjerman Peter Rulman: "Aktiviteti i LPRK-së çon ujë në mullirin e Beogradit".

LPRK KUNDËR RRËNIMIT TË MURIT TË BERLINIT!!!

Puna kryesore e LPRK-së ishte që ta popullarizonte Enver Hoxhën dhe 'Ramiz Alinë, të organizonte demonstrata të njëpasnjëshme para ambasadave të Jugosllavisë për ta sharë revizionizmin titist jugosllav e për ta sharë imperializmin amerikan, socialimperializmin sovjetik dhe reaksionin ndërkombëtar. U shkua aq larg sa që kur filloi rrënimi i murit të Beriinit LPRK organizoi demonstrata mu para atij muri dhe brohoritej për marksizëm-leninizmin dhe për çdo ditë e bindnin Evropën se shqiptarët po luftojnë për ta kthyer stalinizmin në Jugosllavi, të cilin me shumë vështirësi e kishte larguar Titoja me ndihmën e Perëndimit…

"Zëri i Kosovës" u shndërrua në shtojcë të "Zërit të Popullit" për t'i thurur himne Enver Hoxhës dhe Ramiz Alisë e PPSH-së.

U desh të vijnë vitet 1988 e 1990, të ngrihet i tërë populli i Kosovës për ta mbrojtur autonominë dhe për ta parë bota se në Kosovë po ndodh diçka. Përkundër të gjithave, pjesa dërmuese e anëtarëve dhe e udhëheqësisë së kësaj organizate ishin bijtë më të mirë të popullit shqiptar, të cilët sakrifikoheshin dhe jepnin gjithçka prej veti me bindje të thellë se po kontribuojnë në të mirë të atdheut. Trullosja, që ua kishte bërë banda kriminale e Tiranës, nuk ishte faji i tyre.

***

Më 17 shkurt të këtij viti (1992) u mbushën plot dhjetë vjet nga themelimi i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në Jugosllavi, sot Lëvizja Popullore e Republikës së Kosovës. Përkundër të gjitha të metave e gabimeve, roli i kësaj organizate politike në jetën e popullit shqiptar është i madh, për të cilën fjalën e vet do ta thotë historia, por është koha e fundit që të bëhet një analizë e thellë dhe kjo organizatë të lirohet nga dogmat e mëparshme, të riorganizohet dhe të veprojë në përputhje të plotë me kushtet e rrethanat e krijuara dhe të përcaktuara qysh me rastin e themelimit të saj. Kjo organizatë që nga themelimi i saj u përcaktua që të luftojë për një Republikë Shqiptare në Jugosllavi, ashtu siç ishin gjashtë republikat tjera të saj. Qëllimi i fundit i kësaj organizate ka qenë realizimi i aspiratave shekullore të popullit shqiptar – krijimi i shtetit shqiptar brenda kufijve të vet kombëtar. Ky qëllim duhet tëjetë edhe sot. Kjo organizatë duhet të ngrihet në parti dhe ta zërë vendin e merituar që i takon në mesin e partive shqiptare në përgjithësi. Individët që bënë gabime të rënda, duke i zbatuar direktivat e Byrosë Politke të PPSH-së që i sollën dëme kësaj organizate, është e domosdoshme të bëjnë autokritikë dhe të kërkojnë falje.

Gabimi im i madh ka qenë që nuk pata mundësi t'i kuptoj kurthet dhe lojrat e PPSH-së sidomos kah fundi i vitit 1983. Gabimet e vitit 1984 ishin si rezultat i kurtheve të PPSH-së të vitit 1983 e më parë. Lufta ime e pakompromis kundër gabimeve që bëheshin në këtë organizatë, më duhet ta them pa modesti, janë merita të miat dhe të të gjithë shokëve të mi që vepronin në këtë drejtim, pasi që unë kam qenë dhe jam i lidhur shpirtërisht me këtë organizatë. Kurrë nuk kam mundur të jem indiferent ndaj kësaj organizate, pasi që jeta dhe e kaluara ime janë të lidhura ngushtë me të, jo vetëm gjatë këtyre dhjetë vjetëve të ekzistimit të saj, por edhe më parë, pasi që kjo organizatë LNÇKVSHJ e unë si aktivist i saj kam qenë i detyruar t'i marrë rrugët e kurbetit dhe t'ia kthej shpinën familjes sime dhe mbarë Kosovës. Kurse LNÇKVSHJ ishte vazhduese e LRBSH-së, në të cilën jam organizuar qysh në moshën 18-vjeçare dhe si aktivist i saj i kam mbajtur 6 vjet burg.

Çdo nder dhe respekt për të gjitha partitë shqiptare që veprojnë sot, por e vërteta është se kjo organizatë dhe të gjitha të tjerat që vepruan nën terrorin serbosllav e mbajtën barrën kryesore të luftës.

Dëshiroj të gaboj në këtë vlerësim që do të jap. Edhe pas sotit barrën kryesore dhe sakrificën më të lartë në altarin e lirisë do ta bëjnë mu këta aktivistë që vepruan, veprojnë dhe që do të organizohen në këto organizata.
(Sabri Novosella, mars 1992)

Aktgjykimi i Partisë Komuniste - PKMLSHJ

PARTIA KOMUNISTE MARKSISTE -LENINISTE SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI

P-K.nr.167/82

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, në kolegjin e përbërë nga gjyqatri Mentor Qoku, kryetar, gjyqtarës së kësaj gjykate Verosllava Dimiq, dhe gjyqtarve porotë Dojqin Maksimoviq, Ilaz Aliu dhe Azem Emini, anëtar, me pjesëmarrjen e punëtores së kësaj gjykate Atifete Krasniqi, proçesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve: Rexhep Maqedonci, Adem Dervisholli, Sabit Gashi dhe Skender Vardari, që të gjithë nga Prishtina, e të gjithë për veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 1 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ (në tekstin e mëtutjeshëm LPJN), Lutfi Maqedonci, Fatmir Grajqevci, Bahtir Ahmeti, Martin Quni, Meriman Braha, Osman Maqedonci, Arban Hoxha, që të gjithë nga Prishtina, Naim Mahmudi, nga fshati Dragonishta e Vogël-KK Kërçovë dhe Ahmet Islami, nga Prishtina, që të gjithë për veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 2 lidhur me nenin 114 të LPJ: Avdi Krasniqi, nga Peja, për veprën penale cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114 të LPJ; Ahmet Qiriqi, nga Shtimja, Zenun Gjocaj, nga fshati Gjocaj dhe Hamzë Morina nga fshati Vllashkidrenovc, Sallah Jonuzi, nga Ferizaj dhe Idriz Jusufi, nga Prishtina, për veprën penale propaganda armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ; dhe i akuzuari Agim Mehmeti, për veprën penale moskallximi i pregatitjes së veprën penale nga neni 172 al. 1 të LP të KSAK (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), sipas aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Prishtinë PP.nr. 152/82, 156/82, 158/82 dt. 11 nëntor 1982, PP. Nr. 66/82 dt. 15 tetor 1982 dhe PP. Nr. 198/82 dt. 7 janar 1983,

AKTGJYKIM

Të akuzuarit:

Rexhep Maqedonci, i lindur më 3 mars 1956, në Prishtinë, rruga e ”Splitit” nr. 20, ku dhe jeton, ish milicioner, i pamartuar, apsolvent i Fakultetit Juridik në Prishtinë, në paraburgim prej 13 maj 1982, e tutje;

Adem Prapashtica, i lindur më 20 maj 1957 në Prishtinë, ku dhe jeton – rruga e ”Bihaçit” nr. 28 A, i punësuar në Ndërmarrjen tregëtare ”Voçar” në Prishtinë, i pamartuar, ka kryer shkollën e mesme turistike, gjindet në paraburgim prej 13 maj 1982, e tutje, i gjendjes së varfër ekonomike;

Lutfi Maqedonci, i lindur më 4 shtatot 1961 në Prishtinë, ku dhe jeton – rruga e ”Splitit” nr.20, student i vitit të parë të Fakultetit Teknik në Prishtinë, në paraburgim prej 13 maj 1982, e tutje;

Nysret Ahmeti, i lindur më 25 janar 1959 në fshatin Gumnasellë, KK Lipjan, jeton në Prishtinë, rruga ”Robert Gajdiku” nr.60, shtetas i RSFJ, absolvent i Fakultetit Juridik në Prishtinë, në paraburgim prej 13 maj 1982, e tutje;

Adem Dervisholli, i lindur më 7 shkurt 1957 në fshatin Vragoli, jeton në Prishtinë, rruga ”Taslixhe I” nr. 52, i papunë, ka kryer shkollën e mesme – drejtimi pedagogjik, i gjendjes së varfër ekonomike, në paraburgim prej 13 maj 1982, e tutje;

Fatmir Grajiçevci, i lindur më 25 mars 1963 në Prishtinë, ku dhe jeton, rruga ”Svetozar Markoviq” nr. 40-a, student i Fakultetit Teknik në Prishtinë viti i parë, në paraburgim prej 13 maj 1982, e tutje;

Bahtir Ahmeti, i lindur më 30 janar 1956 në fshatin Gumnasellë KK Lipjan, jeton në Prishtinë, rruga ”Robert Gajdiku” nr. 60, student i Fakultetit Juridik në Prishtinë, në paraburgim prej 13 maj 1982, e tutje;

Agim Ahmeti, i lindur më 7 janar 1956 në Prshtinë, ku dhe jeton-rruga e ”Bledit” nr.16, sekretar i shkollës ”Branisllav Nushiq” në Prishtinë, në paraburgim prej 13 maj 1982 gjer më 15 shkurt 1983, tani mbrohet nga liria;

Martin Quni, i lindur më 14 maj 1948 në fshatin Ujcë, KK Gjakovë, jeton në Prishtinë, rruga e ”Bihaçit”, student i vitit të katërtë të Fakultetit Filozofik-Dega e Padagogjisë, në paraburgim prej 13 maj 1982, e tutje;

Meriman Braha, i lindur më 27 shtator 1946 në Prizren, jeton në Prishtinë, rruga e ”Leninit” p.n., profesor i gjuhës shqipe, në paraburgim prej 13 maj 1982, e tutje;

Osman Maqedonci, i lindur më 2 maj 1953 në Prishtinë, ku dhe jeton, rruga e ”Splitit” nr. 20, me profesion axhustator me kualifikim të lartë, i punësuar në ”Elektroekonomi”, në paraburgim prej 13 maj 1982, e tutje;

Arban Hoxha, i lindur më 1 shtator 1963 në fshatin Cërnicë-KK Gjilan, jeton në Prishtinë, rruga ”A. Gjorgjevic”, nr. 11, nxënës i QAMO ”9 Maj” në Prishtinë, viti i katërt, në paraburgim prej 13 maj 1982, e tutje;

Avdi Krasniqi, i lindur më 11 mars 1960 në fshatin Koshutan, jeton në Pejë, ”Boro Vukmiroviq” nr. 180, student i vitit të dytë të Shkollës së Lartë Pedagogjike – Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Prishtinë, në paraburgim prej 13 maj 1982, e tutje;

Naim Mahmudi, i lindur më 5 korrik 1962 në Kërçovë, ka kryer shkollën e mesme, në parapurgim prej 15 korrik 1982 e tutje;

Ahmet Qeriqi, i lindur më 24 dhjetor 1946 në fshatin Krajmirovc KK Lipjan, jeton në Shtimje, profesor i gjuhës dhe letërsisë, i punësuar në Akademinë Pedagogjike në Prishtinë, i gjykuar për vepër penale armiqësore nga neni 133 al. 4 të LPJ, me burgim në kohëzgjatje prej një vjeti e gjashtë muajsh, me aktgjykimin e Gjykatës së qarkut në Prishtinë AP.nr.81 dt. 14 korrik 1981, të cilin dënim akoma nuk e ka vuajtur, në paraburgim prej 12 korrik 1982, e tutje;

Zenun Gjocaj, i lindur më 28 prill 1943 në fshatin Gjocaj, KK Deçan, ku dhe jeton, magjistër i shkencave filologjike, i punësuar në Akademinë Pedagogjike në Prishtinë, në paraburgim prej 15 korrik 1982 e tutje;

Hamzë Morina, i lindur më 11 mars 1950, në fshatin Llashkidrenovc, KK Klinë, ku dhe jeton, i punësuar në gazetën ”Lokomotiva” në Ndërmarrjen hekurudhore si gazetar, në paraburgim prej 15 korrik 1982, e tutje;

Sallah Jonuzi, i lindur më 9 nëntor 1957 në fshatin Uglarë-KK Gjilan, jeton në Ferizaj, rruga e ”Leningradit” nr. 129, student i vitit të tretë, i Fakultetit të Shkencave Natyroro-Matematikore-Dega e kimisë në Prishtinë, në paraburgim prej 15 korrik 1982 e tutje;

Sabit Gashi, i lindur më 3 nëntor 1958 në fshatin Mrmor KK Prishtinë, jeton në Prishtinë, rruga e ”Jastrebcit” nr. 15, student i vitit të tretë të Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore – Dega e Fizikës në Prishtinë, në paraburgim prej 15 prill 1982, e tutje;

Skënder Vardari, i lindur më 15 mars 1961, në Stamboll, jeton në Prishtinë, rruga e ”Emshirit” p.pn., shtetas i Turqisë, student i vitit të parë i Shkollës së Lartë Pedagogjike, Grupi i Batit në Prishtinë, në paraburgim prej 15 prill 1982, e tutje;

Ahmet Islami, i lindur më 29 nëntor 1963 në fshatin Brainë KK Podujevë, jeton në Prishtinë, Laxha eSpitalit nr. 36, student i vitit të parë të Shkollës së Lartë Pedagogjike – Grupi i Batit në Prishtinë, në paraburgim prej 15 prill 1982 e tutje; dhe

Idriz Jusufi, i lindur më 20 qershor 1954 në fshatin Dabishevc, jeton në Prishtinë, rruga e ”Avallës” nr. 19, shtetas i RSFJ, i punësuar si gardian pranë Burgut të qarkut në Prishtinë, ka krye shkollën e mesme, në paraburgim prej 19 nëntor 1982, e tutje,

JANË FAJTORË

I.Të akuzuarit **Rexhep Maqedonci, Adem Prapashtica, Nysret Ahmeti, Kadri Cakiqi, dhe Adem Dervisholli**, sepse gjatë verës së vitit 1978, në shtëpinë e Abdullah Prapashticës, në Prishtinë, - rruga e ”Bihaçit” nr. 28-a, kanë formuar organizatën ilagele armiqësore të quajtur ”Partia Komuniste Marksist-Leniniste e Shqiptarve në Jugosllavi”, me qëllim të kryerjes së veprave penale të drejtuara në rrëximin e pushtetit të klasës punëtore dhe punonjësve, minimin e rregullimit shoqëroro-ekonomik, të përcaktuar me kushtetutë, thyerjen e vëllazrim (…) shpërthimin e demonstratave armiqësore dhe kontrarevolucionare më 11 dhe 26 mars dhe 1 e 2 prill 1981, anëtarët e kësaj organizate e shfrytëzojnë për plasimin e platformës së tyre, në rend të parë duke marrë pjesë aktive në këto demonstrata, e duke insistuar në mesin e demostruesve që të përdoret parulla ”Kosova Republikë”, pastaj shkruan parulla dhe shpërndanë afishe me përmbajtje armiqsore me dt. 14 prill 1981, KQ të LKJ dhe Qeverisë Jugosllave i dërguan ”Notë”, me ç’rast muarën përgjegjësinë për organizimin e demonstratave, me dt. 30 maj 1981 i dërguan letër KK të Kosovës, të gjithë Komiteteve komunale, dhe Sekretariateve për punë të brendshme në Kosovë, ku bëjnë fjalë për gjendjen politike dhe ekonomike të viseve shqiptare në Jugosllavi, më 5 qershor 1981, i dërguan letër kryeradaktorit të gazetës ”Borba” Marko Llolliq, **me dt. 14 gusht 1981 KQ të LKJ dhe Qeverisë Jugosllave i dërguan ”Letër” dhe e ftuan LKJ për bisedime si partner dhe parti të barabarta,** mandej vazhduan aktivitetin ilegal dhe armiqësor, me shtypjen dhe shumëzimin e fletushkave: ”Teoria dhe praktika e revolucionit”, ”Revolucioni”, ”Zëri i atdheut”, në të cilat fletushka në mënyrë të paskurpullt sulmohet rregullimi shoqëror në RSFJ, shkruan afishen të dedikuar pionerve dhe një afishe në formë letre me të cilën iu drejtuan pjesëtarve të kombësisë serbe, malazeze, maqedone etj, që jetojnë në viset ku banojnë shqiptarët,

- me çka kanë kryer veprën penale bashkimi për veprimtari armiqsore nga neni 136 al. 1 lidhur me nenin 114 të LPJ.

II.Të akuzuarit Fatmir Grajçevci, Bahtir Ahmeti, Martin Quni, Meriman Braha, Osman Maqedonci, Arban Hoxha, dhe Naim Mahmudi,

Spse me qëllim të kryerjes së veprave penale të drejtuara në rrëximin e pushtetit të klasës punëtore dhe punonjësve, minimin e rregulllimit shoqëroro-ekonomik, të përcaktuar me kushtetutë, thyerjen e vllazerim bashkimit dhe barazisë së kombeve dhe kombësive si dhe ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të shtetit, të akuzuarit Fatmir Grajçevci dhe Bahtir Ahmeti, që nga viti 1980, ndërsa të akuzuarit Martin Quni, Meriman Braha, Osman Maqedonci, dhe Naim Mahmudi, që nga viti 1981, ndërsa i akuzuari Arban Hoxha, nga muaji shtator i vitit 1981, bëhen anëtar të organizatës ilegale armiqësore të quajtur PKMLSHJ, njohtohen me programin dhe ideologjin e kësaj organizate me përmbajtje armiqësore, siç janë: ”Programi”, ”Materiale”, ”Fletushka”, ”Revolucioni”, ”Teoria dhe praktika e revolucionit”, dhe ”Zëri i atdheut”, marrin detyra

konkrete për masovizimin dhe formimin e grupeve të ”Dhjetsheve” dhe të ”Treshit”, marrin pjesë në përpilimin dhe shumëzimin e materialeve të përmendur me përmbajtje armiqësore, marrin pjesë në demostratat armiqësore dhe kontrarevolucionare me dt. 11 dhe 26 mars dhe 1 e 2 prill 1981 në Prishtinë, e më vonë vazhdojnë aktivitetin e tyre ilegal armiqësor me shkëmbimin e literaturës me përmbajtje armiqësore dhe në angazhimin e ithtarve të rinjë në këtë organizatë –

-me çka kanë kryer veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al 2 lidhur me neni 114 të LPJ.

III.Të akuzuarit Sabit Gashi dhe Skender Vardari

Sepse kah fundi i vitit 1981 në Prishtinë pas kontakteve në mes të akuzuarve Skender Vardari dhe Fatmir Grajqevci, si dhe kontaktit në mes të akuzuarit Skender Vardarit dhe Osman Osmanit, duke vepruar nga platforma e PKMLSHJ, të akuzuarit Sabit Gashi dhe Skender Vardari, e kanë formuar grupin e posaçëm armiqësor të organizuar në formë të treshit, anëtar i të cilit janë bërë këta të akuzuar, e më vonë në këtë grup e kanë angazhuar të akuzuarin Ahmet Islamin, si antarë të tretë të grupit, të cilin grup e kanë formuar me qëllim të kryerjes së veprave penale të drejtuara në rrëximin e pushtetit të klasës punëtore dhe punonjësve, minimin e rregullimit shoqëror-ekonomik, prishjen e barazisë së kombeve dhe kombësive dhe ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të RSFJ, ashtu që i akuzuari Sabit Gashi ka kërkuar që të akuzuarit Skender Vardari dhe Ahmet Islami, të shkruajnë dhe shpërndajnë afishe dhe parulla me përmbajtje armiqësore. Më (…) të vitit 1982, i akuzuari Sabit Gashi, të akuzuarit Skender Vardarit ja ka dhënë një shabllon për shkruarjen e parullës ”Kosova Republikë” të cilën më parë e kishte pregsditur i akuzuari Sabit Gashi, me dt. Të pavërtetuar të muajit shkurt të vitit 1982, i akuzuari Sabit Gashi, të akuzuarit Skënder Vardarit dhe Ahmet Islamit ua ka dhënë afishen me përmbajtje armiqësore të titulluar ”Thirrja e përgjithshme” dhe 70 ekzemplarë të materialit me përmbajtje armiqësore, të cilin i akuzuari Sabit Gashi, e ka nxjerrur nga libri ”Vetadministrimi Jugosllav teori dhe praktikë kapitaliste” e kanë shumëzuar me makinë të shkrimit, pastaj të akuzuarit Skender Vardari dhe Ahmet Islami, në të njëjtën ditë, rreth orës 22.00, e kanë marrë materialin e shumëzuar me titull ”Thirrje e përgjithshme” dhe kanë filluar që të shpërndajnë në Prishtinë në rrugën e Sarajevës, me ç’rast organet e SPB në Prishtinë, të akuzuarin Skender Vardarin e kanë zënë në vepër,

- me çka kanë kryer veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 1 lidhur me nenin 114 të LPJ.

IV.I akuzuari Ahemt Islami

Sepse me qëllim të kryerjes së veprave penale të drejtuara në rrëximin e pushtetit të klasës punëtore dhe të punonjësve, minimin e rregullimit shoqëroro-ekonomik të përcktuar me kushtetutë, thyerjen e vllazrim-bashkimit, prishjen e barazisë së kombeve dhe kombësive dhe ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të RSFJ, në fillim të vitit 1982, bëhet anëtar i tretë i grupit ilegal armiqsor, të cilin e kanë formuar të akuzuarit Skender Vardari dhe Sabit Gashi, (…)-

-me çka ka kryer veprën penale të veprimtarisë armiqësore nga neni 136 al 114 të LPJ.

V.I akuzuari Lutfi Maqedonci

Sepse me qëllim të kryerjes (…) kombësive dhe ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të shtetit me dt. 11 e 26 mars 1981, muar pjesë aktive në demostratat armiqësore dhe kontrarevolucionare të organizuara në Prishtinë, kurse në demostratat e 1 prillit 1981, në Prishtinë së bashku me të akuzuarin tjetër Prapashtica ka brohoritur parollat armiqësore ”Kosova Republikë”, ”Poshtë spiunët”, ”Bashkohuni” etj., dhe ka

shpërnda afishe të cilat kanë qenë të shkruara sipas programit të, që më parë në, ”PKMLSHJ”, ndërsa pas demostratave kontakton me Abdullah Prapashticën, (…) ndër themeluesit e ”Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste të Shqiptarëve në Jugosllavi”, -

-me çka ka kryer veprën penale veprimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni (…) të LPJ.

VII.Të akuzuarit Ahmet Qeriqi, Hamzë Morina, Sallah Jonuzi dhe Idriz Jusufi,

Me qëllim të rrëximit të pushtetit të klasës punëtore dhe të punonjësve, ndryshimin antikushtetues të rregullimit shoqëror-ekonomik të përcaktuara me kushtetutë, thyerjen e vllazrim bashkimit dhe të barazisë së kombeve dhe kombësive si dhe ndryshimin antukushtetues të rregullimit federativ të shtetit, në mënyrë jo të vërtetë dhe me qëllime të këqija i paraqitën rrethanat shoqërore politike me përmbajtje armiqësore dhe ate:

1.I akuzuari Ahmet Qeriqi, në vitin 1979, në banesën e të akuzuarit Zenun Gjocaj, në Prishtinë së bashku me këtë, kanë lexuar dhe komentuar revistën ilegale të emigracionit ekstrem shqiptar, ”Bashkimi”, ”Organ i Frontit të Kuq”, ndërsa nga i akuzuari Zenun Gjocaj, muar për lexim revistën ilegale ”Lajmëtari i lirisë” dhe ”Liria” të cilat revista në muajin tetor të vitit 1980, ia jep për lexim Sanije Qerkinit në muajin shkurt të vitit 1981, ia jep për lexim nxënsit të vet Enver Veseli, kurse në muajin korrik të njejtat revista ia jep për lexim poashtu nxënësit Fatmir Grajqevci, së bashku me materialin ”Fronti Nacional për Çlirimin Kombëtar”, ndërsa nga i akuzuari Fatmir Grajqevci, merr materialet e organizatës ilagele armiqësore ”PKMLSHJ”, ”Revolucioni”, ”Platforma e PKMLSHJ”, dhe ”Zëri i atdheut”, pastaj në muajin dhjetor të vitit 1980 Ymer Halitit ia jep për të lexuar revistat ilegale ”Bashkimi”, ”Lajmëtari i lirisë” dhe ”Liria” numër 1 dhe në bisedë me te ka paraqitur në mënyrë të rrejshme rrethanat ekonomike dhe politike kinse eksploatohen ”Trepça dhe KSAK, -

-me çka ka kryer veprën penale për propagandë armiqësore nga neni 133 al 1 të LPJ.

2.I akuzuari Zenun Gjocaj, në vitin 1979, në banesën e tij në Prishtinë, së bashku me të akuzuarin Ahmet Qeriqi, lexuan revistën ilegale të emigracionit ekstrem shqiptar ”Bashkimi” organ i ”Frontit të kuq” e mandej të akuzuarit Ahmet Qeriqi, ia dha për të lexuar revistën ilegale me përmbajtje armiqësore ”Lajmëtari i lirisë” dhe ”Liria”, kurse në muajin shtator të vitit 1980, nga i akuzuari Ahmet Qeriqi, muar materialin me përmbajtje armiqësore ”Lëvizja patriotike e Kosovës”, e pasi që e lexoj dhe e përpunoi ia dha për lexim Sokol Metajt, -

-me çka ka kryer veprën penale propaganda armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ.

3.I akuzuari Hamzë Morina, në muajin qershor të vitit 1981, prej Halit Krasniqit nga fshati Vllashkodrenovc, mori materialin me përmbajtje armiqësore në dorshkrim, prej 10 faqesh, të njejtat i korrigjoi dhe i përgatiti për shtyp, si dhe fletushkën me përmbajtje armiqësore ”Republika e Kosovës”, të njejtin muaj dhe vit në shtëpinë e Musa Statovcit nga Prishtina, nga i akuzuari Fatmir Grajqevci, muar revistën ilegale ”Liria” numër 2, të cilën ia dha për lexim të akuzuarit Martin Qunit, dhe Beqir Bashës, ndërsa nga i akuzuari Martin Quni, muar fletushkën ”Revolucioni” në muajin shtator të vitit 1981, në banesë e vet, të akuzuarit Fatmir Grajqevci ia dha materialin me përmbajtje armiqësore ”Kosova Republikë”, ndërsa nga Musa Statovci mori materialet e organizatës ilegale ”PKMLSHJ” dhe të njejtat materiale ia jep për t’i lexuar të akuzuarit Martin Quni, -

-me çka ka kryer veprën penale propaganda armiqësore nga neni 133 al 1 të LPJ.

4. I akuzuari Sallah Jonuzi, gjatë vitit 1981 në Prishtinë, pasi që nga i akuzuari Arban Hoxha, mori materialin me përmbajtje armiqësore "Programi i PKMLSHJ" dhe e lexoi, te njejtin ia dha për lexim Hajredin Hajredinit, student nga fshati Radolishtë-KK Strugë, me ç'rast e njohtoi për ekzistimin e organizatës ilegale "PKMLSHJ " e ia dha edhe fletushkën me përmbajtje armiqësore "Teoria dhe praktika e revolucionit” –

-me çka ka kryer veprën penale propaganda armiqësore nga neni 133 al.1 të LPJ.

5. I akuzuari ldriz Jusufi, me dt. 11 mars 1981, njohtohet nga i akuzuari Osman Maqedonci, për ekzistencën e organizatës ilegale armiqësore të quajtur "PKMLSHJ" dhe se ai është anëtar i saj, në gjysmën e vitit 1981 prej tij merr fletushken,,Revolucioni", kurse më vonë, me qëllim të rrëximit të pushtetit të klasës punëtore të punonjësve ndryshimin antikushtetues të rregullimit shoqeroro ekonomik, të përcaktuar me kushtetutë, thyerjen e vllazrim bashkimit dhe barazisë së kombeve dhe kombësive, në menyrë të pa vërtetë dhe me qëllime të kqija, ia paraqiti rrethanat shoqërore politike në atë menyrë që të njejtit i jep materialin me përmbajtje armiqësore "Këngët e lirise", Grupi "Marksist Leninist i Kosovës" - me çka ka kryer veprën penale propaganda armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ.

VIII. **I akuzuari Agim Ahmeti**, sepse në vitin 1979, nga i akuzuari Rexhep Maqedonci, ka marrë "Platformën e PKMLSHJ", ndërsa në muajin qershor 1981, nga i njejti merr edhe fletushkën ,,Revolucioni", të cilat mandej ia kthen edhe pse e ka ditur se i akuzuari Rexhep Maqedonci, është antar i PKMLSHJ dhe se po perkatitej kryerja e veprës penale për të cilën sipas ligjit mund të shiqptohet dënimi me burgim prej 14 vjetesh, apo dënim më i rëndë, nuk u ka treguar organeve të ndjekjes në kohë, gjer sa ende ka qenë e mundur që të pengohet kryerja e saj, kështu që i akuzuari Rexhep Maqedonci, edhe kreu veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 1 lidhur me nenin 114 të LPJ,-

- me çka ka kryer veprën penale mos kallximi i veprës penale nga neni 172 al. 1 të LPK.

Prandaj giykata në bazë të dispozitave të neneve në fjalë, si dhe dispozitave të neneve 5, 33, 38, 41, 50, dhe 66 të LPJ, si dhe dispozitës së nenit 351 të LPP, i

GJYKON

Te akuzuarin **Rexhep Maqedonci**, me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 14 (katërmbëdhjetë) vjetësh, kuillogaritet edhe koha e vuajtur në paraburgim prej 13 maj 1982, e tutje, si dhe koha e kaluar në izolim prej 19 mars 1981, gjer në caktimin e paraburgimit.

- ndërsa të akuzuarve Martin Quni dhe Hamzë Morina u shqiptohet masa e sigurimit ndalimi i ushtrimit të profesionit të gazetarit, dhe ate të akuzuarit Ahmet Qeriqi, në kohëzgjatje prej 3 vjetësh, të akuzuarve Zenun Gjocaj dhe Meriman Braha, dhe Adem Dervisholli në kohëzgjatje prej 2 vjetësh, dhe të akuzuarve Martin Quni dhe Hamzë Morina, në kohëzgjatje prej 2 vjetësh, duke llogaritur prej ditës kur aktgjykimi merr formën e prerë, e duke mos iu llogaritur koha e kaluar në burg.

(…)

ARSYETIMI

Prokuroria publike e qarkut në Prishtinë me aktakuzën PP. nr. 98, 152,156 158 / 82 dt. 11 nëntor 1982, i akuzoi: Rexhep Maqedoncin, Adem Prapashticën, Lutfi Maqedoncin, Nusret Ahmetin, Kadri Cakiqin, dhe Adem Dervishollin, për veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 1, 36 al. 1 lidhur me nenin 114 të LPJ; Fatmir Grajqevcin, Bahtir Ahmetin, Agim Ahmetin, Martin Quni, Meriman Brahen, Osman Maqedoncin, Arban Hoxha, Avdi Krasniqi, dhe Naim Mahmudi, për veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 2 lidhur me nenin 114 të LPJ; Ahmet Qeriqin, Zenun Gjocaj, Hamëz Morina dhe Sallah Jonuzi, për veprën penale propaganda armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ. Me aktakuzën PP.nr. 66 / 82 dt. 15 tetor 1982, i akuzoi Sabit Gashin, Skender Vardarin, dhe Ahmet Islamin, për veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 1 lidhur me nenin 114 të LPJ: ndërsa me

aktakuzën PP.nr. 98 / 82 dt. 17 janar 1983, e akuzoi Idriz Jusufin për veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 2 lidhur me nenin 114 të LPJ.

Pas mbajtjes së seancës kryesore, në fjalën përfundimtare, përfaqesuesit e aktakuzës, bënë ndryshime në cilësimet juridike të veprave penale dhe ate për të akuzuarin Lutfi Maqedoncin, duke i vënë në barrë veprën plenale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 2 lidhur me nenin 114 të LPJ: për të akuzuarin Agim Ahmeti, duke i vënë në barrë veprën penale moskallximi i veprës penale nga neni 172 al. 1 të LPK; për të akuzuarin Avdi Krasniqi, duke i vënë në barrë veprën penale cënimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 144 të LPJ; për të akuzuarin Idriz Jusufi, duke i vënë në barrë veprën penale propaganda armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ; si dhe për të akuzuarin Ahmet Islami, duke i vënë në barrë veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al 2 lidhur me nenin 144 të LPJ.

Përndryshe përfaqësuesit e aktakuzave deklaruan se mes provat e administruara në seancën kryesore, është vërtetuar se të gjithë të akuzuarit i kanë kryer veprat penale që u vehen në barrë me aktakuzat e ndryshuara në seancën kryesore, prandaj propozuan që të gjithë të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të gjykohen sipas ligjit.

Të akuzuarit në mbrojtjet e tyre, deklarojnë dhe ate:

I akuzuari Rexhep Maqedonci, në hetuesi është mbrojtur se gjatë vitit 1977, me Abdullah Prapashticën ka biseduar rreth çështjes pse Kosova nuk mundet me qenë republikë. Gjithashtu kanë biseduar që të formojnë një grup, i cili do të angazhohej rreth kësaj çështje. Në verë të vitit 1978, siç mbrohet ky i akuzuar, janë takuar në shtëpinë e Abdullah Prapashticës, ku kane qenë edhe Abdullah dhe Adem Prapashtica, Adem Dervisholli, Osman Osmani, Faton Topalli, Nusret Ahmeti, Skender Ibishi, Lutfi Maqedonci, Fahrije Osmani dhe Kadri Cakiqi. Në këtë mbledhje është formuar grupi i quajtur "PKMLSHJ ". Më tutje deklaron se në fillim të vitit 1979, Agim Ahmeti, në shtëpinë e tij ia ka dhënë materialin "Platforma e PKMLSHJ", për ta njohtuar me ekzistimin e kësaj partie, ndërsa në prill të vitit 1981, siç mbrohet ky i akuzuar, në shtëpinë e tij ka ardhe Agim Ahmeti dhe Abdullah Prapashtica, e ky i fundit, i ka treguar për ekzistimin e "PKMLSHJ". Në qershor të vitit 1981, Abdullah Prapashtica i ka treguar se në shtëpinë e vet e ka strehuar Vahide Brahën, bashkëshorten e të akuzuarit Meriman Braha, ndërsa për Merimanin ka thënë që e ka strehuar në Ferizaj në shtëpinë e Fatmir Bajramit. Së bashku me Avdullahun, e kanë vizituar Meriman Brahën, e me atë rast Abdullahu e ka prezentuar si anëtar të "PKMLSHJ". Meriman Brahës, ia kanë dhënë materialet "Programi", dhe "Statuti", e më vonë i kanë dhënë një material me dorshkrim që ta korigjoi dhe ta shtypë në maqinë. Thotë se Meriman Braha u ka siguruar shaptilograf nëpërmes të Arban Hoxhës. Më tutje deklaron se me rastin e punësimit në SPB, i ka konsultuar Abdullah Prapashticën dhe Meriman Brahën të cilët kanë konsideruar se një gjë e tillë është sukses i "PKMLSHJ". Lidhur me detyrën e tij si anëtar i "PKMLSHJ" deklaron se ka qenë ngarkuar më anën informative dhe ka paseë për detyrë që të përcjell disponimin e njerezve (..)

Në seancën kryesore ky i akuzuar është mbrojtur se, ”PKMLSHJ" ekziston qysh nga viti I975 e në verë të vitit 1977, janë tubuar në shtëpinë e Abdullah Prapashtices, disa shokë që të cilët kanë dëshiruar që të punojnë dhe te veprojnë nga platforma e kësaj "Partie". Në seancë deklaron se nuk është i sigurtë se a ka marrë pjesë në atë mbledhje edhe i akuzuari Adem Dervisholli, se më në fund deklaron se kryetar i "PKMLSHJ" është zgjedhur Abdullah Prapashtica, e sekretar Osman Osmani dhe ky i akuzuar, ndërsa në udhëheqësi janë zgjedhur Skenderi, Nusreti dhe Fatoni.

I akuzuari Adem Prapashtica, në hetuesi ka deklaruar se pasi që është kthyer nga shërbimi ushtarak ka filluar që të shoqërohet me Osman Osmanin, i cili gjatë bisedave e ka kritikuar pse nuk ngritet ideologjikisht nga pozitat tjera, e jo nga pozitat e LKJ. Deklaron se kane shkruajtur një letër për Kongresin e XI të LKJ, në të cilën kanë bërë fjalë rreth çështjes pse Kosova nuk është Republikë. Thotë se në vitin 1978, Osman Osmani, i ka thënë se për të nesërmen do të shkojnë në shtëpinë e tij me disa shokë, e i ka thënë qe t'i largoi prindërit prej shtëpie. Kështu me atë rast, siç deklaron ky i akuzuar kanë shkuar Osman Osmani, Kadri Cakiqi, Nusret Ahmeti, Rexhep Maqedonci, Skender Ibishi, Faton Topalli, dhe Adem Dervisholli. Në atë takim ka qenë edhe Abdullah Prapashtica ndërsa Kadrije Cakiqi, i ka shërbyer. Më tutje deklaron se është veshur me tesha soleme dhe e ka hapur mbledhjen, e gjatë mbledhjes është folur për Markesizëm - Leninizëm. Pas 3-4 muajsh prej asaj mbledhje, siç mbrohet ky i akuzuar, Osman Osmani e ka njohtuar se i akuzuari Nusret Ahmeti ka dhënë dorëheqje e mandej, dorëheqje kanë dhënë edhe Kadri Cakiqi, Adem Dervisholli dhe më në fund deklaron se edhe vet ka dhënë dorëheqje. Thotë se ka marrë pjesë në demostratat e 26 marsit 1981, gjer sa e kanë larguar organet e sigurimit, e deklaron se nuk ka vepruar asgjë. Në mbrëmje, përsëri ka dalë në qytet, e Kadria ia ka dhënë disa letra, të cilat ka filluar që t'i shpërndajë, por pasi që i ka dhënë tri - katër copë, organet e sigurimit kanë filluar që të hedhin bomba lotësjellese ashtu që turma e demostruesve është shpërndarë. Më tutje mbrohet se më 2 prill 1981, dhe netve tjera, se bashku me Osman Osmanin dhe Lutfi Maqedoncin, në shtëpinë e tij kanë bërë roje, e kanë qenë të armatosur me automatin zyrtar të Abdullah Prapashticës e një gjë tillë e kanë bërë nga se janë frikuar se mos e vrasin Abdullahun. Abdullah Prapashtica dhe Osman Osmasni, siç deklaron ky i akuzuar e kanë derguar Vahide Brahën në Ferizaj t burri i saj - i akuzuari Meriman Brahaa, e cila në atë kohë ka qenë e strehuar. Në tri raste, ka bërë roje, në shtëpinë ku ka qenë i strehuar Meriman Braha, e gjatë asaj kohe ka qenë i armatosur me revole të markes "QZ". Thotë se i ka ndihmuar Abdullah Prapashticës dhe Osman Osmanit me një rast kur në shtëpinë e tij është shumëzuar material propagandistik. Në seancën kryesore ka deklaruar se në mbledhjen e parë të "PKMLSHJ" nuk ka marrë pjese Adem Dervisholli, e për vehte thotë se ka marrë pjesë në demostratat e 26 mars e 1 dhe 2 prillit 1981, në Prishtinë, e në demostrata thotë se ka marrë pjesë edhe Kadri Cakiqi dhe Avdi Krasniqi, dhe se gjatë asaj kohe i ka brohoritur parollat të cilat i ka brohoritur edhe turma e demostruesve.

I akuzuari Lutfi Maqedonci, është mbrojtur se në verë të vitit 1978, ka shkuar në shtëpinë e Abdullah Prapashtices, i cili ia ka dhënë për t'i lexuar disa materiale nga të cilat ka kuptuar për ekzistimin e "PKMLSHJ", e gjithashtu për ekzistimin e kësaj "Partie" i ka treguar dhe Abdullah Prapashtica. Për ekzistimin e kësaj partie i ka treguar Burim Ismajlit, dhe Rrahim Ramës. Thotë se më 2 prill 1981, është takuar me Abdullah Prapashticën në Prishtinë, i cili e ka porositur që të shkoi më vonë në shtëpinë e tij ashtu që kah ora 18.00, ka shkuar ku e ka takuar Abdullah Prapashticën, Adem Prapashticën dhe Osman Osmasnin, e më vonë ka shkuar edhe Gani Grajqevci, me të cilin kanë hyrë një dhomë ku së bashku kanë lexuar "Statutin e PKMLSHJ", e pasi që kanë ngelur duke lexuar edhe pas orës 20.00, atë natë kanë ndejtur në shtëpinë e Abdullah Prapashticës. Më tutje deklaron se me 3 prill 1981, Abdullah Prapashtica, i ka treguar se organet e sigurimit e kërkojnë Ahmet Qeriqin, e për behet thotë se Abdullahut i ka thënë se për këtë gjë do ta njohtojë Ahmetin. Deklaron se në verë të vitit 1978, ka bërë roje në oborrin e shtëpisë së Abdullah Prapashtices. Thotë se ka pasur kontakte me të akuzuarin Naim Mahmutin i cili i ka preferuar që gjatë shërbimit ushtarak ta zgjerojnë rrethin në mes ushtarve.

Thotë se gjatë vitit 1979, Shemsi Bajramit i ka treguar për ekzistimin e "PKMLSHJ", se është anëtar i saj, për qëllimet dhe synimet e kësaj partie, por deklaron se këtij nuk i ka

dhënë material. Në seancën kryesore pranon se ka bërë roje, kur është mbatjur mbledhja e "PKMLSHJ" se i ka lexuar materialet e kësaj partie, por thotë se lidhur me ekzistimin e kësaj partie nuk ka biseduar me askend, dhe se askujt nuk i ka treguar për ate që është bërë anëtar i saj.

I akuzuari Nusret Ahmeti, në mbrojtjen e vet ka deklaruar se në vitin 1978, mes Osman Osmanin, kanë biseduar rreth çeshtjes pse Kosova nuk zhvillohet sa ka mundesi, e në një rast tjetër për ato çështje ka biseduar së bashku me Osman Osmanin dhe Abdullah Prapashticën, pas dy-tre muajsh prej atyre bisedave në korzo në Prishtinë është takuar me Osman Osmanin e ai i ka thënë që të shkoj në shtëpinë e Abdullah Prapashticës, e për vehte thotë se ka vepruar ashtu, ku është takuar me Osman Osmanin, Rexhep Maqedoncin, Lutfi Meqedoncin, Adem Prapashticen, Abdullah Prapashticen, Kadri Cakiqin, Faton Topallin, dhe Skenderin. Në bisedë e sipër, siç thot ky i akuzuar, ka kuptuar për ekzistimin e PKMLSHJ, e Osmani e ka spjeguar për qëllimet e kësaj partie, duke e komentuar platformën, e duke treguar se duhet organizuar në formë të treshit. Pas një kohe, prej këtij takimi, ka shkuar te **Abdullah Prapashtica, e me atë rast Abdullahu i ka diktuar e ky ka shkruajtur letren për organet politiko-shoqerore, me të cilën e ka njohtuar për ekzistimin e PKMLSHJ.** Më tutje thotë se në shtëpinë e **Osman Osmanit, me Abdullah Prapashticën e kanë shkruajtur telegramin ngushëllues me rastin e vdekjes se Shokut Tito.** Në shtëpinë e Osman Osmanit, ka lexuar një pjesë të Statutit të PKMLSHJ, e gjithashtu thotë se në atë shtëpi në një rast kur kanë qenë edhe Osmani dhe Abdullah Prapashtica, të akuzuarit Fatmir Ahmeti, i është propozuar që, të bëhet anëtar i kësaj partie, e më vonë Abdullah Prpashtica, respektivisht në shtëpinë e tij, të akuzuarin Bahtir Ahmeti, i ka spjeguar platformën e PKMLSHJ Osman Osmani. Thotë se në takimet e PKMLSHJ është folur për angazhimin e anëtarve të tij, e për vehte deklaron se nuk është angazhuar në atë drejtim. Më 1 prill 1981, deklaron se demostruesve u është bashkangjitur te Fakulteti Teknik me atë rast i ka brohoritur parollat Kosova Republikë, "Lironi shokët nga burgu" etj. Në demostrata ka pa edhe Adem Prapashticen dhe Osman Osmani, e më vonë jashtë turmës e ka parë edhe Nusret Ahmetin e Bahtir Ahmetin. Më tutje deklaron se e ka bëë korigjimin e "Statutit", gjer sa ka qenë në dorshkrim dhe se kanë folur që t'i shkruajnë letër Kongresit të XI të LKJ për çështjen e Kosovës. Në seancën kryesore është mbrojtur se ka marrë pjesë në mbledhjen e parë të PKMLSHJ, por se nuk është deklaruar shprehimisht që a pranon që të bëhet anëtar i kësaj partie. Gjithashtu pranon se ka marrë pjese edhe në takimet tjera së bashku me të vllanë Bahtir Ahmetin (...)

I akuzuari Kadri Cakiqi, është mbrojtur se në vitin 1978, Osman Osmani, i ka folur për situatën në Kosovë, e gjithashtu i ka treguar për ekzistimin e një organizate ilegale. E ka thirrë që të shkoj te daja i tij Abdullah Prapashtica, ku kanë qenë edhe Rexhep Maqedonci, Adem Prapashtica, Lutfi Maqedonci, Faton Topalli dhe Adem Dervisholli, e normalisht Osman Osmani dhe Abdullah Prapashtica. Thotë se Abdullah Prapashtica u ka lexuar Platformën e PKMLSHJ. Pas këtij takimi, pas pak kohe përsëri janë takuar në të njejten shtëpi, e tani kanë qenë Osman Osmani, Abdullah Prapashtica Rexhep Maqedonci, Adem Prapashtica dhe Nusret Ahmeti. Me atë rast kanë lexuar platformën, siç thot me qëllim që ta përvetësojnë. Thot se në platformë nuk kanë pasur vërejtje. Osman Osmani ia ka dhënë platformën të cilën (...) mandej t'ia jap Nusret Ahmetit, por siç deklaron, pasi që e ka lexuar, të njejten e ka djegur, e për një gjë të tillë e ka njohtuar Osman Osmani, në prezencën e Adem Dervishollit. Deklaron se Osmani Osmani konkretizon se përveç mbledhjes themelore i ka pasë edhe disa takime me Abdullahun, Osmanin dhe Ademin, me ç'rast kanë biseduar rreth çështjeve të ”partisë". Pas tre muajsh prej mbledhjes

themelore në shtëpinë e Abdullahut është takuar me Abdullah Prapashticën, Adem Prapshticën, Nusret Ahmetin dhe Adem Dervishollin, ku më vonë ka ardhur edhe Nusret Ahmeti. Deklaron se kanë patur pseudonime e për vehte thotë se pseudonimin e ka patur "Kulla". Thotë se gjatë vitit 1978 së bashku me Osman Osmani, e ka vizituar të akuzuarin Adem Dervishollin në shërbimin ushtarak në Zajeqar. Me ta ka qenë edhe Adem Prapashtica, e me atë rast Ademin e kanë njohtuar për aktivitetin e "Partisë".

I akuzuari Adem Dervisholli, në hetuesi është mbrojtur se me Osman Osmanin, njihen qysh prej vitit të parë të shkollës së mesme. Në vitin 1978, Osman Osmani i ka thënë që t'i përcjellë njerëzit që veprojnë kundër sistemit të Jugosllavisë, si dhe të lexoj sa më shumë literaturë marksiste. Me 13 qershor 1978, deklaron se ka shkuar në shërbimin ushtarak e Osman Osmani, ka shkruajtur mjaft shpesh duke e porositur që të lexoj sa më shume. Precizon se në një rast, Osman Osmani i ka shkrujtur se edhe vllaut të tijj - Afrimit i ka thënë që të lexoj sa më shumë, e në këtë letër i është përgjegjur që Afrimin ta lej rahat. Mbrohet se nuk ka marrë pjesë në asnjë mbledhje e nuk ka marrë pjesë në demostrata. Më vonë, në hetuesi ky i akuzuar ka deklaruar se në këtë veprimtri e ka shtyer Osman Osmani, prej të cilit ka mësuar se ekzsiston PKMLSHJ. Thot se e ka njohur edhe të akuzuarin Kadri Cakiqi, me të cilin në shtëpinë e Osman Osmanit kanë patur biseda rreth qëllimeve të organiziatës PKMLSHJ, se duhet ta rrisin numrin e anëtarëve të kësaj organizate me anëtar të rinjë, e mundësisht anëtarët e rinjë të jenë anëtar të LKJ. Flet për takimin në shtëpinë e Abdullah Prapashticës, ku kanë qenë Abdullahu, Ademi, Osmani dhe Kadri Cakiqi, me ç'rast Abdullahu ka foluar për gjetjen e anëtarve të rinj. Spjegon se i është i njohur se anëtarët e kësaj partie kanë pasur edhe pseudonime. **Gjatë shërbimit ushtarak korespondencë ka mbajtur me Osman Osmanin i cili e ka njohtuar për punën e orgnizatës.** Në APJ e kanë vizituar Osman Osmani si dhe Kadri Cakiqi dhe Adem Prapashtica, e me atë rast i kanë treguar se shokët e partisë janë mirë, duke e porositur që të jetë më aktivë e të lexoj më shumë. **Thot se letra ka shkëmbyer për shkak të informimit rreth punës së partisë**. Në seancën kryesore është mbrojtur se i njef Osman Osmanin, Kadri Cakiqin, dhe Lutfi Maqedoncin, me të cilët është shok dhe është takuar, e gjatë atyre takimeve kanë pasë biseda të rëndomta. Gjatë vizitës Ahmet Qeriqi, gjatë mësimit, siç mbrohet ky i akuzuar ka kuptuar se është i interesuar për veprimtari armiqësore, e pas demostratave i ka thënë se ndoshta do të bëhet demostrata, duke porositur që të del në demostrata dhe të njejtat t'i organizojnë bashkarisht. Gjatë kohës, gjersa i akuzuari Ahmet Qeriqi, ka qenë në arrati dhe atë pas demostratave, nëpër mes të Tefik Grajqevcit ka shkuar te ai dhe ia ka dhënë materialet me përmbajtje armiqësore "Revolucioni", "Zëri i atdheut" dhe "Platforma". Më tutje deklaron se gjatë vitit 1980, Ahmet Qeriqi, ia ka propozuar për bashkëpunim dhe futje në këtë organtzatë nxënësit Naim Mahmudi nga Kërçova, Enver dhe Gani Veseli nga Prishtina, e siç thot pasi në këtë drejtim ka qenë edhe iniciativa e Abdullahut që vetë të formojë grupin, Enver Veselit ia ka dhënë materialet "Revolucioni", "Platforma", dhe "Zëri i atdheut", e atë e ka porositur që të njejtat t'ia jep edhe Ganiut. Me 2 prlll 1981, ka shkuar në shtëpinë e Abdullahut, ku kanë qenë edhe Adem Prapashtica, Lutfi Maqedonci, dhe Osman Osmani. Me Lutfiun me një dhomë i kanë lexuar materialet, e gjatë asaj kohe në uniformë ka ardhur Rexhep Maqedonci. Thot se atë natë kanë bërë roje duke u ndrruar, e kanë qenë të amatosur me një automat dhe revole. Mes 3 prill 1981, së bashku me Lutfiun kanë kaluar nëpër qytet për të parë se si zhvillohej ngjarja, e mandej kanë shkuar në shtëpinë e Abdullahut dhe e kanë njoftuar. Thot se për veprimtari armiqësore i është ofruar edhe Hamze Morinës, të cilit ia ka dhënë materialet me përmbajtje armiqësore dhe propagandistike "Platforma" dhe "Revolucioni". Më tutje deklaron se qëllimi i "Partisë" ka qenë bashkimi i trojeve të banuara me shqiptarë dhe formimi i "Republikës së

Kosovës". Para se me i lexuar materialet në fjalë, deklaron se me përmbajtjen e të njejtave e ka njohtuar gojarisht Abdullahu. Materiaiet "Platforma", "Zëri i atdheut" dhe "Revolucioni" ia ka dhënë edhe Skender Vardarit, të cilin e ka njohtuar edhe për ekzistimin e PKMLSHJ, mandej si duhet të punohet dhe për angazhimin e anëtarve të rinjë. Thotë se me Skender Vardarin kanë punuar në "Stemën e Kosovës" të cilën nuk e kanë kryer. E pasi që ka shkuar në shërbimin ushtarak Skenderi e ka vazhduar punën me Sabit Gashin dhe Ahmet Islami. Pas demostratave, me Abdullahun kanë biseduar që të organizojnë demostratat e grave në Fakultetin e Mjekësisë dhe në Fabrikën "Kosovka", mes ç'rast të kërkohet lirimi i bijve dhe vllezërve nga burgjet. Më tutje spejgon për bisedat për organizimin e "Organizatës së pionerve", si dhe për gjetjen e maqinës së shkrimit. Pranon se ka marre pjesë në demostrata me Skender Vardarin më 11 mars 1981, e vet thotë se ka marrë pjesë edhe në demostratat e organizuara me 1 dhe 2 prill 1981.

Në seancën kryesore mbrohet se nuk ka ditur për ekzistimin e "Partisë" se nuk është bërë anëtar i saj dhe se askujt nuk i ka dhënë material me përmbajtje armiqësore dhe propagandistike. Pra, në seancën kryesore mbrohet se nuk e ka kryer veprën penale që i vehet në barrë.

I akuzuari Bahtir Ahmeti, në hetuesi është mbrojtur se kah gjysma e muajit prill 1980, Osman Osmani, e ka thirr që të shkoj në shtëpinë e tij, ku ka shkruar së bashku me vllaun - të akuzuarin Nusret Ahmeti, e atje u ka folur për ekzistimin e PKMLSHJ, e pasi që e kanë pyetur se a pranon që të bëhet anëtar, i është përgjegjur pozitivisht. Pas disa ditësh pas atij takimi Osman Osmani ia ka dhënë materialin "Programi i PKMLSHJ", e pasi që e ka lexuar, ia ka kthyer. Në maj te vitit 1980 Osman Osmani i ka thënë që me vllaun Nusret Ahmeti të shkojnë në shtëpinë e Abdullahut është takuar edhe me Osman Osmanin, Abdullah dhe Adem Prapashticën. Me atë rast Abdullahu u ka folë për "Partinë" qëllimet e saja, e mandej Osmani u ka folur për mënyrën e punës, e mandej ua ka sjellur "Statutin" e PKMLSHJ të cilin e kanë lexuar. Në qershor të vitit 1980, siç mbrohet Nusret Ahmeti i ka thënë se duhet të largohen nga ajo veprimtari, për çka është pajtuar dhe i ka thënë Nusretit se për një gjë të tillë ta lajmëroj Osman Osmanin. Deklaron se ka marrë pjesë në demostaratat e 1 prill 1981 e turmës së demostruesve i është bashkangjitur te Shkolla "Vlladimir Nazor" e me atë rast i ka brohoritur parullat "Trepça është e jona", "Obiliqi është i joni", "Kosova Republikë". Më tutje mbrohet se në gusht të vitit 1981, te tregu i Prishtinës, është takuar me Osman Osmanin me të cilin mandej kanë shkuar në lulishten e qytetit, e me atë rast Osmani ka folur dhe i ka ofruar qe t'i pranoj materialet e "Partisë", kështu që përsëri është aktivizuar. E ka marre materialin "Revolucioni" të cilin mandej ia ka dhënë Basri Ratkocerit. Në shtator të vitit 1981 nga Osman Osmani e ka marrë një material për pioner, titulli i të cilit nuk i kujtohet, e cili ka pasë përmbajtje armiqësore, e këtë material ia ka dhënë nipit - Basriut. Të njëjtit i ka dhënë edhe materialin me përmbajtje armiqësore "Teoria dhe praktika e revolucionit". Në seancen kryesore është mbrojtur se Osman Osmani e ka njohtuar me Abdullah Prapashticën e një rast së bashku kanë shkuar në shtëpinë e Abdullahut, ku është folur "Pse Kosova është e pazhvilluar dhe sikur ta kish statutin e Republlikës do të zhvillohej". Pohon se e ka lexuar një material që është folur për zhvillimin e Kosovës, si dhe "statutin", e kur ia ka kthyer Osman Osmanit i ka thënë se nuk dëshiron që të merret me veprimtari të tillë.

I akuzuari Agim Ahmeti, si në hetuesi ashtu dhe në seancën kryesore ka deklaruar se nuk është marrë me veprimtari armiqësore.

I akuzuari Martin Quni, në mbrojtjen e vet deklaron se Abdullah Prapashticën e njef qysh para 20 vjet nga se janë fqinjë. Pasi që është kthyer prej shkollimit ne Beograd, thotë

se ka shkuar te Abdullah Prapashtica, i cili i ka treguar se akoma nuk ka diplomuar dhe se për temë të diplomës ka marrë "Trajtimi i çështjes nacionale të kombësisë shqiptare", dhe i ka thënë se si brendi dhe esencë e kësaj teme do të jetë formimi i,"Partisë Komuniste Shqiptare", siç kanë edhe republikat tjera. Thotë se ka vrejtur kur te Abdullah Prapashtica kanë ardhur Rexhep Maqedonci, Osman Osmani etj. Në një bisedë, Abdullahu i ka thënë se kërkesa "Kosova Republike" është plotësisht e drejtë, e për këëe, siç deklaron është pajtuar. Më tutje mbrohet se në maj të vitit 1981, ka shkuar në shtëpinë e Abdullahut, i cili ia ka treguar gazetën "Rilindja" ku ka shkruar për ekzistimin e PKMLSHJ dhe dy organizata tjera ilegale iredentiste, e për **PKMLSHJ, i ka thënë se nuk është iredentiste,** se ajo "Parti" i ka organizuar demostratat me qëllim që Kosova të formohet si republikë në Jugosllavi. Kah gjysma e muajit maj, poashtu në shtëpinë e Abdullahut, ky i ka treguar se ekziston PKMLSHJ se gjithënjë e më tepër kjo organizatë masovizohet, e me atë rast ia ka dhënë "Projektin, Programin dhe Statutin e PKMLSHJ" të cilin material e ka lexuar në shtëpi dhe ka vrejtur se ka qenë majft ekstrem dhe me shumë gabime. Pas një jave, përsëri ka shkuar te Abdullahu, nga se, siç deklaron, kish filluar një proçes i angazhimit të mendimeve të tij në këtë drejtim. Me atë rast Abdullahu e ka pyetur për materialin e i është përgjegjur se i pëlqen, por se ka gabime gjuhësore, duke i dhënë vrejtje se nuk i pëlqen çështja e forcës, dhunës, dhe terrorizmit. **Më tutje deklaron se kah fundi i korrikut të vitit 1981, përsëri ka shkuar te Abdullahu, e me ate rast ai ia ka treguar artikullin që kish dalur në gazetën "Borba" dhe i ka thënë që t'i shkruaj një përgjegje kryeredaktorit, duke i treguar se ç'drejtim duhet me iu përgjegjur. Një detyrë të tillë e ka pranuar dhe i ka shkruajtur përgjegje kryeredaktorit Marko Llolliq, e përgjegjen e ka shkruajtur në emër të PKMLSHJ.** Thote se më vonë Abdullahu i ka spjeguar për "Partinë" dhe si është e organizuar, duke i thënë se ajo është aktive dhe se e ka organin e vet "Revolucioni", e me atë rast ia ka dhënë atë material. Të njejtin e ka lexuar dhe është pajtuar me atë që ka shkruajtur, e pas disa ditësh prej Abdullahut ka marrë edhe materialin "Kosova Republikë". Pas dy muajsh ka shkuar në banesën e Hamzë Morinës, të cilit i ka treguar për ekzistimin e PKMLSHJ, mënyrën si vepron ajo "Parti", e i ka thënë që të ndikojë që të mos dilet në demostrata. **Prej Hamzë Morinës e ka marre "Liria nr. 1" të cilën i ka dhënë Abdullahut, e ky e ka qortuar se lexon meteriale të tilla, nga se siç deklaron ky i akuzuar nuk u perputhet ideologjia.** Deklaron se Hamzë Morinës nuk i ka thënë që të bëhet anëtar i "PKMLSHJ", por thot se të njejtën e ka vlerësuar si simpatizues të kësaj "Partie". Thot se Abdullahu i ka thënë në një bisedë se pozita e tij ndaj "Partisë" është vetëm si simpatizues. Në një rast, ka desht që ta strehoj një vajzë në shtëpi të vet, e me kërkesën e Abdullahut, por një gjë të tillë nuk e ka bërë nga se Abdullahu në ndërkohë e kish strehuar ne vend tjetër.

I akuzuari Meriman Braha, në mbrojtjen e vet deklaron se Abdullah Prapashtica, si punëtor i sigurimit shtetror, e ka përcjellur, për çka edhe i është meriztur. Më 3 prill 1981, siç deklaron ky i akuzuar Osman Osmani, i ka thënë se i kanoset rreziku nga likuidimi". Për këtë shkak ka shkuar në Prizren dhe është strehuar. Atje ka shkuar Abdullahu dhe Osmani, si dhe bashkshortja e tij, e cila e ka bindur që të pranoj për tu strehuar në Ferizaj. Me automobilin e Abdullahut kanë shkuar në Ferizaj, dhe është strehuar në shtëpinë e Fatmir Bajramit. Gjatë kohës gjer sa ka qenë i strehuar, e kane vizituar Rexhep Maqedonci, Adem papashtica dhe Faton Topalli dhe i kanë treguar për ekzistimin e "Partise", e gjithashtu ia kanë dërguar materialet "Programi i PKMLSHJ" të cilin pasi që e ka lexuar, ka vrejtë se është i shkruar me stil mjaft të dobët. Thot se gjatë kohës së strehimit e ka bërë korigjimin e "Programit" në 30 faqe. Më tutje mbrohet se personave në fjalë u ka thënë se nuk dëshiron që të bëhet anëtar është pajtuar me programin e tyre, duke shtuar se ka thënë se është e

pamundëshme që të bashkohen të gjitha trojet e banuara me shqiptarë në Jugosllavi, në një republikë. Më, tutje deklaron se në bisedë e sipër e paraqit mendimin që nënat dhe gratë e të burgosurve të tubohen dhe të paraqiten te organet kompetente për tu ankuar, duke theksuar se ka menduar se në këtë mënyrë do të ndihmojë në stabilizimin e gjendjes. **Thotë se është mbështetur te personat e përmendur për shkak të gjendjes së krijuar pas demostratave, e përndryshe ata i ka vlerësuar si të papjekur**. Gjatë kohës gjer sa ka qenë i strehuar në Ferizaj, Abdullahu ia ka sjellur edhe "Notën" nga përmbajtja e së cilës ka vrejtur se krejt përgjegjësinë për organizimin e demostratave e kish marrë PKMLSHJ. Thotë se nuk është pajtuar me ideologjin e kësaj "Partie", por ka konsideruar se kërkesa që Kosovës t'i njihet statusi i republikës, pa shkëputje, është e drejtë.

I akuzuari Osman Maqedonci, në hetuesi është mbrojtur së në qershor të vitit 1981, Abdullah Prapashtica, ia kish lënë në shtëpi revistën "Nin", e në të materialin "Zeri i atdheut". Thot se në mbrëmje e ka lexuar atë material dhe e ka kuptuar përmbajtjen e në të cilin është folur për ekzistimin e PKMLSHJ. Të nesërmen, siç deklaron ky i akuzuar, në shtëpinë e tij ka shkuar Abdulah Prapashtica dhe ia ka kërkuar atë material, duke e pyetur se a i pëlqen. Në këtë pyetje është përgjegjur se nuk deshiron të ndëgjoj për gjëra të tilla, nga se është anëtar i LKJ. Thot se Abdullah Papashticës ia ka dhënë hua 10.000.oo dinarë, me rastin kur është martuar, e pasi që këto të holla nuk ia ka kthyer, me babain e tij kanë shkuar në Turqi - në Ankara ku është takuar me Abdullahun, Faton Topallin dhe Osman Osmanin. Së pari janë takuar në shtëpinë e dajës së Abdullahut, e mandej në një hotel, ku Abdullahu ia ka kthyer të hollat. Me ate rast, i ka treguar se ka biseduar me konzulin e Shqipërisë dhe me ambasadorin, të cilët i kishin dhënë të holla dhe se e kish paraqitur kërkesën për te shkuar në Shqipëri. Përveç kësaj thot se Abdullah Prapashtica e ka porositur që vllaut të tij të ia dërgoj me postë një material, për të cilin i ka thënë se ai e din se i ku është mshefur. Thot se për veprimtari armiqësore ka qenë i njohtuar nga Abdullah Prapashtica dhe për të hyrë në një veprimtari të tillë ka qenë i mashtruar.

I akuzuari Arban Hoxha, në hetuesi është mbrojtur se në qershor të vitit 1981, Osman Osmani, i ka treguar se ekziston "Partia" kur është formuar ajo "Parti" si dhe qëllimet e saja. Gjithashtu deklaron se tri herë është takuar me Abdullah Prapashticën në shtëpinë e Osman Osmanit, e herën e fundit, Abdullahu më ka folur për ekzistimin e "Partise", ndërsa Osmani ia ka dhënë materialet "Statuti" dhe "Programi", të cilat mandej ky ia ka dhënë Hajredin Hajredinit dhe Sallah Jonuzit dhe xhaxhait - Imerit. **Thot se që të dy kanë konstatuar se materiali është i dobët dhe me shume gabime**. Përveç kësaj, prej Osmanit i ka marrë fletushkën "Revolucioni", tri ekzemplarë të fletushkes "Zëri i atdheut", e pasi që i ka lexuar ia ka dhënë Hydajete Osmanit. Pasi që janë lajmëruar në SPB Hydajetja dhe Meriman Braha, ka shprehë dëshirën që të mos ketë lidhje më tutje. Spjegon se i ka treguar Osman Osmanit se si mund të bëhet shumëzimi i materialit në menyrë primitive, pasi që ai s'është ankuar nuk mund të shumëzojë materialet. Abdullah Prapashtica siç deklaron ky i akuzuar, i ka treguar se në çdo qyetet ka organizateë të "Partisë" dhe se nuk kanë nevojë përr armë për tani, e nëse paraqitet nevoja, armët do t'i marrin prej APJ nga se edhe atje i kanë njerëzit e vetë. Për njoftimin me Osman Osmanin thot se atë e ka bërë Halla e tij - Vahidja, e cila e ka njohtuar për ekzistimin e "Partisë", ndërsa Osman Osmanin e ka njohtuar për mënyrën e organizimit, qëllimet etj, të kesaj "Partia", me atë rast ia ka dhënë edhe "Programin", të cilin mandej ia ka dhënë për lexim Sallah Jonuzit, dhe Imerit. **Thot se në fund të vitit 1981, në shtëpinë e Osmanit, Abdullah Prapashtica i ka folur për "Organizatën" se anëtarët e saj kryesisht duhet të jenë anëtar të LKJ**, mandej se organizata në Ferizaj ka marrur akcione konkrete-shkruarjen e parollave dhe se neie nuk plotësohen kushtet e kësaj organizate do të

ndërmerren akcione ekstreme siç janë atentate ndaj disa personave. Më tutje thot se në gusht të vitit 1981, Osman Osmasni i ka propozuar qe te orginizohen demostratat e grave. Në seancën kryesore, ky i akuzuar është mbrojtur një lloj si në hetuesi duke propozuar se nuk është bërë anetar i "Partise".

I akuzuari Avdi Krasniqi, në hetuesi ka deklaruar se më 11 mars 1981, e ka pasur ditlindjen, e pasi që ka deshtë që ta festoj, ka dalur për të blerë pije alkoolike, e ka vrejtur se është tollovi, është afruar dhe një profesor e ka lutur që të hypë në një trafostacion të vogël, e t'i lus studentët që të qetësohen, e pastaj tu folë Pajazit Nushi. Thot se studentet e kanë ofenduar, prandej ka zbritur dhe është tërhekur te çebaptorja "Pallma" e cila është përballë mensës së studentëve. Me 26 mars 1981, siç mbrohet ky i akuzuar, përsëri ka hasur në turmen e demostruesve, e ka dalur prej konvikti sipas porosisë së Zymber Zymberit, me të cilin, siç thot ka bashkëpunuar që t'i zbuloj pjesëmarresit e demostratave. Thot se ate ditë është takuar me Abdullah Prapashticen, me të cilin me automobile ka shkuar në qendër të qytetit ku ka qëndruar për ta prituar stafetën e rinisë. Me 1 prill 1981, deklaron më tutje ky i akuzuar, kah ora 15.00, ka dëgjuar zëra, prandaj ka dalur te menza e studenteve, dhe ka vrejtur, e kah ora 16.00, ka zbritur në qytet dhe është ndalur para ndërtesës së Komitetit Krahinor, ku është takuar me Florijen dhe Nazën, e kjo e fundit e ka njohtuar me Adem Prapashticën duke ia prezentuar si dajë. Fahrija, gjatë asaj kohe, me një copë çeramidje në rrugë ka shkrujtur "poshtë spiunet", "Bashkimi", "I duam kushtet", e mandej e ka nxjerr një tubë letrash dhe ua ka dhënë këtij dhe Ademit, duke u thënë që t'i shpërndajnë por në atë kohë janë hedhur bombat lotsjellëse, ashtu që nuk kanë mundur që t'i shpërndajnë. Në maj të vitit 1981, me kërkesën e Fahrijes është takuar me Abdullah Prapashticën te konviktet e studentëve e mandej me automolin e Abduilahut kanë shkuar gjer te Fakulteti teknik e me atë rast Abdullahu e ka pyetur se a ka diçka të re.

I akuzuari Naim Mahmudi, në hetuesi, para gjyqtarit hetues ka deklaruar se gjer sa ka qenë nxënës Enver Veselit, ia ka pareë gazetën "Liria", por për një gjë të tillë nuk është aq i sigurtë, e me atë rast i ka thënë se nuk dëshiron të merret me gjëra të tilla. Në një rast, duke shkuar prej Fakultetit Filozofik, në atë Teknik në Prishtinë, siç thot Enver Veselit ia ka parë "Statutin". Pas demostratave të vitit 1981, siç thot, disa herë, Enveri i ka folur lidhur me gjendjen e krijuar, e për vehte thot se nuk i është bashkangjitur bisedës, për çka, siç thot i akuzuari, Enveri me siguri e ka humbur besimin. Deklaron se nuk ka ditur për ekzistimin e PKMLSHJ. Më vonë, gjithashtu në hetuesi i akuzuari ka deklaruar se është e vërtetë ajo që ka deklaruar në proçesverbalin e dt. 10 qershor 1982 dhe 19 qershor 1982. Thot se programin e PKMLSHJ ia ka dhënë Enver Veseli, e mandej deklaron se qysh në vitin shkollor 1980 /81 me Enver dhe Gani Veselin kanë biseduar për gjëra të cilat nuk janë të lejushme. Në seancën kryesore, ky i akuzuar është mbrojtur se nuk është marrë me kurfarë veprimtarie armiqësore dhe se nuk është bër anëtar i ndonjë partie.

I akuzuari Ahmet Qeriqi, si në hetuesi ashtu edhe ne seancën kryesore është mbrojtur se Fatmir Graiqevcin dhe Enver Veselin i ka pasë nxënës dhe se te dy kanë qenë si nxënës të mire. Thot se që të dy e kanë njohtuar se kanë lexuar literaturë te ndryshme. Më tutje deklaron se gjatë kohës gjer sa ka qenë në arrati, Fatmir Grajqevci ia ka dërguar "Platformën e PKMLSHJ" dhe "Revolucionin", si dhe "Bashkimi" ndërsa ia ka dhënë gazetat "Liria" dhe "Lajmëtari i lirise" të cilat i kanë marrë prej Zenun Gjocaj. Gazetat "Liria" dhe "Lajmëtari i lirisë" ja ka dhënë Enver Veselit. Më tutje deklaron se i ka lexuar revistat ilegale "Bashkimi" në një artikull të së cilës, të mbartur nga gazeta "Ylli", është bërë fjalë mbi gjendjen ekonomike sociale në Kosovë. Këtë e ka lexuar në banesën e

Zenun Gjocaj. Thot se i ka lexuar edhe gazetat "Lajmëtari i lirisë" dhe "Liria", të cilat ua ka dhënë Fatmir Grajqevict dhe Enver Veselit, e gjithashtu ua ka dhënë edhe "Lëvizja patriotike e Kosovës". Ymer Halitit ia ka dhën për lexim ,,Lajmëtari i lirisë", "Bashkimi" dhe "Liria", ndërsa Sanije Qerkinit ia ka dhënë për lexim "Netët Kosovare", "Këngët e Drinit të Bardhë".

I akuzuari Zenun Gjocaj, si në hetuesi ashtu edhe në seancën kryesore është mbrojtur se në vjeshtë të vitit 1980, prej Ahmet Qeriqit, ka marur një material të shtypur me maqinë prej Ahmet Qeriqit titulli i të cilit nuk i kujtohet, e përmbajtja e të cilit ka qenë nga pozitat nacionaliste si dhe gazetat "Bashkimi" dhe ”Lajmëtari i lirisë". Pasi që i ka lexuar, këto materiale i ka lënë në shtëpi prej ku i ka marrë Sokol Metaj. Në pranverë të viti 1981, prej Fetah Berishës i ka marë revistat "Bashkimi" dhe ”Lajmëtari i lirisë", e pasi që i ka lexuar Ahmeti ia ka kthyer Fetah Berishës. Me Ahmet Qeriqin, siç deklaron ky i akuzuar kanë biseduar për gjendjen e veshtirë ekonomike të Kosovës por jo me qëllim të keq. Më tutje mbrohet se në vitin 1980, prej Ahmet Qeriqit e ka marur revisten "Organi i Komitetit të Lëvizjes në Kosovë", ku është shkruajtur për gjendjen e veshtirë në Kosovë, e të cilin material mandej e kanë komentuar me Ahmet Qeriqin.

I akuzuari Hamzë Morina, në hetuesi dhe në seancën kryesore është mbrojtur se në qershor të vitit 1981, në fshat është takuar me Halil Krasniqin, i cili kish shkuar te halla. Halit Krasniqi, ka shkuar në oborrin e shtëpisë së tij dhe i ka thën që të korigjoj një material. Pasi që ka qenë mbrëmje, e nuk ka mund që ta lexoj, të njejtin nuk e ka korigjuar. Pas 15 ditësh, në mengjes, Haliti ia ka dhënë atë material që ta shtyp me maqinë. Më vonë e ka lexuar dhe ka parë se ka përmbajtje armiqësore. Atë material nuk e ka korigjuar e as shumëzuar, por pasi që e ka lexuar e ka asgjasuar. Në korrik të vitit 1981, siç deklaron më tutje ky i akuzuar, nga Gjermania e ka sjellur revistën ”Liria numër 2" e pasi që e ka lexuar ia ka dhënë Martin Qunit, e pas disa ditësh ky ia ka kthyer, e mandej ia ka dhënë Halit Krasniqit, ashtu që më tutje nuk ka shkuar ky material. Në fund të muajit gusht apo në fillim të muajit shtator, siç thot ky i akuzuar Fatmir Grajiqevci nëpërmjet të Musa Statovcit, ia ka dhënë gazetën "Rilindja", ku ka qenë materiali "Revolucioni”. Pas 15 ditësh, në banesën e tij ka shkuar Fatmir Graiqevci dhe Musa Statovci. Fatmiri me atë rast ia ka dhënë një pliko, ku kanë qenë gazeta "Zeri i atdheut", ”Instrukcionet”, ”Statuti” dhe "Dokumentet". Atë ditë, deklaron më tutje, Fatmir Grajqevict ia ka dhënë fletushkën "Republika e Kosovës" që e kish marrë prej Halit Osmanit. Matierialet në fjalë pasi që i ka lexuar, ia ka dhënë edhe Martin Qunit, i cili më vonë i ka thënë se të njejtat i ka asgjësuar. Martin Quni, i ka ofruar edhe materialin "Revolucioni", por i është përgjegjur se te njejtin e ka marrë prej tjetërkujt. Thot se për ekzistimin e PKMLSHJ ka lexuar në gazetë e nuk ka dëgjuar prej askujt.

I akuzuari Sallah Jonuzi, mbrohet se në qershor të vitit 1981, dy javë ka banuar në shtëpinë e Arban Hoxhës. Hajredin Hajredini, e ka parë 2-3 herë dhe se të njejtin e ka njohur vetëm si figurë. Mbrohet se askujt nuk i ka marrë dhe nuk i ka dhënë ndonjë material me përmbajtje propagandistike. Më vonë ka deklaruar se gjatë kohës gjer sa ka banuar në shtëpinë e Arban Hoxhës, ky e ka lutur që Hajredin Hajredini t'ia qoj një material të PKMLSHJ, i cili ka qenë i mbështjellur në gazetë. Këtë material të njejtën ditë ia ka dhënë Hajredin Hajredinit, e ky mandej po ashtu atë ditë ia ka kthyer.

I akuzuari Sabit Gashi, në hetuesi ka deklaruar se me Skender Vardarin njihet qysh nga shkolla e mesme. Në vitin 1979, ka rënë në kontakt me Ekrem Llugiqin, i cili siç thot, ka filluar që t'i pregadisë për veprimtari armiqesore. Kah fundi i vitit 1982, siç deklaron,

Skender Vardari, ka kërkuar prej tij që të shkruaj parolla dhe ai t'i shpërndaj. Së pari thotë se Skender Vardarit ia ka dhënë një letër e cila ka qenë e kombinuar me pezë, e ku ka qenë e grafuar parolla "Kosova Republike". Në fillim të marsit të vitit 1982, Skender Vardarit ia ka dhënë pamfletin "Thirrje e përgjithshme" e shtypur në matricë dhe me atë rast e ka mësuar se si ta shumësoj e i ka dhënë edhe ngjyrën. Më tutje thot se i ka dhënë edhe 70 faqe të shumëzuara, qe ti shpërndajë, material të nxjerrur nga libri i EnverHoxhes, "Veteadministrimi Jugosllavë teori dhe praktikë kapitaliste". Thotë se Skender Vardarit i ka thënë që ta angazhoi Ahmet Islamin, e me atë rast Skenderi i eshte pergegjur se Ahmeti nuk është i ngritur ideologiikisht. Më vonë, Skenderi i ka treguar se Ahmet Islami do ta angazhoj per shumëzimin e materialeve më lartë të përmendur. Në seancën kryesore ka deklaruar se ka punuar siç është mbrojtur edhe në hetuesi por se nuk eshte bërë anëtar i ndonjë partie dhe se me Skender Vardarin nuk kanë biseduar që të organizojnë grup ilegal armiqësor.

I akuzuari Skender Vardari, në hetuesi është mbrojtur se në mars të vitit 1982, Sabit Gashi, i ka treguar se i posedon disa materiale, të cilat duhet që të shumëzohen dhe të shpërndahen. Janë marrë vesh që Skenderit t'ia jep ato materiale. Më 9 mars 1982, siç deklaron ky i akuzuar, Skenderi ia ka dhene materialet në fjalë. Thot se Sabitit i ka treguar se për shumëzimin e atij mteriali do ta angazhoj edhe Ahmet Islamin, e i është përgjegjur "Bënë si të duash" pasi që t'i e njef Ahmetin". Me 10 mars 1982, deklaron më tutje ky i akuzuar, e ka thirr Ahmetin dhe në shtëpinë e vete i kanë shumëzuar 170 apo 180 kopje të materialit "Thirrja e pdrgiitshshme". Në rrugen e "Sarajeves" në Prishtinë, mbi hekurudhë, siç thotë, posa i kanë shpërndarë 4- 5 ekzemplarë të materialit "Thirrja e përgiithshme"' i kanë hetuar organet e sigurimit ashtu që për vehte thot se e kanë zenë ndërsa Ahmet Islamin me ate rast ka hikur. Prej Sabit Gashit e ka marrë edhe një shabllon për shumëzimin e parullës "Kosova Republikë" por të njejtin nuk e ka përdorur. Sa i përket angazhimit të Ahmet Islamit, precizon se kur ka biseduar me te për shumëzimin e materialit, Ahmet Ahmeti vetëm e ka pyetur prej kujt i ka marrë ato materiale dhe është pajtuar. Thot se nuk kanë pasë marrëveshje për formimin e grupit ilegal, por vetëm se i kanë thën Sabitit se janë në dispozicion për shkruarjen e parollave, apo për tu marrur me ndonjë veprimtari armiqësore. Sabiti siç mbrohet ky i akuzuar e ka porositur që parullën "Kosova Republikë", ta shkruaj nëpër mure por një gjë të tillë nuk e ka bërë. Me vonë i akuzuari ka deklaruar se me Fatmir Grajqevcin, merren me veprimtari armiqësore prej vitit 1979. Pas demostratave, në një rast, Fatmiri e ka njohtuar për ekzistimin e PKMLSHJ, e i ka treguar se ai grup e ka marrë përsipër organizimin e demostratave. E ka prositur që me këtë "Parti" të njihet shumica e njerëzve e me një gjë të tillë, siç thot është pajtuar. Në takimet e mëvonshme, siç deklaron i akuzuari Skender Vardari, i akuzuari Fatmir Grajqevci i ka thënë se ka rënë në kontakte me anëtaret e PKMLSHJ, por se akoma nuk është bërë anëtar, për shkak se një anetar i saj - Abdullah Prapashtica ka qenë punëtor i SPB. Thot se për këtë parti çka ka ditur i ka treguar Sabit Gashit. Fatmir Grajiqevci e ka njoftuar me Osman Osmanin, i cili i ka thënë se qëllimi i "Partisë" është fitimi i statusit "Kosova Republikë", si dhe zgjerimin me anëtarë të rinjë. E gjithashtu i ka thën se më gjërësisht do ta njohtoj pasi që t'i lexoj materialet e kësaj partie. Thot se prej Fatmir Grajqevcit ka marrë materialet "Revolucioni", "Statuti", "Programi" dhe "Instrukcionet". Më tutje deklaron se pasiqë Fatmir Grajiqevci ka shkuar në shërbimin ushtarak e ka porositur që të mos kontaktoj me askend por me gjithatë siç thot ka biseduar me Sabitin, të cilit ia ka dhënë për të lexuar materialet në fjalë, e me te cilin kanë vendosur që të ndërmarrin një aksion, të cilin edhe e kanë ndërmarrë e që u permend më lartë, me qëllim që të pranohen në radhët e PKMLSHJ.

Në seancën kryesore deklaron se nuk është bërë anëtar i PKMLSHJ edhe pse ka qenë i gatshëm që të punoj në drejtimin që "Kosova të fitoj statusin e Republikës". Thot se prej Fatmir Grajiqevcit i ka marrë materialet e ”Partisë” siç u përmendën më lartë. Por lidhur me përmbajtjet e tyre nuk ka komentuar asgjë.

I akuzuari Ahmet Islami, në hetuesi është mbrojtur se Skender Vardarin e ka shok klase dhe se shoqërohen qysh moti, ndërsa Sabit Gashin e njef prej vitit 1981. Që të tre shpeshherë kanë qenë bashkë, por thot se asnjë herë nuk kanë biseduar për ndonjë veprimtari aimiqësore. Deklaron se Skender Vardari e ka thirr që të shumëzojnë materialin "Thirrja e përgjithshme". Këtë material deklaron më tutje e kashkruajtur në matricë me maqinën e vet, e me 10 mars 1982, në shtëpinë e Skender Vardarit, të njejtin tërë ditën e kanë shumëzuar, e rreth orës 22.00, me autobus kanë shkuar në afërsi të Xhamisë së Llapit në Prishtinë ku i kanë zbritur autobusit, e mandej kanë shkuar në lagjen mbi hekurudhë ku kanë filluar që t’i shpërndajnë materialet në fjalë, duke i lanë afër dyerve të shtëpive. Me atë rast janë diktuar nga organet e SPB, të cilët e kanë zënë Skenderin ndërsa për vehte thot se ka hikur jashtë Prishtinës, ashtu që një kohë është mëshehur. Thot se e ka bërë një shabllon për shkruarjen e parullës "Kosova Republikë", por të njejtin nuk e ka përdorur. Deklaron se nuk e din se si janë gjetur në shtëpinë e tij kopjet e materialit "Vetëadministrimi Jugosllavë" por shton se të njejtat me siguri ia ka lënë Skender Vardari. Në seancën kryesore, e pranon veprimtarinë, por deklaron se nuk është bërë anëtar i PKMLSHJ.

I akuzuari ldriz Jusufi, ne hetuesi është mbrojtur se Osman Maqedoncin, e ka kusheri të largët prandej edhe njihen-qysh nga femijëria. Thot se pas 11 marsit, e para 26 marsit 1982, Osman Maqedonci, së bashku me vllaun e vet Lutfiun kanë shkuar në shtëpinë e tij, e kur ka dalur që t'i përcjell i ka thënë që don të bisedoj, kanë shkuar së bashku gjer në Tauk Bashqe, ku Osman Maqedonci, i ka treguar se ekziston një grup, i cili angazhohet që **”Kosova të shpallet Republikë"**. Me atë rast, siç deklaron i akuzuari Osmanit nuk i ka thën se pranon e as se nuk dëshiron që të bëhet anëtarë, pergjatë ndarjes, Osmani i ka thënë "U muarem vesh". Thot se kah gjysma e vitit 1981, Osman Maqedonci ia ka dhën fletushkën "Revolucioni" të mbështjellur me gazeten "Rilindja", të cilën pasi që e ka marrë e ka lënë në ulsen e mbrapme të automobilit. Të nesërmen atë fletushkë, siç deklaron ia ka kthyer Osmanit nëpërmes të Isak Krasniqit. Pas një kohe, Osmani e ka pyetur se a e ka lexuar, e i është përgjegjur se e ka lexuar, por se nuk e ka kuptuar. Për festën e Bajramit Osmani dhe Rexhep Maqedonci kanë shkuar në shtëpinë e tij, e në atë kohë djali i xhaxhit - Ejupi, siç deklaron i akuzuari, e ka pasë në dorë broshuren ”Këngët e lirisë”. Këtë broshurë mandej ia ka kërkuar Osmani, prandaj ia ka marrë Ejupit dhe ia ka dhënë Osmanit. Në vitin 1990, Osman Maqedonci, thot se ia ka dhënë për lexim librin ”Shota dhe Azem Galica", për të cilin thot se e ka lexuar pjesërisht. Pas vlerësimeve lidhur me demostratat, ky i akuzuar deklaron se ka vrejtur se ka qenë në rrugë të gabuar, por se ka qenë vonë. Më vonë në hetuesi është mbrojtur se me veprimtari armiqësore ka filluar që të merret pasi që e ka lexuar librin ”Shota dhe Azem Galica", të autorit Ajet Haxhiu. Në seancën kryesore është mbrojtur se nuk është marrë me veprimtari armiqësore, dhe se me Osman Maqedoncin, kanë pasë biseda të rëndomta. Gjithashtu ka deklaruar se nuk ka ditur për ekzistimin e PKMLSHJ "Osman Maqedonci i ka treguar se e ka gjetur fletushkën "Revolucioni" e me atë rast i ka thënë se ia ka dërguar organeve të sigurimit, për çka ka thën se ka bërë mirë. Lidhur me librin "Këngët e lirisë", thot se djali i xhaxhait i ka treguar se e ka gjetur.

==========

Letra të Partisë Komuniste (PKMLSHJ)
1982-1985

Këto letra janë të daktilografuara në bazë të tekstit origjinal, pra nuk janë bërë ndryshime e korrigjime drejtshkrimore.

1. Po na dërgon letra që po ia dikton Abdullah Prapashtica
2. Letër e Abdullah Prapashticës shokëve dhe vëllaut të dashtur Osman Osmani, 14 qershor 1982
3. Procesverbali i rrethit të Shtutgartit, 26 shtator 1982
4. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani), për Xhafer Durmishin-Skenderin, 21 qershor 1983
5. Demaskimi i veprimeve të PKMLSHJ-së dhe formimi i Bashkësisë së Klubeve shqiptare në Evropë, më 9 e 10 korrik 1983 në një shtëpi malore në Zvicër
6. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani), për Sabri Novosellën, 11 korrik 1983
7. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani), për Xhafer Shatrin, 10 gusht 1983
8. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani), për Sabri Novosellën, Dhjetor 1983
9. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani), për Sabri Novosellën, 8 shkurt 1984
10. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani), për OMLK, 30 prill 1984
11. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani) dërguar Sabri Maxhunit-Novosellës në Turqi, 30 prill 1984
12.Letër e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani për Sabri Novosellën, 10 maj 1984
13. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani), për Komitetin "Kadri Zeka", 20 maj 1984
14. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani), për Sabri Novosellën, 10 qershor 1984
15. Letër e Partisë Komuniste (PKMLSHJ - e nënshkruar nga Abdullah Prapashtica, Osman Osmani, Faton Topalli, Nuhi Sylejmani - Luani) dërguar Xhafer Durmishit-Skenderit në Suedi, 13 shkurt 1985 – verzioni i parë, në adresën e Zërit të Kosovës që ka dalë në Suedi
16.Letër e Partisë Komuniste (PKMLSHJ - nga Abdullah Prapashtica, Osman Osmani, Faton Topalli, Nuhi Sylejmani - Luani) dërguar Xhafer Durmishit-Skenderit në Suedi, 13 shkurt 1985 – verzioni i dytë, në adresën e Zërit të Kosovës që ka dalë në Suedi

1. Po na dërgon letra që po ia dikton Abdullah Prapashtica

"*Pasi i përgëzova shokët e Gjenevës, Ejup Ahmetin dhe Elfi Agushin, për organizimin e mirë të demonstratës, (së 10 dhjetorit 1982 në Gjenevë-shën i Xh.D.) ata më takuan me Xhafer Shatrin, të cilit i kërkova bashkëpunim... edhe pse më premtoi* ***me fjalë të „sinqerta“, mjerisht me këtë takim përfundoi edhe bashkëpunimi ynë****!*" (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f.54)

Xhafer Shatri: "***Me Nuhiun po "letërkëmbejmë". Po na dërgon letra që po ia dikton AP*** *(Abdullah Prapashtica-shën i red.) Përmes tyre po përpiqet me tërë qenien e vet ta kuptojë se çka e kemi ndërmend të ndërmarrim. Natyrisht, s'ka mundur të blejë asgjë dhe tash e ka qitur viçin (të gjitha letrat e tij janë shumë provokative) dhe po thotë hiç më pak se "Punëtorët" po i qetë ish-LNÇKVSHJ! Po kërkon takim me "përfaqësuesit e OMLK-s" (Po e përsëris, këtë po e bëj me keqardhje, që të mos ndodhë ndonjëherë të dalë diçka nga letërkëmbimi ynë...). Do t'ia kthej një përgjegje dhe do t'i them merri dy shokët e tu, pra Sk. (Skënderin=Xhafer Durmishin-shën i red.) dhe shokun në Turqi, dhe eja të bisedojmë.*

Pra loja duhet vazhduar*... ata duhet t'i tërheqim për gjuhe ngadalë ngadalë. Natyrisht pa ia përmendur kurrë "Punëtorët" ose fraksionin.* ***Zotriun e tij, udbashin AP duhet ta lëmë le t'i lëpijë kockat*** *Përshëndetje revolucionare Xhema* (Xhafer Shatri) (Letër Qendrës Ekzekutive –Hasan Malës, Faridin Tafallarit dhe Ibrahim Kelmendit, shtator 1983-shën i red.)

(Shënim i Xhafer Durmishit: Kjo letër nuk më dërgohet mua edhe pse isha anëtar i Qendrës Ekzekutive. Kjo letër më ra në dorë për herë të parë më 23 prill 2012)

2. Letër e Abdullah Prapashticës shokëve dhe vëllaut të dashtur Osman Osmani, 14 qershor 1982

Të analizohet Ankara 14 qershor 1982

Të nderuar shokë dhe vëlla i dashtur Halim (Osman Osmani)

Nga letrat dhe materialet që kishin arrit këto ditët e fundit nga ju si dhe nga informatat e materialet që arritën nga Kosova dhe kahjet tjera të botës si dhe nga "Venediku" pjesërisht u informuam për situatën dhe më gëzoi fakti se në çdo pikë të botës ku gjenden shqiptarët mbretëron atmosferë e denjë revolucionare dhe gadëshmëri e plotë për tu vazhduar lufta. Po shifet qartë se gjaku, vujtjet dhe i tër mundi i ynë që po derdhet, në vend se të na dobsojnë, po na forcojnë, e kur kjo e ka epiqendrën në zemrën e Kosovës – në bazën e luftës, është madhështi e cila neve luftarve të mërgimit na përtrin e na forcon që ti përballojmi kushteve të pamundura në mërgim, pa kulëm mbi kokë. Pa tokë të sigurtë nën këmb, pa kushte elementare për jetë, larg vatrave të dashtunve tonë që i lamë pas dhe shum nga nesh i mbyllën. Në rrezik të përditshëm nga plumbat e armikut e pa pamundsi qfardo mbrojtje, larg atdheut, e po qëndrojm dhe do ti qëndrojm duke ju than të gjitha këtyre vujtjeve, smundjeve, skamjes e rrezikut gjithmonë JO. Luftë është kjo, e lufta është e tillë, e kërkon çmimin e vetë, kurse lumturija vjen pas ngadhnjimit të fitores – në liri. E liria ka kushtu dhe do të na kushton shtrenjët, në çka duhet të jemi të gatshëm gjithnjë.

Këto kushte janë të ngjashme kudo. Edhe te ju ishte ashtu. Pra ju informojm se edhe ne këtu nuk gjendemi mirë. Pos të gjitha tjerave që i përmenda më lart, po na ndjek edhe policija vendase e edhe policija e jugut. Pas kërrcnimeve direkte që po na i dërgojn

qe disa her, policija e jugut, si u informuam nga burimet e besueshme, për kokën time e kishin nda një fond të madh të hollash, kurse policija vendase na burgosi në prag të festës të majit, pas përcjelljes njëmuajshe. Në burg na mbajtën dy javë dhe të gjitha hetimet ishin me akuz për spiunazh ndaj vendit të tret – jugut. Në munges të fakteve dhe në bazë të qëndrimit ton të paluhatshëm se në Turqi jemi përkohsisht na liruan, por me akuzë të hapur si terrorista potencial ndaj jugut dhe me hetime të hapura, duke na dhan një javë afat që ta lëshojmë këtë vend. Hetimet nuk ishin të lehta! Pasi dolëm nga burgu, shkuam për në Siri.

Në Siri kaluam një javë dhe pasi nuk kishim kah tja mbajmë u detyruam që prap të kthehemi këtu dhe të vazhdojmi të qëndrojmi nën kërrcnim që të burgosemi prap në çdo lëvizje të dyshmt. Pasi që nuk pranuam se kemi këtu shokë – që të mos krijojmë vështirësi tjera – edhe takimet tona janë vështirsu edhe ma shum. Në anën tjetër, gjendja ime shëndetsore po shkon kah keqsimi e në këtë më ”ndihmoi” edhe ”pushimi i shkurt dy javsh”.

Megjithatë, shpirtnisht jemi njësoj të freskët, moralin e kemi në nivel dhe po ju përballojmi këtyre vështirsive, me fuqi dhe po i kryejm punt që po mundemi.

Plakun e informuam për të gjitha rregullisht si edhe për informatat që erdhën nga ju.

Deri më tash kam pregaditë një përmbledhje të tër të pikpamjeve teorike ku ka dokumente projektore organizative, ligjërata, artikuj etj. Mirpo ato u gjetën të bllokuara pas burgosjes ton përkohsisht.

Deri më tani i patëm katër vizita – për dy nga to ti Halim je i informuar, kurse dy tjera të ma vonshme qenë informative nga ”N. G.” dhe u informuam për arrestimet dhe bllokimin e materialeve që i kërkuam nga arshivi. Prandaj, Halim, angazhou edhe ti që ato materiale të sillen te ju sepse janë të nevojshme!

Udhtimi ynë në Siri nuk kaloi pa rezultate, sepse atje i dërguam dhe i shpërndam ”Zërat”, bam disa vizita të shqiptarëve të randsishëm në Damask dhe i krijuam tri lidhje të cilat ma von do të na shërbejn për krijimin e punkteve ku shkojn materialet dhe ma tutje edhe të Degës të LRSSHJ për Lindje – shtete arabe.

Ky është një raport i shkurt i gjendjes dhe aktiviteti këtu, por jan kryer edhe punë të tjera për të cilat nuk po zgjati këtu si edhe kan ndodhë edhe gjana tjera për të cilat ma von do të informohemi gojarisht nga cilido nga ne këtu!

Tani deshiroj që ti shtroj pikpamjet e mija për disa qështje dhe ti ndriqoj disa kande të luftës politike – bile shkurtimisht.

Që në fillim ju lusë që kësaj teme ti hyni në mënyrë analitike sepse për shkak të mundsive të vogla që ka letra kjo temë do të përmban esencën që do të thot se mund të ketë cungime.

Vija politike dhe vija strategjike

Sa e kuptova nga të gjitha informatat aktiviteti që po zhvillohet atje është mjaftë intenziv kurse organizimi akoma po çalon dhe pikrisht kjo ndikon që spontaniteti të jetë edhe më tutje dominant!

Pjesa organizative me aktivitetin duhet të ballansohet sa më parë në të gjitha degët sepse pikrisht entuziazmi dhe vrulli i pa organizuar na i ka sjell, po na sjell dhe do ti sjell dam qështjes!

Koncepcione e organizimit të udhëheqsis ua dërgova më parë dhe shpresoj se do të ndihmojn në ndarjen e detyrave që na e lehtson punën, dhe jam i mendimit se që nga organi ”Zëri”, ku duhet në ato principe të ndahen rubrikat të fillon kushtimi i kuadrove

në detyrat e veta të cila ma von shëndrrohen në bërthama e grupe punuse të cilat specjalizohen për ato degë – organizata të LRSHJ, duke përcjell aktivitetin e partnerve opozitar në Jug. Për këtë duhet të thuhet ma shum por nuk kam mundisi që këtu të zgjerohem. Shumë është me randsi që LRSHJ të ndërtohet mirë e pastaj të veprohet në organizimin e organizatave të brendshme. Prandaj të kryhet e para. Kjo është me randsi. Në të gjitha dokumentet e LRSHJ, për arsye të njohura, duhet të mungoi terminologjia që na sjell kundërshtar dhe rrezik dhe mjaftonë që LRSHJ do të organizohet në organizata që i kan RS në RSFJ. Kjo flet mjaft. Për këtë qështje në LRSHJ. Sa i përket organizimit të organizatave të brendshme të LRSHJ ajo qështje duhet realizuar, sapo të ndërtohet tërësisht LRSHJ dhe këtë nuk mundet ta pengoi askush sepse ai është vendim i pa tjetërsushëm i dokumentit të bashkimit të 17 shkurtit 1982. Kështu që edhe organizata komuniste edhe tjerat përcjellse do të organizohen. Sa i përket emnit të organizatës komunist, ma merr menja se nuk ka dilemë, sepse plotsisht është i përshtatshëm emni **LK** e Republikës Socialiste Shqiptare në RSFJ nga çdo aspekt e posaqërisht është në vi të LRSHJ. Këtu vetëm në definicionin e **LK të RSSHJ** mund të thuhet ”**LK** e RSSHJ është Parti Komuniste Marksiste Leniniste dhe roli i sajë është pris ideor i klasës punëtore dhe popullit shqiptar në RSFJ, **është pjesë përbërse e LKJ** dhe pjesë integrale e lëvizjes komuniste marksiste leniniste botrore”. Ky definicion vazhdon për dokumentet e **LK** të RSSHJ e jo të LRSHJ. Megjithate në ballë të çdo dokumenti të çdo organizate duhet të qëndron titulli i LRSHJ e pastaj emri i organizatës përkatëse. Sa i përket vetë organizimit të këtyre organizatave ato organizohen nga përbërjet e ma parshme me tituj të njejt në tri drejtimet veç e veç (për shkaqe objektive), kurse kordinimin dhe udhëheqjen e tyre e bën Komiteti i Përgjithshëm i LRSHJ që do të thotë se Komiteti i Përgjithshëm i LRSHJ qëndron mbi Komitetet Qendrore (apo si emnohen) të këtyre organizatave. Konkretishtë, p.sh. nga Kryesia në tri drejtime shtrohet realizimi i këtij vendimi!

Pra tendencat që të mos respektohet ky vendim dhe LRSHJ të shëndrrohet në **Lëvizje klasike të tipit të Lidhjes së Prizrenit, duhet hudhur**, sepse LRSHJ nuk është lëvizje klasike patriotike por është lëvizje e cila përkrah pavarsis dhe barazis kombtare, për të cilat lufton, njëkohësisht zhvillon edhe luft klasore. Andaj kjo duhet të kutphet nga të gjith, dhe nuk ka lëkundje nga ky vendim. Thjesht militantët e tri drejtimeve duhet në kohën që kërkon kjo punë ta realizojnë këtë detyr, e kjo vazhdon edhe për Komitetin Drejtues të KP të LRSHJ për Botën e Jashtme (KD i LRSHJ) edhe për brenda njësoj në kuadër të mundësive dhe kushteve tjera. Pra nuk ka ndamje në ”brenda e jashtë” në këtë drejtim, në drejtim të realizimit të vendimeve të marruna e që kanë randsi të madhe!

Edhe rregullimi i mardhanjeve në KP – KD të LRSHJ në baza të mira ka randsi të madhe. Për këtë ne ua dërguam propozimin e 14 qershorit 1982 i cili zgjedh një varg qështjesh sepse nuk duhet të ndodh që dikush të mund ti ndryshon dhe të mos i realizon vendimet pa qenë ai vendim i shumicës, sikurse që nuk mundet dikush të flas në emën të tjerve apo tjua vesh tjerve gabimet eventuale. Njëkohsisht e eviton tentativën eventuale të dikujt që me arroganc arbitrare dhe dogmatizëm burokratik të imponon qëndrimin e vetë si akt të kryer apo që të fyen dhe të sjell konflikte të panevojshme. Kjo eliminon edhe imponimin e formacioneve të mëparshme mbi LRSHJ. Mirpo ky rregullim i mardhanjeve na venë përgjegjësi të madhe që me kujdes të veçant të analizojm çdo mendim sepse çdo analiz jo ndërgjegjse mundet që ta eliminoi mendimin ma të mir të një shoku dhe ma vonë të dali si ka than ai, prandaj analizë e thellë dhe pa keçkuptime, sepse ka persona që shiqojn gjithnjë nga kandi i zi. Pra çdo gjë duhet analizuar nga kandi i mirkuptimit dhe kështu ma leht dalin në shesh të mirat dhe negativet.

Sa i përket rregullimit funkcional – emrimi në poste të ndryshme është qështje që kërkon zgjedhje të shpejtë sepse ndahen detyrat dhe kemi mundsi që të ju kushtohemi. Kurse sa i përket ksaj qështje nuk ka brengosje pse ai u emnua këtu e tjetri atje sepse ato

do të zhvillohen **në mënyr rotacioni**, kështu që çdo kujt do t'i ipet mundsia që të tregoi aftsit e veta. Pra duhet kuptuar edhe këtë se ska në LRSHJ detyr ma me pak e ma me shum rëndsi.

Në fund të kësaj nënteme dua që të them se çdo lloj polemike demokratike duhet mundsuar dhe potencuar sepse polemika është progresive, mirpo duhet ndaluar dhe hudhur çdo polemik e cila i ngjan grindjes apo akuzave e që zhvillohet me etiketime e fymje. Këto të fundit duhet ndaluar edhe kur dikush me të vërtet ka të drejtë e tjetri ka gabuar sepse ajo lloj sjellje shkon në dam të qështjes sepse then zemrat e shokve të cilët kan vu jetën në disponim të qështjes dhe të cilët jan njerzë të cilët edhe mund të gabojn pa qëllim të keq. Ndryshe është puna me provokatorë e tradhtar e ndryshe me ata që akuzohen pa baza vetëm e vetëm se dikush i lejon vehtes afekte të pa kontrolluara!

Qështje e emnimit të kryetarit, sekretarit, përgjegjësit politik dhe kryesuesit të organizatës komuniste, kryesuesit të org. sindikale, kryesuesit të org. Frontit demokratik, kryesuesit të org. rinisë, kryesuesit të org. të grave dhe kryesuesit për punë me org. e pionerve, nga përbërja e KD të LRSHJ edhe pse kjo duket qështje formale ka randsi për ndarjen e detyrave dhe kushtimit të çdo antari në njohjen e lamis së vetë që do të thot temel i mirë për LRSHJ, për fillim do të ju ishin kushtuar rubrikave shoqrore politike në këto drejtime në org. e LRSHJ "Zërin" e ma vonë edhe do të thellojn punën në këto drejtime. Kjo është e realizueshme.

Tani dëshiroj të flasë diçka elementare rreth visë politike dhe visë strategjike të LRSHJ. Vija politike e LRSHJ edhe ma tutje mbetet LUFTA POLITIKE, në fuqi! Kjo do me than se strategjia politike mbetet lufta politike paqsore! Pra duhet kuptar se qështja e revolucionit të armatosur edhe ma tutje është larg (relativisht). Por duhet ditur se kjo qështje nuk mvaret vetëm nga ne! Mirpo te ne mbetet që kushtet për këtë fazë të realizohen në tërsi, e ato akoma janë larg kërkesave e që duhet realizuar gjatë kësaj faze – luftës politike paqsore. Në këto kushte edhe anmikut po i përgjigjet që ne (LRSHJ) ta braktisim luftën politike dhe të kalojmë në aksione të armatosura. Por, këtyre provokimeve nuk duhet të ju përgjigjemi kur armikut i konvenon, e ati po i konvenon ky potez se tani akoma ka fuqi që të na luftoi. Andaj ne duhet akoma ta godasim me luft politike sepse këtu kemi kriju epërsi dhe në këtë mënyrë do ta dobsojmi për vdekje, e ateher…! Në anën tjetër miqët gjithashtu nuk jan të gatshëm për këtë hap, sigurisht për këto arsye!

Tani për vinë politike nga aspekti i brendshëm! Edhe qështja e moskuptimit të visë politike se kërkesa për Republik duhet të jetë larg kërkesave tjera është për diskutim. Duhet kuptuar se LRSHJ nuk duhet përmend "Vendikun" PPSH, shokun në ball të saj dhe përgjithësisht duhet patur kujdes që të mos përdoret **terminologji për LKJ dhe RSFJ që i përgjithson dhe që për ta është "armiqsore"** sepse në këtë mënyrë i armatosim jugosllavt që të na akuzojn për nacionalizëm dhe irridentizëm. Me këso sjelljesh po i sjellim dam politik LRSHJ dhe PPSH! Këto gjëra duhet shpjeguar shokve, se nuk esht në interes tonin që ta forcojmi armikun e të komprimitohemi! Patriotizmi dhe drejtsia parimore mbetet të përodret atëher kur ti rrokim armet dhe kur ta braktisim luftën politike. Në luftë të armatosur do të hyjmi vetëm atëher kur e dimi se do ta fitojmi luftën. Deri ather duhet diciplin! Ata të cilët nuk e respektojnë këtë vi ose jan të papjekur ose provokator!

3. Procesverbali i rrethit të Shtutgartit, 26 shtator 1982

Pas korrikut 1982 Osman Osmani dhe Nuhi Sylejmani i kanë shkëputë të gjitha marrëdhëniet me rrethin të cilit i kam takuar në Shtutgart.
Më 26 shtator 1982, është mbajt një mbledhje e rrethit të Shtutgartit (pra jo e KVG=Komitetit Vëllezërit Gërvalla). Pasi mbledhja është thirrur me iniciativën e shokëve të Nuhi Sylejmanit edhe vendi i mbledhjes është caktuar në qytezën ku ka banuar Nuhi Sylejmani. Rendi i ditës së kësaj mbledhje ka qenë:

-Çështja e Nuhi Sylejmanit dhe pasojat e fjalëve të tij,
-Situata momentale

Procesverbalin e kësaj mbledhje e ka mbajtur Remzi Ademi, dhe është botuar në tërësi në librin tim (Xh.D.-Skenderi) *Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës*. Në këtë takim të rrethit të Shtutgartit kanë marrë pjesë:

Hasan Veselaj, Qemal Haxhillari, Abdurrahman Sadiku, Faridin Tafallari, Hafiz Gagica, Haxhi Berisha, Ismet Klaiqi, Mejdi Rexhaj, Murat Kryeziu, Naim Haradinaj, Nami Ramadani, Remzi Ademaj dhe Xhafer Durmishi-Skenderi.

Hasan Veselaj ka ardhur në mbledhje prej banesës së Nuhi Sylejmanit.

Hasan Veselaj pas mbledhjes ka shkuar në banesë të Nuhi Sylejmanit.

Pas 9 muajsh (nga 26 shtatori 1982 deri më 21 qershor 1983), si përgjigje, Abdullah Prapashtica ia dikton Nuhi Sylejmanit tekstin e letrës së mëposhtme.

4. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani), për Xhafer Durmishin-Skenderin, 21 qershor 1983

Skender
Përshkak të mos ardhjes në takimin i cili u organizua me iniciativën e puntorve - antarve të LRSSHJ për tu sqaruar gjërat në KVG rreth shpërthimit të përqarjeve iniciator i të cilave ishe ti me dy-tre veta për shkak të cilave unë u largova nga ju që të evitoj qerimin e hesapeve sipas planit armikut i cili nai vrau edhe shokët. Tani po t'i shkëruj disa rreshta. Mosardhja ejote në takim asht ikje nga përgjegjësia për gabimet e shumta të patolerueshme që i ke bër. Unë erdha pikrisht në odë për të nxjerrur në shesh të vërtetën para klasës puntore e cila ju fshehët dhe që para syve tu ti them veprimet tuaja me prapavij të keqe sepse pas shëpines nuk ia bëj askujt ate që ma bët ju mue.
Akuzat e rrejshme, shpifjet, intrigat, sharjet janë jetëshkurta kurdoher kurse të vertetës kurr nuk i behet vonë.
Kësaj radhe nuk erdhe në ballafaqim por përgjegjësijes nuk mund ti ikësh. Rasti yt dotë ndriqohet para KD të LRSSHJ dhe para klasës pununtore sepse LRSSHJ-ja nuk mund të toleron gjëra të tilla.
21 Qershor 1983 - "Luani" (Nuhi Sylejmani)

(Shënim i Xh.D. – Skenderit: Nuk kam kujtesë për këtë letër. Ka mundësi që Nuhiu e ka lënë për mua në Odën e Shtutgartit, që ka qenë rrethi dhe mbështetja ime në Shtutgart, pos tjerash edhe kundër Partisë Komuniste të Abdullah Prapashticës, në një kohë apo ditë kur nuk kam qenë aty. Këtë daktilografim e bëra në bazë të letrës që më ra në dorë më 24 shkurt 2023)

5. Demaskimi i veprimeve të Partisë Komuniste (PKMLSHJ) dhe formimi i Bashkësisë së Klubeve shqiptare në Evropë, më 9 e 10 korrik 1983 në një shtëpi malore në Zvicër

Xhafer Durmishi: ”*Të kthehemi tek fletushka "Punëtorët", tek ky far organi i sindikatave të Abdullah Prapashticës. Xhafer Shatri dhe unë, në bazë të sugjerimeve të mia, merremi vesh ta organizojmë një tubim dyditor të aktivistëve më të dalluar të të gjitha klubeve dhe rretheve të Evropës, në Zvicër, afër Bielit. Qëllimi i këtij tubimi ishte formimi i një bashkësie të klubeve, që do t'i organizonte punëtorët në klube kombëtare, pasi ekzistonte mundësia e çoroditjes së këtij organizimi në sindikata nga A. Prapashtica dhe ndihma që kishte nga ambasada shqiptare e Vjenës në këtë punë. Xh. Shatri, i cili tërë kohën kishte taktizua e këmbye letra me Partinë "Komuniste", si anëtarë i Organizatës Marksiste Leniniste të Kosovës, më thotë ta përgatisë referatin kryesor për këtë tubim dhe tehu i tij duhet të jetë kundër veprimtarisë përçarëse të A. Prapashticës me kompani. Unë e mora seriozisht këtë detyrë dhe e shkova një material prej afër 14 faqe A4, por në përdorim në tubimin e organizuar i përdora si koncept vetëm 11 faqe.*

Më 9 e 10 korrik 1983 u mbajt takimi i shumicës së rretheve e klubeve, në Zvicër, ku u vendos themelimi i Bashkësisë së Klubeve, si dhe u demaskua fuqishëm veprimtaria përçarëse e Abdullah Prapashticës me kompani. Në atë tubim fjalën kryesore më ra ta mbaj mua. Aktivistëve që kishin udhëtuar nga qytete të largëta u fola gati dy orë. Referat tjetër me shkrim nuk u lexua, përkundër asaj që ishte përgatitur ndonjë. Pasi dolëm, (pas mbarimit të fjalimit tim) Faridin Tafallari më thotë: Të lumtë se na e zbardhe fytyrën.” (Lëvizja e Jusuf Gërvallës, 2011; pashtriku.org)

6. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani), **për Sabri Novosellën, 11 korrik 1983**

11 korrik 1983, Götringen, W. Germany

Shok i nderuar Mërgim
Letrën tande të datës 17.6.1983 e morra. Po të përgjigjem me vones pasi që mu desht ta analizoj në tersij ate dhe ta pregadis nji përgjegjëje e cila nuk do të njeh interes tjeter pos interesin e atëdheut e të L.
Përgjegjja e ime në shiqim të parë ndoshta do të duket e ashpër por nëse e kupton drejt do të shohish se nga e vërteta nuk mund të ikët dhe se vetem e vërteta ësht ma e mira sado që dikujt në një moment nuk i pëlqen. Po të shkruj në cilsij të antarit KD të LRSSHJ, por në këso rastesh do të shkruante edhe vllau yt S.N.

Po filloj të përgjigjem me këtë renditje dhe do të mumndohem që të mos ija jap tepër hapt:

-Së pari asnj lëter e imja nuk ka pasur përmbajtje kërrcnimi e as që i kërrcnohem donji shoku. Mardhanjet tona janë zyrtare e jo personale e private dhe privatisht mundemi vetem që të nderojm njëri tjetrin;

-Unë jamë njeri i pjekur dhe i moshuar (i kam kaluar të dyzatat) andaj nuk i nështrohem e as që lejoj që kushdoqoft të manipuloj me mue. E njof vetëm të vërtetën dhe vetëm asaj i bindem. Shokët e luftës i nderoj njisoj nëse ata meritojn dhe nëse ata më nderojn mua.

-Letra yte e 17.6.83 kishte pasur nji përmbajtje shum të rand dhe plot dekonspirime që kusesi nuk guxohet të shkruhet ashtu në nji letër e cila ushton nga nji kontinenti në nji kontinet dhe që kontrollohet. Në këtë leter ipen shpjegimet mbi mardhanjet në LRSSHJ,

dekonspirohen emnat e shokve të LRSSHJ në botën e jashtme, dekonspirohen aksionet dhe me të gjitha ngatrrohet dhe përmendet emri i plakut dhe vendi i tij. Si njeri me përvoj këte nuk ke guxua ta bajsh, por për kete përgjegjsijen e mban ti. Unë vetem mund të kërkoj nga ti që tjetër her asgje që s'me hyn në punë t'mos me dekonspirojsh. Thjesh nuk dua të dij ma tepër se sa më takon.

-Arsyet që ti në këtë letër nxjerr nervozitet dhe shokët e Kosovës me emna e mbiemera, sulmet ndaj shokve të KD të LRSSHJ dhe të partijes në të cilët jemi bashkuar, janë plots isht te pa baza. Habitem se si shoku Bashkim i cili thot se i ka lexuar shkrimet tua dhe i ka par të gjitha ato gabime e bile edhe sot pajtohet me to. Shokun Bashkim të cilin unë nuk e njof e icili nuk asht as antar i KD të LRSSHJ nuk ke guxuar ta njoftojsh me mardhanjet në KD. Shifet se Bashkimi asht nji njeri i pa prevoj me qense i miraton gabimet e huja dhe perzihet në gjërat që nuk i njef.

-Letra yte pesdhjetperqind (50%), përmban fyrje dhe sharje si percjellje të sulmit e të cilat nuk mund të jenë mënyr e komunikimit në mes shokve të KD të LRSSHJ. Pjesa tjetër e letres përmban dekonspirimin dhe maspaku në këtë letër behet fjal për luftën kunder armikut. Po përmendi këto se nga letra e parë qe mak e dërguar kan fillua këto dekonspirime dhe këto sharje kundër shokve të KD të LRSSHJ. Në brendsij të letrës nuk thuhet asgja për të ardhmen e LRSSHJ por vetëm për të kalueren e LNÇKVSHJ dhe për KQ të LNÇKVSHJ të cilat ma nuk ekzistojn. Gabimet e shumta ndaj LRSSHJ mundohet të arsyetohen me emrin e Adem Demaçit dhe të Heroit Jusuf të cilët kanë meritat të shkëlqyera në luftën e popullit tonë për lirij, por të cilët për shkak të rrethanave të njohura nuk arrijtën të bahen pjestar të LRSSHJ. Adem Demaçi, Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Afrim Abazi dhe shum shokë tjer si dhe veprat e tyre duhet te nderohen me nderimet mat ë mëdha, por jo të keqpërdoren emrat e tyre për ti shkelur shoket e sodshem të Luftës.

-LRSSHJ-a nuk lufton për Republik në të cilen do tju bahen leshime Fadilve, Sinanve dhe Velive por lufton për demokracij mat ë madhe për popullin e që ësht nji shkall ma la lart drejt pamvarsijës të plotë.

Dihet se kërkesa për Republikë ka rranjët që nga viti 1945. Në vitin 1968 u organizuan demostratat për Republikë dhe në mes të organizatorve ish edhe vëllau yt S.N. E për këtë me ka folur edhe Halimi. Kjo i takon asaj gjenerate dhe askus nuk ua mohon meritat aa nji shoku. Tani në drejtim të Republikës veproi gjenerata e re dhe të nenvlefsohet puna e tyre asht shum gabim a edhe në të ardhmen do të veprojn gjeneratat e reja tjera dhe gjeneratat e vjetra atyre dotju ndihmojn me përvojën e tyre e jo tju bahen penges në emër të asaj prevoje e të atyre meritave si që uban penges para intelegjences kosovare Fadilët e Nimanët me analfabetizmin e tyre.

-Në lidhje me bashkimin e LNÇKVSHJ, PKMLSHJ dhe OMLK në LRSSHJ unë nuk kam çka të tham ma tepër se sa thot dokumenti i bashkimit 17.2.82 dhe qendrimi im ësht plotsisht i kjart dhe në pajtim me këtë dokument. Vendimet e Bashkimit nga të cilat del vija e qart dhe e drejt LRSSHJ, programi i organizimit dhe programi i luftës së LRSSHJ nga ana ime janë kuptue mirë dhe unë do të jap çdo gjë mbrenda mundsive të mija që ato të realizohen. Kush nuk pajton me këto vendime, kush e saboton zbatimin dhe kush ka pretendime tjera, ai lufton kundër bashkimit në LRSSHJ. Në këtë drejtim e theksoji haptazi se kush nuk pajtohet me karakterin socialist të LRSSHJ dhe me ideologjijen e klasës puntore nuk ka vend në LRSSHJ.

-Shifën qart tendencat negative e antilevizje për mosrealizimin dhe për pengimin e sabotimin e organizimit të LRSSHJ simbas vendimit të 17.2.82 nga disa persona. Ata mundohen që të heqin karakterin socialist të LRSSHJ, mundohen që ideologjija e klasës puntore të Kosovës të mos këtë rrolin e pararojës ideore dhe mundohen të mohojn Komitetit Drejtus rrolin e Organit ma të lart të LRSSHJ, rrolin udheheqës si organ i përbashkët, i vetëm i palve të bashkuara në LRSSHJ, deri me tani.

-Tri vendimet kryesore të bashkimit që po sulmohen: 1.Vendimi mbi bashkimin e plotë në LRSSHJ, organi mai lart i përbashkët i saj, Komiteti Drejtus dhe palët e bashkuara; 2.-Vendimi mbi Organizimin e LRSSHJ në organizata të mbrenshme ku duhët të themelohen ma forcat e përbashkta: PKK si prisëse ideore, FDK, BPK, ORK, BGK, OPK dhe tre organizn përcjells: UPK, SHZK dhe SHEK (nga këto deri më tani me shum veshtirsi iu vunë bazat BPK); 3.-Si dhe ajo që KD, LRSSHJ të përfshijn edhe aktivistët e organeve drejtuese të palve të maparshme në Kosovë, që KD i LRSSHJ të funkcionon si udhëheqësij e përgjithshme.

Si thash mal art edhe vendimet tjera të bashkimit u goditën nga i njejti grup. Posaqerisht u godit organi i përbashkët i LRSSHJ i cili për ndër të shokve të vrar u emrua ”Zëri i Kosovës”. Ky Grup përbëhet nga disa veta të LNÇKVSHJ të ma parshme. Qellimet e tyre me sa duket kufizohen në bajraktarizëm egoist, por ka edhe indikasione të bazuara se në këto sabotime po i shtyn edhe rakcioni ballist, me të cilët mbajn lidhje këta Persona, e ka dhe dyshime të bazuara se në këtë rreth mund të këtë edhe ndonji provokator të UDB-ës.

-Ky grup deri më tani në vend që të mirrët me agjitacion kundër armikut aj ban agjitacion kundër shokve të LRSSHJ, shpall tradhtar e udbash qdo njeri që kërkon: zbatimin e vendimeve të bashkimit ruajtjen e bashkimit në LRSSHJ, qdo njeri që kërkon rregull, diciplin, konspiracion dhe llogari për gabimet e tyre. Ky grup duke folur mas tepermi për ”tradhtij” dhe me ket akuz e sulmojn çdo të dytin shqiptar, a fut nji përqarje, nji mosbesim dhe frig si në mesin e shokve të LRSSHJ si në masa në përgjithsij, çka ndikon në largimin e masave nga LRSSHJ për shkak të frigës së zbulimit. Po ky grup duke sulmuar çdo material që e botojnë forcat e LRSSHJ kundër armikut mundohet ta kufizon aktivitetin. Me akuzën ”tradhtij” sulmohen zakonisht aktivistët ma të dalluar të organizatave të ma parshme dhe antaret e KD të LRSSHJ. Sipas tyre vetëm ata na qenkan patriot dhe vetëm ata paskan të drejt në luft për atëdhe!

Mundohen që LRSSHJ tia mveshin karakterin borgjez duke ija hjek karakterin socialist. Bejn dezinformime, prezentohen rrejshem, mundohen që të fusin grindje e mosbesim në mes puntorve – antarve të LRSSHJ gjë që e banë të bazuar dyshimin se në këtë grup, pran të cilit na u vran shokët dhe i cili tani po vepron kundër bashkimit, mund të ket edhe provokator të armikut.

-Ky grup, (në të cilën, shihet nga letra jote, përfshihesh edhe ti) asht burim i sulmeve ndaj të gjith aktivistve të maparshem edhe të tashëm të LRSSHJ. Nga këto sulme u goditën shokët FKP, të GKZK, të OMLK, të PKMLSHJ dhe në mesin e tyre edhe shokët autoritativ të LNÇKVSHJ. Pra nuk është fjala për nji shokë të këtij apo atij krahu. Thjesht nuk me bind njeri për ate se ashtu patriot, revolucionar e luftetar i lirijës kur në anën tjetër shkel mbi shqiptar që jetën e tyre jakan kushtue atëdheut. Ata që me fjalor rrugaqësh i sulmojnë shokët e vetë të luftës, nuk u qëndrojnë besnik fjalve të veta, dhe kudo që shkojn vetëm kundër shokve flasin, për mua nuk janë patriot por lumpenproletariat, provokator dhe mikroborgjez. Nuk po përmendi shembull tjetër pos ate mas flagrantin kur Heroit Kadri Zekës del nji ”Skender” dhe ija hjek fotografijën e ija shan nanen për së vdekuri e bile dhe ja përgojon gruan e tij duke ia cenuar nderin e saj. Po ky person regjistrin e veprimeve antilëvizje e ka shumë të madh dhe këto këlasa puntore këtu i din. Kjo më habit kur thue se pas veprimeve të Skënderit qëndron ti e KQ i LNÇKVSHJ, gjë që kurr nuk besoj së mund të pajtohuni me gjera të tilla!

-KD i LRSSHJ si organ ma i lart i përbashkët, deri më tani ishte dhe duhet të jetë Qendra e kordinimit të aktivitetit të LRSSHJ në tërsij. Ky rregull nuk u respektua nga ti dhe Skënderi e jo nga shokët e tjer të KD të LRSSHJ. Shkas që mardhanjet në KD (organin m mat ë lart të perbashkët) të LRSSHJ të destabilizohen dhe që të futët përqarja, ishte falsifikimi i Komunikatës të nënshkruar nga ti me ”KQ” të rrejshëm (ti pjesrisht e zbulon këte kur dekonspiron se kush dhe si e ka nënshkruar Komunikatën).

Ti vet thua se Komunikata asht dashur të nënshkruhet me LRSSHJ e në anën tjetër thua se gjoja në atë kohë u formua ”KQ” dhe se aty nuk u përfshin shokët e KD të LRSSHJ të cilin ishin iniciator të bashkimit. Për këtë ”KQ” nuk kan ditur jo vetëm shokët e Partijes por as shokët tjer të KD në mesin e të cilve as unë. Pra këtë ”KQ” e ke ”bër” kok me vete pas shpinës, e papajtimin e palve të bashkuara në LRSSHJ. ”KQ” që përmend ti nuk ka asnji vleft dhe ”Kryetar” që përmend ti nuk ka në LRSSHJ. Sikur që nuk mund të behet nji organizim në krahun tonë – të LNÇKVSHJ të maparshme e ajo të vlej përmbi LRSSHJ në cilën përfshihen tri organizatat. Për KD është vendosur bashkarisht dhe për çdo ndryshim tjetër prap duhët të vendoset bashkarisht.

Shoku Mërgim, këto gabime nuk mund të mbulohen as me shokët ”mbrenda”, as me autoritetin e Adem Demaçit, e të Jusuf Gërvallës dhe as me të kaluarën tënde dhe të vllaut tand, aq ma pak lejohet të thirret në gjera që nuk ekzistojn, si në ”KQ”… Njeriu e ndriton autoritetin e vet me vepra të mira dhe ato duhet të vertetohen gjithnji duke hecur në rrug të drejt, por posa të lëshohet rruga dhe e shtrembron të vertetën, meritat e së kaluarës humbin krejt dhe nuk e shpetojn dot askend.

-Ti sulmon rand shokët e krahut te PKMLSHJ dhe njikosisht të intereson për mardhanjet e mija me keta shokë dhe mendimi im për ta. Dhe, ja, unë po ta shtroj haptazi këtë çështje, sepse nuk ka arsye të fshihet asgja. Duke u nisur nga ajo që unë e kam kuptuar bashkimin në LRSSHJ shëndosh dhe pa pretendime personale (sepse privatisht këtu nuk kemi asgja të përbashkët), duke lan anash ndahësijt e ma parshme të cilat nuk i pranoi as sod, dhe unë jam orvatur dhe do të orvatem që me të gjithë antarët e KD të LRSSHJ të mbaj mardhanje të rregullta e të afërta. Këtë qëndrim e kam edhe ndaj shokve të PKMLSHJ të maparshme edhe ndaj shokve të OMLK e LNÇKVSHJ. Pra, nuk pranoj të lëndohet bashkimi nga kushdo qoft dhe të drejtës e të vërtetës ja jap krahun gjithmon.

- Sulmi i yt dhe i Skenderit ndaj shokve të Partijes në KD të LRSSHJ është jo real dhe ipa arsyshem, sepse këta shokë në asnji rast nuk dolën jasht vendimeve të bashkimit. Ky sulm tani asht intenzivuar edhe ma shumë dhe si pretekst asht marr MBP dhe organi i saj ”PUNTORET”. Unë ju them me BPK dhe me ”PUNETORET” vetëm u realizua nji nga detyrat që dalin nga vendimet e LRSSHJ. BPK dhe ”PUNETORET” janë vepër e puntorve dhe kontrollohen e finansohen nga këlasa punëtore. Pra kush pështyn në këto materiale pështyn në bukën e vetë që ja siguron këlasa puntore dhe kush sulmon këto materiale e ka sulmue drejt përsedrejti LRSSHJ. Me materialet e BPK sulmohet dhe goditet armiku, kush esht kundër këtyre materijaleve esht në mbrojtje të armikut. Sa u përket shokve të Partijes ata nuk dolën nga kompetencat e KD të LRSSHJ dhe se puna e tyre esht vetëm nji pjes e kontributit që ata kan obligim tja japin BPK.

- Tani po dalim konkretisht të shokët e PKMLSHJ të maparshme. Me Halimin njihem që nga ardhja e tij në Gj… në vitin 1982 e deri në shtator me të nuk kam pasur mardhanje të afrta. Mardhanjet në mes nesh janë zyrtare dhe zhvillohen në suaza të antarve të KD të LRSSHJ pa iu imponuar njeri tjetrit gje që vlen edhe për mardhanjet me të gjith shokët tjer.

Halimin e njof si shokë të qetë, të sjellshëm, të diciplinuar. Edhe puntorët tjer nuk patën ndonji vrejtje ne sjelljën e tij. U tregua i zellshëm dhe i durueshëm këtu. Shokun Qemail nuk e njof për së afrmi, por nga ajo se çfar flet populli dhe në baz të shkrimeve të shtypit J. Qemajli dha nji kontribut të mirë. Shokun Kushtrim nuk e njof personalisht, por nga disa letra të përgjithsheme që nai dërgoj vjet nga Turqija kam pershtypje të mirë, sepse n’ato flitej për rujtjen e bashkimit, për organizimin sipas vendimeve të perbashkta dhe për luften kunder armikut. Për Kushtrimin pata rast që të ndigjoj fjal të mira edhe nga Kosova, kurse për aktivitetin e tij foli edhe shtypi J. (Shif ”NIN” 27.6.82, fejtonin e ”Rilindjes” të Rr. Rugova ku sulmuan ky dhe shokët e tij edhe nga Sinan Hasani dhe nga shtypi jugosllav me rastin e gjykimeve të shkurtit 1983 kur atij edhe ju denua me 11 vjet

i vellau dhe disa nga farefisi, miqët dhe shokët). Për Kushtrimin, Halimi më ka shkruar se gjendet diku në sherim dhe se nuk do të këthehet në T. apo Evrop para se ti lind femija e par e shoqeja e tij. E dij se familjet e tyre po torturohen mizorisht nga UDB-ja dhe se edhe keta asht duke i ndjek. E dij se keta shokë po e vazhdojn aktivitetin në kushte shumë të veshtira pa mjete për jetes. E dij se nga ndihmat e Kontonumrit të ZK për aktivitet nuk ju dhan kurr, pjesa e njitretat që duhej të ndahej për këtë krah. Në vend se të ndihmohen ata po sulmohen çnjerëzisht nga grupi rreth "ZK"! Gjithnji rujtën bashkimin dhe vepruan në zbatimin e vendimeve dhe për nji luftë mat ë denjur e mat ë organizuar ndaj armikut. Për këtë qëndrim të drejt e kambnguls u ban edhe objekt të sulmeve dhe pergojime.

-Deri në kohët e fundit Halimi ishte ma i sulmuari nga këta shokë, por tani papritur u përdor "arma e fundit" kundër këtyre shokëve dhe kundër Partijës. Tani i tër sulmi u drejtua në shokun Kushtrim, pasi që pas sa kohe dikujt ju kujtua se Kushtrimi ka punuar në PB me detyr nga PKMLSHJ edhe pse situata rreth tij asht shum e qart. Simbas teje tani nuk asht qudij që t'na del dikush e edhe për Skënder Beun të thotë "tradhtar" pasi që edhe ai ishte oficer i Turqijës, si dhe për shum tjer që i njef historija e popullit tonë. Kjo asht aq absurde sikur njerzit e verbër nga bajraktarizmi egoist tu thot "tradhtar" edhe Ukshin Hotit, Rexhep Maqedoncit, Bajram Gashit, Mustaf Ademit e shum të tjerve që e verifikuan veten si besnik të popullit edhe pse punuan në PB e Qeverij. Por, nuk ësht ketu qeshtja e Kushtrimit nga se tani sulmet që po i bëhen Kushtrimit po i behën tër Partijës e tani edhe LRSSHJ-ës në tërsij.

Jo shoku Mërgim, shpifjeve që ju ke bindur ti Unë nuk u bindem. Unë u besoj vetëm fakteve që dëshmojn të vertetën. Të them ma qart, unë u bindem (besoj) shkrimeve të "Zërit të popullit" dhe "Shqiperijes se re" me rastin e gjykimeve të shkurtit 1983 ku ju dha përkrahje shokve të PKMLSHJ, mas hum se fjalve tua. Bile habitem shum, se si ësht e mundur që ti te rrëshqitesh në këto ujra të trubullëta.

Nëpër të njejtat vuejtje që kalove ti dhe familja jote, sod po kalojn këta shokë dhe familjet e tyre, andaj dhe habitem se si ësht e mundur që të behesh viktim e intrigave të armikut dhe rob i mendimeve të zeza, me këto të hapish dezinformata në Kosovë në ventin e Plakut dhe të mundohesh të "bindesh" edhe neve shokve të KD të LRSSHJ.

Dhe në fund me mbetet të thëm propozimet dhe porosijët e mija zyrtare:

1.Që menjiher të nderpritën të gjitha sulmët ndaj shokve të LRSSHJ pa marr parasysh se cilit krah i kan takuar ma parë,

2.Që menjiher të bani autokritik me shkrim për: falsifikimin, për sulmin ndaj shokve të KD të LRSSHJ, për përqarjet, për moszbatimin e vendimeve të bashkimit, të 17.2.82 dhe për gabime dhe dekonspirime tjera;

3.Që autokritika të behët para KD të LRSSHJ i cili do të përcakton përgjegjsijën;

4.Që të ndërprehen kontaktet me reakcionin

5.Që menjiher edhe ju ti hyni gjegjësisht të merrni pjes në zbatimin e vendimeve të bashkimit dhe që bashkimi në LRSSHJ të ruhet si syt e ballit.

Përshëndetje revolucionare "Luani"

7. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani), për Xhafer Shatrin, 10 gusht 1983

N.S. 7031 Görtringen, Gartenstr. 2, W. Germany

Tungjatjeta shoku Ukë

Përgjegjejen tuaj në letrën time të tret e morra.

Sa i përket pytjeve dhe qëndrimeve që i shtroni ju, unë kam dhan përgjegjeje të qart edhe në letrat e kaluara, por prap po ju përgjigjem si ma par se për të marr kontakt isha i penguar dhe i bllokuar dhe nuk e dij pse ju ndaleni në këtë qështje.

Ësht normale që fati i Lëvizjes të më intereson sepse të gjith ne në KD të LRSSHJ mbajm përgjegjsij të madhe në këtë drejtim. Në lidhje me letrën e Mërgimit që ua dërgova ju dhash arsyetimin në letrën e kaluar. Privatisht nuk e njof Mërgimin e askend tjetër nga shokët e KD të LRSSHJ, kështu që për qështje të LRSSHJ nuk i shkruaj privatisht askuj.

Në lidhje me ate se nuk ju interesojnë mardhanjet në krahun tonë unë as që kam kërkuar të interesoheni për ato mardhanje, gjë që ësht theksuar edhe në letrën e kaluar.

Sa i përket mardhanjeve në KD të LRSSHJ, ndaj këtyre mardhanjeve nuk mund të këtë indifrentizëm dhe mosinteresim. KD i LRSSHJ nuk ndahet "në krahun tuaj e në krahun tonë" andaj mbi këto qështje duhet të jem të informuar të gjith antarët e KD të LRSSHJ, andaj edhe letrat në mes nesh janë të hapura për të gjithë antarët e KD të LRSHJ. Tani kur LRSSHJ-a dalngadal po i merr format e veta reale të një lëvizjeje të përgjithshme popullore të organizuar në nivel të lartë dhe kur aktiviteti i LRSSHJ-ës po merr dimanzione ma të gjera në pajtim me dokumentin e bashkimit të cilin e posedon Mërgimi e të cilët duhet ta kërkoni nga ai dhe ta shiqoni në tërsij, erdhi deri te një fushat të themi fashiste të sulmeve ndaj LRSSHJ e bashkimit, burimet e së cilës janë të njohura. Në mas të caktuar kjo fushat udhëhiqet edhe nga njerz me ambicje bajraktarllaku e me karakter borgjez. S'don mend se armikun vet bashkimi në LRSSHJ e goditi rand andaj që nga qershori i vitit të kaluar kemi shenja të sigurta se në tentimet për të fut përqarje ka dorë edhe vet UDB-ja, prandaj kemi nji ftofje në shkall të caktuar edhe të mardhanjeve në KD të LRSSHJ.

Për këte arsyja për tu shqetsuar për fatin e Levizjës ësht shum shum e madhe dhe ndrrimi i mendimeve në baza parimore e afersij dhe takimet në mes nesh shokve të KD të LRSSHJ janë të domosdoshm sepse përmirsimi i kësaj gjendje, të cilën e krijoj armiku nuk mund të bëhet me injorime e sarkazëm.

Veprimet e armikut për të futë përqarje në LRSSHJ në Kosovë dështuan, mirpo ai të njejtën gjë po e provon në pjesën e LRSSHJ-ës në botën e jashtme dhe nga ne mvaret se a dotë mbesim revolucionar konsekuent apo do të shendrrohemi në mërgatë të qyqeve. Nga ne mvaret edhe fati ynë dhe i kësaj pjese të Lëvizjes e pjesërisht edhe i Levizjes në tërsij, prandaj jo vetëm që pajtohem me gadishëmrijën e juj për nji takim apo këmbim mendimësh por e shoh këte të domosdoshme dhe urgjente. Letrat që i këmbyem deri më tani në mes veti ishin të shkurta dhe në një masë edhe marshim në vend meqë për vet aktivitetin e LRSSHJ dhe për luftën kundër armikut tham fare pakë. Mendoj se tani e tutje duhet ti menjanohemi çdo lloj polemike vetijake që ska të bëjn me qështjen dhe shpresoj se edhe ju dani këtë mendim.

Në lidhje me vijën politike të LRSSHJ u theksue edhe në Komunikat. Në lidhje me programin e organizimit të mbrendshëm të LRSSHJ dhe në lidhje me programin e aktivitetit informativ botues të LRSSHJ e të levave të saj që dalin nga vendimet në dokumentin e bashkimit të 17 shkurt 1982, jeni të informuar pjesrisht se deri me tani me forcat të përbashkëta të LNÇKVSHJ dhe OKMLSHJ janë në ndërtim e sipër dhe funkcionojn PKK, BPK, ORK dhe bërthamat tjera organizative andaj në këto qështje presim përgjegjëje adekuate edhe nga krahu i OMLK-ës. Ky aktivitet në drejtim të organizimit ësht kah zhvillohet nën kontrollin dhe nën drejtimin e anëtarve të KD të LRSSHJ.

Gjithashtu edhe vendimet e programit të aktivitetit informativo-botues janë kah zhvillohen me forca të perbashkëta të LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ.

Kështu në bazë të vijës politike LRSSHJ dhe levat e mbrendshme po zhvillojn nji aktivitet të denj i cili po përcjillet me botimin e materjaleve përkatse dhe organeve gjegjëse të levave.

Kështu BPK në pajtim me dokumentin e bashkimit dhe me pëlqimin e antarve të KD të LRSSHJ me sukses po e nxjerr organin PUNETORET, redaksija e të cilit përbëhet nga

puntorë të krahut të LNÇKVSHJ ma parshme ndërsa shoket e krahut të PKMLSHJ-ës së maparshme vetëm e ndihmojn Organin. Organi PUNETORET u prit me gëzim nga klasa puntore dhe u godit rand armiku, i cili i tmerruar kaloi në kundëraksion, të cilit iu bashkangjitën edhe element nga armiku klasor, për shkak të permbajtëjs se tij dhe ideologjijës së përcaktuar.

Kjo shihet më së miri nga qëndrimi i tyre fashist ndaj ndërtimit të partijës me forcat të perbashkta ndaj BPK, dhe ndaj Organit PUNETORËT.

Esht për keqardhje që në kët kurth të armikut rreshqiten edhe disa njerz naiv e mendjeleht, mandej edhe disa pjestar të LRSSHJ, të cilët u ban përçues të këtyre manipulimeve, por asht me randsij që masa e kuptoj realitetin. Në shpifje kundër organit PUNETORET, nga personat e dyshimt pati thirrje edhe në ju.

Aksionet e LRSSHJ mbrenda kësaj kohe e goditën armikun por sikur të ishin mardhanjet ma te mira intenziteti do të ishte i dyfishuar. Andaj në përfundim kërkohet edhe nga OMLK që ti bashkangjitet realizimit të vendimeve nga dokumenti i bashkimit.

Për këtë prës përgjegjëje në letrën e ardhsheme, madje po patët mundsij edhe takohemi.

Përshëndetje revolucionare shokve të krahut të OMLK

10 Gusht 1983

8. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani), **për Sabri Novosellën, Dhjetor 1983**

Dhjetor 1983

Shoku Mërgim

Dje në adresën time erdhi nji letër të cilën pasi qe e hapa e vrejta se ishte ne emër të tjetërkujt. Pasi kete e ke be me qellim që unë ta lexoj unë edhe ja lëshova nji sy e mbasi aty përmendej emri im e lexova në tërsij. Kur të shkrujsh dikujt letër në adresën time nga jasht duhesh të shenjosh për kend e ke që unë mos ta hapi sepse letrat e hapura nga unë nuk ia dorzoj askujt. Andaj edhe po ta kthej mbrapa ket letër e ti dërgojav atyre shokve në adresën e tyre sepse me qe i kem a afër, të kushton ma lire edhe ma shpejt mirresh vesh me ta. Megjithate, pasi në këtë leter permendet edhe emri im unë do të përgjigjem në qështjet që i shtron!

Sod me erdhi edhe nji letër ngati si përgjegjëje në letrën time të nëntorit kështu që po të përgjigjem në të dyja këto letra njiherit. Letrën që e morra sod nuk mund të konsiderohet përgjigjëje dhe pasi që të till nuk e pranoj dhe po ua dërgoj mbrapa. Tani po i shtroj përgjegjejet në të dyja letrat tuja, me radhitje të tezave që i shtron në to.

-Përgjegjeje në letrën e parë!

Populli thot: Bën mirë gjen mirë – bën keç gjen keç.

Andaj edhe ti mos prit nga të tjeret që të heshtin derisa ti i shan e i përgojon. Populli thot: Ai që ija hap gropën tjetrit vet bjen në te. Ti rae në te e shoket prap e zgjaten doren për të nxjerr, e ti për faleminderim po orvatesh për ta këputur krejt. Të kam than që në letrat që me i shkrun të mos bojsh shpifje e intriga ndaj të tjerve por ti si duket këte e ke në gjakë. Dikur ballistët e reakcioni në Shqipërij u patën bër autoparland të fashizmit të musolinit kunder PKSH dhe LNÇ.

Tani dikush po bahet autoparland i socialfashistve të Beogradit kunder PKMLSHJ dhe kunder LRSSHJ në tërsij.

Kështu tani ti përhap thashëthana të Beogradit e Populli për kete thot: Ndash me than rrene fol shka ke ndij, e me këso gjerash ti na ke lodh bre vëlla.

-Çështjen e F.O. unë nuk e dij thellsisht por sati e dij me sigurij.

Logjika e shëndosh këthough qështje dhe të verteten mbi te e zberthen leht:

Pra, F.O. nëse kaqen e angazhuar nga Partija që të punojn me gratë (e jo kryetare e tyre), ajo ka patur punë me gra dhe ka mundur që t'i zbulojn shoqët e veta, por në gjykimin që përmend ti nuk u dënue as nji shoqe, dhe kj ona deshmon se nuk kemi as nji "tradhtij" nga ajo në këtë drejtim. UDB-ja ka mundur me pyjt F.O. se me kënd është shoqruar (privatisht) vëllau i saj dhe me që ajo nuk e ka dijt randsijen e kesaj pytje, për veprimtarijen ilegale të tyre, edhe asht përgjegjur. E me qe edhe ata shokë që u dënuan nuk kan qenë gra por burra, as ata nuk kan ditur gja për veprimtarijen e saj me shoqet, andaj nuk kan pas çka me thanë në gjygjë. Megjithate, nëse ajo ka sharruar në ndonji gabime duhet të jep llogari personalisht vët. Pra, edhe në këtë rast për këte nuk mund të fajsohet PKMLSHJ e as familja e saj. Ty nuk të ka hije të mirresh me thashetëthonme që ti servon UDB-ja për mes kanaleve direkte e indirekte. Në Kosovë këto gjere dihen ma mirë sesa i din ti O Mërgim!

Ti si duket ke çrregullime të mdha mendore kur edhe qeshtjen e Rexhep Maqedoncit e nxjerr në pasqyr të zez, kur e din edhe vet se vet i treti vlla gjindet në burgjet famkeqe jugosllave. Kur e din edhe vet se si ija tundi trollin Jugosllavit me qëndrimin e vet burrnor. Deri më tani psihestonde i penguen ata që ishin jasht burgjeve, e tani po ta nxan "dillin" edhe ata janë nëpër burgje edhe ke filluar të shkelish mbi ta për tu dukur vetja edhe ma i "madh". Tani esht e qart se ty nuk potë pengojn keta të rijt komunist, por po të sjell dhimbje autoriteti i lart i PKMLSHJ-ës që në gjendje normale tye duhet të gëzonte, që rinia Kosovare tër zjarrin e vet e pa kursyer asgja po ban përpjekje mbinjerzore që të nxjerr Kosovën nga errsira. Kësaj verbsije tënde për bajraktarllëk shifet se i ka ra në fija UDB-ja andaj po të servon lloj lloj intriga të freskta e ti po i shperndan si autoparland në vendse të luftojsh kundër tyre. Kështu ti flet për do far "dëshmijash" e "dëshmitarësh". Por, kur e fjalen për deshmitar para gjygjeve jugosllave, mos ke harrue që në Gjyqin e Qarkut të Prishtinës egziston nji procesverbal ku esht shënuar emri ytë me gjith vella, kur ju dëshmuet kundër Adem Demaçit për shka ai u denua 15 vjet burgë. Nga ajo kohë Ademi u grind dhe i shkputi mardhanjet me ty. Andaj kot meshifesh pas emrit të tij sepse këto gjëra dihen dhe me siguri që keto nuk i harron as historija.

-Ti thua se u sjelle me ndergjegje të "pastërt", se ishe i "ndershëm" dhe se je "ballhapur para historijes"! Megjithate ti ke të drejt kur thua se historija do të jap gjykimin e vet jo në bazë të fjalve që thue ti për veti, por në bazë të veprave tua. P.sh. ti thua se shokët e PKMLSHJ-ës i pranove në shtepijen tande si vllezër e si shokë të vërtetë të idealit, kur ata pranuan që të bisedojnë me ty në lidhje me çështjen e bashkimit. Thua se biseduam dhe murrem vendimet historike dhe lidhet besën e bashkimit e cila krijoj LRSSHJ. Kur ti i pranove si shok e vllezër dhe lidhe besën e bashkimit me ta e ua dhe bukën, atëherë pse i preve në bukën e besën tënde menjiher pas bashkimit duke i goditur pas shpine me shpifje e intriga, i sabotove ato vendime historike të bashkimit dhe realizimin e tyre, pse i dekonspirove emnat dhe aktivitetin e tyre (për shka në Kosovë njerzit ranë nëpër burgje), pse dekonspirove bisedat e tyre të sinqerta duke kthyer të gjitha me kokë teposht. Pragun nuk ta kishin shkelur po ta dinin se e kem e pa besë. Ata erdhen me detyr nga Partija për ta realizuar bashkimin dhe ket detyr e kryen me nder. Por, kur u desht që të fillohet realizimit të vendimeve historike, ti u orvate t'i pengojsh dhe t'i bllokojsh në çdo pikpamje me nji mizerje intrigash. Keshtu me ndergjegjeje të "pastërt" me sjellje të "ndershme" dhe "ballhapur para historijes" ti u orvate me çizmet e UDB-ës të shkelësh mbi këta shokë të cilët që jo që nuk kursyen veten por së bashku me tër familjet e veta hyn në luft për lirijën e atëdheut. U orvate të shkelish Partijën me intrigat e liga dhe kështu fute përqarjen e mosbesimin në LRSSHJ. Kështu u bëre litar që i pshtjillesh nëper kamb LRSSHJ. Populli dhe Aëtdheu përbahet nga Shqiptarët dhe për ta luftohet që të ngriten në kamb e jo që të shkilen. Këso sjelljesh tua njifën në Popull edhe me qendrimin tand me baban! Andaj sjelljet ndaj shokve nuk janë edhe fort për çudij. Ngatrime në mes

luftarve të lirijes solle edhe ma parë po me keso lloj intrigash. Kështu që është e njohur si i ngatrrove RS e IK (Riza Salihun e Ibrahim Kelmendin-red.), shokët KZ e J.G. (Kadri Zekën e Jusuf Gërvallën-red.) dhe po vazhdon me i ngatrru edhe shokët e sodshëm në LRSSHJ po kështu me kso lloj intrigash.

-Ti orvatesh që të hapish grindjet ë kota më të gjith por të tjeret nuk jan grindavec. Ti përmend edhe qështjen e bashkimit. Thue se jur u themelua KD i LRSSHJ-ës gjoja se ti vendose se kush do të jetë antarë. Nga kah të erdhën tye këto kompetenta? Vërtet ishte vendosur në KD të LRSSHJ që udhëheqisit e maparshme të bashkoheshin si një trup i vetëm, si udhëheqijme përgjithshme. Mirpo ti këtë e sabotove duke dalur me ”propozim” (imponim) që të veprohet në krah si më parë adaj KD i LRSSHJ mbeti udhëheqisija ma e lart e përbashkët dhe e vetme. UNE BËRA, UNE PROPOZOVA, UNË EMROVA, UNE ÇKARKOVA, UNE ZHGJODHA, e vetëm UNE UNE UNE janë fjalë të tua të përditshme! Kështu me këtë anarshij e emrove njifar ”Kryesije” pa e votue kush në KD. Dy shokë të KD ishin në burg në atë kohë (ku ranë në rrethana të dyshimta), unë nuk dijsha fare gjë për atfar mesele prej ”Kryesije” e për këte nuk dinin gje as shokët e OMLK pas Ukës. Dhe edhe atëherë atfar ”Kryesije” tënde e shkatrrove vet ti duke fut përqarje e mosbesim mes tyre me rastin e falsifikimit të Komunikatës nga Ti dhe aj kodoshi tjetër. Pas këtyre erdhën sabotimet e vendimeve tjera, uzurpimi i Organit (i cili devijoj) e Organit e kontonumrit të LRSSHJ që ma vonë të shperthen nji fushat e pa artikuluar intrigasg e shpifjesh si në tregun e bagtive. Atëherë kush ju ra shkelm vendimeve të dokumentit të bashkimit, dhe kush duel me magarlleqet e veta. Unë këto nuk po i nxjerri nga koka ime por nga letrat e tua, që mi ke dergue deri me tani. Pra nëse ti deshiron të më bindesh me qëndrimet tua dërgoma kopjen e Dokumentit të Bashkimit i cili vërtetohet me nënshkrimet origjinale të pjesëmarrsve që unë ta krahasoj me atë që e kam par, (procesverbali i mbledhjes së bashkimit esht dikund tjetër, por Dokumentin Origjinal të vendimeve të bashkimit e ke ti). Mërgim në të gjitha qeshtjet ti që i shtron në lidhje me shokët me të cilet ti lidhe bashkimin jamë në gjendje që ti demantoj nji për nji, por kësaj radhe nuk po zgjanohem në ata, mirpo nëse ti je i interesuem shtroj pytjet e unë do të përgjigjem me mendimet e mija dhe me ato që i dije, si p.sh. Në diskutimet rreth Kongresit të Bashkimit rreth shpalljes së Republikës, në lidhje me bisedimet rreth Republikës, rreth madhanjeve të jashtme të LRSSHJ e tjera që ti ven me kokteposht. Pozitën time në KD të LRSSHJ-ës dhe në KQ të LNÇKVSHJ të ma parshme e kam të njohur dhe kjo nuk mvaret nga ti se kush të jep ty atë të drejt her të zgjedhish e her të çkarkojsh antarët e KD andaj nëse i han fjalët i hane për veti, kurse KD asht ai që vendos. Çfar fuqije mbinatyrore ke ti që të luajsh me fatin e luftarve të lirijës dhe ti bajsh ata her ”dikusha” e her ”Kerkusha” si të teket ty. Revolucionaret me vet vullnetin e tyre dhe me veprat e tyre mund të bahen dikusha. E kjo nuk mvaret as nga ti e as nga Adem Demaçi (lavdij ati) i cili gjoja të paska mësuar ty ”që nga kerkushat të krijojm dikusha”. Edhe kerkush mund të bëhet njeriu vetem me veprat e liga të tij e jo pse i teket dikujt. Sa i perket ”KO-QE” kësaj pune i ka dal ngjyra tërsisht, se deri sa ti thua për mendimet tua personale se janë urdhra të ”KQ-QE” në Kosovë shokve që janë jasht, keto mendime tua ua thua shokve në Kosovë se janë ”urdhresa” ”KQ-QE” jasht kete e verteton edhe ku kodoshi ketu kur thot: ”Se ata shokët shka janë në Kosovë nuk kan mund të krijon ”KQ-QE” mbrenda andaj na kemi formue ”KQ-QE” jashtë.”

Kjo verteton se rrena i ka kambet e shkurta.

Shoku Mërgim, egziston vetem nji KOMITET DREJTUES dhe vetëm nji LRSSHJ andaj nëse tani paraqitet edhe nji ”LRSHJ” me nji ”KO-QE”, atëhere do të thot se kemi të bejmi me dy Lëvizje të ndryshme. Kjo ”LRSHJ” e ”KO-QE” nuk njifen ndersa KD e

LRSSHJ janë themeluar në mënyr ligjore, me pajtimin e palve të bashkuara të cilët nënshkruen dokumentin e bashkimit. Ti paraqitësh si ”Lëvizje” e si ”KO-QE” dhe me nji grup injorantësh së pari bëre grupazhin e pastaj e shëndrrove në nji fraksion komplotistësh. Keqpërdorët besimin e KD të LRSSHJ dhe i uzurpuet organin e konton e LRSSHJ-ës. Por edhe pse vepron me atë ”LRSHJ” tande borgjeze ti nuk ke guxim që ”ZK” tija hjekish titullin LRSSHJ në faqën e parë (edhe pse mbrenda del me ”KO QE” e ”LRSHJ” tua antisocialiste), sepse atëhere ”Lëvizjet” tua do të psonin disfat kapituluse para popullit andaj edhe ZK fshihet pas autoritetit të LRSSHJ. Sa i perket kercnimeve të ”Levizjeve” tua akrobatike ato nuk dotë detyrojn askend e le ma LRSSHJ-ën që të humb besimin e veteten. Sa i perket ”kallaballekut” e ”shumicat” e ”pakicat” tua kjo vërtetohet në baz të nënshkrimeve në dokumentin e bashkimit, si dhe në praktikën e sodshëme. Edhe sikur të qëndronte kështu kjo nuk paraqet gja. Sërbija esht shumic para Kosovës por Kosova e ka arm të vërtetën dhe ajo do ta fitojn ket luftë patjetër.

Sa i përket asaj që ti thua se ke dalur me guxim të marre me intriga, dekonspirime, me falsifikime, me sabotime e me përqarje, kjo asht e vërtet dhe kjo aspak nuk të nderon. Por, shokët që thue ti, nuk e kan patur fjalën për këto ”guxime” tua, por mosguximin tënd për të dalur me pikpamjet tua borxheze-politike. Mirpo, ty të kanë rrjedh këto pikpamje nga koha në kohë pa e vrejtur se po demaskohesh vetë. P.sh. me orvatjen tende që LRSSHJ-ës tija hjek karakterin e saj Socialist dhe që ta thjeshtsojsh ate në ”LRSHJ”-borgjeze; kur saboton vendimin e bashkimit mbi organizimin e PKK-ës dhe të organizatave socialiste të masave në kuadër të LRSSHJ-ës; Nga qëndrimi yt armiqsor ndaj të gjithave organizatave dhe grupeve komuniste të Kosovës dhe nga orvatjet tua për të penguar bashkimin e tyre në PKK. Kjo në mënyr të qart shifet në Librin ”Sinovi Orla” (kem harrue met shpreh ngushllime se e kishe vajtue edhe në ”ZK”). Këto shifen edhe në mardhanjet tua me ballistët e të ngjajshemët si dhe nga raporti me policijën Turke, të cilët janë në shërbim të CIA-s e cija në mardhanje me UDB-ën. Sa i përket intrigave dhe arrogancës, këto i toleruan shokët për të rujtun atmosferën në LRSSHJ, po të ishte fjala për tjetër situat apo për qështje private, ti nga këto nuk doti bajshe as 5% pa i ndij thellësisht pasojat.

Pra mos e ushqe vehten me lug të zbrazt duke ushtruar ndaj shokve terror psikologjik sepse qdo gjë të kthehet bumerang. Shokët shum here të thirren me urtsij të madhe revolucionare që të hjekish dorë nga përqarja e anarshizmi arrogant por mos pandeh që urtsija revolucionare ësht e pakufishme dhe mos të mashtron kjo urtsij toleruese që ësht ”humbje besimi ne vetvete”, sepse revolucionarët ndaj qëllimit të vet janë të pathyshëm.

Letrën shokut Halim (mos i dekonspiro emnat e shokve në letrat që i dërgon në adresën time), e përfundon me disa parulla që nuk kan karakter patriotik e klasor. Edhe Turqija, Gjermanija, Fransa, etj. Janë Republika borxheze e antisocialiste. Kurse LRSSHJ – lufton për Republik Socialiste Shqiptare. Andaj parullat që vën ti janë të pavleftshëme për Popullin e Kosovës.

Shtojcë: Disa të dhëna janë nxjerr nga materijali i KD i LRSSHJ mbi paraqitjen e FRAKSIONIT KOMPLOTIST.

9. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani), **për Sabri Novosellën, 8 shkurt 1984**

”Mërgim” (S.M.-N.) 8.2.1984 viti

Katër materjalet që ishin në vijen e LRSSHJ ës dhe letrën tande i morra dhe i lexova. Do të përgjigjem menjiher.

Së pari po e jap mendimin tim mbi këto materjale. Kjo që do të them ka randsij për hapat e ardhshëm të LRSSHJ-ës, andaj ësht me randsij që keto të analizohen me kujdes.

Këto materijale përkah përmbajtja dhe vija politike e LRSSHJ-ës ishin plotsisht në rregull. E vetmja e met e tyre shume e madhe ishte ajo që ato ishin të nënshkruara më ”KQ” e ”LRSHJ” që nuk kan të bëjn me LRSSHJ.

Këto materijale ishin kombinim i sukseseshem i shum materijaleve të LRSSHJ. Aty pat pjes të nxjerrura nga punimet e letrat e shokut Kushtrim që ai i ka ber tani e dy vite ma par, pat pes nga materijalet e Partijës, disa pjes ishin marr nga Dokumneti i Bashkimit në LRSSHJ, disa pjes ishin marr nga ”Puntorët”, disa ishin nga ”Zëri i Popullit” e disa fjal ishin marr edhe nga letrat e mija që ua kam dërguar antarve të KD të LRSSHJ, si edhe nga materijalet tjera dhe konstatime origjinale të vet autorit.

Edhe pse këto materijale vijn mbas dy viteve të vështira për LRSSHJ-ën e për të cilat pat nevoj shum Ma pare, ato e kanë vleftën e vetë të madhe në këto momente aktuale.

Nji pyetje del vetëvetiu: Ku ishte ky njeri kaq i zgjuar që nuk veproji kështu mbar mbrenda këtyre dy viteve, por lejoji që LRSSHJ të kalon nëpër vështirsij kaq të mdha. Megjithate ma mirë von se sa kurr. Andaj, punën e këtij njeriu e përshëndes se ajo vjen në momentin shpëtimtar për bashkimin në LRSSHJ.

Këthesa pozitive ësht bër dhe ajo nuk duhet të bëhet e gjymët por duhet të pastron çdo gjë të keqe deri në fund. Bashkimi në me të LNÇKVSHJ, OMLK, e PKMLSHJ në LRSSHJ duhet të jetë i shëndosh dhe i plotë. Mbështetja e vetme e LRSSHJ ësht Dokumenti i Bashkimit dhe vendimet historike të 17.2.1982 i cili zhduk çdo ndasij të maparme dhe thekson vetëm unitetin i cili niset nga KD i LRSSHJ si organ mail art i përbashkët dhe deri te instanca e fundit e bazes së LRSSHJ.

Nisur nga kjo që e kam thane edhe ma par, e them edhe tani që çdo materijal duhet nënshkruhet vetëm me LRSSHJ ose me KD të LRSSHJ. Kur u arrijt Bashkimi në LRSSHJ nuk u themelue kurfar ”KQ” por u themelue KD i LRSSHJ i përbashkët. Esht e vërtet që në KD të LRSSHJ nuk u përfshin të gjith antarët e udhëheqsive të maparshme dhe se kjo qështje e hapur duhet zgjidhet bashkarisht e kokmeveti nga dikush jo. Pra, mbi KD të LRSSHJ nuk mund të vehet asnji ”KQ” i rrejshëm e as tri ”KQ” të organizatave të maparshme, e as të veprojn ato si ”KQ” veq e veq, sepse kjo ësht qesharake, e domsheme dhe e paqendrushme.

-Shokët e PKMLSHJ i qëndruan besnik vendimeve te 17.21982 dhe bashkimit në LRSSHJ. Partija bëri përpjekje në KD të LRSSHJ që vendimet mbi organizimin e mbrendshëm dhe mbi zgjerimin e aktivitetit të LRSSHJ ti zbaton në tërësij por ti, ”Skenderi” dhe ”Uka” nuk u përgjegjët në vendime. ”Uka” i izoloj dy antarë të KD nga OMLK, kurse mue u mundua të më izolon ”Skenderi”. Ndersa ndaj Partijës murrën masa bllokade uzurpimi dhe u ngrit nji fushat intrigash. U bën falsifikime, u keqpërdor kontonumri dhe devijoj nga vija politike ”ZK”. LRSSHJ-a ishte në rrezik! Ishin shokët e Partijës të vetmit që vazhdimish bajshin thirrje për ruejtjen e bashkimit dhe për zbatimin e vendimeve të 17.2.1982. Unë menjiher u përgjegja në kët iniciativ së bashku me shokët e mij nga klasa puntore – antarë të LNÇKVSHJ-ës së maparshme tani antarë e aktivist të LRSSHJ. Shum letra e apele ju drejtova ty e ”Skenderit” e ”Ukës” për t’i zbatuar

vendimet e 17.2.1982. Kësi hapash kishin marr edhe shokët e Partijës, por hasën në bojkotim të hapët.

-Ishim 4 antarë të KD të LRSSHJ-ës (e dy antar të KD nga OMLK mbaheshin në izolim) që ishim të vendosur që të zbatojm vendimet e 17.2.1982 deri në fund.

Më që ishim 4 veta vepruam si Aktivi Organizativ i KD të LRSSHJ. Krahas luftës në frontin kryesor ndaj armikut i hyrem zbatimit të organizimit të mbrendshëm dhe zgjerimit të aktivitetit të LRSSHJ. PKMLSHJ e maparme i qëndroj rrebesheve të sulmeve, sepse pat forcën komuniste dhe përkrahjen e klasës puntore dhe të popullit që e lindi. Ndrsa ne shokët e LNÇKVSHJ këtu nuk pritëm ma kot që t'na përgjigjen ata që nuk na përgjigjeshin dhe bashk me shokët e Partijës i hyrëm zbatimit të detyrave. Nga radhët e LNÇKVSHJ zgjodhëm shokët e aktivistët ma të mirë, dhe themeluem grupin komunist i cili së bashku me shokët e PKMLSHJ zbatoji ndërtimin e P.K.K. të përbashkët. Bashkarisht vepruem në themelimin e B.P.K., O.R.K. dhe të levave tjera të mbrendshme. Por e lam hapur mundsijën që OMLK e pjes tjera të LRSSHJ të inkuadrohen në zbatimin e organizimit në momentin kur ti kan kushtet. Bashkarisht murrem vendim që pranë LRSSHJ të shënojmë edhe Lëvizja për pavarsijen e Kosovës. Bashkarisht dhe në konsultim me bazën e bëm ndryshimin pozitiv të STEMES. Për çdo gjë vendosem bashkarisht si antar të KD të LRSSHJ me që të tjerët bojkotuen përgjegjjet dhe vepruen nën emna të rrejshëm.

-Çka ësht udhëheqse e çka është prijse ideore e LRSSHJ?

Po fillojm me një shembull praktikë: Brigada Partizane për udhëheqs ka komandantin i cili udhëheq me operacione ushtarake, ndërsa për prijs politik ka komisarin i cili i prin brigadës në aspektin politik. LRSSHJ ësht Lëvizje e përgjithshme popullore e organizuar me të cilën udhëheq KD i LRSSHJ, LRSSHJ-a udhëheq luftën për Republikë. Ndersa P.K.K. unike i prin LRSSHJ në planin ideopolitik. Këtë e vërtetoi edhe praktika.

Ta japim një shembull konkret: Në nji shtëpij nuk mund të behët zotë shtëpije një njeri i huj apo nji njeri i vdekur që nuk ekziston ma (si puna e "K.Q."). Sikur që nji shtëpi nuk mund të ket tre zotështëpije! Pra KD i LRSSHJ i përbashkët ësht zotështëpije në LRSSHJ. Unë këto materiale mundem t'i shpërndaj vetëm me nënshkrimin e LRSSHJ, ose me KD të LRSSHJ.

Tri Komitete Qendrore të organizatave të maparshme e bën bashkimin në LRSSHJ dhe nuk është e vërtet se ato janë kundër bashkimit. Por, bashkimin në KD të LRSSHJ-ës nuk e dojn 1-2 veta për shkak të bajraktarllukut të vet egoistë sepse në KD të LRSSHJ duhet vendos bashkarisht.

Këtë shpjegim e dhash sepse ti përserijt qëndrimin e gabueshëm, tani në nji form të re duke thanë her "KQ" i " LRSHJ" her "KQ" të LNÇKVSHJ e her përmend tri "KQ" të organizatave të maparshme si dhe permend se i merr "udhëzimet nga KQ i krahut tonë." Këto janë gabime. Udhzimet mund të mirren vetëm nga vendimet e Bashkimit të 17.2.1982 dhe nga KD i LRSSHJ. Esht e palejueshme që udhëheqsijtë e maparshme të veprojnë në papajtueshmërij me vendimet e bashkimit dhe pa pajtimin e KD të LRSSHJ.

Tani mbi qështjen e bashkimit të udhëheqsive të maparme dhe mbi zgjedhjen sa më të mirë të funkcionimit te tyre si udhëheqesij e përgjithshme e përbashkët pran KD të LRSSHJ, kam të shtroj një propozim konkret të cilin do ta paraqes para antarve të KD të LRSSHJ-ës për diskutim.

Propozim

-Propozoj që KD i LRSSHJ-ës i cili përbehet nga 9 antarë që veprojn në botën e jashtëme të zgjerohet edhe me 9 antarë të rijë që veprojn mbrenda në Kosovë të cilët do të zgjidhen nga udhëheqsijt e maparme. Kështu, KD i LRSSHJ do të ket 18 antarë – 9 në Kosovë, 9 në botën e jashtëme.

Zgjedhja e këtyre antarve dotë zhvillohet në këtë procedurë:

Çdo antar (9 veta) i KD të LRSSHJ në botën e jashtëme do ta zgjedh nga 1 antar për KD të LRSSHJ në Kosovë në sistemin ”njish”. Antarët e KD të LRSSHJ në Kosovë nuk do të njifen në mes veti (njiher për njiher) por, dotë veprojn si 9 punkte të veqanta të KD të LRSSHJ, gje që për armikun esht e pamundur ti zbulon. KD i LRSSHJ dotë vepron si udhëheqsij organizative (18) veta. Pjesa tjetër e udhëheqsive të maparme mund të funksionojn si Aktive (Aktivist) operative prane KD të LRSSHJ.

Në këtë mënyr dotë zgjidhet qështja e udhëheqsis së përgjithshme të LRSSHJ. Antarët e KD të LRSSHJ në Kosovë do të themelojn grupet punuese operative.

E përfundova propozimin

Sa i përket emrit të LRSSHJ nuk ka nevoj që të diskutojm ma tepër me që në vendimet e bashkimit thuhet se: Lëvizja do të lufton për Republikën Socialiste Shqiptare në Ju… Në lidhje me këte asht e nevojshme të theksohet se materijalet propagandistike duht të nënshkruhen vetëm me LRSSHJ, dhe në këtë të drejtë e kanë ata pjestar të cilët shkrujn në vijen e drejt të LRSSHJ. Kurse vetëm Dokumentet zyrtare të antarve të KD të LRSSHJ mund të nënshkruhen me KD të LRSSHJ.

P.K.K. unike ësht organizat e nji numri të kufizuer ku inkuadrohen vetëm komunistët. Ndërsa në LRSSHJ që është Lëvizje e përgjithshme popullore e organizuar mund të hyjnë të gjith ata që pajtohen me platformën socialiste të LRSSHJ e cila del nga vendimet historike programore të 17.2.1982 kur u themelua LRSSHJ. Në themelimin e LRSSHJ murren pjes bijt ma të mirë të popullit, si thuhet edhe në traktin Qarkorja që ma dërgove ti (e jo kriminelt e agjent).

As në LRSSHJ, an në P.K.K e as në leva tjera të mbrendshme të përbashkta nuk lejohet kurfar ruvaliteti. Në LRSSHJ s’ka përparsij as OMLK, as LNÇKVSHJ, e as PKMLSHJ – ato janë të barabarta. Përparsij do tju ipet atyre kuadrave të LRSSHJ të cilët janë mat ë aftë, pavarsisht se kujt i kan takue ma parë. Këtu nuk kemi shkati lam kohës. Mbi spjegimet mat ë hollsishme dotë flasim në letrat e ardhsheme.

Nga organi i BPK ”Punëtorët” nr.1, nr.2, nr.3, del nji vij e qart politike dhe shum fakte tjera të bazuara në të vërtetën reale. Andaj në mes këtyre numrave nuk ka ndonji dallim. Në traktët që mi dërgove kishte të nxjerruna fjalij edhe nga të gjith numrat e ”Puntorët” andaj skemi se të bajm dallime.

Vendimi i 17.2.1982 mbi organizimin e LRSSHJ në njisij gjegjese të mbrendsheme u tregua shumë i drejt në praktikë. Unë këte masmiri e pash në veprimin e BPK. Organizimi nuk i ”shkaperderdh” forcat por ato i grumbullon në njisij konkrete, duke i evituar spontanitetet e stihit e Lëvizjes imperike. Ti e din se para bashkimit në LRSSHJ vepronin dhjetra grupe e organizata të veqanta të cilat nxjerrshin materjiale e organet ë veta dhe kishin Qendrat organizative. Si ësht e mundur që tani në LRSSHJ të mos ban nji organizim i till e i mirfillt, i cili do të ishte një front i gjer i organizuar në nji vij e program politik që do të godiste armikun nga shum drejtime. Për organizim të till të fort duhet të ket vetëm njerz të aft që e njohin organizimin dhe që dijn të zbatojn ate në praktik. Në LRSSHJ kemi kuadra të këtilla të mjaftueshme dhe atyre duhet tju mundsohet që të zbatojn këtë organizim bashkarisht. Besoj se edhe në këtë pikë jemi të qart.

Në mes vështirësive që duhet ti kalojmi në LRSSHJ ësht uzurpimi dhe bllokimi i kontonumrit dhe ”ZK”. ”ZK” ka ber devijime të shumta dhe ka kompromituar LRSSHJ. Në këte drejtim duhet të marrim qëndrime konkrete. Unë i kam disa propozime, por tani ato nuk po i nxjerr sepse me duhet mendimi ytë për këtë qeshtje: A asht ”Uka” apo ”Skenderi” përgjegjës, apo të dy këta sebashku me ndonji tjetër. Tani po them vetëm kete: Se ne këtë drejtim duht ber ndryshime rrënjsore pozitive.

Tani potë informoj se isha në mbledhjen Komemorative në Zvicër sbashku me nji shok që përbanim delegacionin nga Gjer… Nga Gjermania organizuem shkuarjen e disa dhjetra vetave për në Zvicër.

Shokët në Zvicër na pritën mirë. Vetëm Naimi për të cilen unë e dij se asht djal i mirë e lexoj nji materijal i cili ja kishte pregaditur dikush. Ai punim që e lexoji Naimi në vend se të mirrej me qështje që kishin të bajn me tronditjen e vrasjeve të shokve aty nxjerrshin disa teza reaksionare e përqarse kunder Partijës. Për vrasjen e shokve Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës u tronditëm shum andaj edhe tye të shprehim ngushllime. Por, para neve shtrohet pytja: Kush e zbuloji bazen ilegale të ketyre shokve para UDBës. Bashkpuntorët më të afërt duhet ta zbulojn provokatorin dhe për këta shokë duhet të mirret haku.

Në përfundim të kësaj letre të gjatë due të theksoji diçka konkretisht mbi ate që ti flet për kthesën. Esht e vertet ajo që thua ti: … "Kthes duhet të bej nata që kanë devijue vijën e LRSSHJ"… se me të vërtet të till janë edhe disa tjer. Por, atyre në nji mënyr ua qele rrugën ti dhe në mes tyre ishe edhe ti deri në kohën e fundit. Këte e argumentojn të gjitha letrat që mi dërgove mbrenda këtyre dy viteve. Te unë gjenden edhe disa letra tua apo shënime që erdhën nga Kosova, Italija, e nga Zvicëra, ku ti sulmon vijen politike dhe organizimin e LRSSHJ, ku përdor "KQ" e "LRSHJ", dhe Partijën e shokët kompetent të saj – antarë të KD të LRSSHJ (shokun Nexhat e shokun Kushtrim me emna e mbiemna), që janë vepra përqarse dhe sulmojn bashkimin në LRSSHJ. Kohve të fundit vërtet ke fillue të bajsh kthes pozitive dhe për këte nuk duhet të vijn turp. Turp do të ishte sikur të mos bahej kthes pozitive. Por, këthesa nuk duhet të behet e gjymt dhe e pjesërishme. Gabimet duhet të përmirsohen deri në fund që të jesh plotsisht i qetë dhe në këtë mënyr do ti ndihmojsh shum forcimit te unitetit në LRSSHJ. Besoj se shokët dotë dijn të ç,ojn drejt këtë kthes pozitive. Tani me randsij asht që të ruhet bashkimi në LRSSHJ dhe të eliminohen përqarjet e kota e të damshëme. Në këtë drejtim jam i gadshem që të jap përkrahje edhe unë.

Më vjen keq që kjo letër e imja ësht kaq e gjatë, por ishte e domosdoshme që gjerat të ndriçohen deri në fund, që LRSSHJ-a të lirohet nga ky bagazh i tepërt.

Besoj se në letrat e ardhsheme dotë mirremi vetem me qështjen e luftës dhe ndaj armikut.

Përshëndetje revolucionare – "Luani"

10. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani), **për OMLK, 30 prill 1984**

30 prill 1984

Shokë të nderuar
Antarve të KD të LRSSHJ (nga OMLK e maparme)

Pas bisedës që patëm herën e fundit me shokun H.M. dhe shoqen S.Z. në lidhje me nji takim në mes nesh antarve të KD të LRSSHJ, nga Uka erdhi nji shkres shum e shkurt me kushtzime e me qendrim prej së "larti" gje që na preku. Shkresa ishte shkruar në atë mënyr që qysh tani takimi të mos ket sukses. Në ndërkoh na erdhi nji informat se Uka ka ndërmend me than vetëm nji fjalë: "Ma kurr në jetën e juj mos me folën në emër të Lëvizjes se ua bëj me u kersitur e me u pelcitur lëkura e ftyrës si lëkura e daulles." Si mbi këte si nqdo gje tjetër që ka vepruar Uka ndaj neve, shokve të KD të LRSSHJ, janë

kujdesur që t'na informojn disa burime dhe nuk dijmë se ai kan qëllimet e mira apo jo. Me Ukën, për këto gjera do të bëhet një takim i veqant i jashtzakonshëm.

Megjithate ne ma tepër ju besojmi letrave të tij, por letrat e tij gjithmon ishin të shkurta e pa përgjegjej në qështjet e shtruara, qka na zvarriti shum punë Ai nuk u përgjegj në zbatimin e vendimit të 17.2.1982 të cilët ju prezentuan me rastin e bashkimit të OMLK në LRSSHJ kur ai shprehi pajtimin e OMLK me këto vendime. Uka edhe pse e kishte për detyrë nuk i prezentoj përfaqsust e OMLK në KD të LRSSHJ që ata drejt përsëdrejti të kryejn detyrëb e vet si antar të KD të LRSSHJ, por i mbajti të mvarur dhe të izoluar. KD i LRSSHJ-ës, Ukën e ngarkoi me detyr në redaksijen e "ZK" dhe me konton e LRSSHJ, mirpo KD i LRSSHJ do të rishqyrton këtqeshtje sepse punët nuk shkuen në rregull. E dimi se manipulimet e "Skenderit" dhe të tjerëve e shtyen Ukën në gabime nga të cilat ai duhet të dal dhe të vazhdoi rrugën si antar i barabart në KD të LRSSHJ e të veproi në ruejtjen e unitetit në LRSSHJ.

Mbi veprimet e tija ju dini ma tepër, kurse ne punën e tij e pam nëpërmjes të "ZK" dhe përmes letrave që nai dërgoj, drejtpërsedrejti ku ai nuk veproi si duhet. Ne ju kemi dërguar shum letra juve antarve të KD të LRSSHJ – nga OMLK, mirpo si u pa ai nuk ua ka dorzuar ato andej kan mungua përgjegjejet e juja. Në vendë të jujin (nuk) është përgjegjur Uka. Andaj, kërkojm që të na dërgoni përgjegjeje të veqanta ose kur të shkruhet përgjegjëja të jeni të tret aty që ta nënshkruani, sepse letrat nga Zvicrra po na vijn pa nënshkrime dhe kjo po na bjen në dilem se a të përgjigjemi apo jo. Po ua dërgojm letrën e fundit të Ukës që ta shifni vetë.

Kemi deshir dhe është e nevojshëme që ti lexoni e ti vlersoni të gjitha letrat e antarve të KD të LRSSHJ që erdhën nga antaret e KD për juve antarve të KD në emer të Ukës. Pasi që vrejtjet personale që ju banën Ukës nuk dhan rezultate kërkojmi që të bisedoni me te dhe ne antarët e KD të LRSSHJ të marrim qendrim. Mendoj se ndaj Ukës nuk duhet të marrim qëndrim të ashpër me qe ai ishte viktimë e manipulimeve të tjerve. Besoj se ai do të permisohet.

Antarve të KD të LRSSHJ-ës

Shokë të nderuar,

Pasi që murrem shkresën e Ukës ku pos tjerash bëhej fjalë edhe për takimin që propozuam, na u dasht të vonojm pak përgjegjejën deri sa u murrem vesh edhe me shokë të tjerë të KD të LRSSHJ (të Partisë) më të cilët ishim të shoku H.M. kur edhe biseduem për takim.

Në lidhje me takimin morrem këto vendime:

Çë të mbahen dy takime. Në të parin dotë marrin pjes unë dhe nji nga shokët e Partisë dhe nji shokë nga OMLK. Në këtë takim mund të marrin pjes edhe shokët tjer të KD të LRSSHJ por vetëm si vershtrues e përcjellës. Ky takim ingusht dotë shërbej si para pregaditor për takimin e mavonshëm ma të gjer.

Për të qenë takimi sa më konkret vendosëm që tu dërgojmi nji material të AKTIVIT ORGANIZATIV TE KD të LRSSHJ, ku janë të shkruara gjersisht problemet e mbrendshëme. Asht e domosdoshme që me këtmaterial shokët: H.M., K.A., shoqja S.Z. që ishin bashkpuntor të shokut të lavdishëm Kadri Zeka, të njoftohen me njiher.

Propozojmi që e vetma pikë e diskutimit të është ruajtja e unitetit të LRSSHJ dhe zbatimi i vendimeve të 17.2.1982 dhe vendimet e mëvonshme të KD të LRSSHJ. Mendojmi që diskutimi të zhvillohet ne atëmosfer të mirkuptimit reciprok që biseda të zhvillohet vllëzrisht dhe pa lejuar çfrado polemizimi. Me që shoku Ukë nuk doli në takimin dhe nuk shfrytëzoi rastin që të bisedojmë kur ishim atje, prezenca e tij nuk është e domosdoshëme.

Kategorikisht kërkojmi që askush pos antarve të KD të LRSSHJ nga OMLK, të mos njoftohet para se të kët përfunduar ky takim dhe para se të kemi arrijtun në vendqendrimet tona.

Mbi kohën e takimit dotju informojmi se shpejti. Jemi të pajtimit që ky takim (takimi i parë) të mbahet në Zvicër, ndërsa masat e siguris dhe vendin e takimit ju takon që ti ndermerrni e ti caktoni antarët e KD të LRSSHJ, nga OMLK si mikprits.

Ne vijmi në besën e shokut H.M. të cilit ja besojm sigurijën tonë.

Përshëndetje vllëzrore revolucionare

Për antarët e AKTIVIT ORGANIZATIV të KD të LRSSHJ

"Luani"

30 Prill 1984.

PS. Në lidhje me atë që shtron Uka, dhe për disa qeshtje tjera doti përgjigjemi në veqanti. Tani po ua dërgojm kopjën e shkresës së Ukës që ta vlersoni përmbajtjen e saj.

11. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani) dërguar Sabri Maxhunit-Novosellës në Turqi

Shoku Mërgim 30 prill 1984

Më 3-04-1984 morra nji letër nga ti dhe së shpejti nji material tjetir. Akoma se kisha pregadit përgjegjejen për shkaqet e smundjeve të fmive kur më erdhi edhe letra e yte 8-4-1984.

Sa u përket atyreve tezave që shtron nëletra dotë përpiqem që të përgjigjem, por së pari dota shtroj mendimin tim për materialin që ma dërgove.

Materiali ishte në përgjithsij i mirë mirpo vleren i ja humbte "KQ" i rrejshëm, që nuk ekziston në LRSSHJ dhe vet nënshkrimi i këtill e banë të falsifikuar. Pse një material i till të mos nënshkruhet në emër të antarve apo të KD të LRSSHJ, që esht organë ma i lartë i përbashket si organ ligjitim e zyrtar, kur KD ësht i themeluar me 17.2.1982 me vendim të përbashkët.

Kohve të fundit, "ky KQ" e polli edhe nji "KO-QE" të rrejshëm dhe tani kto "KO-QE" po luftojn njeri kundër tjetrit. Konflikti që po zhvillohet në mes dy personave në emer të "KO-QE" të rrejshme për mes Organit, materialeve, për mes letrave, dhe verbalisht, në emër të LRSSHJ ësht keqperdorim që terhjek pas edhe përgjegjsijën. Nëse konflikti ekziston, aji duhet të zhvillohet në mes juve dyve, ose kjo të shtrohet para KD që shokët të zgjedhin, e jo të bëhet në emër të LRSSHJ.

Veprimi i juj në kët mënyrë shkon ne favor të armikut i cili këte mund ta shfrytzoj që ta rrezikon dikend dhe që pastaj të thot: "qerime hesapsh në mes emigracionit". Pra këto "KQ" të rrejshme e bin në rrezik LRSSHJ, e komprimetojn atë para botës dhe i dezorientojn e demoralizojn masat. Në lidhje me këte me shtyu edhe "NJOFTIMI" i ukes në "ZK" ku ai manipulon më "KQ"-"LRSHJ", dhe nderkoh edhe ti del me nji "KQ" tjetër.

"Në lidhje me "KO-QE" që po përdor ti më duhet të jap nji përgjegjeje definitive që rreth kësaj qështje të mos humbim kohë. Më 17 shkurt 1982 dhe më 15 maj 1982 në nivel të përfaqsusve të tri udhëheqesive (pavarsisht a janë qujtur KQ apo ndryshe) të organizatave të maparme u be Bashkimi - shkrirja e tyre në LRSSHJ të sodshme. Këto tri udhehqsije e Organizata i bashkon KD i LRSSHJ (Antaret e të cilit nuk gjinden nëpër burgje) dhe platforma politike e cila del nga vendimet historike të 17-2-1982. Jemi në kushte lufte pjestaret tjer nuk duhet të nifen (njiher per njiher) as në Kosovë e as jashtë Kosovës. Se a kan për funde në burgje apo gjinden jasht burgjeve antaret e KQ PKMLSHJ

e OMLK ti kete nuk mund ta dijsh andej mos ija përmend askujt. Nuk esht mirë që të japish vlersime të këtilla paushall as për KQ të LNÇKVSHJ-së së maparshme se gjoja ky asht i paprekur nga armiku sepse njerzit dotë thon se të tjeret po bijnë burgjeve kurse KQ i LNÇKVSHJ-ës po pret me e marr pushtetin e gatshëm. Në praktik puna qëndron ndryshe.

Këto tri KQ të maparshme nuk egzistojnë. Me themelimin e KD të LRSSHJ këto tri KQ mund të jen vetem AKTIVE Operative pran KD të LRSSHJ dhe i nenshtrohen direktivave të KD të LRSSHJ.

Nëse, Nji, dy apo ma shum antar të LNÇKVSHJ se maparshme pretendojn që të paraqiten me KQ, ajo ësht paraqitje fraksioniste që i kundervehen në mënyr përqarse unitetit të LRSSHJ dhe kjo është tradhtij ndaj bashkimit. Ata mund të paraqiten si KQ i LNÇKVSHJ e cila ësht shuar dhe dota bejn të njejtin akt posi paraqitjen e rrejshme si "KQ" i LRSSHJ dhe perserij ësht falsifikim. KD i LRSSHJ ësht organ zyrtar i LRSSHJ. Pjesa e KD të LRSSHJ në botën e jashtme e ka për detyr që ta formon pjesen e KD të LRSSHJ, në KOSOVË, gjë që ësht ne zbatim e sipër. Nji propozim tu ka shtrue për këtë. Mbi kët qështje të përfundojm me kaq. Tani po vazhdojm përgjegjejen e letrave tua.

Ti përserit epitetet e llojllojshme mbi Partijën dhe shokët e Partijës. Të kam thanë edhe ma heret dhe po them edhe tash që mos të më shkrujsh mbi mendimet e tua personale për keta shokë. Unë e çmoj partijen dhe keta shokë, për arsye se populli i vlersoj drejt veprat që kryen por unë i çmoj sidomos për ruajtjen e Bashkimit dhe që nuk umurren asnjiher me thashethaneme ndaj të tjerve por me vigjilenc të lart në punën revolucionare.

Sa i përket asaj që shtron mbi PKK dhe mbi organizatat e masave, paske harruar se konsultimet janë bër edhe metye edhe me tjert. Me ato pjesë të LRSSHJ që kan drejtuar antaret e KD të LRSSHJ të cilët zbatuan vendimet, puna ka shkue mbar. Pra qdo gje që ësht marr në ket drejtim ësht bër në baz të vendimeve historike të 17-2-1982 dhe me konsultime të nevojshme. Ata që nuk janë përgjegjur nuk kanë të drejt as të japin kritik në punë me që vet janë për kritik.

Formimi i Partijës Komuniste nuk mvaret as nga egzistimi i domosdoshëm i grupeve e as nga partijet borxheze turke nuk mund të mirren për krahasim për formimin e një partije revolucionare në kushte lufte. As gja nuk pik nga qielli, por qdo gje e bejn njerzit. Shifet se nuk ke njohuri për kët qështje andaj mos i jep vlersimin për gjerat që nuk i njef.

Kisha me të dhen vetem nji porosij: Para se tanxjerrsh fjalën nga goja ose para se tashkruejsh, mbate mirë peshen e saj se të qujsh "zbavitje", "naive" e "marrij" punën revolucionare vërtet asht marrij e madhe. Mandej kurr nuk duhet të japish vlersime paushalle për punën e njerzve apo për gjërat që vet nuk i njef sa duhet, sepse kjo të qët në pozit injorante e kapricioze.

Në njeren nga letrat e kaluara pate deklaruar se nuk dot mirresh ma me polimizime kunder shokve por me punë kunder armikut. Qendroj besnik këtij qëndrimi dhe fjalëve me karakter të shëndosh dhe mos hap përserij polemik më shoketë Partise kur ata tye nuk po të ngasin. Pra kjo punë që po bëhet me vuejtje, gjakë, djers e me shum sakrifica duhet të përshndetët dhe të vazhdohet me forca të përbashkëta.

Sa për shokun K dhe Q nuk ke se çka të thush fare. Ndërsa për "gabimin e rand" që thue se paskem bër unë dhe Halimi ësht e mundur, por këte duhesh ta thujsh në mënyr të argumentuer dhe ne dotë përgjigjemi. Sa për "largimin" ton që përmend mos na thuj në

baz të gjenjeshtrave të Skenderit, se ato janë drrasa të kalbura që edhe ty të shtyrën neshum gabime. Por kur është fjala për gabime, njeriu është mirë që së pari t'i shef gabimet e veta dhe ti pastron ato e jo të mundohet të gjejn gabime aty ku ska.

Sa i përket rujtjes së bashkimit në LRSSHJ, ai vërtet i qëndroji kompoteve të stuhishme sepse ai u arrit në baza të shëndosha dhe u përqafua nga baza e LNÇKVSHJ, PKMLSHJ dhe OMLK dhe nga populli, pavarsisht që nuk njifen fizikisht (as nuk ka nevoj) të gjith njerzit. Ata i bashkon platforma e përbashkët nga Dokumenti i Bashkimit dhe udhëheqsija më e lart e përbashkët KD të LRSSHJ, pavarsisht se 1-2 njerz përpiqen ti bajn bisht bashkimit. Ti thua se "të tjerët nuk pranuen bashkimin"... thuj me emra e mbiemra të cilët janë ata që t'i shkarkojm menjiher nga KD i LRSSHJ pasi se duan ashtu. Ata nuk kan të drejt të flasin ne emer të forumeve të Organizatave të maparshme por vetëm në emen personal - dhe mund të ndahen nga LRSSHJ si individ. Kurse bashkimi në LRSSHJ është i pacenueshem.

Çeshtja e kompoteve të Xh-D, "SS" nuk mund të kaloj ashtu shkel e shko, por ai duhet me dhan përgjegjsij para KD të LRSSHJ. S. ishte antar i KD të LRSSHJ deri me tani, dhe tani kur mbushi kupen me gabime "Salihu" na doli si zavendsus! Mergim ti ke të drejt të propozojsh të shkarkohet nji antar e të zgjidhet nji tjetër kurse KD i LRSSHJ dotë merr vendim për kete, e jo ta bajsh ti simabas mendjes sate. Kush është Skënderi dhe se duhet të shkarkohet këte e di KD i LRSSHJ, por kjo duhet të bëhet në mënyrë zyrtare, me që rast duhet të përcaktohet përgjegjsija e tij. Kush është "Salihu" dhe a e meriton të bëhet anëtar i KD të LRSSHJ kjo nuk dihet nga KD i LRSSHJ. Andej nëse ti apo unë propozojm nji antar për KD të LRSSHJ në duhet ti japim karakteristikat elementare për te, kurse ai shok duhet të jap betimin me shkrim para antarve të KD të LRSSHJ se doti përmbahet vendimeve historike të Bashkimit të 17-2-1982 dhe KD i LRSSHJ të merr vendim zyrtar për pranimin e tij. Ky shok duhet të mban lidhje me direkte me të gjith antaret e KD të LRSSHJ e jo përmes teje. Antarët e KD të LRSSHJ në botën e jashtme duhet të njifen të gjith në mes veti e jo të mbahen në izolim e imvarun se ai dotë drejton më nji pjes të LRSSHJ.

Jam i mendimit se shoku i ri në KD ose duhet të zgjidhet këtu në Evrop ose nëse zgjidhet ky "Salihu" atje në T. ai duhet të vjen këtu ku ka ma shum nevoj perte dhe të lidhet rrethi Skenderit. Atëher kem mundsij që të bashkpunojm si antar të KD dhe dotë kem mundsij që ti shujm përqarjet në mes puntorve që i bëri Skenderi. Ejo të shkarkohet njeni e të zgjidhet tjetri pa dijen e KD të LRSSHJ.

Unë në letrat e kaluara dhash nji propozim për organizimin e KD të LRSSHJ, gjegjsisht për zgjerimin e tij me 9 antarë te rij të cilet do të vepronit në KOSOVE duke THEMELUAR 9 QENDRA ORGANIZATIVE-OPERATIVE të pamvarura në mës veti të cilet do të lidheshin me 9 antaretë ne botën e jashtme. Kjo form e organizimit dotë përfshinte edhe udhëheqsijt e maparme dhe kështu KD i LRSSHJ dotë funkciononte, normalisht si udhëheqsij e përgjithshme e LRSSHJës. Nga shokët tjer morra përgjegjeje pozitive andaj duhet që të përgjigjesh edhe ti.

Tani propozoj që Xh-D "SS" të shkarkohet nga KD i LRSSHJ për shkak të veprimtarijes antilëvizje përqarse komplotiste.

Skënderi umurr me shkatrrimin e materialeve revolucionare të Org. motra dhe përhapi intriga përçarëse për OMLK, FKP e PKMLSHJ edhe para bashkimit. Me këte punë umurr

edhe pas bashkimit në LRSSHJ. Ai futi përqarje e mosbesim në kryesijen e LRSSHJ për Evrop dhe në KD të LRSSHJ duke të nxit ty dhe Ukën kundër meje, kundër Halimit dhe kundër shokve të Partisë. Ai umurr me falsifikime e dekonspirime si dhe beri përpjekje për zbulimin e sekreteve të LRSSHJ. Tani nxiti konfliktin në mes teje dhe Ukës dhe nxiti përqarje edhe në mes puntorve-antar të LRSSHJ gjë që shkaktoi edhe gjakderdhje në mes shqiptarve (në Düsseldorf), ai pregaditi teren për atentatet të UDB-së për shokët e Partisë si dhe vazhdimisht manipulon me reakcionin ballisto-ustash për ta kompremituar LRSSHJ. Bile edhe në "Nova Hrvatska" u botua rasti i policit të Stambollit dhe emri yt. Skenderi kah do që të shkoj pas vetes la gjurma të provokatorit. Për damin që i shkaktoj LRSSHJ duhet të shkarkohet nga KD i LRSSHJ.

Nëse ti propozon ndonji shokë të rij për antar të KD të LRSSHJ atëhere bëne propozimin, jepi karakteristikat reale për atë shokë, shoku i propozuar ta jep betimin me shkrim se doti permbahet vendimeve historike të Bashkimit 17-2-1982 dhe të gjitha këto t'i dërgohen antarve të KD të LRSSHJ, (të LNÇKVSHJ, PKMLSHJ dhe OMLK të maparme - tani nuk do t'i përmendim këto por vetëm LRSSHJ), që të mirret vendimi zyrtar. Ndoshta edhe unë do të baj nji propozim, po sido qoft ai shok duhet ta zavendsoj Skënderin në këtë mes. Tani e tutje nuk do të njofim ndarje në tri Org. të mëparme dhe kushdo që ben sektarizem do ta luftojm si armik të unitetit të LRSSHJ.

Pra gjdo gje ta bëjm në mënyr të pastërt dhe konkrete dhe askujt të mos i lejojm anarshi në LRSSHJ sepse ne qështje të atëdheut nuk guxohet të luhet.

Tani kur e përfunduem problemin e Skenderit mund të vazhdojm me qështjen e Xh-Sh. (Ukës). Ti pranove gabimin në lidhje krijimin e mundsive që Xh.Sh. të bën keqperdorime për uzurpimin e kontos e Organit të LRSSHJ dhe për të tjerat që shkruan ti. Në lidhje me të gjitha këto që ndodhen në LRSSHJ, sidomos për mosrujtjen e Bashkimit dhe mosrespektimin e vendimeve, ti edhe Uka keni përgjegjsij të barabarët.

Përgjegjsija e jote dhe e Ukës ësht më e vogël sepse ju dy ishit viktim e manipulimeve dhe intrigave të Skenderit. Por Uka nuk dotë bënte asgja të keqe po tëmos ija mundsojshe ti. Ju bat përpjekje qëtna bllokoni e izoloni neve antarve të tjer të KD të LRSSHJ (6 veta), edhe nga konsulidimii KD dhe nga Organi i "ZK" si dhe nga LRSSHJ-a në tersij. Por këtë e bët në bazë të gënjeshtrave të Skenderit andaj edhe na mbajtam qëndrim shoqnor ndaj jush dhe vazhdimisht u perpjekum dhe po përpiqemi që bashkarisht ti sanojmi damet që i bëri Skenderi. Besimi ynë dotë shtohet ndaj jush nëse ju veproni në forcimin e unitetit të LRSSHJ.

Pra, të gjith në që jemi antar të KD të LRSSHJ duhet të komunikojm në mes veti, duhet t'i zbatojm vendimet e 17-2-1982 dhe duhet të marrim vendim të përbashkët për qështjet që shtrohen para neve. Pra, KD i LRSSHJ duhet të funkcionoj UNIK normalisht.

KD i LRSSHJ e ngarkoj Ukën me detyr në redaksijen e "ZK". Ti thua se: Uka uzurpoj konton dhe organin e "ZK" dhe beri devijime tjera. Ai i mbajti të mvarur dhe të izoluar H. M. dhe S. I. (antaret e KD të LRSSHJ) nga pjesa tjetër e KD të LRSSHJ duke umunduer që të përfaqsoj vetem ai OMKL dhe të dominoj në këtë pjesë të LRSSHJ. A duhet që këtë qeshtje ta lamë kështu? JO. K-D- e ka ngarkuar me detyr në radeksi të "ZK"; KD i LRSSHJ dota shkarkon nga detyra, nëse për këte mirret vendim zyrtar, dhe nëse Uka nuk përgjigjet në thirrje të KD të LRSSHJ që ti pastron qendrimet e veta. Mendoj se po që se vepruem si KD i LRSSHJ dotë kemi perkrahje edhe prej shokve të vjetër të Kadri

Zekës. Por, separi duhet të hiqet dorë nga "KQ" i rrejshëm, duhet që me shokët e Partisë e me të OMLKës të mëparme të krijohen mardhanje të mira dhe vetem atëher mund mund të marrim vendime të drejta zyrtare në KD të LRSSHJ. Pas të gjitha këtyre ti dhe Uka keni borxhë që të bani autokritik para K-D.

Çë të mos kemi nevoj që nga disa her të përgjigjemi në të njejtat qështje veqe tani tutje të mirremi më qështje ndaj armikut si dhe me punë tjera pozitive unë dotë dergoj nji material të AKTIVIT ORGANIZATIV TE KD të LRSSHJ të cilin ti analizoje sbashku me shokë dhe mundesh të konsultohesh edhe me shokët e Plakut nëse ata duan të japin ndonji vlersim. mendoj se ti si nënshkrues i Dokumentit të Bashkimit dotë pajtohesh me këtë material.

Shoku Mërgim kishte me qenë mirë që të më japësh numrin e telefonit që të bisedojmë drejtpersedrejti. Letrat që mi dërgon mi shkruan me pseudonim të plotë ashtu si po veproj unë. Shokve të Partis ju shkruen letra të veqanta sepse ata nuk e kishin mar ende përgjegjejen e letrës janarit.

Të fala familjare shoqnore ty e familjës dhe shokve. "Luani"

P.S.
Kaluen dy vite nga Bashkimi dhe nga themelimi i LRSSHJ unike kurse ne po përdorim emrat e Org. të maparme OMLK, PKMLSHJ dhe LNÇKVSHJ e kjo ndikoi që ndasija sektare të mbetet si pykë përqarëse duke bër të lekundëshme unitetin në LRSSHJ, e kete e shfrytzoi edhe armiku e veglat e tij. Kjo praktik duhet të nderprehet menjiher dhe të veprohet vetem në emen të LRSSHJ dhe në emër të Org. e të levave të mbrendshme të LRSSHJ.

Në lidhje me këte propozoi që tani e tutje në vend se të përdoret krahu OMLK, të quhet "dega e LRSSHJ - Kadri Zeka", në vend të PKMLSHJ të quhet "dega e LRSSHJ, AFRIM ABAZI" dhe në vend të LNÇKVSHJ të quhet "dega e LRSSHJ-ës VLLEZRIT GERVALLA."

Pasi që LRSSHJ drejtohet nga 9 antarët të KD të LRSSHJ, kemi të bajm pjes edhe me 9 pjes të LRSSHJ të cilët drejtohen nga këta shokë. Mendoj se këto 9 pjesë të LRSSHJ të quhen "nëndeg të LRSSHJ" të cilat do të emertohen në emër të personaliteteve historike. Kjo zgjedhje dotë shprehet mirë në unitetin e LRSSHJ dhe njiherit dotë përjetsojm shokët që ran Deshmor për qështjen e Republikës.

Duke perfundua letrën më erdhi lajmi mbi nji incident fizik në Zvicërr pas të cilit përsërij qëndron Skenderi dhe banda e tij. Ky aksion ësht i armikut posi incidenti i Düsseldorfit, andaj porositi urgjent të gjith shokët kud që gjinden që të ruejn gjakftoftsijen dhe që të qetsojn njerzit që në keso provokime të UDBës të mos rrëshqasin sepse armiku po përpiqet të komprmiton e të shpartallon LRSSHJ - pjesa në botën e jashtme. Armiku po përdor të gjitha provokatorët për ti dhan "goditje përfundimtare LRSSHJ" dhe duket si kur ka "sukses".

Në se jemi të mençur dhe gjakftoft, tani është shansa që LRSSHJ-a të lirohet nga provokatorët e bërllogu i armikut dhe LRSSHJ dotë rilindë në një forcë të pastërt e cila dota godit armikun për vdekje. Duhet vetëm që K-D i LRSSHJ të funksionon normalisht,

që të zbatohen vendimet e 17-2-1982 dhe që të rujm unitetin duke liruar nga ata që janë kundër bashkimit.

"Luani"

(Shënim i Xhafer Durmishit-Skenderi: Kjo letër më ra në dorë për herë të parë më 9 maj 2021)

Xhemajl Shatri: "*Padyshim Xhafer Durmishi është arkiva më autentike për veprimtarinë kombëtare të Jusuf Gërvallës dhe Bardhosh Gërvallës, i cili i ka shkrua mbi 20 libra për Lëvizjen Çlirimtare të Kosovës.*

Për Xhafer Durmishin nuk do të them shumë se nuk jam avokat i tij, por një gjë dua të them, se sa e kam njohur nga afër kam krijue mendimin se është njeri shumë i ngritur kombëtarisht dhe intelektualisht. Xhafer Durmishi është njeri i besës dhe i shkencës, është specialist i librave, dhe është atdhetar i flakt i çështjes kombëtare." (Facebook, 13 shkurt 2023)

12. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani), **për Sabri Novosellën, 10 maj 1984**

10 maj 1984

Mërgim

Pasi që të dërgova postën e fundit më erdhen disa Çarkore, trakte, komunikata të nënshkruara me ”KQ” e ”LRSSHJ” të cilat sulmojnë në mënyrë flagrante unitetin dhe që kishin për qellim shpartallimin e LRSSHJ-ës.

Menjiher nga të gjitha drejtimet me thirren shumë shokë dhe patem konsultime të shumta dhe urgjente, si me shokët e LNÇKVSHJ- së ma parshme – tani pjes e pandar e LRSSHJ, ashtu edhe me shokët e degve tjera të LRSSHJ. Unë edhe vet i kerkova mendime e shokve tjer dhe të gjith nji zëri ishim të mendimit se ky ësht nji ndër sulmet ma të rënda ndaj unitetit dhe me qëllim që LRSSHJ-a të shpartallohet.

Ky akëtë ësht kulmi i diverzioneve të xhafer durmishit me kompani e në prapavij, vepër, tërsisht e armikut. Pas kësaj vjen epizoda e krimeve të UDB-ës.

Ky akëtë i xhafer durmishit me kompani ësht aktë tradhtije ndaj unitetit të LRSSHJ ndaj qeshtjes së popullit dhe atëdheut. Andaj nga LRSSHJ – si tërsij denohet rrepsisht dhe LRSSHJ distancohet nga këto veprime energjikisht.

Qe dy vite rresht xhafer durmishi me kompani e minoi me shpifje e intriga unitetin e Komitetit Drejtues të LRSSHJ, kurse tani po përpiqet që këto përqarje që i futi ai ta shpartalloi edhe unitetin e LRSSHJ në tërsij.

Deri më tani këto i beri me shpifje prapa shpinës, përmes letrave personale si dhe me anën e disa materijaleve të nënshkruara më ”KQ e LRSHJ” ku u sulmuen gadi të gjith antarët e K.D. por edhe aktivistët e pjestaret e LRSSHJ, mirëpo kjo që u bë mëzë të ultë dhe pa përmendur fare emra e mbiemra, kurse tani kjo edhe u ba dhe atë në emër të ”KQ” të rrejshëm dhe në emër të LRSSHJ-ës.

Komiteti Drejtues i LRSSHJ-ës për tër këto dy vite- e ca i zbuloi me emra e mbiemra si dhe veprat nji për nji të fraksionistve komplotist, si ësht shembulli i xhafer durmishit me kompani, por asnjëher këto gjera nuk i nxjerri publikisht, me që këto janë gjera të

mbrendshme të LRSSHJ të cilat nuk duhet ti dinë as miku e as armiku – sepse këto janë punët e shtëpijes.

Kurse tani xhafer mutishi pasi që ra në konflikt privat me Xh SH e I.K. këtë konflikt po përpiqët që ta përgjithson në LRSSHJ. Ai pasi shpalli ”tradhtar” Xhafer Shatrin e Ibrahim Kelmendin e sulmoi edhe ”Zërin e Kosovës” e edhe unitetin e LRSSHJ në tërsij më qëllim që LRSSHJ-a të shpartallohet. Dhelprës kur ju ka djeg bishti – mendoj se po digjet bota. xhafer durmishit po i digjet bishti dhe ai po përpiqet ta djeg tër LRSSHJ-ën dhe qeshtjen e popullit e të atëdheut në tërsij.

As unë e as shokët tjerë të LRSSHJ me të cilët u konsultuem nuk i murrem në mbrojtje as nji njeri që ka gabuer e nuk mbrojm as shkrimet destruktive në ”ZK”. Përkundrazi, Xhafer Shatri e Ibrahim Kelmendi kanë gabime, por kanë edhe veprime revolucionare ashtu si ka gabime por edhe shkrime të mira në ZK dhe të gjitha këto do të vlersohen e do të gjykohen drejt në LRSSHJ.

Të gjitha këto gjëra dotë zgjidhen mbrenda LRSSHJ dhe për to do të mirren masa konkrete nga të cilat nuk do të ket as nji dam LRSSHJ dhe do të zgjidhen në dobij të LRSSHJ. Me këtë nuk do të mirret në mbrojtje as I.K. e as Xh.Sh. por asht marr vendim që të thehet me ashpërsij revolucionare çdo sulm që është i drejtuar ndaj unitetit në LRSSHJ.

Xhafer Durmishi edhe ma parë sikur që edhe tani ma par që nxjurr ”trakte”, ”Qarkore”, ”Komunikata” me ”KQ” të rrejshme pa konsulta dhe pa dijen e KD të LRSSHJ duke sulmuar gjithnjë unitetin e LRSSHJ dhe kësaj duhet ti epet fund dhe LRSSHJ-a të pastrohet nga këto mbeturina që këtë pjesë të LRSSHJ në botën e jashtëme tentojn ta bëjn si mërgatën e qyqeve apo ta shpartallojn si organizatën palestineze.

Kërkoj nga ti që me shkrim të distancohesh në mënyr zyrtare nga veprimet e Xhafer Durmishit të cilat janë drejtuar kundër unitetit dhe për shpartallimin e LRSSHJ. Këtë distancim ta bëjnë edhe shokët tjer me të cilët drejton ti.

Sa i përket qështjes së përgjegjesijës për gabimet e Xh. Sh. e I.K. e tuajat apo edhe të një antari tjetër të K.D. këto qështje dotë vlersohen e do të gjykohen drejt mbrenda KD të LRSSHJ sepse këto paraqesin sekrete për të cilat nuk duhet të dinë as armiku e as miku, sepse me këto veprime të hapta i hapet shtek për t’na rrezikuar armiku, kompromitohet i humb autoriteti LRSSHJ, dezorientohen e demoralizohen masat dhe kjo e bjen shkatrrimin e unitetit të LRSSHJ-ës në tersij.

Duke marr para sysh të gjitha këto KD i LRSSHJ dhe vet LRSSHJ-ja si tërsij, në emër të LNÇKVSHJ, PKMLSHJ dhe OMLK dotë distancohet publikisht dhe do t’i shpall të pavleftshme të gjitha materialet e falsifikuara që janë të nënshkruara me ”KQ” të rrejshme në emer të ”LRSHJ e LRSSHJ”, dhe të gjitha këto dotë shpallen vepra e komplote të armikut.

Kërkoj që kjo letër të lexohet edhe nga shokët tjer te ju dhe këtë ta lexon edhe ”Saliu” të cilin ti e propozon për antar të K.D. ”Salihu” nëse dëshiron të bëhet antar i K.D. nuk duhet të përzihet në asnji nga këto të xhafer durmishit e me ”KQ” të rrejshëm me të cilin ai prezentohet, ”Salihu” duhet të distancohet menjihere me shkrim nga këto ndytsira të xh.d. e ”KQ” të rrejshëm të tij.

Pres përgjegjëje urgjente. Në emër të A.O. të K.D. të LRSSHJ

10 MAI 1984 ”Luani”

13. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani), **për Komitetin "Kadri Zeka", 20 maj 1984**

Antarve të Komitetit Drejtues të LRSSHJ-ës – "KADRI ZEKA"
Shokut HM dhe shoqës SZ

Në përfundim të konsultimeve të neve antarve të KD të LRSSHJ nga degët: "Vllëzrit Gërvalla" dhe "Afrim Abazi", morrëm vendim që takimi i paraparë, parapregaditor, të mbahet me 26.5.84 nëse kjo kohë ju përgjigjet edhe juve. Mbi kohën e takimit po ju lajmrojm me nji vonës të caktuar për arsye se nau desht që të ndërmarrim masa zyrtare kundër "Qarkore, Komunikata, Trakte" të "KQ" të rrejshëm, me të cilët Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi shpalleshin "tradhtar e vegla të armikut" dhe ku sulmohet uniteti i LRSSHJ. Si e dini KD i LRSSHJ-ës nxorri KUMTESEN (e Majit) me të cilën u demantuan dhe u paralizuen akcionet armiqsore të "KQ" të rrejshme. Ne bërem perpjekje tju informojm ma heret mbi kohën e takimit, përmes telefonit të shokut HM por telefoni i tij nuk funkcionionte. Andaj u detyruam që mbi kohën e takimit tju shkruejm në këtë letër.

Mendojmi që në këtë takim të marrin pjes pos tre shokve të autorizuar të degve të LRSSHJ, të merr pjes si veshtrues e percjells edhe nga nji shokë nga të tri degët e LRSSHJ. Pra ne do të vijm me nga nji përcjells dhe gjithashtu nga dega e LRSSHJ "KADRI ZEKA" mund të marrin pjes si vështrues cilido, shoku HM apo shoqëja SZ, mund të merr pjesë edhe Uka por pjesmarrja e tij nuk ësht e domosdoshme, pasi që Uka asnjiher nuk u përgjegj as pozitivisht e as negativisht në mënyr konkrete, as në takime e as në qështjet për të cilat ju shkruen në letra gjatë këtyre dy viteve gje që vazhdimisht na zvarriti punë me qka seriozisht e pengoj aktivitetin e përbashkët të KD të LRSSHJ dhe në këtë mënyr sabotoi unitetin e LRSSHJ si tërsij, përqka atij ija kemi tërhjek vrejtjen drejtpersedrejti. HM dhe SZ janë antarë të barabarët me të gjith antarët e KD të LRSSHJ ku e përfaqsojn OMLK e ma parme. Pra, të drejtat, obligimet dhe përgjegjsija e HM dhe SZ janë të barabarta me ato të Ukës dhe me të gjithë shokët tjer të KD. Pra, në të gjitha ato që nuk është përgjegj Uka, duhet të japin përgjegje HM dhe SZ me që kështu as të ndar e as të bashkuar nuk shkon.

Takimi që qëndron para neve kërkon përgjegjëje definitive se a jemi për ruejtjen e unitetit të LRSSHJ në bazë të vendimeve themeluese, apo jo? Përgjegjeja e Partis dhe LNÇKVSHJ së maparme ësht pozitive: Jemi për unitet të shëndosh në bazë të vendimeve themeluese të LRSSHJ dhe në këtë takim presim përgjegjeje definitive nga OMLK- e maparme.

Armiku e dëshiron shpërbërjen e LRSSHJ dhe në këtë është i ndihmuar nga veglat e tij. Andaj duhet të mendojmi se cili me kokën e vet sepse secili veqëeveqë jemi përgjegjës para LRSSHJ si tërsij, para popullit atëdheut dhe historijës.

Ne nuk kemi qka ti lem kohës, se po ja lëm kohës do të thot tija lam armikut që të shkretron LRSSHJ, andaj duhet përgjegjeje konkrete se, kush ësht për bashkim dhe kush esht kundër bashkimit në LRSSHJ. Ata që janë kundër bashkimit nuk mund të përfaqësojn as OMLK, PKMLSHJ dhe as LNÇKVSHJ (të maparme) por vetem vetveten, dhe si individ duhet të ndahen që mos ti mbeshtjillën nepër këmbë LRSSHJ. Kurse ata që duen të qendrojn të bashkuar në LRSSHJ duhet të afrohen e të bashkpunojn si vllezër e shokë lufte.

Ne e kemi të njohur se baza e OMLK- e plotsisht e ka perqafue bashkimin në LRSSHJ. Besojmi se HM dhe SZ janë për bashkim të shëndosh dhe se edhe në këtë takim dotë përgjigjen pozitivisht. Bile besojmi se edhe Uka ma në fund doti këthehet unitetit sepse ne e dijmi se të gjith ju ishit viktima të nji varg manipulimesh dhe intrigash të njifar

kërkushit – xhafer durmishit. Pra ne e kem të ditur edhe këte: Çe tani kur gjerat po dihen, nëse ju nuk përgjigjeni pozitivisht, atëherë për këtë ka përgjegjësij Uka, andaj edhe KD i LRSSHJ, i cili është i përcaktuar për një vrejtje zyrtare ndaj tij për gabimet e deritashme, në këtë situat dotë jetë i detyruer ti ashperson masat. Por, po e theksojm përserij se kemi besim se do të mirremi vesh së shpejt. Gjithashtu po theksojm se edhe nëse në vend të përgjegjejes pozitive nuk vjen përgjegjeja fare për një kohë të caktuar, do të konsiderohet se përgjegjeja është negative sepse situata nuk e lejon LRSSHJ të i zvarriten qështjet si deri me tani.

Sa i përket qendrimit tonë po e theksojm ate që e ka vërtetuar edhe praktika: Jemi ata që ju qëndrojm tër jeten besnik fjalve që i themi dhe shokve ua zgjasim dorën, me plot garancë e siguri themi se kurr nuk dotë devijojmi vijën e LRSSHJ dhe interesat e popullit e atëdheut.

Nga ju presim qëndrim dhe përgjegjeje vllëznore e revolucionare për sanim të shpejt të mardhanjeve, për pastrim të gjithshka që mes nesh futën provokatorët si xhaferi me band dhe për forcimin e unitetit e bashkpunim të denj.

Ju lutemi që t'na përgjigjeni përmes telefonit nëse pajtoheni për kohën që propozuem për takim. Nëse kjo datë nuk ju përgjigjet, të na caktoni kohën kur juve u përgjigjet, apo shkaqet pse nuk keni mundësij për takim. Në këtë rast na përgjigjeni me shkrim sepse kjo kërkohet nga shokët në këtë formë. Presim përgjegjëje urgjente.

Përshëndetje revolucionare/me autorizimin e shokëve të KD të LRSSHJ

20 Mai 1984 "Luani"

14. Letër e Abdullah Prapashticës (e dorëshkruar dhe nënshkruar nga Nuhi Sylejmani - Luani), **për Sabri Novosellën, 10 qershor 1984**

Antarve të KD (Degës së LRSSHJ "Vllëzrit Gërvalla")

Shoku Mërgim,

Letrën e fundit ta dërgova me 10 maj 1984 dhe pasi që kaloj nji muj e ca dhe përgjigjeje nuk erdhi, potë shkruaj këtë letër në të cilën parasëgjithash ju pyes për shendetin tuaj e të familjes dhe për të gjithë shokët atje. Njikohsisht po ju informoj se ne këtej jemi mirë – aq sa mund të jet njeriu në gurbet mirë.

Në gjysmën e vitit që po përfundon ngjarjet u zhvilluan me një shpejtësi dramatike dhe vërtet nuk ishte edhe leht ti përgjigjemi të gjitha kërkesve që paraqiteshin. Megjithate armikun jo vetëm që e detyruam të kaloj në defanziv, por edhe komplotët që i kishte ber për shpartallimin e LRSSHJ-ës e në të cilët i kishte vër tër shpresat e veta, i dështuan dhe po thuajse ka mbetun me gishta në gojë! Kjo nuk guxon aspak t'na sjell vetkënaqsij por vigjilenca duhet shtuar se bisha e plagosur do të përpiqet të bër edhe nji damë.

Ishte një situat e jashtzakonshëme edhe kjo ndikoj që gjatë shkruarjes së letrave të japim përgjegjeje sa ma të sakëta pa u kujdesur sa duhet për ashpërsijen e tonit me të cilin shkruhej. Besoj se kuptohemi dhe se nuk duhet të mirremi shumë me tonin e letrave por me vertetsijën e përgjegjejeve.

Kohve të fundit pata ma shumë kohë dhe edhe njiher i bera analiz lëtrat e fundit që mi dërgove dhe aty zbulova disa gjera aty që ma parë nuk i kisha vrejtur, më që edhe ti nga njiher i thue dy-tri mendime pa i shkëputur dhe pa i përfill rregullat drejtshkrimore nejse, pikat dhe presjet nuk janë me randsij me randsij është që të kuptohemi.

Në mes kohë këtu ndodhën disa gjera njëra pas tjetrës dhe ato kërkonin përgjegjeje urgjente andaj edhe vepruem në të vendimeve të 17.2.1982 dhe në bazë të parimeve të përgjithshme të LRSSHJ, me që nuk kishim kohë për konsultime të gjera.

Si e dinë edhe vetë qështja e Xhafer Durmishit gadise u përfundua me që ai ija vuri kulmin komploteve të veta keshtu që puntorët e revoltuar - pjestar të LRSSHJ, e ndoqën ashtu si e meritonte që moti. Tani ësht zhdukur në drejtim të pa njoftur dhe nuk është qudi që në bashkpunim me padronët e vet të kurdis donji goditje të re kundër LRSSHJ. Për këtë është i nevojshëm distancimi i juj e i gjith shokve të LNÇKVSHJ-së ma parme nga ky person.

Sa i përket teknikës së shtypshkronjës të organit të LRSSHJ u informova se nji nga makinat që patëm ble ne e me të cilën ka punua Sokoli, tani gjendet te Tafallari. U informova se Tafallari ësht emnue nga Uka – arkatar. Gjithashtu për mardhanjet në mes Ukës e Tafallarit u informova mirë. Teknika e shtypshkronjës së ZK ësht bler me ndjersen e klasës puntpre dhe për të duhet të vendos KD i LRSSHJ, e jo të manipulojn kushtedo e sitëdo me te.

Sa i përket qështjes së Ukës ti i the disa gjëra trishtuese të cilat duhet të verifikohen. Hetimet e KD të LRSSHJ tubuen fakte të mjaftueshme për veprimtarijen antilëvizje të Ukës, dhe atij do t'i bëhet vrejtja e fundit. Po që se nuk beri kthes pozitive edhe ai do të përfundoj atje ku përfundoj Xhafer Durmishi.

Edhe mbi qështjen e Ukës duhet të vendos KD i LRSSHJ-ës.

Në lidhje me ate që shtron ti me nxjerrjen e nji Organi të KD të LRSSHJ me emrin "ZK" unë bisedova edhe me shokët e Partijes dhe edhe ata janë të mendimit që nji veprim i këtill të të esht i arsyshem nëse Uka nuk ban kethes pozitive deri në fund të këtij gjashtmujori. Mendimi i neve të gjithve ësht që Organi i KD të LRSSHJ të del me emrin e rij "ZPK". Redaksija e "ZPK" kishte me qenë KD. LRSSHJ dhe ai kishte me u përmbajtur plotsisht vendimeve historike të themelimit të LRSSHJ. Para se të bëjmi këtë hap së pari duhet të bajmi konsolidimin e KD të LRSSHJ dhe që mardhanjet mbrenda tij të jen të shendosha që ai të ketë mundsij të veproj normalisht.

Pastaj, duhet të behet zyrtarisht shkarkimi SS nga KD dhe emrimi i shokut të rijë në KD të LRSSHJ. Pastaj ti edhe Uka duhet të bani autokritik për gabimet e deritanishme me qrast dotju shqiptohet vrejtja zyrtare dhe nëse Uka nuk banë këthes pozitive edhe ndaj tij dotë mirren masa si ndaj Skenderit. Me vendim zyrtar duhet të shkarkohet Uka nga redaksija e "ZK". Pastaj KD i LRSSHJ duhet të merr vendim mbi riorganizimin e "ZK" në "ZPK".

Mbi të gjitha qështjet tjera dotë mirremi vesh pas përgjegjejës tuaj në këto qështje aktuale. Tani për tani mund të them këtë se jemi të gatshëm të bashkpunojm në kuadër të mundsijve tona në çdo drejtim që i shërben unitetit të LRSSHJ dhe në drejtim të zbatimit të vendimeve historike të 17.2.1982.

Këtu nuk mund të shtrojmi problemin më gjërsisht. Kjo që u tha ësht e mjaftueshëme për nji piknisje të mbarë e ma von dotë takohemi dhe dotë bisedojm gjër e gjatë mbi të gjitha ose ketu ose atje te ju.

Në fund e theksoj se tani për tani ësht me randsij që të shuhen të gjitha përqarjet e grindjet, që radhët e LRSSHJ të bashkohen e të shëtërngohen e tju mbyllin rrugen të gjitha thashëthanave. Ky është kusht i fitores së luftës tonë. Ne duhet të mbështetemi vetëm në forcat tona kosovare, dhe si Kosova të mbështetemi fort njeri te tjetri sepse çdo rrugë tjetër ësht vetëm iluzion që qonë në dështime.

10 Qershor 1984 Të fala tye dhe shokve

"Luani"

15. Letër e Partisë Komuniste (PKMLSHJ - e nënshkruar nga Abdullah Prapashtica, Osman Osmani, Faton Topalli, Nuhi Sylejmani – Luani) dërguar Xhafer Durmishit-Skenderit, 13 shkurt 1985 – verzioni i parë, në adresën e Zërit të Kosovës që ka dalë në Suedi

Shokëve të LNÇKVSHJ 13 shkurt 1985

Në bazë të situatës aktuale dhe të kërkesave të masave për sanimin e marrëdhënieve në LRSSHJ, u drejtohemi me anën e kësaj letre përmes së cilës u ofrojmë edhe njëherë bashkëpunim dhe aktivitet të përbashkët duke u mbështetur në vendimet e 17 shkurtit 1982.

PKMLSHJ dhe LNÇKVSHJ si forca themeluese të LRSSHJ kanë përgjegjësinë historike për fatin e LRSSHJ. Andaj e shohim të arsyeshme që edhe njëherë t´i përtërijmë përpjekjet e sinqerta për mënjanimin e të gjitha pengesave përçarëse dhe të vazhdojmë luftën të bashkuar në LRSSHJ.

Të vetmin kusht që e shtrojmë është zbatimi i vendimeve të 17 shkurtit 82 në mënyrën më të përpiktë me forca të përbashkëta.

Njëkohësisht kërkojmë nga ju që t´i shtroni të gjitha vërejtjet tuaja në punën tonë nga bashkimi gjer më tani, dhe t´i jepni vlerësimet tuaja se si duhet gjykuar ato.

Jemi të gatshëm të përmirësojmë çdo lëshim që ka mundur të ndodhë gjatë aktivitetit tonë, të japim autokritikë dhe përgjegjësi konkrete, ashtu siç do t´i kërkojmë këto edhe nga të tjerët.

Kritizimet e pavenda do t´i luftojmë, ashtu siç do të jemi këmbëngulës në zbatimin e përcaktimeve themelore për çështje të atdheut.

Përgjigje në letër presim gjer më 15 mars 1985.

Përfaqësuesit e PKMLSHJ në LRSSHJ

Letra ka 5 nënshkrime tri prej të cilëve janë: Kushtrimi (Kushtrim Kosova), Halimi, Qemali. Të tretë pjesëmarrës të bisedimeve më 17 shkurt 82. Në mesin e të nënshkruarëve është edhe Luani i Partisë "Komuniste" Nuhi Sylejmani.

16.Letër e Partisë Komuniste (PKMLSHJ - nga Abdullah Prapashtica, Osman Osmani, Faton Topalli, Nuhi Sylejmani - Luani) dërguar Xhafer Durmishit-Skenderit, 13 shkurt 1985 – verzioni i dytë, në adresën e Zërit të Kosovës që ka dalë në Suedi

Letra e dytë

Shokë të OMLK dhe LNÇKVSHJ

Pasi që në letrën tonë të afatizuar të 13 shkurtit nuk na erdhën përgjigjet nga ju, po e përshkruajmë tërësisht edhe njëherë përmbajtjen e kësaj letre dhe në përfundimin e saj do të bëjmë një shtojcë tjetër.

(përmbajtja e letrës tonë të 13 shkurtit 1985)

Shokë (të OMLK – të LNÇKVSHJ) 13.II.1985

Në bazë të situatës aktuale dhe të kërkesave të masave për sanimin e marrëdhënieve në LRSSHJ, u drejtohemi me anën e kësaj letre përmes së cilës u ofrojmë edhe njëherë bashkëpunim dhe aktivitet të përbashkët duke u mbështetur në vendimet e 17 shkurtit 1982.

PKMLSHJ, LNÇKVSHJ dhe OMLK, më pas, si forca themeluese të LRSSHJ kanë përgjegjësinë historike për fatin e LRSSHJ. Andaj e shofim të arsyeshme që edhe

njëherë t´i përtrijmë përpjekjet e sinqerta për mënjanimin e të gjitha pengesave përçarëse dhe të e vazhdojmë luftën të bashkuar në LRSSHJ.

Të vetmin kusht që e shtrojmë është zbatimi i vendimeve të 17 shkurtit 82 në mënyrën më të përpikët me forca të përbashkëta.

Njëkohësisht kërkojmë nga ju që t´i shtroni të gjitha vërejtjet tuaja në punën tonë nga bashkimi gjer më tani, dhe t´i jepni vlerësimet tuaja se si duhet gjykuar ato.

Jemi të gatshëm të përmirësojmë çdo lëshim që ka mundur të ndodhë gjatë aktivitetit tonë, të japim autokritikë dhe përgjegjësi konkrete, ashtu siç do t´i kërkojmë këto edhe nga të tjerët.

Kritizimet e pavenda do t´i luftojmë, ashtu siç do të jemi këmbëngulës në zbatimin e përcaktimeve themelore për çështje të atdheut.

Përgjigje në letër presim gjer më 15 mars 1985.

Përfaqësuesit e PKMLSHJ në LRSSHJ

(fund i letrës së 13 shkurtit 1985)

Shokë,

Pas letrës së 13 shkurtit 1985 erdhëm dy herë në… dhe në rastin e parë u takuam me… ndërsa në rastin e dytë u takuam me shokun… Me këta shokë biseduam afërsisht dhe në mes neve pati një mirëkuptim vëllazëror. Megjithate ata nuk patën mundësi që të na përgjigjen për çështjet që u shtruam ne pasi ata deklaruan se nuk kanë kompetenca për përfaqësim. Mirëpo ne bisedum gjërësisht e shoqërishtë me ata dhe të gjithë i shprehëm mendimet tona duke u pajtuar me faktin se sanimi i marrëdhënieve dhe arritja e forcimi i unitetit janë të domosdoshme. Shoku… pos të tjerash i shprehu disa ide të veta mbi rrugën deri te ky qëllim, dhe ne pranë asaj që i paraqitëm qëndrimet tona të palëkundshme se do të qëndrojmë pranë Vendimeve Themeluese të bashkimit të LRSSHJ i premtuam se në ato ide do të përgjigjemi pas konsultimeve me shokët e bazës. Përgjigja jonë si tërësi është që para së gjithash çdo gjë duhet të fillohet nga vendimet e 17.II.1982 që ishin dhe mbesin kushte themeluese të bashkimit të LRSSHJ dhe që nga këto baza pastaj ka mundësi të bëhen edhe plotësime e ndryshime tjera. Edhe biseda që u zhvillua me shokun… ishte e frytshme, dhe ajo burrëri e tij dhe qëndrimi i tij se duhet të vazhdohet me zbatimin e vijës së LRSSHJ sipas vendimeve themeluese të bashkimit, na inkurajoi në rrugën tonë që të arrihet uniteti i plotë.

Ju komunikojmë edhe njëherë se qëndrojmi para asaj që u tha edhe në letrën e 17.II.1985, dhe nga ju kërkojmi që sa më parë të na paraqitni përfaqësuesit kompetent të OMLK e LNÇKVSHJ të mëparshme që sa më shpejt që është e mundur të bëjmi një takim. Edhe në bisedat që i patëm me shokët që i cekëm kemi theksuar dhe po ju lusim edhe njëherë që në mesin e atyre që do të ju përfaqësojnë të mos jenë ata që deri më tani penguan bashkimin dhe që shkaktuan përçarjet, që ishin zbatues të komploteve, që kanë bërë veprime antiparti e antilëvizje dhe ata që kanë patur çfarëdo kontakti me reaksionin e vjetër ballisto-ustash. Sepse ata që kanë punuar kundër bashkimit dhe që janë kundër tij, sigurisht që këtë rrugë do ta vazhdojnë.

Presim përgjigje me shkrim gjatë muajit Qershor.

shokët e PKMLSHJ

(Shënim i Xh. D.-Skenderi: Letrat – të pikave 7 e 8 të këtij punimi – i kam botuar e gjithashtu iu kam përgjegj publikisht në gazetë, në të njëjtin numër, në numrin e fundit të Zërit të Kosovës, që ka dalë në korrik-gusht 1985, në Suedi. Teksti i plotë përgjigjes sime është ribotuar në librin tim “Protesta e Aspirata”-2006- dhe mund të lexohet në internet).

LETRA NGA HAFIZ GAGICA

1. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skënderin, verë 1982
2. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 13 dhjetor 1982
3. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 22 dhjetor 1982
4. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 28 dhjetor 1982
5. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 31 dhjetor 1982
6. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, janar 1983
7. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, maj 1984
8. Letër nga shokët e Ludvigsburgut për Xhafer Durmishin-Skenderin, 23 gusht 1984
9. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 17 shtator 1984
10. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skënderin, 20 shtator 1984
11. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 26 tetor 1984
12. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 8 nëntor 1984
13. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 28 nëntor 1984
14. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 29 dhjetor 1984
15. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, fillimi i janarit 1985
16. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 29 janar 1985
17. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, shkurt 1985
18. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 16 shkurt 1985
19. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 8 mars 1985
20. Letër nga Hafiz Gagica për shokët e Shtutgartit, 1 prill 1985

Me Hafiz Gagicën jam takuar për herë të parë në verën e vitit 1981 në shtëpinë e Vëllezërve Gërvalla në Untergruppenbach.

1. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, verë 1982

I dashuri shok Skënder,

Ja që tani është hera e parë që këmbehemi me letra. Që në fillim po ju pyes si jeni me shëndet, me punë si i ke hallet, a e ke gati me e krye apo jo.

Tash po të tregoj se unë u detyrova të kthehem prej Hamburgu për shkak se atje nalt ishte vështirsue për të huaj. Shkuarja jonë nalt thuajse në anën tjetër ishte e suksesshme. Ne u takuam me shumë punëtor, njashtu me Isakun (Isak Gutajn) u takuam dhe biseduam për shumë punë. Më në fund u ndanë shumë të kënaqun me shkuarjen tonë atje për shkak se pothuajse kishin qenë të shpërndamë në tri grupe. Provuan që disa të gjejnë një gjuhë me ta, që mos të udhëheq Isaku, por ne jau përmbysëm të gjitha leqet. Jau lam edhe kasetën për video. Tash e kishin ble edhe një video më tregoj Naimi (Haradinaj). Kasetën për në Berlin ia lash Isakut me jau que dhe e njoftova me kend të

ketë punë në Berlin për shkak se më parë tha i kam do shokë atje dhe kishte qenë në klub shpeshherë. Atëherë mendova se më mirë, se edhe ju ba qejfi se kishte pak qejf të lavdohet por edhe ishte punëtor. Bisedova me te edhe në lidhje me Bashkësinë e klubeve. Sipas fjalës së tij ai më tha se kishte qenë iniciator me Hyzri Rekën për Bashkësinë e Klubeve, por për Hyzriun nuk më foli mirë kurse për të tjerët kishte respekt. Biseduam edhe në lidhje me Ibrahimin (Kelmendin), ku e ceka edhe më lartë se ishin kanë ba tri grupe. Ibrahimi më parë kishte shkua shpesh jo për të organizua, por në të kundërtën duke i shty njenin për (kundër) tjetrit dhe Isaku nuk kishte mendim të mirë për te, njashtu si edhe katër shokët e tij të rrethit të ngushtë. (Isaku) më tregoj se e ka përgatitë Statutin për Bashkësinë e Klubeve, por më tha se nuk di ku qëndron pengimi për Bashkësinë e Klubeve. Ma tregoj edhe Statutin që t'ja jap një mendim për te se a asht i nivelit, por unë i thash se ne nuk jemi të ftuem për Bashkësinë e Klubeve dhe nuk di çka të them por më në fund e mora. I thash se do ta shikoj me shokë. Më tha që mos ta din njeri i gjallë që e kam ba unë këtë statut. I premtova se jo, por unë e mora me një mendim që ta marrësh ti dhe ta kontrollosh dhe nëse don ose si u desh, në shumë pika të heqësh apo të shtosh. Vetëm me një kusht që të mos ta qojsh ma lartë apo t'i tregosh kujt.

Ti ndoshta mundesh të thuash se përse ke bisedue vetëm por ashtu i erdh rasti, që unë dola në qytet për telefon, atëherë ai ishte me mue, por u takua edhe me atë shokun e vetë të ngushtë dhe u ulëm në një kafé dhe patëm një bisedë të lirë. Por aty u folë, në lidhje me Demë Demajn e Nagoldit (nga një) që ishte fshatar i tij dhe tregoj Isaku që ka dashtë të merr një kontakt me te. Atëherë i tregova për Demën si është... por nuk i thash se jam diku afër apo i organizuar. I tregova edhe për Ibrahimin se pse është largua (përjashtue) prej shtëpie se ata naltë kishin mendue se Ibrahimi ka qenë shoku më i afërt i Isufit dhe ai është dashtë me e marrë punën e Jusufit, por thanë se kan ndëgjue që Suzana ja ka lanë Skënderit.

Unë i thash se me siguri Isufi ka pasë shokë para Ibrahimit dhe ajo nuk ka mujt me vendosë por atë e kanë bërë shokët e tij. I thash se ka qenë në të pame dhe kam dëgjue prej punëtorëve se Ibrahimi ka sjellje shumë të këqija, jo morale. Ata veç shumë sende i dishin por në fund pothuajse si u duk i vërtetojshin se dy shokë të Isak Gutajt ishin shumë të idhët në Ibrahimin. Por edhe rreth teje biseduem. Thanë pse me ardhë Skenderi në Dusseldorf e me përhap se kush ka punua e kush jo, por përse mos me marrë vendim nëse është me e largue, përse me e lanë me dalë e me udhëheq demonstrata. Unë u thash se edhe unë ka ndëgjua për atë takim në Dusseldorf, por nuk është kanë i thirrun por i rastësishëm, dhe për ato që i janë thënë Ibrahimit, ai (I.K.) e ka kërkua me ja thënë.

Skënder, këtë letër që po e shkruaj jam në tren prej Manheimit për Shtutgart, ndoshta ke vështirësi me e lexue, por besoj se kuptimin ia nxjerr. Unë isha në Zvicër javën e kaluar me Nami Ramadanin. Mirë kaluam shumë. Isha te ata shokët edhe te dhandrri bujta një natë. Një natë u takova edhe me Shaqën (Shaqir Shabanin). Ishim në një klub se ishte zgjedhja e udhëheqësisë së klubit dhe kaluem mirë. Por Skender po të pyes megjithëse kemi biseduar edhe më parë, a mos ka ndryshue diçka. Tubimet që bëhen në salla me shfaqjen e filmave, a e dëmtojnë kërkesën për Republikë. Fotografitë e vëllezërve dhe parulla Kosova-Republikë, se ata shokët e kishin marrë videon që një muaj dhe kishin pas fillue si ju kemi thënë; nëpër banesa, ashtu si ne, por i kishin sulmue shokët e Hasanit. Atëherë kishin vendos në salla por fotografitë dhe parullën s'jua kishin lejua.

Për këto shkruaje një letër e mos prito dhe mos e ba të madhe bisedën që e kam bërë me Isakun, se për Statut nuk i kam treguar as Naim (Haradinajt), (me të cilin kam folë) vetëm për biseda por për statutin i thash se s'ja kam marrë. Ndoshta kam gabue, por më trego, shkruaje një letër menjëherë te Faridini dhe ai ma dërgon mue.

Tash po të tregoj për punën momentale të strehimit. Unë isha edhe në Manheim. U takova me Gëzimin por nuk e paraqita kërkesën se nuk e kisha atë avokatin. Nuk bëni pa ja que paratë dhe kërkonte një përkthyes. Atëherë u detyrova me shkue tek Pjetri në Fellbach. Më priti shumë mirë dhe më tha shko e merri të gjitha aktet tek avokati. Atëherë shkova dhe i mora dhe të hanen kemi me ba kërkesën. Më premtoi se shumë shpejt kemi me e ba me do kroat tjerë të kishave. Tash prano të fala zemërore.

Shkruaje një letër.

2. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 13 dhjetor 1982

I dashuri shoku Skender 13 dhjetor 1982

Që në fillim desha t'ju pyes si jeni me shëndet, me punë si po kalon, njashtu me strehim a vendose ende diç apo jo, edhe pse më kishe shkrue se ndoshta do të bëhet më shpejt. Shumë mirë është nëse vendoseni sa më shpejt pa marrë parasysh se ku, që të mos jemi në ajër.

S. që në fillim po e ceki se kishe bërë mirë që e kishe shkrua këtë letër. Ndoshta unë herën e parë jam ngutë që ta shkrova ashtu por, ne po ngutemi thuaja se të gjithë. S. edhe pse e dij se të ka lajmërua Faridini për demonstratë (të 10 dhjetorit 1982 në Gjenevë - shën. i Xh. D.) desha edhe unë të shkruej se më të vërtetë ishte shumë mirë gjë që ne prej anën tonë nuk e kemi pritë atë rezultat, gjë që prej neve ishin në autobus 32 veta gjë që shifet se vetëm masa e ka kuptue të vërtetën ku e kishe cekë edhe ti në letër, edhe pse propaganda e tyne po vazhdon ende me të madhe por me atë vetëm vetveten po e demaskojnë, se neve asgjë nuk kanë çka të na bëjnë.

S. (Skender) të ka lajmërua F. (Faridini) dhe për atë arsye nuk po zgjerohem shumë në lidhje me demonstratën, se kemi për të tjera çka të shkruajmë, vetëm po e ceki se në Gjenevë me të vërtetë ishte shumë mirë, njashtu edhe numri i demonstruesve ishte i madh, megjithëse ne nuk mundemi të kënaqemi me atë çka kemi arritë deri më tani. Ne në Gjenevë u takuam me atë shokun (Xhafer Shatrin - shën. i Xh. D.) pa nuk ia di emrin, por ti e kupton se me kend. Unë dhe Haxhiu (Berisha) biseduam nja pesë minuta në lidhje me Nuhiun dhe qëndrimin tonë dhe ne pajtohemi plotësisht me atë çka thoni dhe ju. Unë siç e ceka më lartë jemi shumë të kënqaur me rastin e Gjenevës, njashtu na gëzon rasti që patëm rast të takohemi me atë shokun edhe pse ishte një kohë shumë e shkurtër.

Skender, unë kam bisedue me Nezirin dhe për atë çka më ke porositë po t'i dërgojë menjëherë në postë dhe këqyri vetë se prej kujt janë dhe çka janë këto përralla. Për atë se kah ju kanë ardhë dhe kush i ka shpërnda do të ma dorëzon një letër dhe atë do ta postoj menjëherë. Njashtu tek Kola kemi qenë un, Faridini dhe Haxhiu. Tek ta pak a shumë vetëm tek Kolë Mërturi ka ndikue, se ai është pak tepër i besuem se të tjerët, se kishin qenë Hasan (Veselaj) dhe Sahit (Tofaj), një natë më 1 dhjetor dhe ishin mundue mjaft me shpif gjana të pavërteta, por ato nuk kishin nxanë vend te ta. Kolë Paloka me të tjerët, bile u ka thënë se për kso punë mos më ejani më, se unë ju kam pranue në emër të shokëve se për ndryshe unë s'ju njof.

Skender, siç e kishe cek edhe ti për vendosjen e kontakteve me rrethet tjera, unë kam pasë ndërmend të shkruaj për këtë gjë që ta shqyrtosh edhe me shokë, se ne mendojmë sa i përket këtu në Gjermani, është më se e domosdoshme që të vendosim që të kemi takime sa më të shpeshta në mes disa pikave si p.sh. Dusseldorf, Bielefeld, Hamburg dhe ne t'i shqyrtojmë këto punë.

Skender, po të njoftoj se Isaku (Gutaj) ishte këtu tek unë tri ditë, pasi që ishte nisë të shkonte për demonstratë në Zvicër dhe s'e kishin lejue me shkue, u kthye këtu dhe të dielen në mëngjes shkoi. Bisedova me te në disa pika, ku pjesërisht gjatë diskutimit muer pjesë edhe Haxhiu (Haxhi Berisha). Vetëm ne një pikë ai (Isaku) nuk deshti ta ta dinë

dikush tjetër. Tha due vetëm unë dhe ti të bisedojmë dhe Skenderit ia përcjellë apo kujt ta dish. Unë i thash që ai të drejtohet drejt për së drejti në redaksi (të Zërit të Kosovës në Biel-Biene- shën i Xh. D.), por ai nuk deshti ashtu. Ai tha se unë kam fillue tash disa biseda në mes meje e teje dhe nuk dua të përzihna me shumë njerëz. Unë ia ceka se Skenderi do ta dërgon një letër pasi e pashë vetë të arsyeshme që ti t'i shkruajsh një letër, por bëjë si ta pash prapë vetë të arsyeshme, ose më trego se çfarë qëndrimi me mbajtë me te, se tek ai shihet se është një punëtor i palodhun dhe se ka nevojë për këshillime ende, por po të tregoj për këtë njeri ka pak qejf të lavdohet dhe ta dinë dikush se ai është organizator në Hamburg, por vetëm një tjetër e ka shumë të keqe, që frikësohet pa masë. Ai përveç statutit më ka pyetë shumë herë se pse nuk po realizohet dhe kush po e pengon, ma pruni edhe këtë trakt që të pyes se a bën ta shpërndaj apo jo, dhe më pyeti se a bënë me e postue për Kosovë, nëpër shkolla dhe Komitete (komunale) të ndryshme. Unë i thash dërgoje në redaksi, por ai nuk pranoj, dhe kërkoj që nëpërmes neve të kryhet kjo punë dhe të tjerat.

Për statut i thash edhe unë ashtu si ti më pate shkrua, për fat të mirë nuk kisha gabue dhe i thash se njëherë këtë punë me sa di unë shokët nuk e kanë pa të arsyeshme. Por Skender unë e kisha vetëm një propozim, pasi po shifet se ai po ka qejf dikush që është duke punue, unë jam i mendimit që këtë trakt t'ia kishit lejua, por veproni prapë se prapë si të jetë e arsyeshme. Por, unë Skender, mendova se pasi qe dy herë e ka shtrua këtë propozim dhe është mundua në këtë drejtim, (është mirë) t'ia lejoni këtë trakt megjithëse ka shumë me hjek prej tij dhe me shtue, por ti mundesh me e krye aq punë, (dhe) nëse bën ktheje këtë përgjigje sa më shpejt që t'i lajmërohem atij, se më ka thënë brenda kësaj jave të më lajmërohesh.

Skender, me Bielefeldin është bërë një punë shumë e mirë që keni marrë kontakte, se unë po bisedoj shpesh në telefon me Xhavit (Ramabajën), njashtu ua kam que qekun (e xhirollogarisë "Ndihma për Kosovën" në Biel-Bienne - shën. i Xh. D.) që ta shumëzojnë për ndihma dhe ata menjëherë do të marrin një aksion. Njashtu me Dusseldorfin shifet se punë është shumë mirë, edhe pse disa shkatraq po mundohen edhe atje të na dëmtojnë por kot e kanë.

Skender, më 12 dhjetor u takuam me shokë dhe biseduam për Hallë (Hallë për tubim pas që do të bëhej pas demonstratës rreth 17 janarit 1982 në Shtutgart - shën i Xh. D.). Ne vendosëm që për nder të përkujtimit të vëllezërve të përgatisim një dramë, por prapë se prapë nuk dimë a ke kohë me e përgatitë apo jo. Ne vendosëm që të jetë kështu; për Lëvizjen (në një anë) dhe armiqtë dhe tradhtarët (në anën tjetër) në disa pika të shkurta prej katër pesë vetëve (roleve) dhe kemi vendosë me e përgatitë. Nëse e përgatisim tekstin ti prapë shiko dhe nëse mundesh na e dërgo gjer të shtunën, se të shtunën kemi me u takue.

Skender, sa na përket neve, ne endi jemi kështu. Nuk jemi vendosë se nuk ka mundësi njëherit, tash Haxhi (Berisha) pret gjykimin më të 16 (dhjetor 1982). Më datën 19 më duhet të dalë prej Gjermanie. Duhet paguar avokatin, e kështu probleme sa të duash. Unë njëherë gjendem te babai por këto ditë më vjen shoqja dhe atëherë nuk di se çka bëjë hiq. As jam që të shkoj në kamp, e as që të rri kështu.

Skender, ndoshta e zgjata shumë por ta dish se tani është ora 1.30 pas gjysmës së natës dhe mund të ketë gabime (drejtshkrimore), por ti ia nxjerrë kuptimin. Prapë më falë se ndoshta të kam pengue, por do të përmirësohem, siç e kishe cek edhe ti vetë, se ne duhet të mësohemi të shkruajmë. Vetëm kemi fillue që në shumë drejtime të merremi me letra, se me të vërtetë me telefon nuk po ipet hall. Skender tani prano të fala vëllazërore dhe mos u mërzit dhe shiko e vendosu sa më shpejt nëse ke mundësi.

Nëse bën, ma dërgon qatë adresën që të shkruaj drejt për së drejti për ndonjë pyetje më urgjente, si p.sh. me Isakun, etj., se kështu mund të ketë vonime.

3. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 22 dhjetor 1982

Shoku Skender,

Letrën tënde e mora para tri dite, por për shkak të kohës që nuk më premtoj nuk munda menjëherë të ju lajmërohem. Që në fillim të njoftoj për Isakun, që kishe pyet se çfarë shkolle ka të kryer dhe sa kohë është në Gjermani.

Isaku, sipas të dhënave të veta, për pa e pyet, ne kur ishim në Hamburg na njoftoj se prej vitit 1979-1980 është në Gjermani, i papunë, e ka paraqitë kërkesën për strehim por pasaportin jugosllav e ka vetëm si duldung, e ka një letër që e ka paraqitë strehimin. Jeton prej ndihmës së shtetit gjerman, është prej rrethit të Ferizajit, e ka Shkollën e Lartë Pedagogjike të kryer, ka punuar dy vite në arsim, sipas të dhënave të tij në vitin 1974 diku përafërsisht është dalë në Çekosllovaki, ku ka studiua për kameraman apo si regjisor filmash. Thotë se i ka përgatitë tri drama, dhe një film si dhe ka punua në drejtim të rezhisë së Mojsiut etj. Që në fillim të ardhjes në Gjermani është njoft me Ibrahim (Kelmendin) dhe ka pasë një kontakt edhe me Hysen Gegën. Në vitin 1980 ka qenë tek Jusufi me Hysenin (Gegën) në Ludvigsburg.

Skender, sa për atë traktin që kishe shkrue se nuk bën të shpërndahet, me të vërtetë të pata shkrue edhe unë që nuk ishte për me e shpërnda por mendova se ti do të ndryshosh diçka në te dhe ta shqyrtosh vet ti por ajo punë ka marrë fund dhe nuk kemi çka të bisedojmë rreth traktit. Unë ia dërgova (Isak Gutajt) një letër njashtu edhe letrën tënde. Unë i shkrova për Zërin, se për sa (ekzemplarë) ka nevojë rrethi i tij, që në të ardhmen. Skender, sa i përket Kolë Palokajt, ndoshta të ka treguar edhe Faridini se me të vërtetë tash në kohën e fundit është kah tregohet shumë aktiv. Për Zërin (revistën) që kishte pyet, e ka vlerësuar dhe e ka pëlqye shumë. Sa i përket ndihmave ishte edhe Faridini atë mbrëmje kur e ceku, se tek unë pa marrë parasysh nuk mund të ndikon askush. Në dasmë (demonstratë) ishte Kolë Paloka dhe Jusufi se të tjerët nuk i lejoi firma. Njashtu edhe Kolë Mërturi e ka pa se ndoshta është mashtrue në besimin që e kishte pas marrë tek Hasan (Veseli) dhe Sahit (Tofaj). Isha të premten e kaluar, se kanë shkuar në shtëpi (Kosovë). Më kishin pasë thirrë te Faridini që të shkoj. Unë besoj se tek ta nuk ka dyshim fare dhe do të na ndihmojnë sipas mundësive.

Skender, Haxhiu me Zeq. ka kontaktue pasi është kthyer prej shtëpie (Kosove) por sa më tepër po gjendet në shtëpi (Kosovë). Me Muhametin njashtu ka kontaktue por po rren shumë dhe s'ka prej tij asgjë.

Skender, tash desha të dij se a je vendosë ende apo jo. Edhe nëse vendosesh në ndonjë banesë private shiko e mos e qo në banesë composerin (IBM Electronic Selectric Composer -shën i Xh. D.) Se ndoshta të ka treguar Faridini, se tek Namiu e kanë kërkuar ata të fortit e këtuhit composerin. E ndodh që pasi ta paraqitësh kërkesën të të kontrollojnë në banesë. Por unë mendojnë që njëherë në këtë situatë më mirë le të rrinë aty ku e ke.

Sa më përket mua, unë ende nuk kam bërë asgjë në këtë drejtim. Tash më kanë ardhë dhe familja dhe nuk po dijë se si t'ia bëjë fare. Të shkoj me grua në kamp s'po muj me shkua, se po të isha vetëm do të shkoja, por me grua nuk po më shkohet. Momentalisht gjendem tek baba për disa ditë pasi më ka ardhë edhe nëna por edhe këtu është rrezik me banue. Haxhi (Berisha) është shkuar në Zvicër te një banesë e një shokut gjer pas vitit të ri.

Skënder, kësaj radhe po e përfundoj me kaq këtë letër. Tani prano të fala të përzemërta, njashtu ke të fala edhe nga baba dhe të familja.

(Vazhdimi i letrës)

Skender, pas pak çastesh që pushova më ra në mend dhe thash të të pyes, pasi që është vendosë që më 15 janar 1983 të ketë dasmës (demonstratë me rastin e njëvjetorit të atentatit të 17 janarit 1982 - shën i Xh. D.) në Shtutgart, ne duhet që nëpërmes Komitetit Gjerman të marrin lejen, por si thua ti, a të marrin ndonjë kontakt para se t'ju thomë për leje, se unë para dy muajve e pata takue Joachim Röhm-in dhe ai është sjell shumë keq. Më tha si po shifet s'keni bindje politike. Më tha ne ua lejuam zyrën e punës, ju ikët dhe nuk na treguat fare që shkuam njashtu çelësin nuk na e keni pru një kohë të gjatë. Unë me të vërtetë u preka shumë që nuk kisha si të arsyetohem se nuk disha si ka qenë puna e çelësit, gjersa më tregoj Haxhiu. Vetëm ti ka qenë dashtë Skender me ju lajmërua që po shkoj. Për këtë më shkruaj.

Skender Njashtu e kisha një propozim për ty që t'i shkruajsh Mejdi (Rexhës) një letër nëpërmes Faridinit që ta udhëzosh që të konsultohet me Faridinin për të gjitha punët. Njashtu Remzi Ademit ia shkruan një letër, se sa vërejta unë ishte prekun që nuk ju ke lajmërue fare.

Mirë u pafshim H.G.

4. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 28 dhjetor 1982

Shoku Skender,

Këtë letër po ta shkruaj pa marrë përgjigje prej teje, megjithëse nuk e di a e ke marrë letrën time apo jo. Që në fillim po të njoftoj se unë isha te komunistët gjerman. Bisedova me Röhm dhe Lotën për leje të protestës. Ata më thanë se kërkesën për leje të protestës duhet dikush prej neve ta paraqes, së bashku me një gjerman. Njashtu nëse ke përgatitë traktin Skender, Röhmi më tha se ua përkthej dhe shumëzoj. Për sallë jemi kah kërkojmë qe dy ditë me Naimiun. Edhe pse është shumë vështirë të gjendet besoj se brenda këtyre dy-tri ditëve do ta gjejmë. Vetëm nëse duhet trakti në gjuhën gjermane të përkthehet dhe të shumëzohet nga ana jonë, atëherë duhet të na e qoni sa më shpejt. Për kërkesë unë mendova që ta paraqet Remzi (Ademi), me një komunist gjerman, pasi që duhet menjëherë pas vitit të ri të paraqitet kërkesa.

Kësaj radhe kaq. Vetëm të kisha propozua që të dilsh këndej para demonstrate.

Tani prano të fala nga Hafizi.

Skender, dje s'munda me e hedhë letrën në postë, por po të tregoj se dje e morëm në mbramje një sallë, 300 DM në Shtutgart, është për 400 veta.

Tani prano të fala.

5. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 31 dhjetor 1982

Shoku Skender, sot e mora letrën tënde dhe e mora vesh krejt se çka kishi shkrue. Vetëm sa i përket protestës që do të mbahet ne kemi bisedue dhe atë ditë në Gjenevë dhe ne e kemi pa të arsyeshme që të mbahet një protestë, dhe atëherë vendosëm që ta mbajmë me një numër sa më të madh. Unë isha te gjermanët edhe pse ti kishe thënë që të mos ngutemi, por Faridini që është marrë në telefon me atë shokun (Xhafer Shatrin - shën i Xh. D.) që të jetë e sigurtë për leje, atëherë u deshtë doemos të ngutemi në këtë drejtim që edhe sallën e siguruem së është bërë kogja vështirë me gjetë salla për këtë sezonë. Skender, unë besoj se do të ketë efekt të madh edhe kjo protestë. Ne mundësisht do ta kërkojmë lejen gjer te konzullata (jugosllave) por mvaret. Ndoshta do të ketë pengesa me leje. Të kam shkrue edhe një letër tjetër që kësaj here duhet dikush prej radhëve tona ta paraqes kërkesën. Unë po e pres Remzi Ademin se a po pranon ta paraqet kërkesën. Unë i shkrova një letër që është e domosdoshme që dikush prej neve ta paraqet kërkesën, por

nuk e di se a do ta merr ai apo jo. Ende nuk kam marrë përgjegje prej tij, vetëm prapë se prapë kësaj radhe besoj se nuk do të ketë problem.

Skender, ne vendosëm me Faridinin për atë se si do të shkoj protesta. Vetëm ta kesh të qartë se duhet të vish edhe ti kësaj radhe e mos ja bën si në Gjenevë. Duhet të lexohen më se katër referate në gjuhën shqipe dhe një në gjuhën gjermane. Për gjuhën gjermane vendosëm që ta lexon Ibrahim Kelmendi dhe rrugës të flet me megafon në gjuhën gjermane, kurse në sallë I. K. të mos duket fare. Në gjuhën shqipe në protestë ta lexon dikush prej Zvicre, kurse te varret ta lexon Naimi. Në sallë ta lexojnë një Bulja pasi është edhe propozim prej Zvicre, kurse fjalën e hyrjes së programit dhe një referat ta lexosh në sallë, konkretisht të ligjërosh (ta mbajsh një ligjëratë), se është e domosdoshme dhe t'ia dhësh fjalën atij shokut (Xhafer Shatrit-shën i Xh. D.) që të flet edhe ai në sallë. Kjo që të vish dhe të flasish në sallë është më se e domosdoshme, e jo t'ia bën si në 28 Nëntorin, ne të tham dil folë e ti heshte, njashtu nuk erdhe edhe në Gjenevë. Kësaj radhe përgatitu.

Për Ibrahim Kelmendin, vendosëm që ta lexon referatin vetëm për shkak se rrethet tjera po flasin se Shtutgarti e kanë demaskue Ibrahimin, dhe të mos thonë se ja këtu në Shtutgart Ibrahimi nuk u duk fare, kurse në Gjenevë foli gjatë demonstratës dhe njashtu i pruni të falat nga Amerika. Vetëm për këtë e pamë të arsyeshme.

Tani s'po di çka të shkruaj, vetëm kishe bërë mirë që ishte rregullue. Mos e qitë në harresë e të mos vish në protestë. Vetëm ta kesh parasysh se të përgatitesh mirë, se nëse nuk flet mos eja hiq? Tani Skender prano të fala të përzemërta nga Hafizi.

6. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, janar 1983

Shoku Skender, edhe pse e mora letrën tuaj me vonesë dhe pa përgjegje të letrës sime të mëparshme, prapë se prapë detyrohem të ju lajmërohem. Unë e mora një letër prej teje që e kishe dërguar përmes Faridinit. Për ato porosi që i ke dërguar, unë mundohem që si të tjerat dhe radhave të tjera, edhe kësaj radhe do të mundohem dhe i besoj vetes se gjer në vdekje do të jem besnik i idealit, që na lanë shokët si trashëgim.

Skender, në letër që më kishi bërë pyetje për rregullim, ende nuk jam rregullue. Përmes Kolës dhe Pjetër (Mjedës) nuk pata sukses se Pjetri më dërgoi tek disa kroatë por në mes tyre nuk kishte asgjë, tash detyrohem që doemos të shkoj në kamp, por para se të shkoj në kamp po e pres shoqen që të vjen prej shtëpie (Kosove) që kërkesën ta paraqesim së bashku. Këto ditë pres që shoqja të më vjen. Për babën që më kishi pyet mirë është, në shtëpi nuk ka qenë, as nuk po guxon të shkoj tash. E ka marrë pushimin gjer më 31 janar 1983. Njashtu edhe Fejzia mirë është. Në të vërtetë edhe për banesë baba e ka marrë atë banesën që e ka gjetë tek stacioni dhe unë tash momentalisht jam këtu, dhe mirë po e qojmë.

Skender, për Nexhatin (Osman Osmanin, vëzhguesin e Partisë "Komuniste" - PKMLSHJ -shën i Xh. D.) që kishe pyet, nuk e kemi pa dhe nuk dimë fare se ku gjendet, e për këtë tjetrin të ka njoftue Faridini më gjerësisht. Kështuqë unë nuk po zgjatem shumë se ndoshta po bëhet shumë dhe nuk di a ke kohë me e lexua se edhe në letrën tjetër kështu kam shkrue por nuk e di se a e ke lexua hiq a jo, se fare nuk kishe shkrua për atë letër megjithëse të kam pas pyet në atë letër kogja shumë.

Skender, sa i përket punës së Hasan (Veselit) dhe Sahit (Tofajt) ke mund vetë ta vërejsh atë natë aty edhe pse kishe shkrue se Hasani është dëshërue, unë nuk po mundem me e kuptue as njenin, bile atë natë unë jam nda keq me sjelljet e tyre, se shumë janë mundue që të propagandojnë, e për Qazimin mirë kishe thanë, se kemi bisedue edhe me Haxhi (Berishën) dhe është kanë Haxhiu dhe e ka thirrë në punë dhe më s'jemi takue.

Për Kolë Mërturin që i kishe thënë Faridinit, unë nuk di çka të them. Unë e di se duket djal i palëkundshëm, e për atë natë që po mendon se ka pasë diçka, nuk kishte lidhje me atë të Zvicrës, vetëm se ka qenë ulur afër tij.

Me Nezir (Nezirin në Ingolshtat) në lidhje me komunikatën kam bisedue përmes telefonit. Ende nuk e dinë se nga ka rrjedhë, por do të shikoj në këtë drejtim.

Botimi i traktit të atyre në "Zërin e Kosovës" me të vërtetë si të them na habiti, por pasi na tregoj Faridini se me çfarë qëllimi dhe në letër si e kishe cekë, pastaj u kuptuem. Ne deshtëm tua bëjmë një vërejtje në redaksi por prapë biseduam në mes veti dhe vendosëm që të presim çka po thua ti.

Skender, unë ta pata cekë në letrën e parë, rreth Hamburgut, në lidhje me Isak (Gutajn) dhe Hyzri Rekën. Por ti shiko prapë se prapë vetë. Me Hyzriun të kesh lidhje më të forta, se sa i përket Dusseldorfit Hyzriu është me Bacën, shtyllë, dhe ne e kemi përkrahjen prej tyre, por edhe në Hamburg duhet sa më shpejt të marrësh kontakt, por ta duhet kontaktuar nëpërmes Hyzriut dhe Bacës (Avdi Begishollit). Me Bielefledin, e pe vetë, unë jam i kënaqun me ta tash për tash, dhe besoj se edhe në të ardhmen do të vazhdoj kështu.

7. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, maj 1984

Me sa e mora vesh Xhaferi (Shatri) kishte shkrua vetëm për katër veta që përfundoi gjyqi. Unë ende nuk e kam parë, nëse duhet me e përpilue një njoftim të shkurtë, por po të njoftoj se më 20-22-27 nëntor 1983. Në ditën e fundit (27 nëntor) gjykimi ka zgjatë prej orës 9.00-17.00. Gjykatësja që e kryesonte gjyqin quhet Böchme. Shtat avokat kanë marrë pjesë në mbrojtje, të cilët kanë kushtue mbi 3800 DM për secilin. Të akuzuar para trupit gjykues kanë qenë 8 veta. Dëshmitarë të palës akuzuese janë 21 veta, prej të cilëve kanë marrë pjesë 9 veta, edhe ata punëtor, kurse vicekonzulli Lopiqiq me konzullin Trebiq dhe 9 bashkëpunëtor të tjerë s'ju kanë paraqitë trupit gjykues. Gjyqi përfundoj duke mos marrë pjesë konzulli dhe shumica e dëshmitarëve.

Për dy shqiptar që bëhet fjalë, siç ndëgjova është e vërtetë, është e vërtetë se ata kanë qenë dëshmitar të palës akuzuese, por ata na kanë ndihmue më tepër se mbrojtësit p. sh. Haki Haxhiu, i cili i tha trupës gjykuese se unë s'di shkrim dhe lexim edhe unë s'e kam nënshkrua deklaratën por mua më ka marrë Lopiqiqi dhe çka ka shkrua ai nuk e di dhe kush ka bërtitë nuk e di. Tjetri, Haxhi Ahmetgjekaj, tha se unë nuk e di se nuk kam parë se kush ka sjellë apo çka është brohoritë. P. sh. një prej dëshmitarëve të palës akuzuese tha para trupës gjykuese, se ne jemi konsultuar me konzullin para se të mbahet mbrëmja që të mos lejojmë të brohoritet "Kosova-Republikë!", e atë të cilin provon me brohoritë ta qesim jashtë. Ky quhet Josip Martinoviq, për të cilin mendoj të shkruhet me emër. Për çdo rast, nëqoftëse duhet ndonjë plotësim më thuaj më tej dhe të njoftoj.

8. Letër nga shokët e Ludvigsburgut për Xhafer Durmishin-Skenderin, 23 gusht 1984

Të dashur shokë,

Letrën e juaj e morëm së bashku me konceptin e artikujve të përgatitur për numrin e ardhshëm të Organit dhe materialin për Komitetet e Degëve dhe celulave të LRSSHJ.

Vërejtjet e juaja sa i përket çështjes së vonimit të dërgesave të materialeve, apo konkretisht, dërgimit të kokave të makinës, është shumë e arsyeshme dhe na duhet të gjithëve t'i përmbahemi një disipline të hekurtë dhe të jemi të vetëdijshëm se pa një disiplinë të tillë, nuk mundemi kurrsesi të marshojmë me hap të sigurtë përpara.

Sa mundëm me kuptuar nga titujt, na u duk se edhe ky numër ka me dalë në nivel, ndoshta edhe më mirë se numrat e mëparshëm. Titulli na u duk shumë i qëlluar dhe pa marrë parasysh se po kushtojka bukur shumë, ne duhet ta përballojmë.

Materialet me titull "Letërqarkore" i lexuam dhe i kuptuam për aq sa kemi mundësi. Kemi bindjen se ky material është shumë i mirë dhe materiale të tilla vazhdimisht duhet të përgatiten dhe t'u dërgohen komiteteve të degëve dhe nëpërmes atyre edhe celulave dhe simpatizantëve të LRSSHJ. Kjo do t'i kryej dy punë njëherit; do të ndikoj në ngritjen ideologjike të anëtarëve dhe njëkohësisht edhe në popullarizimin e KQ, pasiq pa dërgimin e materialeve të tilla dhe urdhëresave, direktivave etj., atëherë ku ta dinë anëtarët se po ekzistoka KQ i cili udhëheq.

Ne jemi të mendimit që ky material të nënshkruhet KQ i LRSSHJ, pasi që me siguri do të aprovohet nga të gjithë anëtarët e KQ.

Mendimi ynë për këtë material është: Të potencohet konkretisht se materiali është i destinuar për komitetet e degëve, celulat dhe simpatizuesit e LRSSHJ. Të jetë më tepër i potencuar edhe për aktivistët që veprojnë mbrenda, pasi që ne jemi të mendimit se gjithsesi duhet të shpërndahet edhe atje.

Shfrytëzojmë rastin dhe me anën e kësaj letre ju njoftojmë se u formua Komiteti i Degës për Gjermani dhe u bë zgjerimi i KD të Zvicrës, por na duhet gjithsesi të punojmë në formimin e KD në Suedi dhe Belgjikë. Na duhet të punojmë pareshtur në këtë drejtim edhe në të gjitha vendet ku ekzistojnë mundësitë për punë të tilla. 23 gusht 1984

Përshëndetje vëllazërore e revolucionare,

Shokët e Ludvigsburgut

9. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 17 shtator 1984

Të dashur shokë,

Po ju postoj letrën që është kthye prej adresës jo të saktë.

Kam një pyetje konkrete: Përse është vonua Zëri aq shumë, në vend që të del numri 4, tash ju ende nuk e nxorët numrin 3. Nëse është arsyeja e të hollave, i njoftoni shokët e rretheve dhe do ju përgjigjen me aq sa kanë mundësi. Nëse është ndonjë arsye tjetër na njoftoni së paku nëse mund të ju ndihmojmë.

Të fala. Hafizi, Ludvigsburg, 17.9.1984

10. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skënderin, 20 shtator 1984

Te dashur shoke.

Letrën tuaj pa date të shkruar ne pesë faqe (Direktive) e muarëm dje më 18 shtator 1984, e lexuam me vëmendje. Direktiva neve na pëlqej pa masë, dhe jemi shumë më të fortë kur shofim se kohën e fundit janë marrë masa për punë, edhe pse ende ndihet mungesa e disiplinës. Ne shoket e rrethit të Shtutgartit kuptohet 3 anëtarët e KDVG (Komitetit të Degës Vëllezërit Gërvalla) e aprovojmë këtë direktivë dhe do të rnarrim masa të duhura që ta realizojmë në praktikë. Direktiva është plotësisht e drejtë, vetëm neve mendojmë që do të ishte edhe më e drejtë nëse disa udhëzime do t'ju caktoheshin rretheve p. sh. KDVG të siguron këto tekste mësimore nga Kosova dhe të viziton bibliolekën e S. që të siguron këtë statistikë e jo të porositen të gjitha rrethet me të njejtat udhëzime kështu që harxhimet do të jen të mëdha dhe të marrin kohë edhe më tepër.

Ju shpesh e potenconi që të vizitohen bibliotekat e të shikohet çdo vrimë e tyre. Ne i kemi marrë masat edhe më parë për këto kërkesa por siç dihet në këto biblioteka nuk gjenden materiale të shtypit jugosllav. Neve kemi informata se Biblioteka e Malmos, dhe e Stokholmit janë të pasura me materiale nga Jugosllavia. Siç dihet edhe në këto dy qytete

është një numër shokësh të pa punë që kanë mundësi t'i vizitojnë këto biblioteka, sepse neve shpesh herë dimë të udhëzojmë po të punojmë në atë drejtim s'kemi dëshirë. Konkretisht ti Skender ke qenë disa muaj në Paris dhe a e ke hulumtue bibliotekën e Parisit, që tash don t'i qosh shokët prej Brukseli në Paris. Udhëzimet po e potencoj janë të drejta dhe kemi nevojë për to, por të mirren masa që të jenë sa ma korrekte dhe konkrete.

Secili rreth le të angazhohet me një direktivë dhe ta ketë, parasysh që kjo direktivë vlen vetëm për atë rreth, e jo të lihet që çështja në harresë se mund ta kryen St. Gallen apo Brukseli, apo Stokholmi apo HH (Hamburgu), kështu që puna mbetet për pa u krye, ose të porositen prej secilit disa libra të shkollës fillore sepse ato është rnë lehtë të gjenden, por harxhimet janë bukur të mëdha.

Ne i kemi porositë librat e shkollës fillore dhe të mesme si dhe veprat e studiuesve; të dr. Tahirit, dr. Fehmis, Esatit dhe Ali Hadrit, kështu që S. (Skender) shokët tjerë mund t'i informoni se këto janë të porosituna, që mos të bëjnë edhe tjerët harxhime. Këto tekste i sjellin kah fundi i shtatorit.

Të na njoftoni se në çfarë drejtimesh i postoni materialet (është fjala për Gjermani) që ne mos t'i postojmë për së dyti, apo të mbeten pa hiq.

Për tubimin e informatave ma të sigurta nga Kosova i kemi marrë masat dhe në këtë drejtim shpresojmë se do të ketë sukses, pasi që dy shokë që shkuen dje për Kosovë, ju dhamë një varg udhëzimesh, edhe ata në mundësitë e tyre që kanë nuk do të kursejnë asgjë, njashtu nga 20 numra të Zërit të Kosovës i muerën me vete, të formatit të vogël. Do të ishte mirë që ta kishin edhe nr. 3 por ju nuk na e dërguat një kopje edhe pse e patëm bërë kërkesën.

Vonesa e Zërit kësaj radhe po shifet se po ndikon në dëmin tonë por shpresojmë që në të ardhmen s'do të vononi kështu pasi që vazhdimisht po e potenconi se janë kushtet e mira të punës sa i përket çështjes së financimit ne i kemi marrë masat dhe shpresojmë edhe ne nga ana jonë që në të ardhmen do të jemi më të gatshëm për ndihmë veçanërisht që të nxirret organi por edhe ju nga ana juve të na njofton që keni nevojë për të holla e jo del sot nesër organi kështu që edhe ne këndej tu themi njerëzve se del këtë javë, javën e ardhshme organi e nuk është askund. Kështu që ne mund të biem edhe në pozitë të keqe pasi që propaganda e prapaskenës së Ukes është e pandërpreme edhe neve kur nuk jemi më të angazhuar në punë dhe të disiplinuar ç'duhet të bëjmë pastaj.

Shfrytëzojmë nga rasti t'ju njoftojmë për situaten në rrethin tonë dihet sipas shumë problemeve kundërthënieve thash e themeve punët prapë janë kah vazhdojnë mirë dhe në dobi të luftës sonë të drejtë, sepse ku shifet që ata janë më të dobët pasi që detyrohen të mirren me fjalë. Të kapet p.sh. Namiu për një bisedë pa baza për të cilën kemi bisedue para dy viteve që nuk qon pesh në kanarin e politikës së kërkesës Kosova Republikë, prandaj është shumë e drejtë që na porositin (vëllau i madh) (diplomatët e RPS të Shqipërisë - shën i Xh. D.) që të mos merremi me emra dhe me thash e theme, sepse është në dëm të luftës sonë të drejtë nëse merremi me emra, do të thotë krijojmë vetëm armiqësi më tepër.

Kontaktet dhe debatet me shokët e këtuhit nuk i kemi ndërpre e kjo shifet se është e suksesshme. Javën e ardhshme do të shkon një autobus në koncert. Do të udhëtojmë bashkarisht. Plani i Faridinit siç dihet ishte që të shkojnë ai me Namiun e disa shokë, që krahu jonë mos të shkoj, e ai ta shfrytëzon rastin të flet kundër krahut tonë, por ne ju thamë jo ne do të udhëtojmë bashkarisht si më parë.

Kësaj radhe po e përfundojmë këtë letër duke ju uruar shëndet dhe sukses në çdo drejtim. Të fala revolucionare shokët e rrethit të KDVG.

Ju premtojmë se çdo propozim, Direktivë - udhëzim të KQ të LRSSHJ do të përpiqemi që ta zbatojmë me besnikëri.

Ludvigsburg, 20 shtator 1984

11. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 26 tetor 1984

Të dashur shokë,

Ju bëjë me dije se Zërin e formatit të madh e kam marrë dhe e kam shpërnda. Radhave tjera m'i dërgoni 120 ekzemplarë dhe Remziut 100 ekzemplarë. Zërin e formatit të vogël e mora. Ishte mirë, vetëm radhave tjera mos e lidhni sepse unë besoj që është më mirë për ata që e bartin në badifokë për mëmëdhe. Kësaj radhe Zëri ishte më i pasur me artikuj se herën e kaluar edhe pse shifet ende mungesa e artikujve nga Kosova. Kritika rreth Zërit ka veçanërisht rreth numrit 3, pse të shkruhet për demonstratë dhe rreth klubeve, dhe sidomos të ndërpritet akuza mes Zërit, dhe të gjendet një mundësi e bashkimit e të mos përçahemi më shumë kështu, është pjesa dërmuese e lexuesve.

Edhe pse ju njoftova mes telefonit për udhëtimin e javës së kaluar në Munchen dhe Ingolshtad po ju shkruaj përsëri se ishte udhëtim shumë i suksesshëm. Tani po shifet edhe më mirë se aty i bëra me dije për I. K. (Ibrahim Kelmendin) dhe Xhaferin (Shatrin). Më gjerësisht dje më njoftoj mes telefonit Rexhepi, se keni bërë shumë mirë që ju keni tregue njerëzve të vërtetën dhe po na ndihmon e vërteta që ne jemi për takime dhe bisedime kurse ata nuk pranojnë të bisedojnë të kaluarat apo të tashmet, e kjo po i lenë njerëzit me kuptue se këtu ka diçka, se sa për punë që po bëjmë ne s'kishin me na folë as në rrugë, sepse krahu ynë, mendoj Remziu, Mejdiu etj. edhe në klub pritojmë me shkue, vetëm duhet me na thanë disa herë, kurse Faridini dhe Namiu nga disa herë shkojnë nëpër njerëz dhe ju flasin për gjëra që janë ashtu dhe që nuk janë ashtu, dhe klubit nuk i ndahen. Këtu në Shtutgart më së tepërmi po përpiqen t'i gënjejnë shokët e Vaiblingenit. Në javën e kaluar që e patë thirrë baca Selim (Koca) një takim nuk u mbajt. Dihet që u sabotua prej Ismetit dhe Faridinit, sepse Faridini i shtyrë nga Xhafer Shatri, e kishte pasë në plan ta bëjë një mbrëmje pa dijen tonë diku, dhe e kanë mbajt në Tybingen, të dielen e kaluar me të rrethit të tyre dhe me Namiun, Muratin, Smajlin dhe nja tre të tjerë që nuk i kanë ditë problemet. Në atë takim kanë shfaq film dhe kanë bisedue për Zërin e Bielit. Këtë takim e kanë organizuar përmes Shaipit. Shifet se Faridini, i shtyrë nga shefi, e kanë në plan të organizojnë diku në Shtutgart festën e 28 Nëntorit sepse sot më njoftoj Baca Selim, se i ka thënë Faridini duhet ta mbajmë këtu në Shtutgart, por të mos flitet për askend dhe të formohet një komision. Për mbrëmjen e Dusseldorfit, më njoftoj Selimi se ishin 20 vetë, tha në Dussedorf, dhe atje tha bisedova për bashkim, por Faridini s'po më ngon. Megjithate Selimit s'i bihet në fije, se ai kthehet kah të frynë fryma. Ma dha nr. 9 (të Zërit të Kosovës) të Bielit, dhe tha se po i shpërndaj nga 20 nr. dhe të gjithë mirë po thonë, etj. Ju bëjë me dije se situata është vërtetë kah acarohet sepse po shkojnë gjithkund dhe po flasin gjithçka. Akuzat janë më së tepërmi rreth teje Skender. ... Ju bëjë me dije se Selimin janë kah e shtyjnë se Skenderi është kundër Kadri Zekës. Këtë taktikë po e përdorin edhe në rrethe tjera, dhe siç shifet në nr. nëntë e ka shkrua këtë artikull të Kadrisë vetëm për provokim, dhe ne duhet të kemi parasysh e të mos biem në kurthat e tij. Të ribotohet artikulli i Hydajetit që supozonte baci (Sabri Novosella).

Ne do të marrim masa ta organizojmë 28 Nëntorin. Do të marrim kontakt edhe me shokët në Zvicër që edhe ata të organizojnë një mbrëmje qendrore për Zvicër dhe ne për Gjermani. Unë propozoj që të merren masa për 10 dhjetor ta thërrasim një demonstratë në Gjenevë. Kjo do të ishte shumë e suksesshme nëse mundemi me e marrë lejen. Do të ishte mirë të bisedonit me Shaqën (Shaqir Shabanin) sepse ky njeri është i paprituesshëm dhe i shkathët për këso rastesh, dhe mundësisht na njoftoni në lidhje me njerëzit që janë

momentalisht indifirent dhe në luhatje, dhe për raste të tjera edhe pse jeni të nxanun me punë të shumta, do të ishte mirë të na shkruani dhe të na këshilloni e kjo vlen më tepër për bacin (Sabri Novosellën) sepse fare nuk ka shkrue. Ju vërtetë jeni të angazhuem me Zëri, por duhet ta dini se nuk është e lehtë t'i sqarojmë njerëzit rreth problemeve me të cilat po ndeshemi. ... Si qëndron situata me Naimin është mirë të na njoftoni dhe me ata shokë të tjerë në Malmö. ...

Më në fund pranoni të fala shoqërore nga Hafizi 26 tetor 1984 Ludvigsburg

12. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 8 nëntor 1984

I dashur shok Skender,

Letrën tënde e mora. Edhe pse kishe shkrue shumë shkurt prapë se prapë të jam mirënjohës që nuk ke harrue me shkrue. Sa i përket gjyqit, shpresojmë se do të jetë mirë, sepse qëllimi i tyre është që t'i marrin qato të holla a asgjë tjetër, sepse këtyre nuk ju intereson e vërteta, por avokatët po kushtojnë secili nga 3800 DM për njeri. ... Për festat e 28 Nëntorit të kam njoftue përmes telefonit dhe bacit (Sabri Novosellës) në letër, ne do e mbajmë, por përpiqnu edhe ju atje dhe shokët në Zvicër. Me ta po është shumë vështirë të merremi vesh, sepse Aliut ja qova një letër para do dite dhe ai nuk më kthej asgjë. Njashtu Haxhi (Berishës) qe dy letra që ja qoj, veçanërisht e kam pyet herën e fundit për 28 Nëntorin por ai njeri s'lajmërohet. Njashtu edhe Xhemilin rrallë herë po e gjej në banesë.

Për 17 janarin 1985 kemi marrë masa prej tashtit ta sigurojmë sallën. Njashtu besoj se për leje nuk do të ketë problem, sepse me Remziun e kemi marrë vjet dhe prapë do të na e japin. Me rrethet tjera jemi në kontakt përveç me Bilefeldin jo, sepse ne jemi lajmrue disa herë e edhe Remziu, kurse ai (Xhavit Ramabaja) asnjëherë s'lajmërohet përveç kur ishim atje që u lajmrue. ... Të holla, do të shikoj të shtunën t'ua dërgoj 500 DM, vetëm do të ishte mirë që ta praktikoni, si t'ju vijnë të hollat, t'u lajmëroheni shokëve me letër që i muarëm të hollat. P. sh. Remziu para disa ditësh i ka que disa dhe ai njeri nuk e di a ju kanë ardhur apo jo.

Sa i përket për shkruarjen e trakteve për informimin e opinionit të jashtëm do të ishte mirë që të angazhoheni më tepër me shkruarjen e trakteve e mi dërgoni, e unë i përkthej në gjuhën gjermane tek shoku gjerman, dhe ndoshta edhe ju do ta keni më lehtë t'i përktheni prej gjermanishtes në suedishte, dhe dy palëve në hyjnë në përdorim, se është koha që të informohet opinioni me ngjarjet në Kosovë, veçanërisht me largimin e profesorëve nga fakultetet. Është mirë t'ja shkruajsh Ismet (Klaiqit) një letër. Postfahun e ke. ... Njashtu shkruaju shokëve që janë në luhatje, p.sh. Imerja Qamilit në Dusseldorf. Ai ka një simpati për ty dhe do të ishte mirë t'i shkruash, sepse ishte Namiu tek ai, dhe si duket ka ndikue pak, sepse ai ashtu ishte i luhatshëm...

Kësaj radhe me kaq. Prano të fala shoqërore

Hafizi, Ludvigsburg, 8 nëntor 1984, RFGJ

Do të ishte mirë që të shkruash, sepse vetë je ai i cili e potencon vazhdimisht se duhet të shkruajm, e vetëm në raste urgjente me telefon.

13. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 28 nëntor 1984

Shoku Skender,

Letrën tënde e mora njashtu edhe materialin mbi Kosovën e mora, falemnderit. Për letër s'kisha çka të falenderoj pasi që nuk kishte asgjë në te, por për materialin që e mora të hënën, edhe pse ende nuk e kam dhënë intervjun, sepse të marten përfundoi gjykimi më heret dhe ishte shumë i komplikuem kështuqë mbet për javën e ardhshme

nëse shkojmë në gjyq. Adresën e Ismetit po ja qojë menjëherë Musës (Imer Berishës), kurse Fjalorin Drejtshkrimor që e kishe kërkue, unë nuk e kam.

Për gjyq dhe për 28 Nëntorin i shkrova bacit (Sabri Novosellës) dhe besoj se njësoj është. Unë tash kam një propozim për ty: ta përgatisësh qysh tash traktin që duhet të shpërndahet më 17 janar 1985, që ta kemi të gatshëm në fund të dhjetorit e të mos ngasim në ditët e fundit, se ndoshta as përkthyesi nuk ka kohë atëherë. Edhe thirrja mendoj të lëshohet në fillim të janarit por për këtë duhet të jemi së paku të sigurtë për leje, pastaj e lëshojmë (thirrjen), por të jetë e gatshme për fund të dhjetorit. Unë mendoj se do të ishte mirë të lëshohet në emër të KD (Komitetit të Degës) por për këtë bisedoni edhe me shokë të tjerë se si mendojnë.

Më intereson të dij Haxhiu a po ju lajmërohet dhe si i kanë hallet, pasi unë s'kam kurrfarë lidhjesh me ta sepse ata tek Remziu vetëm njëherë janë lajmërue pasi është largue baci (Sabri Novosella) prej këtuhit, kurse unë s'po kam ku t'u lajmërohem. Tek Xhemili thuaja në çdo tri ditë lajmërohem por ata s'po qëllojnë. Me shkrua nuk po lodhen apo po harrojnë, sepse me siguri janë të angazhuar shumë.

Skender unë s shof të arsyeshme t'u shkruajsh të gjithë shokëve të rrethit... p. sh. Namiut, por jo më shumë, por vetëm si një shok që i kemi takue një rrethi, ashtu edhe Murat Kryeziut shkruaj pamvarësisht se çka mund të flasin apo çka kanë folë. Ata i kanë takue rrethit tonë dhe neve na takon të bisedojmë dhe t'ju shkruejmë. Poashtu shkruaj edhe Mejdi (Rexhës) dhe Shaban (Bobajt) edhe pse ata janë në krahun tonë, se mund të thonë vetëm kur të jenë ngushtë po na shkruajnë etj. Mos prito njerëzve me ju shkrue, sepse ti thoshe se janë kushtet e mira. Tani puno pra, pasi paske mundësi. Shkruaji cilit ta pash të arsyeshme, p.sh. bacit Zymer (Zymer Kryeziut) në Dusseldorf, sepse ai vazhdimisht interesohet si për ty edhe për bacin. Të pata pyet për disa veta e s'më njoftove kurrë, si p. sh. për Shaqir Shabanin në Gjenevë, si qëndron puna, por nejse. Jo që mu desht gjë, por deshta vetëm ta di.

Të fala ke ti dhe të gjithë shokët, 28 Nëntor 1984, Hafizi.

14. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 29 dhjetor 1984

Shoku Skender,

Po të përgjigjem me vonesë në letrën e fundit, që e mora javën e kaluar, por siç e dish edhe vet esencën e letrës e kemi bisedue në telefon. Por prapë e shoh të arsyeshme të përgjigjem në disa pika të letrës suaj me sa vijon:

Letra e ardhun në redaksi prej Muncheni është letër provokative sipas Musës (Imer Berishës).

Me Haxhiun dhe Aliun tani jam në kontakt, por me letra - jo me telefon. Tani Haxhiu të precizon dhe të shkruen me rregull. Do të ishte sukses për të gjithë nëse fillojmë të praktikojmë komunikimin në mes veti me letra, e të shkëputemi nga të plogshtit i cili ende na shoqëron. Për delegatët e Dusseldorfit që kishin qenë në Bilefeld e mora vesh por, unë që u takova dje me Namiun, ai thotë se nuk kanë qenë për bisedime me u bashkue me juve apo me Xhavitin, por masa në mes veti e cila sa më parë duhet të bashkohet. Pasi që jam tek Namiu (Nami Ramadani-shën i Xh. D.) po ndalem më gjerësisht rreth takimit me te dhe bisedës që kemi zhvillua. Namiu erdh dje tek unë në mëngjes dhe biseduam rreth 5-6 orë rreth Xhafer Shatrit, I. Kelmendit si dhe rreth teje, bacit, Milaimit, Xhavit Ramabajës dhe Musa Hotit (siç e din ti Namiu e ka merak të kapet për disa fjalë boshe dhe njëherit ushqehet me to, se i duhen për me përpilue vica etj.). Namiu tha se unë qëndroj në ato qëndrime të mëparme, e shpërndaj Zërin të cilin e kam shpërnda gjer më tani, sepse isha para një muaji dhe fola me Klime Priftin (diplomat i Shqipërisë në Vjenë-shën i Xh. D.) dhe ai më tha se qëndro aty ku ke qëndrua gjer më

tani, se mirë e keni. Namiu tha se i thash po unë kam qenë shok i pandarë me Hafizin dhe tani ka ardhë situata me u vra në mes veti se qëndrojmë në pozita të kundërta, e ai tha 'ti shpërndaje qatë (Zërin e Zvicrës.). Namiu tha se më tepër i besoj Klimes se tjetërkujt. Xhaferin (Shatrin) e mbronte se ai nuk bën asgjë pa i pyet shokët, dhe nuk është vetëm Xh. Shatri në redaksi, por janë edhe dy gazetar në burg që i kanë edhe familjen në burg, dhe të tjerë. Te Xh. Shatri e kishte fjalën, që pyet, se këta gjoja e kanë thënë se na kanë thënë neve atje në pushim mos të shkruani ma për këtë fraksion, dhe mos u merrni me ta se ju duhet të ecni përpara e mos të merreni me fjalë, tekstualisht karavani le të ecë e qentë le të lehin etj. Dhe për këtë arsye ai i pyet shokët dhe nuk don të merret ma me fjalë se nëse shkruan ma diçka unë nuk do e shpërndaj Zërin, simbas tij (Namiut). Për Ibrahimin thoshte se edhe ai ka punue dhe unë e njof Ikajën (Ibrahim Kelmendin – shën. i Xh. D.) por ju ma keni afrue për së dyti se thojshi se është përmirësue, e tash kur e patë që frenat që i kishi në disa rrethe ju dualën nga dora, ja nisët ta luftoni. Kur e pyeta more Nami a e di ti se ai ka pasë lidhje dhe ka ende me Sadik Blakajn, dhe pikërisht në banesën tënde janë bërë planet se si t'i çojnë Jusufin me shokë në burg dhe si rezultat i veprimtarisë së Ibrahimit është Hyseni dhe shumë shokë jashtë, ai tha se unë e di... Për mos me e zgjatë se të them të drejtën jam lodhur, Namiu është i organizuem në kryesi të Xhafer (Shatrit) pasi që po e mbron me kaq këmbëngulje, edhe pse Namiu nuk vuan nga kjo sëmundje siç vuajnë disa të tjerë, por tek ky e shfrytëzojnë rastin t'ia ngacmojnë plagën, siç e ka princip, ky ka thënë kështu e ai ashtu. ...

Me Hasan (Veselin) u takova të enjten në mbrëmje, rreth orës 21.00. Isha në telefon dhe duke u kthye në banesë kishte qenë para poste, i thash mirëmbrëma. Ai tha se a nuk po ndalesh more shqiptar me bisedue apo nuk po duesh me shqiptar me bisedue. Gjatë bisedës në këmbë ma bëni me dije se Qazimi është në Café Kunz dhe dualëm aty në kafe nja dy orë biseduem, së pari rreth asaj se si Qaza nuk ka mund të shkoj në shtëpi, me rastin e vdekjes së babës të tij. Biseduem edhe rreth klasës punëtore, siç e merrnin në gojë, se klasa e Kosovës është ende e pangritun, se kur të ngritet dhe kur të del udhëheqësi i saj i vërtetë si pararojë, atëherë do të fitohet Republika. ... Më së interesanti ishte kur thonin se levat e LRSSHJ duhet të bashkohen dhe gjer sa funksionojnë këto leva është mirë...

Me nderime shoqërore ju përshëndet Hafizi, 29 dhjetor 1984, Ludvigsburg

15. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, janar 1985

Shokë, Shokut k. gjerman i ka vdekë e ëma. Do të ishte mirë që të ja ofroni ngushëllimet. Ti Skender posaqërisht pasi të njef Llota, dhe në emër të Redaksisë së ZK. Këtu në Gjermani qenka disa kartolina të posaçme për ngushëllime, në të cilat po u shkruajke vetëm ngushëllime për mëmën dhe emri i personit kush i ofron ngushëllime. Besoj se edhe te ju duhet të ketë.

Adresa e Lotës është kjo: Lotta Krüger, Urbanstr. 126, 7000 Stuttgart 1.

Mos harro ta kryesh sot a nesër se nuk bënë të kaloj kohë e gjatë.

Të fala H.

P. S. Merr masa nëse ke mundësi e eja ma heret, pasi baci s'po mujke me dalë. Edhe Organin (revistën) do të ishte mirë ta merrni këndej për protestë. Por shiko që lidhja të jetë më e mirë se po shkepen fletët, e unë mendoj se më mirë është sikur në nr. e parë.

16. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 29 janar 1985

Shoku Skender,

Këta burrat e botës demonstruan të shtunën. Unë s'munda të dalë sepse s'kisha asnjë pfening. Të hollat e fundit që i pata fola me ty në telefon, dhe siç e pe me ty na u ndërpre biseda. Murati i kishte pa se kanë qenë 80-100 veta kurse ata po thonë se kemi qenë 1000 veta. Sot e lexova në Shtutgarter Zeitung shkruente se demonstruan 300 shqiptarë. Ibrahimi ka thirrë tek gjermanët përsëri e ju ka kërkuar ta udhëheqin demonstratën në gjuhën gjermane, por ata nuk i janë përgjegj. Lota ka kërkua një takim për sqarim të situatës së fundit.

Ma dërgo sa më parë broshurën që e ke përgatitë për gazetë, si dhe letrën e Jusufit dhe letra tjera që e din se më hyjnë në përdorim. Unë jam i mendimit që letra e Jusufit për Ibrahimin duhet të botohet në Zëri, por për këtë merre edhe mendimin e të gjithë shokëve. Unë tek gjermanët do të shkoj me Musën (Imer Berishën), Remzi Ademin dhe ndoshta me Muharremin dhe Januzin, si të jetë këndej.

Javën e ardhshme do të ngjitem në Dusseldorf, dhe do të shkojë në Bochum në Shoqatën e Miqësisë (Gjermani-Shqipëri). ...

Letrën që mendojsha t'ua dërgosh (Partisë Komuniste Gjermane-shën i Xh.D.) në Dortmund, duhet të dërgohet përmes këtyre në Shtutgart. Besoj se është më mirë. Unë bisedova me Llotën që të takohem me Peter Platzmanin dhe një shok tjetër të Partisë, ajo tha se është shumë e drejtë, dhe lajmëroju në telefon e bëne një termin.

Unë jam duke kërkue banesë dhe shpresoj se kësaj jave do ta marrë një.

Të fala shoqërore Hafizi, 29 janar 1985, Ludvigsburg

17. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, shkurt 1985

Shok Skender,

Pasi në telefon s'po mundemi t'i shprehim të gjitha mendimet, po të shkruaj shkurtimisht. Ideja për një dasmë (demonstratë) në Suedi është shumë e mirë, vetëm unë mendoj të peshohet mirë situata dhe rrethanat, që a mund të bashkojmë një numër të madh apo jo?

Mendimi i Aliut për në Bern më duket se është i drejtë pasi shumica e punëtorëve në Zvicër kthehen në fund të marsit dhe fillim të prillit, dhe në atë kohë i kanë të gjitha dokumentet e udhëtimit në komunë. Ju analizojeni si ta shihni më mirë dhe veproni. Nëse vendosim për një dasmë, të fillojmë qysh tash përgatitjet që kur të vinë ditët e fundit mos të mendojmë ç'duhet të bëjmë sot, pasi që është bërë gjer sot, etj.

"Zërin e Xhafer Shatrit" ma kishte çue Shaipi sot (nr.1/1985) por pa pullë postale, të cilën e kishte pague baba. Ata kishin nxjerr një kalendar me fotografi. Nëse bëhet më shpejt kalendari shumëzoje, por nëse vonohet, atëherë mendoj që të pezullohet për këtë vit.

Unë mendoj që të botohet si broshurë ky materiali që je duke e përgatitur si dhe Programi Politik. Ata të Shatrit e kishin vendosë ta botojnë një program të ri të "LRSSHJ" simbas njoftimit të Zërit të Kosovës, nr. 1 - 1985.

Të fala Hafizi

18. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 16 shkurt 1985

Skender,

Më pate premtue se "po ta dërgoj" letrën e Jusufit por ende nuk e mora. Besoj se bënë ta kem edhe unë një kopje të asaj letre. Njashtu më pate thënë për një letër 10-12 faqe që e ka çue një "shok" nga SHBA dhe "do ta dërgoj".

Është mirë që radhave tjera të lajmërohesh së paku me një kartolinë se e more letrën. Fotografi më të mirë nuk kam, por kur të rritet zbardhohet më shumë. Është mirë të botohet në kopertinë të parë, dhe kështu si është me ngjyra. Propozoj që Organi (revista) të nxiret si i k. gjerman. (materialin e kanë tjetër).

16 shkurt 1985 Ludvigsbug. Të fala H. (Hafizi)

19. Letër nga Hafiz Gagica për Xhafer Durmishin-Skenderin, 8 mars 1985

Letrën tënde të datës 23 shkurt e mora, dhe e lexova me vëmendjen më të madhe. Po të përgjigjem me vonesë, por besoj se nuk do të gjejsh keqkuptime. Para dy dite më ra në dorë edhe letra që e ke përgatitë për PKGJ (Partinë Komuniste të Gjermanisë) si dhe letra e A. Prapashticës dhe letrën që e kishe përgatitë për përgjigje.

Po të përgjigjem shkurtimisht në letrën e 23 shkurtit. Në këtë letër mësova rreth problemeve tua me strehim si dhe rreth përçarjes me Sabriun. Problemi yt për strehim mesa vërejta ishte me shpresë se do ta rregullosh, ku do të bëhej shumë mirë nëse rregullohesh. Problemi me Sabriun është shumë delikat, ku kemi bisedue edhe në telefon, dhe mendimin tënd rreth Sabriut e kam ndëgjue, por edhe ti qëndrimin tim rreth jush e ke ndëgjuar, ku mbetem edhe tani në atë qëndrim. Që ju të dytë duhet sa më parë të uleni dhe të bisedoni, pamvarësisht nga kontradiktat që keni pasë. Ti më thua se e njeh më gjatë dhe qysh në Turqi i ke njohtë gabimet e tij, por i ke lënë në heshtje. Është fakt se ti e njeh më shumë dhe më heret. Unë e njoh shumë pak Sabriun, më tepër e njoh përmes jush që më keni tregue, edhe kam pas rast njëherit ta pyesë Jusufin për fotografinë e Sabriut që e mbante në vitrinë. Ai më patë thënë se "është një shokë shumë me vlerë". Ti në telefon më the, të ishte Jusufi këtu s'do të mundte me que shumë me te. Do të pyetsha a kanë pasë lidhje në Kosovë këta të dy apo jo? Rreth lidhjeve të Sabriut me Jusufin s'po zgjatem sepse ti e di ku e ku më mirë se unë, vetëm po ndalem që ti je më i ri se ai ku e ku, dhe ai ka vuajt më shumë se të gjithë ne, dhe për atë arsye duhet të kesh parasysh gjendjen e tij, që ai mund të jetë nervoz, por ka edhe të drejtë, pasiqë ne shumë më të ri se ai po nervozohemi dhe s'po jemi në gjendje të ja ndëgjojmë një fjalë shoku shokut.

Ti vazhdon të thuash se ai s'e ka asnjë pikë të ML (marksizëm-leninizmit). Unë e di, por edhe sikur mos ta ketë asnjë pikë të ML, po të pyesë, a duhet ta bindësh ti si Skender se vija më e drejtë është ML (marksizëm-leninizmi) apo duhet ta hedhësh poshtë. Unë mendoj se një ML (marksist-leninst) duhet të ketë durim dhe të përpiqet që ta nxjerrë shokun prej gabimeve, e jo ta shtynë edhe sa më tepër. ...

Shoku Skender, kësaj radhe nuk do të zgjatem shumë, por po të them mendimin tim se duhet të kemi kujdes e të mos krijojmë përçarje të re. Ti ke përgjegjësi të madhe, për largimin e disa shokëve të mëparm, për disa ndodhi gjatë këtyre tri viteve të fundit, edhe pse këto ndodhi kalojnë mbi supet e të gjithë shokëve të rrethit të ngushtë të Jusufit. Ty pak më tepër se ke qenë me një përvojë më të madhe, me vetëdije më të madhe, me ngritje ideopolitike më të madhe, si dhe në kontakte të përhershme me shumë shokë si në atdhe ashtu edhe jashtë, dhe me ata të vëllaut të madh (diplomatët e RPS të Shqipërisë). ...

Letrën që e ke përgatitë për shokët e PKGJ (Partisë Komuniste të Gjermanisë) nuk ua kam dërgue ende, edhe takue nuk jemi ende. Ata e patën thirrë një takim zyrtar për 1

mars por e shtynë për një kohë e datë të pacaktuar nga ana e tyre. Arsyeja e shtymjes, ma thanë se Joachim Röhmi është i nxanun, por arsyeja qëndron diku tjetër. PKGJ tani ka fillue të merr një rrugë tjetër, atë revizioniste, dhe më tepër bien në pajtim me partinë e Trockit, ku një pjesë e partisë do të ndahet. Disa anëtarë të partisë e kanë thirrë kongresin e jashtëzakonshëm për në pranverë, por udhëheqja e KQ të Partisë ju është përgjegj me jo. Për këtë do të njoftoj më gjerësisht në një letër tjetër pas do dite ku do t'i dërgoj edhe kritikat e tyre, nëse mund t'i përkthej. ...

Me nderime shoqërore e Revolucionare Hafizi, 8 mars 1985 Ludwigsburg

20. Letër nga Hafiz Gagica për shokët e Shtutgartit, 1 prill 1985

Të dashur shokë,

Kaloj një kohë e gjatë që nuk jemi takue. Mes kësaj kohe na janë mbledh një mori problemesh, dhe na presin shumë detyra në të ardhmen. Është e nevojshme që në takim të sjellim mendimin e rrethit dhe të përgatisim veç e veç, raportin e punës së gjertanishme. Për arsye që do të takohemi sa më parë që do të bisedojmë më gjerësisht, këtu në këtë letër nuk do të zgjerohem më tepër. Për këtë takim kur do të mbahet, mbetet që të lajmëroheni tek Remzi Ademi (te Rem. të lajmëroheni brenda kësaj jave, do të thotë prej 2-5 prill).

Mbetem me shpresë se do të takohemi kësaj jave.

Me nderime shoqërore, Fitimi (Hafiz Gagica) Shtutgart, 1 prill 1985.

(Shënim i Hafiz Gagicës për Remzi Ademin): Shoku R. unë mendoj që është më mirë të takohemi të premten në mbrëmje. Nëse të përgjigjet ty dhe shokëve që do të vendosni përmes telefonit, vendosni, nga ana ime për cilën ditë ta shihni të arsyeshme. Të fala H. (Hafizi).

LETRA NGA HAXHI BERISHA

1. Letër nga Haxhi Berisha për Xhafer Durmishin-Skenderin, 18 maj 1983
2. Letër nga Haxhi Berisha për Xhafer Durmishin-Skenderin, fillim i korrikut 1983
3. Letër nga Haxhi Berisha për shokët, 15 mars 1984

Haxhi Berisha nga fshati Prapaqan i Komunës së Deçanit, ka qenë një aktivist që i ka takuar rrethit më të afërm të Jusuf Gërvallës. Me te për herë të parë jam takuar në korrik të vitit 1981 në shtëpinë e Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës.

1. Letër nga Haxhi Berisha për Xhafer Durmishin-Skenderin, 18 maj 1983

Roschach më 18 maj 1983

I nderuari Skender, mirë dita

Ja pra tani vendosa që t'i shkruaj disa fjalë. Edhe pse kaloj një kohë bukur e gjatë, mirë po prapë nuk është vonë. Arsyet se pse nuk të kam shkrue deri më tani, ti me siguri i din, ndonjëherë ka qëllue që flasim me telefon, por edhe adresë nuk kisha dhe prapë nuk kam.

Pra shoku Skender unë jam mirë, dhe shokët këtu janë mirë si me shëndet ashtu edhe me punë, edhe pse kemi pasë disa mosmarrëveshje dhe kanë ekzistua disa

kundërthënie prapë se prapë është arritë një unitet i duhur. Momentalisht jemi duke i shfaq filmat të cilët edhe vitin e kaluar janë shfaq, por prapë se prapë interesimi është në nivel. Filmat shfaqen në dy qytete, në St. Gallen dhe Kreuzlingen. Në të dy vendet po ka mjaft të interesuar ku po arrinë shifra deri në 70-100 veta çdo herë. Unë kam marrë kontakte dhe jam duke punuar në këtë drejtim bukur mirë. Kemi njoftuar shumë shokë të ri, të cilët janë mjaft të interesuar, shokë të pjekur.

Ne këndej me disa shokë jemi duke punuar në këtë drejtim dhe po përpiqemi për hapjen e një klubi këtu në St. Gallen, mirëpo kemi pak probleme me lokal. Disa shokë e kanë marrë iniciativën dhe janë kah përpiqen në këtë drejtim. Besoj se së shpejti do t'ia arrijmë qëllimit. Dhe besoj se në këtë vend klubi do të bëjë punë të madhe. Parashihet që brenda dy muajve, klubi t'i ketë 200-300 anëtarë të rregullt.

Për të gjitha mosmarrëveshjet që kanë ekzistue, te thashethemet e kështu me radhë, ta qojnë mallin e të gjitha atyre të cilat i kemi pasë ne atje, mirëpo këtu kanë qenë të nivelit më të ulët, dhe jam përpjek deri diku t'i zhduku ato mbeturina. Deri diku ia kam arritë qëllimit. Për mënyrën dhe prinicipet që i kam përdorë kemi bisedua kur isha në koncert (të Ansamblit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve të RPS të Shqipërisë në Shtutgart, në prill 1983 - shën i Xh. D.)

Sa i përket masës, janë të kënaqur besoj edhe të gjithë shokët e afërm janë të kënaqur me punën që kem bërë, me përjashtim të Muamerit (Muameri është vëllau i dhëndërrit të Hafizit). Me te po kam kokëçarje, jo që ka ndonjë qëllim të keq apo të caktuar por është mjaft i komplikuar dhe i pështjellon punët. Për këtë kam kritikuar disa herë dhe ai prapë vazhdon me të vjetrën. Si duket është i papërmirësueshëm. Me Faikun punët shkojnë mirë. Kanë ekzistue edhe me te mosmarrëveshje por me te jam kuptue shpejt. Por Faiku kohën e kalon më tepër me Muamerin dhe besoj që ai po ndikon ngapak, dhe kam frikë që në të ardhshmen ndikon më tepër dhe do të na sjellin prapë kokëçarje. Unë do të përpjekna që të sillem realisht sa të mundem.

Tash edhe disa fjalë për Shaqën (Shaqir Shabanin). Menjëherë pas koncertit Shaqa u kthye këtu dhe ka ndejt dy ditë. Kam bisedue gjatë me te. Shaqa është mjaft i shqetësuem dhe besoj se do të na sjell ndonjë problem. Ai më tha; i kam thënë Skenderit që t'i shikon këto punë pasi po duke se edhe aj po i lenë punët zhag. Tha që unë do të pres edhe ca kohë dhe nëse dikush nuk do të merr masa për këto marrina, do të zgjedhi vetë të gjitha problemet. Thotë se problemet e mija i zgjedhi vet nëse është nevoja edhe me forcë. Çak më tha se nëse nuk pushojnë këto marrina do të filloj vetë me nxjerrë gazetë dhe nuk do të vazhdoj më kështu. Unë u paraqita që nuk kam njohuri për këto gjana dhe gjoja nuk di asgja.

Si duket, të gjitha këto e kanë rrjedhimin pse Shaqa ka pasë lidhje me Shtutgart. Unë vetë nuk mund të vij në përfundim tjetër pos këtij, se sa i përket Shaqës ai të gjitha i ka, si njeri që kurrë nuk pushon dhe nuk kursen asgjë. Mirëpo prapë diçka më shtyn të mendoj. Pse Shaqa nuk e hapi asnjë klub në Chur, aty ku ka punuar disa vite, edhe pse dihet se aty ka mjaft njerëz dhe shumë të interesuar? Por ai vazhdimisht ka dëshirë të shkon në vendet ku punohet? Pse? A dëshiron të njihet më tepër si njeri revolucionar apo pse? A dëshiron të njeh më tepër njerëz. Kjo vetëm më shtin të dyshoj se Shaqa ka lidhje me Nuhiun dhe është i dirigjuar prej tij. (Ky është vetëm një mendim i imi).

Por të gjitha mendimet tjera janë që Shaqën e kanë mëni dhe i ngrisin akuza për të vetmin qëllim që Shaqa ka pasë lidhje me Shtutgart, se gjoja në Shtutgart paskan hyrë "udbashët" dhe Shaqa si një njeri i cili ka qenë në Shqipëri dy vjet dhe tani paska ardhë gjoja si "udbash" dhe ka kontakt me udbashët e Shtutgartit. Të gjitha këto i kam ndëgjuar mirë. Jo këtu aq shumë, por në Bern, Biel e tjerë e sidomos në Gjenevë ngrihen akuza të ashpra kundër Shaqës dhe Shtutgartit. Nuk e di pse.

Ti je në kontakt më të shpesht me atë shokun (Xhafer Shatrin -shën i Xh.D.) dhe ke disa punë përsipër. Prandaj duhet t'i shikosh me kujdes më të madh, e jo t'i lejsh nasgja punët, se gjendja është mjaft serioze. Ne akuzohemi në shumë vende si "armiq" se gjoja kemi bërë mëkat të madh me "IKën" (Ibrahim Kelmendin). Si mund të dihen të gjitha këto dhe kush i informoj njerëzit për gjëra të tilla kur këto gjëra nuk i kanë ditë shumë njerëz. Të kemi kujdes dhe të përpiqemi ta gjejmë fajtorin. A janë fajtor njerëzit e "pa informuar" apo dikush tjetër. Dhe nëse dikush tjetër është fajtor, është mjaftë serioze, dhe duhet të kemi kujdes të madh, nëse në mes nesh po përdoret diplomacia. Përderisa është arritë ky unitet dhe jemi bashkue, atëherë për detyrë e kemi se si t'i zhdukim thash e themet e si po duket kjo nuk po praktikohet në të gjitha anët, dhe nëse kjo nuk praktikohet apo më mirë të them nuk hyn në zbatim si te ne ashtu edhe tek të tjerët, është shumë e rrezikshme. Ti shoku Skender e ke për detyrë, sikur që dinë ata çdo gjë për ne, të dish dhe të dimë edhe ne të gjitha për dikend tjetër. Shkurt ne duhet të njofim situatën nga afër. Kjo është detyrë që duhet zgjedhë sa më shpejt. Sikurse kemi bisedue në telefon, se do të vish tek ne diku kah 1 qershori 1983. Këtë bëne e mos e shtyj kohën se çdo humbje kohe na kushton si neve ashtu edhe të përgjithshmes.

Unë propozoj që ti të mos shkosh vetëm, me ty duhet të jetë edhe dikush. Kurrsesi nuk pranoj që bisedime të tilla bëhen vetëm me ty. Është më e drejtë të jetë edhe Faridini. Më lajmëro gjithsesi kur të nisesh. Kishte me qenë shumë mirë të takohemi ne para se të shkosh atje. Kishim bisedue edhe pak për situatën aktuale, për gjendjen këtu dhe në përgjithësi.

Tash edhe disa fjalë për Demën. Unë ka kohë që me te nuk jam takuar, por e dij që ai është mirë me disa shokë. E ka një banesë të keqe momentalisht por besoj se së shpejti do të gjendet një tjetër dhe ndonjë punë. Atëherë do të ketë mundësi më të mëdha që të kontribuoj, për atë nuk kam pse të flasim se është shumë në rregull. Shumë shokë që kanë kontakt me te janë të kënaqur për sjelljet dhe pjekurinë e tij. Para një jave doja të shkoj por nuk mujta për çështje materiale. Mirëpo besoj që së shpejti do të marrë kontakt me te. Besoj që do të shkoj te ai dhe atëherë mund t'ju shkruaj më tepër për te.

Sa më përket mua, rreth qëndrimit tim nuk kam çka të shkruaj. Momentalisht jam kështu siç e din edhe ti vetë, por besoj që së shpejti do të stabilizohem. E kisha ndërmend që brenda kësaj jave të stabilizohem (ta paraqes kërkesën për azil - shën i Xh.D.) por për hir të disa punëve nuk kam pasur mundësi se momentalisht jam shumë i zanun në çështjen e "Klubit". Jemi kah përpiqemi të gjejmë një lokal por ende nuk kemi vendosë diçka definitive, por së shpejti besoj që kam mundësi të shkruaj ma shumë për këtë problem.

Sa i përket emrit të "Klubit" kemi mendue t'i vemë "Ibe Palikuqi" apo "Xheladin Zeçiri" duke u nisë nga ajo se këtu gjendet një numër i madh i punëtorëve nga viset e aneksuara nga Maqedonia. Mendoj që do të jetë ma e suksesshme dhe shumë e arsyeshme nëse i vihet njëri nga këta dy emra. Tash momentalisht në këtë rreth tetovarët janë kah tregojnë aktivitet të madh. Shkurt, masivisht në këtë vit i kanë hyrë punës dhe nëse Klubit ia vejmë atë emër do të marrin edhe më tepër hov dhe do të punojnë me vullnet edhe më të madh.

Për këto pika kësaj radhe nuk do të ndalem shumë, sepse bëhet tepër, por radhave tjera do të shkruaj më gjerësisht. Tash vetëm një pyetje rreth Zërit numër 3: A e ke lexue dhe çka mendon?

Unë këtë numër e kam lexua dy herë dhe më ka pëlqyer shumë. Kishte pasë material të bollshëm dhe shumë të fortë. Më ka pëlqyer jashtëzakonisht por vetëm në një

pyetje e kam: Pse ju ka ndërrua forma organit dhe a je në dijeni për këtë? Më intereson vetëm arsyeja e këtij veprimi, edhe pse ishte mjaft i fortë po kjo më intereson.

Tani prit të fala nga Haxhiu.

Radhën tjetër të shkruaj më gjerësisht. Ju lutem më shkruani sa më shpejt. Mirë u pafshim.

2. Letër nga Haxhi Berisha për Xhafer Durmishin-Skenderin, fillim i korrikut 1983

Mirë dita i nderuari shoku Skender,

Ja tani më erdhi radha që të shkruaj edhe disa fjalë në lidhje me situatën aktuale këtu, si dhe me shumë çështje tjera të cilat na duhen për çdo ditë në jetën e përditshme. Së pari më vjen shumë keq që në letrën e parë që ta dërgova, më ktheve një përgjegje shumë të shkurtër, por prapë jam i bindur se me siguri koha nuk të ka premtuar që të thellohesh me tepër në të gjitha ato pika, të cilat i kisha cekë në atë letër, por të gjitha për mua janë të rëndësishme, dhe ju lutem që në këtë letër të thellohesh në të gjitha ato që i kam cekë.

Do të ishte mirë të më tregojsh arsyen pse nuk erdhe sipas asaj që biseduam në telefon, sepse kjo më jep nganjëherë të kuptoj se po i bën punët nasgja.

Sa i përket gjendjes këtu është mjaftë mirë. Momentalisht merrem me shfaqjen e filmave. Filmat shfaqen për çdo të diel dhe çdo herë shifra e të interesuarve e kalon 200-shin. Deri më tash kemi shfaq në Kreuzlingen. Edhe atje në fillim kishte mjaft të interesuar, por më vonë disa u larguan, për shkak se gjoja dikush paska folë në lidhje me këtë aktivitet dhe paska hapë një panik në masë. Por unë menjëherë kontaktova me shokët të cilët janë më aktiv në atë rreth, dhe vendosëm që filmat mos të shfaqen më si më parë, por të ndërrohet taktika e veprimit dhe ajo u bë, pra u vendosë që ata shokët t'i shfaqin filmat nëpër banesa të punëtorëve dhe kjo u tregua shumë e frytshme. Unë jam në korent të shpeshtë me këta shokë, dhe këta thonë se punët po shkojnë mjaftë mirë. Për çdo natë ka deri në 20 të interesuar.

Tash po kthehem prapë këtu. Si shënova më lartë deri në 200 veta vinë për çdo të dielë, për shikim filmash, dhe deri më tash çdo herë kemi bisedue në lidhje me klubin, dhe herën e fundit me pëlqimin e të gjithëve, u themelua klubi dhe u pagëzua me emrin "XHELADIN ZEQIRI". Sa i përket të gjitha formaliteteve në lidhje me klubin janë krye, vetëm presim që të premten të nënshkruhet kontrata në mes nesh dhe pronarit të lokalit. Për këtë se si bëhet do t'ju raportoj më vonë.

Deri më tash janë lajmëruar 120 anëtarë. Shumica e kanë pague anëtarësinë, por sidoqoftë unë jam shumë optimist në këtë drejtim dhe jam i bindun se në dy muajtë e parë të punës së klubit do të arrinë deri në 300 anëtarë dhe besojë se punët do të shkojnë shumë mirë dhe shpresoj që ky klub do të korrë sukseset më të mëdha në Zvicër, sepse këtu masa është mjaft e ngritur. Them kështu sepse këtu ka shumë të rinj.

Unë kam biseduar me disa shokë në rrethin e Buksit, dhe së shpejti edhe atje do të hapet një klub. Kuadro të cilët mund të drejtojnë apo më mirë të them që mund të kontribuojnë në këtë drejtim ka mjaft, të cilët nuk kursejnë asgjë. Gjithashtu mendohet se edhe ky Klub do të ketë së paku 300 anëtarë, sepse përfshinë një territor shumë të gjerë, duke i bashkuar një varg qytetesh. Është mendua që klubi i Buksit të pagëzohet me emrin "Ibe Palikuqi", mirëpo për këtë nuk është vendosë ende definitivisht. Ky është vetëm propozim i disa shokëve, por sidoqoftë është e mirë që edhe ju të thuani mendimin e juaj në lidhje me këtë, dhe mund t'u shpjegohet njerëzve e ata e kuptojnë. Klubi i St. Gallenit e muar këtë emër duke u nisë prej asaj se këtu gjendet një numër shumë i madh i shqiptarëve nga Tetova dhe pjesëve tjera nën Maqedoni, dhe momentalisht këta janë

shumë aktiv. Për hir të kësaj dhe të faktit se ky emër do t'i bashkoj të gjithë shqiptaret e këtyre viseve.

Këtu në afërsi gjendet një klub tjetër jugosllav në qytetin Vill i cili i kishte diku kah 160 anëtar, ku 90 prej tyre janë shqiptarë, siç treguan disa shokë. Shqiptarët në këtë klub nuk kanë kurrfarë të drejtash as nuk kanë filma shqip, as këngë as nuk posedojnë libra. Pra siç e sheh është një gjendje e vajtueshme, e aq më të vajtueshme gjendjen e bëjnë udhëheqësia e poshtër dhe disa tradhtarë të cilët gjenden në udhëheqësi. Megjithëkëtë unë do të përpjekem që në të ardhmen disa shokë të mirë, të bëhen anëtarë të këtij klubi, dhe në anën tjetër janë duke u munduar, disa shokë tjerë të cilët punojnë dhe jetojnë në këtë qytet, që të përvetësojnë sa më shumë shokë. Kështuqë edhe prej këtuhit nëse dikush anëtarësohet, ekziston mundësia që edhe ky klub të bie në duartë e punëtorëve. Edhe për këtë besoj se më mirë mund të tregoj radhën tjetër.

Në Luzern dhe në ato qytetet tjera përreth kam qenë disa herë por nuk mjafton. Është aq shumë e nevojshme që të shkoja më shpesh, por për shkak të kushteve objektive materiale nuk kam mundësi që të shkoj më shpesh. Megjithatë po merremi vesh ndonjëherë përmes telefonit. Edhe aty, momentalisht merren me shfaqjen e filmave. Thonë se kohëve të fundit edhe atje ka mjaft të interesuar, por atje nuk ekziston puna mirë në mes njerëzve të cilët në sipërfaqe duke si aktivista, siç duke lufta për karrierë. Është gjendja e njejtë siç ka qenë këtu më parë, a disa kohë. Para ca kohe isha atje dhe bisedova me disa prej tyre për çështjen e përgjithshme, për punët që na presin, për detyrat të cilat na i ka ngarkua (koha), dhe e dënova apo më mirë të them e kritikova luftën për karrierë, si sëmundje e cila me kohë duhet të shërohet. Si duket ajo vizitë e imja kishte pasë sukses deri diku, por duke ju falenderuar faktit se atje gjendet edhe ai shoku tjetër, i cili ishte në koncert, këta të dytë janë duke kontribuar në planin e përgjithshëm si dhe në shërimin e sëmundjes për karrierë. Është vërtetë fat i mirë që Demë (Mustafaj) së bashku me atë shokun tjetër gjenden në atë rreth, dhe besoj që do t'i japin një shtytje të madhe luftës.

Sa i përket Demës, ai është shumë në rregull, në pikëpamjet e përgjithshme si në relacionin me njerëz. Është shumë i hapët dhe simpatik për shumë njerëz, por për fat të keq deri më tash ka qenë keq ekonomikisht dhe nuk ka mund të jap atë çka prej tij pritet. Tash ai ia ka filluar punës dhe së shpejti do ta përmirëson gjendjen e vet ekonomike, dhe do të jap fryte më të mëdha. Edhe pse ai njeri deri më tash nuk ka punuar aq shumë, ai ka marrë pjesë rregullisht në shfaqjen e filmave, dhe ka njoftua një numër të madh njerëzish për shfaqjen e filmave. Gjithashtu deri më tani ka formua një rreth shokësh, por për mungesë të qarkullimit nuk ka mund të hapet më shumë.

Kur isha atje, gjatë bisedës me disa shokë unë shtrova hapjen e klubit të Luzern si një punë të domosdoshme, dhe të gjithë e përkrahën propozimin tim, vetëm kur ishte fjala që klubi të jetë i hapët edhe në lidhje me konzullatën, disa e arsyetonin se gjoja nuk ka kuadro të afta për atë punë, dhe njerëzit e aftë nuk paskan mundësi të kontribuojnë për atë klub, se gjoja njerëz të aftë dhe me njohuri të mëdha na qenkan vetëm ata të cilët e kanë të rrezikueme shkuarjen në Kosovë.

Unë këto botëkuptime ua hudha poshtë, duke u tregua shembullin e klubit të Zurichut dhe klubit të ri që u hap këtu në St. Gallen duke ua shpjeguar dobitë që janë në aspektin e përgjithshëm. Kuptohet të gjitha këto me shokët e Luzernit. Po shtoj edhe diçka rreth gjendjes në Luzern. Atje qenka një numër shumë i madh i shqiptarëve me fe frishtere. Këta thonin se katolikët janë shumë pak të interesuar. Arsyen se pse as unë nuk e di, se unë nuk mund të mbështetem në arsyetimet e disave. Për këtë unë propozova, që nëse klubi hapet, të pagëzohet me emrin "Zef Lush Marku", duke menduar se një klub që mban këtë emër do të bashkoj (afroj) më tepër katolikë.

* * *

Edhe kontratën e lokalit e bëmë. Tash së shpejti klubi do të fillon të punojë dhe çdo ditë po kemi punë edhe më të mëdha. Është shumë e arsyeshme sikur të më shkruash në çdo pikë që kërkoj të më përgjigjesh. Sidomos rasti i Shaqës është shumë rast serioz dhe për këtë nuk duhet që ne gjanat t'i bëjmë nasgja. Me sa më duket pasoj e kësaj është që A. P. (Abdullah Prapashtica) del tani si fraksionistë.

Më shkruaj në këtë adresë:
Faik Januzi (për Haxhiun)
Trischli strase 10
Rorschach 9400
SCHWEIZ

* * *

Tash do të ndalem edhe pak për gjendjen atje te ju. Si qëndron puna me ata kangjallozat. Unë ndëgjova për heroizmat e tyre dhe kjo nuk ishte për mua një e panjohur, edhe pse e kam ditur se herdokur Nuhija bashkë me Abdullah Prapashticën do ta tregojnë fytyrën e tyre të vërtetë. Por siç po shifet, e gjithë kjo nuk është vetëm një punë fraksioniste, por kjo mund të shtynë nganjëherë të mendojsh, se e gjithë kjo manovër ka qenë e përgatitur diku tjetër. Kjo sipas mendimit tim është një tradhti e pashoqe. Por sidoqoftë kjo nuk duhet të na frikëson, përkundrazi, të na bën sa më të fortë, se është fat i mirë që ata e treguan veten tash, se më vonë do të kishte qenë edhe më e rrezikshme një punë e tillë. Tash pra të mbetet që të më tregosh në pika të shkurta rreth këtyre "patriotëve". Më shkruaj në pika të shkurta për qëndrimin e shokëve tjerë, para një poshtërsie të tillë dhe a kanë arritur të përvetësojnë edhe ndonjë, apo janë demaskuar edhe më tepër. A e lexuat një trakt që u shpërnda para dy javësh dhe si ndikoi tek masa. Këtu ai trakt është lexue me interesim të madh dhe ka ndikue shumë pozitivisht në masë.

Në kohët e fundit unë kam marrë një letër nga shoku U (Xhafer Shatri - shën i Xh. D.). Ai më kishte shkrue në pika të shkurta në lidhje me punën e kangjallozave dhe ai më tha se ata kanë bërë një punë fraksioniste përçarëse, dhe më tha se duhet t'i luftojmë sa më shpejt dhe sa më ashpër. Mirëpo prapë, ai së bashku me letër ma dërgoj edhe një trakt tjetër i cili ka dalë tash në lidhje me punën e tyre si punë fraksioniste. Mua më pëlqeu, ishte një trakt mjaft i drejtë dhe përfshihet periudha e bashkimit të organizatave, dhe i cek pretendimet e përfaqësuesve të ish-PKMLSHJ, të cilët pretendonin që të formohet Partia Komuniste e Kosovës, dhe ofrimi i Fronit që i kanë bërë këtij shokut (Xhafer Shatrit - shën i Xh. D.) dhe përfshihen një varg çështjesh tjera, të cilat mendoj se do të jenë shumë të vlefshme për opinionin që ta thonë mendimin e tyre në lidhje me këtë punë përçarëse dhe fraksioniste. Por unë për këtë mendoj se janë pasojat e Centralizmit Demokratik. Mendoj se nuk kemi qenë mjaftë të ashpër kundër këtyre gjanave dhe me lëshimet e njëpasnjëshme u kemi dhënë shansë që ata të futen tepër në këtë rrugë të gabueshme. Por për këtë ne do t'i shohim se ku do t'i qetë kjo rrugë. Tash së bashku me këtë letër ta dërgoj edhe një trakt intern në lidhje me këtë tradhtinë e pashoqe.

Mua më intereson të di edhe në lidhje me Shaqën, a ke pasë më lidhje telefonike dhe çfarë të thotë ai? Si qëndron gjendja me te. Unë nga ai shoku (Xhafer Shatri-shën i Xh. D.) e mora vesh se ai paska lidhje të ngushtë me Nuhiun. Më shkruaj në pika të shkurta në lidhje me te, se vërtetë të shtynë të mendojsh, sidomos ajo që Shaqa nuk ka kontribue në vendin ku ka jetue dhe punue. Të shtynë të mendosh se vërtetë ai është njeri i cili ka dëshirë të tregohet në mese tjera, gjoja si aktivist dhe t'u shet mend të tjerëve se si duhet të punohet. Kjo është e vetmja që më ka shty deri më tani të mendoj se vërtetë edhe Shaqa lëngon nga sëmundja e karrierës, por tek ky gjanat ndryshojnë se ky është

dhe do të bëhet edhe më i rrezikshëm. Po që se në mes tij dhe Nuhisë ekzistojnë lidhje të ngushta, për këtë ne duhet të jemi shumë syçelë dhe vigjilentë.

Tash shoku Skender mendoj se të gjitha këto na japin të kuptojmë se vërtetë jetojmë në një kohë përplot kontradikta dhe probleme si dhe është e kjart që kemi shumë armiq dhe tradhtarë, por edhe ne kemi mbi vete probleme të koklavitura, dhe për këtë duhet t'i koordinojmë punët sa më mirë dhe të mos e lejmë asnjë shpraztirë që ta shfrytëzon armiku për qëllimet e veta.

Më shkruaj edhe për gjendjen aktuale, si qëndron në Gjermani, në Dusseldorf, Hamburg, Munchen dhe në qytete tjera. Në Hamburg si janë punët me klube, a janë regjistrue shumë anëtarë, në Munchen a ke qenë dhe si qëndron puna. Për Shtutgart nuk po të pyes se po merrem vesh nganjëherë me Faridinin dhe Hafizin.

Po ti si je me shëndet, a po lodhesh dhe si po e kalon me punë. Prej familjes a ke ndonjë letër apo ndonjë telefon, si janë. Me atë shokun a ke lidhje telefonike dhe ç'thotë, si janë punët në Kosovë?

Me Mërgimin (Sabri Novosellën) a ke këmbim letrash, dhe si është me shëndet, familjen si e ka dhe a e ka brengosë puna e këtyre pisave. Çka thotë ai për këtë, çfarë duhet bërë dhe cilat masa duhet të merren momentalisht kundër tyre. Shiqo, dhe i thuaj të ketë kujdes në këtë situatë, se po që se ne do t'i sulmojmë përmes Zërit të Kosovës, atëherë mund të ndodhë që këta e shofin se e kanë humbur potezin dhe prej tyre pritet çdo gjë. Nuk është hiq larg mendsh se pas të gjitha këtyre, se Abdullah Prapashtica ka qenë i ushtruar për një punë të tillë, dhe ka dalë me të vetmin qëllim që popullit tonë të shenjtë t'ja zgjatë prangat e robërisë. Për këtë do ta shofim më vonë se si do të përfundon e gjithë kjo zoologji.

Ti personalisht ke kujdes dhe mos u sjellë kohë e pa kohë dhe mundësisht të mos operojsh shumë. Kjo që them është në interesin e përgjithshëm dhe asaj duhet të përmbahemi. Të jesh i kujdesshëm nuk do të thotë se po frikohesh, por përkundrazi je edhe më i fortë dhe do të luftosh edhe më fort armikun. Sepse vërtetë kur ata do ta humbin terrenin atëherë prej tyre pritet çdo gjë.

Tash të pyes edhe për Naimin, a të ka shkrua ndonjë letër dhe ç'thotë ai? Çfarë ka bërë me strehim apo nuk i ka hyrë kësaj pune ende atje.

Si qëndron puna me shokët e Zvicrës, me Ukën (Xhafer Shatrin-shën i Xh. D.) a po ke këmbime letrash dhe çka thotë ai për të gjithë këto, çfarë mendon për ata pisat, dhe a është i bindur në ato të cilat i thonim ne para sa kohësh. Çfarë mendon, a janë zhdukur ato mbeturinat e kalueme dhe nëse jo, si të veprojmë që ato mbeturina të zhduken sa më parë.

Unë mendoj që ne duhet të veprojmë ashtu si deri më tani. Të jemi të sinqert dhe të punojmë sa më tepër, dhe puna e çdonjërit do të shihet. Kryesorja është që ne mos t'u lëmë vend mbeturinave të krijohen, se pastaj do të ishte keq për të dy anët, dhe kjo vërtetë do të ishte vetëvrasje. Sa kam mund të vërej, se këndej gjendja ka qenë e vajtueshme dhe plotë thashetheme, e prej nga rrjedhin apo nga kanë rrjedhë është pyetje pa përgjigje...!

Dhe nja dy fjalë në lidhje me gjendjen time. Unë momentalisht jam i papunë, i pa banesë, pa leje të qëndrimit dhe pa asgjë në këtë drejtim, por në realitet asgjë nuk më mungon, i kam të gjitha, kam një numër të madh shokësh që po ma mundësojnë qëndrimin këtu. E kam ndërmend t'i hy strehimit (ta paraqes kërkesën për azil) por për shkak të klubit dhe shumë punëve tjera nuk kam mund t'i hyj kësaj pune ende, se kërkesa për azil do të më izolonte për një kohë, dhe kjo do të ishte jo e dobishme për punën tonë. Në të ardhshmen do të rregullohen të gjitha për këtë jam shumë optimist.

Në pritje të përgjegjes ju përshëndes me gjithë zemër, duke ju dëshiruar shëndet të mirë dhe suksese në punë.

Haxhi Berisha

3. Letër nga Haxhi Berisha për shokët, 15 mars 1984

Të nderuar shokë, Amriswil, Më datën 15 mas 1984

E shoh të arsyeshme të ju dërgoj këtë letër, pasiqë kontaktet dhe mundësia që të kontaktojmë janë jo të lehta. Nga ana tjetër nevoja për një koordinim të mendimeve dhe të veprimeve ndihet më tepër se kurrë ndonjëherë më parë. Sot e shohim më mirë se çdo herë deri më tani, punën e gjertanishme, si dhe të metat dhe gabimet që i kemi pas dhe që ende i kemi, i shohim lëshimet e njëpasnjëshme, oportunizmin dhe deri në një masë mospërgjegjësinë ndaj çështjes. I shohim të gjitha këto sot, sepse të gjitha po shëndrisin, po bëhen dita ditës edhe më të dukshme!

Pse deri më tani nga ana jonë u bënë këto gabime? Pse çdo gjë u la në mëshirën e stihisë? Pse s'u bë një organizim i mirëfilltë, format e ilegalitetit, që është bazë për çdo aktivitet patriotiko-revolucionar?

Shokë, çdonjëri prej nesh e kupton situatën në të cilën gjendemi?! Pra të gjithë ne e kuptojmë se kemi një barrë të rëndë mbi supe, dhe se para nesh shtrohen detyra të mëdha dhe shumë të rëndësishme të cilat duhet t'i kryejmë me nder, guxim, dhe vetëmohim revolucionar.

Të dashur shokë, për kryerjen e këtyre obligimeve me të cilat na ka ngarkuar koha, me një përpikmëri dhe pjekuri të duhur revolucionare është i domosdoshëm shtrëngimi dhe organizimi i radhëve duke u bazuar në praktikën revolucionare. Pra duke i zbatuar me konsekuencë format dhe metodat e ilegalitetit, e jo t'i lihet çdo gjë stihisë!...

Shokë, unë propozojë riaktivizimin dhe riorganizimin e "Komitetit Vëllezërit Gërvalla" si detyrë që sa më shpejt duhet të zgjidhet. E them këtë duke u nisë nga fakti se një Komitet i tillë është formua që të jetë bartës i aktivitetit patriotiko-revolucionar e jo të ekzistoj vetëm formalisht.

Të dashur shokë, ju lutem që në momentin e parë që ta merrni këtë letër, më dërgoni edhe mendimet tuaja në lidhje me këtë propozim.

Unë propozoj edhe shokun Ali për këtë forum, prandaj edhe atij do t'ia dërgoj këtë letër. Kjo letër u dërgohet anëtarëve të KVG gjegjësisht; Skenderit, Faridinit, Hafizit, Naimit.

Unë jam mirë si me shëndet ashtu edhe në përgjithësi, me shokë kaloj gjithashtu mirë. Dëshiroj që edhe ju të jeni mirë. Të fala Haxhiu

LETRA NGA XHAFER SHATRI

Për periudhën 16 maj 1982 - 29 tetor 1984

1. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin dhe Osman Osmanin, 16 maj 1982
2. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin dhe Osman Osmanin, pas 16 majit 1982
3. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, korrik 1982
4. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 10 korrik 1982
5. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 25 korrik 1982
6. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 31 korrik 1982
7. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, verë 1982

8. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 9 gusht 982
9. Letër e Xhafer Shatrit për Sabri Novosellën, 16 gusht 1982
10. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 24 gusht 1982
11. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 8 shtator 1982
12. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 11 shtator 1982
13. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 20 shtator 1982
14. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 26 shtator 1982
15. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 9 tetor 1982
16. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 10 tetor 1982
17. Letër e Xhafer Shatrit për Sabri Novosellën, 12 tetor 1982
18. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 18 tetor 1982
19. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 1 nëntor 1982
20. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 14 nëntor 1982
21. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, dhjetor 1982
22. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 19 dhjetor 1982
23. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, dimër 1982
24. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 26 dhjetor 1982
25. Letër e Xhafer Shatrit për Remzi Ademin, janar 1982
26. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 4 janar 1983
27. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 31 janar 1983
28. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, shkurt 1983
29. Xhafer Shatri -- Letër-Qarkore, mars 1983
30. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 5 prill 1983
31. Letër e Xhafer Shatrit për Remzi Ademin, 28 prill 1983
32. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 28 prill 1983
33. Letër e Xhafer Shatrit për Remzi Ademin, 9 maj 1983
34. Letër e Xhafer Shatrit për Qendrën Ekzekutive, 1 qershor 1983
35. Letër e Xhafer Shatrit në emër të Qendrës Ekzekutive, 7 qershor 1983
36. Letër e Xhafer Shatrit për Remzi Ademin, 10 qershor 1983
37. Letër e Xhafer Shatrit - Qarkore në emër të Redaksisë së Zërit të Kosovës, qershor 1983
38. Letër e Xhafer Shatrit për Sabri Novosellën, verë 1983
39. Letër e Xhafer Shatrit për Remzi Ademin, 7 korrik 1983
40. Letër e Xhafer Shatrit për Qendrën Ekzekutive, 26 korrik 1983
41. Letër e Xhafer Shatrit për Remzi Ademin, 27 korrik 1983
42. Letër e Xhafer Shatrit për Qendrën Ekzekutive, 31 korrik 1983
43. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, gusht 1983
44. Letër e Xhafer Shatrit për QE - apo në emër të Qendrës Ekzekutive, 31 gusht 1983
45. Letër e Xhafer Shatrit në emër të Qendrës Ekzekutive, shtator 1983
46. Letër e Xhafer Shatrit në emër të Qendrës Ekzekutive, tetor 1983
47. Letër e Xhafer Shatrit për Asllan Muharremin, Faridin Tafallarin e Xhafer Durmishin, 18 tetor 1983
48. Letër e Xhafer Shatrit për Asllan Muharremin, 24 tetor 1983
49. Letër e Xhafer Shatrit për Asllan Muharremin, tetor 1983
50. Letër e Xhafer Shatrit për Remzi Ademin, 3 nëntor 1983
51. Letër e Xhafer Shatrit për Remzi Ademin, 7 nëntor 1983
52. Letër e Xhafer Shatrit për Asllan Muharremin, 22 nëntor 1983
53. Letër e Xhafer Shatrit për shokët e Komitetit Qendror (me përjashtim të Xhafer Durmishit), 19 prill 1984
54. Letër e Xhafer Shatrit për shokët të Shtutgartit, 1 maj 1984

55. Letër e Xhafer Shatrit për Ibrahim Kelmendin, 1 maj 1984
56. Letër e Xhafer Shatrit në emër të shokëve nga Zvicra, 29 qershor 1984
57. Letër e Xhafer Shatrit për Faridin Tafallarin, 29 tetor 1984
58. NJOFTIM I SHOKËVE NGA ZVICRA

Faridin Tafallari*: "Me organizatën Marksiste Leniniste të Kosovës (OMLK), që e kishte qendrën e vetë në Zvicër u vu në lidhje edhe Hysen Gegaj. Ky na tregoi se ishte takuar me përfaqësuesit e kësaj organizate. Hyseni foli shumë mire për ta. Por shtoi se për t'u bashkuar pranonin* ***vetëm me kushtin që të udhëhiqnin ata****."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 28)

Vlerësimet e mëposhtme të Hasan Malës e Xhafer Shatrit janë për librin "Terror-Dhimbje-Qëndresë të Faridin Tafallarit.

Hasan Mala*: "Nga zemra të uroj shumë sinqerisht dhe sukses, se është shkruar ashtu si është, si ka qenë. Të lumtë, të lumtë .... se aty është e vërteta dhe vetëm e vërteta."* (Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, f.382)
dhe

Xhafer Shatri*: "Libri është një realitet dhe i paanshëm. Ky libër është si një lis i natyrshëm...Andaj, të lumtë dhe të uroj nga zemra suksese që iu kushtove këtij libri madhor të kohës...".* (Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, f.382)

Mehmet Hajrizi: *"Fillimisht duhet thënë se organizimi në Shqipëri i Luftës Nacionalçlirimtare, që për veprimtarët e kohës, në saje të literaturës që vinte nga Shqipëria, ishte në detaje i njohur, u bë modeli më i afërt, për ta zbatuar në kushtet e çlirimit të Kosovës. Atje ka pasur një Front Nacionalçlirimtar, që bashkonte forcat antifashiste të bindjeve të ndryshme, por Partia Komuniste në të* ***RUANTE ROLIN HEGJEMON."*** *(*Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 97)

Më 14 e 15 maj, në Zvicër u bë një takim në mes Xhafer Shatrit, Osman Osmanit dhe Xhafer Durmishit. Në atë takim, me propozim të Xhafer Shatrit u ndanë këto pseudonime:

Xhafer Shatri- Lleshi
Osman Osmani- Nika
Xhafer Durmishi - Gjergji

Sqarimi kësaj çështje e lehtëson orientimin në këtë korrespondencë.

Në letrën e parë dhe të dytë e kam përdorë apo vendosur në kllapa fjalinë "**Të dyshimtit provokoni në atë drejtim që ta dini se si po reagojnë"** të Xhafer Shatrit nga letra e tij e majit (e dyta sipas numrit rendor në këtë listë) e cila më duket se ndihmon për t'i ilustruar më mirë mendimet e vetë autorit të saj (pra Xh. Sh.)

1. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin dhe Osman Osmanin, 16 maj 1982

Të dashur shokë!

Edhe pse jemi parë dje, po ju drejtohem sërish me këto rreshta në mënyrë që t'i konkretizoj disa gjëra. Komenti do të zgjatet ndoshta edhe më tepër se ç'ju kam thënë për arsyen e thjeshtë se ai duhet të jetë i gjatë, së paku katër faqe të organit dhe se në te do të

jenë konturet e programit politik të LRSHJ-së, i cili më vonë duhet të përkthehet në disa gjuhë dhe t'u dërgohet gazetave, institucioneve dhe shteteve të ndryshme. Prej artikujve që përmenda me këtë rast duhet ta botojmë (po mendon në artikujt që më keni dhënë). "Letrën e një mërgimtari" dhe letrën dërguar Kryetarit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut të OKB-së dhe Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, prandaj ju lutem që në këtë drejtim të punoni ndonjë artikull dhe të ma dërgoni sa më parë.

Edhe përsa i përket punimit që u kam thënë do t'ua dërgoj me një vonesë të vogël, për shkak të përmirësimeve që duhet t'i bëhen në mënyrë që t'i përshtatet plotësisht kushteve të reja.

Do të ishte shumë e rëndësishme që të punoni edhe në përgatitjen e terrenit për dërgimin e organit të ardhshëm në Vajazan, kuptohet se kjo gjë duhet të bëhet në fshehtësinë më të thellë DHE ME PJEKURINË MË TË MADHE dhe për këtë të jeni në korrent vetëm ju të dy dhe askush tjetër, absolutisht askush tjetër. Gjithashtu ju lutem që në të ardhmen të përgatitni që të dy nga një referat për punën e deritashme duke hyrë në imtësitë më të vogla, qoftë të punës në kurbet, qoftë të punës në Vajazan, sepse i kam disa ide origjinale dhe një njohuri e tillë do të më ndihmonte shumë që t'ua konkretizoj sa më mirë atë që më duket shumë e domosdoshme ta bëjmë në këtë kohë.

Çështjen e statusit tuaj është shumë e rëndësishme ta rregulloni sa më parë, sidomos Nika, sepse kërcënimi i atij dostit është mjaft shqetësues. Lidhur me mart. mos u ngutni, sepse fare lehtë mund të ndodhë, që ato, në vend të ndihmës, të kthehen në një pengesë të madhe, të cilën ju sot është shumë vështirë edhe ta paramendoni.

Lidhur me atë rastin e djeshëm, ju mund t'i njoftoni shokët në mënyrë të përgjithësuar, pa përmendur asesi emra ose vende dhe në të ardhmen kujdesuni shumë që për vendin, kohën dhe qëllimin e tak. tonë të mos dijë askush tjetër, pos ju të dyve, absolutisht askush tjetër. Kjo praktikë duhet të kthehet në një princip të përhershëm.

(**Të dyshimtit provokoni në atë drejtim që ta dini se si po reagojnë)**

Po që se ju jepet rasti, ju lutem që t'ia përcillni Kamberit argumentimet tona lidhur me nevojën e ndryshimit të emrit të organit dhe përpiquni të jeni sa më origjinal dhe sa më të arsyeshëm dhe këtë mos e bëni sa për ta bërë, por vetëm pse është shumë e nevojshme.

Po që se ka diçka lidhur me I., më njoftoni, por asesi mos veproni jashtë suazave për të cilat kemi vendosur, pra takt dhe pjekuri të madhe. Gjithashtu pyeteni N., për njëfarë Mehmet Bala e Isniqit dhe më njoftoni menjëherë edhe për këtë gjë. Mos i tregoni se kush po interesohet për të, më duket se i përmenduri e ka edhe babain atje dikund tek ju.

Lidhur me artikujt që ju thashë, ata së paku në këtë numër duhet të jenë shumë të qëlluar, të gdhendur mirë dhe kryesisht nxitës e luftarak. Momentalisht ma merr mendja se në faqen e parë s'është e nevojshme të jetë fare ai simboli i L..., sepse mjafton vetëm ai i pari.

Do të ishte shumë mirë që të interesoheni dhe disi të veni kontakt me shokët tuaj në Vajazan, por me kujdes të madh, se mos i rrezikoni, sepse për ne është më se e domosdoshme që të kemi një pamje të qartë se ç'po ndodh atje, por ama kontakti të vihet në atë mënyrë që të mos humbim asgjë në këtë drejtim.

Në pritje të përgjigjes suaj, pritni përshëndetjet vëllazërore të

Lleshit (Xh. Shatrit), 16 maj 1982

Më shkruani në këtë adresë: Sandui Grandinari, Post Restant 1242, Satigny, Helvetia.

(Kjo letër i është dërguar Xhafer Durmishit dhe Osman Osmanit)

(Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë1998, f. 162-164)

2. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin dhe Osman Osmanin, pas 16 majit 1982

Të dashur shokë, mbrëmë ua dërgova punimet dhe një letër të shkruar me këtë "arapqen" time, të cilën zor se do të mund ta lexoni. E di se janë vonuar por vërtetë ka qenë e pamundur të mbaroj punë më parë. Komenti s'doli ashtu siç e kam paramenduar unë, u frikova se mos po e zgjas dhe mos po bie në përsëritje, përndryshe punimi që është përgatitur si pjesë historike e Programit Politik u pa e nevojshme të botohet si gjoja punim që e ka shkruar një gjerman sepse afekti i tij ashtu do të jetë më i madh, pra si rubrikë e veçantë "Çka shkruajnë miqtë tanë për ne". Unë ia dhashë dikujt ta përpunoj pakëz por ai i kishte lënë disa gjëra shumë të rëndësishme, ndërsa ju po që se e shihni të arsyeshme ta botoni bazohuni kryesisht në kopjen e parë që teknikisht ka dalur më e dobët. Komentin e lash më të shkurtë sepse ma mori mendja që të jetë më shumë si thirrje për mobilizim, ndërsa për qëllimin e Lëvizjes do të jetë e mjaftueshme komunikata. Këto që të dyja i kam shkruar si në emër të KQ për shkak të efektit që do ta kenë. Në komunikatë, siç e patë i kam bërë disa gdhendje e plotësime të cilat s'e kanë dëmtuar aspak esencën e saj të mëparshme. Për "Prijësen ideore" që flitet më duket e gjymtë shprehja Organizata komuniste, sepse ne duhet ta formojmë P. (partinë-shën i Xh. D.) të cilën më duket se është më së miri ta emërtojmë P. e Popullit, apo popullore. Ky do të ishte vërtetë një emër origjinal, ndërsa përmbajtjen do t'i pasuronim ne me punë revolucionare e ide m-l. (marksiste-leniniste-shën i Xh. D.). Për këtë i kam shkruar edhe Kamberit (Sabri Novosellës).

Sa për dasmë (demonstratë), tash duhet t'i nisni propagandimit të saj në mënyrë të përgjithësuar, përndryshe në këtë situatë ajo duhet të bëhet vetëm në një vend dhe të bëhet si duhet në mënyrë që në këtë fillim (nisje prej zerosh-shën i Xh. D.) të jetë njëfarë lloj prove praktike e perspektivës që ka hapur bashkimi ynë. Për leje siç e thash edhe në telefon këtu jepen vetëm dy javë para saj, kështu që ne i kemi organizuar njerëzit që të kërkojnë në dy vende, në Gj. (Gjenevë) dhe B. (Bern) e ku të ndezë atëherë po ia mësyjmë.

Lidhur me zgjerimin e radhëve, mos bëni ndonjë hap të ngutur se mos po bini në "minë" shkoni vetëm në njerëz të sigurt, **ndërsa të dyshimtit provokoni në atë drejtim që ta dini se si po reagojnë**. Këtë punim për çështje organizative akoma s'ia kam përshtatur emrit të ri, por megjithatë do t'ua dërgoja, mirëpo s'po guxoj se mos po përcillet posta e pastaj dihet çelësi i punës sonë...

Për materiale të organit këqyrni dhe seleksiononi si duhet në mënyrë që të mos jetë njëngjyrësh, por në të ardhmen bile një muaj para botimit do t'i tubojmë të gjitha materialet dhe do ta bëjmë maketën e numrit të ri.

Për fjalime të botuara apo të lexuara në dasma ma merr mendja se do të ishte shumë mirë që ta shkruani një reportazh për dasmat e B. (Bonit) dhe V. (Vjenës), ky do të kishte efektin e vet.

Shokëve tanë që kanë fëmijë të rritur u thuani apo caktojuani nga një poezi që ta mësojnë përmendësh në mënyrë që ta recitojnë në dasmë si duhet, duke i abstrahuar të metat e të mëparshmeve dhe duke marrë nga të mirat e tyre.

(Të dyshimtit provokoni në atë drejtim që ta dini se si po reagojnë)

Për emër të organit (revistës) meqë po dalim haptas, **unë s'e shohë të nevojshme t'ia ndërrojmë emrin fare**, por në faqen e parë nëse stema nuk del si duhet atëherë qiteni si më parë, sepse si simbol vërtetë është shumë i mirë. Përndryshe komunikatën botojeni me shkronja nëntitujsh si material me rëndësi historike. Bile s'do të ishte keq që ta botojmë e shpërndajmë së bashku me letërthirrjen për dasmë të cilën do ta shkruaj në rastin e parë dhe do t'ua dërgoj që ta shumëzoni me makinën e re, por nëse s'keni mundësi ta bëni këtë atëherë më lajmëroni. Për çdo rast nëse del diçka e ngutshme ju mund të më kërkoni në atë numrin që ua kam dhënë atë natë. Më kërkoni si Ukë dhe u thuani për kur u duhem dhe ku duhet t'u thërras apo t'u pres.

(**Të dyshimtit provokoni në atë drejtim që ta dini se si po reagojnë)**

Tash besoj së shpejti do të ndërmarrim diçka që ta sjellim këtu Halimin, **ndërsa për makina do të ishte mirë që t'i sjellim së bashku me dasmorët në autobus** por njëherë ju kryejeni shtypjen. Për Halimin na duhet të marrim gjithsesi mbrojtës se s'shkon ndryshe, sepse këta ... po shkojnë duke e ashpërsuar punën me të huajt. Përndryshe mua më kanë detyruar të punojë dhe kjo po më pengon vërtetë shumë, por s'ke ç't'i bëjsh, sepse tash për tash s'ke kah të luajsh.

Me Ibra. (Ibrahim Kelmendin-shën i Xh. D.) ka pasur kontakt një shok imi dhe i ka treguar për bashkimin, kështu që edhe ju ashtu siç jemi marrë vesh lejeni vetëm Far. (Faridin Tafallarin-shën i Xh D) që të kontaktoj me te dhe të tregohet shumë i pjekur dhe i kujdesshëm, sepse ne duhet të kemi sa më shumë aleatë.

Kur kam menduar për ndarjen e detyrave, sidomos për çështje org. (organizative-shën i Xh D), kam menduar se Nika (Osman Osmani) kryesisht të orientohet brenda sepse e njeh terrenin, ka ardhur tash rishtas dhe s'i ka shkëputur lidhjet me njerëz... Ky është për neve fronti më i rëndësishëm dhe pa forcimin e tij ne jemi vetëm një hiq, sepse baza është atje dhe rrënjët tona duhet të jenë atje shumë të forta, absolutisht të pavdekshme po që se ne duam të ekzistojmë.

Ju lutem që për këtë çështje të mendoni shumë.

Tash në pritje të përgjigjes suaj pritni përshëndetjet vëllazërore të

Lleshit.

2 maj 1982 (Gabim shtypi-kronologjie sepse kjo letër është shkruar pas 15 majit dhe para qershorit 1982-shën i Xh. D.)

Në faqen e fundit shënojini adresat e "ZK" (Zërit të Kosovës) në disa shtete ku mund të shkruajnë lexuesit. Ja një adresë e mirë por të mos i shtohet asgjë tjetër: BUCHHANDLUNG, BADHAUSSTR. 35, 2503 BIEL-BIENNE, SUISSE

3. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, korrik 1982

Shok Gjergj,

dje i mora të gjitha materialet që m'i ke dërguar, prandaj të falemnderit, por që në fillim më duhet të them se procesverbali më shqetësoi bukur shumë, disi ai N. ishte larguar shumë keq. Ajo është shumë e dëmshme dhe absolutisht e palejueshme... njëkohësisht i mora edhe dy letra të Kamberit dhe duke iu përgjegjur në to i thash se disi kam përshtypjen se prej fillimit e gjer më sot dikush ka manipuluar me Sahitin, me qëllim që duke i nxitur njerëzit njërin kundër tjetrit ta marrë vet situatën në dorë, prandaj është e domosdoshme që t'i hapësh sytë dhe asesi të mos e lëshosh situatën nga duart, pastaj do të ishte shumë mirë që ta analizosh çdo gjest të njerëzve gjer më sot prej që i njef dhe për çdo njërin të më njoftosh gjerësisht në mënyrë që ta kam një pasqyrë sa më të qartë dhe

të dimë se çka duhet të ndërmarrim, por ti mos gabo ta humbësh torruan apo gjakftohtësinë, sepse dikush mund të leverdisë në këtë farë zbrazëtire që është krijuar. Prandaj ke kujdes se këtu aspak nuk është në pyetje frikësimi i mundshëm i N., por prapa kësaj fshehet krejt diçka tjetër e ndoshta është në pyetje edhe dëshpërimi i tij, sepse ka pritur më shumë ndoshta... sido qoftë hapi sytë sepse kjo mund të ketë pasoja të mëdha edhe tek anëtarët tjerë të K. Është shumë me rëndësi ta di se çfarë qëndrimi në këtë rast (konkretisht pas daljes së tij (N.) nga mbledhja në mënyrë aq demonstrative), ka pasur Nika (Osman Osmani-shën i red.), a ndërmori diçka që ta qetësoj situatën sepse ai ndoshta ka ndikim tek N. dhe të mos e lerë punën të shkoj më larg. Sidoqoftë ti më shkruaj menjëherë dhe propozo se çka të ndërmarrim, apo ndoshta mund ta bindësh N. që disi të vie këndej dhe të bisedoj me të unë, në mënyrë që të mos e lëmë këtë punë të shkojë më larg. Sa i përket Nai. ti duhet të kesh ndikim më të madh tek ai shok, sepse ai, ashtu si edhe ne të gjithë, është ushtar i popullit dhe s'guxon të bëjë apo ndërmarrë asgjë pa iu dhënë urdhër për atë gjë, përndryshe j. memzi që presin që ne të merremi me gjëra të tilla me të cilat jo vetëm se nuk arrijmë asgjë, por edhe e dëmtojmë çështjen shumë keq. Në anën tjetër duhet ta kanë të qartë që të gjithë se këtu ka disiplinë dhe askush s'guxon të hyjë e të dalë sa herë t'i teket në LRSHJ, apo aq më pak të bëjë çka t'i dojë qejfi. Bëjua të gjithëve me dije se nuk jemi klub anglez, por organizatë revolucionare e cila i ka ligjet e veta të cilave s'mund t'u shpëtoj askush.

Punimet i mora dhe siç e ke parë edhe ti ato duhet të përpunohen shumë, sepse në mesin e tyre vërtetë ka shumë të dobëta, dhe këto s'do të mund t'i dërgoj të gjitha menjëherë, por herë pas here dhe ti nëse mundesh nisja t'i shtypësh që tash nëse ekziston një mundësi e tillë, por ngadalë dhe të kesh kujdes që të mos bëjsh asnjë gabim, e pastaj i qet në faqe konkrete ashtu siç të konvenon më së miri, ndërsa për citatin e Jusufit aty s'ka kurrfarë problemi, larg asaj, por ma merr mendja se duke i lexuar punimet e tij të shumta ne do të hasim në citate tjera po ashtu të fuqishme dhe herëpasherë do të qesim edhe tjera. Punimi i Qemalit për gjendjen ekonomike është shumë i mirë, por duhet të korrigjohet, ndërsa ai tjetri s'më pëlqeu edhe aq. Sot e përpunova punimin e Kamberit për Plisin... ndërsa ditëve tjera ata tjerët dhe do t'i dërgoj me radhë dhe mundësisht sa më shpejt por besomë se po kam shumë punë, ndërsa në mbrëmje po kthehem mjaft i lodhur.

Sidoqoftë me organin s'bën të ngutemi, por ta qesim sa më mirë që tash, përndryshe kur të kem mundësi ta lë punën atëherë do të punojmë në të shumë më tepër, dhe natyrisht do të përpiqemi që të dalë në nivel artistik që ka qenë gjatë jetës së Sokolit. Para disa ditësh ta kam dërguar një letër të përgjithësuar për shokët e KD në të cilën jam përpjekur që t'i jap mendimet e mia lidhur me dy letrat që i ka dërguar Kushtrimi, prandaj do dëshiroja të dijë se a e ke marrë, njëherit pyete Nikën se a erdhi akoma ai punimi apo ç'u bë me të, të them të drejtën kjo gjë më ka shqetësuar bukur shumë... mos rastësisht kanë rënë në dorë të të zinjve... në atë punim janë bërë disa lëshime teknike, por besoj se nuk ka humbur shumë nga vlera.

Për këtë numër të organit unë po punoj në një koment për Kong. e XII dhe për këto proceset e tashme politike në Kosovë, dhe posa t'i mbaroj do t'i dërgoj. Sa i përket propozimit tënd për grumbullimin e të hollave ai është i drejt, këtë ta kam thënë që në fillim, por të them të drejtën në këtë drejtim po çalojmë, sepse kemi bërë shpenzime të mëdha duke u përpjekur që të mos i lemë të durojnë urie shumë nga familjet e shokëve tanë të burgosur. Mendoj se për këtë numër do të ishte mirë ta botojmë një letër të prekshme dhe përmes saj të kërkojmë ndihma materiale për familjet e të burgosurve. Letrën do ta shkruaj unë, por ti mendo se si, në çfarë mënyrë dhe ku duhet të dërgohen ato ndihma, në atë adresën e mëparshme apo gjetkë? Letra duhet të botohet në faqen e fundit...

Gjergj, është mirë që me Nikën ta kontaktoni sa më shpesh dhe t'i sqaroni çështjet me gjakftohtësi e sinqeritet dhe të mos e leni punën të marrë përmasa të këqija, sepse do të na dëmtonte shumë. Ju s'jeni të rinj asnjëri sa të mos e kuptoni se çfarë përgjegjësie keni. Kaq... Priti përshëndetjet vëllazërore të Ll. (Xhafer Shatri)

4. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 10 korrik 1982

I dashuri shok, 10 korrik 1982

mbrëmë i mora dy letrat tua në të cilat i mësova bukur shumë gjëra lidhur me marrëdhëniet e ju të dyve (Xhafer Durmishit e Osman Osmanit-shën i Xh. D.), për të cilat kam shpresuar se duhet të jenë në nivel më të lart, por sidoqoftë këto janë gjëra që ndodhin, prandaj është edhe e domosdoshme që të tregohemi të pjekur e tolerantë dhe kurrë të mos i merrni njerëzit si duhet të jenë, por ashtu siç janë, me të gjitha të metat e mundshme që i kanë. Sidomos në të ardhmen keni kujdes, që në prezencë të të tjerëve të mos i qitni në shesh kundërthëniet tuaja, sepse në atë mënyrë e humbni autoritetin në sy të shokëve dhe ata pastaj s'u binden urdhërave tuaja, apo nëse në të ardhmen vie gjer tek ndonjë konflikt i ngjashëm, ju duhet të delni dikund dhe vetëm ju të dytë t'i shqyrtoni ato probleme. Përndryshe sa i përket motos së organit ato fjalë vetëm sa e bëjnë më të fuqishëm atë. Por mu për atë citat unë ka menduar se do të ishte mirë që të gdhendet në një gur (obelisk) të përbashkët varresh për të tre shokët sepse vërtetë është shumë domethënës. Kur jemi tek varret, lidhur me këtë një shok ka biseduar me Ibra. (Ibrahim Kelmendin) dhe ai i paska thënë se gurët janë shumë më lirë dhe shumë më të bukur në Çekosllovaki, prandaj ma merr mendja se do të ishte mirë që për këtë çështje të konsultohemi me një skulptor dhe të na e jap ai një ide, disi për një gur (obelisk) të përbashkët për të tre, disi të jetë i madh dhe i vënë mbi një bazë të përbashkët guri mu në mes të të tri varreve dhe në të gdhenden emrat e shokëve të rënë së pari dhe pastaj ai citat aq i qëlluar... Sidoqoftë për këto gjëra duhet të mendojmë më gjatë dhe ta gjejmë një zgjidhje sa më të mirë.

Përndryshe më pëlqen kontakti yt me "Rininë kosovare" dhe të lutem që për këto gjëra të më njoftosh sa më gjerësisht, sepse ai është një terren shumë i përshtatshëm për neve, ndërsa për magjistrin po e marrë unë përsipër që të kontaktoj me të apo me një shok tjetër që ka mundësi, ndërsa për organin do të ishte mirë që sa më parë t'i rezervoni bile nja 200 ekzemplarë dhe t'i leni tek F. (Faridin Tafallari) e atje do ta çojmë ndoke t'i marrë, sepse duhet ta shfrytëzojmë një rast që t'i fusim disi në Vajazan, ku siç jam informuar disponimi është i mrekullueshëm. A e dëgjove mbrëmë Radio Beog. si lajmëroi për gjykimin e shokëve në Prishtinë dhe mos prezencën për "shkak të sëmundjes" të shokut H. Hysenit dhe reagimi e mospëlqimi i shokëve që të flasin para gjyqit përderisa të mos e sjellin Hydajetin në gjyq. Oh, kjo ka rëndësi shumë të madhe për besë, çka do të thotë se këtu ka qenë në pyetje diçka edhe më e madhe kur ata xhelatë marrin mundimin të njoftojnë për të...

Sa i përket organit në të ardhmen unë do të jap propozime konkrete se çka duhet të bëjmë, përndryshe ne këtu i kemi siguruar tri baza shumë të mira për mbajtjen e makinës dhe teknikës në tërësi... por tash në situatën e krijuar ma merr mendja se duhet ta zgjidhim çështjen organizative njëherë e përgjithnjë, ndërsa sa i përket propozimit për "dekonspirim" të përgjegjësit kryesor këtu ose dhe brenda na duhet të mendojmë më gjatë për këto gjëra, pra t'i masim të mirat dhe të këqijat që dalin prej kësaj dhe sidomos a është ky çelës i mjaftueshëm apo ndoshta duhet ndonjë tjetër që t'i mbyllë që në embrion të gjitha mospajtimet e mundshme që dalin pas këtij bashkimi të cilin duhet ta ruajmë si sytë e ballit dhe ta ushqejmë për çdo ditë qoftë edhe me gjakun tonë. Në anën tjetër për këto

çështje duhet të bisedojmë me Kamberin dhe shokët e tjerë dhe t'i qesim në rrugë të gjitha çështjet. Sidoqoftë duhet ta ruajmë gjakftohtësinë dhe të tregohemi të pjekur...

Të fala Lleshi (Xhafer Shatri)

Këqyr për organ të sigurohen ata numra. Herën tjetër me shkruaj më gjerësisht për të gjitha çështjet. Më njohto më gjerësisht për "R. Kosovare" që ta kem një pasqyrë të qartë për ta.

5. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 25 korrik 1982

I dashuri shok Gjergj,

i mora dy letrat e tua të fundit dhe nga e para e kuptova se ti akoma s'i ke marrë tri letrat e mia, ndërsa e dyta ishte e gjymtuar, sepse i mungonin dy faqet e para dhe nuk e dija se kush janë ata dy të tjerët që paskan dalë prej ku dhe pse, përndryshe dihej se ajo është në kontekst me Halimin, i cili është dashur të na lajmëroj para se të shkoj në T. (Turqi) dhe t'ia japim disa porosi për shokët atje, pastaj s'di si ka guxuar të rrezikojë e të shkojë me veturë nëpër Jugosllavi kur ai është dekonspiruar. Prej Kamberit e mora dje një letër që ishte më tepër në emër të K. (Komitetit) "H. Prishtina" lidhur me letrën time, në të cilën shpreha mendimin tim për propozimet e Kushtrimit. Sidoqoftë unë prej teje s'e mora vesh se a të ka rënë në dorë ai punimi që ia pata çuar Nikës, apo duhet të ta dërgoj ndonjë kopje tjetër. Përndryshe do të ishte mirë që të takohemi sa më parë që të tre dhe t'i analizojmë punët dhe ta zbusim përçamjen në mes jush, sepse kjo është shumë e dëmshme e besa prej saj mund të rrjedhin pasoja edhe më të mëdha. Por një gjë kije parasysh mos të ndodhë që të vij gjer tek ndonjë konflikt i pandreqshëm, por ruajeni gjakftohtësinë që të dy gjer në fund dhe kur të ulemi të tret ne do ta shqyrtojmë situatën dhe konform saj edhe do të ndërmarrim masa konkrete, që ajo farë amullie të mos zgjatë më, sepse me thashetheme nuk qitet asgjë në dritë. Pasojë e parë e tyre është dalja e palejueshme e N. për të cilin ti s'më njoftove më gjatë se çka ka ndodhur, a ke biseduar me të më vonë dhe a e ke përcjellë sjelljen e tij më vonë. Hapi sytë dhe mos gabo ta lëshosh situatën nga duart dhe me zë autoritar bëju me dije të gjithëve se këto punë nuk janë dansing në të cilin mund të hysh e të dalësh sa herë që të teket... dhe kuptohet përpiqu që të depërtosh në esencën e shkakut të këtij rasti dhe jo vetëm të këtij e të më njoftosh gjerësisht në mënyrë që ta kem një pamje më të qartë e ta shpreh mendimin tim lidhur me atë që duhet të ndërmarrim. Për gurët e varreve qenka bërë mirë që kanë marrë fund dhe ndoshta është dashur ta organizojmë një manifestim të madh për atë rast, por tash është vonë e në anën tjetër duhet ta shohim se si po merr puna fund pas këtij pushimit të tashëm të punëtorëve të cilët frikohem shumë se kësaj radhe do të kalojnë keq. Udba tash kryesisht me ta ka punë.

Sa për kurorë në emër të Kr. të KQ të LRSHJ mendoj se është e ngutshme, apo më mirë të them se ndodhë që të preken shokët, prandaj mendoj se do të ishte më mirë që ajo kurorë të qitet në emër të KQ të LRSHJ. Sa për IK unë me të kam biseduar shkarazi për gurët dhe me iniciativën e tij e jo timen, përndryshe ai njeri do të ishte i vlefshëm, ma merr mendja, vetëm në bashkëpunim me organizata të ndryshme e parti politike të këtushme, pastaj me organizata ndërkombëtare etj., dhe jo për tjetër, por pse këtu është kaherë dhe këtë punë e njeh më mirë se ne. Sidoqoftë mendo për këtë gjë më gjatë sepse kam nevojë të di mendimin tënd, e sa për dyshim, të jesh i sigurt, se unë atë s'e heq kurrë, por fle dhe ha bukë me të.

Korrespondenca jote me njerëz të ndryshëm është shumë e mirë dhe atë duhet ta vazhdosh e ta zgjerosh dhe në këtë drejtim do të ndihmoj edhe unë posa ta lë këtë dreq punë, që, për besë më ka lodhur për së tepërmi. Por me këtë farë azili po duan të më zhagisin këta zotërinjtë, dhe pa e marrë atë, punën s'mund ta lë. Pos letrës që ia ke dërguar Engj. (Engjëll Kolanecit-shën i red.) të lutem që për atë njeri të më njoftosh gjerësisht, për aftësitë e tij intelektuale, për intencat e tij lidhur me ne, por kuptohet pa përmendur emra etj., në këtë kontekst mendoj se do të ishte mirë që ta gjesh një adresë më afër teje ku do t'i marrësh letrat menjëherë, sepse ai shoku mundohet ashtu, dhe po vonohet puna në anën tjetër.

Për organ unë po ta dërgoj një artikull për Lubiqiqin që më ka ardhur prej Kam. ndërsa një koment tjetër për Kongresin XII dhe për proceset politike në Kosovë do ta dërgoj posa ta marrë vesh se sa u dënuan edhe këto grupet tjera në mënyrë që të jetë i përgjithshëm. Ndërsa në faqe të parë do të ishte mirë të botohet ndonjë fotografi e shokëve që po dënohen apo edhe gurët e varreve nëse ta merr mendja. Përgjegjen e letrave të lexuesve do ta shkruaj sa më parë sepse ajo ndoshta s'duhet të jetë e gjatë. Ndërsa për Bernin është referati dhe telegrami dërguar Kongresit e besa edhe një reportazh akoma i pambaruar. Unë do t'i dërgoj të gjitha e ti zgjidh çka ta merr mendja e sa për faqe, kjo më tepër mvaret prej materialeve, pra nëse ka materiale atëherë pse të mos i botojmë në 20 faqe, por ai të shtypet ngadalë dhe pa asfarë ngutje, veç kur të dalë ama le të dalë si duhet. Në atë moment që të lodhesh gjatë shtypjes, lere e dil e shëtit një kohë e pastaj vazhdoje prapë punën. Misini më është dukur atë ditë fytyrë e njohur, por vitet e gjata në kuvli lënë shtresë të trashë harrese, aq më parë kur fshati i tij është shumë afër me timin e unë s'e njihja. Por ti ma trego mbiemrin e tij a është Mavraj, Berishaj apo ndryshe e pastaj më njohto edhe për të shoqen e tij prej nga është.

Sa për lënien e makinës nuk ka ndonjë rëndësi se a është njeriu i organizuar apo jo, por duhet të jetë besnik dhe kjo mjafton; ndërsa për Qemajlin vepro siç ke vendosur sepse të dekonspirohet baza e makinës s'është e nevojshme e në anën tjetër edhe atij i duhet një kohë bukur e gjatë që të mësohet të punoj me të. Me komentin për gjykimet do ta dërgoj një karikaturë shumë interesante që ma ka dhënë një shok turk. Për statusin tënd s'më tregove se çka ke vendosur, mendoj se këtë punë duhet ta rregullosh sa më parë, dhe rrethit tënd thuaji le të kërkoj këshilla prej teje e jo prej të tjerëve...

25 korrik 1982 Të fala vëllazërore
Lleshi (Xhafer Shatri)

6. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 31 korrik 1982

Shok Gjergj,

mbrëmë bisedova me F. lidhur me Br., ku shpresoj se do të ndaheni mirë, përndryshe duhet qenë syçelë dhe mos të ndodhë nesër si me N. Sidoqoftë mendoj se me njerëzit azilerosa në Perëndim ta përdorim formën gjysmë legale të punës duke e masovizuar L. edhe në atë mënyrë. Por kur janë në pyetje njerëzit që duhet të kthehen në K. apo edhe të tjerët në të cilët nesër mund të mbështetemi krejtësisht madje edhe në punët më të fshehta, atëherë seleksionimi duhet të jetë më se rigoroz. Për t'i shkruar BKSH "Bajram Curri" kjo është punë shumë e lehtë, vetëm dërgojua organin e fundit dhe shkruaje një letër të mirë thjeshtë shoqërore përmes të cilës do t'ua bëjsh me dije se je anëtar aktiv i LRSHJ, kuptohet duke kërkuar, në ato baza, bashkëpunim më të ngushtë dhe letërkëmbim të rregullt, kur do të bëheshin informime reciproke ndërsa më vonë do

t'u drejtohemi "zyrtarisht" po që se duan që të formohen si organ (k.) i mirëfilltë i L. Mirëpo këtu s'bën të ngutemi, duhet disi t'i nxisim që ata vet të propozojnë një gjë të tillë.

Sa për Br. po frikohem se mos kjo është e ngutur, sepse nuk i njihni njerëzit personalisht e përmes letrash këto punë nuk rregullohen si duhet... Sa për konton që më thua, ata njerëzit s'janë këtu këto ditë, përndryshe po tregohen mjaft aktiv dhe me ndihmën e tyre e kemi formuar Komitetin Zviceran për Repu. Shq. në J. Sa për keqpërdorim shokët më kanë thënë se s'ka asgjë në atë drejtim... por tash duhet të kërkojmë ndihma për familjet e të burgosurve në Kosovë dhe në këtë drejtim do të formojmë grupin e posaçëm që do të kujdeset për familjet e të burgosurve dhe ato ndihma t'i ndajë e t'i dërgojë sa më me rregull, në anën tjetër po i njëjti grup si edhe çdo shok i yni ka për detyrë të marrë informata nga më të hollësishmet se kush është dhe ku është në burg, sa është dënuar etj. Pastaj fotografitë e tyre janë të domosdoshme në mënyrë që t'u shkruajmë për çdo ditë organeve ndërkombëtare dhe shteteve e qeverive të ndryshme. Kjo pos që do ta popullarizojë çështjen tonë, do t'u ndihmojë edhe shokëve tanë të burgosur...

Letra e M. Vranicës është shumë e mirë dhe çështjen ai e shtron shumë drejt, por meqë se dija se si ke ardhur në kontakt me të s'dija se si duhet t'i përgjigjemi, prandaj më njofto për këtë gjë sa më gjerësisht dhe mos të lejojmë të na shkojë një rast i tillë pa e shfrytëzuar. Pastaj me N. Dibranin s'më kishe shkruar më gjerësisht, sidomos se si ke rënë në kontakt me të qoftë ti, qoftë K. Përndryshe këtë punë po e marrë unë përsipër ta rregulloj dhe kuptohet së pari do t'ia dërgoj disa organe...

Sa i përket Dritës ma merr mendja se nuk bën t'i dërgosh procesverbal etj., sepse e dëshpëron atë si njeri dhe në anën tjetër ATA s'i marrin seriozisht punët tona pastaj. Artikujt që m'i dërgove i lexova por ai për gjykimin e Ademit s'është përpunuar aspak dhe atë duhet ta botojmë në shtator kur të bëhen shtatë vjet të arrestimit të tij dhe njëherit ta përpunojmë sa më mirë... si i tillë ai do të dalë shumë i fuqishëm, sepse edhe unë i di disa fakte të cilat s'përmenden aty fare. Për të gjitha këto që t'i shtrova më lart, posa të kthehesh prej Br. më shkruaj gjerësisht, kuptohet duke më informuar edhe për atje se si u ndatë. Djali i Metushit plak është në Aust. këqyr merre adr. e tij ndërsa edhe për H. Gërvallën merr vesh se kur del dhe vërë kontakt me të pa e ditur kush tjetër pos teje dhe Haxh. absolutisht askush tjetër. Ai njeri na duhet shumë, shumë, si ajri. Mendoj se ai do të jetë përgjegjës për t'iu kundërvënë udbës edhe në atë mënyrën tjetër.
Kaq... të fala Lleshi (Xhafer Shatri) 31 korrik 1982

7. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, verë 1982

Shtojcë
Shok Gj.,

Halimi m'i ka dërguar disa poezi kushtuar Afrim Abazit dhe shokëve që u vranë këtu si dhe një punim tjetër që ka ngjashmëri të madhe me traktin që u shpërnda, mirëpo meqenëse në trakt disa gjëra janë thënë më mirë dhe më fuqishëm (po që nuk do të thotë se do të pajtohem me të gjitha) e pash të arsyeshme t'i marrë disa faqe të traktit të cilat mendoj se duhet botuar, së pari sepse disa gjëra janë aktuale dhe së dyti se mosbotimi i punimeve të tij ndoshta do të merrej si injorim i qëllimshëm. Në pamundësi që t'i shtyp po t'i dërgoj fletët e ndara me lutje që gjatë botimit ta bëjsh ndonjë përmirësim gramatikor e asgjë tjetër, sepse në këtë mënyrë edhe kësaj radhe duam t'ua bëjmë me dije se përkundër të gjithave ne i konsiderojmë shokë e bashkëluftëtar, përderisa të ulemi në tavolinë dhe atëherë t'i shqyrtojmë çështjet njëherë e mirë. Këtë punë do ta bëjmë posa të

dalë prej spitalit, sepse kështu nuk shkon më. Ne përfundimisht duhet t'i qesim në vi punët, le të dihet njëherë e mirë kush për çka është dhe atëherë "le të ndahen dhentë dhish" siç thotë populli. Këto mospajtime dhe ndërmjetminime na kanë kushtuar shumë e sidomos mua, sepse po më shqetësojnë edhe më tepër se sa duhet. Dreqi e marrtë unë s'po mund ta marrë me mend pse po ndodhë kështu. Në vend se t'i bashkojmë forcat e t'i ndajmë detyrat dhe çdo njeri të kontribuojë aty ku mundet ne po merremi me gjëra të imëta që nuk guxojnë të çojnë asnjë çik peshë në jetën e luftëtarëve të lirisë. Po më mundon më së shumti fakti se sikur të mos ishin këto ne sigurisht do ta ndërtonim një bazë të fortë brenda në Vajazan, një rrjetë të pathyeshme, sepse tash shkojnë mërgimtarët tanë dhe ne duhet ta intensifikojmë aktivitetin tonë.

Poezinë kushtuar Afrim Abazit e shkrova me dorë, por besoj se ti do të mund ta nxjerrësh shkrimin tim. Kaq...

Të fala Ll. (Xhafer Shatri)

P.S. Fotografinë që po ta çoj ma kthen më vonë, sepse e kam shkëputur prej një libri të huaj.

(verë 1982-shën i red.)

8. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 9 gusht 982

Shok Gjergj,

Po të shkruaj shumë për nguti. E mora letrën tënde dhe ja përgjegjja. Artikujt për Ademin dhe Jusufin duhet përpunuar shumë, sidomos të dytin mos e boto tash sepse ka lajthitje, sidomos teprohet lidhur me mua. Ne nuk guxojmë të bëjmë autopropagandë! Kjo do të na kompromotonte keq në njërën anë dhe në tjetrën s'përkon me moralin tonë. Komentin për burgosjet ta dërgova dje, S'ka bërë të jetë më i shkurtë. Në organ do ta botojmë fletën e gjelbërt me lajme (tash emrat e të dënuarve) të ngjashëm që e botonte Sokoli ynë në Lajmëtarin... Njëherit po ashtu si fletë të pavarur do ta botojmë një fletanketë të Inter. Amnesty-s për të burgosurit (informatat). Nëse bëhet tepër atëherë po e botojmë si trakt dhe e shpërndajmë pas organit.

Mos u ngut gjatë shtypjes, le të dalë pa gabime ky numër, sepse në të ardhmen do ta botojmë më shpesh, sepse unë vërtetë s'bën të punoj më tutje. Më ka ardhur në maje të hundës. Po që se organi s'del i fuqishëm pas nr. 4 e tutje për ne është vdekje. Kjo gjë po më mundon shumë, akullnajë shpirtin po ma bën. I kam marrë dy letra prej K.

Ç'u bë me Nikën? A po e sheh ndonjëherë?

Më shkruaj e më njohto a ka kohë ta përpunoj bile artikullin për Ademin dhe një koment të shkurt për Kongresin XII të LKJ. Për atë të Jusufit bisedo me Mërgimin, dhe përpiqu ta bindësh që ta lëmë për numrin e ardhshëm. Konton ta dërgoj nesër. S'ka pasur keqpërdorime me sa kam kuptuar. Mos u ngut gjatë shtypjes fare.

9 8. 82 (9 gusht 1982) Të fala Ll. (Xhafer Shatri)

P. S. Fotot botoji siç ta merr mendja në këtë numër. Të dënuarit duhet të jenë pikë qendrore.

9. Letër e Xhafer Shatrit për Sabri Novosellën, 16 gusht 1982

I dashuri vëlla,

para dy ditësh më erdhën përnjëherë nga ti katër letra, dy prej të cilave ishin vazhdim i një reportazhi të gjatë, (i cili tregon se autori ka aftësi dhe talent të bëhet një

gazetar shumë i mirë, vetëm porosite të lexoj sa më tepër), dhe dy të tjera tok me raportin aq të thukët lidhur me bisedimet që ke pasur me Plakun (Bujar Hoxhën-shën i red.), por së pari po dua të të njohtoj shkurtimisht për shkakun pse po t'i vonoj nganjëherë përgjegjet e pastaj drejt e në temë.

Siç e di, që më kanë detyruar të punojë dhe prej atëherë unë punoj në një shtypshkronjë të vogël si letërpërpunues, në njëfarë makine shurdhuese të cilës më duhet t'i rri në këmbë prej orës 7-17, mirëpo meqë rruga është bukur e gjatë dhe lidhje direkte nuk ka, pos këtyre nga dy orë po më shkojnë nëpër tramvaj, autobusë dhe në fund në tren. Do të ishte e tepërt ta them se sa po lodhem, pastaj po ia nisin këto obligimet tona të përhershme të cilat s'guxojmë t'i harrojmë për asnjë moment; duhet t'i lexoj gazetat jugosllave "Politikën", "NININ" dhe Rilindjen rregullisht, pastaj bile një gazetë të këtushme, letrat e shokëve, ndërsa libra shumë pak apo më mirë të them hiç edhe pse kam aq shumë nevojë. Kuptohet se kohën më të madhe po duhet t'ia kushtoj organit dhe çështjeve o. por këto të fundit jo drejtpërsëdrejti, mirëpo megjithatë po duhet energji e përqendrim shumë i madh, pas të gjitha këtyre më duhet të fle (kurrë s'po mund të bie para orës 24) e besa edhe atëherë po më ndihmojnë të "pushoj" ëndrrat e domosdoshme për përjetimet në ato kuvlitë e përgjakura. Këto që t'i shkrova mos i merr si lavdim për gjoja punën time "të madhe", por vetëm si arsyetim pse s'po mund të përgjigjem me kohë në letrat tua edhe pse kjo është aq e nevojshme dhe për mua aq e rëndësishme...

”Sa i përket letrës tënde të fundit, për mua çdo gjë është e qartë dhe qëndrimin tënd e aprovoj plotësisht, sepse ta duan dy vetë një njeri kjo është vërtetë më tepër se krim (ti duaj mua e unë veten kjo s’shkon). Përndryshe unë me djem të vëllaut s’kam pasur rastin të rri shumë, vetëm me njërin në Itali. Por këtu jam informuar prej shokëve lidhur me ta, dhe nga të gjitha këto kam ardhur te përfundimi se këta njerëz nuk po e bëjnë atë që duhet ta bëjnë apo atë që pritet prej tyre dhe jam i sigurtë se këtë gjë nuk e dinë eprorët e tyre. Besom se këta njerëz nuk kanë fije konspiracioni në kontakt me njerëzit tanë, p.sh. ai që kam biseduar me të në Itali u ka treguar njerëzve se ku kam shkuar unë...dhe kur e kam kuptuar një lëshim të tillë unë s’kam mundur t’u besoj veshëve të mi. Kjo dhe të tjerat që t’i përmenda m’i kanë hapur sytë shumë prandaj edhe kam insistuar aq shumë më 15 maj që kontaktet me këta njerëz t’i mbajsh vetëm ti. Meqenëse është kështu ma merr mendja se është e domosdoshme që t’u drejtohemi drejtpërsëdrejti sh.e. dhe b.p. dhe atë me shkrim dhe t’i njoftojmë detalisht për të gjitha dhe vetëm pas përgjigjes së tyre me shkrim të marrim qëndrim të caktuar... dhe kuptohet t’ua bëjmë me dije se ne nuk jemi aventurier që me veprimet tona duam ta rrezikojmë edhe atë. Assesi. Prandaj nëqoftëse mendojnë se veprimtaria jonë shpie në atë drejtim, atëherë le të na tregojnë, apo të them më mirë le të na bindin me fakte.

Pas të gjitha këtyre po që se vazhdon avazi i vjetër atëherë do t'i ndërmarrim masat e domosdoshme dhe të bazohemi vetëm në forcat tona. Por në atë rast ti duhet të vish këtu dhe mos gabo që familjen ta qosh atje. Po ta them drejt se edhe me Premtonin keni gabuar, këtë do ta marrësh vesh më vonë... Ne s'guxojmë të kërkojmë ndihma të tilla prej vëllaut, pra ndihma të prekshme që nesër armiku mund t'i përdorë si kompora delikt të them. Ajo ndihmë duhet të bëhet vetëm përmes një personi nga pala jonë dhe në atë mënyrë që pos dy-tre vetësh askush mos ta dijë, absolutisht askush, sepse në të kundërtën kjo do të ishte një lojë e asgjë tjetër. Këtë gjë, po e them prapë, duhet ta bësh vetëm ti e askush tjetër, përndryshe do të ketë pasoja të mëdha, ja për shembull, mbrëmë bisedova me S. (Xhafer Durmishin-shën i red.) dhe po më thotë se ka biseduar me ata të V. (Vjenës-shën i red.) dhe ai i paska kërkuar adresën e atij shokut me të cilin ti e ke vënë atë kontakt aq të mirë në Br. Këtij shokut tonë si thash asgjë, sepse është i ri dhe akoma si kupton shumë gjëra sidomos në këtë fushë.

Pos tjerash i paska thënë se gjoja ti i ke thënë Plakut se edhe ne apo më mirë të them unë s'qenkam i kënaqur me ta... sidoqoftë unë i kam thënë S qysh më parë se me atë njeri dhe as me kolegët e tij unë s'dua të bisedoj, sepse është shoku kompetent për këtë çështje, prandaj nëse kanë diçka le të urdhërojnë e të bisedojnë me të, çka është kjo t'i formojnë qindra lidhje? Lidhur me këtë do të ishte mirë, që ti t'ia tërheqësh vërejtjen Sahitit (Xhafer Durmishit-shën i red.) për këtë çështje dhe le ta kuptojnë ata njerëz se ne kemi disiplinë... Mbaj mend, nëse këtyre punëve s'ua presim rrugët që tash dhe t'i qesim në baza të shëndosha, atëherë do të kemi pasoja nesër që edhe dreqi do të çuditet. Këtu s'ka lojë. Politikë në mes vëllezërve s'guxon të ketë. Dreqi e marrtë thesi është thes, por njëqind bira nuk i ka.

E sa për dëshpërim që më kishe thënë, për këtë mos u mërzit aspak, sepse unë jam i përgatitur për të gjitha ama për të gjitha dhe e di se vetëm të bazuar në forcat tona ne do të fitojmë më lehtë. S'po e zgjas më tepër, sepse jam shumë i lodhur. Në letrën tjetër do të shkruaj edhe më gjerësisht për këtë gjë, por të lutem që edhe ti të mos e marrësh këtë si tragjike, sepse e shkatërron shëndetin kot.

Përshëndetje vëllazërore prej u. (Uka=Xhafer Shatri) 16 gusht 1982

10. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 24 gusht 1982

Shok Gj.

pas një kohe bukur të gjatë, sot po të lajmërohem më gjerësisht njohtoj se unë marrë në tërësi jam mirë, tash pasi që edhe këtë numër veç e kryem po më duhet t'i hy përpunimit të materialeve për numrin tjetër në mënyrë që të mos vonohemi, sepse mund të ndodhë fare lehtë diçka e pastaj ne duhet të shkruajmë për të e kështu bile le të qëllojnë të gatshme këto që i kemi. Lidhur me këtë ma merr mendja se do të ishte më se e domosdoshme që t'i ndajmë rubrikat në disa vetë dhe të perfeksionohemi në to, sepse në atë mënyrë do të na dilte më pak punë e në anën tjetër edhe organi do të ishte shumë më kualitativ. Sidoqoftë mendo për këtë dhe propozoje ndonjë shok që ta merr mendja se mund të kontribuoj me shkrime...

Po ti andej si po ia shpie, a të erdhi ende ai trakti për të burgosurit, pastaj me Nikën a u takuat akoma? Ma merr mendja se do të ishte mirë që të shiheni sa më parë dhe me gjakftohtësi t'i zbutni kundërthëniet e mundshme që keni, sepse pa unitet ne vërtetë s'mund të bëjmë asgjë, ani sidomos në këtë situatë. Gjithashtu edhe me N. (Nuhi Sylejmanin-shën i red.) do të ishte mirë ta zbutësh konfliktin, së paku të sillesh me të, po që se takoheni, me mjaft gjakftohtësi dhe të bëjsh çdo gjë që të viesh gjer tek shkaku i vërtetë që e shtyri të veprojë në atë mënyrë...

Lidhur me rastin në Dyseldorf unë nuk kam marrë letër akoma prej një shoku që ka kontakt me atë mësuesin apo çka ishte ai, por e pata një bisedë telefonike me shokun tim dhe ai po më thotë se ka biseduar me atë, poashtu përmes telefonit dhe ai qenka prekur pse gjoja ti i paske përmendur disa raste të shokëve të vrarë, jo ai ka thënë kështu, jo ai tjetri ka thënë ashtu...

Përndryshe diçka konkrete jo. Besoj se më vonë do të informohem edhe më gjerësisht e pastaj të shkruaj. Fundja edhe harroje atë rast, por kij kujdes në të ardhmen e mos hyr thellë me I. (Ibrahim Kelmendin-shën i red.) edhe nëse të provokon thuaji të lutem këto gjëra kanë marrë fund kaherë, ne jemi bashkuar e po luftojmë bashkë, prandaj t'i lëmë ato që kanë qenë...

Prej Kamberit ka ditë që s'kam marrë letër, s'e di hiç se si e ka punën.

I dashur Gj. tash s'po e zgjas më tepër, por të lutem pranoji të falat e Ll. (Xhafer Shatrit) 24 gusht 1982

Tash e tutje më shkruaj në këtë adresë:
Mark Mirdita
Cl. Al. c/o STC
16 Rue de Chaudroniees
1205 Geneve
(Për shkak të prishjes së shiritit m'u desh të shkruaj në këtë mënyrë, për shkak se çilja mbrapsht e letrës më doli kështu. Më falë pash besën. Besoj se e lexon edhe kështu fundja me pasqyrë. Mos më shkruaj në adresën e mëparshme.)

11. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 8 shtator 1982

Tutjeta Gj.

me vonesë më ra në dorë letra jote, pothuajse menjëherë me organin dhe të them të drejtën marrëdhëniet e ju të dyve nuk më shqetësuan pak, unë vërtetë s'po mund ta kuptoj këtë... do të ishte mirë që të uleni vetëm ju të dy dhe me gjakftohtësi t'i shoshitni gjërat që nga fillimi sepse këtu si duket është një djall i madh në pyetje, ti do të thuash se ai s'po vjen në takim, mirë, por megjithatë bën prapë përpjekje në këtë drejtim dhe të lutem ruaje gjakftohtësinë çkado që të ndodhë... mos harro se nuk guxojmë të ngutemi aq më parë kur përgjegjësia jonë është aq e madhe, prandaj përpiqu sa të mundesh që ta bëjsh mirë sepse keq bëhet fare lehtë, siç po e sheh po kemi vështirësi të mëdha në këtë fillim e bile brenda ta ruajmë në mos tjetër një qetësi të përkohshme (nëse s'ka rrugëdalje tjetër?) gjersa t'i konsolidojmë radhët. Siç po e sheh ne duhet të llogarisim gjithmonë edhe në pengesa nga më të papriturat, por megjithatë duhet të mësohemi me të metat e njëri-tjetrit, mjerisht askush s'është i përkryer, sepse ky shekull i njëzet (më mirë të quhet shekull i nervozës) ka nevojë për njerëz tolerantë, pasi njëmend s'po shkon ndryshe. Të them të drejtën unë as me veten s'jam aspak i kënaqur, por çka t'i bëjsh. Me ata shokët konsultohu dhe ruajeni të gjithë gjakftohtësinë dhe sidomos çdo qëndrim që ta merrni ai le të ketë si qëllim interesin e përgjithshëm...

Për propozimet e tua lidhur me festat e Nëntorit pajtohem plotësisht, por siç i kam propozuar edhe Kamberit në një letër të mëparshme, së do të ishte mirë që më dhjetë dhjetor, Ditën Ndërkombëtare të të drejtave të Njeriut të organizojmë një manifestim këtu para pallatit të OKB, ose më 17 janar aty ku na janë vrarë shokët, ma merr mendja se kjo do të kishte një jehonë të madhe para opinionit ndërkombëtar ani sidomos këtu, por e ka një të keqe sepse është e premte pra ditë e punës, ndërsa për përgatitjet ke plotësisht të drejtë, sepse ato njëmend duhet të bëhen me kohë, por tash për tash mendo edhe ti për këto propozime e pastaj të vendosim të gjithë tok. Këtë të fundit do ta përgatisim shumë më mirë se të gjithë deri më tash, por edhe unë e kam njëfarë problemi: Këto ditë më duhet të operohem dhe kjo sigurisht do të më humbë kohë, mirëpo mos rri fare po shkruaj sa të mundesh, kuptohet se këto nuk dalin që në fillim mirë, por më vonë i përmirëson e redakton ngadalë... Për këtë konfliktin në D, atij njeriut i paska mbetur shumë hatri pse gjoja ti i paske përmendur ata shokët e vrarë... Diçka tjetër jo, së pakut kështu u informova.

Lidhur me organin më duhet të them se skema që ma dërgove në fillim nuk më kënaqi, ishin bërë disa imputime e amputime, ndoshta disa edhe prej ngutjes, në anën tjetër disa ndryshime të shenjave të pikësimit ua ndërrojnë kuptimin shumë fjalive, por kur e mora organin të kompletuar atëherë më la përshtypje shumë të mirë. E sa për atë që më thua ti se si duhet të jetë organi ynë, kuptohet se pajtohem plotësisht, sepse vërtetë është e domosdoshme që të dalim me një organ sa më të fortë dhe atë mundësisht ta shpërndajmë në të gjitha anët.

Dërgimi i apar. atij shokut është ide shumë e mirë, prandaj përpiqu që edhe shokëve më të besueshëm aty sugjerojua që të bëjnë çdo gjë e ta krijojnë nga një lidhje të pavarur, sepse kjo është shumë e rëndësishme... Sa i përket dhënies së materialeve E. (Engjëll Kolanecit-shën i red.) ma merr mendja se nuk do të ishte mirë. Ne ato i kemi për arkivin tonë, e ai e ka gazetën ta lexoj dhe njëherit obligimin që të kujdeset për gjëra më të mëdha...

Të fala Ll. (Lleshi=Xhafer Shatri) 8.9.82 (8 shtator 1982)

12. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 11 shtator 1982

Shok Gj., 11 shtator 1982

sot më ra në dorë letra e 6 shtatorit, lidhur me atë që shkruan përgjithësisht pajtohem, por mundësisht sqaro në letrën e ardhshme këto gjëra: çfarë është ajo që në "esencë" s'po mundke t'i shkruajsh" lidhur me bisedën tënde me E. (Engjëll Kolanecin-shën i red.) siç thekson ti në letrën tënde? Pastaj a mund të marrësh vesh se në çka qenka ankuar konkretisht Halimi tek Plaku?

Sa për "B. Currin" ma merr se ke bërë mirë që ke vazhduar korrespondencën, por përpiqu që sa më tepër të blejsh e sa për bisedime konkrete për këtë, siç e di edhe ti ne s'kemi mundësi veç nëse ata vinë këtu e në atë rast do të ishte shumë mirë që t'i konkretizojmë gjërat sa më tepër me ta.

Sa për letrën e M. Vranicës, mendoj se ajo është e mirë, pra shiko në të ardhmen që të shkruajsh më ngadalë, sepse, siç e di, një letër lë përshtypje shumë të madhe tek njeriu.

Për N. Dibranin s'do ta lëmë keq, do t'ia dërgoj një letër dhe disa numra të organit që sot, lidhur me këtë po të njohtoj se të gjitha letrat apo punimet që po i vinë organit, që të gjithëve u përgjigjemi qoftë unë qoftë ndonjë shok tjetër. Tash kohët e fundit ne i kemi krijuar drejtpërsëdrejti disa lidhje shumë të mira në SHBA, prandaj edhe i thash F. që t'i dërgoj atje 200 ZK. Neve këtu na kanë ardhur shumë pak numra, në të ardhmen duhet të gjejmë një mënyrë më efikase të shpërndarjes, por edhe mua m'i ka lidhur këmbët ky farë statusi i parregulluar gjer më tash.

Për organin e ardhshëm duhet t'ia nisim punës që tash, në mënyrë që ta qesim kah fundi i tetorit, por mua më duhet të operohem këto ditë (këtë mos ia thuaj kujt.)
dhe s'e di sa sado të mund të kontribuoj po që se rri shumë në spital. Puna s'është rrezik aspak, prandaj shpresoj se edhe do t'i kem disa ditë të lira në dispozicion për t'u marrë vetëm me këto punët tona. Përndryshe në F. i kam disa oferta shumë interesante, veçse pa i qitur këto punët tona në vijë disi s'po mund të vendosi për asgjë. Përndryshe në të ardhmen shpresoj se do të kontribuoj edhe më shumë sepse për çdo ditë po më përmirësohen kushtet.

Lidhur me Naimin ma merr mendja se më së miri do të ishte të kërkoj a. aty ose në F. për këto shkaqe: ai ka mjaft fakte për a. dhe do të ishte afër teje e do të mësonte një gjuhë "të madhe" siç thuhet sepse me su. s'mund të bëjë asgjë. Për atje unë kam pas menduar ta dërgojmë Kamberin së bashku me familje po që se atje i prishet puna, sepse aty ka kushte shumë të mira jetese dhe s'do të kishte nevojë të mendojë për familjen aspak, pra ta "ruajmë" atë vend për ndonjë rast më të madh. Si do qoftë mendo edhe ti në këtë drejtim më tepër e pastaj po vendosim si të na e merr mendja se është më së miri.

Shoqja e këtij shokut më njohtoi se ka biseduar me ty sonte dhe se ia ke dhënë ti një emër të një personi që po interesohej për mua... ai mbiemër për mua është i panjohur nëse është Maku, siç më tha kjo gruaja e shokut, prandaj më njohto më gjerësisht për këtë

si dhe për Milaimin se a ka diçka të re për të apo jo, pra a e more adresën e tij apo jo. Kjo është shumë e rëndësishme.

Kaq... Të fala vëllazërore Ll. (Xhafer Shatri)

Klubet kanë vendosur ta nxjerrin fletushkën "Kurbetxhiu". Këtë do ta botojmë ne.

13. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 20 shtator 1982

Shok Gj.

sot dola prej spitalit, tashmë po ndihem shumë më mirë, pothuaj në të njëjtën kohë u informova për letrën tënde me adresë "Vio..", në pamundësi që ta marrë menjëherë i thash shokut tim që ta lexoj përmes telefonit. Sa i përket takimit në të cilit ti po insiston, natyrisht se ai është më se i nevojshëm, dhe për të biseduar kemi jo një por shumë e shumë gjëra, mirëpo në këtë drejtim të lutem të m'i sqarosh këto dy gjëra: nga të dy palët që jeni atje sa keni kompetenca që të vendosni në emër të degëve që përfaqësoni dhe a ke menduar se çka duhet të në atë takim, konkretisht çfarë vendimesh duhet të merren? Për këtë më njohto menjëherë në mënyrë që ta kem një pasqyrë sa më të qartë, sepse meqë ky duhet të jetë takim shumë i rëndësishëm atëherë mua më duhet ta thërras një shok prej shumë larg, prandaj edhe dua të di se në çka qëndroj.

Sa i përket atij shokut që po dashka të shkoj në shtëpi, duhet t'i thuash se ne nuk jemi profetë që ta dimë se çka mund t'i ndodhë, ne nga ato që i dimë duhet t'i themi se ai është i rrezikuar, prandaj nëse vendos të shkojë atëherë në radhë të parë të mos e njohtoj askend për atë hap, pastaj kur të arrijë (?) në shtëpi të mos dal fare dhe natyrisht të mos flejë aty por tek ndonjë i afërm i tij, por kuptohet poashtu pa dal ndonjë fjalë... dhe të mos e zgjas shumë, sepse në situatën e krijuar mund të bjerë në sy... Ne njerëzve të tillë mund t'ua themi vetëm këtë e asgjë tjetër.

Sa për Ha. (Haxhi Berishën-shën i red.) do të ishte mirë që të ma sqarosh çështjen e tij edhe më gjerësisht, po si do qoftë nëse puna ka ardhur gjer tek strehimi ne do ta mbajmë këtu për një kohë e sa për punë është vështirë të gjendet. Nëse ka menduar gjer... kjo është shumë e vështirë, ndërsa nesër do të jetë edhe më vështirë...

Prej Halimit e kam marrë një letër para disa ditësh, bukur të gjatë, prandaj lidhur me propozimin tënd do t'i shkruaj dhe vetë do të përpiqem e do të vij atje, sepse ju jeni më shumë, prandaj radha është që unë të vij atje... mirëpo harrova të të pyes se a e ke diskutuar këtë çështje me Kamberin dhe çka të ka thënë ai?

Gazetat këtu janë shpërndarë si duhet, nuk është dërguar numër i mjaftueshëm në adresat që ua kam dërguar, sepse ne qemë marrë vesh që këtu të dërgohen 2000 copë, pastaj edhe në Amerikë i keni dërguar me linjë të rëndomtë (detare) edhe pse u kam thënë se të gjitha shpenzimet postale i heqim ne vetëm na e tregoni shumën e duhur...

Lidhur me këtë posa ta lexosh këtë letër të dërgohen menjëherë përmes postës në adresë të ZK edhe së pakut 500 copë, por jo përnjëherë... çdo ditë nga 100, pastaj poashtu edhe në këtë adresën e mëposhtme edhe 500 copë tjera po në të njëjtën mënyrë

c/o Mark Mirdita, 16 Rue de Chaudroniess, 1205 Geneve, Suisse

Tash nuk po e zgjas më tepër prandaj të lutem t'i pranosh përshëndetjet vëllazërore të Ll. (Xhafer Shatri)

20 shtator 1982 P.S. Më dhjetë (10.9.1982) më ka ardhë një letër e jotja. Menjëherë të jam përgjegj...

14. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 26 shtator 1982

Shok Gj.

i mora letrat tua dhe në to e kuptova, me shqetësim, se kundërthëniet atje kanë marrë kahje të palejueshme, prandaj unë do t'i ndërmarr të gjitha masat dhe do të vi atje, por mungesa e një shokut tim, që të jetë edhe ai si pjesëmarrës më ka vonuar në këtë, po megjithatë do të dal këto ditë dhe do të bisedojmë gjerësisht, kuptohet se për këtë do ta njohtoj edhe Nikën në mënyrë që të mos ankohet për mos informim, sepse edhe nuk do të ishte e drejtë, e sa për pjesëmarrjen e tij këtu s'guxon të bëhet fjalë, sepse ai është i obliguar për këtë, sikundër që jemi edhe ne të tjerët.

Lidhur me "Kurbetçiun" po e shoh se qenke alarmuar pa nevojë, si së pari ka lindur si propozim i rastit nga punëtor që pasdarkave të vona i bie çaji në kokë. Për këtë më kanë informuar menjëherë, prandaj i kam porositur shokët që pasi që qenka vendosur ta marrin ata botimin përsipër, pra shokët e Gjenevës në mënyrë që ai të jetë në duart tona, për çdo rast. Në fillim shokët më thanë a të propozojmë të botohet si Republika, gjë që më vonë e pamë se nuk bënë për këto shkaqe: e para se ai do të ishte emër politik, gjë që ne s'na konvenon që armiku të ketë fakte për pohimet e veta se klubet janë çerdhe tonat; e dyta si emër vetvetiu për shkak të një propozimi të mëparshëm do të keqkuptohej si qëllim për organ të dytë... gjë që kjo s'guxon të vijë në shprehje kurrën e kurrës. Edhe aludimi më i vogël në këtë drejtim për mua do të ishte fyerja më e madhe, e sa për fjalët e botës ne ato s'mund t'i ndalim, por duhet ta dimë se armiku në një mënyrë ose tjetër është infiltruar në radhët tona, sado periferik qoftë ai, në këtë prizmë unë i shoh të gjitha orteqet e thashethemeve të gjertanishme, prandaj t'i hapim sytë dhe të mos biem nën ndikimin e tyre. Por të jemi të qartë se ato i ka nxitur bukur shumë edhe shkuarja jote dhe F. (Faridin Tafallarit-shën i red.) në Dyseldorf dhe sidomos fjalët tua si përgjegje në provokimet e I.K. gjë që ke mundur ta ikësh fare lehtë dhe për këtë unë të kam dhënë material të mirë që t'ia mbyllësh gojën dhe të mos mbeteni armiq.

Shumë herë të kam thënë se një Lëvizje e tillë siç është e jona nuk mund të jetë kurrë një armatë e disiplinuar, por do t'i ketë edhe njerëzit që edhe pse shkojnë me të, megjithatë ata nuk janë kurrë mish e gjak i mirëfilltë i saj. Këtu s'guxon të kesh asnjë iluzion. Edhe në Bruksel, jeni dekonspiruar krejtësisht, ama krejtësisht. Dreqi e marrtë çka ka qenë e nevojshme ta dijë krejt bota se kush ka shkuar atje dhe përse. Merre me mend edhe pseudonimet tuaja i kanë mësuar njerëzit. Kjo është e palejueshme. Sa për fjalët e N. (Nuhi Sylejmanit-shën i red.) për konton etj., kjo të mos shqetësoi aspak, sepse ai në atë mënyrë e lufton më së miri veten e vetë dhe kjo është e mirë për ne. Për familjen e Na. këtë e kemi pasur parasysh edhe më parë, prandaj në këtë drejtim do të bëjmë diçka sa më parë, e sa për shkuarjen e tij te V. i madh, unë siç të kam thënë edhe më parë, nuk pajtohem kurrsesi. Ne s'guxojmë t'i derdhim radhët tona, ushtarët tanë, pa nevojë. Më ndje për rrallësinë e letrave, por besom se kokën s'po mund ta lëviz prej punëve të shumta. Po ta dërgoj letrën që ia kam dërguar "Vatrës", por që për shkak të ngutësisë s'kam mundur të konsultohem me shokët, pra as me ty, para se ta dërgoj. Siç e di IK ka shkuar në A. dhe pavarësisht nga të gjitha e ka bërë një punë të mirë. Për këtë më vonë.

26 shtator 1982 Të fala Ll. (Xhafer Shatri)

15. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 9 tetor 1982

I dashur shok,

këto dy ditët e fundit i mora njërën pas tjetrës letrat tua, kjo e fundit ishte përgjegjja e KVG në letrën e K, prandaj edhe po ndalem këtu. Letra është e mirë dhe ky nuk është vetëm mendim i imi, por për hir të unitetit do të sugjeroja ta shtypësh edhe njëherë dhe t'i bësh disa korrektime, në mënyrë që të mos jetë aq e ashpër sidomos disa shprehje si "idioteske" etj. dhe sa më parë t'ua dërgosh ti vetë, sepse kështu do të ishte më së miri, mendoj se mund ta gjejsh një mënyrë. Besoj se nuk do të më keqkuptosh aq më parë kur unë do të ktheja përgjegje në atë letër qysh kaherë, por mu shkaku i ruajtjes së unitetit më ka shtyrë që të përmbahem... Në adresë të ZK kishin ardhur dy letra prej Br. dhe ato m'i lexoj përmes telefonit një shok, si duket ato i kishte shkruar M. Hoti apo dikush i tyre dhe disi interesohej të japim përgjegje decidive për Kamberin. Duke besuar në qëllimin e tyre të mirë unë ua shkrova vetë dhe ua dërgova menjëherë, prandaj të lutem merr hetime se çka është në pyetje. Atë natë nuk u lajmëruam fare dhe kemi bërë keq, por besomë se tërë natën dhe pastaj tërë ditën kemi qenë në rrugë, sepse për atë shokun që e pritëm morëm informata se gjoja ka dalë, mirëpo fjala kishte qenë për tjetër kend, kështu që për një mossqarim të vogël u deshtë të humbim aq shumë kohë e mund. Duke kërkuar falje për këtë që po ju falenderoj njëherit për mikpritjen dhe kujdesin.

Lidhur me bisedimet që patëm unë jam i kënaqur, por disi nuk më ra rasti të të pyes për mendimin tënd lidhur me rezultatet e gjertanishme të bashkimit tonë, për të metat e mundshme që ke vërejtur ti ose shokët e tu nga ana jonë, për mundësitë që kemi lënë ne këndej pa shfrytëzuar etj. sa i përket bashkëpunimit, pastaj shkalla e sinqeritetit etj. Të gjitha këto po t'i them me qëllim që të m'i thuash haptas ashtu si shoku shokut në mënyrë që të mësojmë nga lëshimet dhe të mos lejojmë që ato të përsëriten.

Në letra ti po më përson, dhe gjer më sot më vinte keq të ta them, prandaj tash po marr lirinë të kërkoj nga ti që të më drejtohesh gjithmonë me ti sepse ne jemi shokë e bashkëluftëtarë dhe në çdo aspekt të lirë me njëri-tjetrin. Pos kësaj atë ditë desha të ta them edhe këtë gjë, por më erdhi keq: fjala është për Jusufin. Së pari vlera e të gjallit nuk mund të matet kurrë me vlerën e të vdekurit sidomos në këto çështje... unë për vete do ta quaja për nder të madh që të jem një nxënës i rëndomtë i Jusuf Gërvallës e të mos flasim të krahasohem me të. Mjerisht unë s'kam pasur nderin ta njoh personalisht, por nga shkrimet e tij sidomos dhe nga rrëfimet për të jam bindur se ai ka qenë një nga bijtë më të mëdhenj që i ka lindur populli ynë ndonjëherë. Shumë bashkëkohanik madje edhe bashkëluftëtar të tij nuk ia kanë ditur vlerën... ai ka qenë NJERI prej flokëve e në thonj dhe padyshim një nga fytyrat më të ndritura dhe më të pastra të historisë sonë të re. Kurrë vetes nuk do t'i dëshiroja jetë dhe vdekje më të mirë.

Për hapat që do të ndërmarrësh për a. (azil) pajtohem plotësisht. Vërtetë është koha e fundit të vendosësh.

Të fala Ll. (Xhafer Shatri) 9 tetor 1982

16. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 10 tetor 1982

I dashur shok,

e mora letrën tënde të fundit prandaj po të shkruaj menjëherë. Sa për N. unë vërtetë nuk di se si t'ia kërkoj gjërat për të cilat ti më porosit, sepse me atë njeri unë vetëm njëherë në jetën time ka kontaktuar, pra atë ditë në Bern e asnjëherë tjetër.

Sa për mënyrën e parapagimit të organit mendoj se është mirë, me përjashtim të rreshtit të fundit, sepse ne nuk mund t'u japim njerëzve adresa të na i dërgojnë të hollat aq më parë kur ekziston xhirollogaria për Ndihma Kosovës, apo po që se ta merr mendja atëherë ne po e hapim një kontonumër tjetër gjë që s'më duket e arsyeshme...

Për Peterin ke bërë shumë mirë që je takuar dhe ma merr mendja se kontaktet me të duhet t'i mbajsh rregullisht. Në redaksi po na vinë disa letra që po përpiqen t'i kompromet ojnë shokët në Br. Letrat e tilla nuk do t'i denjësojmë fare me përgjegje. Më parë i ka dërguar disa poezi njëfarë Bashkimi i Dyseldorfit dikund dhe unë ia kam kthyer një përgjegje mjaft të mirë shoqërore, por ai nuk më shkroi më tutje, prandaj a di gjë për atë njeri se çfarë është a jo? Artikulli i Jusufit është i mrekullueshëm prandaj botoje sa më parë, por ama të lutem këqyr e përvetësoi rregullat e drejtshkrimit dhe evitoi gabimet e mundshme të shtypit, sepse po marrim letra që po kërkojnë kujdes të madh në këtë drejtim.

Sa për ardhjen tënde këtu që më shkruan ti unë e kam ditur që në fillim se ajo nuk është e nevojshme sepse ai s'do të vie kurrë, prandaj përpjekjen për një "pajtim" të tillë unë e kam bërë për krejt qëllime tjera pa as më të voglin iluzion. Sa për artikullin e "Lajmëtarit" s'di çka të them njëherë, por në numrin kushtuar shokëve të vrarë do t'i botojmë shumë punime të shokëve të vrarë kryesisht të Jusufit...

Kësaj radhe po t'i dërgoj këto punime e nisja që tash punës sepse nuk pret koha. Ma merr mendja se po që na kushton më lirë do të ishte mirë që botimi të bëhet në letër më të lirë dhe kuptohet ta nxjerrim në sa më pak faqe, po mendoj 14-16 faqe më së shumti por të dalë shpesh dhe të mos humb asgjë nga aktualiteti.

Ndoshta në këtë numër do ta botojmë listën e njerëzve që u dënuan këto kohët e fundit.

Kaq...

10 tetor 1982 Të fala Ll. (Xhafer Shatri)

Në një letër të mëparshme të kam kërkua përgjegje për atë se si ti i sheh marrëdhëniet tona gjer më tash sepse më është bërë një provokim i madh në këtë drejtim.

Më shkruaj gjerësisht se çka të kanë thënë për Ibrahim Kelmendin Sk. (Skënder Dushi) i Vjenës!

17. Letër e Xhafer Shatrit për Sabri Novosellën, 12 tetor 1982

I dashur vëlla, 12 tetor 1982

sot i mora tri letra nga ti dhe menjëherë e vura një shenjë në mur, sepse vërtetë u bë gjatë që s'pata marrë letra të tilla, por për esencën e këtyre letrave do të ndalem në letrën e ardhshme, ndërsa tash po të njohtoj me sa vijon: poashtu sot e mora një letër të KK (Kushtrim Kosova=Abdullah Prapashtica-shën i red.) dhe për përmbajtjen e saj do të ndalem vetëm pak. Ai propozon që Halimin dhe Sk. (Skënderin=Xhafer Durmishin-shën i red.) t'i shkarkojmë nga Kryesia dhe të them të vërtetën ky propozim m'u duk i drejtë, sepse me Qemajlin atëherë s'do të kishim asfarë problemi dhe për këtë po nisem nga ajo që ke thënë ti për të, ndërsa në anën tjetër S do të kishte mundësi t'i përkushtohet përvetësimit të teknikës së shtypit dhe kuptohet çështjeve organizative si kryetar i KVG. Këtë propozim të tij unë e aprovoj duke qenë i bindur se është në interesin e LRSHJ, përndryshe sa i përket Sk. unë për çdo ditë po bindem se ai është njeri i punës e besa edhe mjaft i sinqertë. Në anën tjetër unë i propozova KK që unë të vijë atje dhe të takohemi ne të tre dhe t'i qesim punët në vijë njëherë e përgjithmonë... i thash le të mendoj dhe të propozojë për vendin e takimit etj. duke menduar se ju meqë jeni atje do ta rregulloni këtë punë së bashku, prandaj më shkruaj menjëherë të lutem, sepse unë tashmë kam mundësi

të vi, kuptohet me një pasaportë të një shokut tim i cili më përngjan shumë dhe i cili i ka të rregulluara të gjitha dokumentet sa i përket ndejtjes këtu.

E di se shpenzimet janë të mëdha, por ne s'guxojmë ta lëmë punën që të shkojë më tutje kështu. Në takim me shokët jam ndarë shumë i kënaqur. F. meriton të jetë në udhëheqësi edhe pse nuk është i aftë sa N., megjithatë në këtë njeri mund të bazohesh gjithmonë pa kurrfarë rezerve. Lidhur me Nuhiun kam ndërmarrë edhe unë diçka që disi t'i takoj vetëm atë me S dhe t'i pajtoj por akoma s'kam marrë përgjegje prej N. Mirëpo pasi që të paska shkruar ty edhe nëse unë s'kam sukses nuk do të mërzitem aspak ama aspak. Me rëndësi është që të mos mund të fus zallë në një të çarë të tillë, sepse na dëmton shumë. Për këtë hap i kam telefonuar F. dhe ai u pajtua, por nëse ai nuk e shef të arsyeshme një gjë të tillë, atëherë unë do të tërhiqem menjëherë.

Sa i përket "Kurbetçiut" mua më duhet të shkoj këto ditë në Gj dhe në mos ta paralizoj krejtësisht, së paku ta minimizoj dhe se me të nuk do të ketë rastin të merret kurrë IK por një shok imi, anëtar i udhëheqësisë më të lartë këtu.

Për letrën e Vatrës pajtohem me atë që thua ti dhe më beso se koka më ka dhimbtë shumë e shumë gjersa e kam formuluar në mënyrë që "mishi të piqet e helli të mos digjet", por në këtë hap më ka shtyrë fakti se sipas të gjitha gjasave udba është infiltruar në të bukur shumë, pra në "Vatrën" e Nolit dhe në kohën kur Plaku (Bujar Hoxha-shën i red.) me kolegët, bëjnë politikë të "madhe" me llojlloj injorantësh. Para kësaj s'kam mundur të rri indiferent, prandaj e kam bërë vetëm atë që ma ka marrë mendja se i kontribuon asaj që të mos përdhoset një relikt yni siç është "Vatra". Përndryshe në atë drejtim nuk kam asnjë iluzion. Ndërsa sa për ndihma ne do të mbështetemi vetëm në forcat tona. Pohimi yt për ndryshimin e sjelljes pas M. Sh. (Mehmet Shehut-shën i red.) është shumë simptomatik dhe ke bërë shumë mirë që më ke njohtuar me këtë. Të lutem që të më kthesh përgjegje sa më parë lidhur me propozimin tim, dërgoje express. Nëse s'të pëlqen mos të të vie keq të ma thuash!

Të fala vëllazërore U. (Xhafer Shatri) (Për hapjen e le... edhe unë po dysh.)

(Shënim i Sabri Novosellës për Xhafer Durmishin, lidhur me këtë letër: "I dashur vëlla, ky propozim i K. i aprovuar nga U. m'u duk i arsyeshëm edhe mua. Largimi i Halimit do të ishte shumë i arsyeshëm, kurse me Qemalin kam bindjen se do të jetë pozitiv sidomos kur të jetë pranë Uk. Nëqoftëse do të ndahen definitivisht do të na duhet me humbë gjysmën e kohës rreth tyre, pasi ata s'do të heshtin. Kurse ti në ZK nuk do të kryeje vetëm punë teknike, por faktikisht ti do të jesh shtylla kryesore e tij.

Të fala vëllazërore M. (Mërgimi=Sabri Novosella)

18. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 18 tetor 1982

Shok Gj., 18.10.1982

e mora letrën tënde e cila kishte mjaft paqartësi. Së pari unë kam kërkuar që të takoheni vetëm ju të dy, në prezencën time, por jo aq për të ose me ndonjë shpresë se ai do të vie, këtu unë s'kam pasur asnjë iluzion, por kjo ka qenë e mirëseardhur për ne në mënyrë që ta kuptojnë shumë njerëz se aty diçka nuk është në rregull, sepse ai që i ikën takimit nuk e ka ndërgjegjen e pastër. Për të holla në Br. do të bëjmë diçka, por sa për "Ilirinë" siç më ka shkruar edhe Kamberi atë do ta botojmë ne, e besa edhe ta redaktojmë. Por tash për tash ne duhet ta nxjerrim organin sa më shpesh, ndërsa "Ilirinë" njëherë në tre-katër muaj sepse nuk kemi mundësi. Mu për shkak të pamundësisë ne u deshtë ta lëmë krejt "Kurbetçiun" pasi që njerëzit e dhanë pëlqimin e tyre dhe për këtë sigurisht se unë do të kritikohem, bile ashpër. Por nejse. Atë letrën që ta dërgova para disa ditësh nuk

mora përgjegje, unë mendoj se ne duhet ta analizojmë rrugën që kemi kaluar gjer më tash. Lidhur me këtë të lutem të më shkruajsh gjithashtu edhe për bisedën tënde me E. (Engjëll Kolanecin-shën i red.) bile gjerësisht në mënyrë që ta kem një pasqyrë sa më të qartë, sepse diçka më njohtoi F. Duhet të them se disa njerëz që kanë qenë atje më kanë njohtuar se i kanë parë takimet e herëpashershme qoftë me ty qoftë me N. të E. apo të kolegut të tij. Kjo gjë më ka dëshpëruar pa masë. Kjo është turpshme që ata të merren me mospajtimet tona. Mua ma ka dërguar Kamberi letrën që ia ka dërguar N. Në të nuk kishte asgjë. Ajo ishte në stilin e tij: po të them asgjë..." Por nejse. Kalojnë edhe këto. Por do të dëshiroja ta dija se me çka më së shumti ia kishin mbushur kokën E. Poashtu dua të dijë se a ka qenë atë ditë atje Halimi apo jo, pastaj Qemajli etj.

Lidhur me organin ne duhet të ndërmarrim këtë gjë: sa më parë do ta zgjedhim redaksinë së pakut prej 5-6 vetësh. Aty do të jesh ti, një shok prej Bru., Qemajli, një shok tjetër që ti s'e njeh dhe unë. Me atë rast do t'i ndajmë detyrat dhe çdo njëri prej nesh ta shkruaj nga një rubrikë dhe para botimit të çdo numri të mbahet mbledhja dhe të analizohet përgatitja e përgjithshme. Kjo do të na ndihmojë shumë. Mitat Vr. (Vranica) lidhur me letrën e K. na e ka dërguar në Red. një letër shumë të poshtër duke thënë se ai po e ditke se në "livadhin e kujt po kullotkemi ne" etj. Do t'ia kthej një përgjigje. Bisedo me shokët e Br. për redaksinë sa më parë dhe ata le të vendosin për shokun e vet.

Më shkruaj menjëherë... Të fala Ll. (Xhafer Shatri)

19. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 1 nëntor 1982

Shok Gj. 1 nëntor 1982

Kur u ktheva nga rruga më ra në dorë letra jote. Po të përgjegjem menjëherë. Pajtohem plotësisht me atë citimin e Jusufit për domosdoshmërinë e njësimit të deklaratives me monologjet e dialogjet... dhe për atë që thua ti se duhet të botojmë diçka të përafërt me NH (Nova Hrvatska-shën i red.) Edhe analiza e punës së gjertanishme ka koncizitet e besa edhe mjaft ngjashmëri me ato krahasimet që bënë ti. Lidhur me njerëzit që thua ti se nuk duhet të lejojmë të ketë probleme, aty nuk ka asnjë dyshim. Unë jam takuar me Sh. (Shaqir Shabanin-shën i red.) këtu para dy ditësh dhe me kënaqësi kuptova pa ma thënë ai haptas, se ka kontaktuar me ty dhe se në të ardhmen nuk do të mund të manipulohet me të. Unë kam besim të madh në atë njeri, por me qëllim që të mos hy më thellë me të pa dijen tënde do të ishte mirë që ta përcaktojmë se kush mund të kontribuoj më shumë, pra pa lënë të na grumbullohen kuadrot apo anëtarët.

Në këtë rast për çdo individ do të konsultohem ne të dy, sepse siç ua kam thënë se e sa herë unë nuk kam pranuar të bashkohemi me qëllim që të bëjmë veprime diversioniste në radhët e njëri tjetrit por me qëllim që të bashkohemi përfundimisht dhe nga shokët tanë ta formojmë një "organizatë unike e operative", pra një kulm e një ndërtesë e jo një kulm e tri ndërtesa... kur ta kam shkruar një letër më parë, në përgjegjen e së cilës kam fituar përshtypjen se është keqkuptuar krejtësisht, unë kam insistuar që t'i shprehësh botëkuptimet e tua lidhur me këto çështje, pra të mirat dhe të metat, sidomos këto të fundit që i keni parë në këtë anën tonë, dhe këtë jo për tjetër po me qëllim që të mos përsëriten e asgjë tjetër. Ma merr mendja se të kam treguar, jo me fjalë, se këtyre punëve nuk u kam hyrë për të bërë ndonjë karrierë, por vetëm pse e di se duhet të sakrifikojmë të gjithë, prandaj si të tjerët unë po e bëj vetëm atë që po mundem pa i dhënë vetes të drejtë të kërkoj qoftë edhe shpërblimin më të vogël. Si edhe të tjerët jam për atë që të bëjmë aleatë e sa më pak armiq... jam për një unitet të mirëfilltë të mendimit e të veprimit në mes bashkëluftëtarësh, sepse pa të nuk mund ta bëjmë as një hap... këto thashethemet e fundit më kanë humbur shumë kohë dhe më kanë dëmtuar pa masë. Kur

po mendoj në gjëra të tilla po më humb qetësi krejtësisht e pa të siç e di, nuk mund të shkruhet asgjë e hajrit.

Këto punime po t'i dërgoj tash, ndërsa korrigjimin e fejtonit të Ademit nuk e kam bërë, sepse nuk më ka shkruar Kamberi edhe pse pata kërkuar leje nga ai. Ndoshta ka harruar, sidoqoftë përpunoje ti ashtu siç ta merr mendja, por pa lejen e tij mos e bërë. Në Dysel. tash puna është mirë, prandaj s'ke nevojë të angazhohesh atje. Do të ishte mirë që këto qytetet tjera si Kaseli, Frankfurtit etj., të jenë objekt observimi e besa të dalësh edhe kah Aus. Por mendoj se org. duhet të jetë në dy faza: a) të org. njerëzit më të aftë në fshehtësinë më të madhe dhe b) njerëzit përmes së cilëve masoviziohet Lëvizja, por që prej tyre nuk mund të presim ku me dit sa. Këta njerëz nuk bën të përzihen në mes veti. Lidhur me zgjerimin e radhëve mund të bisedosh vetëm me F. po mendoj tek emrat konkret të njerëzve... në këtë drejtim kij shumë kujdes. Pra emrat e anëtarëve mund dhe duhet t'i dijnë vetëm njerëzit që kanë kontakt me ta, por jo edhe ndonjëri prej anëtarëve të KVG që ata njerëz nuk i ka organizuar. F. është tjetër gjë, në të mund të llogaritësh për çdo gjë që paraqitet nevoja, bile unë i kam thënë Kamberit se ai duhet ta zëvendësoj N. në KD.

Për punimin kushtuar Jusufit mendoj se duhet botuar me rastin e përvjetorit të rënies së shokëve, pra në një numër që kryesisht do t'ju kushtohet atyre. Lidhur me emrin tim po të them prapë se nuk bën të përmendet në asnjë mënyrë, absolutisht në asnjë mënyrë, pavarësisht se çka dërdëllitin bota. Unë fjalë e E. që i paska lëshuar i marrë më parë si provokim që të është bërë ty për ta kuptuar se në ç'shkallë është besimi dhe mirëkuptimi ynë, sepse përkundër të gjithave unë s'besoj se ata përpiqen që m'u në këtë kohë ta minojnë punën tonë, unitetin tonë. Tek i lexoj shkrimet e atjeshme, çfarëdo qofshin ato, unë kurrë se besoj se dikush prej tyre guxon të merret me punë që e dëmtojnë një lëvizje nacionalçlirimtare e kujtdo qoftë ajo. Por nëse atij i intereson që ta dij atë punë, atëherë le t'i drejtohet shokut tonë kompetent për marrëdhënie me ta dhe ai do t'ia mbaj një ligjëratë të vogël jo vetëm për këtë "rastin" tim, por edhe për mirësjelljen. Kjo punë mos të shqetësoj aspak. Shqetësues është rasti i Dritës, bile shumë shqetësues, sepse mua nuk mund të më bind askush se ajo do ta përdhosë gjakun e Sokolit tonë. Për këtë numër të organit mendoj se në faqe të parë duhet botuar fotografia e Ismail Qemalit, pastaj një ese për Pavarësinë dhe më pastaj një koment tjetër poashtu për Shpalljen e Pavarësisë. Këtë e ka marrë përsipër një shok yni dhe do të vi tek ti brenda javës. Po a ke ndonjë foto për faqen e parë, diçka si të mirë? Në adresë të organit po na vijnë letra edhe të holla. Radhën tjetër do të shkruaj sa kanë ardhur dhe asnjë tërheqje nuk do të bëhet pa pëlqim të përgjithshëm, sepse sidomos në këtë drejtim duhet të kemi shumë kujdes sepse përmes kësaj do të përpiqen njerëzit të na përçajnë bile do të ishte mirë që të mblidhemi më 10.12 Dita ndërkomb. e të Drej. të Nje. para pallatit të OKB në Gj. apo edhe në Strasburg para Parlamentit Evropian apo me rastin e përvjetorit të rënies së shokëve në St. 10 dhjetori ka jehonë në botë, por edhe qendra gjeografike...

Nesër më duhet të shtrihem në spital për operacion, besoj se nuk do të rri shumë. Kur të dal na mbetet të marrim vendim përfundimtar për manifestimin.

(Xhafer Shatri)

20. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 14 nëntor 1982

Shok Gj.

sot po ta dërgoj këtë punim i cili ma merr mendja se duhet të botohet dikund në faqen e dytë, para komentit historik për Pavarësinë, të cilin ka mbetur ta shkruaj një shok po që gjer më tash nuk ma dërgoj. Do ta pyes nesër në telefon në vendin e punës, e nëse nuk e ka bërë si duhet atëherë po e punoj unë dhe po ta dërgoj që tash. Edhe pse u bë shumë vonë por siç po e sheh nuk po e mbajnë fjalën sa duhet. Punimi që po ta dërgoj ma merr mendja se duhet të botohet me shkronja pak më të mëdha, si në vend urimi i LRSHJ, Atdheut.

Kamberi ma ka dërguar atë propozimin tënd lidhur me parapagimin e ZK dhe lidhur me të i kishte dhënë disa vërejtje që m'u dukën mjaft me vend. Edhe unë mendoj se ajo kërkesë duhet të konkretizohet.

Posa kam dalë prej spitalit, t'i kam dërguar punimet e mbetura, pra sa të vie edhe punimi tjetër, atëherë ky numër po kompletohet krejtësisht. Besoj se do të arrish ta botosh në prag të festës. Punime tjera KK dhe H nuk kanë dërguar fare. Nuk e di se çka dreqi është në pyetje. As në letrat e fundit që ua kam dërguar nuk kam marrë përgjegje.

Në një letër Kamberi më shkruan se gjoja ti po mendoke se unë po taktizoj me ty, do të ishte mirë që në këtë drejtim të më shkruajsh bukur gjerësisht, sepse këtë nuk kam si ta marrë ndryshe pos si një keqtrajtim të sinqeritetit tim. Lidhur me këtë nuk do të kënaqem me një sqarim të rëndomtë, sepse kjo është një befasi shumë e madhe për mua.

Kaq. Të fala Ll. (Xhafer Shatri), 14 nëntor 1982

Mendoj se do të ishte mirë ta botojmë fotografinë e Ademit, por të madhe si POSTER me urimin për 70 vjetorin!

21. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, dhjetor 1982

Shok Gj.

këto janë punimet e fundit që duhet t'i botosh në këtë numër, dhe tjera nuk. Unë shpresoj se për këtë do të gjesh vend sepse pa to org. do të mbetej i zbrazët. Me qëllim nuk i zgjata më tepër. Në letrat tua do të kthej përgjegje më vonë sepse gjer më tash njëmend nuk kam pasur mundësi.

Gjatë botimit jij në radhë të parë gazetar dhe shikoje gjithnjë se çka është aktuale dhe mos të botohen gjëra që u ka dal aktualiteti apo edhe asosh që ne i kemi botuar edhe më parë. Reportazhi për 28 nëntorin, ky për demonstratën dhe ky për punëtorët janë të domosdoshëm.

Të fala LL. (Xhafer Shatri)

Nën letrat e lexuesve botoje edhe këtë letërz të veçantë, sepse fjala është për një lexues nga Brukseli i cili na ka shkruar tri herë rresht dhe ka kërkuar ndihmë mirëpo adresë nuk ka e s'po dimë se si t'i ndihmojmë (moralisht)

pra:

Lexuesi nga Brukseli, i cili tri letrat e tija i nënshkroi me mbiemër që niste me Sh... është e domosdoshme që të na e dërgoi adresën sa më parë, sepse shkak i mospërgjegjes është mungesa e adresës.

(Dhjetor 1982-shën i red.)

22. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 19 dhjetor 1982

Shok Gj.

në letrat tua po të përgjigjem me vonesë, sepse njëmend i kam pasur njëmijë punë, pastaj edhe të punojë po më duhet çdo ditë dhe kjo po më dëmton poashtu. Sidoqoftë po përpiqem të të shkruaj vetëm për çështjet që tash na hynë në punë, për të tjerat duhet të shihemi së shpejti dhe do t'i shqyrtojmë hollësisht, edhe pse kam mbetur jo pak i befasuar pse nuk erdhe në dasmë. Së pakut ti është dashur të vish. Sidoqoftë qëllimi u arritë plotësisht...

Sa për numrin e ardhshëm të organit mendoj se duhet kushtuar kryesisht shokëve të vrarë, dhe për këtë do të kemi mundësi të rrimë e të bisedojmë së shpejti, besoj javën e ardhshme...

Këtë shkresë e shkrova para dy ditësh dhe ia dërgova KK e edhe Mër. Mospërgjegjja e tyre edhe në këtë thirrje na i lë duartë të lira ta bëjmë këtë: pra zgjedhjen e Qendrës Ekzekutive të L në Perëndim prej pesë vetësh dhe atë

Përgjegjësin për or. të jashtëm, (për organizim të jashtëm-shën i red.)
Përgjegjësin për marrëdhënie me bj, (bj=botën e jashtme-shën i red.)
Përgjegjësin për prop., (prop.= propagandë)
për org. të br. (për organizim të brendshëm-lidhjet me Kosovën- shën i red.)
përgj. për ç. mater. (përgjegjësin për çështjet materiale-shën i red.)

Kjo çështje duhet të rregullohet tash së shpejti.

Sa për artikullin kushtuar Sokolit qysh kaherë ti pate kërkuar që ta marrësh përsipër rregullimin e tij dhe unë u pajtova me përjashtim të përmendjes së emrit tim, kjo siç të kam thënë edhe më parë nuk guxon të vie fare në konsiderim, për këtë nuk kemi çka të diskutojmë më kurrë.

Për organin duhet të bisedojmë sa më gjerësisht dhe këtë çështje duhet rregulluar disi sa më mirë në mënyrë që të mos përsëriten artikujt dhe në anën tjetër të botohen ata që janë aktual në kohën që s'e kanë humbur akoma aktualitetin, pastaj për manifestimet e 28 Nëntorit duhet të botohet vetëm një reportazh për të gjithë, pra për S, për Br., për C., për Gj. Hiç më gjatë jo. Sa për referat me sa di unë Shaqa nuk e ka lexuar asnjë referat në C. Përndryshe ai që është lexuar është i gjatë dhe s'bën të botohet.

Unë mendoj se ne duhet të botojmë materiale kryesisht nga Kosova, kuptohet me ndonjë reportazh nga jeta dhe veprimtaria e mërgimtarëve shqiptarë.

Artikujt që unë t'i kam dërguar e që kësaj radhe kanë mbetur pa u botuar më duhet t'i këqyrë se cilët njëmend meritojmë t'i botojmë tash.

Për gazetarët që gjoja Tanjugu ka lajmëruar se gjoja i kemi maltretuar, po të njohtoj se kemi rënë në kontakt me ta dhe se ata na kanë premtuar se do t'i demantojnë me tërë forcën shpifjet e tilla të Tanjugut, bile do të marrim edhe një shkresë me shkrim të cilën ndodhë ta botojmë si dëshmi e dallavereve serbe...

Gazetat e këtushme i kanë dhënë publicitet të madh këtij rasti, bile ajo qendrore e ka botuar fotografinë e dasmorëve në faqe të parë dhe nëpër kiosqe janë botuar shpallje të mëdha "Grand Manif a Geneve". Do të thotë se ia kemi arritur qëllimit plotësisht, e pastaj të shohim e të bëjmë.

Sa për ata komplimentet që ti përmend se ndodhë t'ia japim njëri-tjetrit pas kësaj mbledhje kryesore që duhet ta mbajmë, unë mendoj se bile në këso rastesh nuk do të vij ajo fare në shprehje, ne duhet të punojmë e të luftojmë dhe çdo gjë që na pengon në këtë drejtim e sidomos mossinqeritetin ta luftojmë me të gjitha forcat. Fundja ne njerëzit duhet t'i marrim ashtu siç janë me të gjitha të mirat dhe të metat e mundshme që kanë.

Që të gjithë duhet ta kemi të qartë se para kësaj mbledhje duhet t'i mendojmë të gjitha në mënyrë që nesër apo pasnesër të mos dalë diçka e papritur.

Në konto janë bërë afër 10 000 franga, gjer më tash asgjë nuk kemi nxjerrë, të hollat e fundit për organ i kemi dhënë tonat, dhe as që e kemi ndërmend ta nxjerrim qoftë edhe një qindarkë të vetme përderisa të mos u vëmë një kapak të sigurtë këtyre punëve tona. Kuptohet se në mbl. do t'i shqyrtojmë edhe disa raste mjaft simptomatike e shqetësuese për të cilat veç i kam folur Faridinit në telefon.

Pra në këtë mble. duhet të jemi të gjithë të përgatitur shumë mirë dhe t'i qesim punët në vi, në mënyrë që nesër ose pasnesër të mos kemi vrcmrc në asnjë pikë. Atë ditë do të ndahen përfundimisht detyrat dhe do t'i grahim punës ashtu siç me të vërtetë pritet prej nesh.

Më ndje se nuk po të shkruaj më gjatë, por besomë se i kam njëmijë punë.

Prandaj ti dhe shokët pranoni përshëndetjet e mia të përzemërta.

19 dhjetor 1982 U. (Xhafer Shatri)

Me qëllim që të tregohemi gjer në fund "fer" unë këtë shkresë ia kam dërguar, siç të thash edhe më lartë. Dëshiroj që ta kam ndërgjegjen e pastër në çdo rast.

23. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, dimër 1982

Shok Gj., (dimër 1982-shën i red.)

sonte më ranë në dorë dy letrat tuat. Sa për organin më erdhi keq vetëm pse nuk është botuar komenti për këtë përvjetor, mirëpo pasi që është vonuar s'ke edhe çka i bën, prej lëkurës nuk mund të dalim. Ndërsa tash po të jap përgjegje për të gjitha ato që më shkruan ti. Së pari mua Kamberi nuk më ka thënë tekstualisht lidhur me taktizimin, por në mënyrë indirekte kjo kuptohej fare mirë gjë që më ka befasuar shumë. Sa për ardhjen e shokëve nga Bilefeldi, Dyseldorfi etj. unë këtë po e dëgjoj prej teje, më parë ma ka thënë edhe F., por si një manifestim gati qendror në S. e asesi ndryshe, fundja nga kjo punë nuk shoh asgjë negative përkundrazi, po ashtu edhe për kokën ju nuk keni pse ta mbani ulur. Për besë mua për këtë kurrë nuk do të më shkonte mendja. Lidhur me letrat apo datat e tyre ekziston mundësia fare lehtë të më vonohen letrat dhe dikush të marrë të parën dhe të ma sjell pas të dytës, por jij i sigurt se lojëra të tilla unë nuk bëjë kurrë, ndërsa pse ta kam bërë pyetjen për shkallën e sinqeritetit nga ana jonë, këtë s'e kam bërë pa shkak, sepse kam vërejtur gjëra të tilla që mua më kanë befasuar jo pak, për këto ne do të bisedojmë, prandaj të kam pyetur athua mos edhe dikush nga ana jonë po i kushtëzon ato pa qenë unë i vetëdijshëm fare?

Mos harro se për besimin tim të plot sa i përket anës suaj unë jam kritikuar disa herë, sa që njerëzit më kanë quajtur edhe naivë. Por e kam përbirë këtë se e di se pa besim të plotë nuk ka luftë të suksesshme. Nëse unë nuk guxoj të ta kthej ty kurrizin, atëherë çfarë lufte mund të bëjmë ne?

Sa i përket M. Hakut ti nuk ke gabuar aspak, edhe pse sipas informatave që i kam marrë për të, ai nuk ka qenë aspak njeri i keq. Lidhur me E. unë të kam thënë se më tepër unë nuk dua të takohem me të, sepse jam bindur me fakte se ai pse e sheh udba me ty, me mua e me atë tjetrin nuk i jep pesë pare, e unë thjeshtë nuk jam për takime të tilla, mirëpo pse ti shihesh me të, jij i sigurt se unë nuk kam asgjë kundër, mirëpo mu për këtë njerëzit mua ma kanë zënë për të madhe pse lejoj shkeljen e vendimeve, bile shkojnë aq larg sa që më thonë mua se Kamberi (Sabri Novos nuk është i autorizuar që të ketë vetëm ai kontakte me v.m.!!! (v.m.= vëllaun e madh-diplomatët e Shqipërisë-shën i red.). Kur E. nuk ka aspak kujdes në këtë drejtim, unë s'di si ta quaj këtë ndryshe pos si nënçmim tonin, e me njerëzit që më nënçmojnë unë s'dua edhe të bisedoj, sepse nga biseda të tilla nuk del asgjë. Mirëpo edhe nëse ndonjëherë rri me të, jij po ashtu i sigurt se që në fillim do të

bëjë me dije se unë askujt nuk i besoj më shumë se sa shokëve e bashkëluftëtarëve të mi me të cilët më pret vdekja në çdo hap.

Lidhur me 5000 frangat, kur e kam përmend këtë fjala ka qenë te mbledhja e ndihmave dhe se si njerëzit më shumë janë në gjendje të japin në dorë po që se kanë besim të pakufishëm në dikend se sa të dërgojnë në xhirollogari, përndryshe atë shumë ia ka dhënë një njeri i varfër (e kam parë para dy javësh) një shokut tonë, bile njeri i varfër sa mendja mos ta përthekojë dhe kjo gjë na ka mundësuar të blejmë kerrin, përndryshe jij sërish i sigurt s'ta kam thënë atë për t'u mburr para teje por e kam përmend me shumë njerëz duke e marrë si dëshmi jo të vogël se populli është me ne, i tëri, prandaj edhe kemi obligime të mëdha ndaj tij. Edhe për telefonin është e njëjta gjë, në atë numër thërrasin shumë njerëz të cilët ndoshta s'e din as kush jam, përndryshe unë s'kam nevojë të të fsheh ty se ku ndodhem kur ti këtë gjë e di prej fillimit, unë jam në Z., dreqi e marrtë e jo në F. Ti këtë e di mirë. Edhe për pseudonimet jo vetëm më kanë njohtuar njerëzit përmes telefonit të nesërmen, por kanë ardhur në red. shumë letra për këtë çështje, të cilat kanë për qëllim edhe t'i diskreditojnë shokët.

(Xhafer Shatri)

24. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 26 dhjetor 1982

Shok Gj.,

meqë në letrën e fundit për shkak të ngutjes nuk kam qenë gjithaq i qartë, po të shkruaj prapë dhe po t'i tregoj pikëpamjet e mia lidhur me numrin e fundit të organit. Së pari në faqen e parë duhet të jetë fotoja rrënqethëse ku shihet vetura e bërë shoshë nga plumbat dhe trupi i shokut tonë i shtrirë në dëborë. Në të dytën komenti rreth përvjetorit të vrasjes së shokëve, besoj se do të ta nis nesër. Pastaj fotot e shokëve, por diçka më të mira, po ti dërgoj tri që mua më janë dukur mjaft të mira e ti bëja si të duash, por me porosi që së toku me të tjerat që t'i kam dhënë edhe më parë të m'i kthesh, pastaj vie artikulli i Jusufit "T'i japim shtytje të re luftës", së dyti një artikull nga Liria të cilin akoma nuk e kam zgjedhur nga arsyeja e thjeshtë se nuk po kam kohë, këtë ta dërgoj pasnesër. Pastaj një koment lidhur me demonstratën së toku me foton që është botuar në gazetën autoritative zvicerane Le Suisse, pastaj një reportazh për festimin e 28 Nëntorit në mërgim, pra le të jetë i përgjithësuar, pastaj një koment i shkurt për vitin 83, çka duhet të bëjë rinia kosovare... një faqe do t'ua rezervojmë letrave dhe një përgjegje lidhur me botimet e egra apo për thirrjet në emër të Lëvizjes nga ana e lloj-lloj njerëzve, shembull konkret le të merret komunikata që ma ke dërguar ti ndërsa qëllimi kryesor tek qarkorja për të cilën shpresoj se të ka shkruar Mërgimi. Një artikull duhet të jetë për mikpritjen apo më mirë të them për "mirëseardhjen" që u përgatiti udba shokëve tanë mërgimtarë.

Prej punimeve që ti ke atje lidhur me fejtonin për Jusufin këqyr që të jetë sa më i shkurtë sepse njëkohësisht duhet ta botojmë edhe një për Zeqën që të botohen paralelisht, por të mos jenë aq të gjatë, mjafton nga një faqe e njërit dhe e tjetrit, së pakut tash, në fillim. Më vonë këqyrim. Sa për atë takimin për të cilin kam biseduar me F. tash për tash ka mbetur, sepse duhet ta përgatisim organin e pastaj atë manifestimin për të cilin mendoj se duhet të mbahet më 15 janar, në mënyrë që të kemi kohë për përgatitjen e atij dokumentit që duhet dorëzuar në OKB bile gjer më 20 janar, sepse mbledhja vjetore për të drejtat e Njeriut nisën nga punimet më 30 janar.

Nëse organi nuk ngarkohet duhet të botojmë edhe diç nga shtypi i huaj që shkroi për dasmën e fundit apo për ndonjë temë tjetër më aktuale. Do të ishte mirë të botohet bile një këngë kushtuar tre shokëve në mënyrë që ta mësojë populli dhe ta këndojë...

Këngën do ta dërgoj sa më parë sikurse edhe punimet tjera. E di se po vonohen gjërat, por besom se nuk po kam mundësi të bëjë më shumë, po e sheh edhe vet se na e

ka zënë puna punën, po të shpresojmë se pas atij takimit të ardhshëm ndoshta do të shkojë puna pak më mirë...

Ndihma kanë ardhur, si duket janë mbi 10 mijë franga dhe gjer më sot nuk e kemi nxjerrë asnjë centavos, të hollat për numrin e fundit të organit i kemi dhënë tonat personale vetëm e vetëm që të mos ia lejojmë askujt të thotë se e keqpërdorëm besimin dhe përderisa të mos caktohet shoku kompetent për këtë çështje, unë nuk do të lejoj askënd t'i nxjerrë.

Lidhur me atë që ti thua në letrën e fundit se ne gjoja qenkemi thirrë se manifestimi i Cyrihut është bërë në emër të ZK, kjo nuk është e vërtetë, i vetmi rast që e kam bërë është kur një injoranti i kam thënë se një shoku im i Redaksisë së ZK më ka porositur që t'i them që të na çojë informata për tre vëllezërit e burgosur sepse mendonim ta përmendim si rast në peticionin dërguar OKB-s. Prandaj është e domosdoshme që për këtë dezinformim të më shkruajsh se prej nga dhe prej kujt ka lindur. Edhe për manifestimet unë ju kam dërguar propozime që ta zgjedhim njërën prej tri datave, 28 Nëntorin, 10 dhjetorin apo 17 janarin dhe me bindje se festimet tjera le të jenë lokale për çka e kam njohtuar F. pra se këtu do të mbahet në C. por si qendror për Z. e jo më gjerë. Ndërporpozimi im i ngutshëm për 28 Nëntor, ka ardhur për shkak të fjalimit të fundit... por shokët nuk e panë të arsyeshme dhe që në fillim unë i thash F. që këtë çështje mos ta dij askush pos ju dyve, bile për këtë çështje mua më ka dalur këtu telashe e madhe...

Zëri i Popullit e ka botuar një artikull shumë interesant për dasmën tonë ndoshta s'do të ishte keq ta botojmë, por mos nuk do të ketë vend?

Tash për tash kaq...

26 dhjetor 1982 Të fala Ll. (Xhafer Shatri)

Ty dhe shokëve, të gjitha të mirat për Vitin e Ri 1983!

P.S. Poashtu duhet botuar për gjykimet e fundit.

25. Letër e Xhafer Shatrit për Remzi Ademin, janar 1982

(Xhafer Shatri për Remzi Ademin)

I dashur shok,

po të lajmërohem sërish me këta rreshta me dëshirë që ty, familjen dhe shokët të ju gjejë shëndosh e mirë. Edhe ne këndej jemi fare mirë. Ai shoku ka shkuar, po dukej djalë i mirë, por ishin që të gjithë shumë të rinj dhe mos po bëjnë kund farë kiksi e bien në burg. Sidoqoftë takimi me ta ka një rëndësi bukur të madhe. Për materialin që ke ndërmend ta dërgosh, do të ishte mirë që të bisedosh me F. nëse ka ia ndonjë Zë të mëparshëm të Kosovës, në mënyrë që të mos jenë të gjithë Zk të njëllojtë, pastaj edhe ndonjë libër kombinoje, sidomos "Titistët" dhe unë do ta dërgojë ndonjë ekzemplarë të "Këngëve të lirisë".

Natyrisht nëse nuk bëhen shumë, por kij kujdes në zgjedhjen e njeriut që do ta dërgoj materialin, nëse ke nevojë për material të sërishëm ti vetëm urdhëro e shkruaj, sepse ta dërgoj unë. Edhe gjatë dërgimit është mirë të kish kujdes, po mendoj gjatë dorëzimit të tij. Për këtë operacion do të ishte mirë të më informosh më gjerësisht, në mënyrë që ta dij se si të këshilloj për ndonjë detaj.

Përshëndetje revolucionare B (B=Bacaloku=Xhafer Shatri)

26. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 4 janar 1983

Shok Gj.,

me një vonesë po të përgjigjem në letrat e fundit. Shkak ishte zënia e madhe me punimet e fundit të cilat besoj se do të arrijnë me kohë, mirëpo edhe pse po i dërgojmë expres, megjithatë ato po vonohen çuditërisht, diçka s'është në rregull. Për shkak të ngutjes edhe letërthirrjen për tubimin përkujtimor ia dhashë të shkruar IK që ta shumëzojë, mirëpo këndej e kishte dërguar vetëm një kopje... dreq bjeri në fije, me sa dëgjova ishte shpërndarë edhe një thirrje tjetër... pastaj edhe një trakt... këtë e kam. Pra puna nuk është aspak mirë. Ne duhet të ndërmarrim diçka...

Tash është shumë me rëndësi që ta rregullojmë edhe këtë tubim si duhet prandaj bisedo me shokët... unë e thirra F., por ai qenka në spital, më erdhi shumë keq, por larg, shumë larg dhe nuk po mund të shkojmë e ta vizitojmë ose bile të ndihmojmë në përgatitjet. Duhet të formohet një komision i përgjithshëm përgatitor në të cilin duhet futur sa më tepër punëtorë që janë nën ndikimin tuaj, sepse kjo do ta paralizonte krejtësisht çdo qëllim destruktiv.

Lidhur me letrën e tij unë i shkrova Kamberit e i dhash sqarimet e mia. Sa për punimin tënd unë mendoj se është i mirë, por në të ardhmen këqyr dhe merre një rubrikë të veçantë e specializohu për të, por gjithnjë kije parasysh se propaganda e sotme duhet të jetë e dokumentuar e ashpër dhe konkrete, pra me sa më pak fjalë të thuhet sa më shumë, në çështje ekonomike të merren shifra e fakte konkrete, pastaj të matet pulsi i masës se për çfarë ka më tepër nevojë dhe shkrimet tona t'ia përshtasim shijes së saj... kjo ka rëndësi shumë të madhe.

A mos t'i kanë dërguar shokët e "Ilirisë" shkrimet për numrin tre, çfarë kualiteti kanë, nëse t'i kanë dërguar etj.?

Për çështjet org. po shkon tollovi e madhe, një dreq i madh po e luan rolin e vet për mrekulli dhe po që se vazhdon kështu atëherë mos pyet, po sidoqoftë punët duhet qitur në vijë sa më parë. Mendo për këtë dhe më shkruaj, sepse së pakut tash ti ke më tepër mundësi. Merre me mend unë po punoj 10 orë në ditë dhe kjo po më dëmton pa hesapë. Ani sidomos në këtë kohë kur po kërkohet kaq shumë punë...

Do të përpiqem që të arrij me kohë në tubim por kësaj radhe e kam bukur vështirë, sepse kanë shkuar shumë njerëz me letra të kuqe, të cilët m'i jepnin me dëshirë.

Është tepër vonë ndaj s'po e zgjas më tepër, prandaj prit të fala nga Ll. (Xhafer Shatri), 4 janar 1983

27. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 31 janar 1983

I dashur shok,

sot u lirova pak andaj po të shkruaj menjëherë. Me Sh. s'është puna aspak mirë. Ai njeri me të gjitha forcat po përpiqet të mbjellë përçarje. Merre me mend tash ka nisur të hap një klub në një fshat të vogël në mes Gj e Lloz. pra në mes dy klubesh të mëdha dhe kuptohet me qëllime të caktuara. Për këtë po shihet se ai njeri së toku me N. po i kryen urdhëratë e dikujt, sepse edhe Hasan Veselaj e ka ndërmend të hap një klub dikund kah rrethi i S. Për këtë jam informuar, prandaj këqyr, bisedo me shokë që të marrin hetime dhe kuptohet iniciativën, sepse po shihet se këta e kanë për qëllim të na kundërvihen me klubet dhe kjo është një taktikë shumë e rrezikshme që mund të ketë pasoja të mëdha. Lidhur me Ha. Ves. këtë mbaje në atë mënyrë që të mos dihet kurrë se prej kujt dhe nga ka rrjedhur. Përndryshe ekziston bindja se Sh. e ka hequr maskën krejtësisht, dhe tash ku po shkon po mbjell përçarje gjë që vetëm sa po e komprometon veten shumë, por edhe po na i denoncon njerëzit bile edhe tek pol. e këtushme ata që punojnë në të zezë, vetëm

pse nuk iu bindkan urdhrave të tij. Të merremi vesh se ai këtë po e bën në mënyrë shumë perfide, tamam profesionist.

Për ata të v. të m. më shkruaj gjerësisht dhe më njohto se kur do të mund të dalësh këndej, sepse do ta rregullonim disi një dok... për ty, pastaj çka bëre me pyetjet që i ke pasur, si u ndave?

Në Br. e arritëm njëfarë kompromisi, besoj se në të ardhmen puna do të shkojë më mirë, por nuk po punonin njerëzit fare përkundër kushteve shumë të mira. Shokët e Il. janë më të vyerit, s'ka fjalë, fundja po e tregon edhe puna. Sa për atë rastin në kufi, tërë përgjegjësinë mbaj unë, por pas atyre përshtypjeve të shumta unë e harrova veten fare, krejtësisht dhe u shkova si hutit në zgurajë siç thuhet prej nesh. Kjo më ka kushtuar shumë, por besoj se do të rregullohet. Po e përsëris edhe njëherë: më njohto gjerësisht për dialogun me v. e madh me të cilin pata kontakt dhe krejtësisht se çka i the dhe çka të tha. Ne duhet t'i analizojmë shumë mirë taktikat e tyre që ta kuptojmë esencën, sepse është në pyetje diçka e madhe. Unë nuk kam mundur ta marrë me mend një gjë të tillë kurrë, por ja po ndodhka çdo gjë. Të lutem puno në atë dokumentin dhe kryeje sa më parë.

S'do të ishte keq të vish për një kohë të gjatë këtu, sepse kam vend dhe do t'i kryenim shumë punë. Tash pas këtij organi mendoj që këtë materialin dërguar OKB-s ta zgjerojmë mirë e mirë dhe ta botojmë një broshurë të vogël me titull "Akuzojmë tiraninë". Besoj se do të jetë interesante dhe do ta shesim s'ka tjetër. Por do të përpiqemi që në Kosovë ta fusim sa më shumë.

Këto ditë na ka ardhur edhe një letër-ultimatum. S'ka fjalë njerëzit po përpiqen të na bëjnë bisht të tyre në çdo aspekt e ne kurrë nuk guxojmë të lëshojmë pe. Kurrë, sepse në të kundërtën kjo do të ishte vdekje. Po shihet qartë se qëllimi i adashit tënd (Skënder Dushit-shën i red.) është të mbjellë amulli dhe të mos bëhet asgjë. Ndodhë që fare lehtë që ata të shërbehen edhe me njerëz të ud. (UDB-së-shën i red.) vetëm sa ta bindin në mënyrë indirekte J. (Jugosllavinë-shën i red.) se nuk po përzihen në punët e saj të brendshme. Mirëpo megjithatë unë besoj thellë se këta këtu shumë gjëra i bëjnë kokë më vete. Prandaj sa më parë më njohto se si u çarmatos ai burri i botës, çka thoshte, a përpiqej të kundërvihet dhe si, a ishte sjellja e tij e mëparshme apo ndryshe etj. etj., përndryshe jam i sigurt se ai ka kontaktuar me Nuhiun dhe se ky i fundit ka punuar me direktiva të tij ndoshta qysh kaherë, s'është larg mendsh të ketë qenë edhe rojë e Sokolit, prandaj ashtu sa më realisht që të jetë e mundur më trego për atë se çka thoshte Jusufi për të, sa e çmonte dhe si, pastaj se e shikonte Bardhi etj. Kjo ka rëndësi të madhe që ta njohim këtë njeri sa më mirë që të jetë e mundur.

E kam marrë një letër të cilën s'e deshifrova akoma sa duhet, por si duket udba është në korrent të ngjarjeve lidhur me mua, bile shumë më tepër se që mendoja unë. Pade të shohim. Edhe Demë Demaj e ka provokuar dikend lidhur me mua dhe jam i sigurt se ai njeri është dorë e u. këtu, prandaj porosite F. që ta mbaj gjithnjë në përcjellje dhe njëherit të ketë kujdes edhe vetë. Kam fakte se DD ka njohuri për gjëra të cilat ka mundur t'ia thotë vetëm udba e askush tjetër. Do të të njohtoj më vonë për këtë. Sidoqoftë duhet t'i bëjmë sytë katër.

Në të ardhmen më shkruaj gjerësisht për këto që të parashtrova në mënyrë që të mos lejojmë të na krijohen zbrazëtira por në çdo kohë dhe në çdo rast ta kemi situatën në duar, sepse kemi përgjegjësi të madhe para popullit e atdheut. Naimi bëri shumë keq që nuk i dërgoi informatat për të atin etj. Pastaj një shok i H. (Haxhi Berishës-shën i red.) që e ka në Sent Gallen, prej Maqedonisë e që i ka tre vëllezër në burg s'ka dërguar asgjë. Kjo nuk është aspak mirë dhe këtyre njerëzve ti duhet t'ua tërheqësh vërejtjen, sepse kur obligimet që i kanë nuk i kryejnë njerëzit si ata, atëherë kush do t'i kryej. Bisedo me ta dhe rregulloje këtë çështje.

Të fala Ll. (Xhafer Shatri) 31 janar 1983

28. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, shkurt 1983

I dashur shok,

e mora materialin. Në tërësi është i mirë sepse shtron ide të cilat kërkojnë realizim të menjëhershëm. Për çështjen e mbledhjes është bukur problem sepse mua ato ditë kur të vish këtu duhet të më ndihmosh në pregatitjen e organit, sepse ***unë s'po merrkam aspak vesh në makinë, ama aspak,*** *bile bile edhe shiritin ia kam ngatërruar sa që s'po di si t'ia rregulloj*

Tash për tash është me rëndësi kjo: duhet të ndërmerren masa të menjëhershme për organizimin e pritjen e ansamblit që po vie. Pra t'i ndahen shokëve detyrat se kush ku do të kujdeset për pjesën e caktuar të sallës, sepse ndodhë fare lehtë që të ketë provokime të ndryshme e besa edhe tjetër gjë. Unë një ditë në ngutje e sipër, i formulova disa akte apo më mirë të them skica se si e shoh se duhet të shkoj kjo punë...

Ma merr mendja se duhet që së pakut tetë vetë të kujdesen për çdo sallë, dhe kujdesi të jetë i tillë sa që askush të mos e dij se ata kanë detyra të posaçme. Për këtu në Zvicër nuk ka problem sepse janë vetëm dy koncerte dhe mund të koncentrojmë mjaft shokë, por atje është terreni mjaft i gjerë e besa edhe koncerte ka shumë. Do të ishte mirë që qysh tash t'i caktojmë shokët se ku dhe si të kenë kujdes. Në My. do të ishte mirë të shkoj Hafizi dhe me Muharremin, Misinin (veç me kusht që ky njeri të mos bërtas aq shumë, aman) etj. Në Sind. kemi shumë shokë të mirë dhe aty F. dhe Mej. le ta bëjnë të veten. Kah veriu në Bremen ka shokë, pastaj në Dysel. dhe në ndonjë qytet afër le ta marrë përsipër qoftë Hyz., qoftë Xhav. Për këtë të fundit po të njohtoj se vetëm disa minuta pasi që më thirre ti, më thirri edhe Plaku dhe unë ia shpjegova se atje nuk ka nevojë të shkojë, në rast takimi me të ai mund t'i thotë se nuk iu ka bërë puna dhe Xh. të mos e marr vesh fare këtë se është bërë në mënyrë të organizuar....

... Brenda kemi bërë diçka, bile bukur shumë, por akoma s'po kemi mundësi të mjaftueshme që ta ushqejmë sa duhet me material e besa edhe me mjete tjera. Verës ndodhë të na vijë një kuadër i fortë për këso gjërash, një i orëve të para, e pastaj puna do të shkojë fare mirë. Në Br. (Bruksel) s'është puna mirë. Ata njerëz ishin si kalamaj, për çdo javë po na dërgojnë nga një procesverbal qesharak me fjalë të mëdha, ndërsa tash ishin përçarë e bërë pikë e pesë. Nëse kësaj radhe hetohet se pas kësaj qëndron I. atëherë me të duhet qëruar hesapet njëherë e mirë, kjo do të ishte një thikë prapa shpine, edhe pse Agimi është bukur naiv dhe me gjestet e veta i nxit njerëzit. Numrin e telefonit tënd e kam humbur, ma dërgo prapë.

Të fala Ll. (Xhafer Shatri) (shkurt 1983 shën i red.)

Ndërmerr të gjitha masat që më ***1 mars*** *të jesh këtu.*

29. Xhafer Shatri -- Letër-Qarkore, mars 1983

Vetëm për radhët e organizuara të LRSHJ lëshohet kjo
QARKORE
(interne)

Në fillim të muajit prill do të vij në Gjermani dhe në Zvicër një ansambël folklorik nga atdheu ynë i shtrenjtë, Shqipëria socialiste. Ky ansambël dhe të japë koncertet e veta në disa qytete të këtyre shteteve, por kryesisht në Gjermani, prandaj është e domosdoshme që në këtë rast ne si organizatë politike t'i ndërmarrin masat përkatëse në mënyrë që gjatë koncerteve të mos ndonjë e pabërë, të cilën siç dihet është i interesuar ta bëjë vetëm armiku.

Detyrë e jona në këtë situatë është që ta organizojmë një kontroll të padukshëm përmes shokëve tanë në tërë sallën, në mënyrë që qoftë provokimin apo incidentin më të vogël ta evitojmë menjëherë.

Meqenëse qytetet ku do të jepen koncertet s'janë caktuar akoma tash për tash është detyrë e shokëve që të veprojnë në këtë drejtim:

të propagandojnë që të vinë sa më shumë bashkatdhetarë në këto koncerte, për këtë të bëhen udhëtime ndër të njohur, dhe atyre që janë larg t'u shkruhen letra,

që tash t'i caktoni shokët të cilët mund të vinë në konsiderim të kujdesen për një anë apo rresht të sallës të cilin do t'ia caktojmë disa ditë para koncertit. Me ata shokë të bisedohet gjerë e gjatë dhe të analizohet mënyra më efikase e kryerjes së kësaj detyre të rëndësishme. Shokët që ngarkoni në këtë detyrë duhet t'i obligoni që për këtë të mos i tregojnë askujt. Pasi të raportoni për këtë, para çdo koncerti do të merrni instruksione të hollësishme se si duhet të veproni dhe në bashkëveprim me kënd.

KQ i LRSHJ

30. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 5 prill 1983

I dashur shok,

po të shkruaj përngut, pasi që fola me ty u informova për H. (Halil Malën-shën i red.) se ka arritur aty ku je, më informoi se ia kanë burgosur të katër fëmijët dhe se paskan bërë një bastisje që nuk mbahet mend. Ka shumë burgosje. I thash që të duket kah M. besoj se do të shiheni. Tash si prind që është, ai ndodhë të jetë pak i hutuar por është njeri i mirë, ndaj është mirë që t'i koordinoni punët njëherë e pastaj shohim e bëjmë.

Kosova është në flakë, po vinë lajme nga më rrënqethëset. Ka shumë, shumë burgosje.

Ja adresa e atij shokut i cili shpresoj se do t'i gjendet në ndihmë: Selman Rashica, Rue de Ju (zhyl) Verne nr. 7, Paris 11. Le t'i thotë se po kërkon ndihmë sepse e ka drejtuar në atë adresë një shokë që e ka dikend në Redaksi të ZK, mendoj se kështu është më së miri, apo le t'i thotë se e ka dërguar Mil. edhe pse me këtë njeri i ka shkëputur bukur shumë kontaktet,... Mblidh sa të mundesh informata prej njerëzve të porsaardhur dhe më shkruaj pak më shpesh.

Atje nuk mund të vi kurrsesi.

E. te kush paska qenë? Pastaj për atë mbledhjen themeluese më njohton se çka ka qenë në pyetje. A di diçka për atë traktin që është shpërndarë kohët e fundit në Sindelfingen, më njohto për këtë menjëherë dhe pyete Mejd. pse nuk ka informuar me kohë për atë punë. Kjo nuk shkon kështu, ne duhet ta dim se ç'djallin po bëhet, pra kush çka po bën.

Në Dys. e kishin dërguar të përkthyer në serbo- atë traktin e mëparshëm të Halimit. Si duket Nuhiu.

Të fala Ll. (Xhafer Shatri) Mërgim, 5 prill 1983

31. Letër e Xhafer Shatrit për Remzi Ademin, 28 prill 1983

I dashur shok Remzi,

na erdhën referatet dhe leja e manifestimit të Stutgardit për çka të falenderojmë përzemërsisht, sepse me to do të pasurohet edhe më tutje arkivi i Lëvizjes dhe njëherit do të mbesin dokumente origjinale për aktivitetin patriotik të kësaj gjenerate mërgimtarësh shqiptarë.

Në të ardhmen të lutemi që të na shkruajsh edhe më gjerësisht dhe të na njohtosh për aktivitetin patriotik të shokëve në Ludvigsburg, në atë vend ku ka vepruar një kohë

shoku ynë i paharrueshëm Bardhoshi. Tash në këtë fazë ndodhë të ashpërsohet lufta edhe më tepër, sidomos në atë rrethin tuaj andej, prandaj hapini sytë e jini pandërprerë vigjilentë, sepse armiku më së lehti na lufton nga pozitat tona, pra duke folur me gjuhën tonë ai përpiqet të depërtojë sa më thellë dhe kudo që të hyjë t'i fus pykat e veta të përçarjes. Meqenëse atje janë një vistër shokësh të përvojshëm jemi të sigurt se nuk do t'i shkojë përdore po sidoqoftë kujdesi i duhur gjithmonë ka qenë nëna e sigurisë, e ani sidomos në këto punët tona.

Nëse shokët andej kanë ndonjë vërejtje lidhur me ZK, apo me punën e Lëvizjes në tërësi, të lutemi të na informosh menjëherë, por para së gjithash për çdo problem konsultohu me shokët atje, analizojeni mirë situatën dhe as veprimin e vogël mos e bëni pa e pasur të qartë se në ç'përfundim shpie ai.

Në rast se në kontaktet me shokët merrni ndonjë lajm që meriton të botohet, na shkruaj për të menjëherë dhe përpiqu si ti si shokët që të shkruani edhe vetë diçka, në fillim është vështirë, por me kohën njeriu i mëson të gjitha.

Ti dhe shokët pranoni përshëndetjet e përzemërta të Zërit të Kosovës

Mërgim, 28 prill 1983

32. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, 28 prill 1983

Shok Gj., Mërgim, 28 prill 1983

po të shkruaj përngut, sepse njëmend jam shumë i zënë me përgatitjet përfundimtare të org. po të shkruaj në këtë letër për të treguar se si kanë dalë letrat e org, për përgjegje lexuesve, mjerisht ka dalë një gabim i vogël shtypi, por do ta përmirësojmë.

Letrën tënde e lexova me vëmendje, por disi kam përshtypjen se ti këtë çështjen e profilit tënd më tepër e ke kuptuar si çështje administrate: po bisedon me njerëz sikur ata ta kishin parapërgatitjen tënde, p.sh. me Sh. unë të kam thënë se duhet të kesh shumë kujdes e në anën tjetër i kishe thënë se çështjen se S. është njeri i organizuar. Kuptohet se askush s'është që prej atij apo të tjerëve të bëjmë armiq, ne për këtë kemi marrë qëndrim por sjelljet e atij njeriu janë të një elementi destruktiv, ndaj të cilit duhet të kemi kujdes, por pa ia bërë kurrë me dije se ne dyshojmë në të. Në Dys. ka shkuar puna shumë keq, atë gafin tënd e kanë keqkuptuar e kuptohet pastaj edhe keqpërdorë element të ndryshëm të cilët ti i njeh shumë më mirë se unë, edhe pse në atë mes ka njëmend shokë shumë të mirë, pastaj kësaj i frynë dikush. Posa u njohtova e thirra bacën dhe ia shpjegova se të kanë keqkuptuar, sepse ti ke menduar për klubet tjera legale etj. dhe e porosita që ta qetësojë ambientin dhe të mos lejoj njerëz të ndryshëm që të llomotisin edhe në të ardhmen. Strategjia në M. është e mirë dhe sigurisht se do të ketë sukses, por më mirë ndodhë të shkoj në St. dhe atë nga arsyeja e thjeshtë se njerëzit aty kanë shumë më përvojë. Mendoj se pas daljes së këtij numri duhet ta org. një manif. në Strasburg, për këtë mos i trego askujt, por shiko me atë shokun t'ia bëjmë disi për leje, kuptohet përmes atyre shqiptarëve në F. Angazhohu në këtë drejtim. Në Bilefeld po më njofton Ganiu sot po u takokan me Bremenin dhe Këlnin për t'i rregulluar disa çështje. Thuaj Xh. (Xhavit Ramabajës-shën i red.) mos të nguten me foton e tiranit se mos po na keqkuptojnë masat e pastaj mos pyet.

Abdullah Prapashtica me të dy agjutantët e vet është në Evropë, si duket në Belgjikë, prandaj ai rasti i Dys. mund të ketë edhe më pasoja sepse ata veç po përgjojnë për të futur në rastin e parë pyka kudo që të munden. Ky numër i organit më ka lodhur shumë, sidomos disa konture të Programit Politik që duhet t'i botojmë me rastin e njëvjetorit të themelimit të L.

Letra po vinë shumë mos pyet hiç. Nga të gjitha anët, por punime që duhen, shumë pak. Interesant po janë të rrallë njerëzit që dinë ta përthekojnë problemin ashtu dhe aty ku duhet.

Kjo greva e fundit në Ramiz Sadik i ka dhënë luftës shtytje të re. Për të do të shkruaj, në të vërtetë e kam shkruar komentin e Redaksisë për të, por edhe për rekuiemin e Mahmutit në skenën politike jugosllave. E di që s'bën të merremi me gjëra të vdekura por na kanë ardhur disa letra nga Vajazani që na thonë që t'i kamxhikosim edhe opingat e shkyera...

Ti thua se nuk po shkruaj më shpesh etj. dije se nuk po kam kohë, besom se ky kryeartikulli i tashëm ma ka shkatërruar mëlqinë, sepse duhet të kemi kujdes e kah po shkojmë, merre me mend duhet të jemi de jure autonomist e de fakto seperatist, pastaj janë edhe kundërshtarët e shumtë që po bëjnë presion edhe përmes letrash. Merre me mend prej Amerike ka ardhur një pliko e në të foto e foto të kopjuara të Enver Hoxhës me Dushan Mugoshën, ashtu disa foto pa asnjë fjalë. Porosi kuptohej fare mirë.

Të holla po na dërgojnë bukur mirë, tash i kemi punuar nja 3000 kaseta në të cilat duhet t'i nxjerrim bukur do të holla e pastaj ta blejmë disi një shtypsh... të tërë, pade të shohim se si po shkon puna njëherë. Me Kamberin po korrespondojmë por rrallë, besa edhe po vonohen letrat.

Shkruaji ti pak më shpesh. Tash duhet të kemi kujdes sepse KK nuk do të rrijë kurrë i qetë, dhe për mbarë ai njeri s'do të mundohet kurrë, Këtë e tregoi praktika.

Të fala Ll. (Xhafer Shatri)

33. Letër e Xhafer Shatrit për Remzi Ademin, 9 maj 1983

I dashur shok,

na erdhi letra dhe trakti që qenka shpërndarë andej prej jush, prandaj të falemnderit për interesimin.

Sa i përket asaj se kush e ka shkruar dhe kush e ka shpërndarë, ne e dimë, për këtë mos u shqetëso aspak.

Lidhur me porosinë time për ndonjë informatë për Sh. P. a ke mundur të bëjsh diçka apo duhet të kujdesemi edhe nga anë të tjera, po që se ti mendon se nuk ekziston mundësia atëherë më njohto menjëherë dhe nuk ka asgjë të keqe.

Prej shtëpi a po merrni ndonjë lajm qoftë ti qoftë shokët, çka po thonë si janë andej? Rinia e atjeshme ka bërë çudira, do të lexosh në numrin e fundit të ZK një reportazh shumë të mirë për ngjarjet më të reja në Lumthat.

Organi do t'ju vie tash së shpejti, besoj të enjten. Qoftë edhe për vërejtjen më të vogël të lexuesve të lutem të më njohtosh.

Ty dhe shokëve të fala vëllazërore

Bacalok (Xhafer Shatri) Mërgim, 9 maj 1983

* * *

Më 15 janar 1983, në Ludvigsburg, me iniciativën e Xhafer Shatrit u formua Qendra Ekzekutive (QE) nga pesë anëtarët e mëposhtëm, të cilët morën pseudonimet përkatëse. Qendra Ekzekutive pushoi së vepruari më 3 mars 1984 në Gjenevë, kur u vendosë formimi i Komitetit Qendror, që në korrespondencën tonë do të identifikohej me emrin "Dukagjini".

Pseudonimet:

-Iljazi = Ibrahim Kelmendi
-Xhema= Xhafer Shatri
-Plaku= Hasan Mala
-Fahriu= Faridin Tafallari
-Salihu= Xhafer Durmishi

34. Letër e Xhafer Shatrit për Qendrën Ekzekutive, 1 qershor 1983

Anëtarëve të QE, 1 qershor 1983
Shokë,

dje e mora një letër prej shokut Fehmi, ishte një letër e mirë dhe e sinqertë, një letër tamam shoqërore por edhe shqetësuese. Në të shpreheshin mendimet lidhur me situatën në Dys., për atë se Iliazi kur e paska ditur se çfarë njeriut është H. atëherë pse e ka bërë dhëndërr të atyre etj., pastaj sidomos për Salihun, ai me të drejtë e gjykon qëndrimin e tij lidhur me rastin e Dyseldorfit, për këtë punë mbrëmë më thirri një shok prej andej dhe u shpreh aq keq sa unë kaherë nuk jam ndodhur në pozitë kaq të vështirë. Gabimin e Salihut e kanë shfrytëzuar maksimalisht njerëzit që kanë folur në emër të Il. çka tregon se mosmarrëveshjet e tyre të mëparshme po reflektohen, madje edhe po marrin përmasa të palejueshme mu në kohën kur ne duhet të tregohemi sa më unikë që të jetë e mundur. Prej Salihut e kam marrë një letër, një letër më se të çuditshme, në të thotë lidhur me një element të këtushëm destruktiv se "në masën më të madhe e urrej unitetin formal..." apo kështu disi dhe, si edhe më parë insiston të shihemi. Kuptohet se është e domosdoshme të shihemi, por ja që s'po kemi edhe kushte: kemi qëlluar larg, s'po kemi dokumente e besa as të holla, fundja ne jemi në luftë dhe nuk mund të shihemi çdo ditë: i kemi ndarë detyrat njëherë dhe tash duhet të vazhdojmë luftën, çdonjëri sipas mundësive e aftësive. Unë vetë siç e dini jam tepër i zënë: të nxirret një gazetë për 40 ditë dhe të pretendohet që ajo të jetë busullë e 3 milionë shqiptarëve, kjo është shumë e vështirë, don me një fjalë shumë punë. Fryt i asaj pune është numri 3, pastaj po kam probleme edhe lidhur me futjen e tij brenda, sepse për shkak të përvojës sa do modeste po më duhet t'i mësoj njerëzit se si t'ia bëjmë. Kësaj radhe kemi pasur sukses shumë të madh në këtë drejtim.

Një çështje tjetër është edhe organiz. brenda, vetëm kohët e fundit kam kontaktuar me disa njerëz që kanë ardhur prej atje vetëm për këtë punë e për asgjë tjetër. Edhe kjo po kërkon shumë punë e energji. Thjeshtë nganjëherë po e ndiej veten më tepër se të dërmuar. Pra mu këto janë ato shkaqet që s'po më lënë kohë t'u ndihmoj edhe të tjerëve, edhepse ata e kanë më lehtë, kanë më pak obligime. Ja për shembull Il., siç po shihet e ka shkelur me të dy këmbët betimin e dhënë para shokëve të vet dhe ka treguar për ekzistimin e QE dhe madje edhe për përgjegjësitë që ka çdonjëri prej nesh. Për këtë punë unë kam fakte të padiskutueshme. Lidhur me këtë unë ia shkrova letrën e fundit por akoma nuk kam marrë përgjegje. Kuptohet fajtori të vetmen mbrojtje e ka heshtjen. Keqpërdorimet e tij kanë shkuar edhe më larg. Ka njerëz që shkruajnë se Il., nuk i lejon (kuptohet në mënyrë mjaft perfide) që t'i shkruajnë ZK. Është çështja e të hollave të Zylb. fillimisht i kërkoi 600 marka, më vonë 1100. Po për të njëjtin njeri punëtorët na shkruajnë se të hollat që i kanë mbledhur bashkërisht për t'i dërguar ndihma Kosovës, ai i ka harxhuar, sipas tij, në udhëtime zyrtare në Bruksel etj. E për çështje zyrtare ne kemi vendosur ta mbajmë vetëm një njeri, sepse nuk kemi mundësi e jo për tjetër.

Çështja e fotografisë së Ti. e di se është rritur, por unë nuk mund ta di se çka e ka shtyrë njeriun tonë të thotë gjëra të tilla dhe aq më keq, siç thotë Fehmiu, të vazhdoj edhe

tash me të njëjtin avaz. Duke besuar në aftësitë e S. unë të gjitha propozimet e tij i kam marrë si punë të kryera, ndërsa tash po shihet se ky çështjet organizative, ashtu siç i kam shkruar në letër, i ka marrë tejet administrativisht: përmes një njeriu të njohtohesh për të gjitha në një rreth të caktuar dhe pastaj çka të thotë ai... Xh., dhe F. janë tipa shumë kontraverz, duhet të kemi kujdes, edhe nëse kemi bërë ndonjë lëshim më parë tash nuk bën të mashtrohemi.

Jam i mendimit se duhet t'i hyjmë riorganizimit të themelshëm, të bëjmë seleksionimin e njerëzve dhe të mos i japim askujt kompetenca të shumta, por ato t'i ndajmë në disa shokë të qarku p.sh. Ta këqyrim të kaluarën e njerëzve, karakterin e tyre. Merreni me mend nga të gjithë ata ZK që janë shitur në Dysel. këtu s'kanë ardhur të holla fare. Pastaj organi nuk po shpërndahet kurrsesi. S. tha se duhet ta organizojmë këtë më mirë, por ai nuk ndërmori asgjë në këtë drejtim edhe pse ai është përgjegjës për këtë, sepse vetëm përmes organit mund të organizojë njerëzit me të cilët duhet të punohet pastaj shumë e shumë. Unë nuk e di se çfarë takimesh dhe mendimesh të ndokujt na duhen kur e kemi plot njerëz tokën, njerëz që memzi presin t'ua shtrijmë dorën.

Në letrën e tij F. thotë se e shqetësojnë mosmarrëveshjet e mia me S. Unë nuk e di se për çfarë mosmarrëveshjes është fjala. Sa më përket mua unë për këtë, për besë, vetëm tash po dëgjoj. Lidhur me letrën e mëparshme, që e përmenda kam menduar t'i shkruaj një letër të rrastë, por ai ashtu rrugëve, s'dija ku t'ia dërgojë, prandaj në një bisedë telefonike ia thash atë që mendoja. Letrat shumëkuptimshe e të paqarta, ashtu krejtësisht të shkurta, madje për çështje që unë kam shprehur mendim njëherë e mirë nuk qesin asgjë në dritë. Për atë individ (Sh.-Shaqir Shabanin-shën i red.) unë ia kam analizuar punët dhe fushatën kundër tij nuk e kanë nisur shokët tanë por ai vet me sjelljet e tij aspak të mira madje shumë të dyshimta. Tash ka shkruar aq larg sa po u del njerëzve në rrugë dhe po i kërcënon me armë... ai njeri nuk i ka këputur kurrë kontaktet me N. dhe aq më pak tash kur ai me kompani dolën me një manifest të tillë idiotesk. Meqë është puna kështu, do të ishte mirë që ta ngutni takimin e 3 qershorit për të cilin më pat shkruar S. Ne duhet ta marrim një qëndrim, pra ta demaskojmë apo jo, ta demaskojmë haptas apo si. Kam përshtypjen se sidomos atje nuk po punohet fare me njerëz. Nuk mjafton një mbledhje, me njerëz duhet të shihemi më shpesh. Ne nuk guxojmë t'u besojmë njerëzve që nuk e meritojnë besimin tonë. Ja një shembull: vitin e kaluar njëfarë tipi në St. Gallen s'bënte asgjë, apo më shumë keq se mirë, dhe në mungesë të tjetrit apo të frikësuar se mos po e dekonspirojmë një kuadër perspektiv e lënim ashtu. Këtë vit shkoi atje H. (Haxhi Berisha) dhe ka bërë shumë punë burri i botës për shumë pak kohë...

Kam shumë për të thënë, por po propozoj që të shihemi sa më parë. I. do t'i telefonoj disi sot, dhe me atë rast mendoj të analizohen këto çështje: puna e gjertanishme, propozimi i shokëve nga Tur. që ky aparat të shtohet në 25 veta (unë s'e kam pranuar një gjë të tillë sepse nuk kemi kuadro, nuk i besohet detyra e madhe kujtdo, sepse pastaj mund të humbasim shumë, mendo se duhet t'i kemi çdonjëri nga dy ndihmës, pa ditur ata për QE dhe anëtarët e saj.), formulimi i rregullores së punës së QE, formulimi i Statutit dhe plotësimi i Programit politik, çështja e mjeteve materiale (ka të drejtë F. për të hollat, ne do të vendosim përfundimisht për këtë punë si dhe për atë se kush ka të drejtë të shpenzoj dhe për çka,) çështja e anëtarësisë, pse nuk po mblidhet anëtarësia, si të kursejmë në të ardhmen edhe më shumë, si ta zgjidhim çështjen e financimit, pse ZK nuk po shitet më shumë, apo pse nuk po mblidhen më me sukses të hollat e tij, duke e shitur atë ne mund të fitojmë rreth 7000 franga, kjo nuk është një shumë e vogël, si ta rregullojmë në të ardhmen çështjen e udhëheqjes nëpër lokalitete, si t'i përgatisim kuadrot sepse pa kuadro të forta ne s'mund të bëjmë asgjë, ani sidomos tash kur duhet t'i kundërvihemi një nxënësi të udbës i cili na ka luftuar dhe do të na luftojë edhe më me forcë në të ardhmen, propozoj

që ta hapim një kurs për kuadro, një kurs të shkurt 4 ditor bile dhe ta organizojmë në atë mënyrë që të përfshihen njerëzit e të gjitha qendrave në Perëndim, kuptohet ata më të besueshmit, mendoni që tash për një seleksionim të tillë. Ne disi do ta organizonim fjetjen, vendin e ligjëratave, ushqimin etj., a do ta bëjmë më ndonjë demonstratë (unë i thash S. të këqyr përmes një shokut për një leje, por ai nuk bëri asgjë, bile as që më ktheu përgjegje...) me një fjalë kemi shumëçka për të diskutuar e vendosur. Në të ardhmen mbledhjet do të mbahen me procesverbal të tërë... ose edhe në trakë magnetofoni. Në të ardhmen mendoj se duhet ta zgjerojmë QE m dy anëtarë tjerë, një për sigurim dhe tjetrin për çështje ushtarake... por edhe për këtë do të bisedojmë më vonë...

Çështjen e klubeve ne duhet ta rregullojmë përmes bashkësisë së tyre me të cilën do të udhëheqin njerëzit tanë më besnik dhe ta rregullojmë çështjen e inventarit, për këtë S. na pat folur shumë kaherë por nuk ka asnjë rezultat. Në atë farë bashkësie mendoj se duhet të përfshihen të gjithë shokët që janë aktivist po që në rrethet e tyre ndoshta nuk ka klub, por sallë apo edhe odë. Kjo është e domosdoshme, sepse ndodhë që të na kundërvihen pastaj me sindikatat e tyre këta budallenjtë e fëlliqur.

Mu për këtë sot më shumë se kurrë shtrohet çështja organizative si shumë e rëndësishme, prandaj edhe vendi i S duhet të jetë në mesin e punëtorëve, të mos lerë vend në Gj ku ka shqiptarë që ai të mos e di se kush sa vlen. Në Xhav. po ankohen njerëzit se po ju flet me mburrje se si i ka 30 celula, se si vetëm ai duhet ta shpërndaj ZK etj... pastaj është e vërtetë se po flet me të madhe kundër I. Kjo gjë duhet të ndërprehet, kjo nuk shkon më kështu. Çka janë të gjitha këto thashetheme, aty ku shkojnë S apo I është e pamundur të shpëtoj pa tym. Pasat edhe kur është në pyetje çështja e Lëvizjes, dreqi e marrtë po Lëvizja nuk është çelës i artë që i qel të gjitha dyert. Rreptësishtë është e ndaluar të manipulohet me emrin e saj, njeriut mund t'i imponohet dikujt si autoritet me punë, me sjellje e zgjuarsi e jo me emrin e Lëvizjes në gojë. Merreni me mend po më thotë baca Zymer: kush është ai që guxon të na përzihet në punët tona. Ne s'e njohim Lëvizjen nëse ajo merr vendime të tilla dhe nëse në emër të saj flasin njerëz të tillë e gjëra të tjera që janë edhe më të rënda të shkruhen. Poashtu edhe në Hamburg, ishin të dytë dhe çka ndreqën, asgjë, ama asgjë. Prapë me të vjetrën, afroje njërin e largoje tjetrin, para njëri-tjetrit "pajtohu", pas shpine ç'është një e zezë. Unë thjeshtë po çuditem. Dreqi e marrtë më ka lodhur kjo çështja e dokumenteve, sepse tash po e shoh të rëndësishme që organin ta botojmë edhe rrallë por të merremi me çështje organizative me më sukses. Atje në Gj. duhet të kemi pak njerëz autoritativë e të besueshëm përmes të cilëve përfshihen masat. Ndërsa këtu të përqendrohen të gjitha forcat, sepse ka njerëz sezonal dhe me moshë shumë të re që mund të bëjnë shumë për çështjen tonë. Kjo këtu jashtë është zhurmë, puna bëhet brenda, atje është fronti kryesor.

Ata më thirrën që të shkoj gjithsesi në Dys... dhe sikur ta kisha atë dokument të djallit do të shkoja gjithsesi, sepse ndodhë të shkoj Nu. ai kësi rastesh pret. Tash për tash është shumë me rëndësi që të mendojmë se si ta demaskojmë një klan të tillë të keq e të poshtër që flet për punët që s'i ka bërë fare me aq mburracakëri. Po më vjen turp kur po më bie ndërmend se me çfarë njerëzish kam pasur punë. Në një letër që ma ka dërguar Nuhiu e pash se ai s'është hiq më i mirë se ata, edhe pse letrën dukej se e ka shkruar Abd. Sipas të gjitha gjasave ata do ta lëshojnë së shpejti një komunikatë në të cilën Nu, në emër të LNÇ do të "bashkohet" me PKMLSHJ... jam i sigurt se kështu do të veprojë. Mendoni edhe për këtë dhe veproni ju që jeni atje. Vendi i S tash ka qenë në mesin e punëtorëve në St. e jo gjetkë. Lidhur me atë broshurën e tyre unë e shkrova njëfarë Qarkoreje të

shkurtë që t'i njoftojmë shokët, sepse sidomos këta këtu s'kanë ditur asgjë për këtë punë. Dhe për këtë unë mbaj fajin.

Xhema (Xhafer Shatri) 1 qershor 1983

(Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 168-171)

35. Letër e Xhafer Shatrit në emër të Qendrës Ekzekutive, 7 qershor 1983

Anëtarëve të QE

Të dashur shokë, para dy ditësh kam pasur rastin të bisedojë me disa shokë të Dyseldorfit dhe prej tyre jam informuar për shumë gjëra me rëndësi. Çka është kryesore atje Nuhiu me kompani nuk do të mund t'i fusë hundët, e kësaj unë iu kam frikuar jo pak, sepse ata së bashku me statutin e tyre po u çojnë njerëzve edhe letra në të cilat në emër të Komitetit Kryesues kërkojnë prej tyre që t'ia nisin organizimit të celulave dhe krejt kjo në emër të LRSHJ dhe të PK (ML) të Kosovës (Partisë Komuniste Marksiste Leniniste të Kosovës - shën i red.); Veç po e shpërndajnë edhe fletushkën e tyre me emrin simpatik "Punëtorët". Fletushkën e kam lexuar desha të them statutin, në të ka çdo gjë, por për të mirë pothuaj asgjë, ai ka për qëllim dezinformimin e njerëzve, njoftimin e armikut me format organizative të punës dhe një metodë e paparë e prepotencës (mendjemadhësisë), për këtë çështje ne duhet të ndërmarrim diçka duhet të diskutojmë gjerë e gjatë dhe të ndërmarrim diçka sa më parë që të jetë e mundur, njëherë për njëherë është shpërndarë një takt që është parapërgatitje për demaskim. Natyrisht nëse vazhdon kështu kjo gjendje e nderë, atëherë ata do të mund të bëjnë shumëçka kundër nesh, sidomos në Gjermani nuk është puna hiç mirë... atë ditë ata shokët po më thonë se na ka thënë Musa Daka se ju nuk guxoni të shkoni atje, do të thotë në Gjenevë (sa i përket kësaj ardhjeje ju njoftoj se një natë më ka thirrë baca Zymer, ky s'e ka pasur numrin e telefonit tim dhe po më thotë se a mund të shkojë te ai (ata).

Unë ia tregova punën se nuk kam asnjë mundësi dhe u përpoqa t'ia sqaroj punën e fotos, se ai nuk është ndonjë qëndrim i përgjithshëm për klubet, por shoku ua ka thënë me qëllim që të këqyrni dhe të mos i rrezikojmë shumë njerëz, fliste me tonë të lartë dhe shihej se është shumë i mllefosur.... një natë aty kah ora tre e gjysmë pas mesit të natës, më telefonuan dhe më thanë se po nisemi. Thënë të drejtën nuk arrita të flasë me shumë me ta por u frikova se mos është në pyetje diçka shumë e madhe...) erdhën të nesërmen dhe po më tregojnë se si M. Daka u paska thënë se ju nuk duhet të shkoni pa e pyetur Xhavitin se ai qenka përgjegjës për Gjermani (kuptohet ata e treguan edhe rastin e fotografisë, mirëpo për këtë ne do të bisedojmë më gjerësisht) kjo gjë më brengosi shumë, sepse kjo formë e luftës, nëse kjo mund të quhet luftë është e palejueshme. Lëvizja është një organizatë ilegale që nuk guxon të dekonspirohet para masës, duhet të shihet puna e saj e jo fjalët. Tamam puna sikur ne të dilnim dhe të tregonim përgjegjësit që kemi, kjo metodë është së tepërmi e dëmshme. Lëvizja nuk është një shkop magjik që na i rregullon punët tona as qelës-kallauz që na i hap të gjitha dyert, ne kurrë nuk bënë të flasim në emër të Lëvizjes por me sjelljen tonë, me aftësitë tona duhet ta zbatojmë në masë politikën e Lëvizjes, se flasim në emër të Lëvizjes ne mund t'i themi vetëm shokut të organizuar, dhe një takim me celulën, kuptohet është krejtësisht i ndryshëm me një takim në masën e gjerë. Në këtë drejtim duhet të merren masa të menjëhershme përkatëse dhe të mos përsëriten kurrë më gafe të tilla. Ai i Bremenit ka njoftuar këndej se Xh (Xhaviti) ka shkruar dhe i ka thënë se unë jam përgjegjës për këtu, sepse punoj me 30 celula, prandaj Zërat e Kos. T'i jap unë. Në anën tjetër shkon një tjetër, ai Faz. (Fazli Memaj) dhe i thotë njeriut se jam kompetent të të pyes pse ti nuk je diçka i kënaqur... edhe një rast tjetër edhe

më flagrant me rastin e shfaqjes së koncertit në Dys. shkon Engjëlli (Kolaneci, diplomat shqiptar në Vjenë-shën i red.) dhe i merr Xh. Hyz dhe Faz. (Xhavit Ramabajën, Hyzri Rekën dhe Fazli Memajn-shën i red.) e u thotë: ku është Lëvizja, keni kujdes se aty është udba, mos u mashtroni, hapini sytë dhe kështu në këtë kuptim... diçka e pabesueshme dhe ata burrat e botës asnjëri s'e kanë njohtuar shokun me të cilin kanë kontakt. Çfarë njerëzish mund të jenë ata kur prej tyre ka pasur që kanë thënë në masë se nuk kemi bazë, Lëvizja nuk ka ndonjë bazë të sigurt dhe kështu në këtë kuptim. Shtoja kësaj edhe rastin flagrant të Ilazit atëherë shihet se sa metodë e dëmshme pune është kjo. Sot më shumë se kurrë po bindem se ne duhet të mbështetemi në njerëz të sigurt, sado pak qofshin ata, tre tre mjaftojnë por ama të jenë burra e shokë.

Me Ilazin mendoj se duhet ta lëmë kështu njëherë të mos i bëjmë zë fare, por ai njeri nuk guxon më kurrë të jetë aty ku e kemi zgjedhur, ai është njeri i papërgjegjësi dhe gjer në fund i pabesë. Unë ia kam shkruar një letër në këtë drejtim pa ia potencuar të gjitha këto drejtpërsëdrejti dhe nuk ka kthyer përgjegje, sepse fajtori kurrë nuk ka guxim të flasë, ai mbrohet me heshtjen, që do të thotë se është një pranim faji.

Të tregohen përgjegjësitë që i ka caktuar dikujt populli në një luftë ilegale dhe të dekonspirojë gjëra për të cilat shokët tanë i lënë veshkët e dhëmbët në qeli burgjesh pa qelë gojë, ky është një gjest i papresedan tradhtie e mospërgjegjësie.

Është edhe një rast tjetër, çështja e Shaqës. Në një letër aspak shoqërore Salihu më thotë se e urrej në masën më të madhe unitetin formal, dhe vazhdon pse nuk po ndalen thashethemet kundër Shaqës (Shaqir Shabanit-shën i red.). Dreqi e marrtë po Shaqa i ka nxitur vetë thashethemet me sjelljet e tij të poshtra udbeske, ai shkon dhe i thotë njeriut shko dhe organizoje filan fistekun në Lëvizje sikur L. të ishte kafene pastaj i mashtron dhe i frikëson se do t'ua qesë në Zërin e Kosovës, se ka kompetenca të mëdha e çka po di unë. Për këtë njeri unë nuk dua të harxhoj fjalë e kohë, por po them se ky është një element destruktiv puna e të cilit nuk ka asgjë të përbashkët me Lëvizjen. Ai ose është ambicioz i sëmurë, ose njeri i udbës, dhe unë më shumë droj se ky është i dyti. Tash po na dalin fakte se ai po u thotë shokëve në Gjermani që të kenë kontakt vetëm me Nuhiun... Pra puna ka shkuar larg. Ai njeri kurrë s'i ka shkëputur lidhjet me ish-padronin e vet. Disa herë kam menduar të bisedoj me atë horr...

Kohët e fundit kam qenë shumë i zënë, kam pasur shumë kontakte me shokë të brendshëm dhe besoj se ia kemi arritur të bëjmë shumëçka: atje do të shpërndahen trakte e do të kryhen aksione vetëm nga ana e LRSHJ dhe do t'ia arrijmë që veprimet e fëlliqura të këtyre fraksionistëve të evitojmë në një masë të madhe... por kjo do shumë punë, tmerrësisht shumë punë dhe nerva, prandaj do të ishte mirë që me organizimin jashtë të merreni të gjithë më shumë dhe sidomos Salihu që e ka përgjegjësi kryesore. Ai duhet t'i krijojë kuadrot tona të ardhshme dhe të gjithë frenjtë e organizimit t'i përqendrojë në duartë të veta, por kuptohet me një punë dhe përgjegjësi në nivel me obligimin që ka. Në bisedë telefonike me të mbrëmë po më thotë s'kam të holla... ky nuk është një arsyetim bindës, fundja të hollat për kënd i kemi, për luftën e jo për sytë e zi. Sidomos në këtë kohë ai është dashur të jetë në mesin e punëtorëve në St. (Stuttgart) dhe ta rrokim punën përpara, sepse kemi të bëjmë me njerëz qe s'kanë fije burrërie, por që do të merren edhe me denoncime te armiku, për këtë jam i sigurt, por nëse ne punojmë, nëse ne e qesim shpesh dhe kualitativ ZK ata nuk kanë çka të bëjnë. Do të ishte mirë që në këtë drejtim t'i përqendrojmë të gjitha forcat tona dhe ta lëmë në heshtje punën e tyre, kuptohet duke e qitur krejtësisht nën hije punën e tyre përçarëse e minuese, pra me punë.

Pastaj lidhur me ta t'i sqarojmë punëtorët sa më tepër jo vetëm gojarisht dhe duke e përqendruar vëmendjen në qëllimet e tyre tamam armiqësore, e jo duke ndenjur nën hije, sepse ara pa i zhytur këmbët në dhe nuk mihet... Ka kuadro bile shumë, por ne nuk

po punojmë sa duhet, po na mungojnë ata militantët që s'u shihen kurrë gjurmët por që u ushton puna, e Halimi duhet ta dini është talent i intrigave dhe mashtrimit të njerëzve, prandaj Salihu duhet ta ketë parasysh këtë dhe ta formulojë një formë të veçantë për t'iu kundërvënë. Në këtë drejtim të mendojmë edhe ne si t'ia bëjmë. Natyrisht pa një unitet mendimi e veprimi nuk do të kemi sukses. Mua s'më pëlqen ajo që para syve të luajmë rolin e unitetit e pastaj kur të ftohet muhabeti të ndërrohet pllaka. Vetë nga toni i bisedës së Salihut mbrëmë unë kam kuptuar shumëçka. Edhe pse nuk jam ithtar i mbledhjeve të shpeshta, kjo më detyron të insistoj për një takim të ngutshëm. Ne i kemi marrë detyrat, prandaj çdonjëri prej nesh le të shkrihet për realizimin e tyre, le të duket puna. Natyrisht takimet janë të frytshme dhe mëse të domosdoshme, por po e shihni edhe vet se në çfarë kushtesh po veprojmë, pa dokumente, pa mjete materiale të bollshme, pa status të sigurt, si në vend të huaj më.

Vendin e Ilazit mendoj se duhet ta plotësojmë, por pa e njohtuar njëherë përnjëherë, me të duhet të taktizojmë sa më tepër që të jetë e mundur....

Ju lutem të mendoni për këto dhe të vendosni diçka menjëherë. Për shkak të largësisë unë dhe plaku mund të dalim deri kah Baseli, në mënyrë që ta ndajmë përgjysmë rrugën e besa edhe shpenzimet.

7 qershor 1983 Xhema (Xhafer Shatri)

36. Letër e Xhafer Shatrit për Remzi Ademin, 10 qershor 1983

I dashur shok,

shkoi një kohë bukur e gjatë që ne nuk komunikuam në mes veti, si je tash a po e ndien veten më mirë, do të ishte me vend nëse disi mund ta lësh duhanin, sepse ai të dëmton shumë me ata ithata të djallit. Pastaj të kërkosh ca hapa që quhen Tagamet dhe të ushqehesh vetëm me prodhime qumështi, jij i sigurt se në atë rast për një kohë fare të shkurt do të shërohesh. Familjen si e ke dhe a janë akoma andej?

Po nga vendlindja a ke më ndonjë lajm lidhur me atë që biseduam atëherë përmes telefonit? Do të ishte shumë mirë që t'i sjellësh ndonjërin prej tyre këndej dhe t'i akordojmë aksionet në tërë Kosovën. Nëse ne i arrijmë kësaj atëherë këta farë sharlatanësh që kanë dalë me paçavuren e tyre nuk do të kenë as ndikimin më të vogël në Kosovë.

E sa për këtu nëse ne punojmë sa duhet dhe si duhet as këtu s'do të kenë mundësinë më të vogël të ngulin dhëmbin. Ne, mendoj nuk duhet të merremi me thashetheme, por t'i sqarojmë punëtorët, t'ua tregojmë se ku shpie një veprimtari e tillë dhe ngado që të shkojmë të përpiqemi e të bëjmë sa më shumë miq e dashamirë.

Aktualisht shtrohet si detyrë me shumë rëndësi që t'i vizitoni punëtorët, të mos leni kund shok apo të njohur pa e vizituar dhe pa e prekur mençurisht se në çfarë pozitash qëndron ai, natyrisht duke bërë përpjekje për t'i zbuluar punktet dhe njerëzit e N. me shokë, pra të veprojmë ashtu siç po veprojnë ata dhe t'i lëmë një ditë fare ashtu si peshkun në zallë. Pra t'i mundim me punë e aktivitet revolucionar. Sidomos aty në odë e keni një mundësi të madhe t'i grumbulloni punëtorët dhe të bëni seleksionimin e tyre, të punoni me ta ngadalë e me durim, t'i sqaroni, por ama edhe ta mbani konspiracionin në mënyrë që N. me kompani të mos mund t'ua dij se ku i keni këmbët as kokën.

Nëse ka ndonjë gjë të re në atë drejtimin tonë të lutem më njohto menjëherë.

Ti, familja dhe shokët pranoni përshëndetjet e mia revolucionare

10 qershor 1983 Bacaloku (Xhafer Shatri)

37. Letër e Xhafer Shatrit - Qarkore në emër të Redaksisë së Zërit të Kosovës, qershor 1983

Qarkore interne lidhur me rastin e ish-PKMLSHJ

- Kohët e fundit ka nisur të shpërndahet nëpër Gjermani një broshurë me titull: Platforma Politike, Programi dhe Statuti i OS (organizatës sindikale) Bashkimi i Punëtorëve të Kosovës. Në këto 40 e sa faqe ka gjithçka, prandaj kësaj radhe s'po e analizojmë fare përmbajtjen e saj, le ta bëjë këtë vet lexuesi, por po e analizojmë atë çka i parapriu kësaj: Në vitin 1981 në Kosovë për herë nisi të flitet për PKMLSHJ (Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi), ajo nisi ta nxjerrë organin e vet në dhjetëra kopje me titull "Revolucioni", njëherë tjetër Zërin e Atdheut, kjo e fundit është shpërndarë shumë pak, kështu që nuk dihet për të, ndërsa "Revolucioni" është më i njohur nga ajo se te lexuesi i pjekur që ka qenë në dijeni të organizimit ilegal në Kosovë, ka lënë përshtypje me prepotencën e pashembullt të njërit prej numrave të tij, në të cilin autorët e tij pohojnë se gjoja ata qenkan ata që i kanë organizuar demonstratat e 81, dhe se për këtë sukses kryetari dhe sekretari gjeneral e kanë shpallur veten heronj të popullit. Këto gjëra i kanë indinjuar së tepërmi sidomos njerëzit që kanë vepruar në ilegalitet të thellë gati me dekada, por kurrë s'kanë nxjerrë zë, ata e kanë lënë të tregoj puna e tyre; kjo që thamë, niveli i ulët intelektual i shkrimeve të tyre, fjalori i konferencave jugosllave bënë që te shumë njerëz të fitohet përshtypja se kjo është vepër e UDB-së, në të vërtetë autori i shkrimeve ka punuar në SPB.

Këtë organizatë në një masë e ka popullarizuar edhe regjimi duke shkruar për të në kohën kur ata kërkonin me pishë njëri për t'ia hudhur fajin për Pranverën e 81, sepse ishte qëndrim i organizata tjera ilegale që një shpërthim i tillë në opinion të paraqitet si vepër spontane e popullit pavarësisht nga ajo se kush ka kontribuar në atë drejtim, sepse kjo do të ishte shumë më akuzuese për armikun. Veç kësaj kjo org. në fjalë e ka përdorë me sukses luftën psikologjike, të gjitha shkrimet e veta së pari ua ka dërgua organeve krahinore, kuptohet duke i ngjitur vetes emra të mëdhenj e fjalë që me asnjë rast s'i ka përcjellë punë përkatëse. Kjo metodë është treguar e suksesshme sepse e ka popullarizuar këtë organ. Në të vërtetë kjo organizatë ka qenë, sikundër që edhe është vepër e një grupi të ngushtë familjar dajë, nip, dajë etj. Për herë të parë në Kosovë këta kanë lëshuar në "përdorim" një formë të vjetruar organizative, të kohës së Leninit apo të tipit të sotëm të Perëndimit, do të thotë celulat dhjetëshe, gjë që për realitetin kosovar kjo është treguar si shumë e pasuksesshme, madje edhe e rrezikshme. Në këtë formë organizimi nuk ka pasur asfarë seleksionimi të njerëzve dhe të përfitimi i simpatisë së tyre, siç po mësojmë kohët e fundit, është përdorë me të madhe shantazhi në këtë stil: je i rrezikuar prej policisë, unë punoj në UDBë, ndaj e di mirë, pra eja të të strehojmë, dhe njëmend i kanë strehuar njerëzit viktimë e kësaj forme pune janë profesorët që u dënuan në procesin e fundit politik në Prishtinë. Ata, pa qenë fare, janë dënuar si njerëz të organizuar.

Një parantezë. Në prag të vrasjes tragjike të shokëve tanë Jusufit e Bardhoshit (kanë qenë siç dihet anëtarë të ish Lëvizjes nacionalçlirimtare...) dhe Zeqës (anëtar i ish-Organizatës Marksiste-Leniniste...) janë zhvilluar bisedime për bashkim. Bisedimet kanë qenë të suksesshme dhe sipas të gjitha gjasave natën e vrasjes ka ardhur gjer te bashkimi. Këto organizata kanë vepruar në mërgim sidomos dhe gjithmonë i kanë koordinuar aksionet, janë ndihmuar në mes veti me të madhe, ky është një fakt i padiskutueshëm. Pas rënies së tyre në popull u krijua një indinjim i pakufishëm e mjerisht edhe një huti e palejueshme... Në Kosovë u bënë burgosje të mëdha. Nga të gjitha organizatat u burgosën shumë njerëz, shumë të tjerëve iu deshtë t'ia mësyjnë mërgimit, ndër ta edhe udhëheqësi

i PKMLSHJ. Në mërgim janë zhvilluar bisedime në mes tij dhe shokëve të ish LNÇ... ka ardhur te bashkimi, gjegjësisht formimi i LRSHJ, jo LRSSHJ. Përkundër kësaj nuk është zhvilluar kurrfarë aktiviteti, kjo ka mbetur anonime, çështje e tre-katër njerëzve. Në maj, më 14 e 15 maj janë zhvilluar bisedime edhe me përfaqësues të ish OMLK. Ka ardhur gjer tek bashkimi gjegjësisht formimi i LRSHJ. Për këtë ekzistojnë dokumente. Në bisedime kanë qenë dy përfaqësues të organizatave të mëparshme, si përfaqësues të organizatave të tyre.

Kur ka ardhur te botimi i komunikatës, përfaqësuesi i ish-OMLK-së ka insistuar që ajo të përpunohet pak, por në esencë të mbetet e njëjta, dhe i ka bërë ndonjë plotësim, ashtu siç qe vendosur, dhe e ka dërguar në botim, mirëpo përfaqësuesi i ish-PK... ka insistuar në që në komunikatë të futet pasusi se prijëse ideore e Lëvizjes do të jetë Partia Komuniste, gjë që në fillim tingëllonte fare padajllëzisht... Njeriu kur të bashkohet me dikend të luftoj për të njëjtin qëllim aty s'ka asnjë vend dyshimi, dhe thënë të drejtën sikur të mos ishte përfaqësuesi i LN... kjo do të bëhej, mirëpo ai duke i njohur mirë ua hetoi qëllimin, dhe kuptohet doli komunikata që thotë se LRSH është një organizatë unike e operative... U zgjodhën organet e përkohshme udhëheqëse, por në mbledhjet e tyre mungonte përf. i PK... ai insistonte rregullisht që të flasim vetëm në katër sy... Fillimi si çdo fillim nuk na mundësonte takime të shpeshta nisëm të letërkëmbejmë. Shoku i PK nuk përgjigjej në letra, më vonë njëri prej tyre shtroi në një letër të gjatë propozime të shumta që dukeshin të papranueshme, ndër të tjera insistonte të formohen organizata të brendshme si Fronti demokratik, organizata e gruas, e pionierëve etj. gjë që për realitetin kosovar kjo është e pamundur: në një shtet totalitar të tipit më fashist t'i shkapërderdhësh njerëzit kjo është vetëvrasje.

Në të tjera kushte ka vepruar PKSH, ajo e ka pasur malin... ndërsa Kosovë është krejt diçka tjetër. Në këto shkresa kemi dhënë përgjegje të qarta dhe kemi shprehur mendimet tona. Kemi insistuar për një takim, sepse e pamë se veç ia kanë nisur t'i përçajnë radhët tona, të organizojnë edhe njerëzit e organizuar, duke u shërbyer me shpifje dhe dinakëri krijuan konfuzion të madh sidomos në rrethin e Shtutgardit. Kjo reflektohej keq te punëtorët. U përpoqëm të bisedojmë bashkarisht për këto probleme, por u iknin takimeve. Njëherë udhëtuam me mija kilometra për t'u takuar, por ai burri i botës i iku takimit, vetë shoku i tij më i ngushtë ikjen e tij e çmoj si tradhti... Ky rast pati pasoja të mëdha. Herën e dytë i shkruam letër urgjente që të propozojnë se ku po shihemi dhe kur, bile morëm përsipër që të udhëtojmë 5000 kilometra, me rreziqe të shumta, por përgjegje morëm vetëm pas dy muajsh, kuptohet përgjegje negative. Shkruanin herë pas herë, nuk kthenin përgjegje, apo më mirë, shërbeheshin me arsyetime që s'ishin gjë tjetër veçse gënjeshtra fare të paskrupullta. Duke e parë se çdo gjë është e kotë edhe ne e ndërpremë letërkëmbimin aty kah viti i ri duke thënë se kur të bëhen gati le të shkruajnë në ZK e ne do t'u japim përgjegje. Atë ditë e sot nuk kemi marrë letër. Gjersa marrëdhëniet nuk ishin aq të ftohura ata e shpërndanë një trakt disafaqesh me konglomerat idesh, por në të kishte edhe gjëra të mira. Për shpërndarjen e këtij trakti kemi marrë vesh pasi që na ka ra në dorë. Disa herë kanë premtuar se do të shkruajnë për ZK, këtë e kanë bërë shumë rrallë dhe punimet kanë qenë krejtësisht të dobëta, fare të papërpunuara. Kanë premtuar se do të dërgojnë informata për një dëshmor të ri, Afrim Abazin këtë s'e kanë bërë kurrë. Në një letër të mëparshme kur autorit të këtyre rreshtave i propozuan ta bëjnë "kryetar" të L. dhe kur ky propozim u injorua, si duket i humbën të gjitha shpresat se do të mund të luajnë me emrin e Lëvizjes, të cilës, duhet të themi, duke keqpërdorë sinqeritetin tonë ia imputuan emrin me ndajshtimin LR(S)SHJ, sepse në dokumentet e bashkimit përmendet vetëm LRSHJ, asgjë tjetër. Këtu është shkaku pse edhe sot e tutje në ZK përdoret vetëm në një vend LRSSHJ (Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në J.). Në këtë letër-

informuese është vështirë që për një kohë fare të shkurtë të përfshihen të gjitha ato që na shtynë të bashkohemi, pastaj ato marrëdhëniet ngreh e mos e këput që për ne kanë qenë torturë, minimi i radhëve nga brenda, intrigat e ndryshme, mossinqeriteti total, dëshira e sëmurë për dominim etj. kanë qenë arsenal i tyre i përditshëm në marrëdhënie me ne. Për hir të unitetit ne jemi treguar së tepërmi tolerantë, apo për të thënë më mirë oportunistë. Me ta është dashur ta shkëpusim që në fillim. Me njerëzit që nga hija e vet nuk e shohin interesin e luftës e të popullit, ne s'na lidhë asgjë. Kjo broshurë më tepër është një konglomerat budallëqesh se sharlatanrie të pashoqe. Autorët (i) i saj nuk e njeh apo thënë më mirë se njeh fare realitetin e sotëm, apo thënë ndoshta nuk do ta njohë. Nisur nga kjo që në biseda verbale dhe në mbledhje të ndryshme duhet të plotësohet edhe me shembuj më të freskët e më të imët, tash për tash shtrohet si detyrë që të gjithë anëtarët e LRSHJ ta analizojnë këtë broshurë dhe të shprehin mendimin për të, pa kurrfarë mërie ose inati personal. Ne qëllimisht s'po e bëjmë këtë, sepse na nevojitet mendimi i të gjithë shokëve e pastaj nga ato do të marrim një vendim.

Një gjë është e qartë: ky është një fraksion që mund ta dëmtojë, por kurrë ta ndalë hovin e Lëvizjes. Këta janë njerëz që nuk kanë ndikim në masë, ata i frikohen takimit me të, nuk kanë kurrfarë aftësie intelektuale për të shkruar diçka të mirë, apo aftësi organizative që ta dëmtojnë armikun ashtu siç e kërkon populli sot dhe kushtet ekzistuese. Është dëshmuar se janë mendjemëdhenj të sëmurë, njerëz në të cilët nuk mund të mbështetemi kurrë, dhe s'mund të shohim asgjë të mirë. Sikur të ishin shokë, ata kanë mundur të kontribuojnë, sepse udhëheqësi i tyre ka punuar në çerdhen e armikut dhe ka mundur të na informoj e mësoj për shumë gjëra. Ka ndodhur krejtësisht e kundërta. Mjerisht puna ka shkuar edhe më larg, ka fakte se po na i denoncojnë njerëzit e tyre shokët tanë më të mirë. Sidomos kjo po na dëmton shumë. Është edhe një e keqe tjetër: ekziston dyshimi i themelshëm se në mesin e njerëzve të tyre ka edhe njerëz që punojnë për armikun, fundja të gjitha veprimet e tyre çojnë ujë atje... ku s'duhet. Por megjithatë ne nuk guxojmë të jemi shpirtngushtë dhe t'i kualifikojmë si armiqë e tradhtarë, pavarësisht se puna e tyre është kokë e këmbë e tillë.

Lidhur me këtë nga shokët tanë kërkohet që gjithsesi ta studiojnë këtë broshurë dhe sa më parë t'i shprehin mendimet e veta. Gjatë leximit ta analizojnë së bashku çdo rresht dhe të vinë vetë në përfundime të drejta. Duam ta dimë poashtu se a mendojnë shokët t'i demaskojmë apo jo, t'i luftojmë haptas dhe ta bindim popullin se kush janë e çka duan apo ta lëmë për një kohë se si po zhvillohet situata. Por një gjë duhet ta kemi parasysh, këta njerëz mbjellin hutime e dezorientim te masat dhe kjo është shumë e dëmshme, sepse kompromethohet emri i Lëvizjes, e ata do të vazhdojnë të veprojnë edhe në të ardhmen në emrin e saj, sepse ky është paravani më i mirë përmes të cilit ata i fshehin budallallëqet e veta. Ky është i vetmi shkak që na shtynë të merremi me ta, përndryshe ata janë fare të parëndësishëm. Do të mund të ishin të rrezikshëm vetëm nëse lidhen me ndonjë shërbim të huaj informativ, sidomos me atë bullgar, siç ka propozuar shefi i tyre njëherë, por e kemi kundërshtuar, mu për këtë duhet të jemi shumë e shumë vigjilentë, t'i sqarojmë masat, sepse ata kanë për qëllim të fusin konfuzion dhe në emër të saj të verbojnë Lëvizjen. Të aktivizohemi të gjithë në zbulimin e njerëzve që e shpërndajnë këtë manifest të budallallëkut dhe t'i sqarojmë punëtorët, por pa hyrë në detaje të marrëdhënieve tona me ta. Ata duhet t'i luftojmë me punë të përditshme dhe jo me thashetheme.

Presim mendim të menjëhershëm

Redaksia e Zërit të Kosovës (Xhafer Shatri)

(Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 208-212)

38. Letër e Xhafer Shatrit për Sabri Novosellën, verë 1983

Tungjatjeta shok Mërgim,

pas pritjes se do të vinë shokët e pastaj do të të shkruaj gjerësisht edhe për përshtypjet e takimit me ta e pash se nuk ka gjë në atë drejtim, prandaj vendosa të të shkruaj shkurtimisht, sepse jam duke punuar në numrin 6 të ZK.

Lidhur me njerëzit që kanë ardhur prej atje nuk kam se çka të të them. Disa flasin shumë mirë, madje kanë dëgjuar prej njerëzve kompetent se p.sh. ZK ka artikuj që as në ZP nuk janë botuar ndonjëherë, pra shumica flasin kështu. Më vonë na vie një shok dhe na informon shumë më gjerësisht, po megjithatë fiton njeriu përshtypjen kah e dëgjon atë kristalizim thashethemesh se atje (në Shqipëri-shën i Sabri Novosellës) diçka nuk është në rregull, çka nuk e di, por diçka është në pyetje.

Studentët kosovar e kanë kërkuar t'ua lejojnë leximin e ZK, kanë pranuar. Si duket vetëm pasi që i kanë shkruar KQ.

Ka njerëz që i kanë porositur disa që të mos dëgjojnë askënd, që ne të ndalemi vetëm në kërkesa të ngushta, pra KR e asgjë tjetër. Natyrisht ne nuk mund t'i injorojmë as t'i këqyrim me indiferencë 500 000 vëllezër tanët në Maqedoni kah masakrohen e shpërngulen çdo ditë. Këtë është dashur ta dijë edhe një kalama, pastaj një gjë do të ishte një gabim historik për një organizatë patriotike. Me një fjalë le të thotë kush çka të dojë, politika e Lëvizjes është e drejtë. Ndodhë që kësaj t'i fryej edhe njëfarë Engjëlli i Vj. (Engjëll Kolaneci, diplomat i Shqipërisë në Vjenë-shën i red.) që është mësuar më parë të mvrej e kthjellë këndej e tash pasi që e ka parë që nuk po ia varë kush, përpiqet të na luftojë me metoda kaq të poshtra. Por sjelljet e tyre të bëjnë të kuptosh se ata duan zhurmë e jo punë. Ne nuk jemi për zhurmë dhe natyrisht ata e kanë parë këtë fare mirë. Tufanin kur të shpërndahen tash këto ditë 1200 ZK në Kosovë ia ndien tërë Ballkani e më së shumti ata. (ata=Vëllau i madh. Me këtë nuk kam mund me e kuptuar çka ka dashtë me thënë. ZK po u shpërndajka kundër Vëllaut apo kundër Jug. - shën i Sabri Novosellës). Këto ditë i kanë blerë 100 autobusë në Shkup...

Pak më tutje është konsullati i T. ku si në ditë tregu shtyhen shqiptarët e shkretë për t'i rregulluar dokumentet për të marrë rrugën që nuk ka kthim..

Pra fjalën e kam prapë për Shkupin.

Lidhur me gjykimin e udbashëve atje nuk më shkruat pak më gjerësisht, sepse duhet ta shkruajmë një artikull interesantë në këtë temë, pra a kanë shkruar gazetat gjë dhe pastaj ne të thirremi në to gjë që do të kishte efekt shumë më të madh. Përgjegjen që ia kishit kthyer Nuhiut ishte shumë e mirë. Merre me mend se çka më shkruan, thotë se "Punëtorët" i nxjerr LNÇKVSHJ. Çfarë provokatori i poshtër. Po ua kthejmë çdo ditë njerëzit kundër tyre. Ata sido që ta marrësh janë të vdekur. Lidhur me njeriun që të shkrova në letrën e fundit të lutem më informo menjëherë sepse tash na vjen një kurir i sigurt apo ndoshta edhe shoku kompetent për atë punë. Dhe le të kontaktoj në ka ardhur një njeri. Me të duhet pasur kujdes, po frikoj mos po bëhet ndonjë ngutje sepse njerëzit brenda po duan të nguten e neve nuk na konvenon një ngutje e tillë. Punët duhet të shkojnë ngadalë por sigurt. Kam përshtypjen se tash së shpejti do të ketë atje burgosje masovike, sepse janë liruar të gjitha burgjet. Ama të gjitha. Jam për ata që të zgjerohen radhët por ngadalë, duke i pasur ne këndej jashtë, prej nga nuk mund të marrin askënd ta fusin në rrymë emrat e të gjithë lidhjeve të reja, në mënyrë që të mos mund ta zhdukin apo dëmtojnë rënd organizimin. Ne kemi arritur gjer më tash ta mbulojmë tërë territorin gati, por mungonte kordinator i fort, tash edhe kjo çështje është rregulluar...

Njerëzit po janë të rinj e të papërvojë. Kurrë nuk ka pasur vullnet më të madhë por edhe përvojë më pak gati kurrë jo.

Pra siç ta kam thënë, ma dërgo emrin e njeriut në të cilin ti e ke besimin e plotë ama njeri të përvojshëm në mënyrë që të mos e rrezikojmë shokun, sepse një kuadër i tillë ka vlerë të madhe.

Pra le të njihen njerëzit në zjarrin e luftës, ajo i lidh e i çelnikos edhe më shumë.

Atë ditë të thirra në telefon sepse këtu te unë thirrnin orë e çast dhe më pyetnin për emrin dhe adresën tënde, por unë qëllimisht nuk ua jipja sepse thash mos ke harruar farë dokumenti aty e po kundërpërpiqen të më mashtrojnë. Adresën e shokëve në Australi nëse nuk ua kam dërguar më parë është kjo:

Komiteti i LRSHJ "Bajram Curri" PO Box 36, Hastings, Vic. 3915, Australia

Me këta çdo gjë është në rregull, këta janë burra e gjysmë.

Adresa e shokut tonë në Amerikë është jo aq e sigurt, sepse e ka ndërruar vendin por shkruaj në këtë adresë: X. Kabash PO Box 7197, Flushing, N.Y. 11352. USA

Në Amerikë është më vështirë të veprohet. Po kanë shumë probleme. Ata në Australi më njohin si Bardhyl, ndërsa në Amerikë si Daja nga Zv. Do të ishte mirë që kur të keni kohë të shkruani komente për këto dy Radio të cilat emitojnë vetëm gjëra të ZK. Njerëzit që i udhëheqin janë krejtësisht tanët. Adresat: Gjergj Kalaj, (shumë njeri i mirë), 125 Goldner Aveny, Pontiac Mi. 48054 USA dhe: Zani i Malësisë 315 E 68 st. N.Y. 10021, New York USA

Mundësisht komentet i shtypni në makinë dhe kujdesuni që rregullisht t'i furnizoni të dy palët. Ne për besë nuk po kemi kohë. Të njëjtin koment shtypeni në dy kopje dhe ua dërgoni të dy palëve. Do të ishte mirë që ta marrësh vetë përsipër këtë punë. Por ama bile dy herë në muaj të shkruani për ngjarjet aktuale në Kosovë. Po me Naimin nuk më shkrove se çka u bë, ai nuk u lajmërua fare, dreqi e marrtë jam bërë merak, disa ditë më kanë humbur gati kot në ankthin e pritjes. Do të ishte mirë sikur të vendosej në S. Atje do të kishte kushte të mrekullueshme për punë dhe unë do të lirohesha shumë që të kushtohem orga. pak më tepër. Ne po na mungojnë orga. e fortë, asi që bëjnë shpellë ku t'i mëshojnë. Siç të thash edhe atë ditë në tel, mendoj se ne duhet që tri vjet t'i bimë me gjoks, dhe me se të mundemi, sepse po që se e lëmë hekurin të ftohet droj se do të shkojë kohë e gjatë për ta skuqur prapë...

(Xhafer Shatri)

39. Letër e Xhafer Shatrit për Remzi Ademin, 7 korrik 1983

I dashur shok,

po të shkruaj fare shkurtimisht, të gjitha këto falenderime po t'i dërgoj me lutje që në të ardhmen t'ua japësh vet atyre që kanë kontribuar apo që do të kontribuojnë në dhënien e ndihmave për Kosovën.

Përshëndetje vëllazërore

B... (B=Bacaloku=Xhafer Shatri) 7 korrik 1983

40. Letër e Xhafer Shatrit për Qendrën Ekzekutive, 26 korrik 1983

Të dashur shokë,

po ju shkruaj shkurt. Në broshurën për shpërnguljet nuk ia nisa akoma, sepse po më duhet të punoj në nxjerrjen e organit për muajin gusht, sepse siç ka nisur ne duhet të përqendrohemi vetëm këtu tash për tash. Referatin që S. (Xhafer Durmishi) e lexoj atë

ditë mendoj se tash për tash duhet ta fotokopjojmë ashtu siç është dhe ta lëshojmë në lexim vetëm në radhët më të ngushta, pra te njerëzit që ata mund ta kuptojnë drejt.

E lexova gazetën e atyre burrave, nuk është në nivel të duhur, ajo nuk e ka atë lëngun e nevojshëm dhe siç po shihet s'do ta ketë kurrë, sepse nëse diçka nuk shkruhet me zemër ai s'e tërheq askënd.

Më së keqi na ka mbetur puna në rrethin e Frankfurtit, sepse atje ka shumë element të mirë dhe duhet që S. gjithsesi të shkoj te Ahmeti e të bisedoj me të gjerësisht, sepse janë atje disa azilerosë që do të mund ta ndihmonin luftën shumë, e nëse bien në duart e atyre injorantëve atëherë mund të dezorientohen shumë. Ma merr mendja se ju të dy e madje edhe Hafizi, meqë keni pasur shumë punë me ta, ta formoni një raport plan se si t'iu kundërvihemi, t'i zbulojmë planet e tyre, t'i zbulojmë njerëzit ku ata i kanë punktet e veta dhe t'i luftojmë me të gjitha forcat, në mënyrë që kur ta botojmë demaskimin atëherë të mos gjejnë askund mbrojtje as mbështetje.

Me Shaqën ka biseduar K. ia ka dorëzuar disa gjëra bukur të rëndësishme. Do të bisedojmë më vonë, por ky njeri ka bërë një kthesë të madhe, çka e ka shtyrë në këtë është vështirë të dihet, por atë mbrëmjen e demaskimit këtu atyre të Shq. u ka bërë përshtypje të thellë demaskimi, e ndoshta edhe Sh është informuar për këtë. Sidoqoftë edhe unë do të bisedoj me të, ndërsa ju priteni gjithnjë mirë. Ndodhë që të vie tash edhe te ju, nëse ai e sheh se si është puna dhe është për punë natyrisht se do t'ia japim mundësitë që ta tregoj veten. Me H. është puna në rregull, ai ka arritur një sukses të madh në grumbullimin e njerëzve atje, por duhet t'i ndihmojmë që t'i organizojë. Çka u bë me ata shokët e Italisë, shkuan në Belgjikë apo jo. Do të ishte mirë që me ata njerëz të mos i shkëpusim lidhjet, sepse një shkëputje sado e vogël pastaj po na dëmton shumë, ta marrim si shembull rastin e Agronit, të cilin e ka kthyer ai farë Hyseni. Për këtë ne tashmë kemi fakte të gjalla. Merrni poashtu hetime edhe për njerëzit që ua merr mendja se duhet të jenë të Shaqës dhe si po sillen ata, në mënyrë që ta kontrollojmë përmes tyre se sa është i sinqertë. Në bisedën e fundit K. më tha se dukej mjaft i sinqertë, por dreq merre vesh punën kur për një çështje po të hyn dyshimi në shpirt.

Lidhur me aktivitetin tonë, në të ardhmen është e domosdoshme që ne t'i shkruajmë njëri tjetrit rregullisht dhe sa më gjerësisht në mënyrë që të mos na krijohen zbrazëtira si më parë, përndryshe mos pyet.

Po e përsëris, tash na ka mbetur më së keqi Frankfurti e Manhajmi, prandaj t'i gjejmë shokët tanë edhe aty dhe të mos u lëmë askund mbështetje.

Si duke AP ka shkuar në Holandë dhe do të vendoset sipas të gjitha gjasave atj. Ne edhe atje duhet t'ia zbulojmë bazat e tij, por sidoqoftë më i rrezikshmi prej tyre mbetet Nuhiu, të cilin në të ardhmen duhet ta përcjellim edhe më me ngulm. Duhet ta përgatitni një njeri që i afrohet dhe e fiton besimin e tij.

Po me ata studentët që biseduam si u bë a janë akoma aty dhe kur do të shkojnë në shtëpi. Kijeni parasysh se ata janë aq të vlefshëm sa nuk mund të maten me asgjë. Për kontaktet tuaja me ta nuk guxon të merret vesh shumë dhe natyrisht se nuk bën të rrin haptas me ju, sepse të gjithë ne jemi të përcjellur e besa edhe të fotografuar.

Edhe për këtë numër të gazetës ka material shumë interesant. Besoj se do të dalë shumë e mirë, pade të shohim njëherë.

Përshëndetje revolucionare Xhema (Xhafer Shatri) 26 korrik 1983

41. Letër e Xhafer Shatrit për Remzi Ademin, 27 korrik 1983

I dashur shok,

po të shkruaj fare shkurt. Vendi ku ti jeton e militon tash për tash është ndër vendet kyqe të frontit, prandaj duhet t'i bëjsh sytë katër e të shkosh në mesin e njerëzve kudo, të rrish me ta, të bisedosh dhe të mos i dijë as djalli se ku i ke këmbët, rri dhe bisedo edhe me Sahitin edhe me Hasanin, dhe për çdo bisedë me ta më shkruaj menjëherë gjerësisht dhe kuptohet njohtoi shokët automatikisht, por jo të gjithë, sepse po dalin fjalët pastaj dhe roli yt mund të bie në ujë.

Në bisedë me ta kije parasysh se ata janë njerëz që kanë rënë në një rrjetë shumë të rrezikshëm dhe sot edhe po të përpiqesh t'ua shpjegosh nuk të kuptojnë pa u dalë dehja. Nuk do të shkojë shumë e ata dhe shumë të tjerë do ta kuptojnë se janë viktima të një ambiciozi të sëmurë.

Pra tërë aktivitetin tënd përqendroje aty ku je, nëse ta merr mendja se duhet të vie ndonjë shok tjetër për ndihmë bisedo me Sk. dhe me shokë të tjerë e ne duhet të bëjmë diçka që ta ndihmojmë aktivitetin atje.

Kaq.

Përshëndetje revolucionare B (B=Bacaloku=Xhafer Shatri)

Mërgim, 27 korrik 1983

42. Letër e Xhafer Shatrit për Qendrën Ekzekutive, 31 korrik 1983

Shokëve të QE

Të dashur shokë,

po ju shkruaj fare shkurtimisht dhe po ju njohtoj me sa vijon:

Situata brenda po ashpërsohet, para sa kohe jugosllavët kanë luajtur rolin se gjoja në Gllogovc po presin edhe një desant nga Shqipëria! Forcat ushtarake tashmë një kohë të gjatë janë vendosur dhe nuk ka lëvizje të tyre. Lidhur me këtë ekzistojnë mendime të ndryshme, njëri prej tyre është ky, se në rast kryengritjeje të armatosur, do të thotë se ata po presin se edhe me ne do të përsëritet rasti e 72 në Kroaci, atëherë ta bëjnë të vetën duke e masakruar popullin e paarmatosur në njërën anë dhe në anën tjetër të qëllojnë të përgatitur ne rast ndërhyrjeje nga ana e Sh. Disponimi i popullit është i tillë sa nuk mund të merret me mend, njëmend i janë harxhuar të gjitha rezervat e frikës. Traktet kundër tradhtisë janë shpërndarë me të madhe, sidomos në Prishtinë e Ferizaj dhe në fshatrat e komunës së Gjilanit e Kamenicës. Të trimëruar nga një disponim i tillë i popullit kuislingët, tash më me guxim po i kundërvihen presionit të Serbisë, këtë më së miri e vërtetën intervista e I. Bajrës dhënë Zërit të Rinisë. Lidhur me situatën ushtarake në kufi sidomos kam edhe disa informata të rëndësishme që nuk bën ta ngarkoj letrën.

Për propozimin e Il. që buletini të quhet Kosova, unë pajtohem plotësisht. Për botimin e dramës së Jusufit, nuk kam mundur të bëje asgjë tash për tash, veç përgatitjes së një parathënie të shkurt, sepse po na duhet ta botojmë ZK tash në gusht, kjo m'u duk më e rëndësishme.

Në traktin kam punuar pak, por atë duhet rregulluar për në fund të shtatorit. Lidhur me traktin il. (ilazi-Ibrahim Kelmendi-shën i red.) do të ishte mirë që atje në Suedi ta gjej në post emërtuesin telefonik të Jugosllavisë që është i tëri në një libër dhe të na e dërgoj menjëherë. Fehmiu duhet ta ngarkojë një shok që nga një ZK t'ua dërgoj rregullisht Komitetit Krahinor, të gjitha komiteteve komunale të Kosovës, Bujanocit, Ulqinit, Tetovës, Shkupit, Dibrës, Kumanovës, Plavës, Preshevës etj. pastaj Bibliotekës Universitare në Prishtinë, Institutit Albanologjik etj.

Në këto adresa duhet të dërgohen të gjitha botimet tona. Diçka do të bëjnë edhe shokët nga brenda, por edhe ne nga jashtë duhet t'i bombardojmë ata qelbanikë.

Kam biseduar me një shok nga brenda. Ne duhet të bëjmë edhe shumë më shumë, ne duhet të mendojmë natë e ditë se si ta ndihmojmë luftën brenda dhe të mos lejojmë që një disponim i tillë të mos përcillet edhe me punë përkatëse. Pritet që të vie një shok nga T., të cilit ia kam nxjerrë biletën këtu, për shkak të vizës. Sigurisht se duhet të vendosim se çka të bëjmë me grupin e këtyre udbasho-patriotëve. Letrën përgjegje shokëve në T. mjerisht kam harruar ta fotokopjoj, por po ju njohtoj se është një letër fare e shkurt dhe përmban më shumë vendimet që janë marrë atë ditë.

Për Bashkësinë e Klubeve gjer tash kanë ardhur tri propozime. Por tash duhet të mendojmë edhe për Br. prej atje ma merr mendja se duhet të caktohet ai punëtori që quhet Sabit, ose Qamili, dhe këtë le ta merr përsipër il. ta rregulloj. Do të ishte më mirë të jetë punëtori, pra Sabiti, sepse është njeri shumë besnik dhe nuk mund të thotë dikush se është azileros. Për Mynhen le ta caktoj apo rregullojë disi S. Letrën prej F. me ato informatat e ka marrë, të holla akoma, posa të vinë do të veproj sipas porosive. Frankfurti na ka mbetur shumë keq. Atje dhe në Manhajm duhet të intensifikohet aktiviteti. Po punohet në vënien e themeleve të shërbimit tonë informativ. Propozoni edhe ju njerëzit që do të mund të kontribuonin në ketë drejtim. Brenda është zgjeruar puna shumë mirë, sikur të kisha kohë të merrem më shumë me këtë punë, besoj se do t'i komenzonim të gjitha humbjet e gjertanishme të shokëve të burgosur. Lëvizja është popullarizuar shumë dhe për t'u inkuadruar në të janë të interesuara të gjitha forcat vitale të popullit tonë.

Do të ishte mirë që në këtë drejtim edhe ju ta jepni kontributin tuaj.

Letrën po e shkruaj për së shpejti, ndaj mos ma merrni për keq për lëshimin e kaq shumë gabimeve. Është e domosdoshme që bile njëherë në javë të letërkëmbejmë në mes veti.

Një mbrëmje kam biseduar me Shaqën. Gjatë bisedës me të kam menduar shumë se sa e vështirë është lufta e jonë, sepse ne DUHET TË NDËRKOJMË KALA EDHE ME GURË QË JANË EDHE GRANIT EDHE BALT NJËHERIT. Ai njeri nuk është aspak i sinqertë, ai njeri (kam përshtypjen) ka bashkëpunuar gjer tani me fraksionistët, e ndoshta edhe tash është në shërbim të tyre, sidoqoftë duhet që S dhe F të bisedojnë me të gjerësisht dhe t'ia këpusin që ai të kontaktoj me K. (Kadri Abdullahun-shën i red.) dhe vetëm me të, sepse ai është i vetmi njeri që ka tolerancë të pakufishme dhe është çdo ditë në kontakt me njerëz me të cilët rri Shaqa. Ai më thirri edhe në shtëpi dhe më erdhi keq që të mos i shkoj brenda. I kishte dy fëmijë shumë të mirë dhe një grua shumë bujare. Ia bëra me dije qartë se ne jemi në dijeni se AP dhe sidomos Nuhiu po thirren në veprimtarinë e tij, se po llogarisin në të, se shoku i tyre ka qenë te ky etj. Ky i ka dorëzuar 30 numra të "pun.", ndoshta e ka bërë me qëllim. Sidoqoftë pasi bisedova me të, edhe ashtu qesh mjaft i lodhur, u ndava prej tij me përshtypjen se kam pir ujë të turbullt.

Ndoshta po mashtrohem dhe do të ishte mirë të mashtrohem në këso diagnozash. Sidoqoftë ai më tha se do të shkojë në Gjer. kah i 15 gusht dhe drejt e te F. Prandaj është e domosdoshme që S të bisedoj me të dhe ta detyrojnë që njerëzit me të cilët ai e ka njohtuar N. të mos i lejojë më që të bëhen vegla qorre të AP. Aq më parë kur mu këta njerëz janë bërë vegla të tyre të bindura.

Ilazi do të ishte mirë të marrë informata më të hollësishme për atë farë Sokol Zeqirajn e Brukselit, dhe të na njohtoj pak më gjerësisht, por natyrisht për informata të tilla të tregoj një "mosinteresim" te ata që pyet... Kam një informatë lidhur me atë njeri, ndaj do të dëshiroja ta verifikoj. Ilazi do të ishte mirë që të na informojë lidhur me atë propozimin që ishte për deponimin e të hollave në ndonjë dyqan atje apo gjetkë...

E kam shkruar edhe në atë shkresën-rregulloren e QE se ne duhet të mbështetemi vetëm e vetëm në forcat tona e në askënd tjetër dhe në këtë Ilazi disi reagoi, po shfrytëzoj nga rasti ta pyes edhe kështu, e në kënd të mbështetemi atëherë ne, vallë punët që mund t'i bëjmë ne të presim të na i bëjë dikush? Kurrsesi. NE DUHET TË MBËSHTETEMI VETËM NË KËRQELEN TONË, dhe në këtë çështje të mendojmë më seriozisht, sepse pa mjete materiale nuk çohet lufta përpara. Sidomos njerëzit brenda po kërkojnë teknikë pa të cilën nuk do të mund ta zhvillojnë atë që pritet prej tyre e një teknikë e tillë është shumë e shtrenjtë, pastaj duhet të përgatitemi edhe për dimrat e gjatë që po vien, sepse ne do të livadhisim nëpër Evropë vetëm gjer sa të jetë nevoja, asnjë sekondë më shumë, dhe kur të hymë atje sigurisht se nuk do të hyjmë për të luajtur dansing.

Në Jugosllavi mund të pritet çdo gjë, aty në asgjë nuk është i sigurt njeriu, prandaj nuk guxojmë të na befasojë diçka nesër e pas nesër për të thënë goliatçe, ah s'e kemi ditur.

Pas këtij numri të organit do ta përpunojë atë për shpërnguljet, besoj se do të dalë një broshurë mjaft e mirë, ndërsa tani për tani si material nuk është as përafërsisht i përpunuar, mu për këtë edhe nuk po ia dërgoj Ilazit.

Dramën e Sokolit do ta përgatisim menjëherë pas përfundimit të nr. 5.

Punimin e Ilazit për buletinin e mora, por nuk ishte gjithaq i përpunuar, unë do ta redaktoj dhe do ta botojmë, por është më se e nevojshme që çdonjëri prej nesh që merremi me shkrime ta kemi parasysh një çështje: asnjë shkrim nuk mund të jetë kualitativ po që se ai që ka marrë mundimin të shkruaj nuk e lë në atë shkrim një pjesë të jetës së tij, mu për këtë shkrimi është torturë mbi të gjitha torturat.

Sa i përket M. ma merr mendja se ai duhet të angazhohet atje në veri për çështje org. dhe për këtë le të merren vesh në mes veti Il. Sa dhe Muh. Ai njeri nuk bën të rrij anash.

E thash edhe më parë, në të ardhmen ne duhet që bile njëherë në javë t'i shkruajmë njëri tjetrit, po kështu letra të përgjithshme ku ndërinformohemi për çështje të ndryshme nga aktiviteti ynë. Në mungesë takimesh të rregullta kjo paraqitet si domosdoshmëri. Letrat duhet të jenë të gjata, desha të them të plota dhe informuese.

Përshëndetje revolucionare Xh. (Xhafer Shatri)

Zvicër 31 korrik 1983

Ata fraksionistët po thirren në PPSH. Haptas po thonë se e kanë përkrahjen e shokëve të Vjenës.

(Faqja e parë e kësaj letre, nga gjithsejtë dy, është botuar në librin e Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 207-208)

43. Letër e Xhafer Shatrit për Xhafer Durmishin, gusht 1983

Shok Salih,

pare e mora letrën tënde. Po të përgjigjem shkurt, sepse tash po punoj në organ, i cili duhet të dalë në këtë muaj. Kryeartikulli do ta ketë një për atë se si e shohim ne shqiptarët Shqipërinë.

Artikulli për Fazliun kishte me qenë shumë më i mirë edhe fotoja ishte shumë e mirë, por unë kam pritur material për të që të na vie tash, bile një shok më lajmëroi se do të na e nisin, tash nuk e di se kur do të vie. Pra material burimor e ndodh edhe ndonjë foto tjetër, por një artikull i tillë më i mirë do të ishte sigurisht me rastin e 20 vjetorit të rënies së tij, apo ndoshta edhe me rastin e 28 Nëntorit?

Sa i përket Gjurekoviqit, pajtohem lidhur me atë që ti shkruan, por është e nevojshme të shkruajmë, pavarësisht se çka mund të thotë AP. Ne duhet të shkruajmë në këtë aspekt që me një shkrim të tillë ta demaskojmë udbën e Jugosllavinë pa kurrfarë lavdatash për të vrarin, sepse ata kanë shkruar për shokët tanë dhe do të ishte dobësi po

që se ne heshtim për një krim të tillë monstruoz, merre me mend pasi e kishin vrarë, e kishin përdhosur e sakatosur me sopatë!

Një lajm i tillë do ta kompromotonte shumë Jugosllavinë te lexuesi shqiptar.

Po ta dërgoj këtë statut-program që e ka bërë Hy. për Bashkësinë e Klubeve. Të lutem përpunoje mirë e mirë shtoji ato idetë që kishe dhe përpiqu që ato t'i jetësojmë.

Hamburgu e ka propozuar Ali Ademin, Dyseldorfi, kryetarin, ti këqyr me Mynhen, për këtu nuk ka problem do ta rregullojmë atë çështje. Besoj se për Sent Gallen do të jetë Haxhiu ndërsa punët le t'i marrë në dorë Fehmiu, sepse është më afër teje dhe vepron sipas asaj që ta këshillosh ti.

Sidoqoftë ti mendo se kush duhet të jetë në atë kryesi.

Mehmet Bala më ka treguar se si ka qenë te Sahiti, ky njeri nuk është i keq, së pakut nuk duket. Ky e ka dërguar një letër demaskuese kundër frak. (fraksionit të Abdullah Prapashticës-shën i red.)

Përshëndetje revolucionare Xh. (Xhafer Shatri) (gusht 1983-shën i red.)

Dërgoja Mërgimit atë kopjet e referatit tënd sepse ai është punim i fort se si duhet demaskuar horrat!

44. Letër e Xhafer Shatrit për QE - apo në emër të Qendrës Ekzekutive, 31 gusht 1983

QE,

Të dashur shokë, siç po shihet ne nuk po u përmbahemi vendimeve tona, pra letërkëmbimi nuk po është i rregullt. Ne nuk po ndërinformohemi në mes veti, kjo nuk shkon më kështu. Ju lutem mos të ndodhë më që një letër e shokut sado e vogël apo sado e parëndësishme të mbetet pa përgjegje përkatëse. Kjo le të mbetet vërejtja e fundit.

Lidhur me makinat që thotë Ilazi në letrën e tij të fundit do të ishte mirë që ai të këqyrë dhe të gjej aparat shumëzues që punon me ofset, pra në pllaka llamarine, të jetë i formatit A3, le të këqyr dhe le ta gjej sa më të vogël që të jetë e mundur, sepse ka edhe të tillë dhe mendoj se nuk duhet të jetë aq shtrenjtë. Natyrisht njerëzve që e blejnë nuk bën t'u themi se për ku duhet... pajtohem me atë se fotokopjuesi është i shtrenjtë në çdo aspekt dhe tejet i komplikuar, sidoqoftë duhet të gjendet një zgjidhje bile së shpejti. Kjo është e domosdoshme. Unë pata dëgjuar se Hafizi e ka gjetur një aparat bukur interesant shumëzues, u fol se do ta fus brenda etj. por nuk doli asgjë nga ajo, ky që përmenda, Naimi etj. mua po më befasojnë shumë, unë nuk po mund ta marrë me mend se si mund t'i thonë vetes të organizuar këta burra të botës. Kështu nuk shkohet më, Salihu duhet të ndërmarrë masa të letërkëmbejë me ta dhe me këdo që mundet të vërë kontakt, sepse letrat janë një formë shumë e përshtatshme e mobilizimit të njerëzve: i shpreh mendimet tua e mbyll, e dërgon me mija kilometra dhe e merr një lexues e hap ngadalë ndoshta pa vetëdije se po e hap një bombë që do të shpërthej para syve të tij, gjë që është e vërtetë, sepse është e pamundur që një letër, mendimet e shprehura në te, të mos ia plagojnë bile një çik ndërgjegjen.

Merreni me mend p.sh. H. (Haxhi Berishën-shën i red.) është në rrethin e San Gallës, ka arritur të afroj një vistër të tërë njerëzish sidomos nga Tetova, mirëpo ata njerëz tash duhen organizuar. NE DUHET T'I PËRGATISIM USHTARËT TANË, KUDO DUHET FORMUAR QELULAT TONA AMA KUDO, është koha e fundit të veprohet në këtë drejtim, kudo, sepse praktika po tregon se njeriu i organizuar po ka disiplinë më të madhe poashtu edhe përgjegjësi. Njeriun e paorganizuar nuk mund ta futësh me një thirrje telefoni në zjarr të luftës çka nuk do të thotë se nuk do të jetë e nevojshme bile së shpejti ndoshta, sepse kur ngjarjet zënë të rrokullisen atëherë ne nuk dimë se si mund të

ndalen ato. Poashtu duhet të vepron edhe Ilazi, poashtu duhet të veproj edhe Muhameti atje ku ai mund të arrijë. Kudo duhet t'i formojmë vatrat e lirisë. Njerëzit e paorganizuar janë një lukuni spontanësh që nxehen e ftohen saora. Ne nuk na nevojiten njerëz të tillë. Me qelulat e posaformuara duhet të kontaktohet bile njëherë në dy javë. Ekziston një punim lidhur me këtë çështje dhe meqë nuk kemi ndonjë më komplet atëherë le të veprohet sipas tij. ËSHTË KOHA E FUNDIT QË TA FORMOJMË NJË DISIPLINË NË RADHËT TONA, TA FORMOJMË NJË RREJTË TË QELIKTË CELULASH QË NUK DO TË KETË FORCË NË BOTË TA THEJ, DREQI E MARRTË PO KA KUSHTE IDEALE PËR KËTË ÇËSHTJE, MERRE ME MEND I ORGANIZON NJERËZIT, MBAN TAKIME META DHE NUK KE AS MË TË VOGLËN FRIKË SE MOS PO TË VIE UDBA DHE TA ZË DERËN... Pra duhet t'i shfrytëzojmë këto kushte ideale. Pse të mos organizojë njerëzit atje ku është Ilazi? Këndej po veprohet në këtë drejtim por jo sa duhet, bile as përafërsisht.

NË TË ARDHMEN NE NUK GUXOJMË TË MBËSHTETEMI NË NJERËZ TË PAORGANIZUAR, T'U JAPIM NJERËZVE BESIMIN E PASTAJ TË SHOHIM SE SA JANË TË DENJ PËR TE, NATYRISHT NUK JAM PËR KUANTITET, POR PËR CILËSI. Merreni me mend tash janë grumbulluar e tërë lukunia e mërgatës kundër nesh, me kuqkë e me maqkë dhe po i organizojnë njerëzit edhe me libreza! Është e domosdoshme që të formohen komitetet e vendit, apo do të thosha përgjegjësit e caktuar për një regjion dhe ata le të bëhen bartës kryesorë të aktivitetit për atë krah. Ndryshe nuk shkon shokë! Njerëzit nga brenda po presin prej nesh shumë. Ma merr mendja se duhet ta bëjmë edhe ne njëfarë diferencimi në radhët tona, kush është për luftën me mish e me shpirt le të dihet dhe le të dihen edhe ata që nuk janë. Besimi t'u falet vetëm atyre që e meritojnë, t'i shoshisim njerëzit dhe të mos kemi punë me lloj lloj tipash të Nuhiut. Këtë të shtunë e kemi marrë një telegram prej shokëve të AP në Redaksi.

Kërkojnë takim burrat e botës. Telefonojnë te Kadriu dhe ky u thotë se nuk di ku është ai shoku prandaj telefononi më vonë, për këtë qëllim Plaku (Hasan Mala-shën i red.) erdhi në Gjenevë që të mos thonë se ne po i ikim takimit, fundja ne nuk i kemi borgj askujt e aq më pak atyre qelbanikëve. Mu për këtë Plaku i telefonoj Hasan Veselajt, veglës qorre të tyre, i tha se po i pres tërë ditën në Gjenevë... Ata më vonë telefonojnë te Ka (Kadri Abdullahu-shën i red.) ky u thotë na jepni një numër telefoni (ata lajmëroheshin kinse nga Zvicra dhe këtu, siç e dini çdo kabinë e ka numrin...) e unë po u vë në kontakt me shokët, sepse ata tash nuk mund të vinë këtu janë me qinda kilometra larg. E mbyllën telefonin dhe pastaj thërrasin prapë, duke i thënë a erdhën ata shokët, thjeshtë hajgare... Ky u kthen mosni bre burra, po ne u morëm vesh, ma jepni numrin e telefonit dhe unë po u vë në kontakt me ta... ata e mbyllin prapë duke i thënë do t'ju shkruajmë dhe kështu në këtë stil... Të nesërmen e thirra unë H. Veselajn dhe i thash mos bëni hjagare përmes telefonit me njerëz se nuk u ka hije (Njëherë më parë po Kadriut kur ky e ka pyetur se prej nga po lajmëroheni i ka thënë në mes Gjenevës e Cyrihut...) nëse jeni për bisedime thuaj Abdullahut kur të duash mund të takohemi në cilindo qytet të Zvicrës, vetëm njohtomë një javë më parë në adresë të ZK dhe ia mbylla telefonin. Menjëherë pastaj ka thirrë ai farë Hasani dhe s'ka lënë gjë pa i thënë shoqes së tij, sepse Kadriu s'ka qenë aty. (Kjo duhet të mbetet në mes nesh). Pra ata duan takim, në të vërtetë duan kinse janë për bisedime por takimit i frikohen si gjarpri shpatës. Ne duhet ta ruajmë gjakftohtësinë...

Lidhur me vizitat e bashkatdhetarëve në Shqipëri, unë nuk jam i informuar aspak, por sidoqoftë ajo shoqja e shokut tonë, pra po mendoj se fjala është për Su. ka folur sigurisht duke qenë e painformuar për gjendjen e sotme këtu. Pastaj ata njerëz që po vijnë prej andej po sjellin lloj lloj fjalësh, vetëm të përmendet rasti i Jahirit vitin e kaluar. Në

nuk duhet t'u kushtojmë rëndësi këtyre gjërave, por njëkohësisht duhet të bëjmë përpjekje që lëshimet e lajthitjet e mëparshme të mos na dalin tash si vampirë prej andej kah s'e presim, sepse na pengojnë në punët tona. Thashethemet janë murrjela që pengojnë punën. Për shumëçka mendoj se duhet ta informojmë Su. dhe këtë më së miri mund ta bëjë Salihu, ani sidomos për çështjen e Nuhiut.

> "Ndërkohë, në mënyrë të tërthortë mora lajmin se në fillim të dhjetor 1982, në Gjenevë do të mbahej një demonstratë. Ish-shokët e idealit nuk e kishin parë të arsyeshme të më njoftonin as për demonstratën, e as për mënyrën dhe kohën e udhëtimit. Mora rrugën i vetmuar. Udhëtova me tren. Arrita në vendin e caktuar ku do të mbahej demonstrata. Pasi i përgëzova shokët e Gjenevës, Ejup Ahmetin dhe Elfi Agushin, për organizimin e mirë të demonstratës, ata më takuan me Xhafer Shatrin, të cilit i kërkova bashkëpunim... edhe pse më premtoi me fjalë të „sinqerta", mjerisht me këtë takim përfundoi edhe bashkëpunimi ynë!" (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f.54)

Këtë **qelbanik e stërpleh** duhet demaskuar me të gjitha forcat dhe me të gjitha mjetet.

Tash nuk po e zgjas më shumë, sepse edhe ashtu nuk po kam kohë, por po e përfundoj duke u porositur të gjithëve që të mendoni gjatë e gjatë se a keni njerëz të sigurt brenda, të cilëve ne mund t'u dërgojmë materiale, të gjejmë baza për nevoja të ndryshme dhe t'i organizojmë etj.

Lidhur me këtë do të ishte mirë të veprohet më sistematikisht, sepse njerëzit e "mi" nuk keni pasur mundësi t'i njihni ju dhe kështu reciprokisht....

Përshëndetje revolucionare
Xhema (Xhafer Shatri)

31 gusht 1983

Sa për sllloganin që propozon Ilazi mendoj se ne e dimë se nën petkun e një Lëvizje autonomiste qëndron një organizatë nacionalçlirimtare në kuptimin e mirëfilltë të kësaj fjale, por edhe nëse përdoret nuk ka asgjë të keqe. Do të ishte mirë që të kërkojmë edhe ndonjë sllogan më të përshtatshëm.

Shoku nga T. nuk erdhi. Por sot e kishte dërguar një letër ku thotë se duhet të bëjmë diçka për njohjen e L. në botë. Lidhur me këtë çështje ne kemi biseduar disa herë dhe më në fund pat mbetur që në të gjitha shtetet të përpiqemi të na njohin, pra të gjithë aty ku jemi. Ne nga ana jonë kemi biseduar me një sindikatë dhe ata na kanë premtuar ndihmë, por ka mbetur të bisedojmë edhe me një avokat. Shoku nga T. (Turqia-Sabri Novosella-shën i red.) kërkon që Il. (Ilazi-Ibrahim Kelmendi-shën i red.) të shkoj atje për konsultime në këtë pikë, por ma merr mendja se një konsultim i tillë mund të bëhet edhe përmes letrave, prandaj të mos hargjojmë shumë, sepse qëndrojmë shumë keq materialisht. Duhet të kursejmë e të kursejmë.

Kaq...

(Shën i Xhafer Durmishit: Kjo letër më erdhi më 23 prill 2012)

45. Letër e Xhafer Shatrit në emër të Qendrës Ekzekutive, shtator 1983

Shokëve të QE,

e mora një letër prej Ilazit dhe menjëherë po përgjigjem në të, poashtu e kam marrë një letër edhe prej Fehmiut, kryesisht lidhur me atë që unë kam parashtruar në letrat e fundit... Në letrën e Ilazit ishte një keqkuptim i madh sa i përket termit "të mbështetemi vetëm në forcat tona"... Së pari për rregulloren: Siç e dini unë pata mbetur ta formuloj një

rregullore që në takimin e parë, por këtë e bëra me vonesë dhe atë që e pata përpiluar në takimin e fundit nuk mundëm ta analizojmë apo thënë më mirë edhe harruam për shkak të punëve të shumta, dhe sigurisht edhe për shkak të lodhjes sime të madhe, gjë që nuk është dashur të bëhet ai lëshim, ajo rregullore është dashur të lëshohet në diskutim gjë që do të bëhet, por tash s'më qëlloi këtu që ta shumëzoi dhe t'ua dërgoi të gjithëve nga një... dhe në të unë pata shkruar, kur ishte fjala për çështjen materiale që ne të mbështetemi vetëm në forcat tona, duke pasur parasysh se ne jemi pjesë e pandashme e Lëvizjes, dhe kur e kam thënë atë kam menduar në Lëvizjen si tërësi e jo ne të pestë, që natyrisht pa Lëvizjen do të ishim pesë individë e asgjë tjetër, fundja çfarë kapaciteti (kësaj radhe vetëm ekonomik) mund të paraqesim ne të pestë, tre të papunë dhe dy të tjerë me rroga të punëtorëve fizik që kanë një mori fëmijësh për t'i mbajtur... Pra kam menduar në Lëvizjen gjë që kuptohet vetvetiu, sepse, siç e dini ne mbështetemi në ndihmat që japin punëtorët e shkretë që robtohen e shfrytëzohen si mos më keq, dhe se gjendja e tyre është aq ... e pashpresë kur dihet për papunësinë katastrofike në Perëndim dhe natyrisht shumë prej tyre do t'i ndjekin, siç ia kanë nisur në Gjermani dhe siç kanë vepruar gjithnjë në Zv. E pastaj si t'ia bëjmë ne. Ku të mbështetemi? Lufta jonë është e gjatë dhe mos harroni se shtypja e përditshme e bën të vetën, ajo i lodh njerëzit i drobitë për çdo ditë nga pak... Pra mu për këtë duhet të mbështetemi në forcat tona, ne na duhet mjete të mëdha materiale, e atyre që do të vinë tash së shpejti do t'u duhen edhe më shumë, prandaj ne duhet të bëjmë çdo gjë që ta sigurojmë një bazë solide materiale, pra të gjejmë mënyrë që edhe në kooperim me tjerët, të na dalë çdo ditë na diçka, sepse ndihmat janë shumë të vogla, ato janë tmerrësisht të vogla, shokë... Mungon organizimi do të thoshim, natyrisht se mungon, por ne nuk po mund të arrijmë kudo, përndryshe janë minimum 70 000 mërgimtarë shqiptarë, pa llogaritur mërgatën... dhe vetëm nga një markë në muaj po ta jepnin mjafton, por ne nuk po kemi mundësi që të arrijmë te të gjithë, e dikund ndoshta edhe po e teprojmë...

Ka shokë që nuk po e paguajnë anëtarësinë fare (ta marrim p.sh., celulën Arbëria, që nuk është vetmja...). Ndihma mund të japin njerëzit e paorganizuar, përndryshe të organizuarit duhet ta japin anëtarësinë dhe në këtë drejtim ne duhet të jemi edhe më të kujdesshëm në të ardhmen... Sidomos botimet dhe aktiviteti brenda po kërkojnë shpenzime të mëdha... Tash organi botohet në 6000 copë, ndërsa nuk shiten prej tij as 1000...

Kur thotë Ilazi se nuk bën të dihet se me të holla të punëtorëve do të hapim ekonomi, natyrisht një gjë e tillë nuk guxon të dihet fare prej askujt, fundja ne duhet të mësohemi përfundimisht që të mos na i di askush këmbët. Po shkojnë njerëzit dhe po flasin në emër të L., thotë Ilazi. Të gjithë e dimë se me emrin e Lëvizjes po manipulohet dhe kjo gjë do të bëhet edhe në të ardhmen, por njerëzit e tillë do të demaskohen me të gjitha mjetet bile. Po këtij avazi i bie edhe Sadik Tolaj, letrat e të cilit i lexova me vëmendje... Kur është në pyetje ky njeri më duhet të them këtë: kam dëgjuar fjalë të mira dhe të këqija për këtë njeri. Në mërgim preferohet të njollosen njerëzit dhe ne nuk guxojmë të bëhemi kurrë burizanë thashethemesh. Absolutisht, por në mes veti duhet t'i analizojmë mirë e mirë njerëzit ... ...pravi se tosho, apo izigrava budalu, pra mbarohet shumë naiv dhe pyet për gjëra të cilat ai i di më mirë se ne. Po ai njeri e ka fakultetin, ju lutem. Por në letrat e tij unë kam vërejtur rregullisht se ai përpiqet të dijë për shkallën e unitetit në mes nesh, për atë se në këtë moment çka është më e rëndësishme për ne. Çdo letër e tij është përplot grepa në dukje të parë, të maskuar fare mirë me kureshtjen e njeriut të padjallëzuar, që do të di esencën e neve që bota mendon se jemi "bog i batina". Si ky, si Reshati shkruajnë shpesh dhe gjithnjë të njëjtat pyetje. Vallë paska nevojë t'i mbajmë ligjëratë qoftë njërit qoftë tjetrit për unitet atje? Po ata e dinë fare mirë se çka duhet të

bëjnë, prandaj mu për këtë unë po u shkruaj tash, po ju shkruan tjetër kush. Vetëm në dy letrat e tij që m'i dërgoi Ilazi unë kuptova shumëçka, se çka po do ai njeri: ai është jetikisht i interesuar të mas shkallën e unitetit tonë. Qëllimi i letrave të tij është ky. Ma merr mendja Ilazi duhet të merret me ata njerëz atje, por le t'i hap sytë shumë, sepse ai është terreni më i rrezikshëm për ne. Jemi në gjurmë të disa gjërave që unë kurrë s'kam mundur t'i marrë me mend. Në letrat që do t'ia dërgoj Ilazi ST duhet t'i thotë se Ujkani nuk është këndej për një kohë bukur të gjatë, le të ma heq qafe dhe le të përpiqet që ta ruaj unitetin në mes pleqve që u intereson më shumë emri i tyre dhe në mes të rinjve që ka çdo gjë në mesin e tyre. Sikur të ishte ai që duhet Sadiku, athua do të kishte nevojë t'i thuhet shkruaj për ZK? Po të shkruaj për Diellin si gjeti kohë vallë?

Edhe kur është në pyetje përgatitja teknike e organit, natyrisht se unë nuk kam qëllimin më të vogël ta monopolizoj punën në ZK, por thjeshtë në mungesë kuadrosh po më duhet t'i qorrojë sytë në lektorimin e shumëfishtë të gabimeve, sepse nuk po ka njerëz që meritojnë t'u falet një besim i tillë pa qenë të provuar mirë e mirë, sepse nesër ta bën si Nuhiu. Përgatitja grafike e teknike e org. për mua është torturë, por ja që po duhet gjersa të vihen në vijë edhe disa gjëra... Kuptohet se ka shokë që po më ndihmojnë dhe gjersa të përgatiten se duhet ata më duhet t'i grah kështu. Te njerëzit tonë po më mundon shumë mungesa e ndjenjës së përgjegjësisë, nuk mërziten fortë për lëshimet, nuk mërziten fort për kohën që humbin kot së koti e jeta shkon, ndërsa punët mbesin.

LOJA NUK DUHET VAZHDUAR

"Ndërkohë, në mënyrë të tërthortë mora lajmin se në fillim të dhjetor 1982, në Gjenevë do të mbahej një demonstratë. Ish-shokët e idealit nuk e kishin parë të arsyeshme të më njoftonin as për demonstratën, e as për mënyrën dhe kohën e udhëtimit. Mora rrugën i vetmuar. Udhëtova me tren. Arrita në vendin e caktuar ku do të mbahej demonstrata. Pasi i përgëzova shokët e Gjenevës, Ejup Ahmetin dhe Elfi Agushin, për organizimin e mirë të demonstratës, ata më takuan me Xhafer Shatrin, të cilit i kërkova bashkëpunim... edhe pse më premtoi me fjalë të „sinqerta“, **mjerisht me këtë takim përfundoi edhe bashkëpunimi ynë**!" (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f.54)

LOJA DUHET VAZHDUAR

Me Nuhiun po "letërkëmbejmë". Po na dërgon letra që po ia dikton AP (Abdullah Prapashtica-shën i red.) Përmes tyre po përpiqet me tërë qenien e vet ta kuptojë se çka e kemi ndërmend të ndërmarrim. Natyrisht, s'ka mundur të blejë asgjë dhe tash e ka qitur viçin (të gjitha letrat e tij janë shumë provokative) dhe po thotë hiç më pak se "Punëtorët" po i qetë ish-LNÇKVSHJ! Po kërkon takim me "përfaqësuesit e OMLK-s" (Po e përsëris, këtë po e bëj me keqardhje, që të mos ndodhë ndonjëherë të dalë diçka nga letërkëmbimi ynë...). Do t'ia kthej një përgjegje dhe do t'i them merri dy shokët e tu, pra Sk. (Skënderin=Xhafer Durmishin-shën i red.) dhe shokun në Turqi, dhe eja të bisedojmë...

Pra loja duhet vazhduar... ata duhet t'i tërheqim për gjuhe ngadalë ngadalë. Natyrisht pa ia përmendur kurrë "Punëtorët" ose fraksionin. Zotriun e tij, udbashin AP duhet ta lëmë le t'i lëpijë kockat... Për informimin që thotë Ilazi edhe unë pajtohem, pra shkurt të distancohemi nga ta, por, po që se ata do të dërdëllisin, gjë që sigurisht do ta

bëjnë, besomëni po pritoj shumë të ulem e të shkruaj për ata. Ata do të gëzoheshin një popullarizimi të tillë. Injoranca e "njeriut" nuk ka kufij. Për atë se ku po thirren edhe në PPSH, natyrisht kudo, sidomos në ata të Vjenës. Duhet të presim edhe një kohë e pastaj shohim e bëjmë. Ata duhet t'i mbysim me punë, me organ të fortë dhe me botime e shkrime të forta në ZK. Frikohem se një polemikë me ta do të ishte nënçmim i madh për ne. Ata duhet t'i ndëshkojmë me mospërfilljen. Kjo i qet prej taktit.

Përshëndetje revolucionare Xhema (Xhafer Shatri) (shtator 1983-shën i red.)
(Shënim i Xhafer Durmishit: Kjo letër më ra në dorë për herë të parë më 23 prill 2012; Nëntitujt "Loja nuk duhet vazhduar" dhe "Loja duhet vazhduar" janë të vendosur prej meje.)

46. Letër e Xhafer Shatrit në emër të Qendrës Ekzekutive, tetor 1983

të dashur shokë,

me pak vonesë po përpiqem të shkruaj lidhur me letrën e fundit të shokut Ilaz, nuk po zgjatem edhe gjithaq sepse edhe ashtu po kam shumë punë.

Letra është e gjerën dhe informuese, por disi kam përshtypjen se vuan nga ajo shtro e mos mbulo, pra vlojnë propozimet nga të gjitha anët, por në realizimin e tyre nuk bëhet asgjë. Sa i përket Programit të Lëvizjes do ta rregullojmë këtë çështje, por është e nevojshme që edhe Ilazi vet t'i jap propozimet e tij për Programin ashtu siç e ka bërë Salihu, pastaj të bisedoj edhe me Muhametin që edhe ai të thotë fjalën e tij. Këndej do ta angazhoj edhe një shok, ndërsa shokët brenda janë të informuar dhe diçka kanë bërë në këtë drejtim. Çështja e Programit Politik si dhe e Statutit do të rregullohet menjëherë, besoj në muajin e ardhshëm. Atë do ta botojmë në shumë ekzemplarë dhe do ta shpërndajmë sa më shumë që të jetë e mundur.

Propozimet e veta Ilazi le t'i dërgoj kah 25 tetor, së bashku me të Muhametit... Pastaj edhe për një çështje tjetër duhet të shprehem këtu. Është interesant se as Ilazi as Salihu nuk shprehin kurrë as mendimin e vetëm se si t'ia bëjmë me organin, të flasin për të metat dhe të bëjnë përpjekje që ai të jetë më i mirë, sepse asnjë gazetë nuk mund të jetë aq e mirë sa të mos mund të jetë edhe më e mirë nesër.

Çështja e këtyre propozimeve në erë mua po më mundon. Ne duhet t'i themi çështjet troç, pa asfarë zvarritjesh.

Kohët e fundit ka shkruar letër Enver Hadri, një letër korrekte, dhe thotë se nuk dua ta nxjerrë gazetën që ka mbajtur emrin Zëri i Kosovës dhe se në të ardhmen e ndiej veten si simpatizant i saj, kërkon që ne ta provojmë sinqeritetin e tij në vepër etj. Ia ktheva një letër poashtu korrekte, dhe i thash se hapi i tij është një gjë e rëndomtë kur dihet se i tërë populli është për atë që të gjithë shqiptarët e ndershëm ta japin kontributin e vet në kuadër të Lëvizjes dhe kështu në këtë stil...

Më vonë e dërgoi një qarkore që ua kishte ndarë shokëve të tij se e ka rasformuar organizatën e tij. Ndoshta ai ka pritur që ne të shkruajmë edhe në ZK, por këtë nuk e kam parë të arsyeshme.

Siç e dini kohët e fundit Prapashtica e kompani e kanë shpërndarë një kumtesë në të cilën flasin në emër të Lëvizjes, e përdhosin e shtrembërojnë komunikatën etj., pra punë në atë stilin e tyre. Me ata njerëz tash për tash nuk na konvenon të merremi. Këtë do ta bëjmë më vonë dhe gjithsesi, por duhet të kemi sa më shumë material dhe me një të goditur t'i shkapërderdhim si duhet.

Ata nuk paraqesin asnjë rrezik të madh përderisa nuk kanë mundësi të nxjerrin gazetë të fortë, gjë që nuk mund ta bëjnë kurrë, sepse për këtë duhet qëllimi i pastër para së gjithash, e ata nuk kanë qëllime të tilla.

Tash për tash kaq Përshëndetje vëllazërore Xhema (Xhafer Durmishi)

P.S. Për letërkëmbim jemi marrë vesh. Kjo dihet, ndaj duhet t'i respektojmë vendimet tona. Gazeta del tash një javë. Letrat tuaja dërgojani plakut në Redaksi se është andej pari.

(Shënim i Xhafer Durmishit: Kjo letër më ra në dorë për herë të parë më 23 prill 2012).

47. Letër e Xhafer Shatrit për Asllan Muharremin, Faridin Tafallarin e Xhafer Durmishin, 18 tetor 1983

Të dashur shokë (A.F. dhe S.) (A=Aliu=Asllan Muharremi, F=Faridin Tafallari, S=Xhafer Durmishi-shën i red.)

para disa ditësh e mora një letër nga A. unë nuk iu përgjegja me kohë ngaqë isha shumë i zënë lidhur me këtë tubimin në Gj. Ai propozonte që ta thellojmë organizimin dhe t'i japim atij një kahje vërtetë revolucionar. Po jetojmë në kohë të tilla që pa një organizim taman të themelshëm ku në çdo vend do të jenë kapilarët e gjakut tonë, ne nuk do të mund ta kryejmë kurrë atë që populli pret prej nesh. Sa i përket Z mund t'ju them se është bërë diçka. Ekziston K. për Z. (Komiteti për Zvicrën-shën i red.) dhe në disa rrethe K. e vendit, disa prej të cilave janë shumë aktive. Por disa jo, mirëpo kur po dalë nganjëherë dhe sidomos në një mbrëmje në Gj dhe po i shoh të gjithë ata djem të rinj të cilët unë nuk i njoh fare, po e shoh se nuk është arritur asgjë, sepse ka mundësi për organizim edhe shumë më të madh, shumë më masiv, sepse njerëzit janë të gatshëm të angazhohen në luftë. Tash edhe ndonjë ditë ne presim një forcim me kuadro për Z. dhe besoj se do të bëhet një punë shumë më e mirë.

Sa i përket org. në Gj. atje puna e parë që duhet ta bëjmë është që të formohet K. për Gj. tash për tash prej 4 vetësh (për këtë bisedova edhe me S. e F.) S.F.A. dhe M. Kelm. S le ta udhëheq. A të merret me çështje org. M. me çështje e propagandë dhe F. me çështjen e klubeve. Pastaj të nisemi nga ajo që të formohen K. e v. apo thënë më mirë në zgjedhjen e përgjegjësve për një regjion të caktuar. Këtu duhet të zgjidhen njerëz të besueshëm e të sprovuar dhe në as një mënyrë të mos mbështetemi vetëm në një njeri, sepse po u rritet mendja, por le të afrohet një rreth i tërë dhe ai le ta zgjedhë udhëheqësin e vet dhe t'u ngarkojmë njerëzve detyra që të mos rrinë kot, duke u nisur që nga komentimi i librave e tutje gjer te aksionet konkrete në të cilat do të provohen aftësitë, besimi dhe guximi i tyre, ndjenja e sakrificës etj. Ne duhet të ndërmarrim një ofensivë të tërë për organizimin e njerëzve dhe pastaj të punojmë me ta e të ngritemi së bashku me celulat. Mbledhjet me cel. duhet mbajtur bile njëherë në dy javë dhe për çdo mbledhje të caktohen detyra konkrete se duhet vepruar dhe çka duhet bërë gjer në mbledhjen e ardhshme.

Organizimi duhet të pësojë ndryshime kualitative, taman ashtu siç shkruante Aliu, ta ngrisim konspiracionin në shkallën më të lartë që të jetë e mundur. Dhe ta dimë se në kënd dhe sa mund të mbështetemi në kohët e vështira që do të vinë sigurisht. Pastaj të bëjmë përpjekje për intensifikimin e luftës brenda dhe të gjejmë mundësinë se brenda të dërgojmë material më me shumicë dhe me rreziqe më të vogla. Në një rast patëm biseduar me S. për një gr. që do të ishte në gjendje të fusë material brenda pa rrezikuar asgjë, por më nuk dëgjova se është bërë diçka në atë drejtim. Këtë punë tash njerëzit po e kryejnë me kokën në strajcë.

Përgjegjësit për një vend duhet të jenë nga 3 vet mendoj unë, të zgjedhur si duhet. Në M. (Mynhen) këtë duhet ta rregulloj vet A. Për Halilin më shkroi edhe S. ai është njeri

i mirë, këndej e ka djalin e axhës, pastaj edhe 3 fëmijë në burg, në gjendje shumë të keqe. Jam i sigurt se edhe ai do t'i ketë lidhjet e "veta", por duhet ta sqarojmë mirë se ZK vinë në Myn. në një vend dhe prej aty le të shpërndahen, s'ka lidhje e mbi lidhje., mirëpo është e nevojshme që për këtë ta sqaroj ngadalë A., sepse ai është njeri i vjetër. Një shok i tij R. më ka pëlqyer shumë ishte shumë aktiv. Pra zgjidhni në atë rreth një grup njerëzish dhe le të formohet K.V. por gjersa ta marrë të mbarën si duhet me të duhet të udhëheq gjithsesi A. Për celulat e njërit apo tjetrit prej tyre le të dij vetëm A. e asesi ata, sepse mund të lindin xhelozi të ndryshme e besa edhe të rrezikojmë edhe njerëzit. Por A. nuk bën të ndalet vetëm në një vend... por le t'i formoj celulat kudo që të jetë e mundur, por të merremi vesh, praktika po e tregon se besimin duhet t'ua falim vetëm atyre që janë të denjë për të. Po që se organizojmë celula dhe nuk punohet me to ne nuk do të arrijmë asgjë, ato do ta shohin se nuk është çështja serioze dhe vetvetiu do të ftohen. Edhe vetë Komiteti duhet të takohet sa më shpesh. Prej meje në këtë drejtim mos pritni ku me dit sa, sepse ZK po kërkon shumë punë. Edhe në këtë drejtim do të ishte mirë që S. dhe A. ta caktojnë nga një rubrikë dhe të shkruajnë rregullisht në të, pastaj në bisedë me njerëzit ne mund të vimë te lloj lloj informatash, ndaj seleksiononi mirë dhe dërgojini sepse në këtë mënyrë do ta bëjmë ZK edhe më të fortë.

Edhe lidhur me atë fraksionin do të ishte mirë që të mbledhim sa më shumë informata, t'ua dimë se ku i kanë njerëzit, prej nga janë dhe t'i përcjellim e t'i hetojmë pandërprerë në mënyrë që të kemi sa më shumë fakte për t'i demaskuar, edhe pse një gjë të tillë ne duhet ta bëjmë vetëm kur është më se e domosdoshme. Fjala fjalën nuk e mund kurrë, por nëse ne punojmë sa e si duhet, ata vetë do ta mbysin veten e tyre, por të jemi të kujdesshëm që të mos u japi material për të na luftuar. Të punojmë më shumë me njerëzit tanë, t'i sqarojmë dhe ta ngrisim te ata ndjenjën e përgjegjësisë.

Në Dys. duhet që M. ta formoj një K. V. me H. dhe me ndonjë tjetër dhe të punohet aty sa më shumë sepse jam i sigurt se Riza Salihu nuk rri duarkryq, ai ka kontakte me Musa Dakën, pastaj edhe në Bilefeld le të formohet dhe këtë le ta udhëheqë Xh., por dy shokët tjerë t'i zgjedhë sa më të mirë dhe ata le ta kontrollojnë dhe ta detyrojnë që para tyre të jap përgjegjësi. Përndryshe ai njeri është prepotent i papërmirësueshëm dhe njeri fjalësh.

Poashtu në Dortmund le ta bëjmë me S. (Sylën-shën i red.) Ai është njeri shumë i mirë edhe pse dikush po përpiqet ta njollosë. Ai e ka një rreth shumë të mirë shokësh.

Në Ber. janë do njerëz të mirë dhe këtë mund ta rregulloj Qa. i këtushëm kur të dalë andej ose disi të njohtohet vet S. apo A. me ta dhe ta rregullojmë çështjen.

Sa për simbolet jugosllave ne duhet të punojmë me njerëzit që ata vetë ta kuptojnë një gjë të tillë por ama kurrsesi ne të mos ia mundësojmë dikujt që duke u thirrë në ne t'i përçaj njerëzit. Kjo klimë me plotë pasoja është bërë sidomos në Bremen. Aty janë në pyetje Xhaviti e Zylbehari të cilit si njëri si tjetri kanë interesat dhe sujetat e tyre. Nuk janë ngushtë ata as për Lëvizjen as për popullin.

Në letërkëmbim me Mërgimin i kam thënë se dy shokë brenda duhet të kontaktojnë me njëri-tjetrin me qëllim që të koordinohen aksionet. Ai tha se Aliu duhet të ma jep emrin e Gjonit. Kjo është një çështje shumë serioze prandaj edhe ju mendoni në këtë drejtim se si dhe kend mund ta angazhojmë më shumë brenda që t'u nxjerrim sa më shumë punë. Ta rrahim hekurin sa është i skuqur sepse pastaj duhen dekada për ta sjellur një gjendje të tillë.

Tash këtë muaj pritet ta kemi një demonstratë në Fr. por lejen nuk e kemi marrë akoma. Do të ishte mirë që Aliu ta përgatisë referatin që duhet lexuar para dasmorëve. Le të jetë një punim aktual dhe i fuqishëm.

Prandaj që tash të nisim ta propagandojmë domosdoshmërinë e një demonstrate pa e përmendur askund konkretisht, por ashtu përgjithësisht që ta përgatisim masën që t'i përgjigjet thirrjes sa më masovikisht.

Tash për tash kaq.

18 tetor 1983 Përshëndetje revolucionare (Xhafer Shatri)

48. Letër e Xhafer Shatrit për Asllan Muharremin, 24 tetor 1983

I dashur shok Ali,

E mora letrën tënde si dhe punimet. Me të gjitha jam shumë i kënaqur. Më vjen shumë mirë që ke dalë këndej, besoj se do të kontribuosh shumë në konsolidimin e radhëve, sidomos propozimet tua për brenda janë me vend, dhe më duhet të them se nga ai krah ky është një propozim i një njeriu që di fort mirë se çka duhet të bëjmë brenda, atje në frontin kryesor të luftës. Edhe për makina jam i pajtimit me ty, ato duhet të jenë dy ose më shumë, por tash për tash vetëm dy. Meqë ti ke kontakte me brenda pa u takuar nuk ka nevojë të bisedojmë për atë shokun brenda. Dije mirë se letra jote më ka ardhur në një gjendje të vështirë shpirtërore kur më erdhën lajme për një burgosje shumë të rëndë, për një dëmtim shumë të madh për ne, por më ndihmoj ta kaloj, prandaj edhe njëherë të faleminderit.

Sa për Stras. Do të ishte shumë mirë që të dalësh edhe ti, por të maskohesh mirë me ndonjë kasketë dhe ta lexosh referatin para popullit. Unë besoj se me shokët do të dilni lehtë me autobus.

Përpiqu që ta organizosh sa më mirë që të jetë e mundur ardhjen e shokëve. Referati le të jetë aktual për gjendjen në Kosovë, për shtypjen dhunën e terrorin dhe përplot thirrje për Lëvizjen me qëllim që ta popullarizoj Lëvizjen sa më shumë.
Sipas praktikës së këtushme brenda çdo kryerreshti të gjatë duhet të jetë një thirrje si p.sh. Poshtë dhuna e terrori në Kosovë etj.

Edhe leximin e referatit ushtroje që ta lexosh sa më mirë e sa më qartë dhe përfundimi i tij le të jetë po ashtu me thirrje që janë aktuale për gjendjen në Kosovë.
Punimi për ushtarët ishte shumë i mirë dhe do ta botojmë gjithsesi. Të lutem që edhe në të ardhmen kur të vinë apo kur të kesh informata të tilla dërgoji sepse ato e bëjnë organin sa më aktual. Për çdo siguri referatin jepja Halilit se mos po të bastisin apo të zbresin në kufi. Kështu që mbesim pa të. Sikur të ishe këtu ne do të të qitnim pa vështirësi të mëdha, po megjithatë besoj se me autobus do të kalosh po ashtu mirë. Mundësisht dil pak ma herët që të kemi mundësi të rrimë e të bisedojmë, edhe pse atje do të jetë tollovi e pashoqe.

Tash nuk po e zgjas më shumë, por urdhëro edhe ti me shokët pranoji përshëndetjet e mia vëllazërore U., (Xhafer Shatri) Egsil, 24 tetor 1983

49. Letër e Xhafer Shatrit për Asllan Muharremin, tetor 1983

I dashur shok,

Më në fund u vendos që edhe sivjet ta organizojmë një demonstratë të madhe këtu në Evropë. Kjo është kërkesë e madhe sidomos nga brenda prej popullit, i cili është në pozitë të vështirë për shkak të rritje së dhunës e terrorit shovinist, prandaj përpiqu që kudo përmes shokëve dhe të njohurve ta shpërndani këtë thirrje, të mos leni mundësi dhe rast pa shfrytëzuar që të organizoni sa më shume njerëz të vinë.

Nëse dikush ka mundësi, sidomos nëpër klube e gjetkë, të organizojë recitale, referate etj. le të punojnë në këtë drejtim, sepse është rezervuar edhe një sallë solide ku do të takohemi pas manifestimit. Është obligim patriotik i juaji që kudo që të keni mundësi

të thirrni njerëz në këtë dasme, sepse edhe në opinionin evropian ekziston një interesim i madh për gjendjen në Kosovë.

Interesohuni që me shokë të merrni një autobusë, të vini të gjithë së toku, dhe të përpiqeni që gjatë dasmës të mbahet qetësi dhe rend pa eksesin më të vogël, sepse edhe udba duke iu frikuar një manifestimi të tillë sigurisht se do të përpiqet të na pengojë në rrugën tonë të ndritshme, por në saje të vigjilencës sonë, të organizmit të mirë dhe të qëllimit të pastër, padyshim se të gjitha përpjekjet e armikut do të bien në ujë.

Pra mirupafshim në Strasbourg të Francës!

Zëri i Kosovës (Xhafer Shatri)

50. Letër e Xhafer Shatrit për Remzi Ademin, 3 nëntor 1983

I dashur shok,

atë mbrëmje që të premtova se duhet të shihemi me atë shokun tonë, unë nuk mund të vi me kohë, sepse më rastisi të takohem me një shok që nuk e kisha parë me vjet dhe bisedë pas bisede mbeta gjer vonë, kur u ktheva ju asnjë nuk ishit aty.

Prandaj po të drejtohem me këta rreshta dhe po të kërkoj falje si ty dhe bacës Avdirrahman, të cilit po ia shkruaj një letër të shkurt sa për të rënë në kontakt me të drejtpërsëdrejti.

Letrën e atij shokut ta vonova, por besom se kam qenë aq i zënë sa as frymë siç thonë plakat s'kisha kohë për të marrë sa duhet.

Atje si jeni të gjithë dhe si po shkon puna, si është puna me Remziun dhe me rrethin e tij atje. Do të ishte mirë që t'i ndihmoni pak më shumë sepse ai është si vetëm atje dhe t'ia krijoni së bashku një rreth të fortë shokësh që të mund t'i kundërvihen me sukses atij farë llymit të N.

Në këtë drejtim keni kujdes dhe mos pritni që të vinë njerëzit te ju, por t'i vizitoni edhe ju duke shkëmbyer përvoja në mes veti.

E thash këtë sepse Ludvigsburgu, Mahajmi dhe Frankfurti na kanë mbetur më së keqi.

Jam i interesuar të di për njëfarë Mehmetin, dikun i anës së Lumthatit, që punon në Munhen, merr informata për te dhe më shkruaj sa më parë.

Ti dhe shokët, pranoni përshëndetjet e mia të përzemërta.

3 nëntor 1983 Bcl (Bcl=Bacaloku=Xhafer Shatri)

51. Letër e Xhafer Shatrit për Remzi Ademin, 7 nëntor 1983

I dashur shok,

po të lajmërohem me këta rreshta, sepse, besomë, kam qenë shumë i zënë, pastaj numrin tënd të telefonit e ka humbur dikund, kështu që sake qenë brenda nuk kam mundur t'i lajmërohem as familjes tënde, mirëpo më mirë vonë se kurrë siç thotë populli, prandaj në pamundësi që të vi dhe t'ju shoh, ashtu siç është adet ndër shqiptarë, të lutem që përmes këtyre rreshtave të pranosh urimin tim për lirim nga ai farë qymezi gjerman.

Besoj se keni kaluar mirë, përkundër asaj se ai nuk është aspak vend i mirë. Mjerisht na kanë mbetur edhe disa shokë brenda, por ani, sepse ajo punë i ka dhënë publicitet të madh luftës sonë, merre me mend kanë shkruar gazetat sikur ajo të ishte një demonstratë e madhe.

Po familjen si e ke, dhe prej shtëpisë a ke ndonjë lajm?

Ato ditë në Strasburg të pashë me Maksin, por nuk pata mundësi të të lajmërohem dhe bile të të them që atij të mos ia qelësh atë punën e atyre shokëve brenda.

Këndej nuk ka ndonjë gjë të re, përgjithësisht 28 nëntorin e kemi festuar mirë.

Tash në fund të kësaj shkrese të lutem që ti me shokët t'i pranosh përshëndetjet e mia më të përzemërta.

BCl (BCl=Bacaloku=Xhafer Shatri)

Adresën po e marrë nga një paradërgesë e mëparshme

7 nëntor 1983

52. Letër e Xhafer Shatrit për Asllan Muharremin, 22 nëntor 1983

I dashur shok,

Për shkaqe të njohura edhe për ty unë ta vonova përgjigjen në letrat tua. Kësaj radhe nuk do të zgjatem, por besomë se kurrë nuk kam qenë në një pozitë më të keqe. Por si shumë herë në jetën time, edhe kësaj radhe u binda me fakte se e vërteta dhe drejtësia fitojnë kurdoherë.

Më gjatë nuk po shkoj kësaj radhe. Lidhur me këtë çështje po e pe të arsyeshme , unë do të t'i dërgoj trakat e manjetofonit të atij takimi... Në fund të falënderoj përzemërsisht për fotografinë që më ke dërguar. Ajo është edhe një dëshmi, se kam të bëjë me një shok, me kualitete morale të të cilit mund të llogarisë populli gjithnjë. Kaq... Pranoji përshëndetjet vëllazërore e revolucionare të U., (Xhafer Shatri) Mërgim, 22 nëntor 1983

Shtojcë. Si do që të vie puna, mos lejo që të H. të dalin fjalët që janë thënë këndej. Ne nuk guxojmë t'luajmë me besimin e patundur të popullit në Lëvizje. Ai është urdhëruar që për çdo gjë të konsultohet dhe të veproj sipas udhëzimeve tua.

53. Letër e Xhafer Shatrit për shokët e Komitetit Qendror (me përjashtim të Xhafer Durmishit), 19 prill 1984

(Dukagjini=Komiteti Qendror i Lëvizjes-LRSHJ)

Shokëve të Dukagjinit,

përkundër asaj e vendosëm të shihemi krye një muaji, megjithatë ne s'u pamë. E ngjarjet u rrokullisën me shpejtësi të madhe. Rasti i Dyseldorfit është barometri më i qartë se gjer ku ka shkuar puna. Kur tre anëtarë të një forumi të tillë janë prezentë dhe me punë tregojnë se çfarë "uniteti" kanë, atëherë nuk duhet befasuar pse punëtorët theren mes veti me thika.

Fehmiu përmes Komisionit ka treguar se si e ka parë tërë ngjarjen. Këtë e ka bërë edhe Ilazi. Salihu s'u bë i gjallë. Nuk e di pse. Kanë ardhur shumë letra në të cilat përmenden emra që ata i demaskojnë pa asnjë mëshirë. Çështja pra është shumë serioze. Po shpërndahen trakte të ndryshme përmes të cilave shpifet dhe dekonspirohen njerëzit. Me çka mund të kuptojmë se nënshkrimet e Salihut në dokument paskan qenë asgjë. ne kemi heshtur për hirë të masës nuk kemi dashur dhe as që duam të shfrytëzojmë rastin për të sulmuar ata që me vepër po tregojnë çdo ditë se nuk janë për punë, por për thikime prapa shpine. Të cilët mburren me punët e të tjerëve dhe në çdo hap të vetin minojnë Lëvizjen.

Pa e dëgjuar edhe fjalën e Salihut lidhur me të gjitha këto çështje ne nuk do të marrim asnjë qëndrim.

Pra ne po e presim edhe fjalën e Salihut (Xhafer Durmishit-shën i Xh. D.)

Përshëndetje revolucionare Xhema (Xhafer Shatri)

19 prill 1984

P.S. Ne nuk guxojmë të heshtim në këtë situatë kur masa kërkon sqarime.

(Shënim i Xhafer Durmishit: Kjo letër, edhe pse kam qenë anëtarë i Dukagjinit (Komitetit Qendror) me vendimin e mbledhjes së 3 marsit 1984 në Gjenevë nuk më është dërguar në vitin 1984. Për herë të parë kjo letër më ra në dorë më 23 prill 2012).

54. Letër e Xhafer Shatrit për shokët të Shtutgartit, 1 maj 1984

Të dashur shokë,

mbrëmë bisedova me Faredinin dhe më tregoi për dëshpërimin tuaj në Dyseldorf. Më besoni se edhe unë kam qenë në lëkurën tuaj, por mërgimi qenka shumë i rëndë. Këtu nuk paska fjala peshë. Të shtunën unë kam biseduar me një shok në Dyseldorf. Kishte fjalë të mira. Pastaj bisedova edhe me Plakun dhe ai foli me të plagosurit. Edhe ata e sidomos Syla patën fjalë të mira. Duke u nisur nga kjo e pash të arsyeshme që t'u shtrihet shokëve sa më parë dora e pajtimit. Ju nga ana juaj e keni bërë tuajën, pse dikujt nuk i ka konvenuar kjo është tjetër çështje. Dhe nesër po që se ndodhë diçka dihet se kujt do t'i mbetet përgjegjësia. Kujt iu kujtuar që në këtë çështje ta përziej Lëvizjen si dhe të gjithë atyre që duan të bëjnë shesh për përshesh në këtë situatë kaq të rëndë do t'ua bëjmë me dije, me punën dhe përpjekjet tona të përditshme se i kanë bërë hesapet pa hanxhiun. Prandaj mos u dëshproni, me Musain mbani kontakt parreshtur dhe pos jush mos të kërkoj ai as mësues e as shokë tjerë, sepse do ta qesin në pozitë edhe më të keqe. Thuani le ta ruaj gjakftohtësinë dhe të mos flas me askend tjetër pos me juve për këtë çështje. Herëdokur të vie pajtimi, në mes fjalësh nuk mund të jetë dikush tjetër pos jush. Mu për këtë, prandaj mbajeni Musain afër, këshillojeni, sepse ata që e kanë penguar pajtimin, të jini të sigurtë nuk do t'u dalë e tyrja, sepse jo vetëm juve, por edhe neve na kanë pre në besë.

Armiku memzi po pret të fus pyka në këtë mjegull që e kanë krijuar ata që janë ushqyer me bukën e punëtorëve tanë zemërbardhë e duarplasaritur, prandaj si këta të parët që e kanë nxitur këtë kasaphanë, si këta të dytët që nuk lejojnë të shtrihet dora e pajtimit mes vëllezërish, do të pësojnë disfatë të turpshme para vullnetit të shokëve që kanë lënë shtëpi e familje, dhe janë në gjendje ta lënë edhe kokën për lirinë e popullit.

Prandaj mos u mërzitni, me ata shokë që i keni përreth rrini më shpesh, konsultohuni në mes veti, kijeni parasysh se e tërë kjo mjegull nuk është bërë për tjetër veçse ndonjë hesap i Serbisë t'i ngul dhëmbët në gjak shqiptari. Qoftë edhe një hap apo ndërmarrje të vetme mos e bëni pa u konsultuar me shokët e atyshëm, sidomos me Hafizin, me Musën (të riun) etj. Ta keni parasysh se ne, kështu siç jemi, që të gjithë jemi me ju, sepse keni shkuar në Dyseldorf me qëllimet më të pastra e më fisnike.

Në këtë situatë më shumë s'po mund të bëjë, veçse përmes kësaj letre t'ju përshëndes përzemërsisht.

Të fala shokëve, Bacës Selim, Lutanit, Ismetit dhe të gjithë shokëve tjerë.

Zvicër 1 Maj 1984 B.cl (B. cl është shkurtesë për Bacalokun, emër apo titull i përdorur nga Xhafer Shatri)

55. Letër e Xhafer Shatrit për Ibrahim Kelmendin, 1 maj 1984

Me asnjë kusht nuk do t'i shkruaja këta rreshta, sepse më me dëshirë do të takohesha me ty dhe do të bisedonim gjerësisht, sepse e tërë ajo që dua të them, as përciptazi nuk mund të përfshihet në një letër. Por mbrëmë bisedova me Faridinin, me shokun tonë të mirë, dhe dëshpërimi i këtyre njerëzve të ndershëm që kanë udhëtuar më shumë se 1000 km për ta bërë mirë dhe sjellja jote arrogante ndaj përpjekjeve të tyre po më detyrojnë të them troç: Ti je i papërmirësueshëm. Ti përgjithmonë ke mbetur mbreti i rrugëve, i mospërgjegjësisë dhe i thashethemeve.

Së pari nuk denjove të shkruash për ngjarjen si ka ndodhur në tërësi, por një letër plot panik "me shyqyr që mbeta gjallë." Për atë që është në dijeni të gjërave më mirë ka qenë që ti të mbetesh aty, bile do të qanim... E unë e di mirë se nëse Skënderi është fajtori kryesor që i nxiti punëtorët tanë t'ia fusin thikat njëri-tjetrit, atëherë ti je ai që me tërë forcën tënde ke kontribuar të krijohen kushtet për një atmosferë të tillë. Ti vetë më ke gënjyer në pyetjen time se a ke biseduar me Faridinin lidhur me mbrëmjen e 7 prillit dhe më ke thënë po, e kjo nuk kishte qenë e vërtetë. Madje jo vetëm kaq, por ke shkuar aq larg, sa agjutanti yt, Muhameti, të cilin me çdo kusht po përpiqesh ta mbash nën hijen tënde të mjerë, ka thënë Lëvizja është ku janë masat. E ajo s'ka qenë e vërtetë, sepse Lëvizjen aty e keni përfaqësue ti dhe Faredini e jo masa. Ashtu siç më ke thënë ti, duke të besuar, se njeriu dreqi e marrtë duhet t'u besoj njerëzve, unë e shkrova traktin. Dhe në atë e kam përmendur, sipas asaj që më the edhe 5 vjetorin e themelimit të Klubit. Sepse sipas teje "s'është dashur të rrezikohet Muhameti në Bohum." Merre me mend ti interesat e një njeriu i vë mbi interesat e 200 e sa të tjerëve. Po kush është Muhameti të rrezikohet? Po atëherë pse ka dalë këndej? Si është e mundur të përmendësh gjëra të tilla? I lëmë këto. Pastaj si ke guxuar ti t'i telefonosh Mujës që ta dërgoj telegramin për ta përflliqur traktin që ishte shpërnda anë e kënd Evropës? Me çfarë të drejte manipulimet e tua të ulëta prej një mediokri prepotent përpiqesh në sy të 600 njerëzve, të m'i hedhësh mua (sepse njerëzit e dinë se prej ku është dërguar trakti)? Pse nuk telefonoje te Plaku apo te unë dhe të na thuash neve, që kemi qenë parreshtur në banesa, por e ke gjetur Mujin, po ashtu shokun tonë të mirë dhe ke manipuluar me të.

Jo vetëm kaq, por siç del edhe nga procesverbali i BK, ti i ke thënë Musa Dakës "myzevir" që pa nisur kjo punë, sepse për fjalë ti zakonisht je i zoti, prandaj, mos u mbaro si Pilati para askujt, bile jo para atyre që e dinë punën fare mirë. Unë Musain nuk e shoh si vëllavrasës, ai është një viktimë, së paku nga kjo perspektivë, e sharlatanizmit tënd, pafytyrsisë së Skënderit dhe karrierizmit të Milaimit. Dhe kur ne në pamundësi të kontaktojmë me ty, i çuam disa shokë shumë qëllim mirë, që t'i vënë kapak kësaj pune, që të mos lejojnë më gjakderdhje, që të mos lejojnë të fusë armiku pyka, sepse ti nuk je aq budalla të mos e dish kush dhe pse po shpërndan trakte, në të cilat të përziejnë edhe ty. Dhe vijnë njerëzit atje e ti je aq i pacip, sa që një Sylë e Haxhi që të mbrojtën me trupin e tyre, dëshiron t'i bësh lodra të kapitalit tënd të mjerë politik. Po të m'i kishe dërguar gabelët e Pejës për një pajtesë unë nuk do t'i ktheja prapa. Ti me çdo kusht ke dashur të përziesh Lëvizjen dhe përmes petkut të saj të akuzosh kundërshtarë të ndryshëm. Njeriu nuk guxon të hipën mbi popullin e vet për t'u dukur më i madh as më i pastër. Dhe i kthen njerëzit, shokët tanë të mirë, pa kryer asgjë, bile edhe i keqpërdor. Për tërë këtë përgjegjësia bien mbi ty.

Nuk je ti aq injorant, siç preferon të mbarohesh kur ta kërkon puna, e të mos e dish se në këtë çështje nuk guxon të përzihet çështja-lufta. Në këso situatash i duhet vënë kapak punës, sepse do ta shpëtoje edhe Musain nga kthetrat e merimangave të tipit të Skënderit, sepse në emër të tij nuk kanë ardhur rrugaçë, por njerëz, të cilëve Musa Daka

nuk do të guxojë t'i luaj kurrë. Sepse që të gjithë ata janë njerëz të familjeve të ndershme që nuk luajnë me dikë, por as që lejojnë dikend të luaj me ta. Ata kanë ardhur nga qëllimet e pastra, ata janë konsultuar me ne. Plaku ka biseduar me shokët e plagosur, që të dy kanë treguar gatishmëri për ta bërë mirë. Por ti, që këso rastesh i pret si shkretira shiun apo si bora, ke shkuar aty dhe si njeriu i Lëvizjes ke dashur të bësh gjyq e ligj. Ti ke pasur rastin të tregohesh burrë, t'i shtish njerëzit të pajtohen dhe ta vrasësh një zagar të fëlliqur siç është Skënderi, me pjekurinë tënde, por edhe këtë rast e ke shfrytëzuar të tregosh se je kampion absolut i mospërgjegjësisë dhe meskinitetit.

Nuk po dua të çaj dërrasa më me ty, por po dua të përfundoj: Nëse atyre njerëzve sot apo nesër u ndodh diçka, nëse ata njerëz ndërrojnë në mes veti qoftë edhe një fjalë të keqe, apo po që se këtë atmosferë të rëndë e shfrytëzon armiku në çfarëdo aspekti qoftë, dije mirë se faji të a mbetur ty dhe poashtu dije mirë se unë do të kujdesem që t'i njoftoj njerëzit për atë se kush është shkaktari kryesor.

Nëse vjen gjer te pajtimi, në mes fjalësh nuk guxon të ketë njeri tjetër, pos atyre që kanë qenë gjer aty, sepse fjalëve të tyre Musa Daka nuk mund t'u luaj kurrën e kurrës.

Letra mos më shkruaj dhe ki kujdes e të mos ndodhë më kurrë që të përdorësh letrat me stemën e Lëvizjes për t'u treguar njerëzve "kompetencat" e tua. Janë disa raste që i di mirë, që ti i ke keqpërdorë këto letra.

Edhe sa për të më shkruar mos u lodh, sepse pas kësaj unë kurrë s'do t'u besoj fjalëve të tua.

Xh. (Xhafer Shatri)

(Faridin Tafallari, T-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 417-419)

56. Letër e Xhafer Shatrit në emër të shokëve nga Zvicra, 29 qershor 1984

Xhafer Shatri për shokët e rrethit të Stutgartit

Të dashur shokë

ka disa ditë që na ka ardhur letra juaj, një letër e shkruar me shqetësim për rrokullimën që kanë marrë ngjarjet, për të cilat sigurisht se jeni në dijeni fare mirë. Ne nga ju kemi pritur letër edhe më parë, por një letër me qëndrime të qarta revolucionare, një letër çfarë pritet ta shkruajnë shokët e Jusufit.

Ne e analizuam letrën tuaj, e analizuam mirë e mirë dhe mund të merrni me mend se na qiti në dilemë jashtëzakonisht të madhe. Ju i citoni fjalët e famshme të Hasan Prishtinës: Bashkim e jo përçarje, luftë e jo fjalë. Po ju pyesim shokë, kush e prishi bashkimin? Kush i theu rregullat elementare të Lëvizjes, kush i bëri sekretet e saj dhe i qiti rrugëve në Evropë sikur ato të ishin paçavër bordelesh? Kush shpërndau trakte kundër bashkëluftëtarëve, duke u shërbyer edhe me eksponentë të mërgatës së qyqeve? Kush inicoi që në emër të Lëvizjes të dalin gazeta, të cilat i nxjerrin emisarët e emigracionit reaksionar që janë në shërbim të dreq merre vesh se shërbimeve informative të botës? Ne, shokë, nuk e bëmë këtë, nuk e bëmë asnjërën prej tyre. Ne, shokë, për hir të bashkimit, për hir të unitetit ua shtrimë dorën e bashkëluftimit edhe atyre, që nuk kishin dalë në Evropë për ta ndihmuar popullin e vet por për të luftuar për

Mehmet Hajrizi: *"Fillimisht duhet thënë se organizimi në Shqipëri i Luftës Nacionalçlirimtare, që për veprimtarët e kohës, në saje të literaturës që vinte nga Shqipëria, ishte në detaje i njohur, u bë modeli më i afërt, për ta zbatuar në kushtet e çlirimit të Kosovës. Atje ka pasur*

një Front Nacionalçlirimtar, që bashkonte forcat antifashiste të bindjeve të ndryshme, por Partia Komuniste në të ***RUANTE ROLIN HEGJEMON."*** *(*Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 97)

kolltuk e ballë të oxhakut, e kemi bërë këtë për të mirën e përgjithshme dhe nuk na vi aspak keq, sepse baza, masa e mërgimtarëve jashtë dhe masa e popullit në Kosovë, atje ku është fronti kryesor i luftës, ishte për bashkim e jo për përçarje, ishte për luftë e jo për fjalë. Për ta kryer këtë porosi të popullit, për t'u treguar bij të tij të denj ne u ulëm të bisedojmë dhe të bashkojmë armët edhe me njeri që ia kishte përplasur për toke fotografinë një njeriu që e kishte vrarë udba dhe i cili me shokët e vet ishte bërë idol i tërë rinisë kosovare. U ulëm të bisedojmë edhe me njerëz siç është Mërgimi, për të cilin kishim fakte të padiskutueshme se ashtu si sot, që kur marshonim me kaq shpejtësi na përçau kaq poshtërisht, po ai Mërgim kishte bërë përpjekje t'i përçajë Jusufin e Kadriun, duke u shërbyer po me mjetet e sotme, me shpifje e intriga të ulëta që nuk i bën kurrë një njeri që i thotë vetes burrë.

Ju të dashur shokë, i qitni në të njëjtën vagë gjykimi qarkoret që i shpërndante Musa Hoti, Skënderi, Mërgimi e Haxhiu me kompani ashtu tinëzisht prapa shpine me njoftimin që e botoi Zëri i Kosovës, me aprovimin e shumicës së njerëzve që kanë udhëhequr me luftën brenda e jashtë. E këto gjëra nuk qiten në një kandar, shokë. Nuk ka mbetur që punët tona të na i bëjë një kriminel e spiun i shumëfishtë siç është Musa Hoti. Ne një gjë të tillë nuk do ta bënim kurrën e kurrës. Ne nuk do të lejonim që llapanxhozët e Brukselit që nuk kanë as besë as nder të nxjerrin gazeta dhe në to të përdhosin emrin e Lëvizjes dhe varret e shokëve që me gjakun e tyre i dhanë luftës sonë një shtytje kaq të madhe. Nga letra juaj shifet se ju keni qenë të nxitur në një hap mu nga ata që e kanë sjellur situatën në këtë shkallë. Dhe megjithatë, për hir të luftës që e kemi bërë bashkë ne qemë për atë që të ulemi dhe me fakte t'i bindim ata që as pas të gjitha këtyre nuk paskan mundur ta kuptojnë se kush është për fjalë e kush për luftë, kush për bashkim e kush për përçarje, se kush çka ka bërë gjer më sot, kush po e prish bashkimin dhe përse. Por po këto ditë, po na vijnë fjalë nga njerëz që janë në dijeni të të gjitha këtyre, se Ata nuk qenë të punës. Në kohën kur ne të gjithë shqetësoheshim e përpiqeshim për të tundur Strasburg, Bern e Gjenevë ata thurnin këto plane që sot po i vënë në jetë. Në kohën kur ne shkruanim trakte për të organizuar demonstrata në Nju-Jork e Çikago Musa Hoti, Mërgimi e Skënderi e bënin të kundërtën, tërë natën nuk flinin për t'i sabotuar ato. Gjersa ne u dërgonim shokëve materiale për të demonstruar në Australi dhe për t'ua dorëzuar autoriteteve të vendit, Mërgimi e Skënderi me shefin e tyre, agjentin e dëshmuar të UDB-së, Musa Hotin, dërgonin letra e telegrame për të na fyer e për të na njollosur. Këtë vetëm armiku e bën e askush tjetër.

Këta kurrë nuk i shqetësoi ajo se si të fusim material brenda, se si ta ndihmojmë luftën, këta nuk u shqetësuan të ndihmojmë shokët që jetonin në ilegalitet e që e propaganduan aq shumë Lëvizjen, por mu në kohën kur prisnin ndihmën tonë, ata ilegalë të famshëm të Kosovës, na doli një horr i poshtër si Mërgimi dhe nisi të na fyej e të na poshtërojë vetëm e vetëm që të humbim torruan dhe t'u nënshtrohemi poshtërsive të tij. Të gjitha ato shpifje që janë endur pas rënieve të shokëve ne na i ka vërtetuar Mërgimi me gojën e tij se vet ka qenë burimi i tyre. Dhe kur e pa se nuk u nënshtrohemi budallëqeve të tij por jemi për luftë të mirëfilltë, për punë e jo për fjalë ai ndërroi pllakë dhe nisi të akuzojë me shpifjet më të paskrupulla që mund t'ia dëgjoj sot veshi njeriut.

Përkundër të gjitha këtyre, për hirë të masës së gjerë të shokëve duarplasaritur që nuk kursyen as familjet, as fëmijët e tyre, as shtëpinë, ne ishim për takim, për bisedime në nivel në mënyrë që të binden ata njerëz që meritojnë të jenë në dijeni për disa gjëra se ku qëndron e vërteta, por pasi që edhe propozimi juaj që ne mendonim se është sekret doli nëpër tërë Evropën dhe tani dinë për të edhe ata që kushdo e di se janë vegla të armikut atëherë çfarë vlere edhe mund të ketë një takim i tillë?

Në këso rastesh preferohet t'u thuhet shokëve mos u mashtroni, mos lejoni të luhet me ju, me emrin tuaj se do të turpëroheni se nuk do të shkojë larg dhe t'u vie turp se vegla të kujt jeni bërë me dashje ose pa të. Ne nuk po e bëjmë këtë, qëllimisht nuk po e bëjmë. Veproni ashtu si ua merr mendja. Ne nuk e kuptojmë luftën si tuxharë, të "blejmë" njerëz, e të shantazhojmë ata, kjo nuk është në natyrën tonë.

Prandaj sa i përket propozimit tuaj për takim. Ne jemi për takim-sqarim me shokë lufte me të cilët na lidh lufta e ideali i përbashkët, me njerëz që me vepër kanë dëshmuar se janë për luftë e jo për fjalë, që janë për bashkim e jo për përçarje. Prandaj, në pamundësi që të vimë vetë, jemi pa dokumente, plaku është i sëmurë, etj. do t'ju luteshim që ju si shokë apo rreth t'i zgjidhni dhjetë shokë dhe të vini, të mblidhni të gjitha faktet që keni ju apo dikush tjetër kundër nesh dhe të na i thoni hapur, ne nga ana jonë do të përpiqemi t'ju bindim se jemi shokë që nuk i frikësohemi as armikut dhe as shpifjeve që i lëshojnë nëpër botë zagarët e tij.

Ne ju presim të vini, pra dhe shpenzimet do t'i ndajmë përgjysmë. Ejani kur t'ua merr mendja, kënd të vendosni ju si shokë ta dërgoni.

Me zgjedhjen e shokëve, ju lutem të keni kujdes, sepse ne nuk dëshirojmë, ashtu si edhe gjer më sot t'i bëjmë sekretet e Lëvizjes shesh për përshesh. Pra dëshirojmë të sqarohem të tilla. Ka shumë çka për të shkruar, ka shumëçka për t'u thënë, që ju sigurisht nuk jeni në dijeni, e të cilat në një letër nuk mund të thuhen, por disa gjëra duhej t'i themi. Prandaj edhe po përfundojmë me këtë: Veprimtaria e Mërgimit me kompani ka si burim frymën e sëmurë e të fëlliqur të grupeve, dëshirën për imponim, paaftësinë për ta luftuar armikun don ta shfrytëzojë për t'i luftuar bashkëluftëtarët e djeshëm, me një fjalë ky nuk është as një fraksion, por një grup i mjerë njerëzish në

> **Mehmet Hajrizi**: *"Fillimisht duhet thënë se organizimi në Shqipëri i Luftës Nacionalçlirimtare, që për veprimtarët e kohës, në saje të literaturës që vinte nga Shqipëria, ishte në detaje i njohur, u bë modeli më i afërt, për ta zbatuar në kushtet e çlirimit të Kosovës. Atje ka pasur një Front Nacionalçlirimtar, që bashkonte forcat antifashiste të bindjeve të ndryshme, por Partia Komuniste në të* ***RUANTE ROLIN HEGJEMON."*** *(*Historia e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 97)

mesin e të cilëve pa asnjë dilemë qëndrojnë njerëz të UDB-së, një grup kolltukxhinjsh që mendojnë se duke i bërë varrin të tretit do të ngriten vetë, një grup injorantësh e llapanxhozësh që harrojnë luftën, që harrojnë rënkimin e popullit dhe nxjerrin thikat e përçarjes. Vie pyetja a do të kenë sukses, sigurisht se jo, sepse çdo gjë që mbillet me gënjeshtra e me shpifje dikujt ndoshta i duket e bukur, por kur mbin ajo del e shëmtuar, me dallavere as ndërtohet shtëpia, as ura, madje as gardhi. Kjo është luftë dhe kësi tipash do të na dalin prapë në rrugë, dhe ashtu si Abdullahu me kompani që pësuan disfatë po edhe këta do të pësojnë ashtu. E keqja, përgjithësisht e turpshmja nuk ka jetë të gjatë askund. Ajo mund të lëshojë degë, por edhe ato janë të përkohshme, ato janë degë pa

rrënjë. Bile më mirë që tash këta kanë dalur haptas, që kanë dalur përballë me fytyrën e tyre të vërtetë, se sa kur ishin përkrah me ne. Dhe koha do ta tregojë se në anën e kujt ishte e drejta dhe e vërteta.

> **Brat Berat Luzha**: *"Faktikisht, ne jemi **vetëquajtur** marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia. Kemi qenë veprimtarë të çështjes kombëtare... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*
>
> *...Rilindjen' e kam drejtuar pa asnjë problem të tillë ideologjik.*
>
> *...Përmes ngjyrimit ideologjik, kemi tentuar t'i kundërvihemi ideologjisë komuniste titiste. Edhe në këtë mënyrë e kemi goditur armikun."* . (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 220*)*

Me këso situatash do të mashtrohet ndonjë shokë i painformuar, ndonjë njeri që nuk i njeh gjërat, por ai do të jetë një mashtrim i përkohshëm, sepse gjërave të fëlliqura siç është kjo që po e bën Mërgimi me kompani, u vie era shumë shpejt. Prandaj edhe nuk po shqetësohemi aq shumë, prandaj edhe nuk po veprojmë siç po bëjnë këta nëpër punëtorë dhe të shpifim e të thejm dhëmbët, por si gjithmonë po punojmë, po përpiqemi që me punë ta bëjmë atë që pret sot populli prej çdo njeriu, sepse vetëm puna me nder, vetëm puna e pastër si loti, vetëm puna e çiltër mbetet dëshmi, mbetet për t'u shënuar. Sepse vetëm gjërat e pastra si loti e ndihmojnë luftën e një populli. Me shpifje e intriga ndihmohet armiku. Ne do të mund t'i hidhnim poshtë me fakte të padiskutueshme të gjithë atë helm që po e vjell Skënderi me kompani nëpër Evropë, por ai nuk e meriton këtë, ai nuk është i denjë ne të merremi me të. Ai thirret në emër të Jusufit, por praktika e tregoi se ai s'ka pasur asgjë të përbashkët me të. Jusufi po të dëgjonte se sot në emrin e tij njerëzit duan t'i detyrojnë punëtorët t'i vënë fotografitë e Titos, apo i nxisin punëtorët të therren me thika mes vete, të jini të sigurt, se do të ngritej prej varrit dhe me horra të tillë do të merrej vesh ashtu siç e meritojnë ata.

Ku na ka çuar të gjithëve qerrja e Skënderit dhe punëtori e atdhetari është ai e tregon pikërisht rrethi i Stutgartit, ajo fidanishte që Jusufi e Bardhi e ujitën edhe me gjakun e tyre. Aty sot shumica e njerëzve, këtë duhet ta pranojmë shokë, janë vënë pas qerres së një Abdullah Prapashtica, që nuk ka në kokë aq sa kishte Jusufi në këmbë. Kjo do të jetë një luftë e gjatë, kjo do të jetë një luftë e rëndë, shokë, por në të do të dalin fitimtarë ata që janë të pastër ata që nuk kursejnë asgjë për të mirën e përgjithshme, ata që vuajnë e përpiqen natë e ditë për të mirën e popullit të vet ata nuk mund t'i përlyej askush e lere më një Mërgim, që ka dalur nëpër botë jo për luftë por për të manipuluar me njerëz. Dielli i njerëzve të tillë ka përfunduar përgjithmonë.

Ata që e sollën punën gjer këtu po dashkan të na nxjerrin edhe një tjetër gazetë, madje mu kur ne përgatiteshim t'i shprehnim mendimet tona për një bashkëbisedim mes shokësh që i konsiderojmë burra e shokë, shkon një njeri kafenesh e rrugësh, dhe në "emër" të Lëvizjes don ta ndërroj vendin e adresës së Zërit të Kosovës, një adresë që sot është bërë e njohur për të gjithë shqiptarët e botës, një adresë në të cilën dërgojnë përgjegjet e tyre në kërkesat që i bëjnë punëtorët tanë në demonstrata edhe shtete të ndryshme madje edhe Organizata e Kombeve të Bashkuara, dhe me një njeri të tillë ju, shokë të Stutgartit na propozoni të ulemi të bisedojmë. Jo, me njerëz të tillë, me rrugaç e

> **Mehmet Hajrizi**: *"Fillimisht duhet thënë se organizimi në Shqipëri i Luftës Nacionalçlirimtare, që për veprimtarët e kohës, në saje të literaturës që vinte nga Shqipëria, ishte në detaje i njohur, u bë modeli më i afërt, për ta zbatuar në kushtet e çlirimit të Kosovës. Atje ka pasur një Front Nacionalçlirimtar, që bashkonte forcat antifashiste të bindjeve të ndryshme, por Partia Komuniste në të* ***RUANTE ROLIN HEGJEMON."*** *(*Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 97)

kolltukxhinj që për interesat e tyre të ulëta personale, me njerëz të nxitur e të shtytyr nga xhelozia dhe nga vetë armiku, që duan të luajnë me luftën tonë ne nuk mund të ulemi në një tavolinë kurrë, me ata nuk na bashkon asgjë, ata qe dy vjet, sa ka që jemi bashkuar nuk e kanë treguar as minimumin e sinqeritetit. Këtu bën përjashtim Skënderi, i cili në fillim u tregua shok, gjersa nuk ra viktimë e dallavereve të Mërgimit dhe sot është bërë një vegël e tij e mjerë. Për të shkuar aq larg sa në këtë situatë dhe mjerisht në emër të Jusufit të shkojë aq larg sa të ndërmarrë hapa në Evropë ndër punëtorë të ndershëm e duarplasaritur që të qesin edhe fotografitë e Titos nëpër klube, për të shkuar pastaj edhe më larg dhe për t'i ndërsyer punëtorët t'ia fusin thikat njëri-tjetrit. Ajo çka ka ndodhur në Dyseldorf është vepër e Skënderit. Ai me atë gjest, edhe kur një i ri i papjekur si Milaimi, e ka parë se nuk bën ashtu ai e ka nxitur dhe ja se ku e ka sjellur punën. Me njerëz që e bëjnë popullin mish për top, ne nuk na lidh asgjë.

Nuk ka vend që ka shkuar Skënderi, që i besuam detyrë aq të rëndësishme, e të mos ketë mbjellur përçarjen e mosunitetin, të mos ketë shpifur prapa shpine, e të mos ketë bërë përpjekje t'i përvetësoj edhe njerëzit më të dyshimtë, për të cilët tashmë kemi fakte të padiskutueshme se kush janë dhe kujt i shërbejnë. Dhe tash na doli haptas, pasi e pa se shefi i tij Mërgimi është diskreditуar dhe s'i ka mbetur sy e faqe të dalë para askujt. Sepse letrat që ai shkroi para dy muajsh sot po i boton, të thuash pas asnjë ndryshim "Politika" e Beogradit. Këta kanë shkuar aq larg, sa që për qëllimet e tyre të ulëta luajnë edhe me jetën e njerëzve që kalben burgjeve, me ata njerëz që edhe ndër torturat më të tmerrshme nuk pranuan se njohin ndonjë shok të veçantë, kur Mërgimi me Musa Hotin shpërndajnë trakte dhe thonë, në kohën kur dënoheshin njerëzit, se ata i paska dërguar filan filani. Këtë nuk e bëjnë burrat, këtë një shqiptar që e ka vetëm një dërhem burrni nuk do ta bënte kurrë. Ky akt i ulët edhe një tupnaxhi do ta neveriste. Dhe ju, shokë, na thuani të ulemi edhe me një njeri të tillë e të bisedojmë. Jo, shokë, ai me kompani nuk meriton të mendohet as të shkruhet për të e lere më të bisedohet. Ai ka shkuar aq larg sa edhe sekretet kryesore të Lëvizjes t'i shpërndajnë nëpër botë si të ishin ato bagla leprash, e njerëzit për to lënë veshkë e mushkëri nëpër kazamatet jugosllave dhe nuk e qelin gojën. Por ani ndashtë, aq më keq për ta. Të gjitha këto ndodhën, shokë, dhe ne heshtëm. Ne nuk e qelëm gojën. Ne ua treguam vetëm disa prej këtyre gjërave shokëve që erdhën prej Stutgartit. Dhe heshtëm, as shpërndamë trakte prej Australisë e gjer në Amerikë as dolëm ndër punëtorë që të ndyejmë gojën me shpifje nga më të ulëtat. Këtë e bënë ata që po flasin në emrin tuaj, ata që kanë nxitur shokë në mesin tuaj edhe për të shkruar letra, përfundimisht vetëm ata që e dimë se janë për luftë, me punëtorët që ky realitet i vret dhe i mundon më së shumti. Na lajmëroni disa ditë përpara dhe do të ishte mirë që për takimin të mos përhapet fjala dhe me vete, po e përsërisim, merrni të gjitha faktet që ua merr mendja se ne u kemi hyrë në hak juve apo luftës, mos e kurseni asnjë, jini të sigurt se do të jemi të gatshëm para shokëve t'i pohojmë edhe lëshimet tona, t'i pranojmë të gjitha ato që nuk janë në interesin e luftës, por jemi të bisedojmë me burra e me shokë, me njerëz të fjalës

e të besës. E Skënderi me Haxhiun, me Mërgimin dhe me radaktorin e ardhshëm të Zërit të Kosovës, Musa Hotin le të shtypin gazeta tërë ditën e tërë natën, se kjo neve nuk na shqetëson aspak. Bile po presim të mbledhim sa më shumë material në mënyrë që kur ta themi fjalën tonë, ajo të jetë bindëse, të jetë e fortë dhe shkatërruese për të gjithë ata që e sollën punën gjer këtu, të jetë dërrmuese për të gjithë ata që po përpiqen t'i përçajnë njerëzit mes veti.

Kësaj Lëvizje i kemi dhënë gjak e i kemi dhënë jetë, prandaj themelet e saj nuk do të lejojmë më të rrëmihë lloj-lloj budallai që mendon se lufta e një populli është stof prej të cilit mund të qepen herë brek e herë këmishë.

Nuk po e zgjasim më shumë, shokë, prandaj u mbetet juve të vendosni si të shihni se është më së miri. Veproni vetëm ashtu siç u urdhëron ndërgjegjja juan. Nga ana jonë do të përpiqemi ta bindim çdo shok e bashkëluftëtar se jemi për luftë e jo për fjalë, se jemi për bashkim e jo për përçarje. Pra le t'i mbetet të ardhmes të tregoj se në anën e kujt është e vërteta.

Në pritje të përgjegjes tuaj, të dashur shokë, ju lutem t'i pranoni përshëndetjet e përzemërta vëllazërore të shokëve nga Zvicra (Xhafer Shatri) 29 qershor 1984

57. Letër e Xhafer Shatrit për Faridin Tafallarin, 29 tetor 1984

I dashur shok,

po të shkruaj shkurtimisht. Kësaj radhe po ta dërgoj këtë Statut dhe po të njoftoj se fillimisht u përpoqa ta korrigjojë këtë të Muhametit, por vërtetë ishte e pamundur sepse në të nuk kishte asgjë, ajo ishte thjeshtë një lojë e tij, kështu që u detyrova t'ia nis prej fillimit (zeros - shën i Xh. D.). Besoj se ka dalur bukur i plotë, por sigurisht ka akoma shumë nevojë për plotësim me idetë dhe mendimet e shokëve që duhet t'i japin në takimin e ardhshëm të KQ dhe sidomos në lexim me celulat dhe komitetet e vendit.

Këtë kopje nuk po ia dërgoj fare as Muhametit as Iliazit (Ibrahim Kelmendit-shën i Xh D), sepse e di shumë mirë se do të jetë edhe një shkak tjetër që të na i humbin edhe një mori netësh, duke na lënë pa gjumë në teorizime boshe, prapa të cilave nuk fshihet tjetër veçse ambicieve personale.

Prandaj ti lexoje këtë dhe përgatitu për diskutim qoftë për të qoftë për Programin. Të lutem lexoje me vëmendje dhe mos hezito për asnjë moment për të dhënë kritika të pjekura të cilat gjithmonë ndihmojnë që të përmirësojmë të metat tona.

A bisedove akoma me atë shokun t. për fotok?

Familjen si e ke?

Ne jemi mirë.

Përshëndetje vëllazërore Xhema

Pra për këtë Projektstatut mos i fol askujt gjë

29 tetor 1984

58. NJOFTIM I SHOKËVE NGA ZVICRA

NJOFTIM

Njoftohen shokët Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi për mbledhjen e fundit të KQ të LRSSHJ.

Më 10.2.1985 KQ (Komiteti Qendror-shën. i red.) mbajti mbledhjen e vet të rregullt. Rendi i ditës ishte:

1. Analiza e Organit Qendror dhe shqyrtimi i propozimeve të Redaksisë për ndryshimin e "Zërit".

2. Raportimi për punën e forcave të organizuara në Kosovë.

3. Shqyrtimi kritik lidhur me sjelljet dhe punën e Xhafer Shatrit dhe Ibrahim Kelmendit.

Në mbledhje nuk ishin prezentë shokët Xhafer Shatri e Ibrahim Kelmendi.

Duke pasur parasysh situatën e krijuar në KQ të cilën e ka kapluar fryma e grupeve, frymë e cila është reflektuar edhe te forcat e tjera të organizuara jashtë dhe në Kosovë, andaj është e domosdoshme të bëjmë spastrimin e radhëve nga shokët të cilët janë të ngarkuar me këtë frymë përçarëse dhe të cilët po i shkaktojnë dëme luftës sonë.

Shoku Xhafer Shatri pas ardhjes në Zvicër i hyri punës në të madhe, duke kontribuar shumë në nxjerrjen e Organit qendror "Zëri i Kosovës". Vazhdimësia e daljes së "ZK" është e lidhur drejtpërdrejt me Xhafer Shatrin. Puna organizative e forcave të organizuara në Kosovë dhe fryti që del prej tyre është i lidhur edhe me Xhaferin. Por, në punën e tij Xhaferi bëri edhe mjaft gabime e lëshime politike, duke krijuar edhe frymën e mosbesimit ndaj njerëzve. Duke e parë situatën e krijuar, Xhaferi (Shatri-shën. e red.) dha dorëheqje me shkrim.

Derisa shoku Xhafer në punën e tij që bëri e përcollën edhe gabimet, në anën tjetër shoku Ibrahim Kelmendi nuk punoi fare, por u muar drejtpërdrejt me përcjelljen e punëve dhe gabimeve të Xhaferit; u muar me thash e thëna në mesin e punëtorëve. Bëri edhe dekonspirime të sekreteve të KQ të LRSSHJ-së. Keqpërdori ndihmat për Kosovën, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin e Suedisë në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë luftës sonë prej 50.000 korona, prej të cilave nuk solli asnjë qindarkë, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi; mbjellja e frymës përçarëse në vetë KQ; mospërgjegjësia ndaj punës; prishja me miq zviceranë; mosaktiviteti me të huaj dhe krijimi i ftohjes së tyre ndaj luftës sonë dhe organizatës sonë; qëllimi pretendues i formulimit të fjalisë: "Vërejtjet, sugjerimet e propozimet që do të vijnë pas fillimit të dhjetorit të këtij viti do të kenë vlerën e vet, por nuk do të mund të merren parasysh, pasi në ndërkohë KQ dhe Komitetet e rretheve do të mbajnë mbledhjen për të aprovuar Programin e Statutin e LRSHJ-së" me të vetmin qëllim që të sabotojnë punën e diskutimit dhe shqyrtimit të PP dhe PS dhe në anën tjetër për të shfrytëzuar tubimin e zgjeruar për diskreditimin e Xhaferit me gabimet që ka bërë. Në KQ nuk qe vendosur të thirrej tubimi i KQ me Komitetet e rretheve të cilën gjë shoku Ibrahim Kelmendi e bëri pa dijen e shokëve duke u thirrur se gjoja qenka vendosur në mbledhjen e KQ, gjë e cila nuk ishte e vërtetë. Qëllimi i gjithë kësaj ishte ai që cekëm më lart, diskreditimi i Xhaferit para një tubimi më të gjerë. Kjo tregon se si disa njerëz veprojnë pas shpine pa u konsultuar me shokë, e këtë e bëri shoku Ibrahim Kelmendi.

Për shkak të krijimit të mosbesimit ndaj njerëzve, lëshimeve dhe gabimeve politike si dhe mbjelljen e frymës përçarëse KQ vendosi që të ndërmarrë masa për nxjerrjen e KQ nga situata e krijuar dhe të bëjë spastrimin e radhëve nga mospunëtorët dhe përçarësit.

Kështuq KQ i LRSSHJ me shumicë votash 4:1 (katër me një) vendosi që shokët Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi përjashtohen nga KQ i LRSSHJ-së, përderisa të mos e vërtetojnë të kundërtën me aktivitetin e tyre.

10 shkurt 1985 Zvicër
KQ i LRSSHJ
(Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f .253-254)

Letra nga Ibrahim Kelmendi
1980-1984

E QUAJ TË DOBISHME TË OFROHEN INFORMATA, DËSHMI, DOKUMENTACION

1. Letër e Ibrahim Kelmendit për Hysen Gegën, 4 qershor 1980
2. Letër e Ibrahim Kelmendit për Jusuf Gërvallën, 16 shtator 1980
3. Letër e Ibrahim Kelmendit për Sadik Blakajn, 21 janar 1981
4. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, 21 janar 1981
5. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, 30 janar 1981
6. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, 7 mars 1981
7. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, 18 mars 1981
8. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, 19 mars 1981
9. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, dhjetor 1981
10. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, 8 prill 1982
11. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, maj 1982
12. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, maj 1982
13. Kush është vojvoda Ramë Nikçi?
14. Letër-shkresë e Ibrahim Kelmendit, 17 qershor 1982
15. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive, 14 prill 1983
16. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, maj 1983
17. Letër e Ibrahim Kelmendit për (Xh. D.) dhe Qendrën Ekzekutive, 4 maj 1983
18. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive, 7 maj 1983
19. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin dhe QE, 3 qershor 1983
20. Letër e Ibrahim Kelmendit për Xhafer Durmishi dhe QE, 3 qershor 1983
21. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, 17 qershor 1983
22. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive (QE), 30 qershor 1983
23. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive (QE), 12 gusht 1983
24. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive (QE), 25 gusht 1983
25. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive (QE), 15 shtator 1983
26. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive (QE), 10 tetor 1983
27. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, 3 janar 1984
28. Qarkore e shkruar nga Ibrahim Kelmendi, x. Janar 1984
29. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, (rreth mesit të) janar 1984
30. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive (QE), 11 janar 1984
31. Letër e Ibrahim Kelmendit për Sabri Novosellën dhe QE, 17 janar 1984
32. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive (QE), 19 janar 1984
33. Letër e Ibrahim Kelmendi për Komitetin Qendror ("Dukagjinin"), 19 mars 1984
34. Letër e Ibrahim Kelmendi për Komitetin Qendror ("Dukagjinin"), 22 qershor 1984

* * *

Më 15 janar 1983, në Ludvigsburg, me iniciativën e Xhafer Shatrit u formua Qendra Ekzekutive (QE) nga pesë anëtarët e mëposhtëm, të cilët morën pseudonimet përkatëse. Qendra Ekzekutive pushoi së vepruari më 3 mars 1984 në Gjenevë, kur u

vendosë formimi i Komitetit Qendror, që në korrespondencën tonë do të identifikohej me emrin "Dukagjini".
Pseudonimet:

-Iljazi = Ibrahim Kelmendi
-Xhema= Xhafer Shatri
-Plaku= Hasan Mala
-Fahriu= Faridin Tafallari
-Salihu= Xhafer Durmishi

E QUAJ TË DOBISHME TË OFROHEN INFORMATA, DËSHMI, DOKUMENTACION

Ibrahim Kelmendi: "*Sidomos në prag të 30-Vjetorit të Lëvizjes (populllore), që, - bazuar në përcaktimin tim, - është me 17 Janar 1982, e quaj të dobishme të ofrohen informata, dëshmi, dokumentacion, vlerësime, të debatohet rreth tyre, për të ndihmuar ndriçimin sa më objektiv të kaluarës sonë."* (Letër Xhafer Durmishit, facebook, 23 tetor 2011)

1. Letër e Ibrahim Kelmendit për Hysen Gegën, 4 qershor 1980

Shokë!

Mendojmë se kaloi një kohë e mjaftuar që kur morët në duartë tuaja Programin dhe Statutin e Frontit të Kuq Popullor me material përcjellës. Ai që ka dashur ka mundur të vendosë nëse është dakord që të jetë i organizuar në radhët e Frontit. Dhe ende nuk është hasur në të atillë që nuk janë të gatshëm të japin kontributin e tyre në radhët e Frontit, pasi kan studiuar programin e punës dhe Statutin. Tani mbetet për të vendosur se si do të punohet e veprohet në çdo celulë, që do të formohen në rrethet ku nuk ekzistojnë dhe në ato rrethe ku nuk ka kandidatë të mjaftueshëm për celulë, e se çfarë pune dhe aktiviteti do të ndërmarrin shokët. Para nesh qëndrojnë detyra të vështira. Organizimi i mirë dhe konsolidimi i radhëve tona duan punë dhe sakrifica, duan seriozitet dhe sidomos konspiracion rigoroz e kujdes të madh, pasi duhet të punojmë në ilegalitet. Duhet të pranojmë se radhët tona në mërgim lëngojnë në mungesë të kuadrit. Të gjithë jemi punëtorë mërgimtarë, që erdhëm për t'i bërë bukë familjes (ndonjë person ndodhë edhe të mos jetë punëtor, por kjo nuk peshon aq shumë kur dihet se të gjithë të tjerët janë punëtorë). Por një e vërtetë e tillë s'duhet të na pengojë e demoralizojë në punën tonë. Vetëm nëse punëtori politizohet dhe angazhohet, vetëm atëherë do të tronditet borgjezia në pushtet. Organizatat e tilla, të cilat përbëhen në pjesën dërmuese nga intelektualë revolucionarë, nuk mund të jenë organizata mase dhe nuk janë në gjendje të bëjnë revolucion si të tilla. Organizatat e tilla, që përbëhen vetëm nga të "diturit" vetëkënaqin veten kur ato filozofojnë në nivel të "lartë" të ngritur nga toka në qiell dhe, sa më lart ngrihen, kur të rrëzohen do thërmohen më shumë. Pa mëdyshje, rrëzohen ata që formojnë barriera me masat dhe me klasën punëtore, pse te masa fshihet forca. Por kjo e vërtetë nuk guxon të na bëjë euforik. Vetëm fakti se jemi punëtor nuk mafton të jemi edhe patriotë revolucionarë. Duhet patur edhe vetëdija përkatëse dhe, sigurisht, për të merituar titullin patriotë revolucionar, duhet edhe me qenë i organizuar dhe, si i organizuar, të kontribuojmë atë çka kërkohet nga revolucionari. Nganjëherë formohet përshtypja te ca: në momentin kur vendosë të aktivizohet për të punuar dhe sakrifikuar për atdheun dhe lirinë e tij, u deshka të përmbyset e tërë bota e vjetër, nga e cila ngrihet e reja, konkretisht

menjëherë posa organizohet, ai mendon se u dashka të fillohet nga aksionet që do të trondisin klikën në pushtet, duke e detyruar të gjunjëzohet, pa qenë fare i ngritur dhe i përgatitur që t'i peshojë gjërat. Pa dyshim, një eufori e tillë është e dëmshme. Nga studimi i historive të organizatave tjera dhe historive të partive komuniste, shihet qartë se u është dashur kohë dhe mund e sakrifica që t'i konsolidojnë radhët. Nga vendosmëria, gatishmëria për sakrifica dhe organizimi i mirë është varur suksesi. Shumë nga organizatat, grupet dhe partitë kanë mbaruar në mossukses dhe janë shuar. Ato që kanë dalë fitimtare, nuk kanë ecur nëpër rrugët të shtruara në tepih. Edhe ato kanë patur rrugë të ngjashme me të tjerat, që kanë mbaruar në mossukses, por suksesi i tyre është rezultat i organizimit në nivel dhe vendosmërisë, duke i shtuar edhe ndonjë faktor tjetër, pse suksesi, si edhe mossuksesi, kushtëzohen edhe nga të tjerë faktorë, pos këtyre që po përmendim ne.

Po të analizojmë fillimin e historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë, e cila në fillim është quajtur Partia Komuniste, çka edhe na duhet doemos ta mësojmë, kemi për të parë se Partisë Komuniste i janë dashur më shumë se dhjetë vite derisa është formuar si Parti Komuniste me kuptimin e plotë të fjalës. Ka patur grupe e grupe, ka patur suksese e mossuksese, por më në fund u gjet komunisti i vendosur dhe i aftë që t'i bashkojë ca nga ato grupe për të themeluar PKSH-në, e ky ishte shoku Enver. Sigurisht, themelimin e Partisë Komuniste Shqiptare nuk guxojmë ta lidhim vetëm me një person, qoftë ai edhe shoku Enver, Lenini, etj. Aktiviteti i përbashkët edhe i militantëve të tjerë ka mundësuar sukseset dhe, më në fund, edhe fitoret. Pra, historia katërmbëdhjetëvjeçare e grupeve komuniste dhe aktiviteti i pamohueshëm i militantëve, që jetën ia falën popullit dhe Partisë Komuniste si Ali Kelmendi, Riza Cerova e komunistë të tjerë, mundësoi themelimin e PKSH-së, duke u konkretizuar në fund nga shoku Enver me shokë të tjerë. Asgjë s'u arritë brenda natës, por ka patur histori të gjatë.

E analizuam pak historinë e PPSH-së për të parë se është i pavend demoralizimi i ndonjë shoku, kur hasim në ndonjë pengesë, e cila mund të sjellë edhe mossuksesin. Pengesat na dalin për t'i kaluar, ndërsa mossukseset për të na mësuar se si herën tjetër të korrim sukses.

- Puna e përbashkët garanton suksese më të mëdha. Kjo punë duhet organizuar në celula.

Për të filluar nga aktivitetet, si militantë që jemi duhet të formojmë celula të vogla. Në këto celula të ngrihemi, duke ndihmuar njëri-tjetrin dhe celula duke ndihmuar celulën. Celulat do të kenë aq anëtarë sa janë edhe shokët militantë të njohur. Pra, në celulë nuk do të depërtojë asnjë tjetër, i cili nuk është i njohur nga shokët e celulës. Vetëm atëherë, kur ndonjë shok në një celulë ka një shok të sigurtë dhe besnik në rrethin e celulës tjetër, i cili nuk ka mundësi të aktivizohet në celulën ku shoku është aktiv, duhet t'i propozohet celulës në fjalë që ta përcjellë kandidatin e propozuar nga militanti, pa e ditur se është duke ndenjur me anëtarë të Fronit dhe që bënë pjesë në celulën e rrethit të tij. Një kandidat i tillë nuk guxon të mësoj nga shoku i vet që ekziston një celulë në rreth. Nga anëtarët e celulës së rrethit duhet të mësoj, kur shokët të jenë të bindur, se kandidati është besnik dhe i ndershëm. Përsosja e tij e mëtejme bëhet në celulë, duke punuar dy-tre anëtarë me të më shumë se në mes veti. Në këtë drejtim duhet të jemi rigoroz dhe vigjilent, pse mund të depërtojë ndonjë agjent apo provokator në celulë, kështu që do i dëmtoj të gjithë shokët e celulës. Bile asnjë shok nuk duhet të besojmë, nëse nuk kërkohet, në asnjë besim, asnjë shoku nuk është e nevojshme t'u tregohen emrat e shokëve që bëjnë pjesë në celulën tënde. Po ashtu, asnjë nga shokët nuk duhet të pretendojë të kërkojë se kush qenka anëtar në këtë apo atë celulë. Nëse këtë e bënë ndonjëri nga kurioziteti naiv, atëherë e ka dëmtuar veten, pse në këtë formë bënë të dyshimtë shokun që e ka pyetur, i cili pastaj do ta dërgoj

dyshimin e tillë në diskutim në celulë për t'u ruajtur nga personi që është "viktimë" e kuriozitetit të panevojshëm.

Celula duhet të mblidhet shpesh për të diskutuar ndonjë material që vjen nga qendra. Nëse qendra nuk ka dërguar materiale, atëherë celula prapë duhet të mblidhet, që të diskutojë rreth ndonjë iniciative apo ideje që i ka lindur ndonjë militanti. Në fund të analizave të aprovohet që t'i dërgohet qendrës, e cila do ta analizojë edhe ajo për t'ua shpërndarë celulave të tjera. Ose, nëse nuk ka material nga qendra dhe as nga ndonjë militant, nëse nuk ka ndonjë ide për për ndonjë iniciativë apo aksion, prapë duhet të tubohen që t'i shpjegojnë njëri-tjetrit se çfarë ka lexuar gjatë asaj kohe, në mes të dy tubimeve. Po ashtu, aty mund të lexohen materiale të nevojshme për t'i ditur, por që nuk ia del t'i shpjegojë shoku, pastaj të diskutohet nga të gjithë, derisa të jetë kuptuar nga të gjithë.

Materialet dhe "Bashkimi" duhet të përpunohen mirë dhe me kujdes. Nuk duhet të ngelë asgjë e paqartë. Për ndonjë ide me përgjegjësi më të madhe se rëndom, për ndonjë ide aksioni, nuk do të diskutohet gjerësisht. Ai do të përpunohet nga qendra, e cila do të vendosë nëse do zbatohet. Pasi të jetë kryer, duhet të diskutohet për guximin që ka patur shoku, për rëndësinë, por kurrsesi të përmendet emri i shokut që ka kryer aksionin. Nuk ka vend për lëvdata të panevojshme dhe parakohe, pse ato sjellin dëme. Pra, lypset maturi e madhe, pse duke shitur llafe apo duke lavdëruar shokun, dëmtohet shoku dhe organizata. Nuk duhetë t'i lëmë mundësi ndonjë lëshimi, i cili do t'i ngjiste kalit hamshor, që e zgjidhë dhe pasatj s'mund ta futësh brenda deri sa të ketë plasur duke ngarë. Shoku nuk duhet të preket pse ai është rigoroz në mbajtje të sekreteve, nuk tregon diç që ai ditka, edhe pse po ta mësojë nuk i hynë në punë. Sigurisht, ndodhë që edhe po iu tregua nuk del prapë në "mazgjah" për t'i treguar njerëzimit për guximin e shokut, ama të mësohemi që të kemi durim për të mos kërkuar të dimë atë që është e tepërt dhe të rrezikohet sekreti edhe më shumë.

Që në fillim të diskutohet për vendet e tubimeve të cilat s'do t'i bien në sy njeriut dhe s'do pengohen nga mysafiri, pse ndodh që, gjatë tubimit që po mbahet në banesë të ndonjë shoku, të vijnë mysafir të cilët ta ndërpresin punën. Duhet zgjedhur njëri nga grupi, i cili do të mbaj lidhjen me qendrën dhe do përfaqësoj shokët atje. Kriteret se cilin duhet të zgjedhim, i dimë. Për ata militantë që nuk kanë patur rast ta lexojnë materialin temë "Çdi fillim është i vështirë", s'do të ishte e tepërt ta lexojnë, pra në atë celulë që nuk është i njohur ai material, duhet të lexohet, pasi qe përgatitur nga një shok për celulën ku ai bënte pjesë.

- Kolona e pestë është vetë Kolona e Emin Fazliut e ajo që po shpif matufi Emin

Këto ditë na ka ra në dorë "Besa shqiptare", organ zyrtar i "Besëlidhjes kombëtare demokratike shqiptare". Në këtë qelbësirë organi, fuke kërkuar falje nga Flamuri dhe figurat qendrore të historisë sonë, që janë maskë për këta banditë e që figurojnë në kapak të kësaj qelbësire, udbashi i vërtetë dhe fashisti Emin ka shpifur për organizatën tonë. Për këto shpifje duhet të jetë çdo militant i sigurt se janë trilluar dhe janë të shkruara nga "kokati" në Kosovë. Pra, pa mëdyshje, ato janë të shkruara nga ekpertët e UDB-së ose edhe nga vetë Emini, për të diskreditуar Frontin. Duket se kjo është e kurdisur nga dy "krerët" e dy "organizatave". Riza Salihu, "udhëheqësi" i "grupit komunist" "Zëri i Kosovës" dhe "udhëheqësi" tjetër Emin Fazliu, i cili prezantohet me emrin "Emil Kastrioti". Mendja na thotë, edhe pse nuk kemi siguruar argumente të mjaftueshme, se të dyja "grupet" janë themeluar me urdhërin e UDB-së dhe është zgjedhur një taktikë e rafinuar: dy "grupe" të të dy kahjeve, të djathtët dhe të majtët. Punëtori i mërgimit, i ndershmi por i pavetëdije, të bëhet top tenisi në mes dy "kokave udhëheqëse", të cilave u

"qakan" zemrat për robërinë e Kosovës.

Pse Emini nuk sulmoi Rizahun apo Rizahu Eminin në shkrimet e tyre?!

Sigurisht që Emini ka patur njohuri më shumë për "grupin" e Rizahut. Edhe Rizahu e ka njohur mirë Eminin. Ata kanë kontaktuar rregullisht. Këtu zënë fill mendimet logjike, prandaj nuk kemi nevojë të bëjmë supozime. Emini ka ditur se shoku Asllan Loshi, viktimë e pavetëdijes, mashtrimit dhe tradhtisë, ka qenë anëtar i "grupit" të Rizahut dhe se ai ka shpërndarë trakte që nuk kanë qenë aq të këqija, "të shkruara" nga Rizahu. Nëse Emini është i mbërrishëm dhe që di "shumë", si nuk e kanë njoftuar se ai, shoku Asllan, nuk ka shpërndarë "Bashkim"-a. Shoku Asllan ka shpërndarë legalisht trakte të grupit komunist "Zëri i Kosovës", e si nuk e ka njoftuar ndonjë bashkëpunëtor, si shkronjësi nga Shtutgarti, Gjon Berisha, i cili njeh aq shumë sekrete, por që s'paska parë çfarë bëhet në çarshi e ai arrin të sigurojë sekrete nga konsullata, por jo të shoh se ç'bëhet në rrugë! Atij është dashur t'ia dalë që të zbulojë se shoku Asllan është anëtar i "grupit" të Rizahut! Pse të "përgjigjet" Ibrahimi për "rolin e tij meskin" e jo Rizahu?

I pari nuk e ka njohur fare dhe as që është njohur nga dikush tjetër për veprimtari të tij, pos diç sipërfaqësisht nga një militanti ynë, ndërsa Rizahu ia ka ditur edhe edhe sa zorrë ka në bark. Këto shpifje kanë për qëllim që Ibrahimin ta qesin në kurthet e policisë gjermane, ta diskreditojnë para punëtorëve, nga të cilët, mendon Emini, do të dalë ndonjë patriotë që do t'i falë një plumb të "merituar", ndërsa veten don ta shpallë si "shpëtimtar" të kombit.

Rizahu vepron ndryshe: ai rregullon "ditar" për mrekulli, ku, përpos të tjerash, Ibrahimin e akuzon për "anarshist" dhe "kriminel", i cili Kosovën mendoka ta "çlirojë përmes atentateve". Ibrahimi, ky "intelektual i degjeneruar" ngulë këmbë se Luftën çlirimtare të Kosovës do e udhëheqë PPSH-ja, derisa unë i them se "ne, përmes revolucionit do ta çlirojmë atë...". Do i uronim suksese Rizahut po ta kishte me një mendje, ndërsa Ibrahimin do e demaskonim, por a ka vepruar Rizahu me të vërtetë ashtu si ka shkruar në "ditar"?

Gjëra të ngatërruara qëllimisht, që lënë të shkatërrohen dhe të analizohen se çfarë fshihet vërtetë pas një veprimtarie të tillë.

Pasataj ky Emini, ky kriminel misterioz, shkruan edhe gënjeshtra të bëra qëllimisht, nën titullin: "Si vepron 'Kolona e pestë' titiste në mërgim?" Kjo është pyetje tamam me vend dhe e qëlluar, por Emini nuk qetë në dritë të vërtetën, pse "uji do ta nxirrte atë si urith mbi tokë". Ai trillon gënjeshtra me bisht, provon të demaskoj Frontin e Kuq dhe organin "Bashkimi" dhe shokët e kësaj organizate. Trillim pas trillimi, shpifje pas shpifje, të gjitha me vetëdije, pasi ai e di që janë shpifje, arrin deri atje sa thotë: "Mirëpo Ibrahim Kelmendit nuk i mjafton kjo, por ky viran vazhdoi me intrigat e tij edhe më tutje kundër Besëlidhjes sonë Shqiptare dhe udhëheqësve të saj, kështu filloi të botoj njëfarë lloji "bilteni" me titull mashtrues e bombastik "Bashkimi" në të cilin bilten, në një mënyrë shumë të ulët, mundohet të diskreditojë aktivitetin kombëtar të krejt Besëlidhjes dhe posaçërisht të kryetarit tonë të palodhshëm dhe besnik, në atdhetarizmin e të cilit nuk ka shqiptar të ndershëm që të dyshojë, me përjashtim të armiqve të kombit dhe shpirtshiturve siç është Ibrahim Kelmendi". (gërmë për gërmë, origjinal është përshkruar!)

Ai që e ka lexuar "Bashkimin" do vërtetojë menjëherë se çfarë shpifje bën Emini, kjo "kokë" që "kërkoi" Jugosllavia për terrorist...

Të ndalemi në detaje, nuk do e vlente barra qiranë. "Duhet bërë luftë kundër gjithë atyre që sulmojnë punën e Partisë nga jashtë", shkruante shoku Enver, "sepse duhet ta kemi të qartë se vetëm me një luftë të tillë mund të forcohet Partia. Elementët e dëmshëm

duhet t'i demaskojmë para masës popullore. Derisa mos t'i demaskojmë në popull këta elementë, ata mund të mashtrojnë edhe njerëz të ndershëm". (Veprat, vëll. 1, faqe 9).

Në punën dhe në diskutimet në celulë duhet të diskutohet për dukurinë diversioniste. Se është Emini tradhtar i popullit, i kombit tonë, nuk ka dyshim, por tani duhet të punojmë që ai të njihet nga bashkatdhetarët me fytyrë të vërtetë prej udbashi fashist. Në "radhët" e tij kanë hyrë edhe mërgimtarë të ndershëm, por të pavetëdije. Të tillë anëtarë as që do të përgatiten për diçka. Ata do filtrohen mirë dhe do marrin shkollë e "mësime" të ngjashme, ose, si të interesuar që janë, pasi nga zemra janë patriotë, të "grabiten" që të mos hyjnë në radhët e tyre, në radhët e grupeve ose organizatës sonë. Aty ku mundim, duhet të bëjmë propagandë gojore për këtë, për t'i shpëtuar bashkatdhetarët nga këto kthetra fashiste. Nuk gabojmë nëse do themi se po aq është e vlefshme, nëse do ia arrijmë t'i ruajmë bashkëfshatarët që të mos infektohen nga fashizmi i Eminit. Ai, Rizahu dhe ndonjë tjetër që mund të dalë, kanë për qëllim t'i çorodisin bashkatdhetarët, duke mbjellur frikë dyshimi dhe duke i thyer ata moralisht.

Nuk është larg mendjes që të tillët të keqpërdorin guximin e shqiptarit dhe ndonjë punëtor ta ngarkojnë me ndonjë "detyrë". Kështu ka patur ndërmend të provojë Rizahu, kur ka dashur t'i mashtrojë dy bashkatdhetarë të cilët, për fat, disponuan vetëdijen në nivel, që ta likuidojnë shokun Isuf Gërvalla, intelektual revolucionar. Veprimtaria e till diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin.

Nëse veprimtari të tilla diversioniste do t'i nënçmojmë, do të vijë një kohë kur "s'do njoh qeni të zonë". Se si t'i ndajvehemi këtij diversioni, duhet të mendojmë edhe më, por gjithsesi,konspiracioni ynë do t'ua bëjë të pamundur që të mësojnë diçka për radhët tona, edhe pse që më parë ata nuk kanë ditur diçka konkrete, përveç kanë shpifur e trilluar. Nëse kanë ditur diçka, prapë është faji ynë, por kryqëzimi përmes anëtarëve bëri këtë. Duke mbajtur lidhje me anëtarë të grupit komunist "Zëri i Kosovës", mundëm të mësojmë për veprimtaritë diversioniste të Rizahut, i cili tërë kohën i mashtronte anëtarët e tij, duke i qitur edhe në kurthe më së mbrami.

"Më mirë është të mos punohet fare, se sa të rrëzohen gurët nga muri në ndërtim, që po ndërtohet nga të tjerët", na tha një shok kur na këshilloi. Ta përvetësojmë këtë këshillë, por jo për të mos punuar fare, por për të punuar me mend, që të qesim gur në mur që ai të kryhet sa më parë, duke i qitur pasatj çatinë, që të hyjmë në shtëpinë tonë. Kjo do të thotë që çdo gjë që do të kryejmë dhe çdo aktivitet yni duhet të peshohet në peshore, me interesin e përgjithshëm të kombit tonë. Nuk guxojmë të kryejmë aksione për të kënaqur veten, edhe nëqoftëse në aksione të tilla jemi të gatshëm të japim jetën, por që do sjellin dëme, kur të kihet parasysh interesi i përgjithshëm kombëtar. Po ashtu nuk guxojmë të mbytemi në ngritje teorike pa kryer aksione. Një ngritje teorike pa kryer edhe aksione të menduara mirë është sterile dhe në vetëvete topitet me kalimin e kohës.

Derisa nuk është vendosur kuotizacioni (anëtarësia), pasi edhe në Statut nuk është përcaktuar një gjë e tillë, se sa do të paguajë çdo kush rregullisht si anëtarësi, duhet të jemi të vetëdijshëm në këtë fushë, pse kërkesat e nevojshme që dalin duhet të përballohen nga të gjithë. Në Statut thuhet: "Puna propagandistike dhe materialet e ndryshme që hyjnë në këtë punë, implikojnë shpenzime materiale, që duhet të përballohen nga të gjithë anëtarët. Për këtë qëllim çdo anëtar duhet të japë kontribute të rregullta, sipas mundësive." "Sipas mundësive" nuk do të thotë se dikush të këputet fare dhe tjetri të brijohet. Nëse është thënë "sipas mundësive", atëherë është menduar në ndërgjegjen e militantit, pasi ai,

duke treguar gadishmëri që të bëhet anëtar i Frontit, ka treguar gadishmëri që të sakrifikoj jetën, kur ta lypë interesi i kombit e ç'është më shumë se jeta? Prandaj për të mos qitur ndonjërin në pozitë të keqe, pse mundësitë që të shpjegohemi në detaje për shumë gjëra janë të vogla, në ilegalitet të plotë është vendosur që të paguaj çdokush "sipas mundësive", në mërgim duhet të sakrifikojmë më shumë materialisht. Ndoshta do ia dalim dhe duhet të minimizohen udhëtimet e shumta dhe të shtrenjta, duke u zëvendësuar ato me shtrirjen e anëtarëve sa më gjerë, të cilët pastaj, në terrenin e vet do t'i kryejnë detyrat që kërkohen në fushën e propagandimit dhe agjitacionit. Çdo celulë, në rrethin ku ajo vepron, duhet të sigurojë sa më shumë adresa, që për çdo eventualitet, propagandën ta shpërndajmë me postë.

Sa i përket ngritjes së përgjithshme kombëtare, duhet të propagandojmë te bashkatdhetarët që ata të abonohen në shtypin nga Shqipëria. Një punë e tillë është e lehtë, pasi kjo kryhet nga shokët e Ndërmarrjes së Librit dhe nuk kushton shtrenjtë. Që tani duhet t'u propozojmë dy revista: "Shqipërinë e Re" dhe "Yllin", ndërsa për ata që janë familjarë edhe "Shqiptaren e Re" për gratë dhe "Yllkat" për fëmijët. Enkas për këtë do nxjerrim trakte me të cilat, përpos që do të propagandojmë, ua lehtësojmë punën në porositje.

Nëse hasim në ndonjë shok, i cili do të ketë vështirësi që t'i lexoj materialet dhe t'i kuptoj ato, duhet të provojmë përmes kasetave, duke ia inçizuar materialin e ai do ta përcjellë atë në letër gjatë të dëgjuarit, pasi do të marrë edhe në letër të njejtin material. Më vonë, pasi të jetë praktikuar kështu, ao do të mësoj të lexojë për të kuptuar. Në këtë fushë duhet të ketë solidaritet të të gjitha llojeve.

Provoni përmes ndonjë shoku gjerman të merrni postën. Pra, në shumë rrethe ka celula të Partisë Komuniste Gjermane. Aty do njiheni me ndonjë shok dhe posa t'i keni qarë hallin për postën, do iu gjej shokun më të afërt, përmes të cilit mund të merrni postën. Vetëm për postën ilegale duhet të përdoren adresa të tilla.

Që të jetë praktikë dhe që të mund të bëhet një kontroll, duhet të zgjedhen emra ilegalë për të regjistruar kush ka kontribuar e sa kontribut ka dhënë. Për emrin e zgjedhur duhet të dij vetëm ai dhe i zgjedhuri i celulës. Kurrsesi dhe askund nuk duhet të figuroj emri i vërtetë i ndonjë shoku, pse sjellë me vete rreziqe.

Ju përshëndes nga baza e përkohshme (derisa të zgjidhen shokët e rinj)
Shkrepi (Ibrahim Kelmendi)

P. S. Po dërgojmë një material për studim, të cilin duhet ta diskutoni në tubimin e ardhshëm, por secili duhet të përgatitet për vete, që diskutimet të bëhen në nivel, për t'i kuptuar sa më qartë. Në diskutim duhet të synohet të nxirren mësime për situatën e tanishme. Materiali është nxjerrë nga Vepra e shokut Enver, vëllimi I.

Bisedoni po ashtu për festimin e festave të Nëntorit. Ti, shoku Shanto, tregoju për idenë e Çelikut, që për kremtimin e festave të Nëntorit do të jemi në N. Po provohet të sigurohet ndonjë film i mirë nga Shqipëria. Për rrethet e tjera, që nuk kanë mundësi të informohen nga Shantoja, do të informohen më vonë konkretisht.

(U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari në librin; Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 154-161)

2. Letër e Ibrahim Kelmendit për Jusuf Gërvallën, 16 shtator 1980

Bochum, 16 shtator 1980

Më i dashuri shoku Jusuf!

Me vonesë jo gjithaq të madhe, pasi u ktheva nga rruga,po t'i shkruaj vetëm ca fjalë. Kalova mirë. Tani po vazhdoj jetën normale, punën time të rëndomtë. Më kanë lindur edhe telashe. Viruset provojnë të më infektojnë, kur unë kam dëshirë të jem i shëndetshëm. Por çdo virusi i është gjetur helmi, përpos atij të kancerit...

Enigmatiku Riza (për mua fare), provon të më futi në valle. Në këtë mënyrë ai ka për qëllim të më marrë kohën, duke menduar se ndoshta aventurat e tilla më pëlqejnë. Për këtë jam fajtor vetë. Është që në momentin e parë kur pata rrezik e e njoftova, t'i tregoja që të mos luaj me zjarrin. Tani po më duket vonë. Pavarësisht, unë do të eci në rrugën time, pa patur frikë që ndonjë minak do të më leh përanash.

Po ashtu kokëkrisuri Emin Fazliu, edhe pse unë nuk iu përgjigja as në letrën private, nuk pran së akuzuari. Tani më akuzon se kam shkruar unë apo ndonjë tjetër (një kroat) letër me pseudonimin e tij dhe një letër e tillë i qenka dërguar një organizate reaksionare, që unë as që e lexoj. Sidoqoftë edhe kësaj radhe nuk do t'i përgjigjem. Kishte me pasë vetëm një përgjigje, të cilën ai e meriton, por nuk jam i thirrur për të tilla... Edhe ky po si i pari mund të vazhdojë, unë kam hallet e mia dhe ato më duhet t'i zgjidh. I treti, për çudi, çfarë nuk kam pritur nga ai që do të shkoj aq larg me qëndrim si dy të parët. Dua të pres edhe më. Tani, pasi letrën po e dërgoj në adresë të vjetër, nuk di nëse do ta marrësh. Prandaj edhe ca libra dhe ato fotokopjet nuk po t'i dërgoj gjersa të më dërgosh adresën e re. Ekziston mundësia që në fund të kësaj jave të dalë andej. Po munde telefono, se ndoshta letra nuk do të më arrijë dhe më trego adresën. Nëse ke kohë dhe mundësi, po ashtu nëse ke ndonjë temë (e Ti rëndomë ke çdo herë se për çfarë të shkruash, pasi edhe ka kaq shumë për të shkruar), përgatite për numrin e ardhshëm të "Bashkimit". Mua më duhet që t'i sjell artikujt që t'i korrigjosh për drejtshkrimin dhe ortografinë. Nuk do të dalë në nivel, po nuk punove edhe Ti (e kryesisht Ti) "Bashkimi".

Do të kishte qenë mirë të më ndihmoni, pasi jeni më afër ngjarjes, për rastin e arrogantit Rizah. Sigurisht që Bardhi ka mundur të mësoj më shumë gjëra se unë, pasi unë pos çfarë më thanë të KRIPO-s, nuk di tjetër. Një gjë di se jam i revoltuar shumë me Rizahun për konfiskimin e postës që më ka bërë. Është kjo vepër prej udbashi. I poshtri! Sigurisht që më ka munguar posta. Për këtë kam bërë sa herë fjalë me udhëheqësit e konviktit. Mbeç me shëndet! Ibrahimi

P. S. Përshëndete vëllaun dhe familjen nga ana ime. Mirëupafshim!

(U botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari në librin; Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 117)

3. Letër e Ibrahim Kelmendit për Sadik Blakajn, 21 janar 1981

21 janar 1981

Sadik, po t'i shkruaj ca fjalë:

Je i obliguar të raportosh në çdo imtësi mbi zhvillimin e ngjarjes, që kur keni vendosur të shkoni ti dhe Hyseni, e gjer tek kthimi yt pa Hysenin. Gjithashtu edhe për "dështimin" e "akcioneve" dhe të tjera, duhet të raportosh saktësisht. Përndryshe ke borxh të madh ndaj meje si individ, sikur t'i kishe vrarë dy nga vëllezërit e m'i që m'i ka lindur nëna. Prandaj provo, nëse munde, një përgjegjësi kaq të rëndë t'ja shkarkosh dikujt tjetër, por jo zotit, nëse do të mundesh. Dhe jo vetëm ti, por, në fund të fundit, nëse e vërteta nuk do të ndriçohet sa duhet, të njejtën përgjegjësi do ta ndajnë me ty edhe ca njerëz tjerë.

Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë. Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mossdija...

Sidoqoftë, do të shohim! Unë do të pres se çka do të më shkruash. Bëje sa më parë, përndryshe uji do të rrjedhë drejt kahjes së vet...

Do të ishte e këshilluar që për këtë letër të mos mësoj asgjë as Dema dhe as ndonjë njeri tjetër, pse ata nuk kanë të bëjnë asgjë me këtë çështje, së paku, njëherë përnjëherë.

Më në fund letrën e shkruar, jepja Demës që ta lëshoj në postë, pse unë nuk gjendem ku isha përpara.

U pafshim si e dashtë nevoja!"

(Faridin Tafallarit; Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 407)

4. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, 21 janar 1981

I dashur shoku Taxist, (21 janar 1981)

Mirë jam e s'jam; mirë qofsh. Ndoshta, edhe patjetër edhe ty të ka goditur lajmi i hidhur, i burgosjes së shokut tonë, Shantos. Mua më ka goditur shumë, më shumë se sa të kishte qenë vëlla i vërtetë, pse shoku i idealit është vërtetë më i afërt se vëllau "natyror".

Nëse është e vërtetë se jemi goditur nga ky lajm i hidhur, ç'ka nuk ka dyshim, atëherë duhet edhe të mendohemi sa më thellë, sa më konkret, sa më përkatësisht për të gjitha ç'kanë ndodhur. Kanë ndodhur gjëra me përgjegjësi të madhe, të cilat nuk guxojnë të themi se janë fenomene natyrore, por për këtë, mbi vete do ta marrë dikush përgjegjësinë.

Pasi është S.... ke Skelja, letrat po t'i dërgoj ty, e ti ua jep të dyve, si Skeles ashtu edhe S..., mysafirit të Skeles. Por mysafirit të Skeles i thuaj se vetëm atij po i dërgoj letër, ndërsa Skeles ia jep në vetmi, duke e këshilluar që të mos dinë për këtë S...

E lyp puna që në këto raste të veprojmë kështu: ti t'ia japësh edhe Skeles edhe S... letrat e tyre, duke i treguar Skeles, ku edhe unë po i shkruaj në letrën e tij, ndërsa S... këshilloje që mos ta dijë Skelja që ai ka marrë letër.

Ti shok do të na ndihmosh shumë në ndriçim të hijeve. Ke qenë në korrent (i informuar që nga fillimi, edhe pse në mënyrë sipërfaqësore, por çka është edhe më e rëndësishme, ti ke dëgjuar se çfarë ka thënë S... që kur është kthyer përsëri, pa shokun tonë, pa kryer "akcionet", të marrura përsipër nga koka e tij, por që fatkeqësisht na e "mashtroi", edhe shokun tonë. Nuk ka dyshim se kemi humbur shokun më aktiv të radhëve tona njëherëpërnjëherë, prandaj qëndro e vepro si të dimë dhe si të vlerësojmë. Çdo gjë që është folur nga gojë e tij, mundohu ta shkruash në letër, për të bërë krahasime me atë se çka do të shkruaj ai vetë. Për këtë konsultohu me Skelen, gjithçka që është për t'u konsultuar dhe mendoni metoda edhe më të mira që të zbulohet e vërteta e kulluar, pse kjo përgjegjësi kaq e madhe s'do të ngelë pa përgjegjës. Pra, të mbetet detyrë që ta marrësh mundin që të shkruash çdo gjë që ke dëgjuar, e që do të na ndihmojë për ndriçim të vërtetës; më vonë do të shohim: çdo kujt rrobar sipas shtatit! Provo sa më parë, pasi të tilla ndodhi, duhet të jemi të shpejtë, preçizë dhe të rreptë!

"Bashkimi" i ri është dalur nga shtypi. Ca numra po t'i dërgoj bashkë me këto letra, por asesi të mos i jepni S... Skelja le ta lexojë në punë, le të këshillojë se kujt duhet t'ja shpërndani, nëse ai di më shumë adresa.

Të shihni edhe për një gjë: sa i përket kontributit të rregullt në formë të kuotizacionit (anëtarësisë), edhe ju të celulës suaj, të rrethit tuaj, duhet doemos ta shikoni këtë pak më ndryshe, përkatësisht se si kërkohet edhe përmes Statutit tonë. Pra, ndihmat

tuaja, detyrimet tuaja t'i kuptoni si duhet, pse edhe nga ana materiale kushtëzohen shumë sukseset. Ne mendojmë se ju andej do të keni grumbulluar rregullisht dhe jeni duke i bërë të gatshme për nevojat dhe kërkesat. Tani, nëse keni tubuar përpara, do të ishte e mira së mirës, por nëse jo, atëherë bëje këtë me urgjencë, pse "Bashkimi" do të dalë më rregullisht se përpara. Po ashtu, deri sa të del edhe "Lajmëtari i lirisë", jemi dakorduar që ta ndihmojmë në financim dhe shpërndarje. Prandaj, u përgjieni obligimeve tuaja, duke mbledhur të holla për këto nevoja dhe nevoja të tjera. Për këtë bisedo edhe me Skelën, por edhe me militantët, anëtarët e tjerë, dhe shikoni të mblidhni ndonjë shumë edhe nga simpatizantët.

Menjëherë, posa ta marrësh këtë përgjegje, më njofto në mënyrë sipërfaqësore dhe na informo, e pastaj koncentrohu në atë që të shkruash çdo gjë që ke dëgjuar nga S... për shkuarjen e tyre, për arrestimin e Shantos, për kthyerjen e tij, etj., për të gjitha.

-Ja vdekje ja Liri!

Mirëupafshim Vermosh Gucia

Pas shkrimi: Shiko, janë kthyer shumë shokë nga pushimi. Nëse ke dëgjuar nga ata ndonjë të re, informo. Më në fund, po përfitoj rastin të përshëndes edhe familjen.

S. - Sadik Blakaj
Skelja- Demë Dema
Vermosh Gucia- Ibrahim Kelmendi
Taxisti- Faridin Tafallari
Shanto- Hysen Gega

(U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari në librin; Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 408-409)

5. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, 30 janar 1981

Shoku Taksist, 30 janar 1981

letrat tuaja, tënden dhe të Skeles i mora. Kuptova se edhe ju, ju kishte goditur arrestimi i Shantos. Por, kohë për vajtime nuk ka! Përndryshe, armiku për këtë ka shtuar terrorin në këto përmasa – ne duhet t'i përgjigjemi ashtu si e meriton! Edhe për Shanton ka për të paguar armiku, cilido qoftë! Sigurisht edhe tradhtarët, që janë armiq në katror!

Më konkretisht për rastin e shokut Shanto dhe konsekuencat që duhet nxjerrur nga ky rast, do të shkruaj njëherë tjetër.

Kësaj radhe po ju dërgoj 50 "BASHKIMA". I shpërndani. Gjithsesi duhet të shkoni në Mercedes, ke shokët atje, për t'u dhënë "BASHKIMAT" dhe për të biseduar për Shanton, por jo që të frigohen se u ndodh atyre si Shantos, por që t'u shtohet revolta edhe më. Nëse u duhen shokëve të Mercedesit më shumë, atëherë ma dërgoni adresën e njërit prej tyre. U thoni se konviktet e tyre duhet t'i furnizojnë ata vetë, dhe jo vetëm t'i dërgohet çdonjërit për vete, pse shpenzimet janë të mëdha. Këtë e bëjnë, kur dinë se në cilat dhoma banojnë bashkatdhetarët tanë dhe atëherë kur ata kanë ndërrimin e punës nën derë t'u shpërndahet "BASHKIMI".

Skelja do të ishte dashur të dëgjojë përreth se ku dhe te kush po rrinë S... dhe po ashtu të hulumtohet rrethi i S... në vendlindje, pra, të vijë në kontakt me dajën, duke i shkruar motrës e ajo t'ia dërgoj letrën dajës, ose përmes ndonjë forme. Gjithsesi na duhen informata nga atje, vendlindja. Ndërsa ti, provo të gjesh dikë që njeh burgun e Prizrenit, duke na siguruar ndonjë master plani, se si është i ndërtuar dhe informata përkatëse.

Besoj se së shpejti do të shihemi për të biseduar gojarisht.

Ja vdekja ja liri!

I juaji: Vermosh Gucia

(U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari në librin; Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 409-410)

6. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, 7 mars 1981

I shtrenjti Shok! (për Faridin Tafallarin)

Letrën tënde e mora – ishte e qartë dhe me rëndësi. (E di se ke patur vështirësi, pasi vetëm ti mund të shkruash me maqinën që ti përdor).

Mue gjithsesi më duhet të jem të premten në Bazel, pasi do t'i takojë ca shokë. Kështu, të shtunën do të jem andej. Kështu qëndron puna njëherë për njëherë.

Unë u informova se shoku Skele ka udhëtuar për në Kosovë. Kjo letër do të ishte dashur ta gjej këndej. U çudita për guximin që ka marrë! Sigurisht që edhe u befasova, pasi nuk ka qenë e udhës dhe e kohës të bëhet një gjë e tillë. Por të shohim çfarë do të na thotë dhe si ka kaluar.

Si duket Sadiku është parë prapë (para tri javësh) në Bruksel, por sinqerisht jam lodhur shumë, përndryshe nuk qëndron situata më së miri. Vetëm të bashkuar dhe të vendosur, si kurrnjëherë më parë, do ta përballojmë gjendjen, për të ecur përpara!

Po ndahemi për këtë radhë, duke të përshëndetur ty dhe familjen përzemërsisht!

I juaji: Vermosh Gucia

Pas shkrimit. Po ta dërgoj një fotografi të Shantos. Nëse doni mos harroni që ta ripunoni andej, pasi e kam filmin e kësaj fotografie, bile kam ende edhe fotografi të gatshme.

Më njofto se te kush gjendet romani "Prisja e komitëve", pasi këndej gjendet një shoqe studente, e cila do ta lexonte me andje. Po e patët andej e dërgoni menjëherë. Do ta merrni prap, po që se e keni lexuar.

(U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari në librin; Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 410-411)

7. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, 18 mars 1981

18 mars 1981 (në mërgim)

I shtrenjti shok,

... Të shtunën, në mëngjes do të jem në Stuttgart ke Namiu. Prej aty do të udhëtojmë për në Mynih (München), pasi atje është një panair, ku merr pjesë edhe Shqipëria. Ti ke mundësi, po pate kohë, të vish në Mynih bashkë me mua dhe Namiun. Për çdo eventualitet i telefono Namiut të premten në mbrëmje dhe do dihet definitivisht se kur do udhëtojmë, ose si do ia bëjmë. Mua më duhet doemos të jem andej, pasi do të më duhet të takohem me shokë. Për çdo eventualitet po t'i dërgoj dy numra tel. Të Namiut dhe të Atdheut. Ti paraqitu ke tel. i dytë ashtu si të quaj unë, Taksisti.

Për të tjera gjëra do bisedojmë kur të takohemi.

I juaji Vermoshi

8. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, 19 mars 1981

19.03.1981 (në mërgim...)

Shok,

më duket se vetëm të kam shkruar se t'i dërgojë dy numra telefonit, por s'i kam dërguar. Nëse kam harruar po t'i dërgoj me anë të kësaj kartoline;

Namiu - 0711/312656

Mustafë Kelmendi (vëllau) 0209(+)/428630, pra hyrja duhet me qenë Mulheim/Ruhr, për të cilën s'po jam gjithaq i sigurt.

Besoj se do të shihemi gjithsesi. Deri atëherë mirëupafshim. Të fala Ty dhe familjes.

I juaji Vermoshi

***

INFORMACION i Ambasadës Shqiptare në Paris, 17 korrik 1981

I N F O R M A C I O N

mbi një takim me kosovarin Ibrahim Kelmendi

Me daten 8 dhe 9 korrik takuam, jashte selise se Ambasades, kosovarin Ibrahim Kelmendi qe banon ne Dyseldorf te RFGJ. Kerkesa per kete takim u be nga ana e tij nepermjet kosovarit Mehmet Kastrati i cili banon ne Bruksel. Nga Mehmet Kastrati per te cilin kemi mendimin se eshte njeri pozitiv mesuam se Ibrahimi kishte ardhur ne Paris per te takuar punetore kosovare dhe per te pare mundesine e organizimit te tyre. Me kete rast ai kishte çfaqur deshiren qe te takohej edhe me ndonje shok te Ambasades sone. Kerkoi gjithashtu qe takimi te behej ne ndonje lokal te Parisit.

Ne diten e pare biseda u be ne prani te Mehmet Kastratit ndersa diten tjeter ai kerkoi qe te takohej perseri me ne meqense nuk donte te fliste ne prani te te tjereve.

Gjate bisedes ai na informoi sa me poshte:

Ne Kosove dhe ne Evrope veprojne tre grupe te rendesishme kosovare:

”Fronti i Kuq Popullor”, ”Levizja nacionalçlirimtare” dhe ”Liria”.

”Fronti i Kuq Popullor” eshte krijuar jashte Kosoves me punetore emigrante. Nje nder drejtimet kryesore te punes se tij ka qene ai propagandistik. Gazeta qe botohet prej tij, ”Bashkimi”, eshte shperndare deri ne 3 000 kopje ne Kosove. Drejtim tjeter ka qene puna me kosovaret qe banojne ne Kosove. Per kete qellim jane çfrytezuar vajtjet ne Kosove te elementeve te shendoshe dhe militanteve te Frontit atje per te marre kontakt e per te sqaruar masat e popullit. Keto vajtje kane qene shume te dendura dhe ka qene shfrytezuar çdo rast i mundshem per te shkuar ne Kosove.

Ne syte e kosovareve kjo organizate ka emer shume te madh por ne te vertete ajo nuk e justifikon kete emer. Mbase kjo pershtypje eshte krijuar nga perhapja e gjere e gazetes, por ne fakt nuk eshte keshtu. Kete e them me shume kompetence sepse e njoh me mire se kushdo tjeter kete organizate. Bile mund te them se ne ngjarjet e fundit ne Kosove Fronti nuk ka ndonje rol te veçante, nuk ishte ai qe i pergatiti demonstratat dhe gjithe ate levizje.

”Levizja nacionalçlirimtare” qe drejtohet nga Isuf Gervalla eshte organizata me e fuqishme qe vepron ne Kosove dhe ne Evrope. Ne perberje te saj ka intelektuale dhe kuadro te intelegjences kosovare, nepunes te rangjeve te mesme te partise e te

pushtetit ne Kosove. Ne fakt, kjo eshte organizata qe ka nxitur e shperthyer demostratat e Kosoves. Bazat e saj ne Kosove jane shume te forta.

”Liria” eshte nje organizate ne perberje te se ciles ka komunist dhe elemente te gatshem per te perqafuar idealet e komunizmit. Pjesa me e madhe e tyre jane intelektuale dhe studente. Nuk njihen udheheqesit e saj.

Gjatë bisedes, Ibrahimi u ndal disa here ne çështjen e formimit te nje partie komuniste m-l ne Kosove. Jepte keto argumenta:

Ne kushtet kur levizja brenda ne Kosove po orientohet drejt nje lufte gueriljesh qe do te çoje pastaj ne lufte partizane dhe kur ne Evrope klasa punetore kosovare po organizohet ne forma te ndryshme per te arritur çlirimin kombetar te Kosoves dhe realizimin e endrres te bashkimit me Shqiperine, nder shume komuniste ka lindur mendimi se eshte e domosdoshme qe te krijohet nje parti komuniste marksiste-leniniste per ta udhehequr kete lufte. Jemi te ndergjegjshem se na presin beteja te reja edhe me te veshtira prandaj duhet ta kalitim njerezit tane dhe partine, t’i brumosim ata dhe t’i bejme te ndergjegjshem per luften tone. Ne jemi te ndergjegjshem se bashkimin e popullit tone ne lufte nuk mund ta beje askush tjeter veç nje partie marksist-leniniste.

Siç doli edhe nga biseda, Ibrahimi po punon aktivisht ne kete drejtim. Ai na tha:

Secili prej te tre grupeve e ka ndjekur me kujdes veprimtarine e njeri tjetrit. Eshte pare dhe vleresuar veprimtaria konkrete e tyre, jane verejtur njerez te ndryshem dhe na eshte formuar mendimi se qe te tre keto grupe jane ne rruge te drejte dhe une e perjashtoje mendimin qe ndonjerin prej tyre ta kete formuar UDB-ja. Une, ne menyre personale por edhe si perfaqesues i ”Frontit te Kuq Popullor” kam marre kontakt me shoke te ketyre grupeve. ”Fronti i Kuq Popullor” dhe ”Liria” jane ne unitet mendimi. Nderkohe, ”Levizja nacionaçlirimtare” mban pak distance, jo pse ka gje kunder nesh, por se kane mendimin se eshte e panevojshme qe te krijohet nje parti ne Kosove kur ne e kemi Partine e Punes ne Tirane. Per, rrjedhim, arsyetojne ata, per ne nuk mund te kete dy parti shqiptare. Ne po i vazhdojme bisedimet per te arritur ne ndonje qendrim te perbashket.

Veç kesaj arsyeje, Ibrahimi mendonte se bashkimin e komunisteve kosovare rreth nje partie komuniste m-l e kane penguar edhe klandestiniteti i thelle, faktori gjeografik si dhe frika se mos eshte futur gjekundi UDB-ja. Ibrahimi shpjegoi se forma e organizimit te grupit eshte celula treshe por nderkohe qe nuk njihen te gjithe anetaret e grupit nga ana e udhehqesve te tyre mbahen evidenca te rregullta per te gjithe punetoret ne menyre qe te njihen dhe te provohen ne veprimtarine konkrete.

Gjate bisedes tha se kur kane analizuar ngjarjet e Kosoves anojne me shume nga konkluzioni se u derdh shume gjak por u fitua pak. Organizimi i demostratave çaloi ne shume drejtime. Nje nder dobesite me te medha qe kemi eshte se jemi mbeshtetur me shume tek intelegjencia dhe e kemi nenvleftesuar punen me klasen punetore dhe aq me shume me fshataresine. Megjithate vullneti dhe deshira per ta çuar deri ne fund luften e filluar nuk mungon. Rezistenca e armatosur po merr format e një lufte partizane, te cilen do ta forcojme edhe me shume ne te ardhmen.

Egziston nje mendim, tha ai, se po qe se jugosllavet do te na japin statusin e republikes kete do ta bejne me 29 nentor kur kane diten e festes kombetare te krejt federates. Ata nuk duan qe dita e dhenjes te se drejtes per republike te jete nje dite tjeter e ndryshme nga ajo e federates. Neqoftese kjo nuk do te realizohet, atehere rezistenca jone do te marre nje hov te madh. Do te luftohet ne dy drejtime: demostrata ne qytete dhe lufte ne male. Kemi menduar qe elementet me te mire te mos i hedhim ne demostrata por t’i kemi per luften guerilje ne mal. Keshtu qe gjate zhvillimit te demonstratave njerezit tane do te ndjekin, ne nje distance te caktuar, vargun e demostruesve. Duke qene te armatosur ata do te jene te gatshem te nderhyjne ne rast se kunder demonstruesve do te perdoret dhuna e armatosur.

Lidhur me parullat e hedhura ne demostrata ose ne shtyp ai na tha:

Parulla qe kemi hedhur ”Kosova Republike” nuk eshte e plote. Ne jemi per bashkimin e te gjitha viseve shqiptare ne nje republike, e cila, shpejt ose vone, do te bashkohet me Shqiperine. Po t’i leme shqiptaret nen Malin e Zi apo nen Maqedonine atehere ata do te asimilohen. Prandaj puna duhet bere menjehere, sa kohe qe hekuri eshte akoma i nxehte. Vekuptohet se qe nje parulle te behet e pranueshme nuk mund t’i permbaj me hollesi te gjitha keto.

Ibrahimi shfaqi edhe kete mendim:

Nje hov te madh i dhane luftes se popullit kosovar qendrimet e PPSH-se. Kur degjohej Radio-Tirana apo ndiqej televizioni shqiptar njerezve u shtohej besimi, gje qe e shprehin keshtu: ”Tash jemi gati me hanger me dhambe bjeshket e jo ma serbin”. Kontaktet e vazhdueshme, shkembimet kulturale midis Shqiperise dhe Kosoves kane sherbyer ne nje mase te madhe per zgjimin e ndergjegjes kombetare te popullit tone. Pa keto ne do te ishim akoma shume vite prapa.

Sipas tij, ndihma dhe siguria qe u jep Shqiperia dhe kushtet ne te cilat jeton populli i Kosoves kane bere qe faktori subjektiv te jete me i pjekur se ne vitin 1941 kur u krijua PKSH. Tani ne kemi nje klase punetore te ndergjegjshme e cila po kalitet ne demostrata dhe aksione konkrete kunder armikut.

Gjate bisedes, ai, pa insistuar, sikur donte te mesonte se ç’mendojme ne per demostratat qe ata kane organizuar ne qytete te ndryshme te Evropes. Ai tha: ”Neve na duket qe jemi ne rruge te mbare, por mbase jemi te gabuar. Ne mendojme se demostratat jane nje mjet i mire per te pergatitur njerezit. Duhet mbajtur mire parasysh se ne mergim jane mbi 100 mije punetore te cilet perbejne nje force kolosale. Ata jane pjesa dermuese e klases punetore kosovare. Prandaj kur te vije dita qe te kthehen ne Kosove ata duhet te jene te pergatitur dhe te formuar ideologjikisht.”

Te vetmin sugjerim e kerkese qe Ibrahimi pati ne drejtimin tone ishte qe kesaj vere te lejohen sa me shume emigrante kosovare per te vizituar Shqiperine. Shume prej punetoreve, tha ai, nuk do te mund te vene ne Kosove per arsyet qe dihen, prandaj do te ishte mire qe kete ata ta zevendesonin me nje vajtje ne Shqiperi.

Ne fund tha se punet mund ta sillnin edhe here te tjera ne Paris dhe me kete rast do te kerkonte te takohej perseri me ne.

Ne nuk u shprehem per problemet e organizimit te luftes se Kosoves qe trajtoi Ibrahimi gjate bisedes. Po keshtu edhe per çeshtjen e ardhjes se emigranteve kosovare ne Shqiperi. I folem gjeresisht per perkrahjen e vendosur e pa rezerve qe i japim luftes se drejte te popullit te Kosoves, etj.

Paris, me 17 korrik 1981	Kujtim Hysenaj	nënshkrimi
	Idajet Hoxha	nënshkrimi

***

9. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, dhjetor 1981 (NË BAZA TË SHËNDOSHA MARKSISTE-LENINISTE!)

Shumë i dashur shok, me familje e shokë,

Viti i ri që po ik, pa mëdyshje, do të mbetet vit historik për popullin tonë. Ai na solli fitore të mëdha. Sidomos, fitorja më e madheqe humbja e durimit, për të ndejur në robëri si më parë. Edhe shpirti i sakrificës për lirinë e atdheun, i formuar ke shumë shqiptarë, të themi ke mbarë populli, qe fitore e madhe.

Viti i Ri është viti vendimtar për fatin e ardhmërinë e popullit tonë. Revolucioni do të ketë fazën vendimtare gjatë Vitit që po vjen. Kjo do të thotë se nga ne kërkohen sakrifica më të mëdha se kurdoherë gjatë Vitit të Ri, deri në fitore të plotë përfundimtare. Prandaj më lejoni tua uroj Vitin e Ri 1982 të gjithëve, duke ju dëshiruar shëndet e sukses, sidomos në veprimtarinë patriotiko-revolucionare!

Si shokë që jemi, dëshiroj që gjatë Vitit të R 1982 shoqëria të thellohet edhe më shumë, në baza të shëndosha revolucionare - marksiste-leniniste!

KOSOVA-REPUBLIKË!

I juaj gjer në vdekje

Shoku (Ibrahim Kelmendi)

(U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari në librin; Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 411)

10. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, 8 prill 1982

Në mërgim, më 8 prill 1982

Shoku Fahredin,

nuk dyshohet që t'i s'do i marrësh punët me seriozitetin dhe sinqeritetin më të madh. Por punët duhet filluar shpejt e shtruar, para se përmasat e së keqes të bëhen të pa korrigjuara.

Vetë rrethanat, mbi të cilat edhe biseduam, patën kushtëzuar një punë të tillë, çfarë patëm bërë gjer në vdekjen e shokëve. Të dukej sikur puna nuk ecën sa duhet, si duhet e me sinqeritet. Po të ishin shokët në radhët tona, ndoshta ashtu do vazhdonin prapë, deri në bashkim të plotë. Tani, kur punën në LNÇ (në Perëndim) kanë marrë në dorë ca "shegërta" të pa mësuar mirë, pse shokëve të rënë duket se nuk u ka mjaftuar koha t'i ngrisin për kuadra të nivelit, na duhet të mbajmë qëndrime të matura: Shokët në fjalë (nga egoizmi...) donë të shfrytëzojnë vrasjen e shokëve për ta "ngritur" LNÇ-në gjer në qiell kurse radhët tjera t'i "shtrinë" për balte, çka nuk është shoqërore dhe nuk qon ka bashkimi. Kështu, si po veprohet, siç edhe u bisedua, jo vetëm se dëmtohet lufta, por edhe vlera e shokëve u ulet. Të tjerët mund t'ua masin vlerën shokëve të rënë me nivelin e sjelljet e shokëve që lanë prapa. Sidomos vlera e shokëve do matet me atë se a arriti armiku që të na shpartallon që në orët e para.

Tipat me të cilët shokët e rënë nuk gjetën kurrë mirëkuptim, nuk do të duhej të futeshin me nxitim në radhë ose të informoheshin për bisedat tona. Po ndodhi ajo, atëherë të jep me kuptu se në ato radhë ka depërtuar dikush më heret, dihet nga elementët spuinë. Bisedat që bëhen në mesin tonë, edhe atëherë kur nuk gjindet mirëkuptim, duhet të mbahen sekrete, deri sa dikush të ketë rrëshqitur krejtësisht në pozicione të huaja. Kështu ishte edhe mendimi ytë mbramë. Prandaj shpejto të ua tërhekish vërejtjen shokëve, ndryshe nuk dihet ku do dalin punët tona, pse ka edhe parime, ku pushon toleranca.

Në biseda, si edhe në letër, u zgjerova, pasi ende të dimë për shok të radhëve dhe idealit dhe i tillë duam të mbetesh!

– Kosova - Republikë!

Shoku (Ibrahim Kelmendi)

P.sh. Emrin e ati shoku, që më pat ngarkuar t'i bëjë të fala shokut J..., po ta le. E kryej këtë porosi,

11. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, maj 1982

Shoku Fahredin,

pasi që në Mercedes janë konvikte, nuk po i dërgojmë atje askujt. Ti do të ishte dashur ta marrësh menjëherë mundin që t'ua dërgosh dhe atyre. Sa për Rrethin tuaj, dihet që do i shpërndash.

Po ta keni mësuar se ku dhe kur do mbahet **koncerti** do të kishte qenë mirë të bisedohet se çfarë duhet ndërmmarë dhe çfarë kemi mundësi. Trakti në fjalë synon informimin e bashkatdhetarëve, që, po që se ndërmarrim ndonjë aksion, të kenë mirëkuptim dhe të mos jenë indifirent; po kështu që përpara, udbashët të dezorientohen, se ne vetëm me bojkotim kemi ndërmend t'i ballafaqojmë e pengojmë.

Për të gjitha, po u duk e arsyeshme kosultimi gojor atëherë mundesh të telefonosh ose të shkruash.

Mirëupafshim, Shoku

(Faridin Tafallari; LETRA, TË DËRGUARA FARIDIN TAFALLARIT, NGA IBRAHIM KELMENDI, www.albaniapress.com, 11 dhjetor 2013)

12. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, maj 1982

Në mërgim, maj '82 (1982)

I dashur shok,

(Të njejtën letër po ua dërgojme edhe shokëve tjerë.)

traktët aktuale që po merrni duhet shpërndarë sa më parë, pse në prag është turneja, për të cilën bëhet fjalë në trakt.

Taktika e armikut po dihet. Mbi të lëzojmë edhe në traktin në fjalë, "Klika e Beogradit - "të vret natën e të këndon ditën"". Armiku po synon mashtrimin tonë përmes turneve të këtilla. Kësaj i duhet gjetur ilaçi gjegjës..., prandaj në rrethe duhet të diskutoni me shokë se cila formë është më efektivja për t'ju ndajvuar armikut. Nuk është çasti të bëjmë sehir - në njërën anë të na vrasin, në tjetrën të na mashtrojnë edhe me koncerte, është cinizëm i poshtër. Mendojmë se përmes traktit që keni në dorë është demaskuar armiku, për aq sa është e mundur përmes të një trakti. Por puna tjetër duhet bërë nga shokët në rrethe, pse përvoja na tregon se agjitacioni gojor - traditë popullore - ndihmon më së shumti për t'i sqaruar bashkatdhetarët, që të mos bien në kurthë të armikut.

T'i tregojmë edhe njëherë armikut se jemi bijë e bija të popullit, që nuk biem në kurtha!

Kosova-Republikë! Shokët.

(Faridin Tafallari; LETRA, TË DËRGUARA FARIDIN TAFALLARIT, NGA IBRAHIM KELMENDI, www.albaniapress.com, 11 dhjetor 2013)

13. Kush është vojvoda Ramë Nikçi?

Shkrim i shpërndarë nga Ibrahim Kelmendi në maj 1982 me titullin:

KLIKA E BEOGRADIT –
"Të vret natën, të këndon ditën..."

Sipas informatave të siguruara, ka fundi i majit – për "nder" të "ditës së rinisë jugosllave" (me nder me thën...) dërgohet për të na "argëtuar"... SHKA "Rugova" e vojvodës Ramë Nikçi. Turneja është paraparë në qendrat kryesore të Gjermanisë P., Zvicrës e Belgjikës.

Po kështu jemi të informuar së asnjë shoqëri nuk ka pranuar të ndërmarri turne të këtillë, bazuar në situatën që mbretëron, pos "Rugovës", udhëheqësi "trim" i së cilës ka rrahur gjoks: "Askush nuk do guzon të ma prishë koncertin..." Në fakt shumë shoqëri të afirmuara nuk ekzistojnë më, pse ato kanë kënduar këngë "irredentiste", që kanë "frymëzuar rininë me nacionalizëm shqiptaromadh..."

Kush është SHKA "Rugova"?

"Rugova" është shoqëri kulturore-artistike (SHKA) e Pejës, anëtarët e së cilës janë rugovasë. Folklori dhe lojrat duhet të jenë me origjinë nga Rugova kreshnike, emrin e së cilës e mban shoqëria.

Në historinë tonë të lavdishme Rugovën e njohim si vend ku armiqët pushtues kanë thyer qafën, siç e thotë edhe kënga: "Ku po i del syni Shqipnisë?/ Del Rugova për derë t'kapisë... ndërsa rugovasit si kryengritës trima në mbrojtje të trojeve, veçmas kundra pushtuesve malazezë në mbarim të shekullit të kaluar dhe në fillim të shekullit tonë, kur mbarë populli luftonte për P a v a r ë s i.

Përkundra kryengritjeve të pandërprera çlirimtare, Rugova me tanë Kosovën u pushtu nga mbretëritë shoveniste të Serbisë të Serbisë e Malit të Zi dhe më vonë, pas Luftës Dytë Botërore u ripushtu...

Bijtë dhe bijat e Rugovës, ashtu si dhe të parët e tyre, vendosën që atdheun t'mos e lënë në robëri të plotë – koloni klasike të të huajve. Në Pranverën Kosovare (1981) u ngritën haptas e me vendosmëri për t'i kërkuar të drejtat elementare, që popujt tjerë të Jugosllavisë i gëzojnë, si që Kosovës t'i njifet Statusi i Republikës së federuar. Emrat e këtyre patriotëve revolucionarë u janë të njohur Kosovës dhe më gjerë, si ai i shokut Ali Lajçi me shokë e shoqe, të cilët edhe në gjyqe tmerruan gjykatësit çetnikë me vendosmërinë dhe revolucionaritetin e tyre. Dënimet e rënda, 10 - 15 vjet burgim të rëndë s'i tremben fare, pse ishin të bindur se kërkesat e popullit janë të drejta dhe duhet të plotësohen.

Sa kreshnike na del Rugova, kur flasim për kryengritësit trima, ndër ta shoku Ali Kelmendi, komunisti i orëve të para, kur flasim për gjithë ata rugovasë, që tani gjenden në kampet jugosllave. Sa shumë ia njollosin emrin Rugovës ca bastardë. Por s'do ia arrinë dotë, pse rugovasit ruajnë me fanatizëm krenarinë se janë nga Rugova! Këtë e bën sidomos vojvoda Ramë Nikçi, përmes SHKA "Rugova", anëtarët e së cilës janë kryesisht të kompromet uar, moralisht dhe politikisht, që janë gati të gjithë nga familja e vojvodës dhe farefisit të tij.

Ç'do të thotë fjala v o j v o d ë ?

Vojvodë është gradë ushtarake në mbretërit serbe e malazeze. Këtë fjalë do ta gjejmë të sqaruar në "ilustrovana politika" të Beogradit. Por për çudi, kur klika serbomadhe ka ndërmarrë fushatë histerike kundra "nacionalizmit romantik" shqiptar, si nuk u bie fjala vojvodë në sy, që nuk ka të bëj vetëm me nacionalizmin serb. Për këtë nuk kanë frikë as gazetari shovenist Zec as vojvoda Ramë, që e përdorin me krenari.

"... Vojvoda rugovas, shkruan "ilustrovana politika" (më 26.05.81), është përfaqësuesi i tanishëm "lozës" (serbisht: loza), e cila që nga kohërat turke ruan qetësinë dhe paprekshmërinë e Patriarkanës...)

Siç na del, vojvodët kanë qenë rojë e rendit, ndërsa vojvodët e familjes Nikçi (nga Shtupeçi i Madh, fshat i Rugovës) kanë qenë rojë besnike e Patriarkanës, të ndërtuar nga Dushani, për ta përjetësuar robërinë e "stara Serbisë" (siç e quajnë shovenistët Kosovën.).

Kush është vojvoda Ramë Nikçi?

Të shkruajmë se kush është vojvoda Ramë Nikçi nuk e kemi vështirë, pasi ai vetë na e ka lehtësuar këtë, duke përmbledhur historinë e vetë e të familjes në bisedën dhënë "ilustrovana politikës" së Beogradit, Nr. 1177, të 26.05.81. Pos kësaj bisede, ai në rrethin e Pejës është ndër më të kompromet uarit. Sa ai është edhe vetëm udbashi rankoviçevës Bajram Dreshi. Të dy së bashku, me ca të tjerë, Rugovës ia njollosin emrin e pa njollosur, pse bijtë e bijat i dalin asaj zot.

Në artikullin e revistës në fjalë, "Besa nije vracena" lexojmë:

"Ramë Nikçi është shef i shërbimit juridik ndërkomunal pranë Entit për Inkuadrim në Pejë..." Siç e pamë më lartë, është përfaqësuesi i tanishëm i "lozës" për ta mbrojtur Patriarkanën.

Në pyetje të gazetarit, se a ka marrë pjesë ndonjë rugovas në demonstrata "nacionaliste", vojvoda përgjigjet: "Po. Të tillëve ju takon sipas ligjit nga qeveria, kurse nga rugovasit – bojkotimi (izolimi). Në shtëpitë s'do hynë askush, dërisa Pleqësia jotë të mos vendos ndryshe. Nga vllazëria ime Nikçi nuk ka asnjë demonstrues. E kam vërtetuar dhe për këtë jap fjalën. Askush nga anëtarët e SHKA "Rugova" s'ka marrë pjesë në demonstrata. Më është bërë qefi..." Pastaj vazhdon vojvoda: "Ishim dy herë si shoqëri mysafirë në RPS të Shqipërisë. Këtë vit shqiptarët është dashur të na e kthejnë vizitën, por le të mos vinë..." Më poshtë vijon vojvoda: "... Çka u duhet këtyre demonstruesve që kërkojnë t'i bashkangjiten Shqipërisë (...). Këtë liri, siç e kanë shqiptarët në Jugosllavi, nuk e kanë patur asnjëherë askund dhe secili që mendon ndryshe – është njeri i keq..."

Gazetari pyet: "Babën tënd, gjithashtu vojvodë rugovas, e kanë vrarë në pritë në vitin 1939. Kush dhe përse?"

Ramë vojvoda përgjigjet: "Kanë vrarë babën tim me dy mixhallarë, para syve të mij, brenda gjysmë ore. Ka qenë larje llogarish me fiseve, nuk ka qenë hakmarrje gjaku. U ka penguar (mendohen "vrasësit") pse baba ka qenë vojvodë rugovas, që ka **ruajtur** (nënvizimi ynë) Patriarkanën e Pejës..." Pastaj vojvoda vijon me nostalgji çetnike:

"... Me konakun e vjetër të kishës m'është djegur edhe dhoma në të cilën kam banuar prej 1941-tës e deri në mbarim të Luftës. Në të ka qenë kërveti, në të cilin kam fjetur, aty ka qenë edhe luga me të cilën kam ngrënë dhe fotografitë e t'parëve të mij. Të gjitha janë djegur..."

Artikulli mbaron me fjalët e vojvodës Ramë: "Unë i **dua** (nënvizimi ynë) shumë fjalët e Mark Milanit..." (Ato s'po i citojmë – Shtojmë se Mark Milani ka qenë komandant i forcave pushtuese malazeze, në luftë për t'i pushtuar Plavë, Gusi, Hot, Grudë e Rugovë...).

E cituam si shumë artikullin në fjalë pse u pa e arsyeshme përmes të kësaj reviste çetnike, gjegjësisht përmes fjalëve të vojvodës, ta njohim udhëheqësin e SHKA "Rugova", i cili, sipas "Pravosllavjes" (Gazetë kishtare serbe", "kur ka parë konakun në flakë ka qa." Vojvoda kësaj radhe "demanton" atë çka ka shkruar "Pravosllavja", duke thën se rugovasit nuk qajnë kur t'u ndodhin fatkeqësi të rënda...

"Patriotizmi" serb i Ramë vojvodës, siç na bind ky artikull dhe profesioni i tij si vojvodë, ia kalon "patriotizmit" serb të shumë çetnikëve, të cilët nuk kanë bërë dhe s'do bëjnë aq sakrifica për ta mbrojtur kishën, sa bëri familja Nikçi (nga Shtupeqi i Madh). Krenaria e Ramë Nikçit si vojvod... për ta mbrojtur Patriarkanën...!!

Duket së nana e Ramës kur ka dashur të kryen nevojë (me nder me then) në vend të m... ka pjellur rastësisht vojvodën...

Dy fjalë mbi "ilustrovana politikën".

Pasi cituam si shumë këtë pelenë, duket e udhës t'i themi dy fjalë, pse artikujt tjerë janë vërtetë artikuj të frymës çetnike.

Kjo revistë, bazuar në shkrimet mbi shqiptarët e Shqipërisë, është çetnike e shkuar çetnikëve – edhe më çetnike se ato të emigracionit çetnikë. Për t'u bindur mjafton ta analizojmë numrin në dorë.

Me radhë artikulli i parë mbi Shqipërinë: "Busija mrznje i lazi" (Pusija e urrejtjeve dhe gënjeshtrave"), i cili fillim e mbarim ka qëllim të caktuar – t'i hasmon lexuesit kundra popullit shqiptar e Shqipërisë, atëherë kur është thurur nga shpifjet e trillimet tendencioze.

Artikulli tjetër është: "Ko su albanski terroristi" (Kush janë terroristët shqiptarë"). Në këtë artikull krah plehrave të emigracionit rekcionar të agjentëve, ballistëve e zogistëve, radhiten shokët **Isuf Gërvalla** (Lavdi paqin ai me shokët Bardhosh e Kadri!), e Ibrahim Kelmendi. "Ata (mendohen shokët Isuf e Ibrahim) në fakt janë mizorë të njohur (në gjuhën serbishte, "poznati siledija"), njerëz pa ndonjë qëllim..." pra, nga artikulli kuptohet se shokët si Isufi e Ibrahimi na qenkan "terroristë" e jo klika shoveniste serbomadhe e Beogradit. Dezinformimet, shpifjet e trillimet tendencioze nuk meritojnë analiza, pse edhe "kalemgjinjët" çetnikë dinë se nuk kanë shkruar të vërtetën, por dezinformime të qëllimta në luftë kundra revolucionarëve shqiptarë dhe popullit tonë.

Edhe më karakteristik është artikulli: "To su kriminalci" ("Këta janë kriminelë"). Dëshmorët **Tahir e Nebih Mehaj** "Ilustrovana Politika" dhe klika e Beogradit i quan "kriminelë" pse nuk patën ku të shkojnë përtej shtëpisë, por u mbrojtën si u ka hije trimave – bashkluftëtarëve e nipave të Shote e Azem Galicës! Ata qëndruan dhe ranë heroikisht për të mos vdekur kurrë! Populli do i përjetëson në këngë e histori! Gjeneratat do flasin për qëndrimin heroik kundra njësive speciale të policisë së Beogradit dhe ushtrisë jugosllave, të armatosur gjer në dhëmbë me tanka, topa e helikopterë. Në këtë betejë dëshmorët Tahir e Nebih Mehaj gati shpaguan veten – do t'ishte dashur të ngordhin qindra nga tytë e trimave e jo dhjetëra, për të qenë të shpaguar. Asnjëherë luftëtarët e lirisë nuk mund dhe s'janë krahasuar me pushtuesit... Por, prap, jemi të kënaqur e krenar me këta dëshmorë të pavdekshëm në zemrën e popullit...!

Përse vjen SHKA "Rugova"?

Nuk do mend të thuhet menjëherë se ardhja e "Rugovës" është pjellë e politikës shtypëse, diskriminuese e demagogjiko-mashtruese e klanit serbomadh, në vend "që të vranë natën e të qanë ditën" "të vranë natën e të këndon ditën". Në njërën anë ushtron terror të paparë fashist, duke vrarë, terrorizuar, dhunuar, arrestuar bijtë e bijat më të mirë të popullit, bile edhe fëmijtë, që për hiqgjë dënohen me shumë vite burgim të rëndë, kurse

në anën tjetër detyrojnë turne "argëtimi"... që të mashtrojnë bijtë e popullit në kurbet, sikur në Kosovë s'ka ndodhur asgjë dhe se jeta atje është "normalizuar", sa vëtëm "kërcehet" e "këndohet"...

Sa politikë të poshtër mashtruese ka armiku "ynë" i lig... Ai ende nuk ia ka kthyer popullit kufomat e të vrarëve në demonstrata e burgje që të varrosen sipas traditave, në njërën anë, kurse në anën tjetër përmes vojvodëve ndërmerr turne "argëtimi"... Bile, që t'i fshehin krimet e pafshehshme, klika shovensite e Beogradit (fashiste shkuar fashistëve, pse terrorin dhe mënyrat e tij që ajo ushtron në Kosovë, nuk kanë ditur t'i ushtrojnë as fashistët hitlerijanë...) u ka bërë gjyq të vrarëve, që fëmijët e farefisi të shpresojnë se të afërmit e tyre të vrarë gjenden ende të gjallë në burgje...!!

Ose, mos ndoshta kësaj radhe dojnë të festojnë "suksesin" e tyre, të arritur përmes vrasjes së trefisht të shokëve e vëllezërve tanë, bijve të popullit, Isufit, Kadriut e Bardhoshit... Ah! kriminelët, do festojnë kot – kanë rënë tre, janë ngritur me mijëra!

Na kujtohet viti i kaluar, kur nga salla e koncertit policia gjermane, me direktivën e udbashëve të konzullatit të Shtutgartit, nxori nga salla shokun Bardhosh. Çfarë ndodhi? Bashkatdhetarët u revoltuan shumë, kështuqë pas një proteste te policia gjermane, e cila nuk pranoi që shokët t'i sjell në sall të koncertit, u ngritën duke thirrur njëzëri mbi 500 veta "Kosova – Republikë"! ... dhe demoluan çdo gjë. Të nesërmen koncerti i Frankfurtit u mbajt me veglat e huazuara nga "shkitë".

Kurtha e UDB-së – e cekët.

Vojvodë, more ti vojvodë! rrehe gjoks se do të mbash koncerte, pa guzuar të pengon asnjë "irredentist". Ke gabuar! Ne këndej nuk frikësohemi! Por kësaj radhe se kemi ndërmend të biem në kurthën tënde e të UDB-së. Ju aq u bën që mund të ketë gjakdërdhje. Për ju me rëndësi është kompromitimi i luftës sonë të drejtë, që pastaj, po të ndodhi ndonjë e papritur, shtypi e populli vendës të "bindet" në "vlerësimet" tuaja se ne jemi "terroristë", që në fakt jeni ju.

Kjo kurthë e pasuksesshme ngjanë në ato të Brukselit, ku keni futur në lojë "lojën" e kaubojve. Shkuat aq larg sa të vrisni punëtorë të pafajshëm në klub të punëtorëve. Populli ynë dhe bijtë e tij në kurbet dinë se kush janë armiqtë e vërtetë – ata jeni ju, ti vojvodë bashkë me farën tëndë, klika shovensite serbomadhe e Beogradit dhe mbarë tradhtarët shqiptarë të markës Sinan Hasani e Ali Shukriu me shokë!

Kësaj radhe vojvodë e udbashë, nuk kemi ndërmend të biem në kurthën tuaj, por mos harroni ditën kur do t'i jepni llogari popullit! Ne nuk jemi terroristë e kriminelë siç jeni ju. Ne jemi bijë e bija të popullit – do t'u presim me **bojkotime e urrejtje!** Në vend që të biem në kurthat tuaja, si bijë e bija të popullit që jemi, i bashkangjitemi popullit, rinisë sonë revolucionare e intelegjencës përparimtare duke kërkuar të drejtat tona legjitime, ato të drejta që kërkoi populli në të gjitha qytetët e Kosovës (dihet, edhe në Preshevë, Tetovë e Gostivar, deri në Ulqin), duke larë rrugët me gjak, për të cilat të drejta dhanë jetën aq shumë dëshmorë e dhëshmore:

– Kosova - Republikë!
– Duam punë në vendlindje, pranë familjeve tona!
– Lirim pa kusht të të gjithë të burgosurve politikë shqiptarë!
– Rroftë populli ynë heroik!
– Lavdi dëshmorëve, që dhanë jetën për liri të atdheut!

Punëtorët shqiptarë në mërgim.

(Shkrim në 6 faqe A5, i shpërndarë nga Ibrahim Kelmendi, në maj 1982. Nënvizimet e këtij punimi ishin të autorit të saj, ashtu siç janë në origjinal në shkrimin e shpërndarë)

14. Letër-shkresë e Ibrahim Kelmendit, 17 qershor 1982

Në mërgim, më 17 qershor 1982

Shumë të dashur bashkatdhetarë e bashkatdhetare,

deri në ditën kur do të demonstrojmë në Bern (ose Gjenevë) kanë mbetur vetëm edhe ca ditë. Momentalisht leja është dhënë për në Bern, edhe pse kërkesa është bërë edhe për Gjenevë. Po që se ndërkohë ipet leja edhe për në Gjenevë, atëherë Demonstrata do të mbahet atje, për çka do informohemi kohë pas kohe.

Se në cilin qytet mbahet demonstrata ka rëndësi. Me një detyrë që të sigurohet leja për qytetin e dëshiruar, janë ngarkuar shokët, prandaj kërkimi i lejes në të dy qytetet në fjalë është me vend, që të mos ndodhë për të mbetur fare pa leje. Tani, kur dimë vendin dhe ditën, me rëndësi të veçantë është mobilizimi ynë, që numri i demonstruesve të jetë sa më i madh, demonstrata të jetë sa më e diciplinuar (ashtu siç kërkojnë rregullat e ligji i vendit nikoçir) dhe sa më e suksesshme.

Kësaj radhe, siç po dimë gjer më tani, demonstrata po mbahet në kryeqytetin e Zvicrës, Bern, më 26 Qershor të këti viti. Edhe pse na kanë mbetur pak ditë, na duhet t'i mobilizojmë të gjitha forcat, që në Bern të shkojmë sa më shumë. Dihet se në këtë drejtim kemi përvojë, por nuk është fare e tepërt të ndalemi te format e punës, se çfarë duhet të bëjmë që radhëve t'u bashkangjiten sa më shumë bashkatdhetarë e bashkatdhetare, pse pjesëmarrja e gjertanishme nuk kënaq gjithëaq, kur ta kemi parasysh numrin e përgjithshëm të kurbetçinjve në këto anë. Përkundrazi, duhet menduar shumë për format e axhitimit dhe informimit, të cilat sqarojnë më së lehti e më së shpejti bashkatdhetarët e bashkatdhetaret, që ata të mos mbesin indifirentë në këtë situatë, për të mos thënë, mos të kalojnë verbërisht në anën e armikut.

Së pari kjo demonstratë po mbahet në të njejtën kohë kur po fillon kongresi i 12-të i të ashtuquajturës Lidhje e Komunistëve të Jugosllavisë (LKJ). Mu për këtë arsye është zgjedhur kjo ditë për të demonstruar. Po të ishte Jugosllavia shtet socialist, siç e quan veten, po të udhëhiqej nga një parti e vërtetë komuniste, marksiste-leniniste, pararojë e klasës punëtore, atëherë mbajtja e kongresit do kishte rëndësi të veçant. Nuk do mend të thuhet se me atë rast, s'pari ne s'do bridhnim rrugëve të botës për bukën e gojës, e pastaj s'do kishim nevojë të dërdhnim gjak në demonstrata, duke i kërkuar të drejtat më elementare që popujt tjerë të Jugosllavisë i gëzojnë, ato të drejta që qenë garantuar kur luftohej krah për krahu kundra hordhive fashiste, për të patur të drejtë secili të vendos mbi fatin dhe ardhmërinë e vet - parim ky themelor leninist. Por siç dimë, fatkeqësisht, LKJ është këmbë e kokë revizioniste, që udhëheqet nga klani titist. ...

... Mund t'i duket ndokujt e tepërt kjo, kur kritikohet mosdiciplina, por vërtetë është shumë e damshme prishja e rendit. Më mirë do të ishte të mos demonstrohet fare, se sa të arrihet efekti i kundërt me atë që synon demonstrata. Si shembull e kemi veçanërisht demonstratën e Vjenës, ku ka ekzistuar mundësia të kemi rrjedhime të shëmtuara. Sigurisht që ca nuk kanë mundur ta kuptojnë se përse nuk bënë të demonstrohet, edhe atëherë kur është udhëtuar me qindra kilometra, por kjo prapë nuk e arsyeton reagimin e cave, pse aty nuk ishte vendi për t'u treguar trimëri policëve austriakë në shtetin e tyre. Pa mëdyshje, mossigurimi i lejes është gabim i paarsyetueshëm, për çka mbahet përgjegjësi, por në raste të tilla është e domosdoshme diciplina e razia, kur shokët bisedojnë për kompromiset e mundshme aty për aty. Kurse aty ndodhi ndryshe: ca veta në mënyrë të pakuptueshme e të damshme, donin t'u tregon të tjerëve se janë "trima" e "patriotë", prandaj pse të mos demonstrohej me zor, kur ata të marshojnë në ball. Hiç nuk po zgjatem më gjatë, pse skena të tilla i kritikon çdo njëri, prandaj edhe nuk duhet të

përsëriten. Vërtetë rastësisht dhe në bazë të ujdisë që të shkojmë në rresht në muze (atje ku nuk ishte siguruar mundësia për t'i vizituar shpatën dhe përkrenaren e Skenderbeut) patëm sukses. Por ka mundur të rrjedh përfundim i shëmtuar...

Duke përfunduar këtë letër shoqërisht i bëjë lutje çdo shoku e shoqe, bashkatdhetarëve e bashkatdhetareve më aktivë, që të mobilizohen sa më shumë, pse vetëm të bashkuar do mundim armikun. Bashkimi ynë nuk arrihet vetvetiu. Për ta arritur atë, pos tjerash, duhen sakrifica më të mëdha në raste të duhura. Kështu, të bashkuar dendur, do i tregojmë vrasësve, se nuk na kanë shpartalluar me rastin e vrasjes së shokëve tanë të shtrenjtë, Jusufit, Kadriut e Bardhoshit, por përkundrazi, indinjata e shkaktuar me atë rast na bashkon edhe më dendur, pse vetëm kështu do ua marrim hakun.

Edhe kësaj radhe, mu si në demonstratat kur shokët i kishim në ball, marshojmë me ta në zemër, gjer në fitore, duke ju përmbajtur mësimeve të tyre! Urra! sa më shumë për në demonstratë!

– KOSOVA - REPUBLIKË!

15. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive, 14 prill 1983

Letra parë që i është dërguar nga Ibrahim Kelmendi, Qendrës Ekzekutive dhe mua si anëtar i kësaj Qendre është një letër e datës 14 prill 1983, në 8 faqe A4, që ka të bëjë me një fejesë në mes dy të rinjve. Kjo letër nuk përfshihet në këtë përmbledhje. Përmbajtja e saj moralizuese është interesante nëse krahasohet me portretizimin që Ibrahim Kelmendi u bënë femrave në librin Atentatet.

Të dashur shokë, Në mërgim..., më 14 prill 1983

(dedikuar rastit – shoqes Fitore e Hasanit) (Hasan Kadriut-shën ynë)

Pasi më rastisi të jem në valët e një problemi tejet serioz e shoh të domosdoshme të shkruaj. Dhe, siç do bindemi, na duhet t'i përkushtohemi që të gjejmë zgjidhje të shpejt.

Thuaja se çdo gjë ka marrë kahjen e vet dhe as që ka mundësi të ndërhymë, bile as që është e arsyeshme të ndërhymë për të imponuar ndonjë zgjidhje, pos zgjedhjes që do të gjejnë vet të godituri.

Pasi që kemi të bëjmë me një rast shumë të ndjeshëm, duhet t'i përkushtohemi kronologjisë së tij, për të parë se si qe diç e tillë e mundshme.

Pjesë e luftës sonë është edhe vazhdimësia për të krijuar familje të reja. Kështu, të bazuar në këtë domosdoshmëri, ca prej ne shokëve ndërhymë, ose përkatësisht ndërmjetësuam që fatin e tyre bashkëshortor ta lidhin shoqja Fitore me shokun Hasan. U gëzuam shumë të gjithë ne që dëgjuam dhe i njofim. Sipas të gjitha gjasave, bazuar në rrymimin e ngjarjeve në këto çaste, bashkëshortësia e këtyre të rinjve mori fund. Pasi isha në korent të ngjarjeve, jo vetëm ditëve të fundit, por që në embrion, kur lindi ideja që këta të rinj të bashkohen, dua të them me bindje se fajin, bile të turpshëm e mban shoku Hasan.

Si rrjedhën ngjarjet?

Aktivitetet patriotike na sollën gjer atje sa të njifemi me familjen e Fitores. Nuk e fshehim, që kur kontaktuam dhe u njohëm, ndiem krenari se njofëm familje të ndershme e patriotike. Kjo familje kishte rritur e edukuar Fitoren, me të gjitha virtytet e një vajze shqiptare, por të një shqiptareje revolucionare. Më vonë fitova bindjen, pasi u njohëm edhe më mirë, se Fitorja është yll në lindje, e cila pos që është e ndershme, premton të bëhet revolucionare e shquar. Më gjatë edhe nuk është e nevojshme të zgjatemi mbi cilësitë e shoqes Fitore, pasi ata që e njofin dhe do ta njofin, do thonë se, shoqja Fitore, e rritur jashtë atdheut, e arsimuar në shkolla të huaja, është për çdo lavdatë. Kurse zellshmëria e saj në studime (drejtësi e anglisht), zotërimi i shkëlqyer i gjuhëve të huaja,

shpirti i saj politik e ngritja e saj marksiste, janë dukuri që garantojnë se kjo shoqe do të bëhet një revolucionare e shquar, sigurisht edhe një militante e luftës së popullit tonë të drejtë.

Mbi jetën e veprimtarinë e shokut Hasan nuk kam nevojë unë të shkruaj. Ai duhet ta bënë këtë vet. Por, nuk ekziston as më i vogli dyshim, se që kur shpërthyen demonstratat në Kosovë (që nga demonstrata e parë në Perëndim, nëse nuk gabohem), ishte aktiv në punët patriotike-revolucionare. Të kaluarën dikur nuk ia njihja, por këndej, që kur e njoha, bashkëjetonte me një zvicrane (si duket e pasur...).

Çysh në vizitën e parë prindërit hapën zemrën, pasi që na njifnin që më parë dhe kishin besim të plotë te radhët patriotike. Kështu, pos bisedave për çështje kombëtare, u bisedu edhe për halle të të familjes, pa rezerva.

Të shtyrë nga rrethanat, sidomos ato të quajtura kurbet, e biseduan edhe çështjen e vajzës, se si janë të dëshiruar, pasi ka mbushur vitet, t'i gjejnë një shok, por të ndershëm e patriot. Vajza atëherë ishte maturante në gjimnaz dhe po e kryente me sukses të shembullor. Unë, siç i kujtohet më shumë shokëve se mua, kisha këshilluar prindin e Fitores që të mos nxitohen dhe ajo duhet të vazhdoj në studime, e ndërkohë ka për të gjetur shok nga ata që njofim ne.

Kur u ktheva m'u dha rasti të takoj shokun Hasan. Biseduam, pos tjerash, se kisha njohur një familje të ndershme dhe revolucionare. Ai u gëzua. Biseduam se si në të ardhmen do t'ua krijojmë mundësinë të njifeni dhe po u pëlqyet, të martoheni.

Në ndërkohë prindi i Fitores u njoh me Hasanin. Hasani i la përshtypje të mirë, pasi asaj radhe na ra të rrugëtojmë bashkarisht më gjatë. Kur duheshin të ndahen, prindi i Fitores, përndryshe shok aktiv, muar telefonin nga Hasani. Unë ia bëra me dije, tërthorazi se në telefon lajmërohet një grua, me të cilën Hasani po bashkjeton. Hasani më qortoi pse tregova dhe u arsyetua se te ajo vetëm banon. Me prindin udhëtuam, Hasani mbeti. Biseduam disa herë mbi Hasanin, pasi prindi kishte formuar përshtypje të mirë.

Për më shumë se katër muaj qesh larguar. Por shoku Hasan me familjen e Fitores kishte vazhduar kontaktet, kryesisht përmes bisedave telefonike. Me kalimin e kohës ishin njoftuar e afruar aq shumë, sa shoku Hasan e paskësh parë të rrugës t'i angazhoi shokët që të ndërmjetësojnë.

Në demonstratë të Gjenevës u takuam prap. Kësaj radhe në demonstratë kishte ardhur edhe Fitorja. Kur e pashë në radhë, gati sa nuk qirrej së thirruri parolla, bashk me motrat që kishte përkrahu. Thash me vete, nuk qenka vetëm e zellshme në mësime dhe e ndershme, por qenka taman revolucionare. Po e them këtë me qëllim, pasi nuk është gjithaq e rëndomtë që vajzat e rritura dhe shkolluara në Perëndim të kenë edhe revolucionaritet të këtillë.

Shoku Hasan kishte ngarkuar dy shokë, Ujkanin dhe Bacën që të ndërmjetësojnë. Për mrekulli. Bisedojnë dhe arrihet mirëkuptimi. Por, siç po thuhet tani, prindi na qenkësh informuar se Hasani bashkjetonte me një zvicerane. Shoku Hasan kishte siguruar shokët se bashkjetesa kishte marrë fund, pasi nuk po mirëkuptoheshin, ose siç shprehej edhe shoku Hasan, ishin prishë. Kështu edhe Ujkani edhe Baca i kishin thënë prindit se më nuk po bashkjetojnë. Prindi dhe Fitorja kishin dakorduar që "t'i vënë vizë" (siç shprehen tani) bashkjetesës me zvicerane. Por, sigurisht, kusht i vetkuptueshëm: të mos bashkjetojnë më!

Se si u zhvilluan ceremonitë e fejesës, nuk na hynë në punë. Të gjithë uronim.

Në një mbrëmje, në prag të Vitit të Ri, ku ishin të pranishëm edhe shokë të tjerë, Hasani se si u hap dhe tregoi për aventurat e tija degjeneruese në të kaluarën, që në vitet e hershme të rinisë. Them të vërtetën u dëshprova. Sidomos edhe mënyra e tregimit, në formë krenarie, dhe fakti se disave nuk u bënin përshtypje shumë. Shkurt: shihej se çfarë

pasojash kishim nga robëria jugosllave, ku mbretëron një sistem taman i degjeneruar, sa i përket moralit. Edhe më parë, në trojet tona, ishte përhapur si epidemi "krenaria" për t'u marrë me aventura degjeneruese, duke u shprehur se "duhet të jetohet rinia...". Kur Hasani hetoi se te unë "krenaria" e tij mbi aventura degjeneruese po lenë përshtypje shumë të keqe, e pau të rrugës t'më kërcnohet: "Po më qarte punë te familja e Fitores do të shofish se kush jam unë...", diçka në këtë drejtim bëheshin kërcnimet. Unë i thash: "... punë nuk do të qarti, por ta dish se qëndroj prapa Fitores si prapa motre e shoqes së idealit po që se do të tradhtohet..."

Kisha dëgjuar edhe të tjerët tek flisnin mbi aventurat e tyre degjeneruese, por aventurat degjeneruese të Hasanit ua kalonin filmave amerikan, apo ndoshta ilustronte pasi "krenaria" e shtynte. Sa m'u thy vullneti. Disi me Hasani isha afruar shumë, pasi ishte aktiv në veprimtarinë tonë. E vërtetë është se dija për bashkjetesën me zvicrane dhe për shpirtin e tij aventurier. Por edhe këtë shumë e arsyetonin, kryesisht vetë Hasani, se kushtet e kanë detyruar të bashkjetoi...

Pas fejesës u bë kurorëzimi, më shumë për çështje të rregullimit të lejes së qëndrimit. Por, menjëherë pasi lidhën kuror, përkundër vullnetit të prindërve (Fitorja thuaja se ngjan në figurë shahu, pa u tregu gjithaq aktive kur vendoset diç), Hasani insiston me këmbëngulje të njëmendët, pa i patur as kushtet ta marrë Fitoren, mbi të cilën tash e tutje na paskësh pushtet, pasi e ka grua... dhe të shkojnë në Zvicër. Atje ata kanë fjetur së bashku disa ditë. Gjatë atyre ditëve, siç tregon Fitorja dhe siç e pranoi edhe Hasani, Hasani po me krenari (ndoshta jo – por kështu tregon Fitorja) i ka folur mbi aventurat në të kaluarën, se si ua paska marrë qikninë disa vajzave shqiptare..., etj. (siç na kishte treguar edhe ne më parë.). Shkurt, Fitorja tregoi aq shumë gjëra, sa po të ketë treguar të vërtetën (e unë po i besoj tërësisht), Hasani ose nuk duhet të ketë qenë në vete, ose e ka bërë me qëllim që ta largoi Fitoren. (Për fjalët që ka folur Hasani, po u desh, do të shkruhet veçmas.) Nga e gjitha konkludoi se Hasani dinjitetin e Fitores e kishte cënuar dhe marrë nëpër këmbë.

Në mes të tjerave, biseda në mes tyre është bërë edhe mbi bashkjetesën e Hasanit me zvicranen. Fitorja ka dyshuar nga fakti se kudo që e ka dërguar Hasani, ajo nuk ia ka parë asnjë plaçkë. Hasani i qenkësh betuar se nuk po bashkjeton.

Fitorja është kthyer vetëm. Kur ka ardhur në shtëpi i ka treguar nënës mbi të gjitha. I ka thënë, pos tjerave, "... u qudita mami, se si nuk kërceva nga treni gjatë rrugës..."

Pa ditur asgjë, mua më nxjerri nevoja këndej. Erdha edhe te familja e Fitores. Në mbrëmje nga nëna e Fitores bëheshin shaka, por nuk ishin si të mëparmet, më shumë ishin demaskuese kundra Hasanit. Disa herë reagova mjaft ashpër, pasi nuk më vinte mirë të sulmohej Hasani, sado që në formë shakash. Bile edhe shoku që ishte me mue e pau të arsyeshme të ndërhy për ta mbrojtur Hasanin. Por ne nuk dinim se çfarë kish ndodhur. Vërehej se diç nuk është në rregull. Të nesërmen mësova të gjitha, por thuaja se u ngreh gjama si në raste vdekjeje.

U gëzuan që isha aty dhe kishin kujt t'i qahen. Me bindje thanë se Hasani është te zvicranja. Ishte e diel në mbrëmje, vonë. Nuk u besoja se Hasani është te zvicranja, tani kur të gjithë shokët kishin siguruar se nuk bashkjetojnë më. Vendosa të telefonoj. M'u lajmërua zvicranja. E pyeta se a ishte Hasani aty. Më tha jo. E pyeta se a do vij më vonë. M'u përgjegj se nuk e dinte, bile më tha ndoshta. Atëherë ia lash porosinë të telefononte, pasi kisha diç me rëndësi. Brenda një kohe shumë të shkurtër kishte telefonuar ku ia kisha lënë porosinë. Ishte kjo provë e luhatshme se ishte aty.

Fitorja sikur nuk besonte se Hasani ka shkuar te zvicranja, pasi i është betuar (siç thot ajo, kurse Hasani në bisedën telefonike që pata sot me të, nuk pranoi se i qenka betuar.). Vendosin të provojnë që heret në mëngjez të telefonojnë, por pasi dinin se nuk

do t'u përgjigjej, kishin menduar sikur thirrja i shkonte nga Jugosllavia. Ai ishte lajmëruar. Ka qenë rreth orës 6.00 të mëngjezit, të hënën. Ishte provë e pakundërshtueshme.

Kur u zgjova më vonë më treguan. Vendosa të telefonoj. Telefoni u hap, por nuk fliste askush. Unë i thirra dhe i tregova se kush jam, telefoni m'u mbyll. Ishte provë e fortë se qe ai, Hasani, por nuk më lajmërohej, pasi do i bërtisja. I telefonova shokut Ujkan dhe i tregova mbi të gjitha. U befasu. I thash të telefononte ai dhe ta pyeste e të bisedonte mbi ato që kishin ndodhur, se çfarë e si kishte ndodhur. Më vonë, rreth orës 10.00 më telefonoi Hasani mu, pasi, siç duket, e kishte kuptuar se isha këtu. Kur i tregova se ç'kishte ndodhur dhe pyeta se përse ma mbylli telefonin, më tha se nuk ka qenë aty fare. I thash se edhe mu po më gënjen, pasi ke qenë aty. Kur i tregova mbi telefonin "allo Jugosllavia...", që ia kishin bërë heret në mëngjez Fitorja me nënën dhe ai ishte lajmëruar, atëherë e pranoi. Por pse nuk m'u kishte përgjegj mu, u arsyetu se do t'u tregoja unë Fitores dhe prindërve, bile shprehu dyshimin se do t'ua mbaja anën.

Me prova të thjeshta u vërtetu se ishte aty, por arsyetohej se priste thirrje telefonike...

E kështillova se duhej të merrte kontakt me shokët, që të ndërmjetësojmë, pasi unë isha këtu dhe ata do më tregojnë çfarë duhet të bëjë unë. U telefonuam prap me shokë. U tregova se ngjarjet kanë marrë kahjet e tyre dhe se prindërit bashkë me Fitoren duan ta prishin kurorën, pasi "ultësisht ishin tradhëtuar", siç shprehen ata. Më së shumti i trondiste fakti se e gjitha bëhej nga një shok i radhëve të Lëvizjes.

Pasi edhe sot më telefonoj Hasani, u qartësuan punët, por në të keq. Ai kërkoi që unë t'u them se ai kishte për të kërkuar llogari, nga se prindërit e Fitores e paskeshin alarmuar gjendjen, i paskeshin kurdisur thirrje telefonike "alo Jugosllavia...", e paskeshin përzier Lëvizjen, etj. U hidhërova. Foli edhe gjëra tjera të ulëta. Kur i thash se do t'i shkonte letër nga gjyqi për ta nënshkruar se është i pajtimit të prishin kuror, më tha se nuk do ta bënte pa u marrë vesh. I thash se nuk guzon të përdorë shantazhe e gjëra të ulëta më, por duhet të reflekton si shok, pasi për diç të kësaj natyre duhet dhënë llogari. Sa për alarmim e informova se vetëm ne që duheshim ta dinim, e dimë. Kurse se qenka problem thjesht familjar, që s'paska të bëjë fare me Lëvizjen, i thash se nuk është ashtu. "Për gjëra të tilla ka drejtë dhe duhet të interesohet Lëvizja, përderisa ti militon në radhët e saj..."

I tregova shoqes Fitore për bisedën telefonike. I thash se duhet të merr qëndrim që e gjykon vet, pa ta imponuar Lëvizja. Ajo disa herë kishte thënë se po të thotë Lëvizja se duhet të sakrifikoj jetën dhe duhet gjithsesi të bashkjetoi me Hasanin, pasi ndarja do t'i sillte dame, do ta bënte për hirë të sajë. Unë i thash se duhej të vendoste vetë, pavarësisht, duke patur parasysh se vetëm bashkjetesa e mirëkuptimt është e arsyeshme.

Definitivisht janë dakorduar se duhet të ndahen. Nuk kundërshtova dhe as që e pash të arsyeshme. Arsyetoheshin se Hasanit as që po i intereson mbi asgjë, përndryshe do t'ua tregonte shokëve të vërtetën dhe do pranonte gabimet, duke bërë autokritikë dhe duke na bindur se vërtetë është për bashkjetesë të sinqertë dhe të mirëkuptimt.

* * *

Shokë,

e shoh të arsyeshme t'i ndaj edhe ca mendime konkrete e propozime.

Së pari, pasi gjendemi ku gjendemi, propozoj që të formohet një këshill i zgjedhur dhe ta gjykoj këtë rast. Ne pushtet popullor nuk kemi, prandaj kur raste të tilla ndodhin në radhët tona, ose edhe në popull që i shkon prapa Lëvizjes, duhet të intervenojmë dhe duhet ndarë drejtësinë, sipas kritereve morale të radhëve tona (siç shkruan shoqja Fitore në letrën që shkroi për shokët e radhëve të Lëvizjes.).

Deri sa normat morale nuk i kemi kodifikuar, mendoj se duhet të vlejnë normat e vetëkuptueshme morale popullore, por jo të kanunit të Lekës. Si parimore është që në çdo aspekt burri i gruaja të trajtohen të barabartë. Poashtu edhe degjenerimi moral i burrit të vlerësohet barabar me degjenerimin moral të gruas, e jo siç ndodh padrejtësisht (siç duan të na e imponojnë të degjeneruarit...), se degjenerimi i burrit mund të arsyetohet "pasi është burr", kurse vetëm i gruas na qenka i dënueshëm... Pra, as një lëshim nga normat morale shqiptare e proletare nuk duhet bërë!

Pastaj, duhet vlerësohet për shkelje të parimeve nëse të degjeneruarit, që nuk janë në gjendje të kontrollojnë veten, vihen në krye të aktiviteteve patriotiko-revolucionare. Jam rigorozisht e vendosmërisht kundër çdo lëshimi në këtë drejtim, i cili na kompromiton Lëvizjen!

Ne dikur detyruam bashkatdhetarët që të mos e marrin nëpër gojë shokun Hasan për faktin se bashkëjetonte me zvicrane dhe se ajo e mbante, bile edhe i blente kerre sport... Sigurisht që ai u aktivizu shumë, pikërisht edhe pse ju krijuan mundësitë nga bashkjetesa me zvicranen, por sa do t'i arsyetojmë. Në atë drejtim askush nuk mban përgjegjësi më shumë se unë, edhe pse e afrova me bindje se do të ndahej nga ajo, pa ditur për aventurat degjeneruese të mëparme, të cilat, po të vlerësohen në mënyrë kritike vetëm sa tregon me "krenari" ai vetë, atëherë mund të konkludohet se ka qenë vijë. Sikur mbi të gjitha të dijë një rreth më i gjer i bashkatdhetarëve, çfarë ndodhë? Me siguri që do marrin radhët tona në bisht të lahutës. E kush do t'u përgjigjet thirrjeve, po të ndodhte që Lëvizja të kompromitohej me gjëra të tilla? Shoku Hasan pat shansën të rehabilitohet, po t'u vente shqelmin aventurave degjeneruese. Por jo. Ai edhe atëherë kur thonte se është prishur me zvicranen, flinte me te. Në rastin konkret të Fitores, po provon të arsyeton se gjoja ka pritur thirrje telefonike. Por thirrja telefonike nuk pritet vazhdimisht dhe tërë natën. Pastaj, sikur të vendoste se me atë grua do bashkjetonte nga se e dashuron ose se donte ta marton, do ta arsyetonim disi. Por jo, ai vet ka thënë se nuk do të jeton, vetëm se është duke e shfrytëzuar. Sigurisht që edhe kjo është e dënueshme. Pastaj martoi vajzë shqiptare, ia muar qikninë, dhe prap vazhdoi të shkon te zvicranja. Pa më të voglin lëshim se është e dënueshme. Sikur të vinin në konkludim më parë, kur ishin vetëm të fejuar, se nuk ka kuptim të bashkjetohet dhe razieshëm të ndaheshin, do të duhej të kërkonim llogari më pak. Por edhe atëherë do të ishte e patolerueshme: T'i lut shokët që të ndërmjetësojnë, dihet cilët shokë, duke i siguruar se nuk po bashkjeton me zvicrane (pra duke keqpërdorur besimin që kanë patur shokët tek ai...), dhe pasi t'ia marrësh qikninë dhe dinjiteti njerëzor t'i merret nëpër këmbë motrës sonë të bashkjetoi me zvicranen vërtetë është e dënueshme. Bile, kur t'i shtohen kësaj edhe intrigat që bënë tani, "mos vet", do të thoshte populli.

Mund që kam ardhur në përfundime të gabueshme, por nuk kam patur rast të dëgjoj çfarë do të thoshte mbi të gjitha, por dua të them se mjaftojnë ato që m'i tha në telefon Kazanova (siç i ka thënë Hasani Fitores se është...!!)

Rrethana në përgjithësi janë ngarkuese, po të marrim relacionin e Fitores. Ajo është rritur në kurbet. Prindërit me fanatizëm ia kanë dhënë patriotizmin. Për te shqiptari ka qenë vlerë e madhe. Dhe ja prova e parë serioze... Mue personalisht më goditi përmbajtja e letrës, sa e thuket, aq kuptimplote dhe mendime të peshuara, taman nga pozitat revolucionare. Dhe po të provoi Hasani të ia hjedh fajin Fitores, atëherë le ta di se ka gabuar rëndë... Për as më të voglën aventurë degjeneruse të Fitores nuk mund të flitet, kurse për të Hasanit, mjafton ato që i tregon ai vet.

Po sikur të ndodhte që nga kjo tradhëti (siç po vlerësohet këtu) të demoralizohej në ato përmasa sa t'ia kthente shpinën shqiptarizmit... Por, është aq e formueme dhe aq e

dhënë pas çështjes kombëtare, sa edhe në këtë gjendje pyet se mos është duke damtuar Lëvizjen.

Mund të duket se u zgjata dhe kam bërë gjykime radikale e të njëanshme, por të shohim si do të jetë edhe mendimi juaj. Deri në çastin kur mësova se në çfarë përmasash është shkelur dinjiteti i Motrës sonë, sikur do t'i bënte ndokush tjetër ndonjë sulm Hasanit, do të duhej t'i llogariste dy Hasana. Tani, kur mësova mbi të gjitha dhe kur zura t'i analizojë në mënyrë kritike aventurat e tij, e ndjeva veten se nuk mbajtur qëndrim parimor që me kohë, për ta demaskuar ashpërsisht çdo aventurë.

Hasani ka të vetmen rrethanë lehtësuese: se degjenerimi i tij fillon në vitet e hershme të rinisë, çka do të thotë se i është imponuar nga shoqëria jugosllave, e qelbur. Kështu, nën këtë variant do të shihej deri diku degjenerimi gjer në shpërthimin e demonstratave, por pastaj, kur edhe vetë ju përkushtu aktiviteteve revolucionare, nuk ka arsyetime, edhe pse një dorë e caktuar gjejnë mënyra arsyetuese, gjoja të vështirësive që u lindkan vetëm disave në kurbet. Edhe kundër kësaj forme të degjenerimit atje ku mund të ndikojmë, duhet t'i kundërvihemi duke e demaskuar, pse gradualisht përhapet kjo epidemi...

Në biseda telefonike ka ndodhur të thuhet, sidomos shoku Ujkan, se Hasani ka qenë aktiv, i ka kryer të gjitha detyrat. Kjo është e vërtetë. Por nuk dyshoj se është thënë diç e tillë që të arsyetohet degjenerimi i shokut, ose marria e tanishme.

Përfundimisht, kësaj radhe, nuk po e zgjat më. Gjërave të kësaj natyre duhet t'u përkushtohemi, që më vonë të mos na e haj në dorë qeni shkopin, siç do thoshte populli.

Shoku (Ibrahim Kelmendi)

16. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, maj 1983

Kushtëzohet puna nga ato të mallkuara të holla

Ibrahim Kelmendi: "Sikur të kishe të holla ti aty, (kuptohet që nuk po i mendoj personalet) do të duhej të m'i dërgoje ca, pasi në këtë gjendje kur ende nuk i kam rregulluar dokumentet më duhen, pos tjerash që t'ju bie mbrapa atyre, por më shumë për udhëtime që të takoj personalitete që më duhet t'i takoj dhe punë të tjera që më përkasin, pasi dihet se sa kushtëzohet puna nga ato të mallkuara të holla...

-Për Një Republikë Shqiptare në Jugosllavi!

-Rroftë LRSSHJ-a!"

(Letër Faridin Tafallarit, maj 1983; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 413)

17. Letër e Ibrahim Kelmendit për (Xh. D.) dhe Qendrën Ekzekutive, 4 maj 1983

Në mërgim..., më 4 maj 1983

I dashur shoku S.,

Letrën tënde e mora. Të falenderoj që më shkrove - është letra e parë, njëherit edhe fillimi i letërkëmbimit mes nesh.

Festën e 1 Majit kaluam mirë (pa na munguar edhe një "incident" i vogël...). Nuk di si pat kaluar ju andej dhe a i patët marrë traktet.

Sa për rastin e F. dhe H., përfundimisht mori fund çdo gjë mes tyre në fushën e jetës bashkëshortore. Do të kishim dëshiruar që të mos kishim rrjedhime... Ti nuk kishe shkruar asgjë, bile mbi propozimet që para bërë, pavarësisht nga ajo se nuk i njihje mirë asnjërin. Më duket se pata shkruar mjaft, që të ipet ndonjë sygjerim a mendimet, edhe nëse personat në fjalë nuk njihen personalisht. Unë do jap mendimin tim se si u pleqërua kjo ndarje, duke bërë me shkrim, në pamundësi që të takohemi për të biseduar. Por po ndalem tek mendimi yt: "morali i dobët dhe patriotizmi mund të bashkudhëtojnë për një kohë por me bashkëjetuar nuk munden..." Ky mendim sipas teje, "është ligj i vërtetuar me mijëra herë dhe vlen për çdo kënd". Këti mendimi ka mundësi t'i ipen shumë kuptime. Edhe unë jap mendimin për kuptimin, si unë e kuptoj, sado që shkarazi. Sa për "ligj", mua s'më duket që mund të përligjet edhe në raste tjera, e lerë më në rastin tonë (pasi dimë se ku militojmë.). Po sikur të përligjej "për një kohë" do të ishte shprazëti e atij "ligji"; për dike kjo kohë e pakufizuar mundet me qenë shumë e gjatë, ose mundet me u zgjatë, kurse për dike tjetër mundet me qenë shumë e shkurtër, ose mundet me u shkurtu... Morali i dobët duhet të demaskohet pa i lënë shansë të bashkudhëtoi as "për një kohë" me patriotizmin. Pa u zgjatur, patriotizmi dhe morali i dobët nuk mund të bashkudhëtojnë fare. Ka mundësi që i pari të maskohet me të dytin në rrethana të caktuara, pse jo ta shfrytëzoi të dytin dhe, mu pse ndodh kjo, sikur dukeka se ka mundësi të bashkudhëtojnë. Pavarësisht nga shpjegimet sipërfaqësore, për radhët e LRSSHJ-së, duhet të vlejnë normat morale, të cilat s'do lejojnë fare që morali të jetë i dobët dhe patriotizmi të bashkudhëtojnë e të bashkëjetojnë "as për një kohë"! Po na ndodhën raste, si rrjedhim i vigjilencës së ulët, nga se dikush ia del të maskohet..., atëherë duhet të demaskohet dhe jo t'i ipet shansë të bashkudhëtoi. Përndryshe, do e bënë populli, të cilit nuk mund t'i imponohen "ligje" të tilla, duke patur rrjedhime për radhët tona. Them kështu duke njohur traditat popullore dhe faktin me çfarë fanatizmi ka ruajtur populli ynë fytyrën (moralin). Bile, ruajtja e moralit sa nuk ka kaluar në mit. Edhe njëherë: mendimi dhe propozimi im është që ata që anëtarësohen në LRSSHJ-në duhet të kenë moral të pastër, po deshëm që LRSSHJ-a t'i dalë zot misionit të vet të shenjtë me sukses! Mu për këtë arsye, po sa të na ipet rasti, duhet t'i përkushtohemi (duhet të them propozoj t'i përkushtohemi) edhe çështjes së moralit në gjirin e LRSSHJ-së...

Pasi vendosa t'i përgjigjem letrës tënde, çka është e vetëkuptueshme, pa vazhdoj me radhë.

Në vazhdim më shkruaje "se relativisht njihemi mirë". Sikur të të shkruaja unë i pari, s'do më kishte rënë ndërmend ta përdorë shprehje relativisht, ose më konkretisht, s'do më dukej me vend dhe e arsyeshme për ta futur në përdorim. Për pozitën tonë dhe nivelin e marrëdhënjeve kjo fjalë s'duhet të gjen vend, duhet të jetë e tepërt, edhe sikur ta kishte ndonjë dozë nga e vërteta (për çka edhe unë tani mendoj se ka.).

"Kemi vendosur me luftuar së bashku dhe këtë do ta bëjmë". Po mirë, pse ka nevojë të potencohet. Mendoj se kur bëhen përsëritje të ngjashme, atëherë sikur fshehet dozë e mossigurisë dhe e mosbesimit. Luftën jemi duke e bërë së bashku, ne bashkë me shokë tjerë e popullin, pasi është kërkuar, kemi dëshiruar e vendosur... Ndonjë fillim tjetër të rij nuk pres. Di vetëm se prej ati çasti..., se do të marshojmë prej beteje në betejë, për të dalur fitimtarë! Dhe nëse na del ndonjë punë a betejë e re, nuk do të thotë se do fillojmë luftën, kur, si bashkëluftëtar që jemi, luftën kemi filluar më heret.

"Njëri prej personazheve për të cilin flitet më së shumti je ti", më shkruaje në vazhdim. Në rregull, më duhet të them edhe njëherë. Por, krahas kësaj do të duhej të më

shkruaje çfarë flitet dhe kush flet. Unë, thënë të drejtën, i shurdhër nuk jam, nëse bëjë veshin të shurdhër që të kuptoj më mirë se ku kanë ndërmend të dalin ata që udhëheqin këtë fushatë. Kjo nuk është fushata e parë dhe s'do të jetë as e fundit. Me tallaze të ngjashme jam duke u konfrontuar që kur kam zgjedhur këtë rrugë (e cila më duket e drejtë!). Nuk mashtroj veten se nuk do të ketë fushata... të ngjashme edhe në të ardhmen... Sipas të gjitha gjasave, kreatorët e fushatës në fjalë është një bandë (ta quaj kështu tani për tani), e përbërë nga Reshati, Xhaviti, Isaku, Fazliu... Këta edhe mund të mos i takojnë një bande, në kuptim të ngusht të fjalës, por telat janë duke ju puçur... Se _çfarë bëjnë, cilët janë, çfarë janë duke shpifur, nuk po zgjatem kësaj radhe. Sikur t'u përkushtohesha të tillave fushata e të tillëve njerëz (që po më imponohet...), në të kaluarën, tani dhe në të ardhmen, s'do të më mbetej kohë për aktivitete të tjera që kërkohen nga unë (ashtu, ashtu kam përshtypjen se kohës nuk po ia nxjerr kymetin sa duhet e si duhet.). Më është dukur çdo herë më e arsyeshme t'i përmbahem proverbit popullor: "qentë lehin, karavani le të ec".

E keqja më e madhe nuk qëndron tek ajo se dikush ndërmerr fushatë "demaskuese", por tek qëndrimi oportunist e "pritës" i shokëve të idealit - të radhëve..., me të cilët kam bashkuar luftën. Siç po ndodh, me anëtarët e kësaj bande (e thash, nuk kam fakte se i takojnë një bande të organizuar, por më shumë po shprehem kështu duke u bazuar në veprimtarinë e tyre, pse jo pak edhe në mllefin tim...) të "rastëtis" t'i vizitosh rrethet e ndryshme për t'u informuar e "bashkëbiseduar", edhe për ato që s'do të duhej të ishin të pranishëm të sipërpërmendurit (i mendoj kryesisht Xhavitin e Fazliun). Sa për Reshatin nuk di se në ç'nivel qëndrojnë marrëdhënjet, mu për këtë arsye nuk po konkretizohem kësaj radhe. (Le të mbetet herën tjetër, pasi siç po duket, jam i detyruar të jap mendimin tim rreth manovrave të tija...).

Për t'u konkretizuar edhe më, më duket fare e padrejtë që më leni "vetëm" të përballoj shpifjet që po përhap kjo bandë, duke vështruar si spektatorë e referë... Ti, shok i dashur, sikur të ishte i bindur se ata nuk kanë të drejtë dhe po ta kishe kuptuar se shoku duhet mbrojtur, do ua mbyllje gojën... Përkundrazi edhe pse pata shprehur mendimin (kur qem takuar në ... dhe gjatë rrugës në të kthyer), se që t'katërt (nuk di përse...) janë duke bërë "manovrime", prapë se prapë mund ta bashkëpunon (nëse mund të quhet bashkëpunim vizitave që ua bën rretheve bashkë me ta, çka unë mendoj se është bashkëpunim.), pavarësisht nga fakti se ti dinë sa edhe unë (ndoshta ke patur mundësi të dëgjosh edhe më shumë...), se personat në fjalë janë motorët e fushatës "demaskuese" kundër meje, të cilin ti e quan "se njëri prej personazheve për të cilin flitet shumë je ti".

Sikur gjërat t'i quajmë me emrin e vet, pa patur nevojë të ngurrohemi që t'i shprehim mendimet sado kritike që të jenë (nga frika se kritika dhe sqarimet mund të arrinë efekte negative...), do të thoja se shprehja relativisht po na del vërtetë relative në llogari të asaj se ne nuk njihemi mirë, ose nuk je gjithaq i sigurt. Këtë e përforcon mendimi tjetër i yti: "Ne njihemi vetëm sa na ka kontaktuar puna dhe vetëm (nënvizimi nga unë) puna e asgjë tjetër. Në bazë të saj do të njihemi edhe në të ardhmen." Ja këtu del ajo që thash se po mbahet qëndrim oportunist e "pritës". Përndryshe, po të ishe i bindur se ke për shok një bashkëluftëtar të vërtetë (dhe jo që do të bëhet në të ardhmen...), do t'u kundërviheshe shpifjeve, po shpifjeve, në kuptim të vërtetë të fjalës të personazheve të sipëremërtuar. Sipas të gjitha gjasave këta personazh ndjejnë veten bukur të sigurt se do dalin fitimtarë, duke u mashtruar se të kanë me vete (kështu kam bindjen, të lindur nga...), pa i ditur relacionet e marrëdhënieve tona. Këtë e vërteton mendimi tjetër yti: "Opinioneve të ndryshme u intereson së tepërmi lidhja (nënvizimi nga unë) jote me lëvizjen e mjaft të tjera". (I jap të drejtë vetes, duke kërkuar falje, se fjala Lëvizje është emër i përvetshëm - në kuptimin kur është në pyetje LRSSHJ-a!). "Ngreh një kashtë dalin

gjashtë", thotë një proverb popullor. E unë ngrehi kashtë, siç po më duket, por ja që letrës duhet t'i përgjigjem. Por, po t'i biem me sopatë të madhe, siç përdoret në anën tonë (kur ngatërrohet muhabeti), nuk po kuptoj fare se ç'ke dashur të shkruash.

Së pari, për çdo opinion të veçantë kemi qëndrime të veçanta, sipas kritereve të punës... Unë nuk kuptoj për cilat opinione ke fjalën ti dhe si i klasifikon ti opinionet. Siç duket, ti e ke fjalën për opinionin e përgjithshëm në mërgim, nëse kam mundur të të kuptoj, të cilin e ke ndarë në "opinione të ndryshme" (kjo edhe nuk është e përkufizuar, se për çfarë ndarje është fjala dhe cilat kritere janë përdorur.). Opinionin shqiptar në mërgim, sipas mendimit tim, mund ta ndajmë në opinionin patriotik-revolucionar të shumicës (për këtë mendim duhen analiza më të shtruara), në opinionin reakcionar dhe në atë të veglave naive e çorre dhe besnike të armikut. Ngandonjëherë më ka rënë të dëgjoj të shprehen sikur çdo individ na paska opinion individual, që për mendimin tim ngatërrohen, pasi në pyetje është botëkuptimi i secilit (në filozofi janë dy – materialist dhe idealist). Botëkuptimet individuale varen nga aftësitë e secilit si individ (të kushtëzuara nga rrethi e jeta) për ta kuptuar botën, gjegjësisht proceset që zhvillohen në të, në rastin tonë proceset e zhvillimit të shoqërisë njerëzore...

Me siguri që, secili prej këtyre opinioneve, në mënyrat e tyre, u intereson për lidhjet e mia me LRSSHJ-në, dhe jo vetëm për lidhjet e mia, por edhe të shokëve tjerë, duke shtuar këtu, se më së paku i intereson (me përjashtim të kurioziteteve individuale...) opinionit patriotiko-revolucionar, pasi është i vetëdishëm se në këto rrethana do të ishte e damshme. Unë e di se mbahet konspirative lidhja e secilit me LRSSHJ-në, sigurisht edhe jotja, jo vetëm ndaj "opinioneve të ndryshme", por edhe brenda radhëve të LRSSHJ-së (dihet në cilat përmasa...). Sikur të shprehem, ashtu siç po e kuptoj, se çfarë më shkruaje, atëherë del se për lidhjet e të tjerëve me LRSSHJ-në "opinionet e ndryshme" ditkan. Ekziston edhe një mundësi tjetër, që të kuptohet kështu: nga dashuria që kanë individët (në rastin tonë dihet se për cilët individ është fjala) për Lëvizjen, duan të dinë për lidhjet e mia (të njeriut të dyshimtë, thonë ata), që ta shpëtojnë LRSSHJ-në nga kjo e "keqe"... Pos lidhjeve "opinioneve të ndryshme" u interesokan edhe "mjaft të tjera". Ç'ke dashur të shprehish ti nuk e dij, por unë kuptoj se atyre ju duhen edhe më shumë informata të tjera, më shumë mbi punën time se sa për personin tim. Këtë e kam ditur – mirë që ma bënë të qartë edhe ti. Fjalia pasuese sikur i mbulon ato të mëparmet, por që të studjohen rrethanat duhet bashkëpunim mes nesh, duke mos patur asnjë dozë mossigurie duke llogaritur njëri në tjetrin shok të sigurt e sinqertë. Sa për operacionet (edhe pse kësaj radhe është në pyetje fushata, pasi në atë kontekst është përdorur) "zhvillohen shpejt" duke qenë të dënuara të dështojnë (varshmërisht nga vendosmëria, aftësitë dhe vigjilenca jonë.)!

Dëshiroj që ca nga mendimet në këtë letër të kanë shpëtuar dhe jo se i ke shprehur duke qenë i thelluar, edhe pse nuk guxon të na shpëtojnë gjëra të tilla (çka është e pamundur, por duhet t'i minimizojmë dhe, sigurisht, për ato që na shpëtojnë kritikohemi, kështillohemi, japim llogari...). Po them këto jo për qëllime taktike, por kam përshtypjen se vërtetë në raste të ndryshme gjatë bisedimeve të shpëtojnë fraza, duke u dukur përfundimisht si mendime mozaike. Ndoshta do të kujtohet vizita në Hamburg, pas Mbrëmjes Përkujtuese. Ishin shumë bashkatdhetarë (mbi dhjetë veta, në banesë të një bashkatdhetari ku banon Isaku). Bënim bisedë kryesisht të natyrës sqaruese-informative, me qëllim që të ndihmohen grupet për të gjetur gjuhë të përbashkët, së paku sa i përket çështjes së klubit. Sigurisht që bisedove me tonë të rëndë e "zyrtar", për çka kam përshtypjen se edhe në jetë të rëndomtë gati atë natyrë ke. Në mes të bisedës të patë shpëtuar fraza: "... unë dhe I. luajmë rolin e Miladinit e të Dushanit... Tekstualisht s'e kam mbajtur mend, por ka qenë frazë e kësaj përmbajtje, e cila s'të hynte fare në punë. Pastaj

fillove të tërhjekësh parametra "analog", për të na "bindur" se nuk të shpëtoi rastësisht. Jo vetëm unë, por edhe të tjerët, që e njohin Historinë e PPSH, qenë çuditur. Nuk kishte asgjë analoge me ato të shokut Miladin dhe të çetnikut Dushan, të cilët nuk i patën bashkuar grupet komuniste në Shqipëri... Guxoj të shtroj me këtë rast edhe pyetjen e pa kripë, se cili nga ne të dy ishte Miladini e cili Dushani...?

Opinioni i bandës në fjalë është shumë i kufizuar. Kurse vet personazhët po guzojnë të hapin gojën duke u shitur si të LRSSHJ-së, bile me "përgjegjësi" në këto radhë. Këtë të fundit po ua mundëson qëndrimi yt pritës, në rastin konkret qëndrimi yt oportunist e "pritës" dhe marrja pas veti në takime e bisedime në rrethe të ndryshme, që provojnë t'u imponohen rretheve si të "dërguar" (me taktikë përfide, për të lënë që të vetëkuptohet...) e "autorizuar" nga LRSSHJ-ja. Dhe lidhjet e mia me LRSSHJ-në u duhet shumë nga fakti, se unë i njoh nga orët e para në mërgim, prandaj janë të vetdishëm se për të fituar sigurisht që u hynë në punë të tilla të dhëna. Bile u duhen shumë, duke u nisur nga fakti se në raste kur arroganca e tyre po kalon kufijtë e tolerancës, po u kundërvëhem me vendosmëri dhe do t'u kundërvëhem çdo herë. Këta e ka shijuar secili nga ta...

Duhet t'u ruhemi rrjedhimeve serioze. Nuk dëshiroj të dëgjoj se në praninë tënde, bile duke t'u drejtuar ty, kanë shpifur dhe ti s'më ke mbrojtur. Po kështu, nëse të ka rastisur të dëgjosh se si "opinioneve të ndryshme" u kanë interesuar lidhjet e mia me LRSSHJ-në dhe ti s'u ke dhënë përgjigje të merituar, atëherë jo vetë që vlerësohet qëndrim oportun, por është shkelje e rëndë disiplinore, e diciplinës parimore!

Më duket shumë i arsyeshëm një shembull nga e kaluara. Gjatë aktiviteve të mëparme nuk kanë munguar fushata të ngjashme jo vetëm kundër meje, por edhe kundër shokëve. Edhe pse nuk ishim shokë të nivelit që jemi ne, kundër shpifjeve e trillimeve mbronim njëri tjetrin me vendosmëri, bile edhe atëherë kur paraqiteshin rreziqe serioze. Përse të mos ndodh kështu edhe në rastin tonë? Mosmarrëveshjet që kishim i muarëm si të sqaruara. Ato patën lindur... ose na qenë imponuar... Ne vendosëm... Pas ati "rasti", s'do mend të thuhet se ndaj tjerëve që ndërmarrin fushata "demaskuese" kundër nesh, duhet t'u kundërvehemi bashkarisht e me vendosmëri, e jo të lehet ndonjëri nga ne "vetëm". Sot qenkam unë "personazhi për të cilin flitet shumë", nesër, po të kenë fituar kundër meje, je ti e tjetri me radhë. Në fakt, luftën e fushatat nuk i bëjnë kundër personave, por kundër Lëvizjes, së cilës nuk guzojnë t'i shpallin luftë, përderisa të duan të bëjnë luftë nga pozita, sikur janë të LRSSHJ-së... Në rastin tonë konkret, pasi më njeh "relativisht mirë", ose se "ne njihemi vetëm sa na ka kontaktuar puna dhe vetëm puna e asgjë tjetër", duket se këtë fushatë "demaskuese" po e vështron me admirim, duke pritur edhe çfarë "faktesh" do të dalin në "dritë", për t'i patur si "poena"...

Sikur e bëra tërkuzë, për çka mund të fajsohem se përmbajtjes së letrës tënde i dhash përmasa "dramatike". Gjykimit të ndonjë gjyqi diciplinor nuk i iku. Po kështu, jam për atë që në radhët tona të gjallërohet një kulturë revolucionare për të diskutuar hapur e padroje, për të kritikuar pa hile, përndryshe nga gabimet e vogla (nëse nuk u rrimë gati me kohë) mund të rrëshqasim në gabime të mëdha dhe prej aty edhe në armiqësi. Prandaj, nuk kam përshtypjen as që u zgjerova dhe as që po "dramatizoj". Të shohim çfarë do të thuani ti dhe shokët. Kurse në të ardhmen varësisht nga nevoja dhe zhvillimi i ngjarjeve dhe në varshmëri nga përgjigja që do të marrë, do mbaj qëndrime përkatëse. Unë jam për atë që të bëhem urë për hir të çështjes, por nëse toleroj që të kaloj çdo gjë mbi mu, jam i dobët, kam shkelur parimet dhe është kundërrevolucionare!

T'i përgjigjem letrës tënde po vazhdoj, por më duket se pjesa e dytë, siç më duket e mundshme të ndahet, më shumë shërben për t'i përforcuar mendimet e pjesë së parë, që tërthorazi të përforcohen me "fakte" ato që ke thënë më lartë.

Në vazhdim më shkruaje për "mbresat" që ke fituar gjatë "takimit të parë" në rrethin e Dys. Menjëherë është sjellë fakti se në atë takim "në mes të tjerëve" ka qenë edhe "vëllau yt i nënës". Së pari po bëjë një sqarim të natyrës "teknike", se vëllau për të cilin më shkruan, nuk është nga ana e Nënës por e Babës (që nuk luan ndonjë rol në këtë rast.). Këtu do të jem bukur kategorik: Në fushën e aktiviteteve patriotike për vëllaun nuk jap llogari si vëlla, por vetëm si shok, mund ta gjykojmë së bashku për gabimet që i bënë! Kjo nuk është hera e parë që po e them. Për tradhëti, edhe pse llogari kërkon populli nga secili tradhtar, do nxitoja të lyp llogari, kurse për gabime, le të lypin llogari shokët, në rastin e tij duhet të kërkojnë llogari Kryesia dhe anëtarët e Klubit, pasi ai aty është anëtar. Në aktivitetet revolucionare familjarizmi të ndihmon në fillim, por është i dëmshëm, s'është fare revolucionar. Sikur të mos mbahen qëndrime parimore ndaj familjarizmit që në fillim (duke përjashtuar shfrytëzimin e tij për nevoja revolucionare, pasi në rrethana të kushtëzuara si këto tonat, sikur ndihmon...), mund të bëhet shumë i dëmshëm më vonë. E kur është fjala për LRSSHJ-në, që nuk është ndonjë grup lokal i kufizuar edhe në mundësi, atëherë familjarizmit duhet vuar shqelmin dhe të mos lejohet të ngre fare të kokë në Organizatën tonë. Është e vërtetë se ai do duhej të gabonte me pak se ndonjë shok i nivelit të ti, sikur çdo gjë të ishte në rregull, pasi ekzistojnë mundësitë për të ndikuar në të më shumë se tjetri. Kjo s'do të thotë se u dashka dhënë llogari për të, kur ai është i vetdishëm dhe është në gjendje të jap llogari vet. Në këtë rast konkret, vëllau është anëtar Klubi dhe jo i LRSSHJ-së. Si simpatizant që është, nuk kemi mundësi t'ia ndalojmë të mos jetë, përderisa LRSSHJ-a është pararoja e popullit. Të pranishmit në atë takim dinë se cilin qëndrim kam mbajtur edhe herave tjera, kur kanë qenë në pyetje gabimet e tija. Ndërsa sa i përket anëtarësimit në LRSSHJ-në, kur jam pyetur nga shokët, kam thënë se nuk është në nivel për të qenë anëtar. Ka mundësi që gabimet e vëllaut të më dëmtojnë tek ata që duan të kapen për këto gabime, kur do t'u mungojnë të tjerat. Po kështu edhe te ndonjë që nuk është në nivel revolucionar dhe te ata që mund të mendojnë se unë e "kurdisi" qëllimisht, por te shokët në nivel, as që duhet të diskutohet, pasi nuk kanë as më të voglin dyshim se unë e "kurdisi".

Pa u zgjatur më shumë mbi marrëdhëniet familjare në aktivitetet patriotiko-revolucionare, më konkretisht në gjirin e radhëve të LRSSHJ-së, e cila do të duhej të diskutohej në ndonjë rast tjetër, po ndalem te "vizita e parë" në Rrethin e dys.

Para se të filloj, më duhet ta pranoj se nuk jam në korent mbi takimin, se si është zhvilluar, për të mundur më shtruar të shkruaj dhe për të qenë i sigurt në atë që shkruaj.

Së pari, ky nuk ka qenë takimi i parë. Ti ke qenë edhe më heret në atë Rreth, ke takuar e ke biseduar me shokë të ati Rrethi. Ato takime nuk janë bërë të kota, përndryshe do dilte se atëherë qenka bjerr koha dhe vetëm takimet "zyrtare" (po i quaj kështu, pasi s'po gjej emër më të qëlluar) na qenkan takime pune. Që në fillim po shtoj, ndoshta ke nxjerr mësime se takimet e mëparme, të bëra në frymë më shoqërore e jo në nivel "zyrtar", kanë qenë më të frytshme, janë siguruar informata, janë ndërruar mendime dhe më në fund nuk është alarmuar gjendja si tani, siç je informuar edhe ti.

Në këtë takim ke patur Xhavitin si shoqërues. Që të mos kalon në monotoni, nuk po zgjatem më rreth tij. Po të kërkohet e bëj me një rast tjetër. Kësaj radhe mjafton të them se nuk është kuadër në të cilin guzojmë të mbështetemi, siç e kam thënë. Përkundër kësaj që unë kam shpreh mendim të tillë rreth këti personi, ti ke parë të arsyeshme ta marrësh me vete në takim (dihet të cilit nivel). Unë jam i mendimit se kjo s'është dashur të bëhet, është e gabueshme dhe për këtë mban përgjegjësi. Kjo ka bërë që atmosfera e takimit të rëndohet dhe jo pyetjet e ndërhyrjet e vëllaut. Të gjithë të tjerët Xhavitin e kanë njohur më mirë se ti. Ata ia kanë njohur shumë sjellje e qëndrime gjatë sakrificave që

kanë bërë për ta ndihmuar e përkrahur Klubin e "tij"... Sigurisht që duhet të jenë befasuar për shoqërimin e tij, dhe për mendimin tim, cilido që ka pranuar të diskutoi dhe jap informata më të hollësishme rreth Klubit, nuk ka qenë në nivel, ka gabuar. Po të pyetesha unë, ose po të isha në prani, një takim të tillë sdo ta kisha pranuar. Dhe, hajde e shkarkoja vëllaut fajin pse është alarmuar gjendja, përmes ti tërthorazi edhe mu, për ta shkarkuar nga vetja. Nuk e di si do arsyetohe për këtë gabim, kur secili nga tjerët në atë takim është më i sigurt se Xhaviti dhe kanë eksperiencë të mjaftueshme, në mos shumë.

Pasi ka qenë "takimi i parë", edhe po të mos ishte i pranishëm Xhaviti, a vërtetë është dashur të jetë i një niveli aq "zyrtar"? Ne, nëse të kujtohet, kemi pas biseduar se si duhet sjellur me rrethe e individ, te të cilët disa ngjarje të së kaluarës lënë gjurmë... Njerëzit nuk ndryshojnë aq shpejt edhe kur ata duan dhe nga ta kërkohet. Po të kërkohet ndryshim i shpejt, atëherë detyrohen të jenë formal dhe ky formalizëm bie në provim po sa të jetë prekur në "nervin e ndieshëm". Mu për këtë arsye, aty do të duhej një takim i nivelit më shoqëror, sigurisht edhe pa praninë e Xhavitit. Nga ajo që më ka thënë vëllau, pasi të tjerët nuk i kam takuar (kurse ato që m'i ka thënë vëllau i marrë si informime të bëra në gjendje të revoltuar...), janë shtruar pyetje aq të detaluara, sa, nëse janë të vërteta, edhe mu më befasojnë. Dua të shtoj se informata aq të detaluara nuk na duhen dhe janë të dëmshme. Kur lypsen për punën në Rreth, mund të informoj ndonjëri nga shokët aty për aty që të diskutohen format organizative në rreth, si më të përshtatshme që do gjenden. Puna në Klub duhet t'u besohet shokëve të rrethit. Mjafton me ta të bisedohet për çështjet parimore e statutare. Po, le të mbetet edhe kjo temë e hapur për diskutim, pse duke pritur këto që po ndodhin jo vetëm në Rrethin në fjalë, pata kërkuar që disa gjëra rreth klubeve të diskutohen dhe të bihen vendime.

Shiquar nga ana tjetër, vërtetë do lypsej, për ata që duan të merren me çështje klubesh, të shkojnë në Rrethin në fjalë për të mësuar nga eksperienca e tyre. Ata, të Klubit... jo vetëm që Klubin e tyre e kanë drejtuar si duhet, por vazhdimisht kanë ndihmuar edhe klubet tjera, i kanë përkrahur ato dhe u kanë spjeguar mbi të gjitha rreth klubit. Atë është dashur ta pranon edhe vetë Xhaviti, nëse je këshilluar me të përpara. Jo vetëm në klubet për rreth, por edhe jashtë rfgj. kanë shkuar, vetëm e vetëm që t'u vinë në ndihmë bashkatdhetarëve që të formojnë klube. Në këtë drejtim, Referatin e mbajtur me rastin e 5 Vjetorit dhe Mbrëmjen me atë rast, duhet t'i çmojmë si literaturë, gjegjësisht si mësim praktik.

Mendimi im është se në atë Rreth nuk është dashur tjetër informatë, pos të riorganizohen shokët që janë anëtarë dhe atyre t'u besohet klubi, për të mos patur nevojë në të ardhmen të mbahet kujdes, pasi kemi punë e kujdese tjera mjaft. Jo vetëm në Rrethin në fjalë, por në të gjitha rrethet, edhe sikur vetëm me figura shahu të kishim të bëjmë, duhet zgjedhur mënyra e "lojës". Kurse ne jo, na duken më interesant badihavxhinjtë, fodullët, dallkaukët, pseudointelektualët, që me ta të organizojmë punën, kurse punëtorë, me kuptim të plotë të fjalës, vetëm të dëgjojnë dhe t'u vinë prapa të tillëve. Jo, kësaj duhet dhënë fund dhe do t'i japim se s'bënë. Ka punëtorë të ndershëm mjaft, që kanë dhënë prova, ndërsa të tillët, s'po ua përmend emrin, duhet të mësojnë të respektojnë punën, mësimin, djersën e punëtorëve, për të mos bredhur poshtë e lartë gjoja si patriot, për t'i ndihmuar të tjerët të "ngirten" kur nuk janë vet të ngritur, as sa i përket edukatës elementare për t'u sjellur si njerëz, për të respektuar, e lere më ngritjen ideologjike e revolucionare. Për këto them se kam prova. Të edukuarit yrush edhe ku nuk janë të thirrur, janë në gjendje ta njohin veten dhe dinë se sa janë në gjendje të kontribuojnë.

"... si rreth (mendohet Rrethi i dys., sqarimi nga unë) aty dukej mirë se lokalizmi ka rrënjë të thella dhe njerëzit janë të ushqyer fort me atë ndjenjë për të mos thënë të ngopur apo të tejngopur", më shkruaje në vazhdim. Duhet të mbaj përgjegjësi unë për këtë? Para se të diskutohet për përgjegjësinë, do të pyejsa: si është e mundur të bëhen vlerësime aq të sigurta që në "mbledhje të parë". Më duket se nuk është reale. Nëse janë të bashkuar, nëse u kanë dal zot punëve më së miri (Nuk di ndonjë klub, jo vetëm të emigrantëve ekonomik, por edhe të atyre politikë dhe të migruarëve, të ketë patur kaq jehonë.), nuk do ta vlerësoja për lokalizëm. Siç ke mundur të vresh, vetëm dy veta në takim janë të një ane. Lokalizëm të bartur nga atdheu nuk ka, as që ka mundur të bie në sy gjatë atyre 5 viteve të shkuara. Atëherë, ka mundësi se mbyllja dhe fanatizmi, reagimet edhe emocionale, kur është në pyetje Klubi, janë të kuptueshme, së paku për mua që ia njoh jetën në çdo qelizë dhe i njoh të gjithë anëtarët si në shuplakë të dorës. Mu për këtë arsye kam pas thënë se në atë Klub, me ata anëtarë e ndjejë veten të familjarizuar. Është e damshme. Jo. Të tillë lokalizëm do të kishim dëshiruar në të gjitha qendrat e Evropës dhe përtej oqeaneve, kur t'i shtojmë kësaj edhe faktin se ishte klubi i orëve të para që ju kundërvu politikës diskriminuese jugo-sllavomadhe. Po të ndalesha edhe më gjatë, kisha për të shkruar mjaft edhe për kontributet, për aktivitetet, që në rrethe tjera veç mund të ëndrrohen. Pastaj dëshira që edhe në rrethe tjera të ketë klube të ngjashme, duke qenë të vetdishëm, se pos të mirave tjera të shumta, edhe presioni nga ana e organeve jugosllave do të zvogëlohet, pasi për një kohë ishte i vetmi në botën e jashtme, i shtyri të sakrifikojnë sa asnjë rreth për t'u ardhur në ndihmë bashkatdhetarëve që t'i marrin ose t'i hapin klubet e reja atje ku nuk kishte. Mund të vlerësohet kjo për lokalizëm?! Jo! Çka mund të vlerësohet lokaliste atëherë? Më duket se lokaliste të është dukur krenaria që ndjenë, ose mos hapja dhe rezervat. Sa për krenarinë, është e kuptueshme, sado që është e dëmshme. Kurse mos hapja dhe rezervat, gjithashtu janë të kuptueshme për mu. Kanë sakrifiku shumë. U janë bërë dredhi të mëdha, por i kanë përballuar. Kjo bënë që të kuptojmë se edhe në raste kur nuk lypset, janë emocional, reagojnë ashpër... Ndoshta mendimin tëndë ua ke thënë edhe atyre në takim me "lokalizmin..." Nëse jo, po u pa e arsyeshme, duhet t'ua themi që të diskutojnë edhe ata vetë.

Për statuse e klubeve thue se kemi diskutuar në ... Pse ma rikujton, apo vetëm për të rrezikuar më shumë. Ne kemi diskutuar, por nuk do të thotë se përbëjmë ndonjë mbretëri absolute – kemi diskutuar ne dhe s'u dashka diskutuar më, as në bazë, për t'i lypur mendimet e tyre nëse kemi vendosur drejtë. Bile, kur ndodh të dalin të tilla probleme, të bie ndërmend mendime të reja, prandaj do të ishte dashur që diskutimet dhe vendimet (nëse kemi marrë...) do t'ishte dashur të formulohen, për t'ua dërguar në baza për diskutime, dihet rrethit të ngusht dhe anëtarëve, sidomos atyre që kanë përvojë në çështje të klubeve. Të bëhet, nëse është lëshuar gabimisht, ose pse nuk na ka ra ndërmend. (Dua të them se lëshimet po na i imponojnë rrethanat, situata dhe kushtet...). Po i them këto, pse vet fakti se nuk kanë dashur t'i japin informatat, na bënë me dyshua se nuk duhet t'i kërkojmë (pata shkruar në këtë drejtim edhe më lartë.). Atëherë nuk është dashur të kërkohen, por të diskutohet se a duhet të ipen apo jo, duke i ndihmuar të binden, nëse diskutimet tona kanë qenë të drejta. Kështu me radhë, është diskutuar edhe fotoja e satrapit. Nëse nuk kam harruar, ne patëm diskutuar se në klube të reja nuk prish punë nëse e kanë fotografinë e satrapit, por nuk tham se duhet vendosur në ato klube që e kanë hjekur. Guzojmë more, si jo të diskutojmë për çdo pyetje e çështje, por imponimet nuk janë formë demokratike e revolucionare, dua të them të bazës – anëtarëve të një klubi t'ua imponojmë vuarjen e çfarëdo shenje, edhe nëse na duket më e arsyeshme. Pra, duhet zgjedhur mënyrën e sqarimit, për ta gjetur mirëkuptimin. Fotografinë e satrapin Klubi në fjalë e ka hjekur para se të shpërthejnë demonstratat në Kosovë. Sa të gëzuar kanë qenë

që atëherë. Tani, në këto çaste, kur asgjë s'duket se ka shkuar më së miri (duke filluar prej shoqëruesit), nuk është dashur të diskutohen të gjitha përnjëherë. Nëse më bindni se unë nuk kam të drejtë pse mendoj kështu, i tërheq mendimet prapa. Por, duhet menduar mirë para se t'i përvishemi një pune, që të mos lëshojmë gabime për t'u alarmua gjendja në asnjë mes. Sa të dëmshme janë alarmime të tilla, vetëm ta dije. Presioni është i madh, psihoza është si në gjendje lufte, armiku vetëm po hulumton të çarat për të futur pyka. Sa lehtë mund të demoralizohen e zhgënjehen bashkatdhetarët... Është në interes ton kjo? Sigurisht që do thoje jo. Por po e them me gjithë mend, se të tilla gjëra kur përsëriten, i kanë pasojat e veta.

"... atje qenka alarmuar shumë situata e mjaft gjëra të tjera", më shkruan në përfundim të letrës. Sa keq! Duhet të bëjmë sehir, të presim si do t'ia nxjerrin sytë njëri-tjetrit dhe ne të gjykojmë anash se kjo ose ajo palë, se ky ose ai individ kanë të drejtë ose duhet të japin llogari. Kjo po më duket disi edhe cinike – të bëhet shkaktar "takimi i parë" që të "alarmohet" situata dhe pastaj të informohet, pa shpreh së paku merakun, pa lere të thuhet se duhet të intervenojmë dhe ta bëjmë dert se si (kam shpresë deri sa të ketë ardhur kjo letër "situata e alarmuar" duhet të jetë zgjedhur drejtë, duke ndihmuar ju andej që jeni më afër.).

Letra gati sa nuk është mbyllur me fjalinë "... andaj duhet të shikojmë se kush me çka dhe për çka ushqen rrethin e vet". Nëse më lart faji më është hedhur tërthorazi, duke përdorur si urë vëllaun, nga kjo fjali mund të kuptohet se unë mbaj përgjegjësi për të gjitha. Ky është mendimi yt dhe e ke menduar para se t'më shkruash. Mendim të ngjashëm ke shpreh edhe në raste të mëparme. Tani, ose duhet të përgjigjem unë që vërtetë jam fajtor për të gjitha, ose duhet të përgjigjesh ti për akuzë, e cila sipas mendimit tim është e rëndë.

Së pari, unë detyrën e kam krye dhe shokëve ju kam thënë se nëse vie në vizitë ... (të kam menduar ty), atëherë duhet të dini se ka ardhur një shok që është i ngarkuar. Për të tjerat s'po zgjatem më pa marrë mendimin nga ju (mendoj edhe shokët tjerë) se propozimi im aprovohet apo jo. Pra, propozimi im, i formuluar më qartë është, fajsimet që më janë bërë përmes letrës tënde o janë të vërteta dhe unë duhet të jap llogari, o janë akuza dhe duhet të japësh ti llogari. Kurse edhe mendimet tjera duhet të zbërthehen, për çka janë të nevojshme informatat nga takimet në rrethet dhe mendimet e shokëve në rrethe. Sa për të dhëna plotësuese mbi personat e sipërermërtuara, po qenë të nevojshme, mund të kompletoj diç, por duhet patur parasysh se për punë të tilla harxhohet koha. Në rastin e Reshatit, ashtu ashtu jam i domosdoshëm, pasi kam marrë disa letra na ai, por jo vetëm pse kam marrë disa letra.

Ndahem me përshëndetje revolucionare, duke të dëshiruar shëndet të mirë e punë të mbarë!

-PËR NJË REPUBLIKË SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!

-RROFTË LËVIZJA PËR REPUBLIKËN SOCIALISTE SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!

SHOKU (Ibrahim Kelmendi)

PS: Kopjet e letrës do ua dërgoj edhe shokëve, pasi pos mendimeve që janë vetëm në nivel të përgjigjes, janë edhe disa mendime propozime për të cilat duhet t'i shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre edhe shokët. Veprohet kështu (pasi e shoh të arsyeshme) në pamundësi për t'u takuar, për kushte që dihen.

Diskutimi i letrës me shokë a simpatizantë, ose me radhët e bandës..., që nuk i takojnë Rrethit tonë (mendoj...), pa u dhënë pëlqimi, është shkelje e rëndë e konspiracionit parimor.

Mundësisht t'i firmosësh letrat në të ardhmen, pse preferohet dhe është më e sigurt.

Mirëupafshim.

18. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive, 7 maj 1983

Në mërgim..., më 7 maj 1983

Të dashur shokë,

Në pamundësi që të takohemi (siç patëm menduar...) po ju shkruaj, edhe pse në këto rrethana nuk është gjithaq e përshtatshme dhe sigurt.

Festën e 1Majit nuk e "festuam" si duhet. Duke ditur se për cilën festë është fjala, nuk bëmë atë që duhet ta bëjmë dhe që kishim mundësinë, por më shumë sikur ia lam stihisë e spontanitetit. Nuk e dij kush duhet të mban përgjegjësi (...), por organizimi nuk ka qenë në nivel.

Së pari, nuk kemi lëshuar fare Thirrje. Ky është lëshim! Pastaj është dashur të këshillohen bashkatdhetarët në rrethe, që të organizohen sa më mirë për të dalë në demonstratat e rretheve të tyre, të thirrura nga sindikatët dhe partitë e organizatat politike në rrethe. Sa për Thirrjen që duhej të bëhej, edhe pse isha në punë e sipër që ta bëjë, pata telefonuar dhe më qe thënë se më mirë të shkruhen në nivel (është menduar ana teknike – të radhitet teksti në "kompouser") dhe në secilin rreth do dërgohet një Thirrje, atje, në rrethe t'i shumëzojnë e shpërndajnë. Kurse për traktin (të përpunuar atë të vitit të kaluar dhe të aktualizuar) u pa e udhës të përkthehet në gjuhët gjermane e suedeze varianti që patëm formuluar, ndërsa në gjuhën franceze do ta merrnin shokët e Zvicrës mbi vete.

Thirrja nuk doli fare. Siç më tregoi shoku..., kanë patur shumë punë. Përndryshe së e besoj, por llogaritë duheshin bërë me kohë – puna duhet bërë; nëse duart e disave nuk mbërrinë, atëherë duhet ngarkuar kush mundet ta bëjë. Trakti në gjuhën suedeze u shtyp në 4500 ekzemplarë (të cilin e financoi...), kurse në gjuhë gjermane është shtypur në 15 000 ekzemplarë (dhe ka kushtuar 1100 DM., siç më është thënë.). Për traktin në gjuhë gjermane kemi patur vështirësi. Pasi unë isha në Veri ..., ku gjendem tani, nuk kisha mundësi ta bëjë përkthimin (në gjuhën gjermane nëse përkthej, është i domosdoshëm korigjimi final nga folësit e asaj gjuhe.). Rasti për udhëtim m'u dha kur bashkatdhetarët nga këndej udhëtuan për të marrë pjesë në koncertet e Ansamblit të RPSSH. Përndryshe, pasi më ka dalur viza, nuk do kisha mundur të hy në rfgj. Më në fund mbeti që për shtypje e shpërndarje të interesohen shokët e Rrethit të Barit. Pra, nuk pata mundësi të interesohem për shtypjen e traktit, që të bëhet me çmim sa më të lirë (siç kemi shtypur herave tjera.). Shokët jo vetëm që nuk ishin shumë të sprovuar, por në pyetje ishte edhe koha, prandaj e arsyeshme qe që të pranojmë të paguajmë 1 100 DM (për radhitje, shtyp e palim). Shpërndarja përpak dështoi në detale, edhe pse mundësit ishin ideale. Por, më në fund janë shpërndarë.

Sa i përketë organizimit, që të delet sa më masovikisht dhe të organizuar, thënë të drejtën nuk ju përkushtova, pos këndej ku isha. Në Bruksel pata dërguar letër (po dërgoj kopje të sajë), përmes së cilës ju shkrova se ç'duheshin të bënin! Edhe në Bari, po ashtu, të organizuar mirë (me Parollën KOSOVA – REPUBLIKË! dhe parolla tjera), kishin patur sukses. Për rrethe tjera nuk dij.

Shokë,

shoku Salih më ka shkruar letër më 24 prill. Unë ia kam kthyer përgjegjen ashtu si më është dukur e arsyeshme. Të zgjatem edhe me këtë rast nuk më duket e arsyeshme, pasi jam zgjatur mjaft në përgjegjen në fjalë (nëse nuk e kam tepruar.). Por këtë rast, siç len të kuptohet, po ua dërgoj nga një kopje, që ta analizoni edhe ju se a kemi vepruar më së miri dhe si duhet t'ia bëjmë. Kur ju shkruaj kështu, nuk mendoj se duhet t'ju kthehem gjërave në të kaluarën (pasi vendosëm...), por vetëm të ndalemi te përmbajtjet e letrave.

Mua nuk më duket e parëndësishme që të merremi me disa probleme që janë shtruar në letërkëmbim (jo vetëm pse jam objekt sulmi – "personazhi për të cilin flitet shumë" – i fushatës në fjalë, edhe pse kjo është serioze), pasi me kalimin e kohës mund që ka pasoja.

Më duket e domosdoshme se disa personave (që janë motorr i fushatës), si Xhaviti, Fazliu, Isaku... në RFGJ (psikopatin Besim e kemi qitë e lënë..., siç shprehet populli) dhe Reshati me disa në Belgjikë (për çështje të Belgjikës mendoj se duhet të merremi në të ardhmen – unë do përpunoj disa kujtime e materiale, me shkrim, ca më shtruar) ka ardhur koha t'ua tregojmë vendin, ose të dimë çartë se si duhet të sillemi dhe çfarë qëndrimi duhet të mbajmë ndaj tyre. Them kështu pasi këta tre në rfgj. janë nxe në teneqe dhe nuk po prajnë së shpifuri, siç po duket, kryesisht kundra meje. Mund që kanë arsye burrat e botës, prandaj le të urdhërojmë të pleqërojmë. Më duket se uj ka kaluar mjaft nën urë për të parë se sa është i pastër dhe nëse nuk është krejtësisht i pastër kush është duke e turbulluar. Po sjelli një rast konkret, si ilustrim se çfarë pasoja ka mundësi të lindin. Xhaviti, Fazliu dhe ai i Parisit (pasi s'po më kujtohet emri po e quaj siç po praktikohet) kanë shkuar në vizitë në familjen X. në Bari, pasi në mbrëmje ka patur edhe koncert. Aty kanë gjetur disa shokë tjerë. Ai i Parizit ka filluar nga "biseda" (siç më tha ai pastaj, mbi gjëra të përgjithshme). Xhavitit ju a dukur e arsyeshme të filloj nga të tiat... Ka mbërritur gjer në atë gjendje sa gati i kanë nxjerrë jasht (pasi u është sqaruar se të tilla bisedime nuk bëhen në familje.). Asaj radhe isha edhe unë në atë anë dhe më duhet të ik pa e parë koncertin (e kisha parë njëherë natën e mëparme), por vetëm se kisha shkuar shkaku i traktit. Kur më njoftuan se ç'kishte ndodhur, m'u duk e arsyeshme të ndalem (edhe pse shokut që kisha me vete do t'i humbte puna të nesërmen). I takova, së pari atë të Parisit dhe në pyetjen time se ç'kishte ndodhur, filloi të justifikohet... (se na qenka i ngarkuar të luaj atë rol...). I thash se gjëra të ngjashme nuk guzojnë të ndodhin në atmosferë familjare dhe ca biseda të ngjashme. Po kështu, i thash se nëse diç nuk është në rregull, atëherë duhet të gjendet mënyra dhe rasti që të sqarohemi (nëse mundemi.). Fazliu ma zgjati dorën me zor (me atë gati sa nuk jemi zënë keq më parë...). Kurse Xhavitin e ndava me një anë. Sa injorant që m'u duk. Prap manovrime të vjetra. Kur i thash se nuk kishte bërë mirë që ka shpifur në një atmosferë të tillë, duke provokuar zënje fizike, atëherë si skile zu t'më justifikohet se unë nuk e fillova, ne jemi shokë, ka vetëm disa cikrrime për të cilat duhet të sqarohemi... I thash t'i lërë të vjetrat dhe po pati të qahet se i bëjë të padrejtë le të formon një rreth të shokëve (të cilët do t'i zgjedh ai vet) dhe të ulemi... Pastaj, varësisht nga rezultati, nëse të kërkohet, del e shpif, por të dihet – bëhemi kundërshtarë!

Po kështu asaj radhe më ra të dëgjoj diç shumë të ulët. Gjoja e ka rrahur dikush Sonjën (në banesë të Xhavitit...) në "emër të Lëvizjes...!!" Shpifjet hapeshin sikur unë e kam organizuar rrahjen (ndërsa Xhaviti e ka zbatuar...). Sa gjëra të ulëta thash kur dëgjova dhe po them edhe tani! Sikur s'na ka mbetur tjetër pos të rrahim një qyqe! Po pse përhapen gjëra kaq të ulëta? Për këto dinë më së miri tani për tani Xhaviti (Ramabaja)!

Edhe në Hamburg ka patur "manovrime", prapa të cilave qëndron banda Isak, Xhavit, Fazli... Përkundra të gjithave, siç kam shkruar në përgjegje, shoku Salih në një tubim për çështje të klubit, i ka patur si shoqërues (kështu po shprehem pasi po më duket se është e qëlluar.). Në rreth johomogjen, shoku Salih e ka pa të arsyeshme t'ju thotë se vetëm ai na qenka i autorizuar dhe se po të vijnë të tjerë s'u dashkan dëgjuar fare. (Këto janë burim nga dorë e dytë, prandaj i marrë me rezervë – të dorës së parë i çmoj ato që do të thotë vet shoku Salih.). Nëse është e vërtetë se ka thënë diç të ngjashme në ambient jo homogjen (duke qenë i shoqëruar me përcjellës të lartpërmendur), atëherë qfaq dyshimin se në pyetje ka qenë Meti (i cili në atë Rreth ishte dhe ka dhënë kontribut të nivelit dhe të pamohueshëm). Te ky dyshim që të vihet mundësoi fakti se në shumë takime

të bashkatdhetarëve të Hamburgut ka marrë pjesë Meti (të cilit i kisha thënë se duhet të interesohet që bashkatdhetarët të mos përçahen dhe të këshillohen së çka duhet të bëjnë për t'ua marrë klubin veglave të konzullatit.) dhe aty janë konfrontuar me Isakun. Në fakt janë konfrontuar tjerët, por ky shpesh ka ndërhyrë duke dhënë mendimin e vet mbi fajësimin e kundërfajësimin reciprok, pa qenë plotësisht i sigurt se kush është duke thënë të drejtën., por më shumë duke lënë alternativë në atë mënyrë sa prap të jenë për atë se duhet të mbesin shokë, të bashkëpunojnë për ta marrë klubin në dorë. Dhe edhe këtu shprehu mendimin se shoku Meti është i pjekur dhe duhet të angazhohet e jo të izolohet (edhe pse për izolim të tij më së shumti është fajtor ai vet, besa edhe rrethanat...). Pastaj, derisa mu shoku Salih më qortoi se përse kisha kërku nga Isaku të angazhohet për klubin (çka nuk kisha vepruar ashtu fare – unë e vizitova pasi më thanë se shumë veta drejtpërdrejtë o tërthorazi nuk po i lenë të vinë në klub, gjegjësisht të anëtarësoheshin, pasi në prag ishte tubimi zgjedhor. Me atë rast i pata thënë se mban përgjegjësi për ata bashkatdhetarë që drejtpërdrejtë o tërthorazi nuk i len të merren me çështje të klubit, pasi dihet se çfarë interesimi kishin më parë. Ai, siç doli kur më qortoi shoku Salih, i paskësh thënë se gjoja kam kërkuar që ai me çdo kusht të angazhohet për klubin...), ai vet e kishte marrë në takim me veti dhe e kishte thënë Isaku vet se nuk do merrte pjesë në takim, por vetëm e paskeshin lutur (Salihu me Xhavitin, nëse kam mundur të mbaj mend, në pyetje ka qenë edhe Fazliu). Po e potencoj edhe njëherë, të gjitha këto janë të dhëna nga personat jo gjithaq të besueshëm (të cilët donin të shfrytëzonin rastin në çdo situatë, edhe kur nuk ishte ambienti, kur isha për koncert, t'më flisnin, duke shprehur edhe paknaqësi.). Po shtoj, nuk po merakosem fort për thash e thëna, por më shumë e kam hallin se në atë rreth punët po na ecin si gaforrja.

Që të shkruaj edhe më detalisht për personat në fjalë nuk kam as "vullnet", pos nëse kërkohet. Kështu si i njoh, i njoh që në orët e para dhe fillimisht me secilin (pos me Reshatin) kam patur të bëjë nga afër me ta. sa për Isakun, as që ka nevojë. Ai, më duket ka mbërri në shkallë të Besimit. Shtoj, me budallaqe edhe ia kalon, por është më i rafinuar. Për Fazliun, nuk e dij nëse dikush tjetër di më shumë, por nuk më bëhet të besoj se aktivitetet patriotike e kanë nxjerrë këndej (pasi iu paskësh dashur të ik...). Kjo ka rëndësi, por pasi nuk kemi të dhëna të sakta, atëherë duhet të bazohemi në sjelljet e tija që në orët e para kur erdhi. Jam më se i bindur se ai e keqpërdori respektin që kishin bashkatdhetarët e Deçiqit për rini të Kosovës. Me kalimin e kohës filluan t'i dalin në shesh maniret dhe dal nga dal të distancohen nga ai po ata që e kishin respektuar dhe ishin kujdesur për te. Pasi ishte në moshë për të studjuar, e këshilluem që të regjistrohet në fakultet dhe për këtë u ndihmu. Por, sigurisht që kusht ishte gjuha. Edhe mundësitë që të ndjek kurset e gjuhës në fakultet ju siguruan. Në dritë doli përtacia e tij për të mësuar, që provonte ta maskon me "nevojën" për t'u endur posht-lartë, pasi u kërkuaka të përhap patriotizëm. Por, pasi ai vet nuk ishte i ngritur (i mungonte fjalori, pasi siç lente të dukej, nuk kishte lexuar fare më parë as gjatë shkollimit të mesëm...), tërthorazi u këshillu se duhet të ulët për të studjuar, duke ju bë e çartë se shumë gjëra të përgjithshme për bashkatdhetarët janë të njohura, prandaj duhet të përgatitet më në nivel, pa munguar t'i thuhet se edhe si kuadër në të ardhmen lypsen shokë të përgatitur. Duket se këto këshilla, të dhëna në frymë shoqërore e vëllazërore i keqkuptoj, duke menduar se qëllimisht ju mohokan aftësitë... Kam bindjen se kështu i ka lindur urrejtja, që më vonë të shendërrohet në vijë dhe kështu t'i gjejë "bashkëluftëtarët" për t'më shpallur "luftë". Që në çastet e para, kur këto dukuri po merrnin këmbë, e kritikova. Po kështu, kërkova si të domosdoshme të dalim para shokëve në rreth, për të parë se kush është në gabim dhe sigurisht që të përmirësohet. Kësaj i iku, kurse anash nuk prante së përhapuri shpifje se si unë ia kisha "zënë diellin". Pasi sipërfaqësisht kemi biseduar, thuaja më shumë veç e veç (edhe me shokun Salih)

edhe për Fazliun, duket se është e domosdoshme të shiqohet në nivelin tonë se mos unë jam në pozita të gabueshme (që është më e dëmshme se sa të jetë Fazliu), kurse nëse është Fazliu, atëherë si duhet t'ia bëjmë. Në këtë drejtim më së shumti ka për të thënë shoku Salih (të cilit Fazliu duhet t'i ketë folur shumë për "padrejtësitë" që ia kam bërë dhe për "gabimet" e mia. Fjalën gabime e futa në thonjëza, jo pse nuk kam bërë ndonjë gabim, por për bindjen se sa ka mundur të shpif Fazliu nuk kam bërë gabim...).

Më i ndërlikuar më duket rasti me Xhavitin, pasi është më i rafinuar. Te rasti i Xhavitit asnjëherë nuk kam mundur ta shlyej dyshimin që ma kanë imponuar disa vrojtime të bëra. Thuaja, që në orët e para kur erdha në mërgim njoha Xhavitin dhe pata bashkuar aktivitetet. Por ja, krijova bindjen se ai njeri nuk po kontribon më shumë se sa q'i duhet për maskim, edhe pse kapacitet dhe mundësi kishte që të kontribonte më së shumti, pasi për çudinë më të madhe shumë rrallë punonte, ose thuaja nuk punonte fare. Kohë të gjatë jetoi në konvikt të grave (motrave medicinale), ku ishte e ndaluar për burra... Jetonte te një gjermane, me të cilën tani po "bashkjeton". Në një kohë pat pruar shoqen (gruan) nga Kosova. Më vonë mësova se ishte ndarë me të (për arsyet që s'i dij dhe nuk më interesuan gjithaq, edhe pse nuk ishte e tepër të dija, pasi e çmoja për shok të idealit, që militonim në të njejtat radhë...). Me kalimin e kohës bënte edhe mashtrime të pakuptueshme (se punët shkonin mirë në rreth...). Por provat vërtetonin të kundërtën. Kështu lindi ftohje mes nesh, njëherit edhe distanca. Sa i përket klubit na dukeshin se po bëheshin manovrime të pakuptueshme, në të cilat u përzie më vonë edhe Sonja... Të dy së bashku bënin manovrime në relacione edhe më të përmbledhta se sa klubi, pra sa u përket radhëve revolucionare, përkatësisht LRSSHJ-së. Në sy më së qarti binin dezinformatat dhe dezinformimet në Rrethin e "tyre", shpesh nga pozitat se janë me LRSSHJ-në "demaskonin" atë. Po kështu, manovrime të ngjashme na binin në sy kur i bënim vizitë klubit "Kosova", siç na ndodhi me një rast – që të konfrontoheshim para masës... Pa u detaluar, është një rast që unë nuk e kam të qartë. Por edhe veprimtaria e tij, sidomos me çfaqje të disa filmave, nuk ma mbush mendjen se çdo gjë është në nivel dhe e pastër...

Ato që shihen qartë ke të tretë, janë mendjemadhësia dhe fodullëku, janë pseudointelektualizmi dhe intrigat, kurse të Isaku e Xhaviti edhe dëgjenerimi (Të i pari jo vetëm se nuk po i ka sukses sa duhet, se përndryshe, vetëm një pjesë e asaj që ka treguar vet, me njëfarë "krenarie" po të jetë e vërtetë, atëherë dëgjenerimi i tij gjatë kohës së studimeve në Pragë – ku janë kushtet, pasi edhe sistemi kushtëzon dëgjenerim në përmasa të gjëra... – është vërtetë i turpshëm. Të i dyti, pos "banimit" në konvikt të grave dhe fakti se ka lëshuar gruan shqiptare e po bashkëjeton me një gjermane, nuk më ka rënë më shumë të dëgjoj.).

Bazuar në të kaluarën e tyre dhe në "maniret" e tanishme (nuk janë në pyetje manire, por gabime të larmishme të bëra vijë...), më duket e pamundshme, e dëmshme dhe e palejueshme që këta përsona të aktivizohen në atë nivel, sa në rrethet e "tyre" të ngarkohen për t'i drejtuar aktivitetet. Nëse thëmë kështu, nuk shkel parimin se çdokush që është që viseve shqiptare nën Jugosllavi t'u njihet Statuti i Republikës duhet të jetë me ne. Të jesh me gjithëmend për ta fituar Statutin e Republikës është krejt tjetër nga ajo që të maskohesh, jo vetëm për një interes. Pra, nuk kanë me qenë të rralla rastet që do të na konfrontojnë, kur rrugaçët, aventurierët, të dështuarit do provojnë ta shfrytëzojnë rastin për t'u "rehabilituar". Ndërsa sa për veglat që janë në shërbim të UDB-së, të cilat kanë për detyrë të përdorin maskat më të përshtatshme për të depërtuar në radhët tona, nuk duhet të harrojmë në asnjë çast. Kam përshtypjen sikur në këtë drejtim, kushdo që tregohet entuziast... sikur ia hapim derën menjëherë. Harrojmë faktin se armiku nuk pushon asnjë

çast, prandaj ata që janë në shërbim të armikut, nuk do na tregojnë se janë në shërbim, as që kanë brira për t'u parë, por maskohen si dinë e mundin (duke dhënë kontribute të llojllojshme e aktivitete të "lakmueshme"...), që të na "përqafojnë" sa më shterngueshëm, për të na kafshuar pastaj sa më idhët... (Një pësim të hidhur kemi prapa, nga i cili jemi të detyruar të mësojmë shumë.)

Sa për vigjilencën që kërkohet në këtë situatë, as që më duket e nevojshme të ndalem, pasi është e vetëkuptueshme. Por, sikur e kemi lëshuar ca. Na ka përfshirë liberalizmi evropian dhe po mendojmë se këndej armiku do na le të qetë. Pra, siç mund të vërehet, sikur këndej nuk është asnjë vegël e UDB-së, që sillet rreth, shitet më patriot se kushdo dhe pastaj... Unë nuk dij se çfarë interesash kanë ata që na shkaktojnë pengesa të tilla, pos që luftën kundra armikut ta qesim në plan të dytë, kurse thash-e-themet t'i kemi në plan të parë, për të humbur kohën se si duhet të veprojmë në gjendje të tillë. Sikur ka rënë në harresë një rast, të cilin unë po e rikujtoj në këtë rast, nga i cili mund të nxjerrim mësime (e në të njëjtën kohë edhe t'i përkushtohemi që ta sqarojmë, nëse dikush di më shumë.). Pra, është fjala për njëfarë "revolucionar" Shefqetin, i cili natën e fundit të jetës së shokëve (më 16 janar 1982) ishte "mysafir" (kështu më duket ka qenë prezentuar) nuk u lajmëru fare, as që të vijë të shpreh ngushllimet... Ku mbeti nuk e dij. Nëse është "zhdukur" fare, atëherë po tregoi si qe njohur me shokët Jusuf e Bardhosh, që të shkon pastaj shpesh në vizitë. Fillimi se si qenë njoftuar ka dy varianta (në fakt ka vetëm një, por nuk jam shumë i sigurt.). Varianti i parë është se, duke u interesuar shoku Bardh për ata që iknin nga trojet tona që t'u ndihmojë të organet gjermane (pasi ishte përkthyes zyrtar), ka mundësi ta ketë njohur. Por varianti i dytë më duket më i sigurt, pasi e kam përjetuar. Fjala është për një koncert në Sindelfingen, të cilët bashkatdhetarët e patën prishur. Në atë koncert si më aktivi për të thyer nga qenka treguar "Shefqeti". Bashk me shokët tjerë që të diskutohet se si vajti puna gjatë koncertit edhe "Shefqeti" ka shkuar në banesën e shokëve Jusuf e Bardhosh. Prej ati rasti patën mbetur "shokë"... "Shefqeti", "absolvent i albanologjisë" (kështu më duket se prezentohej?), nga "Bllaca" (e Lumthatit, siç na thoshte), nuk dij ku gjendet dhe çfarë bënë... Këtë shembull nuk e solla që t'i përkushtohemi për ta zbuluar, nëse edhe tjerët nuk dinë se ku ka vajtur ky farë "Shefqeti", pasi nuk ishim të kjo temë (për këtë, që t'u biem në gjurmë kriminelëve nuk kemi prajtur së hulumtuari, pra kemi angazhuar bashkatdhetarë që të pyesin në Bllacë për këtë farë "Shefqetin", por për sa kanë mundur të informohen sikur nuk ekzistueka...), por më shumë desha të tregoj se si mund të afrohen veglat e armikut, nëse "Shefqeti" është vegël...

Nëse potencoj rëndësinë e vigjilencës, nuk kam ndërmend të kontribojmë që të na përfshi ankthi e frika duke lindur një lloj epidemie. Por që të na infekton liberalizmi evropian (siç ma pat thënë shoku Isë me një rast – se "radhët në mërgim kanë qenë të ndikuara shumë nga liberalizmi evropian..." Nëse nuk e kam mbajtur mend ose kam përdredhur diç kërkoj falje, por kështu më duket se më ka thënë.) nuk guzojmë.

Edhe pse u ndala bukur gjatë ke rasti i personave në fjalë, e them se nuk marrë asgjë si armiqësi individuale, mes meje e tyre. Që kur jam ushtar i popullit (të tillë e dij veten!) në asnjë hap nuk jam për atë që të merrem me hakmarrje individuale, për t'i shuar revoltën e ndonjë urrejtje që ka mundur të më lind. Mendoj dhe jo vetëm se mendoj, por konkretisht jam për atë, që të mos merremi me ndonjë aventurë vetëkënaqëse, por që damton luftën në planin global. Pa e zgjatur, do kisha propozuar që vetëm në nivel intern të dimë si do t'ia bëjmë dhe çfarë qëndrimesh do marrim. Që të demaskohen haptas në emër të LRSSHJ-së nuk duhet, pasi nuk dimë edhe përfundimisht se çfarë është duke i shtyrë dhe damtohet lufta. Më duket efektive t'i përmbahemi proverbit popullor: "qentë le të lehin e karavani le të ec". Fazliu e Xhaviti do të ishte dashur të reflektojnë, pasi ka mundësi të jenë anëtarë, ose ta dinë veten për anëtarë të LRSSHJ-së. Në fakt Fazliu qe

anëtarësuar taman në fazën kur organizatat po bashkoheshin, kurse Xhaviti ishte anëtar përpara i ... dhe ndonjë vendim për përjashtim nuk ka qenë marrë, por edhe që të çmohet si anëtar në kuptim të plotë të fjalës nuk është qmuar; më shumë është lënë anash si i ashtuquajtur anëtar pasiv për arsyena që mund të vetkuptohen. Kështu i dijë unë. Mund që ekziston mundësia të jenë të anëtarësuar me plotë kuptim të fjalës. Mbi këtë mund të na informon shoku Salih. Atëherë nëse janë anëtarë, duhet doemos të tregojnë mbi të gjitha, se për çfarë arsye shpifin e trillojnë pa biseduar së pari mes veti që të merret qëndrim i prerë (të dënohet ai që është për t'u dënuar...), të cilit duhet t'i përmbahemi të gjithë.

Më shumë nuk do të zgjatesha kësaj radhe, pa ditur edhe mendimet tuaja, por që është serioze, s'do mend të thuhet. Unë nuk jam për atë që të na ndodhë si me Besimin, Ahmetin, Nuhiun... edhe pse për asnjërin nuk di se është marrë ndonjë qëndrim i prerë, në bazë të cilit do dinim se si duhet të sillemi ndaj të tillve.

Se cilat pasoja rrjedhin po nuk ju përkushtuam seriozisht mund të ndriqoj me shembujt që do sjelli.

Se cili ishte Besim Rexha (alias Shpat Gjirokastra, siç e kishte "pseudonimin" të vënë në zile të banesës...) ne dinim. Mbanin qëndrim në distancë por taktikor. Përfundimisht na dukej i sëmurë... Ai provonte kudo të përhap dezinformatë për shokët e vrarë, gojarisht por edhe me shkrim (ka edhe prova.), duke shpifur gjëra të ulëta. Pasi u vranë shokët ai provoi ta ngatërroi krrabën, sikur na paskësh qenë shok i tyre i ngusht, që prej atyre pozitave të më lufton edhe mu, pasi gjer më atëherë nuk i kishte pasur sukses. Për çudi e pat gjetur ajamin... Me kalimin e kohës e njohën të gjithë, ata që së njëhen dhe që e patën njohur, por heshtnin. Si ka shkuar pastaj nuk e dij, por ajo çka është më e dëmshmja, në prani të tij e me të janë biseduar shumë gjëra... Tani, po ai Besim, na del dhe e shpall LRSSHJ-në për "fashiste" (për çudi në Klub të Bielefeldit...!!) dhe gjëra të ngjashme. Komentimi do të ishte i tepërt dhe i panevojshëm.

Për mjekrrën çfarë të thuhet. Deri sa ishin shokët gjallë, bënim "dua" (siç do shpreheshin fetarët) që të mos na e pret rrugën, se e gjithë puna shkon mbrapsht... Kur pa prit pa kujtuar ia dual t'i marrë në dorë të gjitha dokumentet... Pos kësaj, me aparata ndër më modernët, të fotografon vazhdimisht brenda në banesë të shokëve, në marshime e demonstrata... Se kishte "manire" të çuditshme, nuk ka qenë vështirë të shihen që në vështrim të parë. Se ku gjendet tani dhe ku do dal më vonë nuk e dij saktsisht, por krejt gjera të pastra nuk do t'i quaj...

Për të "shenjtin" Nuhi (i cili binte i fundit dhe zgjohej i pari gjatë ditëve kur prisnim vendimin e regjimit jugosllav për t'i dërguar kufomat e shokëve në atdhe...) nuk di shumë pastaj. Por në kohën e mëparme gjer ku varrosen shokët dija. Ai, hiç më pak as hiç më shumë, gjatë gjithë ceremonisë gjersa shokët u varrosën dhe pastaj, sillej si "padron"... Tani na është përjashtuar (nëse nuk gabohem.).

Mund t'i qesim të gjitha pas shpine tjesht e thjesht? Jo. Ata vërtetë kanë mundësi të na luftojnë më së shumti, pasi, edhe nëse nuk kanë qenë vegla të armikut, nga inati tani mund të bëhen. Dhe dihet sa janë në gjendje ta informojnë, nëse nuk e kanë informuar...

I solla këta shembuj për të parë se cilat pasoja rrjedhin kur bie vigjilenca. Prandaj nuk kemi nevojë të na ndodhin në të ardhmen. Kemi shokë punëtorë të mrekullueshëm, të cilëve nuk mund t'ua gjesh ndonjë shibël dhe që janë ngritur e përgatitur mjaft mirë, të cilëve mund t'u besohen aktivitetet në rrethe dhe të tjera punë që duhet të kryhen, pa patur nevojë të rrezikojmë me "badihavgjinjë" (po i përfshi disa llumpë...)... Nuk do ta fsheh se në të shumtën e rasteve punëtorët po qmohen "të thjeshtë" dhe të "papërshtatshëm" për aktivitete, kurse po na bindin "badihavgjinjtë", të cilët edhe ato aktivitete që i bëjnë (nëse

nuk i bëjnë për t'u maskuar...), atëherë i bëjnë nga mërzia, pasi nuk dinë si ta kalojnë kohën duke mos punuar asgjë... Në këtë drejtim, shokë, qalojmë shumë dhe është koha e fundit t'i përkushtohemi kësaj dukurie! Përndryshe, hiç s'do vonon e do na nxjerrin në bisht të lahutës bashkatdhetarët punëtorë... (Ndonjë rast tjetër, kur t'më premton koha, kam patur ndërmend t'i përkushtohem kësaj teme, që me këtë rast u prek shumë shkarazi. Po e them këtë, duke m'u dukur e arsyeshme që qes ndërmend që mendoni edhe ju, nëse shihet e arsyeshme.)

* * *

Ka mundësi që të jenë dërguar në Redaksi të ZK letra mbi Mbrëmjen e mbajtur në Bruksel, për t'u ankuar ose për të treguar se si unë ua "përzi" punët. Pasi nuk po kemi mundësi të takohemi, më duhet të shkruaj, edhe pse sikur ta kisha lënë në një përshkrim të gjërë (që më duhet ta bëjë mbi emigracionin, dihet atë që është popullor...), do t'ishte më mirë. Por, atje po dërgohen edhe letra tjera dhe kur të grumbullohen shumë, atëherë mund të thuhet: "ç'është me këtë shok, kundër të cilit të gjithë po ankohen..." Po shkruaj edhe me arsye se gjendja gati sa nuk ish alarmuar...

Atje pata shkuar pse m'u dha rasti të udhëtoj pa shpenzime (kjo nuk është edhe aq e arsyeshme ta përmend), pse kisha nevojë që gjatë rrugës t'i rregulloj ca gjëra dhe njëherit pse bisedova me shokë (përmes telefoni), të cilët, më thanë se ishte e domosdoshme që të shkoj. Kur mbërrina (një natë më heret) m'u duk më e arsyeshme të mos takoj shumë veta. Shokët që ishin në Këshillin e Mbrëmjes (pasi bashkatdhetarët kishin zgjedhur një Këshill që do vendoste për përmbajtje të programit), pasi u ishte dhënë referati që kishin punuar 4-5 veta, siç më thanë, ma dhanë ta korigjoj. Pasi që e lexova, m'u duk se nuk ishte në nivel, bile se disa gjëra ishin sa aventuriste aq edhe të dëmshme. Që të korigjohej m'u duke e mundshme, prandaj ju thash se do të rri pa fjetur (edhe pse edhe dy netët e shkuara kisha fjetur shumë pak), që ta shkruaj një tjetër duke i marrë nga ai referat ato pjesë që mund të mirreshin. E paramendoja se do lindin mosmarrëveshje, jo me Këshillin, po me tjerët që duan të shfrytëzojnë çdo rast për të hjedhur mish dhije. Që ta shkruajmë me maqinë thirra shoqen Shqipe (e cila kishte profesion daktilografinë...), pasi nuk kishte mbetur kohë. Ajo më tregoi se referatin e kishte shkruar i shoqi, bashk me te e disa shokë. Po kështu propozoi që të bisedoja me shokun (bashkëshortin) e sajë, pasi ka mundësi që ai të nxjerr komplikime. Erdhi. Në kohën e drekës, kur po drekonim te një anëtar i Këshillit të Mbrëmjes, e biseduam çështjen e referatit dhe u dakortuam se u deshka shkruar i riu. Bile, sikur shprehu njëfarë "gëzimi" që kisha qëlluar andej për ta shkruar të riun. Me atë rast, deri në atë çast të gjithë anëtarët e Këshillit, pos njërit që s'e kishim takuar ende, ishin dakortuar, bashk me dy autorët kryesor të referatit të mëparmë.

Në kohën kur duhej të shpallej e hapur Mbrëmja, më ra në sy se ziheshin mes tyre anëtarët e këshillit në njërën anë dhe autori kryesor i referatit të mëparmë, me të cilin ishim dakortuar çdo gjë në drekë (ku ishin të pranishëm bashkshortja e tij me shokun e Këshillit dhe të shoqen.). Sa të nervozojnë gjëra të tilla, thjesht pabesi e ulët. Shkova të bisedoj. Në atë mes i përziente hundët (të shprehem ca brutalisht...) ai i Parizit, që ndiente veten kompetent (pa ditur fare si qëndronin punët, por ja që i kish thënë autorit të referatit të mëparmë se ju duhet të vendosni, pa ua imponuar askush nga jasht...). I ndava mënjanë ca, edhe autorin që biseduam në drekë dhe u thash prerë: "është tejet e turpshme të bëhen gjëra kaq të ulëta, pasi në drekë u dakortuam, i gjithë Këshilli e ka aprovuar dhe ti shoku M... na del tani të provokosh skandal..." Kur pa vendosmërinë u dakortu.

Reshati, me natyrë prej qypi... kishte zënë vend në një qoshe dhe shiste poza. Ishte i shoqëruar me të panjofshëm... Nuk bisedova fare më shumë se sa ta kryej një formalitet,

pasi vërtetë ishte mbushur kupa – edhe bisedat e ditëve të fundit i kishte përdredhuar, siç thotë populli sy më sy, duke më shkruar letra "historike" plot me dallavere...

Ati të Parisit ia tërhjeka vërejtjen që të mos hy në biseda konstruktive, dua të them të nivelit sikur ai për disa orë do t'i rregulloi budallëqet e viteve, pasi, siç i thash, edhe nuk i njeh problemet e njerëzit edhe nuk ke eksperiencë me dredhi të tyre. Por më duket se nuk iu ka përmbajtur këshillës që ia bëra.

Të tjerëve u thash se është fare e paarsyeshme ta merrni shkas referatin për t'u përqarë edhe më shumë se sa ini. Po kështu u thash se është e dëmshmë ta nxjerrin hapur se kush e ka shkruar referatin dhe ua ka "imponuar". "Nëse u duket se u është bërë e padrejtë, ju pata propozuar, merrni të dy referatat dhe postoni RZK (Redaksisë së Zërit të Kosovës-shën i Xh. D.), duke i shkruar se si ka ndodhur, por sa më sinqerisht, dhe do merrni përgjegje se cili referat ka qenë më në nivel, edhe pse nuk keni nevojë, pasi dukeni se për aq u punon arsyeja..."

Nuk e dij kush dhe përse po zien gjellë të ndytë e të helmosur në atë Bruksel, por kam përshtypjen se në të ardhmen do kemi telashe, pasi, siç ma thon parandjenjat, aty është një klan i dërguar, që ngerdhuzen sipas rastit mes veti për ta kafshuar të tretin... (Dëshiroj të mos kem të drejtë...!) Por të shohim...

* * *

Kështu si e kemi LRSSHJ-në paregjistruar askund jasht, mendoj shtetët e P., vërtetë që do hasim çdo herë në vështirësi. Janë kohë të tilla dhe situatë e tillë, që as luftën tonë të drejtë nuk mund ta propagandojmë sa duhet e si duhet dhe as ndonjë lidhje e kontakt vështirë që mund të vëndosim. Aty ku kemi adresën dhe konton, sikur më duket pa perspektivë të sigurt... Prandaj është koha e fundit kur na duhet definitivisht të vendosim për ta regjistruar LRSSHJ-në dhe të hapet pastaj Fond zyrtar. Në këtë drejtim jam konsulltuar, kam hulumtuar e jam këshilluar. Si kush i parë është që të kemi Program e Status (të cilin duhet përkthyer në gjuhën e shtetit ku do të regjistrohet Lëvizja). Pastaj duhet patur disa njerëz, në emër të cilëve duhet regjistruar Lëvizja. Sipas të gjitha gjasave ligjet më demokratike dhe hapësira më e gjërë duket këtu (ku jam momentalisht). Të mendoni në këtë drejtim dhe të vendosim.

* * *

Për një propagandë konstruktive të çështjes sonë, nëse mendohet efekti dhe në bazë të kontakteve të ndryshme, kam ardhur në përfundim se është i domosdoshëm një Buletin informativ (i kohëpaskohshëm), sa për fillim në tri gjuhë. Sipas të gjitha parashikimeve (edhe pse nuk i kam bërë të gjitha llogaritë), nuk do kushton shumë dhe do kemi mundësi ta nxjerrim në tri gjuhë (anglisht, frangjisht e gjermanisht. Edhe suedisht e kemi më së lehti, por gati nuk ka nevojë, pasi anglishtja e zavendëson.). Ka kohë që po bëhen përpjekje, sidomos në sigurim të adresave të deputetëve të të gjitha shteteve evropiane (të Perëndimit), të gjitha gazetave, bibliotekave, partive e organizatave politike, individëve që kanë krijuar personalitete, shkrimtarëve, filozofëve, etj. Por të gjithë së bashku, do të duhej të bënim shumë në këtë drejtim, pasi afirmimi i çështjes sonë është detyrë prioritare për ne që jemi jasht. Si përfundim, po propozoj që të nxjerret një Boletin informativ në gjuhë të huaja (i kohëpaskohshëm – kur të kemi siguruar materialin e domosdoshëm...). Edhe këtë propozim (ide) kam ndërmend të shkruaj më gjerësisht (ka mundësi që po lë shumë punë për herën tjetër dhe s'do ta përthekoj dot...).

* * *

Këto ditë del nga shtypi broshura "Shpërngulja e shqiptarëve" e ribotuar, teknikisht më në nivel dhe me disa korigjime, bashk me një Pasthënie. Ribotimi i saj u pa e nevojshme nga fakti se në SHBA-të nuk ishte e njohur thuaja fare. Ishte shpërndarë nga Hysen Tërpeza, por fatmirësisht në numër të vogël dhe në nivel të dobët. Pasi patëm biseduar me disa shokë, ata patën shpreh interesimin. Edhe botimi qe rregulluar të bëhet atje (duke u treguar i gatshëm i njëjti bashkatdhetarë që kishte botuar në gjuhën angleze),por u "arsyetu" më vonë se për shkaqe teknike nuk e bëri botimin e sajë. Tani financimin e bëri ... dhe do të dali në 2000 ekzemplarë. Menjëherë do t'i dërgojmë një numër të madh në SHBA-të. Do të ishte mirë t'ua postonim ca edhe Shoqërisë "Bajram Curri" në Australi. Nga se kushtuan (bashkë me traktin e 1 Majit) 5 000 Kruna suedeze, e pamë të udhës t'i vemë çmim që t'i nxjerrim së paku shpenzimet dhe pse jo të dali ndonjë përfitim: çmimi (solidar) 3 dollarë SHBA.

Duke parë rëndësinë që kjo broshurë të botohet në gjuhën turqishte, është bërë përpjekje që ta përkthen ndonjë shok a bashkatdhetar në Turqi. Për arsye të panjohura ... nuk është bërë, prandaj është angazhuar një shok që ta bënë, siç do ta lexoni edhe nga letra... Në mbarim të kësaj jave referati do të jetë i përkthyer, kurse sa për Parathënie të aktualizuar ende nuk është gati. Unë kam dy propozime sa i përket botimit: i pari është që të botohet në dy gjuhë (në njërën faqe shqipe kurse tjetrën turqisht, që t'u ngjallë interesim bashkatdhetarëve për të bërë krahasim dhe kështu të mësojnë edhe shqip; i dyti për arsyena teknike të botohet vetëm në turqishte, pasi duke u bazuar në situatën politike në Turqi, thuaja se duhet bërë përhapja ilegalisht (po kështu, duhet pasur parasysh organet dhe opinioni turk.). Mendoni se cili nga variantët duhet zgjedhur, duke menduar se sa për aprovimin që të botohet nuk do vëhet në dyshim. Bile, vetëm duhet të çuditemi pse nuk është përkthyer gjer më tani...!

* * *

Krahas ca botimeve që po përgatiten, propozoj që të botohet edhe drama e shokut Jusuf "Procesi". Botimin do duhej bërë për dy arsye, pos të tjerave që dihen. Arsye e parë është se mund t'i teket ndonjë tekayti që ta botoi, çka nuk duket e drejtë dhe do ishte e dëmshme... kurse arysea e dytë është se është literaturë shumë konkrete dhe në këtë rrëmujë të arrestimeve, prej së cilës dramë mësojnë se cilin qëndrim duhet të mbajnë para gjyqeve fashiste. Rëndësi tjetër do të ishte edhe një Parathënie e shkruar mirë. Kurse botimi duhej të bëhej në formatë sa më të vogël (në letër sa më të hollë) që të jetë leht për ta futur në Kosovë (kuptohet, edhe në viset tjera shqiptare në Jugosllavi.).

* * *

Duke përfunduar kësaj radhe do më duket e arsyeshme të flas edhe mbi një dukuri, nga e cila po kushtëzohet puna jonë e suksesshme në Evropën Perëndimore e më gjerë. Fjalën e kam për kuadrat, për të cilat po ndihet nevojë e madhe, shumë e madhe. Ta zëmë, që ta afirmojmë dhe propagandojmë luftën e popullit tonë, si e drejtë që është, të opinioni botëror duhen shkrime e njerëz, pos mjeteve materiale, siç duhen edhe për aktivitete tjera... Ka punë shumë dhe ne vetëm një pjesë jemi duke i dalur zot (shpesh herë shkel e shko...), prandaj duhet të mendojmë me seriozisht mbi të gjitha, sidomos mbi sigurimin dhe ngritjen e kuadrave. Janë gjëra që duhet t'ju përkushtohemi shtruar, me seriozitet e sinqeritet, pasi këtu unë vetëm shkarazi sa preka probleme shumë të mëdha, për mendimin tim.

Të veçanta (Në vazhdim do shkruaj mbi disa gjëra të veçanta, prandaj si kopje që po dërgohet letra, nuk do të jenë të njejtat në vazhdim.):

Shoku (Ibrahim Kelmendi)

19. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin dhe QE, 3 qershor 1983

Shumë i dashuri shoku F.,

letrat nga ti i mora. Nuk po vonoj fare të të shkruaj, por jo që t'u përgjegjem atyre. Më shumë desha të të bëjë me dije se i ka marrë, pasi do merakoseshe. Përgjegjen do ta shkruaj me një rast tjetër, pasi të kam kohë – momentalisht jam shumë i zënë me një punim, ca të zgjeruar, për një broshurë në gjuhën turqishte, pasi referatin e Qubrilloviqit, "Shpërngulja e Shqiptarëve", veç e kanë përkthyer shokët. Para se të përkthehet duhet ta aprovojmë përmbajtjen për botimin, prandaj, posa ta kem kryer do ta dërgoj një kopje.

Këndej punët shkojnë mirë, por shqiptarë nuk ka shumë. Përsa është numri i shqiptarëve, marrë në përqindje, punët shkojnë shumë mirë, sidomos sa u përket ndihmave Fondit. Më parë, për shokë tjerë, përmes H. kanë dërguar ndihma solide, tani siç më bënë me dije, janë duke grumbulluar ndihma të reja. Kurse financimin e traktit dhe të broshurës së Qubrilloviqit (2000 ekzemplarë, me Pasthënie të zgjeruar), mendova traktin e 1 Majit në gjuhë suedeze, i kanë financuar këndej.

Për ato që shkruaja, vetëm me arsye dhe pa ndonjë nxitim e pezëm. T'i kapërcejmë ca gjëra, për t'ju përkushtuar vetëm atyre që janë me rëndësi, por vetëm ato që janë të kapërcyeshme. Më gjatë do shkruar, siç shkrova më lartë, herën tjetër, por edhe shumëçka, pasi siç munda të kuptoj, gjatë të shkruarit, më shumë ke dashur të shprehish indinjatë ndaj ca dukurive të këqija, se sa t'i shtrosh me gjakftohtësi dhe qartë. Sikur të kishe mundësi të më shkruaje gjëra ca më konkrete në atë drejtim, pasi për ato që shkruaje, sidomos sa i përket Nu. nuk i kam kuptuar.

Për H., si edhe nga materiali, nuk e shkarkoi veten nga përgjegjësia, por të siguroi dhe mbaj përgjegjësi edhe për udhtimet e mija me te, edhe për udhtimin konkret që kishe zënë në gojë, pasi ajo shoqja është gru me kunorë e shokut tjetër (gruaja e dytë, në atdhe ka një grua shqiptare me fëmijë, por sipas ti dhe të tjerëve, ajo qenka "dakortu" që ky të marton edhe atë...) të cilën e muarën me vete për t'i tejkaluar vështirësit gjatë rrugëtimit...

Sa i përket punimit që ceka, shumë do të më duheshin të gjitha gazetat ilegale që janë botuar, duke u nisur nga Lajmëtari..., ZK, Bashkimi, Liria. Sikur t'i kesh të grumbulluara, m'i dërgo – të siguroj se posa ta kem kryer punën me to do t'i postoj mbrapa!

Sa për merakosjen për të më ndihmuar, unë mendoja se ke nga të Fondit, por jo me të holla personale, pasi e dij shumë mirë si qëndron me to, sa shpenzon e përse, prandaj mos ki merak.

Ndahem duke të përshëndetur dhe uruar lindjen e Kosovares! Asaj i dëshiroj rritje të shpejt e të mbarë – në liri! E përshëndet shoqen dhe uroje për mu për Misionin e sajë si Nënë Shqiptare. I përqafon voglushët!

–PËR NJË REPUBLIKË SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!

–RROFTË LRSSHJ-a!

I yti me besnikëri (Ibrahim Kelmendi)

PS. Numrin e ZK rrite për 20 copë tani për tani, pra i dërgo 50 copë në këtë adresë.

Mirëupafshim.

(Letër Faridin Tafallarit dhe Qendrës Ekzekutive, 3 qershor 1983; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 413-414)

20. Letër e Ibrahim Kelmendit për Xhafer Durmishi dhe QE, 3 qershor 1983

I dashur shoku S., Në mërgim..., më 3 qershor 1983

ca me vonesë po të shkruaj për t'ju përgjegjur letrës së 17 majit, të cilën unë e mora pak me vonesë (për shkak se nuk isha aty ku m'është postuar.). Sipas mendimit të shokut Isë, mendim përkatës nga shokët tjerë nuk kam, përmbajtja e letrës dërguar ty (më 4 janar 1983 e mban datën) dhe letrës për shokë të QE (më 7 maj) duhet të diskutohet në tryezë, të merren qëndrime. Edhe mu po më duket e arsyeshme të veprohet ashtu, por siç po shifet mundësitë janë mjaftë të zbehta për t'u takuar. Nëse do të kem mundësi (e tani për tani duket se jo), atëherë më duhet edhe më tutje të shërbehem me letra, që të komunikohemi. Mu për këtë arsye, kësaj radhe vetëm shkarazi po të përgjigjem në letrën që kam në tryezë....

Kur është fjala për personazhin për të cilin flitet më së shumti, më duket unë kam biseduar për lisa dhe tim më flet për fshisa, siç shprehet populli. Duket qartë një bishtërim përfid, por dua të dëshiroj se jo me qëllim. Rrethin e të interesuarëve e zgjeron aq shumë, sa fare nuk ka të bëjë me realitetin. Unë, lum shoku, kam shkruar për klanin, bandën e kufizuar të individëve, të cilët edhe i kam emërtuar. Ata janë kreatorët e fushatës, e cila do t'u dështoi! Kurse për rreth më të gjer, edhe pse janë munduar ta zgjerojnë, nuk mund të bëhet fjalë; kështu kam bindjen tani për tani! Sa për fërkimet, nga ana ime janë ruajtur në rreth shumë të ngusht, aq të ngusht sa vështirë që ka depërtuar diçka; mendimi im ishte se vetëm armikut i konvenon të dij për fërkimet... Nëse ato janë përhapur nga tjerët, kreatorët do marrin përgjegjësinë.

"Për bandën që e quan ti, duhet të mendosh jo pak, por shumë më seriozisht (...) a nuk bënë që edhe te ata të shtrijmë klimën e harmonisë?...", më shkruaje në vazhdim. Kur të kam shkruar, vërtetë kam menduar seriozisht dhe qëndroj pas asaj, pasi i njoh shumë heret. Unë jam që të shtrijmë klimën e harmonisë te të gjithë shqiptarët e ndershëm e patriotë, por në rastin konkret, para këti rasti, është punuar, bile edhe bashkëpunuar shumë afër (me të katërtit në rfgj.). Në fushatat më të reja, motor i së cilës janë pikërisht ata, e që dinë mirë edhe ti, nuk është asgjë stihike, apo hiçgjë. Gjatë gjithë kohës kam mbajtur qëndrim vrojtues e pritës (mendoj jashtë rrethit tonë) dhe edhe më tutje do mbaj, deri sa të marrim qëndrim. Edhe të tjerët i kam këshilluar të mos reagojnë as si ata e meritojnë. Të shohim, ndoshta sa ta hetojnë se po demaskojnë veten edhe mund të pushojnë. Unë tani për tani nuk jam në korent. Gati po më duket më e arsyeshme t'u përkushtohem vetëm detyrave të mia. Kur të marrim vendim të caktuar, atëherë duhet t'i përmbahemi!

Në përfundim të letrës shpreh besimin te personat në fjalë, duke qenë shumë i sigurt. Po më çudit bindja jote, e formuar për një kohë relativisht të shkurtër dhe në një hapësirë bukur të papërshtatshme. Po pres nëse ke prova për të më bindur. Kurse për fërkimet me rryma të ndryshme do të duhej të na informosh, pasi na duhet një pasqyrë, në mos për tjetër, të dimë se me cilat rryma kemi të bëjmë në rrethe të caktuara, kur do na qetë puna. Sa për bazën, kam bindjen se nuk qëndron puna keq, edhe pse nuk jemi duke e zgjeruar sa lypset; nuk di ta kem keqpërdor ndonjëherë dhe nuk e kam ndërmend!

Vërtetë do të duhej të takohemi, por unë nuk po kam mundësi – pasi me organe gjermane të kufirit, nuk po më ec fati, pasi lejes së qëndrimit i ka dalë afati; në raste të tilla janë shumë të rrept, se kur hynë njeriu për herë të parë. Posa të jem rregulluar do të ju bëj me dije.

Edhe letrën e 4 majit e kam marrë, por siç shkrova më lartë, me vonesë të konsiderueshme. Letra mban datën e 4 majit, kurse unë e kam marrë shumë vonë, bashkë

me atë të 17 majit (nëse nuk gabohem). Sa i përket takimit, shkrova mjaft, kurse sa i përket komunikimit me letra, e bëra. Po pres përgjegje.

Sa i përket Programit dhe Statutit që shkruaje, konturat janë shtruar në ZK, nr. 3 (1983). Edhe në tubimin që kishim, mbet si e vetëkuptueshme se shoku Isë do të punon, pasi disa herë e potencoi dhe ne nuk e kundërshtuam, do të thotë u dakortuam. Ai, si përgjegjës edhe për ZK, ka parë të arsyeshme këto konjuktura (kontura-shën i red.) t'i boton. Mu më duket më e arsyeshme sikur të diskutoheshin përpara dhe të aprovohej botimi në ZK. Të shohim se çfarë do të thotë shoku Isë. Tani, që janë botuar, të takon ty të diskutosh me shokët (anëtarët), kuptohet, ta organizosh diskutimin, por edhe për një punë kaq me përgjegjësi duhet pyetur të gjithë, se si dhe në ç'mënyrë duhet të bëhet diskutimi dhe vlerësimi. Për mendimin tim do të duhej të kompletohet i tëri për t'u diskutuar e aprovuar, duke e shoqëruar me një material shoqërues-udhëzues, për mënyrat e diskutimit, të grumbullimit të vërejtjeve dhe propozimeve, që përfundimisht të studjohen dhe të nxjerret Programi dhe Statuti i LRSHJ-së.

–PËR NJË REPUBLIKË SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!

–RROFTË LRSSHJ-a!

Të përshëndet shoku (Ibrahim Kelmendi)

21. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, 17 qershor 1983

Ibrahim Kelmendi: "Kohë pas kohe po hy borxh, duke të shkruar se do të shkruaj më gjatë njëherë tjetër. Këtë borxh po e rrisë edhe kësaj radhe, pasi vërtetë jemi të zënë me punë konkrete. Më 19 qershor shkon për vizitë kryeministri i Suedisë në Jugosllavi. Atij i kemi shkruar letër dhe me të po informojmë opinionin. Ka gjasa se do të flasë për çështjen tonë. Letrën e kanë firmosur shumë bashkatdhetarë dhe sipas informatave të tërthorta, do të arrij efektin e vet. (Kopjen e letrës ta dërgoj herën tjetër).

- Për një Republikë Shqiptare në Jugosllavi!
- Rroftë LRSSHJ-a!

Përshëndetje nga Shoku (Ibrahim Kelmendi)" (Letër FT, 17 qershor 1983;
(Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 414-415)

22. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive (QE), 30 qershor 1983

Shumë të dashur shokë, Suedi, më 30 qershor 1983

pasi më ra në dorë Qarkorja (pa datë, por mua më erdhi më 29 qersh.), edhe pse më poshtë përdoret shprehja "letër-informative", e lëshuar nga Redaksia e ZK, pa u vonuar po çfaq mendimet dhe do bëjë edhe propozime, të cilat jo shumë me vonesë do t'i përpunoj. Veproj kështu pasi ende nuk e kam siguruar "Platformën..." e "OSBPK", mungesa e së cilës nuk po më pengon tani për tani, që t'i çfaq mendimet e propozimet, pasi siç po shifet më posht, sipas mendimit tim, do të jetë e tepërt analizimi i saj, po qe se bazohemi në parimet organizative. Bile menjëherë do shtroja pyetjen: pse kemi nevojë, edhe anëtarët, ta analizojmë atë "Platformë..."? – siç është propozuar në Qarkore. Nëse anëtarët e LRSHJ duhet ta analizojnë "Platformën..." në fjalë, atëherë do vetëkuptohet se me pëlqim që LRSHJ-së është formuar "OSBPK", por vetëm se na qenka shtrembëruar vija (nga kepërdorimi i besimit i atyre që na qenkan ngarkuar) dhe tani u dashka studjuar

për t'u ndrequr, ose edhe për t'u marrur mbrapa... Pastaj, kur kërkohet që "Platformës..." t'i bëhet vlerësim nga gjithë anëtarët e LRSHJ-së, vetëkuptohet se LRSHJ-a duhet t'ua siguron anëtarëve atë; është kontradiktore në njërën anë të pengohet shpërndarja e materialeve që nxjerrë "OSBPK", kurse në anën tjetër të kërkohet vlerësimi nga anëtarët atë që s'e kanë dhe s'kanë nevojë ta kenë. Unë mendoj se vetëm një grup shokësh do duhej të ngarkohej me studimin e "Platformës...", dhe atë vetëm për nevoja interne të Lëvizjes, duke i bërë të gatshme analizat, por pa u nevojitur për nevoja demaskimi tani për tani, sa për nevoja të pastajme, nëse kjo bandë nuk do të merr mbrapa formimin e "OSBPK", e cila provon të mashtron lexuesit e painformuar se gjoja e kanë formuar "sipas dokumenteve të 17 shkurtit..." ose, nëse nuk do prajnë së minuari Lëvizjen nga "brenda", atëherë kur bëjnë lojëra të tilla "në emër të LRSHJ-së".

Kur përmenda parimet organizative, mendova se vetëm Lëvizja ka të drejtë të formoi organizata të tjera, sipas nevoje dhe kushteve, por asesi individët, për hatër të aventurave "revolucionare" (kështu po shprehem tani për tani, mbase janë edhe "lojëra" armiku). Në këtë rast, secili që di të kupton sado pak, mund të vie në përfundim se Lëvizja nuk ka të bëjë asgjë me të tillë horra, pos që ua ka dhënë shansën, po qenë siç lypset, të bashkohen.

Po të flitet shtruar, ashtu siç kërkohet, për t'i quajtur gjërat me emër të vetin, duhet pranuar se është injorancë e ulët kjo farë "loje" dhe është e mallkuar ajo kohë që duhet të shpenzohet për diç të tillë. Për vlerësime të tilla nuk duhet kushedi çfarë njohurive teorike, mjaftojnë kundërthëniet që ata kanë shkruar në "organin" (pa numër, që u shpërnda në gjysmën e dytë të qershorit 1983) e "OSBPK", i cili bazuar në përmbajtje, është kokë e këmbë "organ" i isht (që në fakt len të kuptohet se nuk është bashkuar) PKMLSHJ.

Se duhet demaskuar kjo "organizatë", më përkatësisht ajo bandë njerëzish dallkaukë, as që do duhej të çfaqet ndonjë dilemë, pasi në veprimtari minuese e kësaj natyre, "në emër të LRSHJ-së", shihet edhe nga i verbëti dhe dëgjohet edhe nga i shurdhëti. Por më rëndësi është të vendoset se si.

”Para se të ndërmerret fushatë demaskimi, do të lypsej edhe njëherë të kthehemi ’dokumenteve’ (që përmendin ata – të 17 shkurtit), të cilat, mendoj dokumentat, duhet t’i ketë LRSHJ-a në dispozicion, që të ecim me hapa të sigurtë, pasi armiqtë kanë më së shumti sukses atëherë kur shfrytëzojnë lëshime e gabime, që ndonjëherë shpëtojnë. Sidomos në këtë drejtim shumë ndihmojnë shokët që kanë marrë pjesë në ato bisedime. Ose, mund që mjafton se të gjitha janë shpifje që mund t'i bëjnë vetëm tipa të tilla.

Sa u përket individëve që luajnë këtë "lojë" dhe PKMLSHJ, nuk kam nevojë të ndalem, pasi edhe nuk më është kërkuar të dij. Besoj se shokët Salih e Fahri dinë dhe kjo do ndihmonte. Them këtë, pasi "trajnerët" e ekipës janë sjell shumë në atë teren, bile e kanë patur si "çerdhe"... banesën e shokëve Jusuf e Bardhosh, ndër ta kryesisht Nuhiu, i cili shfrytëzoi në maksimum oportunizmin dhe naivitetin e disave...

Për shpjegim, kur ishim për bisedime me shoqen B. te shokët, në shtëpi të shokëve Jusuf e Bardhosh, se në cilin nivel dhe si duhet të bashkpunojmë për ta vazhduar luftën, ashtu siç ishte bashkpunuar përpara, ishin të pranishëm, - jo vetëm të pranishëm, por mund të thuhet edhe dirigjues...., - Nuh. (Nuhi Sylejmani) dhe Nexh. (Nexhati - Osman Osmani, siç e quanin atë tip të mbyllur e të heshtur...). Unë nuk munda ta kuptoj se Nexh.-Osman Osmani ishte i PKMLSHJ. Krijova bindjen se ishte kuadër i ri, i dërguar nga brenda nga LN... (LNÇKVSHJ) dhe siç më dukej, nga disa shokë të rinj dhe fare të pa eksperiencë (të cilët gjithë kohën silleshin andej...) ky Nexh., sa për Nuh. të mos flasim, kur ai bënte ç’të donte..., dëgjohej shumë.”

Potencova këtë rast, nga frika se mos gjatë bisedimeve, nëse janë zhvilluar aty dhe nga ata që gjendeshin aty, të mos u ketë lëshuar ndonjë shpëtim (më 17 shkurt), që të kenë mundësi të thirren "në emër të tyre", pasi edhe gjendja ishte shumë, ta quaj specifike. Nëse edhe në këtë drejtim nuk ka ndonjë "kashtë", për të cilën duan të kapen themeluesit e "OSBPK", që të mos mbyten..., atëherë demaskimi i tyre nuk duhet vonuar fare, ngase nuk ka nevojë të rezervohet kohë për të dhëna e vlerësime – fshati që shihet nuk don kallauz. Në rastin e kundërt duhet të mendohet si duhet të veprojmë. Por, as në këtë rast, nuk ka vend për hutim; derisa Lëvizja nuk formon vet sindikatë a organizatë tjetër, atëherë nuk do mend të thuhet se është kundër parimeve organizative nëse individët bëjnë "aventura", duke u thirrë "në emër të LRSHJ-së".

Sikur kam përshtypjen se kjo bandë don të bisedoi, jo si të tillë që janë, por si partnerë, bile partner që dirigjojnë e imponon ë, pasi shtiren sikur kanë masën prapa. Do të shkoj edhe më larg, duke guxuar të bëjë një sypozim tejet serioz, të cilin, në të ardhmen do detyrohem ta tërhjek nëse nuk sigurohen provat, ose do shndërrohet në një të vërtetë. Shpërndarja e "organit" "Punëtorët", është bërë nga një rreth i caktuar njerëzish (duke mos përjashtuar edhe ndonjë anëtar të LRSHJ-së, si rrjedhim i mashtrimit, nivelit të ulët të vigjilencës ose edhe të nivelit të ulët organizativ...), të cilëve disa herë ua kemi zënë emrat, si intrigantë, përçarës, "thash e themgji", fodullë, dezorientues, etj., pse jo duke u thirrë në "intelektualizmin" e tyre, për t'i dirigjuar punëtorët, duke lënë të kuptohen se janë të "ngarkuar nga LRSHJ-a". Unë nuk përjashtoi mundësinë që këto vegla (po i quaj kështu), duke qenë në shërbim të një padroni, janë dirigjuar nga ai të dalin hapur, pasi kanë mashtruar veten se është momenti, duke menduar se e kanë situatën në dorë, së paku në kurbet. Po të jetë e vërtetë kjo, kuptohet se do kemi dame, por pa fije droje shumë lehtë do të demaskohen, pasi masa (i mendoj bashkatdhetarët e vetëdishëm), pas të cilëve sigurisht qëndroj edhe ajo pjesë, që në shiqim të parë sikur duket pasive), mezi pret që të tillët t'i thërrasim me emrin e tyre hapur, duke u nisur edhe nga fakti se ata u kanë ardhë në maje të hundës punëtorëve.

Sipas mendimit tim, i pari do të duhej të na vinte në korent shoku Salih, pasi ai duhet të ketë mundësinë i pari për shpërndarje të çfarëdo materiali dhe nga kush shpërndahet. Bile, do të më duket fare e pakuptueshme nëse mbi shpërndarjen e materialit në fjalë nuk janë porositur së paku anëtarët që të mos mashtrohen për ta shpërndarë, duke i bërë me dije ata se nuk është nga LRSHJ-a. Tani shoku Salih do të duhej të përgatit raportin se kush në cilin rreth ka shpërndarë dhe për çfarë "arsye", pasi mund të ketë edhe nga ata që janë mashtruar e keqpërdorur...

Propozimi tjetër do të ishte që në këtë numër të ZK të botohet së paku një sqarim i vogël, ku do të thuhej se materialet që kanë dal në qarkullim nga "OSBPK" nuk kanë të bëjnë me LRSHJ dhe "dokumenta" në të cilët ata thirren, nuk ekzistojnë. Në vazhdim do të duhej të shkruhej: Qëndrimet e LRSHJ-së lidhur me të gjitha këto do t'i bëhen të njohura së shpejti opinionit. Sikur të kishim mundësi që tani t'i shprehim qëndrimet, do të ishte më mirë, pa u bërë vonë.

* * *

Duke u bazuar në manovrimet e disa tipave dhe të "lojës" që po luhet, mund të vihet në përfundim se shumë ka "kontribuar" oportunizmi i disave ndaj të tillëve, të cilëve, më në fund u është mundësuar të guxojnë të dalin ku kanë dashur, në meset ku nuk do të duhej të guxonin fare. Shumëherë, edhe kur kemi patur prova për punën minuese e dezorientuese, sikur me qëllim bëheshim qorra e të shurdhër, me shpresë se nuk janë siç

po veprojnë dhe se do mësohen të ecin mbarë, për t'u inkuadruar në radhët e LRSHJ-së, që të "rriten" ato. Mbase ka nga ata që mendojnë se për kërkesën Statut Republike në kuadër të Federatës Yu. "hahen" të gjithë. Krahas kësaj, dukshëm vërehet përgatitja teorike jo në nivel, sidomos sa i përketë anës teorike në përgjithësi, qoftë sa i përket organizimit, qoftë teorisë që shpjegon se çka kërkojmë, përse kërkojmë, si duhet ta kërkojmë dhe ç'perspektivë ka çështja kombëtare, si dhe teorinë mbi taktikën, në shërbim të strategjisë dhe strategjinë. Këtë më së miri e shpjegon mungesa e Programit dhe Statutit të LRSHJ-së, konturat e të cilave u botuan në nr. e fundit të ZK, që të hapet diskutimi i anëtarëve dhe në fund, përfundimisht të hartohen e aprovohen. Edhe në këtë drejtim nuk më ka rënë asnjë aktivitet përkatës te anëtarët. Mbi shumë çështje nuk kemi teori të çartë përkatëse, ta zëmë sistemi shtetëror jug. dhe Republika Shqiptare; punësimi në vend dhe Republika Shqiptare (çfarë propozimi përkatës ka LRSHJ-a lidhur me punësimin në Kosovë, duke i kthyer të gjithë mërgimtarët, që dëshirojnë të kthehen); borxhet ndaj botës dhe obligimet e Republikës Shqiptare (pasi shumë borxhe janë marrë në emër të investimeve në ekonomi e bujqësi në Kosovë, por nuk dihet fare ku janë "avulluar"...); zhvillimi i kulturës kombëtare në Republikën Shqiptare; qëndrimet e qarta të LRSHJ-së ndaj kolonistëve, të cilët edhe sot e kësaj dite janë në nivel të misionit për të cilin janë sjellur; programi i këthimit të të shpërngulurëve me dhunë për në Turqi e gjetiu; niveli i marrëdhënieve me partitë politike të botës dhe bashkëpunimi me to, duke filluar nga partitë komuniste (m.l.) e deri te ato reakcionaret, si dhe ndaj qeverive etj. Kur përmenda sistemin shtetëror jug. dhe Republikën shqiptare, ta zëmë, nëse konkretizohem me shembuj, që dalin nga vështirësitë e përditshme. Është fjala për qëndrimet e Lëvizjes ndaj satrapit Tito, kur nga skena jugosllave, qoft nga mendja e titistëve, rankoviqistëve, "liberalëve", "demokratëve" dhe popujve, është duke u "zbehur" ai "personalitet"... Pa patur vendime të qarta, shoku Salih e ka hedhur propozimin se u dashka vendosur fotografia e satrapit në klube të punëtorëve dhe kur ka hasur në rezistencë, pakuptueshëm është tërhejkur, sikur të thoshte: le t'i shfrynë emocionet dhe pezmin e shkaktuar ku të duan e si të duan dhe në fund t'i kthehemi edhe njëherë. Kurse mu më shkruante: "pa më të voglën frikë do t'u hymë diskutimeve më të thella se sa e një fotoje (mendohet fotoja e satrapit Tito – sqarimi im)". Në rregull. Diskutimeve duhet t'u hymë me vend e rend, që të merren aprovime ku duhen dhe kur të dalin në masë, të dalim të qartë, e nëse masa nuk aprovon mendimet, atëherë o duhet të provohet të sqarohet, o nuk janë në rregull dhe me krenari duhet marrë mbrapa atë vendim që nuk aprovon masa. Unë e përgjithësova ca, por diç nga ky përgjithësim ka edhe ai rast. Dhe tani, prap, më shkruan: "Momentalisht kyçi i problemit në korrespondencën tonë shtrohet situata në Dys., ku po raportohet në mënyra të ndryshme e edhe unë e ti nuk po mund të mirremi vesh për këtë pikë. Teorikisht shumë mirë, por në praktikë jo, sendet ndryshojnë për 180 shkallë." Ndoshta edhe nuk i përket temës, për të cilën shkruaja, së paku në shiqim sipërfaqësor, por në fakt po; është tamam mungesa e ngritjes përkatëse, qoftë e imja, qoftë e jotja dhe pasojë e formave të ulëta organizative që keni ndjekur dhe sipas të gjitha gjasave, jemi duke ndjekur. Sa i përket anës sime, unë shokët i kam bërë me dije dhe vërtet tani nuk jam në korent të ngjarjeve në atë rreth, por në këtë drejtim pata shkruar ca më gjerësisht prandaj është e tepërt po t'i përsërisë ato, sado që mund t'i ndryshoj në nyansë ose në të shprehur. Të gjitha së bashku, pa patur nevojë të zgjatemi më, lënë të kuptojme se sa po qalojmë sa i përket përgatitjes sonë në nivel të misionit.

* * *

Në letrën e 7 majit (1983), që ua pata dërguar, bëra ca propozime në mes të cilave edhe botimin e një boletini informativ në gjuhë të huaja (të kohë pas kohshëm dhe me

emrin "Kosova"), përmes të cilit do të trajtohej çështja shqiptare në Jugosllavi në nivel shkencor, pasi çështja shqiptare në Jugosllavi nuk mund të trajtohet bindshëm me anë te trakteve e letrave (të cilat duhet të praktikohen prapë, pasi ato kanë kuptimin dhe efektin e vet). Kjo do mundësonte në të njëjtën kohë që Lëvizja të merret për më serioze dhe përfaqësuesja e vetme legjitime e interesave shqiptare në Jugosllavi. Asnjë përgjegje konkrete nuk pata marrë për këtë dhe propozimet tjera, që në fakt duhet të merret qëndrim ndaj propozimit të cilitdo shok, pos përgjegjes nga shoku Xhemë, ku thoshte: "Edhe për buletinin mendoj ashtu, por kur është në pyetje trakti i fundit (mendohet trakti i 1Majit në gjuhën gjermane – sqarimi im) që u shpërnda këtu diçka nuk hahet, njëherë na tha se kushton 600 marka dhe se kjo punë qenka vendosur, po atë shumë të hollave e kërkonte në fillim edhe Z., pastaj na del se ajo na qenka dy herë më e madhe pra aq sa t'i kërkojë për një gazetë të tër... Kjo tingëllon aq më keq kur tash na kanë ardhur informata prej Br. për keqpërdorim të hollash nga ana e Z..." (nga letra që më ka shkruar shoku Xh., më 16 maj 1983).

Së pari mund të jenë mosmarrëveshje në mes nesh sa i përket çmimit, pasi koha ishte e shkurtër dhe në prag të pushimit nuk kishim alternativë, sidomos për shokë që nuk kanë eksperiencë të madhe me çështje shtypi. Shifra prej 600 DM ka qenë parallogari sipas meje. Kurse shifra e dyfisht janë shpenzimet reale dhe unë nuk kam as më të voglin dyshim. Pavarësisht nga kjo, edhe sikur ai shoku të kishte keqpërdorur besimin, nuk mund të përdoret si arsyetim për të dhënë mendim të tillë për diç aq parimore, siç më duket mua nxjerrja e një boletini informativ në gjuhë të huaja (sado që i kuptojë vështirësitë dhe vështirë që do kemi mundësi t'i dalim zot.

Unë po e përsëris këtë propozim, me shpresë se do shpreh secili mendimin e vet, duke mos mjaftuar vetëm me "po" e "jo", por edhe për të dhënë ide rreth saj.

* * *

Gjer tani letër të përbashkët (po e quaj kështu këtë formë të letërkëmbimit) kam marrë vetëm nga shoku Fahri (letra e 28 majit 1983). Nuk e di sa duhet të jetë praktike, por në mungesë të takimeve, të kushtëzuara nga largësia dhe dokumentet, është thuaja e vetmja mënyrë që të mbetemi në kontakt të nivelit që punën ta qojmë përpara. Halli është te adresat, sa janë konspirative ato. Unë mendoj se në letra të përbashkëta të kthehen përgjegje të përbashkëta, të cilat mund të luajnë rolin e bisedimeve që do të bënim në takime, duke marrë edhe vendime. Shokut Fahri i pata kthyer përgjegje, përkatësisht letër ku kryesisht doja ta njoftoj për marrje të letrës, duke i shkruar shkurt ca fjalë mbi letrën (prandaj s'më duket e tepërt nëse këtë letër do t'ua dërgoj ca me vonesë edhe ju shokëve tjerë, pasi ka të bëjë me letrën e përgjithshme.).

Për, sa u përket letrave të përbashkëta, nëse do praktikohen, mendoj se duhet shkruar vetëm mbi gjëra që duhet të na përkasin të gjithëve, kurse për gjëra të veçanta le të përdoret letërkëmbimi me shokun përkatës.

Në letër shoku Fahri, kryesisht nga shkruante për sjelljet e disa njerëzve, të cilët i kanë rënë në sy, para se ata të dalin hapur, siç kanë dalur. Këtë informim e vlerësoj, por duhet ikur pasioneve. Sa ndihmon informimi i tillë, bind në fakt se të njejtit njerëz mund t'i shkruajnë redaksisë së ZK, kuptohet edhe letra të "stolisura", dhe shokët e Redaksisë, duke mos patur mundësi t'i njofin të tillët ashtu si janë, mund që ju përgjegjen atyre që kanë shkruar (pse jo, për të zbuluar se çfarë përgjegjesh kthen Redaksia në letra tjera, që shkruhen me qëllime të mira, pra, për t'i zbuluar këshillat që Redaksia ua jep lexuesve...), në përmbajtje të letrës, duke mos ditur se janë letra qëllimkëqia... Ose, në atë rreth mund ta nxjerr puna e rruga ndonjë shok tjetër, dhe sigurisht që ka mundësi të gaboi duke mos i njofur bashkatdhetarët, të cilët më heret mund t'i ketë njohur si të mirë... Sigurisht në

rrethet ku shokët gjenden më gjatë mund t'i njofin bashkatdhetarët e ati rrethi më së miri, kjo ndihmon shumë sa i përket çështjes organizative. Kuptohet, nuk do duhet marr me mend se ne, gjatë informimeve të tilla mund të nisemi nga ndonjë inat personal, tek a huq, ose që ndonjë gabim të tjerëve ta fusim nën mikroskop, kurse ndonjë gabim ta fshehim, për hir të ndonjë simpatie a afërsie. Të gjitha këto do të duhej të jenë të huaja për ne. Kurse, përderisa informon ndonjë nga ne shokët, nuk duhet barasvlerësohet me letrat që mund t'i dërgojnë provokatorët e lloj-llojshëm, derisa dihet se ndonjëri nga shokët nuk ka devijuar, ose nuk ka ndonjë hile në informim që bënë. Përndryshe, sikur të kemi siguruar prova se ndonjëri nga ne bënë informime mbi tjerët, duke fshehur mbrapa ndonjë hile, duhet të jap llogari të rrept, pasi dezinformimet mund të sjellin pasoja të rënda në punën tonë të mbarë.

Sa më përket mu, siç shkruante shoku Fahri, unë nuk e kam shkarku veten nga përgjegjësia që më takon, lidhur me H. dhe degjenerimin e tij, përkatësisht mashtrimin që na ka bërë, ndërsa për rastin konkret të vizitës që i kemi bërë shokut F., i kam shkruar (dhe mund të lexoni në letrën që po ua dërgoj).

Shoku Fahri shkruante edhe për përgjegjësinë me të cilën është ngarkuar. Jam i mendimit se ai sektorin e tij duhet ta mbikëqyr dhe drejtoi, duke u ndihmuar në fillim nga shokët që kanë eksperiencë, derisa ai ta zotëron, edhe pse kam bindjen se nuk do mbetet keq, pasi gjatë viteve të fundit është marrë shumë me aktivitete praktike dhe ka treguar zotësi. Në këtë drejtim do të ishte e nevojshme të bëhet informimi mbi gjendjen materiale, për të ditur sa është plafi, që të shtrihen këmbët. Më shumë një informim i tillë do ndihmonte, sikur të dimë se a janë duke u ndihmuar familjet e shokëve në burgje dhe shokët brenda. Kjo e dyta nuk është e domosdoshme të dali, pasi në atë drejtim konspiracioni duhet me qenë rigoroz, dhe a ka mjete që të ndihmohen, nëse do na bie rasti të gjendet ndonjë bashkatdhetar që do përcillte ndihmat e domosdoshme për familjet në fjalë. Nëse në këtë drejtim jemi fare mbrapa, ose për shkak të mundësive ndihmohen vetëm familjet në regjione të caktuara, kurse në ndonjë regjion, ku ato mund të jenë më të domosdoshme, mbeten fare pa to, duhet të insistojmë që ta rregullojmë më në nivel punën, pasi shumë leht, në ndihma, mund të biem në provim. Sikur të mos bëhet fare, në mungesë të mjeteve, atëherë duhet ndërmarrur fushatë, pse jo edhe përmes ZK dhe përmes shokëve në rrethe.

[Ka mundësi se do gëzoheni që po i jap fund, por më ndjeni, edhe unë jam lodhur para jush, më shumë se ju, që të shkruaj, prandaj merreni durimin që ta lexoni këtë letër, së paku njëherë, gjer në fund (kam shpresë se do t'i përshtateni ndonjë mahije të ngjashme që do t'i shkruaj kohë pas kohe)]

– PËR NJË REPUBLIKË SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!
–RROFTË LRSHJ--a!

Përshëndetje revolucionare (Ibrahim Kelmendi)

PS. Sa i përket strehimit, ende nuk jam rregulluar. Sa po më mundon, pasi disi jam lidhur dhe kjo po pengon edhe në punë, pos që isha mësuar "nomad".

Mirëupafshim

23. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive (QE), 12 gusht 1983

Shokëve të QE Suedi, më 12 gusht 1983

Të dashur shokë,

pasi ca me vonesë mora letrën nga shoku Xhemë (të datës 31 korrik të këti viti), të cilën e keni marrë edhe ju të tjerët, po marrë mundin të ju shkruaj.

Sa për gjendjen në Kosovë, vërtetë këndej qenka shumë larg, prandaj edhe shumë pak ka mundësi të informohem. Shumë mirë që shoku Xh. ka marrë mundin të na informoj, sado shkarazi, mbi gjendjen. Kështu do të duhej të praktikohet, për arsye se përkatësisht na duhet të veprojmë dhe të drejtojmë veprimtarinë. Edhe mbi disa aktivitete që janë bërë ose duhet të bëhen, nuk kam çfarë të them, pos: na duhet të gjitha forcat t'i përqëndrojmë në punë - o sot o kurrë! do të thoshte populli.

Sa mirë që po vika shoku nga T. (Turqia-shën i Xh. D.). Me te duhet biseduar për aktivitetet në T., pasi shumë pak, ose hiç, po dëgjohet për kontributin dhe aktivitetet patriotike atje. Pastaj, duhet të bisedohet që t'i kompleton disa adresa më të rëndësishme të njerëzve qeveritarë dhe personaliteteve që kanë ndikim në jetën politike e kulturale të vendit, në mënyrë që t'ua dërgojmë buletinin (për të cilin po bëhet kaq bujë, e populli thotë gjithashtu: "kur murmuron shumë mos prit shi".). Sidomos të bisedohet me te që të angazhohen shokët, nëse ka nga ata që shkruajnë, për të shkruar punime për buletinin. Edhe lidhur me broshurën e Qubrilloviqit, "Shpërngulja e shqiptarëve", të bisedohet; broshura është përkthyer, kurse punimi, në vend të parathënies, me përmbajtje përkatëse është në përfundim. Desha të them referati në vend të broshurës. Me rëndësi është se si do ta shpërndajmë. Mënyrën për ta futur brenda një numër të caktuar, aq sa kanë mundësi t'i shpërndajnë, besoj se e kemi gjetur. Edhe këndej na duhet një numër i madh. Pos shqiptarëve nga T., na duhet t'ua shpërndajmë qytetarëve nga T., që janë shumë të angazhuar e të organizuar dhe që kanë ndikim të madh brenda. Por, këtyre duhet t'ua shesim. Ndoshta nuk kanë mundësi ta shpërndajnë (as ilegalisht, shkaku i gjendjes). Atëherë na duhet siguruar adresat, të cilat shokët do t'i nxjerrin nga librat e telefonave.

Sa për grupin e "udbasho-patriotëve", siç i quan shoku Xh. (Xhemë=Xhafer Shatri-shën i Xh D) vërtetë duhet menduar dhe jo vetëm menduar, por edhe vepruar. Unë qëllimisht këtë shprehje e vura në thonjza, pasi, sipas mendimit tim, një kombinim i tillë nuk është i mundur, kur mendohet patriotizmi shqiptar; ose udbashë ose patriotë, të dyja nuk shkojnë së bashku. Tani kanë nxjerrë nr. 2 të "organit" "Punëtorët", të cilin ma dërgoj shoku F. (Faridin) dhe më shkruante: "nëpër vendet që është dërguar (mendohet "Punëtorët") me postë apo me anë të ndonjë individi, nuk ka pasur sukses, pasi në shumë vende e kanë bllokuar dhe ashtu ka ngelë". Mirë, do të thoja, sa u përket vendeve që dihet se dërgohet dhe te ata kemi ndikim. Por, si qëndron gjendja me ata, të cilëve u dërgohet dhe ne nuk dimë, bila ka mundësi që t'ua dërgojnë bashkatdhetarëve që kurrë nuk kanë marrë as ZK (Zërin e Kosovës-shën i Xh D), pasi ka munguar kontakti. Sigurisht që aty do të ndikon, pasi në shkrimet e tyre bëjnë falsifikim të paskrupullt - kur thirren në LRSHJ-në. Se do të mashtrojnë ndokend, nuk ka dyshim. Them këtë duke u nisur nga fakti, ose më përkatësisht, nga një arsye, pos të tjerave: Në radhët e mërgimtarëve është bërë punë e madhe në ngritje të vetëdijes kombëtare. Te një shtresë kjo vetëdije është evoluar, pasi nuk kanë qenë bazat në nivel. Si rrjedhim, pasi nuk kanë patur kohë e mundësi të mësojnë diç edhe nga teoria dhe mënyrat e të organizuarit, duke u nisur nga ajo se çfarë u është thënë vazhdimisht mbi gjendjen dhe përgjegjësinë e secilit, do të donë të organizohen, pa menduar shumë se për çfarë organizate është fjala. Pikërisht këtë

gatishmëri mund ta shfrytëzojnë këta batakçinjë. Sigurisht që secili do të dëshironte të anëtarësohet në radhët e LRSHJ. Por, pasi nuk do ta gjen mënyrën se si duhet të inkuadrohet në radhët e LRSHJ-së (meqë në këtë drejtim ende nuk e kemi nivelizuar punën, mendoj sa i përket organizimit, për t'i organizuar në radhët tona të gjithë ata që dëshirojnë, kuptohet nëse janë në nivel, duke bërë edhe sistemim në bazë të përgatitjes e gatishmërisë, - mbi këtë temë kam ndërmend të shkruaj një herë tjetër, pasi ka kohë që më duket e arsyeshme t'i shpreh mendimet e mija të dala nga leximi i literaturës përkatëse), mund që nga nxitimi do gabojnë të anëtarësohen në OSBPK. Kjo bëhet aq më e vërtetë, kur t'i kemi parasysh falsifikimet e tyre dhe mënyrat e organizimit të cilat i aplikojnë, për të cilat unë nuk di më shumë se sa është biseduar. Unë edhe njëherë kisha për të kërkuar që të informohemi për mënyrën e depërtimit (të Nexhatit=Osman Osmanit-shën i Xh D) në RFGJ, pse jo edhe në T. (të Abdullahut), si dhe për bisedat që janë zhvilluar, pasi është afër mendësh që ai farë Nexhati, duke qenë shumë kohë së bashku, bile në banesë të shokëve (të Vëllezërve Gërvalla-shën i Xh D), ka mundur t'ua hedh shokëve tanë, meqë siç ka mundësi të dyshohet, gjatë gjithë kohës në anën e tyre duhet ta kenë patur Nuhiun, i cili gjatë gjithë kohës, hundët i ka patur kudo... Një informim i gjerë dhe i shtruar, ma analiza përcjellëse, mirë të përpunuar, do na duhej për informim intern të radhëve të LRSHJ-së. Do të ishte dam i madh që në ZK t'u kushtohet shumë vend. Nëse nuk mbërri (pasi nr. 5 mund të jetë në përfundim), desha të them sikur kjo letër t'ju binte në dorë para se të delte numri i ardhshëm i ZK, do të propozoja që vetëm një njoftim i shkurtër do të mjaftonte, se "Punëtorët" nuk ka asgjë të përbashkët me ZK dhe se "sindikatën..." nuk e ka formuar LRSHJ-a, por është duke u bërë falsifikim i paskrupullt. Kjo mënyrë e luftimit do të ishte më e suksesshmja, pasi të tillëve, shpesh duke i demaskuar, ua rritë vlerën (dihet te armiku). Ma merr mendja se qëllimi përfundimtar i tyre duhet të jetë: të na fusin në polemikë, pasi demaskimit që do t'u bënim, do t'i përgjigjeshin me "demaskimin" e tyre ndaj nesh dhe kështu, përgjithësisht, i gjithë ky "uj" shkon në mullirin e armikut tonë klasik. Pa dyshim se një pjesë të popullit gjëra të tilla do e demoralizojnë. Pra, më duket e suksesshme t'i lëmë të lehin, duke u mbaruar sikur nuk na prishë punë, kurse në plan të brendshëm, intern, të izolohen e demaskohen, duke ua vuar rrethin që të mos kenë hapësirë për të lëvizur. Përfundimisht nëse kemi prova të bollshme se janë vegla të UDB-së, atëherë duhet gjetur krejt tjetër mënyrë... Do të ishte e domosdoshme sikur veprimtarisë së Nuhiut t'i bëhet një analizë e thellë, sidomos në rrethin ku ai ka lëvizur e "vepruar". Shokët e atij rrethi mund që do t'u kujtohen "lëshime" të Nuhiut, të cilat janë bërë vazhdimisht, në kohën kur nuk është dyshuar se ai mundet me qenë vegël. Ne nuk duhet të na befason fare fakti se UDB-ja ka dy kategori agjentësh: një për veprim të aty për atyshëm, kurse kategoria tjetër duhet të infiltrohet, së pari në radhët e popullit, pastaj të organizatave patriotike-përparimtare, për të vepruar kur t'u duhen. Pra, UDB-së nuk i bëhet e tepërt të paguan vite me radhë agjent, të cilën nuk kanë nevojë të japin kontribut, për t'ua nxjerrur kymetin pas shumë viteve shumëfish. Është fare e mundshme, që bashkë me punëtorë, që në fillim, të ketë dërguar edhe ndonjë vegël, të cilat do "shkriheshin" në radhët e punëtorëve, për të dalë tani... "Lëshimet" e Nuhiut nuk janë lëshime që do bënte punëtori i "thjeshtë" (siç praktikohet të përdoret gabimisht ky term). Ato "aventura" duhet të kenë qenë të planifikuara, prandaj të ndalemi për t'i analizuar. Kurse për punën e dy të tjerëve, që kanë ardhur si usta, të shohim – asgjë për atë dynja...! Do të ishte fare e paarsyeshme, sipas mendimit tim, të thuhet "kallupçe" se deri në këtë kohë ka qenë në rregull, por që ndryshoi pasi ka shpirt prej karrieristi, cili do që të jetë. Me fatin e popullit nuk luhet! Dhe, nuk guzon të arsyetohet asnjë dhelpëri, qoftë e Nuhiut apo e kujtdo qoftë, pavarësisht se shoku i kujt gjer në cilën kohë ka qenë!

Sa për Br., se kush duhet të përfaqëson Klubin e tyre, do t'ua përcjellim propozimin tonë, kurse ken do zgjedhin ata, le të shohim.

Ata tani kanë shoqatë mirë të organizuar dhe nuk bënë që t'ju imponojmë asgjë, por le të vendosin si t'u duket më së miri për ta. Edhe unë jam për shokun Sab., pasi ai gjer më tani ka qëndruar i paluhatshëm.

Sa për shërbim Informativ, ai ka qenë i nevojshëm, bile i domosdoshëm më herët. Shoku Mu. besoj se mund të kontribonte shumë, pasi edhe natyra e profesionit dhe përgatitjes shkencore mund të garantojnë për një specialist të mirë. E keqja është se ai nuk është angazhuar sa do të duhej të ishte në gjendje, besoj më shumë si rrjedhim i rrethanave të revolucionaritetit të zbeht, të pafarkuar. Por, ai vet duhet të jetë në gjendje të mos bie viktimë (është shprehje jo e qëlluar) e asnjë gjendje, por të bëhet i zoti që të mbizotëroi të gjitha vështirësitë. Mu për këtë po u pa e arsyeshme, duhet të bisedohet me te, pasi për Shërbim Informativ ai më ka biseduar shumëherë, se është i domosdoshëm për LRSHJ-në.

Për radhët tona brenda, që ato të zgjerohen e forcohen, do të thoja se është detyrë mbi detyrat, pasi atje përfundimisht do të ndahet "mejdani". Secili duhet të kontribuoi në këtë drejtim.

Sa për bisedat që ka patur shoku Xh. (Xhafer Shatri-shën i Xh D) me Shaqën, nuk kam çka për të shtuar. Më duhet vetëm të them se shpesh nxitohemi, pa arsye. Duhet t'i njohim mirë shokët mbi të cilët do peshojmë. Pas takimit..., kur shoku S. shkoi te Shaqa, sikur mu duk nxitim, pasi isha në korent nga ata që bëjnë punët, se ai shumë ua pshtjellon punët në shumë rrethe. Kudo ka udhëtuar, prej klubi në klub, duke ua pshtjelluar punët dhe më në fund duke ia lanë namin vetes për punët që s'i kishte bërë, por vetëm se i kishte sabotuar. Mu për këtë arsye, janë të domosdoshme konsultimet e përbashkëta kur është në pyetje ndonjë bashkatdhetar që do të duhej të ngarkohej me aktivitete, thuaja organizative, me përgjegjësi për ndonjë rreth. Pos asaj, vetë pata eksperiencë të keqe me te. Më bëri mirë dhe e muar vesh krejt pazari, edhe pse ishte me rrezik përkatës. Të gjitha duhet patur parasyshë.

Për personin që kërkohen informata, do të sigurohen. Nëse është një që mendoj tani për tani, me po atë emër (për mbiemrin nuk di, por me atë emër nuk njohim tjetër), atëherë është një patriot "aventurist". Tani do të duhej të jetë në burg, nëse nuk është gënjeshtër që ai të kthehet në Jug. Ka qenë në klanin e Gani Azemit e Reshatit, si drejtues të Komitetit për Kosovën, bashkë me Enver Hadrin e Emin Fazliun me bashkëpunëtorë... Por, ta lëmë për herën tjetër, pasi ka mundësi të mos jetë ai dhe unë të shkruaj kot.

Pasi i shkova letrës me radhë, atëherë duhet t'i përgjigjem pyetjes konkrete që më është shtruar, lidhur me mbështetje në "forcat tona" dhe investime.

Se çfarë ke shkruar në "shkresë-rregulloren" e QE (po e fut në thonjza, pasi prapë nuk po më duket termin i përshtatshëm) unë kam harruar. Nuk kishte me qenë keq ta kem një kopje, pasi, edhe pse e pata lexuar, po bindem se e kam harruar (e rregullorja nuk guzon të harrohet). Kurse, nëse është Rregullore e QE, – për çka nuk di, pasi do të duhej të diskutohej e aprovohej, por mund që është bërë pa praninë time, për çka unë dakortohem, – ma merr mendja se nuk duhet të potencohet se "e kam shkruar unë". Nëse është menduar formulimi gjer në aprovim, atëherë bën të shprehesh ashtu. Por nëse është vërtetë Rregullore e plotëfuqishme, atëherë – jo. (Kjo nuk do të ishte si temë, por meqë po përgjigjem në letër, nuk do më zihet për gabim ose të vlerësohem për cikrrimtar, nëse shpreh mendimin për ndonjë lëshim, për të cilin unë mendoj se është lëshim.)

"... duhet të mbështetemi vetëm e vetëm në forcat tona dhe askund tjetër...", na shkruaje shoku Xh. Së pari, shkaku i paqartësisë, do të shtroja pyetjen: kush jemi ne,

përkatësisht "në forcat tona" dhe të tjerët, përkatësisht "askend tjetër"? Siç e dimë, ne jemi në radhët e LRSHJ-së, të ngarkuar me përgjegjësitë që kemi. LRSHJ-a, siç kemi bindjen, është Organizatë që qëndron në ball, për t'i prirë e për ta udhëhequr popullin. Si rrjedhim forcat e LRSHJ-së nuk mund të ndahen nga forcat e popullit tonë. Në rastin siç je shprehur, forcat tona mos jemi menduar vetëm ne të QE, duke mos u llogaritur as anëtarët e LRSHJ-së dhe radhët e gjëra të saj, kurse të tjerët janë masat popullore. Ndoshta edhe nuk kam kuptuar si duhet, prandaj do të mjaftonte sqarimi sa do i shkurtër. Nëse është kështu siç e kam kuptuar, atëherë parimisht është gabim edhe Rregullorja e QE, sa i përket këtij formulimi. Mbështetja e LRSHJ-së në forcat e veta do të thotë mbështetja në forcat e popullit. Nëse zemra i takon një trupi, atëherë ajo është në atë trup dhe jo që të dalë nga ai trup për të jetuar "në forcat e veta". Po kështu nëse Lëvizja është Organizatë pararojë e popullit tonë, – ndryshe edhe nuk e mendoj, – atëherë vetëkuptohet që populli e mban, ose si te rasti i zemrës e trupit, asnjëra nuk e mbajnë njëra tjetrën, në kuptim të ngusht të fjalës, por asnjëra nuk rron pa tjetrën; secili për vete ka funksionin e vet. Të konkretizohem edhe ca.

LRSHJ-a ka një pjesë të radhëve të veta edhe jashtë atdheut, në mesin e qindramijëra mërgimtarëve. QE është një nye e LRSHJ-së që kordinon e udhëheq punën, kuptohet jashtë, duke e lidhur me atë brenda. Të gjithë mërgimtarët përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullit. Bile, do të thosha një shtresë vitale, qoftë sa i përket moshës, qoftë punësimit, pasi më shumë ka shqiptarë të punësuar në prodhim jashtë trojeve të tyre se sa në trojet e tyre (po kuptohet se fjala është për trojet shqiptare nën Jugosllavi.). Parimore do të ishte që ne, pasi jemi në ball të kësaj shtrese të popullsisë, të mbështetemi te ata dhe bashkë me ta, ta ndihmojmë revolucionin brenda. Siç dihet, një prej faktorëve që të fitojmë janë edhe mjetet materiale. Bile, në kohët e sotme moderne mjaft me rëndësi. Por faktori kryesor janë njerëzit. Atëherë për QE do të ishte detyrë që të organizojnë në nivel, në mënyrë që bashkatdhetarët të përvetësojnë vetëdije të ati niveli, për të ditur se janë ushtarë të popullit e të atdheut. Kur të jen të vetëdishëm për këtë, se secili e ka borxh t'i dal zot popullit e atdheut, duke i ndihmuar, për çka jemi të thirrur, atëherë si nuk do të ndajnë diç nga djersa për ta përgatitur këtë luftë. pra, djersa kushton më lirë se gjaku. Dhe pikërisht se sa do të sakrifikojnë dhe a janë në gjendje të sakrifikojnë edhe jetën po u kërku, për indeks të tregimit kemi sakrificat që bashkatdhetarët do bëjnë në djersë. Sikur ne ta kordinojmë punën në nivel, atëherë pse të mos kemi mjete të mjaftueshme, bile edhe të tepërta, kur jetojmë në gjirin e qindramijëra bashkatdhetarëve. Për ta vërtetuar këtë që them sjell shembull: a vërtetë nuk jemi në gjendje në krejt botën e jashtme t'i sigurojmë 1.000 bashkatdhetarë që do t'i sakrifikojnë së paku 50 DM (dhe valuta të tjera) nga rroga e tyre mujore. Sigurisht që ka mundësi, pas LRSHJ-a është popullarizua shumë në radhët e mërgimtarëve. Ata, edhe më shumë në numër kanë dal në demonstrata. Kuptohet se secili ka qenë i vetëdishëm se sa po sakrifikon, jo vetëm materialisht. Sa ka të tjerë, sikur organizimi të ishte në nivel në rrethe, duke patur celula në çdo rreth dhe duke i ndihmuar që ato të jenë në nivel të misionit të tyre, dhe përfundimisht duke patur bindje të pa lëkundshme se ato ndihma nuk keqpërdoren, të cilët nuk do të kursenin edhe më shumë, e jo vetëm atë shumë ideale që e përmenda. Por më duhet të shtroj pyetjen se pse nuk po ndodhë kjo? Përgjegja mund të ipet e shkurt dhe e qartë: ende nuk i kemi kordinuar punët në nivel, sa çdo gjë të funksionoj si duhet dhe të vihet në binarët e vet për të funksionuar, të them vetëvetiu. Pastaj, po që se nuk e kemi kordinuar punën në nivel, edhe pse gatismëria te bashkatdhetarët shihet, duhet ta them hapur se bukur në nivel jemi kompromituar pa nevojë, duke patur bashkatdhetarët përshtypjen se edhe secili rrugaç militon në radhët e LRSHJ-së. Kurse ne me kohë ua kemi lëshuar disave frejtë nëpër këmbë (disa vërtetë kanë nevojë për frejë), duke u nisur nga motoja "ishalla, mashallah",

siç shprehen me pleqët, ose thënë më përkatësisht i kanë marrë frenjtë nëpër këmbë (pasi kanë qëlluar hamshorë të hasdisur...). Ai bashkatdhetari që punon 10 orë në ditë dhe thuaja që padroni i qëndron me kamxhik mbi kokë, do të mendon me vete: "të jap ndihma për ata që mbrëmjeve bëjnë qejfe diskotekave, për ata që punë e pa punë, ose thënë më përkatësisht pa punë e pa punë endet poshtë e lartë, për atë që shkon i veshur, i lëmuar, si pëllumb, siç i thonë një fjale, pa punuar e fituar fare, për atë që është "xhymert" pa fituar vet fare, për atë që nuk i shihet ndonjë hajr, por vetëm sillet si fodull dhe mundohet t'ju imponohet si i dishëm e komandant, besa edhe për asi, për të cilët hiç për gajle nuk e kanë të degjenerohen, pasi që na qenka "normale" dhe "biologjike..." etj., etj. Mund të thotë ndonjëri, se nuk ka nga bashkatdhetarët që kanë përshtypje të tillë. Unë do t'i thoja ati, kuptoi ato që nuk të thuhen, ato që bashkatdhetari i ndershëm e patriot i mban brenda dhe ia gërryn shpirtin dhe jo vetëm ato që i thotë, pasi shpesh ndodhë të folë vetëm sa për formë. Pastaj, pse një shumicë e madhe nuk i kanë punët ku i kanë fjalët. Mund që unë nuk pata të drejtë më lartë dhe do të kisha dëshiruar të mos kem të drejtë, por diçka nuk është krejt në rregull, për çka duhet të mendohemi mirë e mirë, përndryshe një numër kaq i madh i bashkatdhetarëve, që për fatkeqësi është në botën e jashtme, është forcë e madhe, është ushtri e tërë. Pikërisht në këtë drejtim m'u duk e arsyeshme të investojmë, që punët t'i vëmë në vijë, që organizimin ta përsosim, që te populli të fitojmë besimin e duhur, etj. Po ia arritëm këtyre, pa patur nevojë të mashtrojmë veten, do të shihnim se sa do ndihmoheshim.

Gjer tani të gjitha aktivitetet i kemi financuar jo nga "forcat tona", por nga djersa e mërgimtarëve. Edhe mjetet e nevojshme për investime sigurisht që do jenë djersë e mërgimtarëve, pra djersë e të "tjerëve". Këto nuk mund t'i neglizhojmë.

Mendimi ishte që t'i përmbledhim forcat që të bëjmë botime të shumta e kualitative, që të ndihmohen me gjithë mend familjet e të vrarëve e të arrestuarve dhe të ndihmohen shokët. Nëse nuk kemi mjete, ose frikësohemi se do t'i harxhojmë dhe s'do kemi pastaj as për punë elementare, atëherë duhet organizuar fushatë, duhet që bashkatdhetarët të thirren, edhe përmes ZK (përmes të cilit fare rrallë i kemi thirrë për ndihma dhe asnjëherë nuk ka patur ndonjë artikull, pse jo edhe kryeartikull për ndihmat dhe solidaritetin popullor, si kusht për ta fituar luftën...). Por, po t'i investonim ato mjete që do t'i investonim në ekonomi, atëherë do të bindeshim për përfitime të vërtet. Një punë aq e madhe që do të duhej të bëhej, do bindte bashkatdhetarët në përmasa të gjëra se LRSHJ-a është Organizatë e zoja e cila do ta udhëheq popullin në rrugën fitimtare, prandaj edhe duhet të ndihmohet. Këto punë nuk po bëhen; shoku për propagandë ankohet se nuk po marrin, shoku për çështje organizative arsyetohet se nuk po ka mjete as për udhëtim, unë që do t'i gjeja mënyrat për të udhëtuar (pasi në punën time do të ishte i domosdoshëm qëndrimi i përkohshëm në shtete të ndryshme, për të marrë kontakt me gazetarë, personalitete dhe organizata), ankohem për shkak të dokumenteve të udhëtimit, etj. Shoku për propagandë ka të drejt të arsyetohet se nuk mbërrin, por a vërtetë duhet t'i mbërri të gjitha ai në atë fushë; edhe të formuloj shkrimet që shkruan vet, edhe t'i redakton ato që mund t'i vinë edhe t'i shtyp pastaj vet dhe sigurisht të bëjë punë finale që bëjnë grafikët, për ta quar përfundimisht në shtyp Organin ose ndonjë punim tjetër. Pastaj, është në pyetje edhe korespondenca. Në këtë drejtim, a vërtetë nuk kemi mundësi të sigurojmë kuadër (ta zëmë ai që do të dij të daktilografon në "kompozer") të specializuar që do mundet t'i mbërrin të gjitha, çka lypset për t'u shtypur, apo nuk duam, pse ndoshta duam t'i monopolizojmë të gjitha punët... Pastaj, kur kemi mundësi të sigurojmë mjete për të investuar në ekonomi, e ato duhet të jenë bukur të mëdha, si nuk paskemi mjete solide që shokut S. (Xhafer Durmishit-shën i Xh. D.) të ia paguajmë udhëtimet e domosdoshme për

çështje organizative, nga e cila varen shumë sukseset e LRSHJ-së, sigurisht edhe e ndihmave materiale. Përfundimisht do të thoja: "ekonomistët" e mirë, në këtë situatë kaq të ngarkuar, do të investonin edhe kafshatën e gojës drejtpërdrejtë në veprimtarinë patriotike, prej ku kemi përfitimet më të mëdha. Pra, isha për ate, që nëse ndërmarrin fushatë për të mbledhur ndihma, atëherë jo për të investuar në ekonomi, por në veprimtarinë patriotike-revolucionare, e cila garanton fitime të mëdha, e cila ngrit vetëdijen e mërgimtarëve për të kuptuar se duhet të sakrifikojnë, qoftë materialisht, qoftë edhe me jetë.

Deri këtu ishte vështrim nga një kënd. Vështrimi nga këndi tjetër do të ishte: po që se arrisim të sigurojmë "pavarësinë" materiale, pa patur nevojë t'i "shtrim" dorën popullit, atëherë kjo "pavarësi" mund të bëhet e rrezikshme - të krijojmë shprazëti në mes të LRSHJ-së e radhëve të mërgimtarëve. Mund që atëherë do ta kemi mundësinë të mbyllemi dhe të "qëndisim" mendime në letër, duke "bombarduar" popullin pastaj me gjithë ato mendime të "qëndisura" mirë (por të pa shpirt revolucionar, pasi janë "qëndisur" duke qenë të mbyllur dhe të "pavarur"...). Ne në atë rast do bëhemi "shpirtmirë" ndaj sakrificave materiale të mërgimtarëve, të cilave më nuk do të kemi nevojë t'ua "shtrim" dorën dhe të cilët do t'i ruajmë nga ky "harxhim", por do të arrimë tjetrën, që bashkatdhetarët vetëm teorikisht të inkuadrohen në luftë, me ç'rast kanë mundësinë të fitojnë bindjen se nuk qenka e nevojshme të sakrifikojnë ata fare, pasi çdo gjë e bëjkan të tjerët, ata që mbështeten në "forcat e veta". Pastaj, mos vallë mendohet që aktivitetet tona revolucionare t'i mvarim nga përfitimet që do të sjellin investimet? Nëse po, atëherë është e gabueshme dhe aktivitete të tilla do të jenë tejet sterile, pasi atyre nuk do t'u vij era djersë të popullit, por aftësi prej matrapazëve, nëse edhe këto do t'i kem (për çka do të ndalem më posht.). Pos kësaj, sukseset e këtyre aktiviteteve do të jenë në relacion të drejt e përfitimet që mund të arrijnë investimet e vogla ndaj atyre miliardëshe...

Pa u zgjatur më, pasi po të isha më i pushueshëm do të zgjatesha edhe më shumë dhe ndoshta do të isha më i çartë (tani ka vajtur 3.20 e mëngjesit), po shtoj: shprehja "disi reagoi" nuk është e përshtatshme, pasi mund t'i jipen nënkuptime. Unë nuk pata reaguar disi, por pata shpreh mendime të çarta, se cilat investime janë në rend (Vërtetë investimet e para do të duheshin bërë më herët për ta patur në qarkullim Veprën e shokut Adem, dramën e shokut Isuf, përmbledhje punimesh e artikujsh në një vepër të përbashkët të shokëve të vrarë e punime të tjera. Këto investime do bindnin bashkatdhetarët se LRSHJ-a merret me punë të mëdha dhe është e zoja për to. Por jo, pos ZK dhe të broshurës së Qubrilloviqit, në manifestime e demonstrata LRSHJ-a nuk ka asnjë material serioz për të nxjerrë mbi tavolinë dhe për t'u ofruar bashkatdhetarëve...). Dhe pasi të jetë investuar ku është më aktuale, po të bënim edhe punën tjetër përcjellëse, që të "shkriheshim" në radhët e mërgimtarëve për t'i lexuar së bashku gjithë ato materiale, për t'i analizuar ato dhe për të nxjerrë bashkarisht mësimet e nevojshme, do të shihnim si do të shkonte puna. (Më falni se shpesh po bie të përsërisë, por ja që po më duket se nuk jam i çartë sa duhet dhe nuk po mund t'i them më të përmbledhura mendimet që kisha.)

E marrim sikur unë të mos kem reaguar kurrsesi dhe tani po i përkushtohem kushteve dhe mënyrës së investimit dhe vështirësive reale përcjellëse.

Nga njohuritë që kam në fushën e ekonomisë politike dhe të tregtisë, në botën kapitaliste, ku mbretërojnë ligjet e Xhunglës (të konkurencës, siç quhen ato), kur investon duhet patur parasysh se duhet rrezikuar – o për të fituar o për të humbur. Të gjithë që investojnë nuk fitojnë. Tani për tani, gjatë gjithë kohës jam duke u kujdesur (pasi pa dyshim duhet t'i nënshtrohem shumicës!). Së pari në emër të shokut H. nuk ka mundësi zyrtare që për një kohë të gjatë të investohet në asgjë. Ai do ta bëjë kërkesën për strehim dhe ajo do të zgjatë në rastin e tij nja 4-5 muaj (pasi nuk ka edhe aq shumë prova, por

varet shumë nga gjeturia dhe mënyra e të paraqiturit). Edhe kur të aprovohet strehimi i tij, prapë nuk ka mundësi të investon në emër të vet; sado që duket liri e liberalizim në shiqim, nuk është ashtu. Organeve ju intereson ku kush i merr mjetet për të investuar, pasi dihet për kriminalitetin në ekonomi. Pos këtyre, çfarëdo që të hapet, duhet patur kualifikim përkatës (për restoran duhet me qenë kuzhinier ose kamarier, që ke vërtetim se je marrë me këtë punë. Për këtë që them tani nuk jam mirë i informuar.). Kryesorja e të gjithave është gjuha e vendit; si mund të organizohet diç kur nuk dihet gjuha. Për ta mësuar gjuhën në nivel, me përkushtim serioz, shokut H, do t'i duhen më së paku tri vjet të mira.

I përshkrova vështirësitë sipërfaqësisht jo për të bërë të pamundur çfardo investimi, por pse janë në pyetje ndihma që jep populli dhe me to duhet ditur vepruar, pra, duhet ditur se ku po investohen. Unë do të thoja se e vetmja mundësi për të investuar dhe për të fituar, pasi për atë arsye po investojmë, është që të bashkëpunohet me bashkatdhetarë që kanë eksperiencë, dhe që janë besnik dhe të çështjes. Për shoku H. duhet gjetur mënyrën se si të rregullohen dokumentat, e pastaj, nëse vërtetë do bëhet investim në ekonomi, të gjendet bashkatdhetari me cilin do të bashkëpunon, ose siç quhet në ekonomi do të koperon. Në këtë mënyrë ka mundësi që t'i mbetet kohë për t'ju përkushtuar punës me të cilën është ngarkuar, pasi ka punë shumë me rëndësi, së cilës edhe nëse gjithë kohën ia përkushton prapë është pak. Në këtë drejtim unë do të hulumtoj dhe kam biseduar me bashkatdhetarë, njëherë për njëherë për mënyrat e investimit dhe fitimet që dalin dhe si është e mundur të bëhet. Pastaj, kur të dimë konkretisht se sa mjete do t'i investojmë dhe kur i kemi në dispozicion, atëherë mund t'i përkushtohem konkretisht.

Përfundimisht, pasi jam ende te kjo temë, do të shtroja pyetjen se a ka mundësi të kompromethohemi, pasi një gjë e tillë vështirë që mund të mbahet fsheht? A mos kundërshtarët, po që se i bien në erë, do të na sulmojnë – ja çfarë bëjnë me ndihma të popullit ata të LRSHJ-së.

Sa për shkrimet, jam i vetëdishëm se ende nuk mund të shkruaj artikull, i cili nuk ka nevojë të redaktohet. Unë do të dëshiroja ta kem këtë aftësi, por pasi nuk e kam, nuk mendoj se është keq të shkruaj si di dhe pasi të redaktohet, besoj se do të del diçka. Se duhet lënë një pjesë e jetës në shkrim, unë nuk e di si lehet, por një gjë hetoj në disa raste: se i tëri djerësitem dhe ndiej nxehtësi çuditërisht të madhe, të cilën e hetoj në pauza ose kur të kem përfunduar së shkruari. Pra, me të gjitha forcat e mendjes e zemrës mundohem të shkrihem në çdo punim, që ata t'i bëjë mundësisht të marrin frymë, por u dashka edhe mjeshtëria, e cila, shpresoj, me kohën arrihet, pasi një proverb gjerman thotë: "die Ubungen machen Meister" (Ushtrimet mbarojnë mjeshtër).

Gjatë të kthyer prej andej isha në rrethin e Dys. Bisedova me shumë nga bashkatdhetarët, por në pamundësi që t'i bashkoj së bashku, në mënyrë që të kemi mundësi të bisedojmë më shtruar dhe të nxjerrim përfundime. Me veti kisha shoku Mu., në mënyrë që të jetë në korent dhe të dij se si qëndron situata. Secili në një mënyrë ose në një tjetër mundohej të çfajsohej, çka është e vetëkuptueshme për të tillë që nuk kanë kulturë të njëmendët revolucionare, në mënyrë që kur bëhen analiza kritike, të fillohet çdo herë prej vetëvetes. Pra, si të themi faji edhe kësaj radhe duhej mbetur jetim. Por, unë përfitova përshtypjen sikur është vepruar me qëllim të shpartallimi, nga disa aty brenda. Ndërsa disa nga ta mendonin se nga jashtë u është hedh mish dhie. Sipas të shumëtve fajin më kryesor e mbante shoku Hys, i cili, përkundër marrveshjeve, çështjen e fotografisë e paskësh nxjerrë në masë, pra në klub. Përndryshe, vendimet kishin qenë që një diskutim i tillë të mbahet për një kohë intern dhe pastaj, pa u pajtuan ata të

udhëheqësisë, ta nxjerrin në diskutim që masa të vendosë. Unë me atë kyvetin tim, i cili shpesh po mbivlerësohet (pasi edhe Reshati më shkruante se më dinin për zot andej në Br.), apelova që ta forconin bashkimin dhe të mos e humbnin mirëkuptimin e toruan në asnjë situatë. Më konkretisht, për t'ia lidhur lëmezat mirë edhe nuk m'u duk e arsyeshme, pasi do të ishte i pranishëm pezmi emocional. Sipas tyre ata i kishin punët mirë në klub, ku kishin shtuar diciplinën e vigjilencën dhe sidomos të bindnin se e kanë marrë me seriozitet punën. Edhe në këtë drejtim ankoheshin në Hys. e Bacin, sidomos në Hys., pse i paskësh lëshuar aktivitetet paushall dhe ka bërë ose nuk ka bërë si ju ka tek, pa u konsultuar as pa mbajtur asnjë tubim me kryesinë. Unë, thënë të drejtën u befasova, pasi krejt ashtu se merrja me mend. Me Hys. bisedova në rreth të ngusht fare dhe u pa, e kjo më ka pas rënë në sy shumë më heret, se vërtetë nuk ka dhënë kontributin që është pritur nga ai. Por, njëherit tërheqa vërejtje se nuk ka vend për revanshime, edhe të moskuptimeve familjare; kryetari i tanishëm është kusheri i Hys., por disa kanë inate tmerrësisht të mëdha, me baza nga natyra familjare, të cilat unë i njihja qysh para viteve. Prandaj apelova te shoku Qam. (kryetari i ri), që të ketë kujdes në atë drejtim. Kështu që, edhe shokut Mu. i tregova se kishim biseduar që ai duhet të angazhohet edhe më shumë, bile edhe për kritikat se përse është duke ndenjur anash. Pra, ai duhet të takohet me shokun S. që të bisedojnë më konkretisht se çfarë duhet të bënë në anën e Veriut. Po duhet patur parasysh se nuk ka kuptim që të ngarkohet edhe në Bielefeld, pasi gjendja nuk qëndron si duhet. Ndërsa sa për në Hamb., ai vazhdimisht i ka ndihmuar, edhe pse ndonjëherë e ka patur vështirë.

Qe dy herë më shkruan bashkatdhetari Sadik nga Br. Ai ankohet në njëfarë Ujkanin (unë do t'i kopjoj letrat dhe do t'ia dërgoj atij). Tani kishte marrë letër nga "një shok tjetër i Redaksisë", siç më shkruan, "le që gjërat ishin abstrakte por edhe puna jonë nënçmohej gjë që nuk pranohet" (citim i letrës). Unë në mënyrën time iu kam përgjegj (prandaj edhe pse kopjimi po kushton shtrenjtë, po fotokopjoj edhe përgjegjen, dhe po ia dërgoj Redaksisë, pasi fjala është për te.). Unë mendoj se nëse për këtë bashkatdhetar nuk kemi ndonjë informatë konkrete, duhet të afrohet. Sikur të gjendet gjuha e përbashkët, është një njeri me përvojë të madhe jetësore, sidomos në fushën e arsimit. Që të ketë një punë, e kam ndërmend t'ia dërgoj librin e Obradoviqit "Agrarne reforme i kolonizacije Kosova" që t'i bëjë një recension të gjërë për buletin. Të shohim, pasi ai thirret se është historian, ndoshta në këtë fushë mund të angazhohet.

Ai gjithashtu ka shtruar pyetje konkrete: "Të lutem a din gjë për Këshillimin që u mbajt dhe pse nuk u ftua shoqëria jonë apo mos dikush tjetër e ka përfaqësuar?" (citim red.) Unë thuaja i ika përgjegjes direkte, pasi disi edhe nga gjithë ai rreth të mos jet askush i pranishëm, mu duk një lëshim, ose ndoshta një e metë në punën tonë.

Nga një gjerman ka një letër serioze, ku më shkruan gjërësisht se ka ndërmend të shkruan një libër mbi Kosovën, por jo diçka senzacionale. Pra, sipas letrës, ka ndërmend të shkruan një libër objektiv dhe atë në bazë të kritereve marksiste. Unë jam i mendimit se duhet ta ndihmojmë pasi di se është rast shumë serioz. Por në letër kërkohet ndihmë nga ana jonë, sidomos në udhëzime dhe sigurim të materialit, bile është i mendimit që librin ta shkruajmë bashkarisht. Unë pasi e njoh mirë, ju kam përgjegjur se ne jemi të gatshëm për të ndihmuar dhe bashkëpunuar, kështuqë edhe në këtë drejtim na duhet të përqëndrohemi. Nga shoku S. do ta kërkoja kopjen e librit "Historia e zhvillimit industrial të Kosovës" (disi titull të ngjashëm, nga Dr. Tahir Abdyli, nëse nuk gabohem), që ta pata dhënë. Do ta kthej prapë, por tash për tash nuk po e gjej kopjen që kisha. Ajo kopje do të na duhet për librin në fjalë, që do ta shkruajmë me shokun gjerman, ose më konkretisht, që kemi ndërmend të fillojmë së shkruari.

Sa për buletinin "Kosova", do të duhej të përqendrohemi për të shkruar. Unë po shpresoj se do marrë kontakt me ndonjë shok në Kosovë, që të na vie ndonjë punim prej andej. Për përkthim në gjuhë franceze ende nuk kam ndonjë përgjegje, se a është gjetur mundësia për përkthime.

Kishte me qenë mirë që tani, kur shumë bashkatdhetarë kthehen prej pushimeve, të sigurohet ndonjë informatë nga ta, sidomos sa i përket "lëvizjeve" të Ushtrisë Jugosllave. Tani ajo ka ndërmend të bëjë manovra në Rreth të Shkupit. Kurse gjendja me Bullgarinë është ashpërsuar shumë, sidomos në fushën e propagandës. Bullgaria festën e Ilindenit, më duket 80 Vjetorin, e ka shpallur festë kombëtare në Bullgari, duke mohuar ekzistimin e kombit maqedon. Kjo gjë ka goditur sidomos klikën serbomadhe, e cila sipas interesave, "shpikë" kombe si të ishin këpurdha... Në këtë drejtim një koment shumë i ngarkuar ka qenë në Radio Beograd (më 11 gusht, në orën 22.00). Pra, pa përtes, të vizitohen bashkatdhetarët që janë kthyer nga pushimi dhe të pyeten. Ndonjëri duhet të mos e heton interesimin tonë, por informimi të sigurohet nga biseda e "lirë".

Përfundimisht, më duket se është koha kur të punohet në hartimin e Programit dhe Statutit të LRSHJ-së, për t'u lëshuar në diskutim për aprovim. Tani duhet të shfrytëzohet rasti i ardhjes së ati shokut nga T. (Sabri Novosellës nga Turqia-shën i Xh D) dhe kështu, në një kolektiv të përmbledhur, të hartohet.

Besoj se ua kam hequr merakun me të shkruar dhe të tillë letër jo një në javë, por as një në muaj nuk keni për ta dëshiruar, pasi duhet kohë për ta lexuar. Por të mos ndodhë që të mos e lexoni. Më falni, nuk pata kohë ta shkruaj më të shkurt, siç e thotë një dijetar. Dëshiroj që të hakmerreni, duke shkruar edhe më gjatë secili nga ju.

– Për një Republikë Shqiptare në Jugosllavi!

– Rroftë LRSHJ-a!

Përshëndetje revolucionare

Ilazi

PS. Mundësisht fotokopjet të firmosen origjinal dhe jo firmosja të kopjohet nga origjinale. Pra, pasi të fotokopjohen të firmoset edhe origjinali edhe kopjet për secilin.

Të veçanta:

Shoku F. (Faridin Tafallari-shën i Xh D), materialet që m'i dërgove i mora. Për lenta, momentalisht nuk i kam, pasi janë dërguar diku tjetër. Por, trego cilat të duhet, që t'i dërgojmë vetëm ato. Tani së fundi ka mbërri edhe kaseta e vizitës së shokut R. Alia në qytetet e Veriut. Besoj se e di edhe ti se ç'detyrë të vështirë ke që t'u kundërvihesh atyre plehrave andej. Por mos u dorzo. Do të dëshiroja çfarë qëndrimi po mbajnë shokët tjerë, sidomos ata të "mercedesit" dhe ata nëpër ato fshatra përreth.

E përshëndet shoqen, vëllaun, kojshin dhe sidomos fëmijët!

Mirëupafshim.

24. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive (QE), 25 gusht 1983

PËR NJË REPUBLIKË SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!

Suedi, më 25 gusht 1983

Të dashur shokë të QE,

vetëm nga shoku Xhemë mora përgjegje, ose më mirë të them mora letër përafërsisht në intervalin kohor që propozoi ai në lidhje me komunikimin e rregullt mes nesh. Mirë do të ishte të shkruajnë që të gjithë, sadopak.

Sa i përket mbështetjes në forcat, çdo gjë e qartë. Unë jam duke bërë hulumtime. Për ndonjë të dhënë konkrete nuk po ju shkruaj, se si ka mundësi të bëhen investime, pasi

edhe nuk janë të nevojshme. Kur të di diç konkrete, për akcion, atëherë ju shkruaj që të miratoni.

Këtu nuk i kam përgjegjet që ia kam kthyer ST, por sa t'i siguroj, do t'i dërgoj kopjet. Mendoj se ju kam përgjegjur siç do lypsej. Ndërsa së fundi i kam shkruar edhe Kryesisë së Bashkësisë së Prindërve Shqiptarë nga Kosova "Idriz Seferi". Edhe atë kopje do ta siguroj për arhiv.

Nga vizita "përtej gardhit" janë kthyer disa. Dua të them se më ka rënë të dëgjoj shumë gjëra të mira dhe të këqia. Por, tani po shkruaj për disa gjëra, pa qenë i sigurt në vërtetësinë e tyre. Përndryshe, lirisht mund të them se disa gjëra kanë turpëruar emigracionin punëtor, i cili në opinionin e atjeshëm gëzon respekt të lartë, sidomos rasti i turneut të Ansamblit... dhe pritja kanë bërë të veten. Kjo ka rëndësi të madhe.

Gjatë gjithë kohës me vizituesit ku ka qenë edhe familja e shokut Drini, bashkatdhetarët janë kënaqur që kanë patur ata në mesin e tyre. Por, sipas të gjitha gjasave, shoqja e shokut Drini, duhet t'u ketë folur disave se Ilazi është Davidi në radhët e LRSHJ-së, pra Iljazi i bënka të gjitha të këqijat... Pastaj, Salihu na qenka luftëtari më besnik, por Ilazi ia saboton punën..., kështu ngjashëm. Nuk kanë munguar edhe "argumentet". Ndër "argumetet" më të freskëta ka qenë edhe mosvajtja e bashkatdhetarëve të Shtutg. në vizitë, të cilët i kam penguar unë të mos shkojnë. Pa e zgjatur, – por të jemi në korent se kanë ndodhur gjëra shumë të këqija, për të cilat më gjerësisht doemos më duhet të shkruaj herën tjetër, – mendoj se shokët Salih e Fahri duhet t'i shkruajnë shoqes për unitetin tonë (nëse mendojmë se e kemi, unë mendoj se e kemi siguruar maksimumin e unitetit të mundshëm, i cili do të rritet gjatë pune e lufte të përbashkët!) dhe ta sqarojmë më mirë, pasi disa gjëra, që unë mendoj se i kemi kapërcyer, nuk do të duhej të përsëriten. Ato do na dëmtojnë shumë, pasi në vizitë në të ardhmen do të shkojnë vazhdimisht bashkatdhetarë nga këndej dhe unë s'do të dëshiroja, – për këtë lypset edhe mendimi juaj, – të dëgjoj sërish gjëra si kësaj radhe. Edhe njëherë, bëjë propozim që shokët Salih e Fahri t'i shkruajnë shoqes së shokut Drini dhe ta sqarojnë, ose të kërkojnë nga ajo që për një kohë të mos bisedoj me vizituesit gjëra të ngjashme, përderisa të mos kemi siguruar prova, më përkatësisht, përderisa të mos ketë prova se Iljazi ka bërë gjëra të këqija...

Po kështu, propozoj që shoku Salih t'i shkruan edhe për grupin rreth gazetës "Punëtorët", sidomos për kretenin Nuhi, që shoqja të jetë në korent. Atje nga disa vizitues të Mynihut janë futur disa "Punëtorët" dhe u janë shpërndarë kosovarëve, të cilat u janë mbledhur pastaj... Të gjitha këto janë me rëndësi të madhe, pasi gjëra të tilla mund të keqpërdoren shumë, andej për "vizitë" do të dërgohen edhe vegla nga këndej, të cilëve të tilla fjalë u duhen për të mbjellë përçarje. Nuk kishte me qenë e tepërt, që një letër e tillë, po u vendos të dërgohet, ta kishim kopje.

E thash, mbi këto që shkrova, kësaj radhe po shkruaj fare shkurtimisht. Por herën tjetër do të shkruaj më gjerësisht, pasi t'i kem siguruar të gjitha verzionet e atyre që kanë ndodhur atje, për të nxjerrë një mendim se si vërtetë ka mundur të ndodhë dhe kush nga këndej është shkuar për të "nxitur" gjëra të tilla.

Për veglat teknike do të interesohem. Por, e keqja është se aparatet fotokopjuese për letër normale, formati A3, janë të mëdhenjë dhe pos kësaj, janë të ndërlikueshëm teknikisht, kështu që lehtë prishet e fare vështirë ndreqet.

Sa për veglat që ishin cekur, do të bëjë edhe unë diç në atë drejtim. Do të kemi mundësi të zbulojmë se ku gjendet edhe ai farë Ibrahim Elezaj.

Për akcionet..., shkruar në fillim të letrës, le të mbetet çështje e tyre. Nga këndej çdo këshillë nuk mund të dekonspirohet, siç mund të ndodh edhe nga korrespondenca.

Nuk po zgjatem më kësaj radhe. Sa për shpërngulje dhe kolonizim nga trojet shqiptare nën tutelën e Maqedonisë, është duke shkruar një shok i atyre anëve. Ndoshta do të shkruan edhe ndonjë gjë tjetër.

Po përfitoj rastin të shkruaj edhe për disa gjëra, sidomos mobiljet e familjes së Drinit. Shoku Fahri dhe Salih do të duhej të interesohen se ku gjenden. Pastaj të marrin kontakt se kur kanë një kamion të thatë në dispozicion që ato të gjitha t'ia dërgojmë shoqes brenda, pasi atje mobiljet janë shumë shtrenjtë dhe nuk duhet lënë ato të shkojnë posht kur janë.

Parollën që përdora në fillim, të cilën e kam përdorur edhe në letra të tjera, a është e drejtë? Mos kishte me qenë edhe më e drejtë PER REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI! Ose, që të dya nuk duhet të praktikohen fare dhe përse.

Përshëndetje revolucionare, Iljazi

PS. Shoku Naim ka marrë sot zyrtarisht strehimin dhe është i lirë të lëviz. Me te do të duhej biseduar, pasi kam përshtypjen se për disa gjëra nuk është gjithaq i qartë. Sidomos kjo rezultoi nga bisedat që pata dje me te dhe me Ismajlin (i cili, duket se është tradhtuar nga nervat, në mos tjetër gjë (ai, ka mundësi, ka përzier mbarë e mbrapsht kur ishte në vizitë "përtej gardhit"...) Sidomos kur janë në pyetje investimet, pasi Naimi muar strehimin, nëse do të bëhet ca më serioz e punëtor, mund të bëhet diçka edhe përmes ti. Ati i kanë ardhë prap pesë numra të "Punëtorët", por nuk i ka shpërndarë fare.

Mirëupafshim. (Ibrahim Kelmendi)

25. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive (QE), 15 shtator 1983

PËR NJË REPUBLIKË SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI! Suedi, më 15 shtator 1983

Të dashur shokë të QE,

E pata shkruar një letër që me 10 të këtij muaji, por nuk e dërgova. Arsyen po ua tregoj tani: po më duket se kulturën revolucionare e shoqërore nuk e kemi në nivel që kritika të kuptohet siç lypset dhe ta arrin efektin e vet, kështu që shpesh po ndodh e kundërta – po hidhërohemi e inatosemi në njëri-tjetrin edhe më shumë, pra, kritika po e arrin efektin e kundërt. Mu për këtë arsye, po më duket më e arsyeshme që tani për tani – gjer sa të mësohemi ta kuptojmë kritikë objektive të njëri-tjetrit – të shkruaj me ton më të but. Por, edhe kështu, jo pa të drejtë, frikësohem se jam më i ashpër se sa do të lypsej në këtë situatë e këto rrethana, por që të heshti, nuk heshti dot. Ndërsa, pse nuk marrë përgjegje, edhe ajo është një lloj përgjegjësie për ata që nuk përgjegjen.

Në ndërkohë mora letër nga shoku Xhemë, të cilën e ka postuar më 31 gusht (e që mua më erdhi me vonesë, duke u dashur të vij postim pas postimi...). Por, më parë dua të ndalem ke ca çfaqje të kohëve të fundit, sidomos pas kthimit të Milaimit (të Parisit) dhe të tjerëve nga vizita e pushimi...

Ato që ndodhën kohëve të fundit, e kam fjalën të fushata e Milaimit dhe Xhavitit, janë çfaqje, të cilave duhet t'u përkushtohemi doemos. Por kjo do të bëhej më mirë sikur shokët të na tregonin çfarë dinë për atë fushatë, veçmas shokët Fahri e Salih, që kanë qenë të pranishëm me një rast. Unë kësaj radhe po bazohem në ato që m'i tha shoku Meti përmes telefoni (me ç'rast, për shkak të shpenzimeve, nuk kemi mundur të bisedojmë gjerësisht.).

Në seminar disa gjëra qenë sqaruar, edhe pse, për mendimin tim, nuk ka qenë tubim i ati niveli, që të merret me të tilla bisedime dhe marrje vendimesh (si ai se cili qëndrim duhet marrë ndaj AP dhe shokëve të tij dhe si duhet luftuar e demaskuar ata, e

të tjera bisedime), pasi aty ka patur edhe nga ata që nuk militojnë në radhët e LRSHJ-së dhe si të tillë që janë, nuk meritojnë. Sidoqoftë disa gjëra qenë diskutuar. Kurse në tubimin tonë të pastajmë, u sqaruam edhe më mirë, duke marrë vendime përkatëse. Ndër to ishte edhe fotografia e satrapit.

Përkundra të gjithave, po përsëriten disa dukuri që duhet tejkaluara, ose që duhet shtruar ku është vendi që të diskutohen rishtas e të merren vendime përkatëse, po që nevoja, dhe jo të përsëritet e njëjta, që në masa heterogjene të ndodhin ato që patën ndodhur dhe që ndodhën. Kësaj radhe edhe më konkrete është "misioni" i Milaimit, i cili, po sa u kthye nga vizita..., filloi nga sulmet LRSHJ-së, por tani më si sigurt, pasi derdelisej "në emër të PPSH-së". Këtë gjë më mirë se askush dhe më e mirëseardhur se për çdo kend, diti ta shfrytëzon dhe e priti Xhaviti, për të cilin më nuk do të flas, pasi fjalët po i merr era, kurse shoku Salih edhe më tutje ka bindjen se është shok i mirë (Nëse nuk e mendon bukurinë, atëherë nuk ka pse të mos ndryshon edhe atëherë kur shfaqjet e dënueshme i përsërit, edhe pse në seminar na u desh t'ju ruhemi... dhe t'i përkushtohemi pajtimeve, që, sipas të gjitha gjasave, janë shkelur...).

Sa kanë të drejtë shqiptarët e Kosovës, të strehuar në atdhe, ashtu siç ju desh shokëve të strehohen në Perëndim, të çfaqin kritika e mendime për LRSHJ-në, as që mund të vëhet në dyshim. Por, nëse ato ndodhin, atëherë nuk ka nevojë askush të dërdëlisë rrugëve të botës. Kritikat e mendimet për LRSHJ-në, për vijën e përgjithshme politike, nuk duhet nxjerrur rrugëve, për interesa të ngushta egoiste. Të gjitha kritikat, propozimet e mendimet, duhet të dërgohen për analizim, ku duhet, për të marrë qëndrim ndaj tyre. Pastaj duhet të njoftohen ata që kanë kritikuar dhe kanë dhënë propozime e mendime. Nëse nuk kënaqen me përgjegje, duhet edhe njëherë të ankohet se përse nuk është i kënaqur. Dhe nëse sërish nuk do të jetë i kënaqur, ai që është anëtar, duhet ta bëjë çështje në celulën që militon. Asesi nuk duhet të dalë kokë në vete për të dërdëlisur rrugëve. Pse dalja e tillë, para se të merren vendime dhe pastaj, është e dënueshme – është punë grupazhi e frakcionizmi.

Edhe Milaimi, nëse ka dëgjuar ndonjë kritikë, kështillë a propozim, është dashur t'i njoftojnë shokët që janë në nivel të përgjegjësisë (të cilët ai i ka njohur, pasi ata dhe jo Xhaviti, e patën nxjerrë në ball të demonstratave dhe patën garantuar, nëse mund të shprehem kështu) dhe jo të dekonspirohet para Xhaviti, i cili mezi ka pritur dhe, mendoj, e ka nxitur që së bashku të marrin fushatë "demaskimi" e sulmi. Kanë qenë më se të sigurt, sidomos Xhaviti, se rast më të volitshëm nuk mund të presin, duke menduar se pasi Milaimi është kthyer nga vizita..., çdo gjë që flet do ta flet pse është "këshilluar"..., e lere më se ai vet nuk është kursyer të derdelis "në emër të Partisë...". Sa janë të vetëdishëm që të dy se çfarë do të thot që rrugëve të derdelisësh "në emër të Partisë...", me siguri janë. Prandaj, për mendimin tim, ashtu kanë dashur, të them tani për tani, pse ashtu ua ka lypsur egoizmi i tyre i ulët e naiv (duke menduar se nuk kanë vendin e "merituar" në Lëvizje, dhe këtë, për arsye se i pengojnë persona të caktuar...).

Si po shihet, në pyetje është kompromet imi i Partisë..., nuk ka diskutim. Tjetër është ajo se përse. Bile që të bënë diç tillë, askush nuk mundet më mirë se Milaimi, lulet e të cilit (nëse nuk gabohem) ju dhanë shokut Enver në Tribunë të 1-Majit dhe foli edhe në Televizion Shqiptar (ato që keni dëgjuar). Prandaj më duket serioze. Mu për këtë arsye, propozoj që të analizohet e gjithë puna dhe sjelljet e Milaimit, duke marrë përfundimisht qëndrim përkatës, pasi disa të meta janë parë tek ai edhe më parë. Nuk kam nga t'i ik edhe propozimit tjetër, që nën llupë të merret Xhaviti, me të mirat e të këqiat, duke i peshuar dhe duke dal të çartë se çfarë qëndrimi duhet të merret për ta. Por, si edhe pritet, duhet secili nga ne, për të dytë, t'i thotë ato që dinë.

Për qëndrimin e shokëve Fehmi e Salih, kur ishin në Dyseldorf, gjithashtu duhet të bëhet vlerësimi përkatës, por pasi të na informojnë vet se çka është biseduar dhe çfarë

qëndrimi kanë mbajtur, njëherit të japin mendimin se a kanë qenë të domosdoshme të tilla bisedime të atij niveli. Shtoj, për gjendjen e krijuar në Dyseldorf doemos duhet analizë dhe përfundimisht duhet të përgjegj dikush. Kështu së paku mendoj unë. Nuk e fsheh pakënaqësinë se kemi patur një rreth e një atmosferë, që ka qenë për shembull, prandaj ato që më ka rënë t'i dëgjoj, fatkeqësisht duhet të na prekun të gjithëve. E them hapur, se edhe armiqtë më të mëdhenjë, që nga formimi i atij klubi, çdo herë e kanë humbur betejën me turp...!

Shoku Salih, pa të drejtë më ngarkoi më përgjegjësi pse nuk ishte angazhuar shoku Meti. Tani që ai po provon të angazhohet, nuk e dij cilin qëndrim është duke mbajtur shoku Salih; në vend që të bisedojnë së bashku se çfarë duhet të bëjë në disa rrethe shoku Meti, ai prap provon ta siguron atë se Xhaviti është në rregull edhe atëherë kur hedh të gjitha plehërat e botës në LRSHJ-në dhe Meti e mbron (ndoshta jam i dezinformuar, e nëse po, atëherë duhet të jap llogari Meti.). Shoku Salih do të duhej të thotë se përse vepron kështu. Mos është në pyetje mosbesimi ndaj Metit (nëse po, duhet të thotë), përndryshe pos kontributit të vlershëm, nuk e ka fare cilësinë të pështjell e të bëjë gabime aq të hatashme, sa të disave që vet ua kemi dhënë shansat...

* * *

Të dashur shokë,

pasi letër mora vetëm nga shoku Xhemë, po konkretizohem për t'ju përgjegjur. Por, njëherë duhet të prek disa lëshime të shokut Xhemë, si, "nuk po u përmbahemi vendimeve tona për letërkëmbim" dhe shkruarjen në detale të disa gjërave, që nuk janë të domosdoshme, pasi edhe letërkëmbimin nuk e kemi të sigurt – besoj se adresat na janë dekonspiru dhe djajtë edhe këndej ecin me fenerë, kështu që shumëçka mund të dekonspirohet. Pra, ose unë nuk po kuptoj se si merret ndonjë vendim, ose nuk është marrë vendim i prerë për letërkëmbim. Sidoqoftë, edhe unë jam i mendimit se letërkëmbimi duhet të jetë në nivel, ashtu siç duhet të ipet përgjigje e merituar për çdo pyetje dhe propozimet që bëhen, duhet shprehur mendimin konkret ndaj tyre, në mënyrë që të shkohet përpara. Në disa propozime ende nuk kam marrë përgjegje nga të gjithë, e kjo pritje e panevojshme, në këtë situatë, është për çdo kritikë. Sikur të dinim së paku arsyen...

Në letrën e 31 gushtit shoku Xhemë ka bërë propozime, sidomos sa i përket çështjes organizative. Unë mendoj se për gjendjen kaotike të pranishme në kurbet, askush nuk mban përgjegjësi para nesh. Ama, përfundimisht për disa gjëra duhet patur teori dhe ajo është më kryesorja, përfundimisht LRSHJ-a duhet të del me Program e Statut. Unë pata menduar, kur u botuan në ZK konturat e Programit Politik të LRSHJ-së, se ishte formulim që duhej të shërbente për diskutimet në radhët e LRSHJ-së, nga të cilat duhet të dali përfundimisht Programi e Statuti i LRSHJ-së. Për mungesën e Programit e Statutit, mendoj, askush nuk e mban përgjegjësinë para të gjithë anëtarëve të Komitetit Qendror (të Përkohshëm - pasi deri sa të jepen mundësit që të bëhen zgjedhje të rregullta demokratike, ashtu duhet të quhet, apo ndoshta nuk po kam të drejtë në këtë mendim). Sigurisht që në mungesë të Programit dhe Statutit është vështirë të funkcionon organizimi, ashtu siç mund të bëhen lëshime të tjera, sidomos sa i përket vijës politike (asaj që është shtruar në Komunikatën, të lëshuar me rastin e bashkimit, për të cilin Bashkim, prap KQ duhet të mendon, sidomos sa u përket shokëve të PKMLSHJ.).

Se ka shumë gjëra të pasqaruara, tregon edhe letra që mora nga KHP (Komiteti "Hasan Prishtina" në Turqi - shën i Xh D). Ata QE e quajnë KE (Qendrën Ekzekutive e quajnë Këshill Ekzekutiv - shën i Xh. D.), kurse mua më quajnë sekretar të Sekretariatit

për çështje të jashtme. Duhet përfundimisht të përputhen emërtime të tilla dhe të mos ngatërrohemi me tituj (sado që më duket formale, ka rëndësi që të përputhen emërtimet).

Të kthehem konkretisht te propozimet e shokut Xhemë. Shoku Xhemë shkruan se "duhet formuar qelulat tona kudo". Me këtë pajtohemi të gjithë dhe është, thuaja, e vetëkuptueshme, por si. Kjo është pyetje që duhet të shtrojmë për t'ju përgjegjur. Çështja organizative ju besu shokut Salih, me bindje se është i përgatitur për t'i dalur zot këtij misioni, ose, se shpejt do të aftësohet gjatë punës. Se si qëndron gjendja dhe çfarë rezultati ka arritur, dinë ai më së miri. Por në shiqim të përcipët, nuk duket se qëndrojmë mirë sa i përket organizimit, nga i cili varen të gjitha sukseset tjera, si të përgatitjes së kuadrove, po kështu propaganda, grumbullimi i mjeteve financiare dhe ndihmave si dhe shpërndarja e tyre, sigurimi i informatave nga atdheu, etj., etj. Ndonjë punim për çështje organizative, se si duhet të organizohet dhe si do të duket fillimi i aktiviteteve të organizuara të anëtarit rishtas të anëtarësuar në radhët e LRSHJ-së, nuk na ka rënë në dorë për analizim dhe që të shprehim mendimet tona. As nga shokët tjerë diçka e kësaj natyre, qoftë edhe nga shokët brenda, nuk është vuar në qarkullim. Siç do bindemi të gjithë, në këtë fushë kryesore qëndrojmë mbrapa dhe është shprazëti e madhe sa i përket teorisë organizative. Kurse sa për sektorët tjerë, gjendja nuk qëndron hiq më mirë, me përjashtim, ndoshta, të propagandës - të daljes së ZK, i cili i ka të metat e veta (unë kam ndërmend posa të më dalë kohë, t'i shpreh disa mendime, se në cilin nivel qëndron ZK dhe çka duhet bërë që të dal edhe më i mirë. Kurse sa i përket punës sime, mos vet. Hiç mirë. Më shumë se kudo, mungon eksperienca përkatëse. Besa nuk është në natyrë të shqiptarit të jet diplomat në "nivel", pasi të jesh diplomat në "nivel" sot, në këtë situatë, do të thotë të jesh mjeshtër i finesave edhe dredharake e mashtruese, kurse në natyrën shqiptare është sinqeriteti dhe parimet. Pastaj, si shumë po pengon mosnjohja e gjuhëve të huaja (gjuha gjermane nuk mjafton, do të duhej të zotërohej edhe serbishtja, sidomos anglishtja e frengjishtja.). Por, sikur të ia arrimë të nxjerrim Buletin në nivel, do të kemi më leht që çështjen shqiptare në Jugosllavi si dhe Lëvizjen t'i bëjmë të njohura në botë.

Pastaj shoku Xhemë shkruan: "Është e domosdoshme që të formohen komitetet e vendit, apo (...) përgjegjësit e caktuar për një regjio..." Si edhe në rastin e parë, sa u përket qelulave, është po e njëjta prapambetje. Ndonjë propozim që bëhet, nuk shtrohet si të jetë e mundur të realizohet, por më shumë pasurojnë arsenalin e propozimeve, që përfundimisht, shumica, edhe ngelin propozime. Bile, mund të na ndodh për të njëjtën dukuri të bëhen disa herë propozime të ndryshme, duke harruar se mos ndoshta në një letër dikur është bërë një propozim po për atë çështje dhe po nga i njëjti shok. Kjo vërteton edhe spontanitetin e stihinë në punë e mendime, që në rastin tonë po kushtëzohen nga mungesa e Programit e Statutit, në suaza të të cilit do të ndaleshim të mendojmë dhe të shtrojmë teori komplete që i duhet një organizate siç pretendon të jetë LRSHJ-a. Kurse sa për punim që e paskemi, ndonjë tjetër pos DETYRA TË NGUTSHME, i cili, si i tillë, edhe nuk ndihmon shumë. Me rastin e anëtarësimit të anëtarit të rij, duhet të dihet fare mirë t'i thuhet se cila diciplinë, cilat aktivitete, çfarë sakrificash e presin. Pastaj, celula duhet të furnizohet, vazhdimisht me materiale analizuese e detyra, që të jetë e freskët dhe tërheqëse, nëse mund të shprehem kështu, jeta organizative. Jo, jo, mbeten të analizohen thash-e-themet, duke tërhequr me pavetëdije secilin në të njejtin batak, dhe kështu, u vije radha demoralizimit, dëshpërimit dhe përçarjeve. Prandaj si e si, për rrethanat në kurbet, duke patur parasysh nivelin e bashkatdhetarëve, do të ishin më praktike Komitetet e rretheve (prej 3 anëtarëve), që do kordinonin aktivitetet dhe organizimin në rreth. Them Komitetet, për arsye se kështu si janë, vështirë se një militant do të jetë hallkë funksionuese në nivelin që kërkohet. E po të kërkohet vetëm një, atëherë me andje po iket që të zgjedhet punëtor "i thjeshtë" (siç përdoret gjer në banalitet kjo shprehje – pasi e kundërta e të thjeshtëve, e përbërë, e komplikuar... nuk ekziston – pasi edhe nuk janë të

thjeshtë në kuptimin e fjalës...). Më shumë po preferohet i dituri (që na mungojnë, pos nëse mashtrohen në etiketime që disa i bëjnë vetes...), llafazan (nga këta ka sa të duash...), aventuristat revolucionar, të cilët me kalim të kohës po dalin gjizë... Kurse sikur të vendosnim për Komitet, atëherë do zgjedheshin tre punëtorë, bënë edhe të përgatitur teorikisht, ama besnik, të sinqertë, të sakrificave dhe të fjalës, siç i ka kalitur jeta e vështirë. Me kalim të kohës, shumë shpejt, duke u ndihmuar reciprokisht, do bëhen Leva që i duhen Lëvizjes.

Shoku Xhemë përmend rrethanat e volitshme jashtë atdheut, ku nuk po vika UDB-ja për ta zënë derën. Kjo është më se e vërtetë, por i vërtetë është edhe fakti se bashkatdhetarët UDB-ja po i pret që në kufij dhe kanë qindra kilometra që udhëtojnë duke qenë nën përcjellje të rreptë të policisë... Prandaj thuaja po mjafton një informues në një rreth të gjerë, i cili ka patur mundësinë njëqind herë të infiltrohet, ndoshta jo drejtë e në radhë të organizuara të Lëvizjes (pasi nuk janë), por në radhë të bashkatdhetarëve, të cilët, në shiqim të parë, lënë të kuptojnë sikur janë të organizuar, pasi shumë nga ato punë bëjnë haptas (Bile edhe idhëtarë e klubeve me fotografi të satrapit e me konzullatat jugosllave, hiç nuk ngurojnë që kohë pas kohe në klube të hedhin tema për "diskutim", që do duheshin të diskutohen në mënyrë interne vetëm në celula, të organizuara mirë...). Prandaj do t'i thoja shokut Xhemë: le të ruhet nga infektimi me liberalizëm të vendit, me atë liberalizëm që me të drejtë jemi kritikuar, se ishim infektuar më parë. Për mendimin tim, sa i përket punëve organizative dhe vet organizimit, jashtë do të duhej ilegalitet më i thellë se edhe brenda, pasi atje shkrihet njeriu në popull, kurse këtu nuk të përcjellin vetëm të UDB-së, por edhe të policive e agjensive të vendit dhe të tjera.

Sa u përket AP, Nuhiut dhe shokëve rreth tyre, sa nuk po më pëlqen të dëgjoj gjëra të tilla. Sikur na i kanë ngrën kokrrat, siç shprehet populli. Unë do propozoja që përfundimisht të merret qëndrim i çartë nga baza e gjer te KQ dhe jo t'i ngjas lojës. Në seminar që biseduar shumë, nuk e di çfarë pasoj. Ndoshta vetëm se janë informuar dhe masin pulsin tonë... Përfundimisht, duhet të dinë se kanë punë me patriotë revolucionarë, të vendosur e seriozë, dhe do shihni se a do guzojnë të bëjnë lojra të tilla. Dhe jo vetëm për seminar, por edhe në takimin e QE, sikur u sqaruam prandaj çfarë nevoje kanë manovrimet, nëse guzojë t'i quaj ashtu. Nëse punët kanë shkuar në rregull, atëherë kuptohet fare se puna e tyre është tradhëti. Nëse është tradhti, siç duket, pse të mos demaskohen si të tillë, por të lejojmë që të na e hanë shkopin nga dora!

Është koha që t'i përkushtohemi Buletinit KOSOVA. Duhet shumë shpejt të sigurohen punimet. Kurse, prap vështirësia është, se konturat e Programit politik, të botuara në ZK, nuk mund të trajtohen Program Politik, përderisa përfundimisht nuk janë program (me këtë rast edhe në artikullin e ZK, numrit të fundit, është shkruar sikur ato kontura kanë qenë Program i LRSHJ-së.). Unë vetë nuk jam në gjendje, së pari të shkruaj në nivel që kërkohet, pastaj të shkruaj aq shumë. Por që të organizoj përkthimin, jam duke u përpjekur. Po kështu, edhe për botim duhet të mendojmë. Ka ardhur koha, që përfundimisht, të kemi shtypshkronjë tonë, sado të vogël, pasi shpenzimet do të jenë shumë më të vogla se sa rjepjet që na bëjnë shtypshkronjat e huaja, të cilat edhe nuk i ke në dispozicion kur të duash dhe në raste të shpejta.

Besoj se shkrova mjaft, nëse jo edhe tepër (e halli që shokë Fahri e Bacalok punojnë punë.).

Përshëndetje revolucionare

PS. Po ua dërgoj Komunikatën, të lëshuar në gjuhë angleze dhe të dërguar ku kemi patur adresa. Fjala është për Komunikatë lidhur me manovrat ushtarake, "Jedinstvo-83'. Besoj se nuk do kundërshtoni e kritikoni për përmbajtje, por nuk ka patur kohë për konsultim e aprovim.

Mirupafshim! (Ibrahim Kelmendi)

26. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive (QE), 10 tetor 1983

PËR NJË REPUBLIKË TË SHQIPTARËVE NË JUGOSLLAVI!

Të dashur shokë të QE RFGJ., më 10 tetor 1983

mora të shkruaj pa pritur përgjigjet, që edhe mund t'i keni nisur. Por, sikur kam përshtypjen se ju shkruaj tepër dhe po tregohem mospërfillës ndaj dëshirës suaj që të shkruaj më përmbledhur; faji është se nuk po dij dhe jo pse nuk po du.

Mora letër nga shoku Xhemë, nga shoku Salih ka kohë që nuk kam marr, nuk dij pse nuk po shkruan.

Sa i përket përshtypjes së shokut Xh., se "vuaj nga shtro e mos mbulo", mund të ka diç të vërtetë, bile edhe më duhet të pranoj, ama nuk besoj se është rrjedhim i ndonjë vuajtje që nuk i bije në fije, sa rrjedhim i faktit se është duke na munguar kultura revolucionare për kritikë dhe autokritikë të nivelit.... E shoh të arsyeshme, në këtë gjendje, të mos nxjerri sytë sytë duke dashur t'i qesi vetullat! Edhe ju duhet të bindeni se i ruhemi njëri-tjetrit, se mos nuk kuptohet kritika dhe vërejtjet drejt dhe po hidhërohet... Në këtë drejtim po kontribuon edhe njëfarë mospërfillje për t'u përgjegjur në letra, veçanërisht nga shoku Salih, prandaj do të ishte mirë të na shkruan pse vepron kështu.

Më duket me rëndësi të ndalem edhe te një dukuri që më ka rënë në sy, sidomos te unë që po shkruaj ca më shumë. Për të tilla letra do të duhej më shumë kohë, se koha që po u përkushtojmë në këto rrethana, kuptohet, në mungesë të kohës dhe si rrjedhim i preokupimeve të shumta. Prandaj, mund që do të lëshohet ndonjë gabim. Ndonjëherë kur më del kohë të lexoj ndonjë nga letrat që ua dërgoj, shumëçka do riformuloja dhe do shtroja më ndryshe sikur të kisha kohë. Mu për këtë arsye, do më dukej e vetëkuptueshme të kemi dhe këtë dukuri parasysh, që të mos lind ndonjë keqkuptim.

Shoku Xh. me të drejtë e mundon fakti se bëhet ndonjë vërejtje, në hava, siç do thoshte populli, për përmbajtjen e ZK, përderisa nuk konkretizohet dhe nuk bëhen propozime konkrete se çfarë duhet përmirësuar. Bile, shumë më mirë do të ishte sikur të shkruheshin artikuj, në vend të propozimeve se si duhet të ishin ata që do shkruan tjetri. Me gjasë, është një fazë kur disa krijues janë në formim e sipër, dinë më shumë të kritikojnë se sa të krijojnë. Por ka edhe kritikë, siç ndodh në letërsi, që dinë vetëm të kritikojnë e vlerësojnë, por jo që të krijojnë vet. Unë për veten time për përmbajtjen nuk kam bërë vërejtje sa për stilin, që më është dukur i lartë, fare letrar. Me këtë nënkuptoj se në shumë artikuj, sidomos kryeartikuj, stili është i nivelit të ndonjë reviste letrare dhe jo i Organit të organizatës së masave, Lëvizjes, Pararojës. Nëse është e vërtetë kjo, kuptohet se përmbajtja do kuptohet vetëm nga rreth i caktuar i lexuesve, që kanë kulturë për të lexuar e kuptuar secilin stil. Në këtë përfundim kam ardhur edhe nga përgjimet në teren, siç praktikohet të thuhet, me ç'rast më ka rënë në sy në përmasa serioze se bashkatdhetarët ose nuk i lexojnë artikujt kryesor, ose i lexojnë vetëm një herë me mundim të madh, por fare pak u jetë nga ai lexim. S'ka dyshim se edhe sikur të shkruhet në stil popullor, në përmasa të mëdha bashkatdhetarëve u mungon fare shprehja për të lexuar e kuptuar, por ama një shtresë që tani nuk është në gjendje t'i lexon e kupton artikujt kryesorë, do të

ishte në gjendje atëherë dhe kështu, do ndihmonte shtresat tjera, masat më të gjera, duke aplikuar leximin dhe diskutimet në grupe. Këtu luan rolin e vet, shumë, çështja organizative, që militantët në rrethe ta praktikojnë këtë formë të punës, që është më praktikja për të ndihmuar masat në ngritje të vetëdijes kombëtare e revolucionare.

Pa patur mundësi të ndalem më gjatë, sa i përket stilit, do të shkruaja atë që shumë herë e kemi thënë edhe gojarisht, se mënyra e të shkruarit të Leninit e Enverit, veçanërisht artikujt e shkruar gjatë revolucionit dhe Luftës Nacionalçlirimtare në organet e kohës, për rastin tonë, do të duheshin të ishin busull se si do të duhej shkruar për masat, pa vuajtur nga pseudofilozofimet se teoria filozofike e revolucionit nuk mund të shtrohet në gjuhën e thjesht dhe nuk është teori që kuptohet nga njerëzit e thjesht.

Në letrën e parafundit duhet ta kem shkruar se me një rast të veçantë kam ndërmend të ndalem mbi një analizë më konkrete mbi propagandën tonë në përgjithësi, duke filluar nga organet e mëparme, deri në ditët tona. Në atë analizë kisha idenë të bëjë vështrim kritikë, kuptohet në hallin tim, dhe mbi kontinuitetin e "kthimet" e mëdha; para shpërthimit të demonstratave, pas shpërthimit dhe pas bashkimit. Mendoja se ndonjë ide që mund të më lindte, sidomos mendimet në formë të citateve të klasikëve të marksizëm-leninizmi (**PËR MENDIMIN TIM EDHE SHOKU ENVER HYNË NË RADHËN E TYRE!**), do na ndihmonin për propagandën në të ardhmen.

Se është duke bërë punë të madhe shoku Xh., nuk ka nevojë ta them (jo pse frikësohem se mund t'i rritet mendja e të qoroditet.). Bile, sa i përket punës së gjithmbarshme të QE, sektori i propagandës, fatmirësisht, është më funksionali dhe më i suksesshmi. Por nuk do leja pa u ndalur me këtë rast edhe te përmbajtja, pos që shkrova diç për stilin. Nganjëherë sikur krijoj përshtypje se ZK i nënshtrohet një cenzure që nuk lejon të shkruhen gjërat më konkretisht e më shtruar, më me guxim edhe për tema të "ndërlikuara"... Sikur u vihet vërdallë temave me rëndësi, duke thënë në çdo artikull ngapak, por jo në një kryeartikull "troç", me ç'rast duhej të shtrohej teoria e revolucionit për rastin tonë. Pra, kryeartikujt, pos nja dyve, nuk më duken se janë kryeartikuj për Organ të Lëvizjes, si pararojë e popullit në luftë, të cilët do ishin busull që masat të kuptojnë situatën tani dhe si do të zhvillohet në të ardhmen, në mënyrë që të kuptojnë se nuk ka rrugëdalje tjetër pos të jetojmë me situatën, prandaj edhe të dijnë se çdo të thotë dhe si do të duhet të jetojnë me situatën. Në kësi kryeartikujsh, nëse populli sqarohet se cilat rreziqe kombëtare i ka përpara dhe çfarë sakrificash janë të domosdoshme, nuk frikësohet – edhe pse duket sipërfaqësisht – por bëhet i vetëdijshëm se nuk ka shumë alternativa, prandaj i duhet të përgatitet; përgatitja më efektive është pranimi i organizimit sa më të gjerë dhe jo format e mëparme për kryengritje popullore të karakterit lokal, e ndonjë karakteri të ngjashëm, pasi armiku ka bërë përparime të mëdha në të gjitha drejtimet dhe nuk është ai i mëparmi. Kuptohet, këtu duhet patur parasysh edhe ngritjen e vetëdijes ose mashtrimin e popujve që përmbajnë klikat e "tyre", që shtypin popullin tonë.

Për të luajtur rolin e vet Organi ynë, atje ku nuk mund të mbërrijnë militantët e LRSHJ-së, duhet të shkruhet mbi qëndrimin "pritës" në këtë situatë. Ekziston mundësia që pas ngjarjeve aq të mëdha, pas gjithë asaj gjakderdhje, të demoralizohen masat në përmasa serioze, pasi armiku nuk do të pushon të përhap demagogji mashtruese, se "sakrifikuam kot", se "jemi ngritur para kohe", se "armiku është i fortë dhe ne po ngucim grajzin me krande", etj. demagogji të ngjashme. Mu për këtë arsye, për ta mbajtur në nivel, bile edhe për ta rritur moralin e masës, duhet të shkruhet e propagandohet se "pritje" është e domosdoshme, pasi regjimi, pos terrorit që ushtroi menjëherë, duhet të jap

përgjegje, nëse mendon të stabilizon gjendjen sa i përket kërkesave të popullit tonë. Kurse "pritja" nuk duhet të jetë pasive, por aktive; duhet të kuptohet tamam si armëpushimi në front, që me shpejtësi të madhe të përgatitet gjithë populli për sot, pas minutit nga minuti që po kalon, dhe për nesër! Heshtja dhe mosdija çfarë duhet t'i themi popullit në kohë të "pritjes", ul moralin e popullit, rrit demoralizimin, duke i lënë fushë veprimi armikut, rritë pasigurinë, pesimizmin, oportunizmin, anarshizmin... Është e domosdoshme të dimë t'i themi popullit atë që kërkohet nga ne, përndryshe duhet pranuar se nuk jemi në nivel të përgjegjësisë, përkatësisht LRSHJ-a nuk ka asij militantëve që ta ngrisin në nivel të Pararojës, me plot kuptim të fjalës.

Zbërthimi i teorisë së revolucionit për rrethanat tona, është domosdoshmëri, për t'u përgatitur për praktikën! Që të mund të zbërthehet, duhet së pari të njifet. Në rrethanat tona, shumë veta që janë në gjendje ta bëjnë këtë shumë më në nivel se sa po ndodh gjer më tani, ose nuk kanë kuptuar ose nuk janë të thirrur, ose nuk i kanë mundësitë, pasi organizimi nuk është në nivel. Pikërisht për këtë arsye, do të thoja se janë të domosdoshëm ideologët, siç praktikohet të quhen, që do të shtronin teorinë e revolucionit për rastin tonë shumë të ndërlikuar. Them të ndërlikuar, pasi edhe është. Jetojmë në shtet shumëkombësh. Kombet më të mëdha në përmasa relativisht të mëdha, janë të mashtruara nga klikat imperialisto-shoveniste "të tyre", dhe kjo luan rol. Ato klika janë në pushtet, kurse klika "jonë" është klikë marionete, me përjashtime individësh. Sikur, ta zëmë, populli serb të kishte vetëdije më të lartë popullore e sociale dhe të ngritej në demonstrata masovike, derisa të mos bëhej rrezik serioz për sundimin e klikës së "vet", në asnjë mënyrë nuk do të ndodhte gjakderdhje e përmasave, si në rastin tonë. Ose ta marrim një shembull tjetër. Sikur Lenini të mos ishte rus dhe të provonte me një klasë punëtore të ndonjë kombi të robëruar që mund t'i përkiste, me siguri që nuk do të korrte sukseset që ka korrur, jo pse nuk mund të ishte aq i zgjuar, por pse vet përkatësia do të luante rolin e vet; të shkruarit në gjuhë kombëtare të kombit të robëruar, ose do ishte ndaluar fare, ose nuk do kuptohej nga klasa punëtore e popujve tjerë, aq më pak e popullit shtypës, nëse mund të shprehemi kështu. Mu për këtë arsye, më shumë se në ndonjë rast tjetër, duhet përkushtim më i madh që të shtrohet teori që garanton zbatim të suksesshëm në praktikë.

Nuk ka nevojë të thuhet se në këto rrethana militantët e LRSHJ-së, pavarësisht nga përgatitja, nuk do mbërrinë të kenë ndikim në të gjitha anët e atdheut, përkatësisht nuk do të mbërrinë aq shpejt organizimin e radhëve të veta. Atëherë i mbetet Organit të zavendësoi, pjesërisht, këtë pamundësi, që organizimi të bëhet nga vetvetja, së pari duke rritur bindjen se organizimi është i domosdoshëm dhe se duhet të organizohen, edhe nëse nuk janë në lidhje të drejtë për drejtë me LRSHJ, përmes militanteve, pasi në rreth mund që nuk është formuar ende komiteti i rrethit. Kështu shkrimet në ZK duhet të konkretizohen në atë nivel, sa mos të goditet konspiracioni, për të mësuar armiku se si mund t'i kap. Shokët e shoqet në rrethe duhet të kenë kuptuar se duhet të gjejnë organizimin e përshtatshëm, duke marrë me mend se si do t'i organizonte Komiteti i Rrethit. Me kalimin e kohës, hiç të gjatë, në punë do të gjendeshin kontaktet, për t'u "shkrirë" nga grupet në vete, ose nga grupet e celulat e Lëvizjes, të organizuara nga vetvetja, në radhët e LRSHJ. Kështu do t'i pritej rruga anarzhizmit, fraksionizmit dhe aventurierizmit, në përmasa aq të mëdha, sa vështirë që këto të fundit do mund të nxierrnin kokë ndokund, në përmasa që do damtonin çështjen, pse, sado që fillimisht asgjë nuk lind qëllimisht, më vonë sëmuren vetvetiu dhe vështirë që do të shërohen; krijohet thuaja vetvetiu bindja se ky ose ai grup duhet të luan rolin e pararojës, duke mos qenë në gjendje të dinë se revolucioni, cilido qoftë, nuk është shëtitje korze, që mund të përsëritet kur t'i teket ndokujt, mjafton që t'i ketë teshat e mira për të dalë në shetitje. E për t'ua ardhur në ndihmë atyre që organizohen në vete në rrethe deri sa të kenë lidhur kontakte

me radhë të LRSHJ, duhet që taktika të shtrohet në shkrimet e Organit, deri në përmasat sa të mos damtohet praktika e përgjithshme e revolucionit.

Shumë me rëndësi është të shkruhet konkretisht për situatën, për rrethanat, pra, për faktorët objektiv e subjektiv. Lexuesve të ZK, përmes tyre edhe masave më të gjera, duhet t'ju bëhet e qartë se sa seriozisht, në përmasa të mëdha, fitoret janë të kushtëzuara nga gjendja brenda shtetit dhe faktori ndërkombëtar, përkatësisht nga niveli i mashtrimit të popujve nga klikat e "tyre" dhe kundërthëniet në mes popujve dhe brenda popujve – kundërthëniet klasore – si dhe për situatën ndërkombëtare me kundërthëniet e saja dhe pozitën e rolin e regjimit që shtyp popullin tonë në politikën ndërkombëtare. Po të konkretizohemi, atëherë duhet të kemi parasysh kundërthëniet sipërfaqësore demagogjike dhe kundërthëniet e vërteta, sidomos të superfuqive dhe të regjimeve në njërën anë, dhe kundërthënies së proletariatit dhe të popujve me klikat e "tyre", borgjezinë ndërkombëtare e superfuqitë imperialiste, të bllokuara. Praktika na mëson se për reaksionin ndërkombëtar, për blloqet, luftërat kanë rëndësi, për ndarje të sferave të influencës e interesit, për sigurimin e blloqeve, si dhe për të tërhequr vëmendjen e opinionit, duke synuar mashtrimin e popujve dhe frikësimin, që secili popull të gëzohet se ato bëhen diku larg tyre dhe po nuk skllavëruan, mund që do të goditen. Pastaj, historikisht vërtetohet se sa është e aft klika serbomadhe t'i shfrytëzon të gjitha kundërthëniet ndërkombëtare, duke bërë politikë prej kurve që shkon në shtrat të atij që paguan më shumë e që është momentalisht më i fortë... Sikur të arrinim që të bëjë të vetëdishëm masat për gjithë këta faktorë, atëherë nuk do të kishim pasur nevojë se mund ta përdorte ndokush mish për top, duke shndërruar Kosovën tonë në ndonjë Liban, ku luftëra lokale për hesape edhe të të mëdhenjve, do bënte kërdinë. Me popull me vetëdije dhe mirë të informuar, mund të praktikosh taktikën më të suksesshme në shërbim të strategjisë, duke arritur fitore me sakrifica sa më pak që të jetë e mundshme. E kjo është një ndër detyrat kryesore të Pararojës - LRSHJ!

U zgjata ca në mendime të përgjithësuar, duke dashur të kontriboj që skeleti i Organit të LRSHJ të bëhet skelet i një organit, siç i takon roli, kur është Organ i pararojës së një populli. Shoku Xhemë, sigurisht, jo vetëm që mendon, por është duke bërë punën në redaktim të ZK, prandaj, me eksperiencën që po siguron, mund që ka mundësi t'i përkushtohet punës që të redakton një ZK, tamam Organ të LRSHJ, që çdo herë rritë kualitetin – për t'i dalur zot misionit që i është ngarkuar. Po kështu, secili nga shokët, sidomos shokët në atdhe, duhet të bëjnë gjithçka për ta ndihmuar shokun Xhemë, me këshilla, por më shumë me shkrime. Me këtë rast, nuk po harroj veten, se duhet ta qortoj veten, përkatësisht duhet t'i mallokjë paaftësitë e mia; dihet se qe biseduar që vazhdimisht do të duhej të merrem me rubrikë të përhershme, të ashtuquajturën politikë ndërkombëtare. Por ja, me ndihmë e madhe po më duket që shokut Xhemë të mos i marrë kohë për të lexuar artikujt që s'do meritonin të botoheshin, e jashtë lëkure s'u dilka.

Rasti i Enver Hadrit

Shoku Xhemë na shkruan se ka shkruar EH letër "korrekte". Sikur t'i kisha të dyja letrat, kuptohet kopjet, ndoshta do të shkruaja më trupshlirë. Por edhe kësaj radhe nuk po ngurroj të ndalem më afër, tani për tani duke u bazuar në ato që na shkruan shoku Xhemë.

Menjëherë do të them: me të tillë që të gjitha forcat e mendjes e zemrës (duke mos qenë edhe fukara nga to) i kanë shkrirë vetëm kundra interesave të kombit e atdheut (flas për kohën që kur dij se çfarë veprimtarije ka ushtruar), duhet të jemi shumë të matur dhe të përpikt! Ka raste kur tradhtarët, fraksionistët, aventurierët... mund të na imponojnë kompromise (që pas Leninit janë të mundshme, ose kur njëri ka të drejtë, ose kur bëhet

për të evituar një të keqe më të madhe; mendoj se e kam cituar përafërsisht), kur bindemi se ata kanë pas vete shumë veta të mashtruar dhe na duhet taktikë që t'i shpëtojmë të mashtruarit, për t'i luftuar e izoluar me sukses të parët. Por, kur të tillët janë të demaskuar e të izoluar, duke ju falenderuar punës së ulët të tyre dhe mospërfilljes e sqarimit të masave, nga ana jonë, atëherë nuk ka nevojë të ipet asnjë shansë për të filluar nga fillimi, me taktikë më perfide, në punën e fëlliqur minuese e antikombëtare!

Mjafton të them kësaj radhe se ka qenë njeriu më i dëmshëm dhe marifetxhiu më i madh, që pa mëdyshje, gjithë veprimtaria e tij ka quar uj në mullijtë e armiqve të popullit; i ka zënë aq mirë presat, sa asnjë pikë nuk i ka shpëtuar në mullirin e popullit. Sikur t'i bënim analizë propagandës së gjithmbarshme, sidomos intervjuve që u ka dhënë gazetave e televizionit belg, ndoshta edhe atij francez, mashtrimeve për të plaçkitur të holla, provave që ta kompromet oj demonstratën që bëmë në Bruksel, e të tjera, që ka shumë për të, atëherë nuk do të duhej të nxitohej t'i kthente përgjigje korrekte shoku Xhemë, pasi e gjithë veprimtaria, se jo vetëm se ka qenë armiqësore, por më efektivja për interesa të dollancëve me shokë, pasi në të njejtat ditë bëheshin intervjutë e të dyve, për t'i shërbyer e EH konferencës për shtyp të Dollancit!

Sikur qemë gëzuar që me të tillë nuk kemi punë, pasi na ishin në gjendje të bënin atë që ua kishin ngarkuar padronët! Por, ja, nuk "avullokan" të tillët kollaj-kollaj...

Pse jo, mund të përmirësohet secili që me vetëdije të ulët bënë gabime, mund edhe të mëdha, duke u bindur se ka qenë në rrugë të gabuar, kundër interesave të çështjes kombëtare. Këtë rol duhet ta luan LRSHJ; që t'i ndihmon të gabuarit. Në këtë rast jam shumë skeptik – vështirë që një kuadër i ati "kalibri" është penduar; shumë do të kisha dëshiruar të kem një armik më pak! Ama, duhet që prej të tillit të pritet një metamorfozë aq radikale!?! Nuk besoj se është e mundur, vetëm nëse ka vendosur nga koka të ngulet në këmbë, por për të na bindur do të duheshin prova të tjera më serioze se sa një letër "korrekte". Për këtë arsye, jam i mendimit, pa patur nevojë të humbim kohë për ta bindur njëri-tjetrin, të presim të jap prova të tjera më serioze, që gjithashtu nuk duhet të na detyrojnë që ta përqafojmë aq shpejt; për veprimtari të mbarë kombëtare a fushë të gjerë, që s'e ka monopolizuar LRSHJ. Ai mund të kontribuon, por nuk kemi nevojë t'i japim shansën që pas një kohe të kompromiton, përkatësisht të provon kompromitimin e LRSHJ. E provat më bindëse do të ishin, së pari t'i demanton të gjitha intervjutë në ato mjete të informimit ku i ka dhënë, pastaj të shkruan një autokritikë aq të rrept, sa në mënyrë të shtruar ta dënon veprimtarinë e vet, duke u detaluar në detale më kryesore. Kjo nuk do t'ia ulte vlerën – që se ka, por përkundrazi, do ia jepte shansën ta rritë vlerën nga vlera e nën zeros. Autokritika do të duhej të botohej në ZK, për t'ju treguar të përafërmve se ka mundësi përmirësimi dhe se populli prap pranon në gjirin e tij shpirtshitur, që pendohen që në temel!

Kësaj radhe do të shfrytëzoja rastin që në emër të Redaksisë të mos korrespondohet me tradhtarë, fashistë e zogistë, edhe atëherë kur ata mund të shkruajnë letra "korrekte", për qëllime të caktuara - armiqësore! Disa herë e kam thënë gojarisht, ndoshta kështu do na bëjë të mendojmë më shtruar nëse kam të drejtë. Lufta më e mirë kundër armiqëve e kriminelëve të popullit, agjentëve të shërbimeve të huaja, nëse nuk aplikohet demaskimi, atëherë është mospërfillja. Me ta nuk kemi nevojë të mirremi, pasi assesi nuk do të mundnim t'i neutralizonim; për atë punë janë të regjur e stërregjur, e as t'ua mbushim mendjen që me plotë kuptim të fjalës të mbështesin popullin tonë. Vetëm hjekësive dhe asgjë më shumë nuk duhet pritur nga ta, prandaj pse kemi nevojë t'ua japim as shansën më të vogël për të na hjekësuar. Do të thoja, gjithashtu, se shoku Xhemë përpara do duhej të konsultohej, pa u bërë merak se mund të shkojnë edhe 10 ditë pa u përgjegjur, pasi edhe vonimi në vete është provë për të parë sinqeritetin e tyre; kur nuk e

kanë me gjithë mend shkruajnë rishtaz dhe shajnë e kërcënojnë. Prandaj, për këtë përgjigje, do të thosha se është e nxituar, kurse në raste tjera të jemi ca më të diciplinuar!

Prapashtica...

Shoku Xhemë, duket se sa i përket Prapashticës me shokë, ngadal do bëhet aferë. Në rastin e tyre "shtruam e mbuluam" dhe duket prap mbërdhihemi, pasi mbuloja duket se qe vetëm një quhall i holl, i qkyer...

Të mendojmë ca me përgjegjësi dhe ndoshta mos jemi duke treguar oportunizëm të pa tolerueshëm, ose, përfundimisht duhet të vendosim që secili të ecë në rrugën e tij, ata me "Lëvizjen..." e tyre, kurse ne me tonën, duke sqaruar lexuesit për të gjitha. Sikur po më duket se dëshirojmë të bëjmë politike arriviste, duke dashur që LRSHJ, në vend të pararojës, të bëjë manovrime politike me dreqin e të birin, vetëm që të jetë kulmi i të gjithave, edhe i plehrave (mos qoftë thënë nga goja ime!). Lëvizja do të jetë pararojë vetëm nëse bënë politikë parimore! Kjo gjendje po më mundon dhe do të propozoja që njëherë e bindur të marrim qëndrime, që do t'u përmbahemi. Por përpara duhet të bëhen të gjitha provat që të mos u mbesim borxh në asnjë mënyrë, pasi ata, rreth e rrotull po ankohen se nga ana jonë nuk po pranojmë të bisedojmë.

Disa raste tjera

Kohëve të fundit jemi dëshmitarë të faktit se disa rrugaçë e aventurier kanë dalur hapur e më me guxim, "në emër të Lëvizjes" luftojnë Lëvizjen. Për secilin rast do të ndalemi veç e veç, përndryshe, kur të vijë deri atje sa qentë të na e hajnë shkopin nga dora, atëherë na mbetet të hahemi me qenë... Mu për këtë, do të duhej sidomos lidhur me Xhavitin të mendojmë përfundimisht, pse ai është katalizatori i disave që janë zgjidh nga zingjirët dhe gjithashtu, marrëveshja që qe arritur, është shkelë; ne duhet t'ju përmbahemi vendimeve, përndryshe do vojtemi si gra të këqija! Kësaj radhe po dërgoj një material për një shtojcë vetëm për ZK që shpërndahen jashtë. Propozoj që të diskutohet, nëse aprovohet botimi, të redaktohet edhe më përshtatshëm. Sikur të mos ndërmerret diç e kësaj natyre në këtë drejtim, do bëhemi si defi i magjupes, siç praktikohet të thuhet prej nesh.

Propozoj gjithashtu që shoku Salih të tregon se si ka shkuar Mbledhja në Bielefeld, ku është treguar oportunizëm më i ulët se në rastet tjera; aty Ganiu i ka përsëritur ato që ka thënë diku tjetër, duke mos folur së paku që t'ju jepet të kuptojnë të pranishmëve se ato që ai, Ganiu i ka thënë, nuk janë mendime që aprovon LRSHJ.

Në Bremen para dy ditëve është mbajtur mbledhje e 45 bashkatdhetarëve, bashkë me vicekonzullin e Hamburgut; sa qartë që është parë puna e Xhavitit, kurse ai farë plaku, që Xhaviti e kishte marrë me vete në seminar, ka apeluar te "vëllau" Gazmend (vicekonzulli), që të rregullohen ligje për të mos mbajtur deviza në bankat e Perëndimit, por të dërgohen të gjitha menjëherë për ta ndihmuar Jugosllavinë të dalë nga kriza... Nëse me të tillë mendohet të shkojmë përpara, duke i bërë leva të LRSHJ, atëherë s'di ç'të them tjetër, pos: vaj halli...!

Këtu do të shfrytëzoja rastin të them se "heshtja" e shokut Salih nuk është shoqërore; nuk tolerohet që gjitha këtyre letrave që shkruhen, shumë ka edhe vërejtje e kritika ndaj shokut Salih, t'ju përgjigjet me mospërfillje...! Unë do të vazhdoj të shkruaj, edhe pse nuk praktikohet askund, në asnjë relacion, që disa letrave të mos ju përgjigje fare, në pritje se shoku Salih do të tregon arsyen pse nuk shkruan.

Lidhur me makinat

Gojarisht pata rastin të bisedoj me shokun Salih, të cilin e bëra me dije me mundësitë që ekzistojnë. Ai m'u përgjegj se qenka në rregull dhe duhet të ndërmirret fushatë. Kurse unë, pasi dha ai atë propozim, desha të vazhdoj ca edhe lidhur me çështjen materiale, nga e cila janë të varura shumë aktivitete e suksese.

Së pari, kur na duket e arsyeshme ta bëjmë një punë, që varet kryesisht nga mjetet materiale atëherë nuk duhet të varet nga fushata që do organizohet; mjetet duhet të jenë në dispozicion dhe në bazë të tyre të planifikohet, kurse fushatat duhet të organizohen kohë pas kohe, që të gjenden mjetet për sahat të lik. Në kuadër të kësaj, do të duhej të shkruhej një artikull në ZK lidhur me ndihmat e gjertanishme dhe mbi ndihmat e domosdoshme për të ardhmen, duke u ndalur më gjatë mbi domosdoshmërinë e solidaritetit vëllazërorë, brenda dhe jashtë, si kusht për të ngritur moralin, për t'i forcuar familjet e të vrarëve dhe të burgosurve, për të financuar propagandën dhe aktivitetet e domosdoshme, në interes të çështjes.

Konkretisht sa u përket makinave. Format A3 të vogël në madhësinë që ka menduar shoku Xhemë, bile që kam shkruar edhe unë nga Veriu (duke mos mundur të mirrem vesh), nuk ka. Vetëm A4, duke rregulluar që disa pjesë të copëtohen. Formati A3 është përafërsisht 150/70/110 cm (gjatësi, gjerësi, lartësi). Është diku rreth 250 kg. Edhe për përjashta, duhet të blehet në shtetin që do të përdoret. A4 e re, rreth 15 000 DM. A3 gjithashtu e re, 25 000 deri në 30 000 DM, por varësisht nga prodhimi (firma), të gjitha teknikë Offset. Disa shokë ekspertë këshillojnë që të blehen pak të bajtura, kështu që A3, funksionale për disa vjet pa patur nevojë për ndonjë riparim serioz, mund të sigurohet me 12 000 deri 15 000 DM, kurse A4, gjithashtu pak të bajtur, më 5 000 deri në 7 000 DM. Varet nga rasti e fati dhe aftësia prej matrapazi, por ka shokë të sprovuar. Nëse formohet organizatë dhe lajmërohet zyrtarisht në gjyq, për nevoja të organizatës mund të hapet shtypshkronja, pa patur nevojë të regjistrohet që të paguhet tatim. Mjete për t'i përgatitur pllakat, duke llogaritur në kamerë të përdorur, kushtojnë diku rreth 5 000 DM. Kurse çdo pllakë, me të gjitha shpenzimet, gati kushton 10 DM. Letra në asnjë shtet nuk kushton më lirë se sa në RFGJ.

Mendoni seriozisht që të mos ketë nevojë të bredh kot shitoreve e qyteteve, pasi edhe materialisht qëndroj fare keq. Jeta, gjithashtu, në asnjë shtet nuk është më lirë se në RFGJ, kam parasysh shpenzimet postale, çmimet e dërgesave, të telefonit, etj., si dhe gjërat e konzumit të përgjithshëm. Por, RFGJ ka qeverinë më të poshtër, tani për tani, ndërsa aktivitetet dhe politizimi i masave askund nuk është më i madh se në RFGJ. Besoj që janë këto disa të dhëna që ndihmojnë në marrje të çfarëdo qëndrimi.

Pranoni përshëndetjet revolucionare e vëllazërore nga
Iljazi (Ibrahim Kelmendi)

PS. Bashkë me letrën po ua dërgoj materialin për një artikull për t'i fshikulluar ata që e meritojnë.

Artikullin nuk mbërrina ta përfundoj ende.

27. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, 3 janar 1984

PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!

Konstanz, më 3 janar 1984

Shumë i dashuri shoku Fahredin,

jam mirë. Ti dhe familja qofshin mirë. Ndoshta të erdhi ca keq kur m'i vuan prangat, por s'kemi ç't'bëjmë; Derisa jemi të detyruar të bredhim rrugëve të botës, kështu e ka. Kryesorja është se unë jam fare i pafajshëm dhe si i tillë, besoj, së shpejti do të dal, nëse ende sundojnë ligjet e vendit dhe jo dëshirat e ministrit të Punëve të Brendshme, Z. Zimmermanit.

Gjer më tani jam i gjykuar të më dërgojnë në Jugosllavi. Unë jam ankuar, kurse edhe avokati ka bërë të veten. Shumë më mirë do të ishte sikur të gjeje që në fillim avokat të mirë në qytet, këtu. Por të shohim si do të ndodhë. Gjasat nuk janë fortë të mira, pasi po shihet ku po shkon Gjermania...

Sido të ndodh, të mërzitemi nuk kemi pse, pasi kështu do gëzohen ata të regjimit.

Më mirë do të ishte ta festonim Vitin e Ri 1984 së bashku....

Të përqafon Shoku

PS. Nuk ka nevojë të mësojnë mbi arrestimin tim edhe të tjerë bashkatdhetarë, pasi kjo është gjë e vogël dhe kalimtare.

Të mira dhe sukses në këtë Vit!

Mirupafshim

Harrova të the: Sikur t'i kishe telefonua shokut këtu (Hasim Mjakut-shën i Xh. D.) që të m'i blen ca ndërresa, një peshkir dhe vegla për rroj. (Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin)

28. Qarkore e shkruar nga Ibrahim Kelmendi, x. Janar 1984

(Shokëve të QE – për diskutim, përmirësim e aprovim)
QARKORE

Po afrohet 2-Vjetori i formimit të LRSHJ-së dhe ende nuk kemi Program Politik e Statut të Organizatës sonë. Mungesa e tyre po vështirëson veprimtarinë, njëherit po kushtëzohen gabimet. Fajin për mungesë të tyre duhet ndarë të gjithë, nga baza e gjer në Komitet Qendror. Lehtësim kemi vetëm kur marrim parasysh rrethanat, të kushtëzuara nga ilegaliteti i thellë, nga vrasje e arrestimet, si dhe nga vështirësitë që sjell me vete Bashkimi.

Tani, të gjitha komitetet e celulat në rrethe, si dhe të gjithë militantët e LRSHJ-së, duhet të fillojnë nga diskutimet – të japin propozime e mendime, nga do dali përfundimisht Programi e Statuti i Lëvizjes. Themelet e Programit duhet të jenë Komunikata mbi Bashkimin (lëshuar në "Zëri i Kosovës", nr. 1, 1982), si dhe kërkesa e mirëfillta të mbarë popullit, të vulosura me gjak e sakrifica dhe të njohura tani për mbarë botën. Në ndihmë duhet marrë edhe variantin e kontureve të Programit (të botuara në ZK, nr. , 1983).

Diskutimet le të fillojnë menjëherë, për të mos i vonuar rezultatet.

Gjatë diskutimeve duhet të mbizotëron fryma patriotiko-revolucionare, duhet të merren parasysh të gjithë faktorët, nga të cilët varet shumë se çka do kërkojmë, si do kërkojmë dhe si do fitojmë. Fryma e vëllazërimit me popujt liridashës të Jugosllavisë e të

botës nuk guzon të vihet në dyshim – populli ynë liridashës ka dashur e çmuar të gjithë popujt liridashës të botës, kurdoherë, duke ua dëshiruar lirinë...

Është momenti të tregohet pjekuria e menquria patriotiko-revolucionare, vetëdija ideologjike e politike, si dhe historike, shpirti i internacionalizmit, i durimit revolucionar dhe sakrificës, edhe të jetës, kur e kërkon çështja e popullit e atdheut – liria dhe të drejtat. Nuk guzojnë të na i errin sytë shovenizmi, revanshizmi – këto duhet luftuar, së pari në radhët tona, në gjirin e popullit tonë!

Të tregohemi bijë e bija të popullit, t'i dalim zot misionit e çështjes, ashtu siç kërkohet nga populli e historia!

Komitetet, celulat e militantët e LRSHJ-së në botën e jashtme, pos diskutimeve, le të fillojnë nga fushata për grumbullimin e të gjitha adresave të bashkatdhetarëve në botën e jashtme, të anëtarëve të familjes, të fëmijëve në shkolla dhe jashtë, çfarë statusi (punëtor i "përkohshëm", i migruar në Turqi e gjetiu, azilant, etj.). Këto adresa, po që se grumbullohen me sukses e shpejt, pos tjerash ndihmojnë për të dhëna statistikore, meqë armiku po fsheh të dhënat e vërteta.

Detyrë e përhershme është që të zgjerojmë, kordinojmë e forcojmë radhët e LRSHJ-së, për t'i dalur zot me sukses misionit!

Rezultatet e diskutimeve duhet të jenë dhënë më së voni gjer në fund të shkurtit, 1984. Kurse fushata për grumbullimin e adresave duhet të vazhdoj çdo herë.

– PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!
–LAVDI TË RËNËVE PËR LIRI E TË DREJTA TË POPULLIT E ATDHEUT!
–RROFSHIN POPUJT LIRIDASHËS TË MBARË BOTËS!
–RROFTË LËVIZJA PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!

Më x Janar 1984 Komiteti Qendror i LRSHJ-së
(Ibrahim Kelmendi)

29. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, (rreth mesit) janar 1984

I dashur shok, (Faridin Tafallari) (rreth mesit të janarit 1984)

pata menduar se do të vij andej dhe kështu do ua jap në dorë letrat. Por, jo vetëm s'mu bë puna të vij, por as nuk mu dha rasti të takoj ndonjë bashkatdhetarët që t'i sjell në dorë, kështu që jam i detyruar t'i postoj.

Në ndërkohë, ke mundur të dëgjosh mbi vrasjen e dy shokëve (Rexhep Malës e Nuhi Berishës - shën i Xh. D.). Meqë ndodhi kjo, do kisha dëshiruar të mos kisha shkruar këto letra në këtë mënyrë, por para se ta marrë veshë, veç i kisha lëshuar në postë për Plakun e shokun Xhemë.

Mirupafshim (Ibrahim Kelmendi)

PS. Po të mundoj që t'ia përcjellësh Salihut. Sikur të siguronte një adresë, ku do t'ia postoja.

30. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive (QE), 11 janar 1984

PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!
Në mërgim..., më 11 janar 1984

Të dashur shokë të QE

u bë kohë e gjatë, që kur nuk kam marrë letra nga asnjëri. Pakuptimisht, se si u ndërpre shkëmbimi i letrave. Po jo pse nuk kishim çka të shkruajmë. Më parë pse këtë

formë të shkëmbimit të mendimeve dhe të konsultimeve e marrëveshjeve nuk e përvetësuem, për ta vazhduar në nivel. Ka mbetur të shpresohet se ndoshta në të ardhmen nuk do përsëritet praktika e mëparme. Them ka mbetur të shpresojmë, meqe nuk e kemi ndërmend njëherë e mirë t'ju përmbahemi vendimeve që marrim, pa patur nevojë të shkruaj se që kemi gajle për lëshime të vogla, që qojnë shumë shpejt drejt lëshimeve të mëdha.

Si zakonisht, duhet bërë me dije se kam marrë letër nga shoku Salih, të cilës do t'i përgjigjem shumë shkurt, para se të ndalem së shkruari mbi çka kisha ndërmend.

Do të thoja letra është përshkrim sipërfaqësor i aktiviteteve tona në të kaluarën, sikur të mos i dinim të tjerët. Mendoj se në këto rrethana të shkruhet kështu, ka mundësi të dekonspirohemi, nëse kemi çka të dekonspirojmë. Pra, nuk kam gjë kundër historikut të tillë, po më shumë frikësohem se mos ndonjërit një këso letër mund "t'i hup", ose t'i shpëton ndonjë lëshim tjetër, për t'u dekonspiruar pa nevojë, pasi një pjesë bukur e gjërë e historikut edhe nuk i ka hyrë në punë.

Se kjo letër i dërgohet edhe një shoku, me emër Aliu, nuk e kuptoj. Për mendimin tim, përderisa shoku në fjalë nuk është në QE, nuk duhet të marrë të tillë letër. Pastaj, që të veprohet kështu, së pari duhet lypur pëlqimi i të gjithë shokëve të QE. Përfundimisht, për çfarë i lypset atij kjo letër, këtë duhet të na e sqaroj shoku Salih. Nuk besoj t'i jetë dashur doemos për ndonjë aktivitet.

Se si është zhvilluar takimi i parë, atëherë kur formonim QE në Evropën P., më së miri mund ta dimë nga procesi, nëse është mbajtur fare. Por u pa qartë se vështirë që do të mirëkuptoheshim, për ta quar punën përpara. Meqë shoku Salih përmend shkarazi "diskutimet që nuk u lidhej koka", duke vërtetuar këtë me rastin e Brukselit, atëherë do të duhej të thotë diç më shumë, po të ketë patur qëllim të sqarohet ndogjë, e jo vetëm për të radhitur shembuj, që të shtrohet tereni. Sa për Milaimin, ngjashëm ka vepruar edhe në rrethin e veriut, për mendimin tim, duke u vuar në shërbim të Xhavitit. Për raste të ngjashme, për mendimin tim, me shumë mban përgjegjësi ai që ia ka dhënë shansat Milaimit të hazdiset në atë nivel, se sa edhe vet Naimi, të cilin s'ke si ta marrësh në përgjegjësi (përderisa të mos jetë fare militant i radhëve të LRSHJ, siç e thotë ai). Kështu, në këtë rast, shokët Ujkan dhe Plak mbajnë përgjegjësi për mundësitë që atij ju dhanë për ta begenis vetë dhe pastaj të derdelis. Por, nuk dij mos janë dy qëndrime, nëse Naimi vihet në shërbim të Xhavitit dhe shoku Salih tregon indifirenca të atyre përmasave; përderisa Milaimi është sjellur keq në rrethin e Shtutgartit dhe ajo nuk i ka pëlqyer shokut Salih, se e akceptonte veprimtarinë e Xhavitit, i cili në fushatën e tij "demaskuese" kundër "klikës K." e kishte për ushtar Milaimin. Duket se edhe nuk ka nevojë për shpjegime, pasi shumëçka është e vetëkuptueshme.

Sa i përket rastit të Dys., mendoj se nuk kemi nevojë prapë t'i rikthehemi. Nëse po, atëherë nuk ka nevojë të shkruhet shkarazi me nënkuptime, por të shprehen mendime të plota e të shtruara. Nuk është praktikë e mirë të përmend diç si rastësisht, – sa për ta larë veten, – dhe të kalohet, duke lënë përshtypjen se po qe nevoja, më përkatësisht, "nëse për këtë do të jem i detyruar", kam për të thënë shumë më shumë, sikur ata që u tha nuk është asgjë në krahasim me atë që do të thuhet po u "detyru". Bile, edhe për këtë rast, kopja e letrës që i është dërguar shokut Mërgim, u dashka dërguar vetëm shokut Ujkan, kurse ne të tjerët të ecim si Muqa pas dahive. E sa për dorëheqje, në raste të tilla, duhet të kuptohet më parë si shantazhe në relacionin tonë këndej, kurse andej në Turqi të krijohet atmosferë e tillë, sikur ja çka më bëjnë këndej, sa nuk kam ç'të bëjë tjetër pos të tërhjekem...

Nuk jam i mendimit se takimet doemos duhet të kenë njolla të zeza, siç na shkruan shoku Salih. Kurse njolla e zezë e takimit në fjalë është vetëm hilja që na i qenka kurdisur

shokut Salih, duke e shprehur edhe në këtë rast me metaforë e alegori të panevojshme. Unë nuk e dij "kush e ka shkaktuar dhe në drejtim të kujt është munduar ta lëshoj."

Për demaskimin e fraksionit, unë nuk do të thoja se është bërë me sukses, nëse duam të mendojmë për më larg se sa na arrijnë duartë e këmbët. Demaskim i suksesshëm do të bëhej vetëm kur të shkruhej në ZK, se së paku duhet njoftuar lexuesit se cilat marrëveshje nuk qenë arritur atëherë, me rastin e bisedimeve për bashkimin e organizatave. Po kështu edhe rasti i kthimit të Milaimit nga Sh., tani dihet se sa kemi qenë së bashku dhe se nuk është vepruar si duhet. Kur them këtë, mendoj se nuk janë bërë të gjitha provat që diç e tillë të evitohet pa dalur në masë, kurse në cilat relacione gjatë asaj kohe kanë qëndruar Milaimi e Xhaviti dhe ku ia kanë dhënë herë-herë edhe më larg me "demaskimet" e tija Xhaviti, dihet. Përkundra të gjithave, Xhavitin e kemi "të shenjtë" dhe të tilla gabime duhet të kapërcehen gjithsesi, më shumë për arsye se ai ende është duke m'u dashur... Mund që në këtë qëndrim nuk ka menduar shtruar shoku Salih, për të ardhur në përfundimin se motorit të Milaimit gas i ka dhënë Xhaviti.

Sa i përket mbledhjes së parë të Bashkësisë së klubeve e shoqatave shqiptare në Ev. P., unë do të kërkoja procesverbalin, ose që ai të fotokopjohet, për të parë se si ka shkuar mbledhja. Kulmi i mosrespektimit të mendimeve të mia lidhur me Xhavitin arrihet aty; unë sa herë kam qenë kundër zgjedhjes së tij në ndonjë forum me përgjegjësi, duke qenë i bindur se nuk është i përshtatshëm, prap se prap me inscenim të shokut Salih i zgjedhet në Bashkësi, më duket si kështilltar për klubet e Veriut. Meqë nuk kam qenë i pranishëm, për të shkruar edhe më konkretisht, do të duhej o procesi, o referimi i shokut Fahri. Bile, meqë jemi këtu, nuk do të ishte keq të informohemi se çfarë perspektive dhe si i ka punët Bashkësia.

Pak romantizëm i panevojshëm, me rastin e evokimeve të kujtimeve "për grupet e tyre", me rastin e ardhjes dhe qëndrim të përbashkët me shokun Mërgim. Aman, siç shprehen fetarët, a nuk jam duke marrë unë vesh fare, apo janë në pyetje tregimi i përrallave. Së pari a është e domosdoshme të evokohen kujtime të tilla. Mendoj se në atë relacion nuk është koha për të bërë evokime, që në këtë rast jipet mundësia të kuptohet se janë arritur fitoret për të cilat luftohej dhe është koha e evokimeve. Është koha kur duhet të kuptojmë nga teoria, se në situata të tilla nuk duhet të evokohen kujtime të tilla as në mes të shokëve, meqë mund të merren me mend edhe pasojat. Meqë kanë qenë "grupet e tyre", po vetëkuptohet se shoku Salih nuk ka marrë pjesë, atëherë pse lejon që shoku Mërgim t'ia evokoj ato mendime, përderisa ai nuk është i vetëdishëm se gabon – then konspiracionin, si rrjedhim i dëshirës për të treguar për të kaluarën e tij, që tërthorazi të ushtrohet ndikim te ai që dëgjon, ose edhe për ta freskuar frymën e grupazheve, që, kur të propozoj paritetin më vonë, të aprovohet pa vështirësi. Pastaj, sa jo praktike po tingëllon shprehja "për grupet e tyre në Kosovë", "për pikëpamjet e njejta dhe të ndryshme", sikur shoku Salih të mos militonte në të njejtat radhë...

"Situata vjen deri aty sa Mërgimi merr guximin (nënv. nga unë) dhe e quan U. spiun të UDB-së në shtëpi të vet." Së pari shprehja "merr guximin", më duket se nuk është përdorur me vend në kontekst të mendimit që ka dashur ta shpreh shoku Salih. Përndryshe, kështu si është përdorur shprehja, më shumë ka karakter pozitiv, ndërsa për mendimin tim, në vend të kësaj shprehje është dashur të përdoret shprehja "në budallak", ose diç të ngjashme, përderisa shoku Salih është i bindur se shoku Ujkan nuk është spiun i UDB-së. Pastaj, pasi është shkruar letra në kohën kur nuk kemi mundur të takohemi, më aktualja dhe më kontestuesja ka qenë pikërisht që kësaj radhe të ipen mendime konkrete lidhur me ato që na ndodhën në këtë relacion. Por shoku Salih e sheh të arsyeshme të na shkruan "nuk po zgjatem më tepër, se nuk i takon kësaj letre të merret me përmbajtjen e asaj mbrëmjeje."

Po vazhdoj me radhë, duke dëshiruar që shoku Salih të mos hidhërohet pse po i përgjigjem kështu kësaj letra (ku fitohet përshtypja sikur jam duke korigjuar hartim të nxënësit). Sa lëshimet i ka fjalia në vazhdim. Së pari, akuza e shokut Mërgim ishte se shoku Ujkan është spiun i UDB-së, kurse si shkruan shoku Salih, "se a është U. spiun i UDB-së apo jo", është dyshim. "... duke i quajtur thëniet e tija të pamjaftueshme për akuzë të një shkalle të tillë...", më duket se kësaj radhe shoku Salih ka dashur të shkruan, ose është dashur të shkruan "... duke vlerësuar provat e tij të pamjaftueshme dhe jobindëse për akuzë të një shkalle të tillë..." Për ta zbutur budallëkun e shokut Mërgim fjalia vazhdohet me vlerësimin që QE bëri rreth shkrimeve në ZK. Mund që shoku Salih nuk ka vazhduar të shkruaj ashtu me qëllim, ama kuptimi i formulimit na del i tillë, sikur të thuash e zbuta tërësisht me ngjyrë të zezë, por meqë e stërpika me ca pikë të bardha, është lara-lara. Do të thotë shkrimi në letër vetëm në njërin drejtim shkoi gjer në fund dhe u muar me atë që nuk e kishte ndërmend të merrej letra në fjalë.

Po përse provohet të manipulohet mungesa e Plakut në takimin e komisionit më 18 dhjetor 1984 (duhet të jetë 1983 shën. i red.), nuk po marrë vesh. Ne nuk kishim mundësi të shkonim ke Plaku, kurse Plaku nuk mundte të dali këndej. Çdo gjë e qartë. Atëherë pse kemi nevojë të nxjerrim spica. Me këtë rast nuk e kam të qartë se a i ka rënë procesverbali në dorë Aliut, për të patur nevojë shoku Ujkan t'i thotë se "nuk ka qenë një shok i tij të cilin nuk e kanë njoftuar, duke shtuar në fund, se edhe pse ai nuk ka marrë pjesë, nuk ka dert". Të shohim çfarë do shkruan shoku Ujkan, ama pyetjes se i ka rënë në dorë Aliut procesverbali duhet të përgjigjen shokët Fahri e Ujkan. Nuk po kuptoj pse duhet të ngjajnë gjëra të tilla në këtë relacion. Aliu nuk do të duhej të futet në "lojë" nga asnjëra anë, as për të marrë këtë letër, siç shkrova në fillim, por as për t'u biseduar në tel. diç e tillë, përderisa ai nuk është anëtar i QE.

Në vazhdim kemi të bëjmë me një paqartësi të re (sido që të formulohet, ne vet, tani për tani, kuptojmë se çfarë është dëshiruar të shprehet, ama sikur të lexohen nga dikush që nuk është në korent me ngjarjet, vështirë që do kuptohet se çfarë është dëshiruar të thuhet.). Sikur shoku Salih flet për tubim që nuk ka marrë pjesë, por vetëm është varur nga leximi i procesit, që nuk e ka lexuar, shkaku i lodhjes. Pos që do të duhej të dihen vendimet e vlerësimet, meqë ka qenë i pranishëm, procesi gjatë të mbajtur, por edhe në fund është lexuar.

Sa për dështimin e tubimit të planifikuar, përderisa nuk ekziston vullneti për t'u takuar dhe përderisa të mos organizohet udhëtimi, meqë i dimë vështirësitë me të cilat ballafaqohemi, – pa patur nevojë të gjitha këto të bëhen para vendkalimit kufitar, "her po dal e herë s'po dal", – sigurisht që pezullohet takimi.

Për bisedën tel. të 29 dhjetorit dhe për përmbajtjen përkatëse nuk po shkruaj. Po më duket e arsyeshme të pres përgjegjen nga shoku Ujkan. Më gjatë më duket e arsyeshme të ndalem mbi "krizën", mbi të cilën na shkruan shoku Sali, në vija të përgjithshme. Shoku Salih na shkruan: "Nëse puna patjetër shtrohet ose-ose (nënv. nga unë) atëherë unë nuk jam aq naiv sa ta kuptoj se ajo ka të bëjë vetëm me një person apo dy, me një fjalë, ajo do të përfshij një rreth të gjerë dhe me këtë do të përfundoj një epokë në luftën e Kosovës dhe do të filloj një e re. Në këtë rast nuk do të triumfojnë parimet por fryma e rrethit." Së pari, në një përfundim vihet ose kur bëhen mbivlerësime të personave, ose kur të jetë punuar në atë drejtim, që kur të vij "fundi" të mund të ndodh diç e tillë, ose edhe kur injorohet baza. Kjo e fundit mund të jetë e vërtetë vetëm atëherë kur anëtarët e LRSHJ-së të ishin aq naiv, sa të shkonin pas personave dhe jo pas çështjes – pas LRSHJ-së. Sa për supervlerësime individuale, kjo kaherë është e pranishme. Kurse për t'i dalur i

vërtetë një kësi vlerësimi, mos shoku Salih ka keqpërdorur besimin për të përshtatur formën organizative, që të jetë e mundshme diç e tillë.

Nëse nuk është mbivlerësim i "ose-ose", duke lidhur të ardhmen e LRSHJ për persona, nuk dij çfarë hilesh janë duke u fshehur, përkatësisht se çfarë punëve minuese janë bërë gjer tani, në mënyrë që të shkatërrohet LRSHJ-a. Hajde more, të shkohet aq larg, sa të thuhet se tre persona, qoftë edhe garat e tyre, po kushtëzokan të "përfundon një epokë në luftën e Kosovës, për të filluar një e re"! Besa po më çudit! Kurse sa për shprehjen epokë, më duket se është përdorur rastësisht, pasi nuk i përshtatet kontekstit të fjalisë e as etapizmit të historisë së sotme. Përgjegje ime përkatëse e këtij vlerësimi, përkatësisht këtij parashikimi, do të ishte: ata që do provojnë të përçajnë LRSHJ, jo vetëm që nuk do të kushtëzonin fundin e fillimin e epokave, por të flaken jashtë LRSHJ-së si shkelës të vendimeve për Bashkim, do demaskohen, çka jam fare i besueshëm se vetëm ndonjë anëtar që ka lejuar të dresohet dhe jo të jetë militant i vërtetë i LRSHJ-së, do t'i shkoj mbrapa ndonjë bajraktari për bajrak! Mashtrohet secili nëse mendon se kemi të bëjmë me anëtarë a popull naiv, i cili shkoka çdoherë si dhentë pas ogiqeve! Me këtë rast po dëshiroj nga zemra që ky vlerësim, që na e sjell shoku Salih në letër, të mos ketë kurrfarë bazash, të mos jetë i vërtetë!

Sa për ngjalljen, përkatësisht "ringjalljen e ndonjë fryme sentimentale", besa nuk po kuptoj. Duket se shprehja sentimentale është përdorur pa vend, meqë nuk besoj se shoku Salih mund të jetë për atë, që të kapërcejmë "krizën", për të "ringjall frymë afërsie sentimentale".

Për propozimet që pata bërë më 18 dhjetor do të ndalem, ndoshta më poshtë, ose ndonjëherë tjetër.

Për Organin e LRSHJ-së, "Zëri i Kosovës", besoj që janë dhënë vlerësimet dhe është thënë e gjithë ajo që është dashur të thuhet. Është koha e fundit që të mos mbetemi duke u marrë me thash-e-theme, dua të them me vlerësime e vlerësime, propozime e propozime, vendime e vendime, dhe asgjë të mos ndryshon, asgjë të mos praktikohet ashtu si kërkojnë rregullat e normat, ashtu si bëhen vendimet. Kurse për propozim konkret, s'kam çfarë të them, meqë Aliun unë nuk e njoh fare. Ndërsa sa për formën e punës, që të korigjohen artikujt përmes letrave, më duket e papraktikueshme. Vetëm nëse shoku Ujkan ia arrit të kompleton kolektiv të përshtatshëm për t'i dalur zot punës siç dëshirojmë, mund të presim suksese më të mëdha.

Edhe pse më parë kam shkruar, meqë janë botuar konturat e një variante të Programit, – kokë në vete, – le të organizohet diskutimi në celula, nëse edhe ato kanë propozimet e veta, kritikat dhe ndryshimet, në mënyrë që pjesëmarrja e aprovimit të Programit e Statutit të bëhet nga një rreth, mundësisht, sa më i gjerë. Për këtë arsye do propozoja që përmes Organit të thirren të gjithë militantët e LRSHJ-së për t'i shpreh mendimet, për t'i dhënë propozimet, ose për të formuluar variantet e tyre për Programin e LRSHJ-së. Nuk do më dukej e tepërt që edhe ata që nuk kanë patur mundësinë të jenë militantë të anëtarësuar, por që ndjejnë veten simpatizantë, ta bëjnë të njejtën punë, por kur t'i përcjellin mendimet e tyre, ta bëjnë me dije se janë vetëm simpatizant. Sa u përket celulave, do të duhej të vij në shprehje forma e zgjedhur organizative, për të organizuar diskutimet.

Për organin e ri, sidomos për paritetin që u vendos, kam ndërmend, po më premtoj koha, të shkruaj njëherë tjetër, më gjerësisht, duke përpunuar edhe materialin që kisha ndërmend të lexoj në atë tubim, por që nuk u pa e arsyeshme, kryesisht shkaku i kohës.

Meqë jam duke i shkuar me radhë letrës që po i përgjigjem, sërish po kthehem te Programi. Në takimin që kishim më 18 dhjetor, po dihet se në vitin e kaluar, patëm një mosmarrëveshje me shokun Salih lidhur me diskutimet e tija "durcheinander" (përkthimi

në fjalor gjer. shqip. të Zef Simonit është "rrëmujë", "pshtjellim", kurse mua m'u duk e përshtatshme shprehje, meqë desha t'i vlerësoj bisedime të tilla të pshtjellueshme, kaotike, të ngjashme me figura të artit modern, ta zëmë kur njerëzve ua fusin kokat nënsqetull dhe nuk ua lënë në vend, ose i gjymtojnë...), ku na foli për Programin, përkatësisht për formulimin e Programit nga ana e shokut Mërgim. Nuk dij pse nuk ju duk e arsyeshme të na thotë se ia kanë korigjuar shokët..., kur unë nuk e besoj, ndoshta as vetë shoku Salih nuk e beson, ose më përkatësisht, pse ka nevojë të përsërisim "akrobacione" të tilla me qëllime të caktuara. Dhe përfundimisht, pasi nuk kam nevojë të sjell ato që thoshte, po përsëris çka na shkruan: "Ky (mendohet varianti i Programit, i punuar nga shoku Mërgim, pra i I.K. -shën i red.) që ia kanë korigjuar (më lartë thuhet disa shokë, besoj që po kuptoni se cilët shokë mendohen) për skelet i ka konturet e botuara, me disa ndryshime të vogla, që më duket me shumë të meta dhe aspak i përshtatshëm që të botohet si program politik." Në atë rast, kur shoku Sali bënte këso vlerësimesh, bazuar në projektin që kishte shkruar ai dhe në thënien e tij se si asnjëherë nuk ka lexuar ndonjë program politik të ndonjë organizate, pos një të Partisë, në fakt të Lidhjes "Komunistische Bund Westdeutschlands" (kështu më duket se na ka thënë. Këtu më duhet të shtoj se shoku Salih nuk e njeh gjuhën gjermane për konverzime të thjeshta, e lëre më të kupton përmbajtjen e Programit politik, që ashtu ashtu është i formuluar në gjuhë e stil mjaft të zorshëm për t'i kuptuar ata që nuk e zotërojnë gjuhën), e pash të arsyeshme t'i them se nëse është korigjuar nga ata shokë (unë nuk e kisha patur në dorë ende për ta parë), atëherë nuk e ke hallin të bësh të tilla kritika. Edhe në këtë rast do të them pa ngurrim: mjerë për ne që nuk po ia dimë kaqikun vetes, por gjithsesi ngulim këmbë të shkruajmë a të themi diç, që shpesh është mjaft absurde!

Në përfundim të letrës shoku Salih na shkruan për datat, 17 shkurt apo 15 maj, duke u ndalur prapë te "allashvereshet" e rëndomta që po zhvillohen zakonisht në biseda telefonike. Mendimi i shokut Salih lidhur me këto dy data, se nuk na qenkan për natyrë të tij të dorës së parë, sikur më duket neglizhim i rëndësisë aq parimore. Kurse me data që ende je në to, do të thoja për rastin konkret, nuk ka si të merret historia. Në këtë rast kontestuese është si të shkruhet në Program Politik, përkatësisht cila datë – dhe kjo ka rëndësi të madhe, pasi ndryshimi i datave përcjellet me shkelje të Komunikatës së lëshuar me rastin e Bashkimit. Unë jam për ata, nëse duhet të vendoset ndonjë datë në Program Politik, atëherë të mbetet ashtu si është në Komunikatë.

U gëzova më shumë se ju, se përfundova, jo vetëm nga shprehja e mendimeve në formë përgjegje, por edhe me analiza të tjera përkatëse. Dëshiroj të mos keqkuptohem, ashtu siç do të dëshiroj që të marrë përgjegje të nivelit në letrat e mija, me kritika të të gjitha llojeve, bile edhe të stilit e sintaksore, pasi më ndihmojnë në përvetësimin e zejes së të shkruarit.

Të dashur shokë,

sado që jam në presionin se nuk duhet të ju shkruaj gjatë (meqë më keni kritikuar), po vazhdoj së shkruari, jo pse po dëshiroj, por më shumë pse po më duket e arsyeshme, nëse merrë për bazë gjendjen që na është krijuar, sidomos edhe përgatitjen tonë, përkatësisht mospërgatitjen tonë në nivel, për t'u dalur zot si duhet përgjegjësive, me të cilat jemi ngarkuar, përkatësisht kemi ngarkuar veten.

Se nuk na kanë shkuar punët mbarë, siç kemi dëshiruar ose edhe siç kemi parashikuar, nuk do mend të thuhet. Prova më e mirë është një këso letre që kemi marrë, por më shumë do të thosha se mosmbarvajtja më shumë është kushtëzuar nga gabimet, lëshimet e shkeljet, të cilat në të shumtën e rasteve, nuk kanë qenë fare të domosdoshme, pra, janë fare të paarsyetueshme; po shtoj, për fat të keq, jo vetëm që nuk po mësohet nga gabimet, lëshimet e shkeljet, por po hargjohet energji për t'i mbrojtur e arsyetuar ato.

Që njëherë e mirë të jipen ca vlerësime përfundimtare, së paku unë që të jem në gjendje, do të duheshin informime konkrete të shokëve Mërgim, Ujkan e Salih, si dhe shënimet e letrat përkatëse të shokëve të vrarë, dua të them për bisedimet që patën filluar në frymë fare shoqërore e revolucionare, por që mbaruan keq me rastin e bisedimeve në Turqi. Duhet të pranojmë se fryma e tanishme atje e ka bazën, prandaj, për mendimin tim, shokët në fjalë duhet ta bëjnë atë punë, dhe jo të fjalosen kohë pas kohe, si gratë e këqija, siç përdoret ndonjëherë, kur të ipet rasti, atëherë kur takohemi dhe provohet që njëri tjetrit t'ia zë kokën me marifete e marifete. Për këto që themi tani, nisem kryesisht në ato fjalosjet e gjata në mes shokëve Mërgim e Ujkan. Por më shumë nga fakti, se tërthorazi janë rrëzuar gurë mbi shokun Kadri, përkatësisht ju kanë mbështetur faje e faje për mbarimin e bisedimeve të atëhershme në atë formë, kur më ai nuk është në gjendje të thotë fjalën e vet. E unë, si dëshmitarë i disa takimeve dhe mirëkuptimeve, me bazë në luftën e përbashkët, sidomos në mes shokëve Jusuf e Kadri, dhe në bazë të njohurive mbi aftësitë dhe revolucionaritetin e secilit nga personat, përkatësisht shokëve, dua të them se keqkuptimet që patën lindur, janë më shumë rezultat i paaftësive, i nervave, i fodullëkut, i mosnjohjes së teorisë së revolucionit të shokut Mërgim, i cili ka qenë i ngarkuar për bisedime të atij niveli. Ndoshta pasi të na shkruan shoku Mërgim, kam mundësinë të konkretizohem edhe më shumë, por edhe kësaj radhe, nuk po ngurroj t'i shpreh ca mendime, që më vonë më duhet t'i thelloj, duke shpresuar se shënimet e letrat dhe faktet e tjera, që kanë të bëjnë lidhur me bisedat për bashkim, do na vihen, përkatësisht do më vihen në dispozicion, për këtë rast, kryesisht po bazohem në sjelljet e diskutimet e shokut Mërgim, si dhe në disa punë që ai ka bërë më parë, si, nëse nuk gabohem, ngarkimi i shokut Salih të merret me ato punë që u muar një kohë në Bruksel, pa njohur gjendjen as njerëzit, ose korrespondenca, për të mos thënë edhe anëtarësimi (për këto do na njofton vetë shoku Mërgim), me Musa Hotin, që kur ai ka rënë në burg. Kjo e fundit nuk mund të mbulohet, meqë kam lexuar vetë letër të tillë, bile pjesërisht me dorëshkrim të shokut Mërgim, me gunën e tij (sa për penën, nuk dij shumë, pos për ato që përmenda e që s'më duken në rregull), me natyrën e tij komplete për të biseduar për gjëra me përgjegjësi të madhe, sikur mund të marrë me mend se si kanë mundur të zhvillohen bisedimet mes ati dhe shokut Kadri, ku ka qenë i pranishëm edhe shoku Bardhosh. E përsëris, që t'i konkretizoj mendimet edhe më shumë, pres që të na shkruani, pa patur nevojë të bazohem në bisedat "rafall" në mes shokëve Mërgim e Ujkan, që më shumë i ngjanin natyrës sikur bisedohet në afekt. E potencoj, do ndihmon të sqarohemi njëherë e mirë, pasi gjitha bisedimet e marrëdhëniet e pastajme, sidomos pas vrasjes së kobshme, kanë qenë nën hijen e mosmarrëveshjeve në mes shokëve Mërgim e Kadri, dhe asesi si rrjedhim i keqkuptimeve në mes të shokëve Jusuf e Kadri, pos atyre që prap, kanë mund të kushtëzohen nga ajo bisedë. Jam për atë që të mos ngurrojmë për të vlerësuar bisedimet para vrasjes, mendoj ato për Bashkim, qoftë edhe keqkuptimet e mosmarrëveshjet, ndonjëherë janë përmendur edhe hilet. Kurse për secilin që provon të përvetëson merita se është iniciatori i bisedimeve të pastajme për bashkim, jo vetëm se më duket ligështi e ulët, por më duhet të them se duhet t'i përvetëson edhe hilet prej matrapazi, pasi po shihet se në ato bisedime nuk janë hyrë individët me sinqeritet të pastër – më shumë janë në pyetje "akrobacione" dhe mendjemadhësitë për të bërë kapital personal, me hy në histori...

Sa për organizimin e pastajm, për aq sa jam në korent, më duhet të pranoj, fatkeqësisht, se nuk ka qenë në rregull, përkatësisht as që mund t'i bihej në fije. Për këtë nuk vërtetojnë vetëm pshtjellimet në emërtime, por edhe forma e zgjedhjeve, përkatësisht të formimit të KQ, i cili më shumë është fantazuar. Thënë të drejtën gjer vonë nuk kam dijt se jam anëtar i KQ, e kur kam mësuar më është prishur qejfi, meqë e merrja me mend

se çka mund të bëjë ai KQ, në të cilin jam anëtar unë; thjesht: dëshiroja që anëtarë të jenë shokë e shoqe që kanë qenë shumë herë më të ngritur e që janë shumë në Kosovën tonë martire, kurse ngarkimi im me përgjegjësi më lente të kuptoj se bëhet më shumë si shkak i gjetjes sime këndej. Kështu së paku dëshiroja. Duke kaluar koha kuptoja edhe më shumë. Tani mund të them, fatkeqësia më e madhe nuk ka qenë pse ne nuk kemi qenë të ngritur në nivel, por pse shpesh kemi mbivlerësuar veten dhe mosaftësitë për t'u dalur zot punëve si duhet kemi provuar t'i fshehim pas fajit të njërit ose tjetrit, i cili vazhdimisht ka penguar që secili punën e vet ta kryej siç do ta kryente po të mos pengohej, përkatësisht po të mos arsyetohej se po pengohej...

Vrasja e shokëve bëri të mundur që radhëve tona t'ju shtohet autoriteti. Kam përshtypjen sikur kjo na mashtroj, që pastaj të mbiçmojmë veten para bashkatdhetarëve (nuk po konkretizohem në emra e raste, meqë nuk dëshiroj të arrihet efekti i kundërt), të luajmë rol të revolucionarëve, ndër më të mëdhenjtë dhe të luhet roli që ata, bashkatdhetarët, të krijojnë përshtypje se para fjalës së tyre, përkatësisht tonën, duhet të përkulen dhe të mos e vënë asnjëherë ne dyshim, pra as atëherë, kur ata janë të bindur se nuk është në rregull gjithçka. Më një fjalë, atë autoritet, në përmasa të caktuara, e kemi keqpërdorur. Dhe, duhet thënë edhe kjo: është ai autoritet që ne na mban, përndryshe, sikur bashkatdhetarët të njihnin realitetin, do na respektonin shumë më pak. Pastaj, duke keqpërdorur atë autoritet dhe rrethanat që u krijuan, qenë të mundshme disa "manovrime", duke mos qenë të kritikohen ato, prap si rrjedhim i atij autoriteti, që keqpërdorej.

Se çka u munduan të arrijnë individët pas vrasjes, mund të themi se është e vetëkuptueshme në përmasa të mëdha për ne tani. Por, gradualisht, ata që kanë provuar t'i akuzojnë e difarmojnë të tjerët, kohë pas kohe po demaskojnë veten. Skeleti i gjithë asaj pune përçarëse-miskine është, brenda kohe shumë të shkurtër mund t'i mvishet mishi, për të patur të konstruktuar trupin e plotë...

Edhe kjo klimë e ky ambient, pasojnë se të gjithë asaj gjendje të ndërlikuar, që na robërojnë edhe sot e kësaj dite. Dhe, është koha që duhet të mejtohemi thellë, se duhet gjetur zgjidhje më e përshtatshme e më jetëgjatë. Por, kur është mot i vrenjtur, nuk kemi nevojë të rrezitemi në diell.

Klimën e pranishme vazhdimisht e ka ngarkuar mospuna, mosaftësitë, mossukseset. Kur është dashur të raportohet për punë, për sukseset, pa patur nevojë të detalohem, dihet se si kemi raportuar. Moskënaqësia e psihoza e pranishme ngarkoheshin edhe më shumë, kur dëgjoje raportime të tilla (ndonjëherë edhe jo të sinqerta), përndryshe, sikur të na bindnin ato raporte se po korrim sukseset e mundshme maksimale, do të ngjallej optimizmi, do na hapeshin perspektivat, do na shtoheshin aftësitë për të menduar e vepruar. Sigurisht që kemi korrur edhe suksese, që nuk kemi nevojë t'i përmendim këtu, për të cilat mund të themi se kanë qenë më të mëdha se sa mund të merreshin me mend, sikur të dihej se në çfarë ambienti punohej, çfarë rrethanash mbretëronin, për të cilat, siç mund të kuptohet nga të shkruarit më lartë, kemi dhënë edhe ne jo kontribut të vogël që të arrijmë në atë nivel.

Pa patur kohë e mundësi të zgjatem sa do më duhej, duke i shtruar mendimet edhe më, po konkretizohem në ndonjë veçori e rast, në ndonjë gabim e lëshim, në njërën anë për të konkretizuar ato që shkrova, kurse në anën tjetër, për të ndihmuar që të bindemi njëherë e mirë se duhet të ndryshojmë në gjumëçka, nëse duam që klima të përmirësohet. Për këtë po ndalem në aktivitetin e punën e QE, duke u konkretizuar në sektor.

Meqë po më duket më së lehti, po ndalem te çështja materiale. Si mund të punohet në këtë sektor, kur ende nuk është raportuar se me sa mjete disponojmë, në mënyrë që të dijmë sa kemi mundësi t'i shtrijmë këmbët. Vetë shoku që është ngarkuar me atë

përgjegjësi, Fahriu, ka gjasa se dinë më së paku. E kush din, fare, bile shoku Fahri, se si qëndrojmë me Fondin e Ndihmave, a është duke u ndihmuar ndokush, kush është duke u ndihmuar, a kemi mundësi të ndihmojmë më shumë... Pastaj, kush dinë se nga po vijnë ndihmat, në mënyrë që me ata që ndihmojnë, të bashkëpunohet më afër, pasi gatishmëria për të ndihmuar tregon shumë për nivelin e vetëdijes, kuptohet edhe të aftësive për të milituar pastaj në radhët e LRSHJ-së. Ose, ndoshta mos vetëm po bëjmë iluzione, edhe atëherë kur nuk grumbullohet as minimumi i ndihmave të mundshme. Nëse është e vërtetë kjo, atëherë duhet marrur aksione e gjetur forma për të mundësuar grumbullimin e ndihmave. Përfundimisht, përse i është ikur raportimit mbi gjendjen financiare, edhe atëherë kur disa herë është kërkuar, ose përse nuk i është dorëzuar puna shokut Fahri? Nuk ka nevojë të thotë asgjë në këtë drejtim shoku Fahri, për të na bindur për këtë që them unë. Nëse më duhen të holla urgjentisht, nuk kam pse t'i telefonoj shokut Fahri, më duhet ose shokut Ujkan ose Bacës Plak. Edhe më konkret është rasti më i ri, lidhur me rastin e Shtutgardit. Të hollat që janë paguar për garancion janë ngritur nga kreditë individuale. Nëse ka ndodhur kështu, është e gabueshme, nëse shiqojmë vetëm nga aspekti ekonomik. Për të ngritur gjithë atë kredi, duhet paguar kamatë e madhe, kurse nëse të hollat e veta merren nga banka, për t'u kompenzuar prap si në rastin e parë, me fushata të grumbullimit të ndihmave. Gjithë dami nuk është aty. Të shohim edhe çfarë pasoja tjera kemi nga këto gabime. Padashur, diku në thellësinë e qenies, "lulëzon" pakënaqësia për "mosbesim", në rastin tonë te shoku Fahri. Meqë kaloi kohë e gjatë, pa marrë në duar punën e vet, sigurisht që ka patur njëqind herë mundësi të vij në përfundim të tillë, se ndaj tij nuk ekziston besimi në nivel. Pastaj, edhe më herët ka patur grindje lidhur me Fondin. Tani, kur qe sa kohë është ngarkuar me atë përgjegjësi, lejohet mundësia të dyshohet se diç, një hile, fshehet pas, pasi, ka mundësi të thirret në kontinuitetin e vendosmërisë për të mos i lëshuar të hollat nga dora, përkatësisht Fondin aq shumë të popullarizuar. Në ndonjë rast, kur lind ndonjë grindje, mund të përdoret si shembull kjo dukuri. Unë dyshoj se me këtë rast është bërë gabim në këtë nivel, vetëm rastësisht. Mos ndoshta qëndrimi jo i drejtë është rrjedhim i "kujdesit", për të mos lënë shansën që të ndodh si në rastin e Nuhiut. Sidoqoftë, më të këqijat janë dyshimet e pashprehura, pasi ato bluajnë përbrenda, kurse të shprehurat nuk kanë mundësi të bluajnë gjithaq. Për të vazhduar hala. A nuk lejohet mundësia të bëhen edhe manipulime të tilla: Përderisa mjetet i ka në dorë Plaku, janë në duar të shokut Xhemë, përkatësisht të atij "klani". Nëse bien në dorë të shokut Fahri, atëherë me to do të manipulon shoku Salih. Përfundimisht, gjendja ka arritur në atë nivel, sa, po m'u deshën të holla nga ai Fond, të ngurroj për të lypur, pasi gati sikur më duken se ua lypi të hollat private – që më ipen si ndihmë karitative-kristiane. Kështu ngjashëm tingëlloj në bisedë tel. që pata me shokun Xhemë pai u lëshova. Ai më ofroj ndihma, por sikur ato më ofroheshin vetëm tani, që jam viktimë dhe jo atëherë kur më duheshin, për të evituar që kjo të mos ndodh. Mund që këto rrjedhin nga nikoqirllëku i tepruar, ose për faktin se mjete nuk ka, por që nuk na thuhet, për të na dëshpruar. Cilado që të jetë, është e gabuar.

Besoj se u zgjata mjaft, për të hapur shteg për kritika pa rezervë por edhe për autokritika.

Sa për sektor të organizimit të brendshëm nuk dij çfarë të them, meqë asgjë, pra as punë, nuk më ka rënë në sy. Dëshiroj të kemi korrë suksese. Por, për të arritur suksese, duhet përgatitur kuadra që këtej, ndonjë bashkatdhetarë fare të pakompromituar, edhe të mbaj lidhje, por edhe të hedh farë organizative mes patriotëve e revolucionarëve në Kosovë, pasi po dihet më se pa organizim të nivelit, jo vetëm që nuk qohet përpara revolucioni, por edhe po arrestohen shumë bijë e bija të Kosovës martire, thuaja që në hapat e parë të veprimtarisë së organizuar.

Për sektorin e propagandës, thuaja, kemi biseduar gjerësisht. Kam mbetur borxh që për këtë sektor të bëjë analiza më të hollësishme me shkrim. Pos lëshimeve që janë kritikuar, e pranoj se ka qenë sektori më aktiv dhe më i suksesshmi. Për disa punë që janë marrë përsipër nuk janë kryer. Ndonjëherë thuaja më vështirë e kemi të gjejmë arsyetime, se sa të kryejmë punën. U bë kohë e gjatë që është biseduar për broshurën mbi shpërnguljet. Përfundimisht ka filluar të botohet në vazhdime. Por shumë më praktike do të ishte botimi i saj si broshurë. Kështu edhe me romanin e shokut Adem Dema-Demaçi, tani ka zënë të botohet në vazhdime, për çka mund të them se nuk është fare e arsyeshme. Nëse mendohen lexuesit brenda, vështirë që do arrijnë të kompletojnë e as ta përcjellin. E nëse nuk kane mundësinë këtë, vetëm emri i madh i shokut Adem nuk duhet të na bind se u dashka botuar ZK për ta bërë më atraktiv, sikur njëmend nuk po shitet. Botimi i romanit, nëse i kushtohet çdo herë një faqe e ZK, do të zgjat 2-3 vjet. A njëmend është e logjikshme të presin lexuesit për ta patur komplet romanin, nëse do kenë mundësi ta rregullisht gazetën e tyre ilegale. Nuk do mend të thuhet se ky roman, bashkë me të gjitha tregimet, është dashur kaherë të botohet. Më vjen keq të duhet të shprehem ca më brutal, sikur nuk i vije erë e mirë kësaj zhagitje të paarsyeshme, kur dihet interesimi i lexuesve dhe kur dihet se me shitjen e tij do nxjerrnim përfitime. Pra, që të botohej shumë më heret, mu më ka penguar mungesa e një parathënje të aktualizuar dhe të politizuar, përmes së cilës duhet siguruar ndikimi i dëshiruar. Sa për romanin si roman dhe tregimet, drejtë për së drejti, te masat e gjëra s'ka çka të ndikon, pasi nuk kanë kushedi çfarë përmbajtje të jashtëzakonshme. Shih pra, në mungesë të parathënies, u shty botimi. Sikur bile të thuhej se nuk mund ta shkruaj, ndoshta do bëheshin përpjekje për t'u gjetur ndonjë mundësi që të shkruan ndokush atë parathënie, ose të shkruhet ca më dobët. Kjo nuk ka ndodh. Secilën herë, që kur është biseduar dhe është aprovuar botimi i tij, zotimet nuk janë kursyer se do të kryhet puna. Kjo vlen edhe për dramën e shokut Jusuf. Kjo bile, është literaturë shumë e përshtatshme aktuale, kur po bëhen kaq shumë arrestime. Mund që edhe ndokujt do t'i kujtohet se kryesisht ky faktor e shtyri që t'i përkushtohet shkrimit të sajë. Them se edhe koha është në pyetje, ama që të radhitet në kompozer, nuk është e domosdoshme se duhet ta bëjë vetëm shoku Xhemë. Sa për mrekulli e nxori në makinë të rëndomtë shoqja Bule dramën që ka shkruar shoku Mërgim. Pamëdyshje se do të bënte edhe radhitjen e "Procesi", sikur t'i ishte thënë.

Se si qëndrojmë konkretisht me çështjen organizative këndej në Perëndim, këtë duhet ta dinë më mirë shoku Salih, ama nëse bazohem në letrën e tij, nuk duket se organizimi është bërë në baza të shnosha. Organizimi në baza të shëndosha do jepte provimin në raste kur ndonjë fraksionist nxjerr kokë. Po kështu, sikur organizimi të ishte në nivel, gjendja e krijuar do merrej në shënjestër dhe ndaj nesh do ushtrohej presion tjetër që, ose të përmirësohemi, ose të lëshojmë vendin për më të pregatitur e më punëtorë. E si mund të funksionon organizimi përderisa asnjë material, ama asnjë material intern nuk është shpërndarë, që anëtarët të dinë se çfarë do me thënë me qenë i organizuar, ose ndonjë material i konkretizuar për rastin tonë mbi teorinë e revolucionit a mbi teknikën e konspiracionit. Nëse ka ndonjë anëtarë të organizuar në nivel, nuk dij çka e mban atë të lidhur për LRSHJ-në. Mos vetëm vizitat kalimtare zavendësojnë këshillat, qarkoret, direktivat e gjërat përkatëse, të cilat do mbanin gjallë jetën në celula, do ta bënin më atraktive qenien si militant dhe jo që të goditen nga stërkeqja e monotonia në vete. Se mos militantët kanë marrë në dorë ndonjë punim se si duhet të ndikojnë te masat, se si duhet të afrojnë rreth vetes kandidat, për t'i anëtarësuar kur të jenë të bindur se meritojnë, etj., etj. Ndoshta është bërë ndogjë në këtë drejtim, por ne nuk na kanë rënë në duar ato materiale. Do të ishte gabim. Në njëfarë forme, vetëm kur kryejmë punët e caktuara që dalin nga detyrat, duhet të jemi vetë anëtar të ndonjë celule, për t'u marrë me aktivitetet e

"thjeshta" të anëtarëve të "rëndomtë". Vërtetë nuk dij ku të bazohem për të thënë se në organizim konkret janë duke shkuar punët mbarë. Në rastet kur po kam mundësi të vërej, shoh se në rrethe, meqë po dihen dobësitë, po shfrytëzohen ato, përkatësisht po keqpërdoren. Bashkatdhetarët fare të papërgatitur, me ndonjë manir, që është i pranishëm në raste të shpeshta të përkushtimit çështjes patriotike, në formë të vetëkënaqësisë, sikur ngarkohen me përgjegjësi. Ata pastaj keqpërdorin atë që bashkatdhetarëve tjerë t'ju shesin taraf, se ja ata na qenkan me patriotët në rreth, ke të cilët LRSHJ-a ka më së shumti besim dhe jo ju. Nuk ka dyshim se duke ua ushqyer maniret dhe vetëkënaqësinë, edhe aktivizohen me entuziazëm, por që është i dëmshëm për punën e mirë e të gjatë. E kur të ndodhin raste të tilla, meqë me bashkatdhetarët këndej nuk është punuar gjithaq, sigurisht që të tjerët sikur ftohen nga rrjedhime të tilla. Rasti më tipik janë Qamili dhe Aliu. Se po dëgjuan ndonjëri nga shokët se i pari ka qenë punëtor lidhur me klubin, pa ditur për huqet, ose edhe papërgatitjen për t'u ngarkuar me përgjegjësi që nuk ia përthekon kaqiku, nguten kush të përfiton më parë, duke e propozuar shpejt e shpejt ose duke ia ushqyer pikërisht tërpinë për ta lavdëruar. Pra, kam përshtypjen, sikur duhen të përshtatshëm bashkatdhetarët, te të cilët po u the se ti je më i miri dhe lavdrime të tjera, thejnë qafën. Sikur po vlerësohen duka e sharmi dhe jo cilësia e vendosmëria, shpirti i sakrificës.

Sikur më ka rënë të dëgjoj nga shoku Salih, se tani për tani është përqëndruar vetëm në çështje të formimeve të klubeve. Kurse sa i përket formimit të celulave, krijimit të komiteteve në rrethe, përgatitjes së ndonjë ndihmësi, asgjë, së paku nuk ka mundësi të vërehet dhe aq sa jemi njoftuar. I kuptoj vështirësitë me të cilat është i ballafaquar, si kufizimi i lëvizjeve, ndoshta edhe mungesa e mjeteve elementare, bile sa për udhëtim.

Por nuk besoj se mosskuksesi në këtë fushë të jetë kushtëzuar vetëm nga ky faktor. Mendoj se autoriteti i LRSHJ-së te bashkatdhetarët ka qenë i madh, nga rrjedh se shumë janë që do dëshironin të gjenin format e mënyrat për të kontribuar më shumë, meqë janë bukur të qartë se vetëm duke qenë të organizuar sa më në nivel, mund të japin atë që pritet nga ta dhe jo në mënyrë stihike e spontanisht.

Kur është fjala te klubet, te formimi, nuk dij a guxojmë të jemi të kënaqur, dihet, fjalën e kam tek shtetet tjera, pos Zvicrës. Përfundimisht, sa u përket shenjave e simboleve jugosllave, ende nuk jemi të qartë e as nuk kemi marrë vendime konkrete. Këshillimi që qe mbajtur, sa u përket shenjave e simboleve jugosllave, duket se është keqkuptuar, ose keqinterpretuar. Në këtë rast po sjell një shembull tipik. Gjersa në Hamburg luftojnë klika e Hashimit (kryetarit të klubit "Kosova"), në Bremen i është lënë në dispozicion ta komandoj me klanin që ka klubin në dorë. Çfarë klubi është hapur në Bremen, në çfarë lokali dhe çfarë aktiviteteve, besoj sa të ulëta, aq sa edhe vet konzullata nuk do të kujtohej. Për klube të tilla, që të hapen, zakonisht janë paguar veglat shqiptare që punonin si "nëpunësa" në konzullata. Edhe tani, po të mos i pengojmë, klube të tilla do të hapin ata vet, por ja që atyre nuk u shkojnë bashkatdhetarët, atëherë nuk duhet t'i mashtrojmë ne për t'ua lëshuar në dorë. Vërtetë më duket skandaloze të përkrahet klani, përfundimisht në vepër prokonzullatës, që të hap klub në lokal, ndër më të degjeneruarit, për të sabotuar lokalin e nxjerrë nga Komuna në shtëpi të kulturës. Të presim e të shohim ku do të na nxjerr kjo "taktikë", të cilës njëherë përnjëherë nuk do t'i them "mashallah".

Bashkësia e Klubeve dhe Shoqatave Shqiptare në Evropën P. ende është në fillim. Ka gjasa që fillimi nuk është gjithaq i mbarë, prandaj e ka ca vështirë pastaj. Mendoj se Bashkësija duhet të merret më seriozisht, pasi është formë e veprimtarisë legale, pas të cilës duhet të qëndron veprimtaria ilegale, pa lëshuar asnjëherë format demokratike të aktiviteteve, të praktikueshme në vend.

Gjendja hiç më e mirë nuk qëndron as në sektorin, me të cilin jam ngarkuar. Arsyetimi që kam dhënë që në fillim, se nuk jam i aftë për t'i dalur zot sa duhet e si duhet, nuk guxon të jetë çdo herë arsyetim për mossuksese. Koha po kalon dhe sikur puna të merret me përkushtim, doemos duhet përvetësuar sado pak zejen, për t'i dalur zot punës. Kryesorja në këtë sektor është që të kemi njerëz me njohuri të gjëra, sidomos që zotërojnë ndonjë gjuhë, të ashtuquajtur botërore. Edhe ju do të jeni po të mendimit se të tillë nuk kemi. Nga ata që zotërojnë gjuhët, që janë shumë më heret në kurbet, vështirë që do gjejmë të sinqert për punën tonë, pasi ata më parë janë zezë me punë të tjera, punë të tyre... Nxjerrja e buletinit KOSOVA u shty së tepërmi. Por, edhe kur pata propozuar nxjerrjen e tij, kam thënë qartë se vetë nuk e ndjej veten të ati niveli, sa të shkruaj unë vetë artikuj. Unë mendoja se do ia dal me shokë e shoqe të organizojmë përkthimin, organizimin e botimit dhe shpërndarjen. Për çudi nuk u lajmërua askush në Redaksi të ZK për bashkëpunëtor, qoftë për të përkthyer, ose për të shkruar artikuj. Kjo vërtetë po më çudit. Sikur më bënë të dyshoj se askush në Kosovë, ose nuk është në korent, ose nuk ia dinë rëndësinë kësaj pune, ashtu si na e muar mendja ne. Si duket nuk po jemi të zot të kordinojmë lidhjet. Kurse edhe pse nuk është lajmëruar askush si përkthyes, edhe kjo çudit, ose ndoshta është lajmëruar ndokush, por nuk është parë e arsyeshme të vehem në korent. Për këtë mund të informoj shoku Ujkan. Vështirësi tjetër është statusi i qëndrimit. Krahas kësaj edhe mungesa e mjeteve për të udhëtuar e qëndruar në shtete të ndryshme, ku kohë pas kohe gjenden lidhjet e mënyrat për të depërtuar. Ta zëmë, shumë i domosdoshëm do ishte qëndrimi mujor në Austri, për të gjetur mundësitë e kontaktimit me gazetarë e specialistë të çështjes së Ballkanit, të cilët punojnë nëpër institute. Se sjell suksese, bind qëndrimi në Suedi. Kështu ndodh edhe me Italinë. Këto dy shtete kufitare janë lënë anash, edhe pse dihet nga historia se sa janë të interesuara këto dy shtete për çdo gjë që ndodh në Ballkan.

Pjesërisht, me thonjë e me dhëmbë, jam munduar të grumbulloj material, e edhe të përkthej, që më në fund të bëhet e mundur nxjerrja e buletinit. Por, nuk dij si do duket e arsyeshme të sigurohen mjetet për botim. Nëse kemi mjete dhe ne pengohemi në punë të mbarë kryesisht në mungesë të tyre, atëherë është gjynah i madh, për të mos thënë sabotazh, sado që "ruajtja" e tyre mund të bëhet për ditë më të vështira. Thuaja edhe këtu vlejnë ligjet e ekonomisë: efekti, përkatësisht përfitimi që mund të arrihet duke investuar sot një markë, në mot nuk arrihet edhe sikur të investohen njëqind, pasi, pos tjerash, kalon ajami. Mund që edhe ju do jeni të këtij mendimi.

Sa për bombardimin me letra, memorandume e peticione, organizatat e qeveritë, jemi mbrapa. Së pari nuk e zotëroj gjuhën e stilin e të shkruarit të tyre – e ato kur të dalin nga dora, nuk kthehen prapa. Pastaj, sikur duket më efektive të lidhim kontakte me personalitete, që ato të flasin për çështjen tonë. Po kjo vlen edhe për gazetarë. Sa për marrëdhëniet me organizata, shtrohet pyetja se a nuk duhet të kemi parasysh gjendjen tonë specifike. Të lidhim marrëveshje për bashkëpunim me partitë komuniste, mos nuk është në kundërshtim me kërkesën Republikë Federative. Unë mendoj se po. Në këtë drejtim më së shumti pengon edhe mungesa e Programit Politik, të cilin duhet ta përkthejmë në gjuhë të huaja, si dhe ilegaliteti i LRSHJ-së.

Kohëve të fundit kam patur disa kontakte me rëndësi, për të cilat do të njoftoj ndonjëherë tjetër.

Meqë nuk po më pëlqen të kritikoj veten, po me tonin që kritikoj ndonjërin nga ju, kërkoj që këtë ta bëni ju, duke më këshilluar e dhënë ndonjë propozim a ide në aktivitetet e suksesshme që duhen arritur në këtë sektor.

Të dashur shokë,

pas demonstratës në Bruksel nuk ju shkrova. Tani sikur kam harruar se çka kam dashur të shkruaj – gëzohuni, përndryshe do zgjatesha edhe ca faqe.

Së pari, siç jam shprehur edhe më parë, nuk dij se si është ardhur gjer te vendimi për ta thirrë atë demonstratë. Meqë shoku Ujkan ka vendosur që demonstrata të thirret, duke u nxituar t'ju shkruaj letër në logun e "mërgatës së qyqeve", do të duhej të na informonte se kenë ka angazhuar. Kësaj radhe, të mos përsërisë së koti, do doja së paku kopjet e letrave të shkëmbyera me atë rast, sidomos ato që ka ndërruar me z. E. Hadrin dhe letrën që i është dërguar Shoqatës "I. Seferi".

Kësaj radhe ndodhën marifete e marifete, "akrobacione" e sabotazha. Pa e zgjatur, për demonstratë kemi patur dy leje, njërën që e ka marrë shoku ynë, atëherë ku E. Hadri ka bërë kërkesën duke u thirrë se është ngarkuar nga Redaksia e ZK, atëherë kur me të njejtën punë është ngarkuar edhe Shoqata.

Edhe pse unë isha në vend, kur isha i vendosur kundra dredhive të dredhagjijve, funksionin telefonat. Herë shoku Ujkan e herë shoku Mërgim (për këtë të dytin e lë hapur që të shkruan ai vet), "korigjonin" gabimet e mia, duke qenë mijëra kilometra larg dhe pa njohur realitetin, por më shumë duke u ndikuar në dezinformime. Gjatë gjithë kohës klani Enver me kompani, bashkë me Reshatin, kanë luajtur rol miskin. E unë, në atë pozitë të vështirë, që ta majorizoj gjendjen e ndërlikuar, duhej të mbaj të fshehur se lejen për demonstratë e ka nxjerr edhe Enveri, përndryshe, do mbetej atë ditë vetëm Enveri plus co të demonstroj "në emër të Komitetit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut".

"Akrobacionet" e Enverit s'më demoralizonin, pasi atë e njihja, por më demoralizonte mosbesimi i shokut Ujkan, i cili përkundër që bukur shtruar kisha shprehur mendimet e mia për E. Hadrin, prap nuk po bindej, por vazhdonte ta ngarkon të derdelisë "në emër" të Komitetit... Nëse kuptoj nga punët me të cilat po merremi, kur është në pyetje udhëheqësi i ndonjë organizate, pavarësisht cilës, nuk është në kompetencat e shokut Ujkan, kokë më vete, të nxitohet për të kthyer përgjegje. Së pari letër e tillë, pasi të jetë parë se më takon mu, do duhej të më dërgohet. As unë kokë në vete nuk do guzoja të kthej përgjegje, pa shtruar për diskutim në QE, kur dihet se në pyetje është një organizatë dhe ne, së bashku, duhet të vendosim se çfarë qëndrimi duhet të marrim. Për mendimin tim këtë nuk vlerësoj për lëshim, por shkelje të Komunikatës dhe të parimeve të vetëkuptueshme të LRSHJ-së. Tani nuk e kam pranë Komunikatën, por dij se çfarë qëndrimi është marrë kundër forcave separatiste (për rastin konkret, E. Hadrin, pa dyshim se nuk e çmoj fare për seperatist..., nipin e Kryezive, Cana Beut...). Ndoshta ti shoku Ujkan do arsyetohe se je bazuar në atë që ka shkruar dhe në "qarkoren" që ka lëshuar. Aq më keq – tregohet papjekuri politike.

Disi ia kam dal të siguroj kopjet e letrave që ka shkruar E. Hadri "në emër" të Komitetit, veçmas është për befasi (por jo te unë), se ai i shkruan vetëm Partisë Komuniste Belge (pro BS) dhe asnjë organizate humanitare. Po kështu, ajo përralla se Enveri do angazhon organizatë humanitare (ia kam harruar emrin) për të nxjerrë leje për demonstratë, mund të të kujtohet, unë se pata përbij.

Përfundimisht, u rrokullisën punët si u rrokullisën, se një letër pata përgatitur për PKB, pastaj donim t'i shkruanim edhe kryetarit të komunës, duke e bërë me dije opinionin për të tilla dredhi, përkatësisht duke i informuar gazetat (gazetarët e të cilave E. Hadri i njeh dhe ia botojnë intervjut, kur padronët kërkojnë nga ai, por kur është momenti të shkruhet për çështje të popullit, saboton.). Me këtë rast do dërgoj edhe kopjen e asaj letre, meqë nuk është vonë të bëhet punë e tillë.

Dëshiroj të mos kem patur të drejtë që kam dhënë propozimin parapërjashtim nga QE, ama për një kategori letrash edhe më parë kam tërhequr vërejtjen. E sa për lojën me ballon, ndodhi ashtu si e prisnim, por më vjen keq që mundësoj shkeljen e refuzimit tim,

duke të mashtruar, për të dalur në fund bllof. Më ndjej, sa keq kam që na ndodhin gjëra të tilla, edhe atëherë kur ua marrë kokrrën në sy se çfarë hilesh bëjnë këta saroshë. Për sabotazhe që të mbesim fare pa trakt dhe marifete të tjera, nuk po bjerr kohë. Nuk dij çfarë do thuani ju, por unë e ndjeva veten të lënë vetëm, përball llave të ujqërve, bile me anë të telefonave sikur ndërsehej; sa herë ma ka përmend Reshati se ka telefonuar me shokë në Turqi...

Lidhur me propozimin për përjashtim të shokut Mërgim nga QE, arsyetimet janë dhënë në tubim dhe janë në procesverbal. Por, po konkretizohem ca, sidomos lidhur me korrespondencën me M. Hotin. Që kur isha në SHBA më ra të lexoj letra që shoku Mërgim i kishte dërguar Musës, e si për t'i shfrytëzuar për punën e tij, kishte dërguar kopje në SHBA. Atëherë nuk njiheshim dhe nuk dija se kush ishte ai i mashtruar, siç mendoja atëherë. Kur më ra të shoh të njejtën firmosje te drama, m'u kujtu. Pata keq. Letërkëmbimi kishte vazhduar. Kështu, në prag të demonstratës patëm ca mosmarrëveshje, pasi sipas Musës, ai duhej të vendoste se çfarë kishte për të thënë LRSHJ-a në këto raste. Siç dihet, në raste të tilla nuk pranoj të shkel mbi parime, prandaj edhe ia tregova vendin, sidomos sa i përket demonstratës, për pastaj mbet të merremi vesh. Pas demonstratës, kur isha, sa për formalitet dhe për t'i treguar se nuk jam i bashkuar me te, Musa na lexoj një letër, ku tërësisht ishte shkelur konspiracioni i LRSHJ-së. Përmes letre Musa informohej, njëanshëm, mbi gjendjen para Bashkimit dhe mbi Bashkimin në LRSHJ. Ruajta gjakftohtësinë dhe nuk thash asgjë, mbarohesha sikur nuk dija asgjë prej gjëje për ato që na lexoi ai. Por të tjerët, që ishin të pranishëm, kishin përshtypjen se Musa është anëtar i KQ i Lëvizjes. Besa, thënë të drejtën, kur pata fatkeqësinë t'i dëgjoj ato që na foli shoku Mërgim, dyshova se ka mundur ta "fut" Musën në KQ, që në fakt e dinte si diç personale... Nga shoku Mërgim do të kërkoj kopjen e asaj letre dhe të gjithë korrespondencën reciproke me Musën, me mendim se letrat që shkruan anëtari i KQ në emër të LRSHJ-së nuk janë personale dhe kur të lind dyshimi duhet të vehen në dispozicion për kontroll. Me këtë rast, nëse shoku Mërgim nuk e ka njohur Musën, do provoja ta informoj, ashtu si di. Në rast të kundërt, do të dëshiroja të më ndihmon për të ndryshuar mendimin e qëndrimin, nëse ai është i bindur se çdo gjë është në rregull sa i përket atij, dihet duke pasur prova, ashtu siç kam unë për bindjet e mija. Gjithashtu e shoh të arsyeshme të merret qëndrim konkret për këtë rast dhe nëse shoku Mërgim ka anëtarësuar Musën, unë propozoj që Musa të ç'anëtarësohet. Do shkoj edhe më larg, përderisa nuk ka prova që vërtetojnë të kundërtën, Musa nuk do militon në radhët e Organizatës që militoj unë!

Edhe njëherë: propozoj që Programi Politik, përkatësisht konturate Programit, të shkruara nga shoku Ujkan, sa për orientim, të vehet në diskutim. Për këtë unë do shkruaj një variant të një qarkoreje (nëse mund të quhet ashtu) për komitetet, celulat e militantët e LRSHJ-së, për diskutim, duke dëshiruar që të fillojmë edhe nga puna e tillë. Nëse nuk ia kam qëlluar formulimit, le të riformulohet, por mendoj se kjo punë duhet bërë, pasi Programi i LRSSHJ-së duhet të jetë vërtetë i LRSHJ-së dhe jo vetëm i disa personave, edhe nëse ata janë të ngarkuar me përgjegjësi të caktuara.

Vërtetë jam zgjatur, por kështu doja kësaj radhe. Të shohim se sa jemi të armatosur me kulturë revolucionare, për t'i kuptuar kritikat si kritika, që ndihmojnë në përmirësim të punës, dhe jo si hile. Kam ndërmend, posa të më premton koha, të nxjerri në maqinë materialin që pata përgatitur, shpejt e shpejt, për tubimin e 13 Nëntorit '84 (duhet të jetë 1983-shën i red.) duke i shtuar ndogjë, bazuar në gjendjen që u krijua pastaj.

Pres që secili të merr qëndrim përkatës, duke mos përshëndetur asnjëherë planet pas shpinde, përderisa bëjmë pjesë në të njejtin forum. Po kështu, nuk është patriotizëm

e revolucionaritet i vërtetë, kur merren qëndrime për hatër, ose për ky ose ai është i "anës sime".

-shtojcë-

Shokë,

në momentet e fundit kur po përgatitja letrën për postim (fotokopjim), më ra ndërmend se më duhet t'ju bëjë me dije për disa ndihma që më janë dorëzuar dhe harxhimin e tyre.

Bashkatdhetari Huti, nga rrethi i Livadhisë, m'i ka dhënë 1740 DM. Ato i kam harxhuar në prag të demonstratës në Bruksel, për pagimin e shtypjes së pllakatave që janë ngritur mureve të Brukselit, për kompoozimin dhe shtypjen (në dy gjuhë) të traktit të demonstratës, për pagimin e shpenzimeve të mbledhjes me gazetarë dhe për komunikatë, kam dhënë 120 DM (në fakt 100 Franga zvicerane) që t'i dërgohen nënës së A. A. dhe disa shpenzime të tjera shoqëruese, ndër to edhe udhëtimi në Francë, dihet jo për halle private.

Kur isha në M., Reposhi m'i dha 400 DM për ZK. Nga to bukur shumë pata shpenzuar që të bëja fotokopje të materialeve nëpër biblioteka të atjeshme dhe për t'i blerë ca libra e revista. Të tjerat thuaja gati i shpenzova pastaj, me rastin e rënies në burg...

Tani kam kërkuar nga Plaku të më dërgohen 1.000 Franga, që t'i kem në këto çaste të vështira... Më duhet ta paguaj avokatin për punën e tij të madhe; vëllau nuk e ka hallin, sepse edhe kafshatën e domosdoshme të fëmijëve do detyrohej t'ua merr, prandaj më duhet të gjej mënyrën se si duhet t'i paguaj borxhe që ai ka huazuar në ato çaste – ndoshta mund ta dini se vëllau ka katër fëmijë dhe, sigurisht, shumë na ndihmon edhe ne të dyve, dëshiroj t'i bëjë të gjitha këto jo vetëm pse ndjehet i thirrur nga përgjegjësia familjare...

Për ndihmat e Livadhisë nuk kam lajmëruar menjëherë, meqë nuk më është dukur aq me rëndësi. Pastaj, si rrjedhim i klimës së krijuar, dhe kur më ra të jem i pranishëm për të mësuar se këto ndihma ishin dekonspiruar, atëherë kur po pyeste shoku Y., heshta qëllimisht; besoj se nuk është e domosdoshme të vihet në dijuni shoku Y., pasi për të është kuriozitet të dij më shumë se sa i takon, e kurjozët na dëmtojnë. Kështu, edhe në të ardhmen, duhet gjetur mënyrën se kujt duhet thënë nuk dij, jo pse, për rastin konkret mungon besimi, por edhe superbesimi i panevojshëm e kurioziteti janë të dëmshme.

Nuk di sa jemi duke u përgatitur për përkujtim të 2-Vjetorit të rënies së shokëve. Nëse mund të mbërri (sigurisht që më me rëndësi do të ishte të kem kohë për shkrime të tilla), do shkruaj diç për atë mbrëmje. Do ishte e nevojshme që të gjejmë çka për të pagëzuar me emrat e shokëve. P.sh., do më dukej e arsyeshme që në kuadër të LRSHJ-së të themelojmë Ndërmarrjen botuese, duke e pagëzuar me emrin "Vëllezërit Gërvalla". Kështu edhe me emrin e shokut Kadri do duhej të pagëzonim diç. Mendoni edhe ju në këtë drejtim, se çka është më mirë.

Iljazi (Ibrahim Kelmendi)

31. Letër e Ibrahim Kelmendit për Sabri Novosellën dhe QE, 17 janar 1984

PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!

Në mërgim..., më 17 jan. 1984

I dashur shoku Mërgim (Sabri Novosella-shën i Xh. D.),

po të shkruaj, edhe pse, mendoj, do të duhej të më shkruaje ti njëherë, së paku që të bësh me dije se si u ktheve.

Në ndërkohë, besoj, duhet të jesh informuar mbi mbledhjen që mbajti komisioni, më 18 dhjetor 1983. Nga procesverbali mund të lexohet për vlerësimet që u bënë në përgjithësi, si dhe mbi propozimet konkrete. Ndër to, meqë të shkruaj, ishte propozimi im që ti të përjashtohesh nga ...

Me këtë rast nuk do shkruaj për arsyet që më shtynë që të jap një propozim të tillë, pasi ato janë në procesverbal, sado që janë shkurt të shtruara. Këtu mund të shkruaj vetëm kaq: që të bëjë propozim të tillë nuk më shtyri vetëm ato që ndodhën gjatë takimeve tona, por disa gabime (kështu i vlerësoj) të tjera, sidomos korespondenca me Musën dhe presioni që provohej të më bëhej në prag të darsmës në Bruksel, duke u thirrë në bisedat telefonike që bëheshin me ty.

Që kur isha në SHBA më ra të lexoj letër, që ti kishe shkruar. Ishte pseudonimi yt dhe dorëshkrimi, pasi shumë rreshta kishe shkruar me dorë. Atëherë nuk dija ku t'ia nisë, sa i përket asaj letre, përkatësisht sa i përket korrespondencës në mes të Omerit dhe Musës. Më vinte keq se nuk dija se kush është Omeri, që t'i shkruaj menjëherë se nuk duhet të korespondon me atë njeri në "kullë", pos për të tjera arsye, edhe se të gjitha letrat kalonin jo vetëm nëpër duartë e një agjenture.

Se si ka ardhur gjer te korrespondenca mes jush nuk dij, por jam i mendimit: nuk është dashur të korrespondosh në atë nivel dhe në ato rrethana. Duke u bazuar në relacionet që mbretëronin përpara vrasjes së shokëve dhe para "veprës" së "heroit" të "kullës", ti atë "heroi" nuk duhet ta kesh njohur përpara, ose, nëse e ke njohur, nuk duhet të kesh patur marrëdhënje në nivel të përkatësisë në të njejtat radhë.

Se sa letra ke ndërruar nuk e dij, por, meqë po bazohem në relacionet tona, po më duket e drejt të t'i kërkoj, së paku ato që kanë të bëjnë me LRSHJ-në, – ndërsa ato të nivelit privat dhe familjar nuk më duhen, – qoftë edhe si kopje. Nisem edhe nga fakti se "heroi" para se ta kryen "veprën" ka qenë me trup, i tëri diku tjetër, dua të them në organizatë tjetër. Kështu, së pari duhet të vinin në pyetje qëndrimet ndaj organizate tjetër, përkatësisht relacionet, pasi "heroi" duhet të ketë qenë njëri nga "kokat" udhëheqëse. Sidomos, kontestuese është letra që na e lexoi shumë vetave, tani së fundi, të cilën, sipas të gjitha parashikimeve, duhet të ia kesh shkruar ti.

Në prag të darsmës, në një takim që patëm me disa të tjerë ku qe edhe "heroi", erdhi deri te keqkuptimi, që në fakt nuk mund të quhet keqkuptim. Në atë mbrëmje "heroi" na shitej si udhëheqës, përkatësisht njëri nga "kokat" e LRSHJ-së. Ishte tejet brutal në disa relacione, bile edhe cinik, sidomos ndaj meje, pse jo edhe ndaj LRSHJ-së – ta zëmë, kur thoshte se mund që do t'i thuhej nga Lëvizja (tekstualisht më duket të ketë thënë: "edhe nëse më ngarkon Lëvizja për të marrë pjesë në konferencën për shtyp, unë nuk do të pranojë të marrë pjesë...") për të marrë pjesë në konferencë për shtyp, por do ta refuzonte. Pastaj hyri nëpër "lakra" duke provuar tërë kohën t'i bind të pranishmit se ishte në "kokë" të LRSHJ-së, kuptohet duke mbajtur qëndrim perfid – sikur për shkak të konspiracionit nuk po lëshohej në biseda më konkrete, edhe pse thoshte gjithçka që mund të dinte, besa edhe trillonte. Kuptohet se mbajta qëndrim përkatës, duke ia bërë me dije se si do të duhej të sjellet, si bashk me disa që ishin aty, në darsëm, nëse do dëshironin të demonstronin në radhët e asaj darsme.

Edhe nga letrat që më ka shkruar, – ato duhet t'i kesh edhe ti, – del se ai nuk është vetëm anëtar i "thjeshtë" i Lëvizjes. Bazuar në të gjitha, shtrohen pyetjet: a është ai anëtar i Lëvizjes? Kush e ka anëtarësuar, ose kur është anëtarësuar? Mos është zgjedhur në ndonjë funksion?

Meqë ke korresponduar me te, më intereson shumë, jo vetëm mu, por të gjithë shokëve të QE dhe të Lëvizjes, duhet t'ju intereson se çfarë mendojnë lidhur me "heroizmin" e "heroit", konkretisht çfarë mendimesh ke ti? Kjo është shumë me rëndësi, edhe për arsye se mund të kem mendime të gabuara dhe kështu t'i kem bërë padrejtësi

shumë të madhe, duke ruajtur distancën përkatëse, besa edhe duke "shpifur" e "dezinformuar" edhe ndonjë bashkatdhetar. Po kështu, menjëherë shtoj: përderisa të mos më jenë siguruar prova bindëse, do ruaj distancën e mëparme. Po ndodhi të kemi mbajtur qëndrim të gabuar, do t'i bij në gjunjë.

Shih pra, janë këto arsyet plotësuese, që më bindën se duhet të bëjë propozim për përjashtimin tënd, përndryshe, asnjëherë nuk do ta kisha ndërgjegjen se kam mbajtur qëndrim patriotik-revolucionar, siç i takon militantit të radhëve të Lëvizjes.

Sigurisht që mund të ndryshoj mendimin atëherë kur të jem sqaruar se nuk kam vlerësuar gjërat në nivel, meqë nuk kam qenë mjaft i informuar (në rastin konkret nuk foli për "më ka thënë ky e ai", "kështu e ashtu"), ose se jam nxituar, duke mos ditur se si qëndron realiteti. Mu për këtë edhe të shkruaj, për çka, besoj, do marrë përgjegje pa shumë vonesë.

Gjatë takimeve që kishim, disa herë u sjellën bisedat në mes tej e shokut Zeqë. Lidhur me atë takim, mendoj se duhet të informosh, pak më shumë se sa i ke shkruar "heroit". Them kështu pasi disa fjalë shpëtuan gjatë fjalosjes mes teje e shokut Ujkan, prandaj, pos për arsyerave të tjera, edhe të mos lejohet mundësia për manipulim me fjalët që nuk janë incizuar as mbajtur shënime. Sidomos, do ndihmonte shumë informimi ytë, pasi, me gjasë, vetëm ti je ndër të gjallët, që mund të informosh mbi bisedimet, ashtu siç janë zhvilluar.

Edhe shokut Salih i kam shkruar më heret, se duhet përfundimisht të informohemi se si kanë shkuar bisedimet e 17 shkurtit dhe 15 Majit, por ai nuk e ka marrë mundin. Prap, edhe mes nesh është kontestuese kjo çështje, për të cilën nga shkruan shoku Salih në letrën e 3 janarit të këtij viti, duke u thirrë edhe në letrën që i ke shkruar, ose keni biseduar. Duhet njëherë e qartë, sidomos ju pjesëmarrësit e bisedimeve, të merrni qëndrim prej patriotëve revolucionarë, që ta thuani të vërtetën e plotë, dhe jo të përgjysmoni, duke lënë mundësinë për manipulime e keqkuptime. Shkruaj kështu, pasi asnjëherë nuk po merret qëndrim i qartë lidhur me A.P. me bashkëpunëtorë, por, si të them, po zhagiteni, "ngreh e mos e këput", çka nuk do të duhej. Ose ai i ka shkelur vendimet, ose thirret në vendimet e arritura, ose ekziston edhe mundësia tjetër, se duke u nisur në besimin që është formuar, keni biseduar lirshëm, pa mbajtur shënime precize, ose edhe mund që bisedimet të jenë bërë "shkel e shko" dhe nuk dini se çfarë ka mundur t'u shpëton. E gjithë kohën po mendoj edhe për bisedimet e 15 Majit, për të cilat duhet që të jemi të qartë. Përndryshe, nëse "zhagitet" "ngreh e mos e këput", lirisht mund të krijohet përshtypja se janë takuar në mes vete "matrapazët", që t'ia hedhin njëri-tjetrit, kush të mundet sa më shumë...

Me këtë rast do të pyes, se a ekziston mundësia të ta postoj letrën që ua kam shkruar shokëve të QE (i ka 20 faqe), pasi, bazuar në situatën politike, mund që do ta marrin, ose së paku vetëm ta kopjojnë (e çka duhet më shumë?).

Në atë letër, sa i përket Programit, kam qortuar shokun Salih, se përse duhet përsëri të merremi, përkatësisht t'i përzimë, shokët "përtej gardhi"; na thotë e shkruan se "ia kanë korigjuar shokët...", mendohet varianti që ke dërguar ti. Mu nuk po më pëlqen të provohet t'i implikojmë të tjerët..., prandaj i thash Salihut se nuk është e vërtetë, dhe qëndroj në atë që kam thënë. Së paku, çfarë na duhet të merremi me "muhabete" të tilla, pa ndonjë nevojë, përkatësisht në budallëk. Kopje të variantit tënd më kanë dërguar. Tani kemi grumbulluar mjaft material dhe besoj e shpresoj se nuk do të shtyhet shumë që të aprovohet Programi. Por, jam për atë që edhe formulimi përfundimtar të shumëzohet për diskutime e aprovim, në komitete, celula dhe anëtarëve. Për këtë arsye, kam dhënë propozimin për një Qarkore (bile edhe e kam shkruar dhe ua kam dërguar shokëve që të diskutojnë mbi te, për ta përmirësuar poqëse e shohin të arsyeshme se duhet të lëshohet).

Meqë diskutimet për përmbajtje të ZK nuk kanë përfunduar tërësisht, të them, për shkak të rrethanave që po na pengojnë (jo për dëshirën tonë), shumë do na ndihmonte

sikur të shkruaje një analizë me shkrim. Mendoj se në një analizë të tillë do kesh mundësinë të shkruash më shtruar mbi ato që ke thënë, sepse ka mundësi që, padashas të ka shpëtuar ndogjë që s'do dëshiroje ta thuash, ose të ka mbetur pa thënë atë që do të duket e arsyeshme, dhe ajo që të ka mbetur pa thënë, mund që ndihmon në marrje të qëndrimit sa më korrekt-përkatës. E pata thënë edhe atëherë, se komisioni nuk do të jetë në gjendje të bëjë vlerësime të nivelit (po dihet me çfarë aftësish disponojmë...), prandaj, së paku unë pata thënë, është mirë të angazhohet edhe ndonjë shok e shoqe, që mund të bëjë një analizë të tillë.

Më duket se shkrova ato që kisha për të shkruar kësaj radhe, pa përdorë taktikën – "të them vetëm kaq kësaj radhe". Kështu do dëshiroja që të më shkruash edhe ti, për të gjitha dhe, sigurisht, nuk do ngurroj të përgjigjem, duke u konkretizuar më shumë, poqëse kërkohet.

Të dëshiroj shëndet e suksese në punët e mbara, ty dhe shokëve.

PS. Ma dërgo një kopje të broshurës "Shpërngulja e shqiptarëve" të V. Qubrilloviqit në gjuhën turke (duket se ke harruar që më pate thënë se do të ma dërgosh, ose ndoshta mashtrohem).

Nga një kopje të kësaj letre po ua dërgoj shokëve të KE (QE).

Mirëupafshim. (Ibrahim Kelmendi)

32. Letër e Ibrahim Kelmendit për Qendrën Ekzekutive (QE), 19 janar 1984

PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!

Të dashur shokë të QE, Në mërgim..., më 19.01.1984

përpara kam letrën që ka shkruar shoku Xhemë (që mban datën 6 jan., përkatësisht kallnorit, siç e ka shkruar ai, të këtij viti). Është shkruar shkurt e qartë, për të cilën aftësi edhe po i lakmoj. Por, siç na janë imponuar rrethanat (pjesërisht ia kemi imponuar vetvetes), gjer në takimin e mundshëm, do të duhej patjetër disa gjëra të shtrohen përmes letrave. E vetmja e keqe përmes letrave është, se i frikësohem përgjimit të tyre nga të zijtë... Përndryshe, sikur më duket, me atë rast po ekziston mundësia të mendohemi dhe t'i shtrojmë ato në letër, duke patur mundësi të peshohen. E kundërta po ndodh në takime, së paku në takimet gjertanishme, atmosfera në takime, përkatësisht puna, më duket të ketë shkuar si në mulli – pa rregull, ku bluhet pa rend e pa ujem. Shumë biseda kanë qenë në nivel aq të ulët, sa as ndonjë ndejë bisede të pasdarkave në fshat, netëve të gjata të dimrit, nuk u afroheshin, qoftë për nga përmbajtja e as përnga rendi. Flitej duke u menduar aty për aty. Si rrjedhim, tablloja e bisedave ngjante në artin modern...

Edhe unë jam për një takim, siç është shoku Xhemë. Por gjersa të bëhet i mundshëm, të parapërgatitemi. Për këtë na ndihmojnë letrat.

Teorikisht jemi të gjithë për mbytje të "fryma e poshtër dhe e dëmshme e grupeve" (Xhema), ndoshta edhe me gjithë mend po dëshirojmë, por ja, sikur të kishim sehire (siç shprehen ata që besojnë në mistifikime...), nuk po ia dalim dot. Mu për këtë, duhet të gjitha forcat e aftësitë, të mendjes e zemrës, duhet t'i konkretizojmë, që njëmend të mbytim atë frymë, vërtetë të poshtër. Dhe ajo, mbytet kryesisht me punë, që merr kohën më të madhe, për të mos tepruar për "lëshime". Kuptohet, gjatë punës, duhet gjithashtu të jemi sa më vigjilentë, për të lëshuar sa më pak gabime. Gabimet, kur krijohet klimë e keqe, mund të mos kuptohen si gabime të shpëtuara, por të bëra me qëllim...

Shoku Xhemë, pos që përsëritë se takimi është i domosdoshëm, do të duhej të shkruante se si është i mundshëm, për të mos na u përsërit ato që po na ndodhin nëpër gardhiqe.

Edhe unë jam jo vetëm i mendimit, se "ose një Lëvizje e fortë e unike", (do përmirësoja vazhdimin e fjalisë të shokut Xhemë) me "udhëheqësi dhe anëtarë të seleksionuar mirë e mirë, në çdo aspekt unik, që nuk përgatisin prapaskena, por që i vishen punës-luftës si duhet..." (vazhdimin mund ta lexoni në letrën e shokut Xhemë.).

Këtu do të thoja, që për shokë e shoqe revolucionarë, militantë të Lëvizjes, po që se bien në burgje ose edhe japin jetën për çështje të popullit e atdheut, të mos përdoret shprehja "viktima". Meqë janë bërë arrestime dhe vrasje, duhet të nxjerrim konsekuenca për punë në të ardhmen, duke analizuar nëse është bërë ndokund ndonjë lëshim, në mënyrë që të eksponohen dhe pastaj të arrestohen.

Lidhur me vrasjen e shokëve Rexhep e Nebih mirë që është lëshuar Komunikata menjëherë. Atyre u qoftë lavdi – lum populli që ka në gjirin e tij të tillë trima! Edhe pse nuk e mora Komunikatën, aq sa munda të mbaj mend kur m'u lexua në telefon, nuk m'u duk praktike të shkruhet se Shoku Nebih ka qenë anëtar Shtabi... (kështu diç ngjashëm). Thënë të drejtën, ndoshta edhe u nxitova kur ia thash shokut Xhemë atë mendim, por edhe tani, disi nuk po jam në gjendje të vlerësoj nëse është shkruar më shumë se sa do të ishte praktike, përkatësisht sa do kërkonte taktika e momentit. Vetë nuk do dija si do të shkruaja në atë gjendje.

Sa për "fraksionin" që përmend Salihu, unë kam shkruar ca më gjerësisht në letrën e kaluar, por kjo që shkruan shoku Xhemë këtu, është përmbledhur thukt e qëlluar, duke qenë edhe vet i të njejtit mendim.

Sa për "punëtorët që kanë mbetur rrugëve të botës...", nuk dij çfarë të them. Së pari, ata nuk i nxuarëm ne. Pastaj, gjendja se shkonte e keqësohej, duke kushtëzuar shtimin e papunësisë së madhe në Kosovë. Nisur nga kjo, edhe perspektiva e kthimit të menjëhershëm për t'u punësuar, nuk ka qenë aq e ndritur. Ndoshta vetëm në mënyrën që t'ua plaçkitin edhe ato pak deviza që kanë mundur t'i ruajnë, do punësonin disa, në dam të papunëve në vend. E ata pastaj do të detyroheshin, gjithashtu, të marrin botën në sy (në Libi e gjetiu, ku është duke ua gjetur vendin klika e Beogradit...). Pra, marrë në interesin e përgjithshëm kombëtar, prap i njëjti rezultat, dua të them e njejta e keqe, plus hallit të të rinjve për t'u bërë mërgimtarë – jetë shumë e vështirë. Meqë jemi optimistë se do fitojmë, sigurisht që vetëm në atë mënyrë është perspektiva më e mirë që të kthehen të gjithë. Prandaj, t'i ruajmë duhet, por t'i "kursejmë" duke i frikësuar..., nuk kemi nevojë, përkatësisht nuk duhet. Është koha kur duhet të qëndrojmë, të rezistojmë, t'i tregojmë botës se nuk mund të na nënshtrojnë, për çka duhet sakrifikuar!

Mendoni edhe njëherë mirë, se si është i mundur takimi. Unë, përfundimisht ende nuk kam të rregulluar asgjë, por aty ku do të vendosni të takohemi, do të jem, i gjallë a i vdekur, siç do t'i thonë një fjale. Nuk do të gaboj si kësaj radhe, jo vetëm për fajin se nuk kam ditur si t'i ik asaj që kam marrë me mend dhe që kam mundur t'i ik...

Po ua dërgoj edhe kopjen e letrës, dërguar shokut Mërgim.

Iljazi (Ibrahim Kelmendi)

(Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 416-417)

33. Letër e Ibrahim Kelmendi për Komitetin Qendror ("Dukagjinin"), 19 mars 1984

PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!

Në mërgim..., më 19.3.1984

Të dashur shokë,

shpejt e shkurt po ju shkruaj këtë letër.

Së pari, tani më ra në dorë "Organi" "Republika e Kosovës", që del si "organ i Komitetit – Deges së LRSSHJ: "Murat Mehmeti"". Vetëm sipërfaqësisht ia hodha një vështrim. Po ua dërgoj nga një kopje që ta lexoni edhe ju, në mënyrë që pa vonuar të shprehni mendimin tuaj. Ma merr mendja se është një hap jo vetëm i gabuar i atyre që kanë vendosur ta nxjerrin, jo vetëm që ka shkelur çdo diciplinë e rregull elementare, por edhe pse ka qëllime të mbrapshta e hileqare. Sikur të ishim distancuar nga "Punëtorët" me kohë, do të thoja se pa ndonjë ngurrim, që në numër të parë të ZK duhet të informojmë lexuesit se kjo pamflete nuk ka të bëjë me LRSHJ-në, praktikisht nuk ka komitet të ndonjë rrethi që quhet "Murat Mehmeti" (nëse me të vërtetë nuk ka të njëmendët, pos në qoftë se e ka formuar Musa Hoti; nëse ka formuar komitet të Lëvizjes Musa Hoti, atëherë jam kategorisht që mos ta njohim), e aq më pak është marrë ndonjë pëlqim për të nxjerr "organ" të tillë.

Pasi nuk patëm kohë për të biseduar, propozoj gjithashtu që artikujt që kanë shpërndarë Mërgimi e Musa Hoti, duke keqpërdorur simpatizantë të Lëvizjes, që mu më kanë rënë në dorë gjithsejt tetë, të mos pranohen se i ka nxjerr Dukagjini, "në emër të të cilit" janë shpërndarë. Sa për përmbajtjen e atyre artikujve dhe këtij "organi", mendojn se nuk duhet të shkruhet, pasi do të fillohej të polemizohej, ose do të kishte karakter polemizues njoftimi që do bëhej.

Tani jemi në prag të 3-Vjetorit të demonstratave të përgjakshme të Kosovës. Besoj se pos një kryeartikulli që duhet të botohet në ZK, do të duhej të organizohen akivitete. Sa për demonstratë, pasi nuk ka ndonjë aktivitet ndërkombëtar, përkatësisht ndonjë tubim ndërkombëtar, nuk do më dukej e domosdoshme të thirret ndonjë darsëm. Sikur të kishim biseduar dhe përgatitur teren, marrë parasysh "disponimin" momental të opinionit austriak, sidomos do të kishte qenë mirë të thërrisnim një darsëm atje. Por, po e patë të arsyeshme, nuk do të duhej ta qesim në harresë ndonjë darsëm, ose t'i koncentrojmë forcat, që në mënyrë më të përgatitur se herave të tjera, të dalim në demonstratë, masovikisht, për 1 Majin, bashkë me proletariatin e vendit.

Klubi ED (Emin Duraku - shën i Xh D.) ka vendosur bashkë me 6-Vjetorin (si pretekst maskues) të shënon 3–Vjetorin e Demonstratave në Kosovë, me karakter të gjerë. Çfarë mendoni ju?

Pranoni përshëndetje revolucionare

Shoku (Ibrahim Kelmendi)

34. Letër e Ibrahim Kelmendi për Komitetin Qendror ("Dukagjinin"), 22 qershor 1984

Të dashur dukagjinas, Hamburg, më 22 qershor 1984

... Lidhur me një ZK të jashtëzakonshëm, përkatësisht numër të jashtëzakonshëm, siç e quajtët, nuk dij shumë se çka të them. Disa mendime ua thash edhe në telefon. Meqë nuk kam marrë ende ndonjë material, kot provoj të jap mendime konkrete. Por një do ta them, gabimet që mund të bëhen duke ju "përgjegjur" provokatorëve banditë nuk do t'i

mbroj, nëse ato bëhen duke u nxitur dhe duke shkruar nga pozita prej të godituri. Këtë detyrohem ta them, pasi janë shumë gabime nga e kaluara, për të cilat para Skenderi kam tërhjekur vërejtjen, por që nuk ka bërë efektin e vetë. Dhe tani ky farë Skenderi ka mundësi të na kafshoj pikërisht në ato gabime dhe në të tjerat që do t'i bëjmë, nëse nuk do të jemi më të matur e më vigjilent se sa gjer më tani.

Nuk kam çka të shkruaj më shumë, kryesisht pse nuk kam kohë dhe nuk po mund të konkretizohem më shumë në këtë rast. Kam pritur që të më bije në dorë materiali i këtij ZK para se të vehet në qarkullim dhe ndoshta do kisha mundur t'ju ndihmoj në formulim, duke dhënë edhe unë ndonjë ide.

... Me përshëndetje revolucionare, duke ju dëshiruar sukses në punët e mbara në shërbim të çështjes!

– Rroftë populli ynë heroik e liridashës!

– Rroftë LRSHJ, avangarda e popullit tonë!

I juaji Shoku (Ibrahim Kelmendi)

BIG BROTHER-i i Vitit 1984

1. Ai ishte më i sinqerti
2. Letër Shokëve dhe Shoqes së Komitetit Qendror të LRSHJ
3. RRETH HARTIMIT TË PROJEKTPROGRAMIT DHE PROJEKTSTATUTIT
4. Komiteti Qendror i LRSSHJ i dërgon njoftim më të sinqertit
5. Letër për shokë e shoqe të "KQ", (15 shkurt 1985)
6. TË DËNOHET BASHKIMI I 17 SHKURTIT DHE 15 MAJIT 1982
7. LRSSHJ tash e tutje LPRK, shtator 1985
8. Historiku i shkurtër i Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës dhe veprimtarisë së saj revolucionare
9. BIG BROTHER-i PËR PARAROJËN
10. Komunistët të cilët ia bënë varrin shoqërisë socialiste
11. Miku i mirë në ditë të vështirë
12. PROJEKTSTATUTI I ORGANIZATËS MARKSISTE LENINISTE TË KOSOVËS (OMLK)
13. "ZËRI" I BIG BROTHERIT PËR PARAROJËN
14. I NDERUAR
15. PËRSHËNDETJE – ME RESPEKT

1. Ai ishte më i sinqerti

Mustafë Xhemaili: "Vetëm kur jam arratisur nga Kosova në pranverën e vitit 1984, dhe veçanërisht në verën e atij viti, njohja me I. K., u bë aktive, në bashkëpunim të plotë dhe pothuajse krejt të natyrshme. Veprimtarinë e tij e kisha të njohur. Me rrëfimet e tij, ai vetëm më bindi nga afër se ai kishte qenë dhe ishte kapaciteti udhëheqës organizativ, i cili kishte mbetur i vetmuar, pa shokë që kishin nivelin e tij, guximin dhe këmbëngulësinë për të luftuar dhe ecur përpara, pa intelektual, dhe... me një dëshprim të madh, që ai e ndrydhte brenda vetes. Ai para meje ka qenë i hapur dhe pa ekuivok, pa makijazh dhe pa

sforcim. Mbase me dhjetëra herë m'i ka përsëritur ngjarjet që më vonë do ta marrin formën e prozës së gjatë ATENTATET. E ka bërë këtë edhe në kuadrin e punës që bënim bashkë (ishim në udhëheqje të LRSSHJ-së e pastaj të LPRK-së e OMLK-së degës jashtë vendit si dhe në Redaksinë e ZiK-ut), por e ka bërë këtë edhe si para një shoku, miku, intelektuali. Unë i besoja. Ai ishte më i sinqerti....

Shikuar në aspektin tjetër IK në atë kohë, realisht ishte lideri politik kryesor në mërgatë, gjë që për mua, thjeshtë, e bënte të kuptueshme mosrespektimin e tij të plotë të rregullave dhe disiplinës që, ne, të cilët kishim ardhur në pranverën e vitit 1984 nga Kosova (shih f. 459), përpiqeshim t'i vendosim brenda LRSSHJ-së ekzistuese, LPRK së ardhshme dhe OMLK-së Djv, ato rregulla dhe mënyra pune me disiplinë të lartë, të përditshme, milituese dhe organizative ashtu siç kishim bërë brenda në Kosovë." (ATENTATET E ZBULUARA, Fjala promovuese më 14 prill 2007 në Dyzeldorf, Gjermani, për romanin e Ibrahim Kelmendit ATENTATET, botoi "Fokus", Prishtinë, 2007, www.pashtriku.org)

2. Letër Shokëve dhe Shoqes së Komitetit Qendror të LRSHJ

Të dashur shokë,

e dashur shoqe,

meqë u përpjeka dhe si dita e përfundova së shkruari, sipas mendimit tim kryeartikullin për ZK të ardhshëm, po ua dërgoj për diskutim e (mos)aprovim.

Përse veproj kështu dhe nuk ia dërgoj vetëm Redaksisë së ZK?

Për mendimin tim, kur është në pyetje ndonjë kryeartikull me këtë përmbajtje, në të cilin shtrohen pjesë të rrugës së Lëvizjes, duhet të diskutohet nga shokët e Dukagjinit (Komitetit Qendror-shën i Xh D), pasi vetëm mendimi e vendimi i Redaksisë nuk mjafton.

Kur njeriu nuk është mjeshtër i të shkruarit, sidomos punimeve të kësaj natyre, atëherë vështirë që mund të kufizohet që përpara se sa duhet të jetë i gjatë, gjegjësisht se si duhet të shkruhet sa më i shkurtër, më i përmbledhur, duke i thënë të gjitha që duhet thënë për atë temë, në kuadër të artikullit që i dedikohet, në rastin tonë konkret ZK. Vetëm kur u thellova në materie, pash se nuk mund të përmbledhem më shkurt. E që të shkruhet për këtë në mënyrë të zgjeruar e shtruar, mendoj se është dashur edhe më heret.

Kur kisha parasysh ZK, artikujt kryesisht informativ, që nuk i ka ngjarë organit, siç i ka takuar, atëherë kisha bindjen se lodhesha kot, pasi si i tillë nuk mund të botohet – do t'u merr vend lajmeve e rubrikës letrare... Ose kisha parasysh se do t'u merr atyre që do ta përmbledhin në përmasa, që të del i gjatë aq sa e lejojnë kriteret e Redaksisë. Por, në ndërkohë, duke konsultuar "Lirinë" dhe gazetat tjera, morra frymë lirisht se mund të shkruaj "lirisht", pa patur frikë se zgjerohem tepër. Përfundimisht doli siç do ta shihni, ashtu si dij e mund të shkruaj unë. Dual i gjatë pra (përafërsisht 63000 të rënda makine; kryeartikulli i "Lirisë", "Lufta e popullit tonë është e drejtë dhe do të triumfojë", nr. 3, Maj 1981, ka së paku 75 500 të rënda makine).

Tani, siç e thash edhe në fillim, propozoj që të diskutohet e të (mos)aprovohet nga dukagjinasit, për t'u botuar ose si kryeartikull, ose si broshurë. Për të dy rastet është i domosdoshëm përpunimi i temelt (fatmirësisht tani kemi shokë të zotët për këtë punë) dhe të shohim, besoj se do të dali punim i qëlluar.

Të kthehem të mendimi që dhash në të përshkuar, se Organi i LRSHJ, ZK, nuk ka qenë organ i nivelit që i ka takuar. Për këtë që them, nuk dyshoj, por kam vështirësi të arsyetoj këtë që them, jo për tjetër sa për faktin se rrethanat kanë qenë të atilla që na kanë

kushtëzuar diç të tillë, edhe atëherë kur mund të mos kemi dëshiruar ndonjëri. Me shpresë se punët do të vëhen në binarë (pasi bajraktarët, frakcionistët, likuidatorët na u shporrën nga qafa, me ç'rast dua të shpresoj se nuk do të na ndodh diç e tillë kaq e shëmtuar në të ardhmen), nuk po zgjatem më shumë në këtë drejtim, por vetëm do të apeloj që në të ardhmen çdo herë e më në nivel ZK t'i del misionit të vet si Organ i LRSHJ. E për të kushtëzuar këtë përmirësim, është e domosdoshme që kësi artikuj të diskutohen nga dukagjinasit dhe nga anëtarët e Redaksisë, por këta të dytit duhet t'u nënshtrohen vendimeve të dukagjinasve (nuk kam nevojë të përsërisë se rasti i Numrit të "Jashtëzakonshëm", numrit 5 pra, nuk dëshiroj të përsëritet, përkatësisht duhet të angazhohemi më vendosmërisht që të mos lejojmë të përsëritet, sado kokëfortë që mund të tregohet ndonjëri nga ne – përfundimisht duhet të praktikohen me rigorozitet format demokratike të organizimit të radhëve revolucionare!)!

Edhe njëherë mbi grumbullimin, sistemimin dhe bërjen me dije të të dhënave mbi të vrarët, të burgosurit dhe të përjashtuarit nga puna e shkolla. Shoh se shumë pak e hiç interesohemi të kompletojmë këto të dhëna. Informatat nga ana e bashkatdhetarëve, nëse janë dërguar fare, atëherë janë dërguar në Redaksi. Por sistemimi i atyre të dhënave, me gjasë, nuk është bërë fare; ka mjaftuar të shkruhet në ZK shkurt, siç e ka shkruar dhe të mos sistemohen të dhënat tjera që kanë mundur të dërgohen në letrat që i janë dërguar Redaksisë. Listat që mi dha Xhema, flasin vet se sa emra kishin, si ishin të radhitura dhe a janë futur në përdorim. Tani është e domosdoshme të konkretizohemi në këtë punë, pasi në afirmimin e çështjes tonë tek opinioni ndërkombëtar, provat më kokëforta janë të dhënat e tilla. Sidomos, siç më thoshte edhe një gazetarë gjatë bisedimeve, rëndësi të madhe do të kishte grumbullimi i emrave të nxënësve të përjashtuar nga shkollat fillore dhe të mesmet. Prandaj, le të vendosim edhe njëherë që të ndërmarrim fushatë intensive për grumbullimin e të gjitha të dhënave, që kanë të bëjnë me të vrarët, të burgosurit, të përjashtuarit nga puna, shkolla e studimet. Ata të ai nga Londra shkruajnë se me rëndësi për ta është dita dhe vendi i gjykimit dhe dënimi në bazë të cilit nen është shpallur. Po kështu, ata luten që t'ju sigurojmë artikuj nga gazetat e ndryshme jugosllave, ku flitet për dënimet. Të kuptojmë se sa rëndësi ka botimi i një liste, në formë broshure. Por, sa për material plotësues, ta zëmë në vend të parathënies, pos letrës së të burgosurve, do të duhej edhe një punim tjetër; nuk e di çfarë mendoni edhe ju për artikullin – "Akuzojmë tiraninë", pra, duhet të mendohemi se si duhet t'ia bëjmë me Komitetin e Kosovës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, pasi në atë artikull për atë Komitet bëhet fjalë.

Të shiqojmë nëse kemi forca për të nxjerrë borshura në gjuhë të huaja, meqë nuk po kemi forca për ta nxjerrë buletinin e paraparë. Pra, duhet që të caktohemi, kush cilën temë do ta trajton, dhe pastaj të merremi me përkthime, shtypje e shpërndarje. Le të analizohet ky propozim dhe të merret vendim i realizueshëm. Por, në të njejtën kohë, ata që do të merren me trajtim të temave të veçanta duhet të kenë parasysh lexuesin e huaj dhe jo lexuesin shqiptar.

Uroj të ju punon shëndeti si duhet dhe gjithashtu uroj të keni sukses në punë të mbara revolucionare

Në mërgim... më 30 gusht 1984

Pranoni përshëndetjet e flakëta revolucionare, Nënshkrimi (Ibrahim Kelmendi)

3. RRETH HARTIMIT TË PROJEKTPROGRAMIT DHE PROJEKTSTATUTIT

Komiteteve të rretheve, celulave e të gjithë anëtarëve të LRSSHJ-së (letër interne)

3/4 nëntor 1984

Të dashur shokë e shoqe,

Komiteti Qendror në dy mbledhjet e veta të parafundit caktoi komisionet për hartimin e Projektprogramit (PP) dhe Projektstatutit (PS) të LRSSHJ-së. Në mbledhjen e fundit (më 3/4-11-1984) KQ i diskutoi PP dhe PS ta hartuara nga komisioni i ngarkuar. Me këtë rast u vendos që PP të lëshohet në diskutim në të gjitha komitetet e rretheve dhe në të gjitha celulat e LRSSHJ-së, kurse PS të lëshohet në diskutim vetëm në komitetet e rretheve. Po kështu, u vendos që PP dhe PS t'u jepen për diskutim edhe organizatave e grupeve revolucionare e komuniste, që militojnë vetëm në Kosovë.

Anëtarët e KQ dhe komitetet në rrethe kanë të drejtë t'ua japin për diskutim PP dhe PS edhe atyre simpatizantëve (te të cilët kanë besim të plotë dhe pritet që së shpejti do të anëtarësohen në radhët e LRSSHJ-së), nëse janë të mendimit se diskutimet, vërejtjet, sugjerimet e propozimet e tyre japin kontributin?

Diskutimet, nëpër tubime duhet të kryhen gjatë muajit nëntor, kurse rezultatet e diskutimeve, vërejtjeve, sugjerimeve e propozimeve duhet të dorëzohen më së largu gjer në fillim të dhjetorit (celulat dhe militantët që nuk militojnë në ndonjërën nga celulat, meqë ato në rrethe ende mungojnë, sugjerimet e propozimet e veta duhet t'ua dorëzojnë komiteteve të rretheve). Vërejtjet, sugjerimet e propozimet që do të vijnë pas fillimit të dhjetorit të këtij viti do ta kenë vlerën e vet, por nuk do të mund të merren parasysh, pasi në ndërkohë KQ dhe komitetet e rretheve do të mbajnë mbledhjen për të aprovuar Programin dhe Statutin e LRSSHJ-së.

Gjatë diskutimeve duhet të mbretëroj fryma e lartë e patriotizmit përparimtar dhe revolucionariteti, pjekuria e lartë ideologjike e politike, niveli i përgjegjësisë dhe demokracia e vërtetë revolucionare. Diskutimet duhet të bëhen të peshuara e të shtruara, kurse vërejtjet, sugjerimet e propozimet të jenë të përmbledhura, të thukta e koncize, tamam siç i takon nivelit të përgjegjësisë që duhet ta ketë çdo militant e militante e Lëvizjes. Ai që provon të ndrydhë frymën e demokracisë revolucionare gjatë diskutimeve, ai që provon që të tjerët të mos i lejojnë t'i shprehin lirisht mendimet, vërejtjet, sugjerimet e propozimet, do të shkelë një nga parimet themelore që ka Lëvizja jonë – demokracinë revolucionare brenda radhëve të organizuara të LRSSHJ-së.

Diskutimet rreth aprovimit të PP e PS të LRSSHJ-së janë të një rëndësie të madhe, pasi nga to do të dalin PROGRAMI e STATUTI i LRSSHJ-së, që do të thotë, do të dalë Programi i luftës, ideologjisë, politikës e taktikës që duhet të ndjekë Lëvizja jonë për të arritur qëllimin e vet të fundit – fitimin e Statusit të Republikës për Kosovën dhe të drejtat e tjera shoqëruese që do të parashohë PROGRAMI.

- Rroftë populli ynë heroik liridashës!
- Lavdi heronjve e dëshmorëve të rënë për liri e të drejta të popullit!
- Rrofshin popujt liridashës të mbarë botës!
- KOSOVA – REPUBLIKË!
- Rroftë LRSSHJ!

Përshëndetje revolucionare,

Komiteti Qendror i LRSSHJ-së

(Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 256-257)

4. Komiteti Qendror i LRSSHJ i dërgon njoftim më të sinqertit

NJOFTIM

Njoftohen shokët Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi për mbledhjen e fundit të KQ të LRSSHJ.

Më 10.2.1985 KQ (Komiteti Qendror-shën. i red.) mbajti mbledhjen e vet të rregullt. Rendi i ditës ishte:

1. Analiza e Organit Qendror dhe shqyrtimi i propozimeve të Redaksisë për ndryshimin e "Zërit".
2. Raportimi për punën e forcave të organizuara në Kosovë.
3. Shqyrtimi kritik lidhur me sjelljet dhe punën e Xhafer Shatrit dhe Ibrahim Kelmendit.

Në mbledhje nuk ishin prezentë shokët Xhafer Shatri e Ibrahim Kelmendi.

Duke pasur parasysh situatën e krijuar në KQ të cilën e ka kapluar fryma e grupeve, frymë e cila është reflektuar edhe te forcat e tjera të organizuara jashtë dhe në Kosovë, andaj është e domosdoshme të bëjmë spastrimin e radhëve nga shokët të cilët janë të ngarkuar me këtë frymë përçarëse dhe të cilët po i shkaktojnë dëme luftës sonë.

Shoku Xhafer Shatri pas ardhjes në Zvicër i hyri punës në të madhe, duke kontribuar shumë në nxjerrjen e Organit qendror "Zëri i Kosovës". Vazhdimësia e daljes së "ZK" është e lidhur drejtpërdrejt me Xhafer Shatrin. Puna organizative e forcave të organizuara në Kosovë dhe fryti që del prej tyre është i lidhur edhe me Xhaferin. Por, në punën e tij Xhaferi bëri edhe mjaft gabime e lëshime politike, duke krijuar edhe frymën e mosbesimit ndaj njerëzve. Duke e parë situatën e krijuar, Xhaferi (Shatri-shën. i red.) dha dorëheqje me shkrim.

Derisa shoku Xhafer në punën e tij që bëri e përcollën edhe gabimet, në anën tjetër shoku Ibrahim Kelmendi nuk punoi fare, por u muar drejtpërdrejt me përcjelljen e punëve dhe gabimeve të Xhaferit; u muar me thash e thëna në mesin e punëtorëve. Bëri edhe dekonspirime të sekreteve të KQ të LRSSHJ-së. **Keqpërdori ndihmat për Kosovën**, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin **e**

> ***I. Kelmendi**: "Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (**e as bir kurve**), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë **se nuk kam shpërdoruar** e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje." (Afishuar me**:** 23.03.2007 21:18, www.kosova.de)*

Suedisë në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë luftës sonë prej 50.000 korona, **prej të cilave nuk solli asnjë qindarkë**, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi; mbjellja e frymës përçarëse në vetë KQ; mospërgjegjësia ndaj punës; prishja me miq zviceranë; mosaktiviteti me të huaj dhe krijimi i ftohjes së tyre ndaj luftës sonë dhe organizatës sonë; qëllimi pretendues i formulimit të fjalisë: "Vërejtjet, sugjerimet e propozimet që do të vijnë pas fillimit të dhjetorit të këtij viti do të kenë vlerën e vet, por nuk do të mund të merren parasysh, pasi në ndërkohë KQ dhe Komitetet e rretheve do të mbajnë mbledhjen për të aprovuar Programin e Statutin e LRSHJ-së" me të vetmin qëllim që të sabotojnë punën e diskutimit dhe shqyrtimit të PP dhe PS dhe në anën tjetër për të shfrytëzuar tubimin e zgjeruar për diskreditimin e Xhaferit me gabimet që ka bërë. Në KQ nuk qe vendosur të thirrej tubimi i KQ me Komitetet e rretheve të cilën gjë shoku Ibrahim Kelmendi e bëri pa dijen e shokëve duke u thirrur se gjoja qenka vendosur në mbledhjen e KQ, gjë e cila nuk ishte e vërtetë. Qëllimi i gjithë kësaj ishte ai

që cekëm më lart, diskreditimi i Xhaferit para një tubimi më të gjerë. Kjo tregon se si disa njerëz veprojnë pas shpine pa u konsultuar me shokë, e këtë e bëri shoku Ibrahim Kelmendi.

Për shkak të krijimit të mosbesimit ndaj njerëzve, lëshimeve dhe gabimeve politike si dhe mbjelljen e frymës përçarëse KQ vendosi që të ndërmarrë masa për nxjerrjen e KQ nga situata e krijuar dhe të bëjë spastrimin e radhëve nga mospunëtorët dhe përçarësit.

Kështuq KQ i LRSSHJ me shumicë votash 4:1 (katër me një) vendosi që shokët Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi përjashtohen nga KQ i LRSSHJ-së, përderisa të mos e vërtetojnë të kundërtën me aktivitetin e tyre.

10 shkurt 1985 Zvicër

KQ i LRSSHJ (Komiteti Qendror i Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi)

(Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f .253-254)

***I. Kelmendi**: "Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (**e as bir kurve**), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë **se nuk kam shpërdoruar** e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje." (Afishuar me**:** 23.03.2007 21:18, www.kosova.de)*

5. Letër për shokë e shoqe të "KQ", (15 shkurt 1985)

dëshiroj t'ju bëjë me dije se Njoftimin e mora dje, më 14-02-1985, lidhur me vendimin që kishit marrë në mbledhjen e rregulltë të "KQ", të mbajtur më 10-02-1985.

...Tani më duket e nevojshme t'i bëjë disa pyetje, që do të shërbejnë në sqarime plotësuese lidhur me vendimin që keni marrë:

- A kam të drejtë të jem edhe më tej anëtar i komisionit për përgatitjen përfundimtare të Projektstatutit të LRSSHJ-së?...

- A kam të drejtë të merrem me punime teorike, organizative e të aktiviteteve, të cilat do t'ia dorëzoja forumit udhëheqës më të lartë të LRSSHJ-së?...

- A mund t'i vazhdoj përpjekjet për regjistrimin zyrtar të LRSSHJ-së në njërën nga shtetet e Evropës Perëndimore?

- A do të vazhdohet të më jepen ndihmat e domosdoshme për të mundur të vazhdojë veprimtarinë në shërbim të LRSSHJ, deri sa të kem bindjen (si tani) se ajo nuk ka devijuar nga vija që përcaktohet nga Programi që aprovuam para pak kohe?...

Edhe njëherë - ju uroj sukses vetëm në punët e mbara, dalshim fitimtarë e faqebardhë në veprimtarinë tonë vërtet patriotike e revolucionare!

-Kosova – Republikë!

- Rroftë LRSSHJ!

Përshëndetje revolucionare Shoku (Ibrahim Kelmendi)

(Letër KQ të LRSSHJ, 15 shkurt 1985; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 419-420)

6. TË DËNOHET BASHKIMI I 17 SHKURTIT DHE 15 MAJIT 1982

KOMITETEVE DREJTUESE DHE KOMITETEVE TE RRETHEVE TE LRSSHJ-së
Shokë dhe shoqe,

Kohëve të fundit, në KQ të LRSSHJ-së, nga grupe individësh në botën e jashtme kanë ardhur kërkesa (gojore e me shkrim) me dëshirën për të ardhur deri te një bashkim. Këto grupe gjatë viteve 1982 e 1984 dolën nga LRSSHJ dhe një pjesë e tyre nxori organin "Punëtorët" e një pjesë tjetër nxori në Suedi gazetën me të njejtin emër si të organit të LRSSHJ-së "Zëri i Kosovës" duke formuar një "Lëvizje" të re për Republikën e Kosovës.

Të gjithë ata që po kërkojnë bashkim nuk kanë shtruar asnjë kusht.

Duke e ditur dëshirën dhe vullnetin e mirë të elementëve dhe kuadrove të shëndoshë, patriotëve dhe revolucionarëve, posaqërisht nga radhët e klasës punëtore që punon dhe vepron këtej, si dhe duke e parë të nevojshme dhe parimore që secilit që dëshiron për të luftuar në një front të përbashkët për realizimin e kërkesave të popullit të Kosovës, t'i krijohet mundësia për t'u bashkuar në organizatën gjithëpopullore – LRSSHJ, KQ është i mendimit që t'i marrë parasysh këto kërkesa që janë bërë dhe, juve, shokë e shoqe po ua paraqesim si Propozim për diskutim këto KUSHTE që do t'u parashtronim këtyre grupeve për BISEDIME rreth bashkimit.

Grupet që kanë kërkuar bashkimin, a janë grupe me celula apo pa celula. Nëse janë grupe pa celula, atëherë nuk mund të shtrohemi për bisedime si me palë.
Nëse këto grupe me celula, e konsiderojnë veten organizata (pavarësisht se këto dikur qenë ndarë nga gjiri i LRSSHJ-së), le ta dëshmojnë ekzistencën e vetë dhe punën e tyre si organizata duke treguar rrjetin e tyre organizativ, si jashtë ashtu edhe brenda.

(Këtë punë verifikimi duhet ta kryej një komision i posaçëm i LRSSHJ-së, dhe pastaj (të vendosim se a të) të shtrohemi apo të mos shtrohemi për bisedime).

Gjatë bisedimeve rreth bashkimit si kushte do t'u paraqesim këto:

Të dënohet bashkimi i 17 shkurtit dhe 15 majit 1982, i cili ishte një bashkim krerësh e jo organizatash dhe nuk ishte aspak bashkim e organizim i masave.
Një bashkim dhe organizim të masave, si jashtë ashtu edhe brenda, e patë shtruar drejtë në verën e vitit 1981 OMLK në "Teza rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës" dhe në përpjekje e sipër për t'i vënë në jetë ranë shokët: Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla. Këto "Teza..." u shkelën pikërisht një muaj pas rënies së tyre, në bashkimin e 17 shkurtit 1982.

Të definohet se çfarë organizate po ndërtojmë: Parti a organizatë të masave apo front popullor i gjithë masave.

Të ndërpritet agjitacioni e propaganda dhe veprimet kundër marksizëm-leninizmit, veprime këto që shkojnë në dëmë të unitetit dhe luftës sonë për Republikë.

Në bisedime të marrin pjesë nga tre përfaqësues prej secilës palë.

Në bisedime nuk mund të marrin pjesë krerët e bashkimeve të 17 shkurtit dhe 15 majit 1982.

Ndonjë bashkim eventual mund të bëhet dhe shpallet vetëm si bashkim i emigracionit përparimtar jashtë Kosovës dhe i organizuar në kuadër të një dege të jashtme të LRSSHJ-së që duhet të ndërtohet, zgjerohet dhe funksionoj brenda në Kosovë.

Nëse këto kushte, që do t'u vihen për bisedime atyre që po kërkojnë bashkimin do të diskutohen, plotësohen dhe të bëhen vërejtjet dhe orientimet e nevojshme edhe nga

ju (që të aprovojmë unanimisht) ne do t'u hyjmë bisedimeve për bashkim; në të kundërtën duhet t'u themi qartë përse nuk duam as bisedime, as bashkim!

Përshëndetje revolucionare
KQ i LRSSHJ
Prill 1985
(Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 255-256)

7. LRSSHJ tash e tutje LPRK, shtator 1985

NJOFTIM INTERN PËR ANËTARËT DHE AKTIVISTËT E LËVIZJES ME DISA NDRYSHIME QË DO TË BËHEN NË ORGANIZATËN E MASAVE LRSSHJ SI DHE NË ORGANIN E SAJ "ZËRI I KOSOVËS"

Shokë dhe shoqe!

Duke pasur parasysh se më 17 shkurt 1982, gjatë bashkimit të organizatave, u bënë gabime si në emërimin e organizatës së re ashtu dhe në formimin e saj:

Duke pasur parasysh, veçanërisht se duhet të përcaktohet qartë karakteri i organizatës dhe të organit të saj "Zëri i Kosovës", që nga 17 shkurti e gjer më sot, si dhe rrymimet ideologjike, politike dhe organizative brenda dhe jashtë;

Duke pasur parasysh se pasojat e këtyre lëshimeve dhe gabimeve në të kaluarën do të frenojnë ecjen përpara drejt Republikës së Kosovës;

Duke pasur parasysh edhe situatën që u krijua në ndërkohë nga veprimtaria e regjimit serbomadh të Beogradit kundër Lëvizjes: Patriotët, komunistët dhe të gjithë liridashësit që veprojnë jashtë Kosove, vlerësuan drejt gjendjen jo të mirë të unitetit dhe të bashkimit, të kurbetçinjve dhe të të arratisurve dhe, përgjithësisht të Lëvizjes; vlerësuan drejt nevojën e bashkimit të të gjitha forcave të shëndosha patriotike e komuniste dhe që janë për Republikën e Kosovës, si dhe në anën tjetër, dëshirën e flaktë dhe kërkesat e parreshtura që të kapërcehen të gjitha vështirësitë në luftën tonë të drejtë për Republikë në kuadër të RSFJ-së.

Në konsultime të dobishme sqaruese dhe parimore me të gjithë ata që donin bashkimin e vërtetë rreth parullës famëmadhe "KOSOVA–REPUBLIKË" si dhe orientimet e shokëve nga Kosova, u arrit një bashkim dhe unitet mendimi dhe veprimi. Kështu pjesa më e vetëdijshme e patriotëve dhe komunistëve të Kosovës që veprojnë jashtë, në muajin shtator të këtij viti, mbajtën MBLEDHJEN E PARË RIORGANIZUESE TË KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM, në të cilën morën pjesë edhe shokë të rinj në përbërjen e udhëheqësisë së organizatës dhe u vendos:

I

Organizata "Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi" tash e tutje të emërtohet "LËVIZJA POPULLORE PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS".

Termi LËVIZJE POPULORE shpreh më mirë karakterin e organizatës sonë të të gjitha masave popullore, formën e organizimit të tyre. Ky emërtim përmban emërtimin e drejtë politik e organizativ në luftën për Republikën e Kosovës, ku duhet të përfshihen të gjitha masat popullore pa dallim klase, bindjeje politike, feje e krahine, ndërsa më parë lihej vend për shumë interpretime.

Të hiqet termi SOCIALISTE, sepse vetë fakti se detyrë e drejtpërdrejtë kërkesë e jona është Konstituimi i Republikës në kuadrin e RSFJ-së, pra në të njëjtin sistem

ekonomiko-shoqëror, e përjashton këtë term në emërtimin e organizatës gjithëpopullore. Në Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës, do të bëjnë pjesë të gjitha organizatat dhe grupet ilegale komuniste, patriotike e revolucionare, pavarësisht nëse është Republika qëllimi i tyre i fundit ose jo, pavarësisht nëse janë ose jo për socializmin e vërtetë.

Në vend të SHQITARE duhet të thuhet e KOSOVËS, pasi termi SHQIPTARE nuk është i sakt, për emërtimin politik e administrativ të Republikës së Kosovës dhe si emërtim nuk parqet drejt ekskluzivitetin e përbërjes nacionale të republikës së ardhshme të Kosovës, njëkohësisht i jep material armikut të akuzoj se populli shqiptar në Jugosllavi po kërkon të shpërngulen të gjitha pakicat kombëtare nga trojet e banuara me shqiptarë. Përkundrazi, Republika e Kosovës do të jetë edhe e pakicave kombëtare që jetojnë në të dhe nga e cila do të kenë dobi. Pra, për emërtim më të sakt politik, administraiv e gjeografik të trojeve shqiptare të coptuara e të sunduara nga tri republikat: e Serbisë, e Maqedonisë dhe e Malit të Zi, duhet të përdorim termin REPUBLIKA E KOSOVËS.

Të hiqet termi NË JUGOSLLAVI, sepse kuptohet qartë se Republika e Kosovës kërkohet në kuadrin e RSFJ-së.

II

Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës ta udhëheq KËSHILLI I PËRGJITYHSHËM, KRYESIA E KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM,

sepse:

Emërtimet për udhëheqjen e LRSSHJ-së: KOMITET DREJTUES, KOMITET QENDROR, nuk ishin adekuate për një organizatë me tipare të organizatës së masave. Kështu, këto emërtime për udhëheqjen e LRSSHJ-së nuk shprehin rolin e njëmendshëm për një organizatë të masave.

Termi KËSHILLI I PËRGJITHSHËM, për përbërjen e gjerë të udhëheqësisë së LËVIZJES PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS (LPRK) është adekuat me rolin që do të luaj në drejtimin e organizatës, ndërsa përbërja e ngushtë e kësaj udhëheqësie, KRYESIA E KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM, do të kryej detyrat praktike për orientimin, zbatimin dhe kontrollimin e punëve dhe rrjedhës së tyre në organizatë.

LRSSHJ, pavarësisht oshilimeve politike dhe organizative, megjithatë luajti rol të rëndësishëm në mobilizimin e masave, i bëri ato edhe më të vetëdijshme për rolin e tyre në bashkimin e forcave për t'i dalë krah për të luftuar për Republikën e Kosovës. Ajo dha kontribut sidomos në organizimin e demonstratave anekënd Evropës Perëdnimore, edhe më gjërë si dhe në organizimin e tubimeve përkujtimore për shokët e rënë e të burgosur nga terrori shovinist serbo-maqedono-malazez. Prandaj, në këtë drejtim roli i LRSSHJ-së ishte i madh.

Këto ndryshime që po bëhen, Lëvizjen do ta ngrejnë edhe më lartë në aspektin e vijës politike e organizative.

III

Gazeta "ZËRI I KOSOVËS", organ i organizatës së masave të vazhdojë të dalë me të njëjtin titull,

sepse:

Si emërtim të një organizate të tillë shpreh më së miri, edhe me titullin e vet, zërin e vërtetë të popullit shqiptar në Jugosllavi.

IV

Parulla "PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE DHE POPUJ TË SHTYPUR, BASHKOHUNI" të hiqet nga ballina e gazetës dhe të mos vihet kurrfarë parulle,

sepse:

Heqja e saj do të shkonte në dobi të përfshirjes dhe të bashkimit të të gjitha klasave e individëve me bindje të ndryshme politike e fetare, dhe nga ana tjetër nuk ka nevojë të vihet kurrfarë parulle, sepse vetë emërtimi i organizatës "Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës" shpreh më së miri qëllimin e kërkesës së popullit tonë.

V

Gjithashtu nga ballina e gazetës të hiqet pushka-shtizë në Flamurin Kombëtar dhe ky te vihet në një shtizë të zakonshme, mbajtur në dorë,

sepse:

Kërkesa e popullit tonë KOSOVA–REPUBLIKË nuk e nënkupton në vete dhe nuk është një kërkesë për ndërrimin rrënjësor revolucionar me armë në dorë. Konstituimi i Republikës së Kosovës, edhe pse është një hap përpara, progresiv, një hap revolucionar (në mënyrë revolucionare e kërkoi populli), por nuk është edhe vetë revolucioni. Ajo mbetet si qëllim, detyrë dhe si kërkesë demokratike e kombëtare që hap perspektivën e zhvillimit kombëtar dhe shoqëror të popullit shqiptar në Jugosllavi.

VI

Gazeta "ZËRI I KOSOVËS" të dalë si organ i organizatës "LËVIZJA POPULLORE PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS".

Organi i LRSSHJ-së "Zëri i Kosovës" si gazetë që dalëngadalë mori tiparet e një gazete politike-informative për masat e gjëra është bërë një tribunë ku masat e gjëra popullore e gjejnë veten, ku ato informohen për situatën aktuale, një tribunë ku qartë del domosdoshmëria e formimit të Republikës së Kosovës në kuadër të RSFJ-së.

Oshilimet që kishte, sidomos në formën e tij, ishin përpjekje për të gjetur me këmbëngulje vijën e drejtë e të qartë të detyrës që kishte mbi vete si organ për informim e mobilizim të të gjitha masave. Të metat që kishte në këtë drejtim, nuk mund ta zbusin rolin e madh që luajti deri tash "Zëri i Kosovës".

Me ndryshimet që po bëhen "Zëri i Kosovës" edhe më mirë do ta kryejë detyrën në propagandimin e drejtë e të qartë të vijës politike e organizative të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës.

* * *

Këto ndryshime janë rezultat logjik i fazës më të pjekur të luftës sonë dhe i kërkesës këmbëngulëse të popullit tonë që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës në kuadër të RSFJ-së.

Të gjitha këto ndryshime që po bëhen në organizatën tonë dhe në organin e saj "Zërin e Kosovës", shprehin realisht si asnjëherë më parë thelbin dhe karakterin e vërtetë të luftës sonë, të kërkesave të drejta gjithëpopullore të popullit shqiptar në Jugosllavi për Republikën e Kosovës në kuadrin e RSFJ-së.

Është e qartë se vetëm bashkimi, uniteti i popullit rreth parullës "KOSOVA–REPUBLIKË", vetëm fryma vëllazërore e organizimit rreth saj janë vendimtare në realizimin e statutit të Republikës në kuadrin e Federatës.

Thirren të gjithë ata, të cilët vërtet duan të luftojnë për të mirën e Kosovës, për lirinë e saj, që të lënë mëritë, t'i flakin mënjanë urrejtjet e hasmëritë e tjera dhe pa dallim bindjeje politike, feje e krahine, t'i bashkohen luftës për Republikën e Kosovës.

RROFTË LËVIZJA POPULLORE
PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS!
RROFTË "ZËRI I KOSOVËS"!
KOSOVA REPUBLIKË!

KËSHILLI I PËRGJITHSHËM I LËVIZJES POPULLORE PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS Shtator, 1985
(Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 272-275)

Emrush Xhemaili: "*1985: Hysen Gërvalla kooptohet në Komitetin Qendror të LPRK-së."* (20 vjet veprimtari 1982-2002)

8. Historiku i shkurtër i Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës dhe veprimtarisë së saj revolucionare

Bërthama revolucionare, paraardhëse e OMLK-së, më 1969 u muar me organizimin e demonstratave të 27 nëntorit 1968, por realizimi i tyre për shumë shkaqe dështoi.

Ky dështim për bërthamën revolucionare ishte një mësim i mirë për luftën e mëtutjeshme. Kështu që posa dolën nga burgu ata më parë u morën drejtpërdrejt me organizimin duke formuar më 1972 "Grupin Revolucionar" (GR).

GR-ja duke aplikuar metodat marksiste-leniniste të veprimtarisë ilegale si dhe duke u bazuar dhe mbështetur fuqimisht në mësimet e klasikëve të marksizëm-leninizmit arriti që të krijoj një rrjetë të fortë dhe të qëndrueshme organizative, e cila jepte shpresa se më në fund do të sigurohej një vazhdimësi e sigurtë e veprimtarisë revolucionare në Kosovë.

Me konsolidimin e radhëve dhe me sprovimin e anëtarëve në aksionet masive të shpërndarjes së trakteve dhe shkruarjes së parullave gjatë viteve 1973 dhe 1974, GR-ja u muar edhe më me intensitet në forcimin e propagandës së shkruar, duke nxjerrë edhe Organin e vet "Zërin e Kosovës".

GR-ja si e tillë arriti të nxjerrë vetëm një.. numër të Organit "Zëri i Kosovës", pasi që bërthama udhëheqëse revolucionare burgoset në maj të vitit 1974.

Pasi që GR-ja kishte aplikuar katërcipërisht metodat dhe mësimet marksiste-leniniste të veprimtarisë revolucionare ilegale, në këtë mënyrë edhe u ruajt kontinuiteti i veprimtarisë.

Për një kohë të shkurtër, shokët e mbetur ia arritën të rivendosnin lidhjet dhe të konsolidohen radhët dhe të hidhen në aksione të pandërprera. Një ndër këto aksione ishte edhe aksioni i madh i shpërndarjes së trakteve dhe shkrimit të parullave më 24 dhjetor 1974, në prag të gjykimit të Bërthamës Revolucionare të GR-së.

Edhe burgosjet e disa shokëve më 1975 nuk shkaktuan ndërprerjen e veprimtarisë, pasi që shokët e GR-së duke u mbështetur fuqimisht në mësimet marksiste-leniniste dhe në vijën e përcaktuar politike, ideologjike, strategjike e taktikën e GR-së që më 1972, shkuan

më tej në intensifikimin e luftës, në përsosjen e teknikës konspirative dhe organizative. Duke arritur që më 1976 GR-ja, me zgjerimin e radhëve dhe me ngritjen e kalitjen e anëtarëve, të shndërrohet në "GRUP MARKSIST-LENINIST TË KOSOVËS" (GMLK).

Gjatë viteve 1976-'78 GMLK-ja merret me përpilimin e materialeve për ngritjen teorike, ideologjike, politike dhe organizative të anëtarëve të vet. Ndër këto materiale ishin edhe: "Për zgjerim të radhëve", "Udhëzime për konspiracion", "Takimet", "Mbledhjet", "Disiplina" etj.

Më 1978, me shtimin e vëllimit të detyrave dhe me zgjerimin e mëtutjeshëm të radhëve të GMLK-së, u paraqit nevoja e domosdoshme e organizimit në nivel më të lartë organizativ dhe e shndërrimit të GMLK-së në "ORGANIZATË MARKSISTE-LENINISTE TË KOSOVËS" (OMLK), pasi që Grupi si grup nuk ishte në gjendje të përthekojë e të kryej me sukses të gjitha detyrat që i dilnin përpara dhe që i parashtronte koha.

Komiteti drejtues i OMLK-së, duke ndier nevojën për ngritjen teorike, ideologjike e organizative të anëtarëve, në fund të vitit 1978 nxori numrin e parë të "Pararojës", Organ për radhët e saja të brendshme.

Për punën e drejtpërdrejtë me masat e gjera popullore të shtresave të ndryshme, para OMLK-së u shtrua si nevojë e domosdoshme edhe nxjerrja e Organit të masave, gjë të cilën OMLK e bëri në vitin 1980, kur edhe nxori numrat 1 e 2 të "Lirisë".

Ishte pikërisht "Liria", Organ i OMLK-së për masat e gjera, e cila bëri ndikim të madh tek masat, duke e ngritur në një shkallë edhe më të lartë vetëdijen kombëtare e klasore të popullit. "Liria" ndikimin më të madh e bëri në mesin e rinisë shkollore e studenteske, pasi që edhe ishte shpërndarë, lexuar dhe kërkuar më së shumti nga kjo shtresë e popullsisë.

OMLK gjer në janar të vitit 1982 nxori gjashtë numra të "Lirisë", kur edhe bëhen burgosjet masive në Kosovë, viktimë e të cilave ishin edhe shumë shokë të OMLK-së. Po në janar UDB-ja organizoi edhe likuidimin fizik të komunistit Kadri Zeka me vëllezërit Gërvalla, gjë të cilën e realizoi më 17 janar 1982 në Gjermani.

> Mehmet Hajrizi: "*Në natën e 17 janarit 1982, në Untergrupenbach të Gjermanisë, kanë ndodhur tri ngjarje historike për Kosovën: në bazë të Tezave të Frontit Populllor për Republikën e Kosovës, u arrit marrëveshja e tri organizatave çlirimtare shqiptare, u vranë tre sendërtuesit e atij bashkimi dhe **pushoi së vepruari OMLK**...."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 11) Mehmet Hajrizi: "*Më 1982, nga udhëheqja e saj, Organizata kishte të lirë vetëm Kadri Zekën, të cilit i binte barra e riorganizimit të radhëve dhe e realizimit të projektit të Frontit të bashkuar. Në krye të kësaj detyre, Kadri Zeka është vra bashkë me Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën, më 17 janar 1982, pasi (sipas dëshmisë së bashkëveprimtarit të tyre, Ibrahim Kelmendit) kishin arritur marrëveshjen e bashkimit. Ata u vranë me qëllim që të dështonte bashkimi i radhëve të Lëvizjes."* (E njëjta vepër, faqe 307)

Pas vrasjes së shokut Kadri Zeka dhe burgosjes së shumë shokëve të OMLK-së në Kosovë bëhet edhe shkëputja e shumë lidhjeve gjë që shkaktoi ngecjen e aktivitetit intensiv.

Në kohën kur shokët brenda merreshin me rivendosjen e lidhjeve, një shok i Grupit Revolucionar ia arriti të arratiset nga burgu dhe të dal në Perëndim. Shokët e Degës së

OMLK-së në Botën e Jashtme e autorizuan shokun e arratisur nga Kosova që t'i përfaqësonte në bisedime për bashkimin e forcave me LNÇKVSHJ-në dhe Partisë Komuniste MLSHJ-në të cilat më 17 shkurt 1982 kishin formuar LRSHJ-në.

Edhe pse shokët e Degës së OMLK-së ia parashtruan pikëpamjet, qëndrimet dhe

> Abdullah Prapashtica: *"Ka pas tentativa të armiqve për zhbërjen e bashkimit edhe atëherë! Zhbërja e bashkimit të LRSSHJ ka dështuar edhe atëherë dhe është e destinuar të dështojë edhe sot." (www.albaniapress.com, 2 maj 2011)*

propozimet lidhur me bashkimin, shoku i autorizuar shkeli mbi qëndrimet e shokëve që e kishin autorizuar dhe ra nën ndikimin e imponuar të krerëve të LNÇKVSHJ-së dhe Partisë Komuniste MLSHJ-së, duke devijuar kësisoji vijën politike, **ideologjike** dhe organizative të Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës.

> **Mehmet Hajrizi**: "*Berat Luzha ka vendosur lidhjet e Organizatës me Partinë Komuniste të Kosovës, që udhëhiqej nga **Mustafë Xhemaili** e Rrahim Sadiku, të dytë nga Komogllava, komuna e Ferizajt. **Një tentim për kontakt kishte edhe me (Partinë Komuniste - shën im) PKMLSHJ**, por takimi ka dështuar ngase ata nuk kanë dal në takim."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 363)
>
> Pse nuk i ka dal në takim Abdullah Prapashtica, Berat Luzhës?
>
> Sepse *"Martin Quni (...) Prej Hamzë Morinës e ka marrë 'Liria nr.1' të cilën ia ka dhënë Abdullahut, e ky e ka qortuar se lexon materiale të tilla, ngase siç deklaron ky i akuzuar, **nuk u për-puthet ideologjia**."* (Aktgjykimi i PKMLSHJ, P-K nr 167/72; Ethem Çeku, SHEKULLI I ILEGALES, Prishtinë 2004, faqe 678)

Por ky "bashkim" që u imponua më 15 maj 1982, nuk ishte edhe bashkim i organizatave në fjalë, por vetëm bashkim krerësh, dhe si i tillë nuk mund të ishte i shëndoshë e i qëndrueshëm. Ky "bashkim" me LNÇKVSHJ-në dhe PKMLSHJ-në do të ketë pastaj pasoja të mëdha për Degën e OMLK-së në Botën e Jashtme, e cila ra nën ndikimin dhe manipulimet e shokut të porsaarratisur nga burgu.

Duke pasur besim të tepruar në aftësitë e tij, shokët e Degës së OMLK-së ranë në pozita oportuniste dhe toleruan për dy vjet me radhë manipulimet dhe manovrimet antimarksiste të këtij shoku. Kësisoji edhe u dezorientuan në veprimtarinë e tyre e në këtë mënyrë edhe ndikuan tek shokët brenda. Dezorientimi dhe dezinformimi i shokëve si brenda edhe jashtë, solli amulli në mendime dhe veprime.

> Abdullah Prapashtica: "*Ka pas tentativa të armiqve për zhbërjen e bashkimit edhe atëherë! Zhbërja e bashkimit të LRSSHJ ka dështuar edhe atëherë dhe është e destinuar të dështojë edhe sot." (www.albaniapress.com, 2 maj 2011)*

Duke e parë një devijim të tillë të vijës politike, ideologjike e organizative, shokët e Grupit Revolucionar që dolën nga burgu në vitin 1983, u morën me riorganizimin, konsolidimin dhe bashkimin e grupeve komuniste të mbështetur në parime marksiste-leniniste. Duke u marrë me këtë detyrë mjaftë të rëndë për kushtet e krijuara në Kosovë

pas burgosjeve të mëdha, që ishin bërë pas demonstratave të Pranverës së vitit 1981, ata synuan formimin e një pararoje udhëheqëse të luftës duke u mbështetur në vijën politike, ideologjike dhe organizative të përcaktuar nga OMLK, si dhe formimin e "Frontit Antirevizionist", si front të gjerë të masave. Për një kohë shumë të shkurtër ata arritën të bashkonin një numër të konsiderueshëm grupesh komuniste dhe ishin në prag të realizimit të pikësynimeve organizative të pararojës dhe frontit, por arrestimet masive të dhjetorit 1983, vrasja e shokëve Rexhep Mala e Nuhi Berisha më 11 janar 1984 si dhe burgosjet e shokëve me Kadri Manin-Osmanin që pasuan në janar e shkurt 1984, shkaktuan ngecjen e veprimtarisë në këtë drejtim. Njëkohësisht me shpartallimin e lidhjeve të grupeve, celulave dhe individëve iu mundësua disa individëve në Perëndim të dezinformonin dhe manipulonin me shokët brenda. Sidomos dezinformimi që u bë shkaktoi një mosbesim te grupet dhe individët dhe u bë pengesë e një bashkimi të vërtetë komunist, bashkim i cili kishte gjasa të vendoste sërish një vazhdimësi kontinuale të veprimtarisë revolucionare në Kosovë dhe degëve jashtë.

Duke mos u arritur një bashkim i tillë komunist që edhe synohej nga grupet, celulat dhe individët, grupet, celulat dhe individët e OMLK-së u morën me riorganizimin dhe konsolidimin e radhëve të OMLK-së. Pas vetes ata kishin një mori aksionesh të suksesshme të kryera para vitit 1984, gjatë vitit 1984 dhe sidomos gjatë vitit 1985 e në fillim të 1986-ës.

> Abdullah Prapashtica: "*Ka pas tentativa të armiqve për zhbërjen e bashkimit edhe atëherë! Zhbërja e bashkimit të LRSSHJ ka dështuar edhe atëherë dhe është e destinuar të dështojë edhe sot." (www.albaniapress.com, 2 maj 2011)*

Në vitin 1984 deri në maj 1985 shokët e OMLK-së pos aksioneve konkrete u morën edhe me përhapjen aktive të literaturës marksiste-leniniste, "Zërit të Kosovës" dhe sidomos të botimeve të shumta të OMLK-së gjatë vitit 1985, botime të cilat tani në Kosovë janë me qindra në qarkullim.

Edhe pranë devijimit të vijës politike, ideologjike e organizative të OMLK-së nga përfaqësuesi i OMLK-së në bisedime me LNÇKVSHJ-në dhe PKMLSHJ-në, LRSSHJ e formuar faktikisht udhëhiqej nga Dega e OMLK-së në Botën e Jashtme.

Fakti se përfaqësuesit e LNÇKVSHJ-së dhe PKMLSHJ-së dolën nga LRSSHJ tregonte se Dega e OMLK-së kishte qenë dhe ka mbetur bërthama udhëheqëse e LRSSHJ-së (LPRK).

Në shkurt të vitit 1985 shokët e OMLK-së ishin ata që e përjashtuan shokun e tyre nga forumet e LRSSHJ-së për shkak të veprimtarisë së tij antimarksiste-leniniste dhe antilëvizje si dhe për shkak të përçarjeve të mëdha që shkaktoi me veprimtarinë e tij.

> Abdullah Prapashtica: *"Ka pas tentativa të armiqve për zhbërjen e bashkimit edhe atëherë! Zhbërja e bashkimit të LRSSHJ ka dështuar edhe atëherë dhe është e destinuar të dështojë edhe sot." (www.albaniapress.com, 2 maj 2011)*

Me përjashtimin e tij OMLK-ja u rikthye në pozitat e përcaktuara politike, ideologjike dhe organizative të përcaktuara qysh para vitit 1982.

Proletarë të të gjitha vendeve dhe popuj të shtypur, bashkohuni!" (Marrë nga libri i Faridin Tafallarit, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 282-284)

Mehmet Hajrizi: "*Intelegjencia e Kosovës... duke qenë e re dhe në formim e sipër, nuk mund të kapte problemin në gjithë* ***kompleksitetin*** *e tij teorik..."*
Mehmet Hajrizi: " ... *regjimi socialist pushtues po luftohej me socializëm*"

Berat Luzha: *"Përmes ngjyrimit ideologjik, kemi tentuar t'i kundërvihemi ideologjisë komuniste titiste."*

Teksti i betimit të Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës: *"Në qoftë se e tradhtoj Organizatën dhe idealet e lirisë, mos i shpëtofsha dorës së pamëshirshme të shokëve të ."*

Mehmet Hajrizi: "*Në natën e 17 janarit 1982, në Untergrupenbach të Gjermanisë, kanë ndodhur tri ngjarje historike për Kosovën: në bazë të Tezave të Frontit Populllor për Republikën e Kosovës, u arrit marrëveshja e tri organizatave çlirimtare shqiptare, u vranë tre sendërtuesit e atij bashkimi dhe* ***pushoi së vepruari OMLK****...."*

"Më 1982, nga udhëheqja e saj, Organizata kishte të lirë vetëm Kadri Zekën, të cilit i binte barra e riorganizimit të radhëve dhe e realizimit të projektit të Frontit të bashkuar. Në krye të kësaj detyre, Kadri Zeka është vra bashkë me Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën, më 17 janar 1982, pasi (sipas dëshmisë së bashkveprimtarit të tyre, Ibrahim Kelmendit) kishin arritur marrëveshjen e bashkimit. Ata u vranë me qëllim që të dështonte bashkimi i radhëve të Lëvizjes."

KQ i LRSSHJ (Zvicër): "*Gjatë bisedimeve rreth bashkimit si kushte do t'u paraqesim këto:* ***Të dënohet bashkimi i 17 shkurtit dhe 15 majit 1982, i cili ishte një bashkim krerësh e jo organizatash dhe nuk ishte aspak bashkim e organizim i masave****. Një bashkim dhe organizim të masave, si jashtë ashtu edhe brenda, e patë shtruar drejtë në verën e vitit 1981 OMLK në "Teza rreth Frontit Populllor për Republikën e Kosovës" dhe në përpjekje e sipër për t'i vënë në jetë ranë shokët: Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla. Këto "Teza..." u shkelën pikërisht një muaj pas rënies së tyre, në bashkimin e 17 shkurtit 1982." (*Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 255)

Ramadan Avdiu: "*Në Konferencën e parë të OMLK'së të mbajtur në* ***mars të vitit 1989*** *ku kanë marrë pjesë edhe: Afrim Zhitija, Fadil Vata, Ali Ahmeti, Hajdin Abazi, Bardhyl Mahmuti, Behajdin Allaqi, Binak Berisha etj."*
(http://pashtriku.beepworld.de/behajdinallaqi.htm)

Die Mauer, Muri i Berlinit, 16 nëntor 1989 (shtatë ditë pas tërmetit)

Abdullah Prapashtica: *"Ka pas tentativa të armiqve për zhbërjen e bashkimit edhe atëherë! Zhbërja e bashkimit të LRSSHJ ka dështuar edhe atëherë dhe është e destinuar të dështojë edhe sot."*

Jusuf Gërvalla: "*E ndër pallate të larta të kulturës*
Le t'bredhin qentë - mos e teprova
Në ekuator le të rrëshqas Antartiku
Brenda një nate le t'bashkohet Berlini"

9. BIG BROTHER-i PËR PARAROJËN

Mehmet Hajrizi: "*Berat Luzha ka vendosur lidhjet e Organizatës me Partinë Komuniste të Kosovës, që udhëhiqej nga **Mustafë Xhemaili** e Rrahim Sadiku, të dytë nga Komogllava, komuna e Ferizajt."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 363)

PARAROJA
ORGAN TEORIK DHE POLITIK I ORGANIZATËS
MARKSISTE-LENINISTE TË KOSOVËS Nr. 2. 1986

Komiteti drejtues i OMLK-së duke e parë domosdoshmërinë e një organi të brendshëm, për ngritjen teorike, ideologjike dhe organizative të radhëve të organizuara, në vjeshtë të vitit 1985 vendosi të vazhdoi nxjerrjen e Organit të OMLK-së "Pararoja", numri i parë i të cilit u nxor në fund të vitit 1978 po për të njejtat qëllime.

"Pararoja" do të bëhet udhërrëfyese e denjë e luftës sonë në të gjitha lëmitë e veprimtarisë revolucionare. Ajo mbështetet fuqimisht në **mësimet marksiste-leniniste dhe do t'u qëndroj besnike deri në fund**. Ajo do të ndihmoj në ngritjen ideo-politike të anëtarëve dhe kalitjen revolucionare të luftëtarëve të lirisë.

"Pararoja" do të përkrahë dhe propagandoj çdo lëvizje maksisite-leniniste nëpër botë, çdo sukses të tyre në luftë kundër imperializmit e socialimperializmit.

Me anë të "Pararojës" luftëtarët e lirisë në Kosovë do të njihen për më së afërmi me luftën e popujve të ndryshëm për çlirimin kombëtar e klasor; me luftën e proletariatit anë e kënd botës kundër shtypjes e shfrytëzimit kapitalisto-revizionist.

OMLK e mbështet fuqimisht politikën e brendshme dhe të jashtme të PPSH-së, si politikën më të drejtë dhe më parimore, prandaj "Pararoja" do të mbështesë dhe përkrah çdo iniciativë të PPSH-së në lëmi të ndryshme brenda shtetit shqiptar ashtu edhe në arenën ndërkombëtare. Për këtë arsye organi ynë do të botoj rregullisht edhe materiale të rëndësishme të politikës së saj të brendshme dhe të jashtme. Me anë të këtyre materialeve anëtarët e OMLK-së do të ngrihen ideopolitikisht për rezonimin e ngjarjeve dhe ndodhive të ndryshme me përmasa botërore.

Ftohen të gjithë anëtarët, kandidatët dhe simpatizantët e OMLK-së që të marrin pjesë me shkrime në ngritjen cilësore të Organit "Pararoja". Orientimi në shkrime të jetë në fushat e veprimtarisë revolucionare dhe atë sidomos në çështje teorike-ideologjike, çështje organizative, propagandistike etj. Këto shkrime duhet të bazohen dhe mbështeten fuqimisht në mësimet e marksizëm-leninizmit.

Organi "Pararoja" do të dalë në çdo tre muaj.

REDAKSIA

(Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 285)

Berat Luzha*: "Faktikisht, ne jemi vetëquajtur marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia. Kemi qenë veprimtarë të çështjes kombëtare... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*

...Rilindjen' e kam drejtuar pa asnjë problem të tillë ideologjik ...Përmes ***ngjyrimit ideologjik****, kemi tentuar t'i* ***kundërvihemi ideologjisë komuniste*** *titiste. Edhe në këtë mënyrë e kemi goditur armikun."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, faqe 220)

10. Komunistët të cilët ia bënë varrin shoqërisë socialiste

Marksistë-Leninistët e OMLK-së janë ata që më së shumti luftuan kundër shoqërisë socialiste dhe mu për këtë kishin tepër jehonë në popullatën shqiptare. Me fjalët S. B.e saj pajtohet plotësisht ideologu i OMLK-së Mehmet Hajrizi.

"*Organizata e cila pati më së tepërmi jehonë në qarqet e përgjithshme të popullatës shqiptare dhe e cila kontribuoi që rrjedhat e shoqërisë ish-****socialiste*** *në Kosovë të merrnin kah krejt tjetër, ishte pasardhësja e 'Grupit Revolucionar" që më vonë u shndërrua në Organizatën ilegale shqiptare "Organizata* ***Marksiste-Leniniste*** *e Kosovës.*" (Mehmet Hajrizi, Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 316)

Në mënyrë aq fenomenale dhe bindëse është zbërthyer kjo çështje sa nuk më ka rënë të gjej tekst më të kthjellët. I vetmi person që mund të ketë mendime më të sinqerta dhe inteligjente për 'komunistët' në fjalë është Vasil Stanilov i cili thotë se është e pamundur që në të njëjtën kohë të jesh inteligjent, i sinqertë dhe komunist.

Pse?

Sepse:

Nëse je inteligjent dhe komunist, nuk je i sinqertë
Nëse je i sinqertë dhe komunist, nuk je inteligjent.
Nëse je inteligjent dhe i sinqertë, nuk je komunist.

11. Miku i mirë në ditë të vështirë

Ramadan Pllana-Dëshmitari: *"Pra, një muaj, pas rënies heroike të dëshmorëve të lartpërmendur, më 17 shkurt të vitit 1982. Në Turqi, Sabri Novosella, në emër të LNÇKVSHJ-së, dhe Abdullah Prapashtica, në emër të PKMLSHJ-së,* ***pa e përfillur OMLK-në****, me të cilën, Jusufi e Kadriu, i kishin bashkuar aktivitetet nga viti '81, në prezencën paternaliste të diplomatit të shtetit shqiptar në Turqi, Bujar Hoxhës, - shpallin të formuar Lëvizjen për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (LRSSHJ)*." (DËSHMI TË KOHËS PËR ORGANIZATËN PATRIOTIKE LNÇKVSHJ, www.pashtriku.org, 17 mars 2009)

12. PROJEKTSTATUTI I ORGANIZATËS MARKSISTE LENINISTE TË KOSOVËS (OMLK)

...OMLK përfaqëson dhe mbron interesat e popullit shqiptar në Jugosllavi, udhëheq me LËVIZJEN POPULLORE PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS...

... Statuti i OMLK-së nuk guxon të jetë vetëm një grumbull rregullash formale, por një armë e fuqishme ideologjike e organizative në duar të anëtarëve të OMLK-së, që t'i ndihmojë në çelikosjen e disiplinës dhe në edukimin revolucionar të tyre....

... Anëtari i OMLK-së ka për detyrë:

...k) të jetë kudo shembull i mirësjelljes e moralit revolucionar-komunist, të mos e ndaj kurrë fjalën nga vepra;...

... Anëtarët e rinjë të celulës, duke përfshirë edhe ata që i kanë takuar ndonjë grupi a organizate tjetër, duhet të japin betimin...

... BETOHEM PARA SHOKËVE TË MI NË FLAMURIN KOMBËTAR DHE NË FYTYRAT E KUJTIMIN E TË GJITHË ATYRE QË DREDHËN GJAKUN PËR LIRINË E ATDHEUT DHE PËR ÇËSHTJEN E REVOLUCIONIT PROLETAR, SE SI KOMUNIST E PATRIOT DO T'I PËRMBAHEM RREPTËSISHT PROGRAMIT DHE STATUTIT TË OMLK-së..." (Projektstatut i përpiluar pas vjeshtës së vitit 1985 në Zvicër)

13. "ZËRI" I BIG BROTHERIT PËR PARAROJËN -KRIMET E KUQE-

Prof. Abdyl Kadolli: "Lëvizja kombëtare shqiptare kurrë nuk ka pasur karakter ideologjik. Nëse ndonjëherë hapen dosjet e krimeve komuniste, numri i spiunëve e bashkëpunëtorëve të paguar e të papaguar do të dilte shumë i madh. Një Rezolutë e miratuar nga Kuvendi i Kosovës do t'i përkufizonte mirë këto krime antikombëtare e antinjerëzore, ndërsa një ligj nuk do të lejonte më në pushtet personat e kompromentuar.

Kështu, ne do të çliroheshin njëkohësisht edhe nga mendësia komuniste, edhe nga mendësia sllave.

Krimet e fashizmit dhe të komunizmit nuk qëndrojnë shumë larg njëra-tjetrës...

Ideologjia komuniste pati reflektime të thella në fatin tonë kombëtar.

Komunistët shqiptarë kontribuan shumë në mbetjen me sllavët dhe nën sllavët.

Janë të tmerrshme krimet komuniste të periudhës së pasluftës, kur gjatë Kryengritjes shqiptare u masakruan e ekzekutuan rreth 50 mijë shqiptarë." (KRIMET E KUQE, Zëri i Kosovës, 20 janar 2009, www.lpk-kosova.com)

14. I NDERUAR

Letër Xhafer Durmishit, 22 tetor 2011

I nderuar ish Bashkëveprimtari Xhafer!

Lexova rreth 300 faqet e para të kakofonisë ("librit") Tënde, të emërtuar "Lëvizja e Jusuf Gërvallës", sa për të mos injoruar fare, meqë ishim bashkëveprimtarë. Do përpiqem t'i shoh edhe rreth 700 faqet tjera.

Fillimisht dëshiroj të të falënderoj për mundin dhe përkushtimin, sepse kishe investuar energji të madhe (nëse e ke sajuar vetëm).

E mirëkuptoj hidhërimin dhe mllefin Tënd, por të kaluarën nuk mund ta ndryshoj, për hatër e qejf të askujt, po vetëkuptohet, siç e kam kuptuar, përjetuar e mbajt mend.

Besoj, edhe Ti e di, se pata shkruar roman dhe jo libër historik e dokumentar dhe as memoare. Pata bërë njoftimin se janë nga mbamendja dhe përjetimet e kohës kur kanë ndodh dhe jo mendime e konstatime të kohës kur e kam shkruar romanin.

Në vend të komentimit të menjëhershëm të kakofonisë Tënde, do t'i bëja ca pyetje, nëse ke kohë e vullnet për t'u përgjigjur:

1. Kur, ku dhe nga kush është themeluar LNÇKVSHJ'ja?
2. Ka ndonjë pjesëtarë të gjallë që ka sqaruar, që është përgjigj ose që do të përgjigjet në pyetjet e mësipërme?
3. Kush di për strukturën organizative dhe veprimtarinë e saj në Kosovë?
4. Përmes cilës lidhje dhe kur e ka anëtarësuar Sabri Novosella Jusuf Gërvallën?
5. Kur, kush dhe si të ka anëtarësuar Ty në atë Lëvizje?
6. Çfarë veprimtarie të organizuar ke ushtruar në Kosovë dhe a ke ndonjë të bashk-organizuar që e di veprimtarinë Tënde të organizuar në Kosovë?
7. Kush e ka nxjerrë Sabri Novosellën deri në kufi të RPS të Shqipërisë në fund të vitit 1979, kur është "arratisur"?
8. Di emrat e ndonjë anëtari të Komitetit "Hasan Prishtina" në Turqi gjatë vitit 1980-81, për të dëshmuar se nuk ka qenë vetëm emër fiktiv?
9. Beson Ti se Qeveria Shqiptare i pat dhënë vetëm 10.000, - USD, aq sa ia kishte kërkuar Jusuf Gërvalla përmes letrës dërguar Enver Hoxhës në vitin 1980, të cilat i erdhën përmes Sabri Novosellës?
10. Beson se Qeveria Shqiptare nuk i ka dhënë më mjete asaj Organizate përmes Sabri Novosellës dhe nëse i ka dhënë, i ka shfrytëzuar ato Organizata, apo i ka mbajt për vete "udhëheqësi" Sabri Novosella?
11. Cila është veprimtaria e "bashkëveprimtarëve të ngushtë" të Jusuf Gërvallës në emigracion nga 17. 02. 1982 deri në vitin 1999, ta zëmë e jotja, Sabri Novosellës, Nuhi Sulejmanit, Xhavit Ramabajës, Besim Rexhës, Sadik Blakës, Misin Mavrës, Haxhi Berishës, Hafiz Gagicës, Fahredin Tafallarit, Demë Demaj (nuk po më kujtohen të tjerë që vetë - lavdërohen deri në monotoni)?
12. Kush duhet t'i ketë falsifikuar "raportet" e "letrat", kinse të dërguar nga Jusuf Gërvalla në vitin 1981 "udhëheqësit" Sabri Novosella dhe ku janë origjinalet e tyre?
13. Kush e ka tani arkivin e Jusuf Gërvallës?

Po shpresoj se do të kesh vullnet të mirë që t'u përgjigjesh këtyre pyetjeve?

Me respekt,

Ibrahim Kelmendi (facebook dhe www.pashtriku.org, 22 tetor 2011)

15. PËRSHËNDETJE – ME RESPEKT

Letër Xhafer Durmishit, 23 tetor 2011

Përshëndetje (Xhafer Durmishi)

Edhe për refuzimin Tënd që të përgjigje në pyetjet që të bëra, të falënderoj, meqë edhe kështu ke dhënë një pjesë të përgjigjes.

Rëndom, kur publikohen libra, bile edhe gjatë promovimit të tyre, ju jepet mundësia të interesuarve të pyesin autorët.

Besoj, analistët e vëmendshëm kanë kuptuar se sa të nevojshme janë sqarimet rreth asaj organizate, sidomos rreth themelimit të saj. Mbaj mend të ketë thënë vet Jusuf Gërvalla, se ndonjëherë edhe UDB-ja ka themeluar organizata "patriotike", për të zbuluar patriotët që dëshirojnë të angazhohen. Bile pat shtuar, se edhe atyre ua kemi parë paksa hairin, meqë edhe përmes tyre është mbajt gjallë nevoja e organizimit të vërtet.

Thënë të drejtën, në kohën që trajton romani ATENTATET, dyshoja se ajo Lëvizje është pjellë virtuale e Sabri Novosellës, për të zbuluar patriotët që kanë gatishmëri për veprimtari çlirimtare. Me keqardhje e dhimbje me duhet të pranoj, se as pas 30 viteve nuk kam mundur të informohem, se ishte organizatë e themeluar prej të vërtetëve për qëllime fisnike. E, tani pata menduar si Ti je në gjendje për të dhënë sqarime, meqë Sabri Novosella të pat plasuar në emigracion (në Evropën Perëndimore) si pasardhës politik e organizativ i Jusuf Gërvallës dhe atë pozicion e ushtrove, deri sa të skartoj "ligji" i seleksionimit (gati 2 vite), pastaj pushove veprimtarinë, meqë nuk kishe më hapësirë...

Nga ana ime, me sinqeritet (deri në naivitet), kam shpjeguar për të gjithë veprimtarët dhe veprimtarinë e asaj kohe në emigracion, po vetëkuptohet, versionin autentik, bazuar në mendimet dhe vlerësimet e mia. Edhe tani dhe kurdoherë jam i gatshëm të jap sqarime plotësuese për të gjithë të interesuarit, për aq sa di dhe duke pas parasysh përkufizimin, se sa mund të thuhet në kohë e hapësirë të caktuar. Sidomos në prag të 30-Vjetorit të Lëvizjes (popullore), që, - bazuar në përcaktimin tim, - është me 17 Janar 1982, **e quaj të dobishme të ofrohen informata, dëshmi, dokumentacion, vlerësime, të debatohet rreth tyre, për të ndihmuar ndriçimin sa më objektiv** të kaluarës sonë.

Shpresoj, kemi krijuar distancë të bollshme kohore, për të diskutuar e për të shpreh mendime e vlerësime, pa inate, pa hile, sidomos pa armiqësime.

Mirëpres angazhimin edhe të ish oficerëve të UDB-së dhe informatorëve të tyre, sidomos të atyre që me profesionalizëm kanë zbatuar ligjet përkatëse të kohës, siç i kanë zbatuar ligjet përkatëse të kohës, të miratuara nga të njëjtat struktura shtetërore, mësuesit, profesorët, nëpunësit, etj.

Uroj që debati të ketë nivel sa më të kulturuar e të kultivuar, pa fyerje e ofendime, me shpresë që secili dhe secila të jenë skajshmërisht të sinqertë.

Me respekt,

i.kelmendi@hotmail.com (facebook, 23 tetor 2011, 19.22)

BIG BROTHER-i I VITIT 1985

1. Letër nga Januz Prekazi për Xhafer Durmishin-Skenderin, 6 korrik 1985
2. Letër nga Elmaz Ademi (Zvicër) për Asllan Muharremin dhe Xhafer Durmishin (Suedi), 9 korrik 1985
3. Letër nga Hafiz Gagica për Asllan Muharremin, 9 korrik 1985
4. Letër e shokëve nga Zvicra për Xhafer Durmishin-Skenderin dhe Asllan Muharremin, 9 korrik 1985
5. Letër nga Januz Prekazi për Xhafer Durmishin-Skenderin dhe Asllan Muharremin, 11 korrik 1985 Delèmont
6. Letër nga Januz Prekazi për Xhafer Durmishin-Skenderin e Asllan Muharremin, 12 korrik 1985
7. Letër e hapur e Hysen Gërvallës
8. Përgjigje në letrën e Hysen Gërvallës
9. Letër nga Januz Prekazi për Xhafer Durmshin-Skenderin dhe Asllan Muharremin, 12 gusht 1985

Me Januz Prekazin, jam njohur në Mitrovicë në fillim të vitit shkollor, në vjeshtën e vitit 1977, kur kemi qenë studentë në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik, në Mitrovicë, në degën e Tekonologjisë.

Me aktivistin Elmaz Ademi, nga rrethi i Tetovës, jam njohur përmes Haxhi Berishës dhe rrethit të tij në Zvicër, në vitin 1984.

1. Letër nga Januz Prekazi për Xhafer Durmishin-Skenderin, 6 korrik 1985

I dashur shok! (Shkruar më 6 korrik 1985, Courroux)

Para së gjithash shfrytëzoj rastin që të përshëndes thelë nga zemra, duke të dëshiruar gjithë të mirat në jetë dhe punë.

Përsa i përket gjendjes time personale, unë jam shumë mirë, sikurse me shëndet poashtu edhe në aspektet tjera të jetës. Njëkohësisht edhe shokët tjerë janë shumë mirë. Edhe pse më parë biseduam në telefon, dhe u kuptuam se jemi të gjithë mirë, e edhe ti se je mirë e cila na gëzoi pa masë, gjë të cilën ta dëshirojmë edhe në të ardhmen, sikurse ti poashtu edhe shokëve të tjerë.

Pasi që ishte e pamundur të e vazhdon shoku Xh. letrën, se na erdhën dy shokë, po e vazhdoj unë, sot pas dy dite.

Duke e parë të arsyeshme t'u njoftojmë për gjendjen e krijuar momentalisht po u shkruajmë këtë letër shkurtimisht.

> Sabri Novosella: *"Fushatë e tërbuar filloi kundër Xhafer Durmishit."* (Si e themeluam Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi - LRSHJ; Zëri, 28 mars - 4 prill 1992)

Pasi erdhi M. (Mërgimi=Sabri Novosella) këtu filloi ta akuzoi me akuzat më të rënda shokun Skender (Xhafer Durmishin). Ai arriti ta akuzon edhe si vegël të policisë suedeze, e lere më si udbash. Ne në fakt s'e kundërshtuam se Ai ishte në gjendje të dalë edhe përjashta.

Sa i përket Hysenit (Hysen Gërvallës) të them të drejtën më ka çuditë. Ky arriti deri atje sa ta hudhë gazetën dhe shokun Skender (Xhafer Durmishin) e akuzoi edhe si

"Kriminel të kombit". Ndoshta ramë në pozitë oportuniste por s'e pamë të arsyeshme të hyjmë në polemikë...

Ne u kemi thënë se gazeta na ka pëlqye, vetëm se është pakëz i gjer, ndoshta s'është dashur të zgjerohet aq tepër e të përsëriten gjërat, por kur e shofim se njerëzit kanë për qëllim vetëm të akuzojnë, duhet të sqarohen si qorrat, atëherë jemi plotësisht dakord me atë që është shkruar në gazetë.

Hysen Gërvalla e akuzoi se si e ka parë të arsyeshme të shkruhet kundër "Punëtorët" (revistës së Abdullah Prapashticës- shën i Xh.D.) kur e din se tani jemi kah mundohemi të bisedojmë për bashkim. Sa i përket këtij të ... M. (Mërgimi=Sabri Novosella), ky në të shumtën e rasteve i dilte në mbrojtje Gazetës, ashtu pa kontroll, por ashtu si fëmijë, të them të drejtën na u dhimbtë se në çfarë pozitash është ra.

Tani se e pamë (Sabriu-shën i Xh. D.) shifet se është plotësisht në pozita të Hysen Gërvallës, shumë rrallë ia prishë, mendoi e kundërshton.

Kësaj radhe po e përfundoj e kaq, por herën tjetër do t'u shkruajmë më gjerësisht pasi këto ditë do të vijë edhe shoku Elmaz me Surkun (Haxhi Berishën).

Me këtë letër po ua dërgoj edhe këtë Fragment, nëse u hyn në punë.

Pranoni të fala nga shokët Januzi, Xhema dhe Dema.

Januz Prekazi

2. Letër nga Elmaz Ademi (Zvicër) për Asllan Muharremin dhe Xhafer Durmishin (Suedi), 9 korrik 1985

9 korrik 1985, Arbon

Në fillim ju njoftoj se me shëndet gjendemi mirë, me shokë dhe me familje. Një shëndet të tillë ju dëshirojmë edhe ju atje larg. Larg, shumë larg me trup, por afër me zemër dhe punë. Dy forca janë që veprojnë ndër ne: njëra mundohet dhe ia arrinë qëllimit që të na largon si trupa, fuqia e ekzistencës personale, nevoja për jetë (nevojat e jetës). Përkundër kësaj vepron një fuqi kolosale, që nuk njeh një largim të tillë, nuk njeh kufij as kilometra, por na afron dhe na bën grusht. Kjo është fuqia e idealit të pastër, e dashurisë së sinqertë për Kosovën dhe popullin. Dhe një forcë e tillë do të rritet sa më tepër që ta pastrojmë idealin nga veset e dobëta, sa më të kjartë që të jemi në vetveti se kjo luftë është e përgjithshme, dhe se i gjithë mundi ynë duhet të përgjithësohet, të shkrihet në popull duke mos na ngel asgjë për vedi.

Letra jote (Asllan Muharremi - shën i Xh. D.) më gëzoi pa masë, më gëzoi fakte se të gjitha ato, paskan qenë shpifje rreth shokut Skender (Xhafer Durmishi). Një fushatë e tillë është duke vazhduar edhe këndej. Unë nuk jam takue ende, por më kanë njoftue shokët. Për te nuk kam çka të flas më tepër.

Edhe Baci tjetër u lirua nga burgu. Rreth detyrës që ia kanë ngarkue vetes nuk janë duke tregue rezultat. I riu (Iliri) është duke u treguar shumë i papjekur. Organin (revistën Zëri i Kosovës që ka dalë në Suedi - shën i Xh. D.) posa e ka marrë, pa e lexue asnjë fjali në te, është munduar ta hedhë si të pavlerë. Një bindje të tillë ia forcoi edhe Osa (Sabri Novosella) duke thënë se shokët e Malmös posa e kanë marrë e kanë hudhë në pleh. Për papjekurinë e tij më tregoi edhe shoku im Ragipi i cili qëndroi disa ditë atje në mesin e tyre. Për shumë pyetje që i ka bërë rreth çështjes së organit (revistës) dhe kritikave pa bazë që i bën rreth tij dhe shokëve, nuk është përgjegj në asnjë. Shoku më tha, se Ilirin "e gjen gjithmonë në ajër e asnjëherë në tokë".

Osa (Sabri Novosella) takohet edhe me bacin (Hysen Gërvallën), dhe pas kësaj Baci takohet me Jahën dhe D. dhe u thotë se Zëri (Zëri i Kosovës që ka dalë në Suedi) nuk qenka përmirësue aspak, por e kundërta paska dalë krejt reaksionar. Ja në artikullin e parë e shehë të gjithë. E sheh se ai shoku e ngre vedin lartë, se ai qenka gjithçka.

Kam bindje se as njëri (Sabri Novosella) dhe as tjetri (Hysen Gërvalla) nuk e kanë pa qëllim. I pari, Osa (Sabriu) e bën kuptohet nga qëllimet karrieriste. I dyti, Baca (Hysen Gërvalla) e bën duke mendue se i prishim punë në detyrën e tij, duke i vërejtë ca shenja sikurse tek i pari. Kur pa se nuk i bindemi verbërisht, kur pa se na nuk njohim emër e as autoritet, por njohim vetëm punë, fillon të lëshon fjalë boshe, të përkrah fjalët dhe mendimet e ..., siç është Osa. Unë do të mundohem të takohem me ta dhe do t'ju raportoj më gjerësisht.

Sabri Novosella: *"Fushatë e tërbuar filloi kundër Xhafer Durmishit. ... Filloi të dalë edhe një organ me emrin Zëri i Kosovës me adresë në Suedi. Këtë organ e udhëhiqte Xhafer Durmishi. Xhafer Durmishi i frikësuar tmerrësisht se mos po akuzohet si reaksionar, e kur të jepej epiteti reaksionar nënkuptohej edhe se je kundër PPSH, kundër Shqipërisë e tradhtar, kështu që Xhafer Durmishi në këtë organ u bë më Lenin se Lenini e më Stalin se Stalini, për të cilën gjë e jepte bekimin diplomacia shqiptare në Stockholm për çdo numër të organit*. Për këtë punë intervenova unë dhe e ndala botimin e "Zëri i Kosovës", me adresë në Suedi." (Si e themeluam Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi - LRSHJ; Zëri, 28 mars - 4 prill 1992)

Për të qenë më të qetë, dhe më të sigurtë për vijën që ndjekim, vizitone më shpesh "vëllaun e madh" (diplomatët e RPS të Shqipërisë në Stockholm-shën i Xh. D.), ku kam bindjen se nga takimet me ta do të mësojmë shumë, do të mësohemi të bëjmë sa më pak lëshime dhe gabime. Këtë e them si proletar, si njerëz që jemi lind dhe rritë në mesin e tyre dhe besoj që asnjë shok nga radhët tona nuk ka arrijtë në atë shkallë, që duke e rritë mendjen të dalë përmbi këtë masë, duke thënë se di gjithçka e nuk kemi nevojë për mësimet e askujt.

Dija rreth së vërtetës është e pafund. Çdo zbulim i ri sjell edhe metoda të reja të studimit. Prandaj duhet të veprojmë sipas kohës dhe hapësirës, e të mos vendnumërojmë për shkak të mendjemadhësisë. Mendjemadhësia do të na largon nga mënyra dialektike e punës dhe luftës sonë, do të na hudh në një metodë që vendnumëron, në një metodë që për çdo ditë plaket duke mos bërë asnjë hap përpara.

Shokë të nderuar, ca adresa të disa shokëve të interesuar prej këtuhit, kishit bërë mirë që na i kishit dërguar. Na do të mundohemi si e qysh me kontaktua me ta, por do të ishte mirë dhe e arsyeshme sikur ju t'ju përgjigjeshit së pari direkt prej atje.

Më shkruani. Ju përshëndes nga zemra Elezi (Elmaz Ademi)

3. Letër (pjesë) nga Hafiz Gagica për Asllan Muharremin, 9 korrik 1985

I dashuri shok,

Letrën tënde të datës 1 korrik e mora dje më 8 korrik, dhe vendosa që menjëherë të përgjigjem në te. Parasëgjithash më vjen mirë që rrugës kalove mirë dhe tani atje je rregullue, kurse për probleme të tjera bëhet mirë nëse neve vetë jemi të mirë?

Letrën e lexova me vëmendjen më të madhe. Të gjitha ato që i ke cekë në letër (kuptohet në shkurtica) rreth Mërgimit (Sabri Novosellës) janë të vërteta... Unë personalisht kam pas një konsideratë për te si luftëtar i vjetër, por kisha qenë gabim...Vitin e kaluar tek ky kam vërejtë se është mendjemadh, karrierist dhe lokalist i mykyn, të cilat t'i kam thënë para se të ngjitesh lartë. ...

Unë mendoj se është mirë që po e njohim se kush është ky njeri, por ta luftojmë nuk bënë (se nuk ka nevojë) të hapim plagë të reja.

...(Shkaku) i sjelljeve të Sabriut për karrierizmin e tij të fëlliqur e krijuem këtë përqamje aq të madhe që në historinë e emigracionit shqiptarë nuk ka ndodhë kurrë.

9 korrik 1985 Shtutgart, Hafizi

4. Letër e shokëve nga Zvicra për Xhafer Durmishin-Skenderin dhe Asllan Muharremin, 9 korrik 1985

Të dashur shokë,

E ndjejmë për detyrë t'ju njoftojmë për përshtypjet e këtyre shokëve të rinj për "Zërin". Nuk mund të themi se kanë ndikuar. Ky shoku që ka ardhur nga ju, për qëndrimin që tani këta kanë.

Përsa i përket këtij të voglit, A. (Asllani) e njeh më mirë dhe nuk e shohim të arsyeshme të humbim kohë. Ndërsa ky i madhi, porsa erdhi prej "atje" e kërkoi organin (revistën) dhe të nesërmen erdhi dhe vazhduam diskutimin rreth tij. Për të mos filozofuar më tepër, po ju tregojmë pikat më kryesore në të cilat e sulmon apo e lufton organin (revistën) dhe kryesisht kryeredaktorin.

P. sh. në faqen e parë nuk kanë qenë dashtë të jenë këta rreshta: "Lajmi mbi vdekjen e udhëheqësit të shquar popullit shqiptar Enver Hoxha u prit me dhimbje të madhe në çdo vatër të Kosovës". Ndërsa artikulli është i shkëlqyeshëm.

Në kryeartikullin e organit, në faqen dy deri në mbarim të këtij artikulli ka shumë gabime, që ai (Hysen Gërvalla-shën i Xh.D.) i quan të pafalshme dhe arrinë deri atje, që kryeredaktorin ta akuzoj "Kriminel" të kombit. Ne po e shofim të arsyeshme t'i cekim disa raste ku ai i mbështet akuzat.

1. Përse t'i jepet material (argumente) UDB-së që ta luftoj LK (Lidhjen komuniste) të Kosovës, kur ajo vazhdimisht luftohet nga shovinizmi serbomadh.

2. Derisa ne (Hysen Gërvalla) një detyrë që vërtetë që vërtetë është e rëndësishme, për bashkimin e të tri grupeve, që tek ju e kemi parë një faktor shumë pozitiv në këtë drejtim, si është e mundur që ju të delni të parët me shkrime kundër grupeve tjera? Ku e patë të arsyeshme të shkruani për dobësitë dhe në çka bazoheni kur i tregoni UDB-së se çfarë forcash gjenden në atë grup (fjala është për fletushkën PUNËTORËT).

3. Në faqen tre, shtylla e tretë: -I patë dy taktikat e UDB-së... Këtu shoku në fjalë (Hysen Gërvalla), e sheh se është shkruar pikërisht për te.

4. Si është e mundur që mërgimtarët të jenë bagëti?

Sa për përfundim të këtij artikulli do t'u japim edhe një përshkrim të shkurtër: Ka mund të jetë një artikull shumë i mirë, në më së shumti dy faqesh.

Në pamundësi që të ndalemi në të gjitha pikat, siç ju thamë më parë, po ndalemi vetëm në disa pika që janë më kryesore. Një ndër ta është edhe artikulli që është shkruar për Zijah Shemsiun. Si është e mundur dhe çfarë logjike është ajo, që për Zijah Shemsiun të shkruhen vetëm gjashtëmbëdhjetë rreshta e gjysmë, i cili pas plotë njëzet muajsh në tortura më çnjerëzore, vdiq në duartë e udb-së gjakatare, kurse për Enver Dugolli (i cili vërtetë meriton një artikull të tillë) të shkruhet një artikull një faqesh? Në këtë pikë edhe ne jemi plotësisht dakord. (Përgjigje: Ka ndodh kështu vetëm sepse për Zijah Shemsiun nuk kemi pasur të dhëna nga jeta e tij, ndërsa për Enver Dugollin po. - shën i Xhafer Durmishit).

Të dashur shokë; Në disa pika të shkurta po i themi edhe përshtypjet tona rreth organit (revistës). Përsa i përket numrit të fundit të organit (revistës), e lexuam dhe pamë gjëra mjaft të mira. Mirëpo nuk e pamë të arsyeshme të zgjeroheni aq tepër, aq sa edhe nuk është dashtë, kur bëhet fjalë për artikullin e parë. Ne kemi vërejtur se aty bëhet luftë në mes veti dhe jo kundër armikut që e kemi përballë. Kur jemi përcaktuar në mbështetje të këtij organi (reviste, Zëri i Kosovës - Suedi) kemi pasur për qëllim të bëjmë luftë kundër

serbomëdhenjve, për të ndihmuar në realizimin e kërkesës së popullit "Kosova-Republikë!", e jo për luftë kundër njëri-tjetrit, dhe nuk e shohim të arsyeshme që organi ynë të merret, në mënyrë direkte apo indirekte me persona. Mbesim me shpresë që në këta pak rreshta do të na kuptoni drejtë.

Ne u propozojmë që në numrat e ardhshëm të bëhet luftë vetëm për "Kosovën Republikë" e jo të diskutohet për luftë klasore. Ne e dimë se jemi të bashkuar të luftojmë për Republikë në kuadër të RSFJ, edhe pse jemi të bindur që Jugosllavia s'ka asgjë me socializëm. Ne e dimë se nuk jemi ngritur në luftë kundër borgjezisë për të ngadhënjye proletariati në botë, jo pse nuk e dëshirojmë një gjë të tillë, por ne e dimë se lufta jonë është e përqendruar në realizimin e kërkesës së popullit "Kosova-Republikë".

Të fala nga shokët: Xhema, Dema, Januzi.

5. Letër nga Januz Prekazi për Xhafer Durmishin-Skenderin dhe Asllan Muharremin, 11 korrik 1985 Delèmont

Të dashur shokë,

Po u shkruaj në pika të shkurta, pakëz për gjendjen momentale.

Këtu si t'u them, këto ditë jemi në një gjendje bukur të vështirë, sa po e shofim se kemi ra në një pozitë oportuniste, ngase nuk jemi duke iu kundërvu akuzave të këtyre (Sabri Novosellës dhe Hysen Gërvallës - shën i Xh. D.). Jemi duke u thënë se Zëri na ka pëlqye dhe na është dukur i drejtë.

Sa i përket Mërgimit (Sabri Novosellës - shën i Xh. D.) t'u them të drejtën është shumë duke e akuzuar shokun Skender (Xhafer Durmishin). Arrinë deri atje, sa për të na bindë ne i përdorë disa shprehje që vërtetë po del krejt nga kontrolli. ... se Skenderi është për ta zhdukur kombin, se është për "Federatën Ballkanike", se u thotë shokëve në Malmö "është primitivizëm me u martua me vajza shqiptare", se unë personalisht nuk martohem me vajzë shqiptare, e shumë e shumë këso lloj akuzash që vërtetë po e tregojnë shpirtin shumë të vogël të këtij njeriu.

Kur jemi te këta shokët e rinj (Hysen dhe Avdyl Gërvalla), ne u themi se ende s'e kemi të kjart se çka donë të bëjnë. E themi këtë kur e shofim se gabimet e shumë të tjerëve, që vërtetë mund të themi se janë të pafalshme, këta nuk i shohin fare dhe gjejnë rrugë për t'i arsyetuar, atëherë si është e mundur të akuzohen shokët për "Kriminel të kombit", vetëm se paskan shkruar të vërtetën.

Unë e shoh të arsyeshme t'i shkruhet një letër këtij shokut (Hysen Gërvallës) se vërtetë ka fituar një bindje shumë të keqe. S'them t'i shkruhet për t'i hedhë hi syve, por për t'i treguar të vërtetën, se ku gjendemi dhe se nga çfarë pozitash jemi nisë kur e kemi shkrua këtë artikull.

Elmaz (Ademi) dhe Surki (Haxhi Berisha) do të vijnë me sa më duket këto ditë dhe besojë se do të sqarohen pakëz këta shokët. Me kaq po e përfundoj, por do të jam i rregullt në të ardhmen.

Pranoni të fala nga shoku i juaj Januzi

6. Letër nga Januz Prekazi për Xhafer Durmishin-Skenderin e Asllan Muharremin, 12 korrik 1985

Të dashur shokë, 12 korrik 1985 Delèmont

Ne gjendemi mirë dhe juve ju urojmë të njejtën.

Pas bisedës telefonike që patëm dje, po u shkruaj këtë letër t'i shpreh mendimet e mija për këta shokët këtu: Për Hysen Gërvallën nuk kam besue që do të bije në influencën e ndokujt, por ja se po shifet se vërtetë ishte një njeri i odave. Unë s'mund të them se kishte ndonjë aftësi për të gjykuar një problem. E lexova disa herë këtë numër (të revistës) dhe vërtetë unë s'munda ta gjej kundi Hysenin, por kur njeriu don të gjej "vegëza" për t'u mbajt, për ta sulmuar dikend. Ja ka edhe asi njerëz që e sulmojnë Leninin dhe Stalinin se kanë qenë sllav, sulm vërtetë qesharak, por dihet se nga kush sulmohen. Kur shoku në fjalë arrin deri atje, që ta çmoj veten aq shumë sa e thotë edhe vetë, kur i thua diçka, se "hajde hajde, u ba Hysen Gërvalla me të mësue gjithkushi, pra ky qenka një njeri që paska zbritë nga qielli, qenka i afër i Perendisë. Ne s'kemi ardhë ende tek ndonjë konflikt por edhe s'kemi ndejtë më me te. Ne do ta durojmë por jo ku s'durohet. Sikur të ishte ndonjë problem personal apo privat atëherë ne jemi të detyruar të kemi durim dhe ta respektojmë si më të vjetër, ndërsa kur është puna tek çështja e popullit, atëherë s'kemi pse ta durojmë; edhe sikur të jetë Babi im do t'i them: "Më ke rritë, më ke pru gjer këtu, por për këtë s'jam me ty", pra kur babës tim besoj që do të isha në gjendje t'ia them këto, atëherë dikujt tjetër as që mendohem në këtë drejtim.

Kur thotë se Sabri Novosellën e njeh tërë Kosova, mos mendon vallë se ky është baba i kombit. Jo, kështu s'do të lejojmë të luaj me ne, por vetëm sa të bisedoj edhe me Elmazin dhe Surkin, atëherë ne do t'i tregojmë hapur mendimet tona, me gjithë që ia kemi thënë në ditën e parë. Megjithatë unë e shoh të arsyeshme t'i shkruhet një letër dhe t'i tregohet e vërteta dhe jo të fitoj njeriu mendime shumë të dobëta për ne, megjithëse ne jemi munduar t'i tregojmë sa kemi patur mundësi, të vërtetën, por ai ngulë këmbë në atë se "ju s'keni faj por koka është e kalbur, se gjoja po shërbekemi si qorrat, pa ditë se pas kujt po ecim!". Pra nëse keni mundësi i dërgoni një letër.

Pranoni të fala të përzemërta nga shoku i juaj Januzi.

7. Letër e hapur e Hysen Gërvallës

Letër e hapur
Tri grupeve që, respektivisht organizatave që luftojnë në emrin e LRSSHJ-së

Që në fillim e shoh të udhës të theksoj se propozimi i parashtruar më poshtë, është mendim i lirë, i mbështetur në qëllimet më të sinqerta, të cilat ia ka imponuar koha dhe momenti çdo njeriu të ndershëm të popullit tonë e që jam i bindur se i ka parasysh secili prej jush.

Para së gjithash mendoj se të tri grupet duhet ta studiojnë këtë propozim në mënyrë sa më objektive, të paanshme e pa pasione dhe të marrin qëndrim, duke patur parasyshë gjithnjë interesin e përgjithshëm dhe rrugën, e cila na shpie drejt qëllimit për realizimin e kërkesës së popullit tonë – konstituimin e Republikës së Kosovës në kuadrin e Federatës Jugosllave.

Ashtu siç është e ditur, duke filluar nga data 17 shkurt 1982, u bashkuan LNÇVSHJ dhe PKMLSHJ; respektivisht më 15 maj 1982, këtij uniteti iu bashkangjit edhe OMLK-ja. Këto grupe formuan organizatën e vetme, e cila veproi nën emrin LRSSHJ.

Duke u mbështetur në këto fakte, krijohet bindja se ky bashkim ishte vetëm formal e jo esencial. Këtë e dëshmojnë edhe ngjarjet të cilat pasuan dhe sollën deri te shpartallimi i Lëvizjes.

Mirëpo, siç thotë Lenini, bëhet një bashkim i cili dështon për të ardhur deri te një bashkim i fuqishëm (duhet të ndahemi që të bashkohemi!)

Prandaj është e domosdoshme që të bëhet një bashkim i vërtetë dhe esencial i tri grupeve, respektivisht organizatave të lartpërmendura.

Madje, edhe nëse ekziston ndonjë grup apo organizatë tjetër me orientime dhe qëllime të drejta, mendojmë se është e udhës t'i bashkohet Lëvizjes së përgjithshme.

Përvoja historike e popullit tonë dhe lëvizjet e shumta të popujve të tjerë, kanë dëshmuar se bashkimi bënë fuqinë, garanton fitoren dhe sjell deri te shpëtimi kombëtar, kurse shkapërderdhja e distribuimi i forcave çon në dështim, në zvetënim dhe në katandisje të lëvizjes.

Në bazë të këtyre dal me këtë propozim:

-që te tri grupet t'i autorizojnë përfaqësuesit e vet me të gjitha kompetencat e duhura, prej 3-5 vetave.

-bashkimi të bëhet pa asnjë kusht nga të tri grupet ekzistuese, respektivisht organizatat. (Po deshëm të arrihet mirëkuptimi, duhet t'i hedhim poshtë të gjitha pretendimet se njëra është e drejtë, se tjetra është më e fortë, apo se "akcila" është koka e kombit shqiptarë, pretendime këto megalomane, tendencioze, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi shkojnë në dobi të armikut e që pengojnë bashkimin e lakmueshëm).

Edhe pse nuk mund të mohohen anët pozitive të luftës që është zhvilluar nga këto grupe, lufta e zhvilluar që nga koha e bashkimit formal, ka qenë më tepër luftë në mes grupesh dhe individësh se sa luftë kundër armikut.

Që të shkohet përpara dhe të eliminohen të gjitha anët negative të këtyre grupeve është e domosdoshme të arrihet bashkimi i tyre në një organizatë të vetme dhe të njësuar, në mënyrë që tërë aktivitetin e vet ta drejtojë kundër armikut – shovinistëve serbomëdhenj dhe të tjerëve që na bëjnë pengesa në realizimin e kërkesës së popullit shqiptar për formimin e Republikës Socialiste të Kosovës në kuadrin e Federatës.

Mendoj se kjo do të arrihet:

1. – me shkrirjen e tri grupeve në një organizatë të vetme e cila do të emrohet: Lëvizja për Republikën Socialiste të Kosovës në Jugosllavi.

Arsyetimi:

Republikat ekzistuese në Jugosllavi emërohen sipas emrit të territorit, p.sh. RS e Sllovenisë, RS e Kroacisë etj. Prandaj e shoh të arsyeshme që të emërohet kështu edhe RS e Kosovës, në mënyrë që mos t'i mbetet rrugë dhe mundësi askujt të na sulmojë gjoja se kërkojmë Republikë "të pastër etnike".

2. – duke pasur parasysh se "Zëri i Kosovës" është Zëri i tërë popullit shqiptar në Jugosllavi dhe i atyre në mërgim, që thërret për një Republikë në kuadrin e Federatës, e shoh të arsyeshme që të mbetet emri i organit "Zëri i Kosovës".

3. – Simbolet e gjertanishme siç janë stemat dhe pushka me flamur duhet të hiqen, pasi për këto simbole duhet ta jap fjalën vet populli i Kosovës dhe ta përcaktojë vetë stemën për Republikën e tij.

-Arsyetimi:

Pushka me flamur nuk përputhet me platformën e kërkesës së popullit tonë në luftën e tij për Republikë pa përdorimin e dhunës.

Do të ishte mirë që simbol i organit të jetë lbri dhe pena, të cilat në këtë moment dhe në këto rrethana specifike do të simbolizonin luftën tonë me libër e me penë dhe me mjete tjera demokratike pa u përdorur dhuna.

Lëvizja përfundimisht duhet të distancohet nga të gjitha format e luftës që mbajnë erë baroti, njëherit mendoj se është me vend mos t'i imponojë Jugosllavisë asgjë tjetër, përveç realizimit të kërkesës për konstituimin e Republikës së Kosovës, respektivisht LRSKJ-në. Jugosllavia nuk duhet të luftohet as si shtet, as në pikëpamjet e sistemit shoqëror dhe kam bindjen se me konstituimin e kësaj Republike, populli shqiptar në Jugosllavi do të jetë i barabartë me të gjithë popujt e tjerë të Federatës dhe të menjanohet rreziku i ndonjë konflikti më të gjerë në përmasa Jugosllave e Ballkanike. Për derisa populli shqiptar është i persekutuar dhe pa të drejta, nuk mund të ketë paqe dhe qetësi as për popujt e tjerë që e përbëjnë Federatën.

Këto që u cekën edhe shumë të tjera që mund të nënkuptohen, na bindin se ndihma jonë po që se është e drejtë, do të jetë shumë e madhe, po të mos jetë e drejtë – kontributi ynë do të jetë i vogël, sepse populli e di mirë rrugën e vet. Pra, bashkimi do të reflektohet si besëlidhje në vazhdimësinë e fitoreve tona dhe do të tregojë qartësinë e pjekurinë e përgatitjes sonë për luftë. Besëlidhja e fortë ka qenë gjithnjë kushti i parë, i cili ka shpënë në fitoret e pareshtura dhe përfundimtare. Na kanë mësuar rrugët e gjata dhe të hidhura se vetëm të bashkuar mund të luftojmë drejt, se gabimet e bëra gjatë luftrave të kaluara duhet të na shërbejnë si mësime të shtrenjta. Nga ana tjetër luftrat mes grupesh gjithnjë janë paraqitur në momente kur na ka humbur qartësia, por atë – qartësinë – e kemi gjetur së shpejti, jemi bashkuar pa pengesa, duke i eliminuar gabimet e vogla, kurse të mëdhat i kemi zvogëluar dhe kështu ka ecur shqiptari nëpër rrugën e historisë, i munduar, por kurrë i thyer, kurrë i asgjësuar. Kjo qëndresë u arrit përherë duke u mbajtur për njëri-tjetrin dhe duke i bërë pushkët strumbullarë në duart e bashkuara dhe të fuqishme.

Po që se ky bashkim nuk arrihet, do të vërtetohet edhe njëherë se në mesin tonë ka njerëz që punojnë për armikun, do të vërtetohet papjekuria jonë në çështjen e madhe, e cila duhet të qëndroj mbi çdo interes personal dhe mbi çdo tendencë individuale dhe subjektive.

Duhet t'ua theksojmë shokëve të ndershëm që të marrin drejtqëndrimin dhe ta thonë fjalën e vet, çdo njëri në emër të kësaj çështjeje të madhe, të distancohet secili pa ngurrim, pa humbur kohë dhe pa luhatje prej grupeve, prej dinastive, familjarizmit, bajraktarizmit, përkatësive primitive fisnore e të odës dhe mbi të gjitha prej "Krerëve" që pengojnë bashkimin; ta thotë secili fjalën e vet haptas, mendimin e vet të lirë e konstruktiv, sepse siç ka theksuar Ismail Qemali, çdo shqiptar i ndershëm ka të drejtë të flasë në të mirë të kombit dhe atdheut.

Nder i madh është të përcaktohesh në shërbim të atdheut, ndërsa tradhti të vihesh në shërbim të individëve destruktivë, sepse forca qëndron në masë e jo në grupe e as individë.

Delemont – Zvicër, 12 korrik 1985

8. Përgjigje në letrën e Hysen Gërvallës

Nga ti, H. Gërvalla e kemi marrë një letër të datës 12 korrik 1985. Ne e analizuam atë me kujdes, e lexuam disa herë, dhe këtu më poshtë po të japim përgjigjen tonë në letrën tuaj të datës së lartpërmendur.

Ne e dimë se jeni vëllau i madh i dy vëllezërve që u vranë më 17 janar 1982 pranë Shtutgartit. Ky është një fakt shumë domethënës dhe i mirë për ne të gjithë, por për shkak të luftës sonë, karakterit të saj, fazave të zhvillimit të saj, vetëm kjo e dhënë nuk mjafton që ne të merremi vesh në të gjitha pikat.

Prandaj prej teje kërkojmë:

Që të na tregosh për platformën tënde politike, pasi letra është shkruar në emrin personal, pasi ajo nuk na është e njohur plotësisht.

Të na tregosh se ne që na e ke dërguar këtë letër, si për kend na e ke dërguar? Sipas pikëpamjeve tuaja kush jemi ne në këtë rast para teje: A jemi grup, organizatë, dinasti, rreth familjar, bajraktarë, injorantë, grup i përkatësive primitive, komunistë, ballistë, liberal, demokratë apo nuk po e dimë as vetë kush jemi e nuk po e shohim veten. Për këtë arsye ne kërkojmë ta dimë se çka jemi para teje. Çka din ti për programin e statutin tonë dhe si qëndron në raport me to? Çka mendon për gazetën tonë dhe kujt i shërben ajo?

Të na tregosh se kush janë dy grupet tjera, që ua ke dërguar letrën dhe që je optimist se do t'i bashkosh të gjithë në një vend? çfarë pikëpamjesh politike kanë, çfarë interesash mbrohen pas fjalëve dhe deklaratave të tyre nëpër gazeta? Cili është programi e statuti i tyre, pasi ne këto nuk i dimë?

Të gjitha këto pika të ndryshimeve, të gjitha pikat e përbashkëta duhet t'i ketë të qarta një njeri që donë të bashkoj dikend, duhet t'i ketë të qarta një grup i cili donë të bashkohet me një tjetër.

Në të gjitha këto pika duami paraprakisht të sqarohemi më shumë nga ti para se nga ana jonë, të japim ty personalisht çfarëdo mendimi të mëtejshëm lidhur me (iniciativën) letrën tënde të hapur. Në vartësi nga ajo nga ajo se si do të na sqarosh në pikat që shënuam më lartë do të varet edhe qëndrimi e përgjigja jonë në të ardhshmen.

Xhafer Durmishi 22 korrik 1985, Stockholm

9. Letër nga Januz Prekazi për Xhafer Durmshin-Skenderin dhe Asllan Muharremin, 12 gusht 1985

Të dashur shokë, (Skender e Asllan)

Pasi e lexuam së bashku me shokë letrën tuaj, ku i kthyet një përgjigje shumë të drejtë dhe sa e pamë në "Z.K." ishte shumë mirë i sqaruar bashkimi, ne u munduam të plotësojmë diç, të cilin po ua përcjellim këtyre këtu dhe juve. Ndoshta s'kemi mundur edhe aq drejt ta plotësojmë por s'prishë punë, se në "Z.K" përgjigja është shumë e drejtë dhe e kjartë. Se si do të reagojnë këta do ju njoftoi më vonë. Kësaj radhe po e përfundojmë me kaq.

Ju uroj shëndet dhe sukses në punë.

Delemont 12 gusht 1985; Të fala Januzi

Komunikim mendimesh, të kërkuara nga Sabri Novosella, gjatë muajit shkurt 2012

1. Letër nga Sabri Novosella për Xhafer Durmishin, 1 shkurt 2012

Från: nenanaile
Skickat: den 1 februari 2012 10:48:41
Till: xhaferdurmishi

Përshëndetje i nderuar, emailin tënd e morëm. Ne do t'ua dërgojmë librin "Kuvendi i Taksimit" dhe "Rezistenca kosovare në mes dy zjarresh" i ribotuar me disa plotësime. Do të dëshironim që ta dinim pastaj mendimin tuaj për këto libra mundësisht na dërgoni me email (pasi ti keni lexuar), pasiqë e vlerësojmë lart mendimin tuaj.

Përshëndetje vëllazërore të dërgon Sabriu

2. Letër nga Xhafer Durmishi për Sabri Novosellën, 7 shkurt 2012

Från: Xhafer Durmishi
Skickat: den 7 februari 2012 13:54:09
Till: nenanaile

I nderuari Sabri,

Dy librat e përmendura më parë më erdhën dje. Të falenderoj shumë. Tani lidhur me mendimet e mia që i pret rreth librave. Këto ditë jam i zënë pak me disa punë. Pastaj është edhe një çështje tjetër e stilit tim në punë, që nganjëherë disa gjëra i kryej ngadalë. Për këtë arsye po të them se përgjigjen apo komentin tim me shkrim do ta bëjë gati në gjysmën e parë të muajit të ardhshëm. Shpresoj se afatin e kërkuar prej meje do ta shohësh si të arsyeshëm.

Gjithë të mirat Xhaferi

3. Letër nga Sabri Novosella, 8 shkurt 2012

Från: nenanaile
Skickat: den 8 februari 2012 14:24:06
Till: xhaferdurmishi

Përshëndetje i nderuar, shkrimin tuaj e morëm ju faleminderit. Deshëm të ju informojmë se nga fundi i muajit të ardhshëm do të hynë në shtyp Libri "40 autor për Librat e Sabri Maxhuni - Novosella", jam i mendimit që edhe komenti i juaj të jetë pjesë e këtij Libri. Do të bëjmë si ta shifnit të arsyeshme ju.

Përshëndetje
Sabri Maxhuni (Novosella)

4. Letër nga Xhafer Durmishi për Sabri Novosellën, 28 shkurt 2012

Komenti im për dy librat e dërguar
Från: Xhafer Durmishi
Skickat: den 28 februari 2012 15:44:14
Till: nenanaile

I nderuari Sabri,

Komentin tim për librat "Kuvendi i Taksimit" dhe "REZISTENCA KOSOVARE MES DY ZJARRESH" e ke në filin-dokumentin e bashkangjitur.

Gjithë të mirat Xhaferi

Letra bashkangjitëse në këtë rast është kjo:

I nderuari Sabri,

Falemnderit për dy librat e dërguara e të nënshkruara për mua. Edhe zarfet e shkruar prej teje ma kujtuan kohën e viteve 1981 - 1983 kur na vinin në Shtutgart letra prej teje nga Stambolli. Më vjen mirë që pas tridhjetë vitesh i quan të rëndësishme mendimet e mia për atë kohë në të cilën kemi vepruar bashkërisht, edhe pse nganjëherë kemi pasur qëndrime më të përafërta e nganjëherë më pak të përafërta.

Librin "Rezistenca kosovare mes dy zjarresh", botimin e parë e kam lexuar më herët, dhe e rilexova tani botimin e dytë. Prej botimit të parë kam marrë disa citate për punimet e mia, ndërsa librin "Kuvendi i Taksimit" e lexova këto ditë.

Në pozitën time, para se të jap mendimet e mia, më duket se ndodhem para një detyre delikate; të vështirë dhe të lehtë në të njejtën kohë.

Po ndalem së pari tek "Kuvendi i Taksimit." Ky libër kap një periudhë të gjatë kohore, 1912-1999. Kujtimet e Hasan Prishtinës janë shumë interesante, por për analizimin dhe interpretimin e tekstit të tij nuk e ndiej veten të përgatitur se mund ta bëjë tani. Kjo do të thotë se nuk e ndiej veten kompetent, as edhe si amator t'i komentoj interpretimet tuaja që i ke bërë në librin "Kuvendi i Taksimit". Kontributi im në fushën e shkrimeve kufizohet në Lëvizjen tonë Nacionalçlirimtare dhe peshën e Jusufit në te, dhe punën time në këtë pikë nuk e konsideroj krejtësisht të përfunduar. Temat që i prek ti në librin tënd "Kuvendi i Taksimit" por që përsëriten në mënyrë identike edhe në "Rezistenca kosovare mes dy zjarresh" janë të ngjashme, janë shumë të koklavituna dhe nuk mund të përgjigjesh në to me gjeneralizime e shabllonizime tepër të gjëra. Nuk kam marrë ndonjë fjali apo ndonjë rast konkret për t'i ilustruar thëniet e tuaja, por dua t'a potencoj një të metë kryesore, që sipas mendimit tim, shfaqet në librat që më ke dërguar.

Ti e lufton një ide, idenë marksiste apo komuniste duke i sulmuar bartësit, personat që kanë ushtruar pushtet në emër të asaj ideje, pra e vendos shenjën e barazimit në mes bartësve të idesë dhe vetë idesë. Këtë barazim (futjen e të gjithëve në një thes) nuk ma merr mendja se e ke përdorë kur është fjala tek feja, pra barazimin e veprimet tejet të dënueshme të bartësve të ndryshëm të saj ndër shekuj me vetë fenë. Duke u nisur nga fakti se këta bartës kanë vdekur, kanë varre, janë të varrosur, t'i nxjerrë konkluzionin se me ta është varrosur edhe ideja me të cilën e kanë ngjyrosur apo bojatisur veten. Ti, por dhe shumica absolute e autorëve të sotëm veprojnë në këtë mënyrë. Tërmeti i vitit 1989, nga mendimi dominues i gjeneratës sonë konsiderohet si tërmeti i fundit dhe se pas kësaj ngjarje korja e tokës e ka stabilizuar dhe harmonizuar përfundimisht edhe koren e bukës.

Ti shkruan si nacionalist, dhe përpiqesh që baza kryesore e mendimit tënd të ndërtohet në këtë ide, duke u munduar ta pastrosh nga kundërthëniet apo kontradiktat. Nacionalizmi ynë më duket prapë se prapë është një nacionalizëm i një populli të vogël dhe të shtypur e të copëtuar, e në këtë kuptim ndoshta edhe më i justifikueshëm, por nuk duhet harruar se pushtuesit e kombeve më të mëdha e shtypëse, me të gjitha mjetet e dhunës në dispozicion, e etiketojnë veten me nacionalizëm dhe përpiqen që shtresat e klasat e tyre t'i mobilizojnë e ndërsejnë kundër të tjerëve pikërisht duke e luajtur rolin e

viktimës, duke u thënë se sa të pabesë e sa mosmirënjohës janë treguar popujt e vegjël ndaj tyre, e sa shumë e kanë keqpërdorë ata bujarinë, mirësinë e urtësinë e tyre.

Ka mendime se ta shkruash historinë është punë shumë e vështirë. Jam përpjekur të jem i vetëdijshëm për këtë dhe kam shkruar për një periudhë të shkurt kohore dhe për një rreth të caktuar, rreth në të cilin mund të them se jam inkuadruar përmes çelësit tënd. Çelësi yt, ma ka hapur një derë të madhe, më ka futur në një botë e cila e popullon mendjen time. Aspekte të këtyre ngjarjeve i ke përshkruar në librin "Rezistenca kosovare mes dy zjarresh".

Në librin tënd "Rezistenca kosovare mes dy zjarresh", qendrën e tyre e përbëjnë kujtimet e tua, prejardhja, familja, fëmijëria e deri në ditët e sotme. Në një segment të caktuar gjendem edhe unë. Për periudhën kur kemi pasur aktivitet të përbashkët, kam shkruar më gjerësisht se ti, por sasia e numri më i madh i fjalëve nuk është garantues i cilësisë. Jeta jote është interesante. Për hir të realitetit po i përsëris edhe dy mendime që më ka rënë t'i lexoj e të cilat po i përmbledhi në një: "Edhe jeta e njeriut më të thjeshtë është me e koklavitur e më e pasur me ngjarje se sa personazhi më i komplikuar i Shekspirit. Problemi qëndron në atë se prej botës mendore të përjetimeve, gjatë rrugës deri në letër humbin pjesa më e madhe e tyre... por në shumicën absolute të rasteve tragjikja është edhe më e madhe sepse ngjarje aq magjike e vështirë të imagjinueshme rrugën prej trurit e deri në letër nuk e marrin fare." Duke u nisur nga kjo, jam i sigurt se jeta jote ka qenë shumë më interesante dhe më e pasur në ngjarje se sa ke arritur me i hedhë në letër.

Një aspekt tjetër është se disa ngjarje që i kam përshkruar unë përmes shumë dokumenteve, nuk përputhen me disa nga ato çka i ke thënë ti në këtë libër. Natyra e komunikimit shoqëror ndikon që ky shkrim i shkurt nuk ndien nevojën të jetë sheshim e krahasim i këtyre dallimeve. Ti i ke thënë mendimet tuaja në kujtimet tuaja, e unë i kam parashtruar ngjarjet (të cilat nuk mund të quhen kujtime) në librat e botuar sidomos në mes 20 tetorit 2011 e 14 janarit 2012. Megjithatë, ia vlen të thuhen disa gjëra për vijën kryesore të librit, që ka të bëjë me pjesën ideore. Me sa kam vërejtur shumë njerëz që janë të zhdërvjelltë, praktik e të shpejt, që ndikojnë shumë në rrethinën e vet, nganjëherë nuk iu kushtojnë rëndësinë e duhur detaleve. Pse ndodh kështu, ekzakt nuk mund ta di, por është fakt i pamohueshëm. Ka mundësi që disa përkufizime nga fjalia e mësipërme vlejnë edhe për ty. Në librin tënd parakalon një plejadë e tërë veprimtarësh të njohur për popullin tonë. Në rastin tim po ndalem vetëm tek Jusuf Gërvalla, pasi disa rrethana e kam më të lehtë t'i komentojë. Në vitet 1981 e 1982 nuk ke pasur kundërthënie me Jusufin. Është vështirë, në mos e pamundur, për mua me e kalua në heshtje faktin se shumë fjalë të shkruara prej teje, më 2010 e 2012 i qesin në sipërfaqe disa kundërthënie problematike në mes teje dhe fjalëve që i ka shkruar dora e Jusufit, e të cilat i ke të njohura nga letrat dhe revistat që t'i ka dërguar. Ka mundësi qe me kalimin e kohës ato kundërthënie e mospërputhje të zhduken por mund të ndodhë edhe e kundërta, dhe fati i shkrimeve politike të Jusufit të jetë i ndryshëm me atë të kujtimeve tua. Si do të zhvillohen ngjarjet në këto dekadat e ardhshme, në mënyrë shkencore është vështirë me i parapa. Është interesant se shkencëtarët janë shumë të sigurt se çka ka me ndodhë me tokën, si trup qiellor, pas 4 miliardë vjetësh, por asnjë nuk ka idenë dhe as guximin të pretendoj se e din se çka mund të ndodhë me shoqërinë njerëzore pas 100 vjetësh.

Unë të jam shumë mirënjohës që përmes teje jam njohur me Jusufin dhe rrethin e tij në Shtutgart. Ti e ke dëshmua në praktikë me zgjuarsinë dhe aftësinë tënde me i gjykua disa gjëra drejt për momentin, gjykime të cilat reflektohen në bazën tënde ekonomike. Libri yt "Rezistenca kosovare mes dy zjarresh" dhe ideja themelore e tij përputhet me idetë politike që mbretërojnë ditëve të sotme. Shkrimet e Jusufit në gazetat ku ka vepruar nga vitet 1980-1982, si brenda Organizatës sonë ashtu edhe jashtë saj, kanë disa dallime

në këtë pikë. Se ku është vendi im në këtë mes, besoj se është bërë e qartë përmes shkrimeve të mija, për të cilat (qoftë edhe pjesërisht) më the disa fjalë të mira.

I nderuari Sabri, shpresoj t'i marrësh këto fjalë me po atë frymë me të cilën më je drejtuar. Gjithë të mirat; Xhafer Durmishi

ZËRI I JUSUF GËRVALLËS PËR PARAROJËN

1.

Jusuf Gërvalla: "Ç'kanë pra këta intelektualë që të çajnë kokën dhe t'i trazojnë të përbrendshmet duke dërdëllisur dhe duke mbajtur "ligjërata" të ethshme sesi nuk po ia dalin dot në realizimin e të drejtave dhe të lirisë krijuese në kuadër të sistemit fashist jugosllav? Nuk po dinë, vallë, a nuk po duan të dinë se, kur s'ke si t'i gëzosh të drejtat elementare kombëtare, është puna më e kotë në botë të kërkosh të realizosh të drejtat për krijimtari shkencore, artistike e kulturore, që janë pararojë e lirisë së vërtetë kombëtare e shoqërore?" (Letër një shoqi intelektual, Bashkimi, prill 1980, faqe 2)

2.

Jusuf Gërvalla: Të mbërthyer ndërmjet shfrytëzimit të egër të Perëndimit e Lindjes dhe politikës antipopullore të udhëheqjes titiste, e cila interesat e vendit i ka shitur fare lirë te imperializmi e socialimperializmi, popujt e Jugosllavisë ndodhen në prag të një revolucioni popullor. Duke përfituar nga kjo situatë, si dhe nga niveli i lartë i vetëdijes shoqërore e kombëtare të shqiptarëve që lëngojnë nën thundrën jugosllave, FRONTI I KUQ POPULLOR, duke u bërë pararojë e luftës për LIRINE E PAVARESINE e shqiptarëve dhe për bashkimin e tyre me vendin amë, do të luftojë pa kompromis për të vjelë frytet e revolucionit, të cilat janë në pjekjen përfundimtare." (Programi dhe Statuti i Frontit të Kuq Popullor, maj 1980)

3.

Jusuf Gërvalla: "Busullë e vetme për të gjithë anëtarët e FRONTI I KUQ POPULLOR do të jetë lufta analoge e FRONTIT NÇ, i krijuar nga PKSH në prag të Luftës së Dytë Botërore (prill 1942.) dhe historia e zhvillimit të PPSH, si pararojë. (FRONTI NÇ i udhëhequr nga PKSH, sot PPSH, luftuan për çlirimin e tokave shqiptare dhe për ndërtimin e Socializmit të vërtetë në atë pjesë të tokave që përfshinë brenda kufijtë e Shtetit Shqiptar të sotëm, të cilit Fuqitë e Mëdha ia shkëputën arbitrarisht më se gjysmën e tokave shqiptare.)" (Programi dhe Statuti i Frontit të Kuq Popullor, maj 1980)

4.

Jusuf Gërvalla: "Nën kujdesin e Partisë së Punës të Shqipërisë, sot në Atdheun tonë socialist lulëzon një literaturë e begatshme revolucionare. Nga literatura e tillë, që duhet të përvetësohet në mënyrë të domosdoshme dhe të ngutshme, sidomos nga pararoja jonë revolucionare, donë veçuar këto pikëmbështetje kryesore: veprat e Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit e ato të marksist-leninistit dhe prijësit të madh shqiptar, shokut Enver Hoxha; historia kombëtare shqiptare, ajo e PPSH-së dhe dokumentat e PPSH-së; shtypi shqiptar, sidomos publikimet shkencore nga lëmi i historisë dhe ai i ndërtimit teorik dhe praktik të socializmit në Atdheun tonë." (Bashkimi bën fuqinë, Bashkimi, janar 1981, faqe 1, shtylla 2)

5.

Jusuf Gërvalla: "Revista "NIN" e Beogradit, nëpërmjet intervistash me funksionarë të lartë shtetërorë, nga numri në numër po e shtron çështjen e bashkëjetesës së popujve të Jugosllavisë në federatën jugosllave. Natyrisht, ndonëse ky paraqet një hap të çuditshëm të kësaj reviste, pas të cilit mund të supozohet se qëndron kryekëput qeveria dhe i cili sigurisht fsheh ndonjë qëllim tinëzar, s'ka kurrfarë "rreziku" se mund të pyeten popujt e Jugosllavisë sa e duan dhe a e duan fare ata "bashkëjetesën". Sa për popullin shqiptar, e sidomos për pararojën e tij patriotike dhe revolucionare, nuk shtrohet fare çështja e bashkëjetesës me popujt e tjerë në kuadër të kufijve administrativë të Jugosllavisë. Kjo "bashkëjetesë" është e dhunshme dhe e paligjshme, sepse viset shqiptare në Kosovë, Dukagjin, Maqedoni, Mal të Zi e në Serbi janë vise shqiptare, që trungut të përbashkët shqiptar iu shkëputën në mënyrë të paligjshme, në kushte të errëta historike dhe kundër vullnetit të popullsisë vendëse shqiptare." ("Bashkëjetesa" e xhelatit me viktimën, Bashkimi, janar 1981, f. 9)

6.

Jusuf Gërvalla: "Mbi të gjitha, ndërsa është arritur që ata të pranojnë cilësimin e shpërnguljeve të mëdha për në Turqi si migrime politike, përkatësisht të terrorit dhe të dhunës, ata i propagandojnë migrimet e sotme të shqiptarëve thjeshtë si një dukuri të rëndomtë ekonomike, të parrezikshme, madje edhe të dobishme, duke i lidhur këto migrime me gjoja inkuadrimin e Jugosllavisë në "ndarjen ndërkombëtare të punës". Po dokrrat e tilla nuk pinë ujë te populli ynë i shumëvuajtur. Pararoja patriotiko-revolucionare e Kosovës dhe e viseve të tjera shqiptare e di mirë se ne, për aq sa është çështje politike - bile e një politike diskriminuese që kufizohet me fashizmin e racizmin - niveli jashtëzakonisht i ulët i zhvillimit ekonomik të viseve shiptare, aq është politike edhe çështja e emigrimeve të sotme, që janë pasojë e drejtpërdrejtë dhe e domosdoshme e diskriminimit të tillë." ("Bashkëjetesa" e xhelatit me viktimën, Bashkimi, janar 1981, faqe 9)

7.

Jusuf Gërvalla: "Si gjithmonë, edhe sot, pararoja jonë revolucionare dhe mbarë populli ynë, me sy e me zemër jemi të drejtuar nga nëna Shqipëri dhe presim çastin që fatin tonë do ta lidhë sërish me fatin e saj, si një pjesë e pandashme, për tërësinë e së cilës është derdhur gjaku i bijve martirë të Shqipërisë ndër shekuj." (Lajmëtari i lirisë, tetor 1980, faqe 3)

8.

Jusuf Gërvalla: "Gjithë ata shqiptarë që - duke harruar demonstratat historike të vitit 1968 - ka harruar ç'është forca e masës së revoltuar, këto ditë pati rast të përkujtohet edhe njëherë, me demonstratat e futbolldashësve të Prishtinës, më 21 shtator.

Vendi dhe preteksti i tyre mund të jetë i pakuptim në dukje të parë: reagim për një padrejtësi sportive në fushën e futbollit. Por, duhet të jesh fare jashtë realitetit shoqëror kosovar, nëse çështjen e kufizon në këtë mënyrë. Edhe fizikisht, demonstratat kaluan jashtë fushës së sportit, u përhapën në rrugët e Prishtinës dhe zgjatën deri natën vonë. Vallë, një padrejtësi e thjeshtë sportive mund t'i shtynte qytetarët tanë që "tërbimin" e tyre ta derdhnin mbi çdo automjet, të madh a të vogël, që nuk kishte targë të Krahinës sonë?! A s'i përkujtojnë autobusët dhe veturat e përmbysura, demonstratat e 1968-ës?!

Ky dokument i gjallë i pakënaqësisë së masave, pos që i dha grusht qeverisë së Beogradit, duhet t'i bëjë të mendojnë pak më thellë edhe forcat tona revolucionare, sidomos pararojën e tyre: në qoftë se nuk evidentohet pakënaqësia e përgjithshme, në qoftë se ajo nuk shfrytëzohet në mënyrë të organizuar për qëllime revolucionare, atëherë s'do mend se pakënaqësia e tillë, si potencial që kërkon shkarkim të domosdoshëm, do të manifestohet patjetër në mënyrë spontane. Dhe dihet se në raste të, vendi dhe preteksti s'kanë si të jenë të qëlluar, domethënë në mënyrë vitale të nisin dhe të zhvillohen atje dhe ashtu si e do puna.

Ky shpërthim ndodhi në një kohë të përshtatshme, kur disa elemente të revolucionit tonë, të tërhequr nga ofensiva për shkak të presionit të madh policor e politik të pushtetit, kishin zënë të përqafonin aty-këtu edhe ide disfatiste e kapitulluese. Një pjesë e intelegjencës sonë donte të thoshte - natyrisht, jashtë ligjeve të dialektikës - sesi te populli ynë qenkan vërejtur edhe shenja përgjumjeje dhe mosgatishmërie për t'iu përgjigjur pararojës revolucionare. Ata e harrojnë traditën shekullore luftarake të popullit shqiptar dhe, nga hutesa e vet, bëjnë llogari të gabuara dhe veprime të rrezikshme: dyshojnë dhe përhapin dyshime lidhur me situatën reale te ne dhe me shpirtin luftarak të popullit tonë në këto çaste të vështira robërie e mjerimi.

Tani, jo me fjalë e me shtrydhje sterile të trurit që të shpie në udhë të pakrye, po me një vepër të shkëlqyer të manifestimit konkret të forcës së popullit, këto demonstrata na e tërheqin veshin qortueshëm dhe sikur na thonë fare qartë se kush ka të drejtë të dëshpërohet: inteligjenca me popullin, apo populli me inteligjencën? Pakënaqësia dhe revolti i shtresuar i masës në rrethana të caktuara historiko-shoqërore janë, pa dyshim, të barasvlershme me potencialin e pafrenuar të rrymës së rrëmbeshme të lumit. A do të derdhet kot ai potencial, apo do t'i lëvizë turbinat e revolucionit, varet nga djalëria pararojë, pjesë e pandashme e së cilës është inteligjenca popullore." (Lajmëtari i lirisë, tetor 1980, faqe 6)

9.

Jusuf Gërvalla: "Në sytë e fshatarësisë dhe të punëtorisë shqiptare, lufta e pararojës shqiptare të rezistencës kundër hegjemonizmit dhe shovinizmit serbomadh duhej të paraqitej si pavor diuurmius i disa individëve të papjekur, të cilëve u ka mbetur në fyt buka e bardhë titiste dhe prandaj kërkojnë pogaçe! Si do të nxirreshin ndryshe me dhunë nga populli ynë i robëruar (që, si thotë poeti, është afër sofrës po i pangrënë dhe afër dijes po i panxënë) deklarata sesi gjoja vetë populli e gjykon pikërisht brezin e vet që ndodhet në ballë të luftës?!" (Lajmëtari i lirisë, tetor 1980, faqe 10)

10.

Jusuf Gërvalla: "Në qoftë se vendet fqinje ballkanike kërkuan t'u ndaheshin tokat shqiptare si shpërblim për fitoren e tyre mbi Turqinë dhe në qoftë se kërkesën e tillë ta përligjën fuqitë e mëdha të kohës, kjo nuk ngjau aspak për shkak se populli shqiptar nuk kishte luftuar. Përkundrazi njerëz përparimtarë nga gjiri shovinistëve të Ballkanit, siç është socialdemokrati serb D. Tucoviq, e thoshin me gojë të vet se populli shqiptar kishte qenë pararoja dhe shtylla e luftës shekullore kundër Turqisë." (Lajmëtari i lirisë, janar 1980, faqe 2-3)

11.

Jusuf Gërvalla: "Pararoja e rinisë kosovare ju fton në luftë për çlirimin e tokave tona të shtrenjta nga kthetrat e kralëve të rinj revizionistë jugosllavë. Lufta e popullit tonë

për pavarësi nuk ka pushuar asnjëherë ndër shekuj. Populli ynë e rinia jonë heroike luftojnë e do të luftojnë deri në çlirimin e të gjitha territoreve nga shovinistët jugosllavë. Dhe për të ecur drejt kësaj rruge të shenjtë, sot duhet t'ia caktojmë vetes detyrat që kërkojnë prej nesh zgjidhje." (Lajmëtari i lirisë, janar 1981, faqe 4)

12.

Jusuf Gërvalla: "Ne nuk mund ta shtojmë numrin e shqiptarëve në Jugosllavi. Por, duke u nisur nga rëndësia që ka për ne ky regjistrim i popullsisë, pararoja jonë revolucionare e patriotike e fton popullin tonë që syçeltësinë më të madhe në regjistrime ta kuptojë si një domosdoshmëri patriotike. Rinia përparimtare thirret të jetë sa më mobile me propagandën dhe agjitacionin e drejtë në popull, në mënyrë që armikut t'i japim një grusht të fortë edhe në këtë drejtim, duke mos ia "falur" asnjë njeri. Një aktivitet jashtëzakonisht i gjallë propagandistik në këtë pikëpamje në mesin e shqiptarëve të shpërndarë nëpër republikat e Jugosllavisë – për ne duhet të jetë detyrë e posaçme dhe domosdoshmëri. (Lajmëtari i lirisë, janar 1981, faqe 9)

13.

Jusuf Gërvalla: "I shtyrë nga shtypja e egër ekonomike, politike, shoqërore e kombëtare nën thundrën e pushtetit gjakatar titist, populli shqiptar në Jugosllavi është ngritur i tëri në luftën e tij të drejt për bukë, liri dhe të drejta demokratike. Ai e pa të arsyeshme të kërkojë me këmbëngulje Republikën e federuar të shqiptarëve në Jugosllavi. Në themelet e kësaj kërkese të shtruar në rrugë paqësore, me fajin e qeverisë shoviniste të Beogradit, u vu gjaku i derdhur, plagët e shumta dhe torturat çnjerëzore që po i bëhen burgjeve e gjyqeve një rinie të tërë shqiptare. Sot për këtë kërkesë është hedhur në gjyqin e tërbuar fashist i tërë populli ynë liridashës, të cilin, në prezencën dhe nën kërcënimin e milicisë dhe të ushtrisë serbe, po e detyrojnë të "diferencohet" nga kërkesat e veta më vitale, të shtruara në pranverë nga ana e djalërisë patriotike, komuniste e revolucionare të Kosovës.

Aktet barbare, me të cilat udhëheqja serbomadhe po përpiqet ta shtypë me çdo kusht e me çdo mjet vullnetin dhe të drejtat e patjetërsueshme të popullit tonë heroik, rrezikojnë në mënyrën më flagrante çdo arsyeshmëri dhe çdo cak të bashkëjetesës normale të popullit tonë me popujt e Jugosllavisë në kushtet ekzistuese, i hedhin helm plagës së madhe të popullit tonë martir dhe nxisin – me përmasa të papara deri më tash – urrejtjen ndërnacionale mes shqiptarëve dhe popujve të Jugosllavisë.

Prandaj, në mbrojtje të vullnetit sa e sa herë të ndrydhur e të nëpërkëmbur të popullit shqiptar në Jugosllavi, ne - një pjesë e pararojës patriotike e komuniste të shqiptarëve të robëruar, që jemi organizuar në gji të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi – dalim para popullit tonë, para opinionit jugosllav dhe atij botëror me këto kërkesa minimale të parevokueshme:" (Zëri i Kosovës, i Jusuf Gërvallës, nëntor 1981, faqe 2)

14.

Jusuf Gërvalla: "Vërtet që, duke qenë radiotelevizioni dhe shtypi kosovar zëdhënës të politikës shoviniste që ndjek qeveria e Beogradit, Kosova ishte pa gojë. Por matanë kufirit, në Shqipërinë mëmë, vigjilon Partia e Punës, e cila e ngriti lart zërin e saj të fuqishëm në mbrojtje të popullit tonë të shumëvuajtur. Dhe zërin e saj populli ynë i robëruar përkëtej kufirit, e mori si zë të vetin dhe u bë me një gojë që flet shtruar e me

argumente të ngjeshura, sepse për bazë ka drejtësinë. Ndërkaq, me ato që bëri e po bën në fushën e betejës populli shqiptar në Jugosllavi, me vendosmërinë e tij për të mos kursyer sakrificat në realizimin e aspiratave të ligjshme, me trimërinë e tij të trashëguar përballë armiqve të egër e shumë më të mëdhenj, jo vetëm që mahniti botën, por u dha forca të pashtershme edhe revolucionarëve, komunistëve e patriotëve të tij pararojë." (Zëri i Jusuf Gërvallës, nëntor 1981, faqe 3)

15.

Jusuf Gërvalla: "Te kjo Shqipëri, pararoja patriotike e revolucionare e shqiptarëve me banim në Jugosllavi, gjeti jo vetëm Atdheun e vet të shenjtë, po edhe pishtarin më të denjë të ideve të luftës nacionalçlirimtare dhe të revolucionit.

Prandaj, përkundër robërisë e skamjes, torturave e kurbetit, që na i dha "peshqesh" titizmi, ne sot, më të fortë se asnjëherë në histori, po e ngrejmë së bashku këtë dolli, duke përgëzuar 28 Nëntorin 1912, ditën e Pavarësisë së parë, dhe 29 Nëntorin 1944, ditën e Pavarësisë së madhe të Atdheut tonë.

Lavdi marksizëm-leninizmit, idesë dhe realitetit të pamposhtur të pararojës së njerëzimit!" (Lajmëtari i lirisë, janar 1981, faqe 3)

(Tetor 2012)

==========

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit
01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013
13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013
16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013
18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: *"Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror*." (14 janar 1981)

Shënime për autorin

Xhafer Durmishi-Skenderi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi". Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

==========

XHAFER DURMISHI-SKENDERI Tetor 2012-Shkurt 2026